

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS

BOTIME TË VEÇANTA CLXI
SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË
LIBRI 57

IDRIZ AJETI

STUDIME PËR GJUHËN SHQIPE

Vepra të zgjedhura

Zgjedhi dhe përgatiti akademik Rexhep Ismajli

KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
SPECIAL EDITIONS CLXI
SECTION OF LINGUISTICS AND LITERATURE
BOOK 57

IDRIZ AJETI

ALBANIAN LANGUAGE STUDIES

Selected Works

Selected and prepared by academician Rexhep Ismajli

Approved for publication at the meeting of
the ASHAK Presidency
held on 18th January, 2017.

Editor: Academician Eqrem Basha,
Secretary of the Section of Linguistics and Literature.



AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS

BOTIME TË VEÇANTA CLXI
SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË
LIBRI 57

IDRIZ AJETI

STUDIME PËR GJUHËN SHQIPE

Vepra të zgjedhura

Zgjedhi dhe përgatiti akademik Rexhep Ismajli

U miratua për botim në mbledhjen e
Kryesisë së ASHAK-ut
mbajtur më 18 janar 2017.

Redaktor: Akademik Eqrem Basha,
Sekretar i Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë.

Copyright © ASHAK



Idriz Ajeti

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE	9
ZHVILLIMI HISTORIK I SË FOLMES GEGE TË ARBËNESHËVE TË ZARËS.....	19
PAMJE HISTORIKE E LIGJËRIMIT SHQIP TË GJAKOVËS NË FILLIM TË SHEKULLIT XIX	223
RRETH VEHBIJES SË TAHIR EFENDI BOSHNJAKUT.....	309
GJUHA E “DIVANIT” TË SHEH-MALIQIT	321
RRETH DISA VEÇORIVE TË TË FOLMEVE TË SHQIPTARËVE TË RRETHIT TË PRESHEVËS DHE TË BUJANOVCIT	361
HISTORIA E GJUHËS SHQIPE (Morfologjia historike).....	381
FORMIMI I FJALËVE DHE PASURIMI I GJUHËS SHQIPE.....	511
VËSHTRIM I SHKURTËR I PUNËS NË STUDIMET ETIMOLOGJIKE TË GJUHËS SHQIPE.....	541
ARRITJET KRYESORE TË STUDIMEVE ETIMOLOGJIKE TË SHQIPES	557
MBI DISA FJALË E SHPREHJE SHQIPE NË DIALEKTET E SLLAVËVE TË JUGUT.....	581
PËR GJALLËRIMIN E STUDIMEVE GJUHËSORE BALLKANIKE DHE PËR DISA HUAZIME SHQIPTARE NË TË FOLMET SERBOKROATE	595
SHQIPJA E VËSHTRUAR NGA ASPEKTI I STUDIMEVE BALLKANISTIKE	609
SHQIPJA DHE GJUHËT FQINJE.....	619
RRETH ZËVENDËSIMIT TË TOGUT BASHKËTINGËLLOR LATIN –CT NË GJUHËN SHQIPE.....	629
KONTRIBUT PËR STUDIMIN E ONOMASTIKËS MESJETARE NË TERRITORIN E MALIT TË ZI, BOSNËS E HERCEGOVINËS DHE TË KOSOVËS.....	633
RRETH DISA EMRAVE TOPIKË ME PREJARDHJE SHQIPTARE NË MAL TË ZI NË VËSHTRIM GJUHËSOR.....	649
ZHVILLIME PARALELE FONETIKE DHE NDIKIME TË NDËRSJELLA TË DIALEKTEVE SHQIPTARE DHE SERBE TË KOSOVËS	657
EMËRTIME GJEOGRAFIKE NË SHQIPEN DHE SERBOKROATISHTEN	665
MBI ORIGJINËN ILIRE TË GJUHËS SHQIPE.....	679

NJË FUSHATË FILLZEZË KUNDËR SHQIPTARËVE.....	689
AUTOKTONIA E SHQIPTARËVE NGA PIKËPAMJA LINGUISTIKO-HISTORIKE	693
MBI DISA PROBLEME TË FORMIMIT TË GJUHËS SHQIPE DHE PËRPJEKJET E KEQPËRDORIMIT TË REZULTATEVE SHKENCORE.....	701
TEKST I BOTUAR NË ENCIKLOPEDI NË JUGOSLLAVE.....	707
SHQIPTARËT E GJUHA E TYRE	715
PATOLOGJIA E NJË SIMETRIE.....	727
DISA MENDIME MBI SHKRIMET E DISA SHKENCËTARËVE NË SHTYP E NË PUBLICISTIKËN TONË MBI GJUHËN SHQIPE DHE KULTURËN SHQIPTARE....	735
VËREJTJET E PROFESORIT DHE PËRGJIGJET TONA.....	743
VROJTIME MBI FORMIMIN E POPULLIT SHQIPTAR DHE TË GJUHËS SË TIJ.....	747
RRUGA E FORMIMIT TË GJUHËS LETRARE SHQIPE	751
PËR NGRITJEN E KULTURËS GJUHËSORE	771
ÇËSHITJE TË GJUHËS LETRARE SHQIPE.....	793
TOSKËRISHTJA DHE BAZA DIALEKTORE E SHQIPES LETRARE.....	797

PARATHËNIE

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës dhe institucionet shkencore dhe kulturore të Kosovës, Universiteti i Prishtinës, Instituti Albanologjik i Prishtinës dhe mbarë opinioni shkencor në Kosovë e më gjerë sivjet shënojnë 100-vjetorin e lindjes së intelektualit dhe gjuhëtarit të shquar, albanologut akademik Idriz Ajeti.

Akademik Idriz Ajeti është një nga albanologët më të shquar të sh. XX dhe të fillimit të sh. XXI. Veprimtaria e tij intelektuale dhe studimore, arsimore dhe organizuese në fushën e shkencës dhe të dijeve, studimet e tij frymëgjata për gjuhën dhe veprimtaria e tij në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe të politikës rezistuese në Kosovë e bëjnë atë një nga personalitetet me rëndësi të jetës shkencore, intelektuale e publike ndër shqiptarët e Kosovës, të ish-Jugosllavisë dhe të tërë botës shqiptare. Idriz Ajeti është shquar po ashtu në studimet e raporteve të shqipes me gjuhët fqinje dhe me këtë edhe në studimet ballkanistike, duke e afirmuar veten dhe dijen tonë prtej suazave kombëtare. E gjithë veprimtaria e tij publike-shkencore e prej dijetari bie në një fazë dinamike të zhvillimeve kulturore e kombëtare të shqiptarëve të ish-Jugosllavisë, ndërsa ndihmesa e tij në këto zhvillime ka qenë gjithnjë e rëndësishme.

Prania e Idriz Ajetit në të gjitha zhvillimet shkencore-kulturore në këto 7 dekada ka qenë e dukshme dhe thelbësore. Puna e tij është shtrirë dhe në fushën e të drejtave të njeriut e në veprimtarinë shoqërore si *Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës* në periudha të vështira në fund të viteve '90, në *Delegacionin e Rambujesë*, etj.

Duke e vlerësuar lart veprën dhe veprimtarinë e tij shkencore, kulturore e qytetare, ASHAK ka vendosur që me këtë rast të botojë një vëllim jubilar me vepra të zgjedhura të Idriz Ajetit.

Idriz Ajeti i takon brezit të intelektualëve të Kosovës që me tërë veprën albanistike e tjetër, me tërë punën e tyre prej pedagogu, me gjithë veprimtarinë në udhëheqje të institucioneve të larta arsimore e shkencore,

me tërë prezantimin e tij të autoritetshëm në kongrese e simpoziume ndërkombëtare, të gjitha i ka mbështjellë me një ndjenjë të ngrohtë, njerëzisht të ndritshme për prosperitetin e popullit të vet.

Krijimtaria e tërësishme shkencore e Idriz Ajetit tregon se ai iu qas studimit të shqipes duke e kuptuar gjuhën në frymë të teorisë së Humboldt-it, që ajo “është emanacion specifik i shpirtit të popullit”. Iu qas, pra, me një dashuri e respekt të tillë, me kujdesin e veçantë që të mos lëndohej e që të mos e lëndonin as si të folme të një krahine, as si gjuhë kombëtare e letrare, as si kontinuitet që nga lashtësitë e saj të thella. E mund të thuhet se gjuha shqipe e pati Idriz Ajetin një ndër kujdestarët e dalluar të pastërtisë së saj, një ndër spikatësit e begatisë së saj. E do të jetë ky respekt që do t’i impononte të përdorte jo një metagjuhë shkencore të thatë e krejtësisht të ftohtë akademike, por një metagjuhë me frymëmarrje të lirë të gjuhës amnore, që u mor si model nga mjaft gjuhëtarë ndër ne. Me këtë ndjenjë janë të lidhura edhe shkrimet e tij për ndikimet e shqipes në fjalorin e gjuhëve sllave në kontakt, kontributi i tij në krijimin e gjuhës standarde gjithëkombëtare e për përsosjen së saj, si dhe me shkrimet udhëzuese për kulturën e gjuhës etj.

Në tezën e doktoratës “*Zhvillimi historik i së folmes geqe të shqiptarëve të Zarës së Dalmacisë*”, Idriz Ajeti trajtoi me kompetencë të lartë një temë që e kishin shtruar para tij gjuhëtarët famëmëdhenj Gustav Weigand-i e Carlo Tagliavini dhe, jo vetëm që nxori në shesh pasaktësisht dhe mangësitë e prezantimit të kësaj të folmeje dhe të mjaft përfundimeve e sqarimeve të tyre, por, duke i dhënë punimit të tij një strukturim dialektologjik historik krahasues, ai arriti të përcaktonte masën e evoluimit e të ndryshimit të kësaj të folmeje nga të folmet e Briskut e të Shestanit të Krajës. Punimi është vlerësuar nga W. Cimochowski më të drejtë si “monografi tepër interesant e me vlerë në dialektologjinë historike, një fushë që zakonisht është paraqitur tepër pak edhe në shumë gjuhë të tjera të hulumtuara më rrënjësisht...”. Ai ka thënë gjithashtu se “gjuhësia dhe dialektologjia i detyrojnë Ajetit mirënjohje të veçantë për të dhënat mbi të folmen e Krajës dhe vendosjen e pozitës së saj në kuadër të të folmeve fqinje të shqipes veriore”. Kjo mënyrë e trajtimit të materies dialektologjike i cakton një vend të veçantë Idriz Ajetit në dialektologjinë shqiptare të deritashme.

Në punimet e tij për shkrimet shqipe me alfabet arab, siç janë “*Veh-bija*” e Tahir Efendi Boshnjakut dhe “*Divani*” i Sheh Hilmi Maliqit, profesor Ajeti u mor me gjuhën e autorëve të tyre, duke përcaktuar ndryshimet që kishin pësuar të folmet përkatëse, e Gjakovës nga viti 1835 dhe e Rahovecit nga fillimi i shek. XX. Në këto studime bie në sy edhe puna filologjike me tekstet me alfabet arab. Ndërkaq ai do të realizonte dhe studime të tjera me interes për dialektologjinë aktuale, si për të folmet e Kosovës, për të folmen e Preshevës dhe Bujanovcit, etj.

Studimet e mëvona të Idriz Ajetit, si në fushën e dialektologjisë historike dhe moderne, ashtu dhe në fushën e historisë së gjuhës kanë ardhur duke u përdegezuar dhe thelluar njëherësh në aspektet e studimit të krahasuar të shqipes, sidomos me gjuhët fqinje dhe me gjuhët sllave, për çka ai na ka lënë një ndihmësë me vlerë. Posaçërisht me rëndësi janë studimet e tij për gjurmët gjuhësore e onomastike shqipe në hapësirat e Malit të Zi e të Hercegovinës, ashtu si ndikimet e ndërsjella të shqipes me gjuhët e dialektet sllave jugore. Në këtë gamë të gjerë interesimesh bien në sy vështrimet e tij etimologjike. Në fushën e brendshme të historisë së shqipes Idriz Ajeti ka lënë dhe gjurmë të tjera: ka hartuar një nga gramatikat e para historike të shqipes, ka shqyrtuar dhe studiuar çështje të ndryshme nga zhvillimet fonetike të gjuhës dhe është marrë me paraqitjen e rëndësishme dhe sistematike të albanologjisë shqiptare dhe të huaj para opinionit tonë.

Idriz Ajeti është albanologu që ka marrë pjesë si personalitet qendror në të gjitha veprimtaritë studimore dhe planifikuese për shqipen letrare/standarde që nga viti 1952 në Prishtinë, për të vazhduar me ndihmesat e tij po në Prishtinë më 1957, më 1964 dhe sidomos më 1968 në Konsultën Gjuhësore dhe më 1972 në Kongresin e Drejtshkrimit në Tiranë dhe në të gjitha rastet e ka dhënë ndihmësën e tij thelbësore. Ai njihet si një nga kampionët e gjallë të shqipes së përbashkët letrare/standarde në sh. XX dhe në fillim të sh. XXI.

Në fushëveprimtarinë e Idriz Ajetit shquan aktiviteti i tij arsimor dhe arsimues (profesor gjimnazi në Prishtinë, lektor dhe arsimtar i gjuhës shqipe në Katedrën e Albanologjisë në Beograd, themelues, profesor dhe shef i Degës së Gjuhës Shqipe në Prishtinë [1960], drejtues institucionesh (Dekan i Fakultetit të Filozofisë në Prishtinë, Rektor i Universitetit të

Prishtinës, anëtar i Akademisë që nga themelimi dhe Kryetar i saj në dy mandate). Një ndihmësë të veçantë ai e ka dhënë me themelimin dhe drejtimin shumëvjeçar të Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, që u bë vatër e kontakteve midis albanologëve nga gjithë bota përtej ndarjeve ideologjike e politike, të kohës së luftës së ftohtë e më vonë. Atij i bien merita të mëdha edhe për themelimin e revistave shkencore si *Gjurmime albanologjike* më 1962, e të tjera më vonë derin te *Studime* 1994.

Veprimtaria shkencore-hulumtuese e Idriz Ajetit është e gjerë dhe e larmishme, përfshin aspektet më të ndryshme të studimeve gjuhësore, për shqipen dhe për gjuhët e Ballkanit, gjithnjë të para nga pikëvështrimi i albanologut. Dialektologjia historike në të gjen njërin nga autoritetet e mëdha, ashtu si studimet për historinë e gjuhës, për prejardhjen e gjuhës dhe të popullit shqiptar dhe sidomos ato për shqipen letrare. Filologjia e teskteve shqipe me alfabet arab gjente tek Ajeti njohësin e thelluar, ashtu si në tërësi filologjia shqiptare.

Niveli i studimeve gjuhësore të Idriz Ajetit që nga fillimi u bë pikësynim i dëshirueshëm i gjuhëtarëve kosovarë që po formoheshin. Ky nivel ndikoi në mënyrë efektive që edhe ndër ne të bëheshin shpejt të paprueshme si shkencë improvizimet, nxitimet e dija e pamjaftueshme në trajtimin e temave gjuhësore, ndikoi të kuptohej ajo që ka shënuar Emil Benveniste-i se “të folurit është vërtet lëndë e vështirë” e se “analiza në studimin gjuhësor bëhet përmes rrugësh të vështira”.

Akademik Idriz Ajeti për gjuhëtarin e ri të Kosovës ishte ai kritiku i nevojshëm me të cilin komunikohet në mungesë gjatë procesit të krijimit, ai mentori i ashpër prej të cilit duhej marrë pëlqimi i heshtur se trajtimi i temës së zgjedhur është solid. Dhe akademik Idriz Ajeti u zgjodh me të drejtë si i tillë edhe për shkak se nuk u kursye të drejtonte, të udhëzonte e të ndihmonte ata që premtinin dhe për arsye se personalitetin e tij e ka hijeshuar gjithmonë gëzimi i sinqertë për veprën e sukseshme shkencore të tjetrit.

Në këtë vëllim ne përzgjedhëm thelbin e studimeve të Idriz Ajetit për dialektologjinë historike, studimet filologjike-historike, studime të veçanta për aspekte të ndryshme të historisë së gjuhës, përfshirë morfo-

logjinë historike, studime për prejardhjen e gjuhës dhe për fazat e hershme të saj, studime për etimologjitë, studime për gjuhën letrare, ashtu si dhe një numër diskutimesh dhe reagimesh publike në instanca të ndryshme në ish-Jugosllavi gjithnjë në mbrojtje të gjuhës shqipe, të historisë së saj dhe të të drejtave të shqiptarëve, për çka mori dhe kërcënimin me jetë. Në kohën e problematizimit shkencor e politik të çështjes së prejardhjes ilire të gjuhës shqipe dhe të popullit shqiptar dhe përgjithësisht të prejardhjes së gjuhës shqipe, të lashtësisë së saj në Jugosllavinë e pas vitit 1981, Idriz Ajeti kishte marrë guximin të reagoonte dhe në Kongresin e nëntë të Lidhjes Komuniste të Serbisë, të mbajtur në Beograd në vitin 1982, në të cilin merrte pjesë kishte bërë, siç thoshte vetë, “një paraqitje në lidhje me disa probleme të gjuhës letrare shqipe, me historinë e kësaj kombësie, mbi tekstet e botuara në Enciklopedinë Jugosllave, që bënin fjalë mbi tekstet e letërsisë dhe kulturën e shqiptarëve në Jugosllavi”. Pas disa ditësh ai kishte marrë letrën kërcënuese anonime të postuar nga Zagrebi me këtë përmbajtje:

“Sada imate posla sa nama. \ \ Vi ćete biti srećan čovek jedino u Albaniji \ \ U zemlji odakle ste i došli! \ \ Sutra je u pitanju \ \ A noć je duga i \ \ Za Vas i za Vaše najdraže!” (Tash keni punë me ne. \ \ Ju do të jeni njeri i lumtur vetëm në Shqipëri \ \ Vendi prej nga keni ardhur! \ \ Çështja është për nesër \ \ Ndërsa nata është e gjatë edhe \ \ për Ju edhe për më të dashurit Tuaj!)¹

Vepra shkencore përmban mundin e mundur të hulumtimeve dhe të kërkimeve, këmbënguljen shteruese të energjisë fizike e krijuese në një jetë të tërë. Për të gjitha këto akademik Idriz Ajeti pati shpërblimin më të madh e më të këndshëm që mund të pritet: në letrat e shqipes hyri në radhën e bijve të paharrueshëm të popullit të tij.

Idriz Ajeti lindi në Tupallë të Medvegjes më 27 janar 1917, mësoi në shkollë të ndryshme të kohës, ndër të cilat shquhet Medreseja e Mbretit në Shkup (1938). Studioi në Zagreb e në Itali, u diplomua në Beograd në Degën e gjuhëve romane më 1949. Në Beograd i vijoi studimet nën drejtimin e albanologut Henrik Barić. Idriz Ajeti u thellua në studimet e gjuhësisë krahasimtare, në romanistikë e sllavistikë, studioi me themel trashëgiminë albanistike ndërkombëtare, veprat klasike të G. Meyer-it, të H. Pedersen-it,

¹ Shih shënimin e botuar nga ai në I. Ajeti: Për të vërtetën shkencore, ASHAK 2007 dhe të rimarrë këtu më poshtë.

të N. Jokl-it, të H. Barić-it, etj; me zotërimin e gjuhëve sllave, romane e të gjermanishtes, me dije të sllavistikës, të romanistikës e të gjermanistikës, i hapi vetes fushë veprimi të gjerë hulumtuese brenda shqipes në historinë e saj, në degëzimet dialektore, dhe, në një kontekst më të gjerë ballkanistik e indoeuropian, në krahasimet dhe vështrimet etimologjike. Në mësimet në Shkup Idriz Ajeti kishte zotëruar fillimet e dijeve të filologjisë orientale.

Profesor i gjuhës dhe i letërsisë shqipe në Gjimnazin e Prishtinës, mësimdhënës në Seminarin e Albanologjisë në Beograd, doktor i shkencave filologjike më 1958 në Beograd, më 1960 Idriz Ajeti nisi karrierën e gjatë të veprimit universitar dhe shkencor në Kosovë, së pari si profesor i Historisë së gjuhës shqipe dhe i dialektologjisë në Katedrën e Gjuhës dhe të Letërsisë Shqipe në Fakultetin e Filozofisë të Prishtinës më 1960, për të vazhduar me botimin e revistës *Gjurmime albanologjike* më 1962. Pas vitit 1966 Idriz Ajeti dhe një grup arsimtarësh përbënin bërthamën e ekipit që hapësirën e mësimdhënies në gjuhën shqipe në universitet duhej ta pushtonte me shpejtësi, jo rrallë me gjoks e flijime. Më 1967 në Prishtinë u themelua Instituti Albanologjik me 5 punonjës me në krye Fehmi Aganin. Idriz Ajeti ishte një nga shtyllat kryesore të hulumtimit dhe të organizimit të punës. Aty u kalua revista *Gjurmime albanologjike*, u nis *Recherches albanologique* më 1984 me Idriz Ajetin kryeredaktor. Në fushën e botimeve Idriz Ajeti shquhet me punën në revistat e *Buletin i Punimeve të FF*, *Studia humanistica* dhe *Seminari*. Më 1994 Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës vendosi të botonte një revistë shkencore me profil të gjerë të shkencave shoqërore *Studime*; Idriz Ajeti dhe Gazmend Zajmi ishin ata që më kërkuan t'i hynim kësaj pune dhe ja që edhe në ato kushte, në bashkëpunim me Kryeredaktorin Ajeti, revista u bë.

Idriz Ajeti ishte në krye të shumë projekteve hulumtuese e shkencore me afat më të gjatë në kuadër të veprimtarisë shkencore të Institutit Albanologjik, të ASHAK më vonë, të Universitetit të Prishtinës dhe të institucioneve të tjera. Më 1972 në Fakultetin e Filozofisë Idriz Ajeti doli në krye të projektit të studimeve të shkallës së tretë në fushat e gjuhësisë dhe të letërsisë. Më 1974 ai ishte në krye të nismëtarëve për themelimin e Qendrës/ Seminarit Ndërkombëtar të Gjuhës, Letërsisë e Kulturës Shqiptare, ku mbledheshin studiues të njohur e të rinj nga mbarë bota. Seminari u

bë qendër me rëndësi për daljen e rezultateve të albanologjisë dhe të kulturës shqiptare jashtë, për afirmim të mëtejme të Kosovës e të botës shqiptare, dhe njëherësh rrugë për të sjellë përvoja, dije, informime e vlera nga bota në mesin tonë. Prishtina ishte bërë një nga qendrat e mëdha albanologjike. Idriz Ajetin e kishim në krye të këtij institucioni gati dy dekada.

Rreth dy dekada Idriz Ajeti qe Shef i Katedrës së Gjuhës dhe të Letërsisë Shqipe të Fakultetit të Filozofisë. Në vitet 1971-1973 Idriz Ajeti ishte Dekan i Fakultetit të Filozofisë, ndërsa në vitet 1973-1975 Rektor i Universitetit të Prishtinës. Në vitet 1980-1982 qe drejtor i Institutit Albanologjik të Prishtinës.

Më 1975 u themelua Shoqata e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, që më vonë do të shndërrohet në ASHAK. Idriz Ajeti u zgjodh ndër anëtarët e parë të saj. Ai shquhet në kuadër të veprimtarisë së Akademisë, në krye të së cilës ishte në vitet 1979-1981 dhe 1996-1999. Në vitet '90 Idriz Ajetin e gjejmë të angazhuar në Këshillin për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut në Prishtinë. Ndërsa në vitin 1998 Idriz Ajeti u zgjodh Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Një meritë me peshë e veprës së Idriz Ajetit, qëndron në shqipen e tij veçanërisht të bukur, të mbështetur në shprehjen autentike popullore, por të selitur dhe të zgjedhur.

Ne, studentët e Idriz Ajetit, mburremi që patëm fatin të mësonim nga një studiues kështu i rëndësishëm i disiplinave albanologjike, po dhe nga njeriu Idriz Ajeti, të cilin e shquajmë virtytet si maturaia, vendosmëria, afërsia, dashamirësia, solidariteti dhe atdhedashuria.

Në rastin e akademik Idriz Ajetit, siç ndodh me krijues veçanërisht të dalluar, mendimi i të tjerëve për vlerën e veprës së tij është krejt i afërt a identik me idenë që ka ai për veprën e vet. Kualitetet e trajtesave të tij shkencore kanë bërë që vepra e tij të radhitet ndër veprat e qëndrueshme të gjuhësisë shqiptare, të radhitet krahas veprave të pak gjuhëtarëve shqiptarë, krahas veprës së Aleksandër Xhuvanit, Mark La Pianës, Selman Rizës, Shaban Demirajt, Mahir Domit – të prira nga vepra e Eqrem Çabejt.

Rexhep Ismajli

Për figurën dhe veprimtarinë Idriz Ajetit është shkruar dhe vazhdon të shkruhet. Lidhur me këtë paraqitje mund të shihen edhe:

- BARDHI (1977), Mehdi – HALIMI, Mehmet: *Bibliografia e pu-nimeve shkencore dhe profesionale të prof. dr. Idriz Ajetit*, **Gjurmime albanologjike**, SSHF, Prishtinë, 19-25.
- BLAKU (1982), Murat: *Veprimtaria shkencore e akademik Idriz Aje-tit*, në AJETI, dr. Idriz: **Studime gjuhësore në fushë të shqipës I**, Rilindja, Prishtinë, 1982, 5-30.
- CIMOCHOWSKI (1968), Waclaw: *Idriz Ajeti, Istorijski razvitak ge-gjijskog govora Arbanasa kod Zadra*, Sarajevo, 1961, **Lingua Pos-naniensis**, t. XII/XIII, Posnanj, 176-184.
- ISMAJLI (1982), Rexhep: *Idriz Ajeti për historinë e gjuhës shqipe*, **Rilindja**, Prishtinë, 21.8.
- ISMAJLI (1986), Rexhep: *Idriz Ajeti, Studije iz istorije albanskog je-zika*, **Godišnjak knjiga XXIV**, Centar za balkanološka ispitivanja, knjiga 22, Sarajevo, 236-238.
- ISMAJLI (1987), Rexhep: **Artikuj mbi gjuhën shqipe**, Rilindja, Prishtinë, 239-245.
- ISMAJLI (1997), Rexhep: *Figura dhe vepra e akademik Idriz Ajetit*, **Studime 4/ 1997**, ASHAK, Prishtinë, ff. 17-34.
- QOSJA (1977), Rexhep – HALIMI, Mehmet: *Jeta dhe veprimtaria shkencore e prof. dr. Idriz Ajetit*, **Gjurmime albanologjike**, SSHF, Prishtinë, 11-17.
- RAKA (1996), Fadil: *Zhvillimi i gjuhësisë shqiptare në Kosovë*, **SEMINARI XVII**, Tiranë.
- Studime 4/1997*. Me rastin e 80-vjetorit të lindjes së Akademik Idriz Ajetit, ASHAK, Prishtinë, ff. 509.
- Studime 14/ 2007*. Me rastin e 90-vjetorit të lindjes së Akademik Idriz Ajetit, ASHAK, Prishtinë, ff. 273.

**ZHVILLIMI HISTORIK
I SË FOLMES GEGE
TË ARBËNESHËVE
TË ZARËS**

ZHVILLIMI HISTORIK I SË FOLMES GEGE TË ARBËNESHËVE TË ZARËS²

NË VEND TË PARATHËNIES

Studimi i të folmeve shqipe, siç dihet, është në fillim e sipër, prandaj ky për historinë e gjuhës shqipe është me dobi të madhe, pikërisht për mungesë të njohjes së dokumenteve të shkruara të vjetra dhe për burimet e tyre gjuhësore në përgjithësi.

Shi për këtë, profesori im i ndjerë Henrik Bariqi, që nga ditët e para të njohjes sonë, insistonte me ngulm që t'i rrekem studimit të së folmes së oazës së vogël të arbëneshëve të Zarës.

Për mua është kënaqësi e veçantë që, duke kujtuar mësuesin tim, Henrik Bariqin, ta falenderoj dhe t'i shpreh mirënjohjen edhe njëherë për ndihmën dhe këshillat e pakursyeshme që m'i dha gjatë hartimit të këtij punimi.

Gjatë kohës së kërkimeve të së folmes së arbëneshëve të Zarës, në dy ekspedita të mia, nga ana e arbëneshëve jam mirëpritur përzemërsisht, duke më ofruar ndihmë të pakursyeshme në këtë drejtim e duke pasur kujdes të veçantë ndaj meje. Ata bënin gara ndërmjet veti se cili prej tyre do të ofronte më shumë lëndë gjuhësore. Mund të dëshmoj se pjesa dërrmuese e arbëneshëve bëri çmos në ofrimin e materialit për gjuhën e tyre dhe për traditën gojore në përgjithësi.

Ndiej kënaqësi të veçantë që me këtë rast mund t'i falenderoj posaçërisht veteranët e arsimit Josip Vladoviq – Relën dhe kolegun e tij Budimir Peroviqin, të quajtur Miroa i Kikicës, të cilët me mirëpritje të veçantë ndaj meje. Ata bënin gara ndërmjet veti se cili prej tyre do të ofronte më shumë lëndë gjuhësore. Mund të dëshmoj se pjesa dërrmuese e arbëneshëve bëri çmos në ofrimin e materialit për gjuhën e tyre dhe për traditën gojore në përgjithësi.

² Përktheu nga serbokroatishtja: *Mehmet Halimi*.

Këta dy nuk kursyen muknd, që, në çdo moment, në saje të njohjes së shkëlqyeshme të gjuhës së vet amtare, të më ndihmojnë që lëndën gjuhësore të grumbulluar ta verifikoj në terren. Përzemërsisht i falënderoj një numër të madh informatorësh në Brisk e në Shestan, të cilët gjatë kohës së kërkimeve të mia në Krajën e Malit të Zi – truallin e arbëneshëve të Zarës, më dilnin vazhdimisht në ndihmë, duke më siguruar të dhëna dhe material për gjuhën e tyre amtare.

Edhe pse këtu nuk është vendi, por unë e ndiej për detyrë që publikisht t'i falënderoj referentët-anëtarë të komisionit në përbërje të Dr. Karl Oshtirit, profesor i Universitetit të Lublanës, Dr. Milan Budimirit, profesor i Universitetit të Beogradit, Dr. Milivoje Pavloviqit, profesor i Universitetit të Novi-Sadit dhe Glisha Elezoviqit, anëtar korrespondent i Akademisë Serbe të shkencave të Beogradit, para të cilëve mbrojta disertacionin e doktoratës, që tani po botohet nga Shoqata e Shkencave e Republikës Popullore të Bosnjës e Hercegovinës, - sepse ata në kohën kur çështja e Komisionit, që për vlerësimin e këtij punimi duhej të ngrihej u gjend në krizë të rëndë – morën përsipër të kryejnë një detyrë të rëndësishme për vështrimin dhe përfundimin e suksesshëm të saj.

Autori

ZHVILLIMI HISTORIK I SË FOLMES GEGE TË ARBËNESHËVE TË ZARËS

I. NJË VËSHTRIM MBI DIALEKTET SHQIPTARE

(Hyrje)

E folmja e arbëreshëve të Greqisë

1. Majeri në librin e vet të pestë *Albanische Studien* botoi më tepër se tetëdhjetë fabula të Ezopit, të cilat i kishte përkthyer në shqipe një shqiptar nga Porosi; pastaj edhe dhjetë tregime të shkurtra popullore, disa pjesë nga Ungjilli dhe disa këngë popullore lirike nga Porosi, nga Hidra dhe nga Athina. Arbëreshi Kupitoris përktheu në të folmen arbëreshe të Hidrës disa tregime, që i kishte mbledhur Hahni dhe De Rada; khs. Meyer, *Alb. Stud.*, II.

Kur është fjala për lëndën gjuhësore të së folmes së arbëreshëve të Greqisë, atëherë duhet të kihet parasysh fakti se atë lëndë nuk e ka eksploruar një njeri, por në këtë punë kishin marrë pjesë një numër i madh njerëzish. Përmbledhja e Reinholdit, pas vdekjes së pronarit, i mbeti në dispozicion Majerit, të cilën ai e shfrytëzoi mirë.

Majeri shfrytëzoi edhe glosarin (fatkeqësisht fragment) e njëfarë mjeku me emër Nerustos Beja nga Ramleja e Aleksandrisë, i cili, pas vdekjes së pronarit, gruaja e të ndjerit ia la në dispozicion Majerit.

Në lëndën gjuhësore të Majerit gjendet edhe një material i përmbledhjes së këngëve Bleta Shqiptare e arbëreshit Thimi Mitkos. Përveç kësaj, ka edhe lëndë gjuhësore të cilën Majeri e voli në vise të ndryshme të Greqisë, të banuara me shqiptarë.

2. Shikuar nga aspekti fonetik dhe morfologjik, e folmja shqipe e

shqiptarëve të Greqisë është mjaft arkaike: në të janë ruajtur trajta, të cilat, në të folmet toske dhe gege, që moti janë zhdukur. Po zëmë ngoje grupet e njohura konsonantike shumë të rëndësishme për historinë e gjuhës shqipe; e këto janë kl', gl', lg dhe ng. Duke përjashtuar disa të folme të shqiptarëve në Itali dhe Besarabi, dukuria e zënë ngoje, si në të folmet toske ashtu edhe në ato gege, me kohë ka perënduar: bil'a tosk, dhe geg. Bija; gl'uga tosk, gûha dhe geg. Gûha, gjuha e në Kosovë guha; kl'îša > kíša > kiša; kl'an > kán; kian. Diftongu uo, i cili merret arkaik në të folmet e arbëreshëve të Greqisë, ka përfunduar në ua. Aty-këtu edhe tek arbëreshët e Italisë dëgjohet edhe shkalla e parë uo. Ndër të folmet gege, duke përjashtuar të folmet e Krajës së Malit të Zi dhe pjesërisht edhe të folmen e arbëneshëve të Zarës, diftongu i zënë ngoje ka përfunduar në ua, ue me një reduktim të pjesërishtëm të vokalit palatal e.

2. Vokali ü këtu shqiptohet i: të dü > të di; nde mes ta tire (türe); ndrîsem (= ndrüşëm); frihem në vend frühem; khs. Me të folmen e Gjirokastrës, Visaret e Kombit, III, 48-49; për mirditishten, libri IV faqe 241.

Majeri bashkë me Reinholdin, dalluan natyrisht tre tipa të tingullit I, ndërsa Vajgandi (G. Weigand), tri dekada më vonë, nuk i shkoi ndoresh të dallojë tre tipat e tingullit I, por vetëm dy, në të vërtetë aq sa janë në gjuhën shqipe.

Për të folmen e arbëreshëve të Greqisë shkencëtari gjerman Gustaw Weigandi shkroi më se tri dekada më vonë një monografi të veçantë me titull *Das Albanische in Attika, Balkan-Archiv, II, 1926*, faqe 167-220.

Monografia ngërthen tekste prej faqes 169 deri 196; prej faqes 197 deri 203 autori merret me shqyrtimin e ndarjes së foljeve dhe me zgjedhimin e tyre; gjithsej në dy faqe ai shqyrton veçoritë dialektore të së folmes në fjalë; dhe në fund prej faqes 206 dhe 220 zë vend glosari.

Vajgandi arriti të shtjerë në dorë shënimet e Reinholdit në kohën e qëndrimit të tij në Greqi prej 1855-1857; (Khs. *Balkan Arhiv, II (1926)*, faqe 167. Autori i monografisë së lartpërmendur pati fat të mirë që u njoh me përfaqësuesin e british School of Archaeology, në Athinë, i cili në Atikë

kaloi nëntë vjet, e gjatë kësaj kohe mblodhi mjaft lëndë gjuhësore për të folmen e arbëreshëve në Koropi, në jug të Athinës, dhe të gjithë lëndën ia la në dispozicion Vajgandit.

Unë këtu do të shtroja çështjen e korrektësisë dhe të besnikërisë së materialit të shënuar, meqë dihet se e kanë mbledhur të tjerët, e jo autori i monografisë në fjalë.

Një mënyrë e këtillë e të shkruarit të monografive dialektologjike është shumë e guximshme, por edhe me mjaft përgjegjësi.

Para së gjithash, ne ende nuk kemi njëmonografi të përkryer për dialektin e shqiptarëve të Greqisë. Mendoj se në mbështetje të lëndës së eksploruar gjuhësore, kjo mund të shkruhej mirëpo, gjatë të shkruarit të saj për shkak të mundësisë së zhvillimit të mëtejme të proceseve fonetike, morfologjike dhe evoluimit të tërësishëm të dialektit në fjalë duhet të kihet parasysh që një monografi e tillë ndoshta nuk do të ishte e përshtatshme. Gjatë luftës së fundit dhe pas saj, popullsia shqiptare në këto troje është rralluar, është ndjekur, e ndoshta, duke ushtruar presion, edhe është shkombëtarizuar.³

Gjuha e një numri të vogël të popullsisë, e cila atje përjetoi sjellje të ashpra të policisë, domosdo që pësoi edhe ndryshime të mëdha, dhe unë shpesh dyshoj që kjo popullsi, nëse nuk është helenizuar plotësisht, me tiparet e veta ajo sot paraqet objektiv me interes të veçantë, që do të nxiste kureshtjen e shkencëtarit. Ai, megjithatë, do të ishte i rëndësishëm nga aspekti diakronik i gjuhës shqipe, dhe se gjatë studimit të historisë së kësaj gjuhe, siç dihet shkencëtari patjetër do t'i ketë parasysh, tiparet mjaft arkaike. E pa një punë të këtillë paraprake të studimit të të gjitha dialekteve dhe nëndialekteve shqipe në Shqipëri dhe jashtë saj, nuk mund të bëhet fjalë e as nuk mund të merret kurrfarë ndërmarrje sa i përket hartimit të ndonjë doracaku të gramatikës historike të gjuhës shqipe. Është e natyrshme që për një punë të këtillë janë të nevojshme edhe kushte të tjera, siç janë, për shembull, sigurimi i monografive gjuhësore të shkrimit të

³ *Actes agressifs du gouvernement monarcho-fasciste contre l'Albanie, 1947.*

klasikëve shqiptarë – Buzukut, Budit, Bardhit, Bogdanit në gegërishte nga njëra anë dhe të tjerëve në toskërishte nga ana tjetër. Pas kësaj, në mbështetje të përpunimit të gramatikës historike, do të mund të mendohej për gjuhën shqipe.

4. Duke u nisur në veri, në drejtim të Shqipërisë, atëherë ndeshim në krahinën e Çamërisë, e cila, në kohën e sundimit turk, ishte krejtësisht e banuar me popullsi shqiptare. Për këtë dialekt kemi një monografi të përkryer, të cilën e shkroi indoevropëisti dhe albanologu i shquar, shkencëtari i Kopenhagut – Holger Pedersen: *Albanesische Texte mit Glossar*, Leipzig, 1895. Pedersen pati fatin që më 1893 të qëndrojë në Korfuz plot gjashtë muaj. E dihet se në atë kohë në Korfuz jetonin një numër i konsiderueshëm shqiptarësh, prej të cilëve ai mblodhi lëndë të pasur gjuhësore. Një kohë të shkurtër qëndroi në fshatin Mursi në afërsi të Konispolit dhe fshatit Lëkursi te Saranda, me qëllim që ta vërtetonte materialin e shënuar.

Prej gjithsej tridhjetë e pesë tregimesh, sa kisht shënuar Pedersen, në monografinë e vet përfshin vetëm dymbëdhjetë sosh, pastaj edhe disa nga gjëegjëzat dhe disa këngë popullore etj. Pjesën tjetër të kësaj monografie e përbën glosari, prej faqes 105 deri në faqen 107.

Na është e njohur se dialektologjia shqiptare nuk ka monografi të përsosura. Shënimi i materilait gjuhësor kalimthi në udhëtim e sipër, me vështrime të shkurtra për tiparet e së folmes shqipe në fjalë, që e ndeshim te disa albanologë: Vajgandi, Lambertzi dhe të tjerë, - nuk mund të krahasohet me monografitë e plota dhe moderne italiane, madje as me monografitë dialektologjike të sllavëve të jugut. Njohja e gjuhës shqipe në gjendjen e atëhershme, si duke tishte më kryesore dhe më e ngutshme për shkencëtarët, të cilët në mungesë të burimeve të mjaftuara gjuhësore të vënin studimin krahasues të gjuhës, prandaj edhe shumë pak u është kushuar kujdes çështjeve filologjike të gjuhës shqipe dhe dialektologjisë së saj.

5. Sipas mendimit të albanologëve, monografia e Holger Pedersenit, paraqet një kthesë të madhe në studimet e dialektologjisë shqiptare, sepse ndër të tjera ai sjell metodë të re në studimet e gjuhës shqipe në përgjithësi. Në parathënien e vet të shkurtër, por të thukët, Pedersen arriti që të

spikasë tiparet më qenësore fonetike dhe morfologjike të çamërishtes.

Po përmendim disa nga tiparet më kryesore të së folmes së shqiptarëve të Çamërisë në fjalë:

Û-ja labiale në këtë të folme është subsituar në palatalen i: atire, tire në vend të trajtave atüre, türe; ki ndaj kü; ede te mbit në vend të mbüt; te me hañe sîn në vend të sün; baba it ndaj üt; tij për tÿj; pÿl për pÿl, nga lat. padülem. Në këtë dialekt në vend të ü shpesh ndeshim u labiale, për shembull kÿre, për kÿre, dalanduşe, skÿre, ndaj kÿre, dalanduşe, skÿre. Unë nuk mund të pohoj se në të vërtetë nuk ka shembuj të kalimit të ü në u, së paku sipas mendimit tonë, në të vërtetë nuk është rezultat i ndonjë ndryshimi të vokalit të caktuar, por në rastet e zëna ngoje u-ja është vokal që në krye të herës, që në disa të folme shqipe u alternua në ü. Këtë më së miri na e dëshmon analiza etimologjike e fjalëve të tilla. Të marrim për shembull fjalën kÿre, siç tregojnë fjalorët (e këtë çështje e di nga njohja ime personale) dhe të shohim se si në pjesën dërrmuese të të folmeve shqipe, toske dhe të një pjese të gegërishtes, ndeshim kÿre, e jo kÿre. Në të folmen shqipe të Krajës së Mlait të Zi, ashtu si edhe në të folmen arbëneshe, te fjalët e zëna ngoje ndeshim u, e jo ü; prandaj, është më se e bindshme se u-ja është e kryehershme dhe origjinale e jo ü. Etimologjia e fjalëve nuk është e njohur, por një pjesë e mirë e dialekteve flet në favor të u-së si tingull lmë i vjetër në këto fjalë. Këtë e dëshmojnë disa të folme mjaft arkaike shqipe, siç është dialekti i toskëve të Përmetit dhe të të rrethinës (khs.: Auguste Dozon, Manuel de la langue chkipe ou albanaise, Paris, 1879), - që sipas mendimit tonë është dialekti më i pastër i të folmeve toske. Në fjalorin e Dozonit (f. 41), shihet qartë: kÿrate. Dikush mund të shtrojë pyetjen se a nuk është ky rast njëri nga delabializimet e shpeshta të të folmeve toske, mos duhet ta konsiderojmë ndoshta rastin tonë të kalimit të ü-së labiale në u si duguri të shpeshtë të delabializimit në të folmet toske. Unë mendoj, se në këtë rast, për të cilën çështje bëmë fjalë edhe më parë, nuk kemi të bëjmë me dukurinë e zënë ngoje. Prania e tingullit u, e jo e tingullit ü në të folmet më arkaike toske dhe gege, dëshmon qartë për ekzistimin e vokalit të kryehershëm u e jo ü, në fjalët përkatëse.

Pedersen, në parathënien e vet, duke shqyrtuar vokalet në të folmen e Çamërisë, veçanërisht thekson se grupi en+konsonant në gjuhën shqipe është reflektuar në dy mënyrë: in, en; këng, king; išta, ešte nga ensti (shih Majer: Alb. Stud. III, f. 85; ġemb në të folmen e shqiptarëve të Greqisë – glimb); miš, por peš nga indoev. *pēns, indishtjra e vjetër pānsus, avest. pānsu, sllav. vj. peťь; khs. Pedersen, IF, V, 47. Duke analizuar në kritikën e vet të gjatë onografike⁴ lidhur me të folmen e dialektit të çamërishtes të Holger Pedersenit, Pekmezi (Archiv i Jagiqit, XXI f. 220) nuk pajtohet me mendimin e albanologut kopenhagas që alternimi i vokalit indoevropian e dhe grupi konsonantik ns-en, përkatësisht in, por edhe en, duke sjellë si dëshmi të vetën disa shembuj në të cilët vërtet en është një dukuri e re: tosk. kuvent (te Majeri kuvent); vende (te Kavaloti, Reinholdi me e, te Majeri, Pedersen vende); ndeń (te Mitkoja me e, Majeri me ε) tremp (Kaval, Mitko me ε etj.). Për të folmen e vendlindjes së vet Pekmezi pohon se en në fjalë të ngjashme është dominuese (Pekmezi, op. cit. 220).

Mendimin e Pekmezit të them sinqerisht nuk e kam kuptuar në tërësi: a thua me vërejtjet e veta ka dashur të tregojë se en është alternim indoevropian en+kons, apo, ndoshta ka menduar në faktin se sot në disa të folme toske ndeshim edhe shembuj të gjysmëvokalit ε të dalë nga reduktimi. Unë mendoj se nuk duhet humbur kohë lidhur me argumentimin se shembujt e zënë ngoje pa reduktim janë të vonë. Mjafton të veçojmë një ose dy nga ata shembuj ku ε etimologjikisht është e domosdoshme, siç janë pe-ri geg, pē-ni, që njeriut t'i bëhet e qartë se ε, gjatë zhvillimit të dialekteve shqiptare, kaloi në vokalin e plotë oral e. Mjafton t'u hidhet një shikim të folmeve toske që njeriu të bindet se sot në to ndeshim shembujt me ε të pazëshme dhe me e, që ka hukmbur pazëshmërinë e vet, siç ndodh, ndër të tjera, edhe me të folmet gege ku ndeshim denazalizimin e vokaleve në fjalët që po zëmë ngoje: pē-ni>pēni; frē-ni, por edhe frē-ni, nga lalt. Panus, frenum. Prandaj, nëse fjalët e këtilla me ε të domosdoshme etimologjike në të folmen e vendlindjes së Pekmezit, të

⁴ *Archiv für slavische, Philologie*, XXI (1899), f. 213-224.

cilat sot kryesisht janë me e të pastër orale, e kjo nuk do të thotë se kjo e në to është dukuri e sotme. Të liruarit e gjysmë vokalit nga reduktimi dhe denazalizimi në toskërishte, te gegët – është një dukuri e shpeshtë, e unë do të thosha, është një tendencë aktive e gjuhës shqipe në përgjithësi.

Te Pekmezi ndeshim shpesh vërejtje të pashprehura deri në fund dhe, më mirë të themi, të paformuluara mirë. Ai në një vend me të drejtë vërteton se *ε-së* së pazëshme toske, në gegërishte i përgjigjet e nazale, duke shkuar edhe më larg, ai sjell shembuj nga e folmja e Dibrës, duke u përpjekur ta dëshmojë mendimin e vet se *ε* e pazëshme në fjalët e toskërishtes i përgjigjet edhe o (tosk. *tende*, *dibranishtja tōnde*), në mbështetje të së cilës nxjerr përfundim se *ε-së* toske, në gegërishte i përgjigjen e, o. Unë e kam plotësisht të qartë se ç'donte të thoshte Pekmezi me te, mirëpo mendimi është dashur të sqarohet. Ja si qëndron puna: *ε-së* së pazëshme toske në gegërishte i përgjigjet e nazale dhe *ã* nazale, mirëpo meqë te vokalet e gjata (qofshin ato edhe nazale) te një pjesë e mirë e të folmeve gege mbizotëron tendenca e labializimit të *a-së*, Pekmezin, sipas gjithë kësaj e ka tërhequr në të vërtetë mu kjo tendencë dialektore e disa të folmeve shqipe: *ε* *ã* nazale; varianti që sjell Pekmezi sigurisht është i vonë. Unë me këtë nuk mendoj të kontestoj shembujt që ka sjellë Pekmezi për të folmen shqipe të Dibrës, apo të dyshoj në ta, por vetm dua të vë në pah rrethanat se kjo o dolil nga a nazale, si për këtë ky tipar dealektor është i vonë. Fundja, ajo përfshin një trevë të gjerë, në të vërtetë, ajo është e përhapur edhe në të folmen shqipe të Kosovës; khs. Bariq Arhiv, lib. I, vëll. 1=2, f. 54-66; pastaj Jokl, Vuks albanische Liedersammlung, f. 43, 45, 46; Kujunxhiçi, Arnautsko-sprski rečnik, f. 79-133; Kangë populore shqiptare të Kosovës-Metohis; Lambertz, Bericht uber meine linguistischen Studien in Albanien von Mitte Mai bis Ende August 1916, u Anzeiger der königlichen Akademie der Wissenschaften in Wien, ph. Hist. Klasse, 1916) nr. XX, f. 122-146; F. Fishta, Hylli i dritës, XIV, 9, 1938, f. 169; S. Mladenov, Balkan-Archiv, I, f. 48, 55, 57, 60; Elezović, Arhiv, II, f. 243, 244; Skok, Lingvistička proučavanja, f. 215; Pekmezi, Grammatik der albanesischen Sprache, f. 6, paragr. 8.

6. Sa i përket konsonantizmit, Pedersenit kryesisht u përqendrua në shpjegimin e tipave të tingullit l të së folmes të cilën e përshkroi, duke e shqyrtuar atë edhe në të folmet shqipe në tërësi. Ai në çamërishte ndeshi në dy tipa të tingullit në fjalë: l të fortë dhe l' të butë (ai e shënoi me l). Tingullit l Pedersenit i kushtoi një studim të veçantë *Die L-Laute im Albanesischen*, KZ, XXXIII, 235-251. Këtu ai tregoi se në shqipe sipas origjinës, ka tre tipa të tingullit l. Këtu duhet pasur parasysh se l' e butë e heq zanafillën prej dy burimesh të ndryshme. Ndërkaq Pekmezi ia zë për të madhe Pedersenit se ai vërteton se në gjuhën shqipe, sipas të gjitha gjasave, ekzistojnë dy tipa të tingullit l, ndërsa ai angazhohet me përkushtim për tre tipa të tingullit l; khs. *Archiv für slavische Philologie*, XXI, 218-220.

7. Në të folmen e Çamërisë janë ruajtur grupet konsonantike kl', gl'; si duket kjo është pika më veriore e të folmeve toske ku mund të gjenden shembuj të ruajtjes së grupeve 3; madje në veri të kësaj pike ndeshim në palatalizimin e tyre: gl'uha, gl'uni, kl'an, gl'ate > gúha, gúni, kán, kúan, gáte etj. g⁵.

Deri në shekullin XVII për të folmet geqe kemi dokumente ku dëshmohet ruajtja e grupeve të përmendura konsonantike. Për shekullin XVI ekzistimin e tyre e dëshmon shkrimtari shqiptar Buzuku (1555). Për shekullin XVII praninë e tyre në të folmen e Mirditës e tregojnë disa nga objektet toponomastike: *Santa Grux ad flumen Glomisichia* (1638).

8. Kjo e folme konsonantet k, g përpara i, n, m i kthen në i; mijte (=mikta) – fijts (=fikts); plejts (=plekts); zojte (=zoqta); vdijna (vdična); u përpojne; (=u përpočne); mijte (=mikte); Pedersenit, *Albanische Texte*, f. 7. Kjo dukuri fonetike është e njohur edhe në të folmet e tjera të gjuhës shqipe: zojta e ndeshim edhe te Buzuku; khs. *Antologji e letërsisë shqipe*, Prishtinë, 1954, f. 22, 24, e këtë e ndeshim edhe në të folmet e sotme shqipe.

9. As Glosari nuk kemi ç't'i bëjmë vërejtje; në të kryesisht është

⁵ Duke kaluar kufirin e caktuar, grupi i përmendur, konsonantik dëgjohet aty-këtu te Korça (Dardhë, Sinisa; khs. E Çabej, *Buletin për Shkencat shoqërore*, 1955/2.

përfshirë frazeologjia, për të cilën thuhet se është shpirti i një glosari apo fjalori. Në këtë glosar Pederseni, aty-këtu, fjalëve të shpjeguara u qaset nga aspekti historik, duke përcaktuar prejardhjen e tyre. Kështu, për shembull, për fjalën e shpjeguar *kuḗ*, *kuḗ*; Pedersen, o.c. 145.

10. Kuantitetin e vokaleve Pederseni nuk e ka shënuar, me siguri për arsye se ky në dialektin toskë nuk paraqet ndonjë problem; ky dialekt ka vetëm gjatësinë e shkurtër dhe të mesme, por kjo nuk do të thotë se gjatësia e gjatë krejtësisht ka perënduar në të folmet toske, sepse këtë e shohim qartë në shkrimet e italo-arbëreshit-Matrëngës; ai e shënoi gjatësinë duke i dyfishuar vokalet, siç duket kjo ishte bërë shprehi edhe te shkrimtarët e tjerë shqiptarë të kohës së tij: Buzukut, Budit, Bardhit dhe Bogdanit.

Pederseni⁶ hetoi në këtë të folme të shqiptarëve të Çamërisë tiparin me interes fonetik, në të vërtetë n labiale, përkatësisht r: khs. Pederseni, o. c., f. 8-9, dhe Pekmezi, Grammatik der albanesischen Sprache, paragr. 13, H. Bariqi Lingvističke studije, f. 45. Në bazë të këtyre tipareve të gjuhës shqipe, së pari Jokli, e pastaj edhe Bariqi treguan se nga trajta e vjetër Barbanna doli emërtimi i sotëm Buene, Bune. Trajta serbokroate Bojana, siç treguan Jokli dhe Bariqi, duhet të ketë dalë nga trajta shqipe Bauana; khs. Jokl, Indogermanische Forschungen, 49, 50; Barić, Slavistična revija, f. 356-359, dhe Lingvističke studije, f. 45.

Nëse duam të bëjmë vlerësimin e monografisë së Pedersenit për të folmen e Çamërisë, atëherë duhet pa tjetër të pranojmë se deri më tani ajo është punimi më i mirë në dialektologjinë shqiptare. Këtu ai ofroi aq lëndë të pasur gjuhësore, saqë, nëse dikush do të dëshironte të hyjë në thellësi të studimit të kësaj të folmeje, do të ketë material me burim të pashtershëm. Unë mendoj se në të, lënda gjuhësore është mbledhur në mënyrën më besnike për të folmen në fjalë, për të cilën pak lëndë gjuhësore ndeshim edhe në Visaret e Kombit, vëll. IV, e cila duhet shfrytëzuar me kujdes të veçantë për shkak të pasaktësisë së saj.

11. Për të folmen e Përmetit dhe të rrethinës para më se shtatëdhje-

⁶ Holger Pedersen, *Albanesische Texte mit Glosar*, f. 8-9.

të vjetësh konsulli i atëhershëm në Janinë (Auguste Dozoni), mbloodhi lëndë të bollshme gjuhësore dhe e publikoi në veprën *Manuel de la langue chkiye ou albanaise*, Paris, 1879. Vepra ndërthen njëzet e katër tregime, këngë popullore; një pjesë e mirë e tekstit i është kushtuar gramatikës, prej faqes 177_336; pjesën e tretë të veprës në fjalë e përbën fjalori (1-104).

12. Nëse do të provonim të tërhiqim një paralele ndërmjet dialektit të shqiptarëve të Çamërisë dhe të atyre të Shqipërisë jugore, do të thotë të Përmetit dhe të trevave përreth, - atëherë do të na bjerë në sy që ky i fundit, d.m.th. gjuha e Permetit, në krahasim me tiparet arkaike të së folmes së Çamërisë, ka evoluar në shumë pika, kështu që në të nuk ndeshim më grupet konsonantike kl',gl', por ndeshim asimilimin e tyre: k', g', për shembull i gátε në vend të i glátε në çamërishte; guri (gjuni) përballë trajtës gluri të çamërishtes: guha përballë trajtës gluha. Në shembullin e fundit është kryer edhe jotizimi i tipit I të cilin në çamërishte edhe sot e ndeshim të paprekur: goja përball gola të çamërishtes; bija përballë trajtës çame bila.

13. Në vend të palatalit i, dialekti i Përmetit ka labialen burimore ü, për shembull: kü, e jo ki; mbüt, e jo mbit; mbüt, e jo mbit.

14. Sipas mendimit tim, ky dialekt përfaqëson të folmen më të pasur popullore toske, që ndoshta nuk dallohet aspak nga dialekti letrar toskë. Mund të thuhet se letrarishtja toske gjithnjë e më tepër po largohet nga përdorimi i tepruar i së pazaëshmes ε, me të cilën është e stërm bushur e folmja e shqiptarëve të Përmetit dhe letrarishtja toske, - që mund të thuhet se po favorizohet edhe si gjuhë zyrtare shtetërore, ngadalë po lirohet nga përdorimi i tepërt i ε-së së pazëshme, jo vetëm në fund të fjalës, do të thotë atje ku ajo nuk është e theksuar, por në të shumtën e rasteve ajo shkruhet, shpesh edhe shqiptohet nga ndikimi i theksit si e orale, si për shembull në fjalët vent – vëndi, kuvent – kuvëndi, të cilat sot rëndom shkruhen: vent – vëndi, kuvent – kuvëndi; kështu edhe: pε-pεri – sot pe-peri. Në këtë drejtim edhe grafia gege ka ndryshuar; edhe atje nuk shënohen më shenjat e nazalitetit.

15. Vokalizmi këtu nuk paraqet kurrfarë problemi, do të thotë se në evoluimin e tij nuk ka risi qenësore, ashtu siç ndodh edhe me të gjitha të

folmet toske, të cilat në krahasim me të folmet gege, struktura fonetike dhe morfologjike e së cilës për një kohë relativisht të shkurtër është ndryshuar dukshëm, - në raste të shumta është mjaft konservative. Duke pasur parasysh këtë fakt, ne këtu nuk do të ndalemi.

16. Kur është fjala për konsonantet, po theksojmë se Dozoni, i cili sikur nuk besonte se ekziston tipi i mesëm i tingullit l evropian, në këtë folme ai hetoi dy tipa të tingullit l, khs. Dozon, o. c., f. 181. Ndërkaq, edhe ai vetë pranon se nuk është i sigurt se ky tingull absolutisht nuk ekziston. Arsyeja për këtë duhet kërkuar, siç thotë edhe ai vetë, në faktin se ai shumë vështirë dalloj tipat e këtij tingulli, për këtë gjatë shënimit që i shtrënguar që për kualitetin e tingullit l t'i drejtohet informatorit të vet kurdoherë që duhej ta shkruante këtë. Dozoni pranon se nuk mund t'i dallojë as tingujt r, r̄; Dozon, o.c., f. 181.

17. Kur është fjala për vokalet në përgjithësi, vlen të theksojmë se lirimi nga pazëshmëria në disa raste është dukuri që duhet pasur parasysh në këtë dialekt, e kjo do të thotë se fjalët të cilat në çamërishte kanë ε të pazëshme, në dialektin e Përmetit janë liruar nga pazëshmëria. Si dëshmi për këtë po sjell disa shembuj: *ken*, çam. *ken*, shkodr. *Ćen*, geg. jug. *ken*, nga lat. *canis*; *përballë e ema ndeshim* edhe *e ema, emere-i*; te Majeri *emēn*, çam. *emēr*; *përmet. ndeń*, aor, *ndeita*, *përballë ndeńta, ndeńa*, çam. *ndeĵ, ndejm, ndejti* (Pedersen, o.c., 57, 6); *përmet.ńera*, çam. *ńeri, ńera*, mirëpo dat. *ńeit*; ja *dane neit zabitit* (f. 89 a), *ńeit kruşkari* (89 b), *ńeit çifutit* (27 b), *ńe vajz e ńeit mbretit*. Nga shembujt e mësipërm shihet qartë një gjë: se lirimi nga vokali i pazëshëm në përmetishte dhe çamërishte është dukuri e vonë, gjë të cilën e dëshmon edhe shembulli *ńeit*, etj.

Unë në këta shembuj dhe në dukurinë e pazëshmërisë e zhdukjes së saj, jam ndalur pak më gjatë, sepse dukurinë në fjalë për shpjegimin e nazalitetit të folmes gege e kam konsideruar me rëndësi të veçantë, çështje kjo që në kapitujt e gramatikës historike të gjuhës shqipe paraqet një kapitinë të ndërlikuar. Natyrisht që ndriçimi i kësaj dukurie nuk është i mundshëm vetëm në saje të varianteve dialektore, por patjetër duhet marrë parasysh edhe prejardhja e çdo rasti të reduktimit të vokaleve toske, nga

njëra anë, dhe nazalizmi i të folmeve gege, nga ana tjetër. Vetëm një metodë kësisoj e studimit të kësaj çështjeje mund të na japë rezultate të sigurta.

18. Për trevat e tjera të dialektit toskë⁷ nuk kemi kurrëfarë materiali të sigurt e as ndonjë monografi. Nuk do të dija të them se deri në ç'masë njeriu mund të mbështetej në veprat e Naimit dhe të Sami Frashërit që, në bazë të shkrimeve të tyre, do të provonte të shkruajë monografinë gjuhësore për të folmen e vendlindjes së tyre.

Kësaj periudhe i takojnë edhe përkthimet e Kristoforidhit elbasanas, mirëpo duke pasur parasysh se përkthimet e tij janë nga librat e shenjtë që kishin karakter praktik, ndaj ai u përpoq për formimin e një gjuhe letrare të përbashkët për të gjithë pjestarët e dialektit gegë, duke i bashkuar të gjitha të folmet gege, ndaj është krejtësisht e natyrshme që përkthimet e tij nuk i përkisnin së folmes së elbasanishtes së pastërt, por ato ishin një përzjerje duke synuar një zgjidhje kompromisi të kësaj çështjeje.

Në vështrimin tonë që u bëmë dialekteve shqiptare mendojmë që me këtë të përfundojmë panoramën e të folmeve toske, folësit e të cilave jetojnë brenda kufijve shtetërorë të Shqipërisë dhe tani të ndjekim të folmet toske në emigrim, duke shpresuar se ato në Shqipëri i kemi paraqitur në pikat qenësore.

19. Hulumtimet e të folmeve të diasporeve toske do t'i filloja me të folmen e shqiptarëve të Ukrainës. Të dhënat historike për braktisjen e atdheut të tyre janë mjaft të varfëra dhe të zbehta.

Thuhet se shqiptarët e viseve të Shqipërisë lindore filluan që moti ta lëshojnë gjirin e vendlindjes së vet dhe të kërkojnë strehim në vendet e krishtera të Bullgarisë, Rumanisë, Rusisë – duke filluar që nga shekulli pesëmbëdhjetë e deri në shekullin nëntëmbëdhjetë; khs.: D. Jaranov, *Preselničesko dviženie na Bъlgari ot Makedonia i Albania, към istočnite Bъlgarski zemii prez XV do XIX vek, Makedonski pregled, VII, v. 1 1931*), f. 63-118.

⁷ Instituti shkencor në Tiranë, pas luftës ndërmori studimet e të folmeve shqipe brenda kufijve shtetërorë të Shqipërisë, *Buletin për shkencat shoqërore, 1955/2*, f. 210.

Konsiderohet se shqiptarët nga Korça, Ohri, Elbasani, Çermenika, Gollobërda, Dibra dhe Mati, në fillim të shekullit pesëmbëdhjetë, shkruan në Maqedoni, Traki, Dobrugjë në punë sezonale, dhe me kryerje e këtyre punëve, në vjeshtë, ktheheshin në shtëpitë e veta; khs.: Pierre Belon du Mans Les observations, - Pari, 1555, Buletin për shkencat shoqërore, Tiranë, 1955/II, f. 164; Shqiptarët si “argatë” shkonin gjithkund nëpër qytetet e perandorisë turke, ndaj nuk është çudi se disa prej tyre u ndalën edhe më gjatë, e ndoshta edhe u vendosën atje përgjithmonë.

Shqiptarët e Ukrainës, para se të vendoseshin në Rusi, sipas rastit e nevojës, u vendosën dhe banuan në Bullgarinë Veriore, në afërsi të Varnës. Ndërsa pas luftërave ruso-turke (1806-1812, 1828-1829) me qëllim që t’u iknin represaljeve turke, filluan ta lëshojnë Bullgarinë, duke ikur më në veri, në Besarabi.

Pas Luftës së Krimesë kjo popullsi shqiptare shkoi edhe më tej në veri, në Rusi, në Ukrainë, dhe atje u vendosën duke formuar vendbanime të vogla, ku jetojnë edhe sot.

Akademiku Derzhavin më 1925 vizitoi shqiptarët e Ukrainës, dhe rezultatet e kërkimeve të veta i publikoi në Sborniku-n e Miletiqit, 1933, f. 504-512; e më vonë më 1948, Derzhavini iu rikthye atyre kërkimeve edhe në revistën Sovetskaja Etnografija, nr. 3 në artikullin Shqiptarët e Prijaovnës në Ukrainë, Republikën Sovjetike (mjerisht unë nuk arrita t’i kem në dorë këto studime, por i kam cituar sipas Tagliavinit, Le terre albanesi redente, I Kossovo, f. 7; dhe sipas revistës Buletin për shkencat shoqërore, 1955/2, dhe nga studimi i shkurtër Material gjuhësor nga Kolonitë shqiptare të Ukrainës, f. 163-180). Autor i studimit të shkurtër të zënë ngoje ishte Islami, bashkë me etnografen J. V. Ivanova, që më 1949 vizitoi vendbanimin shqiptar në Ukrainë dhe me këtë rast mblodhi pak lëndë gjuhësore, e cila, për çdo rast, ishte një mirësearchje për studiuesit e dialektologjisë shqiptare.*

* Në Buletinin Ученія записки – Институтъ славяноведения, том XIII 1956, f. 254-287 pak material dialektologjik për të folmen shqipe të Ukrainës, sjell N. V. Kotova.

20. Po sjellim këtu tiparet themelore të dialektit të shqiptarëve të Ukrainës:

1) Ruajtja e grupeve konsonantike kl'; kl'umešt, kl'ań, kl'se, gl'išt, gl'u, gl'ate, gl'im, si dhe: val', femil'ε, gol'ε, bil'ε. Këto grupe sot ruhen në dialektin e çamërishtes, në disa të folme të italo-shqiptarëve, sporadikisht edhe në të folmen shqipe të Korçës (Dardhës dhe Sinicës).

Kur këto të dhëna të kihen parasys, atëherë na del i saktë mendimi i Islamit se shqiptarët e Ukrainës së sotme kanë prejardhje nga rrethina e Korçës, - o.c., f. 165, - të cilët vendlindjen e tyre, sipas pohimit të tij, e lëshuan kah fundi i shekullit gjashtëmbëdhjetë dhe në fillim të shekullit shtatëmbëdhjetë.

2) Monoftongimi i diftongut ua, ie, ue, në u, i, ü, si p.sh. du në vend të dua, muj në vend të muaj; dur në vend të duar; gru në vend grua; dił, mił, krü, dür, püs në vend të diel, miel, krüe, düer, pües. Monografimi kështë kryer edhe atje ku diftongu ka sosur në je, p.sh. viher, në vend të dhjetε; tīre në vend tīera. Unë mendoj se ky monoftongim është kryer në truallin e ri dhe se nuk ka asgjë të përbashkët me dukurinë e të folmeve italo-shqiptare, dua të them, se ato u krijuan pavarësisht njëra nga tjetra; khs.: M. Lambertz, *Italo-albanesische Dialektstudien*, KZ, 51, 53.

3) Përdorimi i admirativit për të treguar veprimin në të kaluarën, p.sh.: paska ńε djal'ε; rojtkan prost, nuk paskan buke te hańε, i 6enka babo e6e dü kopejka djal'it te veje te blere buke te hańε. Djal'i vatka i bleka ne djarp; khs. B. shk. shoq; 1955/2, f. 169.

4) Dialekti në thelb është toskë, me një numër të vogël trajtash të gegërishtes.

5) Jostabiliteti i ʘ-së labiale nistore, si në fjalët: kur t'εje=is veje; t'eme=te veme; do t'ine=do te vine; ocker-vocker.

6) Përdorimi i trajtave arkaike: japene, püsen kositen, me 6emben në vend të trajtave të sotme: japin, püesin, kositin, me 6embin. Trajtat e para janë më të vjetra sepse i ndehsim edhe në shkrimet e shkrimtarëve të vjetër shqiptarë.

21. Islami thekson disa tipare, “gege” të të folmeve të shqiptarëve ukrainas, siç është përdorimi i fjalës küiř (që, sipas autorit të vështrimit në fjalë në B.Shk. shoq. është karakteristikë e elbasanishtes dhe e së folmes së rrethinës së Korçës – Vithkuqit, Gorës, Oparit, pastaj mšesa, řpija, djarpi, jet=mbet etj., dhe kjo është mjaft e bindshme për lokalizimin e truallit të atyre shqiptarëve ta kërkojë në zonën kalimtare të dialektit toskë dhe gegë, për afërsisht në viset ndërmjet Polisit, afër Elbasanit, dhe Pogradecit, afër liqenit të Ohrit. Dëshminë për mendimin e vet Islami e gjen në të folmen e shqiptarëve të Ukrainës, ku kryesisht, janë kryer reduktimet e diftongjeve, që ai i identifikoi me dukurinë e së folmes së Elbasanit, ku monoftongimi i diftongjeve është njëra ndër tiparet e saj; o.c., 167. Duhet pranuar se sot (do të ishte tepër e guximshme) është mjaft vështirë të japim gjykim të prerë për të, të saktësohet lokalizimi i truallit të shqiptarëve ukrainas, aq më tepër kur dihet se dialektet në Shqipëri janë hulumtuar shumë pak; mirëpo, nga ana tjetër, duhet pranuar së fundi për guximin të përcaktosh prejardhjen e një dialekti në emigrim në mbështetje të dy-tri fjalëve, siç është rasti me Islamin, i cili në të folmen toske të shqiptarëve ukrainas “gjeti” disa trajta gege.

Unë mendoj se thjeshtimi i diftongjeve në këtë të folme duhet konsideruar si dukuri që evoluon në truallin e ri të të ikurve shqiptarë. Fjala küř, siç thekson edhe vetë Islami, është sjellë nga trualli i vjetër, e kjo nga rrethina e Korçës, (o.c., 167), që do të thotë se kjo fjalë nuk është vetëm e gegërishtes, por është edhe e toskërishtes.

Ne nuk do të ndalemi te të folmet shqipe të emigrantëve shqiptarë për të cilat nuk kemi material autentik gjuhësor, siç është e folmja e shqiptarëve të shpërndarë nëpër bullgari, khs. Jaranov, Preselničesko bŭlgari ot Makedonia i Albania към istočnite bŭlgarski zemii XV-XIX vek. Maked. Pregled vëll. VII, 1932, 63-118.

Meqë e shqyrtoam çështjen e të folmeve toske të shqiptarëve të diasporave dhe të dialekteve periferike, si dhe atyre brenda Shqipërisë, do të merremi edhe me çështjen e dialekteve të tjera shqiptare me dialektin gegë përbrenda kufijve të Shqipërisë dhe jashtë saj, aq sa për këtë na

mundësojnë kushtet për një vështrim përmbledhës.

22. Kur bëhet fjalë për shtrirjen e dialektit toskë dhe gegë, atëherë kryesisht si ndarje në mes tyre merret lumi Shkumbin afër Elbasanit, mirëpo thuhet, se dialekti gegë shtrihet edhe përtej këtij kufiri, sepse popullsia përtej lumit të përmendur flasin një të folme që në thelb i përngjet më tepër gegërishtes. Mirëpo kjo ndarje ndërmjet toskërishtes dhe gegërishtes është në vija të trasha; këtë do ta fiksojë saktësisht vetëm atlas linguistik i të folmeve shqipe, për të cilin ende nuk ka ndonjë punë përgatitore paraprake.

23. Meqë dihet se lumi Shkumbini afër Elbasanit përfaqëson pikën më jugore të gegërishtes, atëherë shqyrtimin e të folmeve gege po e fillojmë me elbasanishten. Si dokumente më të vjetra gjuhësore të së folmes së Elbasanit mendoj se konsiderohen shkrimet e mësuesit Dhaskal Todhtir nga shekulli XVII. Është e pakontestueshme se në shkrimet e përmendura mund të mbështetemi vetëm pjesërisht. Ndërsa për shekullin XIX mund të mbështetemi në përkthimet e Konstantin Kristoforidhit, gjuha e të cilit duhet shqyrtuar me kujdes, sepse ai, siç kemi theksuar edhe më parë, nuk mund të merret si burim i sigurt për studimin e së folmes së Elbasanit; sepse Kristoforidhi, duke synuar për një njësim të të gjitha të folmeve në një gjuhë letrare gege, për të mori trajta nga të gjitha nëndialektet gege. Prandaj, gjuha e përkthimeve dhe e shkrimeve të tij në asnjë rast nuk mund të jetë pasqyrë besnike e së folmes së Elbasanit, por rezultat i një përzierjeje të të folmeve gege dhe trajtave të shkrimtarëve të vjetër gegë të shek. XVI dhe XVII. Ndërkaq, nëse kjo nuk është huazuar nga shkrimet e klasikëve shqiptarë, atëherë Kristoforidhi shqiptimin fonetik të dialektit toskë, në përkthimet e veta e shartoi mbi dialektin gegë, duke i ruajtur gjithsesi tiparet karakteristike të tij.

24. Njërin ndër burimet më të sigurta për studimin e së folmes së Elbasanit duhet pandehur gramatika e Vajgandit: *Albenesische Grammatik im süd-gegischen Dialekt (Durazzo-Elbasan, Tirana)*, Leipzig 1913.

Mendohet se në shekullin XVIII në Shqipërinë e Mesme ka ekzistuar një literaturë e tërë, qoftë në përkthime ose në origjinale, e

shkruar me të ashtuquajturin alfabet të Elbasanit. Për lashtësinë e këtij alfabeti ekzistojnë versione të ndryshme. Sipas Hahn-it⁸ ky alfabet është aq i vjetër të cilin e kishin përdorur edhe stërgjyshërit e shqiptarëve të sotëm. Studimet e mëpastajme, veçanërisht të shkencëtarit sloven Nahtigalit⁹ dhe lingvistit shqiptar Pekmezit,¹⁰ dëshmuuan se alfabeti elbasanas është alfabet i vonë, alfabet grek i stilizuar i shekullit XVIII. Është me interes të veçantë për historinë e shkrimit shqip që të studiohet alfabeti i Elbasanit dhe të shikohet numri i veprave të shkruara me këtë alfabet, - dhe në ç'masë është përdorur ai në Shqipërinë e atëhershme, dhe kush është shpikësi i tij. Instituti shkencor shqiptar i Tiranës,¹¹ pas kësaj lufte, bëri kërkime në këtë drejtim, por mjerisht rezultatet e tyre ne na munguan. Rezultatet e kërkimeve të mëvonshme të alfabetit elbasanas do të ndriçojnë gjithsesi historinë e shkrimit shqip në përgjithësi në një rën anë, ndërsa veprat e shkruara me alfabetin e zënë ngoje do të shërbejnë në tërësi si lëndë gjuhësore për studimin e elbasanishtes, nga ana tjetër.

25. E folmja e Elbasanit, të cilën një numër i mirë albanologësh, të huaj dhe të vendit, e pandehin si të folmen më të përshtatshme që do të duhej të merret për bazë të gjuhës letrare shqipe, sepse duke qenë në qendër të vendit do të ishte e kuptueshme si për toskët dhe për gegët,¹² - karakterizohet me këto tipare.

1) Thjeshtimi i diftongjeve [ue>u]; ie>i; üe>ü; khs.: Weigand, o.c., f. 4-5.

⁸ G. Von Hahn, *Bemerkungen über das albanesische Alphabet*: Sitzungsberichte der phil. hist. Classe der k. Akademie der Wissenschaft, Wien, Bd. V (1850), v. 6-10, f. 841.

⁹ R. Nahtigal, *O elbasanskom pismu in pismenstvu na njem*. Arhiv za arbanasku starinu, jezik i etnologiju, lib. 1, vëll. 2; nga i njëjti autor: *Die Frage einer einheitlichen Sxhriftsprache*, Graz, 1917.

¹⁰ G. Pekmezi, *Anzeiger* der phil.hist. Cl. der k. Akademie der Eïssensch., 1901, IX, f. 39.

¹¹ Për alfabetin e Elbasanit në kohë të fundit janë publikuar edhe këto studime: *Anonimi i Elbasanit, shkrimi i shqipes n'Elbasan* në shekujt XVIII-XIX dhe Dhaskal Todhri, nga Dhimitër S. Shuteriqi, në Buletin për shk. Shoq. 1. (1949), 33 – 54 e pas tij: *Dorëshkrimi i Anonimit t'Elbasanit*, nga I. Zamputi, Bishk. V, ¾, 1951, 64 – 131. Shënimet u morën nga *Bibliographie linguistique*, që botohet nga Organizata e kombeve të Bashkuara.

¹² G. Weigand, *Albanesische Grammatik im südgegischen Dialekt*, Leipzig, 1913, Vorrede, f. V.

2) Reduktimi i vokalit labial fundor të patheksuar u në e: i bukur>i buker. Duke dëgjuar të folmen e banorëve elbasanas, njeriut i duket sikur çdo vokal i shqiptuar ka një ngjyrim nazal, dhe nëse duam saktësisht ta përshkruajmë këtë të folme, atëherë gjithsesi, çdo vokal dëgjohej si hundor.

26) Kam përshtypjen se kjo e folme nga aspekti i kuantitetit të voka-
leve dallohet nga të folmet e tjera gege, kryesisht nga ato të Malësisë, në
këtë të folme sikur janë shkurtuar gjatësitë. Këtë e vërejtë edhe Vajgandi, i
cili thotë se disa folës në Elbasan nuk mund ta shqiptojnë e, o, të mbyllur,
por në vend të tyre shqiptonin e, o të hapur, Vajgand, o.c., f. 3. Pajtohem
me vërejtjen e Vajgandit se palatalja e që i paraprin konsonanti palatal, në
këtë të folme shqiptohet si a, mël'a < mël,e; Weigand, o.c.

27. E e pazëshme nuk është ruajtur në tërësi. Në mbështetje të
shembujve të gramatikës së Vajgandit, mund të thuhet lirisht se kjo ka
rënë, p.sh.: gōc; ka mā̄r, pelhūr, te mīr se erde; gēršān, por gēršanet; pāl',
por pal'et. Nga shembujt e sipërm mund të konkludohet se gjysmëvokali e
paraqitet në trajtën e shquar shumë, si p.sh.: l'ōp, pl, l'ópet, ku gjysmë-
vokali e vërtet edhe shqiptohet në të folmen e elbasanasve. Në të folmet e
tjera gege gjysmëzanorja e është reduktuar në minimum, për të mos thënë
në mënyrë të prerë se pazëshmëria nuk ekziston, edhe pse aty-këtu është
ruajtur, shqiptimi është krejtësisht tjetër; artikulimi i saj, pra, është i një tipi
tjetër, që do të thotë se ai në shqiptim krejtësisht eliminohet, ose duke u
liruar nga pazëshmëria shndërrohet në e të mirëfilltë: mōtr ose motër;
lōpn, lōpën; ditn, ditën; khs. Cimochowski, *Le Dialecte du Dkushmani*,
Poznanj 1951, f. 11. Atje ku ajo është ruajtur, në gegërishten jugore shqip-
tohet si e e mirëfilltë identike me atë të toskërishtes.

28. Edhe pse Vajgandi pohon se në këtë dialekt të gjitha vokalet në
çdo rast, janë nazale, unë dua të theksoj se përshtypjet e mira në këtë
çështje nuk përputhen me një konstatim të tillë. Është fjala për vokalin
palatal e, i cili në të shumtën e rasteve, në këtë dialekt është denazalizuar,
p.sh.: gēršān, shkod. gēršān; tēršān, shkod. tēršan, tosk. tēršere; émen,
femen, (tosk. femer, geg. fēmën); zemer (tosk. zëmer, geg. zëmër); ku-
vën(d), te Fjalori i Vajgandit: kuvënd (tosk. Kuvent, geg. kuvën(d)). duke

pasur parasysh shumësinë e vokaleve nazale të përmendura në këtë dialekt, (shih Fjalorin e Vajgandit) – unë nuk mund të heq përshtypjen se Vajgandi, ndoshta diçka “përmirësoi”, ndaj një numër shembujsh me vokale nazale, ndoshta duhet t’i mvishen mu këtij përmirësimi. Ndoshta gaboj, por unë kam një përshtypje të tillë. Unë, për shembull, pothuaj kam – bindjen se fjala kuven(d), në të folmen e Elbasanit, për dallim nga disa të folme gege, nuk shqiptohet me vokalin nazal *ë*, por me oral. Shembujt e denazalizimit të *e-së* nuk janë të rralla as në të folmen e shqiptarëve të Krajës; unë do të thosha se në këtë pikë kjo e folme puqet plotësisht me të folmen e Elbasanit.

29. Shikuar nga aspekti i konsonanteve vlen të theksohet se kjo e folme dallohet nga të folmet e tjera gege (me përjashtim të së folmes së shqiptarëve të Krajës) me tingujt e butë *ć, ğ*, të cilët në pjesën dërrmuese të të folmeve gege shqiptohen si afrikate, ts dz. E folmja e Elbasanit në tingujt e zënë ngoje ka ruajtur palatalitetin maksimal, identik me shqiptimin toskë të këtyre tingujve. Ky dialekt dallohet nga disa të folme, veçanërisht nga ato të Malësisë edhe sipas shkallës së afrikatizimit të *ćs dz* afrikate; *ćsas, ćsup, d ami, dzesve*. Derisa këta tinguj në të folmen e Elbasanit janë identikë me *ć, đ* serbokroate, në të folmet e Malësisë këta fillepërpe përputhen me *č* të fortë të të folmeve serbokroate. Unë mendoj se afrikatizimi i këtyre tingujve në të folmet e Malësisë ka depërtuar nga të folmet kufitare serbokroate, posaçërisht ato malazeze.

30 Vajgandi, në të folmen e Elbasanit, hetoi dy tipa të tingullit *l(l', ĺ)*, ku largohet nga pohimet e linguistit shqiptar – Pekmezit, i cilil në kohën e vet shkroi se pikërisht e folmja e Elbasanit posedon tre tipa¹³ të këtij tingulli: *l', l, ĺ*; khs.: Anzeiger d. Akademie der Wiss., 1901. Shkencëtari polak, Cimohovski¹⁴ (Cimochowski) pohon se në dialektin e Dushmanit e ashtuquajtura *l'* e butë shqipe është identike me *l*-në e frëngjishtes. Mirëpo *ĺ*ja

¹³ Lidhur me këtë çështje mendimin tim e kam shprehur në studim të veçantë: *Tingulli L në të folmen shqipe të Krajës*, botuar në librin e parë të *Vjetarit të Institutit Ballkanologjik të Sarajevës*.

¹⁴ Cimochowski. *Le Dialecte de Dushmani*, f. 15.

frënge është më palatale, ndërsa në gjuhën shqipe, së paku në të folmet geqe, ka artikulum tjetër.

31. Grupet konsonantike¹⁵ *nd, mb, ng*, në të folmen e Elbasanit, pjesërisht janë ruajtur, kurse pjesërisht janë asimiluar në *n, m, n*: *vend*, mirëpo edhe *ven(d)*; *kendoj* dhe *kenoj*, *perëndi*: *pereni*, *kāmb*, *kānr*, *mbuš*, *muš*, mirëpo thuhet vetëm *nīs*, tosk. *ngis*, *nges*, *ngāl* në të folmet shqipe të Kosovës.

Pasi parashtruam disa nga tiparet e së folmes së Elbasanit, përkatësisht dialektit të Gegërisë Jugore, duhet vazhduar shqyrtimi i së folmes së Matit dhe të Krujës. Sa i përket lëndës së kësaj të folmeje, së paku për sh. XVII nuk qëndrojmë keq, sepse mund të shfrytëzojmë përkthimet e Budit. Mirëpo, nëse i rrekemi studimit të kësaj të folmeje në mbështetje të përkthimeve të shkrimtarit në fjalë, atëherë, së paku deri më sot ka qenë praktikë, do të hasim në vështirësi të një natyre tjetër, vështirësinë e mungesës së transkribimeve fonetike të përkthimeve të Budit. Mjerisht, deri sot askush nuk iu përvesh botimit komplet të teksteve të shkrimtarëve shqiptarë të shekujve XVI-XVIII. Ato përpjekje¹⁶ të pakta që kemi as për së afërmi nuk i plotësojnë kërkesat e një nevoje të këtillë.

Transkribimi i saktë i teksteve kparaqet çështjen kyçe të një ndërmarrije të këtillë, që do të na bëjë të njohur alfabetin të cilin autori e përdori në shkrimet e veta. Depërtimi në fshehtësinë e punës së autorit ishte një parakusht themelor në botimin e teksteve të vjetra shqipe. Këtë po e theksojmë për arsye se në këtë punë, në mungesë të teksteve origjinale – kam qenë shpeshherë i shtrënguar të shfrytëzoj transkribimet, në të cilat e njëjta fjalë është deshifraur në mënyra të nduaruarta, ndaj është e natyrshme se burimet e këtilla nuk mund të merren si të sigurt: këto shpesh njeriun e shpiejnë në rrugë dhe në përfundime të gabuara.

¹⁵ Cimoehowski, o.c. 24-26 – thotë se ky grup është ruajtur në të folmen e Shqipërisë së Mesme dhe Shqipërisë Jugore, mendim ky që për Shqipërinë e Jugut mund të pranohet në tërësi ndërsa pjesërisht edhe për Shqipërinë e Mesme.

¹⁶ J. Rrota, *Monumenti mā i vjetri i gjuhës shqipe*, Shkodër, 1930; Namik Ressuli, *Buzuku*, roma, 1958, Biblioteca Apostolica Vaticana.

32. Tiparet gjuhësore që do të sjellim këtu vlejné për të folmen e Matit të shekullit XVII. Për gjendjen e saj të sotme, për shkak të mungesës së lëndës gjuhësore bashkëkohore, nuk jemi në gjendje të themi diçka të sigurt. Me siguri dimë vetëm se Visaret e Kombit nuk mund t'i shërbejnë këtij qëllimi, sepse atje gjuha është ndrequr sipas kërkesave moderne të gjuhës letrare; prandaj përmbledhja në fjalë nuk mund të merret në konsiderim për këtë shqyrtim tonin dialektologjik.

Njëra nga veçoritë e kësaj të folmeje, të cilën studiues të ndryshëm të gjuhës së Budit (duhet të pohojmë – se janë mjaft të sipërfaqshme) e transkriptojnë në mënyra të ndryshme është zëvendësimi i grupeve konsonantike të shqipes së vjetër kl', gl'. Sipas njohjes sime të së folmes së Matit, është zëvendësimi i grupeve në fjalë: k, g; p. sh.: me kene, guni, nga trajtat e vjetra gl'uni, goba nga globa, me origjinë sllave; guhe nga gl'uhe.

Ta shohim si duket kjo në antologjitë e gjuhës shqipe. Sipas krestomacisë Shkrimtarët shqiptarë, I, në të folmen e Matit ndeshim këtë zëvendësim të grupeve konsonantike kl, gl: e te ghus, f. 36; e ndeguene mire kofsen, 36; u tue kene, 36; nkeva ne Konfesionare giuh ce latine, 37; mbe giuhen tane, 37; tue e ndeguom, 37; se kenka,.. 37; per guhu tane, 37; guhe sonë, 37 (bis): e e ndegova, 38; kane me kene t atij populi, 38; me kene, 39. Në revistën Leka, 1932, vëll. 7-8, ndeshim në këto raste të transkribuara të zëvendësimit të grupeve të vjetra kl' gl': nde ghu tane; a ka me kene ga, 224; e te giuhus sane, 224; e ndeguene mire kafsen, 224; neva ne Konfesionare giuhe ce letine mbe giuhen tane, 225; per giuhu tane, 225; mbe giuhut te vet, 229; mbe tjera giuhu, 229; mb'atë ças ke, 267; ku ke mpsuom, 267; mejaft ke 267; aštu kofte, 308.

Ndërrimi i këtyre togjeve në krestomacinë tjetër: Antologji e letërsisë shqipe, Prishtinë, 1954, është ky: kaa me kene lupune, 42; meriton me kene, 32; se kofte, 32; as me kene, 30, 31; kofte, 31. kofte, 31. Thjeshtimin e togjeve të vjetra konsonantike në shqipe kl', gl' në k, g e ndeshim në një përmbledhje tjetër të teksteve shqipe: Fillimet e gjuhësisë shqiptare, Prishtinë, 1952, ku ndeshim shembujt vijues: kane me kene, 114; e kur keše, 116.

Një inkosekuencë e këtillë në alternimin e togjeve konsonantike kl',

gl' në të folmen e shqiptarëve të Matit është si pasojë e të kuptuarit dhe të shpjeguarit të alfabetit, të cilin shkrimtari shqiptar Budi në përkthimet e veta nga gjuha latine në atë shqipe, e përdori, e ndër të tjera – kjo duhet pranuar – se ishte mjaft i larmishëm te të gjithë shkrimtarët shqiptarë të shekujve XVI-XVIII madje edhe ë vonë, derisa në Manastir më 1908 u njësuat të gjitha alfabetet shqipe të deriatëhershme.

Nga shembujt e mësipërm pamë se alternimi i togjeve konsonantike arkaike gl' në të folmen e Matir, sipas autorëve të antologjive të zëna ngojë, është gj, ndërsa sipas disave - g. Unë jam i bindur se thjeshtimi i togut gl' në shekullin XVII në të folmen e Matit ka qenë k, gjegjësisht g, e kurrsesi k, gj, siç shihet fare mirë nga shembujt e mësipërm. Në qoftë se shembujt me k, gj duhet të merreshin si shprehje e saktë e fonetikës së të folmes së Matit të shek. XVII, - atëherë shqiptimi i këtyre grupeve k, gj nuk duhet assesi të identifikohet me shqiptimin e tyre të sotëm. Për ne është e ditur se trajtave të sotme k, g patjetër do t'i ketë paraprirë faza fonetike k, gj. Mirëpo, duhet të kihet parasysh se shqiptimi i tyre asokohe ka qenë shumë më palatal; nga kjo është e qartë se shkalla e tyre e mëvonshme ka mundur të jetë k, g, ndaj ekzistimi i ndryshimit në mes të shqiptimit të sotëm dhe atij të dikurshmit të k, gj është plotësisht i qartë.

Shqiptimi i grupeve k, gj gege sipas palatalitetit, mund të thuhet se i përgjigjet shqiptimit të sotëm të tingujve maqedonë k, g -, disa të folmeve toske të Shqipërisë së Jugut dhe dialekteve shqiptare të Italisë Jugore. Edhe shqiptimi i sotëm i grupeve arkaike kl, gl, në dialektin e Matit, flet në favor të mendimit tonë se këto në shekullin XVII përfaqësoheshin nga tingujt k, g. Sot kjo e folme njih k, g, që te Buzuku u përgjigjeshin grupeve kl', gl'. Supozimi që k, gj në të folmen e Matit të shekullit XVII, qysh shqiptoheshin atëherë – përputhen me shqiptimin e sotëm k, g, është i papranueshëm, sepse palataliteti i grupeve të atëhershme konsonantike k, gj, përputhet me shqiptimin e sotëm të k, g.

33. Nëse mbështetemi në gjuhën e shkrimtarit Budi, nga Mati, atëherë do të vërejmë se tek ai, e kjo do të thotë deri në shekullin XVII, është ruajtur diftongu uo, i cili te shkrimtarët e mëvonshëm reflektohet në

ue (Bardhi, Bogdani). Në pjesën dërrmuese të të folmeve gege ekziston një tendencë e fuqishme e monoftongimit të diftongjeve; khs.: M. Sirdani, *Hylli i Dritës*, 555; Gelasius (Gazulli) o.c., XVII (1941), 547; Kumbona e së Diellës, VI (1943), 115; Jokl, *Vuks alb. Versamml.* 1, 45, 81; Pekmezi, *Gramm.*, f. 16; G. Majer, *Kurzgefasste alb. Gram.*, 1888, f. 4; C. Weigand, *Albanesische Grammatik im Südgegischen Dialekt*, Leipzig, 1913, f. 4-5.

34. Ne nuk do të ndalemi më në gjuhën e shqiptarëve të Matit të shekullit XVII, për shkak të mungesës së lëndës gjuhësore të së folmes së sotme të tij, në bazë të së cilës do të ishim në gjendje të japim së paku një prerje gjuhësore, për disa vjet të fundit, kurse materiali gjuhësor me të cilin punojmë është mjaft i pasigurt.¹⁷ Është i pakontestueshëm fakti se në disa nga këto përmbledhje të zëna ngoje, gjendet edhe ndonjë shënim besnik lidhur me tiparet e disa të folmeve shqipe, mirëpo këto, nga ana tjetër, janë të stërngarkuara me gabime dhe me trajta jo të drejta. Këto janë arsaset që unë në këtë vështrim të dialekteve shqiptare, nuk kam dashur të mbësh-tetem në një material të tillë të pasigurt, ku janë bërë “rikonstruktive” në të cilat kanë dorë mbledhësit, redaktorët dhe korrektorët.

35. Shpjegimin tim lidhur me vështrimin e dialekteve shqiptare do ta vazhdojmë me theksimin e tipareve themelore të së folmes së Mirditës. Që në fillim po theksoj se në këtë të folme fillon një dukuri interesante gjuhësore, diftongimi i disa vokaleve të tjera: *ī* në vend të p.sh.: *dī* skiferë; *i diti*, *i tine* (= *i dūti*, *i tūne*); *aĭ*, *e*, *ne*, *nei* në vend të *i*, *ni*, *saj*, *kajše* (= *kiše*); *Škipne*, *dašnej*, *muĕ* në vend të *Škipni*, *dašni*, *muĭ*, etj.

36. Në këtë të folme ndeshim alternimin interesant të velares *g* në palatalizimin *ĝ*, *gi*, *dj*: *ĝišt* > *ĝišt*; *gūr* > *dur*; *grue ĝrue*: *drue*; me *godit* > *ĝodit*. Duhet theksuar se *ĝ* prepalatale në këtë të folme ka kaluar në *dž* = postpalatale, p.sh. *Ĝérċ* > *erċ*; *ĝint* > *int*; me *ĝetun* me *detun*; *ċ* > *ć*; me *ċit*, *ċatje*, *ċafën*; khs.: J. Rrota, *Letratyra shqype*, Shkodër, 1934, f. 18, 1; . G. Meyer, *Alb. Stud.* VI, 46, 59.

Në atë lëndë të paktë gjuhësore që kemi për të folmen e Mirditës

¹⁷ *Visaret e Kombit; Lahuta e Dibrës; Kangë popullore gegnishte, Sarajevo*, 1911.

muknd të shihet se në të janë të njohura grupet konsonantike kl', gl', që përfuknduan deri në atë proces të palatalizimit duke u shqiptuar k', g' ose č, đ. Unë edhe në këtë pikë nuk mund të mos shpreh dyshim në besnikërinë e materialit të cilin e kam përdorur në këtë të folme, aq më tepër kur për këtë të folme ende nuk ka kurrfarë monografie, kurse ajo lëndë e pamjaf-tueshme gjuhësore nga Albanesische Studien, sipas të gjitha gjasave, nuk është marrë nga burime të sakta. Një varg shembujsh jo të saktë e vërto-tojnë dyshimin tonë.

37. Nëse ngjitemi më tutje në veriperëndim, në drejtim të Shkodrës, arrijmë në krahinën e Zadrimës. Nëse do të dëshironim të studiojmë të folmen e Zadrimës tre shekuj më parë, atëherë pa kurrfarë dyshimi duhet patjetër të marrim në shqyrtim fjalorin latinisht-shqip të zadrimorit Frang Bardhit, të botuar në Romë më 1635. Megjithëkëtë, ky fjalor do të na hynte në punë vetëm për prerjen historike të kësaj të folmeje, kurse për studimet krahasuese të dialekteve shqiptare ai ka një vlerë të paçmueshme, por jo edhe për vështrimin e gjendjes sinkronike të së folmes në fjalë. Përkundër kësaj, si lëndë dialektologjike nuk mund të merren veprat e zadrimorit tjetër, të poetit Gjergj Fishtës (1871-1940). Edhe pse rëndom thuhet se ai veprat e veta i shkroi në dialektin e vendlindjes, mirëpo është më se e sigurt se gjuha e veprave të Fishtës nuk është gjuhë e pastër e një treve, por përfaqëson bashkëkritjen e disa prej tyre, veçanërisht të dialektit të Shkodrës, në të cilin shkruhej që nga shekulli XVIII.

38. Ndërkaq më e besueshme është lënda gjuhësore, të cilën gjatë Luftës së parë botërore e mblodhi M. Lambertzi, kryesisht në viset e Shqipërisë Veriore. Numri më i madh i tregimeve popullore në koleksionin¹⁸ e tij janë nga e folmja e Zadrimës, që na jep mundësi të veçojmë tiparet e saj kryesore. Kjo e folme nuk ka diftongizim sekondar të vokaleve, siç kemi pasur rast ta shohim atë në të folmen e mëparme shqipe të Mirditës. Kryesisht të gjitha diftongjet janë ruajtur mirë. Në aspektin e vokaleve nazale unë edhe këtu shpreh dyshimin në besnikërinë e koleksionit të

¹⁸ Max Lambertz, *Albanische Märchen*, bot. i Akademisë së shkencave të Vjenës, 1922.

tregimeve të përmendura. Në të vërtetë, është fjala për faktin se në të folmet geqe shqipe ekziston tendenca e labializimit të a, kjo do të thotë synim drejt ndërrimit të vokalit a në o; khs.: Tagliavinin, *Le parlate albanesi, Le terre alb. Redente*, Roma, 1942, f. 32-36; Kujundžić: *Srpsko-arnautski Rečnik*, Beograd, 1902. Nuk ka dyshim se tendencat e përmendur e labializimit të vokalit a është shtrirë edhe në të folmet e tjera geqe, ndaj edhe në këtë të folme për të cilën po bjmë fjalë. Lambertzi në këso rastesh të labializimit të a>o mendoj se është fjala për nazalitetin e vokaleve përkatëse; mirëpo, unë mendoj se ai këtu është mashtruar, sepse nazaliteti i vokaleve është diçka tjetër, kurse labializimi i vokalit a një gjë tjetër; mendoj se këto dukuri nuk duhen identifikuar. Po sjellim disa shembuj: e di nātam i.c., 140; vlā, 140; e kište pā, 140, ku nazaliteti, sipas ligjeve etimologjike, nuk duket i drejtë, e unë mendoj se këtu nuk është fjala për raste të nazalitetit sekondar që në të folmet geqe është i njohur fare mirë.

39. Togjet konsonantike mb>m; nd>n (nn), me anë të asimilimit u thjeshtuan në këtë të folme në m, n (-nn) p.sh....: išin ml'ēd, 131; ket mēnnim; dona me e müt, 131; kam tunnue, 139; me hi mrēnn, 151. Te Lambertzi ka edhe mospajtime të natyrës tjetër; në një vend ndeshim: n'koft kuš 141; ndërsa, në një vend tjetër: ka kēn, 142. Sidoqoftë grupet konsonantike kl', gl' në këtë të folme kanë evoluar ë fazën k̄j, ḡj, ndaj thuhet: me k̄jā, ḡjuni, etj. Prepalatalet k̄, ḡ në këtë të folme shqiptohen njësisht si afrikatat: tś, dź (-ć, ź).

40. Më në fund aritëm te e folmja e Shkodrës. Nga aspekti kulturor Shkodra për Shqipërinë Veriore ka qenë ashtu siç ishte Korça për Shqipërinë e Jugut. Ne nuk do të marrim në shqyrtim atë material që nuk është shkruar në shkodranishte; ndaj edhe mendoj se në këtë rast duhet filluar nga edicionet e kurisë së Romës. Osservazioni grammaticali nella lingua albanese nga F. Da Lecce,¹⁹ Romë, 1716, doracak i gramatikës, që autori ua dedikoi kolegëve të vet të gjakut dhe të gjuhës italiane, të cilët në gjirin

¹⁹ Thuhet se F. Da Lecce ka bërë redaktimin e teksteve shqipe të *Concilium Albanum*; khs. I. Rrota, o.c., V, 30.

e krishterëve shqiptarë kryenin detyrën e predikuesve.²⁰ Më vonë pasojnë një mori përkthimesh në shqipë: Guagliata, Dottrina e Kerschten, 1845, 1856, 1873; E. Radoja, Jezu n'zemer t'Mesctaarit, 1862; Nji Frat, Uda e Sceites crúc, 1862; G. Bruschi; Momajit, 1864; Rossi, Regole grammaticali, 1866, ibid. Vocabulario italiano epirotico ed epirotico-italiano, 1866, 175; T. Marcozzi, Urat, 1867; ibid. T' verteta t'pasosme, 1867; E. Radoja, Mci-me t'nevoiseme per deset J. K. 1870; Barile, Ruga e Parrisit, 1873; Nnr. Logoreze, T'mledunit e doktrines keršten. 1880; Ndr. Mjedia, Jeta e soeiteit se' Gnon, 1888; N. Nikai, Vakinat e Sceites Kisc, 1886; J. Junki, Jeta e Scen Luigit G., 1889; Ndr. Mjedia, T'perghjamit e Zojs te bekume, 1892.²¹

Kur bëhet fjalë për besnikërinë e gjuhës së autorëve të zënë ngoje, atëherë duhet të kemi parasysh faktin se numri më i madh i këtyre autorëve qenë me prejardhje të huaj, kryesisht italiane, shi për këtë edhe shtrohet çështja se deri në ç'shkallë këta njerëz e njihnin gjuhën shqipe, apo deri në ç'shkallë gjuha e veprave të përkthyer nga këta autorë i përgjigjet shkodranishtes së periudhës përkatëse.

41. Për studimin e së folmes së Shkodrës në fillim të shekullit XVII material na ofron gramatika e përmendur e Françesko Da Leçes. Prej disa rreshtave të kësaj gramatike që e kam përpara, po shoh qartë se e folmja e Shkodrës në atë kohë ende ruante gjysmëvokalin é: Arbsnuer kanë haber; punë e mirë. Edhe diftongjet janë ruajtur mirë: se da mure; me mbaruem; ndijema. Grupet konsonantike nd, mb janë ruajtur të paprekura: zotnit tande; scen-detne; mbaruem; ndiema.

Që nga gjysma e dytë e shekullit XIX, një numër të tipareve të cekura nuk i ndeshim më; nuk ka më as gjurmë për ε të mbyllët, e kjo dëshmon për faktin se në shqiptim nuk është përdorur më. Edhe diftongjet ie, ue, në pjesën dërrmuese të rasteve të përdorimit të tyre u thjeshtuan në monoftong, mirëpo kjo nuk do thotë se këto janë zhdukur krejtësisht.²² Zhdukja e grupeve të përmendura është me interes të ndiqet në të folmen

²⁰ A. Straticò; *Litteratura albanese*; J. Rrota, *Për historinë e alfabetit shqyp*, Shkodër, 1936.

²¹ J. Rrota, o.c. 34-35.

²² Giacomo Jungg, *Elementi grammaticali della lingua albanese*, f. 31; J. Rrota, o.c. f. 75.

e Shkodrës. Në tekstin e vitit 1862. (Bucciarelli, Roma 1862) shihet se ende ishte në përdorim: tuĭ mbleđun; massandeĭ ja sendritti meņden; .. n meņden; .. n meņd; ać nder; mirëpo kemi edhe nuk muņesc; cusc muņet; prej Cunvendit; por n veņd t assaĭ muņou; me meņdue sctat gazmeņet; J. Rrota, Për historin e alfabetit shqyp, 75. Qysh më 1872, në tekstat e përkthyer të misionarit shkodran E. Radoja asimilimin e togjeve në fjalë e gjejmë të kryer deri në fund.: knuessi, massanei; ne mram, massi cĭnnrue mnogni; J. Rrota, o.c., 77.

42. Burimi më besnik kpër studimin e së folmes së Shkodrës është përmbledhja e tregimeve popullore e Jan Urban Jarnikut, që mban titullin Prispěvky ku Poznani Nareči Alblanských, Prag, 1883. Unë do të thosha se ky është teksti më besnik për të folmen e Shkodrës, megjithëkëtë mbledhësit ia zë për të madhe që e nxori nga përdorimi e-në e mbyllur (kjo te ky krejtësisht është likuiduar, ose ka marrë fizionominë e palatales së pastër e, p.sh. > baben, f. 20; vënen, 21; doren, 20; 21; flānzen, 19; mjal'ten, ēmen, 18; doren s ams. 20. Në aspektin e s-së së mbyllur në të njëjtën mënyrë veprimi edhe Jungu štuls ose stüles; khs. Gramatikën e tij Elementet, f. 10.

Gramatologu i tretë i së folmes së Shkodrës Julius Pisko, në veprën e vet Kurzgefasstes Handbuch der albanesischen Sprache, Vjenë, 1896, e mbyllët përfundon në e të pastër palatale.p.sh.: nāñen; naña e čikes; đinija e babeş; punojn token me babeņ; moter; moter, koder, lunder, loder, veper, numer,f. 8 dhe 12. sipas mendimit tim të gjithë studiuesit e së folmes së Shkodrës gabojnë kur e-në e mbyllët e shënojnë si e të pastër orale. Unë mendojseajo duhet të konsiderohet si vokali i shkurtër i zhdukur, ose edhe si një gjysmëtingull mjaft i reduktuar, që mezi dëgjohet, p.sh. lopën, vjehër, motrën, ditën; khs. : Cimochofski, Le dialecte, f. 11. Sigurisht që e në fjalën lopën nuk shqiptohet si e e pastër, siç na i paraqesin shkrimtarët e përmendur, por ajo është më e hapët, që do të thotë se nuk ka atë mbylltësi që karakterizon vokalin e reduktuar të të folmeve toske.

Vumë në spikamë tiparet e së folmes së Shkodrës, veçoritë e saj, në të vërtetë togjet konsonantike mb, nd kanë përfunduar në shqiptimin e konsonantit të parë m dhe n. megjithatë kjo m e n nuk është identike me m

dhe n të rëndomtë, por artikulimi i tyre ndiqet me një shtypje të fortë të masës së ajrit drejt zgavrës së hundës. Këtë saktësisht e hetuan edhe shkrimtarët shkodranë të shekullit XIX, të cilët këtë tingull nuk e shënuan me n të rëndomtë apo me m labiale, por me n dhe m të dyfishtë. Këtë saktësisht e vërejti edhe Cimohovski, o.c., 24-25.

43. Rëndom thuhet se e folmja e Shkodrës ka mjaft nazalizma sekondarë. Më në fund, kjo është njëra ndër çështjet më të ndërlikuara të gramatikës historike të të folmeve gege, ku numri i shembujve të denazalizimit nuk është i vogël. Për të ndriçuar deri diku nazalitetin e tyre, është e nevojshme një analizë e veçantë e çdo vokali ose fjale. Në këtë drejtim të folmet toske mund të na e lehtësojnë punën, sepse është e njohur se vokaleve nazale gege u përgjigjen vokalet e reduktuara të toskërishtes. Duke e bërë këtë punë njeriu duhet të ketë kujdes dhe durim, sepse në dialektin toskë lirim nga reduksioni nuk është dukuri e rrallë, siç është, më në fund, mjaft i shpeshtë nazalizmi sekondar në të folmet gege.

Mendoj se te fjalët e së folmes së Shkodrës që do të marrim në shqyrtim, duhet konsideruar si shembuj ku nazaliteti nuk ishte në ballë të kohës, por ishte dukuri e vonë me ljëð Jarnik, o.c., f. 39; mër, 7, 11, 31, 37; mërte, 15, 16, 34; sënn, 9 (bis); vërò, 19, 32, 35; i vërpt, 12, 23; vjêf, 7, 17, 19.

44. Në territorin e të folmeve të Malësisë së Shqipërisë Veriore janë bërë kërkimet në trevën e Dushmanit. Studimet i bëri shkencëtari polak WaclaW Cimochowski.²³ Monografia e tij për të folmen e Dushmanit është thjesht përshkruese; me të dialektologjia shqiptare u pasurua për një studim të shkëlqyeshëm për të folmen në fjalë, sepse autori në të bëri prerjen e gjendjes së sotme të së folmes së Dushmanit, duke dhënë çdo dukuri në mënyrë të zgjeruar dhe të përmtuar, arriti me sukses që të japë njërën ndër monografitë gjuhësore më komplete.

Me këtë do ta përfundoja vështrimin lidhur me gjendjen e kërkimeve dialektologjike të gjuhës shqipe brenda kufijve shtetërorë të Shqipërisë dhe do të filloj të bëj vështrimin e së folmes së shqiptarëve në Jugosllavi.

²³ Cimochkoëski, *Le Dialecte*, 1-228.

45. Në toponomastikën dhe në onomastikën e Malit të Zi, të Hercegovinës dhe të Bosnjës historianët vërtetuan se një numër i emrave të vendeve dhe të emrave vetjakë vërtet kanë prejardhje shqiptare. Në fiset shqiptare me siguri bëjnë pjesë Goljemadi, 1441, Burmazi; me prejardhje shqiptare janë edhe emrat Šin, Djon, Šekulare etj. Në mbështetje të toponomastikës dhe të onomastikës, që do të thotë në mbështetje të emrave të vendeve dhe të emrave të pronarëve, shihet qartë se shqiptarët, veçanërisht në mesjetë, bashkë me rumunët, përfaqësonin elementin e dukshëm në formimin e fiseve malazeze. Gjurmët e shqiptarëve i ndeshim buzë Detit Adriatik mjaft herët, siç është familja Šestanović, në Dubrovnik, 1379; A. Alb. 2, 359; familja Šestani përmendet gjithashtu edhe në Tivar, A. Alb. 2, 774; Jiriček, Romanen, 3, 60.

46. Unë nuk do të ndalem në të folmen e shqiptarëve të Malit të Zi sepse asaj mendoj t'i rikthehem më vonë, kur do të bëj fjalë për gjuhën e shqiptarëve të Krajës. Ndoshta do të ishte e udhës të them diçka për të folmen e Ulqinit, për të cilën, në mungesë të dokumenteve dhe të burimeve, mjerisht nuk mund të themi shumë, prandaj do të kufizohemi vetëm në disa tipare të saj: për bazë marrim disa këngë dhe tregime të botuara në revistën shqipe Jeta e Re dhe një vështrim për të folmen në fjalë po në këtë revistë, 1953/3, f. 223-229.

Sa u përket vokaleve, duhet të theksojmë se në mungesë të lëndës gjuhësore të shënuar fonetikut, nuk jemi në gjendje të themi shumë, por megjithëkëtë nga ky material i paktë shihet se në të folmen e Ulqinit ka përfunduar në ue, e pastaj kryesisht është shkruar në u. Në rrethinën më të afërt të Ulqinit, siç bëhet e ditur në këtë artikull, diftongu është në përdredhje dhe lëkundje të vazhdueshme, kështu që diftongjet uo dhe ua alternohen njëri me tjetrin. Është i pakontestueshëm fakti se diftongu uo është trajta më arkaike, nga e cila më vonë doli diftongu ua dhe ue. Prandaj është i paqëndrueshëm mendimi se te diftongu ua u reflektua trajta uo.

Sa i përket kuantitetit dhe kualitetit të vokaleve të së folmes në fjalë nuk dimë asgjë të saktë, sepse lënda gjuhësore nuk na ofron bazë për çfarëdo dëshmie qoftë. Është mjaft me interes të theksojmë se në këtë të

folme është kryer plotësisht denazalizimi i vokaleve.

Nga tiparet e konsonanteve po përmendin togjet kl', gl', të cilat te shqiptarët myslimanë të Ulqinit janë palatalizuar, ndërsa te shqiptarët katolikë shqiptohen si k_l, g_l. Të njëjtin rast e ndeshim edhe në të folmen e Shkodrës. Në të vërtetë, në pjesën myslimane të qytetit grupet e përmendura konsonantike kaluan në k', g', ndërsa te shqiptarët katolikë të Shkodrës shqiptimi i tyre dëgjohej k_l, g_l, khs. Kasem R. Taip, *Zâna popullore e kângë popullore, Shkodër, vëllimi I, 1933*. Këtu ndeshim: qosh (=kóš), f. 15; qanë (=kane), 15; me qa (=ka), 23; shqa (=ška), 23; qoftë (=kofte); i qofshim falë (=i kóšim fal'ë), 231. Trajtat e përmendura i ndeshim në ato këngë që janë shënuar në Shkodër, me siguri ndër shqiptarët e konfesionit mysliman. Këto trajta te pjesëtarët e kkonfesionit katolik tingëllojnë: k_loš; k_lan me k_la; šk_la; k_loft; k_lošim, etj. Është i papranueshëm mendimi²⁴ sipas të cilit trajta e kosovarishtes kân, kôn ka dalë nga trajta kl'ane, ndërsa trajta e sotme kën i përgjigjet kl'en! Unë mendoj se ã nazale te fjalët me k_lân, kân, kôn është sekondare, siç është rasti me trajtën ãst në të folmet geqe, që doli nga trajta en ensti, në tosk. ëšta! trajta me ã me kân, ndeshet në të folmen e Mirditës; khs. Meyer. Alb. Studien, Band CXXXVI, f. 46.

Është i papranueshëm konstatimi se trajta me kën, te shqiptarët e konfesionit mysliman të Ulqinit është reflektuar nën ndikimin e së folmes së Shqipërisë së Mesme, me të cilët gjoja se peshkatarët e Ulqinit kanë mbajtur lidhje të pandërprera.²⁵ Nëse shqiptarët e Ulqinit si detarë dhe peshkatarë kanë pasur ndonjë farë takimi me sivëllezërit e tyre në Shqipëri, atëherë është më se e kuptueshme dhe e qartë se këtë e kanë bërë me Shkodrën. Prandaj, nëse në të folmen shqipe të Ulqinit ka ndonjëfarë ndikimi, atëherë në radhë të parë ky ndikim duhet marrë parasysh nga Shkodra.

Unë qysh në fillim të vështrimit tim për të folmen e Ulqinit, në mun-

²⁴ Se diftongu *uo* u paraprin trajtave të sotme *ua*, *ue* nuk ka dyshim, ndaj nuk ka vend droja në aspektin e pranimit të prejardhjes së diftongjeve sipas Joklit, shih *Indogermanische Forschungen*, 49, 50.

²⁵ *Jeta e re*, 1953/3 – f. 226.

gesë të lëndës gjuhësore, jam kufizuar nga shqyrtimi i hollësishëm i veçorive të saja; kjo do të thotë për shkak të mosnjohjes sonë lidhur me të folmen përkatëse. Prandaj jemi kufizuar në njohuritë e përgjithshme lidhur me këtë të folme. Nëse në të ardhmen kjo e folme bëhet objekt i veçantë studimi, për ne do të ishte kënaqësi e veçantë.

Përkthimi i tregimit Djali plëngprishës në shqipen e Istrisë

47. Kur linguisti italian Bjondeli u dërgoi qarkore të gjithë famullitarëve të famullive në trevat e gjuhës italiane, që për atlasin e projektuar linguistik italian të shënojnë tregimin për djalin plëngprishës në dialektin e vendit të tyre, as atij vetë, as bashkëpunëtorëve të tij as ndërmend nuk u kishte shkuar se ndër këto tekste do të gjendet edhe një tregim i shënuar në dialektin e shqipes së Istrisë. Meqë gjuha e këtij tregimi të shënuar ishte e panjohur për Bjondelin dhe bashkëpunëtorët e tij, ky dorëshkrim mbeti në arkivin e bibliotekës Ambrosiane të Milanos, derisa linguisti torinas Mateo Bartoli e mori ta filmojë, ndërsa kopjen e dorëshkrimit pa transkribim e publikoi në revistën Studi Albanesi, vëll I, 1931: së shpejti pas kësaj tekstin dhe transkribimin e tekstit u përpoq ta japë në shqipe poeti Mjeda, Leka, IV (1932), f. 352-362.

Ajo që në shikim të parë na bie në sy në fotokopjen e dorëshkrimit, siç do të shohim, është e vërteta se dorëshkrimi i tregimit shqip nga dhiata e re sipas mendimit të Bartolit, nuk mund të jetë përkthim i klerikut poreças, Korinaldit, por se ky vetëm shkroi diktimin e përkthimit të huaj nga gjuha italiane, gjegjësisht nga dialekti i Venedikut, në të folmen lokale shqipe të Poreçit. Si dëshmi për këtë është të shkruarit e të disa fjalëve ngjitmas në një fjalë, që do të thotë se kleriku jo vetëm që nuk e ka zotëruar shqipen, por nuk e ka kuptuar aspak. Larmia në të shkruarit e spiranteve interdentalë, që janë veçori të gjuhës shqipe, dëshmojnë se shënuesi u përpoq të gjejë shenja sa më adekuate, që gjuhës italiane i mungonin dhe se me atë rast nuk pati asnjë tekst të shtypur shqip.

48. Kur është fjala për shqiptarët e Istrisë, është me interes edhe një çështje tjetër, në të vëretë çështja e kohës së shpërnguljes së shqiptarëve të Istrisë në trevën e Poreçit. Pietro Stancoviqi, istrias më 1835 lidhur me këta shqiptarë vetëm konstaton se “ristretti ad alcine poche e piccole villette nel territorio di Parenzo unicamente”. (Cituar sipas M. Bartoliti. *Le Reliquie del dialetto albanese dell Istria*, Studi Albanesi, I, 1932, f. 7).

Shqiptarët e Poreçit i përmend: C. Franceschi, *Sulle varie popolazioni dell Istria*, 1832; C. Battisti në studimin *Istria alloglotta*, në revistëne *Merlos L'Italia dialettale*, libri IX, vëll. IX (1933); Fran Barbalig, *Peroj, srpsko selo u Istri: 1933*, f. 8, dhe Bariqi në *Enciklopedija Jugoslavije*, I, (1955), f. 250.

Në mbështetje të kësaj literature të varfër për shqiptarët e Istrisë mund të thuhet me siguri të plotë vetëm një gjë: se në Poreç pati shqiptarë deri në gjysën e shekullit të kaluar, ndërsa nuk ka të dhëna që do të përcaktonin kohën e shpërnguljes së tyre dhe lokalizimin e truallit të tyre të hershëm. Megjithëkëtë, në mbështetje vetëm të tekstit istro-shqiptar mund të përfundohet me siguri se vendosja e shqiptarëve në Poreç nuk është bërë as në shek. XI as në shek. XVI, - sepse në të folmen e Shkodrës ose në të folmen e rrethinës së saj të ngushtë, prej nga, sipas mendimit tonë, u shpërngulën shqiptarët e Istrisë, ku asimilimi i grupeve konsonantike kl', gl' ende nuk ishte kryer, që do të thotë se migrimet e shqiptarëve të Istrisë nuk janë bërë para fillimit të shekullit XVII. Emri i lumit Kiri afër Shkodrës te Barleti (1537) shqiptohet Clyro: “a torente Clyro alluitur, quem verus flunium dixerim”. Grupet kl', gl' në Mirditë u ruajtën deri në shekullin XVII (1638): “Santa Crux ad Flumen Glomisichia”, përballë trajtës së sotme Gomsiqe. Mirëpo, gjykuar sipas tekstit të këtij tregimi – në dialektin e shqiptarëve të Istrisë – nuk ka asnjë gjurmë për dukurinë në fjalë, që do thkotë se asimilimi i grupeve konsonantike kl', gl' në atë kohë kishte përfunduar. Fakti se vokali i reduktuar e në këtë dialekt është ruajtur vetëm pjesërisht, dëshmon se këtu nuk është fjala për trajtat arkaike, ku paraqitet ky gjysmëtingulli.

Gjithashtu në mbështetje të këtij teksti istro-shqiptar, mund të

përcaktohet, së paku për afërsisht, trualli i hershëm i shqiptarëve të Istrisë. Në dy-tri raste teksti përmban trajtat: *neni*, *tekneni*, *sikurnenin*, e kjo është veçori tipike e së folmes së Shkodrës ose edhe e Ulqinit, Tivarit, khs. lidhur me të: M. Sufflay, *Srbi i Arbanasi*, Beograd, 1925, f. 23; (për të folmen e tyre nuk kemi kurrfaqë të dhënash): *pastaj Jirečeku*, *Die Romanen*, I, 85, II, 34. Trajtat e përmendura nuk përkojnë plotësisht me trajtat përkatëse të së folmes shqipe të Titogradit dhe të Pejës, nga, sipas mendimit të poetit shqiptar Mjeda, duhet të vinin shqiptarët e Istrisë, e ato forma duken kësisoj: *njani* tek *njani*, sikur *njanin*, që pikërisht përputhen me variantet e toskërishtes, ku ndeshet vokali i reduktuar *e*.

Teksti përmban edhe trajtën *niri* (*njeri*) që përputhet plotësisht me *niri* të shkodranishtes, që ne e konsiderojmë si argument se shqiptarët e Istrisë kanë origjinë nga viset e zëna ngoje.

Si argument i tretë që shkon në favor të mendimit tonë se shqiptarët e Istrisë erdhën nga trevat gjuhësore shqipe të Veriut, e që në kohën e shpërnguljes së shqiptarëve të Istrisë, përdorej kryesisht diftongu *ue*, siç janë trajtat: *me mue*, *tek mue*, të cilave në të folmet shqipe të Titogradit e të Pejës i përgjigjeshin trajtat me diftongun *ua*, sporadikisht edhe me *uo*; khs.: Erdeljanović, *Kući*, pleme u Crnoj Gori: *Dar Kruo*, *kruo* (i bukur), *tambli pa vluo*, *meišortuo*, 576; st. Dučić, *život i običaji plemena Kuća*: *lavrtuo*, *kafšuo*, 570. Sikur Podgorica e vjetër ose Peja të ishin trualli i shqiptarëve të Istrisë, në të folmen e tyre do të kishin mbetur së paku gjurmët e përdorimit të diftongu *uo*.

I. Grafia e tekstit

49. Teksti është shkruar kryesisht me grafinë italiane. Për tingujt e shqipes, që në gjuhën italiane mungonin, shënuesi u është shmangur kombinimeve të shenjave të ndryshme të shkrimit të gjuhës së vet amtare, nga njëra anë dhe shënimit të veçorive fonetike të shqipes për tingujt e caktuar të gjuhës italiane, nga ana tjetër.

Vokalizimi

A =ë: kasso tatas, 12; me karko tatam em, 18; e contra talas tem, 18; e nuc posaritem, 19; e tambasonat, 22; e kacimca, 25; e cosarit, 26);

O =ë: gra paktominna (=gra pak të mina=te mira).

O =a: casso 12; em jon (=em gan); kajon (=ka dǎn), 12; e kason (=kazǎn) 14; medo cunjo (=me dǎn kurǎ ĩ), 16; e kasso (=ka dǎn), 17; bon (=ban), 19; tata kaso (=tata ca san), 22; e kosarit (=e ka serit), 26; kasoniri (=ka san niri), 27; e nuc mekeso (=e nuc me ke dǎn), 29.

Autori i tekstit tonë nuk ka qenë i mësuar t'i shënojë vokalet nazale. Prandaj forma më e përshtatshme iu duk që voklain nazal a ta shënojë me shkronjën o. Për këtë edhe ndeshim o atje ku do të duhej të përdorej a, edhe pse këtu sigurisht nuk kemi të bëjmë me labializimin, do të thotë kalimin e vokalit a në o, siç është rasti me dialektin e shqiptarëve të Kosovës (khs. N. Jokl Vuks albanische Lidersammlung, f. 44), sepse kjo dukuri nuk është e njohur në truallin e shqiptarëve të Istrisë.

O=u: Zaponon (=ke ponon) 15; kadergo (= ka dergo), 15; meĭ kolot (=me kolot), 15; barkon (=barkun), 16; etj., tambosonat; kakie dekon (=ka kie deku), 32; meroit (=me ruit), 25; kadingo (=ka dingu).

E =i: me vite (=me vete); 13, bir ien, ti ie simpre me mue (=! ! sempre). 31; I=ü dü bir (=duu), 11; grika (=grüka); cunira tie (=kuntra tü – sot me ablativ); zëvendësimi shpjegohet me faktin se në dialektin venedikas ü ishte tingull i panjohur; kjo gjithashtu vlen edhe në aspektin e zëvendësimit të tingujve).

U = u: jus (=ġus) 12; jutet (ġutet), 14; per tue (=per tuu), 31; biriut (=biri ut), 27. Te pjesa dërrmuese e shembujve ú është shënuar me she-njën u: beriut, 19; vlai ut, tata ut, 27; biriut, 30; vlaut. Shënuesi, në tërësi, në transkribimin e ü-së shqipe në grafinë e sotme, do të shënohet me ü të gjuhës gjermane që do të ishte e njohur për të. U =v: mairiv (+ma i riu), 12.

U = i: ne vuch 23, 27 (por vizin, 30, = vicin).

Konsonantizmi

50. C=k, k: me këtë shenjë në tekst shënojmë tingullin k, por k shpesh shënohet edhe me ndihmën e grafisë k: e cuntra, 21; barcon, 1; e contra, 18; de con, 24, 32; kozimca, 25; ka pas, 11; kasso, 12; kaion, 12; bask, 13; kavoit, kukvoi, 13; kason, 14. Në një vend (28) shenja ci lexohet ši; ciel (18, 21) lexohet kiel.

Sci=ć: scio (=ćo, ćui), 20.

Ch=ć: per soch, 2; vuch, 23, 27; memich, 29.

Z =s, k, z, c, ć: 1) paz (=pas), 11; 2) ze (=kī), 12; 13; 16; 17; 3) zuni (=zuni), 23; 4) kazinca (=kēcimka), 25; 5) vizin (=vićin), 30.

J=ǰ: jon (=ǰān), 12; jus (=ǰūs), jan (=ǰān), 15; jutet (=ǰütet) 13; 14; kan groi (=kam ngran ǰi); kunjō (=kurǰa); jupin (=ǰupin) 22; karsjal (ka ard gal), 24, 32.

J =j: mejetit, 14; jakni, 22; temajen, 23, 27; letaje, 23; kanpiet, 25; matmajin, 30; binjen, 32.

I =k: kai viet (=kak), 29.

G =g: kur është para labialeve vokale, qëndron m.g: kadego, 15. Pagoit, 19; Kadingo, 25; kangro, 30; mirëpo kjo g ndeshet para palataleve vokale: me giest, mengia.

G =g?: gie te, 31, giteti, 30.

V =δ: estivano, 28; takuisvano, 29; gn' evs, 29.

S =δ, s, š, z: 1) ka arsial, 32; karsmbrapa, 27; karsnespin, 25; karsid, kars me vete, 17.; në fjalët e përmendura shkronja s qëndron në mes të spirallit të zëshëm interdental – δ. 2) s=v; kasso, 12; e pokaso, 17; sonati me vosarit, 21; tmbasonat, 22; cosarit, 26; om kapus; 3). S=s: basi, 14; pasnu 14; kapas: 16; podis, 17; sikurgnenin, 19. 4) S=š serbotorae, 21; giest 22; tas, 24; etas, 24; serbitor, 26; sendos, 27; nu kadas, 28; serbe, s, 31; est, 32; 5) S-z: t gasment, 32; kaso (bis), 28; musiken 25; unasen, 22; lete ksaniij, 30. Sci's sciet, 15.

Në dy shembuj ndeshim n në vend të r: veri unasen, 22; medo poktomina, 30; kunjjo, 16. Ndodh që këtu është hetuar gjurma e artikulimit të n labiale, përkatësisht r, në gjuhën shqipe; për këtë khs. Pedersen, Albt, f. 8-9; Pekmezi Grammatik der albanesischen Sprache, paragr. 13; Barić, Lingvističke studij

II. Gjuha e tekstit

51. Në pjesën e parë të vështrimit tonë kemi sjellë disa shembuj të kalimit u>o. Në të folmen shqipe të Kosovës dhe Metohisë, këtë dukuri e vërejtë saktësisht Jokli (Vuks albanische Liedersammlung, (f. 44), edhe pse për këtë nuk gjeti shembull të përshtatshëm. Shembulli dikon në vend të dikun, që sjell Jokli, nuk ka asgjë të përbashkët me atë që ai deshi të shpjegojë. Sepse dikon është trajtë dialektore, që në të folmen e shqiptarëve të Kosovës shqiptohet dikā(n) trajta letrare geqe, (dikë-toskërishtja).

Te Kujunxhiçi saktësisht qëndron dikon tçojš dikon, (f. 41) në kuptimin me caktue, me dërgue, tekstualisht: “me dërgua dike”, por kjo vetëm sipas Fjalorit të Kujunxhiçit (f. 37, disa faqe më tutje), njeriu mund të bindet se dikon nuk ka kuptimin “dikund”, por “dikë”, ndaj nuk mund të merret si shembull ku është bërë ndërrimi i u-së në o.

Dukurinë e delabializimit e ndeshim edhe te disa të folme shqipe. Për të folmen çame khs. Pedersen, Alb. Texte mit Glossar, f. 6; për të folmen shqipe në Greqi: G. Meyer, Albanesische Studien, V, f. 6-43; për atë të Mirditës: Vasaret e kombit, vëll. 3, f. 203-209; vëll. 4, f. 240, 241.

Në bazë të shembujve të tekstit të së folmes së shqiptarëve të Istrisë, ku është kryer delabializimi, mund të pohohet se ajo këtu është e pjesërishtme; në disa shembuj është ruajtur ü, shih rreshtat 19, 27, 30, 32; në shembujt e tjerë me labializimin e vokalit ü është përftuar i, u, për shembull, Contra tie, 21; grika (=grüka) dü (=düü); gús (=güs,) per tue (=per tüe); biriut (=biriüt).

Unë mendoj se edhe shembujt e fundit përmbajnë ü labiale, mirëpo

ajo shënuesit i ka shpëtuar në të shkruar. Mjeda mendon se zanafilla e labializimeve të zëna ngoje që i ndeshim në të folët shqip të Istrisë, duhet kërkuar në të folmen e shqiptarëve të Podgoricës, duke menduar se ajo pasqyrohet për bukuri në të folmen e shqiptarëve të ikur në Shqipëri.

Një gjë duhet ta kemi të qartë: në Podgoricën e paraluftës ka pasur pak shqiptarë, mirëpo ka pasur myslimanë malazezë, të cilët gjuhë amnore e kanë serbokroatishten. Unë jam i bindur se Mjeda duhet të ketë hasur në Shkodër në myslimanë-malazezë podgoricas, të cilët posa kishin filluar të belbëzonin në shqipet, ndaj është krejt e natyrshme që ü-në shqipe e shqiptonin si u ose i. Me këtë bie edhe supozimi i fundit që do të shkonte në favor të hipotezës së prejardhjes së shqiptarëve të Istrisë nga Malësia.

Është interesant se si në fjalën Vuch (=vić, 23, 27), ka pasuar labializimi i vokalit i>u, meqë në rreshtin e tridhjetë të tekstit është shkruar drejt cićin. Ndoshta kjo është kushtëzuar nga labiali v.

52. Në tre shembuj të këtij teksti të diktuar për gjatësinë e vokalit, në vend të traditës së mirë të shkrimit të klasikëve shqiptarë; që i shënonin duke i dyfishuar ato, këtu është përdorur shenja e, për shembull, tue, tie, ie, cuntra tie, sciet, me giest. Unë mendoj se kjo graFI E Korinaldit duhet shpjeguar nën ndikimin e grafisë gjermane, siç kam përmendur, sipas të cilit gjatësia e vokaleve shënohet duke i shtuar një e; për shembull, liegen, vorliegen, biegen, zufrieden. Është e qartë se shënuesi i këtij teksti e ka njohur gjermanishten, ndaj grafinë gjermane e ka bartur edhe në shqipet.

53. Janë shumë me rëndësi shembujt që po sjellim: im kamarem, grika, am kapus; janë me interes sepse tregojnë se disa konsonante, me qëllim të një artikulimi sa më të lehtë, ndikojnë në krijimin e ovkalit të përparmë, që në gjuhë të ndryshme – është i nduarduart. Kjo dukuri paraqitt edhe në shkrimet e shkrimtarit më të vjetër shqiptar – Buzukut (1555), i cili i shënoi me vokalin e, për shembull, ençonem, engritih, 25; eteth enbavunah, 26; ne entuimasi she tuus, 25; e envernih, 26; tue engraneh, 26; iss endare, 26; J. Rrota, Monumenti mâ i vjetri i gjuhës shqype, Buzuku, Shkodër, 1930.

Ky gjysmëvokal nistor ka përfaqësuar një çështje të pazgjidhshme

për të gjithë studiuesit e derisotëm të gjuhës së Buzukut. Jokli pandehte se kjo shenjë është r sonate; khs. N. Jokl. Sbornik Miletić, 1933; Hylli i Dritës, 1930, VI, f. 150. Linguisti shqiptar E. Çabej (Buletin për Shkencat Shoqërore, Tiranë, 1955/2. f. 86-87), në studimin e vet për gjuhën e Buzukut, mbron mendimin se në të qëndron një veçori gjuhësore që vlen të studiohet, në të vërtetë se konsonantit nazal n, labiales m dhe likuides l, në ballë të fjalës, në pozitë parakonsonantike, i paraprin elementi vokalik, që, sipas mendimit të tij, përfaqëson zëvendësimin në shqipe të vokaleve të patheksuara indoevropiane ose latine në pozicion parakonsonantik në ballë të fjalës. Ky mendim i Çabejt nuk mund të pranohet sepse sikur ky shpjegim të ishte i saktë, atëherë kjo dukuri do të duhej të përfshinte edhe të gjithë ata shembuj në të cilët ky element në ballë të fjalës etiologjikisht do të ishte i drejtë (shih: Miklošić, Albanische Forschungen, II; 73; (1871), A. Balota, La nasalisation et le rhotacisme dans les langues roumaine et albanaise, f. 75-85), shi për këtë nuk mund të pajtohem me mendimin e Çabejt. Sipas mendimit tim, ky element vokalik është kupshtëzuar nga nevoja e lehtësimit të artikulimit të tingujve përkatës.

Sipas mendimit tonë, Çabej gabon që dy dukuri të ndryshme të disa të folmeve shqipe i shkrin në një. Njëra qëndron në faktin që, elementi vokalik para konsonanteve të gjata është kushtëzuar nga nevoja e artikulimit sa më të lehtë të tingujve përkatës, ndërsa fakti i dytë u përket gjukrmëve të tingujve vokalikë të dobësuar, të cilët, duke qenë të patheksuar, qëndrojnë në rrugën e asimilimit të plotë. E para dukuri konsiderohet si inovacion në të folmet shqipe, ndërsa e dyta është shenjë e reduktimit të vokaleve në fjalët me origjinë indoevropiane, apo latine.

Rrethanat që kjo dukuri në të folmet periferike shqipe, në Greqi dhe në Itali, qysh herët para Buzukut perëndoi, (Çabej o.c., 87), nuk i ndihmon teorisë së Çabejt lidhur me elementin vokalik të gjuhës shqipe, por vetëm e përgënjeshton, sepse në se ky tipar është i panjohur për tos-kërishten, dialekt shukmlë arkaik qysh në kohët para Buzukut, atëherë duhet të jetë e qartë se kjo dukuri as sot e as dje nuk ka qenë tipar i përgjithshëm i gjuhës shqipe.

54. Grupet konsonantike mb, nd, (Basi, 14; e te lendid, 16; scupit tande, 19; e tambaonat, 25; me kamb karsmbrapa, 27; Šendos, embasi, 30; gat gasmend, 32). Nga shembujt e mësipërm shihet qartë se kjo e folme i ka ruajtur grupet e përmendura konsonantike së paku deri në gjysmën e shekullit XIX. Çabej mendon se asimilimi i grupeve konsonantike të zëna ngoje nuk është kryer deri në çerekun e shekullit XVII, eventualisht deri në kohën e botimit të veprave të Pjetër Bogdanit (1685). E folmja arbëneshe e Zarës tregon qartë se grupet e përmendura konsonantike në Krajën e Malit të Zi, sigurisht u ruajtën deri në gjysmën e parë të shekullit XVIII, ndërsa unë mendoj se asimilimi i tyre nuk u paraqit së paku edhe për njëqind vjet. Në vitin e kaluar në Krajë të Malit të Zi, në fshatrat Brisk dhe Shestan ndesha dy plaka njëra tetëdhjetëvjeçare, ndërsa tjetra nëntëdhjetëvjeçare, të cilat i artikulonin qartë grupet e përmendura konsonantike: masandei, andei, ndera, etj.

55. Në njërin shembull të përmendur në vend të asimilimit progresiv është kryer asimilimi regresiv, do të thotë ka rënë konsonanti bilabial m. Nëse ky nuk është gabim i shënuesit, ajo mund të ishte edhe dukuri fonetike, që është një ndër tiparet e njohura në të folmen e Kelmendit; khs. Jeta e Re 1955/3, f. 195-199, Buletin për Shkencat shoqërore, 1955/2, f. 185-190.

56. Vlen të theksojmë se në të folmen e shqiptarëve të Istrisë në vend të trajtave të përgjithshme gege *āst*, *bān*, ndeshim trajtat me vokale të reduktuara: *ēs̄t*, *bēn*, prej të cilëve i pari është primar, që do të thotë se *āst* në të folmet e tjera gege është sekondare, *ensti* > *ēs̄t*; khs.: Pedersen, o.c., f. 6 dhe shembujt nga i njëjti shkrimtar në JF. V, 47.

57. Në bazë të analizës së grupeve konsonantike, në të vërtetë velar+likuidi *I*, gjegësisht *likuidi I+velar*, të cilën i pari që e theksoi ishte albanologu i Vjenës-Jokli (*Revista filologică*, II (1929), *Hylli i Dritës* VI, 151; para tij në Jahrbuch, XIV, 169, e pas tij nxënësi i tij – shkencëtari shqiptar Çabej (*Buletin për Shkencat Shoqërore*, 1955/2, 95, 97), shihet qartë se fati i grupeve të përmendura konsonantike nuk ka qenë në të gjitha të folmet e njëjtë. Ja ç’thotë Çabej për këtë dukuri: “Sa i përket kronologjisë së grupeve konsonantike në fjalë, besojmë se nuk do të

shkelim në dërrasë të kalbur nëse dëshmojmë se më parë është paraqitur dhe është kryer palatalizimi i /s-ë, e pastaj ka pasuar asimilimi i grupeve *kl'*, *gl'*, dhe më në fund palatalizimi /përpara velarit", (Çabej, o.c., 97).

58. Është interesant të *theksojmë* se në të folmen shqipe të Istrisë diftongjet janë ruajtur vetëm pjesërisht natyrisht s'do mend, nëse mund të mbështetemi në tekst; (khs.; *ciel 18, 21; kopeit, 27; kopiet 26; mue, 11; me mue, tek mue, 20*), Diftongu *ue* në pjesën dërrmuese të rasteve është shënuar me *o: dergo: dërgue; me karko: kërue*. Dikush do të mendonte se ndoshta ky është rezultat i procesit asimilues të diftongut *uo*, ku me anë të asimilimit regresiv përfundoi në *o: dergo, karko*. Unë mendoj se për shkak të rasteve *me mue, tek mue* ky supozim duhet hedhur poshtë kategorikisht. Unë jam i gatshëm që më parë të shpjegoj këtë dukuri, duke kërkuar kalimin e labiales së gjatë *u>o*, sesa në çdo gjë tjetër.

Për shpjegimin e shembullit (ko) *pjet* ekzistojnë dy rrugë: palatalizimi i vokalit velar *ū>i*, pastaj në *ie*; ose duhet konsideruar zëvendësimi i *e*-së së shkurktër palatale të latinishtes *e: lat. pētio*, shqip. *Ptes*, prej nga me anë të labializimit u përftua trajta *pües*, trajtë për të cilën ekzistojnë një mori trajtash dialektore: *pëves, bëves, pves, bves, dves, ves, veti*. Megjithatë alternativa e dytë duhet të jetë më e besueshmja.

59. Tani do të them disa fjalë për gjurmët e gjuhës shqipe në të folmet serbo-kroate të Bosnjës dhe Hercegovinës.

Nëse abstraktohen gjurmët e një numri të madh fisesh ilire në toponomastikën e Bosnjës në tërësi, Hercegovinës, Dalmacisë, atëherë në emrat e përveçëm gjeografikë në tërë këtë trevë ndeshim një numër fjalësh me prejardhje shqipe. Në thellësi të Malit të Zi, ku sot nuk mund të dëgjohet asnjë fjalë shqipe, ndeshim në emër vendi *Šindjon*, pastaj fisin *Golje-made* (shqip *Golemaōi*), që zihet ngoje qysh më 1444. Elementi shqiptar ka hyrë në përbërjen e fisit *Mataguža, Mahine Malončića* të bregdetit, në luginën e Zetës, *Mataruga*. Në popull ekziston tradita se fiset malazeze *Vasojeviqt, Piperët* dhe *Ozriniqt* dhe fiset shqiptare *Krasniqi* dhe *Hoti* kanë një lidhje gjenealogjike nga një i parë i përbashkët; khs. *Shufflay, Serbët dhe shqiptarët*, 59-60; Jireček (*Die romanen in den Städten Dal-*

matiens, I, 41; *Staat und Gesellschaft im mittelalterlichen Serbien* I, 24; *Illyrisch-albanische Forschungen*, I 69)=përsiati ekzistencën e komuknave baritore *Burmaza* (shqip-buñ-i mað) ose *Burmazović* në trevën e Stolcit. Një pjesë e mirë e emërtimeve blegtorale në Hercegovinë knaë origjinë shqipe; *balja* – dele e bardhë që ka pikla të zeza në krye, ose dhi e zezë me pikla të bardha; te shqiptarët me emrin *bal'ë* emërtohet kali ose delja me balosh, njollë të bardhë në ballë (khs. *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë 1954); *ćeno*=qen i ri, në shqipe *kën*, nga latinishtja *canis*; *keó*, *keća*, *kić*, *kića* pasthirmë të cilën e përdor bariu hercegovas kur i tremb dhitë, (khs. J. Dedijer, *Hercegovina, naselja* VI, SE Zbornik, XII, 105). Në gjuhën shqipe ekziston fjala *keć*, *kec* me kuptim të *edhit*, që dëgjohet krahas saj edhe *keð*, *eð*. Në të folmen e shqiptarëve të Jabllanicës për ndjekjen e dhive përdoret pasthirrma *kic*.

60. Në gjuhën e fshehtë të zejtarëve²⁶ osaqanas pjesa dërrmuese e fjalëve janë me prejardhje shqipe; të përmendim disa prej tyre: *kalajac*, *kalf-çe*=kalë (nga shqipja *kal'e*, latinisht *caballus*; *miš* me të njëjtin kuptim në shqiptet; *ćen* nga shqipja *kên*, *ken*; *buke* për *buke*; *ruša*=verë, nga shqipja *řuš-i*, që nuk e ka kuptimin e frytit të rrushit, sepse në gjuhën shqipe për këtë ka fjalël të veçantë: *veš*, *kal'aveš*, *vil'e*; *vajza*=që e përdorin në kuptim të njëjtë me shqipen; *urda*; *šulina* nga shqipja *šeline* nga fjala *šelina* e lat. *salina*. Shtrohet çështja prej nga janë gjukrmët e zëna ngoje të gjuhës shqipe në Bosnjë e Hercegovinë. Është e njohur dukuria se shqiptarët e rrethinave të Plavës dhe të Gucisë dhe më në veri nga këto me kopetë e tyre shkonin për të dimëruar deri vonë në Bosnjë, e kjo shihet edhe nga shënimet interesante të Millosh Velimiroviqit lidhur me kultivimin e bagëtimeve të tyre (Godišnjica, XVIII, 166-180).²⁷ Këto që përmendëm më tepër do të ishin lidhje të reja ekonomike të shqiptarëve me Bosnjën. E si t'i shpjegojmë lidhjet ekonomiko-kulturore shqiptaro-bosnjako-hercegovase? Historiani i njohur Jireçeku (*Staat und Gesellschaft*, II, 23), shkruan se në

²⁶ Grgić – Bjelokosić, *Glasnik Zemaljske muzeje za Bosnu i Hercegovinu* XX (1910), f. 589-591; I. Popović, *Jeta e re*, 1953/6; *Godišnjak Muzeja* për qytetin e Beogradit, 1954.

²⁷ Khs. *Arhiv za arbanasku starinu*, I, 1-2, f. 202.

shekullin XIV nisin shtegtimet në gjirin e barinjve të Gadishullit Ballkanik, e me pushtimin turk marrin hov edhe më tepër. Duke depërtuar në jug, turqit merrnin me vete edhe fiset e veta, blegtorët e vet, ndaj nuk ka dyshim se vinin në lëvizje shtegtimi edhe barinjtë vendës, Skarić, *Porijeklo pravoslavnog naroda u sjeverozapadnoj Bosni*, Glasnik ZM, BiH, XXX (1918), f. 227. Në afërsi të Sinjit të Dalmacisë gjendet fshati *Arbanasi; Lopari* është fshat në rrethinën e Zvornikut në Bosnjë (Skarić, o.c.). Në të vërtetë, Skarići vërteton se emri *Arbanas* është më i vjetër se emri *Arnaut*, prandaj këtë vendbanim mund ta pandehim, nëse jo më të hershëm, menjëherë pas ardhjes së turqve, derisa nuk ishte familjarizuar fjala *Arnaut*, që në viset tona e sollën turqit, (Skarić, o, c. 229). Lashtësinë e vendbanimeve shqiptare në Bosnjë, e dëshmojnë edhe vetë fjalët e mbledhura deri tani nga barinjtë shqiptarë. Shi për këtë është me interes fjala *šulina* (nga fjala shqipe *šeline*), ku është ruajtur vokali *u*, e që sigurisht ka prejardhjen nga *ë* e pazëshme e shqipes. Kjo do të thotë se në atë kohë zanorja e pazëshme *ë* ka qenë aq e fortë që në veshin e sllavëve të Bosnjës ka tingëlluar si *u*. Këtu bën pjesë edhe fjala *kećurati* – shikoj, në gjuhën e “fshehtë” të muratorëve osaçanas²⁸ nga shqipja *me kećure*=shkoj, kuk *ë* (ε) e pazëshme në gjuhën serbokroate u reflektua në *e* të mirëfilltë palatale. Në revistën shqipe *Jeta e Re*, Ivan Popovići publikoi një vështrim lidhur me fjalët e gjuhës së fshetë të muratorëve osaçanas, duke i veçuar ato me origjinë shqipe. Njëra ndër këto fjalë është mjaft me interes për datimin e elementit shqiptar në Bosnjë, e kjo është *klenište* = qumështë. Popovići e veçoi këtë fjalë si shqipe, nga *kl'umešt* (qumësht). Nëse turmiret kjo atëherë elementi shqiptar në Bosnjë do të na dilte mjaft i lashtë, siç e tregoi mjaft bindshëm Jireçeku me çdo kusht na del që nga periudha e depërtimit të drejtpërdrejtë të turqve në Gadishullin Ballkanik, e ndoshta edhe më herët. Grupi konsonantik *kl'* u ruajt në të folmet shqipe deri në shekullin XVI, e ndoshta edhe deri në shekullin XVII. Meshari shqip i *Gjon Buzukut* dëshmon për ruajtjen e tij në të folmet e Malësisë, së cilës i përket edhe gjuha e Buzukut.

²⁸ Grkić – Bjelokosić, o.c. 589-591.

61. Historiani Qoroviq, në studimin e vet të shkurtër *O arbanaskim tragovima u Hercegovini*, (shih *Arhiv za arbanasku starinu jezik i etnologiju, lib. I, v. 1-2, f. 201-202*) thekson se një pjesë e gjukrmëve të shqipes duhet kërkuar në emra tanë të vendeve, të personave dhe të familjeve. Fjala *zot=zotëri*, në shqipe edhe *zot-në*, në Hercegovinë është ruajtur si emërtim i vëllazërisë së vjetër *Zotović*. Në fshatin *Burmaz*, nga shqipja *huri-mad* – njeri i madh, *Jefta Dedijer*, (o.c.121), lexoi në një kryq të vjetër që një plak i tyre është quajtur *Petar Zot*, e jo *Zotović*. Dedijeri pohon se kjo ishte një familje e vjetër, dhe duke u mbështetur në një shënim, thotë se “peshkopi Noktaris Zotoviqi, trebinjas në vitin 1705, i fali ikonën manastirit të Trebinjës”. Edhe familja e shtambaxhinjve *Perendia* duhet lidhur me fjalën shqipe *Perëndi*. Emrat *Leka* dhe *Lekić*, aq të shpeshtë të malazezët dhe të serbët, kanë origjinë shqipe: *Leka. Ćorović* sinjalizon edhe për familjen ortodokse *Barzeta* të Mostarit, duke treguar paralelen shqipe *Barzeci* (ndoshta *Barđeci=Bardec*). Familjet katolike *Kakarida* dhe *Preka*, dihet, vazhdon më tej Qoroviqi se janë me prejardhje shqiptare dhe se në Mostar u vendosën në shekullin XIV si Xhuxhe myslimane (f. 38).

Është i njkohur fakti se shqiptarët erdhën në trevën e Hercegovinës dhe si mercenarë. Gjatë kohës që zhvillohej lufta në Konavle (1430-1433), Republika e Dubrovnikut solli shqiptarë si luftëtarë për ta mbrojtur atë – pohon historiani Qoroviq. Për këtë në Arkivin e Dubrovnikut ka mjaft dokumente.

62. Tani të kalojmaë në të folmen e vendbanimeve shqiptare të Sremit, edhe pse sot atje askush nuk flet më shqip. Natyrisht se është e nevojshme që vendbanimet e përmendura të kelmendasve të ndriçohen në aspektin historik. Dihet se disa fise shqiptare kelmendase pas luftërave të pasuksesshme të ushtrisë austriake kundër Turqisë në jug të Serbisë më 1737 u vendosën në Srem, e bashkë me ta shkuan edhe serbët. Më 1737, kur koloneli Lentulus me ushtrinë austriake depërtoi deri në Novi-Pazar, me meritën e patriarkut Arsenije dhe kryepeshkopit Mihailo Sumës, shqiptarët çohen në kryengritje kundër Turqisë, e në anën e Austrisë, si dhe fiset ortodokse malazeze përreth nga Malësia, Kuçi, Bratonoziq, dhe

Piperët, Vasojeviqt, pastaj edhe serbët ndërmjet Pejës e Novi-Pazarit, ndërsa fiset shqiptare katolike – Kelmendi, Hoti dhe Gruda.²⁹

Duke u tërhequr në veri, fiset kelmendase me familjet e tyre u vendosën rrëzë Rudnikut dhe Avallës. Sipas memoareve të gjeneral Shmetanit, që mori pjesë në këto beteja në vitin 1737, qenë rreth njëzet mijë luftëtarë serbë dhe shqiptarë, mirëpo turqit të Valeva i thyen dhe i shpërndanë në dhjetëshe. Emigrantët shqiptarë u katandisën në një pozitë të mjerueshme. Për ta nuk kujdesej askush, e më së paku pushteti austriak. Në fillim shqiptarët jetonin në shpella ndërmjet Karllvcit dhe Savës. Ata nuk furnizoheshin as me të holla e as me ushqim, ndaj sëmundja bënte kërde në mesin e tyre. Në ushtrinë austriake ata u organizuan nga oficerët serbë, ndër të cilët ishin edhe dy shqiptarë: Dedë dhe Vat Gjokaj, udhëheqës të emigracionit shqiptar në Srem. Pushteti austriak pas një dredhie dhe zvarritjeje u ndau parcela toke në spahillëkun e familjes Pejaçeviq afër Mitrovicës. Kështu pra, më 1749 ata zunë vend në fshatrat përreth Hërtkovicit, Nikincit dhe Jarkut.

Vlerësuar sipas të gjitha gjasave, i pari që i vizitoi këta ishte serbi Simeon Pishçeviqi, oficer austriak, dhe në memoaret e veta shënoi përshtypjet nga ky udhëtim, që më vonë i publikoi në revistën ruse – *Vestnik Jevropi*, për vitin 1870. Memoaret e Pishçeviqit kanë rëndësi të jashtëzakonshme për studimin e zakoneve të shqiptarëve kelmendas të Sremit.

Më 1882, në fletushkën *Ungarisches Magazin*, Petrograd Von Windisch, shkencëtar hungarez, botoi artikullin me titull *O klimentama u Sremu* (Për kelmendasit e Sremit), që përmban të dhëna të pasura për shqiptarët e Sremit: për prejardhjen e tyre, jetën, zakonet, veshjen dhe gjuhën e

²⁹ Kostić Mita, *Arnautsko naselje u Sremu, Južna Srbija*, lib. III (1923), nr. 27, f. 274, mirëpo unë nuk e shoh të arsyeshëm pohimin e Kostiçit se shqiptarët pranuan të luftojnë në anë të ushtrisë austriake, jo për arsye fetare dhe kombëtare sikur serbët, por për interes material, e para së gjithash kur dihet se fiset kelmendase malazeze dhe shqiptare janë nga vise të njëjta, me standard jetësor të njëjtë dhe në një nivel të njëjtë kulturor. Është fakt se kelmendasit myslimanë nga Peshteri nuk pranuan t'i bashkoheshin ushtrisë austriake, por vetëm kelmendasit katolikë nga Malësia, vërteton mendimin se pranimi i tyre për të luftuar kundër Turqisë ishte i nxitur nga ndjenjat fetare.

tyre,³⁰ mirëpo, është shkruar mjaft sipërfaqësisht; fjalët janë shkruar gabimisht, kështu që i gjithë materiali është i pasigurt si lëndë gjuhësore.³¹

Një shekull më vonë, Kuhaçi i vizitoi shqiptarët kelmendas në Srem, shënoi disa këngë, mblodhi mjaft lëndë etnografike për shqiptarët e Sllavonisë, dhe i publikoi në studimin *Die klementiner in Slavonien*. Në fillim të këtij shekulli doli në dritë studimi i historianit hungarez Ludvig Tallcit, *Die albanische Diaspora* (në *Illyrisch-albanische Forschungen*, I, pjesë e *Albaner in Sirmien*, 303-322). Ky është studimi më i vëllimshëm për shqiptarët e Kelmendit të Sremit, mirëpo autorit ia zënë për të madhe³² për pretendim dhe për moskujdes ndaj literaturës në gjuhën serbe, si dhe për përshkrimin e sipërfaqshëm të disa operacioneve ushtarake të kolonelit Lentulus në Sanxhak dhe në Serbi.

Disa këngë popullore, disa sosh epike e disa sosh lirike, i publikoi Faik Konica në revistën e vet *Albania*, (Bruksel, Londër, 1902, 1903). Shqiptarët e Sllavonisë përmenden edhe në Danica Ilirska më 1839. Këngët e botuara në revistën *Šćiperia e Re*, Konstancë, 1930, i mblodhi më 1921 famullitari shqiptar Leon Ashiku. Dhe përfundimisht, një sasi të mirë lënde gjuhësore nga mbledhësit e zënë ngoje për të folmen e shqiptarëve të Sremit u botua në Buletinin e Institutit të Shkencave të Tiranës (*Buletin për Shkencat shoqërore*, 1955/2).

63. Do të përpiqemi të japim tiparet më kryesore të shqipes së Sremit si është folur ajo para se të shuhej. Nëse do të provonim që në mbështetje të lëndës gjuhësore të japim karakteristikat e vokalizmit të së folmes së kelmendasve të dikurshëm të Sremit, shumë pak do të mund të ndriçonim në këtë drejtim. Me siguri të plotë mund të thuhet që, në të vërtetë kuantiteti i vokaleve ka qenë ruajtur. Gjatësinë, për shembull, Kuhaçi e shënoi ose me dyfishimin e vokaleve përkatëse ose me shtimin e shenjës h; këto në të vërtetë ishin shenjat për gjatësinë e vokaleve; për shembull,

³⁰ *Buletin për shkencat shoqërore*, 1955, 2, f. 181-190.

³¹ Krahajo mendimin e Ludvig Thaloczit, *Albaner in Sirmien*, u *Illyrisch-albanische Forschungen*, I, f. 202-322.

³² Dr. Mita Kostić, o.c. 277-278.

grah, te shkrintarët e vjetër gegë: *graa*; *süü=sy*; *uhn (=une)*; *zuh=zuu* dhe *rah=raa*.

Ekziston tendenca e labializimit të vokalit të gjatë *a*, ashtu siç vepron në një pjesë të mirë të të folmeve gege: *đan=gān*; *omat=āmat*; *konk m. kānk*; *gron m. grān*; *son m. sān*, *nona m. nāna*; *prom m. prāma*, etj. Në mbështetje të këtij materiali për nazalitetin e vokaleve nuk mund të thuhet asgjë e sigurt, megjithatë unë jam i bindur se nazaliteti në të folmen e shqiptarëve të Sremit është ruajtur deri kah fundi i shekullit XIX. Nuk mund të themi asgjë për nazalitetin sekondar të vokaleve të së folmes së kelmendasve. Kjo dukuri në disa të folme gege është e vonë.

Trajta më e shpeshtë e diftongut arkaik *uo*, në të folmen e Kelmen-dit, para mbarimit të shekullit XIX ishte *-ua*, sporadikisht edhe *ue*: *grue*. Sa na është e njohur, trajta *ua* është trajtë dominuese në të folmen e gjithë kelmendasve, kudo qofshin ata: *fua=vua* (thua); *un jesi puštua=un betem šerbetori*, *ti i malkua*, *un dua me gran-uu duā me grān*, por ata *duoñ me gran*. Në shembujt e fundit paraqiten trajtat e diftongut të vjetër *uo*.³³

Njëri ndër tiparet më kryesore të kësaj të folmeje deri kah fundi i shekullit XIX, duhet cekur ruajtja e interdentalëve *đ*, *v*. Tingujt e përmendur Kuhaçi i shënoi me shenja të ndryshme, që vërteton pohimin tonë të drejtë. Njëri ndër faktorët e ekzistimit të spiranteve interdentalë në fjalë, në kohën për të cilën e kemi fjalën, duhet pasur parasysh e dhëna se Kuhaçi tingullin e fundit të fjala *pigjivē*, (*pigiʋ*) e shënoi me shenjë të veçantë *ξ*, që do të duhet të shprehte spirantin interdental të shurdhët.

Nëse mbështetemi në teks, atëherë duket se, deri kah fundi i shekullit XIX, në të folmen e shqiptarëve të Sremit nuk ka pasur tinguj dyfa-rësh *č*, *ć*, te Windisch-i me *tsch*. Kuhaçi përdori dy tinguj, *č* dhe *ć*, mirëpo në këtë drejtim nuk është konsekuent; e njëjta fjalë njëherë është shënuar me *č*, e herën tjetër me *ć*: *keč*, *keć*, *čitne* dhe *ćitne*. Në të folmen e shqiptarëve kelmendas të Sremit, është mjaft vështirë të saktësohet gjendja e tingujve *č* dhe *ć*. Është e vërtetë se mbledhësit e lëndës gjuhësore nuk i

³³ Buletin për shkencat shoqërore, 1955/2, f. 183-184.

kanë kushtuar kujdes mënyrës së vjeljes së materialit gjuhësor – e në vend që ta lehtësojnë, përkundrazi e kanë vështirësuar gjendjen tonë në përcaktimin e natyrës së tingujve të përmendur të së folmes së kelmendasve të Sremit. Është edhe më i papërpiktë në shënimin e tingujve *đ, đ*, të cilët i shënoi me tingujt *gj, dj*. Përveç të metave të tjera, një veprim i tillë sjell hutim, sepse ai tingull *dj* lexohet si *đ* e *dj*; ndaj ka mundësi të ngatërrohen. Kuhaci në tekstet e veta përdori dy tipa të tingullit *l* (në grafinë e tij *lj, l*); vlen të theksojmë se ai i hetoi shumëllojshmëri *l*-në e butë dhe *l*-në e trashë. Mirëpo, shënimi i *l*-së së trashë me *l*, do të thotë me *l* evropiane nga Kulhaçi, e shtie njeriun të mendojë se ndoshta *l* e trashë në të folmen e kelmendasve të Sremit, kaloi në *l* të mesme evropiane. Megjithatë unë nuk jam i pritur t'i besoj një supozimi të tillë, sepse në këtë rast në *l* të mesme do të kalonte edhe *l* e butë.

Është me interes të përmendim se në grupet konsonantike *nd, mb*, është bërë asimilimi në *t*, përkatësisht në *p*, për shembull, *kurkuš nuk na pet = kurkuš nuk na mbet*.

64. Tani do të shohim si qëndron puna nga aspekti gjuhësor i shqiptarëve të Kosovë-Metohisë, në Jugosllavi. Nëse dëshirojmë të themi diçka për të kaluarën e tyre, atëherë hasim në dy supozime. Historiografia serbe, apo edhe ajo jugosllave kategorikisht pohon se vendbanimet shqiptare në Jugosllavi, dhe konkretisht në Kosovë – janë të vona, që datojnë nga koha e shpërnguljeve të popullsisë serbe në ish Monarkinë Austro-Hungareze, më 1690-1937, por në vendet e përmendura nuk kontestohen edhe një numër i konsideruar *katundesh*. Në regjistrin e Manastirit të Deçanit (1330) ndërmjet lumit *Lim* dhe Drinit të Bardhë përmenden një numër katundesh shqiptare dhe vllahe, ndërsa diploma e Car Dushanit (1348), thekson se në Manastirin e Prizrenit – në veri të Prizrenit³⁴ ekzistojnë nëntë katunde shqiptare. Është e pamohueshme së në mesjetë, në viset e zëna ngoje, ekzistonin katunde shqiptare, mirëpo vendbanime të këtilla ishin të paqëndrueshme dhe nomade.

³⁴ Milan Šufflay, *Povijest sjevernih Arbanasa*. Arhiv za arbanasku starinu, lib. II (1924).

Marin Bici duke folur për Prizrenin përmend se krahas serbishtes në këto vende flitej edhe shqipja, që dëshmon se Prizreni ishte qendër e popullsisë shqiptare. Udhëpërshkruesi turk, Evlija Çelebiu thotë se në Vuçiternë një pjesë e popullsisë së konfesionit mysliman flet shqip. Çelebiu shëtititi nëpër Kosovë dhe Metohi më 1640, do të thotë para dyndjes së të krishterëve në veri, që ndodhi pas vitit 1690. Me këtë nuk u sqarua çështja se a kishte vendbanime shqiptare apo jo në Kosovë-Metohi gjatë sundimit turk, pra para dyndjes së të krishterëve në veri. Unë mendoj se dokumentet turke mund ta ndriçojnë këtë çështje, por kjo kërkon durim dhe punë këmbëngulëse në arkivat e Stambollit, e kjo është punë me rëndësi të madhe për studimin e historisë së popujve të Ballkanit.

65. Dokumentet e para në të cilat mund të mbështetemi në kërkimet gjuhësore të të folmeve shqipe të Kosovës dhe Metohisë janë shkrimet, përkatësisht veprat, kuptohet me përmbajtje fetare të shkrimtarit shqiptar Pjetër Bogdanit, të botuara më 1685, në Padovë.

Meqenëse Pjetër Bogdani shërbeu si famullitar në vende të ndryshme, në Kosovë, në Shkodër dhe në Tivar, ka mundësi që e folmja e këtyre vendeve të jetë përzier me të folmen e vendlindjes së tij. Këtë mundësi e dëshmon edhe Taljavini (*Le parlate albanesi di tipo ghego orientale*, 21), kur pohon se gjuha e Bogdanit ka ngapak ndikime nga e folmja e gegërishtes lindore. Në të vërtetë, është fjala për ndërrimin e grupeve konsonantike arkaike *kl'*, *gl'* në të folmen shqipe të Kosovës, që këtu i ndeshi *k*, *g*, ndërsa në të folmen e gegërishtes-perëndimore - *kj*, *gj*: me *kān*, *guni*, *guha*: me *kjen*, *kēn*, *gjuni*, *gjuha*, etj. Te Bogdani tiparin në fjalë e ndeshim sporadikisht në të folmen e gegërishtes-lindor, përkatësisht të shqiptarëve të Kosovës! Për shembull, *me ga*, Shkodra, *me gja*=me përngja (shih Jungg, 37, Bashkimi, 126; Cordignano, 44) alternimi i grupeve të përmendura në gegërishten jugore është *g*, *k*: me *kēn*, *ngaj*, *gāt*; khs. Weigand, Wörterbuch, 25. Veçoritë e së folmes së gegërishtes lindore i ndeshim në Fjalorin e Rosit (*Vocabulario della lingua epirotico-italiana*, Roma, 1875), ku përveç së folmes së Shkodrës, aty-këtu paraqiten edhe tipare të shqipes

së Kosovës: *i gaat*, Shkodër *i gjaat*.³⁵ Në këtë rast nuk do të marrim në shqyrtim gjuhën e Kazazit, gjakovar, sepse ai në përkthimet e veta nuk është besnik në përdorimin e gjuhës e as në veprat origjinale.

Burim i rëndësishëm për studimin e së folmes së Gjakovës është Fjalori serbisht-shqip (*Srpsko-arnautski rečnik*) i Kujunxhiqit, gjakovar, i botuar më 1902. Autori, siç thekson edhe vetë, nuk ka pretendime të ofrojë një vepër me vlerë shkencor. Përveç gabimeve të shumta, në këtë vepër të shkruar jo sipas kërkesave dhe metodës shkencore të kohës, ky fjalor mund t'i shërbejë dialektologut, të veçojë tiparet qenësore të së folmes së Gjakovës të shqiptarëve të atjeshëm.³⁶

Është shukmë me interes edhe studimi i Joklit për të folmen shqipe të Metohisë, që e shkroi në saje të dhjetë deri në trembëdhjetë këngë të shënuara në Pejë nga Vuk Karaxhiqi. Mirëpo – këtu duhet theksuar se shkencëtari i madh vjenez – shpesh është viktimë e burimeve të pasakta, siç është rasti me këto këngë të mbledhura në Pejë. Vuk Karaxhiqi, këto këngë i shënoi sipas tregimit të një murgu nga Peja, që nuk e njihte shqipen, por, siç shihet nga lënda e mbledhur, as këngëtari që i këndoi këto këngë sa i përket njohjes së shqipes – nuk qëndronte në pozitë më të mirë. Në këngë,³⁷ ndeshim substitucionin interdental të spirantit të zëshëm δ me dentalin e zëshëm d , e kjo assesi as pas 120 vjetësh nuk ndeshet në të folmen shqipe të pejës dhe të rrethinave të saj.

Për të folmen shqipe të Kosovës dhe të Maqedonisë Perëndimore, shkencëtari bullgar S. Mlladenovi shkroi një studim të shkurtër rreth 27 faqesh dhe e publikoi në *Balkan-Archiv*, I (1925); shih recensionin për studimin në fjalë në revistën e Bariqit *Arhiv za arbanasku starinu*, vëll. III (1926). Shkencëtari bullgar Mllaldenovi gjatë Luftës së Parë Botërore vizitoi vendet që i kishte okupuar ushtria bullgare dhe shënoi disa nga

³⁵ Tagliavini, *Le parlate albanesi*, në *Le terre albanesi redente*, roma, 1942, 42.

³⁶ Shih për këtë kritikën e gjerë të Anton Çettës: *O dijalekatskoj vrednosti toga rečnika*, në librin e parë të Institutit Ballkanologjik të Shoqatës së Shkencave të BeH të Sarajevës.

³⁷ Jokl, *Vuks albanische Leidersammlung*, herausgegeben und mit sprachëisenschaftlichen-sächlichen Erläuterungen versehen, 63, dhe kritika e H. Bariqit, *Arhiv za arbanasku starinu*, lib. I, 230-234.

tiparet e së folmes shqipe të Maqedonisë Perëndimore dhe të Kosovës. Sllavisti i Sofjes, në këtë udhëtim të vetin, vërejt një veçori të së folmes së Maqedonisë Perëndimore: diftongimin e vokaleve të gjata \bar{i} , \bar{u} , $\bar{u} > aj$, ej , au , aj , ej . Këtë inovacion e ndeshim edhe në të oflmen shqipe të trevës së Preshevës. Disa të folme të trevave të Shkupit e të Tetovës karakterizohen për asimilimin e grupeve konsonantike bl' , pl' , bj , pj , $ć$, bd , d' (= bd , sh).

Përveç kësaj, unë mendoj se studimi i zënë ngoje i sllavistit të Sofjes, Mladenovit, është një vështrim i shkruar shkel e shko, duke u përqendruar në veçoritë më të përgjithshme të të folmeve shqipe të Maqedonisë dhe të Kosovës. Nuk janë vënë në spikmaë tiparet kryesore të këtyre të folmeve; nuk dimë asgjë për kuantitetin dhe kualitetin e vokaleve; e nuk ceket as nazaliteti i tyre.

Një punim tjetër shumë më i mirë për të folmen e popullsisë shqiptare të rrethinës së Shkupit – është studimi i romanistit zagrebas Petar Skokut, i botuar në *Godišnjak Muzeja Južne Srbije* (1941).^{*} Shkencëtari dhe albanologu ynë i merituar, duke u kufizuar në trevën e Shkupit, u ndal veçanërisht në diftongizimin si dukuri e vonshme e së folmes së popullsisë shqiptare të Shkupit. Në këtë drejtim atij i shkoi për dore të caktojë dhe të fiksojë shtrirjen gjeografike të dukurisë në fjalë. Skoku në studimin e së folmes së popullsisë shqiptare në fjalë të trevës së Shkupit la pas dore tiparet kryesore të saj: kuantitetin dhe kualitetin e vokaleve, nazalitetin e tyre, e cila në këtë të folme, nëse nuk është zhdukur plotësisht, - është reduktuar në shkallën më të ulët.

66. Tani do të pasqyrojmë veçoritë më të rëndësishme fonetike dhe veçoritë e tjera gjuhësore në të folmen e shqipes së Kosovë-Metohisë. Tendencë e përgjithshme e së folmes në fjalë lëshhtë labializimi i $a > o$, për shembull, $kam > kám$, $jam > jám$, jom ; dhe $gân$ $đan$, $đan$, me $đán$, $đon$: me $bã > me$ $bō$, $zã > zō$; kjo tendencë ka përfshirë edhe të folmet e Maqedonisë Perëndimore, trevën e Preshevës dhe të Kumanovës: $đamb > dom$; $tãmběl > tomběl > toměl$.

^{*} Studimi mban titullin: "Lingvistička proučavanja neslovenskog stanovništva Skopske kotline".

Vokali (ε), i reduktuar, si tingull plotësisht i pazëshëm në të folmet shqipe të Kosovë-Metohisë, kryesisht është zhdukur. Edhe në raste ku të gjitha kushtet bëjnë të mundur ekzistimin e tij, ky tingull nuk është më ε (ë) e vërtetë, por është shumë më i hapur, për shembull, te akuzativi i emrave femërorë, *pul'a accus. pul'ën*. Të njëjtin rast e ndeshim edhe me atë grup fjalësh që sosin me *r, l, m, n*; për shembull, *moter*, por *motra; āmel* (omel); vokali në fjalë është reduktuar, mezi dëgjohej dhe është më i shkurtër se vokalet tipike të shkurtra.³⁸

Sa i përket kalimit të tingullit *ū>u*, së paku në të folmen shqipe të Kosovës nuk mund të pranohet kurrësi mendimi që ka shprehur Taljavini (në *Le parlate*, f. 42), duke përfshirë këtu edhe të folmen e Gjakovës. Shembujve që i ka përdorur Taljavini³⁹ nuk mund t'u besohet, sepse janë të pasigurt, të pasaktë.⁴⁰ Shembujt *ćuš, tdruškiš=ndrūšk*, të marrë nga Fjalori i Kujunxhiçit (*Srpsko-arnautski rečnik*), nuk mund t'i ndeshim sot në asnjë rast, e lëre më para pesëdhjetë vjetësh në kasabanë e Gjakovës.

Në fillim nga veçoritë e konsonantizmit po përmendim ndërrimin e grupeve konsonantike arkaike *kl', gl'* në të folmen e gegërishtes lindore, sepse këto, për dallim nga të folmet e tjera gege, përfunduan në *-k, -g*. mendohet që asimilimi i grupeve në fjalë, do të thotë zhdukja e likuidit *l*, u bë para se të pasonte spirantizimi i saj. Këtë mendim e vërteton dhe e dhëna se *k, g*, si zëvendësim i grupeve të vjetra konsonantike ndeshet edhe në shkrimet e autorit shqiptar, Pjetër Bogdani: *gase*, në vend të *gāse*, edhe shembuj të tjerë, nga të cilët shihet qartë se në periudhën e Bogdanit reduktimi i grupeve të lashta konsonantike në fjalë në të folmen e gegërishtes lindore kishte përfunduar në *k, g*. mirëpo, unë nuk mund të kaloj heshtazi, edhe pse ky shembull është shumë i shpeshtë te Bogdani, ai nuk shkon në favor të mendimit se zëvendësimi në *k, g* u bë me rrugë të pandërmjetme, drejtpëdrejt, e ky është shembulli me *kjān* mund t'i besohet plotësisht.

Grupet e lashta konsonantike *kl', gl'*, në dialektin e gegërishtes

³⁸ Waclaw Cimochoowski, *Le dialecte de Dushmani*, f. 11.

³⁹ Tagliavini, o.c. 48.

⁴⁰ Taljavini u mbështet në Kujunxhiçin, *Srpsko-arnautskim rečnikom*, Beograd, 1902.

lindore të shqipes së Kosovës janë zëvendësuar pa përjashtim me velaret *lk, gl*, për shembull: *me kan, kon, gunik guha, me ngue, kiša i gat*. Është me interes të theksojmë se në këtë dialekt ndeshim një numër bukur të mirë shembujsh ku zëvendësimin me *k, g*, e ndeshim edhe tek ato fjalë, të cilat etimologjikisht nuk mund të lidhen me grupet e lashta konsonantike *kl' gl'* për shembull; *keř* < *lat. carrum*, me *kēp* në vend me *képe*, *lat. capio* (për etimologjinë e saj khs. Pedersen, KZ, XXXVI (1900), 330); *kep-a* nga *lat. cepa* (khs. Miklošič, AF., II, 97, Meyer, EW., 223). Taljavini (në, o.c. 57), me siguri ka të drejtë që këtë dukuri e shpjegon me analogji.

Duke u besuar burimeve të gabueshme, në të shumtën e rasteve të pasigurta për studime dialektologjike, Taljavini (në o.c.57) përmend gabimin e Kujunxhiçit në Fjalorin e tij (*Srpsko-arnautski Rečnik*) se *h*-ja nistore në të folmen e Gjakovës është zhdukur plotësisht.

Nuk është Taljavini i pari, i cili duke u mbështetur në shembuj të pasigurt të Fjalorit të Kujunxhiçit, bëri gabime; para këtij edhe Jokli në studimet e veta albanologjike, duke u kmbështetur në të, nxori rezultate të gabuara. Sipas Taljavinit, (o.cit., 58) e folmja e Gjakovës nuk njih bashkëtingëlloren *h*, ndaj në të ndeshim: *ongar, ekar, ōn=hān i ūj<i huj huej; gua (=guha=guha); vjera (=vjehra), kra=(krah)*. Jokli, shembujt pa *h*: *iću (=hiću)* e të tjerë, i pandehu të sigurt,⁴¹ ndaj edhe operoi me ta si të ishin të sigurt. Për të folmen e Vuçiternës, Elezoviqi sjell shembujt pa *h*: *šojin (=šohin, ongër)*, Arhiv, II, 243.

Do të shqyrtojmë spirantin e zëshëm interdental, pikërisht për mundësinë e kalimit të tij apo ndërrimit në likuidën *l* të fortë. Unë jam i paluhatshëm në pikëpamjet e mia se këso rastesh në të folmen shqipe të Kosovës assesi nuk ndeshim (me përjashtim të e folmja e shqiptarëve të konfesionit katolik të Prizrenit). Edhe pse nuk besoj se një dukuri të këtillë mund ta ndeshim, për të folmet shqipe të Maqedonisë jugosllave nuk mund ta vërtetoj këtë gjë. Megjithatë, Taljavini, duke u mbështetur në burime të pasigurta (autorët e të cilave kryesisht nuk janë shqiptarë) në studimin e

⁴¹ Jokl, *Vuks alb. Liedersammlung*, 81.

cituar (59) disa herë ka pohuar se në gegërishten lindore, si edhe në të folmet e gegërishtes perëndimore, ekziston tendenca e kalimit të spirantit të zëshëm interdental në likuidin velar *ʃ*, në një trevë të gjerë dhe citon Urosheviqin, (*Prilozi nar. poezije*, I 203, 204). në shembujt e tij për Vuçitërnën; *me dosht zoti me i llon* (11=ʃ) beriçet, *kur don zoti me i llon beriçet*. Unë jam i bindur se shembujt e përmendur janë shënuar pikërisht në Vuçitërnë, madje, këto i ka shënuar njeriu që shqipen nuk e ka pasur gjuhë amtare; e të këtillë në Vuçitërnë ka mjaft: këta janë myslimanët, të cilët gjuhë amtare e kanë turqishten, thënë shkurt, këta janë turq, të cilëve pasi ky tingull u mungon në gjuhën e vet amtare e shqiptojnë si *ʃ* të trashë. Në fshatra të banuara me shqiptarë sigurisht nuk ndeshim në këtë dukuri. Unë i kam shikuar dhe lexuar tre blenjtë – *Kangë popullore shqiptare të Kosovë-Metohis*, M. Bakija, 1952, 1953, përpos konsultimit me studentët e mi nga rrethina e Vuçitërnës, mirëpo në asnjë rast nuk kam hasur në shembujt me të cilët do të dëshmohej kalimi i *ʃ* interdentalë në velaren *ʃ*. Kësi shembujsh ndeshim në këngët e Vukut të shënuara sipas tregimit të një murgu; unë jam i bindur plotësisht se Vuku i shënoi saktësisht ashtu si i dëgjoji, dhe i dëgjoji me siguri ashtu, por murgu Obadoviq e shqiptonte *ʃ* (*ʃ*) në vend të *ʃ*. Njërisht nga radhët e intelektualëve serbë shumë herë i jnaë përveshur punës të mbledhin dhe të shënojnë tregime popullore të shqiptarëve në Jugosllavi, dhe kryesisht i shënonin besnikërisht, mirëpo u përvidheshin edhe gabime të vokla, ndaj përfundimet në mbështetje të tyre vështirë mund të pranohen. Lidhur me këtë desha të theksoj se Taljavini në punimin e cituar mori shembullin (i marrë nga punimi i Mlladenovit, *Balkan – Archiv*, 1, 51, 57, 67) me të cilin deshi të tregojë se dukurinë e alternimit të *ʃ > ʃ* ndeshim edhe në të folmen e shqipes së Dibrës. Unë prej fillimit e deri në fund e kam shikuar veçanërisht përmbledhjen e këngëve *Fyelli i Dibrës*, që i mbledhi dibrani vendës, Haki Stërmilli, mirëpo, mjerisht askund nuk kam hasur në asnjë shembull ku *ʃ* të përdoret në vend të spirantit të zëshëm *ʃ*. Fjala *oudha=auda* përmendet dy herë, në faqet 52, 92, mirëpo jo me *oʃ* ashtu siç e gjeti Taljavini te Mlladenovi, por: *u mboush oudha me dervejshtë*, (o. c., 52) “ka mar oudhën n’ogur t’Allahit” (92).

Për të folmen shqipe të Dibrës dhe të rrethinave të saj, Glisha Elezoviqi, në botim të Akademisë së Shkencave Serbe, publikoi punimin me titull: ”*Veçoritë fonetike të dialektit të shqipes së Dibrës dhe të rrethinave të saj*” (në *Dajalektološki zbornik*, knj. XI, Beograd 1950). Punimin e recensuan dhe e interpretuan Hasan Kalessi dhe Kadri Halimi në revistën shqipe *Jeta e Re* në Prishtinë, 1951/5, dhe në Buletinin e Universitetit, 1951, nr. 57).

Sipas mendimit tim, shikuar nga aspekti metodologjik, punimit në fjalë nuk mund t’i bëhet vërejtje. E vërteta se në këtë punim ka gabime, shpjegohet me të metat e përmbledhjes *Fyelli i Dibrës*, e përgatitur pa kritere shkencore, e të cilën glisha Elezoviqi e shfrytëzoi si lëndë për punimin e vet, prandaj nuk mund të merret si një pasqyrim i vërtetë i së folmes shqipe të Dibrës.

II. VËSHTRIM KRITIKO-HISTORIK I PËRDPJEKJEVE TË DERITANISHME PËR STUDIMIN E SË FOLMES SË ARBËNESHIT

67. E folmja e Arbëneshit të Zarës, së cilës i kushtohet edhe kjo monografi jona, është studiuar deri tani mjaft.

Njoftimet e para për këtë të folme i kemi nga shkencëtari i famshëm Franjo Mikloshiçi, i cili në studimet e veta *Albanische Forschungen*, përmend rreth dyqind fjalë të së folmes së Arbëneshit, e pastaj shkencëtari kroat Ivo Berçiq, i lindur në Zarë, njeri me kulturë jashtëzakonisht të gjerë, që merrej me studimin e glagolicës, la pas vete një numër të konsideruar studimesh dhe librin nga fusha e filologjisë së sllavishtes së vjetër; Enciklopedija Jugoslavije, I. A. Bosk, f. 478-479.

Të shohim si duket e folmja e Arbëneshit sipas fjalëve që kemi shënuar atje. Njëri ndër problemet më interesante në këtë të folme, është çështja e tingullit /ku ndeshim dy tipa të /-së, /, e kjo tregon se e folmja e Arbëneshit para fundit të shekullit të kaluar ka pasur edhe /të mesme, dhe / (/) të trashë. Për /të mesme po sjellim shembujt: *nalt*, *koj*, *kandil*, *ksula*, *floku*, - *lelduo*, *libruom*, *plumb*, *puła*, *m_luo*, etj. Këtu shtrohet një çështje, se a mos ndoshta tingulli /në shembujt e përmendur shqiptohet si /' e butë, sepse ky tingull në të folmet e tjera gege dhe toske shqiptohet vetëm si /' e butë? Uknë mendoj se / e trashë në të folmen e Arbëneshit nga fundi i shekullit nëntëmbëdhjetë kishte filluar të kalonte në / të mesme evropiane. Të këtillë janë shembujt vijues: *moła* < *moła*, *këngała* *kengala*, lat. *cicala*, *plumbi* < *plumbi*; *malkuo* = *malkuo* lat. *maledicare*, - në të cilët /-ja intervokaliqe latine, sipas teorisë së Pedersenit, në gjuhën shqipe është përfaqësuar me /.

Nga ana tjetër / e trashë, deri kah fundi i shekullit nëntëmbëdhjetë, në të folmen e arbëneshit ende ruhet *kiel* (*kiel*), *katma*, *ufi*. Në një numër të m irë fjalësh, ku spiranti i zëshëm interdental etimologjikisht është i drejtë ndeshim në dukurinë e kalimit të saj në / të trashë, si për shembull

në fjalët: *baλ*, *darλa*, *λambi*, *maλšti* (= *maδšti*); *ilnuo* (= *iōnuo*); *mteλ* (= *mteδ*); *uλa* (-*uδa*). Në të gjitha fjalët e zëna nga *λ* (= *λ*) patjetër duhet të ketë prejardhje nga *δ*; përndryshe ai edhe shqiptohet si *i* tillë në pjesën dërrmuese të të folmeve gege dhe toske. Unë besoj se *l*'e butë në këtë të folme, kah fundi i shekullit XIX, filloi ta hukmbë palatalizimin e vet, duke synuar në këtë mënyrë identifikimin me *l*-në evropiane nga njëra naë, ndërsa në anën tjetër edhe *l* e trashë velare kaloi në *l* të mesme evropiane.

Sa i përket diftongut, ai kah fundi i shekullit XIX, filloi ta humbë palatalizimin e vet, duke synuar në këtë mënyrë identifikimin me *l*-në evropiane nga njëra naë, ndërsa në anën tjetër edhe *l* e trashë velare kaloi në *l* të mesme evropiane.

Sa i përket diftongut, ai kah fundi i shekullit XIX, gjykuar sipas fjalëve të Mikloshiçit në studimet e tij të përmendura kryesisht përdoret në trajtën *uo*, e ky diftong është trajta më e vjetër për të cilin mund të pohojmë në saje të dorëshkrimeve të vjetra të gjuhës shqipe: *fortsuo*, *dišruo*, *kërkuo*, *gikuo*, *malkuo*, *martuo*, *urdënuo*, *paguo*; *une duo*, *mluo*, *ilnuo*, etj. Është interesant të përmendim se në të vërtetë diftongun *uo* e ndeshim edhe më vonë në studimin historik të Tullio Erberit i cili bën falë për vendosjen e shqiptarëve të Krajës në Zarë: *meškuo*, *me krlzuo*, *mebesuo*, *membaruo*, *i munduošim*, (Tullio Erber, *La Colonia albanese di Borgo Erizzo presso Zara*, Dubrovnik, 1883, f. 72-73).

Në faktin se ndërmjet *ć*, *č*, *ǰ*, *đ* të butë dhe të fortë në të folmen e Arbëneshit nuk bëhet kurrfarë dallimi pajtohen të gjithë studiuesit e saj, duke filluar prej Berçiqit e deri te Erberi, Vajgandi e Taljavini; e me këta bashkohemi edhe ne.

Në studimet e Mikloshiçit për shqipen janë dalluar dy tipa të tingullit *ć* *č*: *faće*, *fličinet* (*plur.*), *mustač*, *faće*, *otšitovat* "manifestare" *poručit* – racomandara, Mikloshiçi në dy raste periode edhe shenjën *ć* për *ć* të butë shqipe: *ćere*, *ćiel*. Ne nuk e kemi të qartë se a thua shenja *ć*, që Mikloshiçi e përdori në dy fjalët e përmendura, duhet të shënojë butësinë e tingullit *ć* në kuptim të palatalitetit të dialektit toskë, apo kjo është

identike me afrikaten, *tš: č:* unë besoj se këto dy shenja përdoren për të njëjtin tingull – edhe pse nuk përjashtohet mundësia e ekzistimit të tingullit të butë palatal në kuptimin e toskërishtes të së folmes së Arbëneshit të asaj kohe.

Ekziston papërcaktueshmëri edhe në të shënuarit e tingujve *ǵ, đ* të cilët te Mikloshiçi janë shënuar me shenjat *ǵ, đ: me ǵukuo, ǵutet, ngüe*, etj.: *dj-rdjant*.

68. Kronologjikisht, më parë duhet përmendur artikulli *Arbëneshët e Zarës dhe kryepeshkopi Zmajeviq*, të cilin në Kalendarin popullor, më 1868, e shkroi Stjepan Buzoliqi. Artikulli në fjalë, në tetë faqe të plota, përmban të dhëna të vlefshme për jetën, zakonet, gjuhën dhe truallin, pra edhe për prejardhjen e shqiptarëve të Zarës. Çështja që na intereson në këtë artikull, është e dhëna për dukurinë fonetike të së folmes së arbëneshëve të Zarës, dukuria që flet se arbëneshët e Zarës në atë kohë nuk e shqiptonin *lj* (ль), por vetëm të mesmen apo atë evropiane siç quhej rëndom; khs. artikullin e përmendur të Stjepan Buzoliqit, f. 78, ku thuhet se arbëneshët e Zarës nuk mund të shqiptojnë *polje* (полье), vetëm *pole* (полье), *vola* (воља) në vend të *volja* (воља). E kjo do të thotë se *l'* (ль) e butë kah fundi i shekullit të kaluar kishte filluar të zhduket nga e folmja e arbëneshëve të Zarës.

69. Studimin e parë e të rëndësishëm mbi vendosjen e arbëneshëve në Zarë dhe në rrethinën e saj e kemi nga italianian Tullio Erber me titull *La colonia albanese di Borgo Erizzo presso Zara*, Dubrovnik, 1883, f. 5-160.

Studimi u shkrua në mbështetje të dokumenteve arkivore të Zarës. Po përmendim disa mendime lidhur me prejardhjen e arbëneshëve të Zarës. Është interesant se deri vonë shumë pak është ditur për truallin e arbëneshëve të Zarës, madje edhe ajo që është ditur ishte jo e saktë. Erberi shtroi dy hipoteza për truallin e arbëneshëve të Zarës. Sipas njërit version, trualli i vjetër i tyre duhet kërkuar në jug të Shkodrës. Atje ekzistojnë dy fshatra, me emrat *Preshja* dhe *Shijak*. Shqiptimi i këtyre emrave deri diku i afrohet shqiptimit të emrave të vendeve *brisk* dhe *Šest – Briskët* dhe *Šestanët*, që gjenden jo larg detit. Kjo përputhet me faktin se arbëneshët

e Zarës në truallin e vjetër i takonin juridiksionit të Tivarit – prej nga kinse duhet nxjerrë përfundim se këta në Shqipërinë e kohës së Turqisë jetonin diku përreth detit. Vërtet në mbishkrimin e kishës së arbëneshëve të Zarës thuhet se stërgjyshërit e arbëneshëve të sotëm janë nga Tivari, mirëpo ky mendim duhet shpjeguar me faktin se ata u nisën nga limani i Tivarit; porse kjo nuk do të thotë se ata janë me prejardhje nga Tivari.

Erberi supozonte një mundësi tjetër lidhur me truallin e vjetër të shqiptarëve zaras. Ai pandehte se më i besueshëm është mendimi se arbëneshët e Zarës janë nga Mirdita. Ai besonte në këtë fakt, duke menduar se në këtë mënyrë do të mund të plotësonte të dhënën se në Zemunik, afër Arbëneshit, jetonin edhe dy familje të konfesionit ortodoks, e sipas shpjegimit të tij, në Mirditë ka pasur ithtarë të kishës greko-ortodokse, (Erber, o.c., 62). Mirëpo në këtë supozim ai kishte parasysh edhe faktin se në Shestan, përveç shqiptarëve, jetojnë edhe serbë ortodoksë (në Draçevicë, në atë kohë edhe në Selc flitej shqipja – I.A.), atëherë vetvetiu zgjidhej edhe çështja e prejardhjes së dy familjeve ortodokse të Zemunikut.

Është e pakuptueshme përse u brodh aq shumë në çështjen e përcaktimit dhe saktësimin të truallit të vjetër të arbëneshëve të Zarës, kur Buzoliqi kishte treguar për Briskun dhe Shestanin menjëherë përmbi Shkodër si truall të arbëneshëve të Zarës; khs. Stjepan Buzolić, *narodni koledar*, 1868, f. 79.

Erberi në studimin e përmendur historik ku bën fjalë për peripecitë e arbëneshëve të Zarës, kishte mbledhur disa dhjetësha fjalësh, kishte bërë zgjedhimin e dy foljeve ndihmëtare, nga një emër dhe mbiemër, e kjo ishte tërë ajo që kishte shënuar ai me këtë rast, (T. Erber, O.c., 71-75).

Edhe pse është mjaft vështirë të depërtojmë në fshehtësinë e alfabetit të tij, që përdori duke regjistruar ato pak fjalë të së folmes arbëneshë, do të përpiqemi të cekim disa dukuri që mund të vërtetohen. Vështirësitë që na dalin, siç thamë, në saktësimin e veçorive fonetike të së folmes arbëneshë, janë për shkak të shënimit jo të përpiktë të historianit Erber.

Spiranti interdental i ruajtur në këtë të folme është veçori që e

karakterizon shqipen, vetëm se ne këtu duhet të theksojmë faktin se veçanërisht spiranti interdental i zëshëm është jostabil, sepse në një pjesë të mirë fjalësh tregon tendencën e kalimit të l-së trashë, dhe anasjelltas, l velare synon të kalojë në ð; p.sh. *moła* (=l=ð;=*moła*), *ćiedi*, *diedi*, *üedi* = *ćieli*, *dieli*, *üeli*; *ula e ciedit*, “Via lattea” (= *uda e ćielit*). Shembujt e përmendur tregojnë qartë jostabilitetin dhe mosekzistencën e tingujve në fjalë në të folmen përkatëse.

Mungesa e alfabetit stabil nuk ofron mundësi të bëjmë diferencimin e tipave të tingujve *ć, ć, ġ*.

70. As pohimi i Vajgandit lidhur me truallin e arbëneshëve të Zarës, sipas të cilit ata duhet të kenë prejardhje nga Kruja dhe rrethinat e saj, nuk mund të qëndrojë (Weigand, *Der gegische Dialekt von Borgo Erizzo bei Zara in Dalmatien, Jahresbericht des Instituts für rumänische Sprache, Leipzig, 1911, f. 177-239*).

Studimi i Vajgandit përbëhet prej kapitujve: parathënia 177-181; përshkrimi i së folmes 181-207; pastaj tekstet me përkthim në gjermanisht 207-233, dhe në fund glosarin 224-239.

Monografia e Vajgandit për të folmen e arbëneshëve, është studimi i parë serioz i shkruar nga një linguist. Atij i është zënë për të madhe se ka bërë përmirësimin⁴² e teksteve të shënuara, në përshtatje me kërkesat etimologjike. Unë me këtë mendim nuk pajtohem kryesisht, edhe pse aty-këtu ka raste korrigjimi në lëndën e tij gjuhësore të shënuar. Për këtë do të bëjmë fjalë më hollësisht në këtë kapitull.

Konsiderohej lëshim i Vajgandit⁴³ që nuk e hetoi veçorinë interesante në të folmen arbëneshë ku tingulli *s* kalon në një farë *ś*, sepse këtë dukuri Taljavini, kinse, e kishte dëgjuar jo vetëm në fjalët me origjinë shqipe, por edhe në ato sllave, që do të thotë në mesin e arbëneshëve, kur ata bisedonin edhe në serbokroatishte. Kjo, sipas Taljavinit, do të ishte veçori e përgjithshme e së folmes së arbëneshëve. Gjatë qëndrimit tim në Zarë,

⁴² Tagliavini, *L'Albanese di Dalmazia*, f. 17.

⁴³ Tagliavini, o.c.

në mesin e arbëneshëve të atjeshëm, - veçanërisht i kam kushtuar kujdes kësaj çështjeje që të dalloj ata tingull, megjithëkëtë, as nuk e kam hetuar në këtë të folme e as ma kanë dëshmuar njërëzit, të cilëve u jam drejtuar për ekzistimin e dukurisë në fjalë. Kolegu Krono Kërstiqi, arbënesh i lindur në Arbëneshin e Zarës, me letër më ka njoftuar se për ekzistimin e këtij tingulli (s) nuk mund të bëhet fjalë në të folmen e arbëneshëve të Zarës, por kjo mund të jetë rezultat i të metave në të folur të së ndjerës informatore të Taljavinit, Lidije Vuksani, e cila i ka pasur dhëmbët të dalë jashtë e të deformuar me gjithë fulqinjte e që ka shkaktuar artikulum të veçantë të tingullit *s*(š), prandaj nuk mund të tumiret mendimi se kjo është dukuri e përgjithshme e së folmes së arbëneshëve të Zarës.

Vajgandi në monografinë e vet mbi të folmen e Arbëneshit të Zarës, pohon se ekzistojnë dy tipa të tingullit *l*:/dhe *l*. Për të parin ai thotë se është më palatal, e kjo do të thotë se tingulli *l* në të folmen e Arbëneshit të Zarës është identik me *l*-në evropiane, siç e kemi bërë zakon ta quajmë. Sa i përket *l*-së velare, - Vajgandi vë në pah se me këtë të folme kjo shpesh kalon në spirant interdental të zëshëm, (Weigand, o.c., 186). Kur mungojnë këto ndërrime, atëherë ajo në të gjithë shembujt e tjerë (fjalët) shqiptohet si *l*e trashë, ashtu siç shqiptohet në të gjitha të folmet gege dhe toske: *i mał* (por *i mađi*); *mieł*, por *miedi*, *mał*, *moła* dhe *mođa*.

Mosekzistimi i tingujve *đ* dhe *l* në të folmen arbëneshëve është e qartë, por ajo qëndron në shndërrimin reciprok të një tingulli në tjetrin (shih shembujt e lartpërmendur). Përveç kësaj tendence, në të folmen arbëneshëve ekziston edhe dukuria e kalimit të velares *l* në të mesme, gjegjësisht në *l* evropiane, dhe shtrohet çështja a kishte dominuar kjo *l*e mesme evropiane në kohën kur e mblodhi lëndën gjuhësore shkencëtari gjerman Vajgandi, mbi velaren *l*, unë personalisht nuk mund të pajtohem me pohimin e Vajgandit se velarja *l* në kohën kur ai kishte qëndruar në Arbënesh të Zarës, ishte edhe trajtë dominante, siç del edhe nga tekstet e tij të shënuara, kur velarja *l* qëndron atje ku etimologjikisht është e domosdoshme.

Gjykuar sipas gjendjes së sotme unë jam i bindur se *l* velare në kohën e kërkimeve të Vajgandit në të folmen e arbëneshëve kishte arritur në

shkallën e përdorimit minimal. Prandaj pohimi i Taljavinit për përmirësimin e teksteve nga Vajgandi – nuk është i pavend, sepse ai faktikisht ekziston.

Se ç'e shtyu Vajgandin të veprojë ashtu është çështje tjetër, mirëpo përmirësimi i teksteve është fakt i pamohueshëm. E ky përmirësim, sipas mendimit tonë, më tepër është bërë te tingulli *l*.

Një numër i mirë njerëzish të gjeneratës pak më të vjetër edhe sot e kësaj dite e bëjnë dallimin shumë mirë të *l*-së (*l dhe ð*) së mesme dhe të fortë.

Mendoj se korrigjimi më tepër shihet te tingulli *ć* (*ċ*). Edhe vetë Vajgandi pohonte se më në fund është edhe e vërtetë se *ć* në të folmen arbëneshe u kthye në afrikatën *ć* (*tś*), e që së fundi do të thotë se me fortësi, ajo është njëjtësuar me *ś* (*ç*) të fortë. Megjithëkëtë, Vajgandi në *Glosarin* e vet përkundër kësaj përdor shenjën *tś* (*č*) për të shënuar ç-në e fortë në të folmen e Arbëneshit. Unë qëndroj i paluhatshtëm në atë se tipat e tingujve të butë dhe të fortë: *ć* (*tś*), me kalimin e së butës në afrikate janë identifikuar plotësisht, dhe se në mes tyre nuk ka kurrfarë dallimi tingullor. Ndërrim ka pasur edhe në këta shembuj: *tśerek*, VI, 28, *tśobo-ani*, *tśōin*, (*erhebe*), *tśoem*, *tśuo*, por *tśaf-a*; *tśeni*, *tśelbi*, *tśep-a*, *tśeni*, *tśelbi*, *tśep-a*, *tśeš*, *tśešem*, *tśiel-di*, *tśint*, *tśümbe*, *tśüş*, etj. (Shembujt u morën nga *Glosari* i Vajgandit, f. 237).

Nuk shoh arsye për përdorimin e dyfishtë të shenjës *dź*, *d'*: *dźint*, *dźie*, *dźūs*, *endźul*, *endul*, nga njëra anë, dhe *d'un-i* (gjuni), *d'umi* nga ana tjetër, sepse në të vërtetë këto janë shenja për të njëjtin tingull, kur jemi te këta shembuj, është e nevojshme të theksojmë se Vajgandi me siguri nuk ka të drejtë kur për tingujt *kj*, *gj* vetëm për përdorimin në arbënishte – përdor shenjën *d'*: *ĝ*, siç është *d'uni* (gjuni), *d'ua* (gjuha), *d'ingōju ngas*, *ngō* (Weigand, o.cit., 186). Kjo nuk mund të pranohet, sepse do të kuptohej se grupet e njohura konsonantike *kl'*, *gl'* në të folmen arbëneshe u ruajtën si *ċ* palatale ose *ć* (*tś*); *ĝ* (*d'*, *dź*); përkundrazi, grupet arkaike konsonantike në gjuhën e arbënesheve të Zarës u zëvendësuan me *kj*, *gj* si në një pjesë të mirë të të folmeve geqe, pra edhe në të folmen e truallit të vjetër të

arbëneshëve të Zarës. Me siguri, Vajgandi edhe këtu përdori korrigjimin, sepse, nëse kjo do të ishte e saktë, do të duhej të shqiptohej *kĕn*, *me kĕjō*, siç ekziston edhe faktikisht në arbënishte.

Kur ka vënë në spikamë dukurinë e kalimit të shpeshtë të tingullit *f* në spirantin interdental *v* (th), atëherë është dashur të jetë i kujdesshëm dhe i matur që të mos bëjë gabime të shembujt të cilët nuk bëjnë pjesë në gjirin e dukurisë për të cilën flet ai. Janë të saktë shembujt vijues: *priv-i* < *prif(t)* < *praebiter*. Megjithëkëtë, nga dy paralelet *uvul* dhe *uful* e para me siguri është më e vjetër; prandaj Vajgandi nuk ka të drejtë që për të vërtetuar pohimi i tij – merr edhe shembullin *uful* > *uvul*, gjoja se tingulli *f* është kthyer në *v* që të vërtetojë arsyen e pohimit të sipërm, ai sjell edhe *ńov* < *ńof*, që do të thotë se tingulli *v* është përfutur nga *f*. Mirëpo, kjo kurrsesi nuk mund të qëndrojë, sepse tingulli *h* është zëvendësim i *k*-së indoevropiane, ndaj *f*-së në fjalën *ńof* është sekondare, lat. *gnosco*. Ky rast ndodh edhe te paralelet *šoh* > *šof*; *ndihe* > *ndife*.

Vajgandi pohon me siguri të plotë se forma e sotme arbëneshë *me še* – është trajtë e shkurtuar nga *me fše(-h)* (Weigand, o.c., 187). Për t'u vërtetuar një gjë e këtillë, është e nevojshme të dihet si ishte ajo në burimet dhe shkrimet e vjetra gjuhësore. Pasiguria është edhe më e madhe kur dihet se *f*, *m*, te trajta *fše(h)*, *mšef*, janë prefikse folore, e kjo do thotë se trajta fillestare shqiptohej *seh* > *šef*, *fšeh*: *mšef*. Nuk përjashtohet mundësia që në këtë të folme është ruajtur forma arkaike *še* (*h*).

Vërejtje të tjera për tekstet e Vajgandit parimisht nuk kemi. Vërejtjet e bëra kanë të bëjnë me korrigjimin dhe përmirësimin e disa tingujve fonetikë, që më mirë mund të thuhes se ata u përkasin disa veçorive fonetike që ekzistojnë në arbënishte, mirëpo në një masë shumë më të vogël sesa i paraqiti shkencëtari gjerman Vajgandi. Unë kurrsesi nuk dyshoj se informatori i Vajgandit Maroviqi ka folur me atë gjuhë që na e prezenton Vajgandi, mirëpo duhet pasur parasysh fakti se a është folur një gjuhë e tillë në Arbënesh të Zarës, përkatësisht a ishte kjo gjuhë amnore e arbëneshëve të Zarës në atë kohë.

Lëndën e vet gjuhësore Vajgandi e mblodhi nga njeriu i brezit të vje-

tër, duke mos e vërtetuar më te *njerëzit* e brezit të ri. Nga kjo del se gjuha e teksteve të Vajgandit është gjuhë e brezit të vjetër të arbëneshëve të Zarës. Sipas të gjitha gjasave, Vajgandi qëndroi në Zarë një kohë të shkurtër dhe lëndën e mbledhur gjuhësore e shënoi vetëm prej një njeriu, që konsiderohet veprim i gabuar dhe i padrejtë, sepse ajo e folme nuk mund të merret si gjuhë e folur e arbëneshëve të fillimit të këtij shekulli. Sidoqoftë, duke pasur parasysh kohën e shkurtë të qëndrimit të Vajgandit në Zarë dhe ngutësinë në këtë punë, tekstet në tërësi, duke përjashtuar aty-këtu rastet e korigjimit të disa trajtave, përgjithësisht janë shënuar mirë.

71. Vepra e vogël historike e famullitarit Qurkoviç, - *Povijest Arbana kod Zadra*, Shibenik 1922 (3-33), kryesisht nuk ka asgjë të panjohur për arbëneshët e Zarës, edhe pse autori i punimit në fjalë përveç studimit *La colonia albanese di Borgo Erizzo* të Tulie Erberit – u mbështet në regjistrat e amzës të famullisë arbëneshë dhe në traditën e gjallë të bashkëvendasve të vet të Zarës.

Çurkoviçi, në saje të të treguarit të vendësit Don Shime Stipçeviqit të nderuar, e qëlloi lokalizimin e arbëneshëve të Zarës, e këto janë Brisku dhe Shestani, që i përkasin juridiksionit të Tivarit. Këtë ia dëshmuar edhe ushtarët e Zarës dhe të Arbëneshit, të cilët gjatë kohës së Luftës së Parë Botërore, kishin kryer shërbimin ushtarak pikërisht në viset që konsiderohen trualli i vjetër i arbëneshëve të Zarës.

72. Në mbështetje të dokumenteve të reja, deri më sot të panjohura, në Arkivin e Zarës, arbëneshi K. Kërstiq, po përgatit një studim të gjerë për shpërnguljen e stërgjyshërve të arbëneshëve të Zarës dhe të rrethinës. Siç më njofotn, Kërstiqi ka ndërmend që në studimin e vet të përfshijë jo vetëm historinë e arbëneshëve të Zarës, por do të bëjë edhe përshkrimin e së folmes së saj. Ekstraktin e këtij studimi, me rastin e 225 vjetorit të ngulimit të parë të arbëneshëve të Zarës, ai e botoi në *Glas Zadra*, 1951/30.

Siç shihet nga ky ekstrakt i botuar, Kërstiqi i kishte përmirësuar shumë përfundime të gabuara të autorëve të mëparshëm që kishin shkruar për fatin historik të arbëneshëve të Zarës. Para së gjithash, këtu gjejmë

mendimet e Erberit⁴⁴ dhe të Çurkoviçit⁴⁵ që bëjnë fjalë për shkaqet e shpërnguljes së stërgjyshërëve të arbëneshëve të Zarës: gjoja se ndjekjet fetare, çnderimet e dhunimi nga ana e turqve i detyruan të arratisen. Ndërsa Kërstiqi përmend këto arsye për shkak të cilave ata e braktisën truallin e tyre të lashtë: 1) për shkak të murtajes, e cila në atë kohë kishte përfshirë edhe këtë pjesë të Ballkanit, e kundër së cilës turqit nuk ndërmerrnin asgjë, kurse venedikasit zhvillonin luftë sistematike kundër përhapjes së saj; 2) grindjet e vazhdueshme, vjedhjet e grabitjet, zjarret, hakmarrjet ndërmjet popullatës turke, malazeze dhe pashtroviqve, ku më tepër pësonin popullsia e trevave kufitare; 3) dërgimi me dhunë në ushtri dhe mbledhja e mercenarëve për luftë që kishte shpërthyer në mes Turqisë dhe Persisë e cila zgjati prej 1725 e deri më 1736.

Ai korrigjoi mendimin e të gabuar të Tulio Erberit,⁴⁶ se në shpërnguljen e parë kishte të arratisur nga Brisku, ndërsa dyndjen e dytë e përbënin të ikurit⁴⁷ nga Shestani dhe rrethina. Përkundrazi, Kërstiqi, në bazë të dokumenteve, vërtetoi se në dyndjen e parë kishte të shpërngulur nga Brisku, Pniçiqi, Shestani, ndërsa në të dytën – nga Shestani, Larja, Brisku.

Kërstiqi korrigjoi dhe një hutim tjetër të historianëve të mëparmë që u morën me çështjen e fatit të arbëneshëve të Zarës; në të vërtetë është fjala për bindjen se të ikurit e parë u vendosën nën vendin e quajtur *Shamark*, te fabrika e duhanit në fshatin e sotëm Arbënesh të Zarës, siç pohonin Erberi, Qurkoviçiqi e të tjerë, kurse Kërstiqi tregonte se vendbanimi më i vjetër arbënesh në fshat shtrihej buzë rrugës kryesore nën kishë (shtëpia Petani) afërsisht deri te rruga që pothuaj shpie drejt gjirit të Bregdetit (te Vani i Joviçiqit); K. Kërstiqi, *Zadarski Arbanasi*, Glas Zadra, 1951/ 30.

Zakonisht thuhet se në pjesën verilindore të fshatit banojnë arbëneshët, që erdhën nga Brisku; në jug të kishës u vendosën kolonistët e ardhur nga Shestani, ndaj mendohet se tingujt e parë *v, δ*, shqiptoheshin si *s, t* e

⁴⁴ Erber Tulio, o.c. f. 23.

⁴⁵ Çurkoviçiq, o.c. f. 10-II.

⁴⁶ Tulio Erber, o.c. 60-61.

⁴⁷ Çurkoviçiq, o.c. f. 9.

trashë polake ose sikur *ʃ* e benovasve në fjalët *vlah, lula*, (Çurković, op.cit., 9). Para së gjithash, nëse δ interdental shqiptohet si *ʃ* e polonishtes, atëherë ajo nuk është e mirëfilltë, siç mendon Çurković, por jo e mirëfilltë.

Pohimi se popullata e fshatit Arbënesh deri te kisha flet në një të folme, kurse prej kishës e tutje në një të folme tjetër mendoj se është i paqëndrueshëm, për shkak se kolonistët si në dyndjen e parë po ashtu edhe në dyndjen e dytë u përzien me të ikurit nga Brisku dhe Shestani. Se ka dallime të vogla në të folmen e arbëneshëve të Zarës ajo është e vërtetë.

Dallime ka ndër disa familje ose, më mirë të thuash, te disa individë, te cilët diftongun *ua* e shqiptojnë në trajtën e tij arkaike *uo*, ndërkaq disa të tjerë, shumica e tyre, e shqiptojnë *ua: me škuo me punuo, gruo: me škua, me punua, grua*. Unë mendoj se popullata arbëneshë solli me vete këto dallime në shqiptim, siç janë: diftongu *uo*, sipas bindjes sonë, u soll bashkë me kolonistët nga Shestani, Pinçiqi, Muriqi, ndërsa diftongu *ua* nga Brisku, Larja, Dobreci. I pari është ruajtur mirë edhe në të folmen e truallit të vjetër në Shestan, Pinçiq, në trajtën e vet arkaike, do të thotë *uo*; në të folmen e Briskut dhe të Larjes diftongu kaloi në trajtën *ue: me punue*, të dialektit gegë që është trajta më e përhapur.

Dallime ka edhe në shqiptimin e spiranteve interdental *v, ɖ*: disa individë i shqiptojnë mirë; kryesisht është i drejtë spiranti i shurdhët ndërdhëmbor *v*. Ndërsa te disa të tjerë këta kanë kaluar në *s, ʃ, l*. As në të folmet e Krajës nuk janë ruajtur tingujt e përmendur – tingulli δ në *Shestan*, kryesisht ka kaluar në velaren *ʃ*– që në të folmen e Briskut e të Ljarës ka filluar ta zëvendësojë *ʃ*-në e trashë. Tingulli *v* në të folmet e Krajës ka mbetur i paprekur. Sa u përket këtyre dallimeve në të folmen arbëneshë, unë personalisht mendoj se ato e heqin zanafillën qysh nga trualli i lashtë, sepse ndryshe nuk mund të kuptohej pohimi se dallimet në të folurit e arbëneshëve pasuan më vonë në truallin e ri.

III. PEJARDHJA E ARBËNESHËVE TË ZARËS – LIDHJA E TYRE ME TRUALLIN E LASHTË

(Shestani – Brisku)

73. Ardhja e turqve në Ballkan shkaktoi një përzjerje të tërë ndërmjet popujve ballkanikë. Heroi shqiptar Gjergj Kastrioti – i quajtur Skënderbe, me një grusht shqiptarësh u bëri rezistencë këmbëngulëse hordhive turke, mirëpo pas njëzet vjetësh luftë vdiq si komandant ushtarak i këtij populli të vogël e trim. Vendin do ta ndërmerrnin përsëri hordhitë turke. Popullsia shqiptare e grykave të maleve fillon rishtazi të tërhiqet në drejtim të veriut, duke u strehuar në strehimore të sigurta. Kjo gjendje zgjati deri në shekullin XVIII, mirëpo më vonë shqiptarët braktisën gjirin e vendlindjes së tyre dhe kërkuan strehim në viset veriore.⁴⁸ Në kohën e Venedikut ata shërbenin si “viktima” jo vetëm në qytetet e Ballkanit, por edhe në Dalmaci e Lompardi. Edhe dubrovnikasit e kotorasit kishin grupe shqiptare, të cilët rekrutoheshin, një pjesë e tyre në Zetën venedikase, një pesë në trevat e despotëve serbë”; khs. Shufflay, *Povijest sjevernih Arbanasa, Arhiv za arban.star.jezik e etnologiju, II, libri II, 224*. Kur filloi të përhapet murtaja edhe në Ballkanin e Turqisë, e cila shkatërronte pamëshirshëm jetën e shëndetin e njerëzve, e kundër kësaj sëmundjeje vdekjeprurëse turqit nuk ndërmorën kurrnjë hap serioz; kur filluan edhe konfliktet e pandërprera kufitare, më në fund ia mërzitën jetën, dërgimi me dhunë në ushtri, rekrutimi i mercenarëve në luftë, që shpërtheu në mes Turqisë dhe Persisë, gjendja u bë e padurueshme, - me gjithë ndihmën e përzemërt, të Vinëenc Zmajeviqit, me 1726, nga Kraja e Malit të Zi – nga Brisku e Shestani shkuan në Zarë 19 familje. Kjo ishte shpërngulja e parë e shqiptarëve të Krajës për në viset e veriut. Pas një kohe, disa vjet më vonë,

⁴⁸ Nuk duhet të harrojmë se shqiptarët në shekullin XVIII, duke pranuar islamizmin, depërtuan deri në Nish e Toplicë dhe i banuan me këtë rast trevat e pabanuara të Kosovës dhe Metohisë, shih Tomiq, *O Arnautima u staroj Srbiji*, 1913, f. 40. Në Kosovë, e veçanërisht në Metohi, sipas burimeve historike, edhe përpara kishte vendbanime shqiptare.

më 1733, bëhet shpërngulja e dytë e shqiptarëve nga Shestani dhe e rrethinave të tjera, ku kishte 28 familje me 199 anëtarë. Shënimi i lokaliteteve i përmendur nga Shufflai;⁴⁹ “me seli në Zarë il governatore Ghinicon 200 Albanesi”, duhet marrë sikur shqiptarët shërbyen edhe në ushtrinë venedikase si mercenarë, mirëpo këta shqiptarë nuk knaë asgjë të përbashkët me arbëneshët e sotëm të Zarës, për të cilët me siguri dihet se këta në Zarë u vendosën jo më 1602, por më se njëqind vjet më vonë. Pushteti venedikas me ndërmjetësimin e politikanit të përmendur kishtar dhe shkrimtarit Vinçenc Zmajeviqit, të ikurve u dha pasuri dhe u ndërtoi ndërtesa banimi në pronën e klerikut Gjoni i Tmerrshëm. Lokacioni i falur gjendej në jug, jashtë qytetit të Zarës, sot pjesë përbërëse e tij. Shqiptarët këtë vendbanim e quajtën *Arbënesi*; kroatët në fillim e quajtën – Ericino selo; italianët – *Borgo Erizzo*, sipas providitorit Nikola Eriçi; kroatët më vonë e quajtën *Arbanasi*. Sipas mendimit të Taljavinit, (*Albanese di Dalmazia, a f. 71*), që “*Il nome locale Arbăneş è di origine croata, arbănor e arbănişt sono sicuramente indigeni*”, në asnjë mënyrë nuk do të jetë i saktë: emërtimi nuk do të jetë me origjinë kroate, sepse kësaj i kundërvihen edhe arsyet fonetike nga njëra anë, e nga ana tjetër edhe ndjenjat e arbëneshëve të Zarës ishin të forta për një emër të një vendi të tillë, ndaj nuk është çudi që ata vendbanimin e tyre e quajtën *Arbăneş*; khs. *Arbneş* – emër fshati rrëzë Taraboshit. Kjo nuk është asgjë e re,⁵⁰ sepse emërtimi *Arbeneş*, *Arbereş* – në të vërtetë ndeshet si emërtim për shqiptarët mjaft herët. Ai është në përdorim edhe sot e kësaj dite si në të folmet toske po ashtu edhe në të folmet gege (khs. M. Ressuli, *Raporti kronologjik i trajtave: Arbneşh – shqiptar*, Leka, VIII, N^o 1, 1936/38-39); për emërtimin

⁴⁹ Šufflay: “*Počeci sjeveroarbanaske kolonije u Borgo Eries (BorgoErizzo)*”. Fillet e kolonisë shqiptare të veriut në Borgo Erico (Borgo Erizzo) afër Zarës janë edhe më të vjetra sesa konsiderohen ato”; Thaloczi, *Illyrisch0albanische Forschungen, I, 322*; Weigand, *Der gegische Dialekt vou Borgo Erizzo*, Jahresheicht des Instituts für rumänische Sprache, 1911 vit. 1602 me seli në Zarë, il governatore Paolo Ghini con 200 Albanesi”. (Horvat, *Bos.glasnik*, 21/1909/83)”.

⁵⁰ Gabim të rëndë bëri edhe Shpend Bardhi, *Leka*, VII (1935), IV, 185 – 186; kur pohoi se trajta *shqiptar* kronologjikisht është më e vjetër se trajtat *Arbënesh*, *Arbëresh*, dhe se kjo trajtë prandaj është formë e vonshme *te italo-arbëreshët* dhe arbëneshët e Zarës.

toskë dhe gegë, prandaj nuk mund të thuhet se u pagëzua nën ndikimin e emërtimit kroat Arbanasi.

74. Nëse mbështetemi në traditën e arbëneshëve të Zarës, atëherë mund të përfundojmë se stërgjyshërit e arbëneshëve të sotëm të Zarës u shpërngulën nga Brisku e Shestani, dy fshatra në lindje të liqenit të Shkodrës. Për t'u bindur se stërgjyshërit e tyre u shpërngulën nga vendet e përmendura mjafton të shikojmë onomastikën e arbëneshëve të Zarës: *Marco Nicadobrez* (Erber, o.c., 42); *Pietro Pinčić*, Sestani (Illyrisch-albanische Forschungen I, 328-329. Brezi i sotëm i Zemunikut, që nuk e ndien më veten arbënesh, e as e konsideron veten me prejardhje arbënesh, ende mban emra dhe mbiemra shqiptarësh: *Paleka, Šestan, Pinčić, Prenda*, etj. Është e pakontestueshme se mbiemrat e këtillë, që janë në përdorim edhe sot e kësaj dite tek arbëneshët e Zarës, historianëve mund t'u shërbejnë si rrethanë lehtësuese në përcaktimin e trullit të tyre të lashtë.

Në mbiemrin *Šestani – Šestanović* ndeshemi shumë më herët se vendosja e arbëneshëve zaras në Dalmaci. Qysh në shekullin XIV në qytetet bregdetare të Dalmacisë ndeshim shqiptarë me mbiemër *Šestani – Šestanović*, të cilët atje rëndom merren me tregt, shërbejnë si priftërinj, mësues, etj. Këtë e dëshmon edhe mbiemri *Šestanovich*, Ragusaner Kaufleute im XIV Jahrhundert, vgl. Sestan”, *Jireček Die Romanen in den Städten Dalmatiens Während des Mittelalters*, III, 60; *Sestan*: 1) *S. Sextan, Presbyter Ostoia S.* aus Antivari, 1445, Div. rag. Filii Petri S., 1913-1446). Jorga, *Notices et extraits I*, 212 und. 3, 215 – 216; 2) *In Cattaro presbyter Johannes f. Sestani* (Sestagni) c. 133, - *von einem Ortsnamen. Dorf Sestani auf dem Westufer der Sel von Scutari Villa degli Sestan* 1409, khs. Jireček, *Romanen*, III. 60. Siç shihet, emri *Shestani* përmendet mjaft herët, qysh më 1409, khs. Regjistrat e Sima Lubiçit, VI, f. 22, lib. VI. J. ak. Znanosti i umjetnosti. “*Et remaneat similiter sancta Maria de Rotezo cum suis confinibus, villis de li Sestan, intelligendo, quod ser Marinus de Elia possideat territoria sua, que habet in Propat*”).

Marian Bolica, nga familjet e njohura aristokrate të Kotorrit më 1614, shkruante në raportin e vet të njohur *Relatione et descriptione del*

Sangiacato di Scutari – se në Shestan në atë kohë ishin 100 shtëpi me 260 luftëtarë, ndërsa fshati i vogël *Muriq*, që gjendej pikërisht në bregun perëndimor të liqenit të Shkodrës, kishte 20 shtëpi me 50 luftëtarë, komandant, i të cilëve ishte *Gjon Muriqi*, khs. Shime Lubiq, *Starine*, XII, 156-193.

Më vonë, siç del nga libri i Ivan Markoviqit: *Dukljansko-barska mitropolija*, 1902, ndeshim të dhënë se në *Ljare* të Krajës së Malit të Zi, 1749, u transferua për kryepeshkop, peshkopi i Sapës shqiptar nga Shkodra – *Llazar Vlladanji*, i cili vdiq në moshën 78 vjeçare në famullinë malore të dioçezës së Tivarit, në *Ljare*, më 5 janar 1786; I. Markoviq, o.c., 151. Kjo flet qartë për ekzistencën e shqiptarëve të besimit katolik në *Ljare* në atë kohë, e që do të thotë se një pjesë e kësaj popullsie u shpërngul në *Zarë*.

Shkencëtari gjerman G. Von Hahn në veprën e vet *Reise durch die Gebiete der Poretsch und Vardar*, shkruante se “Shestani dhe *Ljare* gjenden afër Liqenit të Shkodrës dhe se atje flitet shqip (arnautçe), sepse banorët janë shqiptarë “albanezë”. Më tutje Hahn thotë: “Ka Shestan të Poshtëm dhe Shestan të Epërm. Në të epërmin bëjnë pjesë fshatrat: *Gurza*, *Lukiq*, *Dedanj* dhe *Bardanj* (shqip Barđan-Bardhanj), ndërsa në të poshtëmin: *Gruvace*, *Karolaj*, *Marnikaj*, *Bjugeri* (tre emrat e parë nuk më shkoi për dore t’i identifikoj, ndoshta mund të jenë shënuar gabimisht – I. A.).

Shestani gjendet në kufirin malazias. Banorët nuk paguajnë kurrfarë haraçi. Më 1875 kishte 1579 frymë. Famullia e *Ljares* përbëhet nga këto fshatra: *Ljare*, *Paiçi*, *Dobreci*, *Brisku i Epërm* dhe *Brisku i Poshtëm* dhe *Ftjani*; më 1875 kishte 440 frymë”; khs. Hahn *Reise* f. 526-529. Gjatë vizitës sime në Shestan, mësova se Shestanin e Poshtëm e përbëjnë këto fshatra: *Marstjepanj* (dikur thirrej *Bujgri*, gjegjësisht *Bulgri*); *Karanikiqi* (më parë *Ndreka*), që kishte dy paralagje, prej të cilave e poshtëmja thirrej, e edhe sot mban këtë emër – *Peshqjer* që në të vërtetë ka kuptimin: *poshtë, nën, përfundi*; *Gurak* (serbisht Đuravci) dhe *Pecanj* (serbisht Dračevica), popullata e së cilës përdor dygjuhësinë dhe është me besim ortodoks.

Unë kam krahasuar mbiemrat e vjetër të shqiptarëve të Shestanit me mbiemrat që përmenden te Erberi, por mjerisht, me përjashtim të një mbiemri, nuk kam hasur në emra identikë, përkatësisht nuk kam hasur në

përputhje ndërmjet mbiemrave të shqiptarëve të Krajës dhe arbëneshëve të Zarës. Megjithëkëtë, mbiemrin Perçobanj e ndeshim si ndër shqiptarët e Zarës po ashtu edhe ndër shqiptarët e Krajës: *Giov, duca detto Ciobo, Pietro Duca detto Cioba*, te arbëneshët e Zarës (shembulli i fundit është cituar nga libri i Erberit – *La colonia albanese di Borgo Erizzo*, f. 58). Si të shpjegohet atëherë fakti që arbëneshët e Zarës nuk i ruajtën mbiemrat e tyre që i kishin në truallin e lashtë? Dihet se shqiptarët mbajnë nga dy mbiemra: njëri është familjar, për të cilin di vetëm rrethi i ngushtë farefisnor, në rastin tonë i gjithë fshati, ndërsa i dyti është mbiemër zyrtar, që gjithsesi e morën pas vendosjes në Zarë. Zakonisht mbiemrat familjarë, kryesisht sipas trajtës, janë shqiptarë; shpesh na kujtojnë emrat e familjeve ose fshatrat e vendlindjes, ndërsa të tjerët janë me origjinë krishtere – kroate; khs. Çurkoviç, o.cit., faq. 32.

Meqë dhamë disa vërejtje me të cilat vërtetuam ekzistimin e vendeve Shestan dhe Brisk si truall i vjetër të arbëneshëve të Zarës, ku kumti i parë lidhet me shekullin XV, është e nevojshme të japim një pasqyrim të kushteve jetësore të shqiptarëve të sotëm të Shestanit dhe të Briskut.

Në të vërtetë, ne në fillim të këtij kapitulli mblodhëm disa të dhëna me të cilat, ndoshta, kemi vërtetuar ekzistimin e Shestanit me ndihmën e emrave vetjakë. Të dhënat janë shtruar, duhet pranuar, pa ndonjë kontinuitet, të palidhura, mirëpo sidoqoftë dëshmojnë se vendbanimi Shestan është mjaft i vjetër. Kur është fjala për përcaktimin e vjetërsisë së vendeve të përmendura, atëherë nuk duhet ta largojmë prej mendësh se *Shestani* i përket krahinës ku popullsia shqiptare dhe serbe kishin kontakte ndërmjet tyre shumë herët, gjithsesi në mesjetën e hershme. Një vend i vogël sot fshat me 60 shtëpi, i quajtur *Bes* – përmendet në A. Alb. I. 172 – (1231 – 1 septembris – 1242), shumë herët, qysh në shekullin XIII. Ai sigurisht, përmendet si katund shqiptar nomad (*Vir* dhe *Bes*), prej nga del se: ni Arbanasin da ne ima zu zimovišt – *Albanenses ne habeant hiberna*”. Emri i *Virit* të sotëm sipas të gjitha gjasave rrjedh nga fjala shqipe *veři* – “kullosë dimri”, Shufflaj, *Povijest sjevernih Arbanasa*, f. 36 (cituar sipas ekstraktit). Gjurmët e emrave shqiptarë i ndeshim edhe më tutje në

perëndim, në thellësi të Malit të Zi, ku sot askush nuk flet shqip. Procesi i amalgamimit në këtë trevë vazhdon sot e gjithë ditën. Popullsia shqiptare e Shestanit edhe sot është bilinguale: vetëm fëmijët nuk dinë “nashke”, që do të thotë serbisht. Të gjithë të moshuarit dinë serbisht, ndërsa gjuha familjare është vetëm shqipja. E kjo është e natyrshme, sepse kjo botë njerëzish, qofshin burra, qofshin gra, janë në kontakt me popullatën serbe të Tivarit, Virpazarit, ku shqiptarët e Shestanit shkojnë të blejnë artikuj të nevojshëm jetësorë, nga njëra anë, por edhe vendbanimet malaziasë nuk janë aq larg prej tyre, nga ana tjetër, shqiptarët e Shestanit shpesh edhe lidhin miqësi me malazezët fqinjë: rëndom malazezët martohen me shqiptarët e Shestanit, Briskut dhe të fshatrave të tjera, të afërta të banuara me shqiptarë.

Meqë dihet se shqiptarët dhe malazezët në trevën e përmendur të Zetës, së vjetër me shekuj jetuan në simbiozë, atëherë aspak nuk duhet të na habisë fakti përse shqiptarët i huazuan thesar leksikor fqinjit të tyre të drejtpërdrejtë, edhe pse jo në atë masë aq sa ata morën nga bashkëfistarët e tyre. Të përmendim disa sosh. Fjalë shqipe më tepër ndeshim në të folmen e fisit Kuç, e kjo për shkak, siç dëshmon historia, dikur kuçët kanë folur shqip, e më vonë pësuan ndikimin sllav deri në atë shkallë sa që ky fis sot – pjesa më e madhe, është malazez; vetëm një pjesë e vogël e tij flasin shqip. Është pra e natyrshme se toponomastika në trevën e Kuçit është kryesisht shqiptare. Po marrim shembull *Djutedza Pusat* (16, 22 – Stev. Duçiq, *Život i običaji plemena Kuča* 1931). Edhe njëri emërtim edhe tjetri janë me origjinë latine, i pari nga lat. *Civitatem* > *kütet*+sufiksi deminutiv *-ze*, *kütedze*, nga e njëjta fjalë latine u krijua *Cavtati* ynë; *Pus* <lat. *puteus*. Do të zëmë ngojë edhe disa fjalë shqipe të huazuara në të folmet serbo-kroate:

bucak=enë e drunjtë për të mbushur ujë; khs. studimin e Ivan Popoviqit, *Einige albanische Lehnwörter im serbocroatischen*, Zeitschrift für slavische Philologie, Band XXIII, Heft. 1. 1954, f. 121 – 133; F. Cordignano, *Dizionario alb. ital., ital.albanese*, Milano, 1934; Luk Lukaj, *Fjaluer shqip serbohrvatisht*, Beograd, 1935;

koa, *kua* = kohë, nga shqipja *koha* = (vreme); fjala është në përdorim te serbët e Kosovës, po ashtu edhe në të folmet maqedone;

rānj – Vuku e përmend këtë fjalë në kuptim “njëfarë druri si qarri, ose dushku”.

E ndeshim edhe te Erdelanoviqi – *Srpski etnografski zbornik*, XXXIX, 500 – dhe te Joviçeviqi, *Srp, etn, zbornik* XV, 535; *Ranjev Do*, Erdelanoviq a.a.o.; *Ranjska Glavica*, Joviçeviq, a, a, o. Fjala është me origjinë shqipe nga *rañe* në gegërishte, *rēne* në toskërishte, në kuptimin *rrënjë, rrëzë*.

Popoviqi (o.c.) sjell edhe shembujt *štilja, štiljega, štiljeza* “Zwirnspindel”. E përdorin Bjelopavliqtë dhe Kuçët – *Srp. etn. Zbornik*, XLVIII, 30. Prejardhja e saj duhet kërkuar nëa fjalën latine *hastilia*, prej së cilës me të drejtë u reflektua fjala shqipe *štil'e, štil'eze, štijez; štize*. Kjo është *l* e tretë latine intervokalike që në gjuhën shqipe është reflektuar me *l'* të butë, që sot në pjesën dërrmuese të të folmeve gege dhe toske është jotizuar.

Me origjinë shqipe gjithsesi janë edhe fjalët *grep* (= *udica*, 67); *fošnja* (209), *fošnjica*; shqip *fošñe* = fëmijë i porsalindur; *andrak* (145, st. Dučić) = kaçubë e madhe – *Srp. etn. zbornik*, XLVIII.

75. Me interes të veçantë për studimin historik të gjuhës shqipe është elementi sllav në të folmet e Krajës. Studimi i këtij elementi ndihmon në ndriçimin e lashtësisë së popullsisë shqiptare në trevën e Krajës së Malit të Zi. Së këndejmi duhet përfshirë edhe rëndësia e toponomastikës së trevës së Krajës – në të cilën shpesh janë ruajtur fjalët, që sot kanë dalë nga përdorimi i gjuhës së flur te shqiptarëve të Krajës. Po përmend disa nga këto, edhe pse nuk tregojnë pothuaj asgjë nga lashtësia e elementit shqiptar në këto vise: *bra-bren*⁵¹ = emër përroi, ose burimi; për arbënisht shih: Tagliavini, *L'Albanese di Dalmazia*: *brō, breni* = tra, që sigurisht ka lidhje me fjalët serbokroate *brv, brvno*, ku *vn* me asimilimin në gjuhën shqipe ka dhënë *n*, sipas ligjit të njohur fonetik grupi konsonantik *vn* në të folmet shqipe asimilohet, për shembull *borovnica* > *boroniç, Libovnik* >

⁵¹ A. Joviçević, *Naselja*, II (1922), f. 45, 64.

Libonik. Kjo mund të shpjegohet me tendencën e përgjithshme të gjuhës shqipe që të eliminojë bashkëtingëlloret e zëshme intervokalike (Leskovac, përkatësisht *Leskovc>Leskoc* në shqipe: *Bujanovac > Bujanovc> Bujanoc; Trnovac > Ternavc > Ternoc, sclavinica > škinike; ograda > ograie*, ku jështë epentetike;* *uda>uje - jpërsëri është rezultat i epentezës.*

Toponomastika e Krajës është plot e përplot me fjalë të origjinës shqipe. Ne kësaj here nuk do të ndalemi në to, por do të ndalemi vetëm në ata emra vendesh që konsiderohen truall i lashtë i arbëneshëve të Zarës. *Briska* rrjedh nga fjala shqipe *brisku*; *Livare*, trajta shqipe *Ljare* – nga fjala shqipe *livare, livaria* me kuptim *katarakt, ujtare*; fjala është kompozitë, nga prefiksi *I+var* (=le, la, li), *la+vjeŗa, la+tred, lebardŗe=le+bardŗe, l’efût = le+fût I* (e, *vurŗ=I*(e) +*vurŗ*; prandaj, toponimi *Livare* (pas rënies së *v*-së zëshme labiale intervokalike: *L’are*) është me prejardhje shqipe.

Shestanët asnjëherë nuk kanë përfaqësuar fshat të veçantë, por kanë përfaqësuar trevën ku bënin pjesë disa paralagje, siç janë: *Dedanj*(serbisht *Dedić*), *Bardanj* shqip *Bardań* (serb. Bardić), *Gurza, Lukiqi*, këto bëjnë pjesë në Shestanin e Epërm; kurse Shestanit të Poshtëm i përkasin këto fshatra: *Karanikiqi*, (dikur *Bulgri, Bujgri* që shqip do të thotë *bulger*=njëlloj lisi, bung), lagja e të cilit quhej *Peštjer*, që tekstualisht ka kuptimin (lagjia) “e poshtme”, *Marstjepanj* (Marstjepović); *Durać*, (Đuravci), *Dračevica*; shqiptarët shestanad e quajnë *Pecanj*, sipas emërtimit fisnor.

Brisku dhe *Larja* nuk kanë qenë pjesë përbërëse e Shestanit. Këtu bën pjesë edhe paralagjia *Dobreci*, toponim me prejardhje sllave – dobër+sufiks – *ć*; fjala *doběr* këtu ka kuptimin e rrëzës, rrafshit, që saktësisht i përgjigjet konfiguracionit të trevës nën shpatet e Rukmisë. *Pinćićet* me paralagjen *Rjeps*, ka 29 shtëpi me 160 banorë. Sipas të gjitha gjasave, ky emërtim nuk është i vjetër, ai mund të jetë emërtim vëllazërie nga e mori emrin e tërë fshati. Emri i paralagjes *Reps, Rjeps* – nuk di se ç’kuptim ka, vetëm nëse ka lidhje me *riŗepes, riŗeps*, nga folja *riŗep*- me rripë lëkurën, në kuptimin figurativ bartës edhe njeri i varfër, i gjorë.

Nuk më është e njohur se ç’do të thotë emri *Shestani*. Joviqeviqi

(o.c.f. 69) i beson gojëdhënës, se si në atë vend në kohë të lashta ngulën për të banuar gjashtë vëllezër, e në këtë mënyrë u krijua ky vendbanim. Kjo nuk mund të jetë kështu, aq më tepër se deri më tani askund nuk është vërtetuar se emërtimet e toponimeve bëhen në bazë të numërorëve. Një bindje tjetër është se toponimi *Shestan* është krijuar nga fjala shqipe *shes – me shitë*, me *t* epentetike dhe sufiksin *an*, që gjithashtu nuk do të thotë se ky pohim është i saktë.

Emri i paralagjes *Gurza* është nga fjala shqipe *gūr* dhe sufiksin - *ze*. *Bardić* që dëgjohet te popullata malazeze (shqip *Barđan*) nga fjala shqipe *barde* dhe sufiksi – *an*, origjina e së cilës duhet kërkuar në sufiksin latin – *aneus*, *-anius*. *Bardanj* (*Barđan*), sot emër fshati në Shestan, dikur ishte emër kryesisht për farefis, familje. Ky te shqiptarët më së shpeshti është emër familjeje, si te gegët po ashtu edhe te toskët në jug. Sot ky më tepër është ruajtur te malësorët; *Zenel’aj*, *Bicaj*, *Kol’gecaj*, *Gegaj*, *Gjokmarkanj*, *L’ukanj*, *Gjulperanj*, *Vuçanj*, *Gjonaj*, *Perkol’anj*, *Pecanj*. Meqë sot shumë fshatra u krijuan nga anëtarët e një vëllazërie, ky mbiemër familjar u shtri në tërë fshatin, se këso emërtimesh në të kaluarën ishin të shpeshta te shqiptarët, më së miri dëshmon mbiemri i familjes së njohur të *Bogdanëve* (*Cuneus proph. Bd. II, plechienia e sctepisse Bogdagnet*).

I njëjti rast është edhe me emrin e fshatit *Dedaj*, që në ballë të kohës ishte me siguri emër familjeje.

Nga emri i familjes lindi edhe emri i fshatit *Lukiq* që gjendet në Shestanin e Epërm.

IV. POZITA E TË FOLMEVE TË KRAJËS NË GJIRIN E DIALEKTEVE FQINJE TË SHQIPES

76. Caktimi i pozitës së të folmeve shqipe të Krajës në gjirin e të folmeve fqinje të shqipes për shumë arsye nuk është punë e lehtë. Së pari se asnjë nga të folmet fqinje të malësorëve shqiptarë nuk është studiuar⁵² as deri në atë masë sa të mund dëshmohej raporti i njërës së folme ndaj të të folmeve fqinje të të Krajës; së dyti se edhe më pak janë studiuar të folmet shqipe të Krajës që të mund dihet raporti i saj në gjirin e të folmeve të tjera fqinje.

Të dhënat historike lidhur me prejardhjen dhe lashtësinë e shqiptarëve të Krajës gjithashtu janë të varfëra dhe të pakta.

Megjithatë të dhënat e pakta historike tregojnë se shqiptarët e Krajës gjenden në këto vise shumë herët; të dhëna për shekullin e 13-të na ofron *Acta Albaniae*, I (1241), në të vërtetë atje përmendet edhe emri *Bes* – sot vendbanim i vogël buzë bregut të majtë të Liqenit të Shkodrës. Ky emër padyshim ka të bëjë me fjalën shqipe *besë*, besim. Po në këtë të folme përmendet edhe fjala *veri*, në skajin veriperëndimor të Liqenit të Shkodrës, qi sigurisht është *Vir* i sotëm (Vir Pazar), me domethënie *kkullosë dimri*, diërishtë; le të krh. M. Shufflay, *Povijest sjevernih Arbanasa*, botim i *Arhiv za arbanasku starinu, jezik i etnologiju*, f. 36 (cituar sipas separatit).

77. Në të vërtetë, sot ekzistojnë teori, shumë të përhapura dhe të dokumentuara me argumente solide, se shqiptarët nuk knaë banuar gjithmonë në territorin e sotëm. Ata duhet të kenë ardhur nga thellësia e Gadishullit Ballkanik, ku kishin truallin e tyre të hershëm.

Sa i përket truallit të shqiptarëve edhe sot ekzistojnë dy teori të kundërta: sipas njërës teori, shqiptarët janë pasardhësit e ilirëve, të cilët edhe sot jetojnë në trojet e stërgjyshërve të tyre. Teoria e dytë, e cila dita-

⁵² Waclaw Cimochoowski, *Le dialecte de Dushmani*, Poznanj, 1951, (1-233).

ditës gjithnjë e më tepër po arsyetohet dhe vërtetohet me argumente të pakundërshtueshme, veçanërisht me argumente gjuhësore,⁵³ qëndron në pohimin se trualli i sotëm i shqiptarëve është i një date më të vonë; prandaj, trualli i tyre i hershëm duhet kërkuar diku gjetkë, me siguri në brendi të Gadishullit Ballkanik. Beismin tradicional të kontinuitetit të truallit shqiptar që nga kohët antike e deri më sot e mohoi edhe historiani i madh çek K. Jireček në veprën e vet monumentale *Ceschichte der Serben*, I, 152, dhe truallin e hershëm të shqiptarëve e kërkoi në viset malore, ndërmjet Dalmacisë dhe Danubit. Jokli, mbrojtës i dikurshëm i teorisë së kontinuitetit, truallin e lashtë të shqiptarëve e kërkoi në pjesën veriperëndimore të Ilirisë së lashtë të trevës së Ballkanit, ku gjuha trakase ishte në kontakt me ilirishten (H. Barić, *Lingvističke studije*, Sarajevo, 1954, f. 25).

Shtrohet çështja se kur e braktisën shqiptarët truallin e tyre të lashtë dhe e popullzuan territorin e sotëm historik. Sllavisti sovjetik A. M. Selishçev, në veprën e tij të rëndësishme *Slavjanskoe naselenie v Albanii*, Sofje, (1931), 246, mbron mendimin se shqiptarët e braktisën truallin e tyre të lashtë dhe u vendosën në truallin e ri pas sllavëve, prandaj sllavët në territorin e sotëm historik të shqiptarëve depëtuan para tyre. Mendimi i sllavisit sovjetik hasi në kritikë të ashpër dhe të arsyeshme të albanologut vjenez N. Joklit dhe sidomos të H. Bariqit; krh. Jokl, *Slavia*, XIII; *Zur Geschichte des alb. Diphthong ka-ur*, Ing. Forschung, 49, 50, (1932), 42 dhe se H. Bariqi, *Ime reke Bojane*, Ramovšev Zbornik, Ljubljana, 1951, 356-359, *Lingvističke studije*, I, ... *Poreklo Arbanasa u svetlu jezika*, f. 45; por edhe në *Hymje në historin e gjuhës shqipe*, f. 48. Nga emri antik i lumit Buna – *Barbanna* me ndërmjetësimin e shqipes përfundoi sigurisht në trajtën *Bauanna*, nga e cila shumë lehtë përfundoi në trajtën e sotme *Bojana*; a e patheksuar në truallin sllav u përftua në *o: Salona > Solin*, në vend të jndeshim shpesh *v. Motajica > Motavica*. Pra, nga trajta *Bauanna* shumë lehtë ka mundur të përfundojë në trajtën e sotme *Bojana*, madje me mjete të gjuhës serbokroate. Mirëpo, shtrohet çështja a thua me

⁵³ H. Barić, *Albanorumänische Studien*, q, 1919, 19; nga i njëjti autor: *O uzajamnim odnosima balkanskih jezika*, f.27.

ndërmjetësimin e serbokroatishtes do të mund të evoluonte nga trajta antike *Barbanna* në trajtën e sotme *Bojana*. Me ligjet fonetike të kësaj gjuhe – jo, kurrsesi, ndërkaq, me anë të *shqipes – shumë lehtë*. Është e ditur se gjuha shqipe njuh *n* labiale, e cila në pikëpamje akustike dhe fonetike është e ngjashme me nazalen *r*, ligj të cilin e vërtetoi Holger Pedersen në studimin e vet fundamental mbi të folmen e çamërishtes (*Albanesische Texte mit Glossar*, III) edhe Pekmezi (*Gramatik der alban. Sprache*, 13). Tingulli *r* në *Barbanna* ka rënë, madje, me ndërmjetësimin e disimilitimit të nazales *r*, me këtë mund të shpjgohet, do të thotë *r* nazale dhe *n* labiale në gjuhën shqipe, e kjo gjithsesi e pa kurrfarë dyshimi është dukuri parasllave, sepse rotacizmi, i cili në gjuhën shqipe mbështetet në identitetin akustik dhe fonetik të *n* labiale dhe *r* nazale, nuk i ka përfshirë as elementet më të vjetra sllave në gjuhën shqipe.

78. Shkencëtarët në këtë rast i hutoi rrethana se toponimet e zonës gjuhësore dhe të territoreve historike të shqiptarëve nuk kanë fizionominë fonetike të gjuhës shqipe, do të thotë toponimet në trevat përkatëse nuk kanë pësuar ndërrime fonetike të cilat do të dëshmonin se shqiptarët jetonin që në krye të herës në territorin ku sot jetojnë. Mungesa e terminologjisë indigjene bregdetare në gjuhën shqipe flet qartë në favor të së dhënës se shqiptarët në truallin e tyre historik u vendosën vonë. Nuk duhet lënë manash një gjë: se shqiptarët në truallin e tyre historik u vendosën gjithsesi para sllavëve, do të thotë para ardhjes dhe depërtimit të tyre në viset e bregdetit Adriatik, e kjo ndodhi me siguri kah fundi i sundimit romak në Gadishullin Ballkanik (Bariq, o.c.).

Atëherë si të shpjgohet mungesa e fizionomisë fonetike të toponomastikës në historinë e fushës gjuhësore të shqipes, nga njëra anë, dhe mungesa e terminologjisë indigjene bregdetare në gjuhën shqipe, nga ana tjetër? Gjithsesi jo duke vënë në pah hipotezën se shqiptarët depërtuan vonë në territorin e tyre historik, do të thotë se ata në truallin e tyre të ri u vendosën pas depërtimit të sllavëve. Shpjgimi i kësaj çështjeje duhet kërkuar në nënçmimin politik e ushtarak të barinjve shqiptarë, të cilët një kohë të gjatë pas vendosjes në truallin historik u shmangeshin

kontakteve me banuesit e rinj bujq të botës sllave. Shqiptarët – si barinj, verën e kalonin në lartësitë malore, ndërsa dimrit ata zbritnin në lugina të buta klimatike, por gjithmonë larg rrjetit të komunikacionit, krh.: Bariq, *Lingvističke studije*, 29, *Hymje në historin e gjuhës shqipe*, f. 48.

Se shqiptarët para ardhjes në truallin e tyre historik jetonin në brendi të Gadishullit Ballkanik, këtë sot e pranojnë edhe mbrojtësit dhe ithtarët e teorisë së kontinuitetit ilir në gjuhën shqipe (*Jokl, Alblaner; Erbets Reallexion der Vorgeschichte*, I, 900; Vasmer, *Z.f.sl.Ph.*, V. 280). Bariqi, në mënyrë linguistike të pakontestueshme, dëshmoi se trualli dyjësor i shqiptarëve është i pamohueshëm. Ai në gjuhën shqipe zbuloi dy shtresa të elementit roman kronologjikisht dhe gjeografikisht të ndara. Dyllojshmëria e elementit roman në gjuhën shqipe shihet qartë pikërisht në ndërrimin e grupit konsonantik latin Ict, x. derisa në një numër fjalësh romane që përmbajnë këtë grup konsonantik ct, x në shqipe janë zëvendësuar me ft, fš, - sigurisht në truallin e vjetër të shqiptarëve, në brendi të Ballkanit, - kurse shqiptimi shqip grupet të përmendura romane te fjalët e tjera është reflektuar me ĩt – (ĩt). Për shtresën e parë po sjellim shembujt: *tractarius* > shqip *taftar*; *coctorium* > shqip *koftor*, *koře* < *coxa*. Ky alternim i shqipes i përgjigjet alternimit rumun me pt: *kukptor* < *coctorium*. Për të dytin: *treapta* < *traiecta*. Alternimi tjetër shqip ĩt i grupit latin ct, x, i përgjigjet alternimit të dalmatishtes së vjetër ĩt=krç.froit, arb. *Frũit*, sot *frũt* nga lat. *fructus*, shqip, *drejte*, < *directus*; *trajton* < *tractare*; *l'actes krç.laite, alaite*; serbokr. *Traita* < *tracta*; *Maisan* < *maximus*. Me këtë, pra, u hetuan dy shtresa huazimesh romane të grupit ct, x në gjuhën shqipe, njëri u reflektua në ft, fš, ndërsa tjetri me ĩt; i pari përputhet me alternimin rumun, ndërsa i dyti me alternimin e dalmatishtes së vjetër në gjuhën romane të Adriatikut. Kjo do të thotë se shtresa e parë e fjalëve romane depërtoi në shqipe dhe në truallin e lashtë të shqiptarëve, në kontakt të drejtpërdrejtë të stërgjyshërve të rumunëve të sotëm, ndërsa shtresa e dytë është e kohës kur shqiptarët u vendosën në truallin e ri historik, do të thotë, pra, nga periudha e zbritjes së tyre në bregdet.

Se shqiptarët më herët banuan më në veri nga territoret e sotme,

shihet edhe në trajtat e disa toponimeve të lashta në pjesën lindore të Gadishullit Ballkanik. Emri i vjetër i qytetit të sotëm *Shtip*, shqiptohej *Astibos*, e që deri te trajta e sotme *Shtip* mund të ketë përfunduar vetëm me ndërmjetësimin e shqipes: vokalet nistore të patheksuara të huazimeve romane në gjuhën shqipe zhduken, si për shembull *amicus*>*shqip mik*; *argentus*>*rgent*, *rgān* (t). *S* me rrugë të drejtë në shqipe dha *š*, si *Scupi*>*shqip Shkup*, *Naissus*<*Niš*, *secretus*>*shq. škret*, *summus*<*šume*, etj. Pnë ligje të rregullta u reflektua nga *b*, pra: *Štip*<*Astibos*. Edhe deri te trajta e sotme *Ohrid* në mënyrë të rregullt patjetër duhet ketë përfunduar me ndërmjetësimin e shqipes *Lychnīs*, *Lychnidos*; *n* indoevropiane pas guturaleve në gjuhën shqipe kryesisht është *r*, për shembull: *grue*, *grua* nga trajta e vjetër *gruo*. Të krahasohet: ind.vjet. *gnā* si edhe në indoevr. *Khnak*>*shqip*, (*h*)*rek*, gjerm. (h)nakki), gjerm. *Nacken* (Bariq, *Albanorumänische studien I*, 82), e kjo dëshmon se Ohri i sotëm përfaqëson pikën më jugore në të cilën depërtuan stërgjyshërit e shqiptarëve të sotëm. Kur të kihet parasysh edhe fakti se edhe toponimi *Niš* nga *Naissus* është dashur pa tjetër të kalojë nëpërmjet gjuhës shqipe, atëherë mund të konkludohet se trualli i vjetër i shqiptarëve, të thuhet më drejt trualli i stërgjyshërve të tyre, trakasve, shtrihej në përfundim dhe në lindje të Nishit, në jug deri te Ohri, në kuadër të së cilës bënte pjesë Bullgaria, do të thotë Dardania e vjetër dhe Peonia.

Me këtë deshëm të vëmë në spikamë faktin se në truallin e sotëm historik të shqiptarëve, shikuar në mënyrë kronologjike më parë u vendosën shqiptarët pastaj sllavët, do të thotë se sllavët atje i ndeshën shqiptarët.

Nëse kemi këtë parasysh, atëherë nuk përjashtohet mundësia se shqiptarë mund të ketë pasur në mesjetën e hershme edhe në Zetë, megjithëse për këtë nuk kemi dëshmi historike. Gjykuar sipas të gjitha supozimeve, nuk është e saktë hipoteza se shqiptarët në territorin e tyre historik u paraqitën vetëm në shekullin XI, kur edhe i zënë ngoje kronistët bizantinë.

A. Tingujt

79. Duke sjellël tiparet gjuhësore më qenësore të të folmeve të Krajës qëllimi ynë ishte që të përcaktojmë pozitën e tyre në mesin e të folmeve fqinje të malësorëve. Që në fillim do të theksoja se të folmet e Krajës, më saktësisht të folmet e Shestanit dhe Briskut, përfaqësojnë tipin më arkaik të të folmeve gege. Kjo deri në një masë është edhe e arsyeshme kur të merret parasysh se popullsia e viseve të përmendura është tepër e izoluar; së këndejmi është krejt e natyrshme se në këto të folme sot e kësaj dite ruhen trajta shukmë arkaike. Duke u gjendur në kufi me turqit, Malin e Zi dhe Venedikun, do të thotë në periferi të territorit gjuhësor të shqipes, të folmet e Krajës ishin larg nga të folmet gege fqinje, në të cilat u kryen procese të inovacionit dhe në përgjithësi të ndryshimeve të tjera. Ndryshimet që pasuan në të folmen e Shkodrës dhe të dolmeve përreth, në të folmet e Krajës nuk u ruajtën njësoj: sa më të afërta të jenë këto të folme, me të folmet e lartpërmendura, - aq më i madh është edhe ndikimi. Të themi më saktësisht e folmja e Briskut ka qenë më fort nën ndikimin e së folmes së Shkodrës që hetohet në mënyrë të dukshme, ndërsa e folmja e Shestanit është ruajtur e paprekur nga shumë ndikime gjuhësore, të cilat depërtuan në të folmen e Briskut. Unë do të përmend disa ndikime të tilla. Është e vërtetë se diftongu i sotëm *ue* në të folmen shqipe të Briskut është ndikim i shkodranishtes, ndërsa e folmja e Shestanit edhe sot e kësaj dite e ruan diftongun e vjetër *uo*, sepse kjo e folme, duke u gjetur pak më larg, u shpëtoi ndikimeve të tilla. Nga ana tjetër, edhe ndikimi i dialekteve të serbo-kroatishtes ndihej më fort në të folmen e Shestanit sesa në të folmen e Briskut.

Të folmet e Krajës, Brisk ekl Shestan, që zënë vend në bregun e majtë të Liqenit të Shkodrës, bëjnë pjesë në grupin e të folmeve shqipe të gegërishtes. Në mes të njërit grup dhe grupit tjetër të të folmeve në fjalë – veçanërisht sot – ka dallime të mëdha. Faktori kryesor që shkaktoi këtë dallim – pa dyshim është theksi, ndikimi i të cilit në gegërishte qe aq i madh saqë eliminoi të gjitha vokalet e patheksuara, prandaj në mënyrë të

ndjeshme u largua nga grupi i të folmeve toske. Këtu bën pjesë gjysmëvokali ϵ , i cilil nën ndikimin e fuqishëm të theksit dinamik për një kohë të shkurtër u zhduk nga grupi i të folmeve shqipe të gegërishtes. Me rënien e gjysmëvokalit ϵ në grupin e përmendur të të folmeve shqipe pasoi edhe dukuria tjetër; në të vërtetë, ky dialekt fitoi një tipar karakteristik, zgjatjen e vokalit si kompensim i reduktimit të vokaleve, do të thotë reduktimi i plotë i gjysmëvokalit ϵ në të folmet geqe të shqipes. Kjo dukuri nuk i përfshiu të folmet toske: tek ato edhe sot e kësaj dite është ruajtur gjysmëvokali ϵ , mirëpo për këtë arsye tek ato të folme është shkurtuar gjatësia e vokaleve, e cila në dokumentet e hershme shqipe hetohet qartë. Kuantiteti i vokaleve është shënuar qartë si te gegët ashtu edhe te toskët – Buzuku, Budi, Bogdani, Matrënga dhe te shkrimtarët e tjerë shqiptarë. Shenja e gjatësisë është shënuar me dyfishimin e vokaleve: *zaa, vuu, deet-i, kee*, etj.

80. Pozita e theksit të kryehershëm luajti rol vendimtar në të gjitha gjuhët. Kjo mund të vërtetohet edhe në gjuhën shqipe. Nga pozita e theksit të gjuhës indoevropiane është varur se me cilin konsonant do të bëhet zëvendësimi në gjuhën shqipe *s* me *ś* ose *ǵ*; nëse ky konsonant gjendej drejtpërdrejt para theksit të kryehershëm – atëherë në shqipe u reflektua me *ǵ* ndërsa pranë vokalit jopalatal të patheksuar kaloi në *h*, khs. H. Pedersen KZ, XXXVI, 260, pastaj Bariqi, *Etimološki i gramatički prilozi, Arhiv za arb.star. I, 158*; nga i njëjti autor: *Indoevropski palatali, Glas Srp.kralj. Akademije*, 1927, f. 42, nga i njëjti autor: *Hymje në historinë e gjuhës shqipe*, Prishtinë 1955, f. 12; Po ashtu edhe në: *Lingvističke studije*, Sarajevo, 1954, f. 39.

Kemi bërë fjalë për zhdukjen e vokaleve të patheksuara në të folmet geqe. Këtyre u ka paraprirë edhe reduktimi i gjysmëvokalit ϵ , sepse përndryshe nuk do të ishte i qartë fakti se *cūbītum* të latinishtes në shqipet i përgjigjet *kūt* me *u* të gjatë; kjo dëshmon se trajtës së sotme *kūt* i ka paraprirë faza *kuet*, ndaj reduktimi i gjysmëvokalit ka lënë gjurmë në gjatësinë e vokalit labial *u*. Nga ana tjetër, rënia, përkatësisht zhdukja e vokaleve të patheksuara, është më e vonë sesa faza e ndërmjeme; kjo dukuri ka përfshirë, siç është e njohur, elementet latine si edhe huazimet më të

vjetra të origjinës sllave, si për shembull në fjalët *Berat* nga *БѢЛЪРАБЪ*; Jokl. *Studien.*; Bariqi, *Indoevropski palatali*, f. 40 – 41. Është e pakontestueshme se dukuria e rënies së gjysmëvokalit të patheksuar e përfshiu gjuhën shqipe në tërësi, sepse këtu është fjala për huazimet e para latine dhe sllave. Në të njëjtën mënyrë duhet shpjeguar fjala *kal'ε* nga latinishtja *caballus*, - sigurisht me anë të *kaal'ε>ka'ε*. Te Buzuku ndeshim fjalën *m̃jeek* nga lat. *medicus*, ku sipas rregullës *ē* e shkurtër latine në gjuhën shqipe i përgjigjet diftongu *je*, ndërsa *ē* e gjatë është kushtëzuar nga reduktimi i gjysmëvokalit të patheksuar *ε*. Te Buzuku dhe te shkrimtarë të tjerë gegë të vjetër në shkrimet shqipe ndeshim *liiroj* nga lat. *liberare*; *peendohem* nga lat. *poenitare*; *beekoj* nga lat. *benedicere*; *špirt* nga lat. *spiritus*, shembuj këta që nuk mund të ndahen nga dukuria e theksuar e gjuhës shqipe.

Kjo rregull vlen edhe për disa shembuj me prejardhje indoevropiane. Jokli tregoi për shembull se *deet*, duhet të ketë ardhur nga indoevrop. **deub – eto* (Jokl, *Studien zur albanesischen Etymologie und Wortbildung* [1911] f. 15); e cila me rrugë të drejtë kaloi në *deet*, pastaj me anë të aglutinit pasoi zgjatja e palatales *e*, duke përfunduar në *dēt*.

Kuantiteti i vokaleve të sotme në të folmet gege është njëra ndër veçoritë karakteristike që i lidh këto, por nuk përjashtohet mundësia edhe e largimit të tyre. Të folmet e Malësisë kryesisht përputhen në çështjen e kuantitetit të vokaleve, mirëpo këto nuk përputhen gjithmonë me të folme të tjera gege. Kjo nuk do të thotë se dallimi ndërmjet tyre është aq i madh, mirëpo ky dallim ekziston si në kategorinë nominale po ashtu edhe në atë verbale. Në aspektin e gjatësive të shkurtra nuk ka kurrfarë dallimi në mes tyre; nuk përputhen në gjatësitë e mesme dhe të gjata. Atje ku kemi gjatësinë më të madhe të vokaleve të folmet e Malësisë dhe të atyre të Kosovës, të folmja e Krajës, në pjesën më të madhe, kemi gjatësinë e mesme. Ta shohim këtë në shembuj. Në të folmet e Malësisë dhe të Kosovës thuhet *me mēt*, në të folmen arbëneshe gjithashtu *me mbēt*, në Shestan *me met*; Mals. *l'ōp*, arbën. *lōp*, Shestan *l'ōp*; *me kōf* (Mals., Kosovë), Shestan *me kōf*, *me kōf* (Pinçiq), *me kōr* (Ljare). Nga shembujt e

mësipërm shihet qartë se gjatësitë e mesme janë të kohës së vonë. Këtë e dëshmon fakti se gjatësia në shembujt e caktuar nga e folmja e Shestanit, në Krajën e Malit të Zi, sipas zanafillës është më e madhe, mirëpo me kohë është shkurtuar dhe ka përfunduar në gjatësi të mesme. Duhet cekur se një fjalë me gjatësinë e vokaleve të saj në njëinfshat nuk përputhet me gjatësinë e vokaleve të së njëjtës fjalë ë të folmen e fshatit tjetër më të afërm. Duhet theksuar një gjë si të pakontestueshme se e folmja e Shestanit, e deri diku edhe e Briskut – sa i përket kuantitetit të vokaleve nuk përputhen gjithmonë me gjatësinë e vokaleve të Malësisë. Kjo është e vërtetë. Shkurtrimin e gjatësisë në një masë, edhe pse mjaft rrallë, e kam hetuar edhe në të folmet shqipe të Kosovë-Metohisë. Në të folmen e vendlindjes sime, të Jabllanicës së Epërme, në jug të Serbisë, thuhet *būk*, në vend të si rëndom *būk*, tosk. *buke*. E nuk është rast i rrallë kur bashkë me shkurtrimin e gjatësisë ndërrohet edhe kuptimi i fjalës. Në të folmen e vendit tim *būk* nuk e ka kuptimin e bukës si tërësi, por ka kuptimin e ushtimit *me hangër būk* – “me drekue, me darkue, me ngrënë”, edhe pse për këto kuptime ekzistojnë shprehje të veçanta. *Būk* me *u* të gjatë ka kuptimin e bukës si tërësi. Me këtë desha të them se ndërrimi i kuantitetit të vokaleve shpesh bart pas vete edhe ndërrimin e kuptimit të fjalës, kuantiteti i së cilës është shkurtuar.

Nëse është i vërtetë konstatimi⁵⁴ që vokalet e gjata janë njëkohësisht edhe të mbyllura, ndërsa të shkurtrat – të hapura, atëherë nga lënda gjuhësore e Taljavinit mund të shihet qartë se në të folmen e arbëneshëve gjatësia e vokaleve është shkurtuar dukshëm. Taljavini, në të vërtetë, nuk e ka shënuar gjatësinë e vokaleve, por vetëm kualitetin e tyre. Nëse kjo është e vërtetë, do të thotë nëse në kualitetin e vokaleve të së folmes së arbëneshëve janë bërë këso ndryshimesh atëherë duhet menduar në ndikimin, për shembull, të dialektit venedikas, i cili përjetoi një proces të ngjashëm. Megjithëkëtë, unë, duke vërtetuar, tërë lëndën gjuhësore të Taljavinit, kam konstatuar se nga e tërë kjo nuk ka asgjë: në të vërtetë, nuk

⁵⁴ Pekmezi, *Grammatik der alb.Sprache*, 52.

është i saktë mendimi se në këtë të folme ka pasuar një shkurti i tillë i zanoreve dhe se duhet përsiatur për ndonjë ndikim nga jashtë. Shkurtimi i kuantitetit, sipas Taljavinit, është përcjellë me kalimin e vokaleve të mbyllura në vokale të hapura, e ky mendim është vetëm fryt i kumtimeve të gabuara të Taljavinit për të folmen arbëneshe, e këndej e ka burimin edhe hutimi i linguistit italian. Ne do të ndalemi më hollësisht në këtë kur do të marrim në shqyrtime tekstet e mëtejme, të Taljavinit, nga njëra anë dhe variantin tonë të verifikuar të teksteve të tij, nga ana tjetër. Atëherë do të mund të vërtetohet kush ka të drejtë, Taljavini apo ne.

Cimohovski, pa dyshim, ka të drejtë kur pohon se vokalet e gjatësisë së mesme përfshijnë një numër të konsideruar të foljeve që sosin me konsonant. Në të vërtetë, ai pohon për të folmen e Dushmanit, si *me cít; me véš; mav; me u dük; me lýp*, krh. Waclaw Cimochowski, *Le Dialecte de Dushmani*, f. 7. Cimohovski asgjë nuk na tregon për gjatësinë e mesme të vokaleve të foljet e përmendura, ose është e lashtë kjo dukuri apo e vonë. Këtu mund të kemi dy shpjegime: sipas njërës, gjatësia e mesme në fjalët e mësipërme mund të jetë gjurmë nga ajo periudhë kur kategori të këtilla foljore sosnin me ϵ të mbyllur, do të thotë me prapashtesë të zgjeruar foljore *-un, -tun*, (për shembull: *me cítë, kítë, kítun*, etj.), voklai i të cilave që gjendej në mes ishte i gjatësisë së mesme, ndërsa sipas shpjegimit të dytë, një gjatësi e tillë ishte dukuri e një kohe më të vonshme. Unë anoj në shpjegimin e dytë, sepse në një mal foljesh me gjatësi të gjatë nuk ka arsye të ketë përjashtim për një numër të vogël, nëse nuk është kushtëzuar nga arsye të veçanta. Në vështrimin tim për kuantitetin e vokaleve në të folmet e Krajës nuk kemi përmendur dialektin toskë pikërisht për shkak se ndryshime të këtilla kuantitative atje kryesisht nuk ka. Dihet vetëm se disa të folme periferike ose të folmet e toskëve në emigracion, e knaë gjatësinë e vokaleve, pikërisht njësoj sikurse të folmet gege; përndryshe atje kryesisht janë evituar dallimet kuantitative; Çabej, *Buletin për shkencat shoqërore*, 1955/2, f. 83.

Dukuria gjuhësore të cilën e përshkruam më lart përfshin edhe të folmet e Krajës, të cilat në vokalizëm ruajnë tipara arkaikë.

81. Në tiparet arkaike të së folmes së Shestanit të Krajës numërojmë diftongun e vjetër *uo* (i ruajtur në të folmen e Shestanit, në të Epërmin dhe në të Poshtmin, pastaj edhe në Muriq dhe Bes – fshatra buzë Liqenit të Shkodrës, ndërsa në të folmen e Briskut dhe paralagjeve të tij ky diftong ka kaluar në diftongun e sotëm *ue*). Kjo është forma më arkaike e diftongut që deri më sot është vërtetuar në të folmet gege dhe toske. Pohimi i Eqrem Çabejt nuk është vërtetuar në të folmet gege dhe toske. Pohimi i Eqrem Çabejt nuk është i bindshëm (Buletin 1955/2, f. 89) se në nshembujt *growa-groua*, të Arnold Von Harff-i dhe *Grovemire-Grouemure* (emri i fshatit të sotëm *Gruemir*, në lindje të Shkodrës), i dokumentuar më 1416-1417, (krh. Shufflay, *Srbi i Arbanasi*, Cordinano, *Catastro veneto*), - vërtetoi shkallën e diftongut *ou*. Lidhur me këtë Jokli zhvilloi teorinë e vet në IF 49, f. 274; 50, f. 33: *on, o, ou, ou, uo, ua, ue*. Shembulli i parë është mjaft i pasigurt, aq më tepër se udhëpërshkruesi gjerman Arnold Von Harffi përdori një alfabet të përzier e të paqartë, ndërsa, në shembullin e dytë në toponimin e sotëm *Gruemir* tingullin *u (=v)* autori anonim e përdori qëllimisht për t'i ikur hiatit, e ky është rast i shpeshtë, të cilit i shmangeshin autorët italianë në atë kohë.

Sa u përket të folmeve gege, shkalla e evluimit të diftongut *uo* është konstatuar bukur moti, që atëherë kur u zbulua vepra e shkrimtarit shqiptar Buzukut; J. Rrota, *Monumenti mâ i vjetri i gjuhës shqype*, Shkodër, 1930.

Se ç'trevë gjuhësore përfaqësonte Buzuku, kjo nuk dhet as sot. Shkrimtari i dytë me radhë Budi (1630), - i cili përfaqëson trevën gjuhësore të Matit, në Shqipërinë e Mesme, - në veprat e veta përdor diftongun arkaik *uo*, ndërkaq, të Bardhi, Bogdani (1635, 1685) nuk e ndeshim më diftongun e zënë ngoje *uo*, por *ue*. I pari është përfaqësues i trevës së Shkodrës – Zadrimës, ndërsa i dyti përfaqëson vetë Shkodrën, e pjesërisht Prizrenin e Metohinë. Më habit fakti se në *Kuvendin e Arbënit* (1703), krahas diftongut të zakonshëm *ue*, shpesh ndeshet edhe diftongu *uo*, p.sh. *i tretî muoj*, f. X; *e ðeu mbuolî*, f. 13; *u bduori*, YIV; *duo te mař*, 21; *ci duoli prej se skukemit*, 14; *per duu muoje*, 28; *e ri ndene sundit e huoj*, 53;

perserii duoli davija, 54, *caa gni here nde muoj*, 70; *kete detüre mos ta keete Diocese e huojë*, 74 (cituar sipas botimit të dytë prej 1888). Cili është autori veprës në fjalë, nuk dihet me siguri as sot, mirëpo mendohet se është Vicko Zmajeviqi, kryepeshkopi i Tivarit, i cili më 1703, në Mërkinj ftoi tubimin kishtar të priftërinjve shqiptarë. Në mbështetje të materialeve të Kuvendit të Arbënit për autorësinë e Zmajeviqit bëhet fjalë edhe te Farlati, VII, f. 172-176; “Aktet e kuvendit latinisht dhe shqip i shkroi vetë Zmajeviqi dhe ia kushtoi Klementit XI”, thotë IVAN Markoviqi, *Dukljansko barska mitropolija*, Zagreb, 1905, f. 150. Nëse pranohet pohimi se Zmajeviqi është autor i tekstit latinisht dhe shqip të Kuvendit të Arbënit, atëherë është i qartë fakti se prej nga ishte prania e diftongut arkaik *uo* në shkrimet e tekstit shqip të Kuvendit në fjalë. Provincializmat e gjuhës shqipe të cilat Zmajeviqi i zotëroi – me siguri ishin nga territoret gjkuhësore të Krajës së Mlajt të Zi, ku diftongu *uo*, në atë kohë ishte mjaft aktiv dhe i përdorshëm. Po ta kishte redaktuar tekstin shqip ndonjë shqiptar nga Shkodra, atëherë në tërë tekstin do të ishte përdorur diftongu *ue*, diftong i cili në atë kohë ishte i vetmi që përdorej në të folmen e Shkodrës. Unë, megjithëkëtë, nuk përjashtoj mundësinë që tekstin e Kuvendit e redaktoi ndonjë shkodran, të cilit shembujt e përdorur me *uo* i shpëtuan, mirëpo pjesën më të madhe të shembujve i përmirësoi në *ue*, siç shihet qartë nga teksti i Kuvendit.

Diftongu *uo*, përveç Shestanit, sot në disa shembuj sporadikë është ruajtur edhe në të folmen shqipe të Kuçit; krh. Erdeljanoviq, *Kučí, pleme u Crnoj Gori*, 1905; *Dar Kruo* (=Nder Kruo), 199, *Kruo* (i bukur), 103, *tambli pa vluo*, edhe te Stevan Duëiqi, *Život i običaji plemena Kuča*, 1931; *kaľuo* (-ka ľuo), 570, *mejšortuo* (me i šortuo), 586, *đuotar* (=đuotar), *me paguo* (me paguo) 586. sa u përket të folmeve të tjera gege, unë s’kisha dijeni që në ndonjërin prej tyre është ruajtur diftongu *uo*, shembujt që i mblodhi Glisha Elezoviqi për të folmet e shqiptarëve të Kosovës, në të cilën kinse diftongu *uo*, ishte në përdorim para tridhjetë vjetësh, nuk janë bindës. Shembujt e përmendur me diftongun *uo* në të folmen e Kosovës, përveç Elezoviqit, nuk i dëshmoi askush. Me këtë, unë mendoj se është

shteruar çështja e të folmeve gege të cilat e ndeshim të ruajtur diftongun *uo*, i cili ka ende përdorim të dendur te shqiptarët e Shestanit, ndërsa në një masë të mirë është ruajtur edhe në të folmen e arbëneshëve.

Dialekti toskë, në të cilin sidoqoftë janë ruajtur tiparet arkaike të gjuhës së vjetër shqipe – me shkallën e diftongut të vet *ua*, nuk ka treguar ndonjë aftësi më të madhe zhvillimi sesa, siç është rasti në disa të folme gege. Diftongu *uo* është ruajtur sporadikisht vetëm në disa të folme toske të italo-arbëreshëve; Lambertz, KZ, 51; 274; K. Kamsi, *Leka XV* (1943), 73. Nëse duam ta rrumbullakësojnë çështjen e diftongut *uo*, atëherë do ta përfundojmë me pohimin se e folmja e Shestanit në këtë pikë paraqet një gjendje arkaike.

Nuk ka nevojë të ndalemi në diftongjet e tjera të së folmes së Krajës, Briskut e Shestanit, pikërisht për shkak se ata në asnjë mënyrë nuk dallohen nga diftongjet e të folmeve të tjera gege, natyrisht tek ato të folme ku janë ruajtur diftongjet, p.sh. *diell-i*, *miel-i*, mirëpo thuhet *dje*, *me vje*, *me vjed*, *me sje*, e kështu thuhet edhe në ato të folme gege ku diftongjet janë ruajtur pakëz.

82. Me interes jo të vogël është edhe çështja e nazalitetit të vokaleve të të folmeve të Briskut dhe Shestanit të Krajës. Për dallim nga shkodranishtja, e cila shikuar nga numri i vokaleve zanale, qoftë të kryehershme qoftë sekondare, konsiderohet njëra ndër të folmet e para gege, - e folmja e Shestanit dhe ajo e Briskut në këtë çështje paraqesin një kundërvënie të vërtetë. Është e vërtetë se në të folmet e shqiptarëve të Shestanit dhe të Briskut *e*-ja është denazalizuar plotësisht; shkodranishtja *vën(d)*, kosov. *vën*, *mals.vën*, kraja.*vën*, tosk. *vent-vendí*, geg. jug. *vënd*; shkodr. *mënn*, kos. *mën*, kraja.*mën*, geg.jug.*mënd*; tosk. *ment-dí* nga lat.*mentem*. Për të dëshmuar nazalizmin e të folmeve gege duhet t'ëkihet patjetër parasysh a është reduktuar vokali *e* apo jo në dialektin toskë. Sa herë që lind dyshimi për ekzistimin e nazalitetit në dialektin gegë, për ta vërtetuar këtë duhet patjetër të konsultohet toskërishtja. Mirëpo, për këto çështje duhet parasysh fakti se në dialektin toskë shpesh ndeshim në vokale që i kanë shpëtuar reduktimit; më saktësisht, do të thotë se në

toskërishte *ε* është shndërruar në vokal të plotë, p.sh., *ε* në tosk. *vent*, ndaj kemi *vent*, e kjo është tendencë vitale e të folmeve toske, ashtu siç është denazalizimi i vokaleve tendencë e fuqishme e të folmeve geqe. Në të folmet e Krajës thuhet *pē-ni*, *frē-ni*, *li-lini*, shkodr. *lī-līni*, kraja. *mulimulini*; kraja. *drē-ni*, shkodr. *drē-ni*, kraja. *kjen*, *kam*, *kjēn* nga shqipja vjetër *klenee*; *kam kēne*, me denazalizimi të gjysmëzanores: *kēne*. Vajgandi për gegërishten jugore sjell *kēn*, Dozoni për tosk. *kēne*, *kēnur*, - *Vocabulaire albanais – français* 41; kraja. *kēn-i*, shkodr. *čēn-i*, Cordignano, 164; *kēn-i* Wajgand, 43, tosk. *kēn* dhe *kēn* nga latinishtja *canis*, arbën. *čēn*: kraja.: me u *trēm*; shkodr. sipas Cordignanit: *m'u trēmb*, çamërishtja: *trembej se mos zgonej vajza*, - Pedersen, *Alb. T.*, 187; *kosov.m* u *me u trēm*; *perm.*: *tremb*; *ti yeçe kē na trembe*, Dozoni, *Manuel de la langue chkipe ou albanaise*, 90; e folmja arbëneshe *me u trēmb*, lat. *tremuo*, greq. *krēmω*. Te fjala *temb*, tosk. *tremb*, ku farianti gegë posedon *ē* nazale, ndërkaq trajta toske është me *ε* të reduktuar, nazaliteti, të shprehemi ashtu, është i lashtë; këtë e tregon edhe trajta toske me vokalin *ε*. Thamë se në dialektin toskë ndeshim në një numër të madh fjalësh ku vokali i reduktuar *ε* është liruar nga reduktimi, siç kemi p.sh. *femer*, geg. *fēmēn* nga latinishtja *femina*, sepse mund të haset edhe varianti toskë me *e* të reduktuar: *femer*, Dozon, *Manuel* (glosari). Kështu pra, trajta geqe me *ē* nazale: *fēmēn* është shpjeguar me ekzistencën e variantit toskë me *ε* të reduktuar: *femer*. duke gjurmuar trajtën paralele të fjalës geqe *řēn*, kam ndier kënaqësi të veçantë kur kam ndeshur trajtën *řerε* në dialektin toskë, - Pedersen Alb. 183, trajta e përmendur *řerε* (geg. *řēn*) përdoret në Çamëri, në fshatin *Lëkurësi*. Është e pakontestueshëm shpjegimi etimologjik i fjalës së përmendur *řēn*, duke pasur parasysh variantin toskë, që dëshmohet në të folmen e Çamërisë. Unë mendoj se trajta geqe me nazalen *ē* nuk mund të konsiderohet formë e nazalizimit sekondar kur dihet që varianti toskë është shumë i rrallë, është vërtetuar vetëm te Kamarda; krh. Pedersen, *L-Laute im albanesischen*, KZ. XXXIII.

Ne do të sjellim vetëm edhe disa shembuj me të cilët nazalizimi gegë në mënyrë të përkryer e shpjegon çështjen e vokalit të reduktuar në

dialektin toskë. Sa për ilustrim po marrim në gegërishte *ēmēn*, që në toskërishte i përgjigjet *emer*, mirëpo krahas kësaj trajte rrallëherë paraqitet edhe *emer*, në të vërtetë *ember*, G. Schiroi, *Canti tradizionalied altri saggi delle colonie albanesi di Sicilia*, f. 412 dhe Pedersen, *Alb, t*, 124 (*ember*). gjysmëvokali në fjalët e përmendura sot në pjesën më të madhe të të folmeve toske shqiptohet si *e* e hpaur orale, ndërsa te një pjesë e mirë e të folmeve geqe, përkundrazi, është ruajtur *ē* nazale: *ēmēn*. Në këto të folme geqe, pra, ku është kryer denazalizimi i nazales *ē*, si në fjalën *ēmen*, bën pjesë edhe e folmja e Briskut dhe e Shestanit të Krajës. *Emer* e ndeshim edhe te Hahni III, f. 33, prejardhja e të cilit pa dyshim është nga indoevropianishtja nga *enmen*, greq. *onoma*, lat. *nomen*: krh.te Meyeri, EW. 94; A. st., III, paragr. 97; Pedersen, *Kelt Gramm.*, I 46, Walde – Pokorny, I, 132, prej nga në dialektin gegë drejtpërdrejtë është shkaktuar nazalizimi, ndërsa në të folmet toske është bërë reduktimi i *e*-së nistore në *ε*.

Rrallë e tek është ruajtur në trajtën e kryehershme të drejtë edhe fjala *maz*, tosk. *mes*, *mezi*, ital. *menzo*, bask. *mando-mushkë*, lat. *mannus* (nga *mandus*)=kalth; krh.: iliro-mesapishtja hyjnia *Jupitermenzana*, të cilit si therori u dërgoheshin kuajt. Trajtat e përmendura dëshmojnë saktësisht trajtat shqipe *māz*, tosk. *mes. ā-ja* nazale është ruajtur edhe në të folmet e Krajës; prandaj trajta e theksuar do të duhej të shqiptohej *māz*. mirëpo edhe këtu paraqiten përjashtime, ku në vend të *māz*, thuhet *māz*, së fundit, ashtu si edhe në një pjesë të mirë të të folmeve geqe, ku bën pjesë me siguri edhe e folmja e Kosovës, në fjalën *maz*, është denazalizuar vokali *a*, këtu bën pjesë edhe e folmja e shqiptarëve të Jabllanicës, në të cilën, në fjalën *maz* nuk është ruajtur nazaliteti i vokalita. Sidoqoftë, në fjalën *māz*, të folmet e përmendura geqe, duke përfshirë këtu edhe të folmen e Krajës, kryesisht e kanë ruajtur nazalitetin e vokalit *a*: *me bā*, *me lān*, *mevān*, *medān*, *rānd*, *dāj*, *rāñ*, *me u vrā*, *vrānt*; tosk. *vreret*, *vre*, fjalë kjo, prejardhja e së cilës nuk mund të jetë sllave, sepse rotacizmi në gjuhën shqipe është dukuri parasllave. Nëse në fjalën përkatëse do të prananim prejardhjen sllave, atëherë ky do të ishte shembull i vetmuar i huazimit sllav me rotacizëm të dëshmuar në gjuhën shqipe; krh. A. Bariq, *Albanorum Studien*, I, 117-118, ibid. *Lingvističke*

studije, Sarajevo, 1954, f. 45, ibid. *Hymje në historin e gjuhës shqipe*, 78; Skok, *Arhiv za arb.starinu*, II – 331, shënime 31. Të nxitur nga shqyrtimi i Majerit për fjalët shqipe *vrāne, vrānt*, tosk. *vrë, vreret*, Vasmeri, (*Stud zur alb. Wortforsch.*, 65) dhe Jokli (IF, XXXVI), e nxjerrin këtë fjalë nga sllavishtja e vonshme *vranv*, shpjegimi i Bariqit për këtë fjalë është nga evrop. *urv-no* do të mund pranohej vetëm atëherë nëse do të dëshmohej se rotacizmi është dukuri parasllave në historinë e gjuhës shqipe.

Në vokalin e denazalizuar bën pjesë edhe shembulli *menër*, që e ndeshim më të folmen shqipe të Shestanit, shkodr. *mënnër*, Weigand *mēndēr*, Leotti *mëndërzë*. Fjala është me origjinë latine nga *mintā* (Mayer – Lübke; Gröbers Grdr., I. 1044), nga e cila drejtpërdrejt është krijuar fjala shqipe *mēnder*, tosk. *mender* trajtat *mënnër* dhe *menër* në të folmen e Briskut dhe Shestanit të Krajës janë variante dialektore, në të cilat është kryer asimilimi i grupit konsonantik *nd > n (nn)*; *nt* latine në gjuhën shqipe ndoshta është *nd*; psh. lat. *mentem* = shqip *mënd, ment*, lat. *sanitatem* = shqip *šendet; conventus* = shqip *kuvēnd*, tosk. *kuvent*, shkodr. *kuvendi*. Trajta me vokalin e denazalizuar *i kštēn, krštēn*, tosk. *kerštere; gaku i keršterimit* – “das Blut des Christen”, Pedersen, Alb. T. 141, është me prejardhje latine, nga *crīstianu*.

Në fillim të paragrafit ku bëhet fjalë për vokalet nazale për të folmet e Krajës, Briskut e Shestanit kemi theksuar se e folmja e përmendur e shqiptarëve të Krajës kryesisht e ka denazalizuar vokalin e vet e në të gjitha fjalët ku nazaliteti, sipas prejardhjes, është i domosdoshëm. Denazalizimi i vokalit të përmendur i të folmes së shqiptarëve të përmendur, natyrisht që nuk është i vetmuar. Në zemër të Malësisë, në trevat kufitare të krahinës së Dukagjinit, në veri të Shkodrës – ndeshim në popullsinë nga e folmja e së cilës në një masë të mirë është zhdukur nazaliteti i vokaleve, veçanërisht i palatales *e*: *pē, pēni*, shkodr. *pē-ni; frēni*, shkodr. *frē-ni*, etj. Nga ndikimi i kësaj dukurie, siç thamë, nuk është kursyer, natyrisht as e folmja e afërme e Dushmanit, (krh.: Waclaw Cimochowski, *Le Dialecte de Dushmani* f. 58), në fjalët *kama*.pl. *kam-t; plam* (tosk. *pelembe*); *lan, l’ān, l’āna*, tosk. *l’ende*, f. 59-60.

Në shembujt e përmendur, siç shihet kemi sigurisht denazalizimin e vokaleve, në të cilin na drejtojnë variantet toske ku është kryer procesi i

reduktimit të vokaleve. Denazalizimin e vokaleve e ndeshim edhe në një varg të tërë të folmesh gege. Për të folmen e Dibrës krahaso *Vísaret e kombit*, lib. XIV, në përmbledhjen *Fyelli i Dibrës*, nën redaktimin e Haki Stërmillit dhe Gl. Elezoviqit, *Srp. akad.nauka, Dijalektološki Zbornik*, lib. XI, XI, 1950. Të folmet shqipe në Maqedoni, kryesisht, nuk kanë vokale nazale; do të thotë se atje është kryer denazalizimi i tyre. Kam njohuri se zhdukja e nazales paraqitet edhe në të folmen e shqiptarëve të Preshevës dhe të rrethinës së saj (nga kujtimi i të folurit të shokëve të mi të shkollës të lindur në Preshevë). Unë mendoj se kjo zhdukje e nazales *e* ka nisur në të folmen e të gjithë pjesëtarëve të fisit kelmend. Për këtë, mjerisht, na mungojnë të dhënat.

Është fakt i pakontestueshëm se e folmja e Shkodrës më besnikërisht e ka ruajtur nazalitetin e vokaleve. Pa mëdyshje mund të thuhet se nazaliteti i kësaj të folmeje, me përjashtime të vogla pothuaj pikë për pikë puqet me reduktimin e vokaleve të dialektit toskë. E kjo do të thotë se kudo që në shkodranishte kemi vokal nazal – në toskërishte është kryer reduktimi i tij. Mirëpo, nga ana tjetër, shkodranishtja është dëshmi e shkëlqyeshme për t'u bindur se nazalizmi që nga periudha e shqipes së vjetër e deri në ditët e sotme – ka qenë veçori e fuqishme e të folmeve shqipe të gegërishtes, e posaçërisht e shkodranishtes. Ajo përfshinte thesarin gjuhësor me prejardhje indoevropiane, huazimet latine, elementet sllave, më në fund edhe huazimet turke që ndeshim në të folmet shqipe të gegërishtes. Po sjellim disa fjalë turke: *pâgje-a*, *nišân*, Cordignano, *Dizionario albanese-italiano*, 131-136.

83. Në një kapitull mjaft të ndërlikuar të gramatikës shqipe, çështja e nazalizmit të fjalës *pēs* sot e gjithë ditën nuk është ndriçuar nga pikëpamja e prejardhjes së saj.

A është *e*-ja zëvendësim i sonantes *n* indoevropiane, ose është refleksi i indoevropianishtes *e*, *penkue*, kjo është çështje kontestuese. Nëse fjala shqipe lidhet me fjalën indoevropiane *penque*, atëherë ajo me siguri do të shqiptohej *pisa*, krahas *miš*, e cila është rezultat i procesit asimilues të grupit *e+ns*: ind. Vj. *māsa*, sllav.vj. *meso*. Kjo është çështja e parë. Çështja

e dytë ka të bëjë me faktinse a është zëvendësuar *n* sonante indoevropiane në gjuhën shqipe me vokalin *a* ose me vokalin *e*. Mendimi të cilit i del zot Bariqi (*Lingvističke studije*, 17), i kundërt me mendimin e tij të hershëm, se zëvendësimi i sonantës *n* indoevropiane në shqipe është bërë me *a* (*n=a*), e jo me *e*, e cila është ruajtur deri më sot mendoj se shpjegon edhe çështjen e nazales *ē* të trajtës gege *pēsē* më herët *pāse*. Nëse pranojmë mendimin senë periudhat më të hershme në gjuhën shqipe kalimi i *a* në *e* u bë nëpërmjet fazës nazale *ē*, ashtu siç shprehet qartë sot kjo dukuri në të folmet gege, atëherë pa dyshim se nazalja e sotme *pēsē* në ballë të kohës është shqiptuar *pase*. Të sjellim disa shembuj të kalimit më të vonë të *a* në *ē* në të folmen e sotme të Shkodrës: *nalt-nēlt*; shkodr. *skañ>skēj*; *haja = hēia*; *prāp=prēp*; *tāš=tēš*; *bārk=bērck* (Gjakovë). Mendoj se Bariqi (*Lingvističke studije*, f. 17) me nxjerrjen e përfundimit të vet të fjalëve shqipe *pese* geg. *pēs*, përfundimisht e zgjidhi tërë çështjen e prejardhjes së saj.

84. Njëri ndër të vetmit shembuj të ruajtjes së palatales nazale *ē* do të mund të merrej fjala *meē* (*mē* nga *māj*<*malē*), ku *l*, krahas lat. *vitulea* kaloi në *l* dhe dha *ftule=ftuje*. Diftongu *ae=e*, *ē* është dukuri shumë e shpeshtë në të folme të tjera të gegërishtes, te të cilat kjo *e*, në një pjesë të mirë të tyre, është palatalizuar p.sh.: *un paš, ti pāe, un laš, ti lāe*; pastaj te emrat: *ngē* (=kohë e lirë), tosk. *ngē* shkodr. *ngae*, lit. *gaivus*, me të cilën fjala shqipe përputhet plotësisht. Trajta bazë nga e cila niset Jokli për shpjegimin e fjalës së sotme shqipe *ngae*, është *gadhā*, ku sipas rregullës ka rënë intervokali nistor; *n* në fillim të fjalës nuk do të thotë të jetë epentetike; krh.: Jokl. *Studien zur albanesischen Etymologie und Wortbildung*, 62, 63.

85. Nivelizimin e grupeve vokalike e kushtëzoi theksi ekspirator, i cili me intensitetin e vet shkaktoi rrafshimin e grupeve vokalike. Rrafshimi i grupeve të përmendura vokalike *ae, oe* ende është në zhvillim e sipër. Ka edhe sot të folme, kryesisht gege, në të cilat grupet vokalike në fjalë *ae, oe* janë ruajtur. Të folmet e Krajës, me përjashtime të vogla, nga aspekti i kësaj dukurie përputhen me të folmen e Shkodrës; në to, grupet vokalike në fjalë (*ae, oe*) shqiptohen *ē, ō* p.sh. *pae=pē, rae=rē; roe=rō; voe=vō, voes=vōs; ngae=ngē*, për dallim që në këto nuk ndeshim një *e* të tillë, siç e

ndeshim në të folmen e Shkodrës, në të cilën ky tingull nuk është *e* e pastër: *pae, rae, ae=e; δāe*. Palatalizimi të fjalët e zëna ngoje është ruajtur edhe në të folmet e shqiptarëve të Kosovës, në të cilat në të vërtetë, trajta e vjetër *ae, oe* është zëvendësuar me vokale të ndryshme: *pā^ç, rā^ç, vā^ç, δā^ç, vō, rō; vōs*, etj. Këtu, siç shihet vokali i parë është më i vjetër dhe është ruajtur në grupet vokalice *ae, oe* që do të thotë se intensiteti i theksit i ka rrafshuar vokalet e grupeve të përmendura vokalice, duke përfunduar në *a* ose *o*, duke përjashtuar në këtë mënyrë vokalin e dytë dhe kështu ka pasur shkrimin e vokalit të dytë në të parin *a, o*. Shkrimet e shkrimtarëve të vjetër shqiptarë dëshmojnë për faktin se grupet e përmendura vokalice janë shqiptuar në të folmet geqe të shekullit XVI – XVII; ato u shqiptuan të këto të folme edhe në vonë; khs. *Buletin* 1955/2, 91. Në të folmet toske shkrimin e grupeve vokalice u bë shumë herët, e këtë e dëshmojnë edhe dialektet e shqiptarëve të Greqisë dhe të Italisë Jugore, të cilat edhe ashtu konsiderohen mjaft konservative.

86. Sa i përket vokalizmit të të folmeve të Krajës, unë do të theksoja edhe një tipar të saj, i cili sipas mendimit tonë, është me interes të veçantë. Fjala është për të dhënë e të folmeve të Krajës, Brisk dhe Shestan ku ndeshim kryesisht në një veçori dialektore toske. Pra, në këto të folme edhe sot thuhet: *është i mīr*, përkatësisht *īšt i mīr*, në vend të trajtës geqe *āšt i mīr*; trajta e saj e kryehershme ishte *enstī*, e kjo forcon pohimin se trajta e sotme geqe *āšt i mīr*, trajta e saj e kryehershme ishte *enstī*, e kjo forcon pohimin se trajta e sotme geqe *āšt* është sekondare. Pastaj në të folmet e përmendura të Krajës ndeshim edhe këto trajta *kó v̄ēn, un bēń, ti bēn, ai bēn, na bējm, ju bēni, ata bējn; ełe v̄elpna i ko v̄ān; mos m vra se taš bēhem zagāri iōt* (shembull nga shënimet e mia për të folmen e shqiptarëve të Shestanit); *harapi s kō č bēn*. Në këto të folme krahas *un bāń, ti bān, aj bān, na bājm, ju bājm, ata bājn* thuhet edhe *un bēń, ti bēn, aj bēn*, etj. Nuk duhet lënë pas dore edhe fakti se trajtat dyjësore të prezentit të foljes *me bā i* ndeshim edhe në të folmen arbëneshe. Shtrirja e trajtës *është* ose *īšt* (=est), sikur na inkurajon të pohojmë se ajo përfaqëson zëvendësimin – *en enstī* indoevropian. Trajtat dyjësore të prezentit *bēń,*

bāń, pastaj participi *ṽěn* (*dictus*) – nuk besoj se heqin zanafillën nga lashtësia; unë megjithatë mendoj se reduktimi i vokalit nazal *a* në fjalët e përmendura u bë, gjithsesi, në kohën kur në të folmet e Krajës filloi denazalizimi i vrullshëm i *e*-së, ndaj kjo dukuri e përgjithshme përfshiu edhe denazalizimin e *a*-së në fjalët e përmendura.

Në paragrafin e parafundit, kur kam bërë fjalë për intensitetin e theksit dhe ndikimin e tij në shkrirjen e grupeve vokalice në gjuhën shqipe, në kuadër të kësaj dukurie, sigurisht është dashur të sjellë edhe shembuj që i kam shënuar gjatë qëndrimit tim në Shestan: *sonte m m döhet; untöhët; haruša inöhët ede mařën e pin; pö ik*. megjithkëtë duhet patjetër të përmend se kjo dukuri është mjaft e kufizuar, sepse e kam dëgjuar vetëm prej një të riu në Shestanin e Poshtëm.

87. Te një numër i konsideruar fjalësh me vokalin oral *a* të gjatë, paraqitet edhe labializimi, që do të thotë se ai në të folmen e popullsisë së Briskut e Shestanit nuk shqiptohet si *a* e pastër, por synon drejt tingullit *o*, e pasi ka kaluar gjysmën e rrugës nuk shqiptohet si *a* e pastër orale, e as si *o* e pastër, por disi si në mes të njërit dhe tjetrit tingull; ne do ta shënojmë me *â*: *e kiti i treti vlâ; ather bāni gōst t'māde; ede filoj me rā bor; ede rā n nī špet t live; dōt, ti pā bišt: kërkon ujku napualiona āri; ede i rān šebutl ede asāi; ede ni nāt mūtën nī ka n'mal; un po kërkoj ni roktār; ko ṽān: si me dā gruon; ede e kam dēt vajžën n trā*. Të folmet e Krajës nuk janë të folmet e vetme gege ku haset tendenca e labializimit të vokalit *a* në fjalë. Ka edhe të folme të tjera gege ku ekziston veçoria e përmendur, Weigand, *Der gegische Dialekt von Borgo Erizzo bei Zara in Dalmatien*, në *Jahresbericht des Instituts fuer rumaenische Sprache*, XVII-XVIII; Carlo Tagliavini, *L'Albanese di Dalmazia*, Firenze, 1937; pastaj edhe shembuj nga materiali im. Këtu, sa i përket së folmes arbëneshe, duhet të kufizohemi, sepse vokali i gjatë *a* ka arritur deri në shkallën *o*¹, e kjo është shkallë e kundërt me *a*^o të së folmeve të Krajës. P. sh. Për dialektin arbënesh: *gom-ōr* traj. shq. *gomari; funt-ōn-a; r-ōter; tr-ō, trāni*. Mua më duket se shkalla e vokalit *a* në të folmen arbëneshe nuk ka arritur deri te *o* e pastër, siç mendojnë studiuesit e mëprashëm të së folmes së shqiparëve të Zarës.

88. Po vazhdojmë të nxjerrim në shesh tiparet e konsonantizmit të të folmeve të Briskut e Shestanit të Krajës. Është rregull i vjetër që struktura e tingujve të një gjuhe në çështjet e marrëdhënies së saj me të folmet fqinjë përfaqëson elementin vendimtar. Ajo, si dihet, ndryshon shumë ngadalë, prandaj edhe i ruan gjurmët e trajtave arkaike të tingujve. Po sjell shembullin e një tingulli nga e folmja e Krajës, i cili, me gjithë rrebeshin e ndikimeve të jashtme fqinjësore, mbeti i paprekur: e ky është tingulli *ќ*. Është për t'u çuditur se si ka mundur të ruhet butësia (palatalizimi) i këtij tingulli kur çifti i tij *ć* nën ndikimin e të folmeve malazeze, nga aspekti i afrikatizimit u identifikua me këtë tingull në shqiptimin e gjuhës së huaj fqinje. Ndërkaq, butësia e saj (palataliteti) është identik me butësinë e dialektit të gegërishtes jugore dhe dialektit tosk.: *i kuk*. Mirëpo, te fjalët *ćobān, ćorāp, ćudi, u ćuon* tingulli *ć* është identik me tingullin *č* të serbokroatishtes, përkatësisht të të folmeve malazeze. Duke përjashtuar të folmet e gegërishtes jugore, të folmet e Krajës janë të folmet e vetme të gegërishtes, te të cilat deri më tani është ruajtur butësia (palataliteti) i tingullit në fjalë, e tillë siç ka qenë me siguri edhe në shqipen e vjetër. Po përmendim disa fjalë l dhe fjali ku ndeshim *ќ-ën* e butë, *Ѓurak*=fshatn ë Shestanin e Poshtëm; *ќūrēk*=lloj lopate; *guńik*=derrkuc; *ćoje i điri mićt e tī; mos t na vrase Leka i kēć; kē mē kćūr kur t pikńe tri pik ġak; kó dāl' mreti me t ġil n šetī*. Ajo që u tha për *ќ* e butë vlen edhe për *ģ*- të butë dhe të fortë. Prandaj unë në shembujt e mi do të sjell fjalë e fjali kudo të ketë *ģ* të butë: *kó kġēn ní hān kŭ pritrńin ġuetort* (përveç fjalëzës tue, - *ģuetari* është e vetmja fjalë ku diftongu arkaik *uo* ka kaluar në shkallën *ue*, por thuhet *me ġuo*); *mē ē ġēt tāmł'in e hasłanešs; ede kŭ ka on ġil nrećt' ede e šokġa i kaəon kí atŭ ġinet e bukra e deut; tē špiġa i pikēn trī pik ġāk; por po t'ģień nī kařōc; mos diktōn kun ġā*.

Unë mendoj se origjina e butësisë së tingullit *ќ* në të folmen fqinje të Cernicasve,⁵⁵ duhet kërkuar pikërisht në të folmet shqipe të Briskut e Shestanit, aq ë tepër kur të kihet parasysh se ky tipar takohet vetëm në të

⁵⁵ Branko Miletić, *Crmnički govor*, SDZ, IX (1940, f. 74 [282]).

folmen e Cermnicës, e nuk ndeshet askund në të folmet e tjera fqinje malazeze. Tekefundit, nuk është ky i vetmi ndikim i së folmes fqinje shqipe të Briskut e Shestanit në të folmen e Cermnicës. Ekzistenca e dukurisë së tingullit / l të trashë në atë të folme, siç është pranuar kryesisht⁵⁶ duhet kërkuar në shqipe, i cili mund të gjendet si para palataleve ashtu edhe para vokaleve labiale: *mulī, fēļ, kalin, mieļ, mola, puļa, ufla*, etj. Prandaj unë kurrësi nuk mund të pajtohem me mendimin e B. Miletiqit (SDZ, IX) se *k, g*, në të folmet shqipe të Krajës së Malit të Zi para vokalit palatal u palatalizuan në *ć,ǵ* gjegjësisht në *ǵ*, p.sh. *kek. Është e vërtetë se tingujt k, g, që i paraprijnë ć,ǵ* së butë janë në një masë më të buta se të rëndomt, mirëpo se konsonantet qiellzore të sprasme kalojnë në palatalet *ć,ǵ*, kjo nuk qëndron askund. Është e vërtetë se konsonantet velare të përmendura janë zbutur, gjithsesi nga ndikimi i shqiptimit të *ć* së butë vijues ose *ǵ*. Sipas të gjitha gjasave, kjo duket si një parapërgatitje për të siguruar butësinë e palataleve *ć,ǵ*, e kjo arrihet në atë mënyrë që me kohë zbogëlohet kapaciteti i masës së ajrit dhe përftohet butësia e caktuar e tingujve *k, g*, nuk di a mund të vërtetohet me anë të parimeve teorike të fonetikës së përgjithshme ky shpjegim imi, mirëpo sa i përket kësaj dukurie në të folmen e Briskut e Shestanit, për këtë jam i bindur.

Pohimi i I. Popoviqit⁵⁷ që butësia e konsonanteve palatale *ć,ǵ* në të folmet shqipe të toskërishtes është ruajtur në saje të afërsisë së gjuhës greke – nuk është i bindshëm, sepse, siç është e ditur, butësia e tingujve të përmendur është dëshmuar edhe në veri të Shkodrës në të folmet shqipe të Briskut e Shestanit. Fakti se butësia e tingujve të përmendur është ruajtur në të folmet e Malësisë së Krajës, flet në favor të mendimit se konsonantet palatale *ć,ǵ*, edhe në të kaluarën kanë qenë në përdorim në të gjitha të folmet shqipe; do të thotë se kjo ishte veçori i mbarë gjuhës shqipe.

89. Tingulli / l në të folmet e Briskut e Shestanit nuk paraqet kurrfarë problemi të veçantë, ndaj unë nuk do të ndalem në analizën e Branko

⁵⁶ A. Belić, *Galički dijalekat*, 1935, f. 104; për këtë nga i njëjti autor: JF. 172, dhe Mih. Stevanović, JF. lib. XIII.f. 42-45.

⁵⁷ I. Popoviq, *Istorija Srpskohrvatskog jezika*, Novi Sad, Matica Srpska, 1955, f. 137.

Miletiqit (Crmnički govor, SDZ, IX (1940), f. 281), i cili duke shqyrtuar tingullin /nuk i hetoi këto elemente: “Sa i përket vetë artikulimit ktë /së, në të, së paku aq sa kam mundur kalimthi të hetoj, vërtet ndërmjet së folmes së Cermnizës dhe asaj të shqiptarëve të Krajës ekzistojnë pikëtakime të dukshme. Kështu në Dr. (shkurtesë për Draçevicën) kam dëgjuar tri lloje /, të cilat sipas përshtypjeve akustike më janë dukur krejtësisht identike me të folmen e Cermnicës, për shembull: *lom-i* (dhëmbi), *me lón* (dhënë, *fitoj, mola, pula, ufla feł, let-i (loti), me lez* (dhezë), *l’ala, (bac, axhë), l’opa, l’uga, bol’et*, e të tjerë shembuj të ngjashëm. Mirëpo /në shqipet mund të gjendet edhe para vokalit të radhës së parë: *kaliń-i, miel-i el-i (edh-i), orlija*. Për kalimin e /l’ khs. *l’ivada* (krahaso or*l-i*), o.c. 281.

Nga rreshtat e mësipërm shihet qartë se Miletiqi në të folmet shqipe të Krajës së Malit të Zi shënoi tri lloje të /së, njëri është / e butë (në albanologji shënohet zakonisht me shenjën /) /evropiane dhe / (e trashë) labiale (/në grafinë moderne të shkrimit shqip).

Vlen të thuhet se a është e qëndrueshme nga aspekti historik ekzistenca e tri llojeve të /së në gjuhën shqipe. Për këtë tingull është shkruar mjaft. Linguisti i Kopenhagës, *Pedersen* i kushtoi një studim të shkurtër. *L. Laute im Albanesischen*, KZ XXXIII, f. 535-551. Ai pas një analize të huazimeve latine në gjuhën shqipe, tregoi se / shqipe sipas ekzistencës së saj është tri llojesh. E para, /latine intervokale në shqipe dhe /labiale, p.sh. *bubalus*>shq. *buel bual*, lat. *fufica*, shqip *fellânze*, tosk. *velenze*, *motinum*, shq. *muti-ni*, tosk. *mutiri*. /së dyfishtë latine në shqipe i përgjigjet – / e butë, p.sh. lat. *gallus*>shqip. *gel’*; *pullus*, shq. *pul’e*; *fabella*>shq. *fjal’e* (Pedersen, o.c., 535). Në tipin e tretë të tingullit / *Pedersen* i përmend edhe /shqipe që është rezultat i /j (*li, le*) latine, e cila te pjesa dërrmuese e të folmeve shqipe kaloi në j, duke u kryer jotizimi, p.sh. lat. *milia*>shq. *mil’e, mije*; *familia*>shq. *femil’e, femije*, *vitulea*>shqip *ftul’e, ftuje*; *oleum*>shq. *vol’, val’>voj, vaj*; *rosalia* shq. *řšaje*.

Kaq sa i përket prejardhjes së /së shqipe. Ndërkaq, *Pedersen* i kushtoi një studim të veta askund nuk pohon se sipas shqiptimit në shqipe ekzistojnë

tre tipa të *l*-së. Për dy tipa të *l*-së ai flet në monografinë për të folmen e Çamërisë (*Albanesische Texte mit Glossar*, f. 8). Për këtë ai konkludon: “Ich glaube behaupten zu dürfen, dass bis jetzt keine hinlänglichen Zeugnisse für eine dreifache Verschiedenheit der alb. *l* – *Laute* vorliegen”, o.c., f. 8.

90. Për dyjësinë e tipit *l* në shqipe, pak para Pedersenit shkroi konsulli francez në Janinë, Auguste Dozoni, në gramatikën e vet të vëllimshme: *Manuel de la langue chkipe ou albanaise*, Paris, 1879. Sipas tij në shqipe nuk ka *l* evropiane (ai thkotë franceze). Pasigurinë në dallimin e njërit tip të *l*-së nga tjetri Dozoni e shprehu haptas: “...Capendent j’avoue que ma certitude à cet égard n’est pas absolue. Quand on me dictait, il me fallait souvent demander quelle était la qualité de *l* entendue (de même pour *r* et *rh*), tandis que ouvent aussi je discernais parfaitement les sons décrits au texte. Enfin dans le son rendu par *ly*, on dirait parfois qu’il y aurait à distinguer une *l* molle et une *l* suivie d’un *i*, comme dans *lièvre*. C’est ce qu’indique aussi la forme *fyéta*, je dormis, pour *flyéta*, où la semi-voyelle seule a été conservée”, o.c. 181.

Edhe pse Dozoni me vështirësi i dalloi tipat e tingullit *l*, një gjë është e sigurt: se në tekstet e tij të shqipes ka dy tipa të tingullit *l*, *l* labiale (tek ai *lh*) dhe *l* (në grafinë e tij *ly*). Pa dyshim se në disa raste, ai hetoi nuancat ndërmjet *ly* të butë dhe *l*, pas të cilit pason vokali *i*, për shembull *ljepur*.

Ky pohim i Dozonit e vërteton bindjen time se *l*, e butë në dialektin toskë, në jug të Shqipërisë, duhet të jetë patjetër më pak palatal sesa *l* siç e ndeshim në të folmet gege; së këndejmë del edhe mundësia e dallimit të këtij tingulli *l*, pas të cilit pason vokali *i* në dialektin toskë. Unë edhe sot jam i paluhatshëm në bindjen se *l* toske është më pak palatale nga ajo e gegërishtes; këtë ma ka dëshmuar edhe verifikimi te studentët e mi të cilët gjuhë amnore kanë dialektin toskë. *l* e butë e shqiptarëve të Kosovës plotësisht përputhet me tingullin *lj* të të folmeve serbokroate. Duket se Dozoni ka të drejtë që në shqiptimin e tingullit *l*, dëgjon një nuancë të vogël, e kjo do të thotë se kjo duhet të jetë një *l* evropiane, nga njëra anë, dhe *lje* butë serbokroate ose *l* e gegërishtes, nga ana tjetër.

91. Gustav Meyer mendon se në gjuhën shqipe ndeshet edhe *l*

evropiane, e kjo paraqitet vetëm në fjalët e huaja. Një mendim i tillë nuk mund të jetë i saktë, me përjashtim nëse Majeri ka menduar për përdorimin e fjalëve të huaja në gojën e intelektualëve shqiptarë. Në dialektin e shqiptarëve të Greqisë ai kategorikisht mendon se ka tre tipa të *l*: “...*seine Unterscheidung der drei l – Laute, (l', l, λ, wie ich schreibe l', l, λ), habe ich beibehalten, denn sie existieren im griechischen Albanesisch wirrklich. Auch das l ist mehr erweicht als unser gewöhnliches l, aber der Unterschied von l' ist bei einiger Übung auch nicht schwer zu erfassen*”, Meyer, *Alb. St. V.*, f. 3.

Tekstet e Majerit në veprën *Albanesische Studien*, V, VI, janë shumë të larmishme në përfaqësimin e tingullit të përmendur, ndaj për shkak të pasaktësisë nuk mund të konsiderohen të sigurt. Kjo laramani në shënimin e tingullit në fjalë u shkaktua ngase autori mori material nga përmbledhjet e këngëve dhe lëndës gjuhësore nga mbledhës të kombësive të ndryshme, të cilët kanë pasur vesh të mirë, mirëpo sigurisht u ka munguar parapërgatitja fonetike për të shënuar saktësisht lëndën gjuhësore.

Nga aspekti i tingullit *l*, disa tregime që Majeri i shënoi në vise të ndryshme të Greqisë të banuara me shqiptarë, është me interes të theksojmë se *l* e butë gjendet pothuaj në të gjitha fjalët *l*-ja e të cilave në pjesën dërrmuese të të folmeve shqipe jotizohet, përshembull: *bil'e > bije*, *ftul'e > ftuje*, lat. *vitulea*; *mal'e > maje*; khs.: Meyer, *Alb. stud.*, V, f. 32-51.

92. T'u kthehemi shembujve të Miletit për tingullin *l*, që ai i shënoi në Draçevicë, të Krajës së Malit të Zi. Nuk duhet lënë pas dore fakti se në Draçevicë jeton popullata serbe e konfesionit ortodoks. Popullata është bilingve (dygjuhëshe). Duke pasur parasysh shembujt që i shënoi ai, unë nuk mund të pajtohem me të, ku në vend të *l*-së së trashë kjo popullatë ka në përdorim të mesmen, përkatësisht *l*-në evropiane: *let-i (lot)*, *me jez (me dhezë)*; Miletit, Crmnički govor, f. 73.

Unë e kam shëtitur kryq e tërthuer Krajën e Malit të Zi, Shestanin e Briskun, ku gjëllin popullata shqiptare, mirëpo askund nuk më ka rënë të dëgjohet *l* evropiane. Atëherë si mund të shpjegohet fakti se në Draçevicë përdoret *l* e mesme? Kjo është e thjeshtë. Popullata e Draçevicës është

bilingve; madje, kjo në mes vete përdor gjuhën serbe, dhe natyrisht se subjekti, me të cilin Miletiqu ka biseduar, ia ka përshtatur shqiptimin sipas artikulimit të tingullit të gjuhës amtare të bashkëbiseduesit të vet.

Vlerësimi i pasigurt i Miletiquit për tingullin / shihet qartë në shembujt /*ala*, në vend të /, e dëgjoji /, edhe pse / dhe /', për shkak të dallimit të vogël në shqiptim, shpesh alternohen, por që të paraqitet kjo luhatje edhe te / dhe /'ku dallimi në mes të njërit dhe tingullit tjetër është mjaft i madh është i pakuptueshëm.

Në të folmen e sotme të arbëneshëve të Zarës, trualli i të cilëve është Brisku e Shestani i Krajës së Malit të Zi, /ja është tingull dominues (në gjeneratat e moshës së vjetër aty-këtu dëgjohet edhe t (/) velare). Mirëpo, është e qartë se kjo / e mesme në këtë të folme është dukuri e vonshme. Sot, kjo e folme ka zëvendësuar çdo spirant të zëshëm interdental ($\delta > /$ p.sh. *me lēu* [me dhezē], *me lār* [dhënë] etj.). Pa dyshim senë fillim ndërrimi bëhej me labialen /, siç tregojnë për bukuri shembujt e Berçiqit që i kishte mbledhur për sllavistin e famshëm Mikloshicin në vitet e gjashtëdhjeta të shekullit të kaluar: *Malsti* (superbia), (i)leti (*decem*), *darla* (sot në arbënishte – *darda*, *lamb* (dhëmb), *me mbleλ* (me mbledhë) *me ilnuo* (adirarsi), *ula* (udha); Miklosich, *Albanische Forschungen*, II. Fjalët e përmendura tregojnë qartë se substitucioni i spirantit të zëshëm interdental në fillim është kryer nga labiali /, siç dëshmon sot qartë e folmja e shqiptarëve të Krajës.

Pamë se në të folmen gege të Krajës së Malit të Zi nuk ka / të mesme, përveç artikulimit të të huajve, që në rastin konkret do të thotë se subjekti bilingual, siç është popullata e Draçevicës të cilit Miletiqu në përgjigje i ishte drejtuar, përshtaste shqiptimin sipas artikulimit të tingullit / të gjuhës së vet amnore, përkatësisht gjuhës së bashkëbiseduesit të vet.

93. Po shfrytëzoj rastin t'i kthehem pohimit të Pekmezit, i cili disa herë e shprehu në referatin e vet të gjerë lidhur me studimin tashmë të cituar të Pedersenit për të folmen e Çamërisë. Ai e konteston pohimin se / e mesme ndeshet vetëm në fjalët me prejardhje të huaj. Kjo deri në një masë është e saktë, sepse pa dyshim në vend të /' së butë, që e përligj

etimologjia, te toskët dëgjohej edhe një /l/ më pak palatale, e kjo kryesisht para vokaleve të mbyllëta dhe konsonanteve, për shembull: *lot*, *lope* (unë këtu do të rreshtoja edhe shembujt *los*, *lut*, që Pekmezi i pandeh fjalë me /l/ të butë; *Archiv für slavische Philologie*, XXI, f. 219), *đalp*, *đalme*, *helm* *đilperë*, *pulpe*, *đelperë*, do të thotë se /l/ në fjalët e zëna ngoje – për shkak të vokalit të mbyllët, ose konsonantit që pason, është depalatalizuar. Së këndejmi /l/ në dialektin toskë shqiptohet me një palatalitet më të paktë. Kjo dukuri është e njohur edhe në disa të folme jugosllave, për shembull, në dialektin e kajkavishtes, ku në vend të /l-së/ etimologjike në fjalën *l'ubiti*, indoevr. *Leubli*, përsëri për shkak të velare pasuese *u*, /l-ja/ është depalatalizuar. Me këtë, besoj se është evituar pengesa para së cilës ishte stepur vetë Pedersen. (Pekmezi, o.c. 219).

Fjalët në mbështetje të të cilave Pekmezi e bazon teorinë e vet, një pjesë e mirë janë me prejardhje të huaj, veçanërisht nga gjuha greke, ku /l/ me siguri është e mesme. Me prejardhje turke janë këto fjalë: *leđen*, nga turq. *Legen*, *ligen*; *lelek* turq. *leylek*, *leilek*; *lezet*. Huazime latine janë: *lemš*, geg. *lamš* < lat. *glemu* + *s*, që është sufiks i shqipes; *letre* < lat. *litterae*; *lava* < lat. *lavare*; *leće*, pl. nga *lak*; burimin e ka nga fjala latine *lagueus* me të njëjtin kuptim; *lišoj*, *lešoj* < lat. *lassare*; *levdoj* < lat. *laudare*; në huazimet greke bëjnë pjesë: *lakra*, geg. *lakna* < gr. *Aayavcy*, *lipsem*; *litar*. Këtu ka disa fjalë pa dyshim me prejardhje indoevropiane – /l/ në të cilave Pekmezi e pandeh të mesme: mirëpo, analiza etimologjike dëshmon se në gjuhën shqipe sipas prejardhjes së /l/ ekzistojnë dy grupe fjalësh.

Është trashë velare shqipe është refleksi i grupeve konsonantike indoevropiane *ls*, *sl*, parasll. *kolso*, sllav.vj. *klase*, shq. *kal-i*, indoevr. *kasla* > shq. *kolë*, *kōl*, sllav.vj. *kašalj*. Megjithatë /l/ në shembujt (lind) *le*, *lind*, *leń*; *lis* (ekziston mendimi sekjo është huazim sllav – (*les*), *leš*), që sjell Pekmezi, nuk janë rezultate asimilimi të grupeve konsonantike *sl*, *ls*.

Le te na lejohet të bëjmë analizën etimologjike të shembujve të sipërpërmendur. Fjalës shqipe *liō*, në fjalën latine sipas Joklit (*Stud.z.alb. E tym.u Wortbil*; I, f. 99), i përgjigjet *ligare* (binden), lit. *laigōnose* (Bruder der Frau), nga indoevr. * *leig*. Prejardhjen e kësaj fjale Bariqi e kërkon në

indoevropianishte+ *uld(h)ō*; e cila nëpërmjet trajtës parashq.⁺ *vlido(v) liō* (*o*) dha *li-δ-em, liv*, - dhe e krahasoi me lat. *volvo, rolle*, gr. *Ελύω* Winde krümme, ind.vj. *valayah* (Armband, Reif), rus. *vólotb* (Faden, Fasser); Bariqi, *Albanorum. Stud.*, I, 44; *Hymje në historin e gjuhës shqipe*, 43.

As etimologjia e fjalëve shqipe *l'vi, l'ajvi, l'ejvi*, nga paratrajta* *l'eška, l'e(š)kv, *l'ejv* nga *l'ajv* (khs. *Bariqi Albanorum. Stud.*, I, 44; Jokl. *Unters*) *lajví*, lit. *lalzda*, - nuk flet në favor të shkrimit me *l* të mesme, por me të butën; *lajv-i, lejv-i*. *L*-ja është e butë në fjalën *l'eš*, - ndaj si duket Majeri kishte të drejtë kur këtë fjalë e nxjerr⁺ nga indoevr. **tleusi* (evvb-241), ose Jokli (st.50), i cili niset nga *leu-s* me formantin *s*, ose Bariqi (*Albanorum. St.*, 45): **velā* nga *ulv-s* indoger.* *ueld* ind. vj. *uřina*, lit. *vilna*, lat. *lana*, gr. *λῆνος* got. *Wulla*.

L'ind (l'en) – Meyeri e nxjerr nga latinishtja *levare* (EWB 241); Pedersen (Albt.12) tregoi të dhënë se trajta *l'en* nga *l'ind* u përftua nga asimilimi; prejardhja e saj është nga indoevr.* *leud(h)-m*, got.liudan (me u rritë), ven. vj. *botan*, ven.re *Leute*, sllav.vj. *ljuds* (popull), let. *laudis* (popull); Jokl, *Stud. 49, Unters. 262*, Walde – Pokorny, II, 416. Etimologjia e fjalës nuk i bie ndesh faktit se *l*-ja në të është e butë.

Mejeri besonte se prejardhja e fjalës *l'ot*, duhet kërkuar në latinishtje *l'ot*, duhet kërkuar në latinishtje *flētus* (vaj), EWB. 249 H. Bariq: nga indoevr.* *lē (j)-to*, (i derdhur), sllav. *Лѣjn, lějo*, lit. *lėju* (toçitë), *lytus* (shiu), dhe Waldeu sjell. *Lat. Etym. Wb*, 422, Ficka, 427, këtë fjalë e krahason me sllav.vj. *lěto*, nga *lādning* (pranverë); Arhiv, I, 149. Sa i përket tingullit nistor *l*, nuk ka vend dyshimi se ai shqiptohet i butë.

L'ope - Etimologjia e fjalës nuk është vërtetuar (Meyer, EWB, 248; Jokl, iF, XLIII, 57. Ekziston bindja e shkencëtarëve – albanologë se ajo është me origjinë paraindoevropiane. Mirëpo, *l*-ja nistore në çdo rast është e butë.

Lakra, geg. *lakna*, prejardhja e saj është greke (*layava*, Meyer, EWB, 236; Jokl, *Unters. 308*). Nga aspekti etimologjik nuk ka vend dyshimi në palatalitetin e tingullit nistor *l*.

Pekmezi bën gabim të madh kur pohon se / shqipe është refleksi i geminates // latine (p.sh. lat. *mantellum* > shq. *mendel'e*, *menel'e*, *menl'e* (shpërgaj), *montellus* > shq. *Munel'e* (emër kodre në Shqipëri), sot *Mnel'e*, *Mnel'e*, *fabella* > shq. *fjal'e*) - duhet konsideruar / e mesme, sepse kjo kundërshtohet me të dhënë se // edhe në latinishte ishte e butë, siç dëshmojnë shembujt në gjuhët romane, e është në kundërshtim edhe me shpjegimet e Holger Pedersenit lidhur me tipat e /-së së gjuhës shqipe (KZ, XXXIII, 535-551).

Pekmezi /-në e mesme e ndesh në shembujt vijues, të marrë nga përmbledhja e Reinholdit: *ble*, *bluaj*, *fle*, *flake*, *flete*, *flok*, *fluturoj*, *flori*, *plak*, *flas*, *plakos*, *plep*, *plešt*, *plot*, *plehure*. Pekmezi as këtu nuk ka të drejtë, sepse / në fjalët me prejardhje latine, si *fluturoj* < lat. *fluctulare*; *flok* < lat. *floccus*, *plep* < lat. *ploppus*, me siguri është e butë, siç e ilustron për mrekulli reflekset romane, që dëshmojnë faktin se kjo në gjuhën latine ishte / e butë, p.sh.: *floccus* > ital. *fiocco*, *ploppus* > *pioppo*.

Butësia e tingullit / në grupet *bl'*, *pl'*, *fl'* dëshmon qartë dukurinë e spirantizimit të /-së në disa të folme gege, përkatësisht ku i tërë grupi konsonantik palatalizohet, p.sh. *pl'ak* > *pjak* > *ćak*; *pl'eh* > *pjeh* > *pćeh* > *će(h)*; *plot* > *pjot* > *pćot*; *pl'ešt* > *pjēšt* > *pćēšt* > *ćešt*; *pl'ep* > *pjep* > *pćep* > *ćep*; *fl'ok* > *fjok*; *fl'et* > *fjet*; *bl'et* > *et*; *ble.bje* > *e*; *ćaj bdeške* (= *ćaj bjeshke*); khs. Skok. *Lingvistička proučavanja*, f. 218-219; Mladenovi, *Balkan – Archiv*, I, 54, 63, 65; Jokl. *Vorl Bericht*, 7; J. Rrota, *Letratura shqype*, I, 19) Tagliavini, *Le terre albanesi redente*, Roma, 60 – 61; W. Cimochofski, *Le dialecte de Dushmani*, 23.

Thjeshtimi i grupeve konsonantike *bl'*, *pl'*, *fl'* është asimilimi i tyre në ć, siç shihet nga shembujt e përmendur, të cilët tregojnë qartë se kjo / është e butë, sepse rruga deri te ć patjetër është dashur që / të jetë e butë në grupet e përmendura konsonantike. Kjo dukuri ndeshet edhe në të folmen abruceze; ital. *piano*, *abruc.ćano*; lat. *clarus* > ital. *chiaro*, *abruc.ćaro*; *claudus* > ital. *chiodo*, *ven.ćodo*.

Dukuria e përmendur e palatalizimit të labialeve është e njohur edhe në dialektet rumune: *piatra* > *Pćatra* > *ćatra*; *Pćept* > *ćept*; khs. *C*.

Tagliavini, Scritti in onore di A. Trombetti, Milano, 1937, f. 94.e pastaj edhe E. Herzog, *Revista filologica*, II (1928), 154 dhe te, Meyer – Lübke, *Palatalizarea labialelor*, në *Dakoromani*, II (1922), f. 9.

Sa i përket *l*-së, sipas Pekmezit në shembujt e tij të sjellë *bl'e, bl'uaj, fl'e, fl'ak, fl'et, pl'ehurë*, ajo me siguri rrjedh nga rregulla e njohur sipas së cilës *l* palatale para vokaleve labiale, përkatësisht konsonanteve – depalatalizohet.

Pekmezi pohon se *l* e mesme ekziston edhe në të folmen e vendlindjes së tij (Strugë), ndërkaq, për Dibrën, Gjakovën e Shkodrën ia dëshmuar subjektet, të cilët kishin vendlindje qytetet e përmendura. Unë jam i bindur se kjo *l*“e mesme”, për të cilën Pekmezi u angazhua aq shumë – është *l*'e butë e shqipes së gjithmbarshme, e cila në pjesën më të madhe të të folmeve toske është më pak palatale; kjo është një *l* e cila pranë vokaleve të mbyllëta ose konsonanteve – është depalatizuar.

Mirëpo nuk mund të pajtohem me pohimin e Pekmezit se *l*e mesme paraqitet edhe në të folmen gege të Gjakovës. Bindjen e vërteton edhe Fjalori i Kujunxhiçit *Srpsko-arnautski rečnik*, Beograd, 1902 (sidoqoftë, fjalori duhet përdorur me kujdes të madh, sepse nuk është i sigurt). Edhe pse Kujunxhiçi të njëjtën fjalë njëherë e shkruan në një mënyrë, ndërsa të dytën herë në tjetrën mënyrë, megjithatë tek ai një gjë shihet qartë: se fjalët për të cilat Pekmezi ishte i bindur se kanë *l*të mesme, në të folmen e Gjakovës paraqiten me *l* të butë. Po sjellim disa fjalë nga Fjalori i Kujunxhiçit, të cilat sipas Pekmezit posedojnë *l* të mesme: *fl'et* (gjeth), *tbl'eiš*, *bl'ejsi*, *pobl'ej*, *pobl'eiš*, *pobl'en*, *tl'oeš*, *pl'ak*, *pl'aki*, *l'opa*, *l'ot*, *pul'e*, *fjal'a*, *kadal'sum*, *mial't*, *tml'oiš*, *ml'oje*, *ícl'ún*, *el'*, *kal'i*, *pl'ot*.

Kundër tezës së ekzistimit të *l*-së së mesme në të folmen e Gjakovës dëshmon edhe verifikimi im te studentët nga Gjakova. Dhe në fund, mendoj se nuk ka mbetur gjë e errët lidhur me dyjësinë e tingullit *l* në gjuhën shqipe.⁵⁸

⁵⁸ Unë nuk mund të pajtohem me pohimin (f.15), se *l*' e butë shqipe saktësisht i përgjigjet *l* franceze. Në këtë dyshoi edhe vetë francezi Dozon, kur në veprën e vet të vëllimshme

94. Njëra ndër veçoritë e së folmes së Briskut e Shestanit të Krajës që duhet konsideruar si inovacion është edhe ndërrimi i tingullit *κ* në *j*, e cila, tek e fundit, nuk është e rrallë edhe në të folmet e toskërishtes: thuhet *šókí šojn*, por edhe *šókí šókin*; mirëpo, meqë shembujt e kësaj dukurie në të folmen e Briskut e Shestanit të Krajës janë mjaft të rrallë, nuk meriton t'i kushtojmë një shpjegim më të gjerë. Nga ana tjetër, mendojmë se është me rëndësi të theksojmë një tipar tjetër të së folmes së shqiptarëve të Krajës, e ky është substitucioni i tingullit *j* me palatalen *κ*, p.sh.: *nrek* < *nreit* < *ndreit*; *bíkt* < *bijt*. Kjo dukuri nuk është veçori vetëm e të folmeve të Krajës; kjo ndeshet edhe në të folmet toske të shqiptarëve të Greqisë dhe të Italisë, khs. *Marchiano, Poesie sacre albanesi*, 17. Natyrisht se për këtë duhet pasur parasysh se dukuria e përmendur u përket trajtave inovatore për të folmen në fjalë, e kjo thënë më saktësisht do të thotë se *κ* në fjalët e përmendura është rezultat i procesit të disimilimit të tingullit *j*, qënë shqipe është një përftim nga grupi konsonantik i latinishtes *ct*, që do të thotë se i përket asaj periudhe kur grupi i përmendur *ct* i latinishtes në shqipe u zëvendësua me *jt*. Kësaj i paraprin periudha e latinitetit ballkanik, kur grupi i përmendur *ct* në gjuhën shqipe u zëvendësua me *ft*, *fš*; khs. Bariqi, *Uzajamni odnosi balkanskih jezika*, f. 22-23.

95. Njëra ndër pikat dalluese ndërmjet dialektit gegë dhe dialektit toskë pa dyshim është edhe raporti i nduarduartë ndaj grupeve konsonantike *nd*, *mb*, *ng*. E folmja e sotme e shqiptarëve të Krajës, Briskut e Shestanit nuk i ruan në tërësi grupet e përmendura konsonantike, sepse në to është kryer asimilimi i okluziveve, prandaj shqiptohet vetëm elementi i parë i tyre *n* ose *m*, siç ndodh, tekefundit, me pjesën dërrmuese të të fol-

(1879) *Manuel de la langue shqipe ou albanaise*, f. 181 shprehet: *L français paraît ne pas exister en albanais ly (=l') équivant aussi à l'italien gl'et se rapproche de li dans lion*". Është me interes vërejtja e koleges Stana Kashanin, lektore e gjuhës frënge në Katedrën e romanistikës në Beograd, se studentët shqiptarë nga Kosova, Metohia dhe Maqedonia, në orët e ushtrimeve, tingullin *l* si duket e shqiptojnë më të butë sesa faktikisht shqiptohet në gjuhën frënge në të cilën gjë ajo vazhdimisht ua tërhiqte vërejtjen se *l* franceze është më pak palatale dhe si e tillë duhet shqiptuar. Kjo e dhënë është vendimtare në përcaktimin e butësisë së *l'* shqipe. Do të thotë se ajo nuk është identike me *l* franceze.

meve gege; p.sh. në të folmen e Krajës: *mnel'a* nga lat. *mantéllus* > *mendel'a*; *masanej*<*masandej*; *knej*<*kndej*<*kendej*, *gínja*<*gíndja*; *šnoš*<*šendoš*. Megjithëkëtë, unë gjatë qëndrimit tim në Shestan e Brisk, kam hasur njerëz të shkuar në moshë, të cilët besnikërisht i shqiptonin grupet konsonantike *nd*, *mb*: *andej*, *masandej*, *mbret*, *katund*, *šendoš*, *kuvend*, *ndër*, ekjo tregon faktin se grupet e përmendura konsonantike në të folmet e Krajës qenë në përdorim edhe një kohë të gjatë pas shpërnguljes së arbëneshëve të sotëm në Zarë nga këto vise. Se këto grupe konsonantike shqiptoheshin edhe në të folme të tjera gege, dëshmojnë qartë dokumetet gjuhësore të shkruara në shekullin XVI-XVII: për fillimin e shekullit XVIII kemi të dhëna nga *Kuvendi* Arbënit 1703, ndërsa për gjysmën e shekullit XVIII dëshmi është Arbëneshi i Zarës (ardhja e stërgjyshërve të arbëneshëve të Zarës në intervalet kohore prej 1726 deri 1733; te Buzuku ndeshim: *te endigluom*; *me zdritun pak mendete e atüne!!! Embas sodi*; *e ate ne enbaroš*; *e tue lane te štrebbe nene, ende, kañduor V dit*; *e ake nuke munde kelOnin*; *ende per muo*: *Antologjija e letërsisë shqipe*, Prishtinë, 1954, 21, 22). *Te P. Budi*: *E prifti mbet ende kenduu tutje nde ndooñe, nde mend* (o.c.; 30. – 31). Te Frang Bardhi (nga parathënia): *me ndimuem, e dindene nde ket te kuvendit, mbasandaj*, (o.c.46). Te Pjetër Bogdani (nga parathënia (*Cuneus prophetarum*); *andaj, ende, me nderekene, festijr mundete, ndermjetsime, ju urdenoj*. S. kuvend, (o.c., 52). Kur është fjala për kronologjinë e asimilimit të grupeve konsonantike të përmendura, atëherë është më se e bindshme se ky asimilim nuk është kryer në të gjitha të folmet gege njëkohësisht, prandaj është krejtësisht e arsyeshme mospërputhja e dialekteve në këtë pikë, do të thotë është e kuptueshme se në të njëjtën periudhë kohore, njëri i ruan këto grupe (dialekti toskë), ndërsa tjetri jo (dialekti gegë). Unë mendoj se shkencëtari shqiptar E. Çabej ka të drejtë kur pohon, (*Buletin për shkencat shkoqërore*, 1955/2, f. 93) se epiqendra e kësaj dukurie duhet kërkuar në qendrën e territorit të dialekteve gege, që me siguri kjo qendër është Shkodra, prej nga kjo dukuri rrezatoi në të gjitha anët.

Me Çabejn nuk mund të pajtohem nga aspekti i ruajtjes së këtyre

grupeve konsonantike, i cili mendon se ato u ruajtën në mënyrë të përkryer përveç në toskërishte edhe në të folmen e Gjakovës edhe në disa të folme shqipe të Kosovës. Është interesante të theksohet se këto grupe konsonantike u ruajtën edhe në të folmet shqipe të Pejës dhe të Vuçiternës; ndërkaq, në vende të tjera të Kosovës unë nuk i kam dëgjuar. Unë mendoj se qytezat e përmendura në këtë aspekt paraqesin oaza, sepse fshatrat përreth nuk e njohin këtë tipar arkaik. Sa i përket kronologjisë së asimilimit të dialektit të shqiptarëve të Krajës, unë mendoj nuk duhet marrë fundi i shekullit XVIII ose fillimi i shekullit XIX. Se ky proces vazhdoi deri vonë, dëshmojnë qartë edhe sot gjurmët e ruajtjes së këtyre grupeve në të folmet e përmendura.

96. Me përdorimin e tingullit *ń* e këtillë në disa trajta ruhet në mënyrë të përsosur edhe sot, siç thamë, në të folmet e Briskut e Shestanit të Krajës, madje në të gjitha ato trajta në të cilat edhe dialekti toskë i ka ruajtur; unë madje do të thosha se e folmja e Krajës në këtë aspekt është më arkaike se të folmet toske, te të cilat tingulli i përmendur aty-këtu është palatalizuar plotësisht. Shkrimtarët e sotëm të Shqipërisë së Jugut shkruajnë kryesisht në *benim, ju flinit, ata flinin*; etj., në vend të trajtave të vjetra *ruaním, ruanít, ruanín; flením, fleńít, fleńín*; khs. Buletini, 1955 / (1-2). Siç shihet, palatalizimi *ń* është kryer kryesisht në pluralin e imperfektit; për njëjësën e emrit nuk kemi dëshmi. Ndërkaq, në të folmet e Krajës nuk ka asnjë gjurmë të palatalizimit të tingullit *ń*, as te foljet as te emrat dhe as te pjesët e tjera të ligjëratës: *ata dilńín ka dń-tre; sońa-te mesuemít; i kińńeń vńn; Pecań=Draçevíce; Mal'ań (Maljevíci) Barđań (=srb. Bardići); Dedań (=Dedići); kuń, šeńmíra; šeń; streń*; D. Kurti, HD, XIV, 87. Tingulli i përmendur, përveç gegërishtes jugore, në të folmet e tjera geqe është zhdukur plotësisht, në të vërtetë ai sot në ato është palatalizuar tërësisht. Dokumentet e shkrimtarëve të vjetër gegë dëshmojnë se dialekti gegë ka njohur vetëm *ń*, e ky tingull është ruajtur deri në fillim të shekullit XVIII, prandaj sigurisht edhe në të folmen e Shkodrës, khs. *Da Leece, Osservazioni gramaticali della lingua albanese*, 1716, zonat laterale të të cilave, gjithsesi, i ruajtën për një kohë më të gjatë, siç dëshmojnë të folmet e Bris-

kut e Shestanit.

Çabej bën gabimin e dytë kur pa verifikim paraprak sjell të dhëna sipas të cilave tingulli i përmendur është ruajtur edhe në të folmen e sotme të Gjakovës (Çabej, o.c., 95). Shembujt që sjell ai apër Gjakovën: *ftoñat, ron* (në vend të *ftoft, řajt řojt*) me siguri nuk janë të vërtetë e të saktë. Prandaj duhet reviduar konstatimi i Çabejt për lokalizimin e tingullit *j* të dalë nga *ñ* e të folmeve geqe.

97. E folmja e Briskut e Shestanit të Krajës nuk bën kurrfarë përjashtimi as në konsonantin likuid *l*, fatin historik të së cilës e tregoi linguisti danez Holger Pedersen (KZ, XXXIII, 535). Ndoshta është me interes, grupi *lj*, i cili në të gjitha të folmet geqe kaloi në spirantin *j*, madje, siç del nga dokumentet e klasikëve gegë, të shkrimeve shqipe-mjaft herët. Është me interes që për këtë dukuri të përmendim emrin *Goljamadi* (shq. *Go-l'amađi*) – ofiq fisnor i dëshmuar më 1402 në perëndim të Malit të Zi, ku sot nuk ka as gjurmë për shqiptarët (Shufly, *Srbi i Arbanasi*, 76). Emri në fjalë është me rëndësi për trajtën që ka, sepse tregon se tingulli *l* në fjalën *goje* < *gol'e* ruhej në atë kohë, qoftë edhe në periferi të trevave gjuhësore shqipe. Në dokumentet e mëvonshme gjuhësore kjo dukuri nuk u dëshmuua askund. E folmja e Briskut e Shestanit, siç vura në pah më lart, nuk e ka ruajtur *l'-në* arkaike, por, si në të gjitha të folmet geqe, ky tingull edhe këtu u spirantizua në *j*. Në të folmet e Krajës ndeshim: *voj*, përballë latinishtes *olium, oleum*; *niej*=*ndiej* < lat. *indulgeo*; *bī* (= *bije*) nga *bil'e*; *maj*, sigurisht nga ital. *maglio*; *malj* përdoret edhe në të folmet serbokroate të Malit të Zi.

98. Në pozitë pas velarit në këtë të folme nuk janë ruajtur as likuidet, por vetëm pësuan palatalizim, p.sh. *i gjat* < *glatë*; *gjuh* < *gluge*; *kjen* < *klene*; tosk. *klene* > *kéne*; shkodr. *kēn*; kosov. *kān* (te Bogdani - *kiāne*). Një gjë është e vërtetë, se shqiptimi i *kj, gj* në të folmet e Briskut e Shestanit të Krajës disi është më i butë se ai në të folmen e Shkodrës.

99. Meqë e folmja e Briskut e Shestanit të Krajës në zëvendësimin e spirantit labiodental *f* dhe interdentalit *θ* (=th) shkoi më tej sesa të folmet e tjera geqe, në këtë do t'i kushtojmë më tepër kujdes. Është i njohur fakti

se ngatërrimi i spiranteve *f* e *ð* në të folmet shqipe është dukuri mjaft e shpeshtë. Sigurisht që Çabej ka të drejtë kur pohon se kjo dukuri u paraqit më parë në të folmet qendrore të gjuhës shqipe, dhe se ajo shumë shpejt u përhap në drejtim të periferive (Buletin, 1955/2). Është i saktë konstatimi se dialekti toskë e ruajti më mirë *h*-në e vjetër shqipe sesa të folmet geqe. Unë do të thosha se sipranti i përmendur u ruajt mirë në të folmet periferike geqe, më mirë sesa në të folmet e gegërishtes jugore, do të thotë se të folmet qendrore geqe. P.sh. në të folmen e shqiptarëve të Kosovës; *ñoh, ñeh. ñohim*, etj.; *šoh, šeh, šohim, šihni*, etj.; *the, me kréh, me řeh, řáh, me préh, me řmih*, ndërsa në gegërishten jugore këto dëgjohen: *šof, ñof, tef, me kref, me řaf, me mpreř, me mij, meřef* (Kosovë, *fšeh*). Edhe toskërishtja, kryesisht e ka ruajtur *h*-në arkaike. Kjo mund të dëshmohet gjithashtu edhe për gjuhën e klasikëve gegë, për Buzukun: *šihni fíkne e give lisat, se ñohme e duome dunetine e kíelše; u me mihnuë; nuke mundiñ*. Mirëpo, sporadikisht ndeshim: *ue te ñofš se je špetuom en doret se pa emenit; per se nuke viñ te floftet en dent* (cituar sipas Çabejt, *Buletini*, 1955/1, 97). Më vonë, në rrjedhën e kohës, tingulli *f* përfshin terren gjithnjë e më të gjerë, në disfavor të tingullit *h*, pikërisht në ato fjalë të cilat përdorëshin në kohën e Buzukut. Kjo mund të shihet edhe te Pjetër Bogdani (1685): *do šifte, 14; e ftofte, 15; nšefun, 15, 19, 31, 33, nuk ñoh, 20, 21; por per ta ñofun, 30, 31, etj.* Mirëpo, megjithëkëtë të folmet e malësorëve, në aspektin e kalimit të tingullit *h* në *f* dhe anasjelltas, në këtë drejtim janë shumë larg në konkurrencë me p.sh. elbanishten dhe të folmet e gegërishtes jugore në përgjithësi.⁵⁹

100. Për të vërtetuar se cila e folme ruajti numrin më të madh të fjalëve në të cilat paraqiten *ð*, *h*, gjenetike ose *f*, duhet bërë pa tjetër analiza e prejardhjes së çdo fjale veç e veç. Thuhet se toskët në fjalët e mëposhtme: *uðuł, ðele, keðuł*, kanë ruajtur tingullin e kryehershëm interdental, i cili në pjesën më të madhe të të folmeve geqe u shndërrua në spirantin labial *f*: *ufuł, feł, kfieł, te* etj. Fjala e parë *uðuł* duhet, sigurisht,

⁵⁹ Weigand. *Albanesisch-deutsches, deutsch-albanesisches Wörterbuch*, 1914; nga i njëjti *Albanesische Grammatik*, 1913; nga parath. "Cuneus prophetarum", Shkodër, 1930.

përqasur me shqipen *aðete*, khs. Serbkr. *Ljut, kiseø*, lit. *astrús, usni*, - Distel, Bariq *Albanorumänische Studien*, 111-112. Këtu tingulli ð pamëdyshje është i lashtë; *f* është sekondare.

Se tingulli ð në fjalën *ðete* është i lashtë e tregoi Pederseni (KZ, 36, 332), duke theksuar se ai duhet lidhur me greqishten *koτλος*, ind.vj. *sūnam* – *Leere*; prandaj trajta me *f*, *fēl* është e kohës së vonë. Jokli tregoi bindshëm se fjala *keðiet* mund të ndahet në këto pjesë përbërëse: në prefiksin *ke*, i cili është prefiks i shpeshtë në gjuhën shqipe, ndërsa *ðe* është baza e fjalës. Se është kështu, shihet për mrekulli nga trajta *fjela=fjelle* në të folmen shqipe të Sicilisë, në të cilën është ruajtur trajta pa prefiksin *ke* me kalimin e interdentalit të pazësëm ð në spirantin dental *f*: *fjela=kthjellët*. Prejardhja e *ðe* së shqipes duhet kërkuar në bazën *e* indoevropian.* (*S*) *kej*, sllav.vj. *sinoti* (me shkëlqye), got. *skeinan*, sllav. *Čist* (pastër), lit. *skāistas, skaistrus*; Jokl. *Studien für alb.Etymologie und Wortbildung*, 37-38. Ndërkaq, në dialektin toskë ndeshim *f>ð*; *fulica* <geg. *felānze*, tosk. *ðelenze*, lat. *Filicarius*>geg. *fier, fīr*, tosk. *ðier* (Dozon, 93); *favilla* > geg. *fel'ε*, tosk. *ðiel'e*.

Ja se si duket përzjerja e ndërsjelltë e dy tingujve në të folmet gege: lat. *farrinem*>geg. *ðeřime, ðřim, ðermi, me ðrmue* duhet të jetë nga latinishtja *fragminare*; *feřε*, me siguri nga lat. *vepres*, *v*-ja e së cilës dha *f* (njësoj sikurse te fjalët *vicinus*>shq. *fķin*; *invitare*>*fton*, etj.); gjithsesi, kjo fjalë duhet lidhur me foljen *ðeřε*=shpuar, shpoj. Në të folmen shqipe të Shestanit ndeshim: me *ðeř*, si substantiv gjithashtu *ðeř*; në Briskë: *me ðeř*, por substantivi - *feř*; e folmja arbëneshe njih të dy trajtat: me *sēr* (*ðer*) dhe me *fēr*. Në të folmen shqipe të Kosovës ndeshim trajtën: me *ðeř shpoj, ðeř-a*, mirëpo prandaj në të ndeshim *feřac* (plehnik, therrishtë) (L. Lukaj, *Rečnik arbanasko-srpskohrvatski*, Beograd, 1935).

101. Është mjaft enigmatike prejardhja e fjalës *ðengīte*, te Dozoni *ðengīl* dhe *fengīl*. Duket sheshazi se ajo nuk mund të nxirret nga lat. *favilla*, siç mendonte dikur Majeri (EW, 90); nga kjo mund të pasojë vetëm *fel'ε-flegër*, copë. Pederseni e la të pashpjeguar (KZ. 33, 538). Jokli mendoi se për shpjegimin e saj duhet nisur nga sllav. (*ð*)*og^bp*, serbokroatisht *ūgalj*,

ček. *uhel*, polon. *wiegel*. Kalimi i labialit ϑ në spirantin *f* është i mundshëm; në të na përvijon fjala *fuge=gërmusha*, nga fjala serbokroate, *vüga* me të njëjtin kuptim. En shpjegohet shumë lehtë me anë të nazalit labial *o*: *orodijb* shq. *orendije;podarb* >shq. *pendar*; Meyer, EW, 332. Tingulli *ǵ*, sipas Joklit, shpjegohet me palatalizimin e serbokroat.g, si në *ǵose* nga *kozje; ǵore* nga serbokroat.*gorē*. ϑ nistore në gjuhën shqipe mund të japë *f*, dhe për shkak të afërsisë së artikulimit me interdentalin e shurdhët dha ϑ : *ðengil*. Rrethanat në të cilat fjala *ðengil* në të folmen e shqiptarëve të Kosovës shqiptohet *ðngil*, *ðingil* nuk shkon në favor të shpjegimit të Joklit, veçanërisht për shkak të disimilimit *ng* në *ng*, sepse grupi *ng* në të folmen shqipe të Kosovës është ruajtur: *ën ul*, *ëngël*, *me n al*, *me ndit*, *me ndüe i del'bt* nga *ndel'bt*, të cilët në dialektin e Shkodrës i përgjigjet: *énuł*, *me nāl*, *me nūt*, *me nūe*, *i nel'm*, etj.

102. Vlen të theksojmë se jo shumë moti, e folmja e Briskut dhe e Shestanit të Krajës – më tepër e folmja arbëneshë – *f*-në më pak spirante e kthyen në spirantin interdental ϑ ; Krajë *ðtuo* m. *ftuo*, nga lat. *cotoneum*; *Krajë-diðtuo*; *me nōðt* nga *me nōft*, por thuhet *un*, *nöh*: *pridti* nga *prifti* nga lat. *praesbiter*; *ðmī* nga *f(e)mī*, trajtë e cila pjesërisht edhe sot përdoret: *lūðt*, *me luðtuo* nga *lūft*, *me luftuo*; *ðtūj*, nga *ftūj*; trajta më e vjetër *ðetuje* nga lat. *vitulea*; arbënisht *me nōð*, *me nōs*; *prid*, *pris*.

Kjo tendencë, pavarësisht nga të folmet e Krajës dhe të Arbëneshit të Zarës, përfshiu edhe të folmen e malësorëve të Dushmanit; krhs. Cimochoowski, *Le Dialecte*, 227: *ðmī*, *ðtovt*, *ðtujak*, *ðtue*, *ðturk*, trajtë me metatezë *tðurk*, nga *tfurk*.

103. të folmet e Briskut dhe Shestanit të Krajës dallohen me tiparin se spiranti interdental i zëshom δ , në të shumtën e rasteve, kaloai në *ł* të trashë: *uła e mār*; *li eden*, *hīni* (=hidhni, gjujeni), *pešlēt*; *jan lān* (=u dorëzuan); *as tttat nuk kan dāš me i δān*; *mreti i hjet pašalart perjašta*; *mrēti i hjet vajzēn perjašta*; *pl'aka i mol'i lit ede i la pl'akut*; *ede lit u trēmēn*; *ede kū po vien n'špi i iłt*. Me këtë nuk duam të themi se në të folmen e Krajës është zhdukur plotësisht interdentali i zëshëm δ . Ai, nëse nuk mbizotëron, në këtë të folme, përdoret mjaft. Mirëpo, këta dy tinguj,

veçanërisht në Shestan, ngatërrohen shumë; ndërsa në të folmen e Briskut këtë dukuri – e ndeshim më pak. Gjatë kërkimeve të mia në Shestan jam bindur se shqiptarët e atjeshëm nuk i dallonin dy tingujt e përmendur: ata do t'ju shqiptojnë edhe *đī* dhe *lī*, duke mos qenë të vetëdijshëm se në artikullimin e këtyre dy tingujve ekzistojnë dallime.

Justin Rrota (*Letratyra shqype*, Shkodër, 1934, f.19) pa dyshim gabon kur pohon se të folmet e Krajës velaren *l* e shndërrojnë në interdentalin e zëshëm *đ*, dhe sjell shembuj; *đad*=*gád*; *fedanzat* m. *felanzat*; *moda* m. *moła*; *đadε* m. *gáε*. Kjo nuk është e saktë, por siç kam theksuar më lart, është raport i kundërt, që atje është i njohur: *đī*: *lī*; *me đān*, *lān*, në këtë vise, pra thuhet *lī*, me *lān*, etj., *gīl*, e *kursesi gīđ*. Së paku në të folme të tilla të Krajës të cilat i kam studiuar unë, një dukuri e tillë është e panjohur.

B. Trajtat

104. Të folmet e Briskut dhe të Shestanit të Krajës meritojnë vështrim të veçantë edhe për ruajtjen e trajtave arkaike të deklinacionit dhe koniugacionit (lakimit dhe zgjedhimit); në të vërtetë, në këto të folme, edhe sot janë në përdorim trajtat, të cilat në të folmet e tjera gege moti janë zhdukur. Unë mendoj se izolimi dhe konfiguracioni i terrenit të Briskut e Shestanit janë njëra ndër shkaqet e ruajtjes së trajtave të vjetra të këtyre të folmeve.

105. Vëmendje të veçantë meriton edhe fakti se në të folmet e shqiptarëve të Krajës, Briskut e Shestanit ndeshim një tipar mjaft arkaik – njëgjinishmërinë e emrave të gjinisë mashkullore, ndërsa në të folme të tjera gege, e në një masë më të vogël edhe toske, ekziston dygjinishmëria, këtë e ndeshim në të folmet e Krajës: *ku prītnīn guetart n ata māle šum vende tjer*; *kta vakte nuk kan*; *kjen kta hal'ete*; *kta brege*; *pa kaluo tre katune* (Shestan); *eđe kápēn mal'et e škret*; *kjo e škreta (vājz) trētēn n male t'škret* (emri dhe mbiemri janë në gjininë mashkullore). E kjo do të

thotë se emrat e lartpërmendur edhe në njëjës edhe në shumës janë të gjinisë mashkullore, që nuk është dukuri e të folmeve të tjera gege. Unë mendoj se dukuria e dygjinishmërisë së emrave, edhe pse e ndeshim edhe te Buzuku në të folmet gege, është e vonë. Të sjellim disa shembuj: *malet te nalta*, sing. *mal-i* (khs. *Antologjia e letërsisë shqipe*, Prishtinë, 1954, f. 24). Në dygjinishmërinë e kategorisë së emrave të përmendur sporadikisht ndeshemi edhe te Pjetër Bogdani: *unë dashë urdënimet jo te mira* (nga ekstrakti i Bogdanit – *Cuneus propheterum*, f. 35). Për faktin se njëgjinishmëria në kategorinë e fjalëve të zëna ngoje në gjuhën shqipe është e lashtë – nuk duhet bërë fjalë. Dygjinishmëria, siç kemi thënë – është dukuri e vonë në të folmet gege dhe si duket nëpërmjet gegërishtes kaloi edhe më dialektin toskë.⁶⁰

Nëse kërkojmë shkakun e kësaj dukurie, gjithsesi do të duhej nisur nga analogjia e kategorisë së emrave të gjinisë femërore me *e*, *si l'ul'e; nuse; krunde; del'e; řeze, řizja; řkipe, řkipja; řoke, řokja peřgve-ja; pite-ia, vale-ja; viře-ja, řuře-ja* te të cilat njëjësi dhe shukmësi janë të njëjtë dhe me këtë trajtë identifikohen me emrat e gjinisë mashkullore të tipit *řkrime; punim* shumësi *punime*.

Fakti se njëgjinishmëria e kategorisë së emrave të gjinisë mashkullore është ruajtur flet qartë në favor të rrethanave se e folmja e Krajës së Malit të Zi, Briskut e Shestanit është dialekt mjaft konservativ, madje edhe në saje të pozitës së vet gjeografike dhe izolimit të këtyre viseve, përndryshe nuk do të kuptohej prania e dukurisë së përmendur arkaike.

106. Vlen të theksojmë se te lakimi i emrave të gjinisë mashkullore dhe femërore në rrjedhore në njëjës dhe në shumës, në këtë të folme është shumë më i qëndrueshëm sesa në të folmet gege dhe toske, veçanërisht në këtë të fundit. Mirëpo, kjo nuk do të thotë se mbaresa e rrjedhores së

⁶⁰ Fakti se ndërrimi i gjinisë te kategoria e përmendur e emrave të gjinisë mashkullore paraqiten edhe në dialektin e Çamërisë: *ato vënde, ato lafe, ato kuvënde, ato mal'e, ato berikete, ato hale, ato zjafete, ato habere*; H. Pedersen, Alb.T.f.10, - megjithatë duhet konsideruar si mundësi serioze të pavarur të ndërrimit të gjinisë së emrave në fjalë.

emrave të gjinisë femërore të trajtës së shquar është hequr krejtësisht: *ja kiš vu sūt l'òps*. Mbaresa e rrjedhore *t* për njëjës, për shumës *š* është ruajtur në këtë dialekt, veçanërisht pas prepozicionit: *pej řaštet përmréna kmīšet; mās disa kòhet; u zū anej pej anet t hūkmetit; ... t martuome mas pašalarš, atje škon te nifar mrétit; ...i msün ni šehrit*.

Kur shkruante Pekmezi (*Grammatik der alb.Sprache*, f. 99) se shumësi i rrjedhore në dialektin gegë shpesh mund të përdoret në vend të shumësit të gjinore, jam i bindur se nuk ka menduar në sufiksin *-š* por në sufiksin *ř*, për shkak se ky i fundit është dukuri mjaft e shpeshtë në shumësin e rrjedhore së dialektit gegë. Që kjo të jetë më e qartë, po japim paradigmen e lakimit të një emri: *vër* (=stina e verës).

<i>njëjës</i>	<i>shumës</i>
emër.vër	emër.vëra
gjin.vëre	gjin.vërave
dhan.vëre	dhan.vërave
kallëz.vër	kallëz.vëra
rrjedh.vëre	rrjedh.vëraš

107. Meqë jemi te lakimi, duhet të përmendim edhe faktin se trajta e shquar dhe trajta e pashquar e lakimit të të folmeve të Krajës, ashtu si edhe te të folmet e Shkodrës dhe të Malësisë, janë ashtu të përziera njëra me tjetrën, që në të vërtetë nuk mund të flitet për dyshquarësinë e lakimit të të folmeve të Krajës.

<i>njëjës</i>	<i>shumës</i>
trajta e pashquar trajta e pashquar	
emër.līs	lisa
gjin.i lisit	i lisave
dhan.lisit	lisave
kallëz.līs	lisa
rrjedh.lisit	lisaš
<i>njëjës</i>	<i>shumës</i>
trajta e shquar trajta e shquar	

emër.lisi	lisat
gjin.lisit	lisave
dhan.lisit	lisave
kallëz.lisin	lisat
rrjedh. lisit	lisaš

Te emrat e gjinisë femërore kemi këto mbaresa:

<i>njëjës</i>	<i>shumës</i>
emër. -a, -ia	lôpa - t lôpt
gjin. -s	lôps -ve lôpve
dhan. -s	lôps -ve lôpve
kallëz. -en	lôp(en)-t lôp(t)
rrjedh. -et	lôpet -š lôpš

mbaresat e lakimit të emrave të gjinisë femërore të trajtës së pashquar dhe trajtës që dallohen ndërmjet veti vetëm në emërore njëjës dhe shumës, në kallëzore njëjës dhe shumës, dhe me asgjë tjetër. Rrallëherë ndeshim edhe në: *pej kso šoknie*, në vend si zakonisht *šokniet*.

Në përdorimin e trajtës së shquar dhe të pashquar të lakimit të emrave dhe të dallimit të saktë të tyre të të folmeve gege ndeshim shumë rrallë. Ndërsa e folmja shqipe e Jabllanicës së Epërme saktësisht i dallon njërin lakim nga tjetri.

108. Nuk është e parëndësishme të theksojmë edhe tiparin e së folmes sonë, tiparin morfologjik, domethënë shenja *u* është mbaresë nominale për trajtën e shquar të lakimit të emrave të gjinisë mashkullore me konsonantet velare *-k, g*, si dhe emrat me vokale të theksuara *ā, ī, ē*: *brëg-u, l'ak-u, präg-u, bārku, ĝak-u*, etj. Këtë veçori të dialektit tonë po e përmendim për shkak sepse mbaresa *u* për kategorinë e emrave të gjinisë mashkullore të zëna ngoje më lart te një numër të folmesh gege nuk është *-u* por *i*: *zog-i, pešk-i, bark-i, ĝak-i*, khs.: Kujunxhiçi, *Srpsko-arnautski rečnik*, Tagliavini, *Le terre albanesi redente*, I, 65, dhe atje në literaturën e përmendur; *Kangë popullore shqiptare të Kosovë-Metohis*, Prishtinë 1952, lib.I, II, III. Se e folmja shqipe e Kosovës në të kaluarën ka njohur mbaresën *u* te emrat që sosnin me velarin e mbrapmë qiellzor *k, g*, tregon

qartë edhe sot luhatja në mes mbaresës *i* dhe *u* te kategoria e caktuar e emrave, nga njëra anë, dhe shembujt nga vepra e shkrimtarit Bogdani, vendlindja e të cilit është rrethina e Prizrenit, nga ana tjetër: *te jete ende fort se ndriçimit ġakut se Davidit* (8); *fruitet se barkut* (9); *a vue zogu give i ngüem* (68); *pse ašt i kuć peteku üt* (69); *e anemiku i tinaj Amoni* (66); *se pešku, Baleni i detit kí e mbajti per tri dit nde bark e vuel* (66).

Këtu duhet të theksojmë edhe një gjë tjetër, do të thotë faktin se kategoria e emrave të gjinisë mashkullore me spirantin *h* në fund, në të folmet e Krajës dhe në disa të folme të tjera gege dhe në dialektin toskë, nuk përputhen në mbaresën e lakmit të emrave të shquar. Derisa mbaresa tek emrat që sosin me spirantin *h* në pjesën dërrmuese të të folmeve gege është *i*, me përjashtim të gegërishtes jugore, ku është *u*, në dialektin toskë është kryesisht *u*: *krah-i; ah-i; pleh-i*; khs. *Cordignano, Dizionario albanese italiano*, f. 2, 92, 154; *Cimochowski, Le Dialecte*, 30, 35; për toskërishte khs. Pedersen Alb., 142; *krahe i preu krahun; tund krahune: tund krahun*: khs.: *Auguste Dozon, Manuel: krahe trajt.shq. krahu* f. 36. Kjo trajtë ka qenë e njohur, siç shihet edhe nga shkrimet e Buzukut, edhe në dialektin e vjetër gegë; khs.: Mann, *An Historical Albanian-English distionary*. Londër 1948, f. 212, *krah*; Buzuku: *krahi*. Filologët shqiptarë në kundërshtim me shembullin *krahi* që ndeshet te Buzuku, formë letrare preferojnë *krahu*, ndoshta pse një trajtë e tillë ndeshet te shkrimtarët toskë.

Nuk ka dyshim se në lakimin e emrave të trajtës së shquar në fillim është përdorur mbaresa *i*, nga indoevr. **is* (on), kurse mbaresa *u* nga indoevr. **ovos* u krijua si rast i mirë për të evituar paqartësinë dhe hutimin ndërmjet njëjësit dhe shumësit të emrave me konsonantet fundore të qiellzës së mbrapme *k, g*, njëjës *mik-i*, shum. *mik-i*; khs.: Bariqi, *Hymje*, f. 40. Edhe më pak është e bindshme se mbaresa postpozitive e asaj kategorie emrash me spirantin fundor *h* do ketë qenë *u*.

Shembujt e Buzukut me *i: kahi* na udhëzojnë në mohimin kategorik të mendimit se një kategori e tillë emrash në një kohë relativisht të largët në gjuhën shqipe do të ketë pasur mbaresën postpozitive *u*. Sa i përket faktit që kategoria e emrave që sosin me spirantin *h* në dialektin toskë

njihet vetëm mbaresa postpozitive *u*, unë mendoj se kjo duhet shpjeguar me ndikimin e analogjisë së *u*-së postpozitive të atyre emrave të cilët e njihnin qysh herët mbaresën postpozitive. Dialekti gegë nuk i është nënshtruar këtij inovacioni.

a) Emrat e gjinisë asnjane

109. Gjinia asnjane në gjuhën shqipe është reduktuar vetëm në disa shembuj. Nëse abstrahohet një numër mjaft i madh i emrave të gjinisë asnjane të krijuar nga emërimi i mbiemrave dhe pjesores, atëherë numri i emrave të gjinisë asnjane është reduktuar në dy-tre shembuj. Në të folmen e Krajës ndeshim: *kta ūj, ūjt është t'mir; t' ftoft; krue-t*, plur. *kreń-t*. Një numër emrash e ka ruajtur neutralitetin vetëm te përemrat të cilët i paraprijnë: *kta rakī, kta dĵāŭ, kta mĵāl't, kta drīŭ*, ndërsa vetë emrat nuk ruajnë kurrfarë shenje të gjinisë asnjane, por kanë kaluar në kategorinë e emrave të gjinisë mashkullore, ose eventualisht në emrat e gjinisë femërore: *raki-ja, dīŭ-i, drīŭ-i*, emrat e këtillë zakonisht kanë kuptimin e një gjëje që ka rrjedhur nga një materie, do të thotë të emrave kolektivë.

Sa u përket emrave të gjinisë asnjane që dolën nga emërimi i mbiemrave ose i pjesorëve, kësish ka shumë pak, sepse pothuaj nga çdo mbiemër, ose pjesor, mund të ndërtohen: *tĵ barđt; tĵ kukť, t zīt, tarđunat, t dal'unat, t ŧkuemt, tsosunit*.

110. Përfaqësues i një numri të vogël fjalësh, por pa dyshim shumë të rëndësishëm është edhe *dĵel'm, dĵel', dĵem*, që është nga shumësi i emrit *dĵal'e*. Është interesant sufiksi *-m*, që tregon kolektivitetin, sikurse të *vĵām* (=pobratim).

Nuk është pa rëndësi të sjellim disa shembuj nga të cilët do të shihet mënyra e formimit të fjalëve, veçanërisht e emrave në të folmen e Krajës. Këtë nuk e bëjmë për të theksuar disa nga tiparet e veçanta të së folmes sonë në formimin e fjalëve dhe eventualisht për të cekur veçoritë e saj specifike, por vetëm për të treguar kuptimin e disa mbaresave sufiksiale të

emrave, që në të folme të tjera janë shumë të rralla, e ndoshta edhe me kuptime të tjera. Unë nuk do të zë ngoje ato prapashtesa që hyjnë në punë për të formuar emra e mbiemra që janë të njohura pothuaj në të gjitha të folmet e tjera, domethënë prapashtesa të mbarë gjuhës shqipe, por vetëm ato prapashtesa që kanë përdorim të kufizuar dhe kuptime të veçanta.

111. Mendoj se një prapashtesë e këtillë për formimin e emrave, është përdorur në atë kuptim, që në të folmet e tjera ndeshet shumë rrallë; *oç*: *kok-řoč*, *gjatōč*, prapashtesa –*oč* në këtë fjalë është përdorur në kuptim të madhësisë që shpreh emri përkatës: *kókēj*, *kok-řoč*, duhet të ketë kuptimin kokërr e madhe; *gját* (i gjatë), *gjátōč* (i madh, i gjatë, serbokr. *dugonja*). Këtu sufiksi –*oč*, pra, është përdorur me kuptim augmentativ, por jo edhe pejorativ.

112. Prapashtesat për formimin e emrave në kuptimin e punonjësit, pikërisht kryerësit të një pune, mjetit, veglës, aparatit, i ndeshin në shembujt: *lŭps* (= *lŭpes*), që tregon njeriun që lyp, lypsin. Sot fjala *lŭps* tregon vetëm të varfërin, skamnorin, kështu që në vetëdijen e popullit ka humbur kuptimi se ky emër është formuar nga *lŭpe+s*. Në kuptimin e veglës kjo prapashtesë paraqitet edhe te fjala *te hoŭes* (= *okllagi*, *otllagi*). Ndërkaq mbaresa sufiksale –*as* tregon përkatësinë e ndonjë qyteze, emërton qytetarin: *đakovs*, *šestanas*, *elbasanas*, *prištinas*, në kuptimin e banorëve të vendeve përkatëse, e ky sufiks, as nga kuptimi as nga prejardhja nuk ka lidhje me sufiksin e lartpërmendur.

Shembull i mirë për të shprehur augmentativitetin me prapashtesën – *oč* tregon fjala *taroč*, në kuptimin mëzat, që përdoret në kuptimin bartës, figurativ: njeri guximtar, i patrembshëm.

113. Është shumë interesante prapashtesa – *ul*: *mjedul'-i* (= i mesëm, mestar); *funul'-i* (fundul') me kuptim të të përfunduarit të diçkaje, fundi i një gjëje, nga *fund* (në të folmen tonë *fun*, skaj, mbarim, të sosurit); *fundl'-a* plur. *fundlat*-shtresë, ortek, mbeturinë; khs. *Luk Lukaj*, *Rečnik arbanasko-srpsko-hrvatski* f. 225. Unë mendoj se prapashtesa e lartpërmendur emërore duhet lidhur me prapashtesën e njohur –*ul*, te fjala *modula*=karrotë, nga *modē*+sufiksi *ulē*, pastaj me *vjēduŭē*, prej nga edhe

fjala rumune *vjezură*; e ngjashme me këtë edhe *gróšël' nga gróše*=fasule. Pa dyshim se sufiksi i përmendur këtu është përdorur në kuptimin figurativ.

114. Fjalën *ðeknore* e kam shënuar në kuptimin kaçamak me miell thekre nga *ðekën* dhe sufiksi *-ore* për gjininë femërore; gjinia mashkullore, *or, uer* nga latinishtja *orius*. Ndërsa prapashtesa *ore* ka edhe kuptime të tjera në të folmet shqipe, kuptimin e *nomina agentia*: *ğaksuer, ğaksore, mağetore, darsmore*; veçoria kuptimore e fjalës që do të thotë: *mal'sore*, kuptimi i veglës: *l'atore*=njëlloj sèpate; shënimi i vendit ku ndodh një ngjarje > *nevojtoe, mel'ore, misrore, grunore, gropore* (vend me gropa), *Pùlore, Pùlorja* (kështu dikur quhej Epiri), në serbokroatishte më së miri do t'i përgjigjej përkthimi Šumadija, nga fjala shqipe *pùle* < lat. *padùlem* < *palùdem*; *verore, vještore*, do të thotë pemë që piqen në kohën e verës ose të vjeshtës.

115. Sufiksi *-ak*: *verak*, është mjaft produktiv në gjuhën shqipe, edhe pse me origjinë të huaj, - gjithsesi sllave. Këtu *verak* është përdorur në kuptimin: fiku që piqet në stinën e verës, për fikun që piqet në vjeshtë, në këtë dialekt, unë kam shënuar fjalën me prejardhje sllave *ziml'ic*. Ne këtu nuk po i përmendim të gjitha kuptimet e tjera të sufiksit *- ak*, por do të kufizohem vetëm në disa sosh:

1) ai mund të tregojë cilësi: *motāk* – kafshë njëvjeçare, *zemrak* – trim, njeri i vlefshëm (në të folmen e Gjakovës – *zemërnik*);

2) ai mund të emërtojë qytetarin: *Duñ(e)sāk, Ul'kinak* – qytetar i Durrësit, i Ulqinit; *fušarak* banor që jeton në treva të ulëta, e kundërta me *mal'sueroe bješkatar*;

3) *šeřak* – shpirtlig, smirëzi.

116. Në të folmen e Krajës kam ndeshur edhe sufiks *=an*: *human*, njeri i humbur, hutaq, i trullësuar, matuf. Dhe ky sufiks (*-an*) ka shumë kuptime:

1) ky sufiks ka kuptimin e cilësisë: *kùkan* – i paaftë, njeri i pagjendshëm; *mrapsťan*-njeri që punët i shkojnë mrapsht, të cilit nuk i shkon asgjë

ndoresh; *žeskān*-njeri i zeshkēt; *rošan*-dash me katër brirë;

2) tregon edhe prejardhjen e ndokujt: *škodrān* (thuhet edhe *škodrān*) *dibrān* (dhe *dibrān*);

3) shënon edhe emërtime gjeografike: *Murikān*, *Kukān*.

b) Foljet

117. Edhe trajtat foljore të të folmeve të Krajës ruajnë tipare arkaike, edhe pse këto trajta përbëjnë pjesën më të ndërlikuar të gramatikës shqipe, sepse në të gjitha veçoritë aq shumë janë ndërthurur saqë është mjaft vështirë të pohohet ç'është në të arkaike, e ç'është e re.

118. Foljet shqipe ndahen në tri grupe kryesore: 1) Foljet me *-mi*; 2) me *-n* dhe 3) koniugacioni pa *-n*. Në grupin e parë mund t'i fusim foljet ndihmëtare: *jam*, *kam* dhe *đom*. Në grupin e dytë bëjnë pjesë ato folje të cilat në temën e prezentit kanë *o*: *me punuo*: *punoń*, *punon*, *punon*, *punōjm*, *punóni*, *punōjn*, këtu bëjnë pjesë edhe këto folje: *kërkoń*; *bl'uoń*; *škruoń*; *martoń*, *soń* (=mësoj); *frigoń*; *neroń*; *řnoń* (tosk.řoń); *muń*; *besoń*; *bāń*, *běń*; *kujtoń*; *štroń*; *kašoń* (kallëzoj); *diktoń*. Po zgjedhojmë foljen me *řnuo* në kohën e tashme.

un řnoń	na řnojm un	bāń. běń	na bājm, bējm
ti řnoń	ju řnońi	ti bān, běn	ju bāni, běni
ai řnoń	ata řnojn	ai bān, běn	ata bājn, bējn

119. Në kategorinë e tretë të foljeve bëjnë pjesë ato folje, mbaresa infinitive e të cilave mbaron me konsonant: *mě mār*, *mě prīt*, *mě hīp* (në këtë të folme ka kuptimin me u ngjitë, me hy: *hīp mrēna* – hyn brenda); *mě bērtīt*; *mě hāp*; *mě dāl*; *me trēm* (me frikësua dikë), *mé u trēm* (me u frikësua vetë); *mě đir*, *đrīt*.

me mār *me đir*

un mār	na mārō,	un đrās	na đrāsīm
ti mēr	iu mērni	ti đrēt	iu đrīni

ai mēř	ata mārīn	ai ǎřřēt	âta ǎřrâsin
	<i>me prīt</i>		<i>me hīp</i>
un prēs	na prēsīm, prēsēm	un hīp(i)	na hipīm, hipēm
ti pritēn	ǎju pritni	ti hipēn	ǎju hipni
ai pritēn	ata prēsīn, prēsēn	ai hipēn	ata hipīn, hipēn
	<i>me ĩk</i>		<i>me hap</i>
un ikiń	na ikīm, ikēm	un hāp(i)	na hāpīn, hāpēn
ti ikēn	iu ikni	ti hapēn	ǎju hapni
aǎ ikēn	ata ikin, ikēn	aǎ hāpēn	ata hāpēn
	<i>me godīt</i>		<i>mē bēřtīt</i>
un godīs	na godisīm, godisēm	un bēřtāsna	bēřtāsīm(-ēm)
ti goditēn	ǎju goditni	ti bēřtēt	ǎju bertitni
aǎ goditēn	ata godisīn, godisēn	aǎ bēřtēt	ata bēřtāsīn (-ēn)

119. (bis) Nga zgjedhimi i foljeve më konsonant shihet se një tip foljesh sikur me mbaresat e saj vetore bën pjesë në *-n* koniugacionin, sepse merr mbaresat *-īn, -ēn, -ēn*, etj. siç sihet te volja *me ik: un ikiń, ti iken, ai iken*, etj., që do të thotë se te foljet e përmendura mbaresat vetore është zgjatur. Që të jetë e qartë kjo që po themi, po sjell disa shembuj me të cilët do të dëshmojmë se mbaresat vetore është zgjatur, kryesisht në veten e dytë dhe të tretë njëjës të prezentit të foljeve më konsonant: *ede kajmakāmi řehēn telīn; ede pē pvētēn; tař u čilīn kur t vkēhem; čil'īn* është në prezent, *u* është përdorur në vend të *ǎju*; *ede řgīlen aǎ ato trī řije; ede aǎ hipēn mrēna; ede ē nisēn t birīn; ede mūřēn řīnīn pl'ōt mē l'ira: kur mřīn n řpī e bvētēn ē řokǎja; se po na ĩ mūtēn; nī řlēpēr po bvēten (kā(h) po ikēn, minō; ĩk, t ikiń*. Është interesant përdorimi i *dubleteve: dāři pō pvētēn*. Sa i përket kronologjisë së dy mbaresave *-sēn, -tēn* në fjalët e përmendura, mendoj se ajo është formuar njëkohësisht sipas analogjisë së vetës së parë – *bǎřs: ē harūřa i čil'ēn ũkūt nī grōp ede ē mūtōn ũkūn n ēt*.

E vërteta se këso mbaresash ndeshen edhe te Buzuku edhe te Bogdani tregon qartë se kjo dukuri nuk është e vonë në këtë të folme. Te

Buzuku hasim: *čilen, aj maten*, etj. Pohimin tonë e vërtetojnë shembujt nga e folmja e arbëneshëve të Zarës, që tregon lashtësinë e dukurisë në fjalë në dialektin e shqiptarëve të Krajës. Ja disa shembuj të cilët i shënova gjatë qëndrimit tim kërkimor në Arbënesh të Zarës. Nga folja *me mbët* na paraqitet ky zgjedhim.

un mbës ne po mbësim un biri ne birim
 ti mbëtën ju po mbetni ti birën ata birin
 ai mbëtën ata po mbësin aj birën ata birin

Ja edhe disa shembuj: *lopa e puvëtan*, 50; *aj nuk ko dit më fól lãtišt e pãrta e povëtãn*, 55; *ku odgovoritãn*, 55; *e kamarjéri e povëtãn*, *povëtãn*, 55; *e pojn ĝélin ku po kantátën* (fjala e fundit është shkruar sipsas versionit të korrigjuar të teksteve të Taljavinit; khs.: L'Albanese di Dalmazia, Firenze, 1937).

Lashtësinë e dukurisë së përmendur në të folmen shqipe të Krajës, e dëshmojnë edhe shembujt nga veprat e Pjetër Bogdanit. Po përmendim disa sosh: *taš po écen i ĝašti muej se ãst me baře*, Bogdani, nga përfundimi i veprës (*Cuneus prophetarum* në redaktim të Ndre Mjedës, f. 21; pastaj në *Antologji e letërsis shqipe*, f. 52; ... *ujete ku mbe disa vise rjed verde;...kah écen e rjed tue kãane deu plõt zeha ari; ujete hipene nde maĩste mal'evet*. A ndihet ndikimi i shqipes së Kosovës në karakteristikat gjuhësore të Pjetër Bogdanit – është vështirë të thuhet, sepse Bogdani jetoi një kohë të gjatë në Shkodër dhe në rrethinën e saj, që tregon mundësi se veçoritë e përmendura gjuhësore mund të jenë edhe veçori të së folmes së Shkodrës. Mirëpo, të ndeshurit e këtyre tipareve edhe te Buzuku, tregon për mundësinë e njohur edhe të tipareve të së folmes së Malësisë, si dhe të gjuhës shqipe të Metohisë, gjithsesi në një masë më të vogël sesa siç është rasti me të folmen e sotme shqipe të Krajës.

119. (ter) Të përmendim edhe një tipar të së folmes së Krajës për të cilin mendojmë se është veçori arkaike. Kjo është: *-ém, -ën*, përballë *-im, -in*, si mbaresa të vetës së parë dhe të tretë shumës të prezentit për foljet që sosin me konsonant: *aštu e mù=sën ljéprin e e hãn; pë mãrëm e hãm*;

kur däl'ën; jau mārēn ato pāre; hāinat kal'ōjn me dēl'e e kē pērmi hudūn n Némce de i šēsēn n Kotoř; anmíkt flāsēn e t pēlsāsēn por ġárpnin mos ta pērkasēn; ata bērtāsēn mrēna. Lashtësinë e tiparit të përmendur të së folmes sonë e vërtetojnë shembujt që i ndeshim në shkrimet e Buzukut dhe të autorëve të pasajmë gegë.⁶¹ *ansoš kí fluturoñēn, 23; as ata ki i ndjēken, 33; ... tē silat ġāsēn pētekut, nga përfundimi i veprës Cuneus prophetarum e keta deta mařene ani āmenile e řjēdēne kroenate; se ujenat dāl'ene n deti; e jo se dāl'ene l'umena tē unġina,* të gjithë shembujt janë të faqes 53 nga *Antologjia e letërsis shqipe*, Prishtinë, 1954. Mbaresat e përmendura i ndeshim edhe te shkrimtarët toskë të periudhës së Rilindjes kombëtare, kështu te Naim e Sami Frashëri, pastaj te Fan Noli e Faik Konica, që nga njëra anë tregojnë lashtësinë e trajtës për të cilën këtu është fjala, e nga ana tjetër na udhëzojnë duke dëshmuar se dallimet ndërmjet dialektit toskë dhe dialektit gegë në të kaluarën kanë qenë të pakta e të pahetuara.

120. Veçoritë e prezentit të së folmes së Krajës, që deri më tash i kemi zënë ngoje, kryesisht janë tipare arkaike të saj. Tani do t'iu tregojmë një tipar inovacioni të së folmes së atjeshme shqipe, i cili gjendetn ë përdorim të dendur të trajtave *kēna, jēna* në vend të trajtave rëndom të vjetra *kēmi, jēmi: e na ōmī nuk kēna; aġde se kēna pāre mġāft; kēna ārd mē māř t dēkunin, ě nā nŭk kēna; aġde se kēna pāre mġāft; kēna ārd mē māř t dēkunin, ě nā nŭk kēna;* për gegërishten në përgjithësi khs.: Pekmezi *Grammatik der albanesischen Sprache*, f. 71, për shkodranishten shih: Meyer, *Kurzgefasste albanesische Grammatik*, f. 30: *jēna, kēna, ōna;* për të folmen shqipe të Dukagjinit, khs. Waclaw Cimochowski, *Le Dialecte*, f. 125 – 126; *kēna, jēna.* Kjo *–na* nuk është asgjë tjetër pos përemër vetor i vetës së parë *na: kēmi+na,* ndaj fituam *kēna, jēna;* Pekmezi, o.c., faqe 71.

121. Vlen të theksojmë se në të folmen tonë përdorimi i koniunktivit është ruajtur plotësisht, dukuri kjo që nuk është ruajtur në një pjesë dërrmuese jtë të folmeve gege. Ja shembujt që e dëshmojnë këtë: *deri t*

⁶¹ *Hylli i Dritës,*

knoń kũkũja e kũke; e ta hãpnie gõin; kũ mund ta hańie, kur t piknie ajo... trĩ pik gãk – kam me maruo un; mos ta vrase. Prej të folmeve gege në të cilat është ruajtur koniunktivi, në vend të parë janë të follmet e gegërishtes jugore, për të cilat le të shihen: Weigand, *Albanesische Grammatik*, f. 58 – 59, 117, 118: *të pastroj, të pastrosh, të pastrõj, të pastojm, të pastroni, të pastrõjn.* Nga të folmet gege që e ruajtën koniunktivin duhet zënë ngoje dibranishten; khs. *Visaret e kombit*, lib. XIV... 63, 92... Të folmet e tjera gege, duke përjashtuar të folmet e Krajës dhe arbënishten e Zarës, nuk e kanë ruajtur në tërësi koniunktivin, në të vërtetë, në këto të follme veta e tretë e lidhores së kohës së tashme është identifikuar me dëftoren e së tashmes, kështu që veta e tretë njëjës e prezentit i përgjigjet vetës së tretë shumës të dëftores, p.sh.: *hjeđ(i), ti hjeđ, aj hjeđ*; koniunktivi; *t hjeđ(i) un, t hjeđ(i)đ ti, t hjeđin ai*; trajta e fundit, siç kemi thënë, është e njëjtë me jvetën e tretë shumës të dëftorës: ata *hjeđin*. Për të folmen e Dushmanit, khs.: Cimočovski, o.c., f. 125-195. Për të folmet shqipe të Kosovës, krahaso: *Kangë popullore shqiptare*, Prishtinë, 1953. Për toskërishten nuk do të sjellim shembuj, sepse atje koniunktivi është në përdorim të hovshëm edhe sot dhe është ruajtur i paprekur e në fizionomi të plotë, dhe se ky është përdorur edhe në të kaluarën në të gjitha të folmet gege, dëshmon qartë gjuha e veprave të shkrimtarëve gegë të shekullit XVI deri në shekullin XVII. Unë mendoj se përzierja e koniunktivit me indikativin në këto të folme nis në fillim të shekullit XIX, sepse ky në të folmen e Shkodrës, siç shihet nga gramatika e Fr. Maria Da Lecces nga çereku i parë i shekullit XVIII – përdorej ende, pa shembuj të përzierjes së tij me indikativin,; khs. Da Lecce, *Osservazioni grammaticali nella lingua albanese*, 1716.

122. Vend të veçantë meriton imperfektinë të folmen shqipe të Krajës, sepse është ruajtur në një trajtë mjaft arkaike, ndërsa në një numër të konsideruar të folmesh gege nuk e ndeshim më. Ai në të folmet e Krajës edhe sot përdoret në atë trajtë siç është i njohur kryesisht në dialektin toskë, në trajtën me *-ńa*, p.sh.: *punoń, imperf. Punońa, ti punoe, ai punonte, na punońim, ju punońi, ata punońin*, ndërsa nuk është ruajtur

imperfekti tjetër me trajtë sigmatike (me *š*): *punoša (punošm) punoše*, etj.), mirëpo ai në këtë dialekt paraqitet edhe në këtë trajtë: *un muńeš, ti muńe, ai munte, na muńim, iu muńi, ata muńin*. Ne këtu nuk do të sjellim shembuj të tjerë nga dialekti ynë, sepse këta nuk janë shembuj sporadikë për të; trajtë tjetër ata as që kanë. Thamë se të folmet e Krajës kanë vetëm një trajtë të imperfektit, e kjo është *punońa punońe, punonte*, etj., ndërsa e folmja arbëneshe ka dy trajta të imperfektit, duke pasur parasysh se imperfekti me trajtën *-ń* është më i vjetër, *punońa ose punoesš*, ka marrë kuptimin e kondicionalit, ndërsa trajtat *punojša, punojše, punojši, punojšim, punojšit, punojšin* kanë kuptimin e imperfektit. Atëherë si të shpjegohet fakti se trajta e imperfektit të fundit është ruajtur në arbënishte, ndërsa të folmet e Krajës nuk e njohin. Unë mendoj se çështjen tonë në fjalë mund ta ndriçojmë vetëm nëse e krahasojmë me gjuhën e shkrimtarëve të vjetër gegë. Te Buzuku paraqitet vetëm imperfekti i indikativit me *-ńa*, p.sh.: *me zditune pake mendete e atune kí t endiglońine, perse ata kí štampońine kišin te made fedige, f. 50; ak nuk mund kelońine se faj te mos bańine, f. 51; ...kí ŗiit kulosńine, f. 110; ...kí e kl'uońine, lib. 5 f. 222; ma ata kujtońine 294; ti ne išńe klene ketu, 295; ti ne klenkišńe ketu, 297; kí por kl'ańine, 297; a s te muńtke kũ; .. kũ kí mos vdis, 298; a mos išńeš ti maa i mad se perindi ŗne, lib. X, f. 571; duol gĩŗe gĩndja e vińin tek ađ, 574; e ŗošne dišpuńte, 574; khs. *Hylli i Dritės*, viti VI dhe shembujt e librit të përmendur. Laramani më të madhe të përdorimit të trajtës sonë ndeshim në veprat e Pjetër Bogdanit (1685): *e me të mad te prujte e te pervute i šerberńine, 16; kur ŗne ta krehińe, ani ta mbukurońe me drandofile e vjoleza, f. 60; ...se sil'et dil'in; khs.: nga pasthënia e veprës së Bogdanit *Cuneus prophetarum*. Është fakt i pamohueshëm se prejardhja e trajtës së imperfektit me *-š* duhet kërkuar në aoristin sigmatik, ku shqipja përputhet me imperfektin e sllavishtes (Bariq, *Hymje*, f. 44), mirëpo nëse dëshirojmë më saktësisht të shpjegojmë formimin e imperfektit sigmatik në dialektin gegë në përgjithësi, unë mendoj se duhet të kemi parasysh disa rrethana të tjera. Në gjuhën e sotme shqipe dhe në shqipen e vjetër ndeshim dy imperfekte, njërin për diatezën aktive, e tjetrin për diatezën**

pasive: *punoña ose punoñe*, madje edhe *punoñeš* etj., edhe për pasiv: *punoheša* te shkrimtarët e vjetër, edhe gegë edhe toskë, - *punoheša*. Marrim një shembull më të përshtatshëm: *laña (me l'ā)* dhe *l'ahesha* – trajta e vjetër *l'anesha*. Në gjuhën e veprave të klasikëve shqiptarë ndeshim shumë shpesh përdorimin e imperfektit admirativ i cili gradualisht mori funksionin e imperfektit rëndom indikativ: Po sjellim disa shembuj të imperfektit admirativ dhe pasiv nga veprat e Bogdanit *šume here i bajtekešin gele*, 16; *i bajteke gele*, 16; *i šerbūekešin Engijt*, 16; *te siite me te mađ zel ruetekešin ato šejte Virgina*, 16; *vašezat ki te gindešin pa buře*, 17 e *me ato kujtime fort te mira bake e Lumeia Virgin urate; bake urate e Lumeia Virgin Mri*, 20; ... *nde štepit te vet bake urate*, 20; *perse arku permbrenda bajteke deřasat e Lijsë*, 26, *gide ata ki nuk řeđpřitešin*, (Mjeda e lexonte řeđpřitešin=imperfekti i indikativit, - tek unë është pasiv, sepse indikativi nuk do të qëndronte kurrse); *nuk mbahešin per fist t Abramit*, 34; *nde mos bake aštu, šekuli nuk kiš me mbajtune per Mesi*, 35; *perse kur řeđpřitešine femia šume patne dvekun*, 35; *Diogeni... ki bajteke*, 42; *e diemenite flissin* (te Mjeda *flisšin*); 42, *persa i pevessin* (Mjeda – *pvesšin*, f. 43); *ma mbassi pa se kiš po bařine*, 54.

Dy imperfektet e parafundit, sipas Mjedës, duken sikur janë shembuj nga imperfekti sigmatik, mirëpo, unë nuk mund të pajtohem me një mendim të tillë, sepse dihet se një numër i konsideruar foljesh, si në gjuhën e veprave të klasikëve shqiptarë ashtu edhe në gjuhën e sotme të atyre të folmeve në të cilat kjo trajtë e imperfektit është e njohur, - ka humbur mbaresat karakteristike të imperfektit,⁶² siç e dëshmojnë shembujt e përmendur: *vrissin* në vend të *vrissnin*, >*vrissnin*; *flissin* në vend të *flissnin*, *flissnin*. Unë mendoj se Mjeda është mashtruar në rrethana që te Bogdani ka ndeshur *s*-në e dyfishuar: *flissin*, e kjo nuk do të thotë se *s*-ja e dytë është dashur të lexohet si *š*, sepse edhe njëra edhe trjeta *s* në fjalët e theksuara sipas modelit të grafisë italiane qëndrojnë në kuptimin e *s*. Për ekzistencën e imperfektit sigmatik me rëndësi vendimtare është admirativi i përmendur.

⁶² Pedersen, *Alb.t.* 14.

dur: *bajteke*, *bākej*, shembuj të cilët duhen konsideruar si trajta të shkurtuara nga *bajtekej*, *bakej*, nga të cilat me anë të asimilimit janë përfutur trajtat *bajteke*, *bāke*. Trajta *bajke* në të folmen e sotme shqipe të Kosovës në vetën e tretë njëjës të imperfektit – plotësisht përputhet me trajtën *bāke* te Bogdani, që duhet të konsiderohet trajtë e imperfektit admirativ, kur, siç kemi theksuar, shkurtimi u bë me rrugë të asimilimit: *bakej*: në, *ti bakesë*, dhe veta e tretë njëjës *bakēj*. Se trajtat e reduktuara të imperfektit më vonë morën funksionin e imperfektit indikativ, më së miri tregon shembulli *bājke* i vetës së tretë njëjës të imperfektit indikativ, në të folmen shqipe të Kosovës: *ai bājke*, *u bājš(n)a*, *ti bājše*, *aj bājke*, etj. Prandaj në formimin e imperfektit sigmatik gjithsesi ndikuan edhe trajtat e imperfektit pasiv: *laheshë (-a, -em)*, *lahesh (-a)*, *laheshë*, *lahesh* ose *lahesha*, që në pjesën më të madhe të të folmeve gege sot ka kaluar në *u (la(h) ša, lahše*, etj., ku *u*-ja si karakteristikë e pasivitetit i paraprin foljes.

Si të shpjegohet atëherë fakti se e folmja arbëneshe posedon të dy imperfektet me *-ña*: *punoña* – i cili sot në realitet, siç kemi theksuar, kryen funksionin e kondicionalin, dhe trajta e dytë imperfektit me *-š*: *un punojša*, *ti punojše*, *ai punojši*, *ne punojšim*, *ju punojšit*, *ata punojšin*, përdorimi i të cilit ka përfunduar në minimum? Ekzistojnë dy rrugë shpjegimi për të. Njëra: duhet të shpjegohet nga ndikimi i jashtëm, domethënë, imperfekti me *-š* në të folmen arbëneshe duhet shpjeguar edhe huazimet e të folmeve të tjera shqipe, e këtë pos shpërnguljes së stërgjyshërve të arbëneshëve të sotëm të Zarës; hipoteza është mjaft e guximshme, por edhe e mundshme. Është fakt se gjatë kohës së administrimit austriak në Dalmaci disa gjenerata të arbëneshëve të Zarës mësuan shqip në skollat fillore, madje pikërisht nga mësuesit shkodranë: Bardhi, Ğerg Kol’eci, Ndue Pal’uca, J. Rrota dhe Pavle Đerđa – përveç të fundit, të gjithë ishin nga Shkodra. Është e padiskutueshme se ata, në ligjëratat dhe në bisedat e veta me vogëlushët arbëneshë, kultivonin të folmen e tyre të Shkodrës.

Sa mund të jetë i vërtetë ky supozim, është vështirë të thuhet. Mundësia e dytë do të ishte supozimi se ruajtja e imperfektit sigmatik në të folmen e arbëneshëve të Zarës është sjellë nga trualli, ku gradualisht është

zhdukur, edhe se gjurmët e tij janë ruajtur në të folmen e sotme të arbëneshëve të Zarës.

Është çështje e veçantë vjetërsia e dy trajtave imperfektive në gjuhën shqipe. Ne pamë se të folmet geqe kanë poseduar, nëse jo deri në fund të shekullit XVIII, atëherë deri në gjysmën e tij, kryesisht imperfektin me *nie* (*-ña*), etj., i cili që atëherë në disa të folme filloi t'ia lëshojë vendin imperfektit me trajtë sigmatike⁶¹ me *še* (*ša*). Analiza e teksteve të vjetra të shkri-meve të klasikëve shqiptarë, si dhe studimet dialektologjike tregojnë sheshazi se në formimin e imperfektit të shqipes morën pjesë dy mbaresa: mbaresa e foljes ndihmëtare – *jam*, nga njëra anë, dhe mbaresa –*n* e kategorisë së temës së prezentit, nga ana tjetër. Mbaresa e parë ndeshet te imperfekti sigmatik, ndërsa mbaresa e dytë në imperfektin e rëndomtë me –*nie* (*-ña*). Një analizë e këtillë do të dëshmonte se edhe njëra edhe tjetra mbaresë kronologjikisht janë paraqitur në të njëjtën kohë dhe me përdorim jo të njëjtë morën pjesë në formimin e trajtave të imperfektit në gjuhën shqipe. Se mbaresa e foljes ndihmëtare – *jam* mori pjesë në formimin e imperfektit toskë, tregojnë shembujt vijues të vetës së tretë njëjës të imperfektit në të folmen e Përmetit: *martoni š, škruani š, driđi š*, ku *i š* është e vetës së tretë njëjës të imperfektit të foljes ndihmëtare *jam*; khs.: Meyer, *Kurzgefasste albaneische Grammatik*, f. 39. Meqë e dimë se edhe në dialektin gegë, deri në fund të shekullit XVIII ishte në përdorim, kryesisht imperfekti me –*nie*, përkatësisht me –*ña*, atëherë është e qartë se kufizimi i saj nga të folmet geqe filloi pikërisht atëherë kur në atë dialekt nis thjeshtimi rapid i tingujve dhe grupeve të tingujve.

123. Edhe pse futuri i të folmeve të Krajës me asgjë nuk dallohet nga futuri i gegërishtes, megjithatë ne do të bëjmë pak fjalë lypër të . Tipi dominant i futurit të së folmeve të Krajës është *kam* +infinitivi: *masanej ké me kít atú ní gúr; e kó me dál' ní kén; kó më tu dük ní bīr; por kó me kjen dēr e*

⁶¹ Se imperfekti i rëndomtë gradualisht ia lëshoi vendin imperfektit sigmatik, - shihet qartë edhe nga e folmja e Elbasanit, në të cilën kemi këtë gjendje të imperfektit: *un pūsje, ti pūsje, ai pūsje, na üsjim, ju pūsjit, ata pūsjin; krahas na pūsšim, ju pūsšit, ata pūsšin*; khs. *Ëeigand, Albane-sische Grammatik*, f. 106. dhe Aleksandër Xhuvani, *Libri i gjuhës shqipe*, f. 73-124.

made; kô me dâš mrëti me t lãn mrët; por mos u bā razī; kam me t kazuo kuš jam; ško, đot, atū ku m ké gēt muo, ke me đir; kan me t đãn, kan me t bvet; jo, plāk, nuk kam me t pjerđ; kur t škoš nėsēr, ké me vãn; po, ku i ke, kô me tđãn; kur t bāhet đmija ét vječ, kô me kcüe. Mirëpo, kjo do të thotë se tipi i dytë i futurit nuk ndeshet kurrësi. Në realitet, unë gjatë qëndrimit tim në terren kam shënuar dy shembuj të përdorimit të tij; *u čuen kta e bisedōjin; si do t pstoim na: nuk do t kaloñe koha.* Është fakt i pakontestueshëm se tipi i futurit të parë do të thotë *kam ose jam +infinitivi*, në gjuhën shqipe - është më i vjetër se futuri i dytë: *do të punoñ*, i cili është sot në përdorim kryesisht në dialektin toskë, e i cili sigurisht u krijua nën ndikimin e gjuhës greke. Se futuri me *kam +infinitivi* në gjuhën shqipe është dukuri e lashtë, tregoi Jokli (*Litteris*, IV, 207 - 208), duke pohuar se admirativi i cili sot ndeshet si në dialektin gegë ashtu edhe në dialektin toskë, në fillim kishte kuptimin e futurit. Nga kjo del se trajta e futurit të kryehershëm në gjuhën shqipe ishte *kam +infinitivi*, ndërsa *do tē +prezenti* i koniuktivit - është dukuri e vonshme, që vërshoi toskërishten, ndërkaq, përdorimi i tij në dialektin gegë është mjaft i rrallë dhe i kufizuar. Me këtë hidhet poshtë mendimi i disave që në gjuhën shqipe që të dy tipat e futurit i konsiderojmë si një dukuri të lashtë.⁶²

Ne nuk do të ndalemi në kohët dhe mënyrat e tjera, sepse në to nuk ka asgjë që do të ishte katakteristike për të folmet e Krajës, e që nuk do të ishte veçori e përbashkët e të gjitha të folmeve geqe.

c) *Pjesët e tjera të ligjëratës*

Përemrat

124. Edhe te përemrat e të folmeve të Krajës janë ruajtur trajta arkaike. Kjo do të shihet më qartë në paradigmen e mëposhtme:

Përemrat vetorë

v. 1. *un* v. 2. *ti* v. 3. *aĵaio*

⁶² S. R i z a, *Tri monografina albanologjike*, Tiranë, 1944, f. 128 - 133.

nom.	un	ti	aĵ aĵo
gen.	i muo	i tũ t(a) tĩ i	(a) sãi
dat.	muo m	tũ, t (a) tĩ	(a) sãi
ak.	muo, m	tũ, t (a) t	(a) t
alb.	meĵe (-et)	teĵe (-et)	(a) si (t)sõĵe (t)

	v. 1. <i>na</i>	v. 2. <i>ĵu</i>	v. 3. <i>ata - ato</i>
nom.	na	iu	ata
gen.	i neve	i ĵuve	i (a) tũne
dat.	neve, ne	ĵuve, ĵu	(a) tũne, u
ak.	neve, ne	ĵu	(a)ta, - (a) to dhe
alb.	Neš	ĵuš	(a) siš - (a) soš

Vërejtje: te përemrat, po ashtu edhe te ndajfoljet e së folmes sone, zakonisht i shtohet edhe pjesëza *ne*; *ktane=kla+ne*; *tine=ti+ne*; *atane=ata+ne*; *kĵone=kĵo+ne*; këto megjithëkëtë nuk humbin kuptimin e tyre: *ede atane dol'ën t dũ me krũe t štũpin*; *ktane e hãn ede ãt*; *ne mos t bieš tine*; *kcen atũne*.

125. Është me interes të përmendim zhvendosjen e theksit te përemri *ate* në fillim të fjalës, do të thotë *ãt* në akuzativ, e kjo shihet qartë kur përemrit përkatës i paraprijnë ndonjëra prej parafjalëve; *per me*, ose akuzativi i këtyre përemrave përdoret me theks të zhvendosur edhe pa parafjalët përkatëse: *ede ãt e mũšen*; *aštu e mũšen*; *aštu e mũšen e hãon ede řnon bukur mėt* (në vend të *me té*) *ede kĵone kò dãš me luoĵt mėt*; *Ķõ šnoš e ěšt munuo përt*; *ede e mutõn uĵkun nět*; *sikuš ngũsën mėt*. Zhvendosja e theksit u krye nga prania e dy fjalëve njërrrokëshe, që secila prej tyre kishte theksin e vet, ndaj ai u zhvendos përpara dhe krejtësisht u zhduk, duke u përfshirë në theksin e parafjalëve të përparme: *per, me, n: përt, mėt, nět*.

126. Ablativi është i paprekur, domethënë se ai në të folmen tonë ka përdorim të dendur, që nuk është dukuri për të folmet e tjera gege - veçanërisht pas parafjalëve që kërkojnë ablativin. Ai në dialektin tonë përdoret në mënyrë të veçantë, e kjo, siç vumë në spikamë, nuk mund të

them për një numër të mirë të të folmeve gege dhe toske, te të cilat në vend të ablativit përdoret genitivi; khs.: Cimochoowski, *Le Dialecte*, f. 87, dhe Pekmezi, *Grammatik*, f. 130. Ablativi i përemrave vetorë dhe dëftorë të të folmeve të Krajës shpeshherë merr edhe nyjen në fund: *tëjē (t)*, *sī (t)*, *sōjē(t)*; në disa rase nyjën *t* e ndeshim edhe te përemrat vetorë të së folmes çame: *atīt néri*. Pedersen, *Alb. Texte*, f. 11, 105. Emri pas përemrit dëftor në dativ shpesh mbetet i pandryshuar, do të thotë se nuk lakohet: *si me ja bā ksajj pūn* në vend të trajtës së zakonshme *ksaj pune*; *tue škuo asaj rūg* (=ruge); khs *je nīs*, *birō*, *ksaj*, *rūg*.

V. SISTEMI I SË FOLMES SË ARBËNESHËVE TË ZARËS

A. Tingujt

127. Nw krahasim me pjesët e tjera të gramatikës, fonetika e së folmes së arbënesheve të Zarës më së paku pësoi ndryshime. Këtë pjesë të së folmes arbëneshe do ta filloj me kuantitetin e vokaleve, e këtë do ta bëj për arsye sepse me *Taljavinin* në shumë pika largohemi. Sipas tij djo e folme në shumë raste ka humbur gjatësinë e vokaleve, me të vilin pohim unë kurrsesi nuk do të mund të pajtohesh. Unë pranoj se i njëjti vokal, në të njëjtën fjalë në rrethana të veçanta, mund të ketë dy gjatësi të ndryshme, mirëpo nëse mospajtimet tona në vlerësimin e kuantitetit të vokaleve janë të mëdha, atëherë ku fakt nuk mund të shpjegohet me kurrfarë rrethanash. Në të vërtetë, Taljavini nuk e shënoi kuantitetin e vokaleve të së folmes arbëneshe, por vetëm kuantitetin, mirëpo së këndejmi mund të merret me mend edhe kuantiteti i vokaleve në tekstet e shënuara. Megjithëkëtë edhe kjo është gjysmake, sepse siç dihet kualiteti shënohet vetëm te dy vokalet *e, o*, kështuqë gjatësia e vokaleve të tjera arbëneshe te Taljavini mbeti e pashënuar, ndaj për ne mbeti e panjohur. Unë, përkundrazi, kam shënuar si kuantitetin ashtu edhe kualitetin e vokaleve. Në dialektologjinë shqiptare janë studiuar një numër mjaft i vogël të folmesh, madje edhe më pak të folmesh me kuantitet të caktuar vokalesh. Mirëpo, duhet përjashtuar e folmja e Dushmanit, që gjendet në veri të Shqipërisë, të cilën me kujdes e studioi shkencëtari polak Vaclav Cimohovski. Po sjellim disa shembuj nga tekstet e Taljavinit me kualitete të caktuara të vokaleve, të cilat i kam verifikuar gjatë kërkimeve të mia shkencore në Arbëneshe. Te Taljavini ndeshim: *ǵi čiš ko kęn me bą*; verifikimi im: *i čiš kó kęn mę bō*; Talj. *ǵli me vọt me kulọt lopăn*, e njëjta pas verifikimit tim na del: *ǵli me vọt me kulọt lópěn*; Talj.: *lopa ko źan asóji m'í fól*, tek unë: *lópa kó zān me í fól*; Talj.: *e ko zan me kǵo*; te unë: *e kó zān me kǵo*; Talj.: *śamo mu ke mbil bọr*; te unë: *samo mě kę me mbil bọr*; Talj.L *nuk muni me vọt*, 61 (te unë: *me vōt*) Talj.: *ko źan asóji m'í fól*, 49, *ko*

žan kăštu me i fql, 54 (=te unë *me i fql*); Talj.: *i ko žan me fql*, 54, *i ko žan me i fql*. Talj.: *lopa e puvëťān*, 50, *e kamerieri e puvëťān*, 55; Talj.: *e puvëťan kuš*, 62, *aťer po puvëťān para*, 62. Siç shihet nga shembujt e mësipërm, te Taljavini e njëjta fjalë njëherë ka njërën gjatësi të vokaleve, herën e dytë tjetër gjatësi, që dëshmon se këtu diçka nuk është në rregull. E metë e madhe e Taljavinit është shënimi i kuantitetit të vokaleve sepse tek ai nuk ka gjysmë gjatësi, të cilën shqipja pa dyshim e ka; khs. Pekmezi. *Grammatik der alb. Sprache*, f. 46. Unë e kuptoj se në njërin dialekt mund të paraqitet ndonjë shembull i shkurtimit të vokaleve, atëherë kur zakonisht edhe kuptimi i fjalës ndërrohet, mirëpo që shkurtimi i vokaleve të ketë përfshirë një numër aq të madh fjalesh, është e pakuptueshme, por edhe nëse është i saktë, atëherë arsyet duhen kërkuar në dialektin fqinj. Në rastin tonë konkret, duhet menduar në dialektin e Venedikut, te i cili ndeshim gjatësitë e shkurtuara; përkundrazi, dialekti ynë i arbëneshëve të Zarës në kuantitetin e vokaleve, jo që nuk ka pësuar kurrfarë ndikimi të huaj, por në këtë aspekt, kryesisht i ruan tiparet e veta arkaike.

128. Tingulli *ü*, kryesisht, është ruajtur në arbënishte *đūs-a*, *füt-i*, *drü*; *süni*, *flūra*, *frđūsa-t*; *ćümbe* (= *qime*) *rüpi*, *i*, *e mükët*; *k(ě)cüe*: *e ko k(o)cüe jašt pe murit*; *düet me špū kět krüć*; *me këmbüe*; *me k(e)cüe në kinkiz* (= *me këcye më një këmbë*); *p(e)štumba* (= *pështyma*). Gjenerata më e vjetër e arbëneshëve të Zarës për mrekulli e ruan edhe sot vokalin e përmendur, që përkundrazi nuk mund të thuhet edhe për gjeneratën e re. Po sjellim disa shembuj të kalimit të *ü < u*: *e lüme < e lume*; *zońa e lüme nek ta ndüenie!* *e lüme kioš o nān!* ... (Jeta e Re, 1952, 1952/2, f. 118). Krahas *büđa*, *büsa*, e folmja arbëneshë ka edhe paralelet *busa*, *busat*, pra, *ü > u*. Te Taljavini, (Alb. di Dalmazia, f. 99) ndeshim *ćur* m. *kur*: *u < ü*. Unë nuk do të thosha se kjo fjalë mund të radhitej në shembujt në të cilët është *ü > u*, sepse *kuř*, *kuřat*, e jo *kür*, *küřat*, thuhet në të folmet e Krajës, *kuř* e ndeshim edhe te toskët; khs.: A. Dozon, *Manuel de la langue chipe ou albanaise*, f. 42. Prandaj nuk është i saktë pohimi i Taljavinit që *ćur* te e folmja arbëneshë duhet radhitur në shembujt me *u* sekondare nga *ü*, porse *ü* është sekondare në disa të folme geqe. Në shembujt me *ü* sekondare nga

u bëjnë pjesë këto fjalë *kūmsī* (qumështi) nga *kjumsš(t)*; *gūni* nga *gūni*, nga trajta e vjetër e shqipes *gl'uni*; *gūa* nga *gju(h)a* < *gluha*. Këtu mund të numëtojmë edhe *dūtūr*, nga *detūr*; *ndüe*, *ndüem* nga *me ndie(m)*, lat. *indulgere*, tosk. çamërishtja *ndel'ení*. Te Buzuku ndeshim trajtën *endigl'oni*; *me u drūd (-l)*, gjithsesi nga *me u drīd*; *düet* nga *duhet*. Te Rosi ndeshim nën *moccio*, *escremento di naso*, f. 463, *kūr-a*, *ës* dhe *ciur-a*, që tregon faktin se shkodranishtja nga fundi i shekullit XIX, njihet dubletet *kūr*, *kuṛ*, e kjo na shtyn të mendojmë se *kūr* (në arbënishte *çur*), e jo *kūr*, duhet konsideruar trajtë e vjetër.

129. Dukurinë e kalimit të *ū-së* në *u* të arbënishtes, Jokli (*Zur Erforschungen der albanischen Mundrat von Borgo Erizzo in Dalmaten*, f. 107, in *Archivum Romanicum*, vëll. XXIV, 1940) e lidh më disa të folme të Malësisë, e veçanërisht me të folmen e Kosovës, dhe sjell shembuj në të cilët *ū* dha *u*: *kruç* < *krūč*; *ćuš* < *ćūs*; *t druškiš* < *ndrūšk*, khs. Kujunxhiqi *Srpsko-arnatuski rečnik*. F. 26, 96. Unë nuk do të dëshiroja që në fillim të kontestoj përputhjet fonetike të së folmes arbëneshe me disa të folme geqe të Malësisë, mirëpo, lidhur me shembujt e përmendur të Joklit, me të cilët dëshiron të identifikojë disa tipare fonetike të së folmes së Gjakovës dhe arbënishtes - mund të them me siguri se me to nuk mund të vërtetohet dukuria fonetike në fjalë e kalimit të *ū* > *u*, sepse në të folmen e Gjakovës, së paku në fjalët përkatëse, nuk ndeshet *u*, por *ū*, ashtu në të gjitha të folmet shqipe. Jokli këtu shkel në dërrasë të kalbur nën ndikimin e shembujve të pasaktë të Kujunxhiqit, por deri diku edhe duke u besuar burimeve verbërisht. Ndërkaq, sa u përket dubleteve *kūr*, *kūr*. Jokli thotë: "index handelt es sich hier offensichtlich um erhaltenes, *u* zugleich um line Erscheinung, die ebenso dem ostgeg. Lignet; Jokl, o. c., f. 107.

130. Të themi dila fjalë për diftongun *ue* ose *ua* të së folmes së arbënesheve. Taljavini dhe Vajgandi bëjnë fjalë vetëm për diftongun *ua*; në të vërtetë, Taljavini thotë se diftongun *uo* e ka dëgjuar vetëm te fjala *gruo*, përballë *grua*. Është e vërtetë se *ua* sot është trajtë dominuese në arbënishte, mirëpo pohimi se *uo* arkaike në të folmen tonë ndeshet vetëm në një fjalë të vetme, siç del nga shpjegimi i Taljavinit; o. c., f. 27 - 28,

është gabim i madh. Mua, gjatë studimit të së folmes arbëneshe, veçanërisht më interesonte gjendja e diftongjeve *uo*, *ua*, prandaj edhe në biseda me përfaqësuesit e gjeneratave më të vjetra dhe të reja në Arbënesh i kam kushtuar kujdes të veçantë. Mund të thuhet pa ngurrim se sot janë në përdorim edhe njëri edhe tjetri diftong *ua* dhe *uo*. Mirëpo, ndërmjet dhjetë njerëzve, gjithnjë, nuk do të thosha gjysma, por një e katërta me siguri, në të gjitha fjalët ku diftongu është i domosdoshëm - do ta shqiptojmë vetëm diftongun *uo*. Kjo mund të shihet edhe nga tekstet e mia, ku ndeshim të përdoret vetëm *ua*, por ka edhe tekste ku janë shënuar vetëm me *uo*. Se në të kaluarën diftongu *uo* ishte trajtë dominante, flet qartë njëllor emrash dhe mbiemrash të emëruar e fjalë të tjera: sot në të folmen arbëneshe thuhet vetëm *đukuosi* edhe tek ajo pjesë e popullatës tek e cila është në përdorim vetëm *ua*. Kështu ndeshim: *gađ uosi* (=gisht tregues), *punon t uoive* (*t'huoive*) i *munduošim*: *neri i munduošim nuk këndon*; *sot po luon keć*; *biri juoi*; *me zō t'lëndum*. Shembujt e përmendur janë nga shkrimet e dy arbëneshëve të Zarës (*jeta e Re*, 1952/2, 5-6), të cilët edhe në të folur edhe në shkrime përdorin kryesisht diftongun *ua*. Këtu shtrohet një çështje tjetër, me fjalë të tjera a është diftongu *ua* dukuri e lashtë apo dukuri e vonë në të folmen arbëneshe. Në mbështetje të së folmes amë të arbëneshëve të Zarës nuk mund të konkludohet asgjë, sepse atje nuk ka as gjurmë të diftongut *ua* (të themi kalimthi, atje është e njohur *uo*, gjegjësisht *ue*). Nuk përjashtohet mundësia se ky diferencim është i lashtë dhe se të parët e arbëneshëve të Zarës e sollën nga Kraja e Malit të Zi, prandaj ky diferencim në truallin e re mori karakter më të theksuar, duke shtyrë diftongun *uo* - *ua* u bë trajtë mbizotëruese në të folmen arbëneshe. Origjina e diftongut të sotëm *ue* në disa fshatra të Krajës së Malit të Zi: *në Brisk, Ljare, Dobrec*, etj., nga ana tjetër duhet kërkuar te ndikimi i të filmeve fqinje, në të cilat ky diftong është në përdorim. Ky tipar dialektor, gjithsesi, është sjellë nga trualli i lashtë, mirëpo të thuhet se mbi bazën e tij mund të konstatohet se nga ç'vend u shpërngul kjo apo ajo familje, sot për sot është e pamundshme sepse te përfaqësuesit me diftong përkatës, për shembull në *uo*, me lidhje të forta martesore dhe lidhje të

tjera u paraqit edhe varianti me *ua*, dhe anasjelltas, te pjesëtarët e së folmes me *ua* me të njëjtën rrugë u paraqit çifti *uo*.

131. Diftongu i dytë me radhë do të ishte *ie*, i cili në këtë të folme kryesisht është ruajtur mirë, pa përjashtim te emrat, që për folje nuk mund të thuhet, sepse te to është asimiluar në *i*; *me did* (= *me djég*); *me vil* (*me vjël*); *me hić* (= *hjek*); *me mil* (= *me mjël*); *me pić* (= *me pjëk*). Te pjesët e tjera të ligjëratës, veçanërisht tek emrat, askund nuk kam ndeshur në fjalë me diftong të asimiluar *ie* > *i*; *miel*, *diel*, *ndies*; *e ti ke ndie*; *ćieli*. Tagliavini (o. c., 27) sjell një shembull ku *e* e vjetër shqipe është diftongizuar në *ie*: (*iap*), *jep*, nga *ap*. Unë mendoj se shembulli i përmendur *iep*, *iepni* nuk ka kurrfarë lidhjeje me diftongun *ie*; vlen të përmendim se në shumë të folme gege dhe toske ndeshim *ap*, *ep*, *apin*, *epni*, *apin*, krahas *iap*, *iep*, *iapim*, *iepni*, *iapin*; *Grammatik*, Pekmezi, f. 231. Shembujt e përmendur *iep*, *iepni*, nuk janë asgjë tjetër, pos trajtat me *j* protetike për të cilat flet Pedersen, *Fest. til Thomsen*, 246; khs.; Jokli, *Archivum Romanicum*, XXIV, f. 105.

132. Diftongjet *oe*, *ae* kryesisht janë asimiluar në *o* ose në *e*: *voe* > *vo* > *vö*, *postae* < *postë*. Mjerisht, këtë dukuri, në mungesë të shembujve te të cilët në ballë të kohës janë ndeshur diftongjet e përmendura, nuk mund ta ndjekim kap më pah; prandaj do të mjaftojë të themi se diftongjet në fjalë në të folmen arbëneshe kryesisht janë asimiluar, e kjo është bërë në atë mënyrë, duke mbetur tingulli i dytë, do të thorë *e*; khs, për këtë shpjegimin tonë të mëparshëm.

133. Të shohim si qëndron puna në këtë të folme me shysmëvokalin *ε* (*ē*, *ě*), Taljavini (o. c., f. 30) ka bërë një shpjegim mjaft të përcaktuar dhe të pasqaruar mirë, duke pohuar se ai në fund të fjalëve ka rënë, e ky është i tërë shpjegimi. Ēeigandi (*Der gegische Dialekt von Borgo Erizzo bei Zara in Dalmatien*, në *Jahresbercht des Instituts für rumänische Sprache*, lib, XVII-XVIII, f. 184) konsideron se nuk është e drejtë që për këtë gjysmëvokal të flitet si për një tingull të reduktuar. Është e vërtetë se ky gjysmëvokal i së folmes sonë ka humbur te të gjithë emrat e gjinisë femërore, si *mōl*, në vend të *mołe*, *ǃ(e)nešt* në vend të *venešte*, *ćep* në vend të *kepe*, etj.; ai gjithashtu është zhdukur edhe te foljet nga infinitivi dhe

participi me konsonant: *me dāl* (= *me dal'e, dal'e*); *me fāl, fal(um)*, (= *fal'e, fal'e [um]*). Mirëpo nuk duhet lënë pas dore fakti se ky gjysmëvokal është ruajtur edhe në nominativ, akuzativ dhe ablativ të emrave të shquar në shumës, si edhe te mbiemrat me prapashtesë mniemërore *të* ose *ët*. Ai, gjithashtu, u ruajt deri në ditët e sotme edhe në rasën e 2, 3, 4, të emrave të gjinisë femërore në njëjës: nomin. - akuz. *djelmët, abl. djelmësh; micës; zora, zorët, zorësh; me i takāt k(e) pucët*; abl. *k(ë) pucësh; e ja ga on drünët; n(d) ërmiet siš e kam lan fjalën; mos m'u kujtuo se ja kan špū vājžen; mama e vajzës jeme; e čila dërën të obòrit; i kalbët; mola është e kalbët; i rulët, si je i đinët (= sinët); i marët; flokët më kán zān m'u čua*. Meqë këtë e pamë në shembuj, është e nevojshme të shqyrtojmë artikulimin e vokalit të përmendur në të folmen arbëneshe: a është e njëjtë sipas artikulimit me gjysmëvokalin e të folmeve toske, apo me të folmet e dialektit të gegërishtes jugore apo është diçka tjetër? Unë nuk do të pajtoheshja me mendimin e Vajgandit se vikali i reduktuar (ε) në të folmen arbëneshe ishte si çdo vokal i reduktuar në ato të folme ku ai është ruajtur, si për shembull në toskërishte. Unë e kam dëgjuar shqiptimin e këtij vokali nga shumë pjesëtarë të së folmes së Elbasanit, mirëpo më është dukur se vokali i tyre i reduktuar ishte më i mbyllët nga ai që e kisha dëgjuar tek arbëneshët e Zarës, te të cilët është më i hapur, me redukcion më të fortë, ashtu si në pjesën më të madhe të të folmeve geqe; khs.: Cimochoëski, *Le Dialecte de Dushmani*, f. 10 - 12. Shembuj: *kumiša; taš m(e) lišo dorët; fumi* (= fëmijë) – karakterizohet nga theksimi i *u-së* e cila mund ta ketë prejardhjen pikërisht nga gjysmëvokali *ε: mušile dërën* (nga *mëshile*), Taljavini (o. c., f. 30) mendon se sufiksi *-šëm* (= *šem*), e jo *-šim* është i lashtë te ndajfoljet e së folmes arbëneshe, për të cilat mbështetet në vërejtjet e Pekmezit (*Grammatik*, f. 224) se sufiksi *-šem*, në të folur, dëgjohej edhe *-šim, -čim*. Është shumë vështirë të pranohet një pohim i tillë, sepse është i njohur fakti se në veprat e klasikëve të gjuhës shqipe haset kryesisht sufiksi adverbial *-šim*, prandaj, varianti *-šëm* (*-šem*) është i vonshëm. Është e natyrshme që trajta dialektore *-šim*, që e ndeshim në disa të folme të izoluar, të konsiderohet variant arkaik. Megjithatë,

vërejtja e Pekmezit nuk flet asgjë për lashtësinë e varianteve të përmendura adverbiale me sufiksën *-šim -šem*. Ai me këtë vetëm tregon se ekzistojnë edhe variantet *-šim, čim* në disa të folme shqipe.

134. Se në të folmen arbëneshe nuk ka më vokale nazale, në këtë pikë pajtohen të gjithë studiuesit e kësaj së folmeje: *rān-a; sān*, gjegjësisht *ṽān, ln, zān, ḍn* ose *lān; pē; remb, mulī, ī (=hi); bō; cēn-i*; geg. *čēn-i*, tosk. *Ken-i < canis*. Është vështirë të thuhet me saktësi se a filloi denazalizimi në truallin e vjetër të arbëneshëve të Zarës, në realitet, denazalizimi ka përfshirë edhe të folmen e vendit amë, të Krajës së Malit të Zi, mirëpo kjo dukuri atje është e pjesërishme: ka përfshirë vokalet *e, i, u, ü*; vokali *a* nuk është përfshirë nga ky fenomen. Të themi edhe diçka për denazalizimin. Është e qartë se vokalet *i, e, u, ü* pas denazalizimit u kthyen në vokale orale, mirëpo për tingullin *a* kemi një vërejtje, në të vërtetë, ajo ose kaloi në oralen *a* (*rāna, ṽān, lān*) ose si vokal i gjatë i theksuar u labializua në *o*; *me bō; zō* (*por zān*) dhe kështu iu bashkua numrit të madh të fjalëve të cilat *a*-ja e gjatë e theksuar kaloi në *o*, si: *me vrō, me kļō me pō, gomōr* (*por gomari*), *ḍol* (nga *ḍol*); *brōd* (serbokroatisht (*brada*), *bevōnd-a; gušōr-i; me cō; kōl; me rō=raa; čiš je i mōrt; capuni* (=kazma); *frigū*, ose *frigun* (i fërguar). Mungesa të vokaleve të gjitha të theksuara, si p.sh., vokal *o*, tregojnë shembujt e mëposhtëm, ku format e kryehershme *o+n, o+l, o+r*, në fjalët e huaja, në arbënishte u zëvendësuan me vokalin *u+n+l+r*: *sampu-ni*, me labialen epentetike *m*. Trajtë, kjo, që, në të vërtetë, ndeshet edhe në dialektin kroat të Dalmacisë (khs. M. Hraste, *Čakavski dijalekat ostrva Hvara, Južn. Filolog*, XIX, I. 59), në të cilat ndeshen pikërisht *sampun, dumboko*, dy shembuj me *m* epentetike, ku sipas mendimit tonë, edhe duhet kerkuar prejardhja e fjalëve shqipe. Mendoj se trajtat e përmendura në arbënishte depërtuan pikërisht nëpërmjet të folmeve serbokroate të Dalmacisë, ose ato pikë për pikë përputhen me zëvendësimet e serbokroatishtes. Ja disa sosh: *sartur-i, saltur-i*, nga venetishtja *sartor*, nëpërmjet të folmeve kroate të dalmacisë: *sartur* (khs. Kušar, 22, dhe Cronia, j. F. VIII); *piāvūl-a* (=lodër fëmijësh, kukull); *peverun* nga venetishtja *peveron*, nëpërmjet të folmeve kroate të

Dalmacisë: *peverun*; *marangun-i* (- zdukthëtar, marangoz), venetishtja *morangon*, dialekti kroat *marangun* (Cronia, *L'Italia dialettale*, VI, 114); *kapunër-a* venet. *caponera*, kroat. *Kapunera* (Cronia, I D); *kantu-ni* trajta e dialektit kroat *kantun* (Kušar, 20); *armenun-i*, trajta e dial. Kroat, *armerun* (=orman); *škatul-a*, ital *scatola*, trajta e dial. kroat *škatula*, (Cronia, *L'Italia dialettale*, VI, 121); *balku-ni*; e ndeshim madje edhe te Bardhi: *fenestra=fniestra oo balkue* (f. 25); e ka edhe Bashkimi (32); *balkue*, *balkoi* edhe *balkoi* dhe *balkoni* në kuptimin *dritare*; fjala, është huazuar me siguri nga dialekti i Venedikut: *balcon* - në kuptimin balkon, dritarel në të folmet kroate të Dalmacisë ndeshim zëvendësimin e fjalës venedikase *barcon>barkun*, (Kušar, 20; Oronia, ID, VI, 106). Meqë e ndeshim edhe në trevën e Shkodrës nuk përjashtohet mundësia që të parët e arbëreshve të Zarës ta kenë sjellë me vete gjatë shpërnguljes së tyre në Dalmaci. Te ajo na çon mungesa e trajtës kroate *barkun* në arbënishte. Në të folmet e Krajës për këtë term ndeshim huazimin turk *pen ere*.

135. Në shkurtimin e diftongut *aj* te fjalët *maj majë* nga trajta e vjetër *mal'e*, arbënishtja pikë për pikë përputhet me të folmet e Krajës, khs. paragrafin 84 të kësaj monografie. Edhe te njëra, edhe te tjetra e folme trajta *meē*, ku me veprimin e theksit dinamik u rrafshuan grupet vokalike *ai*, *ae*, në *ē*, sepse siç duket qartë pesha e theksit ra në tingullin e dytë me radhë, në *i*, *e*.

Në mbështetje të shembullit *gršaint* (?!), (Taljavini, o. c., f. 27) ndërtoi ligjin fonetik sipas të cilit *a* dhe *ai*. Para së gjithash, unë mendoj se Taljavini gabimisht e dëgjoi *gršaint*; unë e kam shënuar *gëršanít*. Mirëpo, edhe nëse supozojmë se varianti i Taljavinit është kapur saktësisht, megjithatë nuk duhej prej saj të nxirret dukuria fonetike. Unë mendoj se deri tek *ai* nga *a* do të ketë përfunduar kryesisht nëpërmjet konsonantit fqinj *n*, edhe pse po e përsëris edhe një herë gjatë hulumtimit tim për të folmen arbëneshe unë nuk e kam dëgjuar trajtën *gëršanít*, *gëršanít*. Që vokalet në fqinjësi me *n* prodhojnë një *i* palatale apo *í*, kjo është e njohur edhe në të folmet serbokroate, në dialektin e kajkavishtes thuhet *kojn* në vend të *konj*.

Mendoj se nuk është e nevojshme të zgjatemi në fonetikën e së folmes arbëneshe, sepse shumë gjëra lidhur me të i kemi thënë në kapitullin e mëparshëm. Këtu do të bëhet fjalë vetëm për atë që nuk është folur më parë. Shi për këtë kapitulli për fonetikën e së folmes arbëneshe sigurisht do të jetë më i shkur tër nga kapitulli i mëparshëm ku bëhej fjalë për fonetikën e të folmeve të Krajës.

136. Po vazhdojmë studimin e fonetikës të së folmes arbëneshe me një tipar të saj arkaik, pikërisht me grupet konsonantike *mb*, *nd*, *ng*, sepse nga pjesa më e madhe e të folmeve gege këto janë zhdukur, do të thotë janë asimiluar, duke përfunduar, kryesisht në shqiptimin e vokalit nistor, sporadikisht edhe okluzivit të sprasmë. Ja shembuj për arbënishten: me *këndua* (*kënduo*); *mendoj*, *mbromie*; *kumbar*, *i munduošim*; *djali i Bageš të ndüem* (= *djali i të ndjerit Bage*); *në mbarim* (=në mbarim); *si mbétën ol? nuk j'o kanda*; me *đi zember škoñeš mas sī*; *na kó ndie*; *i katundi*, *ndalu nek te đom*; *š't'o ndōđ* (=ç'të ka ndodhur?); *ngrük*; *mëmdo kaliboć*; *dua me sua menděš* (=dua të mësoj përmendsh); *mendo bir*; *këmbōn* (=bie këmbora); *dalndūš*; *dundofile*, *un të dua*; *kandilo mos na mboro*; *mo të nderšim jân se ne*; *e kam nděš të bīn*; *nuk ju ndüej (ń)*; *ndīen kuburat*; *Lulzon lulja në prende të naněš*.

Pastaj në të folmen tonë ndeshim edhe shembuj të këtikkë: *zëmbër*, *zëmbra*; *trimb*, *trimbi* (trim-i); *ćümbe* (=qime); tingulli *b* te tri fjalët e fundit, nuk e ndeshim as tek ato të folme, ku janë në përdorim këto grupe; për toskërishte krahaso: *Dozoni*, Manuel: *zëmera*, *zëmbra*, *trim*, pl. *trima*; khs. edhe - Pedersen ALBT: *ëmera*, *trim*; për gegërishte khs. Bogdani: *zëmer*. Prania e bilabiales *b* në fjalët *trimb*, *ćümbe*, *p(e)štümbe* - është dukuri e vonë në arbënishte, sepse para së gjithash, nuk e ndeshim as në të folmet ku grupet konsonantike *mb*, *nd*, *ng* gjenden në përdorim dinamik.* Duhet hedhur poshtë çdo supozim se grupi konsonantik, në tri fjalët e zëna ngoje, ka prejardhje të lashtë, mirëpo, pa dyshim, është e vërtetë se *b*-ja e saj u përftua nga disimilimi i konsonantit të zgjatur *m*, siç është rasti me fjalën *pende* në shqipet nga lat. *Pinna*, *škamb* nga *scamnum*, *řenmb* nga *ramu* (s), *lemb* nga *lemm*, për të cilën supozohet se *m*, *n*, në gjuhën shqipe ishin

konsonante të zgjatura, e pastaj me anë të disimilimit dhanë *mb, nd*; khs. H. Barić, *O uzajamnim odnosima balkanskih jezika*, I, Beograd, 1937, botim i bibliotekës Arhiv za arbanasku starinu, jezik i etnologiju. Tani do të sjellim disa shembuj për të folmen arbëneshe, të cilët do të dëshmojnë a janë ruajtur dhe në ç'shikallë janë ruajtur grupet konsonantike arkaike *ng>nd*.

137. Është e njohur dukuria se grupi *ng* në shkodranishte u asimilua në palatalin *ń*, p.sh. : *ēńě, ēńl <angelus>*; arbënishte. *enděl-i*, Kraja *enġul-i*; shkodr. *unıl-i<lat. evangelium>*, arbënisht. *undıl-i*. Kraja *unġıl-i*; shkodr. *đńıl*, arbënesh. *đěń đini> šěń đinj, fěńđini*, Kraja *đńġín* (plur.); shkodr. *me nıt* nga *n-đit*, arbën. *ndit*, Kraja, *ńıt*; shkodr. *ńāđ* nga *ndāt*; arbënesh. *ndal*, Kraja *ngat*; shkodr. *kı, kin*, *<king>ng>ń*; lat. *agniculus*, (?) arbënesh. *čind*, Kraja *king, kin*, plur. *kinga, kina*, e folmja e Kosovës: *kind -i, plur. kında*. Siç tregojnë shembujt e përmendur, arbënishtja e ka ruajtur grupin *ng* ose *nd*, pa përjashtime, që nuk mund të thuhet për të folmen e Krajës, sepse te to, paralel me shembujt me *nd*, ndeshim edhe shembuj me *ng* të asimiluar në palatalen *ń*. E kjo do të thotë se ndikimi i shkodranishtes kishte filluar të hetohet edhe në të folmet laterale.

138. Në gjuhën tonë ka inovacione, në aspektin e artikulimit të tipave të tingullit /t/ të cilët sot, kryesisht, janë reduktuar në një tip të tingullit /d.m.th. në /t/ të mesme ose evropiane. Mirëpo, ky tingull para disa dekadash nuk ka qenë i tillë. Po sjellim disa shembuj me të cilët do të dëshmojmë gjendjen e /s/ në të folmen arbëneshe: *mola* (/e mesme), *moła* (te njerëzit e gjeneratës së mesme); *boła* (/e fortë, te e njëjta gjeneratë), *bol, bola* me /t/ të mesme (te plaka 70 vjeçare); *dial'i*, (me /f/ të butë si te plaka që përmendëm më parë, ashtu edhe te djali saj i moshës së mesme); *dieli, ćeli, mola, bola, vlai, miel, me flēt, koli, kolomboć, letra, kolai*, të gjitha me /t/ të mesme (në artikulimin e plakës), *l'ibri l'ikura; me l'ivrua*, te të tria fjalët ndeshim artikulimin me /f/ të butë (te plaka). Siç shihet nga këta shembuj, në arbënishte mbizotëron tipi i mesëm i tingullit /t/, sporadikisht, para vokaleve palatale, veçanërisht para vokalit /i/, dëgjohet /f/ e butë e pastër, por vetëm te artikulimi i disa individëve. Kryesisht, mund të thuhet se në të folmen arbëneshe të gjitha tipat e tingullit /t/ janë reduktuar në /t/ të mesme.

Shumë rrallë ndeshet tipi i trashë i këtij tingulli, përkatësisht tipi i butë, që, ose janë gjurmë, të artikulimit që nga koha kur këta tipa ishin në përdorim të dendur ose artikulime analogjike me të folmet serbokroate. Megjithatë, unë mendoj se alternativa e dytë është më e bindshme. Për procesin e reduktimit të këtyre tipave të tingullit /më të rëndësishmit janë shembujt e mëposhtëm, që i ndeshim te Mikloshiçi⁶³ (*Albanische Forschungen*, I, II): *leter-i* (altar); *nalt*; *kōl*; *kieλ*, -i, *kalma*=calamus; *kandili*; *kngala*; *leleduo*; *livruo*; *me lō*; *me malkuo*; *molat*; *mulini*; *uli-a* (=ulliri), *plumbi* (pëllumbi); *mluo*; *barλ barδ*; *darλa* (sot *darda*) *darða*; *leti det* (=dhjetë); *(i) maλ (i) maδ*; *małšti mađšti*. *me u ilnuo me u idnuo*; *me mblēλ*, *me mblēδ*; *ula uða*. Siç tregojnë shembujt e theksuar, spiranti interdental i zëshëm δ kaloi pa vështirësi e pa përjashtim sipas vendit të artikulimit në konsonantin më të afërm / (=λ). Ka në shembujt tanë edhe raste të këtilla ku / (=λ) e trashë gjenetike / (=λ) shpesh ngatërrohet me të mesmen, gjegjësisht me tipin e butë të tingullit /, /'; p.sh. në fjalët: *molat*, në vend të *mołat* (=mołat); *mulini*, në vend të *mułini* (=mułini); *plumbi*, në vend të *płmbi* (=płmbi). Shembujt e mësipërm të Mikloshiçit do të thonë edhe diçka tjetër, në të vërtetë do të thonë se / (-λ) e trashë në vitet e shtatëdhjeta të shekullit të kaluar ishte ende në përdorim në të folmen e arbëneshëve. Lidhur me çështjen tonë të tipit të tingullit / në të folme arbëneshë vlen të theksojmë faktin e δ interdental shpesh alernohet më labialen /te të folmet e Krajes, për këtë shih paragrafin 103 të kësaj monografie.

Sot /e mesme në të folmen e arbëneshëve i ka shtyrë tipat e tjerë të këtij tingulli. Këtë e vërteton qartë fakti se në këtë të folme edhe /' (ъ) e butë serbokroate ka kaluar në / të mesme: *greblja* në arbënishte *grebla*: *ključanica* arbën. *Ključanic-a*; *kralj*>*kral-i*; *Klubica*>*Lubic-a* *melja*:>*mel-a*; *šupljača*>*šuplač-a* *tralja*>*trāl-a*; *cilj*>*cil*; i vetmi përjashtim sipas Taljavanit, (o, cit., 32), paraqet shembullin *dimjōk-u*, kinse kjo ka prejardhje nga fjala serbokroate *dimljak*, e cila nuk ekziston fare. Fjala arbëneshë është huazuar nga serbokroatishtja *dimnjak*> *dimjōk-u*.

⁶³ Në të vërtetë, te Mikloshiçi nuk ka diferencime grafike ndërmjet / së mesme dhe /' së butë; shenja / shënon edhe njërin edhe tipin tjetër.

139. Si në të folmen arbëneshe po ashtu pothuaj edhe në të gjitha të folmet gege, tipat e tingujve *k*, *tś*, *ĝ*, *dź* janë larguar shumë nga artikulimi i kryehershëm i tyre. Në arbënishte nuk ka më palatale të buta *k*, *ĝ*, por këto janë identifikuar plotësisht në artikulum me tipat e *tś*, *dź* të fortë (ne do t'i shënojmë me *ć*, *đ*), pra, kanë kaluar në afrikate *tś*, *dź*. Shembujt për të folmen arbëneshe, *endul-i ćursuā, ćile ćiš ko të të" liet e đs; për ćiš nuk muš me ārd (-t)?; ćiš ko lān (=đān)? ćet ĵan t'm (ě) leń; dera e đütetit ěšt e male*. Identifikimi i tingujve *k*: *ć*, *ĝ*; *đ* në të folmen arbëneshe me siguri është e një kohe të vonshme, sepse tipat e këtyre tingujve në të folmet e Krajës janë plotësisht të diferencuara, Identifikimi i këtyre tingujve gjithësesi është i vonë edhe në të folmet e tjera gege. Është interesante të përmendim se në të folmet e Malësisë, ashtu si edhe në të folmet shqipe të Kosovës, nuk ekzistojnë tingujt *k* dhe *ĝ* në në kuptimin e të folmeve të Krajës, gegërishtes jugore dhe toskërishtes, siç pamë pak më parë, në këto të folme këta tinguj kaluan në afrikate ndërsa çiftet e tyre të forta, me siguri nën ndikimin e të folmeve fqinje serbokroate, kanë artikulum plotësisht identike. Për të folmet e Malësisë khs. Lambertz, *Bericht*, 20; për shkodranishten-Jarniku, Prizpevky, Pragë 1883; për trevën e Dukagjinit-Cimochoëski, *Le Dialecte*, 1951.

Vajgandi me përdorimin e shenjave *d'*, *dź*, për tingullin *d* të së folmes arbëneshe krijoi një hutim, sepse njësoj i shkruan *d'el*, por *d'isht*, *d'uja*, *d'umi*, *d'uni*, por edhe *džuteti*, *džüs*, *džie*, *džind*. Unë dyshoj se para jo plot pesëdhjetë vjet në të folmen arbëneshe të ketë pasur kësso mrekullish në shqiptim. Është e pamundshme t'i marrim si shembuj të saktë *d'isht* (nëse kjo duhet të lexohet "*djišt*") pastaj *d'uni* dhe *d'u-a* (gjuha), sepse *d'* e këtyre fjalëve, me siguri rrjedh nga grupet konsonantike arkaike *gl'*, *glišti*, *gluha*, *gluni*, trajta të cilat sot në të gjitha të folmet e Malësisë, pra edhe në të folmen arbëneshe, shqiptohen si *gi*, pse *g*, prandaj fjalët e përmendura në arbënishte shqiptohen *gišti*, *gü-a güń-i*; në malësorçen: *gišti*; *gjuh-a*, *gju-ni*; khs. Jarnik, khs. Cimochovski. o. c., f. 22. Edhe pse Vajgandi me shenjën *d'* deshi të tregojë palatalitetin e tingullin *gi* në të folmen e arbënesheve, ajo praktikisht u tregua e papërshtatshme, sepse grafikisht u identifikua me *d'*

te *d'umi*, *d'eli*, shqiptimi i së cilës megjithatë nuk përputhet me shqiptimin e fjalëve *gīšti*, *gū-a*, *gūnī*. Edhe vërejtja e Taljavinit, (op. cit. 31) vendosmërisht flet kundër ekzistimit të *d'së* palatale në fjalët *gīšt*, *gūn*, mirëpo nga ana tjetër Taljavini bën gabimin tjetër, kur pohon, kinse, kjo *g* është përftuar nga *ĝ*, që kurrsesi nuk mund të pranohet, sepse shkalla e zhvillimit të ardhshëm të grupeve konsonantike arkaike është *kl'*, *gl'L kī*, *gī*, e kurrsesi *Ķ*, *ĝ*, siç del nga provat e Taljavinit.

140. Sa i përket artikulimit të sibilanitit *s* në të folmen arbëneshe nuk do të kisha kurrnjë vërejtje, mirëpo, meqë Taljavini (o. c., 17, 18, 33) në këtë të folme nga ky tingull zbuloi mrekulli të vërtetë, e që ai i shënoi me *š*, *ʃ*, ndaj më duhet t'i shqyrtojë këto. Unë gjatë qëndrimit tim në Zarë, në mesin e arbëneshëve, me interesim të veçantë kam përcjellë shqiptimin dhe artikulimin e tingullit *s*; kam shkuar nëpër shtëpi, i kam dëgjuar se si bisedojnë ndërmjet tyre në treg, kam bërë biseda me ta e këtë ma bënte të mundur njohja e gjuhës shqipe dhe njohja e së folmes arbëneshe, po megjithëkëtë nuk kam hetuar kurrfarë artikulimi tjetër, pos tingullit të njohur *s*. Të përmendim kalimthi se si Vajgandi nuk e ka dëgjuar atë *s* (*s*) për të cilën flet Taljavini. Mungesën e një tingulli të këtillë (*š*) ma vërtetoi edhe arbëneshi vendës Kruno Kërstiqi, i cili më shkroi se informatorja kryesore e Taljavinit, Lidije Vuksani kishte të meta në dhëmbët e përparmë: gojën e kishte të tërhequr e të dalë përpara, shi për këtë, ajo me siguri kishte një artikulum të veçantë të tingullit në fjalë. Është e vërtetë se arbëneshët ose nuk bëjnë dallimin ndërmjet *van* dhe *sān*, që Taljavinit është dashur t'i shërbejë si fakt i tezës së tij (o. cit., 18) që në të vërtetë nuk thotë asgjë në favor të saj: ko do të thotë se interdentali i shurdhët *ʃ*, në këtë të folme, për nga shqiptimi është identifikuar me sibilantin e rëndomtë *s*, dhe asgjë tjetër.

141. Nuk është e parëndësishme që me shembuj të vërtetohet a ka raste të kalimit të tingullit *f* në *ʃ*, *h*, dhe anasjelltas. Edhe pse një numër fjalësh të cilat mund të na shërbenin për ilustrimin e dukurisë sonë dolën nga përdorimi në të folmen arbëneshe, megjithatë në mbështetje të numrit të fjalëve që kanë mbetur mund të vërtetohet veprimi i kësaj dukurie në

gjuhën e arbëneshëve të Zarës. Që në fillim do të themi se në këtë drejtim nuk ka shumë ndryshime. Këtë më së miri do ta shohim në shembujt më poshtë: *adët; vëndini dhe fëndini, prið(t), pris(t); me nōð-nōs* (nga *nōh*), tosk. *nōhur; fēr-a* (Kraja: *fēr-a* dhe *vēr-a*); *uðul-a, usul-a*; (Krajë *uðul-a*, dhe *uful-a*); te Vajgandi po ashtu: *uðul, fēmi, fumī-u*, Kraja *ðmī*, e ka edhe *fmī; ðkjel i, e, kðjelt, i, e, kðjelun* (Kraja *i, e, ðkjetl*); *ðembēr-a, sembēr-a*. Kur të kihet parasysh tingulli i kryehershëm *f, a ð*, në fjalët e cekura, atëherë duket sheshazi se vetëm në pak shembuj ka tingujt *f*, apo *ð*, kanë pësuar ndryshime. Me *f* të kryehershme e të alternuar në *ð*, është edhe fjala *prið* nga *prift*, lat. *praebiter*. Vajgandi (o. c., 187) e ka klasifikuar këtu edhe *nōð*, duke konsideruar se *ð* në fjalët e përmendura sekondare, në të vërtetë ajo në ballë të kohës shqiptohet *nōf* (atë, si duket, e ka hutuar varianti i së folmes së Elbasanit, e cila shqiptohet *nōf*). Çështja e prejardhjes së tingullit *ð* në fjalët e përmendura është tjetër problem, ndërsa tjetër është varianti i tij paraprijës i drejtpërdrejtë. Unë mendoj se në fjalën *nōh* tingulli i kryehershëm është *h*-ja, e jo *f*-ja; variantet e saj janë *nōf* dhe, siç shohim në arbënishte edhe *me nōð*, kurse trajta e saj e drejtëpërdrejtë gjithsesi është trajta infinitive *me nōft*, pra me *f*, të cilën e ndeshim kryesisht në infinitiv dhe në particip; në trajta të tjera foljore shqiptohet *h*, e jo *f*: *un nōh*, ndërkaq në të folmen arbëneshe, për shkak të zhdukjes së tingullit *h*: *un nō*, etj. Procesi i zhvillimit të trajtës sonë në fjalë është: *nōh > nōf > nōð > nōs*. Trajtën infinitive dhe participore *me nōft, nōftum* ose *nōft* e ndeshim edhe në pjesën më të madhe të të folmeve gege, ndërsa *ð*, u përftua nga *h*-ja në fqinjësi me dentalin *t*. Te fjalë të tjera me tingullin *f*, përkatësisht *ð* që cekëm për arbënishten, nuk ndeshim më dukurinë e dizimilimit, që do të thotë se e folmja jonë në këtë aspekt ka ruajtur tipare arkaike; khs, shpjegimin tim lidhur me këtë çështje, paragr. 99, 100, 101.

142. Për gramatikën historike të gjuhës shqipe s'është pa rëndësi të theksojmë faktin se në të folmen arbëneshe shpesh ndeshim *-g* sonore në vend të *k*-së së shurdhër, si *nt* në vend të *nd*. Ja disa shembuj: *garaguci* (= *karaguci*) = lakuriqi; figur.; varfanjaku, skamnori; *me gaəuo* (-a) = me tregua (= *kaəuo, kałəuo*); Kraja *kaəuo*, përdoret edhe *kałəuo, kałəue; gaća*

(*kaće-ia*); *gusōr*; (*kusar*) *šiguo* (-ua) Kraja, *šiguo* (-ue); *žgilēt* (=serbokr. *škiljav*); *g(e)pucēt*, paralel me *k(e)pucēt*; *gērmuo*(-ua), *karmuo* (-ua); *guštuo* (-ua), *kuštuo* (-ua), - *cistare*; *grabosnec*, malazezishtja e vj. *kravošec*; fjala e fundit në të folmen arbëneshe depërtoi nga malazezishtja e vjetër, ëysh në truallin e lashtë të arbënesheve të Zarës. Edhe me më shumë rëndësi për gramatikën historike të gjuhës shqipe është ndeshja sporadike e grupit konsonantik të paasimiluar *nt*, në vend të *nd*, në të folmen e arbënesheve të Zarës: *nant* (Kraja. *nānt*, *nāntlēt*, *nāntmlēt*=*nāntmđet*). Edhe pse ky është shembull i vetmuar ku nuk është bërë sonorizimi i okluzivit *-t*, megjithëkëtë ky ndikim është mjaft i bindshëm se në shembullin tonë në fjalën e përmendur *nānt* është ruajtur trajta arkaike. Përdorimi i fjalës *nānt* në truallin e vjetër, do të thotë në të folmet e Krajës, vetëm e përforcon mendimin tonë. Gjurmë të trajtave të desonorizuara ndeshim mjaft shpesh edhe në shkrimet e Buzukut (1555): *kankε*<*lat. cantica*; *palma e himna e chanch te špiritit –in psalmis et hymnis et canticis spiritualibus*; *ban te mos dich e štemanchtah jote kiš ban e dđaththa jotenesiat sinistra tua quid fasciat dextera tua*. Në të folmet toske kësi shembujsh ka shumë më tepër; khs.: Reinhold, *Antologjja*, 8, 18; Glossar 12, 13, 29, 36; Marchianò, *La Rondinella carne nuziale albanese inedito con parafrasi antica*, publicata da uni manoscritto del secolo XVIII dhe ... (1906), 4; G. Dara, *Kanka e sprasme e Bales*, 110, 117.

143. Njëra nga pikat dalluese të dy dialekteve shqipe është edhe konsonanti palatal - *ń*. Zakonisht thuhet se toskërishtja është më arkaike, e cila ruajti të paprekur konsonantin (*ń*) në fjalë, ndërsa gegërishtja e ka shndërruar në *j*. Mirëpo, një gjendje të këtillë nuk e ndeshim në gegërishten e vjetër, e këtë e vërtetojnë edhe disa të folme të sotme geqe, ku mund të ngërthejmë edhe të folmen arbëneshe edhe të folmet e Krajës së Malit të Zi. Së pari po përmendim disa shembuj nga shkrimet e Buzukut dhe shkrimet e shkrimtarëve të tjerë gegë të shekullit XVII, e pastaj do të kalojmë në të folmet tona në fjalë. Te Buzuku; *u boni šen atüne – dedit illis signum*; *endë líkee the luanet – in lacum leonum*; *nukë te lüpín: as nuke te tentoń tenezone – non petam, et non tentado Dominum*; te Budi

(1635): *tèniētene* – *te eten, kopeštiñevet*; te Bardhi, nga Zadrima: *zoña* (=domina); *řaña* (=radix); te Bogdani (1685): *Romañite* (I Romani), *me buñtune* (a pernottare); cituar sipas *Buletin për shkencat shoqërore*, 1955/2 f. 94. Në bazë të njohjes së dialektologjisë sot me siguri mund të thuhet se palatali i përmendur *ñ* është ruajtur sporadikisht vetëm në disa të folme gege, ku mund të përfshijmë, përveç të folmeve të Krajës dhe arbëneshe, pa dyshim edhe të folmen shqipe të Dibrës. Ja shembuj për të folmen e arbënesheve të Zarës: *šėñ* (signum); *ʋ* (=s) *ʋoñi; mulaiña; lakna te šuliña* (=lakëra turshi); *güñi; un preñ; gardñet; bëñeš bë, se të dūja kan fōl për tū, un malñe rzoj; drećñet; balkuñt; si do të s'kñje; rōjñ ne gūñ; nek keñe; zotūñ nek të benkoñe; me škopñe po i gārmōjñ; difar zañeš po perzien; po (k(e)ćejñ me kāp doñi cōp; ian ćit si ćeñt; s po muće m'u ćet, u g(e) zoñeš natūres s'borđ si të kište me m'kēñ në vodli; kur të viñe pe jušaš; mo doñeš me dēk pe uje, se me kēñ lūpc; Joko, un të lutñeš; ku u martoñe?; si kente kur teʋoñeñ se je pē špije, pe famēlje të gusorve?! e un taš nuk e patñeš farēñ; doku keñeš fōl; mo šum vōj patñeš me punua. Nga aspekti i palatalit *ñ*, arbënishtja përputhet plotësisht me dialektin toskë; unë do të thosha se kjo e folme bashkë me te folmet e Krajës ruajti me konservatizmin më fanatik konsonantin në fjalë, sepse e ndeshim edhe në shumësin e imperfektit, e që nuk është cilësi e dialektit toskë, kështu në të folmen arbëneshe ndeshim; *un punoña* (punoñeš). *ti punoñe, aј punonte, ne punoñim* (-ñeñ), *ju punoñit, aya punoñin* (nēñ), ndërsa në toskërishte kemi: *punonim, punonit, punonin*.*

144. Njëra ndër veçoritë që e cilëson të folmen arbëneshe, e që mund të konsiderohet inovacion i saj, është asimilimi i grupit të spiranteve *fš*. Nga shembujt që do të sjellim këtu më poshtë shihet qartë se në këtë dialekt nuk ka mbetur asnjë fjalë ku mos të jetë kryer asimilimi i grupit të zënë goje. Ja disa shembuj: *mēndaš* nga mentax; *kašāt-a* që më tepër thuhet *kašata*, nga *kašuo* < *kašuo*. Asimilimi është kryer kryesisht në dëshirore: *nē piša* < *pišša*, *nē ćošin Tinin* < *ćofšin*; *i špūt* në vend *špūft*, nga *me špū* (dërguar, sjell); *nē bëša* ose *boša*, *nē bëš*, – *bōš*; *nē bēt*, – *bot* < *bēšš*, *bāšš*, nga folja *me bā*, se *ne mos e baškōt* < *baškōft*. Foljet *me ši*

(me pastruar, me fshi grurin, *pastaj me fshesë*) dhe *me së* (*fshëh*, mshef), të cilat në të folmet e tjera gege dhe toske shqiptohen *me fših*, *mšeh(e)* nga e para dhe *fšisa*: *mšesa* (*fshesa*) - mendoj se nuk do të mund të klasifikohen në shembuj me asimilim të kryer të grupit të spiranteve, sepse *f*, gjegjësisht *m* është prefiks në trajtat e përmendura, prandaj trajtat pa prefiks *f*, *m*, janë me siguri më arkaike.

145. E folmja jonë nuk ka kurrfarë risish te grupi *l̥* dhe *velari+ likuidi*. Në grupin e parë, siç dihet, që nga koha e Buzukut (1555), ndeshim në asimilimin e tij në *j*: *bil'a>bi(e)*; *voj<oleum*, *me f̥iuo*: *f̥jua* (gaboj) < lat. *fallere*, ndaj nuk mund të pajtohem me Vajgandin, i cili në monografinë e vet të përmendur (f. 227) sjell fjalën *ftul-i*, lat. *vitulea*, kec femën një, ose dyvjeçar *likuidi* i së cilës, në të folme të tjera gege dhe në pjesën më të madhe të të folmeve toske, - është jotizuar qëmoti. Dyshojmë në ekzistimin e shembullit *ftul* për shkak se në të folmen tonë një likuid të tillë *l*, përveç shembullit të përmendur, nuk e ndeshim, e kjo nuk është dëshmuar në asnjë të folme gege, ndaj është e pakuptueshme se si mundi të ruhet ajo në një shembull të vetëm, madje këtë në të folmen ku termat me prejardhje indoevropiane në sferën e kafshëve shtëpiake filluan t'ua lëshojnë vendin shprehjeve të huaja: *kōz-a* (*di, li, li* – nuk përdoren më); për pelën përdorin fjalë turke *bedevī* (*pēl* përdoret vetëm në shprehje të shtanguara: *është stri si pela*).

146. Ndonjë risi të veçantë, kryesisht nuk kemi as në asimilimin e grupeve *gl̥*, *kl'* (*velat+likuid*): me *k̥jo* (=k̥ja)<*kl'a*; me *k̥n* (*kjēn*)<*kl'ene*; *i*, e *gjāt*<*gl'ate*; por kemi edhe *gū-a* (=gū[h]a); *gūn-i* (=gū-ni)<*gl'uni*; *gišti*<*gl'išti*; me *ngjatua* (-o) [*me zgjatë, zgjatur*]: *n+gl'ate*; *kiš-a*<lat. *ecclesia*; *ćind* (krajançe *kin̄g*, *kin̄*, plur. *kin̄ga, kin̄a*) nuk do të duhej të ngërtheheshin në shembujt e deritashëm, sepse konsonanti fillestar *k̄*, apo *ć*, e jo *ki*, siç pritej nga grupi arkaik *kl'* në të folmen tonë. Shembujt me *k* nistore, si *kin*, plur. *kin a*, shumë pak do të na ndihmonin në zbërthimin e prejardhjes së fjalës *kin*, *ćin a*, *kin̄-a*, sepse në të folmet në të cilat ndeshim shembujt me *k* (*kin*) *ce* të latinishtes, kryesisht, i përgjigjet, në vend të *k̄*, *ć* - përsëri *k*; kështu *cepa-ae kēp*; *me cēp*<lat. *capio*; *ke-i*, plur. *keře*, lat. *carrum*.

Me përjashtim të dy shembujve me *g*: *gūa*, *gūn-i* grupet e përmën-

dura arkaike *kl'*, *gl'* në të folmen e arbëneshëve kanë përfunduar në shkallën *ki*, *gj*, natyrisht nëse nuk llogariten këtu shembujt përjashtues me *k* ose *g*; *kīš*, nga *kl'* dhe *gišt* nga *gl'īšt*; Nëse në monografinë e vogël të Vajgandit shenja *d'* është përdorur *dj* (*đ*), atëherë është e pakuptueshme ndeshja e shembujve vijues në të folmen arbëneshë: *d'e* (*dje*), *đavt* (= *djavt*); te Taljavini *giāt* (djathtë); *d'īšti* (= *đīšti gišti*); *d'u-ia'* *d'u-ia'* *d'un-i* (*gjuni*). Nëse shembujt e përmendur me *d'*=*dj*, janë të saktë, atëherë në arbënishte të gjithë shembujt me *kl'*, *gl'* arkaike duhet të kishin *ć*, a *d'*, *đ*, *đ*. Është e pakuptueshme përse vetëm shembujt e përmendur bëjnë përjashtim.

Fakti se grupi i përmendur është ruajtur në arbënishte tregon dëshminë e sigurt se fillimi i rënies së tij në të folmet e Krajës është i vonshëm; nga ana tjetër, në këtë dialekt kemi edhe shembuj që e ruajnë *ng*, e kjo u ruajt në saje të pozitës izoluese që kanë të folmet e Krajës.

147. Në faqen e 30 të monografisë së vet, Taljavini, në bazë të një shembulli të vetëm, i atribuoi së folmes arbëneshë veçorinë se *dj* në fjalën *djāvte* që shëndrrohet në *gi*: *giāt* (djathtë), që Jokli (o. c., st. 107) e lidhte me një tipar mjaft të përhapur të disa të folmeve të shqiptarëve në Jugosllavi; krhs. Skok, *Lingvistička proučavanja neslovenskog stanovništva skopske kotline*, Godišnjak muzeja Južne Srbije, 1941, pastaj rev. *Jeta e re*, 1955/1-2. f. 89/ *djeo* > *deo*; *djali* > *đal'i*; *djađ* > *ađ*; *po m'djeg* > *po m' deg*, etj. Unë një trajtë të këtillë nuk e kam dëgjuar te arbëneshët e Zarës, këtë nuk e ndeshim as te Vajgandi, i cili në të vërtetë, shënoi *d'adt* (rechts). Vetë fakti se thuhet *djađ* e jo *đavđ*; *djal*, e jo *đal*; *me di đ*, *me djeg*, e jo *deg*. Flet shumë pak në favor të supozimit të ekzistimit të trajtës *giat* < *djāvte* në arbënishte, sepse po të ishte ky tipar i arbënishtes, atëherë kjo dukuri do të duhej të përfshinte edhe shembujt e përmendur me *dj*. Shi për këtë ka shumë pak arsye që të ekzistojë trajta në fjalë.

148. Çështjen e disimilimit të tingujve *đ* dhe *d*, të cilëve u paraprin likuidi *r*, po e klasifikojmë në fonetikë. Në të vërtetë, në arbënishte, ekzistojnë një numër i vogël fjalësh spiranti i sprasmë i tëshëm interdental i të cilave (*đ*), kur u paraprin tingulli *r*, kalon në dentalin *d*, siç dëshmojnë

shembujt: *kokoporda* (bajga, të pëgërat shtazore); *porda* nga *porða*; *dorda* < *dorða*; *bord* < *barð*; *ërda*, nëpër *erla* < *herða*; *me ard* (-t) sigurisht nëpërmjet *ārł* < *ārð*. Unë mendoj se për shpjegimin e trajtës *darda*, *ārd(t)* nuk duhet të shtiem në përdorim kombinimet e ndryshme, veçse atë ta njehim dukuri të njohur të disimilimit të interdentalit $\delta > t$, a *d*, siç tregojnë shembujt e lartpërmendur. Nuk do mend se shkalla e parë e disimilimit të tingullit δ ka qenë *t* velare, ndaj rreth argumentimit të saj nuk duhet humbur kohë. Mirëpo, meqë interdentalit δ i parapriu likuidi *r*, së cilës *d* ishte më e afërta për nga artikulimi, Jokli (*Archivum Romanicum*, XXIV [1940], f. 110) mendoj se *ārd* ka mundur të vijë nga *art*, e kjo nëpërmjet *arðt*, dukuri e ngjashme që e ndeshim te shembulli i pasigurt *djaðt* > *gját*. Nuk ka dyshim se kombinimi është nxjerrë me mendjemprehtësi, mirëpo nuk di si mund të shpjegohen në këtë rast shembujt: *dard*, *bard*, *ërd*, *pōrd*, *kokopord*, sepse te këta nuk paraqitet kurrfarë *ðt*, nga e cila, sipas mendimit të Joklit, me rënien e interdentalit të shurdhët ϑ do të përfundonte në *t* e kjo me anë të sonorizimit do të kalonte në *d*. Unë mendoj se Jokli nuk ka të drejtë kur te tingulli *t* i fjalës *art* (*ard*) sheh sufiksin participor *t*. Para së gjithash, unë *t* nuk do ta quaja sufiks participor, por sufiks mbiemëror. Mbaresë participore është *n*: *kam dalun*, *kam arðun* (ose *arðe*), - dhe ja disa shembuj të adjektivit me sufiksin *t* (*e*): *i mōrt(e)*, *i maŕte* (= *i marrë*), *i mšelt*, *i çelt*, *i marët*; *i ðinët* (*sinët* = *i thinjur*), *i blutët*, *i rulët*; *i mükët*, *i çorët*; ndërsa *i çoruom* = *i verbuar*. Sufiksi adjektiv *t*, si edhe *šem*, i jep mbiemrit kuptimin e cilësive të përhershme. Është e pakontestueshme se ka participe të adjektivizuara, të cilat shumë shpesh sipas kuptimit u përgjigjen mbiemrave me sufiksin *t*; mirëpo, tendenca e përgjithshme e mbiemrave të shqipes është klasifikimi i tyre sipas kuptimit, e kjo do të thorrë diferencimi i kuptimit të mbiemrave me *t* dhe atyre me *n* (*m*). Është interesante se te Buzuku ndeshim participe me sufiksin *-t*: *me vut*, *me pīt*, *me pat*, *me prut* (khs. J. Rrota, Hylli i Dritës, 6, 1930, 43), mirëpo, sot participe me *-t* në gjuhën shqipe nuk ka; *-t* sot është rezervuar kryesisht për adjektivë. Sa i përket kronologjisë së trajtës *art*, unë mendoj se kjo ëshë e një kohe të vonshme. Unë mendoj se disimilimi në fjalët e përmendura duhet

shpjeguar me kontraktimin e grupit tretingujsh - *rđti* - *rđti*, *rti*.^{*} Këtë e dëshmojnë shembujt *darła*, *barł*, *rłia* (hardhia) nga *darđa*, *barđ*, (*a*) *rđia*, që do të thotë se ð interdental, në fillim, pa marrë parasysh se në ç'vend gjendej, është disimiluar në velaren *ł*; khs. Mikloshiçi, J: *Albansche Forschungen*, II, Die romanischen Elemente im Albanischen.

149. Në risitë e së folmes së arbëneshëve të Zarës bën pjesë edhe dukuria e adjektivizimit të sufiksit participor *-n* dhe *-m*. Ja shembuj: *era teme e dašum* (në vend të si rëndom *e daš(t)un*; do ditur se sufiksin *-n* në gjuhën shqipe e ka vetëm ajo kategori e foljeve, që në infinitiv sos me konsonant; lloje të tjera foljesh nuk i nënshtrohen kësaj rregullore); *i ćilum*, *i mšilum*, *i ćuditum*; *i dekum*, *i posum*, *i lagum*, *i ardum* > *ordum*, etj. alternimi i përmendur ka vepruar te të gjitha llojet e mbiemrave dhe të pjesorëve të mbiemërzuar, duke mos marrë parasysh mbaresat participore ose infinitive. Kështu, për shembull, participi i adjektivizuar, - te foljet ose te participet me vokal të gjatë *me pā*, në arbënishte *me pō*, *kam pō*, morën sufiksin - *um*: *poum* (= *pām*); së këndejmi *pouma* ka kuptimin e pamjes së pjesës dramatike; *dā* > *dō*, *i doum* (i ndarë); *vrā* > *vrō*, *i vroum* (i vrarë, i lënduar); *lā* > *lō*, *i loum* (i larë); *me prē*, *i preum* (i prerë); *bā* > *bāi*, *boum* (i pjekur); *ńeri* i *boum* (njeri i pjekur); *me šeh* < *še*, *šeum* (i fshehur): *me tērbim* te *šeum* (i fshehur). Unë mendoj se në formimin e këtyre participeve të adjektivizuar rol vendimtar ka luajtur analogjia. E dimë se mbaresa mbiemërore e participit me diftong është *m*; - pra: *baškuo*, *i baškuom*; *pērdoruo*, *i pērdoruom*; *štekiuo* nga *šteg* (rrugë, shteg), *i štektuom*; (*me*) *kēnduo*, *i kēnduom*; (*me*) *turbuluo*, *i tēr* (*tur*) *buluom*. Duke pasur në ndërgjegje mbaresën *-uo* (*m*), te ky lloj foljesh, participorëve të tyre, - pjesëtarët e së folmes arbëneshe, nën ndikimin e analogjisë, filluan t'ia shtojnë mbaresën - *um* edhe atij grupi të participorëve që përfundonin me vokale të gjata, siç janë *ā*, *ē*, (që në arbënishte zakonisht shqiptohen *o* dhe *e*: *bā* > *bō*, dhe *boum*; *prē* dhe *preum*, etj.). Ky tipar i së folmes arbëneshe rastësisht përputhet me të njëjtën veçori të gegërishtes

^{*} Në të folmet shqipe të Kosovës dhe të Jabllanicës së Epërme, krahas trajtës së drejtë *erđi*, dëgjohet shpesh edhe trajta (= *erti*, *m'erti keē*).

lindore, të fshatit *Rapçishte* në Maqedoninë e Jugosllavisë): *kaum* (= *kam*); *proum* (= *pram*, *mbrëmë*); *akšoum* (= *akšam*, *muzg*); khs.: Jokli, o. c., f. 110. Nuk ka dyshim së koïncidencat e të folmeve në fjalë u bën pavarësisht nga njëra-tjetra. Mbi ndonjëfarë ndikimi të njëres së folme në tjetrën nuk mund të bëhet fjalë, ndërkaq ky tipar me siguri nuk është i lashtë, lindi, pa dyshim, në territoret e sotme të të folmeve në fjalë, të larguara më se pesëqind kilometra njëra prej tjetrës.

150. Sa i përket zhdukjes së tingullit *h* nuk kemi ç'të themi, përpos të theksojmë se fillimi i zhdukjes së tingullit në fjalë është i lashtë. Në të folmet amë të Krajës ka raste të rralla të rënies së tingullit *h* në fjakë; raste të rënies së tingullit të përmendur kam ndeshur edhe në *Concilium Albanum* (1703). E gjithë kjo flet në favor të besimit se rënia e *h*-së në të folmen arbëneshe ka filluar qysh në truallin e vjetër. Rrethanat në të cilat u zhvillua e folmja arbëneshe në mjedisin e ri nuk flasin për ekzistimin e mundësisë së ndikimit në drejtim të zhdukjes së tingullit të përmendur (*h*): *elmi* (= *hëlm*); *me anger* (= *hanger*); *e anea* (= *hane*); *an-a* (= *han[e]-a*); *me aruo(-a)* (= *me haŕuo [a]*); *âtër* (= *hatër*); *baet* (= *bahet*); *kra-u* (= *krah-i-u*); *krāni* (= *krahën-i*); *ērd*, *erĭ < ērd* (= *hērd [e]*); *me mī* (= *me mih[e]*); *me še* (= *me šeh*); *i*, *e*, *ōl* (= *i*, *e*, *hōl*). Linguistët albanologë të cilët mbështeten si në fjalë qind për qind të sakta të Fjalorit serbisht-shqip të Kujunxhiçit, (Beograd 1902) e bëjnë kombinime me këta shembuj bien në gabime të mëdha. Ne shumë herë në këtë monografi tonën, edhe në vende të tjera, kemi treguar pasaktësinë e këtij Fjalori. Së këndejmi edhe pohimi i Taljavinit është i pasaktë, kinse, tingulli *h* është zhdukur nga e folmja e shqipe e Gjakovës; khs.: Tagliavini, *Le terre albanesi redenti*, f. 57; ai sjell këta shembuj në të cilët kinse është zhdukur *h*: *ongar*, *prli* (= *hardhia*); *aruša* (= *haruša*); *ekar* (= *hekër*); *düer* (= *dü herë*); *ōn* (= *hanë*); shembujt e përmendur janë nxjerrë nga Fjalori i Kujunxhiçit; *vjeŕa*, *gua*, *krā*, etj. Në të gjitha fjalët e përmendura tingulli *h* në të folmen e Gjakovës dëgjohet qartë. Pa dyshim se Taljavini, duke sjellë kësi shembujsh, përsëri gabimet e Kujunxhiçit. Unë mendoj se Taljavini gabon kur për trajtën "e gabuar"

arūš propozon *haruš*,⁶⁴ seose në të gjitha të folmet shqipe thuhet kryesisht *ari-u*, kurse ndërmjet *ari* dhe *arūš*, gjithsesi ekziston lidhje gjenetike, ndaj tingulli nistor *h* në trajtën *harūš* është pa dyshim sekondar dhe si të këtillë nuk duhet të lidhet me fjalë të cilat *h*, sigurisht, ka rënë.

151. Palatalizmi i velareve në fund të fjalëve njërrokëshe me origjinë italiane është fakt i vitalitetit të veçorive të se folmes arbëneshe, si dhe i gjuhës shqipe në përgjithësi: *fiancé(t)* (nga *fjank-u*, venet. *fianco*=anë, faqe); *tak-u* plur. *tacēt*<*taltacco*. Këtë dukuri e ndeshim të elementet më të vjetra me prejardhje indoevropiane, të greq. Vjetër, latine, sllave, italiane dhe turke: *dušk*, *duške*; *bark-u* *barke*; *fik*, *fić* *furk(e)*, *furket*; *lug*, *luĝe*; *prag*, *praĝe*; *fjank-u*, plur. *fianće*; *hak-u*, plur. *hake*; *uhūke*. Pas mendimit tim këto janë tipare të përbashkëta të gjuhës shqipe, - sot shumë produktive, - ndaj nuk paraqesin kurrfarë risie në arbënishte, e nuk është dashur as të theksohen; khs. Tagliavini, o. c. , f. 32.

152. Përkundër të folmeve geqe, e folmja arbëneshe *ř*-në shqipe krejtësisht e ka humbur (*rr* në grafinë e sotme gyrtare të shqipes letrare), e kjo është më interesante kur dihet se ky tingull në truallin e vjetër është ruajtu i paprekur. Në mbështetje të kësaj, unë mendoj se reduktimi i tingullit të përmendur në *r* të butë është kryer pas shpërnguljes së shqip-tarëve të Krajës në Zarë. Hipoteza e kundërt do të duhej të pohonte se ky tipar inovativ në arbënishte do të ndeshej edhe në fazën e sotme të të folmeve të Krajës. Shkrimtarët e vjetër gegë shumë pak mund të na ndihmojnë në këtë drejtim. Në fjalët e caktuara të shkrimtarët e vjetër njeriu shfaqet për *ř*, a *r*vetëm në mbështetje të gjendjes së gjuhës së sotme, sepse grafia e tyre ka qenë jo stabile dhe e përqëndrueshme. Ja se ç'shkruan poeti Mjeda për tingujt e paqëndrueshëm *ř*, *r* në parathënien e shqyrtimit të veprës së Bogdanit *Cuneus prophetarum*, (f. 4); “është shumë i pasigurt (për Bogdanin) në shkrimin e likuideve *r* dhe *ř*, siç duket, në të folmen e tij nuk janë dalluar”.

Në dialektin toskë shumë shpesh në vend të *ř*-së së fortë dëgjohet *re*

⁶⁴ Tagliavini, *Le terre albanesi redente*, Roma, 1942. f. 57.

butë, në të vërtetë, në vend të *r̄*-së rrotullore te fjalët përkatëse të dialektit gegë, ndeshim shumë shpesh edhe dubletet; *řeze, reze; řevđ, ređ*, plur, *řavđe, ravđe* (qark, rreth, rrokot); *řeg, ređ* (mbret); *řemp, řembi*; geg. řemb, çamur. *řeńe, řeze*, Alb. T; 182 (rrëzë malit), që te gegët dëgjohej *řāz(e); řāz(e)*. Dihet se *r̄* e fortë shqipe është rezultat i asimilimit indoevropian latin ose sllav e italian, grupi *rn*, p.sh.: shq. *baře*, greq. *φερπή*, në kundërshtim të fjalës *bar-i* (bar, ilaç), khs. greq. *Φορός*; iral. *Inferno*, shqip. *fěř; toř*; <ital. *torno, steře* (zi), sllav. *črnъ*, me *s*. ose *st* përballë sllavishtes *č*. Është interesante se edhe *r* nistore e latinishtes, në gjuhën shqipe, ka dhënë *r̄* të fortë; pastaj *ruga* < *řuge*; rallus sipas gjasave *rarus* me disimilim në shqipe *řale; rotha* > *řote; řete* < shqip. *řjete*; khs. Pekmezi, *Grammatik der alb. Sprache*, 39. Siç shihet nga shembujt e përmendur, dialekti toskë ka një numër të konsideruar fjalësh, në të cilët përkundër gegërishtës, në vend të *r** së fortë ndeshet *r* e butë. Asimilimin e *r̄* së fortë në *r* të butë e ndeshim sporadikisht edhe në të folmen e Kosovës *me mar (már) kám már*.

153. Nuk është e parëndësishme të theksojmë tiparin e së folmes arbëneshë dhe të së folmes së Malësisë së Krajës ku në vend të *j*-së së zakonshme, në disa fjalë, ndeshim palatalin *ć*, apo *ķ*; *bīr* (djalë), plural *bī* > *bić-ët* dhe *bir* > *bīk-t*, (Kraja e Madhe, e jo Malësia e Krajës). Për palatalizimin e tingullit *-j* në të folmet e zëna ngoje dëshmojnë edhe këta shembuj: për të folmen e Malësisë së Krajës: *t n(d) reķt; t n (d) reķtat* < *të drejta, të drejtat*.

Se alternimi i përmendur *ĵ* > *ķ* është i vonë, tregojnë shembujt kur nuk e ndeshim këtë dukuri: *me pajtuo-a; pajtim*, lat. *pactare*; nëse në ndonjë nga të folmet e tjera të përmendura geqe ose toske ndeshim në trajtën me *paktuo-ua, -ue*, tosk. *paktuar(e)*, atëherë kjo me siguri është nga fjala *paķe* < lat. *pacem*.

* Çabej, *fonetika historike e shqipes*, Tiranë, 1960, f. 127, ka plotësisht të drejtë kur pohon se kjo *r* e fortë, që nuk është rezultat i procesit të asimilimit të grupit konsonantik *rn*, - duhet trajtuar si tingull të formuar me rrugë ekspresive. Këtë mendim Çabej e shpreh në punimin e tij të rëndësishëm: *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe, Buletin i Universitetit shtetëror të Tiranës*, 1960/4, f. 9-82.

Shembujt e fjalëve arbëneshe *ndret e ndrët, të ndretat*, nuk mund të merren si pohim i alternimit $j > k > ç$, sepse këto paraqesin shkallën e vonshme të trajtave të asimiluara arkaike *i ndrëjt*, etj. lat. *directus*, edhe pse nuk mund të përjashtohet mundësia se trajtave të sotme *ndret e ndrët* të dialektit arbënesh i ka paraprirë trajta *ndrekt, ndrëct*, që shumë lehtë mund të shpjegohen me anë të asimilimit në *ndret*.

154. Kur jemi te tingulli *r*, atëherë nuk do yë ishte e panevojshme të përmendim se ai shpesh kthehet në *j*, siç tregojnë këta shembuj: *bīr*, plur. *bij*, *arbënesh i bukur*, plur. *të bukuj*; për dukurinë në fjalë është i rëndësishëm shemulli: *kora, koje*, koje (korja e bukës); *kore, koje*; *kua, kue*, trajta e shquar. *koi, (kon)* etj., lat. *corium*. (Shpesh ndeshim edhe *gomār, gomāj*). Duket sheshazi se fjala e përmendur *kore, koje* nuk ka kurrfarë lidhjeje me dubletin *kore, ikone* < greq. e re *ēikona* (lezohet *ikona*), e cila plotësisht i takon shtresës më të vjetër të huazimeve të greqishtes së re në gjuhën shqipe, sepse për vjetërsinë e huazimeve tona dëshmon edhe dukuria e rotacizmit, nga njëra anë, dhe rënia e vokalit nistor të patheksuar, nga ana tjetër: *ikona > kore*. Në sllavishte, në epokën më të vonë të historisë së gjuhës shqipe - dukuria e rotacizmit, sipas të gjitha gjasave, nuk është dëshmuar.

155. Nga aspekti i përdorimit të tingullit *s* në arbënishte, Taljavini nxori përfundimin sipas të cilit *s* në të gjitha huazimet e venetishtes u shndërrua në sibilantin *š*, ndërkaq, çdo *s* shqipe, apo e origjinës sllave dha tingullin *s*, të llojit të veçantë, që taljavini e shënoi me shenjën *š*. Lidhur me këtë ne kemi shprehur mendimin tonë më parë. Pa dyshim, Taljavini saktësisht e ka spikatur që sibilanti *s* i të foljeve italiane të Zarës dhe të Dalmacisë, për shkak të natyrës së saj të veçantë, mbeti anash nga ai tingulli “i famshëm” *ś*, për të cilin Taljavini në monografinë e vet angazhohet veçanërisht. Megjithatë, shembujt e tij ku sibilanti *s* kalon në *ś* nuk janë të saktë, sepse trajtat *śoś*, me *śoś*, sigurisht që nuk bëjnë pjesë këtu, sepse tingulli nistor te ta është *š*, e jo *s*, siç i gjejmë te shembujt e Taljavinit (o. c. m 246).

156. Në të folmen e arbëneshëve kë një numër të vogël fjalësh me

bashkëtingëllore epentetike, ndër të cilat shumica janë me origjinë të shqipes, e një numër i vogël sosh me origjinë sllave: *katriga* (= *kariga*, *kariga* - huazim venecian (*kar[i]jega*, *měřšil* (= *mšil*, *mšel*, *mběřšele*) Bađi: Fjalori, 12, 167. Përveç këtyre që përmendëm po sjellim edhe trajtat: *mběšele*, *mbetšel'*, *mbertšel'*, e kjo do të thotë se folja e përmendur përbëhet nga dy pjesë përbërëse: *mbe(r) + tšel'*. Se a është tingulli *r* në prefiks pjesë përbërëse e saj, është vështirë të thuhet, mirëpo paraprirja e prefiksit *mbër* në fjalën *mbertšel'* te shkrimtarët e vjetër gegë të shekullit XVI dëshmohej *r*-ja gjenetike. Prandaj, unë dyshoj se tingulli *rn*ë prefiksën e fjalës *mbe+r+tšel'* është inovacion i vogël, ndaj, gjykuar sipas të gjitha gjasave, likuidi *r* në fjalën *mbetšel'*, ose te *mbertšel*, nuk duhet të jetë epentetike: Po shtojmë edhe trajtat: *benkua*, *benkuo*; lat. < *benedicere*; *dumboko* (sllav. *duboko*). Unë anoj në huazimin e kësaj fjale nga të folmet serbokroate të Dalmacisë në trajtën siç na del ajo në arbënishte, domethënë, me bilabialen epentetike (*m*); khs: Jb. Lib. X, vëll. 1-3, f. 31. Atë që thanë për fjalët e mësipërme, vlen edhe për shprehjen *sampung-ni* (*sapun*) < ital. *sapone*. Nuk përjashtohet mundësia se fjala *sapu-ni*, *sapuo*, *sapuni*, *sampu-ni* në shqipe mund të jetë futur me rrugë të gjuhës së re greke (*εαπον*), ashtu siç mendonte edhe Majeri, E. W., 378 - 389. Supozimi i Mikloshiçit (AF. II, 740) se kjo është fjalë shqipe me prejardhje latine është pa kurrfarë baze, para së gjithash për shkak të *s*-së nistore, e cila në gjuhën shqipe do të zëvendësohej me sibilantin *š*, edhe për shkak të rotacizmit, sepse *n* intervokalike në dialektin toskë, sigurisht do të kalonte në *r*. Në fjalët me epentezë konsonantike bëjnë pjesë edhe *vektua* nga *vetuo*; *vetua*, *vetue*, tosk. *vetetit*; me *mběrsüe* (me *repentetike*).

157. Po sjellim disa nga shembujt e asimilimit, disimilimit dhe rënies së zanoreve ose bashkëtingëlloreve, në fillim dhe në mbarim të fjalës: *me mběl* (këtu *ě* tregon gjysmëvokalin dhe shkurtësinë e tij) < *me mblēd* (ε); *dundofile* < *drandofile*, - që sidoqoftë është huazimi nga greqishtja e re (τρικανταφυλλον). Ja shembujt për disimilimin: *trat* < (*m*) *pkat*, lat. *Peccatum*; *loktōr* nga *roktōr*, *roktari*; *litrat* < *ritrat*, *čarcín* nga *šalcín*; *kolinka* nga *kolivka*; *tue štrūk krat* < *štrūd*; *běrbili*, < *bilbili*. Në të folmen

tonë në fjalë ka një numër të konsideruar shembujsh me metatezë (konsonantike): *proli nga plori: pluer, plori* (umi i parmendës); *me frutulua (-uo)* nga flutura (-uo); *me dril nga dlir(e)* <lat. deli *berare*. Dhe në fund, po sjellim disa shembuj ku ka rënë zanorja, ose bashkëtingëllorja, në fillim, në mes ose në mbarim të fjalës: *drül <drüd nga ndrüd, ndrül* te numërorët prej njëmbëdhjetë deri në nëntëmbëdhjetë është zhdukur tingulli i grupit *mđ*, ose *ml*; *nimet* nga *nimdet*, a *nimlet*; *dümet, tremet, katërmet, pesmet*, etj. Rënie e konsonateve e ndeshim edhe te këto fjalë: *mīāt* nga *mīaft* (e përbërë nga *me+aft*); *mēndaš* nga *mēnfāšš*, lat, *metax*; rënie e tingujve e ndeshim edhe në mënyrën dëshirore te të gjitha foljet me diftong dhe me vokal: *me pā*, dëshirorja është *un(e) pafša, ti pafš, ai pāft(e)*, etj; *me baškua* dëshir. *un(e) baškafša, ti baškofš, ai baškoftē*. E folmja arbëneshë nuk e ka tingullin *fnë* dëshiroren e tipit të këtyre foljeve.

B. Trajtat

a) *Lakimi i emrave*

158. Edhe pse e folmja e arbëneshëve nuk jep shkas që rreth emrave të saj të ndalemi më gjatë, ne për shkak të disa tipareve inovative, do të themi diçka për ta. E folmja arbëneshë, më në fund, ashtu si mbarë shqipja, njih njëjën e paravënë dhe të prapavënë. Nyja e paravënë *i, e, te* për shumës, iu paraprin mbiemrave: *i mīr (e), e bukur, te kēkīn (= kēkij)*, ndërsa nyja e prapavënë për gjininë mashkullore është *i, u*, për femëroren *a*. Prejardhja e tyre deri diku është vërtetuar saktësisht.

Për njëjën *i* kryesisht është pranuar etimologjia e Majerit, - nga indoevrop.* *si* (lat. Is-dem) ose *ei* (në lat. *ae* nga *eia*), ndërsa nyja e dytë e prapavënë *u*, në *štog-u, zog-u*, zëvendësimi i shqipes nga *ovos+* indoevropiane, në kuptimin e përemrit dëftor – *ky*, khs. Meyer. Alb. Studien, III, f. 40 dhe 79, pastaj Brugmann, *Grdr*, 2, bot. I, f. 94 dhe 277; Skok, *Arhiv za arbanasku starinu*, III, 168; Bariq, *Hymje në historinë e gjuhës shqipe*, f. 40.

Që shpjegimi ynë lidhur me mbaresat rastore të jetë sa më i qartë, po japim këtu më poshtë paradigmen e tyre:

Trajta e pashquar e emrave Trajta e shquar e emrave

	<i>Njëjës</i>	<i>Shumës</i>	<i>Njëjës</i>	<i>Shumës</i>
nom.	djāl	djelm	djáli	djëlmët
gen.	i, e djālit	i djelmve	i djālit	i djëlmve
dat.	djālit	djëlmve	djālit	djëlmve
akuz.	djāl	djëlm	djālin	djëlmët
vok.	djāl	djëlm	-	djëlmët
abl.	peḡ nī djālit	djëlmëš	djālit	djëlmëš

Lakimi i emrave të gjinisë femërore

vājz-a

nom. vok.	vājz	vājza	vājza	vājzat
gen. dat.	i vājzës	i vājzave	i vājzës	i vājzave
akuz.	vājz	vājza	vājzën	vājzat
alb.	vājze	vājzaš	vājze	vājzaš

159. Para së gjithash, në pasqyrën e mësipërme bie në sy se te lakimi emri nuk ka dy trajta: të pashquara dhe të shquarën, ashtu siç paraqiten në një numër të mirë të folmesh geqe, ose, të themi më saktësisht, gjinorja dhe dhanorja e trajtës së shquar në të dy numrat (njëjës e shumës) pjesërisht janë njëjtësuar me rasat përkatëse të trajtës së shquar. Këtë identifikim e hasim edhe te të folmet e Krajës, Shkodrës, madje edhe te disa të folme të Malësisël khs.: Cimochoëski, *Le Dialecte de Dushmani*, f. 37-38. Trajta e pashquar dhe ajo e shquar janë ruajtur te emërorja dhe kallëzorja në të dy numrat. Megjithatë, arbënishtja dallohet në diçka nga shkodranishtja, të folmet e Malësisë dhe të folmet e Krajës, në realitet, ajo në ablativin njëjës të femërorëve ka *-e*, ndërsa kjo mbaresë në të folmet e përmendura është *-et*. Për të folmet e Malësisë krahaso Cimochoëski-n, o. c., f. 37; për shkodranishten le të krahasoher Jungg-u, *Elementi*

grammaticali della lingua albanese, Scutari d'Albania, 1881, f. 10, por vetëm për ablativ njëjës të trajtës së shquar; për të folmet e Krajës le të krahasohet me shpjegimin tonë të mëparmë, në këtë monografi, paragrafi 106. 107. Dialekti toskë, si edhe gegërishtja jugore, ruajnë që të dyja lakimet e emrit (me të cilat pikë më pikë përputhet e folmja shqipe e Jabllanicës së Epërme, në Serbi); khs.: Weigand, *Albanesische Grammatik*, f. 28, 82; për të folmen e Çamërisë, H. Pedersen, *Alb. Texte mit Glossar*, f. 9. Se zhdukja e trajtës së pashquar në lakimin e emrave të së folmes arbëneshe, të Shkodrës dhe të folmet e Malësisë edhe dukuri e vonshme, shihet qartë nga gjuha e shkrimtarëve të vjetër gegë të shekujve XVI - XVIII: Buzuku, Bogdani, *Doncilium Albanum*, 1703. Te Buzuku ndeshim: *u of [ruo një] bujari se kütetes s'atdeu, kondra kettii, ordeni; E şpune djeri maje náj mali; tue klene dale në şpirt en njëj*; khs.: *Hylli i Dritës*, VI (1930), I, 44; te Bogdani (nga parathënia e *Cuneus prophetatum*, 1930, f. 37): *Ma mire me kjàne ní lua biri i ní lëpuru; se me kjàne ní lëpur biri i ní luani. Ma mire më kjàne ní i kerštëne biri i ní turku, se me kjàne ní türk biri i ní te kerštëni, ban véperat e ní te vertëti, te kerštëni* (o. c., 37); *pat ardone asi moti; ki řodne asi móti*; (o. c. 35, 34); *kü émen Jezu řjed prej asi émenit*, (36) ku në vend të trajtës së pashquar *emeni* kemi edhe mbaresën e trajtës së shquar *-t*. Është interesante të theksojmë se ablativi të shkrimtarët e përmendur saktësisht përputhet me ablativin e së folmes arbëneshe, në të vërtetë, si të parët ashtu edhe të mbaresat e ablativit të emrave të gjinisë femërore në njëjës dëgjohet *e*, për shumës *š(šit)*; mbaresa e sotme rasore e emrave të gjinisë femërore në ablativ është *-s*, për plur. *-ve +t*.

160. E folmja arbëneshe plotësisht përputhet me gjuhën e shkrimtarëve gegë të shekujve XVI - XVIII në çështjen e njëjës së prapavënë për atë kategori emrash të cilët në trajtën e pashquar sosin me *k*, *g* të përbashkët; në të vërtetë, emrat që përfundojnë me velarin *k*, *g*, në trajtën e shquar, ashtu si në dialektin toskë, marrin njëjën *-u*: për shembull, *plak-u*, *furk-u*, *štog-u*, *rodak-u*; *unuk-u*; *zverk-u*; *mik-u*; *šigoe cilikokun*. Në kategorinë e emrave të lartpërmendur bëjnë pjesë edhe emrat me vokal të gjatë fundor, *ā*, *ē*, *ī*, *sī*, *šiu*; *đi*, *điu*, *barī*, *bariu*, *kā*, *kau*; *vlā* (*vlā*) - *vlau*, dhe

vlaĳ; *brē*, *breu* (it. Abete); mirëpo, e folmja arbëneshe, bashkë me gjuhën e klasikëve gegë të shekujve XVI - XVIII dhe një pjesë të mirë të të folmeve të sotme gege, nuk përputhet me dialektin toskë dhe me të folmen e gegërishtes jugore në çështjen e njëjës së kategorisë së atyre emrave, të cilët në trajtën e pashquar sosin me spirantin *h*. Derisa tek emrat e parë është *-i* te të dytët është *-u*. Buzuku përdor: *krah-krahi* (shembulli i marrë nga *Mann-i: Fjalori shqip-anglisht*); Pekmezi, *Grammatik der alb. Sprache: krah-u* dhe *krah-i*; Cimochoëski, *Le Dialecte de Dushmani: ah-i, krah-i; sabah-i, ðünah-i*; f. 30. 31. Për paralelen toske khs. Dozonin *krah-u* (fjalori, 36): *alah-u* (f. 2); Pedersen, *Alb T.*, 142: *i preu krahun; tund krahunë*. E folmja arbëneshe këtu nashkohet me të folmet gege, te të cilat emrat me *h* në trajtën e pashquar, marrin *i*, e jo *u*, siç e pamë në toskërishte; në arbënishte deshëm *ple-i*; por kemi edhe *kra-u*, mirëpo kjo me siguri është inovacion i vonshëm, e që mund të shpjegohet shumë lehtë, duke pasur parasysh se me rënien e spirantit *h* te fjala *krā*, në ndërgjegjen gjuhësore të arbëneshëve të Zarës është identifikuar me emrat e kategorisë që sosin me vokal të gjatë, në vokalin *ā*, për shembull, - me emrat të cilët, siç është e njohur, trajtën e shquar e bëjnë analog me *kā-u*, me njëjën e prapavënë *-u*, pra *kra-u*. Për t'u bindur se ky është tipar i vonshëm i së folmes arbëneshe shihet më së miri nga e folmja e Malësisë së Krajës, truall i arbëneshëve të Zarës, ku kryesisht thuhet: *krah-i, ðünah-i; ah-i, Vlah-i*, etj.

161. Arbënishtja, siç duket nga paradigma, nuk ka ruajtur mbaresën rasore të lokativit. Se ky ka ekzistuar në të gjitha të folmet gege, ky është fakt, që dëshmohet për mrekulli nga veprat e shkrimtarëve të vjetër gegë. Edhe pse mbaresa e përmendur rasore, siç theksuam më lart, është zhdukur nga e folmja arbëneshe dhe të folmet e Krajës, megjithatë duhet thënë diçka për të, meqë në disa të folme gege, haset sporadikisht (për elbaskanishten khs.: Eëigand, *Albanesishe Grammatik*, f. 82). Do të vëmë në pah menjëherë se lokativi, siç shihet nga dokumentet gjuhësore, deri në shekullin XVIII ishte në përdorim edhe në të folmet e Malësisë. Mbaresa vendore në gjuhën e dokumenteve të vjetra kaloi nëpër tri shkallë të zhvillimit të saj. Emrat e gjinisë mashkullore njëjës kishin mbaresat *-it, -ut,*

ndërsa emrat e gjinisë femërore *-t*, emrat e gjinisë mashkullore në trajtën e pashquar kishin *-š* në trajtën e shquar *-šit*. Duhet pasur parasysh se lokativit i paraprinte njëra nga këto prepozicione: *nde*, *mbe*, *mbi*, *nden*, *ndeper*, *per*, *me*,⁶⁵ pa këto parafjalë lokativi nuk paraqitet kurrë: *ate*, *u rae ende kuat enbe kielit enbas keso fjal'eš*; *ma ata kujtonine ai se fl'itt per gumet*; *ki pate me arđun ende šekulit*; *vote e griši Merie ende kšil*, 297; *kujtuone se ajo duoi me vote ende vořt*, 297; *enbeřini enbe vořt*, 298 (nga H. Dritës (VI/V): *fil per enbii pust*, HD, VI (X), 569; *klofte volundetia jote si enbe kilt*, *aštu edu ede enbe deet*, VI, HD, VI (XII), 671; *beson ende špiritit*, VI (XII) 673. Shembujt e mësipërm janë të shkrimtarit më të vjetër shqiptar - Buzukut (1555). E tani disa shembuj nga Bogdani (1685): *nde lekuret*, 36; *me perlüeme špaten nde ğakt*; *me ditune si nde teřt te nates*, 37; *kišine vume soĝet permbi bješket*, 38, *mā teper nde dijjet*, 38; *permbi nı dore gamil'eš* 38; *Sa po silej ndeper dēt*, 39; *ndjere mbe de*, 39; *nde kišet*, 40; *nde kiše*, 40; *ĝive sa mbe sekulit*, 40 Shembuj janë marrë nga ekstrakti i veprës *Cuneus prophetarum* (1685), në botimin e Ndre Mjedës, Shkodër, 1939. Këta tregojnë qartë se lokativi në gjuhën shqipe kaloi nëpër tri faza të zhvillimit.⁶⁶ Faza e parë e lokativit të emrave të gjinisë mashkullore e femërore plotësisht përputhet me ablativin e tyre; por te faza e dytë dhe e tretë nuk ka më përputhshmëri, apo pajtim të mbaresave rasore ndërmjet akuzativit e lokativit.

Mbaresa shqipe për lokativin njëjës dhe shumës të gjinisë mashkullore dhe femërore është *-t*, sipas Joklit dhe H. Bariqit, mendohet nga një *dhi** indoevropiane prej së cilës pas rënies së *i*-së fundore, *d* e zëshme duke u gjetur drejtpërdrejt në fund të fjalës, u shurdhua në *-t*. Me këtë, sigurisht, lidhet edhe sufiksi lokativ *-j* (= *dž*) i armenishtes që rrjedh nga indoevrop. **dhi*; krahas. armenisht *telvoj* nga *teľi*, *teleae*, që pikërisht i përgjigjet sufiksi i shqipes *-zi*, në tosk. *Prápazi*; Jokl, *Studien*, 103; H. Bariq, *Studien*, I, 120. Gjithsesi tjetër prejardhje ka mbarsa e shumësit *-te* shqipes, nga indoevrop. Që i detyrohet* *tod* > *te*.

⁶⁵ G. Meyer, *Kurzgefasste albanesische Grammatik*, 13.

⁶⁶ Për përhapjen e tij shih *Buletin për shkencat shoqërore*, 1955/4, 113-114.

162. Diçka rreth prejardhjes së mbaresave emërore. Mbaresa *a* tek emrat e gjinisë femërore (*pune*, ose *puna*) është përftuar nga bashkëshkrimi e vokaleve $\varepsilon + e$, për këtë pajtohen të gjithë studiuesit e gjuhës shqipe, për to ka argumente të plota, e njëra prej tyre është: përemri proklitik $me + e$ jep *ma: te + e = ta*; në analogji me këto edhe $pune + e = puna$; khs.; *Arhiv za arbanasku starinu*, lib. III, 171. Mirëpo me praninë e mbaresës *e* në gjenitiv dhe dativ në lakimin e emrave të pashquar në gjuhën shqipe: *pune*, shtrohet është çështja tjetër: a thua njëra dhe mbaresa tjetër (*a, e*) u krijuan me të njëjtën rrugë, do të thotë me kontraktimin e vokaleve $\varepsilon + e$,⁶⁷ apo $e + e^2$. Sipas Skokut (*Arhiv za arbanasku starinu*, 171), mbaresa *e* për gjenitiv - dativ për emrat e pashquar u krijua me analogjinë sipas trajtave *nuseje, beje* nga *nuse + e, bē + e* (sonati *j* u përdor me qëllim të evitimit të hiatusit). Sipas Bariqit, (*Arhiv za arbanasku starinu*, III, 281; nga i njëjti autor, *Hymje në historin e gjuhës shqipe*, f. 42), trajtat e gjenitivi dhe dativit të emrave të gjinisë mashkullore të pashquar u përfatuan nga dativi indoevropian *ōj, ōu*, në rrokjen e patheksuar, sepse me ruajtjen e *j, u* me karakter konsonantik para vokaleve të fjalëve vijuese nga *ōj, ōu* më parë u përftua *aj, au*, e prej nga rrodhën *i, ū* të rregullta. Pastaj, duke u gjetur në fund të fjalës, me anë të reduktimit u reflektua *i, u* (gjithsesi, para se të kalonte *ū* e gjatë në *ū*). Mbaresa *e* e gjinore dhe e dhanore, e emrave të gjinisë femërore të pashquar u përftua nga *ias* indoevropiane (Bariq Hymje, 42). Edhe pse për *ias* indoevropiane* ndeshim zëvendësimin edhe në armenishte edhe në irlandishte (sepse *ami* është trajtë për gjenitivin nga *am, ama-v*, nga indoevropianishtja **samiās* në irland. *tuathe* prej **theutiās*), është shumë e besueshme se edhe prejardhja e *e* gjenitiv - dativit të shqipes te emrat e gjinisë femërore të pashquar duhet kërkuar në trajtën e përmendur indoevropiane **ias*. Mbaresa rasore *-ve* për gjinoren e dhanoren pa kurrfarë vështirësie mund të nxirret nga mbaresa **ōm* indoevropiane, ku konsonanti fundor, sipas rregullave, ka rënë, ndërsa *ō* e gjatë ka dhënë *e*, sikurse te shqipja *ne* nga **nōs*; *v* këtu është ndërfitur për t'i ikur hiatusit, sikurse te fjala *veš* nga indoevrop. **ōs*. Edhe mbaresa ablativ

⁶⁷ Krahaso, Pedersen, *Alb. T.*, f. 6.

s, ka prejardhje burimore nga indoevropianishtja, nga ablativi* indoevropian *su* (khs. lokativi i gjuhëve sllave tëxū, indoevrop. *tesu*); khs. H. Bariq, *Hymje*, 42. Mirëpo, me atë që Pekmezi pohon: (*Grammatik der alb. Sprache*, f. 99) “*In Gegischen äird für den unbest, Gen, auch der Abl. Gebraucht*”, unë nuk mund të pajtohem. Për mua mbetet e panjohur që në të folmet shqipe - ose në ndonjërën prej tyre - e për shumësin e gjenitivit të emrave të pashquar të përdoret sufiksi *š*. Edhe pas kontrollimit të dokumenteve të vjetëra gjuhësore të shqipes unë nuk jam bindur për një gjë të tillë. Sa i përket prejardhjes së mbaresës së akuzativit njëjës - *nε*, unë mendoj se shpjegimi i Pedersenit është më tërheqës nga **om*, **tom* > **am*, *tām*, (KZ. XXXVI f. 310) se sa supozoi mi i Skokut, (nga **(o) nām* > *nε*; khs.; *Arhiv za arbansku starinu*, f. 174), që i del vështirësia e pakalueshme fonetike e shpjegimit të mungesës së rotacizmit.

Tani, meqë e kemi shqyrtuar çështjen e prejardhjes së njëjës dhe mbaresës rasore në gjuhën shqipe, besoj se nuk do të ishte e tepërt nëse japim paradigmen e lakimit të nujës në dialektin arbënesh.

b) *Trajtat e njëjës së pashquar*

	<i>Njëjës</i>	<i>Shumës</i>	
		gj. mashk.	gj. femër.
nom. i	e	t(<*tē)	t(<*tε)
gen.	t(<*tε)	t(<*tε)	t(<*tε)
dat.	t(<*tε)	t(<*tē)	t(<*tε)
akuz.	t(<*tε)	t(<*tē)	t(<*tε)
abl.	t(<*tε)	t(<*tē)	t(<*tε)

Vërejtje: në arbënishte nuk e ndeshim trajtën e shquar të njëjës, siç e ndeshim te të folmet e tjera të gegërishtes dhe toskërishtes; p. sh. : *E rîë ti Makun të Lucit? Pse s ga ova mundët të mija i ujt të jetës nuk ma ndalin zjarmin të zembrës*. Njjet e theksuara në të folme të tjera të gjithës shqipe shquptohen kryesisht *e*. Në të vërtetë, dallimi qëndron në atë se nyja e prapavënë mbiemërore, që pason pas nominativit, akuzativit shumë dhe akuzativit njëjës tek emrat e caktuar në arbënishte nuk shquptohen, siç duhet, *e*, por *tē* (tε), e se ky zëvendësim i njëjës *tε* të shumësit me njëjës *e*

është i lashtë, tregojnë qartë shembujt e një substitucioni të këtillë që ndeshim të gjuha e Buzukut. E tani, të shohim në cilat raste ndeshet nyja në të folmen arbëneshe dhe se a gjendet në të gjitha ato raste që e ndeshim edhe në të folmet e tjera të gjuhës shqipe. Në arbënishte e hasim në këto raste: 1) Si nyjë e paravënë në një numër të kufizuar që shprehin raporte familjare, siç janë *i jati* ose *i ati*; *e ama*, *i biri*. Shprehjet e tjera të farefisnisë familjare në të folmen arbëneshe nuk e knaë ruajtur nyjën e paravënë. Një pjesë e mirë e mbiemrave kanë yjën e përparme *i*, *e*, *të*; *i mīr*; *e mīr*; *i*, *e bukur*, *të bukuī*, *të mīr*, etj.; them, një pjesë e mirë e mbiemrave, sepse siç është e njohur, pjesës tjetër të mbiemrave nuk i paraprin nyja: *ćeni ěst besnik*, në të cilët e folmja arbëneshe ka veçori të posaçme. Emrave të gjinisë asnjansë gjithashtu u paraprin, nyja e përparme *i*, *e*, *të*: *të derduma-t*, *te derduma-t* (jashtëqitje, shkuarje e barkut).

163. Në dialektin tonë ka raste të veçanta të ndërrimit të gjinisë së emrit, siç është për shembull, *fēmi-u*. Në të gjitha të folmet e tjera, fjala e përmendur, dëgjohet *f(e)mī* ose *femije-a*, çamërishtja *femī'a*, nga lat. *familia*. Të vetmin përjashtim, siç shihet, e bën arbënishtja *fēmi-u*, në realitet edhe në të folmen e Kosovës thuher *kū ōmi*-traj-shq. *ōmia*, megjithatë mbaresa femërore është ruajtur.

	<i>Fēmi-u</i>		<i>Zotni-u</i>	
nom.	fēmi	fēmīt	zotnī	zotnīt
gen. i, e	fēmiut	fēmive	i, e zotniut	i, e zotnive
dat.	fēmiut	fēmive	zotniut	zotnive
akuz.	fēmīn (fēmīun)	fēmīt	zotnīt	zotnīt
ablat. peḡ	fēmiut	fēmiš	zotniut	zotniš

Emrat e gjinisë mashkullore me vokal të gjatë fundor *ā*, *ī*, *ē*, në trajtën e shquar zakonisht marrin mbaresën *u*, mirëpo në të folmen arbëneshe ka përjashtime: *ka-u*; *škjau* (pjesëtar i besimit ortodoks, i krishterë); por *vō* (nga *vā*), *vani*; kjo trajtë pikërisht përputhet me trajtën e Krajës *vā*, *va ni*. Krahaso - Cimochofski; *vā*, *vau*, f. 8; Veigand; *va-vau*. f. 96; për toskërishte khs.: Dozon, f. 96 (glosari): *va*, *vaya*, – “gué”. “espèce de barque”; N. Frashëri: *va-vahu*; Mann, Fjalori, etj. Nga të folmet gege, bëjnë

përjashtim vetëm arbënishtja dhe të folmet e Krajës në mbaresën e trajtës së shquar të fjalës së përmendur, do të thotë nuk ka *-u*, por - *ni*. Në grupin e emrave me zanore fundore të gjatë duhet përfshirë edhe emri - *dë*, konkretisht në këtë të folme *ĭë-ni*, krajançe. *ĭë-ni* (dheu, toka) mbaresa e së cilës - *ni* nuk përputhet me asnjë të folme geqe, e as të folmet toske, te të cilat paraqitet mbaresa *-u*: *dë-u*, plur. *dëna*, tosk, *dëra*. Vlen të përmendim edhe emrin *mi-u*, Kraja, *mi-ni*; Ēeigand, ka (55): *mi-u*; Cimochoëski, 8, 51; *mi-ni*; Kosovë *mi-ni*; Dozoni, 52: *mi-u*. Trajta e së folmes arbëneshe përputhet plotësisht me format e toskërishtes dhe të gegërishtes jugore; trajtat e tjera të të folmeve geqe, si dhe të së folmes së truallit të vjetër, ndërmjet bazës dhe nyjës vënë *n* epentetike, e cila me siguri daton vonë.

c) *Mbi shumësin e disa emrave të gjinisë mashkullore*

164. Një numër emrash i gjinisë mashkullore, të cilët në nominativ shymës në të folme të tjera geqe përfundojnë zakonisht me *e* - në të folmen arbëneshe e ndërpusin një *n* epentetike; për shembull: *kó pú šum voríne*; *më krúćne*; e *ja gaəon drúnetl* e *ja gaəon tatëš doifor đfar drećneš*; *kan đirāt për jēt përmí ujneš, detneš, bređeš e malneš*; *përmí diaənnē disfār*; *đifār zañeš*; po përzien; šetne nga *šōt-i=shat*). Trajtat e përmendura të shumësit nuk ndeshim në asnjë të folme geqe ose toske, prandaj këto inovacione që u krijuan në arbënishte, sigurisht janë pas ardhjes së përfaqësuesve të tyre në truallin e ri.

165. Lakimi i emrave në arbënishte dallohet, kryesisht, për tendencën e largimit nga trajtat e sotme “të rregullta” të të folmeve të tjera geqe, - tendencë kjo, që më në fund, mbaron me varfërimin e trajtave, duke e degjeneruar kështu edhe vetë gjuhën. Këtë e dëshmojnë këta shembuj: *me urāt në dōra* (në vend të *ne duer*). Shumësi nga *šoc* në arbënishte sot dëgjohej: *šocēt* në vend të *šokēt*, *šoket*. Se kjo trajtë është inovative në të folmen arbëneshe, dëshmon mungesa e saj në të folme të tjera shqipe dhe në gjuhën e shkrimtarëve të vjetër shqiptarë. Ja edhe disa shembuj: *i kó čuo* (-*čuo dōrat*; *ćili dērat tāt i dašum* (në vend të *ćili dūert*, *tāt i dašum*); *ńert po štypin me Ÿ(s)upra të gjjata*. Shembujt e përmendur tregojnë, nga ana tjetër, se kjo tendencë në arbënishte synon rrafshimin e dallimeve të

trajtave eventuale ndërmjet njëjësit dhe shumësit të emrave, në të vërtetë ekziston aspirata që të evitohen trajtat e parregullta të shumësit të emrave, gjë që tregojnë për mrekulli shembujt e mësipërm: *dër*; plur. *dëra-t*; *dōr-dōrat*; *šocēt* nga *šoc*, e jo *düer*, *duer*, šokēt, siç dëgjohen përndryshe në mbarë gjuhën shqipe.

166. Ajo që te mbiemrat e së folmes arbënishe bi në sy që në fillim, është prania kryesisht e atij grupi mbiemrash të cilëve u paraprin nyja e paravënë dhe mungesa e plotë e mbiemrave pa nyjë të përparme, - rrethanat dëshmojnë se grupi i dytë i mbiemrave daton vonë në gjuhën shqipe. Mungesa e mbiemrave pa nyjën e përparme në gjuhën e dokumenteve të para në gjuhën shqipe në përgjithësi, e veçanërisht në të folmen arbëneshë, - është e vonë. Prej 300 faqesh tekst, që kam kontrolluar në arbënishte, nuk kam hasur asnjëherë në mbiemra pa nyje të përparme; i vetmi shembull i shënuar është *fīsnik*, që në arbënishte depërtoi, gjithsesi me anë të shtypit. Po sjellim disa shembuj të përdorimit të nyjës së përparme në të folmen e arbënesheve: *e i u dišronte ulën të mbār, pë vjēteš të paršme; por đisi u blente dić të bukur për bōrka jo të mloja; si jēta e nderšme; kō kēn nī djal i rī; pē cimatorje të plāk; ndaj fulete të plāk; i ziu fēmil kam kēn fort i unēt; kuš e nziu nērin të ndrēt; o dieli jem i āmbēl; po flet fjal të randa; mos cit fjal të tānda; van tū nērit të boum; nērit të ūrt; si pļēpuni i vōgēl nje ti e kontent jemi e ne: kēštu m je e kanda; brōmbēn të mīr; ju tāt kō kēn i ūrt; mendimja to e špēit; e gūa e mbret; e po ju dišroj të mīr dārk; i kanda djal; e un jam e ūnēt; zyne me kjo si vjēta e zēz; djelmēt, të mleń; i vōgēl, pl. të vōđi; i žūt; i atīđ (i fortë); i fōrt; i klańēt (i çalë); i ćorēt; i šūrlēt; i tatkāten; ngita si i mōr; jedva i đol (mezi i gjallë); i blūtēt; i mārēt, i, e ćaro; i ćilēt; i ćor, e ćore; Kraja. *kōr* - pa nyjë të përparme; *i desno; i de* (i dehur); *i divlo* (i egër); *i, e drīl* (i pastër); *i, e golo* (lakuriq), *i, e gūbēt; i, e gjāt; i, e đušto* (i drejtë, i rregullt); *anter ja kō mār dōrēn të šolākēt* (dorën e majtë). Shembujt e përmendur tregojnë qartë për vetëdijen e fortë gjuhësore të pjesëtarëve arbëneshë, që i shtyn ata që edhe nga trajtat e huazuara të mbiemrave në tërësi pa nyjë, të formojnë mbiemra të cilëve u paraprijnë nyjat e përparme *i, e, t* - edhe pas ven-*

dosjes së tyre në truallin e ri; khs. për këtë shembujt e përmendur të mbiemrave me prejardhje sllave.

Për çështjen tonë në fjalë është me rëndësi trajta arbëneshe e huazuar nga turqishtja *i ćorĕt* (i verbër), e cila, nga njëra anë, dallohet nga nyja e përparme, e nga ana tjetër, nga sufiksi mbiemëror *tĕ-t(e)*. Këto cilësi u mungojnë trajtave të të folmeve të tjera shqipe; Kraja *ķorĕ*; Gordignano *ćor*; për të folmen e Malësisë së trevës së Dukagjinit, Cimochoëski, 81; *ćorĕ* (*ćorĕ*); për toskërishte Meyer, Eω, 228: *ķor*. Nëse do të dëshironim të përcaktojmë kronologjinë e fjalë së huazuar arbëneshe, unë duke u mbështetur në trajtat shqipe, do të merrja kohën pas ardhjes së stërgjyshërve arbëneshtë në rrethinën e Zarës, e kjo do të thotë se fjala jonë është huazuar nga të folmet serbokroate të prapalagjes së Zarës; *ćorav*, *ćorava*, *ćoravo*. E këtë pikërisht e dëshmon edhe trajta *ķorĕ* e Krajës, e cila si duket sikur të ishte huazuar në të njëjtën kohë kur u huazua edhe *i ćorĕt*, do të thotë në kohën, para shpërnguljes së stërgjyshërve të arbëneshtëve në rrethinën e Zarës, nga forma do të duhej të ishte identike me trajtën e sotme arbëneshe (*i ćorĕt*). Njeriu mahnitet kur sheh se me çfarë ndjenje të flaktë e dashuri ndaj gjuhës së vet amtare - arbëneshtët i modifikojnë trajtat mbiemërore të sllavishtes dhe huazimet e tjera, duke ua nënshtruar ligjeve gjuhësore të së folmes së vet.

Pozita e mbiemrave në të folmen arbëneshe, si dhe raportet e tyre me emrat, nuk i jep askujt shkas që për ta të zhvillohet këtu diskutim. Mbiemri qëndror si përpara ashtu edhe pas emrave, mirëpo vendi i tij është kryesisht pas emrave. Nëse ai është pas emrit, atëherë lakohet vetëm emri, e kur mbiemri është para emrit, atëherë lakohet vetëm ai (mbiemri); këtë do të na e tregojë qartë paradigma e lakimit - emër+mbiemër dhe mbiemër+emër.

bur i mal (= *i madh*)

trajta e pashquar	trajta e shquar
(<i>njĕjĕs</i>)	(<i>njĕjĕs</i>)
Nom. bŭr i mal	bŭri i māl
Gen. i, e, bŭrit të māl	bŭrit të māl

Dat.	bùrit të māl	bùrit të māl
Akuz.	būr të māl	bùrin të māl
Abl.	búrit të māl	bùrit të māl
	<i>búra të mleń</i>	<i>bùrit të mleń</i>
N.	búra të mleń	bùrat të mleń
G.	bùrave të mleń	bùrave të mleń
D.	bùrave të mleń	bùrave të mleń
Ak.	búra të mleń	bùrat të mleń
Ab.	búraš të mleń	búraš të mleń
	e bukura vājz	
	(<i>njējēs</i>)	(<i>shumēs</i>)
N. e	bukura vājz	të bukura (t) vajza (t)
G. i, e të,	bukurēs vājz	të bukurave vajza
D. të	bukurēs vājz	të bukurave vajza
A. të	bukura vājz (tr. shq. vājz)	të bukurën të bukurat vajza (t)
Ab. pë-ńi	të bukure (?) vājz	të bukuraš vajza
	(thuhet - pë ńi vājz të bukur)	

d) *Përemrat*

167. Përemrat, veçanërusgt pronorë (posesivë) paraqesin kapitullin më të ndërlikuar të gramatikës shqipe.⁶⁸ Pedersenin në kohën e vet disa herë iu kthye këtyre, pra, shumë gjëra ndriçoi, mirëpo megjithëkëtë ana historike e tyre ende nuk është sqaruar sa duhet.⁶⁹ Për përdorimin praktik të përemrave pronorë shkruan poeti Mjeda dhe Selman Riza, i pari në studimin *Vrejtje permí përemna pronës të gjuhës shqype*, Shkodër, 1934, ndërsa i dyti në *Diftorën e shqipes dhe historiat i tyre*, Prishtinë, 1953; Përemrat pronorë, Buletini, 1956.

Të shohim se ç'i karakterizon përemrat në të folmen arbëneshe. Siç do të shohim nga paradigma, ata në arbënishte janë thjeshtyar mjaft,

⁶⁸ Cimochowski, *Le Dialecte de Dushmani*, f. 84.

⁶⁹ Pedersen, *Festskrift til Vil. Thomsen*, 248 - 252; nga i njëjti autor: *Ces pronoms démonstratifs de l'ancien arménien*. 1905, KZ XXXVI.

kështu që përemri pronorë të cilit i paraprin emri është reduktuar në një trajtë të vetme, në ç'pikë e folmja arbëneshë me të folmet e tjera të gjuhës shqipe kurrsesi nuk përputhet, sepse tek ajo për çdo rasë të emrit, kryesisht, ekziston edhe trajta e përemrit.

Përemrat vetorë

(paradigma)

Njëjës

Veta e parë - unë enk.	Veta e dytë - ti enkl.
N. unë	ti
G. -	-
D. mua (-muo) m(e) ÷ e = ma	tü t(e) ÷ e = ta
Ak. mua (-muo) m(e)	tü t(e)
Ab. mee	tee -

Shumës

Veta e parë <i>ne</i>	Veta e dytë <i>ju</i>
N. në	jÿ
G. -	-
D. nëve nă	jÿve jÿ
Ak. në (nëve) nă	jÿ (jÿve) jÿ
Ab. nëš	juš

Përemri vetor i vetës së tretë

Njëjës

Shumës

N. ai ⁷⁰	ajo	ată, atò
G. i (a)tÿt	i asòj	atÿne
D. (a)tÿt i + e = ia	i asòj i + e + ja	atÿne (ju)
Ak.ăt e	ăt e	ata ato (i)
Ab. (a) sÿ	(a) sòje	asiš asoš

⁷⁰ Përemri vetor i vetës së tretë në te dy numrat njëkohësisht mund të jetë edhe përemër dëftor.

168. Dativi dhe akuzativi i përemrave të përmendur, siç shihet nga paradigma, përveç trajtës së plotë, kanë edhe trajtën përemërore jo të plotë, ndërkaq, dativi në vetën e parë dhe vetën e dytë të njëjësit të përemrit vetor *me + e* por *ma, ta*; po kështu edhe dativi dhe akuzativi veta e parë dhe veta e dytë shumë - *na, na, ju, ju*, kjo natyrisht ndodh edhe me vetën e tretë shumë në dativ dhe akuzativ të përemrave vetorë: *i + e = ja* (për gjininë mashkullore *aj* dhe për gjininë femërore *ajo*); akuzativi njëjës është *e* (për gjininë mashkullore dhe femërore; për shumë *ju* - dativ dhe akuzativ *i*. Po sjellim disa shembuj përdorimi të trajtave të bashkëshkrira: *a ma bën ni átër; mos ma përmend daktórin ión; Vanon teme ma mori; S ma kó dāš; përse ta ndíti?; po ta ndüej (djasin) - (po të fali); kurkuj nuk ja jap bīn; kur ja lézi tre kater frakaleša; da ko kēn diku tjetër, ja kiñneš süe korizin; gzimin ja ké pru; ndrjen ja kán špū f(e) miut t(e) vët düet me ja ndüe; ja dā ní paket; kuj ja ke dān át djas; an ja štiu nër sjetula; ja kó šguo e güen; e façen na kán nai; fisin na kan mborua; në diž grocje po na çet; e ne dñuc na kan me sīr neve na düet me punua; ka čua me na sān se vinkan; un ju kam dān fjalën; vota me ju sān; e ne ju gazōjm; tata e nana ju kan me ndüe; nuk ju ndüej. Trajta jo e plotë përemërore *ju* përdoret në vend të *u*.*

Përemrat dëftorë

169. Në përemra dëftorë zakonisht bëjnë pjesë *aj* (që njëkohësisht është edhe përemër vetor); *kü, kjo, k(e) ta, k(e)to*. Lakimin e përemrave *aj, ajo, ata, ato*. Kemi pasur rast ta shohim kur kemi bërë fjalë për përemrat vetorë. Tani do të merremi me lakimin e përemrave të tjerë dëftorë, si dhe me raportin e tyre ndaj emrave.

<i>Njëjës</i>		<i>Shumës</i>	
	mashk. fem.	mashk. fem.	
N. kü	kjo	këta	këto
G. këtët	kësōj	këtüne	këtüne
D. këtët	kësōj	këtüne	këtüne
A. këtë	kët	këta	këto
Ab. kəsi	këso	kësiš	kësoš

N. kü	djāl	këjo vājz	këta búra(t)	këto vājza (t)
G. këtët	djālit	kësōj vājzēs	këtüne burave	këtüne-ve
D. këtët	djālit	kësōj vājzēs	këtüne burave	këtüne-ve
Ak. këtë	djāl	(kësōj vajzeše)	(këtüne burave)	(këtüne-ve)
Abl. kēsī	djālit	Ak. këtë vājz	këta bura	këto vājza
		abl. kēsō vājze	kēsīš buraš	kēsōš vājzaš

Përemrat pronorë (posesivë)

170. Lakimi i përemrave pronorë veta e parë

njëjës (imi)

N. miku	jem	puna jeme	miçët t'im	punët t'mia
G. i mikut	jem	punësh jeme	miçve t'mi	punave t'mia
D. miku	jem	punësh jeme	miçve t'mi	punave t'mia
Ak. mikun	tem (jem)	punësh jeme	miçët t'im	punët t'mia
	(teme)			
Abl. miku	jem	pune teme	miçësh t'mi	punësh t'mia
	(tem)	(jeme)		

a) Përemrat pronorë veta e parë shumës (yni)

mashk.	fem.	mashk.	fem.	
N. zjarmi	jōn	buka jōn	dazmort jōn	darzmat jōna
G. d. zjarmit	jōn	bukësh jōn	darzmorve jōn	darzmave jōna
Ak. ziarm	(in) jōn	buk (ësh) jōn	darzmort jōn	darzmat jōna
Ab. ziarmit	jōn	buke tōn	darzmorš jōn	darzmaš jōna
	(jōn)			

Në vend të trajtave të rëndomta *ün tane, tona*, në dialektin arbënesh përdoren trajtat *jōn, jōn, jōna*.

b) Përemri pronor i vetës së dytë shumës (juaj)

N.	darzmori juoĳ	darzma juoĳ	darzmort juoi	darzmat juoĳa
G. d.	darzmorit juoi	darzmës juoĳ	darzmorve juoĳ	darzmave juoĳa
Ak.	darzmor(in) juoi	darzma (ën)juoĳ	darzmort juoĳ	darzmat juoĳa
Abl.	darzmorit juoĳ	darzme juoĳ	darzmorš juoĳ	darzmaš juoĳa

c) Përemri pronor i vetës së tretë njëjës

i gjinisë m. dhe f. (meli dhe kiza (satër))

N.	meli i ti kiza e ti	meli i sōĳ kiza e sōĳ
G. d.	melit të ti kizës te tī	melit të sōĳkizës të sōĳ
Ak.	melin të ti kizën të tī	melin të sōĳ kizën të sōĳ
Abl.	melit të ti kize të tī	melit të sōĳkize të sōĳ

Shumës

N.	murizat të ti	šarat të tī
G. D.	murizave të tī	šarave të tī
Ak.	murizat të tī	šarat të tī
Abl.	murizaš të tī	šaraš të tī
N.	murizat të sōĳ	šarat të sōĳ
G. D.	murizave të sōĳ	šarat të sōĳ
Ak.	murizat të sōĳ	šarat të sōĳ
Abl.	murizaš të sōĳ	šaraš të sōĳ

Në akuzativ njëjës, nominativ dhe akuzativ shumës, në vend të nyjës së rëndomtë në dialektin tonë qëndron vetëm nyja *të*; ak. *dĳa;(in) të tĳ*, *dĳelmët të tĳ*.

d) Lakimi i përemrit pronor, veta e parë

njëjës, trajta e shquar (i imi)

Njëjës

	m.	f.
N.	ĳemi	ĳemja
G. D.	i ĳemi	t ĳemjes

Shumës

	m.	f.
	t mĳt	t miat
	t mive	t mijave

Ak.	ḡëmin	ḡëmjen	t mīt	t miat
Abl.	ḡëmin	ḡëmie	t'miḡ	t miaḡ

f) Përemri pronor i vetës së dytë njëjës “ai yti”

N.	ḡōti	ḡōtja	tūt	t tūat
G. D. i	ḡōtit,	ḡōtit	ḡōtjes	t tūve t tūave
Ak.	ḡōtin	ḡōtjen	t'tūt	t tūat
Abl.	ḡōtjt	ḡōtje	t tūḡ	t tūaḡ

g) Përemri pronor i vetës së parë shumës – “yni”

N.	ḡōni	ḡōna	ḡōnet	ḡōnat
G. D.	ḡōnit	ḡōnēḡ	ḡōnve	ḡōnave
Ak.	ḡōnin	ḡōnēn	ḡōnēt	ḡōnat
Abl.	ḡōnit	ḡōne	ḡōnēḡ	ḡōnaḡ

h) Përemri pronor, veta e dytë shumës - juaji

<i>Njëjës</i>		<i>Shumës</i>	
m.	f.	m.	f.
N.	ḡuoḡi	ḡuoḡa	ḡuoḡt ḡuoḡat
G. D.	ḡuoḡit	ḡuoḡes	ḡuoḡve ḡuoḡave
Ak.	ḡuoḡn	ḡuoḡen	ḡuoḡt ḡuoḡaḡ
Abl.	ḡuoḡjt	ḡuoḡe	ḡuoḡḡ ḡuoḡaḡ

Përemrat e tjerë

171. Përemrat pyetës: *sili, sila, i kuj e kuj*

Lakimi i përemrave pyetës

N.	sili	sila	silēt	silat
G. D.	silit	siles	silve	silave
Ak.	sikin	silen	silēt	silat
Abl.	silit	sile	silēḡ	silaḡ

e) Foljet

(Formimi dhe funksioni)

172. Meqë në këtë punim nuk mendojmë ta shqyrtojmë në veçanti sintaksën e foljes, sepse për të do të bëhet fjalë në kapitullin ku do të flitet për foljet nga pikëvështrimi morfologjik. Unë që në fillim po theksoj se kategoria foljore është pjesa e dytë e vështirë dhe mjaft e ndërlikuar e gramatikës shqipe.

Sa u përket foljeve, mënyrës dhe kohëve të saj të së folmes arbëneshe, këto, së paku deri më tani, janë ruajtur në tërësi. Në vështirimin e parë në këtë të folme hetohet zhdukja e disa trajtave foljore të kësaj të folmeje, e cila është kompensuar në atë mënyrë duke formuar trajta analoge me folje të tjera, nga ana tjetër. Këtu vlen të përmendim se në të folmen tonë zotëron aoristi sigmatik. *daš* nga *īap*, *raš*, nga *me rā*; *kēs* (*kjes*) nga *me kēn* (*kjen*, *kēn*); *vaš* nga *them*, *thom*, *laš* nga *me lān*, *etj*, është zëvendësuar me aoristin tjetër dhe me të tjera mbaresa - *va*; *luva*, ose *luna*, *rova*, *ruva*, *seva*, *suva*, *kejta*; në vend të *paš* (*me pa*) këtu ndeshim *pova*. Në këtë kapitull ku bëhet fjalë për foljet do të kemi rast të njihemi edhe me disa trajta të tjera të foljeve ndihmëtare, *ken* dhe *pat* (*-pas*), që, për shembull, në asnjë të folme tjetër geqe dhe toske nuk i gjejmë.

Së pari do të njihemi me veçoritë e prezentit të së folmes arbëneshe.

Tipat i përbashkët për prezentin dhe kohët e tjera të arbënishtes, që është synim për evitimin e trajtave “të parregullta” foljore, siç është, për shembull, nga *pō* (nga *pā*) prezenti në këtë të folme nuk bën *un šo(h)*, por *un pōj*, ose *poń*, etj., nga folja *me rō*, prezenti nuk do të bëjë *un bie* (edhe pse një “parregullshmëri” e këtillë është ruajtur sporadikisht), por *un rōń*, *rōj*. Kësaj tendence sigurisht duhet t’i vishet edhe ikja nga trajtat “e parregullta” të aoristit sigmatik në të folmen tonë në fjalë.

Folja, në të folmen arbëneshe ka trajta aktive, pasive dhe këto mënyra: *indikativin*, *koniunktivin*, *imperativin*, *optativin*, *admirativin*, me kohë përkatëse. Nga kohët e thjeshta po përmendim: *prezentin*, *imperfektin*, *aoristin*.

1) Prezenti

Zgjedhimi i foljeve ndihmëtare

173. Prezenti në saje të rrënjes foljore ose të mbaresave të prezentit mund të klasifikohet në grupe. Nëse duam që foljet t'i ndajmë në bazë të mbaresave të tyre, atëherë do të kemi këto zgjedhime: 1) - *mi koniugacioni*; 2) -n *koniugacioni*; 3) zgjedhimi, rrënja e së cilës folje përfundon me *konsonant* dhe 4) ajo që rrënja foljore përfundon me *zanore*.

me kën

me pās (pās)

me sān (thanë)

Prezenti i dëftores aktive

1. jām jëmi	kām këmi	sam	sōjm sōm
2. jē jëni	kē këni	sua-suo	sōni
3. ēšt jān	kō kån	sōt	sōjn, sōn

Prezenti i koniunktivit

1. të keñš	të keñëm	të patnš	të patnëm	te kiñeš
2. të keñe	të keñët	të patne	të patnët	të kiñe
3. të kente	të keñënt	të pate	(patnëni)	
	të kiñëm	të kinte ose	të patnën	të kinte
	të kiñën			

s a n

të soñeš	të soñëm
të soñe	të soñët
të sonte	te soñën

Që shpjegimet e deritanishme dhe paradigma të na jenë sa më të qarta, po zgjedhojmë edhe foljen *me punua (punu)*

I. Indikativ-koniunktivi

Prezent-aktivi

1. punoń	punōjm	të punoñeš	të punoñëm
2. punon	punōjn	të punoñe	të punoñët
3. punon	punoni	të punonte	të punoñën

Indikativi

prezent	imperfekt	aorist	perfekt
---------	-----------	--------	---------

1. íam-íemi	iša ⁷¹ išim	keíta keítěm	kăm kěmi
2. íe-íeni	iše išit	keíte keítět	kē kěmi kěn
3. ěšt-íān	iši išin	keíti keítěn	kō kān

II. Pluskuamperfekti

1. kiša	kišim	keíta	keítěm
2. kiše	kišit kěn	keíte kěn	keítět kěn
3. kiši	kišin	keíti	keítěn

Futuri I

1.	kam me	kem me
2.	ke me kěn	ken me kěn
3.	kome	kan me

Futur II Kondicionali

1. dot kješa	dot kěim	keńeš	keńěm
2. dot kješ	dot kěini	keńe	keńět (keńemi)
3. dot kjet	dot kěin	kente	keńěn

Perfekti Pluskuamperfekti

1. keńeš	keńěm	tě kiša
2. keńekěn	keńět kěn	tě kiše kěn
3. kente	keńěn	tě kiši

ose

tě kišin	keńeš pās	keńěm pas
tě kišit kěn	keńe pās	keńět pas
tě kišin	kente pās	keńěn pas

III. Koniunktivi

prezenti I prezenti II

1. tě keńeš	tě keńěm	mě kěn un	mě kěn ně (tě ĵeni)
2. tě keńe	tě keńět	mě kěn ti	mě kěn ju (tě ĵeni)
3, tě kente	tě keńěn	me kan aí	mě ken ata

⁷¹ Kjo trajtë e imperfektit përdoret vetëm me lidhoren; përveç kësaj ekzistojnë edhe trajtat *keiša, keíše, keišim, keišit, keim*.

*Perfekt I**Perfekt II*

- | | | |
|--------------------------|-------------------|-----------------|
| 1. të kiñeš kën të keñëm | më pàs kën un | më pàs kën ne |
| 2. të kiñe kën të keñët | ken më pàs kën tì | më pàs kën ju |
| 3. të kinte kën të keñën | më pàs kën aì | më pàs kën ata. |

Perfekt III

- | | |
|---------------------|-------------------|
| 1. da të kam kën un | da të kemi kën ne |
| 2. da të ke keën ti | da të keni kën íu |
| 3. da të kò kën aì | da të kan kën ata |

Imperfekti

- | | |
|--------|------------------|
| t'isha | t'išim |
| t'iše | t'išit (t'išeni) |
| t'iš | t'išin |

Pluskuamperfekti

- | | | |
|----------------|--------------|-----|
| të kiša | të kišim | |
| të kiše | kën të kišit | kën |
| të kiš (kište) | të kišin | |

IV. *Optativi**Prezenti**Perfekt I*

- | | | | | |
|---------|--------|-------|-------------|-----|
| 1. keša | kešim | patša | patšim | |
| 2. keš | kešeni | pateš | kën patšeni | kën |
| 3. ket | kešin | pat | patšin | |

V. *Imperativi*

Prezenti

- | | |
|---------------------|--------------------|
| 2. ke (kíe) | 1. keíme |
| 3. nek kene (keíne) | 2. keíni, nek keín |

VI. *Admirativi*

- | | | | | |
|-----------|---------|--------|-------------|-----|
| 1. kenkam | kenkemi | paskam | paskemi | |
| 2. kenke | kenkeni | paske | kën paskeni | kën |
| 3. kenko | kenkam | pasko | paskan | |

174. Nëse kohët e cekura të paradigëmës sonë krahasohen me kohët e të folmeve të tjera shqipe atëherë shihet qartë se e folmja jonë në fjalë ka trajta që nuk i ka gjuha shqipe. Paraqitur më konkretisht, në të, p.sh. në vend të trajtës foljore të aoristit të foljes ndihmëtare *më kën* (forma letrate, *më këne*): *kešë, ké, kě, kemë, ketë, këne* (Kraja, *kješ, ti kje, aj kje, na kjem, ju kjet, ata kjen*), është formuar trajta *kejta, kejte, kejti, kejtëm, kejtët, kejtën*, analoge, siç shihet, me foljen e aoristit me konsonant, me *cīt, aor cīta*, etj. Përveç imperfektit *iša, iše iši*, etj., në të folmen tonë ndashim edhe paralelen *kejša, kejšë, kejši, kejšim, kejšit, kejšin*, trajtë kjo analoge me trajtat e imperfektit sigmatik, që u krijua përsëri nga folja ndihmëtare *me kën*. Si risi e dytë e së folmes sonë do të mund të zinin në gojë prezentin e lidhpres, i cili formohet *të keñeš, të keñe, të kente, të keñëm, të keñët, të keñën*, që me zhdukjen e trajtës së rregullt të prezentit të koniunktivit e mori funksionin e tij: Trajtën e re të koniunktivit, natyrisht, e ndeshim edhe në kushtore, që në arbënishte dëgjohet: prez. *keñeš, keñe, kente, keñëm, keñët, keñën*. Tani shtrohet çështja cili është imperfekti i vërtetë i indikativit, ose i koniunktivit. Siç e kemi parë, imperfekti në të folmen e dialektit tonë bën: *iša, iše, iši, išim, išit, išin*, ndërsa imperfekti koniunktiv: *t'iša, t'iše, t'iš, t'išim, t'išit, t'išin*. Duhet theksuar se kjo trajtë imperfektive përputhet kryesisht me koniunktivin: *si t'išin bakti; si t'išin gur, si t'ište po fisit t(e) nalt*. Trajta e futurit *do t kješa, di t kješ, do t kejt do t kejm, do t kejni, do t kejn*, tregon qartë se prezenti i koniunktivit të vërtetë ka dalë nga përdorimi dhe se është zëvendësuar me trajtën *të kješa, të kješ të, kjet, të kejm, të kejni, të kejn*, të formuara nga folja *me kien*, ose *ken*.

175. Për prezentin e optativit kemi gjithashtu trajtën e re: *keša, keš, ket, kešim, kešeni, kešin*, në vend të *kiofša, kiofš, kioft, kiofšim, kiofšit, kiofšin* (letrarishtja, *qofsha, qifsh, qofsh, qoftë, qofshim, qofshit, qofshin*). Dhe në fund, nga inovacionet e trajtave foljore po përmendim imperativin: *kë, apo kië, nek keñe, (kejne), kejmi, kejni, nek këjn*, për dallim nga *ji, le te jëtm jīni, le te jën*.

Në paradigëmë do të japim pasqyrën e kohës së foljes tjetër ndihmëtare *me pās (pāt)*.

Indikativi

Prezenti	Imperfekti
1. kam kemi	kiša kišim
2. kē keni	kiše kišit
3. kō kan	kiši kišim

*Aoristi**Perfekti*

1. pata patëm	kam kemi
2. pate patët	kē pās keni pās
3. pati patën	kō kën

Pluskuamperfekti

Futuri I

1. kiša kišim	ka me	kem me
2. kiše pās kišit pās	ke me pas	ken me pās (pāt)
3. kiši kišin ko me	kan me	

Futuri II

Futuri III

1. pās pāsım	dot pās	dot pāsım
2. pāren pātni	dot pātëš	dot pātni
3. patën pātni	dot pātët	dot pāsın

Kondicionali II

Prezenti I	Prezenti II
1. patnëš patnëm	kinëš kinëm
2. patne patnët	kinë kinët
3. pate patnën	kinte kinën

Pluskuamperfekti

1. kinëš	kinëm
2. kinë pās	kinët pās
3. kinte	kinën

Koniunktivi III

<i>Prezenti I</i>		<i>Prezenti II</i>	
1. të patnëš	të patnëm	të kinëš	të kinëm
2. të patne	të patnët	të kinë	të kinët
3. të pate	të patnën	të kinte	të kinën

Prezenti III

1. me pās un me pās ne (tě kemi)
2. me pās ti me pās ju (tě keni)
3. me pās aí me pas ata

Perfektí I

1. tě kińěš tě kińěm
2. tě kińe pas tě kińet pās
3. tě kinte tě kińěn

*Perfektí II**Imperfektí*

1. me pās un me pās ne tě kiša te kišim
2. me pās pat ti me pās pat ĵu tě kiše te kišit
3. me pās aĵ me pās ata tě kište te kišin

Pluskuamperfektí

1. tě kińěš tě kińěm
2. tě kińe pās tě kińět pās
3. tě kente tě kińěn

*Optativi IV**Prezenti**Perfektí*

1. patša patšim patša patšim
2. patěš patši patšeni patěš pās patšit pās
3. pat patšin pat patšin

*Imperativi V**Prezenti*

păt
 nek patńe
 patmi
 patni
 nek patin

*Admirativi VI**Prezenti**Perfektí*

1. paskam paskemi paskam paskemi
2. paske paskeni paske pās paskeni pās

3. pasko paskan pasko paskan

Këtu duhet përsëritur disa nga vërejtjet që janë theksuar nga aspekti i foljes ndihmëtare *me kën*. Nga aspekti i trezentit të koniunktivit dhe kondicionalit është e nevojshme të theksojmë së në vend të *të kem, të keş, të ket, të kemi, të keni, të kën*, ose *kiša, kişe, kişte, kişim, kişit, kişin*, paraqiten trajtat *të patnësh, të patné, të pate, të patnem, të patnët, (patnien), të patnën*, – trajta që u formuan nga folja ndihmëtare *me pās, pāt*. Për dallim nga imperativi *kī, (kij), të ketë, kini, le te kenë*, e folmja arbëneshë njih vetëm trajtën imperative *pāt*, edhe më tutje: *nek patné, patmi, patni, nek pasin*.

Që shpjegimi i deritanishëm për foljet të na bëhet i qartë, po ndalemi edhe te folja *me punua* në të gjitha mënyrët dhe kohët e saj.

ME PUNUA (-UO)

I. Indikativi (aktiv)

<i>Prezenti</i>		<i>Imperfekti</i>	
1. un punoń	punōjm	punōjşa	punōjşim
2. ti punon	punōni	punōjşe	punōjşit
3. ai punon	punōjn	punōjşi	punōjşin
<i>Pluskuamperfekti</i>		<i>Aoristi</i>	
1. kiša	kişim	punova	punovëm
2. kişe	punua kişit	punua	punove punovët
3. kişi	kişin	punovi	punovën
<i>Aoristi II</i>		<i>Perfekti</i>	
1. punoíta	punoítëm	kam	kemi
2. punoíte	punoítët	kë punua	keni punua
3. punoíti	punoítën	kò	kàn
<i>Futuri</i>			
1. ka me		kem me	
2. ke me	punua	ken me	punua
3. ko me		kan me	

Pasivi: lahem

Prezenti *Imperfekti*

1. loem loemi u loeša u loešim
2. loe loeni u loeše u loeši
3. loet loen u loeši u loešin

Pluskuamperfekti I *Pluskuamperfekti II*

1. u keiša lō u keišim lō u iša u išim
2. u keíše lō u keiši lō u iši lō u išit lō
3. u keiši lō u keišin lō u iše u išin

Aoristi *Perfekti*

1. u lova u lovēm jam jemi
2. u love u lovēt ie lō jeni lō
3. u lovi u lovēn ēšt jan

Futuri I *Futuri II*

1. u kam me u kem me kam mu kem-m u
2. u ke me lō u ken me lō ke mu lō ken-m u lō
3. u ko me u kan me ko mu kan-m u

Kondicionali II

(aktiv)

Prezenti

1. punońeš punońēm
2. punońe punońēt
3. punonte punońēm

Perfekti

1. kińeš kińēm
2. kińe punua kińēt punua
3. kinte kińēt

(pasiv)

Prezenti

1. u lońeš u lońēm
2. u lońe u lońēt
3. u lonte u lońēm u kinte

Perfekti

1. u kińeš u kińēm
2. u kińe lō u kińēt lō
3. u kińēn

Koniunktivi III

(aktiv)

Prezenti

1. tē punońeš tē punońēm
2. tē punońe tē punońēt
3. tē punonte tē punońēn

Imperfekti

1. tē punońša tē punońšim
2. tē punońše tē punońšit
3. tē punońšin tē punońšin

Pluskuamperfekti

1. të kiša të kišim
2. të kiše të kišit punua
3. të kiši të kišin

Perfekti I

1. të kineš te kinem
2. të kine punua te kinet punua
3. të kinte te kinen

Perfekti II

ose

1. da kam do kemi të kem të kemi
2. da ke punua do keni punua të keš punua të keni punua
3. da ko do kan të ket të ken

(pasiv)

*Prezenti**Imperfekti*

1. t'u loñeš t u loñëm t u loeša t u loešim
2. t u lone t u loñët t u loeše t u loešit
3. t u lonte t u loñëm t u loeši t u loešin

*Pluskuamperfekti**Perfekti I*

1. t'iša t'išim t u kiñëm t u kiñeš
2. t'iše lō t'išit lō t u kiñët lō t u kiñe lō
3. t'išt (ište) t išin t u kiñën t u kinte

Perfekti II

1. do jam do jemi
2. do jelō do jeni lō
3. do ešt do jan

Optativi IV

(aktiv)

Prezenti

1. punoša punošim
2. punoš punošit
3. punōt punošin

Perfekti

- | | | | |
|----------|-------|--------|-------|
| 1. patša | | patšim | |
| 2. patěš | punua | patšit | punua |
| 3. patt | | patšin | |

(pasiv) Prezenti

- | | |
|-----------|---------|
| 1. u loša | u lošim |
| 2. u loš | u lošit |
| 3. u lot | u lošin |

Perfekti

- | | |
|-----------|---------------|
| 1. u keša | u kešim |
| 2. u keš | lō u kešit lō |
| 3. u ket | u kešin |

*Admirativi(aktivi)**Prezenti*

- | | |
|-------------|-----------|
| 1. punuakam | punuakemi |
| 2. punuake | punuakeni |
| 3. punuako | punuakan |

Perfekti

- | | |
|-----------|---------------------|
| 1. paskam | paskemi |
| 2. paske | punua paskeni punua |
| 3. pasko | paskan |

*(pasivi)**Prezenti**Imperfekti*

- | | | | |
|-----------|---------|---------|----------|
| 1. loukam | loukemi | loukiša | loukišim |
| 2. louke | loukeni | loukiše | loukišit |
| 3. louko | loukan | loukiš | loukišin |

Imperativi VI

- | | |
|------------|--------|
| punō | punomi |
| nek ponońe | punoni |
| nek punōjñ | |

176. mendoj se më së miri do të ishte që të shqyrtohen mënyrat dhe kohët për të cilat ishte fjala më parë, por të foljeve të tjera, ndër të cilat

gjenden edhe ato të parregulltat, që kanë veçoritë e veta. Sa i përket indikativit të prezentit, këtu është bërë fjalë vetëm për foljet ndihmëtare *me qenë* dhe *me pasë*, dhe për foljen *me punue*, për të gjitha mënyrat dhe kohët e tyre.

Prej tri foljeve që bëjnë pjesë në *m* - koniugacionin (*jam, kam, dom*), dy të parat janë përfshirë në paradigmat e mëparshme; ka mbetur të spikaten tiparet kryesore të foljes së tretë *dom*, prezenti i së cilës bën: *dom, dua, (duo), dot, dom, doni, dojn*. Kohët e tjera të saj nuk dallohen në thelb nga foljet që sosin me konsonant ose me vokal. Aoristi i saj nuk e ka ruajtur trajtën sigmatike, por në analogji me trajtat e foljeve me diftong, është ndërruar në këto trajta: *dova (sova), dovi (sove) dovëm (sovëm), dovët (sovëm)*. Me zgjedhimin e foljes *punoñ* jemi njohur me tërë kategorinë e foljeve *-n*, ose *-o*. Mbetet të shqyrtohet kategoria e foljeve *-n*, që në temë nuk kanë *o*, por ndonjë vokal tjetër, e këto janë ato folje tema e të cilave mbaron me diftong *ua-uo*, do të thotë ai tip foljesh që për mbaresë rasore kanë ndonjë zanore, *ē, ā*, etj; *me pagua (-uo)*, prezenti bën: *paguaní (i) ose paguoní(i), ti paguan, aj paguan, ne paguajm, iu paguaní (ioní), ata paguajn (uojn)*. Kohët e tjera të kësaj foljeje me asgjë nuk dallohen nga foljet e tipit ku bën pjesë edhe folja *paguan*.

Ja prezenti i foljes me prë:

1. un preñ ne prëjm
2. ti pren ju preni
3. aj pren ata prëjn

Aoristi bën *preva*. Duhet theksuar se një zgjedhim i këtillë i foljes *me pre* nuk përputhet me të folmet e tjera, tek të cilat ai bën: *pres, pret, pret, presim, pritni, presin*, këto, sigurisht janë trajta të zgjedhimit të foljes *me prit(e)*. Në të njëjtën mënyrë zgjedhohet edhe folja me *fšhe, mšhe*. Ka edhe aso foljesh që sosin me zanore, të cilat megjithatë, nuk mund të klasifikohen në grupin e foljeve të lartpërmendura; e këtillë është, për shembull, folja *me pī*, që zgjedhohet: *un pi, ti pi, ai pi, ne pim, iu pini, ata pin*; aoristi bën *piva*. Disa folje, si *me vra, me nga*, kanë zgjedhimin kësisoj: *vras, vret, vrasim, vritni, vrasin, ngas, nget, nget, ngasim, ngitni, ngasin*. Në

grupin e foljeve *-n* klasifikohet edhe folja *me bā*. Kjo ka këto trajta:

prezenti	aoristi				
1. un bēn (bēi)	ne bēim	boń (i)	bōim	bova	bēva
2. ti bēn	ju bēni	bon	bōni	bove	bēve
3. aĵ bēn	ata bēin	bon	bōin	bovi	bēvi

bovēm etj.

177. Është shumë interesante rrethana, siç kemi pasur rast të theksojmë, se në të folmet tona, në arbënishte dhe në truallin amë të saj, ndeshim dy variante trajtash të foljes *me bo* (Kraja *me bā*), *bēn*, dhe *biń*, krahas trajtave të Krajës *bāń*, *bēń*, etimologjia e së cilës është *bhanjā*.

Është interesante edhe dubleti kur dihet se në të folmet gege volaki i lashtë *a*, pas të cilit person *n* nazale nuk reduktohet, ndërsa në të folmet toske reduktohet. Dubleti *bēń*, *bon* (Kraja *bāń*) deshmohe në disa shembuj me reduktimin e vokalit *a* në *e* në të folmen arbëneshe dhe në të folmen e saj amë.

178. Pjesa më e madhe e foljeve konsonantike zgjedhohet në këtë mënyrë: nga folja *me kāp*, prezenti bën: *un kapi (kapiń)*, *ti kapēn*, *ai kapēn*, *kapim*, *iu kapni*. Kështu zgjedhohet *me šuškat*, *me u rugat*, *me čep*, *me ndeš*, *kris*, *pēvet*, *me trēt*, *me bīr* (me bĵer), *me mbet*, *me ēšt* (heshtë), *me prīc*, *me prēk*, *me mbūš*, *me mbūš*, *me cīt*, *me grabit*. Folja *me tret* (me u zhdukë) zgjedhohet kështu: *un tres*, *ti tretēn*, *ai tretēn*, *ne tresim*, *ju tretni*, *ata tresin*; njësoj bën edhe *un mbēs* (me mbet), *ti mbētēn*, *aĵ mbetēn*, *ne mbesim*, *iu mbetni*, *ata mbesin*. Bëjnë përjashtim ato folje, të cilat edhe pse sosin me konsonant, vokalin *a* në vetëm e dytë dhe të tretë njëjës e kthejnë në *e*, siç është rasi me foljen me bërtit: *un bārtās*, *ti bērtēt*, *na bērtāsim*, *iu bērtitni*, *ata bērtāsin*; *un flas*, *ti flet* (sporadikisht edhe *fōlēn*), *aĵ flet* (*o fōlēn*), *ne flasim*, *iu flitni*, *ata flasin*; *un dal* (nga *me dal*), *ti del*, *ai del* *ne dalim*, *uĵ dilni*, *ata dalin*; dhe: *me mar*, *un mār*, *ti mēr*, *aĵ mēr*, *ne marim*, *iu marni*, *ata marin*, nga folja *me zān*, përfundimisht, prezenti bën: *un zō*, *ti zē*, *aĵ zē*, *ne zōm*, *iu zini*, *ata zōn*.

2) Imperfekt

179. Lidhur me imperfektin e së folmes arbëneshe kam bërë disa vërejtje në kapitullin kur kemi bërë fjalë për të folmen e Malësisë së Krajës, kryesisht në paragrafin për imperfektin. Vërejtjet tona për imperfektin këtu do të jenë vetëm plotësuese. Na habit fakti se në arbënishte ndeshim dy tipa të trajtës së imperfektit, 1) *na-ńa* (*punońeš, punońe, punonte, punońem, punońen*), i cili ka marrë kryesisht, funksionin, e kushtores, *kur ti martoneš s e mirōeš kėrkėn van ĳonin; kur t(e) kente i dekun, ater dińeš ciš patńeš me bō; dorėn tē dias e kińeš dān pėr nderĳe t(e) ti dhe 2) tipi i dytē, i ashtuquajtur i imperfektit sigmatik: e ata u perzie-išin me t(e) ri, e rota e made e aneš si tue u češ, u čoĳši kodāl mi katundit; ... čėnt umatsšin (lihnin); ... e tē kėnduom pak kō pak, tu u largua, u ndieĳši i mo mangut; tē rīt si tē rīt kėndoišėn, e luoĳšin, vale ede matsšin forcėn t(e) vet; nē ĳi dĳer u štoĳšėn tue ngā, kėčeĳšin, čitšin gūr ... u kapšin e u mundoĳšin kuš kėn e kapėrdišėn; nē livad ngitšin me kđāl e kėčeĳšin gardńet ... as e e điršin tietėrsi.*

Se trajta me *-ń* (*punońeš*) ka qenë që në krye të kohës imperfekt i vërtetë dhe ka kryer funksionin e imperfektit, tregojnë qartë edhe këta shembuj që po sjellim këtu më poshtë: *e đi katundi i pėrcilte e iu dišronte ulėn t(e) mbār, kur kseńėn i i pritte katundi, kumbonat luneĳatńėn, e ata kėrsitńėn pē kuburaš.*

Sa i përket formimit të imperfektit sigmatik, lindja e tij duhet kërkuar në bazën e prezentit, të cilit i shtohen mbaresat e imperfektit *še, še, š (šte), šem, št, sne*; khs. G. Meyer, *Kurzgefasste albanesische Grammatik*, f. 39; H. Pedersen, *Alb*, T. f. 136, 137: *A. Dozoni, Manuel de la langue chkipe ou albanaise*, f. 228. Këtë e dëshmojnë për mrekulli trajtat e imperfektit të foljes ndihmëtare *jam* dhe *kam* në të folmen e Çamërisë: *ješe, ješe, iš, ješem, ješt, išne; keše, keše, kiš, kešem, kešt, kišne*, - ku *je, ke* në fillim të fjalës nuk janë gjë tjetër pos gjutme të foljeve ndihmëtare *jam* (jem), *kam* (kem). Këtë edhe më qartë e tregon mbaresa *iš* e vetës së tretë njëjës te e folmja e Përmetit, në të cilën kjo vetë dëgjohet: *martoniš, škruaniš, driđiš, a iš (er war)*. Më në fund, mbaresat e përmendura të

foljeve ndihmëtare *kam, jam* të imperfektit të gjuhës shqipe shihen qartë te trajtat imperfektive të shkodranishtes: *martošë, martote, martošim, martošit, martošin* (kosovarishtja - *martošna, martošë, martojke, na martojshim, martojsh(t), martojshin*; mbaresa *-ke* e vetës së tretë njëjës është bartur nga imperfekti admirativ në imperfektin indikativ. Mbaresa *š* është ruajtur në vetën e parë të aoristit të disa foljeve, të cilat në të kaluarën ishin më të shumta sesa sot. Edhe tipi i dytë i imperfektit u formua nga tema e prezentit dhe e mbaresave nduarduarta të imperfektit: *na(m), a në(m), në, te, nime, nite, nine; punon(m), ose punonë (m), punonë, punonte, ne (a) punonime, punonite, punonine*. Veta e parë dhe veta e dytë njëjës e dialektit të Përmetit ruajnë mbaresat më të vjetra imperfektive *e, e, drođe, liđe*; khs. Meyer. o. c. , 39. Foljet me konsonant në imperfekt nuk kanë mbaresën *-nte*, por vetëm *-te*, për shembull *ai çilte*, mirëpo te Bogdani, në vetën e tretë njëjës ndeshim *-nte* edhe te foljet konsonantike; khs. parathënia nga *Cuneus prophetarum* në botimin e Ndre Mjedës: *Ki t i ndritente (=me ndritune) as šekuli te mos sodinte per dune* (nga *me sodite, soditune*); *sodinte posi ni perendeše, si ište*; a. c. , f. 17.

Neve posaçërisht na intereson çështja e tipit dytësor të imperfektit në dialektin arbënesh dhe përfundimin e tij në një tip (imperfekti) në të folmen e Malësisë së Krajës të Malit të Zi.

Se dyjësia e trajtave të imperfektit në të folmen arbënesh është gjurmë arkaike e saj - nuk duhet dyshuar. Mirëpo shtrohet çështja - përse në këtë rast edhe të folmet e Malësisë së Krajës nuk e ruajnë këtë tipar të përmendur arkaik, në të vërtetë, përse në to nuk e ndeshim dynjësinë e trajtave imperfektive, trajtën me *-i*, edhe trajtën sigmatike të imperfektit me *š*? Unë, megjithatë, mendoj se këtu nuk është çështja e ndonjë ndikimi nga jashtë, madje aq më parë kur dihet se imperfekti pasiv i tipit sigmatik në arbërishte ruhet edhe sot.

Dhe më në fund, duhet përmendur se përdorimi i imperfektit në të folmen arbënesh ka përfunduar në minimum dhe se sot në shumë raste zëvendësohet nga perfekti.

3) Aoristi

180. Edhe pse aoristin në të shumtën e herëve e ka zëvendësuar perfekti, ne megjithëkëtë do të ndalemi në shqyrtimin e tij, sepse ky përdoret edhe sot më një masë bukur të mirë. Ajo që duhet spikatur që në fillim, është e vërteta se në të folmen e arbëneshëve është zhdukur aoristi sigmatik, kështuqë në këtë të folme nuk ndeshen më trajtat: *raše, paše, dać (daše), vaše, keše, laše*, siç janë ruajtur në të gjitha dialektet e tjera, të cilat janë zëvendësuar në një tip të aoristit tjetër: *rova, pova, duva, luva, sova* (veta 2 *sova*, veta 3 *sovi* a *sou*); *kejta, kejte, kejtī*, etj., *luva*.

VI. TEKSTET

Këtu kam klasifikuar pak lëndë dialektore, të cilën, përveç një tregimi të papërfunduar nga Shestani i Krajës së Malit të Zi, e kam mbledhur në Arbënesh të Zarës. Jam përpjekur të jap transkribimin fonetik të teksteve. Ajo që është më me rëndësi jam përpjekur të shënoj kuantitetin e vokaleve, e që duhet të pranoj se shënimi i teksteve ishte çështja më e vështirë në fushën e fonetikës, e aq më tepër kur këtë punë e ka bërë askush deri më sot. Kuantitetin e vokaleve nuk e kam shënuar për arsye të thjeshtë, sepse nga kuantiteti pa ndonjë vështirësi mund të përcaktohet edhe lloji i vokaleve, meqë dihet se vokalet e gjata njëkohësisht janë edhe të mbyllëta, ndërsa të shkurtrat të çelëta. Kam përdorur shenjat stabile të albanologjisë, sepse shenjat në grafinë e sotme të shkrimit të gjuhës shqipe janë të pamjaftueshme për transkribimin e lëndës dialektore.

Kuantiteti i vokaleve: (˘ ā) = gjatësia e gjatë; (˘ è) = gjatësia e mesme dhe me shenj ˘ (ë) janë shënuar vokalet e shkurtra; kjo shenjë në tekst shënon edhe vokalin e reduktuar.

NË PÛN SËT E ARÛOM NË KATÛND IÛN

Në bjë në mënd sikÛr të pas kën kjë. Këmi šetit më mëštri nër Kõrm. NË šók ë kõ lÛt mëštrin më lišu à në špi së kó; sóvi, më óes dëlmet. Përmëndëm ële së jãm àt bõ mborÛa në vët-vëte tue mendÛa: Áj vëc punõn ë bën dobi, në špi, -ë ùn?!!

Órda në špi ë j sòva nánës: “À kè do dõ për mua më punÛa? Nna më pëvétì: “Š’ t’ õ ndõl sõt, së põ më kën ï viešim?”

Ï kãm kaóÛa š; kó sãn àj djalóc, šók ï škulës, ële ï sòva së dÛet ë më m lãn donË pÛn më punÛa. Põr nánës ï kó rõ díç tjetër në mënd, àni më sõt: “Màs drëke škõim të nË miknëš tème.” AštÛ ë u ndõli. Këmi võt dikÛ lãrg kÛ mbarõn katÛndi, àn ip në nË špi.

Kur ipa mbrenda m' ò siël pàra sùš, nùk kàm dit çjš pàra më šigùa. Pëf – àšt fëmna, grò e vájza, pò punòjn. Nàna pò šprišën ë tjetra, në tók me gárza, pò garzátën lëshin. Nì plàk, tue rit në àrk, pò tirën; fùrka j' ò fòrt ë bükur; më dór të šolákët pò prišën lëshin ë më dór të tirën tue sil bóštin. Nì vājz pràn sòje pò përdjëlën pënin të bārì më të të zi.

N'atà më kò sir nì vajzic, mòca jème: “Á dònë tì me më dimùa më puna? mbëriti të tràniti nì tufe pë ë, me büz në ngáz, sóvi: :Štrijì dórat: Nùk të kómë kën ránd kjë pùn: dëri t'ë pëštilša lámin, të ka òn díc të kùkur.”

Në špi të uoq düet me dingùa: ì kàm cùa dórat, amà vajzica tõe pëštil làmšin, s'pò fòlën àš fiàl, vèt pò më šigòn tu cëš. Màs pakut zàn me gërgàt, së diñeš mir àt me ndigùa. Grót ę vájzat u cëjšin në këtò fjalà të sòja ë ùn u kùca sì lalkúci. Atù nì vājz me ùlpàn në nì dór ë me tjetrën, pò cëpën pàšk cópat të postëš ë pò këndòn nër zò. Zàni ì àmbëk, pòr kànga sì tue ankùa. Kùrdour prënte me geršàn cùmbet pë ònaš. Vajzucz ë mbaròvi të pëštilum antèna e çiti làmšin nërmjéd tiërš në nì kròn e.

Tàš ùn u špòra pë sòje, àštù sì pò de dàš, ë u priça tē nàna. Nàna ë mòri nì postë, atër sóvi zòtjes të špis: “Së, këštù donëš me mà bò nì postë për šràt të kėti dialóc tēm; tapardjë ë kàm nòue pënin në të movi ë në të kúc për postë.

U aftòva mò šùm nànes me pò mò mir vèket, ë më pò ële šì goditën postët. – Kětà më kò kën šùm kànda me šigùa.

Kur nàna mbaròvi me fòl, ù nisëm në špi. N'atà ajò vajzic ngàvi màš, nëš, ë në nibòt ù šèti, pàra mée, àni mà štrijti nër ùnd nì bréz të lëshit. “Nà, mbàe, – sóvi – kětà pòga për atë çjš më kè dimùa!” ë mì kràš mà lišòvi brëzin, antèna ìku.

I škrèti ùn, pë mbòrje ë pë difàr ndijemit të kànda, aròva me ià fàl ndërjes ë u turbulva àštu së s kàm mùit àš me mār vëšt çjš kàn bërtit atò tjetrat pë špije, vèt di së ján cëš me ìzò ë mèk pë ngàzit.

Nàna, tue šigùa brëzin të bükur, sóvi: “Sòt e tì kè pàk punùa pòr kët pòg nùk ë kè miritùa!” Fòli sì tue dàš me çortùa, ama ùn vagulòva në sù të sòia së èšt šùm ë kuntënt.

Këtō pūn mę lësh sōt j̄an tē aruom nē katund j̄on, pōr kuĳitim nē āt dit ūn pō ē mbōñ mir ēle sōtedit.

Budimir Peroviqi, mēsues nga Arbēneshi Zarēs
pesēdhjetē vjeçar)

Koleci e gomari

Kō ārd Kolēci nī mbrōmje pē pazōrit mę gomōr, ċiš ē kō blē. Gomárin ē kō lil nē obōr mę konōp pēr stūpc ē kō ĳp nē kuĳin. Nē obōr j̄an ōēt āt mbrmje fēmnat tē špīs bāšk mę diždō sōš pē konšije. Fēmnat sī fēmnat, dōn mę dīt ōi, aštú ē tāš kán rīt mę šigúa fār gomárit ē kō blē Kolēci. Kūr ē kán šigúa mīr; kán zāt mę u ċēš ē mę sīr Kolēcin. :Sī pō súa sē ē kē blē gomárin, kūr nūk ēšt vān kēna!?”; pō bērtāsin ē pō ċēšēn. Jē plāk, ē s pō dī āsēle ċiš gomári ē ċiš ēšt kēna; – ōl s pō šē tāš mīr nē sū? – ĳškretī tī, sī tē gēnēvi āi nēr! – a e kē pagúa štrēnt” Kēsōš f̄jāl j̄an pērziĳe bāšk mę ngāz tē fēmnave.

Kolēcit s ĳ kō kēn ĳ kanda kū sulāc ĳ fēmnave, pōr s ĳu kō sān ās ní f̄jāl.

Māš dārke kō vōt mę flēt, pōr kūrasi mē kāp ōumi pē mendimeš: a št ē vērtēta o ĳō atā š kán sān fēmnat ē ēšt ndie ĳ lēnduom.

Sī s kō mūĳt kūrasi m ū pajtúa pē kēsōš mēndimeš, nēñibōt u cōvi ē mori kandilin āni škōvi nē obōr.

Kō rīt pāk tue šigúa gomárin, atēr ĳa cōvi bištīn, pōr frk ĳā lišōvi, ē ngiti nē kuĳin sī ĳ pērvluom.

Māš pákut ōrdi mę cakīc, āni mę tē dūā dōra ē cōĳiti nált antēna mē šī fōrc ĳa vau tē škrētēs kēn ē ĳa préu ċáfēn.

U skēu prap nē štrāt, amā tāš ē kápi ōumi pēr bukurī.

Budimir Peroviqi

Nani nësh – – nani siš

Kur bükur e plenoben arën, atër kan zan me livrúa. Tùe livrúa pòjšin òinsfár sòje gicipòlaš për n'ar, pòr nük kan vòt mãs siš ... aštù e kan mbièð krüen eðe kan kën të kuntënt, psë nük i u kò me u dësh mō me dān šum asër për krüp?

Kur dò ard kóa me mbī, kò vòt buru me pō sī kò mbī, mã šum u çuditi kur kò pō së krüpa s kò mbī eðe. Mãs tèt kīt ko vòt prap me pō, pòr kļō krüpa nük kò mbī as kòkër.

- Mòs ë kò angër doóō? ë pëveti ë ama.

- Ë cíš kò mūit me angër? - ðòvi tاتا.

- Mòs e kan angër gicipòlat? Šum kan kën kur ë kēmi livrúa arën! – Eðe tās i kām pō šum për n'ar – ë gļatòj.

- Munte me kën ..., tùe mendúa ðoijtì tاتا.

- Ë cíš pátnem me bō? – prap pëveti naba.

- Më ì vrō! Me dril arën pe siš! – me guōim u nzèu biri.

- Ë tاتا ë nana iā begeniten birit. Tاتا ë biri u armătēn me puška ë nana ë mòri nī dajāk. Kur òrdēn ői tùe u tulāt afër are, biri škòvi në nī òn t'arēs, ë tاتا ne tjetrēn. Nana kò mbēt nī grīm m lārg sī t'iste kēn rezerva. Pòr as tاتا as biri, sī pērdūn, nük ë ndēsēn kurrī gicipòl. Tùe óua kēštū, u afróvēn nāni tjetrit, atēr k(e)cevi nī gicipòl: Ték èšt! bërtitēn të dū në nī zō. Ë tاتا ë còvēn meñier puškēn dēri në sū ... pòr gicipòli trėti. Mãš pakut ë pòu dļali gicipòlin në pārzma të veta ... Pēr mōs me trēmb kēt, i viškilòj kodāl tātēs, ë ìa gazòj me gışt gicipòlin. Tاتا ë ngrēvi pükēn krisi!

Kur u k(e)ðevēn në špī, ì pëvėtšin: Me kën ë kan pāt, ë sī kò mbarúa megdāni. Mãs grúoje, e cila ë gaóòj në gļāt luðten, buri e mbaròj:

- Nük èšt óc kēc: Nāni nësh – nāni siš!

Josip Relja, mēsues nga Arbēneshi i Zarēs

Kò pāt tاتا kātēr bíc, kò kēn i vórfum andár kan ard të mlěj e s kò mūit me ì dō e ì sòt: kápne vétēn e škòni për ìt, sili mò mīr të sòne aì mò

mīr kò mē pāt. Kán vōt. I pāri e ndēšēn sī nī aštronom, i dūti e ndēšen gusārin, i trēti āt čīš uon, i kātērti ē ndēšēn āt čī cépēn robē. Dēr kán suo zanātin kò pērbi šūm mōt. Kán ārd te špija ē tāta i kò prit būkur, i kò pēvēt si jū kò vt pūna? Ē pēvētēn tē plakun: “čīš kē suo tī?” Kū i gaóōn čīš kò suo, ē ja gaēn kanočálin čīš ja kò lān zoti.

E, mīr – i sōt i jāti, tī kē suo mīr zanātin e pēr tū kōme kēn mīr.

Antēr ē pēvētēn tē dūtin, i dūti i gaóōn sē ē kò suo gusrīn, e ja daóōn drūnet e ramandélat. I jati i sōt: “Tī ē kē suo zanātin mīr, e tī miritōn dīć”.

I trēti i sōt sē kò suo mē ōou, ē ja, kò gaóuo tátēs puškēn.

- Aferīm, e tī miritōn dīć.

I kātērti i gaóōn tátēs sē aj e kò suo šartorin: mē cēp robēm e ja gaóōn tátēs donifār ōulpánaš, gēršānš e difār drécneš e aparāteš tjēra.

- Mīr, biro e tī.

I jati jū sōt: “Tē šī kēni suo mīr, pērtā nuk di me jū do ōōn, vān tāš jū pōi tāš pára mēe ē gaóōn zanātin tē vēt”.

Tāta i kò špū nāj ni stūpc fōrt tē māl (giāt) e tē nālt. Antēr tāta ē pēvētēn tē plākun: “Mē gaóō tī čīš pō suo sē pōn šīčīš ko notje nē mēe tē stūpcit; e aj kò mār ē kò vėnduo kanočálin nē mee tē stūpcit e šigō kēštū, šigō aštū, mandevōn sōt tátēs: “Nālt nē mēe ēšt nī ērd me kātēr kókra vō mī tē silš pō flē zōgu, – bēsa, birō ti miritōn dīć pē ōoe”.

Masandēn tē dūtin, gusārin e srēt i jāti e j sōt: “čīš pō suo sē ē kē suo (gusrīn) sī nī gusōr i viešim ip nālt ē mēri vōt pō mē ik zōgu pē érde; ē aj kò ārd nēr ērd ē mē atō aparāte tē tija ē špōn ērdēn pesī pēštjērit e vōt i kán rō nē dōr, ē kò prū pēštjēr me ja gaóuo tátēs.

Tāš i sōt tē trētit, ēja kán e j dōn kētō kātēr kókra vō nē kātēr ōn, tī čīš dī mē ōuo mir ē mē krīs tē dūet mē nī tīr te puškēs me j sūe tē kātērtat vō. Kū u venduo sī kò aj dīt; krisie j sēvi tē kārertat vō.

- Bukur, biro, i viešim jē.

Tāš i sōt tē kātērtit: Tī čīš cépēn mīr, tē kātērtat vō tē dūet mē j cēp aštū mōs mē u dīt sē kán kēn tē sūema.

- Bësa, mīr e tī, pōr prāp s mŭj mē jŭ dō sē jēni tē ōi te viešim, vān mirne vētin e škōni prāp pēr jēt.

E kām vōt tē ōi bāšk. Škōvĕn ōikā. Ę kām ndie sē krālit po mēngōn bijā, ě atā ndĕrmjĕt sīš ě kām lān fjālĕn mē vōt te krāli e mē i sām sē atā kām m’u štī mē ōĕt bīn tē tē; e aštu škōvĕn tŭ krāli, ě j kām sām sē kām ndie sē pō i mēngōn bijā. Krāli jŭ kō sām:

- Mīr, škōni; āj š’tē ōĕtnĕe – ě tija kōmĕ kĕn. Vlājznit škōvĕn mē ķĕrkŭo. Kām irāt pēr jĕt pĕrmī ūjĕš, dĕtnĕš, brĕĕš e mālĕš. Mandevōn ōršin nĕ nī māl, ě kšn pušŭo ě kām šigŭo mē ōĕt. Kŭ mē kanoĕāl šigōvi pĕ ěi ōnĕš, kŭr jō bō sē dīc pō pōn ě jŭ sōt vlāznive sē dīc notīĕ pō pōnĕ, ě atā i sōn: “prāp šigō mīr, mōs pō gĕnĕje”, ě āj šigōn prāp mīr, ě jŭ sōt sē ěšt nī vājz, ě sē pō j flĕ zmājī mē krŭe nĕprĕnde.

I sōn gusārit mē vōt mē jā špŭ zmājīt zājzĕn, ě atā ě godisin difār dōrke pēr mē pĕrbī pĕrmī ūjt, pēr mē ārd te vāiza ě aštŭ ōršin. E gusāri u nis ě kō ārd nĕj vājz, ě kĭō vājz ěšt kujtŭo pēr ĕiš āj kō ārd. E sī zmājī kō flĕt nĕ prĕnde tē sōja kodāl ja ĕōvi krĕnin, e gusāri ě kō zvīš kaparānin e kadāl ja kō štī nĕr krŭe pēr mē j kĕn bŭt, mōs m’u kujtŭo sē jā kām špŭ vājzĕn.

Tāš yĕ ōi bāšk ĩkĕn ě kŭr kām ārd pēr ōūs ūjt, zmājī ū ĕōvi e atā i sōvĕn vlāit: “Tŭk ěšt ĕōo zmājī, tāš trĕsim tē ōil nĕ mōs ě vritĕš”. E āj krisĕn ě ě vrĕt zmājīn, pōr šigō drĕcīn, zmājī i vrōm bjĕ nĕ bōrk ě borka atĕr bōĕt ōi ĕōpa, ě atā ě sitšīn tē kātĕrtin vlō ě j sōjšin:” fĕrk ě fĕrk ĕĕpi ĕōpat e nĕ mōs prāp trĕsim, ě āj, pēr zōtin ĕĕpi mē nī trĕn. Zmājī škōvi nĕ fŭnd tē ūjt, ě atā ĩpĕn nĕ bōrk ě ōrdĕn nĕ tōk.

U nisĕn ě škōvĕn tē krāli ě krāli ōĕ i kuntĕnt mē pō bīn sē pō jā bien, aštŭ bŭkur ĩ kō prīt ě kō prīt ě kō rīt nĕ bjĕsĕd me tā, ě j pĕvĕtĕn kŭš ě kō ōie – ě tia kōmĕ kĕn. Kŭ mē kanoĕāl sōvi: “ŭn ě kām ōĕt – jĕmjā dŭĕt mē kĕn’.

- Mīrpō, vlō, kŭr s ě kiĕš ŭn gusurŭo - jōtja s’kiš m ě kĕn, vān dŭĕnte m ě kĕn jĕmjā.

I tretī sōt: dā s ě vrāva ŭn zmājīn – tē ōi nā kiš āngĕr, pēr ta dŭĕt mē kĕn jĕmjā.

I káterti sôt dā s'kéva ūn pēr mē cēp bōrken, tē ī ē kiñem mbüt, pēr tã düet vājza mē kēn jēmja (tēmia).

Králi ĵu sôt: “kurkūĵ kūró! Bij kómē kēn émja, ě ĵūve tūk io kĵo kulēt mē ōr ě ĵū sôt škōni nē špī ě kēni mē mūĵt mē mbēt óol būkur”.

Kūr kán ārd nē špī tãta i pēvétěn sī kō vōt pūna, ě atã ī gazōĵn sē ěšt mīr ě sē s'ĵū düet óoja ě tãtēs, ě tãta ĵū st: “Tē ĵū kiñēš mbōĵt nē špī, s'kiñet pāt kurnāni kūró”.

Tregoi Zef Marshani, bujk nga Arbēneshi i Zarēs

Kō kēn nī nān ě vōrfum ě kō pāt šum fēmī e nevōja ě kō štringuo ě ĵ mēr dü cē, i špiě mē ĵ šit. Si aĵō škōĵ mē ĵ šitē ndēšin dü nēr ě škōĵn mās sōje. Nāni ĵētěn nī cōp ūle mbrāpa, ě tĵetri mās sōje mē pō ċiš pō bōn aĵō mē kětã dü cē. Kō ārd) nē pazōr ě kětã dü ī kō šit, ě kō mē ĵ mār āsērt, ě kū kō pō sē aĵō i kō šit ě škōvi mbrāpa m'ī gaóuo šokut š' kō mbēt mbrāpa. Kĵō gruo u nxis m'ū ksue nē špī, ě ndēši mē āt i sili kō mbēt mbrāpa ě ĵ sôt: “mīr dīt, gruo, lārg tí?” E aĵō ī sôt: vóta nē špī. I sôt āĵ: “Aštū m'ō kánda, škōĵm bāšk, aštū vīm pára tūe besĵeduo”. Kūr kán ārt nē ūl krúć kū nēr i sôt: Áña ě přejm ūlēm ūlěn kēsājt sē pára vīm ... E aĵō kō kēn ě kontént ě škōvi mēt (mē t). Mās sē kán bō ĵō kēc ūl, asōĵĵō bō se kĵō ūl nūk pē špiě nē špī. Aĵ sôt sē ěle pāk vīm nē špī. Kūr kán ārt nē vēnd kū kō dāš āĵ, ndālěn ě sôt: “Kēmi ārt atū kū düet, ě dāĵ (=am) āsērt, štátin”, ě aĵō zōvi mē kĵō ě mē lūt mōš mē ĵ bō óo sē kō šum fēmī, s'kō kērķēn, ě sē ěšt šum ě vōrfum; āĵ aĵ s'kō dāš mē dīt pēr kūró vān mē ĵã lān āsēt ě aĵō ĵã lūvi. Mās sē ĵã lūvi e bēvi m'ū zvīš garagūć ě ě prūvi āfēr nī bire tē mále; aĵō u kujtōvi ċiš pē přēt ě ĵ sôt: “Tē lūs līlmi sūt mōš tē pōñ ċiš pō mē ndólet; e āĵ e mōri faculētěn, e tue ĵa līl sūt asōĵ, aĵo e štūvi āt nē bīr. Düet mē dīt sē kū pára sē ĵã lili sūt, i ċiti robēt tē gruos nē bīr, aštū tē tãš mbēti garaūć; e aštū garagūć u nisi mbrāpa, e tē pára špiĵa š' dēši, kō lūp pāk robē mē mbluo ndērĵen, e k(e)štū ě višum ōrdi nãĵ tē mbřetēt ě gaóovi ói sī kō kēn. Atã tē mbřetit kán vōt mēt (mē t) mē pō kū ěšt aĵō bīr, ě mē vēte kán prū nērīn sili dō tē škōne mbrēnda nē bīr. Kēštū e kán óēt nēr mē āsēr tē sōja; atū n'āt bīr bāšk mēt kán óie šum krēñ.

Kü kür dōli jăšt i prūvi më vête šolat të gruos e ja luvën asōi šolat e robën, e kân lân šum ljeta ndim përsë më këtā e kō gazūo ċiš ěšt ndōl e ċiš kō mūjt m’u ndōl.

Zef Marshani

Martesa e vlazēnve

Kišin adēt, đā m’ni vën me kīt nī đūpër kūr t’škōnin me u fejūo. Ĕ kiti, đā mā ĩ pāri vlaš° ě škōj n’ni špī; u fejūo ěde u martūo. E kiti, đā ěde ĩ dūri, ěde arī ĩ škōj n nī špī; u dejuo ěde u martūo. Ĕ kiri i trēte vlaš°, i škōj n’ni ċūb: atēr i dān mülk me kīt prāp, e kiti prāp e škōj atū.

Atēr mōri sáfēn e rrrōi? n’ċūb, atū gēt ni žāb me rāšt aĳ dĳāli ĩš puntūr, škōnte n’ pūn, kūr vinte n mrāmĳē, t’ ģiđā punt i ģēnte t’ rahatūome; masanĳ ĩu mūš mēni me ĩ ruoĳt: küš ja bān punt. Kūr dōli nī nūse e mīr pēi asāĳ rāštet atēr hūpi mrēn e mōri pēr dōre, aĳ bērtiti: “Amān, rāštēn mōs mā škūej”. Ĕde ě coptōjĳ ja đā prāp ě aĳo ě štīu n’ó ěpa. Atā kĳĳn t’ birit merētīt, i điri mrēti n’ gōst t’ trē dĳĳt me t tri nūse; atēr dāni gōst t’ māde; ě kišin adēt nūset me kcūe. Atō kcēnin ě nūses s vōgĳl ‘ ĩ knōnin bül ‘ būlat n’ ěp; ěde ĩš ě būkĳr porsi drita. Škūon t ģil n špiĳa t’ vēta. Ĕ điri dĳālin ě vōgĳl mrēti, ě ĩ đōt: “Tāš, dĳāl mem prū nī bostān, me ngī t ģil askērin”. Ĕde kü pō vĳĳn n’ špī i ĩlt.

1955

Simë Malaj, nga Shestani, 30 vjeçar

Koleci e žukosi

Ni tē štūnde škōvi Kolēci nē pazōr. Kō šetīt pak atĳĳ – kân tūe šĳūa ċināat e baktīt. Iō kāp sūš nī s(đ) ĩ, o kōc e mīr. U ndāli pāra zōtīt te s(đ)ĳut, nī puntōrit, ān e pēvēti sō po kĳrkōn pēr đin. Kü ĩ sōvi: “Šĳōĳe mīr siun, antēna fōlim”.

Kolēci, tūe šĳūa siun pē ĳi ónaš, s(đ)ōt puntōrit, më būz nē ngāz: “Tī

põ sua sě ěšt siu, ě ůn põ sō mīr sě ěšt dōsa. Budāl, e jo nēr ōl põ mendōn sě mūš mūa mě mě gěñüe!”

- Kī kě sān vĕt i pāri, e jo ůn, kur me ke pĕvet per baktium, se ěšt sit, – u ěš puntori e ia šou nanen aštu si po me daš.

U lĕz Kolĕci nĕñibot s flāka, e ěōj dōren, ān jǎ krisi krĕs puntōrit aštŭ sě jǎ per áaku fácen. Škōvi puntōri ěle āt dīt, nĕ ůúc me kĭd Kolĕcin. Kō ārd dita e ůuk'mit. Nĕ ůúc i pāri e kō mār fjalĕn puntōri. Kolĕci i kō ěua vĕšet si ljĕpuri e ndigŭa mīr ōjĕlĕn fjal tĕ kĕtit. Kŭr kō mbarŭa puntōri, pĕvĕti ůukōsi Kolĕcin, ěiškō aĭ me ka ůa. Kolĕci s(ŭ) ōvi se s kō kŭrĕ. ůukōsi po ěuditet ě pĕ pĕĉĕtĕn sě sĭ s kō kŭrĕ mě fōl. Kolĕci n'atǎ sōt ukōsit: “Nŭk kām ěiř mě fōl, pĕřšĕ nĕri kō ka ůa sĭ kō kĕn”. “Mirpo”, e ěōvi zānin ůukōsi, pĕřs atĕr jǎ kĕ nĕit!?” N'atǎ Kolĕci: “Dot p mendōni, zotnĭ, se m'ō dāř me pŭs pĕr atǎ s'ma kō šō nānĕn?” Sigurĭřt pŭna s kō kĕn pĕr t'ŭ pŭsum, ama tĭ nŭk kĕ derit me nĕit.

- Uň jō, po sua, e vān kŭř atĕr? – sōvi Kolĕci e mbĕti me gōj tĕ āpĕt.

- Kurkŭř – jǎ perĕĕi škŭrt ůukōsi.

- E, ata nuk muĕne me ken.

- Aštŭ ěř lĕǎa, a põ mĕř vĕřt! Tĭ nŭk guōn me lān frakaleša.

N' ěřt aštŭ, bĕsa, fōrt e mīr ěřt lĕǎa! – sĭ t'ŭ dāř mě u ěš sōvi Kolĕci, e jǎ kō derit me šō nānĕn!? ůukōsi kō zān m u ilnŭa:

- Tĭ nŭk guōn mě frakalešŭa, a põ mĕř vĕřt!?

- E āj guōn me šō nānĕn!? – sōt Kolĕci e, tŭe mbĕl vĭĕtulat, põ řigōn ukōsin nĕ sŭ. ůukōsi u turbulŭa:

- ř põ m'řigōn!?

- Psĕ kām sŭ!

Tāř u ilnŭa ůukōsi ěle mō řŭm, u ěōvi pĕ katrige āni řtŭpi mě dōr nĕ trŭĕs e zijti mě řĭ zō mě bĕřtĭt: “Tĭ s'guōn mě rā!”

- Un nŭk guzōn mě rā, mirpo, muń me ra-pĕřĕĕi Koleci. Zukosi, ĭ ilnuom me řĭ, bĕřtiti:

- A põ dĭ tĭ mě kĕn põ fōlĕn!?

- Pō dī, sī jǒ, pǒr ũn dōt štūpiń, zōtni ũkũos, ũkō! – bĕrtiti tǎš e Kolĕci.

ũkōsi ũ ũl tue frũ, antĕna mĕ zō tĕ ũlĕt sōvi:

- Kũr pō mbōet ōc tr idĩmb, dōt tĕ kōmĕ kĕn mĩāt āšt mōj bũrk pĕr m'ũ sũa mĕnd ě mĕ dīt sī dũet mĕ fōl.

Mǎs kĕtō fĩalĕš jǎ lezōj ũkōsi kondonimin, e u mbarũa ũkimi.

**PAMJE HISTORIKE E
LIGJËRIMIT SHQIP TË
GJAKOVËS NË FILLIM TË
SHEKULLIT XIX**

PAMJE HISTORIKE E LIGJËRIMIT SHQIP TË GJAKOVËS NË FILLIM TË SHEKULLIT XIX

Hyrje

Që në ballë të këtij vështrimi do të themi se titulli i sipërm, sikur ndamë ta quajmë, nuk do të mundet t'i kënaqë ata që e pandehin atë trajtim të rrasët mbi ligjërimet shqiptare të kësaj treve: njëherë, sepse na mungojnë pothuajse kryekëput të dhëna dialektore të shkoqura, që do të na jepnin krah e dorë për të bërë një vëzhgim të mirë rreth të folmeve në truallin e Kosovës. Edhe më parë, kushdo që kishte marrë të hetonte ndonjë prej ligjëtimeve të këtyre viseve, për mungesë materiali të saktë gjuhësor, pak gjë ka nxjerrë në dritë.

Në lidhje me dialektologjinë shqiptare, po m'u lejua, do ta thosha një të vërtetë të provuar, porse të hidhur, se studimi i shqipes kishte zënë fill disi mbrapshtë, jo ashtu sikundër janë gjurmuar gjuhët e tjera indoevropiane. Do të ishte rrugë e mbarë ajo që studimi diakronik i shqipes, që do të thotë dukuritë e saj të kapeshin në vijën e zhvillimit të tyre historik, të ketë pasur një vistër të tërë pune përgatitore në lëmin e filologjisë dhe të dialektologjisë shqiptare. E hetime shkencore të shqipes në qarkun e studimit krahasues të gjuhëve indoevropiane filluan, mund të thomi për afërsisht vetëm këtu e një shekull më parë. Në gjendjen e asaj kohe të dijes shqipja njihej fare pak. Linguistët mund të përdornin vetëm një pakicë fjalorësh e botimesh të tjera, të qëmtuar poshtë e lart. Njohja jonë e dokumenteve të vjetra gjuhësore, rezultatet e të cilave kanë rëndësi të dorës së parë, është tepër e kufizuar. Në punën e vështrimit të shqipes, në anën tjetër, ka peshë shumë të madhe studimi i dialekteve për arsye se burimet e shkruara të gjuhës sonë datojnë shumë-shumë në kohën e pushtimit turk të Ballkanit.

Nga burimet e vjetra gjuhësore, tëbotuara për herë të parë në ligjërim të tyre, me dialektet e shkrimtarëve të Kosovës ka të bëjë vepra e Pjetër Bogdanit që doli në dritë më 1685 në Padovë të Italisë. Pasi ngrehu banimin e vet në Shkodër, Bogdani jetoi atje një kohë të gjatë; por në shkrimet e veta nuk mundi t'i rrinte larg gjithherë ndikimit të shkodranishtes dhe të të folmeve të tjera të atyre anëve. Për këtë arsye, përse u përket shfaqjeve fonetike, gjuha e Bogdanit, megjithëse ky bir i këtyre tërthoreve, vetëm në rasia të rralla ruan gjurmë të kosovarishtes së asaj kohe.

Një prej tipareve kryesore të gjuhës së Bogdanit, si na dëshmojnë shkrimet e tij, na qenka ndërrimi i bashkëlidhjes tingullore *kl, gl* në *k, g*, bie fjala: *gasë*, shkodr. *g-jasë*, të *dala nga trajta e hershme glasë*, një cilësi kjo dialektore që vërteton vjetërsinë e një dukurie gjuhësore të së folmes shqiptare të Kosovës. Ky ndërrim vërtetohet edhe më vonë në *Vocabulario della lingua epirotica-italiana*, Romë, 1875, në të cilin, ndryshe nga forma e shkodranishtes *gjaat*, në gegërishten veriore kemi trajtën *gaat* (*gāt*), domethënë, në vend të okluziveve palatale (bashkëtingëllore mbylltore qiellzore) *gǵ, gǰ* paraqitet grykorja *-g* prej së vjetrës *gl*, e fjala vetë, sikur e vërtetoi Vasmer,¹ Stud. 39, do të nxirret nga një dhngt-to=*gl' atë*, e jo prej trajtës së vjetër *dhlough-to* sikur mendonin Pedersen,² KZ, XXXIII, 544; XXXVI, 308, dhe G. Meyer,³ Albanische Studien, IV sepse prej saj do të përftohej një *gǵandë*, tosk. *Gjëndë* khr. H. Barić,⁴ Lingvističke studije, Sarajevo, 1954, f. 17.

Pas Bogdanit në gjuhësinë shqiptare vjen gjakovësi Nikollë Kazazi, i cili më 1743, botoi në Romë, *Doktrinën krishtene*. Në mungesë të tekstit të *Doktrinës*, na në këtë rasë nuk do të mundemi ta shqyrtojmë gjuhën e tij, e përse e njohim nga një copë e shkurtër, mendojmë se autori i saj nuk ka ndonjë individualitet të caktuar gjuhësor; krahas trajtës *uo* të diftongut, te ai takojmë zakonisht edhe *-ue*, prandaj, në lidhje me veprën e Kazazit

¹ Max Vasmer, Studien zur albanesischen Wortforschung (Acta et Commentationes universitatis Dorpatensis B.I.) Dorpat, 1921, f. 1-71, 39.

² Holger Pedersen, KZ, XXXIII, 554; XXXVI, 308.

³ Gustav Meyer, Albanische Studien, IV, 81.

⁴ Henrik Barić, Lingvističke studije, Sarajevo, 1954, f. 17.

përgjithësisht do të thoshim se vlera e saj peshon shumë pak në punën e vëzhgimit të historisë së shqipes. Me vdekjen e Kazazit, me të cilin merr fund veprimtaria gjuhësore, letrare e kulturore e autorëve të vjetër shqiptarë, në letërsinë shqiptare për një kohë të gjatë kemi një golle e në kulturën e shqiptarëve të Kosovës, të zhvilluar në dialektin e tyre, zotëron një amulli dhe shterpësi.

Në fillim të qindvjetëshit XX, prifti Kujunxhiç që punonte në Gjakovë, më 1902, botoi një fjalorth me titull *Srpsko-arnautski rečnik*. Autori i fjalorthit – thotë sheshazi se ai nuk ngrehte kurrfarë pretendimi të jepte një vepër shkencore në fushën e leksikografisë. Sikundër pohon edhe vetë, autori thoshte se kishte qëllime praktike: t’u lëshonte në dorë bashkë-kombasve të vet të Serbisë Jugore dhe të Maqedonisë një doracak kësisoj që ta nxënë gjuhën e *fqiut* të afërm – shqiptar, sidomos në ato vise ku bashkëjetesa e tyre daton qysh në kohën e mesjetës së hershme.

Fjalori në shqyrtim paraqet dialektin e Gjakovës.⁵ Megjithë rëndësinë e madhe e në mungesë të plotë të veprave kësodore leksikografike dhe dialektologjike, Fjalori ngërthen në vete shumë të meta gjithfaresh,⁶ të krah. *Vlera dialektore* e Fjalorit serbisht-shqip të Kujunxhiçit.

Vuk Karaxhiçit, siç dihet, i detyrojmë qëmtimin e disa këngëve popullore shqipe. Në gjysmën e parë të shekullit të kaluar, duke mbledhur material dialektor në truallin e serbokroatishtes, në Kragujevac a Krlevë Vuka u takua me një murg nga Gjurakovci, që quhej Dovica Obadoviç (ndoshta Novica Obadoviç) e që për punë të veta kishte ardhur në Kragujevac. Murgu Obadoviç i diktoi Vukës disa këngë popullore, gjithsejt 12. Vuka shqipen nuk e zkotëronte, as që e merrte vesh, mirëpo, as njohja e Obadoviçit murg nuk ishte e mjaftueshme. Ndër material gjuhësor, që

⁵ Çështjen e identifikimit të trevës gjuhësore të fjalorit të Kujunxhiçit e ka shtjelluar në mënyrë të thelluar Hilmi Agani dhe mbi dëshminë e shumë të dhënave gjuhësore, ka vërtetuar bindshëm se treva gjuhësore e Fjalorit të Kujunxhiçit nuk ishte Gjakova, as gjakovarishtja gjuha e tij, porse vërtetoi se gjuha e Fjalorit ishte e folmja shqiptare e Rahovecit.

⁶ *Anton Çetta, De la Valeur dialectale du vocabulaire serbo-albanais de Kujundžić, in Godišnjak I Balkanološkog instituta Naučnog društva NR Bosne i Hercegovine, Sarajevo, 1957, f. 212-242.*

mblodhi Vuka ka lëkundje fonetike dhe gjuhësore gjithfarësh, fjala vjen nuk shënohen kurrkund zanoret hundore, pastaj nuk janë të rrallë shembujt e ndërrimit të fërkimores së zëshme ndërthembore me dhëmboren e thjeshtë, një gjykim këtë që ne nuk mund ta pranojmë kurrsesi, sepse një shfaqje e tillë fonetike nuk mund të ndeshet as sot në atë të folme, e për pasojë, janë të pakta mundësitë e ekzistimit të një shfaqjeje kësodore këtu e më se njëqind vjet më parë.

Në fillim të këtij shekulli, më 1916, albanologut të mirënjohur Norbert Joklit, i ranë në dorë 12 këngët e regjistruara prej Vukës, që në mbështetje të tyre Jokli nxori një studim tërrasët dhe ribotoi më 1921, në një edicion kremtues, të kushtuar veprimtarisë linguistike-dialektologjike të dijetarit serb të Beogradit Aleksandar Beliq.⁷

Më 1935, Lukë Luka nxori në dritë në Beograd, Fjalorin shqip-serbokroatisht (A-Gj) ku, përherë të parë u regjistruan fjalë që s'i kishin fjalorë dygjuhësh të botuar më parë. (Recensionin ia bëri P. Skok, në Revue Internationale des Etudes Balkaniques, 1935).

Më në fund, në një edicion të Akademisë italiane, më 1942, prof. Karl Taljavini u përpoq t'u bëjë një sintezë të gjitha botimeve, të shtypura në dialektin shqiptar të Kosovës, shoqëruar me një sy kritik.

Është punë paradoksale, por e vërtetë, se megjithë sintezën që Taljavini përmbodhi mbi gjendjen diakronike e sinkronike të së folmes shqipe të Kosovës, në të vërtetë ne as sot e gjithë ditën nuk kemi studime të thelluara të mjaftueshme.

Në një artikull të botuar në Arhiv za arbanasku starinu, jezik i etnologiju, br. 1-2, f. 231-234, H. Barić, studimit në fjalë të Joklit i bëri disa plotësime dhe ndreqi pak lajthime që i kishin shpëtuar dijetarit të vjenës, për veprën e të cilit përfundoi duke u shprehur me fjalë lavdërimi dhe e njehu për edicionin më të mirë të llojit të vet.

Në Jetën e Re 1951/6 të dymbëdhjetë këngët i botoi Hasan Kalesshi duke i shoqëruar me koment.

Në studimin e tij me titull: O radu Vuka Karadžića na uključivanju albanske narodne književnosti u evropske okvire, Medjunarodni slavistički centar, Beograd, 12-18, IX 1974, Prof. Shefqet Pllana, mbi dëshminë e të dhënave të reja i saktëson disa gjykime.

Pas kësaj pamjeje të shkurtër mbi materialin gjuhësor të shtypur deri më sot mbi ligjërimin e shqiptarëve të Kosovës, dëshirojmë duke përfutuar nga rasti, të bëjmë disa vrojtime në lidhje me zhvillimin e gjallërishëm të literaturës shqipe, të shkruar me alfabetin arabo-turk në truallin e Kosovës.

Do thënë mirëfilli se kjo lloj letërsie – material i vlefshëm dialektologjik, zuri të shfaqej në këto krahina të pushtuara prej turqvet jo shumë kohë pasi u vendosën ata në këto troje.

Kohën e fundit, në saje të interesimit që stihoi kureshtjen e inteligjencies sonë të re, u zbuluan disa vepra, të shkruara te ne me alfabetin arab, në gjuhën shqipe, që janë garanci e fortë se gjurmimi i mëtejshëm do të kurorëzohet me gjetjen e veprave të tjera kësodore me anë të të cilave do të ndriçohen shumë çështje, të mbetura pezull deri më sot.

Për nga vjetërsia vendin e parë e zë *Vehbija* e Tahir Efendi Boshnjakut nga Gjakova, e shkruar me të gjitha gjasat, më 1835 dhe e botuar në Stamboll.⁸

Nga mbarimi i shekullit që shkoi, pa dritë një mevlud, i shkruar me alfabetin arab, autor i të cilit është Tahir Efendi Popova prej Popovës së Vuçitërnës.

Pak më vonë sheh Maliq Rahoveci zuri të merret me shkrime letrare, që i botonte me alfabetin arab. Trashëgimia e tij letrare është e pasur, por mjerisht, ka mbetur djerre, pa e pasë marrë në dorë ndonjë mjeshtër, që ta ngjeshte për studime gjuhësore. Të gjitha dorëshkrimet e sheh Hilmi Maliqit, si pat mirësinë e më kumtoi shoku Mark Krasniqi,⁹ ruhen në Teqen e Rahovecit nën kujdesin më të madh të Shehut të atjeshëm.

⁸ Këtë vepër do ta hetojmë në këtë vëzhgim, prandaj u dha shënimi më i përgjithshëm i saj.

⁹ *Mark Krasniqi* nxori në dritë duke botuar disa episode nga vjershat e Sheh Hilmi Maliqit, krh. *Jeta e Re*, 1953/5, f. 260-266. meqë transkribimi, që na u tha në numrin e ckeur sipër të *Jetës së Re*, nuk është bërë në pajtim me kërkesat e fonetikës së përgjithshme, na nuk i shohim tiparet kryesore fonetike të dialektit që paraqesin vjershat e botuara.

Dokumenti më i vjetër i shqipes së Kosovës i shkruar me alfabetin araboturk

S'ka kaluar shumë kohë, që zunë të kërkohen e të studiohen dorëshkrimet e shqipes, të shkruara me alfabetin arab. Kundrejt trashëgimie gjuhëtarët shqiptarë e të huaj, pas mendimit tonë, kanë mbajtur qëndrim, në mos përbuzës, indiferent po sigurisht. Dikur nga të dhëna asisoj të dala prej librash fetare e të shkruara prej hoxhallarësh e myderrizash të pajisur shpeshherë me kulturë të gjerë teologjike dhe me njohje të thellë të gjuhës shqipe, mund të ndriçoheshin shumë çështje të errëta në historinë e shqipes, sikur edhe mbi bazën e dokumenteve të shkruara në ndonjë prej gjuhëve indoevropiane. Është e vërtetë se një dokument gjuhësor, i shkruar me alfabetin arab, për mungesë shenjash grafike, që të pasqyrohen të gjithë tingujt e shqipes, nuk lejon të nxirren përfundime e përmbyllje të hollësishmenë fushën e fonetikës si një dialekt, mirëpo as një dokument tjetër i paraqitur me alfabetin e ndonjë gjuhe të Evropës, në lidhje me shfaqje të ndryshme gjuhësore përgjithësisht nuk do të mundet të na kënaqë kërsërinë tonë mbi këtë çështje filologjike a linguistike.

Në fushën e kësaj veprimtarie janë bërë përpjekje që të shpiket shenja grafike, me fjalë të tjera, shumë filologë janë rrekur që alfabeti arab t'i përshtatet gjuhës sonë. Mjafton të përmendin Rexhep Vokën nga Tetova, autor i "Mendimeve" e i shumë veprave të tjera, për të cilat kishte krijuar një alfabet arab, i cili natyrisht, s'ia linte dalë alfabetit të sotëm të shqipes, dhe kishte 44 grafema.

Ata që erdhën pas, ndoqën rrugën që kishte marrë Rexhep Voka, duke ecur në atë shteg, në shtegun e përshtatjes të së njëjtës grafemë me pak modifikime për ta pasqyruar sistemin fonetik të gjuhës sonë.

Në pasqyrzën që dhamë, nuk përfshimë të gjithë ata shkrimtarë dhe veprat e tyre të shkruara me alfabetin arabo-turk; këtij vështrimi i ramë rrëshqitas.¹⁰ E në këtë sprovë të përvuajtur vëmendjen tonë e kemi

¹⁰ Sikur të bënim një përshkrim vetëm sa është zbuluar deri më sot në fushën e kësaj

përqëndruar kryesisht në paraqitjen e një pamjeje të tipareve kryesisht fonetike të ligjërimit shqiptar të qytetit të Gjakovës këtu e më se njëqind vjet më parë; e kemi fjalën, sikur u cek në fillim të këtij vëzhgimi, të *Vehbija*, e cila e kthyer në shqipe do të thotë *dhuratë*, *dhunti*, një vepër kjo që doli në dritë në Stamboll më 1835.

Autori i saj është Tahir Efendi Boshnjaku prej Gjakove, njeri me kulturë të gjerë teologjike dhe njohës i mirë i shqipes, sikundër dëshmon vepra saherë e zënë ngoje. Mbiemri “Boshnjaku” duhet kuptuar ashtu që të parët e tij të jenë shpërngulur prej Peshterit të Sanxhakut dhe kishin themeluar tbanën e tyre në Gjakovë. Me rastin e qëndirimit tim në Gjakovë me qëllim studimi të së folmes së saj, Baba Qazim Bakalli nuk u kursye të më jepte sa më shumë shënime në lidhje me origjinën e autorit të kësaj vepre.¹¹

Ai më kumtoi se origjina e tij do kërkuar ndër shqiptarë të Plavës, të Gucisë,¹² porse nuk dihet se në ç’kohë të parët e tij erdhën e zunë vend në Gjakovë.

Tahir Efendi Boshnjaku s’do të përzihet me Tahir Efendi Llukë Gjakovën dhe ai, veprimtaria e të cilit kronologjikisht nuk puqet me të Tahir Efendi Boshnjakut, i cili me sa dihet na ka lënë vetëm Vehbijen, e Lluka – një mevlud të botuar në Stamboll.¹³

Përveç 16 vargjeve të invokimit në ballë të saj, vepra mban edhe

veprimtaria, - s’ka dyshim se do të na dilte një vepër e vëllimshme me vleftë të madhe për historinë e shqipes. Në lidhje me këtë çështje, Hasan Kaleshi bëri një panoramë të përgjithshme mbi veprimtarinë letrare, të botuar me alfabetin araboturk, të fetarëve në trevat e banuara prej shqiptarësh në kohën e Turqisë, krh. *Godišnjak Ballkanološkog instituta naučnog društva NR BiH*, Sarajevo, 1957.

¹¹ *Hasan Kaleshi*, po aty, disi ndryshe e sheh këtë problem, ai thotë se quajtja “Boshnjak” do të ketë mbetur prejse myderriz Tahiri e kishte bërë zakon e shtegtonte nëpër vise të bosnes, për ç’gjë mori emrin “Boshnjak”.

¹² Në një studim mbi veprën *Doktrina e Krishtenë* të Gjon Nikollë Kazazit, dorëshkrim, H. Agani “Boshnjakët” e Gjakovës i bie të ardhur nga Peshteri, sepse gjuha në veprën *Emni Vehbije* të Tahir efendi Boshnjakut në shumë pika pajton me të ligjërimeve shqiptare të atyre anëve.

¹³ Mbi këto pika shprehu mendimin e vet, në veprën e përmendur, shoku *Hasan Kaleshi*.

treqind e katër vargje si dhe 12 të tjera, që autori i quajti Bajramije e që kanë të bëjnë me festën e bajramit. Ky libër u shkrua në vargje e prozë, në pajtim të plotë me traditën e letërsisë persiane, me qëllim që t'u vijë në ndihmë hoxhallarëve me rastin e mësimin në popull. Në vepër flitet kryesisht për mrazëtinë a kotësinë e jetës, mbi xhenetin, xhehnemin, mbi detyrat e njeriut përgjithësisht, mbi detyrat e burrit ndaj familjes, mbi dijen dhe vleftën e saj, mbi përvujtninë, prozhmimin, koprracinë, etj. khs. Hasan Kaleshi, Godišnjak I Balkanološkog instituta instituta, Sarajevo 1957, f. 362.

Kur është fjala për Vehbijen, do të themi që ajo u transliterua në fillim të shekullit XX, më 1907, dhe u botua në Sofje. Transliterimin dhe transkribimin e bëri Ismail Haxhi Tahir Gjakova. I parë nga aspekti i kriterëve shkencore, transkribimi nuk është pa të meta e lajthime të shumëllojshme. Nuk jemi në gjendje ta arsyetojmë autorin, pse nuk i është mbajtur origjinalit, por vise-vise, në vend që të lexonte, bie fjala: *Ķetër, Ķind, Ķilln, Ķesin, Ķüş, ka marrë dhe i ka modifikuar çetër, çind, çillon, çesin, çüs, etj.* Kjo mënyrë veprimi na tregon, në anë tjetër, që okluzivet palatale origjinale *ĳ, ĝ*, ishin afrikatizuar në *ç, xh* një gjendje qysh ruhet sot e atë ditë.

Po qëndruam në parimet shkencore, transkribimi në shqyrtim është mjaft i mangët, fjala vjen nuk del e kuptueshme pse zanoret hundore mbi bazën e sistemit grafik që autori shtie në përdorim, nuk janë dhënë me ndonjë shenjë të veçantë, për shembull: *ā?*, *ē*, sepse dialekti në fjalë si e folme geqe që është, ka një sistem bivolalik.

Me kaq nuk do të thotë se mbaruan vërejtjet tona mbi transkribimin e Ismail TahirkGjakovës; do t'i kthehemi atij prapë kur do t'i hetojmë ato pika që lidhen me të në një mënyrë logjike të këtij vëzhgimi.

Sistemi vokalik i së folmes së Gjakovës sipas dorëshkrimit tonë.

Para se të bëjmë hetimin e vokalizmit të së folmes së Gjakovës, të parë në dorëshkrimin a në veprën e Vehbijes e shohim të arsyeshme t'i themi dy fjalë mbi alfabetin arab me të cilin u shkrua kjo vepër dhe mbi mundësitë e tij për paraqitjen e sistemit tingullor të këtij dialekti. Dihet mirë se sistemi vokalik i arabishtes është tepër i varfër, që të shprehë gjithë

vokalet e shqipes ashtu si ka mundësi vetë gjuha shqipe me një repertor të pasur vokalesh. Që ta përballojë këtë vështirësi, bie fjala në leximin e shenjës grafike të alfabetit arab **واو** autori ka paraqitur fonemat shqipe: *u*, *y*, *o* dhe *ā*, me të gjitha nuancat e kuantitetit të tyre.

Megjithëse, në gjithë tekstin tonë nuk jemi ndeshur me shumë raste aq të kapërthyeshme, prapëseprapë, te folja **دوقت** nuk kemi qenë të sigurtë ta lexonim *duket* apo *doket* ndonëse trajta e fundit ndëgjohej në gjithë ligjërimin shqip të Kosovës sot e gjithë ditën. Në lidhje me leximin e drejtë të kësaj folje nuk kemi aspak arsye të qëndrojmë me këmbëngulje në mendimin që ajo trajtë foljore të përmbante fonemën *o* që në krye të herës, sepse dhe te Bogdani i Rrafshit të Dukagjinit na dilte *duket*. Me dy mendje kemi qenë saherë jemi takuar me fjalë që mbaronin me bashkëtingëllore grykore *k*, *g*, se cilat ishin mbaresat rasore të tyre *u*, apo *i*, fjala vjen, *petku*: *petki*, *miku* apo *miki*, format me *-i* siç dihet, mbizotërojnë përmbi ato me morfemën *-u* në mbarë idiomën shqipe të Kosovës.

Papërsosja e vokalizmit arab, që është shtënë në përdorim në veprën tonë në shqyrtim, na ka vënë para dilemës a të transkribojmë *a* nasale apo *-o* te fjalët: *kân* apo *kôn*, *rând* apo *rônd*, bāhet apo *bohet*, āsht; osht; *gā* – *gō*, etj. Vokalet hundoret në këtë vepër paraqesin problem në vete, për ç’gjë, edhe pse situatë plot dyshime e luhatje, kemi formuar një mendim të prerë.

Tingujt

Po marrim në shqyrtim sistemin vokalik të së folmes së Gjakovës ashtu qysh pasqyrohej ajo këtu e njëqind e njëzet vjet më parë, për të parë ndryshimin e madh në fushën e vokaleve dhe të bashkëlidhjeve të tyre që në rrymën e kohës pësoi ky ligjërim gegë në këtë truall anësor të shqipes. Një krahasim sado i përgjithshëm i shkallës më arkaike me atë të sotmen të kësaj të folmeje gege margjinale, dëshmon për ekzistencën në atë të folme veriore gege të një fuqie vepruese pa ndërprerë (e vepron edhe sot e

gjithë ditën) në punë të tjetërsimit si në lëmë të vokalizmit, si në fushë të kategorive të tjera gramatikore. Është mirë të vihet në pah se në këtë ligjërim provohet për mrekulli një rregull apo ligj, që e vendosën disa gjuhëtarë në kuptimin që ndryshimet dialektore, në të shumtën e herave përftohen nga një qendër prej nga rrezatojnë ato në vise të tjera skajore të një gjuhe.¹⁴ Porse këtu, për të folmen e Gjakovës, si qendër rrezatimi nuk do të kundrohet me siguri Shkodra, e folmja e së cilës të ketë ndikuar pa farë dyshimi në këmbimin fonemor, morfosintaksor të gjuhës ndër krahina anësore të kësaj zone të gegërishtes. Po e njehëm të saktë parimin e vendosur prej linguistëve, që të folmet e qendrave të qyteteve pësojnë shumë më shpejt ndryshime që shtrihen pastaj deri në tokat më të skajshme malore të gjuhës që e flet një popull, e cila, në përgjithësi, ruan një gjendje gjuhësore konservative, - atëherë arsyet e këtyre risive në tëfolmet shqipe të kësaj treve duan kërkuar në një qark tjetër, në qytezën e Gjakovës, inovacionet gjuhësore të së cilës, të dala njëherë në qerthullin e saj, zunë të përndahen edhe në ligjërimet të tjera të afërme.

Në lidhje me hetimin e të folmeve veriore gege duhet në këtë mes të përmendet edhe një prirje, që ato kanë treguar qysh në kohë të hershme e ajo është tendenca e ndërrimeve a e këmbimeve të ndryshme kryerjeje në fushën e fonetikës së tingujve. Mjafton të zihen ngoje ndryshimet fonetike në fjalët, për shembull: *gla, gia, ga: gas*, etj. në shkrimet e Bogdanit, veprimtaria e të cilit bie në mbarim të shekullit XVII (1685).

Vokalizmi

Mbi bazkën e tekstit të transliteruar dhe të transkribuar të Vehbijes, sistemi i saj vokalik ne na ka dalë me këtë inventar.

¹⁴ E. Çabej, *Buletin për shkencat shoq. 1954/2*, f. 73 dhe në *Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, 1957/2*, f. 207, Matteo Bartoli *Saggi di Linguistica spaziale*, Torino, 1945.

Si në të folme të tjera gege, bivokalizmi edhe në këtë ligjërim është njëri prej veçorive të tij, pra ka një repertor prej shtatë vokalesh, ku duhet të mbahet parasysh që i shtati vokal i reduktuar a neutral qysh e quajmë disa linguistë, del shumë i rrudhur në përdorimin e tij, ashtu që, praktikisht, vokali i reduktuar (ë) është zhdukur duke lënë gjurmë në kuantitetin e vokaleve.

i: î	ü: û	u: û
e: ê	o	
e: ê	(ë)	o
a: â		

Si në mbarë të folmet gege, vokalizmi edhe në ligjërimin tonë në shqyrtim paraqet problem të pështjellueshëm, por edhe kuantiteti i zanoreve të theksuara është gjithashtu i kapërthyeshëm. Lëvruesit e studjuesit e shqipes, në studimet e tyre albanologjike, kanë arritur të konstatojnë tri shkallë gjatësish: *gjatësinë* e vokaleve, *gjatësinë e ndërmjeme* dhe *kuantitetin e shkurtër*. Dozon, Manuel i gjuhës shqipe¹⁵ (1879). Pekmezi, Gramatika e gjuhës shqipe¹⁶ (1908); Vaigand, Gramatika e gegërishtes jugore (1913).¹⁷ Dijetarët që u zunë ngoje, kishin treguar që shqipja, sikundër thamë, paska *shkurtësinë*, *gjysmëgjatësinë* dhe *gjatësinë* e zanoreve, bie fjala, te *māl-a-ja* është e shkurtër, ndërsanë trajtën e shquar *māli -a-ja* merr kuantitet të mesëm duke u kthyer në një zanore me kuantitet të ndërmjeme; *gjatësi* të ndërmjeme, për shembull, kanë edhe fjalët: *nátë*, *pāsë*, *rātë*, kurse gjatësi të plotë kanë vokalet:

Bã, gã, vã, bãr, barĩ, hatã, kã, kē, drũ, frũ, drũ, dũ.

Ligjërimi i Gjakovës, qysh del nga teksti i Vehbijes, sikur edhe të folmet e tjera gege, ka edhe një gjatësi tjetër – gjatësinë kompensative që në këtë ligjërim dhe në ligjërimet e tjera gege përftohet te fjalët e rrokjes paraprise, kur bie e-a fundore e reduktuar: *dadp* > *daad* > *dād*; *ditë* > *diit*

¹⁵ Auguste Dozon, *Manuel de la langue shqipe ou albanaise*, Paris, (1870), 179.

¹⁶ Gjergj Pekmezi, *Grammatik der albanesischen Sprache*, Wien, (1908), 46.

¹⁷ G. Weigand, *Albanesische Grammatik in Südgegischen Dialekt*, Leipzig 1913: 5.

> *dīt; pikë* > *piik* > *pik*; *patë* > *paat* > *pat*; *fletë* > *fleet* > *flēt*; > *botë* > *boot* > *bōt*; > *borë* > *boor* > *bor*; > *arë* > *aar* > *ār*; *anë* > *aan* > *ān*; gegërisht edhe *ān*; *rānë* > *rāan* > *rān*; *kafë* > *kaaf* > *kāf*, por në lakim, në rasi të zhdrejta, gjatësia e tyre e plotë shkon e shkurtohet, pra *rāān*, por *rāāna*. Po zanorja e rrokjeve të shkurtëra në eptimin emëror merr e zgjatohet për një shkallë duke marrë kuantitet të ndërmjeme: *māl, māli, tūl, tuli; būlk, būlku, būjk, būjku, tfūrku, tfūrku, bāc, bāci, i mādh, - i mādhi, i kūq, - i kūqi, māz, māzi*.

Edhe dialekti ynë në studim, sikundër të folmet e tjera gege, njeh tri shkallë gjatësish të vokaleve të theksuara: shkurtësinë, gjatësinë e ndërmjeme dhe gjatësinë e plotë të vokaleve, ndonëse nga teksti që kemi në duar, për mungesë shenjash grafike të alfabetit me të cilin ishte shkruar dorëshkrimi, ka qenë vështirë të veçohet kuantiteti i vokaleve të theksuara. Në transkribimin tonë, te ky dorëshkrim hasim në shembuj, që provojnë gjatësinë e plotë të zanoreve: Ti nī pik tūe kān u bāne i gāt, gān, pra badihava st lān, 13... për me t'rā belāia; š'ka ā škrūe në bāt, s jet pa t'dāl 23; masi kī kān đān për tā kī kštu-ā 28... nuk t'fal gā aj... ka đān žahīli āšt dušmāni üt ani kī žahīli ā kītūe bāba üt... 17; škado me kān tek žahīt ēku āšt mā i kek... sa ā gāt... 17 Këtu poshtë po sjellim fjali në të cilat na del gjysmëgjatësia e vokaleve të theksuara: - Po me ženétin e kán t'gíđ tūe kēs, kuš s muer prej kūj gā...6; me đān kūj... āpa u ndāl për kā ia për gā... 6; Neri ška bān -bān vėti. 9; Masi kī būri āšt mbrėti i grūes i bje kām̄t me ja (n) gēs̄ e me j đān lepe fjals, 10; Təri řahmet zōti i bāni nuk še belāš. M'tūrli belāš u póka përse šókin tem e dóga.. 10; Rnimi i prindēs maskaria e t'birit e s'bīs, 11; Sikur i miri kī pengohet me šēr ashtu i kēki šum hēr pēngohet m hajr. 11; masi kī būri grūes e grūeja būrit pētk jān u bje nāni kētriu me arnūe çdo me kān ..14; kuš rā me cik e bani atā grūe me kāf e muer mā, e j rā me mbajt tūe limue 14; pa u limue škado hūpet-grūeja pa u limue pēlset. 14.

E në vargjet e prura më poshtë, ndeshim në vokale me kuantitet të shkurtër: *Kuš* e forcon dašnīn (e) dūnās i *de/me ju mni& (?)* ūle mās, 15. Në bāft jārāni me t'kek't'mundōjn si me kān i kek, 25; I ngrāti insān kah po gzōhet nuk *dī āi*– 28; Masi kī kān đān për tā kī kštu ā, 28; *kuš* habēr *pāt aj*

hukāti, s'bánì šěř, 28; kuš *ěp* bakšis për çkado, s'ã për kãnd, 28; mend n'pací ti mjaft t'del; mã s'kam me fól, 28; s'ãšt për tã bajram kí bakł avėn aj e pat, 31.

Kur është fjala për gjatësinë e plotë të vokaleve të theksuara të gegërishtes – këtu brenda edhe gjakovarishtja, e djeshmja dhe e sotmja, do bërë një vërejtje, që në këtë kemi një numër të madh gjatësish kompensatore që janë përfutur, bie fjala duke rënë te emrat femërorë *e*-ja fundore e reduktuar e vokali i rrokjes paraprise ka marrë e është zgjatur për nga kuantiteti duke u bërë gjatësi e plotë, për shembull: *pík* (=pikë); *pās* (=pasë); *pāl* (=palë); *tōk* (=tokë); *fjāl* (=fjalë).

- Po se ženëtin e kán gjith tūe kēš; ženet ka për gjith jēt; mier për tã kí hak insanit ka *měkãf* < *kãf*

Mbi zanafillën historike të kuantitetit të zanoreve të theksuara të shqipes janë shprehur shumë gjykime; Hahn¹⁸ te Studimet shqiptare, II (Kontribut për një gramatikë të dialektit toskë, 27), është i mendimit se zanorja e rrokjes së theksuar në përgjithësi del e gjatë; pastaj fjalët njërrrokëshe që mbarojnë me zanore, për nga kuantiteti, pa ashtu, janë të gjata, pavarësisht prej rrethanave, qenë ato më nominativ, apo në rasi të zhdrejta: *bari*, *baríu*. Si në rasën *bari*, si në tjetrën *baríu*, *i*-ja, sipas këtij dijetari, ka kuantitet të njëjët, me të cilin gjykim ne nuk mund të pajtohemi.

Na duket se Eqrem Çabej (Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, 1958/II, f. 207-214), në lidhje me natyrën e rrokjeve të gjata të shqipes, ka hedhur mbi këtë çështje të koklavitur dritë mjaft mirë, duke vendosur disa rregulla të prera. Në kundërshtim me dijetarë të tjerë albanistë, që, ç'është e drejta me shqipen ishin marrë rrëshqitas, albanologu shqiptar i del zot një mendimi tjetër, që zanoret e fjalëve shumërrrokëshe nuk janë të gjata, sepse janë të gjata, por sepse edhe në periudhën parashqiptare kanë pasur gjatësi të plotë, në qoftë se kuantiteti i tyre nuk është rezultati i shkrirjes së disa tingujve, që me bjerrjen e tyre e

¹⁸ G. Hahn, *Albanesische Studien*, II, (Beitrage zu einer Gramatik des toskisshen Dialekt), 27

kanë shkaktuar gjatësinë e zanoreve të shkurtra që në krye të herës. Disa raste të kësaj dukurie në fushën e zanoreve të shqipes, ia detyrojmë Pekmezit,¹⁹ Gramatika e gjuhës shqipe, i cili në fjalën *kūt* nga lat. *cubitus* nëpërmjet trajtës *kuēt* provoi një shkallë më të hershme – *kuēt*, sikundër thamë, kjo shfaqje në shqipe u vërtetua edhe me një rast tjetër nga Pekmezi, me fjalën *kaal* (lat. *caballus*), që duhet të ketë kaluar nëpërmjet fazës *kēalē*, shkrija e së cilës kavatoi *kalē*. Me fjalën *dēt*, arbërishtja e Italisë jugore *dejt* nga indoevrop. *Deub-eto* u mor *Jokl*²⁰ - te *Studime të etimologjisë dhe të fjalëformimit*, vokalin e gjatë të së cilës e nxori nga trajta *deēt* të një faze të lashtë. Me tkurrjen duan shpjeguar edhe rastet siç janë *mjek* prej *medicus*, *pyll* nga *padulem*; *shpirt* nga *spiritus* qysh e gjejmë të shkruar te Buzuku (1555), të cilave në një periudhë më të hershme duhet t'u kenë prirë shqiptimet *mjeek*, *shpiërt*. Përdorimi vetëm në nominativ të shquar i disa emrave në ligjërimi shqiptare të Kosovës, bie fjala *guri*, *kali*, *bari*, *shati*, etj. mbas mendimit tonë, ka të bëjë me kuantitetin e zanores në rrokjen e parë nga fillimi i tyre, që në tëfolme të tjera geqe shqiptohen *guur*, *kaal*, *baar*.

Fati i vokalit neutral -ë

Pasi jemi te zanoret e këtij ligjërimi gegë, nuk do lënë pa zënë ngoje edhe ë-ja e patheksuar, që s'është gjë tjetër veçse përfundimi i reduktimit të një vokali të plotë që s'kishte theks. Për këtë të folme marginale geqe do të theksohet një gjë tjetër në lidhje me zanoren në shqyrtim, do të themi që s'do lënë pasdore karakteri i saj që ndryshon ndjeshëm prej natyrës së përgjithshme të këtij vokali të rrëguar të shqipes. Në të folmet geqe kjo zanore e pathekse sot nuk dëgjohet pothuajse fare; e zuri të tërhiqet nga gegërishtja që lashti, në gjysmën e dytë të shekullit XVIII. Në Gramatikën e Da Leçes, të botuar në Romë 1716, përdoret me të madhe ... - *Punë e*

¹⁹ Gj. Pekmezi, *Gramatik der albanesischen Sprache*, 49.

²⁰ N. Jokl, *Studien zur albanesischen Etymologie und Wortbildung*, 1911, f. 15.

*mirë është qi më parë marënë vesh kaha; ndë mos paça mirë rrjeshtitun fjalëtë ndiema; ... veç për ata Fratini qi vijnë për së largu me i u shërbyem;*²¹ e në shkrimet e Kazazit (1743) shkon e pakësohet... unë po e banj e po ta falinj këtë *pun* teme.

Sa për ekzistencën e saj ndër botimet e shkrimtarëve të vjetër gegë Buzuku-Budi, Bardhi, Bogdani s’kemi fare arsye të dyshojmë, mjafton të marrim një fjali nga gjuha e Buzukut e përfundimi do të jetë krejt i qartë: ende *vëneshtë* the tii ζ in vineam suam ζ ; perindi hi qiellat e *hi dheut*. Sa i përket shqiptimit të kësaj zanoreje po atë gjendje e kemi edhe te Budi e te pasuesit e tjerë të shkrimit të vjetër të shqipes: Budi... *dërejtë* tue *mbe-tunë*... të *shëtundënë* ζ sabatum ζ ; te Bardhi: ... Dita e *shëtund*... embelidhni copëtë që *en betne* e hipërunë *shpatënëh* regjit përpara; Bogdani: ... egni par *petëka*. Kur e marrim në vëzhgim gjendjen e këtij vokali ndër dialekte gege ne nuk mund të pajtohemi me gjykimin e Çabejt, që mbi dëshminë e një rasti të vetëm që ndeshi në HD. XIV ζ 1938 ζ m 92; *Po ta çoj një dhunëti*, arrijti në përfundim se gjysmëvokali i përfillur në të folmen e shqiptarëve të Krajës ζ Brisku-Shestaniç nuk është zhdukur.²² Pas vrojtimeve që patëm rast të bënim për ligjërimin shqip të kësaj treve, ne na rezultoi bjerja e plotë e vokalit në hetim në pozicion mbrapa theksit: Atër mōri safën e rnoj n’cūb, aty ^ et ni žāb me rāšt, ai djali iš puntūr; škonte n’pūn, kur vinte n’mrāmje, t’ ^ iđa pūnt i ^ ente t’rahatuome; masanej ju mush meni me i ruojt: kush ja *bān pūnt*. Kur doli nī nuse e mīr, pej asaj rāštet, atër hūpi mren e mori për dore, ai bërtiti: “Aman, rāštën mos me škyej”!. ...i điri mrēti n’gōst t’tre djelt me t’ri nuse: atër bāni gōst t’māde ζ I. Ajeti, Zhvillimi historik i së folmes gege të arbëneshëve të Zarës, 154 ζ . Zhdukjen e vokalit në shqyrtim e konstatuam edhe në tekstin e transkribuar të Vehbijes: tue nīs thash une allahut-azin- 19; tue kān dēka mā e rānd, 2; Beg e *pāš*e vezir, desin, tōk bāhen rezil, 2; *Štāt pāl*tōk, 4; kuš na do ^ ftyrën, 4; por për ženet vjen me *fōl* kur s’āšt dōr, 5; edhe hakun

²¹ Le të vërehet P. Justin Rrota, *Për historinë e alfabetit shqip*, Shkodër 1936, f. 34-35.

²² E. Çabej, *Buletin*, 1955/2, f. 86.

kan me *lÿp* prej jush, 14; kundër njet kundër zahmet sa $\tilde{a} \wedge \tilde{a}\tilde{t}$, 17; njāni ōa: keš un pa kpÿc n'erbajn, 26; shembujt qē kētu i prumē na dēshmojnē shkoqur zhdukjen e plotē tē vokalit neutral nē pozicion para a prapa theksit, mirēpo, nē kētē rast e nē lidhje me vokalin nē hetim do thēnē edhe një gjē, qē nē tekstin tonē jo rrallē ēstē pērdorur ky vokal; shembujt qē po i sjellim vërtetojnē pohimin tonē: Ehli ehnem jan me zinžir hem me kam, 3; sicili ka nī gÿr mē kāf lidim āšt, 3; mē kēt jet jem zamarit pēr atē jēt jam jaratis, 4; ...nē vend tē *petkavet* me peškve... 4; prej žehnemit *zotÿn* na ruejt e na štift nē ženet me kerem t'vet, 4; *Nē t'rāft nē mēnd* masi t'skōjn dēnt s t ep dobī kuñni sēnd, 5, na tašti kak jem t'pabrīg pēr vor si me pās çelsin e ženetit *n'dōr*. Por pēr me pās me štī n'dōr 5; taš n'dōr āšt \wedge iðkuš, 5; e \wedge ið jan t'drējt, 5; n'ženet jemi, 6; ... tē tān kī faji üt, 6; *jēt* nē žehnem, 7; duhet ti ũrnekun me e *enbajt nē mēnd*, 7; štine gištīn *mē zjarm*. 7; pēr me t'rā *nē mēnd*, 7; kujton kī hi ti m \wedge ũnah nē ženet, 8; mjer pēr tā kī hak insanit ka mē kāf, 8; *mē kēt jēt*, 9; ... nē ženet, 9; *mē dūna*, 9; i keki šum her pēndohet m'hajr, 11; sa mundoheš t'hi *n'dor*, 13; mos kujto kī t'hi *n dor*, 13, dije *tē tān* 13.

Megjithatē ne jemi tē mendimit qē vokali i reduktuar *ē*, edhe pse nē kētē tekst paraqitet nē një numēr tē madh, ai nuk do tē jetē shēnuar, sepse shqiptohēj nē atē periudhē zhvillimi tē këtij ligjërimit skajor gegē, veçse arsyēja do kërkuar nē traditēn e kētille shkrimor dhe nē pērpjekjen pēr t'u paraqitur shqipja me alfabetin e mangēt arabo-turk nē mēnyrēn sa mē tē lehtë, pra, paraqitja e kētille grafike do njehur një pērdorim thjesht konvencional.

Po i quajtmē tē sakta tē tria rastet qē i ndeshim nē tekstin tonē e qē dēshmojnē pēr praninē e zanoreve nistore te ato fjali qē fillojnē me bashkētingëllore hundore apo tē lēngēta nē pozicion antekonsonantik, atēherē domosdo do tē ngrehim edhe njëherē çēshtjen e zanoreve nistore qē po na dalin sot nē rasa sporadike e qē te Buzuku i gjejmē tē pērdorura me shumicē. Thamē po tē jenē tē mirēfillta, po reflektuan gjendjen e atēhershme besnikërisht tē tria rastet tona qē i hasēm nē kētē dorëshkrim, njëherē, sepse nuk mund tē pērjashtohet mundësia qē grafia e tillē do

kuptuar në vëshrimin e përdorimit konvencional të kësaj zanoreje nistore në alfabetin arab, sepse kudo që fjalët në atë gjuhë mbarojnë me bashkëtingëllore pasuesja do të nisë me një zanore që në të vërtetë nuk i takon rrënjës së saj, porse ka të bëjë me lehtëshqiptimin e fjalëve asisoj. Mikloshiçi është i pari, me sa po duket, që e vuri re këtë çështje ndër huazimet latine, që në atë gjuhë nisin me zanore të pathekse, në pozicion nazal a likuid,²³ e që në shqipen japin pamjen e një ndërrimi në kupitmin e reduksionit të zanoreve nistore, bie fjala latinizma *altare* në shqipen do të këmbehet njëherë në *elter*, *lter* dhe *lter*; *argentum* = *ërgjent*, *ërgjând*, *rrgjand*. Mikloshiçi e zgjeroi këtë dukuri duke pandehur që nëpër një shkallë të tillë ndërrimi do të jenë përshkuar fjalët si *ammicus* shqip *mik* nëpërmjet *emik*, që nuk është dëshmuar kund ndër dialekte as nëpër tekste të shkrimtarëve të vjetër.

Në disertacionin e tij të doktoratës mbi hundorësinë dhe rotacizmin në rumanishten dhe shqipen, dijetari rumun Balota,²⁴ shtroi përsëri çështjen e zanoreve initiale në këto dy gjuhë. Kohën e fundit shkencëtari shqiptar Eqrem Çabej i kushtoi këtij problemi një studim të thellueshëm; njëherë e kishte trajtuar atë në një studim mbi gjuhën e Buzukut, Buletin për shkencat shoqërore, 1955/1-2 e tutje, pastaj në Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, 1957/1 f. 96-101. Do të shtojmë, që Çabej rrahu këtë pikë me rëndësi të historisë së shqipes duke shtënë në përdorim material të pasur gjuhësor, të nxjerrë nga vepra e Buzukut që e studjoi e të transkribuar e përgatiti për shtypje.²⁵

Përsa i përket shqiptimit të kësaj zanoreje nistore të fjalëve që fillojnë me hundore ose lëngëtore (n,m) që u pasojnë bashkëtingëllore të tjera, Çabej ndjek ravën e mësuesit të vet N. Joklit, që mendonte se në të tilla fjalë *n*-ja do të ketë qenë sonantike.²⁶ Rezultati i këtij ishte ky: “Zanorja initiale (a, i) e pathekse e latinishtes në këto dy gjuhë ballkanike

²³ Franz Miklosich, *Albanische Forschungen*, II, 73.

²⁴ A. Balota, *La nasalisation et le rotacisme(?) dans les langues roumaine et albanaise* (1925).

²⁵ I transliteruar dhe i transkribuar “Meshari” i Buzukut u botua më 1968.

²⁶ N. Jokl, *Hylli i Dritës*, VI (1930), 150.

u reduktua në pozicion nazal dhe likuid në një zanore të mesme ë”, Çabej, Buletin, 1957/1, f. 99.

Në lidhje me këtë çështje ne dëshirojmë të dimë si do gjykuar kjo dukuri fonetike e shqipes, a do marrë si dëshmi e një gjendjeje fonetike më të lashtë, apo si një shfaqje e vonë që është përftuar në këtë apo atë të folme të veçuar skajore shqipe. Rastet sporadike të izoluara dialektore, numrin e të cilave e shtoi Çabej në studimin e zënë ngoje që ne, po i shtojmë disa të tjera: Çele derën krah em krah, apo krah um krah (krah më krah); t’ëm (t’um falish (t’më falish); u kapën fyt_{em} fyt, fyt_{um} fyt (fyt më fyt); pa kurrfarë dyshimi duan njuhur dukuri e më vonë e disa të folmeve geqe.

Ne besojmë se në frengjishten, në rastin *dame* prej latinishtes *dom(i)na* kemi paralelizëm me dukurinë e shqipes, sepse *o-ja* e fjalës frenge sipas ligjeve fonetike të asaj gjuhe nuk na del e përftuar prej *o-së* latine, khr. Meyer-Lüpke, Historische Gramatik der franz. Sprache, I, porse do kuptuar si lehtësim shqiptimi i *m-së* sonantike, khs. Godišnjak Balkanološkog instituta, I, 1957, f. 199.

Askujt nuk do t’i shkojë mendja të vërë në dyshim ekzistencën e kësaj dukurie në gjuhën e Buzukut, porse shtrohet çështja se si do gjykuar kjo shfaqje fonetike: si dukuri e re për kohën e tij, apo si një konservim i një gjendjeje më të hershme. Po u tumir kjo dukuri e Buzukut si gjurmë e një gjendjeje më të përparme, do të thotë të pranosh që zanoret nistore të pathekse të fjalëve me burim indoevropian a latin në shqipe nuk janë zhdukur përnjëherë, porse kanë kaluar nëpër një shkallë, që na është dëshmuar në gjuhën e Buzukut, me fjalë të tjera do të thotë të pajtohesh me gjykimin që ato zanore nistore, në fazën e parë të jenë ndërruar në zanoren e mesme a të reduktuar, bie fjala nga *altare*, shkalla e parë në shqipen paska qenë *elter*, *lter*, pastaj *lter*; argentum – *ergjānd* dhe *rrgjānd*.

Me këtë mendim nuk mund të pajtohemi për dy arsye: njëherë, sepse zanoret initiale do të vërtetoheshin në të gjitha huazimet në shqipe pa dallim pozicioni, mjafton që ato të kenë qenë të pathekse në gjuhën e burimit; prej latinizmit *amicus* do të pritnim *emik*, një shkallë kjo që

Mikloshiçi,²⁷ pandehte të ketë ekzistuar, khs. Kërkime të gjuhës shqipe, II, 73; pastaj sado që gjuha e Buzukut të pasqyrojë fazën më të vjetër të shqipes, nuk mund të thuhet që dukuritë e saj fonetike nuk janë dëshmuar në dialektologjinë shqiptare, me fjalë të tjera, asnjë shfaqje e vjetër gjuhësore e Buzukut nuk ka mbetur pa u vërtetuar në këtë apo atë të folme shqipe, e sidomos në ligjërimet e arbëreshëve në ngulimet e Greqisë dhe të Italisë Jugore; mund të thuhet që ato të folme paraqesin një pamje më arkaike se gjuha e Buzukut, khs. *Golë*, Buzuku: *gojë*; *shtilë*, Buzuku *shtizë*.

Hundorëzimi i vokaleve në tekstin e Vehbijes

Kur është fjala për cilësinë e zanoreve të të folmeve gege, njëra prej veçorive të dorës së parë, padyshim, është hundorësia e tyre. Kur dihet se hundorësia e zanoreve në një të folme gege nuk pajton gjithherë me nazalitetin e një ligjërimi tjetër gjithashtu gegë, atëherë çështja e hundorësisë shkon e bëhet gjithnjë e më e vështirë. Ndër disa të folme gege, shpeshherë atje ku një vokal duhet të shqiptohet si hundor, dëgjohet zanore gojore e pastër, një punë kjo që dëshmon për prirjen e denazalizmit të vokaleve. Në anë tjetër, në kundërshtim me këtë shfaqje, ndër disa ligjërimet gege ndeshim jo rrallë në vokale hundore sekundare.

Në këtë lesh e li kautik të kualitetit të vokaleve të të folmeve gege një gjë do pasur parasysh, që në këtë situatë e para punë që do bërë është ajo që të ngjitemi në historinë e etimologjinë e fjalës me vokal nazal dhe mbasi të kemi shqyrtuar metodën e gjurmimit etimologjik të fjalës në studim, nuk do të ishte rrugë e gabueshme të ndiqej metoda e krahasimit me natyrën e vokalit gjegjës të toskërishtes, sepse zanoreve hundore *ā*, *ē* të gegërishtes do t'u rrijë kundrejt *ë*-ja e rrëgjuar e toskërishtes.

Në disa të folme gege të fazës së tyre të hershme si dhe të kësaj periudhe, ndeshim në fjala në të cilat në vend të *ā*-së hundore, sikundër do

²⁷ F. Miklosich, *Albanische Forschungen*; II, 73.

të pritej, na shfaqet një *ë* e reduktuar: te Buzuku – *një: gneh* nierii pat dy biih “homo quidam habutt duos filios”. L. Luka, 15; Budi: përdor gjithashtu *një, njā, një*, te Bardhi – gjejmë dy të parat: *një, njā* e te Bogdani regjistrohet vetëm – *njī*, te De Leçeja – *njī*, khs. Çabej Buletin për shkencat shoqërore, 1955/83. Këtyre shembujve, për të folmen e Malësisë së Krajës si dhe për Arbëneshin e Zarës do t’u shtonim disa të tjerë: *është (išt, -Ulqin). bēń, bēn, bēn, bējm*, imperf. *bēńesh* etj. përkundër trajtave *bāń*, etj. Ja se ç’thotë Jokli në lidhje me një – *ë* të theksuar të gegërishtes: “Alle diese Falle *ranë* aus lt. *arena*, Sand *rāni* “ich eile herbie” “Tropfe”; *rā* – Lab: *rend, rēnd* (ich laufe); *lanë*, tosk. *lērë*; gr.: *ωλενη* zeigen also, dass eine Entsprechung des tosk. *ë* vor Nasal einst auch im hrh bothsnfrn war”, Jokl Linguistisch Kulturhistorische Untersuchungen aus dem Bereiche des Albanischen”, f. 281.

Për ne ka qenë punë e vështirë t’i binim në fije ekzistimit të nazalitetit në të folmen e Gjakovës më një fazë t’ëhershme, njëherë sepse grafia e tekstit nuk lejonte të formonim kurrfarë bindjeje mbi praninë e vokaleve hundore të këtij ligjërimi. Shenjë grafike për të paraqitur hundorësinë në këtë vepër, autori nuk kishte rezervuar. Grafema e rezervuar për të paraqitur vokalet *o, u ü* i shërbente autorit edhe për *ā* hundore.

Një rrethanë tjetër që nuk na jepte krah në punën e kapërthyeshme të kualitetit të vokaleve të së folmes së Gjakovës këtu e njëqind e njëzet vjet më parë, buronte nga fakti se në lidhje me këtë pikë ne nuk mund të shfrytëzonim as transkribimin e tekstit tonë të bërë prej Ismail Tahir Gjakovës (Sofje, 1907); nga transkribimi i përfillur përse u përket zanoreve hundore, nuk përfituam gjë, sepse sa herë që e gjetëm *a*-në gojore. Ne na merr mendja se kjo larmi dhe lëkundje në paraqitjen e hundorësisë do kërkuar në pasigurinë e vetë autorit në shqiptimin e zanoreve hundore, të themi në lëkundjen shqiptimore të hundoreve në ligjërimin tonë në fillim të këtij shekulli (1907). As fjalori i Kujunxhiçit, kur është fjala për këtë pikë të natyrës së vokaleve, nuk na shpie në rrugë të drejtë. A-ja hundore këtu është shënuar zakonisht me një grafi me të cilën paraqitej edhe *o*-ja orale,

e të tjerat zanore hundore nuk kanë shenja të posaçme grafike.

Në këtë fushë të errët të fonetikës e në lidhje me ligjërimin e Gjakovës ashtu qysh tingëllonte ai këtu e më se një shekull më parë, ne jemi bindur, ashtu edhe kemi vepruar në transkribimin tonë, se zanoret hundore të së folmes në shqyrtim, pas mendimit tonë, do të jenë një prej tipareve dalluese që atë e shquanin në atë kohë. Ja disa shembuj: Neve s'na bān pra dūna hiç vefa, 1; *dēka āšt mā* e rānd se në vegš me u vlúe, 2; tue kān dička mā e rānd se me u prē me gēršān, 2; por vōrin e dēkēn e vet prej fsāmes nuk dáhet, 2; dāmi i nānit sa ni bjēšk bāhet taman, 3; štati i nānit štāt dit ūd āšt i mað, 3; kã e štērngōjn me tã s'díhet aĭ, 4; neri ška i bān vēti sun ia bān kētri, 4; kur t'pīn ūj kan me ðān se për źenet sa āšt vēnd ktu s'ka ní sēnd, 5; nē t'rāft në mēnd masi t'shkōin ðēnt s't'ep dobī kuřni sēnd, 6; nuk ĩa lān elbete pa ia bā ní źezā, 10; ġiðkuš āšt pēng kur ġūnah bān, šūbe s'kā, 11; dije tē tān me dēk jemi kān, por për sot mūhlet na kān ðān, 13; vet zotūn ða: ðmīn e ġān kuš i mba sēnd, 14; ai i ða: jam un fatbarð saġ me tã, 22; prej harāmit pētrihen kah ana e ġūnahit, 22; āšt ðāšnia e dūnās rāña ġiðsa, 25; mēnd në pać ti mjaft tē del mā s'kam me fōl, ka nā, ka nā, kštu bihaber, 29;

Labializimi: $\tilde{a} = o$

Vendosëm të lexojmë \tilde{a} e jo o sa herë që ndeshëm në shenjën grafike ə , duke u mbështetur edhe në një rrethanë tjetër kur në tekstin tonë nuk hasëm kund në ndonjë rast velarizimi të a -së, që do të thotë në këmbimin e fonemës a me gjatësi të madhe në fonemën α ; ç'është e vërteta në gjithë tekstin tonë të traskribuar kishim gjetur vetëm katër raste me prirjen e këmbimit të a -së në a -hundore: *kām, jān, jān, ān*, e këtë ndryshim fonetik do t'ia detyrojmë fqinjësisë së bashkëtingëllores hundore n , m pranë vokalit a . Tendenca e zënë ngoje, për të folmen shqipe të Kosovës, është krhyer në një shfaqje të zakonshme; sot s'thuhet më: *me rā*, por *rā°*, me *dā=dā°*, *pā=pā°*. Për zanoren a të gjuhës së Buzukut, E. Çabej,

Buletin, 1955/2 f. 85, mendon se do të ketë pasur karakter të mbyllët sepse e gjeti të këmbyer disa herë në -o.

Po deshëm të përmbledhim ç'u tha deri këtu mbi hundorësinë e zanoreve të së folmes së Gjakovës në gjysmën e parë të shekullit të kaluar ne na rezulton ekzistenca e saj për të gjitha zanoret në atë periudhë kohësore; prandaj kur kemi parasysh këtë fakt atëherë është shumë vështirë të tumiret mendimi i Joklit, Vuks albanische Liedersammlung 44, 54, 56, që pranon praninë e *ō*-së, madje të *ō*-së hundore për të folmen e Gjurakovcit në fillim të qindvjetëshit XIX.

Buzorëzimi i zanores *a* në *o* te fjala *molit* për *malit*: *Ele sa ka neri Prizren, kti molit me šku*, Kujunxhiç, Rečnik, f. 135, dijetarin austriak Jokl, një njohës i mirë i gjuhës shqipe, e shpuri në një shteg jo të sigurtë, Untersuchungen, f. 162, duke njehur trajtën *mol* të saktë e mori të ardhur nga një formë të lashtë indoevropiane – *melo*. Duke pandehur trajtën *mol* të padëshmuar kund deri më sot, por që do njehur për *mal*, Jokli këtu shkeli në dërrasë të kalbët, një shfaqje kjo aq e shpeshtë në ligjërimin shqip të Kosovës, pra edhe në të folmen e Gjakovës.

Diftongje e grupe zanoresh

Kur flitet për dallimet ndërmjet gegprishtes e toskërishtes thuhet zakonisht që në të parën përdoret diftongu *ue*, vise-vise, i rrudhur në *u*, e në të dytën *-ua*. Kjo përmbyllje, megjithëse jo krejtësisht e saktë, e marrë në përgjithësi, përkon me gjendjen e sotme të diftongjeve në të folmet gege. Gegërishtja jugore diftongun *-ue* si dhe diftongjet e tjera i ka rrudhur në monoftongje *ue=u; ie=i; ye=y*; khs. Vajgand, Gramatika e gegërishtes jugore.²⁸ Nga gramatika e Francesco Da Leçes, Vërejtje gramatikore të gjuhës shqipe²⁹ dëshmohet që në shkodranishten e asaj kohe përdorej

²⁸ G. Weigand, *Albanesische Grammatik in südgegischen Dialekt* Leipzig, 1913; *Albanisch-deutsches und deutsch-albanisches Wörtèrbuch* 1914.

²⁹ Francesco Maria *Da Lecce, Osservazioni* grammaticali della lingua albanese, Roma, 1716.

shkalla e diftongut *ue*. Në të folët e Malësisë në këtë pikë kemi një përdorje njësore të diftongut; për Dushman të Dukagjinit na dëshmon Cimohovski,³⁰ - E folmja e Dushmanit të Dukagjinit. Malësia e Krajës, ku pata rast të bëja hetime në këtë pikë, nuk paraqitet aq e njësishtme: ndërsa Shestani dhe katundet që i takojnë (Dedan, Bardhanj, Lukiq, Gurza, Gjuraç, Karanikiqi, Muriqi), në fushën e diftongjeve na dalin arkaike, sepse e ruajnë shkallën e diftongut të hershëm *-uo*; Brisku me Lare e katunde të tjera përreth përdor *-ue*; Malësia e Madhe, në anën e kundërt të Liqenit të Shkodrës, në fushën e diftongjeve na jep një pamje të larmishme, sepse herë ndeshim diftongun *-ua*, herë dyzanorshi *-uo*, por edhe *-ue*, khs. Buletin, 1958/2. Për ligjërimin e kolonistëve të Zarës të shpërngulur prej Malësisë së Krajës së Malit të Zi, që themeluan banimin e tyre në afërsitë e atij qyteti, pas hulumtimit tonë, na rezultoi një përdorje alternative *uo:ua*. Në Kuç të Malit të Zi, sikundër dëshmohet nga të dhënat etnologjike të Erdeljanoviçit:³¹ *Dar Kruo* (Ndër Kruo), 199; *Tambli pa vluo*; si dhe prej shkrimeve të Duçiqit, Jeta dhe zakonet e fisit Kuç, 1931: *Kalsuo* (*ka lshuo*); “rojila se” 570; *Mejšortuo* (*me i shortuo*) “Kalemiti ih” 576; *djuotar* (gjuotar) “lovac”; *Mepagua* (me paguo) “plaçati” 576 – kemi një pamje të përdorjes së vjetër të diftongut *uo*.

Në fushën e diftongjeve, e folmja shqiptare e Kosovës paraqitet me një pasqyrëz laramane. Do të provohet që në këtë trevë tash për tash kemi vetëm diftongun e mesëm, me prirje të forta rrudhjeje në *-u*, edhe diftongjet e tjera, sikur janë *ie*, *ye* shfaqin tendenca të shënueshme të mbledhjes në monoftongje *-i* *-y*. Për gjakovarishten, siç na del nga Fjalori i Kujunxhiqit (1902) procesin e diftongut e gjejmë të përfunduar qysh në fillim të këtij shekulli. Mirëpo, nga teksti ynë që u shkrua në gjysmën e parë të shekullit të kaluar, në lëmin e diftongjeve kemi një pamje të njësishtme për mrekulli; në të gjejmë vetëm e vetëm diftongun e mesëm *-ue*, sikundër po e quajmë, por edhe diftongjet e tjera na paraqiten gjithashtu të plota e jo të

³⁰ Waclaw Cimochowski, *Le Dialecte du Dushmani*, Poznanj, 1951, 10.

³¹ Jovan Erdeljanoviç, *Kuči, pleme u Crnoj Gori*, Beograd 1905, I. Dučić, *Život i običaji plemena Kuča*, 1931;

rrudhura sikur i ndeshim sot në atë ligjërim, t'i sjellim disa shembuj: Tue kãn deka mã e rãnd se me u prë me gëršãñ, 2; Dëka ãšt ma e rãnd se në vëgš me u *përvlúe*, 2; e me šãr me u *šãrue*, 2; prej zjarmit *zotün* na *ruejt*, iose na s'dijm me u *ruejt*, 3; íeri pa *hañue* vehten sun kës sado me u *vëš*, 6; Sã kuš turk pa *madhñue*, ška ã mađni, 7; pa *voglúe* ška ã për vogli, 7; kuš jët pa *ndihmues birët* si me kãn pa *msues*, 7; pa ju ça *krüet t'kekit* nuk i bãn dobi t'folmit, 2; ška t'mbjellš në kët jët, 9; mas sa vjetve për punue dička kek, 9; kãn gíđãñ gíđ *jët* ní gúnah me t'kitue masandai sado šum me *řdue* për kat gúnah duhet me *gímue*, 11; ti me pã hã kí po kës *đuej* pëse po kës ti me zã, 12; më *krúe* s ka mã rãnd se evladi, vařa po šndoš ãšt evladi, 14; masíkí buri gřues e grueja buřit petk *jãn* u bje nãni këtrin me *arnue*, čdo me kãn, 14; Vet n'i mbuši *đjet flët* me turli hikmet, 32.

Në të folmen e Gjakovës sot kurrkund nuk mund të haset ndonjë rast të diftongut të mesëm, atje qysh në të zënë të këtij shekulli, siç po e vërteton Fjalori i Kujunxhiçit, ky dyzanorësh na del i mbledhur në monoftong: *u, í, y*. Po ngrehëm pyetjen se kur zuri diftongu i shkallës së qëmoçme *uo* të përdoret në të mesmen *ue*, në mbështetje të të dhënave gjuhësore të Bogdanit, të lindur në Zhur të Prizrenit, do të thoshim se ky ndërrim do të datohet në një kohë, së paku për truallin gjuhësor të Kosovës, para se të fillonte krijimtaria letrare e kulturore e shkrimtarit dukagjinas. Këtu si dhe në fushat e tjera do pasur parasysh edhe një gjë tjetër që duan vënë në peshë edhe ndryshimet krahinore; kështu që një kohë në të cilën mund të vendosej ndërrimi i një dukurie fonetike për një zonë të caktuar gjuhësore nuk mund të ndërthehet po në atë kohë edhe alternimi i së njëjtës dukuri, por për një truall tjetër gjuhësor, khs. Gjykimin e Çabejt, Buletin 1958/3 f. 7. Është e natyrshme që për ruajtjen e formës së lashtë të një veçorie gjuhësore rëndësi vendimtare ka izolimi i truallit ku flitet një ligjërim.

Pa dashur ta zgjasim këtë vështrim mbi diftongjet e të folmeve shqiptare të Kosovës, ne do të zinin ngoje edhe një mendim të dijetarëve mbi përdorjen e diftongjeve të të folmeve të këtyre anëve tona, është ky një gjykim që thotë se në Kosovë, vise-vise ruhet edhe sot e gjithë ditën

diftongu i hershëm *uo-*, një mendim ky që ne nuk na duket i mbështetur, sepse nuk del kund në tekstet gjuhësore të kësaj treve, sikur rreh ta nxjerrë G. Elezović.³²

Togje zanoresh: ae, oe

Përsa u përket togjeve vokalike që dalin në të folmen e Gjakovës së asaj kohe që i takon teksti në vështrim, ne nuk mund të lëmë pa përmendur bashkëlidhjet zanore *o-e*, *a-e*, sepse ato në të folët e asaj qyteze në kohën në të cilën u caktua teksti në shqyrtim shqiptoheshin si dofrongje *oe*, *ae*, pa u shkrirë në zanore sikundër na dalin shtatëdhjetë vjet më vonë në Fjalorin e Kujunxhiçit, f. 30: *Ljuska: liora vos*, f. 25; *jaje = vō*, pl. *vōt*. Në tekstintonë gjejmë: - kuš ā emin e pa *droe*... por duhet na me pas *droe t'tān*, 3; ... dert per dūna kah me māf *hae e* kah me *vēš*, f. 5; te Kujunxhiqi: po kom *dro* (bojim se).

Të folmet gege largohen njëra nga tjetra edhe në përdorjen e këtij togu zanor, varësisht prej vendit ku bie theksi, që do të thotë në qoftë se theksi bie mbi *o*-në e dyzanorëshit *oe*, atëherë elementi i dytë i tij, duke qenë i patheks, me kohë do të bjerë e do të zhduket krejtësisht, për shembull: *vō; drō*, përkundrazi, po qe e theksuar pjesa e dytë, me kohë do të sjellë zhdukjen e plotë të vokalit të parë të togut zanor *oe*, *ae*, sikundër vërtetohet qëmoti në ligjërimet toske bashkë me gegërishten jugore: *voe=ve*, *vezë*; *voese=vesë*; *roe=re*.

Përsa u përket të folmeve shqiptare të Kosovës e në lidhje me bashkëlidhjet zanore, do vënë re se procesi i shkrirjes së *oe*-së, *ae*, në një zanore të vetme, në zanoren *o*, *e* nuk ka marrë fund ende. Në ligjërimin e Gjakovës, qysh na dëshmon edhe Kujunxhiçi, sot dëgjohej *o*, gjë që vlen edhe për gjithë rrafshin e Dukagjinit (kumtim i kolegut Anton Çetta) por jo edhe për viset malore të Kosovës, khs. *Kangë popullore shqiptare të*

³² G. Elezović, *Arhiv za arbanasku starinu, jezik i etnologiju*, I, 55; II, 244, 246, 257, 389 dhe te *Buletin*, 1955/2, f. 90; 1958/3, f. 38.

Kosovës, 1, 2, 3 dhe te Jeta e Re, 1949-59, në të cilat treva ruhet edhe sot e gjithë ditën togu zanore *oe*.

Në lidhje me diftongjet do theksuar edhe një gjë tjetër që në rastin e fjalëve *ðjet* si dhe të *tetðjet miðke triðjet vjet bãna hizmet, keð tu ti, 22*, që në këtë vepër përdoret fund e maje, e gjejmë të ruajtur dyzanorëshin *ie*, vjetërsia e të cilit dëshmohet në të folmet toske dhe prej shkrimeve të autorëve të vjetër gegë. Buzukut me shokët. Trajta e sotme e asimiluar, e monoftonguar *ðet* ndër ligjërime gege, do kundruar inovacion.

Me rastin që këtë tekst po e rimarrim në dorë, në kundërshtim me mendimin e shprehur prej nesh rreth toponimit *Veñat e Llukës*, që bie midis Pejës e Gjakovës e që në botimin e parë të kësaj vepre e lidhnim me foljen *vjerr* – e quajmë të udhës që duke e tërhequr etimologjinë e parë ta bashkojmë me shprehjen nga sfera e bimësisë *verri*-i pl. *verra*-t, verri, vërri m. “*alnus*, një dru i madh me lëndë të fortë, që rritet afër ujrave”.

Sistemi konsonantik

Sistemi bashkëtingëllor i gjuhës që pasqyrohet në tekstin tonë në vështrim duket me një inventar kësisoj fonemash:

I. Bashkëtingëllore shpërthyes (eksplozive)

pt k

bdg

II. Bashkëtingëllore fërkimore

f ks hð

v z ž ð

III. Afrikatet

c č k

x(dz), dž ğ

IV. Tingëllueset (sonantet)

m n ñ

r ř l, ł, j

Shumëherë është theksuar, madje edhe provuar që në fushën e konsonantizmit, të folmet shqiptare të Kosovës, përsa u takon okluziveve palatale, përkundrajt shqipes së hershme, kanë pësuar një ndërrim të ndjeshëm, për ç'gjë flasin edhe gjuhëtarë: Lambertz, Përrallat,³³ St. Mladenov,³⁴ Jokl, Përmbledhje e këngëve popullore e Vuk Karaxhiçit,³⁵ Taljavini, Të folmet shqiptare të tipit gegë verior.³⁶ E kjo do të thotë që okluzivet e larta palatale në shqipen e Kosovës janë kthyer në afrikate *č, ǰ*. Për të folmet e Gjakovës kjo dukuri dëshmohet nga Kujunxhiçi, Fjalori, në të cilin të njëjtën fjalë njëherë e ndeshim të shkruar në një mënyrë, e herën tjetër e gjejmë të regjistruar ndryshe: *Jep në pać*, 97 Podaj ako imaš); *Npać ćef* mujim me i bō zō (ako ti je po volji možemo ga zvati), f. 104; Du mem *lon* paret í m kije *borǰ*, f. 85, i kam pas lüp me ma la borǰin; Sa t'ka borǰ, f. 102.

Një pështjellim të këtillë në përdorimin e fonemave të zëna ngoje tregojnë edhe këta shembuj: a po e nǰoiš at gru ele čat *ćik*? Po e nǰoj at čik, ajo ošt štiza lúla; po čat gru s po e nǰoj, f. 80; në anë tjetër ndeshim në raste si këto: Po, bān un po e nǰo, ajo ošt Šota, 82.

Nga këto raste mund të nxjerrim si përfundim që në fillim të këtij shekulli, kur u botua Fjalori i Kujunxhiçit, okluzivet palatale *k, g*, në ligjërim të Gjakovës kishin zënë e po rrafshoheshin, duke kaluar në një palë afrikatesh *ć, ǰ*, sepse Kujunxhiçi, që në Fjalor të tij përdori grafemat *ć: ǰ* dhe *č, ǰ*, për të dyja afrikatat prepalatale shtiu në përdorje shenjat grafike *ć, đ*, e për palët e tjera, për afrikatatmediopalatale shtiu në punë *č, dž*.

Sa për rrethin e Pejës, për Gjurakovcin, nga *Këngët* popullore shqipe që i mblodhi Vuku, me gjasë, nga vitet 1830-1831, na dalin dy palë shenjash, njëra për okluzivet palatale, sot të rrafshuara në afrikate *ć đ* dhe pala tjetër për afrikatat *č: dž*, khs. Joklin në veprën e cekur, f. 40-41, 42, 65, 66. Rrethana që në të folmen e zënë ngoje për atë kohë kemi dy palë

³³ Max Lambertz, *Albanische Märchen*, 103.

³⁴ St. Mladenov, *Balkan-Archiv*, I, 5.

³⁵ N. Jokl, *Vuksalbanische Liedersammlung* në *Zbornik A. Belić, Separat*, f. 40, 41; 103, 105.

³⁶ C. Tagliavini, *Le parlate albanesi di tipo ghego orientale*, 50-52.

shenjash grafike për të dyja llojet e konsonanteve *č, ċ, ċ:dž*, një palë për të paraqitur okluzivet *k, ĝ* dhe lagjja tjetër për të shfaqur afrikatet *ć, ž*, na lëshon në dorë një të dhënë që na forcon në mendimin tonë se ligjërimi në fjalë në atë kohë, kishte dy palë guturalesh palatale: *k:ğ, ć:ž*, nga të cilat dy të parat, pas mendimit tonë, ende s'ishin fortësuar në afrikate, sikundër mendojnë të tjerët. Mendimin tonë e mbështesim edhe mbi një rrethanë tjetër, mbi rrethanën që guturalet palatale po ruheshin edhe në një të folme ët afërt, në të folmen e Gjakovës, në atë kohë (1835), sikur dëshmohet nga teksti në studim, autor i të cilit është një i Gjakovës.

Nuk do të lëmë pa theksuar, ëq në tekstin tonë nuk kemi ndehsur më ndonjë rast që në vend të *k*, të jetë përdorur *ć*-në. Po sjellim disa fjali me të cilat do të provojmë sheshazi ç'thamë sipër: *ćũnkĩ* shkove ti Muhamet Mustafa; neve s'na bãn pra dũna *hić*; dije ti ćdo me kãn i fort štati üt; kuš e vėš kmjšen vãdoi *kapućin*, f. 1; kuš ã ai i mećem, f. 1. *mã* gerdićem s'ka se plekńia, 1; Se me pãs ćilsin, 5; Kuš s'muer prej kũi *ğã*; pa u ndãl për *kã iã* për *ğã*, f. 6; prej ćkafit kan fol, f. 9; dićka me bã, f. 8; ti *kũkan* kujton *kĩ* hi mi' gũnah f. 8; ti *mĩ* pik tue kãn u bãne i hiješem, i gãt, i *ğãn*, f. 13; kan đãn žahili ãšt dušmani üt 17; aniki žahili ã kiťue baba *ũt*, f. 17; pa kput prej veti sun gindeš e *ngeti*, f. 24; ška t'ja kujtojš šokit tit, elbete t'bj e mẽ krũe tat, fũ. 23; mos e većo sendin për veti se ta mařin e apin e ngeti, f. 24.

Mirëpo, kjo fazë e një gjendjeje kur ky ligjërim i dallonte për mrekuili okluzivet palatale nga afrikatet, nuk mbajti shumë kohë, sepse në një provë transkribimi që e bëri Tahir Ismail Gjakova dhe e botoi në Sofje, më 1907, na jepet një pamje në të cilën vërtetohet rrafshimi i okluziveve palatale që u kthyen në afrikate sikundër na dëshmojnë këta shembuj: marrim statçind dono me šum bono ma pak, f. 14; çyš e kije hařin aštu ta ćesin, f. 14; insani për veti *ketër ga s'ka*, 8; për *ketër kak* f. 10. Nga këto palë shembujsh nenjëherë shohim që guturalet palatale ndër të folme shqiptare të Kosovës përdroreshin mbarë e drejt deri nga gjysma e shekullit XIX e njajo gjendje do të ketë mbajtur – shumë-shumë deri nga mbarimi i atij shekulli; e për fillim të pasuesit del një përzjerje a pështjellim në këtë pikë, për ç'gjë na provon Fjalori i Kujunxhiçit. Natyrisht, këtu i lamë anesh

ata shembuj të okluziveve palatale që në këtë të folme kanë bërë një zhvillim më tej duke u ndërruar në velare të thjeshta: *k, g*, fjala vjen: *kesh-kesh, Kep-kep Keṛ-keṛ, Keng, King, king*, për ç'gjë bëjnë fjalë Jokl, Archivum Romanicum XXIV, 9, 19, Taljavini, Të folmet shqiptare, 50-57 dhe Çabej, Buletin, 1958/1, 31-33.

Në lidhje me kronologjinë e ndërrimeve fonetike që u shqyrtuan më lart, duhet thënë në lidhje me alternimin e guturaleve në afrikate palatale për gegërishten veriperëndimore pikërisht për të folmen e Malësisë së Krajës – Brisk e Shestan, ne nuk mund ta quajmë të mbështetur mendimin e Çabejt që pohon (Buletin, 1958/1, f. 33) se të folët e Arbëneshit të Zarës do kundruar kapërcyell i këtyre ndërrimeve fonetike të gegërishtes veriperëndimore duke përfshirë këtu edhe shqipen e asaj treve që njihet djep i kolonistëve të Zarës. Dihej edhe prej tjerësh para nesh, si janë Vajgandi,³⁷ Taljavini³⁸ që në ligjërimin e këtij ngulimi pranë Zarës, okluzivet palatale janë ndërruar në afrikate dhe për nga natyra dhe artikullimi i tyre janë njësuar krejtësisht, e në anë tjetër në të folmen e Krajës, nga u shkulën në gjysmën e parë të shekullit XVIII të parët e arbëneshëve të Zarës, okluzivet palatale ruhen të paprekura edhe sot e gjithë ditën. Mbas gjykimit tonë, siç na rezultoi nga gjurmimi që bëmë në vend, shqipja e Malësisë së Krajës, më saktë, shqipja e Briskut dhe e Shestanit, po të lihet jashtë gegërishtja jugore, është një gegërishte e rrallë që i ruan të paprekura okluzivet e përfillura palatale. Afrikatat mediopalatale u përgjigjen në mënyrë të mrekullueshme afrikateve të të folmeve malazeze (mbi këtë pikë flasim në disertacionin tonë më gjerë).

Po deshëm të përmbledhim ç'shtjelluam për këtë pikë, do të përsëritnim mendimin tonë që kronologjia e ndërrimeve në fushën e okluziveve palatale të të folmeve verilindore dhe veriperëndimore të shqiptarëve në Jugosllavi – do shtyrë më vonë, sepse kapërcyell i këtyre këmbimeve nuk do të merret, sikundër mendon Çabej, koha e shkuljes së shqiptarëve të Zarës prej trojeve në anën perëndimore të Liqenit të

³⁷ Gustav Weigand, *Jahresbericht des Instituts für rumänische Sprache XVII-XVIII*.

³⁸ Carlo Tagliavini, *L'Albanese di Dalmazia*, Firenze, 1937.

Shkodrës. Të dhënat tona mbi shqipen e Gjakovës të fillimit të këtij shekulli, në një anë dhe ruajtja e gjendjes së hershme sa u përket okluziveve palatale të ligjëritit shqip të Krajës – hedhim pakëz dritë mbi pikën e përshtjellueshme të guturaleve palatale dhe mbi kronologjinë e këmbimeve që zunë të përfothen në të folmet e kësaj apo asaj treve.

Togjet bashkëtingëllore: mb, nd, ngj (ng)

Dy kryedialektet e shqipes, gegërishtja e toskërishtja paraqesin dallime jo të vogla edhe në togjet konsonantike *mb*, *nd*, *ngj*, sidomos në pamjen e sotme të tyre, sepse në fazën e hershme të zhvillimit të tyre, ato ruanin tiparet e lashta të grupeve bashkëtingëllore. Si në shumë pika të tjera të fonetikës dhe të morfologjisë, në gegërishten qesin krye prirje të forta për këmbimin e këtyre togjeve bashkëtingëllore; shembujt e parë të ndërrimit a të asimilimit të *mb*-së në *m* (mm, të *nd*-së në *n*, dhe të *ngj*-së në palatalen *-nj*, – na dëshmohen si në toponimi, si në të folme të ndryshme të shqipes mjaft heret, këtu e një shekull më parë – po, sigurisht. Për ruajtjen e ekluzivit të këtyre grupeve flet Çabej në studimin e tij: Për historinë e konsonantizmit në gjuhën shqipe, Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, 1958/1, f. 35-40.

Po japim një pamje të togjeve bashkëtingëllore qysh na paraqiten para njëqind vjetësh në shqipen e Gjakovës, një pamje kjo që na del nga teksti që e kemi përpara e që ka të bëjë me gjakovarishten e gjysmës së parë të shekullit që shkoi. Ky ligjërim në kohën kur u shkrua ky tekst, i ruante shumë bukur të gjitha togjet bashkëtingëllore, gjë që provon bindshëm teksti në fjalë, po të përjashtohen disa fjalë siç janë: *masíki*, *hupet*, *kām shtrembnohet*, *shtremt*, 12, 13, 14, 15, 16, 19, 20, 26, 27, 28, në të cilat mungon okluzivi, nga rezulton se ai në këto fjalë nuk do të jetë shqiptuar në atë kohë në shqipen e Gjakovës.

Rastet e asimilimit të ekluzivit në togjet e zënë ngoje janë pakrahasimisht më të shumta në Fjalorin e Kujunxhiçit, në të cilin jo rrallë ndeshim

për të njëjtën fjalë dy variante fonetike, khs. fjalitë e nxjerra nga ai: Dita e mīr e pukna e *mbar* t'koft; *mar* e mir t'łašt zoti (= për të dhasht zoti) f. 107; nuk po di me *kndu*, ti s po di me *kndu*, f. 96; zar s t'kom ni dje ćuš po *kndon*, f. 96; po djali jem ka mirad me *knue*, f. 101; a po *kndoiš* barem? po, un po knoj guhtar, f. 79. Okluzivi sikur po konstatojmë nga Fjalori i Kujunxhiçit për gjakovarishten e fillimit të këtij shekulli ruhet në shumicën e madhe të rasteve, gjë që forcohet edhe nga pohimi i Joklit, Archivum Romanicum, XXIV, f. 15. Por mendimi i tij nuk pajton me gjendjen e sotme mbi togjet e tilla në atë të folme, sepse sot kemi një situatë krejt të re ku mbisundon asimilimi i plotë i okluzivit te grupi në studim, khs. Kangë popullore shqiptare të Kosovë-Metohisë, I-III; Tagliavini, Le Parlate albanesi; 63.

Kur është fjala për togun *ngj* nuk do lënë pa u theksuar që në vargun e fjalve me *ngj*, një pjesë e madhe do njuhur sekundare: Puna e insanit nuk i *ngihet*, 28; në gjithë tekstin tonë përdoret vetëm *unğ*, *unź*, që do afruar te toskërishtja *unem*; folja *utem*, në shqipen e Kosovës në vatrën e saj kuptimore nuk ngërthen edhe vështrimin “zbres”, “rri poshtë” “varem”, por del me domethënien “njom teshat, rrobet”. Te Kujunxhiçi numri i fjalëve me “*ngj* shtohet: a po *ngini* kët zotni? (f. 127); nuk po e *nźo* n't'zofun, 127; nuk i kišna nźoft, me pas *kōn*vetum, 11; Kta djem pa *nźojn* žiđkond, 116. Ta shtojmë numrin e rasteve me *-ng*: *nźom* “sirov”, Kujunxhiç, 60; *enźom*, poaty; *unźės* (sesti), f. 59; po *nźej*, po *nźeiš*, po *nźen*, f. 5.

Nuk mund ta mbyllim këtë pikë po s'prekëm edhe një dukuri që ka të bëjë me një numër jo të vogël fjalësh që sosin me *mb*, *nd*, okluzivi i të cilave historikisht nuk mund të përliqet, veçse do shpjeguar me mjete të brendshme të shqipes. Puna e asaj shfaqjeje qëndron në faktin që labiali *m* a nazali *n* në fund të fjalës zgjerohet shpeshherë në shqipen duke marrë edhe nga një okluziv *b*, *d*, fjala vjen nga turqishtja *šen* me kohë u përftua *shend*, nga serbishtja *pelin*, në shqipen vise-vise doli *pelind*, prej rrënjës indoevropiane *krmis* në shqipe buroi *krimb*, me labializimin e *i-së-* *krymb*. Nga latinishtja *ramus* u përftuan *rrēmb*, *rrēmp*. Për *b*-në fundore të kësaj fjale Meyer Lüpke mbronte mendimin që mbas tij u përpoq ta mbante në

këmbë albanologu austriak Jokli në veprën e tij “Kërkime gjuhësore e kulturo-historike nga fusha e shqipes,”³⁹ sipas të cilit okluzivi në fjalët e shënuara sipër është përftim i kombinimit të $u+s$; mirëpo rastet e shumta me gurrë sllave a turke, si dhe të burimit të shqipes. ku m -ja e n -ja fundore marrin nga një b, d , janë provë e mirë që për shpjegimin e okluziveve, b, d , do rrahur një rrugë tjetër. Duke ecur në një shteg krejt të ri, pas mendimit tonë, H. Bariçi – Mbi marrëdhëniet e ndërsjellta të gjuhëve ballkanike⁴⁰ e zgjidhi njëherë e përgjithmonë çështjen e kësaj shfaqjeje interesante të fonetikës së shqipes. Kohët e fundit E. Çabej e ngriti përsëri këtë problem, Buletin, 1953/3, duke e shtjelluar çështjen kaq të rrahur, jo pse nuk e tumirte gjykimin e Bariçit, por pse dëshironte që publiku shqiptar ta njihje të pajisur me më shumë shembuj të tjerë të emarrë nga brumi i shqipes. ja disa raste të nxjerra nga teksti ynë ku na del ky tipar i mbarë shqipes: Për $mā t'mad$ mundim zoti $kānd$ s'ka se atā ki hujin e $keč$ tabijāt e ka, 23; por me $gīvkānd$ ka ni pūn aj, 27; sa për me ngrān, 27.

N, (nj)

Për shumicën e të folmeve gege, përkundër gegërishtes së vjetër, mund të thuhet që në pikën e konsonantit n ruajnë një shkallë të re në shiqptimin e këtij palatali; duam të themi se të folmet e gegërishtes së sotme i përshkon një prirje e fortë spirantizimi, $n=j$. Është mirë të dihet që n -ja e shqipes është vazhdim i një gn , por edhe përfitimi i $n-i$, që në rrjedhën e moteve shkoi e u palatalizua duke dalë në të njëjtin shteg. Te Buzuku e te shkrimtarët e tjerë që erdhën pas tij, dalloheshin ende shumë mirë, më një anë: $nōh, nōmē, nūmti$, e në anë tjetër: $nieri, nierkē$, etj., n -ja e të cilave më vonë u palatizua më $n̄$. sot – $njeri, njerkē$, po edhe kronologjia e këtij palatalizimi nuk është e njëjtë për $n̄$ -në e ballit me atë të mesit e të mbarimit të fjalës (Çabej), Buletin, 1958/1, f. 44.

³⁹ Norbert Jokl, *Linguistisch-kulturhistorische Untersuchungen aus dem Berèiche des Albanischen*, Berlin, - Leipzig, 1923.

⁴⁰ H. Bariç, *O uzajamnim odnosima balkanskih jezika*, Beograd, 1937.

Megjithë inkonsekuencën e shprehjes grafike të këtij konsonanti, palatali *ń* i tekstit tonë na dëshmohej pa farë dyshimi për shqipen e Gjakovës të fillimit të shekullit që shkoi. Ekzistenca e palatalit *ń* në këtë ligjërim anësor gegë na provohet për bukuri nga Fjalori i Kujunxhiçit: *řon* (koren), 27; *ńeri* (çovek), 73; *kuń* (çivija), 73, *dűńa* (svet) 58; i *ńřon* (sirov) 60; *zońa* (aginica), 1; a po še at *ńerin* atje, 79; kom *ńi* vła ele ni motër, 80; po tu ađ ařt *ńifar*, 80; M čet špi ka nait *ńi* vakt baba e jem, 88; ađ e ka pru *ńifar* leër, 91; *ńo* kom *vec*... 92; ku jemi *ńřoft* me kėt tužarin, 93; jam tue šku n dugon, 104; *ńže* dakikat, 107; kuš *ńier* řěn atere kur s'i zoet bės, 125, çvare osht çajo patkon, 137.

Në këtë fushë shqipja e Kosovës ka pësuar ndërrim të plotë në kuptim të spirantizimit të *ń*-së në *ř*; në këtë dialekt sot ndëgjohej řaj, řoj, ni *ńieri*, kűj. Kjo prirje nuk ka marrë fund në të gjitha të folmet gege: në Malësi të Krajës, Brisk e Shestan, *ń*-ja ruhet, qysh konstatoam me rastin e kërkimit tonë në atë trevë të shqipes veriperëndimore në të gjitha ato raste ku e gjejmë në shqipen e monumenteve të vjetra këtu e dyqind a treqind vjet më parë (Çabej, Buletin, 1958/1, f. 46-47).

Bashkëtingëlloret fërkimore

A. H:F

Kur është fjala për dallimin e gegërishtes me toskërishten në fushë të konsonantizimit, të gjithë albanologët janë të mendimit që, në kundërshtim me gegërishten ku janë përfutur inovacione jo të vogla, toskërishtja në këtë lëmë ka ruajtur një shkallë më të hershme. Është tjetër punë ajo që gjendja e sotme që përmban këmbimin e spirantit *h* në *f* te disa të folme gege nuk pajton me stadin e saj të hershëm, që në rase sporadike na del kjo shfaqje.

Siç dihet, Pekmezi është i pari dijetar që rroku këtë dukuri duke vënë re se bashkëtingëlloja *h* në fund të fjalës dhe përpara konsonanteve, sidomos përpara dhëmbores *-t*, ndërrohet duke u kthyer në *-f*: *shoh*=*shkof*; *njoh*=*njof*, (Pekmezi – Gramatika e gjuhës shqipe, 62). Për të folmet e Kosovës, ne na duket që të gjitha rastet e këtij këmbimi puthiten

për mrekulli me rregullën që vendosi shkencëtari shqiptar këtu e pesëdhjetë vjet më parë: me *njoftë* prej këndeje unë *njof*; vise-vise edhe *ngjofhtë*, i ngoftun; me u *ftoftë* prej adjektivit a ndajfoljes *ftoftë*, i *ftoftë*. Në shqipen e kësaj treve *h*-ja u ndërrua në *-f* edhe kur gjindej në fillim të fjalës: *flAD* prej serbishtes *hlad*; *fell* (pewj *thellë*). Ndryshim te *h=f* kemi edhe në kompozitin *këthjell-këfjell*.

Në vargun e këtyre foljeve nuk hasim kund që *h*-ja të zëvendësohet me *f*: njoh, apo *njoh*; *shoh*, *prehi*, *shehi*, *řmih*, *řehi*, *krehi*. Nga teksti ynë kemi këto raste: *řihni kuđ* i ra *řorti ađ řkođ* pa haber, 29; *već* ilmit si duhet *već* amelit kuř lųpet puna insanit nuk i *nđihet*, 28; nuk t'*řohin* *ki* me hajr je, 19; *řihni* Musan kur u lut ađ *ři* me *rā*, 25; Mos ba *řtrejt*itėk se *đunah bān* ti me zor, 24; dora *đat* pa urat – pra sa ta *řohin* eđtėkun ta pėrmėndin paçtėkun, 24; *řka* dihet me hal sun *fřihet* me *fjāl*, 22; ... po t'*mađ* *đunah bān*, 20; ... i *fėł*, 16; po ni insan kur ka *baht* ađ, po ka, 10.

B. Đ-F.

Në punën e kapërthyeshme të ndërrimit të spirantit ndërdhëmbor në spirantin buzodhëmbor *đ-f*, kriteri më i shëndoshë që të na shpjegjë te burimi i saktë i kësaj a asaj fjale, pas mendimit tonë, është etimologjia, që shpeshherë as ajo nuk na sjell në gurrë të tyre. Te fjala *đmi* që përdoret në këtë tekst *đ*-ja do të ketë dalë prej spirantit *f*, sepse na provon latinizma *familia*, prej nga rrjedh *fėmilė-fėmijė*, *đmijė*, *đmī*, në anë tjetër *fja* e fjalës *fe*, qysh e ndeshhim këtu është përfutur nga një *đ*, *đetė*. Te fjalët *đetė*, *kđjetė*, *đeřa*, *feřa*, *uđut-uthull*, *đėlėnzė*, *fėłanzė*, spiranti parėsor duhet të jetë *đ* e jo *f*, megjithëse në lidhje me lashtësinë e këtyre spiranteve, fjalën e fundit do ta ketë etimologjia; përkundrazi te *fellė*, *đtė*; femën-*đemėn*; *fjeshtėr-đjeshtėr*, *fėmijė-đėmijė*, konsonanti *f*, siç na dëshmon burimi i fjalëve, është më i vjetër se *đ*-ja khs. Meyer, Studimet e gjuhës shqipe,⁴¹ V, f. 75; Jokl,⁴² K. Treimer.⁴³

⁴¹ Gustav Meyer, *Albanische Studien*, V, 76.

⁴² N. Jokl, *Indogermanische Forschungen*, 36, Untersuchungen, 218; Festschrift der

Asimilim të këtij grupi konsonantik kemi edhe në të folmen e arbëneshëve të Zarës: *mëndaš* prej *mëndafš* *kašatë* nga *kafšatë*, *kašuo* nga *kašuo*, që ka përfshirë edhe optatimin: në *piša*, në çoşin Pinin, i šput... se në mos e baškot (shembujt janë marrë nga disertacioni ynë: Istorijski razvitak gegijskog govora Arbanasa kod Zadra).

Në lidhje me këtë tog bashkëtingëllor të së folmes sonë në studim, nuk mund të shprehim gjykim të prerë, sepse na mungojnë shembuj që përmbajnë në vete togun e përfilluar bashkëtingëllor.

Për grupin tjetër konsonantik *šk* mund të pohojmë pa grimë dyshimi se ai në këtë ligjërime ruhej më mirë se sot, gjë që na dëshmohet prej fjalëve që i gjejmë në tekstin tonë: Për tã kan đãn disi ršket... hatku *ršket* (i) mađ e i vogël kũšdo bãn, f. 20; Rahmet i koft Tahir Efendis u bje në đãn se ja u vëndoi škipen më kalem, f. 32 e sot në atë të folme thuhet: *ršet*, *šip*, *šiptar*, šume dritën, ušum, për ç'gjë na siguron Kujunxhiçi, Fjalori.

Format

Në fushën e sistemit të formave gramatikore shqipja ka humbur me kohë shumë nga këto kategori, ashtu që sot mund të thuhet se ajo ruan dy-tre rase, që do të thotë që ato të tjerat janë rrafshuar.

Po deshëm të vijojmë shqyrtimin e sistemit të rasave nuk do të lënim pa përmendur faktin që shqipja në rrjedhën e moteve, siç thamë më parë e ka rrafshuar instrumentalin qysh na thotë edhe Pedersen, Eberts Reallexicon der Vorgeschichte, I, 223; porse, në anë tjetër janë përfutur edhe riformime rasash të tjera, bie fjala lokativi, sikur e shohim prapë te Pedersen, Albanische Texte mit Glossar, 9; KZ 36 (310, 317); nga kallëzorja a gjinorja duke iu prapangjitur nyja *-të*, pastaj nga dhanorja doli gjinorja identike për nga trajtat e tyre në njëjës e shumës.

Sa i përket nyjës, teksti ynë nuk jep kurrfarë shkasi të marrim e ta

57 Versammlung deutscher Philologen und Schulmänner in Salzburg, 127; Studien zur albanischen Etymologie und Wortbildung, 105.

⁴³ K. Treimer, *Mitteilungen des rum.* Instituts I, Wien, 375, *po ai*, Kz. 65.

hetojmë këtë çështje të koklavitur morfosintaksore të shqipës.

Në lidhje me atë kategori emrash që mbarojnë me velaret *k, g*, ne nuk kemi mundur t'i binim në fije nyjës së prapavendosur, a duhet të lexohet *-i* apo *-u*. E nuk kemi mundur t'i binim në të sepse fjalët e tekstit të shkruar me alfabetin arabo-turk, nuk janë vokalizuar qysh praktikohet zakonisht, prandaj, ta zëmë, fjalën, *hortëk* nuk dinim si ta lexonim: *hortekin* apo *hortëkun*; *hatkit* apo *hatkut*: *žahitëki* apo *žahitëku*, ahmaki apo ahmaku. Megjithatë, edhe pse nyjzimi i prapavendosur te shembujt e prurë sipër nuk është aq i shqueshëm, ne jemi të sigurtë se prapavendosja e nyjeve do t'ë jetë bërë me *u* e jo me *i*. Gjendja përgjithësisht arkaike e fonetikës së gjuhës së tekstit tonë flet në dobi të këtij pohimi. Këtu duhet të përjashtohen ato fjalë që mbarojnë me *h*, sepse në këto rasa të gjitha të folmet veriperëndimore e veriore marrin nyjen *i*: *günah-i, sabah-i*, etj.

Do të theksohet edhe një gjë tjetër në këtë mes, që një prapanyjëzim i tillë më *-i* fjalëve në shqyrtim ndeshet që te Buzuku;; kjo dukuri, siç po na dëshmohej prej shkrimtarësh të vjetër, na qenka e kahershme. Do të ishte punë mjaft interesante të ndiqet hap për hap kjo shfaqje, sepse në ligjërimet toske e në juggegërishten sot haset vetëm nyja *u*, pra gjynahu, sabahu, ahuh, tehu, që në gegërishtet e tjera kemi *i*: *tehi, ahi*, etj.

Edhe një gjë tjetër do të vihet në pah në lidhje me prapavendosjen e nyjeve të emrave, një dukuri kjo që na dëshmohej nga teksti ynë në studim. E kemi fjalën për shquarësimin e emrave në gjinore, dhanore, rrjedhore, shumës, rasa që, sot në këtë ligjërim i hasim në trajtën e pashquar, ja disa sosh: se me *u* shit betaravet... si hōžt ki po u šiten žahilavet, 28; s'ju kkür sürvetavet as amelavet, por ju kkür zemravet, f. 16; prej gūnahevet pa u špōr na ćare s'ka, f. 11; në vend të petkavet, f. 4; dërmje dy krihvet, 4; t'parvet s'ju kañke, 18.

Trajtat e rasave gjinore, dhanore, rrjedhore në shumësin e shquar gjatë këtyre shekujve të fundit kanë zënë e po përdorengjithnjë e më shumë pa nyjën shquese *-t*.

Përkundrajt kësaj shfaqjeje, te disa të folme geqe, në Arbënesh të Zarës, në ligjërimet shqiptare të Briskut e të Shestanit, kemi vënë re

luhatje në përdorimin e trajtave të shquara në lakimin e pashquar, bie fjala: *mustakët* e një *njeriut* ishin të verdha (= të një *njeriu*); *pusat e kësaj ane* janë *të thellë* (= kësaj *ane*). Toskërishtja, e të shumtën edhe gegërishtja u rrinë larg këtyre tendencave.

Në tekstin tonë nuk kemi ndeshur ndonjë rast që gjinorja, dhanorja shumë të mbarojë me *et*, sikundër hasim në të folme, si dhe në gjuhën e shkrimtarëve të vjetër gegë e toskë, porse në të ishte ngulitur mbaresa standarde me *ve-t*.

Po deshëm të dimë për vjetërsinë e tyre, do të thoshim se nga këto dy trajta mbaresash, vendi i parë do t'i lëshohej asaj me *e-t*; që do nxjerrë prej *-om*, qysh na dëshmon Pedersen, Festschrift till. Vilh. Thomsen, 54, Zeitschrift für vergleichende Sprachforschungen, 36 (315), prej nga doli prapashtesa shqipe *-e*, e sa për *v-në* e mbaresave *ve-vet*, dihet se kjo është e mëvonë, pra është trajtë sekundare, që hyn në punë për të larguar hiatin, sikur ka ndodhur me *v* nistore të fjalës shqipe *vesh*, që është përfutur nga *os* = *ěš* dhe me *v*-atematike doli *veš*, qysh mendojnë Mark Piana, në Studi Linguistici albanesi – Varia, 65, dhe Jokli, Indogermanisches Jahrbuch.

Të gjitha rrethanat flasin kundër mendimit të P. Skokut,⁴⁴ që mbaresën e shumësit *ve-t* e njeh të hershme, ndërsa trajtën *e-t* e quan të vonë dhe duke e kundërshtuar mendimin e Pedersenit që mbaresën rasore *et* e nxirre nga *ōm*, sepse nuk do të mund të qendronte e pandryshuar pas mbaresës së emërores shumë *-a*, *-i*, së cilës i ngjitej. Edhe mendimi i tij që zanafilla e gjinorës shumë *-ve-t* do parë te arketipi i hershëm i përemrit të sllavishtes (*o*) *vom* – është i pambështetur, (Çabej, Buletin i shkencave shoqërore 1955/3; Demiraj, Morfologjia historike e gjuhës shqipe, I, (1973), 72).

Pa ngrehur pretendimin ta shterim, ne këtu nuk mund të lëmë pa përmendur, qoftë edhe rrëshqitas, çështjen e sufiksavet emëror, sepse edhe vetë teksti jep pak material për të.

⁴⁴ P. Skok, *Arhiv za arbanasku starinu*, jezik i etnologiju, III (1926), 163.

Përkundër praktikës ndër klasikë të shkrimit shqip – Buzukut me shokë, ku ndeshim shpesh përdorjen e mbiemravet të emëruar, qysh na dëshmon edhe Çabej, Buletin 1955/2, 44, 45 në tekstin tonë hasim shumë më shpesh në emra foljorë: *Ārnimi* i prinës – maskariia e *t'birīt e s'bīs*, f. 11. *ġāja dūnās* – *gzimi* i *ġmīs* – *rġzimi* i prindes, 13; sebaab me *kān* sał me mundim, mundimi i magarit s'is *kān* pa fitim, f. 18... Pagimin ta lūp bütün, 39; *Ārāna* e azgintëkut āšt *gzimi* i insanit, f. 29... prej zjarmit pštimin ti ne daš, 8; për pštım kušdo e ka, 15 rāndimin e dek(ē)s kije me(e) pās, 27; *rnimi* i plakut – gërdija e berbërit, 31;

Nga sa po shihet prej shembujve të prurë, sufiksi *im*, që zuri të përhapet në gjuhën letrare qysh në kohën e rilindjes e tëhu – e nxori nga përdorimi shumë të shpeshtë deri në atë kohë mbiemrin e emëruar: të *bardhët*, të *zit e thonit*; të *lig*, të *verbët*, të *shtruem* etj. *Formanti -im*, sot është aq i përdorueshëm, sa që mund të prftohet prej kategorie trajtëfjalësh; i parë = parim; rruzull = ruzullim; nga çdo folje e zgjedhimit të *n* muknd të sajohen emra me formantin *-im*; bashkue-*bashkim*, gëzue-*gëzim*; bekue-*bekim*, guxue-*guxim*, kursye-*kursim*, shëbye-*shërbim*; shelbue-*shelbim*; shpërblye-*shpërblim*, trishtue-*trishtim*.

Këta emra me formantin *-im*, në shumicën e rasave kanë kuptim abstrakt, rrallëherë emra të tillë mund të kenë edhe vështrim konkret, p.sh. *burim*, në rend të parë del me domethënien konkrete: ujë që buron nga toka, vendi ku del një rrjedhë uji, amë. Mbase i hymë kësaj pune të formuesve nuk po lëmë pa i zënë ngoje edhe disa të tjerë, bie fjala një me gurrë të huaj, me burim turk; *disa hōz* me mǎ pak mundim e kan *hožatëkun* se *žahili ki ka žahitëkun*, 21; *rāna* e azgintëkut aštu *gzimi* i insanit; dora *đat* – pa urāt, pra sa ta šohin ejtëkun – ta përmëndin pakitëkun, 24; *ulematëkun* – *ahmakitëkun*, *žahitëku*, 17; škado me *kān*, *keč*, *žahitëku* āšt mǎ i *keč*.

Prapashtesa *llëk*, *llik*, *lluk*, është e *turqishtes*, që në shqipen së pari ka hyrë bashkë me fjalë turke, dhe pastaj u shtri edhe në fjalë të burimit të shqipes dhe ka formuar emra konkretë, abstraktë, etnika dhe emra vendi (Xhuvani – Çabej, Prapashtesat); në shqipen e sotme të shkruar formuesi

izënë ngoje është zëvendësuar me sufiksin shqip – *i*: *žahili*, *ahmaki*, analogjikisht me *dhelperi*, *dhelpeni*, *vogjeli*, *dashuri*, *dashuni*, *burrni*, *njerëzi*, *hajni*, *turqni*.

Po radhishim disa shembuj emrash të pajisur me prapashtesën *es* (ës, s) që u ngjitet trajtave participore a prezentit të foljeve duke sajuar emra veprues (nomina agentia: por *rał* gëndet kałžues, 23; zoti *đ*a se *ãšt* dërmje juš štisi, 28; *bãnu nžãns* ti ja *msues*, ja *digues*, 17; por kuš *ãšt* dīs, 17; *folsi* ja *diguesi* 29; *điri* telãfi, *dil* ti štins, 25. Pos vështrimit të veprimit të vepruesit a kryesit të diçkajes, emri me prapashtesën *-es* tregon edhe veglën me të cilën kryhet a bëhet një punë: *tëhollues e hollës*.

Është e vërtetë se sufiksin *-ës*, *-es*, *-s*, megjithëse me një përdorim shumë të kufizuar, e takojmë qysh herët; në këtë mes na interesojnë fjalët *nxanës* e *msues* që do të jenë farkesa librore intelektualësh e datojnë në një kohë kur zunë të *happen* e të punojnë shkollat shqipe ndër shqiptarë. E meqenëse emrat e tillë u regjistruan në fillim të shekullit (1835) në qoftë se kjo datë mund të merret e saktë, që do të thotë para hapjes së shkollave shqipe, tërë kjo punë na vë në dyshim. Të thuash që autori, i ndikuar prej farkesash analogjike të cilat që në atë kohë ekzistonin në gjuhën e popullit – t'i ketë krijuar ai vetë, prapë nuk e besojmë. Më tepër mundësi do të ketë pandehja që këto dy fjalë të jenë marrë prej shkodranishtes, ku me kohë po zhvillohej një veprimtari kulturore, prandaj nuk është e pamundshme që autori t'i ketë huazuar së andejmi, qysh e merr me mend edhe Hasan Kaleshi, *Godišnjak Balkanološkog instituta*, I, Sarajevë, 1957, në studimin e tij – *Arbanaška književnost na arapskom pismu*, 365.

Fjalën *mësonjës* na sjell edhe Kristoforidhi, në *Fjalor të tij* (1904), por atë e hasim edhe më parë në shkrime të Samiut (1886) e mbas të gjitha gjasëve, ajo do marrë si krijim i Samiut, që do të ketë gjetur vend edhe në shkrimet shqipe të autorëve të këtyre anëve.

Kur shqyrtohen formuesit e shqipes, nuk do lënë pa zënë ngoje edhe një prapashtesë emërore, që ka ngulur rrënjë vetëm në gegërishten, sepse ligjërimet toske, në vend të saj shtien në përdorim një formant tjetër, fjala është për prapashtesën e emrave foljorë, siç janë *rritje*, *pritje*, *pamje*,

mbathje, veshmbathje, që po të përjashtohet gegërishtja jugore, në të folmet e tjera gege kurrkund nuk e hasim.

Kemi edhe një tjetër prapashtesë që sajton femëroren: *mbret- mbretëlë*, Pedersen.⁴⁵ Në gjuhën popullore të dialektit gegë na del më rrallë: *bukël, vegl, pendël, shkrolë, dhendël, pupël, pikël*. Kësaj prapashtese që u përket më tepër të të folmeve toske, në ato gege i përgjigjet një prapashtesë tjetër, me *ë*; bie fjala: *rritë-a, pritë-a; dukë-a, dokë-a*, që i ngjitet temës së participit: *dredhë* (dredh); *shtrojë* (shtroj), *mbathë* (mbath). Formimet me *-je*, sikur *pamje, dukje, pritje, lutje, veshje*, janë krijime librore të ardhura nga toskërishtja që nuk e njohin as klasikët e shkrimit shqip, Buzuku me pasuesit e tij Budin, Bardhin, Bogdanin; te Buzuku gjejmë: *pasë, pasa*: e përfaroi gjithë *pasënë* e vet...

Foljet dhe përdorimi i kohëve

Është vënë re dhe theksuar shpeshherë që në sistemin e foljeve janë bërë shndërrime dhe, pas analogjisë, zhvillime të reja. Po deshëm të bëjmë një kategorizim gramatikor të foljeve, ne nuk shohim grupim më të përshtatshëm se ndarjen tradicionale të tyre, në *-mi* koniugacionin (*jam, kam, thom*), në *-n* zgjedhim dhe në një lagje foljesh që në temën e tyre nuk knaë një *-n*, porse tema e tyre mbaron me ndonjë bashkëtingëllore tjetër.

Në vëzhgimin e foljeve nuk do lënë pas dore një gjë që pos risive të tjera është vënë re edhe një prirje e fortë që ndjek trajtat e së tashmes; është kjo një prirje që qëndron në faktin që, mundësisht çdo vetë të shprehet me një trajtë të veçantë, qoftë me anë të kuantitetit të zanoreve, qoftë duke këmbkuantitetit të zanoreve, qoftë duke këmb zanoren rrënjore të foljeve, si dhe duke zgjeruar temën e prezentit me një prapashtesë të re, sikur del në disa ligjërime gege e toske: *mas, matën, matën; lypi (lypinj), lypën, lypën; vras, vret, vret...; dal, del, del; ngas, nget, nget...; pëlsas, pëlset, pelset,...; rrej rren, rren...*

⁴⁵ Holger Pedersen, *Albanesische, Texte mit*, Glosar.

Në tekstin e këtij ligjërimi, diferencimi i trajtave të vetave të njëjësit bëhet zakonisht me anë të kuantitetit të zanoreve të së dytës dhe të së tretës vetë njëjës: *lypi, lýp, lýp; rrej, rrën, rrën*, si dhe me këmbimin e vokalit të vetave që posa u zunë ngoje: *vras, vret, vret; dal, del, del...*; Vetëm ato folje që në tema të tyre kanë diftong nuk pësojnë kurrfarë ndërrimi në numrin njëjës: *rrjedh, rrjedh, rrjedh; djeg, djeg, djeg; vjell, vjell, vjell*; unë *vjel, ti vjel, ai vjel*; unë *nxjerr, ti nxjerr, ai nxjerr* që në aoristin diftongun e prezentit e mbledhin në *o*: *rrodha, dogja, volla, vola, nxora*.

Diferencimi i vetave të njëjësit në të folme anësore gege bëhet edhe nëpërmjet zgjerimit të vokalit të vetës II e III. Për ilustrim po sjellim disa shembuj: *nuk ta fāk نونوق تفال* nimetin ai, 29; *nuk t'fā نونوق تفال* gā ai, 29; *Pagimin ta lyp bytyr*, 29; sikur të ishin të shkurtëra, atëherë nuk do të shkruheshin me *a, ü, و, ا, , porse نونوق تفال*; *زوطن جو نونوق تفال*. Këtu poshtë po japim një pasqyrë të zgjedhimit të foljeve ndihëse: *une kam*, ti kije, ai kã, na *kemi*, ju *keni*, ata *kân*; *une jãm*, ti je, ai *ãšt (ã)*, na *jemi*, ju *jini*, ata *jãn*, *une thôm*, ti *thue*, ai ajo *thot*, na *thôm*, ju *thoni*, ata *thôn*. Mandej po japim gjithashtu paradigmen e foljeve të rregullta, fjala vjen: unë *bie*, ti *bje*, ai (ajo) *bje*, na *biem*, ju *bini*, ata *bien*; *une di*, ti *di*, ai *di*, na *dim*, ju *dini*, ata *din*; *une shti*, ti *stie*, ai *stje*, na *stim*, ju *stini*, ata *stîn*, *une due*, ti *do*, ai *do*, na *dôm*, ju *doni*, ata *dôn*; Pra, s'di ku *ã ai*, 28; ti po di qi je *kãn* dhe, 30; elbe e t'bie *më krye tat*, 23; para ki bje me fjët, 11; sa ni *kokëf drið s t lãn*, por dãn hesab, 12; kuj i bje me dëk e me lãn ðmít me grue, s'un ja paguen sado me u mudnue, 15; ja ška s'di me kažue, 17; masi ki kan ðãn për tã ki kštu *ã*, 28; nni fjal t'kam, 27; žahilin e kie dũnãn ki aštu melune; kũš e kie hatrin kaštu ta kesin *farën*, 18; ška e le mas vëti *ãšt engëti*, 24; ška kije hupet, ška s kie hafohet, 8; na bje me ik prej šerit, pra, 8; e stje vet zjermin n'bark, 28; s'di kah me pãs gzimin 31; rahmet i koft Tahir Efendis u bie me ðãn se ja u vëndoi škípen më kalem, 32; šum na bje me kait, pra, 2; lum ai ki Vehbijen e nže, 32; kajo nuk *flë*, 23; por murad *ãšt kuš* po di, 19; s'ãšt murad, do me *këp*, 19.

Dikur i rregullt, zgjedhimi i këtyre foljeve ka arritur të diferencohet aq sa sot është kthyer në një kategori tjetër foljore duke u integruar në kategorinë e foljeve me *-n*: *punoj, punon, punon; shkruen, pij, pin, pin*,

shtij, shtin, shtin; bij, bjen, bjen, bijnë; dij, din, din, dijmë, dini, dijnë. Shembujt e fundit, merret vesh nuk hyjnë në kategorinë e foljeve me *-n*, mirëpo, prejse ato në një numër të madh të folmesh geqe pas analogjisë janë trazuar me kategorinë e madhe të foljeve më *-n*, siç u tha, atëherë edhe ky grup i vogël foljesh, dikur në të vërtetë i parregullt, në një varg gramatikash tona normative janë integruar në lagjen e madhe të foljeve të *-n* koniugacionit. Thamë që ky përshtjellim ka përfshirë një pjesë të madhe të ligjëtimeve geqe, mirëpo disa të folme të tyre me tipare të lashta sot e gjithë ditën u rrinë larg këtyre prirjeve për ndryshim (të folët e Krajës: Shestani e Brisku, arbënishtja e Zarës; gegërishtja jugore, Vajgand, Gramatika shqipe, f. 111-12; dibranishtja).⁴⁶

Kur jemi te foljet e gjuhës së tekstit tonë në studim, ne nuk mund të harrojmë që të gjitha të folmet toske në fushën e sistemit foljor ruajnë një stad të vjetër, Dozoni, Manuali i gjuhës shqipe (1879), Pedersen, Tekstet shqiptare (1895), Pekmezi, Gramatika e gjuhës shqipe (1908).⁴⁷

Pasi shqyrtuam kohën e tashme të foljeve të diatezës veprorë, nuk do lënë pa thënë nja dy fjalë dhe për prezentin e lidhores, (koniunktivit). Dihet se kjo mënyrë në shqipen e Kosovës përdoret shumë rrallë, por edhe kur përdoret trajta e disa vetave ndryshojnë nga format e përgjithësuara të shqipes, fjala vjen veta III njëjës shprehet me formën e shumësit të prezentit të doftores: *të punoj unë, të punojsh ti, e në vend të punojë ai*, dëgjohet të *punon ai*, ose *të punojnë ai*, në tekstin tonë për vetën në fjalë kishim shënuar: Kur *të vjen kazaja kōoheš* për me t'ra belaja, 13; *mas nīmī* taalateve n'i muhalefet mund t *bjen* pōšt, 22. Format e nënvizuara: *t vjen, e t bjen* janë trajta tipike kosovare të përdorura për të rregulltat le *të vijë, të bjerë*: në masa të tilla, në vend të vetës III hyn në punë shumësi: *të lidhen ai, të apin ai, të avisin ai, të bajnë ai*, gjë që s'e ka lënë pa e çekur edhe Pekmezi në gramatikën e tij, f. 168-171.

⁴⁶ G. Weigand, *Albanesische Grammatik im südgegischen Dialekt*, f. 111-112.

⁴⁷ A. Dozon, *Manuel de la langue chkipe ou albanaise*, Paris, 1879; Pedersen, *Albanesische Texte mit Glossar*, Leipzig, 1895; Pekmezi, *Grammatik der albanesischen Sprache*, Wien, 1908, 166-167.

Për zhvillimin historik të shqipes nuk është pa rëndësi edhe imperfekti, ashtu si përdoret në ligjërimet e kosovarishtes. Në tekstin tonë në studim kemi gjetur disa trajta të kësaj kohe që nuk janë shunuar kund në të folme toske e gege. E kemi fjalën për vetën III njëjës të imperfektit, që këtu shprehet në këtë mënyrë: sa zarar *të dilke* me u ndāl nī sahat bashke mā šum se dobija kak vjet, f. 21; nāni falke dy rekatē, *bājke* dua; ška po *lypke*, *bahke* hasil daima, 22; përse *s punojke* por *po folke* aĵ kŭkan. Musa e pa nānin po kajke aĵ me lot, škoi kur erđi e ġet aĵ *ġimojke* edhe fort, 24.

Në vend të kësaj forme të imperfektit, po të përjashtohen ligjërimet arkaike të diasporës shqiptare në Italinë Jugore dhe nëpër ishur të Greqisë, që ruajnë format e thjeshta të kësaj kohe, në të gjitha të folmet e tjera gege e toske përdoret kjo mënyrë e së pakryerës: *bante*, *bēnte*, *dilte*, *punonte*, *flite*, (*fliste*) *qante* (*kjante*) *ġjimonte*, etj.

Mbaresa e imperfektit të këtij ligjërimi për vetën e tretë njëjës, në vend se me *-nte* (*te*), siç po shihet, shprehet me *-ke*. Si tjerët, ne na intereson edhe një gjë në këtë mes: a do të jetë mbaresa e kësaj vete të imperfektit ndonjë këmbim fonetik i së përmendurës *-nte*, apo ajo *-ke* do të jetë, ndoshta, përfitim i diçkajes tjetër. Shqipja e vjetër, as kjo e sotmja, nuk na lëshon në dorë kurrfarë faktesh që të pohojmë se kemi të bëjmë me një këmbim fonetik të saj. Prandaj shpjegimi i këtij ndërrimi do kërkuar gjetkë, që na këtu po rrahim t'ia gjejmë fillin.

Trajta jonë *bajke*, sikundër po duket, bën pjesë në kompleksin problemor të imperfektit sigmatik të shtrirë në një numër të madh të të folmeve gege: *punoshe*, *punoshe* (*punojshe*) *punonte* (kosovarishtja – *punojke*) *punoshim* a *punojshim*, *punoshit* a *punojshit*, *punoshin* a *punojshin*.

Imperfekti i shqipes shprehej dikur edhe në gegërishten me *-nja* a *-nje*: *punonja* (*punonje*) *punonje*, *punonte*, *punonim*, *punonit*, *punonin* qysh ruhet në disa ligjërimet (arbënishtja e Zarës, shqipja e Malësisë së Krajës-Brisk e Shestan, dibranishtja). Mirëpo, mbaresa *-nje* (*-nja*) do të ketë qenë prapashtesë vetëm e kategorisë me *-nje* që më vonë erdh e u shtri edhe në kategori të tjera foljore, duke u përgjithësuar në mbarë shqipen. Gjuha e shkrimtarëve të vjetër gegë e toskë si dhe dialektologjia e

sotme na vërtetojnë ekzistimin e mbaresave ndër kategori të ndryshme foljore. Mund të thuhet se secila folje kishte një trajtë të veçantë qysh na dëshmojnë ligjërimet, sidomos ato që paraqesin një stad më të hershëm formash fonetike e morfologjike.

Kur është fjala për imperfektin sigmatik të gegërishtes, do vënë në dukje, që ai nuk ndeshet në shkrimet e autorëve të vjetër: Bogdani, bie fjala, nuk e ka, por përdor vetëm imperfektin asigmatik, me *-nja*, me një ndryshim të vogël që ai nuk e shkruante ata *punonin a punonjin*, por *punojin*, duke kthyer fonemën *-ín* në *-j*: *punojim, punojit, punojin*, që për nga ana tingullore u afrohen shumë formave foljore të prezentit: *punojmë, punojnë*.

Në Kuvendin e Arbënit (1706) hasim trajtën e vjetër të imperfektit; nuk dimë se si do ta ketë përdorur këtë kohë Da Leçe në Gramatikën e tij, të botuar në Romë 1716, që, fatkeqësisht s'e kishim pasur në dorë.

Në Gramatikën e Vajgandit, të shtypur në Lajpcig të Gjermanisë, më 1913 – në lidhje me të pakryerën regjistohen këto forma: *rroje, ti rroje, ai rronte, na rrojshim, ju rrojshit*, ata *rrojshin*, f. 11; *pije, pije, pinte, pishim, pishit, pishin; baje, baje, bante, bashim, bashit, bashin*, 28; *bleje, blije, blente, bleshim, bleshit, bleshin* (blije, *blije, blinte*) f. 109. Ky ligjërim është shumë drejtimdhënës kur është fjala për përfitimin e formave të së pakryerës sigmatike të të folmeve geqe, sepse na tregon rrugën e pushtimit të këtij trualli dialektor nga ana e imperfektit sigmatik, sikur po duket, duke nisur me shumësin për të dalë në njëjës, pra, kjo do të jetë rruga e përgjithshme e shtrirjes së kësaj forme të re të imperfektit, të imperfektit sigmatik në ligjërimet të tjera që sot dinë vetëm për trajtën e re të kësaj kohe.

Si do kuptuar ky ndryshim? – me ndërrimin e palatalit *-ín* në *j*, siç u pa në shembujt e sjellë pak parandej format e shumësit të imperfektit asigmatik *punojim, punonjit, punonjin*, në një fazë më të vonë erdhën e u këmbyen kësisoj: *punojim punojit, punojin*, që për nga ana akustike u janë afruar shumë trajtave të prezentit: *punojmë, punojnë*. Këtu duan kërkuar arsyet që ndjenja gjuhësore e shqipfolësve rrihte që konceptet t'i vendoste në kohë të ndryshme edhe për nga forma saherë që këto nuk siguornin vendosjen kohësore të koncepteve të caktuara.

Po ku do të jenë marrë format e së pakryerës sigmatike? Ato do të jenë përftuar nën ndikimin analogjik të formave të së pakryerës së foljeve *jam*, *kam*, *thom* (*jeshë*, - e ish, jesh(ë) më; jesh(ë) të, *ishnë* etj.); në përfitim të trajtave të së pakryerës së diatezës veprorë, s'mund të kenë mbetur pa ndikuar edhe format e së pakryerës së diatezës joveprorë; *lahesha*, *laheshe*, *lahej*, *laheshin*, *laheshit*, *laheshin*, që ndër disa të folme shfaqen edhe kështu: u *lahsha*, u *lahshe*, u *lahte* (u *lahke*), u *lahshim*, u *lahshit*, u *lahshin*. Pra, nuk përjashtohet mundësia që kjo trajtë të jetë huazuar për të shprehur imperfektin e diatezës veprorë: *lasha*, *lashe*, *lante*, (*lahte*), *lahshim* *lahshit*, *lashin*, porse, siç e vëren mirë S. Riza, Tri monografina albanologjike, f. 191-194, njëherë, do të jenë marrë format e shumësit, sepse atje shfaqej rreziku që shumësi i prezentit duke iu afruar atij të imperfektit të ngatërroheshin idetë e shfaqura me to.

Në sferën e imperfektit ne na mbetet të ndriçojmë edhe një gjë që nuk ka qenë objekt trajtimi në shkencën albanistike: është fjala për vetën III të së pakryerës së diatezës veprorë, siç na del në të folmen e shqiptarëve të Kosovës, me variantin: ai *punojke*, ai *bājke*, ai *u endke*, u *sillke*. Arsye që të përligjet një këmbim i tillë fonetik – nuk ka, sepse në të folmet e shqipes ndërrime kësodore fonetike nuk janë dëshmuar, prandaj shkaqet e shfaqjes duan kërkuar gjetkë. Siç e kemi shtjelluar në një vend tjetër, shprehim mendimin tonë që trajta e përmendur e imperfektit të dëftores përkatësisht veta III singular s'është gjë tjetër, veçse veta III njëjës e imperfektit të admirativit: unë *bākështa*, ti *bākështa*, ai *bāke* (j), e kjo formë e fundit erdh e u shtri edhe në imperfektin e dëftores mun atëherë kur habitoret na ishte në shqipen shumë e gjallërishtme dhe kishte përdorje të madhe.

Po deshëm të vendosim kronologjinë e këtij riformimi në të folmen shqipe të Kosovës, na nuk mund të lëmë pa vënë në dukje që një rizhvillim të tillë nuk e ndeshim në shkrimet e gjakovësit Nikollë Kazazi, vepra e të cilit u shtyp më 1743. Për mungesë të dhënash guhësore këtë këmbim nuk mund ta ndjekim hap për hap. Teksti ynë është i pari dokument që na dëshmon për ekzistimin e një shfaqjeje kësodore në këtë ligjërim anësor të

shqipes, në të folmen e Gjakovës. Praninë e asaj dukurie për shqipen e Pejës me rrethe na e vërteton një dokument tjetër gjuhësor me këngë popullore të shënuara prej Vuk Karaxhiçit në fillim të shekullit të kaluar, 1830-31.

Sa i përket përhapjes së kësaj shfaqjeje, trualtit që ajo përfshin, jemi të mendimit që ajo shtrihet në gjithë Kosovën dhe Rrafshin e Dukagjinit; në Malësinë e Gjakovës, depërton në të folme shqiptare të rrethit të Preshevës, shkurt ajo kap të gjitha ligjërimet gege që dinë për këmbimin e togut të lashtë bashkëtingëllor *kl, gl*, në *k, g*.

Nga këta pak shembuj që i nxorëm nga teksti ynë mund të pohojmë se në të folmen e Gjakovës, para më se një shekulli, paskemi pasur dy trajta futuri: *ti po di qi je kãn* dhe *e apēt do të bëhesh* dhe, 30; *ška t'apış me dōr atã kije me e pãs në voř*, 31; *Po me mundim ka me pãs gã*, 13; *eđe hakun kan me lüp* prej juš, 14; *kēt fjalën řoke ti se řšt lül mend në pać ti mjaft t'del, mã s'kam me fōl*, 28; *Sa zere hajr a řeř kuš bãn do ta ře řezãn*, 8.

Nga fjalitë e sjella këtu sipër shihet sheshazi se në dialektin tonë, në kohën e botimit të këtij teksti, ishin në përdorim dy forma të ndryshme futuri: njëra me prezentin e foljes ndihmëse: kam+infinitiv, e tjetra shprehej me *do të* së bashku me prezentin e koniunktivit: *do të bãheš*, *do ta ře řezãn*, 8; ndërsa ajo e para: *kije me e pãs* në voř, 31: o me mundim *ka me pãs gã kētër*, jo, 13; *kan me lüp* prej juš, 14;

Fjalìa: *do ta ře řezãn*, 8, na vërtetonedhe njëherë qënë këtë ligjërim veta III e së tashmes së koniunktivit, qysh u përsërit sa herë në këtë studim, po ngatërrohej me vetën III të së tashmes së indikativit.

Nuk duam ta përfundojmë punimin tonë, po s'i thamë nja dy fjalë rreth huazimeve, që nuk janë të rralla në të folmen tonë në studim.

Nuk na habit numri i madh i elementeve turke që, sikur dihej, në turqishten kanë hyrë nëpërmjet arabishtes me shumicë, e në shqipen kanë depërtuar me anë të turqishtes, duke qenë kjo në kohën e sundimit turk gjuhë administrate dhe kulture përgjithësisht. E autori i veprës sonë, për më tepër ishte formuar ndër shkolla fetare të Stambollit e na ishte njohës i

mirë i turqishtes dhe i arabishtes. Në fondin e fjalëve orientale ndeshim edhe asosh që nuk njihen në gjuhën e popullit.

Turqizmat

Megjithëse termi turqizëm nuk i përshtatet gjithherë saktësisë shkencore, sepse ndër turqizma hera-herë shihen fjalë me burim arab a persian, nuk deshëm t'i largohemi, qoftë edhe në një punim të këtij lloji, terminologjisë tradicionale.

Vehbije-Vehbija: Këtu është përdorur me vështirim dhunti, dhuratë. Në rend të parë ka kuptim emër gruaje: dhuruar prej zotit; mashk. Vehbi, turq. Vehbi, që buron prej arabishtes Vehbije. (< ar. Wāhbiyyā).

Vezni = vargu, masë ritmike, turq. vezin, marrë nga arabishtja wezni.

Mydamr: mudeet=kohë, aat, nga turq. müdet e prejardhur nga arabishtja mudde.

Akibet = pasojë, rrjedhim, përfundim, rezultat nga arab. akibe.

Ķefin-i(m) = turq. forma letrare kefen, arab. kefen.

Amel-i = punë, turq. amel prej arab. amel.

AnĶak = vetëm, mun, nga turq. ancak.

Azad, adj. = i lirë, i shpëtuar, turq. azad nga gurra persiane azad.

Baht-i = fat, risk, në turq. baht – burimi i saj te persishtja baht.

Batil-i = zuzar, i poshtër; i padobishëm.

Barabar = adv. (pees) = kundruall, së bashku; njësoj, njëlloj.

Bukaqi = pranga, turq. bukagi.

Divane, divania = i marrë, i çmendur, i trentë.

Daima, adv. = gjithherë, kurdoherë, turq. daima, arab. daima.

Duá-duaja (t) = lutje.

Ebet = kurrë.

Elbete, elbetena dhe *evet* adv. = pa farë dyshimi, sigurisht medomos.

Emin = njeri i sigurtë, njeri i besës, besnik.

Erz = nderi.

Fasik-u = mëkatar, i keq, zuzar.

Gafil-i = njeri i pakujdes, i shkujdesur, indolent.

Garib, adj. (arab.) = 1. i huaj, i ngratë, i varfër, njeri i pakushëri, i pafarefis;

2) i çuditshëm i jashtëzakonshëm, turq. *garib* nga arab. *garib*.

Hal(halle)-i = rrethanë, situatë, gjendje, pozitë; kujdes.

Heman = atypëraty, turq. *hemen* nga pers. *Hemen*, fjalë e përbërë prej persishtes *hem* dhe arab. *an* “kohë”.

Hizmet-i = urti, dije arab. *hikme*.

Hüzet = tur. *Hycet* nga arab. *hygge* = vendim i gjyqit.

Igra-igraja = dënim, ndëshkim, turq. *icra* nga arab. *agra*.

Kaher: arab. = pikëllim, ngashërim, mall, kujdes, mundim.

Llaf-llafi = fjalë, bisedë, turq. *llaf*, pers. *laf*.

Magfîret = shpëtim, falje mëkatesh; përdëllim, turq. *magfîret* prej arab. *magfire*.

Mahrum (adj.) = *izhveshur*, i privuar, i tëhuajuar, turq. *mahrum*, *hyrë* nga arab. – *mahrum*, nga folja *hirman* = ndal, i dal në rrugë dikur për diçka.

Masraf-i = shpenzime, harxhime, të dala; në shqipe ka *hyrë* me anë të turqishtes, e burimi i saj do kërkuar në arabishten, nga folja *sarf* – *harxhoj*.

Melun-i (m) = i mallkuar; djall, dreq, turq. *melun*, arab. *melun*, part. nga *lean* = mallkoj.

Muhalefat = trashëgim.

Mühlet-i kohë, afat, vade, në shqipe ka *hyrë* prej turq. *mühtet*, këtu nga arabishtja *muhle*.

Mürat (arab.) = qëllim, dëshirë.

Murdar-ad. Pers. = i flliqët, i ndragët, i ndotur.

Nefs. = *epsh*.

Nihajet-i = mbarim, fund, prej arab. *mihaye*.

Nimet-i = *mirëqenie*.

Sahih, *sahi*, adv. = me të vërtetë, pikërisht, në rregull. Në shqipen ka *hyrë* nga turq. e në turqishten prej arab. *sahih*.

Sezde = përluje hyjnore; prirje.

*Şefa*t = mëshirë.

Šübe = dushim, turq. *Šübhe*, nga arab. šubhe.

Tabiat = natyrë, adet, zakon, turq. tabiat, arab. tabia.

Taptiset = adhurohet, nga turq. tapti, perf. i foljes tampak – adhuroj.

Zahmet = mundim, përpjekje, turq. zahmet, nga arab. zahme.

Zakum, zekum = leandër, arab. zeggum.

zebani-a = grua famëkeqe.

zevk-u = gëzim, gosti, turq. zevk nga arab. dhewg = gëzim, galdim, mirakande, mirëqenie.

Zulum, arab. zulm = dëm, padrejtësi, paudhëni, dhunim, terror.

Žahil = i padije, njeri i keq.

Përsa u përket huazimeve sllave, ato janë minimale, në krahasim me numrin e turqizimeve të këtij ligjërimi, po edhe me numrin e atyre që dalin në të folme geqe e toske.

Këtu poshtë po biem paksa sllavizma dhe po rrahim t'i shpjegojmë për nga ana historike.

Dobi-a (dobit, korist, utilita, vantaggio). Është vështirë të thuhet me siguri se prej së cilës formë sllave do të jetë përftuar fjala shqipe *dobi*; dihet se në jug në të folmet toske, është vërtetuar folja *dobis*; te Bogdani – dobitun me kuptim mund, i mujtun (sipas Selishçevit). Duket se fjala *dobi* do të jetë formuar prej rrënjës sllave, së cilës pas analogjisë së një kategorie emrash i është ngjitur prapashtesa *-i*, sikur te liri, bukuri, dashuri. Po kjo rrugë do ndjekur edhe për fjalën gërdi-a.

Uzdāj-a (nada, uzdanje, spes, fiducia) – është interesante të dihet se në të folmen serbe të Kosovës, në vend të *uzdanje* qysh e hasim te Vuk Karaxhiçi (Fjalori) ndeshim formën *uzdaja -e*-ja e shqipes duhet të jetë përftuar prej një *-nj* serbishte, gjë që përputhet mrekullisht me një shfaqje të njohur fonetike të këtij ligjërimi.

Në sllavizma të këtij ligjërimi numërojmë: vikas, vërsnik, stërvina, apet, etj.

FAKSIMILET E VEHBIJES

وَدَخَلَ فَاذَاعَ اَوْشَاقَ قَشْتَمَا

تَوَانِسُ تَانِسُ اَوْتَاكَ الْعَظِيمِ	بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِیْمِ
قَوْتِ صَلَوَةٍ بِخَيْرِ نَبِيٍّ هُمْ قَوْتِ سَلَامِ	تَانِسُ مَسْئُولًا لِدَلِّ الْكَلْبِ نَبِيٍّ
جَوْنِكَ شَعْوَةٍ فِي حَسْبِكَ حَصْطَانِي	اَذَهَ الْتِكْرُ مَتَوَيُّونَ قَوْنِ مَدَامِ
سَارِ نَبِيٍّ بِرَاكُوْنِي بِرَعَايَتِهِمْ مِيَانِ	تَاوَعُ سَابُوْنِي بِرَاذِنِيَايَهْ هَبِيٍّ وَمَا
دِيْبِيَّ بِرَاكُوْنِي مَتَوَيُّونَ نُوْرِيَّ شَانِ اَوْشِ	عَاقِدَتْ وَبِيْنِ دَاقِيْنِ اَيُّهُمْ قَامَا بَايَانِ
قَوْنِ اَوْشِي قِيْشِي وَانْدُوْمِي فَايُوْرِي	قَالَ بَشِيْرٌ اَسْمُوْنِي سَمِيْدِيَّتِ وَنَدَاوْتِ
سُوْمَعُوْنِ سُلْمَانِ دُنْيَانِ سُوْمَعُوْرِيَّ	فَرِيْقِ يَادَا اَيْشِي مِيْدِي اَوْتِشِي كُوْنِيْنِي
قَوْنِ اَوْشِي مِيْحَمِ اَحْمَدِي دِرْمِيْدِي	اَوْشْتِ بَارَا اَبَا رَمِيْدِي كَرِيْمَانِ دَرْمِيْدِي

مَا عَسَى دِيْحَمِ سَفَاةٍ يَلْكُنِيَا رِيْنُوْنِ اَنْغَرَايِي بِرَاقَانِي نَبِيَا
 مِيْحَمِي وَبِيْتِ رِيْنِيْمِ اَنْوَانِ دُنْيَايَهْ يُوْتِيَا مَعُوْنِ يُوْدَاقِيْنِ بِلِكِي حُوْرُوْقِيْتِ نَبِيْدِي فِي سَابَاغِيْنِ
 كُوْنِشِي بِرَاكُوْنِي فِي دَاقِيْنِ مَوْرِي كُوْنِشِي تَوَا قُوْنِ دَاقَا اَمَا رُوْنِدِي مَا دُوْرِي مِيْحَمِي نَبِيَا
 دَاقَا اَوْشْتِ مَا رُوْنِدِي نُوْوَاغِيْشِي مَوْلُوْءِ اَمْسَارِ مَا وَاوْشَارُوْءِ
 بَعْغِ اَبَا شِ اَوْزِيْغِي دَا اَيْشِي تَوُوْءِ بُوْعِيْنِ رَاذِيْلِي

اِمَاذ

اما داو و غول درین که حاله قشنگ اوشت
 دنیایه ستره دین لوئیس معلوم بلک کس
 بوس دنیان مومور انجالی احو اوشت
 بون پر جهر هم کانا که جان اپر بی کس
 اوشت علامت سقا سالت بود لونه
 کوشم جو تو هم اسپو قایم نین تنای
 ظاهر بی سیم بوجیز یادم موعات ناما

قای مورعی زان بن مونس پو شمشیر تا در پیشش

دنیایه پیر اویاق امر دزه آپا قرا د این صرا و اپیت قومی دوی کروی سزاو
 امین مونس مپانس کتره دوت بود و ورین آد اقیه و در بر کاشم مونس موقاد هت
 ماسیک دوط نانا مونس قشقی بود بود قای بو شو هم نایب معایت بلک

دنیانا اقیه دوشمانه پر اموسی بی مراد سپه روانه

شتات دیت هاد زیارم جهر سالت پیر
 قشور زیارم کوشم دوریم نین تنای
 چونک سدور ویم مونس انرا تین تنای
 و خ زیارم میت ساسا نور علی مهر لهاد
 پرخا زیارم میت تو تو انغراف قی آده قای
 قوش سپه تو تیت اسپو فاهو اذ و تری عا

رخصه دو بوع بو آب مهر لکت واکر موشت پایو اجلا

کیت چلیت قشقی غور مو کاف لذن اوشت زیارم توو اکت نالت غور پریا کیت پوشت
 جهر هم بونا پیر اوشت غور یا فال که شتات دیت بی هویت اوشت نادر مورا
 نووند تدرووت زیارم دنیان نوسه هم نینا اسود قول فان مپانس
 پرخا زیارم میت رطل نادر وایت یورک ناسدیم یاد و وایت

اهل جهرنم شتات فان عفورت تمامه
 دؤم گونيت ساني بيشتو بوخت تمامه
 اهل جهرنم بون سورنجين هم موقتم
 اوچك بدين يا اوچو شون دوت تمامه
 شتات گونيت شتات دوت اوڭ اوڭ لمانه
 قوندره شتات شير ميان ديت اي كوكانه
 بوغجي فان اده تورق حانه زقمم
 هم زبانيت ايقيد بسن مدين امانه

قوش او امين پارو وعه بر جهرنم اي اوڭت پاشب اهل جهرنم
 اهل جهرنم با ايمان شقاوت بون ناشي سديت قوش كلون پور دوهن نالبا درووه توتوا
 چيسه نو جهرنم با ايمان نوزدم مپاس بوغ پورسا اهل جهرنم تور بو غضب مپايو
 شتا اهل جهرنم نيت نووند تور پاشا ورت مپاش قوم اومت رطل نارد اويت

موقت يات يام زمارت پرات يات يام بار ايتيش
 برع زبانيت گوني خليف مابو يا
 سالماز اوڭت فاش ديت اي پور يا
 شيرن زنجين جهرنم سا اوروندا
 قوشن مغوي مشور سديت اي
 كاڭ او توشن جملك شيرن سامبا
 بر ميكت ايسان نو جهرنم زوق امرا
 شتات پال تم قن بي حالق هو ايعوندا
 پور علامت اوڭت كي شوش قور او اي

برع جهرنم رطل نارد اويت انا شتت نو ميمت كيم توتوش
 درميه روفر هومت زبانيت ديت اوڭ اوڭت سخي ز اهر شتات ديت بر و شاد بوردوش
 وساقه فتح غوبات يا او شدين زنجينه افغ غوبات او نير بر دوش
 پور ناز و طيت اوڭت محكمت پرايس بو اموندا كالمك
 شيرع شقا بون واي مرون بون كاتر عا

حاليا اونه

حايا ائتوت اوت زقوم كونا احوات
 ما سكه خان دوت بتو نوهت كه فاذ
 قور تپين اوغا قان مئون ساغور ووز اوغا
 كوش نادوك فموز انار سوم عا شير دوعا
 اوشت بوج ستم قال فيا اله فوز بافا
 سه بر تو سا شوم فيال قائم باق
 عيسو شيرين بيم باق ووه مور موق
 سه سبو قاقوش دوت بوج ستم عيسو بوقا

نوز اذت نومندا ماسي شومون دنت سته دوعا قور في سندا

ناشي نا فان با م نيا بوج بروج وورده سي ما باس سلسنه جنات ندور باسي عوم بوج موي
 سي قور بون في جناتي منار با د ستم او مرق ووش اهل جهنم ظلل با نهارينه
 قوا قاروقا دنيا ي سا سيمو عا بوج بون اغي اوشت سي كانا كه لو بوسيدون
 شقه توع و توع في اقيبه قوا كوزي عيسو في ييه

دشت جناتين في بوج قشقا بايون باندا
 سه بر جنات سا او وند قشقا ماني سندا
 بوج بوج جنات و بون مفعول قور موق ندور
 خالقي كفضي بوج ماسي ماشي ندور
 ناش ندور اوشت كوت قور نا با كوش بوج
 سي محبت قان اكو كوت بون موق
 دنت بوج دنيا قح عمار سا قح موش
 بوج جناتين اقا ان كيت تو آفاش

موان قوش بيه هت چيه هت امدنيا قوش بيه هت نو وود چيه هت
 قوش سموار بوج قوش كوا سيات ندور مذون قوش كوي هي نوحيت با او ذال بوج با كوي
 جنات قان كيت بات بوز بولون كيت اوشت بوز انا ك بون اندر ايت
 يدي عا يا حرو ووهتن سونا قاش سادومين با وواش
 مامو خطا قوش سومه اغي كه ووهتن ادو

شاره من العتق تارخو فائز پر دین کی ضرورت سے وہ فای اوتون قشود برن
 چونکہ دوہنت محسن ظن ذوقک ہو تونہ ناگناہ پر غامس خلیت قام شدت
 قشود باطل شویم فیال قاہ باہمانہ کیت اسچلی فان بر باطل تونہ جوائہ
 سچی مہاش انکار من تحت کو سپورونہ مہافت نادل لالک الالک تونہ

تونہ اذان محماتت پریشتم اقام کناہہ باشم جو سبائہ نوجنت بانہ
 بو مہاشم تونہ قشود جویم شمع سبوا تونہ غیلات تونہ یوحی شمس ما یامرکم باکم ناھوت
 نا شیحی باطل تونہ سبوا پا اذون نسلخ الق تونہ کہ فای او تضرار سبوا
 ما سکر تونہ اوشت دو غامالت پر اقوش سغائل اوشت محروم پر غامالت
 موشرا ساراشی افا و لا اور سبوا یا اغوہا مقدرہ فی تونہ

زیاریم دنیاں کترہ خوش بود اور تونہ اوشت پر مدیت ناز یاریم ہر نایت قشود اوشت
 ماشیحی غیشین تونہ جویم قصد کناہہ پر غی زیاریمت من سچ شمار نا اذہا
 بیت نوسرا ہم انجاق انا کی دست فاورد سہ ادویجی کہ تونہ یوحی انا و تونہ فاورد
 امن او تونہ پاتوق او تونہ تونہ تونہ دو جی بابہ تھنظیم پر ہمتہ دوہنت تونہ دو جی

عقوقش تونہ پا اذ تونہ شقا و پر ہادغی اہا و غلق شقا و پر ہادغی
 دوہنت فی اور باقی رہانیت تونہ ناک اکت سبوا مشون شقا و زیاریم سقوم
 نا شیحی نا یا شیحی غیشین تونہ زیاریم دونہ ہاد سنا یہ تونہ زیاریم ہر نایت تونہ ہاد
 شیت غیشین تونہ زیاریم دونہ ہاد پر من تونہ غصالی زوطیت من ہار
 قوش بیت بالند مو اس بیت کت سچی سمون بال سوسا س

ماد تونہ

ماذنوعاً في أمثرت زوطيت بالوشور
 قوش او غلونه حور بهت يا قاور
 برعاً حقت قان قول كه كه كو هكوف
 بق كو كان قوتبعان كه هيتي شكناه
 وچقه مشو كوش دو مبعو حوش عمل
 بود شق لو بيت كوش بو لو بيت او شق عمل

شق قيب سو بيت شق قيب حرو هت قح عمال كو نيت

ماسك زوطانا اناسي زان غير باشر قوش بوند و تاشه جزانده اسانج بابيه پايون برعاً شق
 زوط منادش نوجبت حال مرمت نافرشي پاناز امارت مودر طرمت

زوطانا اناسي پرواني كتره كو سفا بودر و بيت موندت افا

پايو جاقرو و ت تقا كت نوق ابو باد و بي نغولت

ثاني ايمان يا عمل قوش و وسپاسن
 او شت درو با ماده كه نورق نوق دس اع
 ميكن بر قع كه حاوا انسانت فامو كاف
 موعى يا قيب حاوا شت دره ايتا
 اع كو كان نهلو كه ساسا قامپاسن
 نورق نوق بو هت نوجبت مفا اع
 حاوا سبي انوش بتر قوش قامو كاف
 اع شت ان كود نماه او نديت

شق نميدلش موقت بامه في انو قور موات بات

عمالت پرا امانه دروشه سبوعه بودرسي رونيت بر لس بونا نو اد او امانه اند مو است بونه
 سسي بو قوتيو ناي نوهوش باد ما و نوجبت هم در اجن قيه پايون سسي قيب بو موندت
 بر كيشا سدق اموره افو امر حيت نلو بر بواز تار برغي قور درون سبويه هم ادر
 كوش فال شميبا اغن و هتن بر پنده اذ نوهن

حاقن قوش زو طوقا لا يادون
 لني كاوش حاقن درميه جيو انت تاملون
 سما يورد الميرك مودنيا بري ناسا
 حاقن امن بري عساكي كبرينا پات
 قوش مقصد انبوني قودا بونديكت
 سادوقه كيت فوسه نيم ابد اني
 قودون مبعي قودا و باسقا مان انداني
 سامرا كاق فاموكافي هو انخر اكي

نيري حاقن بون بون وليق مونس فويشو ك او شني اكي اني

مانس او يتوع بر ميون فوعه ديمه قوش بون نيست
 موكا نيست انو ابوني انور
 گناهكار اقا گناه و نفا گناهت
 انون ك اويديس نار موقيات
 مبعي مود بادم او شني بري
 انبوني اده انبوني او شني بري
 دانشي پور موعا
 نيري كتن شپان سپر پور ايجر
 موعه و نديت

ساني زاره نتريني دوديهو قور پورفا
 نغو بالون البت با بوني جنه
 بوعه في انان قور بوقا بحت اي بوفا
 نار ديمت زو ط ابون نوقاش بلا
 يا بوقا خيد سا با عور كوت قور نماز
 باشنا عنت قور ادي مانس نوم زمان
 يا ميان سندر و كور شتم قانيناز
 پورده او شني رال اني سويان اعتبار

دطس زانان دين بوانعت رحمان
 كاتيك و اندي نوندر رحمان
 ميان سندر اكون شتم قور بوقا
 رال ميان سندر شتم شمش پوجو
 موعه بوردال
 سوي قور شاي اهل جنان او شني
 حابن اشتم شاي اهل جهنم او شني
 شار
 ما يكر بور او شني مبل افر
 و ان ايپ قور ت ميا كاش
 ايا شون لپه فيا لسن
 مستور لي يكل اش او بوم
 بون شو كين م ا دو كا

نيري گناهون

پری کناهوت با او شیه ریابان سفا
 ماسیک زطس نا شیه انا نا
 مور بو نو دک پری زیار من دو هج هج
 حلالی شیه ر و عینیه بو هم نا نا
 شقه منون ناماسیک زطس نا نا
 کیت قوشاوشن پینج توفا شو نوین دیه
 وچ اتوت ک پونوین خیر انا
 قته ابوین و هندن آزار شیه سفا
 سحر ایس ک پینج هت مشر اشو ازال نوم هاد پینج هت مخین
 فان نون موکت یاز کناه متکلج مار اندی ساد و نوم مزو کات کناه دو هت کناه
 منرا کوفیالار و طیت کیری پری شیه دو اوشن پینج وچ شیه قیت انا پری شیه
 قوش بو هت پری بار کیری مینا ک اجوین نو وقت او اندوین مو هت

رینمی پری بندن ماسیاییندین اسپس

کیت قوشاوشن پینج قور کناه بو کله سفا
 پری سالیت کیشا سده قوشا فاهمان
 پری سالیت با بو مصر او و اشس اسان
 سانی قور دیت سله با بو دوه هرابا
 قح امون قوشیه دونه جوا
 دغه کیه اوشت کناه با کفر فاضرا لری شیه کیه اوشت پانگ 272
 مندیجیت کوشن بو قوشن و قادرا جن نامو نوین بو قوشن نا شیه بو قوشن پری شیه
 حاجی مانا پری دوهت معلومون با عهت بو در راجیا امو نو هت با او پینج هت
 خیمیا گو ک پوقش مزو نو ای پری بو قوشن مزو نو ای پری مو قی مو مو
 رینمی پری وانی سالقون پری کاش کاک او دوندن

وَتَظُنُّ نَانُونَ كَيْ سُوْرَتِ بُونِ صَرَارِ
 هَلُوْ مَوَكَّافِ يَأُوْرَ اَوْشِ كَاوْشِ فَاغِي
 وَتَظُنُّ نَاكُوْشِ بُوْغُوْشِ دُوْرَ اَكْمِ
 مَا فُوْ بُوْغِي مَرِيحِي اَوْشِ اَمْرَ اَوْشِ

سُوْرَتِ اِنْسَانِي اَنْجَاغِ اَوْشِ فَاغِي بُوْنِ صَرَارِ
 بِرَ الصَّرَارِ اَلْبَتَّ اِي شَيْءِ مَرِيحِي عَسَاغِي
 كِي يَابُوْغِي اَجْوَالِ يَالُوْجِي حَافِي مَرِيحِ
 اِي اَوْشِ دِيْتِ كَاوْشِ بُوْرِي مَرِيحِي اَوْشِ
 دُظُنُّ تَنَّا اَوْ اِي سَنَابَرِ فَا صَرَارِ عَسُوْرِي بُوْرِي مَرِيحِي نَاوَا اَشْرُوْ وَرُوْطِ نَاغِي
 فِي يِي بُوْغِي مَرِيحِي نَوَا فُوْ اَوْ بُوْنِ اِهِي شَيْءِ اَلْغَاغِ اَلْاَكُوْنِ اِيَا مَسَا بِي مَرِيحِي يِي بِرَ اِيَا مَسَا اَسَلُوْغِي
 يَالُوْ بُوْغِي مَرِيحِي بِي اَمْرَ سِي اَمْرَ سِي اَمْرَ سِي اَمْرَ سِي اَمْرَ سِي اَمْرَ سِي
 مَرِيحِي فُوْرِي مَرِيحِي مَرِيحِي مَرِيحِي مَرِيحِي مَرِيحِي مَرِيحِي مَرِيحِي مَرِيحِي
 فُوْرِي مَرِيحِي مَرِيحِي مَرِيحِي مَرِيحِي مَرِيحِي مَرِيحِي مَرِيحِي مَرِيحِي

وَتَظُنُّ نَا مَرِيحِي مَرِيحِي مَرِيحِي مَرِيحِي
 بُوْرِي مَرِيحِي مَرِيحِي مَرِيحِي مَرِيحِي
 بُوْرِي مَرِيحِي مَرِيحِي مَرِيحِي مَرِيحِي
 بُوْرِي مَرِيحِي مَرِيحِي مَرِيحِي مَرِيحِي
 بُوْرِي مَرِيحِي مَرِيحِي مَرِيحِي مَرِيحِي
 بُوْرِي مَرِيحِي مَرِيحِي مَرِيحِي مَرِيحِي

دُنْيَا يِي تِيْتِ سَا قِي مَرِيحِي مَرِيحِي مَرِيحِي
 دُنْيَا يِي تِيْتِ سَا قِي مَرِيحِي مَرِيحِي مَرِيحِي
 دُنْيَا يِي تِيْتِ سَا قِي مَرِيحِي مَرِيحِي مَرِيحِي
 دُنْيَا يِي تِيْتِ سَا قِي مَرِيحِي مَرِيحِي مَرِيحِي
 دُنْيَا يِي تِيْتِ سَا قِي مَرِيحِي مَرِيحِي مَرِيحِي
 دُنْيَا يِي تِيْتِ سَا قِي مَرِيحِي مَرِيحِي مَرِيحِي

وَتَظُنُّ نَانُونَ

وَتَ رُطْنُ نَائِمِينَ أَكُونَ مَعَهُنَا كَمَا
 هُوَ نَكْرٍ مُسْتَأْفِزٌ تَعَزُّوْطِ أَنَا يُؤَى
 وَجِ اتُّوْنُ كَيْسٍ يُؤَنُوْنِمْ خَيْسٍ أَنَا
 وَتَ رُطْنُ نَائِمِينَ أَكُونَ مَعَهُنَا كَمَا
 سَالِ اسْمُ رُطْنُ زُوْطِنِ أَيُّ مَوْفُوْهُنَّ أَنْدُ
 يُوْرَا أَيُّ أَوْتِ سَامْتُونَ أَهْ مَبْرُؤُ
 كُوْشٍ مَا حُوْبِيْنَ عَمْرِيْنَ تَمَّ ائْتِزَاتِ أُوْ
 مَوْفُوْءَ سَمَامَارُوْنْدَسَ أَوْلَادِهِ وَارَا يَأْسِيْدُوْشُوْتِ أَوْلَادِهِ
 عَرُوْءَ يَأْسَادُوْتِ هِيْ ذِيْ كَيْمِ تَبُوْرَتِ سَأَجْدُ بَا مَعُوْنِ جَائِيْ قُوْجِيْ وَجِ رُوْطِنِ وَهُوَ تَمَّ بَابُوْ ائْتِزَاتِ
 مَا يَكُ بُؤْرُ عَرُوْءِ اسْمِ عَرُوْءَ يَأْبُوْرَتِ سَبَقِ يُوْنِ أُوْبِيْ كُوْنِيْ كَانِيْنَ مَا اَزْ نُوْءِ هِيْ دُوْخُوْ
 قُوْشٍ رَأَيْجِيْ ائْتِزَاتِ عَرُوْءِ مَوْكَافِيْ كَمُوْ اَدُوْ اَدَامَانَا بَاتِ تُوْ اَلْوَعِ
 يَا اَلْوَعِ سَتُوْ رُوْ سَمِيْ سِيْ عَرُوْءَ يَأْبُوْ اَلْوَعِ بَلِيْسَتِ
 وَتَ رُطْنُ نَائِمِينَ بَعْدَ كَيْمِيْ اَعْبَادِ
 بُوْرِهِ دُوْ عَمَانِ يُوْنِ دِيْ سَاهُوْ رُوْ هِيْ
 نُوْجِيْ اُوْ يَأْنِ دَرْتِ دَاهِيْ رِيْ عَارُوْطِنِ رِيْ نَا
 اَدَهْ حَاقِنِ قَانِ مَا لُوْ بِيْ رِيْ بُوْشِ أَنَا
 وَتَ رُطْنُ نَائِمِينَ كَمِيْ قُوْشٍ يُوْ اَقَا
 يَادُوْجِيْ اَقَا مَعِيْ اَمْتِ سِيْ رِيْ نَا
 يُوْرِيْ رُوْطِنِ قُوْشٍ اِبَانِ رِيْ وُلَانِيْ يُوْ
 زَانِيْ رِيْ اَبَانِ اَبَانِ اَرْضِ رُوْطِنِ كُوْنِ رُوْ
 مِيْ سَاقِتِ نَا اَوْلَادِيْ سَبَقِ سَتَائِيْ رِيْ بَابُوْ رِيْ قُوْشٍ وَا
 سَالُوْشِ اَزْ مَوْ بُوْرَتِ سَالِ اَسَاقِيْ عَرُوْءِ اسْمِ يَأْبَا عَمْرِيْ اَيُّ مَبْرُؤُ هِيْ كُوْرَتِ هِيْ دُوْخُوْ
 مَعِيْ اَبِيْ مَدَانِ اَلْوَانِ نَائِمِينَ مَوْ عَرُوْءِ سُوْنِ يَأْبَا عَمْرِيْ سَادُوْ مَا مَوْ مَوْ دُوْءَ اَسَالِيْ
 مَدَانِيْ دُوْ نَهَارِ مَرْزُوْءِ اَمْعُوْ وَا نَدِيْ مَاعِيْ عَرُوْءِ اَوْتِ تُوْ اَبِيْ سِيْ مَانْدِ مَوْ
 حَيْقِيْنَ مِيْ مَاعِيْ مَاعِيْ قَائِيْ كَارِ دِيْ اَلْوَانِ مِيْ مَاعِيْ مَاعِيْ قَائِيْ كَارِ

وَنَزَّ رُطْنٌ نَائِمِينَ بِرُحْمِكَ فَالْأَعْمَاءُ قُورَسِيًّا فَا بَرِيحٌ كَأَوْشَتِ دُورًا فِي فَا لَمَّا
 أَوْشَتِ غَائِلِ بَرِيحِي عَمَّا زَنَتْ نُوَادِي كُورِ نُوْرِي نُوَادِي كُنْتَ أَيْمُو حُجْرَتِ كُنْزِ سُوْرِ
 وَنَزَّ رُطْنٌ نَائِمِينَ بِرُحْمِكَ يُعْمِلُ مَا مَنَدُ نُوَانِي زَانِيَةً مَسْعُورَةً فَكَيْتُ سَبَا سَنَدُ
 سَا فُوْرُوْدُ بُوْرِي حَالِي سِيَا لُوْرُوْدُ كُوْرِي أُوْبَتِ سُوْرِي نِي مَنَدُ سِيَا لُوْرُوْدُ كُوْرِي أُوْبَتِ
 قُوْرِي أُوْمُو طَاعَتِ بِأَعْمَلِ أَوْشَتِ بِرُحْمِكَ قُوْرِي أُوْمُو طَاعَتِ نُوَادِي لُوْرُوْدُ نِي

بِيغَمْبَارِ زَانَا دُوْرًا سِيَعِي فُكُوْرُوْدُ مَسْعُورًا نُوَادِي عَسْرًا لُوْرُوْدُ نُوَادِي بُوْرِي فُكُوْرُوْدُ زَانَا لُوْرُوْدُ نُوَادِي
 بِيغَمْبَارِ زَانَا بُوْرِي فِي عِبَادَتِ رُطْنِ بَرِيحِي مَا لِيَا أُوْرُوْدُ فِي كُنْزِ أُوْرُوْدُ نِي
 قُوْرِي سَنَائِي سَتِ رُطْنِ بَارِزُهُ أَلْبَتِ دُوْرًا نَائِي سَتِ كَلْمَتِ مَنَدُ
 يَا أُوْمُو قُوْرِي زَانَا أَسِيْنِيَا سُوْرِي دَرَا كُنْتَ نُوَادِي كُنْيَا

وَنَزَّ رُطْنٌ نَائِمِينَ أَوْ حَالِي سِيَعِي أَيْ عَمَلُوْهُ أَيْ مَعَارِفَتِ قُوْرِي فِي عِبَادَتِ بَرِيحِي أَيْ أَيْفَا
 حُجْرَتِ كُنْزِ سُوْرِي سَا فُوْرُوْدُ نُوَادِي عَسْرًا لُوْرُوْدُ نُوَادِي بُوْرِي فُكُوْرُوْدُ زَانَا لُوْرُوْدُ نُوَادِي
 هَمْمِي نِي كَالْمَعَالِيْمِ كَالْمَنَائِي سَتِ دُوْرًا نَائِي سَتِ كَلْمَتِ مَنَدُ
 رُطْنِ نَائِمِينَ أَوْ حَالِي سِيَعِي أَيْ عَمَلُوْهُ أَيْ مَعَارِفَتِ قُوْرِي فِي عِبَادَتِ بَرِيحِي مَا لِيَا أُوْرُوْدُ فِي كُنْزِ أُوْرُوْدُ نِي

دَا سَنِيَا يُوْرُوْدُ سَا نُوَادِي نَا كُوْرُوْدُ نُوَادِي عَسْرًا لُوْرُوْدُ نُوَادِي بُوْرِي فُكُوْرُوْدُ زَانَا لُوْرُوْدُ نُوَادِي
 بِرُحْمِكَ نَائِمِينَ أَوْ حَالِي سِيَعِي أَيْ عَمَلُوْهُ أَيْ مَعَارِفَتِ قُوْرِي فِي عِبَادَتِ بَرِيحِي مَا لِيَا أُوْرُوْدُ فِي كُنْزِ أُوْرُوْدُ نِي
 سَا عَالِيْمِ أَيْ عَمَلِ أَيْبَارِي دَعْمَدُ قُوْرِي نُوَادِي سَتِ دُوْرًا نَائِي سَتِ كَلْمَتِ مَنَدُ
 نُوَادِي عَسْرًا لُوْرُوْدُ نُوَادِي بُوْرِي فُكُوْرُوْدُ زَانَا لُوْرُوْدُ نُوَادِي
 نَشَقِي سِيَكْتِ نُوَادِي هَيْكَلِ سِيَا لُوْرُوْدُ نُوَادِي عَسْرًا لُوْرُوْدُ نُوَادِي بُوْرِي فُكُوْرُوْدُ زَانَا لُوْرُوْدُ نُوَادِي

وَنَزَّ رُطْنٌ نَائِمِينَ

وَتُذْصِرُ نَاجِهُلِ اِنْسَانِ اَوْشَتِ مَوْشَرِ
 بِرِ اَشْتِ هَشْرِ بُوْر نُوْبُوْشِ فِ كُوْشِ تِلَاشِ
 قُوْشِرُوْ جَاهِلِ سَادِي اِيْمَانِ نُوْشِ اَوْتُوْشِ
 قُوْشِ دُوْشِ دِيْتِي سِي اَلَا قَامُوْكَانِ
 سِي عَلِي الْعَجِي اِي اَعْمَلِ اَوْشِ اَسْمَاقِلُوْ اَشْتُوْ جَاهِلِ اَلْعِي اَوْشِ مَوَازِلِ اَلْعِي

سَاهِي اِي اَقِيْبِ دُنْيَانِ كِي اَوْشِ مَلْعُوْشِ بِرِ اَمْعُوْشِ اَوْشِ اِيْمَانِ اِيْمَانِ اِيْمَانِ اِيْمَانِ اِيْمَانِ
 نُوْ اَمُوْشِ مَوْشِ اَوْشِ نَا دُنْيَانِ اِيْمَانِ اِيْمَانِ اِيْمَانِ اِيْمَانِ اِيْمَانِ اِيْمَانِ
 اَن نُوْنِ جَاهِلِ اَوْشِ دُوْشِ اَوْتِ اِيْمَانِ اِيْمَانِ اِيْمَانِ اِيْمَانِ اِيْمَانِ اِيْمَانِ
 شَعْرُ دُوْ مَوْشِ اَفَاكِ جَاهِلِ اَلْعِي اَوْشِ اَلَا اَفَاكِ

سُوْ نَمَازِ اِيْمَانِ اِيْمَانِ اِيْمَانِ اِيْمَانِ اِيْمَانِ اِيْمَانِ
 قُوْشِ اَلْعِي اَوْشِ دُوْشِ اَوْشِ اَوْشِ اَوْشِ اَوْشِ اَوْشِ
 قُوْشِ اَوْشِ اَوْشِ اَوْشِ اَوْشِ اَوْشِ اَوْشِ اَوْشِ
 قُوْشِ اَوْشِ اَوْشِ اَوْشِ اَوْشِ اَوْشِ اَوْشِ اَوْشِ

مُوْشِ اَوْشِ اَوْشِ اَوْشِ اَوْشِ اَوْشِ اَوْشِ اَوْشِ
 اَوْشِ اَوْشِ اَوْشِ اَوْشِ اَوْشِ اَوْشِ اَوْشِ اَوْشِ
 اَوْشِ اَوْشِ اَوْشِ اَوْشِ اَوْشِ اَوْشِ اَوْشِ اَوْشِ
 اَوْشِ اَوْشِ اَوْشِ اَوْشِ اَوْشِ اَوْشِ اَوْشِ اَوْشِ

کوم عالیت ماخیزلی اوشت ناد سلا
 عبادت قور بونجه باهیل قور
 ماخیزلی بونجه دود کات بر عبادت نا
 قورن کاردت کور موند و همن دانیا
 انامی عالیه شرم از سقا قور او شرم
 پور نا فالزوه تا شتی ای قور او شرم
 پور قور ان تون دیر شکر بونجه قورن
 خلق ریشک کور ماده او و سول کورن و بونجه
 دیرس پور او شرم پان کور با خالق شکر منجهن قورن تا شون شکر
 ما بونجه میانس بارانی مکان جاهل کور سلو و همن کور میانس بارانی کات عالم کور انجه
 پروردن نماز کور سعید او شرم علم آبات پروردن نماز کور سعید او شرم علم
 آهل عبادت میونس کات او شرم قور ان میانس ای کور با هسان
 سو نیسی قور بونجه بونجه بونجه نماز کور انجه
 هم مانا ای فیال نین قورن سکده
 ناسموندونین موات بات قورن بونجه
 سا اموندونین انج کور دیر پان
 پوررد و سپه عیلت ای سبانه قور انجه
 نایا بر ایسور بوزرت و عظیم سحرشان
 پور کور بونجه بونجه بونجه بونجه بونجه
 پور قور ان تون مین بر سیه ای سال هزار
 مین پور حالیم کورن و این شانه انجه
 دعانه پور بوزرت کورن و ای دودینا سینه پورن عیلت انجه
 فی سوج کور الا خالق ای بوزره او کیند سی ندون ای او شرم با موثر کور کور قورن
 و سلسوج سما پانی موندیم آفان سوج لعین کور باهیل کور آفا جاهل لعین
 قورن یا بونجه عروین شوکت و دت ای و دت بار امونوسیت
 قورن کیندات قورن قور قورن انجه

هَمْ اَوْ نَا كَيْتْ قُو شُرْ مَوْ كَافِ فَا دِي بِي تَهْلَفْ كَا وُ شُرْ بِي نُو مَحْصُوسِ بِالْوَرِي مَبَانِ مَنَا
 سَ بُونُونِ اَيِ تُو رُو مَحْدَمْتِ نُو مِ زَمَانِ پَا بُو اَوِي سَنَدِي شِيمِ اَيِ وَ تَشْفَا اَنَامِ
 هَمْ بُو اَيِ بِنِ بَرِي دِسَا وُ تُو رُو شِعْمِ بُو رُو دِسَا پَا قِ تُو رُو بِنِي اَوِي شِي اَيِ شِعْمِ
 قُو اَوِي مَزْدُونِ قُو اَوِي وَ نَدِ رُو نِ قُو اَوِي قُو اَوِي نَعْمَتِ لُو بِنِ مَحْدَمْتِ قُو رُو بِي
 نِي اَوِي وَ تَشْفَا قُو بِي تَشْعُمِ نَعْمَتِ سَا وُ تَشْفَا لُو بِنِ اَيِ مَحْدَمْتِ
 بِي اَشْرَقِي سَا نَدِي مَحْصُوسِ سَا وُ لُو مَحْصُوسِ اَوِي اَوِي اَوِي اَوِي اَوِي اَوِي اَوِي اَوِي اَوِي
 رُو بِي قُو اَوِي بُو لُو بِنِ نَعْمَتِ بَرِي رُو طَبِ اَوِي بُو لُو بِنِ مَحْدَمْتِ بَرِي رُو بِنِ
 پَا بُو بِي سَا نَدِي مَحْصُوسِ اَوِي نَافِيسِ پَا مَوِي اَوِي مَوِي اَوِي مَوِي اَوِي مَوِي اَوِي مَوِي
 خَا بَرِي نُو وُ غَلْتِ اَوِي شُرْ كُ مَخَا بِي تَا زِي تِ

مَوْ سَا وُ مَبَانِ شُرْ وُ بَرِي سَ دَسُو لَ نَا كَيْتِ فَيَا لَ اَفَا لَ مَوَابِ قَا قُو شُرْ نُونِ هَمْ قُو شُرْ بُو اَوِي
 سَا نَا اَيِ قُو شُرْ دُو بُونِ هَمْ كُو شُرْ وُ بُونِ بُو رُو سَا اَوِي شُرْ قُو شُرْ بُو رُو هَمْ مَبَانِ اَوِي
 مَسِي مَوَابِ قُو شُرْ مَخَا بِي تَقِ قَا لَ اَفُو مِ مَسِي مَبَانِ مَرَا دِ قُو شُرْ وُ مَسَا پَا مَحْصُوسِ اَفُو مِ
 سَا نَدِي اَفُو مِ مَوِي نَا بَا قِ مَسَا يَا دَا نَا نَا بُو رُو سَا اَوِي شُرْ زِي اَوِي اَوِي اَوِي اَوِي اَوِي اَوِي
 زَهْ وُ سَا اَوِي رُو مَحْصُوسِ اَوِي اَوِي اَوِي اَوِي اَوِي اَوِي اَوِي اَوِي
 خَا بَرِي اَوِي مَسِي مَبَانِ سَا نَدِي اَوِي مَحْصُوسِ اَوِي اَوِي اَوِي اَوِي اَوِي اَوِي اَوِي اَوِي
 نَعْمَتِ اَوِي مَوَابِ رُو مَحْصُوسِ اَوِي اَوِي اَوِي اَوِي اَوِي اَوِي اَوِي اَوِي اَوِي
 مَالِ اَوِي مَحْصُوسِ اَوِي اَوِي اَوِي اَوِي اَوِي اَوِي اَوِي اَوِي اَوِي اَوِي
 سَمِي مَحْصُوسِ اَوِي اَوِي اَوِي اَوِي اَوِي اَوِي اَوِي اَوِي اَوِي اَوِي

شعوم

گوم عالیجن ماخیرلی اوشت نادره
 سے عبادت قوز بون جاھیل قور
 ماخیرلی بون رور کات برنج ایت نا
 سے قوتون کارد که موند وھن دانما
 بود زافالزوه نامستی ای قوش اوشت
 نامھی عالم شرماذر خاقور اوشر
 پھر قوفان تون دیر رشک بون قوتون
 خلق رشک ماذہ او و نول کوش و بون
 دیرس پیر سے اوشت پان کور یا خالق
 خلق منھن تون نالوش و بون
 ماخیرلی میانس بار این مکان جاھل
 کیر سلود وھن سے مہان قور ای
 مکت عالم کور اوشر
 پزدت نماذ که سفید اوشت علم
 آبان پزدت نماذ که سفید اوشت علم
 آھل عیالت مین مکت اوشت
 قور ای میانس ای کویاھاب
 سونیبی قور بون بون ما نماذ
 کذا بون
 ہم نانا ای فیال تیر قوش سکھ
 ناسکھ ندون موات بات قوند
 سا اموندون اتغ کیر دپی یاد
 پورد و پست عیلت ای سیات قور
 آباد
 نایا پر اسرین پوزر و عظیم
 ستر شان
 پیر شوقان تون مین پر ماھل
 مال هزار
 مدعا ھے بھار کوشق آری
 در وطن اس سفید ستر
 فی سوح کوالخالق ای بون
 آو کیندی سی تدون ای اوشت
 ما موثر لو کہ سے قوتون
 دسا سوح ما باق موندیم
 آفان سوج لعین سے جاھیل
 کافا جاھل لعین
 قوش یا بون غروبین شوکت
 قوت ای وند پارامو تو سبت
 قوش کیندات قودو قور قوش
 انور سکھ

مَن دَر بَاحِ عَجْفَتِ فَيَا لَيْلِي رُؤْيِي
 بَرِي فِي دَارِ سِرِّ حَقِّكَ اَوْشَن قَوْلُ مَوْجِي
 فَوْرُ مَوْجِشِ مَآخِرِي اَوْشَن قُشْتُو نَانَا
 سَهْ عِمَادِ بِنِي كِه كِتْ خَالِقِي اَقَان
 هَم نَجِي وِيتِ نِي مَبُوحِدَتِ صَحِي
 مَانَس نَجِي وِيتُوج مَآوَدَال اِبَادُوجِي
 سَآضِرَازِ نِدَاقَتِ مَآوَدَالِ بِنِي صَحِي
 بُو هَفَ مَآ شُوم كِه دُوبِيَا كَالِ وِيتِ
 مَنِي مَخَالِفَتِ بَرِي مُونِ رُجُوعَتِ سَامِنِي جَالِ عَآذِ سُونِ بُو هَفَتِ
 مَانَس نَجِي جَالِ عَآتُوجِ فِي مَخَالِفَتِ مُونِ نَبُوجِ بُو هَفَتِ سَامِنِي جَالِ عَآذِ سُونِ بُو هَفَتِ
 سَوِيَادُوجِي مَآوَدَالِ سَامِنِي شُوعِ اَمُويَا تِ سَامَا وُجُوعِ اَمُو وَا نِدِرِ مَآوَدُوجِي
 بَرِي عَآ مَسِي بِي سِرِّتِ اِبَآ شِي جُوعَتِ قُوشُوجِ جَالِ اُونِ سِرِّتِ
 شَقَرِ دِي هَتِ مَحَالِ سُونِ فِرِي هَتِ مِغِيَا
 كُوجِي فَا لَقَهْ دُورِ كَالِ بُو لَقَهْ دُعَا
 سَقَرِ بُولُوجِي بُو هَفَتِ حَاصِلِ دَا لِيَا
 جِدْ نِكَارِ بَانِي نَازِ هَآزِ اِي حُوجِي خِي
 كَنَزِي دِي تِ وِيتِ نَبُوعِ اَعْدَمَتِ قُشْتُو نَانَا
 اَتِ نَآزِ هَم دُعَا نِ فَالِ رُوجِي خِي
 بُو مَآوُوجِي فَا تِ بَارِزِ مَآوُوجِي سِي خِي
 اِي اِنَا سِي وُوجِ اُونِ فَا تِ بَارِزِ مَآوُوجِي
 بُو دِ حَرَامِ جَا هَم بُو هَفَتِ كِي مَآوُوجِي
 بَرِي حِي دَمَا تِ قُوشِ سِرِّتِ اِبَآ مَآوُوجِي فَا لَقَهْ
 بُو سَهْ اَوْشَن سَرِ اِي فَا رِ اَشَارِ تِ بَرِي عَآ سِي خَوَانِ بَرِي سَرِ اِي تِ بُو بُو هَفَتِ اَمُو اَزِ قُوشِ اَوَا كِنَا
 قُوشِ دُورِ مَآوُوجِي بَرِي كِنَا اِبَآ سَرِ نَآزِ اِبَرِ تِ مَآوُوجِي نَدَاقَتِ بَرِي دُعَا سَرِ
 مَآوُوجِي حَرَامِ اَمُوسِ قَوْلِ زَانِ نَبُوعَتِ دُعَا يَاقُوعِ قُشْتُو نَانَا
 سَقَرِ اَوِ شَقَرِ نُو بَالِ سِي تِ بَانِ اَزِ

او بر ماند

او پر ماندی غرور ندی پيشمخت
 کابو نوون فلي بون عبادت نانت اوت
 د بانی نوفا سے بوانون کيت مون ابو
 بود اذيت بون مغوغ قور شيعه ابو
 نانا ابو حنين غا نو سحر نام او ن ابو
 جو نکر اقا سموت قان د بکت ابو
 هم حرام سالن شيبه و نيز با ن بابي
 هم تشنه نيت با ن ز قوم سبال دارق
 انبيي برجا سادس با او نجي برجا سادس با او نجي برجا سادس

مبي داق بلا سقا امبي وورد ر سقا امبي نفس و عثمان سقا امبي سوي نمان فلي سقا
 بر ما نانا مودوم دوط قوند سقا سقا او کي سموت قان طيمنت اقا
 مشق تيا فونيو ايش شوکت نيت البت نيب مور و نانت
 فونش پوات نوفا بيرت بود رال کيند فالزو اکر دوت

برغي غرور غور ازان پيشمخت
 کابو ميلا او شون بون عبادت نانت اوت
 بود بو قاشتن نيلو نوفا ابو قو کوا بو
 نادر سول بر اچو نکر فاشتن نيلو نايو
 جفا ز خبير فاپر شون کاوشن پير ابو
 بر افيالين نامة ناشن سرح موه
 مونس بو شتن نيلو کناه بون في مرزا
 مبي بو بون جاهل هم غوبوني موز
 مونس او جو ساندان پروا ن سقا زامان اينا اشکاني

د طلع ننامو سحر و حيس نونن برجا نياش کي اوت کولين سقا نورد رال
 نير سقا جون سولني اوت اوان مشق ال مان واني اوت اشکاني
 دور ازان با اورت پر اسانا شو صفا ايلقن تا نر ماندين با کلغون
 با قيبوت برجا واني موند کيندش اشکاني

موعی ابا کونین بوقیمة ای ملوت
 شقه عا قود ارض اکت اعی کومبتاده فونز
 موعی نا ای زط فود و بجوم دروعنا
 ساپوتوتت زانت اکت ای پور بوغا
 زوط نا ابا موعی مزوتش قشتو اوشت
 مزوتت بر عا قراش نوا فایز مینوس ساروت
 دو دوت ما نغانت تار مکبیل ای سامبل
 قوادشت دنیان سبا فایز فاین هو
 اوشت دانشیا دنیان فرو و ته کیشا سرت نما

پیچبار نا نا دنیا اوشت شپیا ای که موعی سنا ایز نه بیولاد انجان ای که مند سنا
 عیایه زاموره بی که او دنیان بر مبعو خبرانه زلمت ساع اوشت مالماز سیرانه
 قوش افور چون دانشین دنیان اول موعی علم اسر
 اوشت دانشیا دنیان دنونیا کیشا بلانس

بشرین موسان قود اولوط ای شی مر
 لهر بی انسان کلمه ای فک شی عورا
 موعی نا ای زط ا حکمت شی سارا
 زوط نا اوشت رمب بو کشت شی سورا
 بشری تلال ذلی شتس هو شی سارا
 نوجا و قایق شتس باد ای اورا
 موعی نا ای زط شتس باد ای سارا
 زوط نا ای بو بی نوبه شی اورا
 نبو خشرقی یارانی متغاف موندوین بی موعی فی اذلا

بر فی نیری که کوهی اوان شی سورا بر امعونا نه تون تکی شی باهم زانو بیوع عور اوشت
 معود و هشت نه پیکش معوعه پکنو معو خشر یوهش موعی تانی انکو هوش
 بیو عا با سر و که بودیب موعی فایز فایز سون قش باو بر شی دوق
 شی نبویش نبوین دورها ز ناشوین

موعی نا

کوهی نافر او را با قیوح من بعید
 ساوه حکمتش قهر او نغز هفت قوت ما بر
 نادر اباش تو من تو ایالت سیاست غی قوت
 نافر شکری قوت قوت قوم بر استغای موی
 قوش سحر بر کوه او و غلوه ای قوما
 ساد و شعوم نعت میانس ای ندی کرانیا

مرغی بر چرخ بلال شکار دوت یا تکاسی بر غنچه کاردوت

یدری ساسه ز غنچه او شت بی خبار که فایضت ساد و قوت سما نغز غنچه بر ابی میدان
 ما شعوم قوت بر باغ سید بر سیاست که بودت ش بر شعوم سید بری فایض
 قوت دوت نافر کز این دنیا من رو ندیدت دافوسیه ما با من

اسماقی با احوب نجاری قوما توت

بی خیال نغمه قوش آلت بری عسای
 موه قوت غنچه سون موه کسری فایض
 نوق بو غنچه کال موه دیا بورد مپا
 چهار قوت ما من به قوت بودن بی دوت سنا
 نوق شهنش که موه غنچه یا موشتر
 بوع تقابن جد و تپاش بی سال کبزه
 دوط سنا قوت بر منغزونه بود همان
 بورد مکتب قوت دای بی بون ای قوت دوت شکان

مهر قوت یان باجم زلمار دوت برات یان باجم یار انیس

مانر و دسینت فی صحت دینی سیدت سوز با عجمت موه موه سونیدت غنچه
 مانر مواتت فی صحت دینی سیدت سوز با عجمت موه موه سونیدت غنچه
 شنای تقا کین گنجه موش بود فرو بی شورس موش او شت
 نما لک کشا خیرت او شت صابر نیرت

اینغزایت انسان فتح بوغزو و هبت نوقا دعای
 قوز او جا هیل او شت اراق براسو کور
 قوز یونوغا کور ای قه مغز و ذی خبان
 شو جی اینغزایت قوز علم سقا قویون ایغ
 ماسیک فان نون بر تو کور قسغتا او
 قوز او عالم او شت نکتم براسی قوز او
 قوش سباز یان ای سو قان سبوغی شتر
 هاجه میافت اول کور غایت شغای فانی

آبار یا انسانیت مرد از منی امر ایاست و بر کینب غورده
 جا هیله نیان نامسون کوش عالم فان نار جون عالم فاسیجی دانشید دنیان شتوز
 قوج غلیت سی دوهنت اوج عمالت کور لولیت بودا انسانیت نوقا انکیرت
 سغاما بئش مے او شیت بنار اوز بهی نامحوت کور بو شیم ایمل اوت
 قوش آب بافتیش بر جقه و سوز قوندا لوم سه بر نوق

قیت فیالین روقب فی عتده او شت اول
 بار حاو اعلی نیقی او حاستب رطبا
 بر ایلاما میتن ندل سوزیم سفا
 یا شکر نیغای فای او شت کور موکانه
 نند نوبالچ فی میافت ندل او شتوم سوز
 نوق تغال کور ای باغین ایمل بو نون
 بر سه شکر هجو سوزیت تمکین مشبه سفا
 نوق نا ذال نعمان ای هله مؤس بولان

اما ناد نیان نار او بو نامیق مبه موش سوزت مریق اکان زما دینغ
 دوشیا از غو نایقیت او شت غنیمتی انسانیت غنیم او شت سزایون او شت غنیم او شت دیرک اوز
 بر ای فیالکون نیان سوزی یاد غو آسی و بی نیان یافو لسی او شت موقی سانس
 کور یا انسانیت سی اوندرا کونیت رشقه تغزون قور شحوت ندون
 قور نیابویش غر و بر کوریت سئلون مونه با نکیرت

شیرین

شهنش قونجا اوشوردي اشي شعورني باخباره
 فاكوفنا كوفنو شعورني شعورني خباره
 كاتو فان باسن باراشن موعاي مداف
 ناشني اونيت كوني بره اش مومده اوي
 كوني بره اشني عوردي اشي شعورني
 شعورني كه كان باقاپ اشي شعورني
 قونجا اقاد اشوردي اشي شعورني فون نوور
 فونش اوي اولا فونش در من اشي فون اوور

شيدني انانتي اوي ايلجانتي

مورد بايوته كالا شعورني مورد يا
 كالا كادوج مورد يا كوني كالا كادوج
 ستاني فانيو كوني سنياد اوين مالادغ
 اوشني صاليج كونا با انا انا اوشني
 في بودي كوني فون زاه اياك
 دوشهش زاه اياك قرانوشن مومده انا
 ستاني انانتي اوي شعورني اوي

مومده يومك مومشني اداوشني
 ميكت ايوه شعورني عمالين فونش مومده اوي
 فونش فون اشي مومشني بايني شعورني
 ميكت ايوه شعورني عمالين فونش مومده اوي
 برال فون اوشن لاشن مومشني
 بانا اوشوردي شعورني مومده اوي
 فونش اوين بايوه مومشني فونش مومشني
 مومشني مومشني مومشني مومشني

فونش اوي اولا فونش در من اشي فون اوور

ووزنه اقيبي نچيا اجنانتي باغور
 پاريا دمنيت پر اوشن اوقور باع الين
 شق نايشني مدور اوقور فونش
 ما باسن فونش اوشن اوشن
 زيري فونش اوقور مومشني
 الميا ايقين مومشني فونش اوشن
 زيري فونش اوقور مومشني
 مومشني مومشني مومشني مومشني

EMNI VEHBIE

Vezni (i) ksai āšt kštu

Failatun, failatun, failat
 „Bismil-lati rāhmani rāhim”
 Tue nīs, ħaš une al-lahul-azīm
 ħaš me tū elhamdul-il-lahil kerīm
 Kōft salat Pejgamērit hem kōft selām
 Eḏe alit ķi mē tū ĵām kān medām
 Ćünķi škove Ti Fuhammet Mustafā

Nëve s na bān prā dūnā hić vefā
 Sā rñim prā nāni preĵ nēš šum mē pās
 Akibet vjen dēkēn aĵ hem ka mē pās
 Diĵe ti ķi ćdo me kān (i) fōrt štāti üt
 Kālbeš e hupes ķi s dihet vēndi üt
 Kūš e vēši kmišēn vāndoi kapūcin
 Frik ĵa dēšin, mīr ĵa vēšēn ķefinin
 Hā me kān Sultan (i) dūnās, hā garib
 Ašt barabar ćūķi suttani dēs garib
 Kūš ā (i) mēncēm e ħairl'i dērmie nēš
 Dēkēn aĵ e kā pl'ōt nasihat — merni vēš .

Mā ġerdićēm s ka se pleķnija —
 Rñon i ngrāti pēr me kēs ĵmija
 Me nimi vjet rñim e tān dūnaia (e) jotja me kān
 La dēkēn belķi ħorĵekun tenesiret s ta paguen.
 Kūš po e ħarōn ti dēkēn more ķūķān —
 Tue kān dēka mā e rānd se me u prē me ġēršān
 Dēka āšt mā e rānd se nē vēġš me u vl'ue,
 E me šār me u šarūe.
 Bēġ e pās e vezir dēsini, tōk bāhēn e rezil —
 I maḏ i vōġel' dini ķi ħaĵi kštu āšt.
 Bā si dūnān mamūr an ak — ahmak āšt
 Dūnaia stērvin l'ūpsi mel'gun — bel'ki ķēn —
 Ĵān pēr ĵehennem ķatā ķi hān e pīn si ķēn,

Ede kan ħān p̄er k̄atā k̄i s k̄āin me l'ōt
 Āšt al'amet — s k̄ān sel'amet por me l'ōt
 Küš s po tutem e s po k̄āim mjert na
 Zahar p̄ersē jēmi bā ziār̄m mā gati nā,
 Kai mori zēmbēr — mos t'pušoiš tēri t'pštojš
 Dūnāia p̄erse ā pak e merdār e pa karār,
 E p̄er zarār ipet kuido ani se ā si magār.
 I mēnc̄mi mos me p̄ās ketēr dert
 P̄or vōrin ē dēkēn e vet prej fšāmēs nuk dahet
 Masi k̄i zōti na ħā: — mos kēšni ħu — por k̄āni
 Šum na bie me k̄āit prā.
 Dūnān e k̄iie dušmāne — pra mos i jep muradin se ie
divān

Štatđiet hēr ziār̄mi i ħehnem̄it, biro,
 āšt mā i n̄ĵēt se ziār̄mi i dūnās ā
 K̄štu ziār̄mit k̄uš i durōim mjert na
 K̄ünk̄i s durōim sobs enĵet mjer na
 Već ziār̄mit s̄a tūrl'i kahēr i māđ
 Kā nē ħehnem sa ziār̄mi ħan dert i māđ?
 Prej ziār̄mit tutu i ngrāt ti eđe k̄āi
 Kuš s po tūtet e s po ka hā dot hi ai
 Zotün robve ħu ėp mühtet
 Ve lakin s'āšt pa bā ħrā
 ħiċiċit k̄ā ni gūr m (e) k̄āf liđun āšt
 Ziār̄mi tük e ket nālt guri p̄er me k̄it pōšt
 ħehnem ħu ħa p̄erse āšt gropa fēf k̄i štatđiet mi viēt
āšt tēri mē mēk̄.
 Nē vēnd t'druvet ziār̄mit dūnās nē ħehnem insān e
surfuĸ k̄ān mē p̄ās
 Prej ziār̄mit Zotün nā rueit ħo e na s dīm me u rueit
 Ehĸi ħehnem štat̄in kan fōrt t māđ
 Štati i n̄ānit štat̄ dit ūđ āšt i māđ.
 Šāmi i n̄ānit sa n̄i biēšk bāhet taman.
 K̄ündēr štatit p̄er mē p̄ās đimt ai k̄ük̄ān k̄ān
 Ehĸi ħehnem ħān mē zinĵir hem mē k̄ām
 Bukagi kan eđe tumruk hān zekum
 Uĸi k̄i p̄in ħa u copton zōrt taman
 Hem zebānit ikdisin s dīn imān

Kuësh emīn e pa droje për jehnem aġ ħšt pā šube ehel'
 Ehl' jehnem pa imān škuest ian tašti s dihet kuësh
 ħifon por duhet na me pās droe t tān.
 ...nē jehnem me imān mundemi me pās po
 por sa el'k jehnem tūrl'i gazep me pās io
 Štati i ehli jehněmit nē vënd tē pētkavet mē pēškve
 lūhet zotūn na rueit.
 Mē kēt jēt iēmi zamarit për āt jēt jēmi jaratis.
 Prej zebanīs nāni haħkut me iu pā — kaħ u tūtšin
 jūnl'e diššin sa me pā.
 Sa i māđ ħsht katērdđiet mi pērnihēr —
 Pēr me ħit insān nē jehnem rōk e mēr.

Šihni zinjirin ē jehněmit sa (i) rānd
 Štāt pāl' tōkēn ni haħk havā e l'kund.
 Kā e štērngōin me tā sod dihet aġ
 Pōr al'amet ħšt ħi s tūtet kūš ħ aġ.
 Prēj jehněmit zotūn na rueit e na rueit e na štīft nē
 jenet me ħerēm t'vet.
 Dērmje dū krihvet zebanīs ni vjet ūđ ħšt me ni t'rehme
 štātđiet mī vēt i rjon pōšt.
 Disāve kāh goiat ia u štin zinjirin e kāh goiat ia u
 njiērin
 Puna ē zōtit ħšt mē ħiħmet pra porse po u mundon
 kaħ s jōhet
 Nēri ška i bān vēti sun ia bān ħētri.
 Hāja e tūne ħšt zakum ħi fēra hān. Masi ħi hān dert
 bētēr bāhet ħi kān.

Kur t'pīn ūi kān me jān: sa ugursuz ūi
 Kūš na doġ ftūrēn e na rjoi mišin ūi
 Ašt për jehnem — kaħ fial kā fōrt pāk
 Se për tā šum fial kā me t'pāk.
 Nēm pvētš ti pērse pakōve morē mħk
 Se s po kā kuësh dert per jehnem asni pħk
 Nē t rāft nē mēnd masi t'škōin đēt
 S t'ēp dobi kuēni sēnd.
 Tašti na kaħ iēmi t'pa brīg për vōr si me pās cēlsin

e žennëtit n'dōr ja si me mŭjt me hī me zōr.
 Si kujton ti žennëti me t'rā pa zahmet — u mirke vēš
 për ehl'i žehnem zŭlmi pa nihajet.
 Kā e kā rōk dūnaja sa s'mri për dīn — ai āsht si kēn
 ki l'ŭp stērvīn.

Ška t'vŭe — tŭ tī e kiie — tŭ ketri asni fiie,
 Dēšta ženëtin — ni pīk ktu me pērmēnd
 Se për ženet sa ā vēnd ktu s ka ni sēnd.
 Por për žennet vien me fōl' kur s'āšt n'dōr
 Haŭku lakmī për me pās me štī n'dōr
 Taš n'dōr āšt giŭkuš e mba ki āšt për tā
 Si me hŭjjet kán atŭ giŭ iān me tā.
 Dert per dūnā kah me mā hae e kah me vēš
 Po se žennëtin e kán giŭ tue kēš

Me vēn kuš pihet — ċpihet n'dūnā — kuš pihet n'vōr
 ċpihet
 Kuš s muer prej kūi gā e s pat n'dōr me δān kui gā
 — hi n'ženet pā u ndāl për kā ia për gā
 ženet kā për giŭ jēt por s po lān giŭsavet — por ata
 ki iān t'drējt.

Nēri pā haŭie vehten suñ kēš sado mīr mē u vēš.
 Mā me hatā s'ā se ai ki vehten e dō.
 Šēri (i) haŭkut tēri khā kā mri për dīn
 Ki zarār s bān — fajī atŭne kštu dīn
 Ćunŭki dŭhet hŭsni zān zōtit po ŭōn
 Na gūnah prei hŭsni zannit kēmi δān
 Kštu batil' šŭm fiāl' kán pa hesab
 Giŭciŭ kan për batil' t'vet ževāp
 Si me pās inŭkar me zahmet gā s'po don
 Miaft na del' lailahe ilāŭahu ŭōn
 ŭōn fēn(e) Muhamëtit për pštīm e kēmi gūnah
 Patēm hā s patēm nē ženët iēm(i)
 Po mbāhem Turŭ, khā bāim škā s bān
 kuŭni milēt, kuitōi bies mā iēmhrŭkŭm imanŭkŭm nā
 ŭōhet.

Tašti ni batil' kūš s bān pa i δān tesel-i
 Haŭku' tē tān ki fajī ŭt zarār s t'bān

Masi k̄i sevābi āšt̄ rūga e amēlit prā kūš s k̄ā amēl'
 āšt̄ malrum prej sevābit.
 Mōtra sa dašnī i k̄ā v̄l̄aut sun(e) pagūn mē kadife
 nimī kūt.

Ziarmi (i) dūnās ketēr s'āšt̄ por ūrnēk āšt̄
 Pēr me dīt nā ziarmi i žehnēmit k̄stu āšt̄.
 Me štī gišt̄in kur t'bāim kās̄d gūnāh
 Prei ziarm̄it frīg me mār̄ na eḏe ai
 Jēt n'žehnēm anjāk ai k̄i des kauṛ
 Skā dobī k̄i kuiton ai vet si kauṛ
 Ēmni ūt e pēt̄k(i, u ?) ūt nuk bān dobī
 Pā bā teazīm pēr čka duhet s t'ēp dobī.
 Sā kūš Turk pa maḏnue škā ā pēr maḏni, pā voglue
 škā ā pēr vogli.

Duhet ti ūrnēk(i u)n me mbājt n(ē) mēnd

Prei haḥālit̄ ḡiḏsēnd kuš k̄ā hemān
 Eḏe ai pēng āšt̄ se don hizmet tamān.
 Prei haḥālit̄ pā bā masraf vēses e hās.
 Ai derējet māng i k̄ā kur s'āšt̄ me mās.
 Sa ni kōkēr driḏ̄ s t'lān, pōr dōn hesab —
 Kāh ē mōre kū ē štine dōn ževāb,
 Degmede k̄i āšt̄ gūnāh pa k̄ūfür mā zararli se nimēti
 k̄i āšt̄ pā šūk̄ūr.
 Me tepric gūs n'bāfš zevk derējen ta mungōin, n'bāfš
 hajr —

ta štōin — n'bāfš šēr t pēngōin.

Hārji mā tepēr se duhet mē amel' šum pagúhet, por
 derežia i mugohet, ia vet pēngohet.
 Ti me pā nā k̄i pō kēs̄ mē zā ḏuej pērsē po kēs̄ ti
 mē zā

tue ḏije mā ti mē, mē

Nëri për vëti sâ ë leton, për ketër kaq e rëndön.

Vet zotün ða: ðön ki huti bân zarār

Hûti insânit injak äšt faj ki bân zarār

Hã me kaf ia u vrã hûtin k äšt faj

Pra zarār elbete aj së prej asâi.

Vet zotün ða- Kûs s po tütet robi em, ki ia bãy ijgrã
e ia lüpi hãkun tem.

Me kuítue prej sei äšt e me se äšt

Aj e kiš dit ki äšt për diçka çare s'äšt.

Zotün t'ða: ðuej s'na prëk zarār äs do bi

por škã nã kã škrúe zòti na mri.

Ti ní pik tue kãn u bãne i hijesëm, i gãt, i gãn e pa
hesãb

me -nimët je prã padihava s tlãn.

Pa kuító prej sëi ë më së je për kã ië — ia šitòheš me
gið ska ië

Nimëti kur s bãhet hizmet äšt ní faj ki s bãhet
magfired.

Kur t vien kazãia koõòheš për më t rã belaja.

Vët zotün ða: magfired bãj kuító io —

Pã u hüp rëna e hãniã sùn drëkniã turkniã

Vet zotün ða: kuš ä alim i paamël' —

aj magarit fört i përget ani i fël

Çünki amël s'kã aj po kã ilmin e vët —

Si magari ki kã kitãb më špin t vët.

Hëm për kãt alim kaj teptis dúnãs aj —

Ki ia ëp nefsit mürãdin kûš do aj

Zotí ða: ai äšt si kën nuk dahet ai —

Bãne men n'dãš, ani le n'dãš, aj se aj.

Dašniã ióte sëndin t'koõon e t'šurðon e ta hüp
mëndën.

Për murãd t'nefsit mundimin kûš e veçon ai äšt mã
betër se teptisi (i) krúkit kãn ðãn.

Sa alimi i pa amël' i biërin degmede kuš s'ã masi ki
zotí kënit e magarit i përgau atü.

Nt'viejt erzi (i) dúnãs e i fës nefsit mos i zë bës.

Ška piket nŭk hiĳet si tabiati i kĕk' nŭk lihet.
 Vet zotŭn ĳā: ĳahil' insan āšt mĕ tĕr —
 Ašt hem ĳor hem si haiĳan ia betĕr
 Prā ųtoheš por nĕ bāfš ti ĳuš t'flās —
 Bānu nĳāns ti ia msŭes ti, ia digues,
 Kuš ā ĳahil' sā s di imān — nuk ā Turk —
 Fasik āšt pĕr nĭ mesele kuš s'kā rŭg.
 Kuš do tetĳietmĭ mesele kā mĕ kāf —
 Ti ĳŭĳkan s'dĭ tet mesele por nĭ laf
 Si ųlemaĳeku i paamĕl' āšt ahmaĳĕk, āštu
 ĳahil'eku, āšt magarĳek

ĳahilin e ĳije dŭnān ĳi āšt melune, prā mos u pik'
 me tā pā t'pagŭe, ia ųka s dĭ mĕ i kaĳĳue.
 Tue mos me kān pŭna (e) dŭnās prej fĕs e deĳta,
 apĕt mā ugursuz se atā ĳi s iĕ vet s'e ĳĕtā.
 Kān ĳān: ĳahilĭ āšt dušmāni ųt ani ĳi ĳahilĭ ā ĳitŭe
 bāba ųt.

Škado me kān i kĕk' ĳahil'eku āšt mā i kĕk'.
 Hā nemaz, ia hā inĭm, ia hā duā —
 Hā zĳĕr ia hā kurān, ia ĳeter skā
 Kto amĕle kušdo bān po s'mĕr sevāb —
 Por kuš āšt dĭs hem pŭnŭn ĳuš flet ĳitāb.
 Kštu marst iān ani i rĭ āšt ani plāk —
 Mařin ųtatĳind doŭā mā ųum, doŭā pāk.
 Kundre ilm meř kundre duhet kundre hāl'
 Kundre niĳet, kundre zahmet sa ā ĳāl.

Sevāb mĕ kān saĳ me mundĭm, mundimi ĳ magarĳ,
 s'ĳ kān pā fitĭm.
 Amĕli i pā ĳlm, ia pā takvā, ia i pahal' ia i paniĳet, ia
 i pazahmet, ia tue ndāl' ĳitŭon asĳā, ia i lig menzi
 ĳāl.
 Kān ĳān takvāia (e) ĳahilĭt pĕr mĕ u bā s ā si takvāia
 ĳlmi fasikŭt me u ųng io.
 Kundre mařnoheš me ĳlm ĕ mĕ hal', zotŭn ta mařnon
 sevābin, bile faĳn ta fāl'.
 Kŭš e ĳije hāl' in aštu ta ĳĕsin fārĕn.

Hëm u ða giðkuš më k̄āf k̄ā dička h̄ā —
 K'āšt për t̄ā maħsus ja lūpin, çare s'k̄ā.
 Se punon aī tūrlī hizmēt šum zemān —
 Pa b̄ā āt s̄ēnd p̄štīm aī v̄ēt s'k̄ā taman
 Hem po lūpen preī dis̄āvet fōrt šum —
 Po disa pak kur t b̄āin āšt si šum.

Kundre mēndon — kundre vēndon, kundre viet-kun-
 dre nimet lūpin hizmet kurgā s'iet.
 T'p̄arvet s'iu k̄ānke šum nimet se ū tutšin s un pa-
 gūein me hizmet.
 N'dāš ti s̄ēnd maħsūs e sa ā lūp me thī n'dōr, — lē
 šērin e mundo për šum h̄āir t̄ēri në vōr.
 Rōbi kūnder po lūp nimēt preī zōti pō lūp hizmet
 preī rōbit.
 Pa b̄ā s̄ēndin maħsūs eðe nēfsin e mūit mos keš se
 t'p̄ēvišet vōri ūt.
 H̄āiri i t'vōglit — āšt gūnāhi (i) t'māðit

Mos u maštro përse resūli ða kēt fiāl' —
 Kaḳ sevāb k̄ā kuš inon hēm kuš po fāl'.
 Se s'ða ai; kušdo b̄ān hem kušdo b̄ān —
 Pōr murād āšt kuš po dī, hem mīr e b̄ān.
 Si me ðān ti: kuš me kēp petk kaḳ i kām
 S'āšt murād kuš do me kēp h̄ā po i kām.
 H̄ā me k̄ān gōg, h̄ā tabak pa zanāt
 Por murad terziia k̄āmil' ḳi e ma

Zoti s ta k̄ḳūr sūrētin as amelin, zēmbren ta k̄ḳūr
 tevon amelin —
 H̄āiri përse ā si mestit s̄ēndin donā b̄ān, šēri përse ā
 si me priš kušdo b̄ān.
 Tūk ā sevāb r̄uga e amel'it e ðe ameli pēma (e) ilmit,
 pa ilm ie mahrūm preī sevābit.
 Ma i poštēr kuš s'ā se āi ḳi tūe k̄ān asgā p̄l̄sēt më
 haḳ se s'e mban gjā
 S'mires kušdo (i) b̄ān mīr, s'keḳes i mēnēmi (i) b̄ān
 mīr.

ġumi i alimit-mā hairli āšt, ģa Resuli —
 Se ibadēti kur po bān ģahili kul'. —
 Mā hairli iān dū reċate prei disit ģa —
 Se t' tān kērt kī mundohen daimā
 Por na kaġon tašti ai kuš āšt betēr —
 ģa mbi alim šēri i māđ s'kā kur
 ā šēr
 Pēr tā kan ģān disī ršket po t'tān —
 Haġku ršket (i) māđ e i vōġel kūsdo bān

Disi pērse āšt paskuriā e haġkut štrelnōhet kur tā
 šōhin štreln.

Mā mir ti me pās ģaranī me k'āt ģahil' kī s livdō-
 het se me pās ti ģaranī me k'āt alim kī krenohet.
 Pēr dērt t'māđ s kīie āšt ilmi, apēt pēr dērt t'māđ

kī s'e kīie āšt ilmi.

Ehli aġalit me ģu ġēt — āšt sevāb, āni mē pās āi
 ġā pa hesāb.

Huiniki tevbe sun bān, po t'māđ ġünāh bān.

Hem na ģā: āi nī fiāl' mier kuš s'e mēr —
 ģa s'mundōin m'at iēt kānd betēr.
 Sa e mundōin atā kī diie pat —
 Por dobin (ē) ilmit s'e pat kur e pat.
 ģa ia presin būzt vazġis me ġēršān —
 Pērse s punoike por po fōlke ai kūkān.
 Pēr tā kan ģān: mier pēr ģahil' soġ niher —
 Mier pēr alim k'āšt fasik štat her.

Duān e peġgambērit kī kštū e di, zōtit isiginisena prei
 ilmit pa dobi

Nī hōġ-kī lā haġkun si iān e po u ġindet si t'dōn,
 ai āšt mā m'telhūce se t'tān.

Disa hōġ mē mā pāk mundim, kan hoġalēkun se
 ģahili kī e kāġahitēkun.

Kuš ia bān ġrōpēn šōkit tvēt āi vet pa rā me tā s'iet.

Kuš ġindet kudo-kurkuš atā s e dō.

Mënd n'pac ti kët fialën rōke ti —
 Prei ní zeres për škă äšt fōl, mos bǎ ti.
 Kur t'ruheš mā hairli äšt kštu žān
 Se ibadëti k̄i ḡiđ hāku e k̄an.
 Hem nimī vjet ti me bǎ hizmet sahi —
 Mas nimī vjetve me u ndāl' pa dobi.
 Sa zarar t'dilke me u ndāl' ní saħät —
 Bāhke mā šum se dobiia kaĸ vjet.

Me ní muhalefet neri mun r̄jōhet sa nimī taāt sun
 cōhet.

Mas nimī taatave ní muhalefet mun t'bien pōšt
 sa me nimī taalate s'ie hip nāl̄t.
 S'ǎ pa dobi me u ndāl' sa me pušue ë më fiēt, sa

Sa po tütet nāt e dīt āi por po kā (n)
 Zoti žā: ia Musa, meī veš kštu äšt —
 Trunt prei krēs tue kait me i sōs me lōt.
 Duert mā ngat teri m'kieĸ āi sa mirā
 Tue dēšt dūnān s'ia fali fain hā.

Äšt dašniia dūnān krue ḡiđsa šerit taman. Peiga-
 mbëri na žā: dūnaia äšt špiia e ati k̄i mā špī s'kā ë
 për tǎ po mleđ anjak āi k̄i mënd s kā.
 Isāia žā: morë ti k̄i e dō dūnān për me bǎ hairāt,
 t'lānmit e sāi äšt mā i māđ hairāt.
 Kuš e forcon dašn̄in (e) dūnās, i dēl me iu mnī
 ulemās
 Äšt dašniia (e) dūnās rāna ḡiđsa (e) belās.

Šihni Musān kur u lūt ai ši më rā
 Për ni insān se kifoī keķ ši s'rā.
 Musa ħā ei zot n hiķmet ši s'nā rā —
 Zoti ħa se āšt dērmie iuš štinsi s'iu rā
 ħiri tel'ał dil' ti štins hā ši më rā —
 Tuk vikati štinsi pā dāl ši u rā
 Musa ħā: ei zōt štinsi pā dāl ši nā rā —
 Zoti ħa: ai bāni tevbe ši u rā.

N'bāfš ħarani me t'keķ t mundōjn si me kān ti
i kēķ

Për ni nēri se kifoī i keķ ši s u rā
 Prā me kān i tān t kķi si ħemi na, kujtoī ħūr u
 kiš rā.

Më kā duheš-me tã piķeš, me kā piķeš me tã ha-
šer bāheš së më bōi t'ati ngūheš.

Nēri pā haħue ķi po zħe mōti kāh s'un kiš me u
pērtri s dūti

Si t' bāiš ta bāin, donihēr ta štōin.

Nāni ħā: kēš un pa kpūc n'erbain —
 Sā pō hiķkeš kur u ngrihke kām̄t ma dīn

Kaķ m'rā rānd, dēšta më plās. Kpūc s'kām
 Tēri pās nānin topał ķi s'pāt ni kām̄.
 Tuk e pās u āi m'i harōi kpūct mā —
 ħaš šūķūr ķi kām̄t i kām̄ prā, s kāi mā
 Kūš s'mēr ibret ħān e voglōn si s ħē kā —
 Sado šum nimet me pās āi s'dī ķi kā
 Mēr ibret prei belās t'ķervet — ħa t'ķesin pēr ibret
 t'ķervet.

Nēri sa s'ā nīs me mār ibrēt āšt bi haber ķi kā
nimēt, i dōket s'kā nimēt ās pēr pāk ħizmēt.

Mā šum tūtu pēr pak sēnd prei siasētīt së po tū-
teš pēr šum sēnd prei fāit.

Kūndre tã kieš lezetin (e) dūnās — rāndimin e

dék(e)s kiĕ me (e) pās.

Ahmaku pā e hūp nimétin

s'ia di kimetin.

Ni fjāl' t'kām, tuteš elbete prei asāi —

Me t'tān ūmri s'bān mā asni fāi.

Nūk po t'mbān ġaġ m'(e) dūnā pōr me pā —

Ćfar kumaš iē ċka punon ti dōn me pā.

Tuk t'sohin kī me hāir iē, iā m'sēr —

Po t'kāpin ċdo me pās ti haġ beter

Zōti s'e mbā kānd pēr me ngrān būk hemān.

Pōr me ġiġ kānd kā ni pūn āi kūndre t'hān.

M'kēt jēt iēmi zamarit-pēr āt iēt iēmi iaratis.

Mas vērsnikut ni sahat r̄nimi hāirāt, s'un pagūhet
me t'tān mundimin ē ūmrit.

Mās mūtsit ni sahat r̄nimi (i) šerit s'vajtohet me
t' tān vāin ē fīsit.

Štātī i t'kekit ketēr s'āšt pōr krōni i šur(ē)s e
mūtīt āšt.

Temeli (i) ġiġsa hāirit āšt sábrī (i) nērit.

I ngrāti insān kāh gzōhet nūk dī āi —

Masi kī kán ġān pēr tā kī kštū ā.

Kur ā ġahīl — āšt i dek(ē)(u)n, prā s'ā ġā —

Kur ā alim — āšt n'gūm, prā s'dī kū ā.

Kur punōi ġā, āi kē magrūr bi habēr —

S'āšt pēr tā bairām kī túrli pētka vēš —

Pōr pēr tā kī škōn nē ġenēt hul-le vēš.

S'āšt pēr tā bairām kī mē t'dāsun u pōk —

Pōr pēr tā kī nazli gilmanit me tā u pōk.

S'āšt pēr tā bairām kī dōrēn haġku ġa pūġ —

Pōr pēr tā kī fākēn hūrīs ġa pūġ.

S'āšt pēr tā bairām kī sōd kā nesēr s'kā —

Pōr pēr tā kī kā nē ġenēt daimā.

S'āšt pēr tā bairām kī ċaġġit āi i pāt —

Pōr pēr tā kī kapërcej si mbi sirāt.

Kuš do me t'ba beq mos i këndō belā kurnihēr
se mun bëhet. ta bājn ijrā fājn tānd meñihēr.

Diftōj kŭi muhabetin sa kije me ndihmŭe jōse për
tepër t'nēm se kije me mbaštrŭe.

Motra për hāir t'vŭaut sa hukāt, vŭau sun ia pa
gŭn me nĭmi dukāt.

Nuk punon fiala e taštīt pa u pā ki iu cā krŭet
nānit.

Škado vien kapërcen, pōr vōri s'kapërcën.

Zōtit i kōft livdim pa nihajet ġimōn se u tue pās
mēnden sa për dēk dŭ-tri fiāl' me i ōñ.

Vet m'i mbuši ōeit flēt me tŭrlĭ hiqmet te vōn sa
ōmni vehbiē me u bā, i rā uigŭn.

Lŭm āi ki vehbiēn e nŭē, e kaŭjon sē ā si drita
e sabāhit kŭido ki i difton.

Rahmet i kōft Tahir Efendīs u bje me ōñ sē ia
u vēndōi škipen me kalēm e Vehbiēn me vezën.

Mē) k'āt vākt ki t'tān për zarār ġāl iēmi kān.

Seña nĭmĭ e dŭkĭnd e pesōeit e nā. (1251).

Taman u bā Vehbiē, kŭr zōti ma ōa hediē.

RRETH VEHBIJES SË TAHIR EFENDI BOSHNIJAKUT

Dr. Muhamet Pirraku "Kultura kombëtare shqiptare deri në Lidhjen e Prizrenit, 1989".

Në veprën e tij të vëllimshme, zoti Pirraku, disa faqe u rezervonte veprimtarëve shqiptarë që ishin marrë me shkrime, thuaja letrare, në gjuhën shqipe me alfabetin arab. Sikur të tjerët, edhe Pirraku në bazë të këtyre përpjekjeve të para në fushën e shkrimeve paksa letrare, vinte Tahir efendi Boshnjakun, - njeri me kulturë të gjerë teologjike, i formuar në shkollat përkatëse të larta të Stambollit. Vepra kryesore e tij, duket, është *Vehbije* "dhuratë, dhunti". Në lidhje me autorin e saj, ne, në këtë mes do të veçonim *Vehbijen* e tij, dorëshkrimi a broshura e së cilës është shumë e njohur, sidomos në Kosovë, ku ka shumë kohë që qarkullon dorë më dorë duke pësuar paksa ndryshime, kur formohen zakonisht shfaqje versionesh a variantesh të reja.

Z. Pirraku, është autor i përfuturimit, i zbulimit, mos ta themi i një shpikjeje, me fjalë të tjera ai, sikur na kumton në veprën e posacituar të tij në një bibliotekë private të një shkodrani të quajtur Mulla Ramadani, paska rënë në një kopje të dorëshkrimit a të broshurës së *Vehbijes* me datën e hartimit të saj jo qysh mbajnë të gjitha kopjet e kësaj vepre që qarkullojnë e qarkullojnë edhe sot e gjithë ditën në Kosovë: 1251 (1835), por – thotë Z. Pirraku: 1221 (1806), vep. Cit. f. 374, 375, 376, 377 (374-384).

Vepra jonë *Vehbije* dhe autori i saj Tahir ef. Boshnjaku s'kishin mbetur pa u studiuar; studimeve të tyre u prin, do të thoshim ne, Hasan Kaleshi, orientalisti më i përgatitur me njohuri të gjera të filologjisë arabe e turke, i cili në numrin e parë të Godišnjakut, të Revistës së Institutit Ballkanologjik të Sarajevës më vitin 1957, nën titullin: *Prilog poznavanju arbanaske književnosti iz vremena Preporoda* (Arbanaska književnost na

arapskom alfabetu) f. 352-386 (Rés. 2 faqe). Në faqën 364 të studimit të tij lexojmë:

“*Senja nimi e dyqind e pesdhjet e njo tamam u bo* “Vehbija” kur zoti ma fali hedije”, godine *hiljadu dvestotine pedeset i prve* završena je “Vehbija” kada nam je bog podario kao poklon”.

Më vitin 1960, i nënshkruari i këtyre radhëve bëri një sprovë të përmbledhtë brenda një paraqitjeje a pamjeje të tipareve, kryesisht fonetike të ligjërimit gjakovar. Autori i veprës (Vehbije) është Tahir ef. Boshnjaku prej Gjakove, njeri me kulturë të gjerë teologjike dhe njohës bukur i mirë i shqipes dialektore. Vepra ishte hartuar më vitin 1251 (1835).

Në librin e tij – *Shkrimet shqipe* (në vitet 1332-1850), Dhimitër Shuteriqi në faqen 207/8, për Tahir ef. Gjakovën sjell këto shënime:

“Tahir efendi Jakova, Emni Vehbije, Shuteriqi thotë: “Përshkruajmë ksomblën që ruhet në B. e Myftisë së Tabakëve, Jusuf Sidiku (1800-1904), Shkodër. Pasonjë shënimet: “Risale e Tahir efendi Jakovës (risale – broshurë), titulli: Emni Vehbije; Emni i autorit gjendet në fletën 12a: “Tahir efendija” njeri i mirë o kanë; data e hartimit të veprës është në dy vargjet e parafundit: *Seneja nimij e dyqin e pesdhet e nji*” – tamam u bo Vehbije. Pra 1251 (1835).

Një tjetër dorëshkrim të kësaj vepre e kemi parë në BSH, Shkodër – vazhdon Shuteriqi. Në FLLb, dy rrjeshta me kalem, me germa arabe lexojmë: “Bu qitab Tahir efeni, ai rahmet past”. Po aty, prapë me kalem: Nr. R. 627. Tahir efendi Jakova. Risale e Tahir Jakovës Vehbij-jeh, 1251 (1835).

Për veprën është dhënë gabimisht viti 1221 (H) 1806 (D. 1927, 293). Të tjerat kopje që njihen mbajnë kurdoherë datë vitin 1251 H.

T. Jakova thuhet se ka lindur në Gjakovë ku edhe vdiq dhe i ngritën tyrben. Jetoj në pjesën e parë të shek. XIX. Studimet i kishte bërë në Stamboll dhe ka dhënë mësim në një medrese të qytetit të lindjes. E kanë quajtur edhe Tahir efendi Boshnjaku. Disa thonë se ishte boshnjak prej origjine, disa se kishte marrëdhënie me Bosnjën, Dhimitër Shuteriqi, Shkrimet shqipe, f. 208.

Nga dy madhësitë e datimit të hartimit të “Vehbijes” 1251: 1221: 3:1 është në favor të 1251-it, pra edhe nga kjo pikëpamje mbizotëron madhësia e parë.

Kemi përshtypjen që zoti Pirraku as nga ana praktike nuk i ka hyrë zgjidhjes së këtij problemi me gjithë mend dhe racionalisht me manovrime dhe një retorikë të pafrytshme: Po ta zëmë se kemi dy variante, sikur pa-ndeh ai (Pirraku), atëherë ne propozojmë të merret e të krahasohen dy kopjet e versioneve origjinale të shkruara me alfabetin arabo-turk e pa transliterim dhe transkriptim të tyre – (sepse Pirraku, pas gjykimit tonë, nuk është mjeshtër i mirë i tyre), dhe ashtu dy variantet do të përquasen duke rezultuar me zgjidhjen e këtij “lëmshi” të krijuar në dekadat e fundit të shekullit XX. Ndërkaq, nuk duhet të pushojë hetimi edhe i pjesëve të kësaj veprimtarie që kishte bërë Glisha Elezoviçi: disa zgjidhje të tij na bëjnë të krijojmë mendime që çojnë nga zbardhja e ndonjë pike të errët të kësaj çështjeje; bie fjala te Elezoviçi, në studimin e H. Kaleshit, këtu të cituar. *Prilog poznavanju arbanaske knjizevnosti... Godišnjak*, Sarajevo, 1957, f. 366, në gjysmëvargun e dytë të të parit: S’ošt për tû (?) bajram cí turli petka veš – por për to cí škon n’đzenet – džveš, të cilën džveš, Kaleshi, po në atë vend e quan absurd, sepse përgjigja e gjysmëvargut të tillë, po aty tingëllon:

Por për to qi shkon n’xhenet hul-le vesh, p.sh e gjejmë edhe te Ajeti. Trajtën foljore džveš të Elezoviçit nuk e ndeshim në variantet kosovare të Vehbijes; atje shohim vetëm: vesh-vesh.

Te Pirraku, vep. e cituar, vargjet në Emni Vehbije sherif te variantit që ka në dorë ai: S’ošt për tâ bajram qi turli petka vesh/ por për tâ qi shkon n’xhenet xhvesh, Pirraku vazhdon: “Te Ajeti, qendron: “Sâsht për të bajram qi turli petka vesh – por për tâ qi shkon në xhenet hul-le vesh” (!), Najstariji dokumenat, 70. pikëpyetja bashkë me pikëçuditjen këtu sipër e vënë te hul-le vesh, është tregues i padyshimtë i mospajtimit të Pirrakut ndaj shprehjës sonë – hul-le vesh, pra dhe miratues i asaj që Elezoviçi aty vinte shprehjen xhvesh, të cilën orientalisti yni i njohur H. Kaleshi e quante absurde.

Këtu te të Pirrakut të paditur, në emër të orientalistit tonë, po vëmë ne “absurd”.

Në vitet gjashtëdhjeta të shek. XX në Prishtinë ishin hapur disa institucione kulturore, një shkollë e lartë pedagogjike, Fakulteti Filozofik me katër degë të studimeve universitare. Më vitin 1957, Hasan Kalessi, asistent në Degën e studimeve orientale të Universitetit të Beogradit bontonte për numrin e parë të Godišnjakut të Institutit Ballkanologjik të Sarajevës studimin ku shtronte një panoramë nën titullin – *Arbanaska književnost na arapskom alfabetu*. Edhe ne po në atë kohë po merreshim me hetime, gjurmime e studime të literaturës shqipe në alfabetin arabo-turk dhe më vitin 1960 botuam te Rilindja e Prishtinës veprën Vehbije (Emni Vehbije) të autorit Tahir Efendi Boshnjakut, i cili kishte mbaruar studimet teologjike në Stamboll. Mbi tekstin e Vehbijes ne dhamë një pamje historike të ligjërimit shqip të Gjakovës në fillim të shekullit XIX; në librin e parë të revistës Gjurmime albanologjike 1962, doli një version serbo-kroatisht i Pamjes historike të së folmes së Gjakovës. Në Përmbledhjen e një vargu studimesh tona me titull Kërkime gjuhësore (1978), u rishtyp edhe libri ynë mbi veprën e Tahir ef. Boshnjakut – “Emni Vehbije”.

Studimi ynë mbi veprën e Tahir efendi Boshnjakut nga Gjakova, ngjalli komentime të heshtura, dhe ishte patronimi Boshnjak ai që nxiste shpjegime të një vargu dukurish gjuhësore – dialektore të cilat, në të vërtetë nuk përkonin as me trajtat historikisht të gjakovarishtes, as me leksikun jo gjakovar, bie fjala folja shporr, s’ishte punë që të pranohej si shfaqje dialektore gjakovare, ndonëse ky patronim është mjaft i hershëm ndër qytetarë të Gjakovës, që do të thotë se shtegtime nga Plava, Gucia, Rozhaja, nga krahu i Peshtenit, ka pasur parreshtur nga ato treva në drejtim të Kosovës e të Rrafshit të Dukagjinit (Gjakovë-Pejë), sidomos pas luftërave të shpeshta që shkaktonin lëvizje të popullsisë në kërkim të vendeve më të sigurta e pa tronditje të mëdha të qytetarëve dhe të mbarë popullsisë së rrezikuar. Kur e kemi fjalën për Vehbijen e Tahir ef. Boshnjakut, do të themi që ajo, që në fillim të shekullit XX, më 1907, u botua në Sofje transliterimin dhe transkriptimin e së cilës e bëri Ismail Haxhi Tahir Gjakova; nga aspekti i kritereve shkencore ne s’kishim mbetur i kënaqur, sikur u shprehëm që në fillim të këtij punimi: s’kishim qenë në gjendje ta përli-

gjinim autorin pse nuk i ishte mbajtur origjinalit, por, vise-vise në vend që të lexonte, bie fjala: *ketë, killon, kesin, küş*, autori ka marrë dhe u ka bërë modifikime: *çetë, çind, çillon, çesin, çüş*, e që okluzivet palatale *ќ, ǵ* në kohën e botimit a hartimit të kësaj vepre, Vehbijes, pra në shqipen e Gjakovës, vetëm po të paragjykonim nuk shqiptoheshin si të tilla, veçse fonemat *ќ, ǵ* ishin kthyer në afrikate paragjuhore *ç, xh*. Tahir ef. Boshnjaku i dallonte pa dyshim për mrekulli tipat e *q:ǵ* nga *ç:xh* pa asnjë gabim; a do të jenë shqiptime të autorit të Vehbijes, a reflektime të shqiptimit të mbarë qytetarëve të Gjakovës më vitin (1251-1835), kur mendonim ta ketë hartuar Vehbijen intelektualit i ditur Tahir efendi Boshnjaku.

“Gjuhën e Vehbijes vërtet e marrim në shumë elemente, si të qytetit të Gjakovës – thotë Hilmi Agani, Fjalori i L. Kujunxhiçit, Rilindja, 1981, f. 127. një shikim më rigoroz, ndërkaq, dikton domosdonë e njohjes së jetëshkrimit të autorit të saj. Vehbija nuk është e liruar nga elemente që nuk mund të merren si të së folmes së Gjakovës, pa marrë parasysh se vepra është e gjysmës së parë të shekullit të kaluar. Këndeј, duke përfillur në parim konstatimet e Ajetit, bindja jonë është se mbarimin definitiv të ndërrimeve fonetike *q>ç, ǵj>xh* do të duheј ta shtynim më tutje në kohë se ç’thotë Ajeti. Kjo bindje mbështetet pjesërisht në njohuritë tona që nga vitet 30 e këtej të këtij shekulli si dhe në gjurmimet e kryera ndër njerëz edhe të moshave të shkuara në Gjakovë, dhe jo vetëm sot, por edhe më parë. Gjendja që na dëshmon transkriptimi i vitit 1907, kur dihet se transkriptimin e bëri një njeri i pjekur në moshë, na thotë se ai, transkriptuesi, atë gjendje të këtyre konsonanteve e përvetësoi që në fëmijëri që do të thotë bukur thellë në shekullin e kaluar”.

Edhe Hilmi Agani me mëdyshje pranon mendimin që Vehbija të jetë e liruar nga elemente që mund të merren si të së folmes së Gjakovës, pa marrë parasysh se vepra është e gjysmës së parë të shekullit të kaluar dhe duke përfillur në parim konstatimet e Ajetit, shpreh bindjen se mbarimi definitiv i ndërrimeve fonetike *q>ç, ǵj>xh*, do të duheј shtyrë më tutje në kohë se ç’thotë Ajeti, të cilin mendim qi e mbështet pjesërisht në njohuritë e tij që nga vitet tridhjeta të shekullit XX si dhe nga kumtimet e

marra nga njerëz edhe të moshave të shkuara në Gjakovë, Fjalori i L. Kujunxhiçit, f. 127/8.

Çështja e okluziveve palatale *ǰ*, *ǧ* dhe të afrikateve prepalatale (paragjuhore) kërkon të ndiqet me shpjegime të hollësishme të shtuara dhe në rrethana të tjera duke përfshirë aty edhe elemente të tjera të huaja të hyra së jashtmi më vonë në strukturën gjuhësore të së folmes së Gjakovës. Këtu po i afrohem një gjykimi të heshtur fshehurazi, si tinëz, se tek Vehbija ka shumë elemente gjuhësore të dialekteve të tjera, një mendim që ka gjetur vend edhe në fillimet e këtij punimi: autori i Vehbijes nuk ishte me prejardhje nga Kosova, të parët e tij nuk dihej se kur, në ç’kohë, kishin ardhur nga treva shqiptare jashtë Kosovës; ai quhej Tahir Boshnjaku, prandaj Hilmi Agani shkruan se do pasur parasysh se T.B. sipas pohimit të Hafiz Bajram Aganit ishte nga Rozhaja dhe Prof. Agani me atë hov shpreh mendimin e tij se trajtën *kié-kije* autori i Vehbijes e kishte nga vendlindja e të parëve më të largët mbase nga Peshteri. E do logjika e sendeve që të vazhdohet rruga e kërkimit të elementeve fonetike dhe leksikore në gjithë tekstin e Vehbijes se në ç’masë diktohet numri i përputhjeve, i konkordancave në një anë dhe i veçimit të tyre në anë tjetër, me fjalë të tjera do të shquhen karakteristikat gjuhësore midis njërit dhe tjetrit dialekt, bie fjala në leksikon e Vehbijes në një rast autori ka përdorur foljen *shporr*, e cila, sipas informatave të marra prej gjakovarëve nuk njihet në të folmen e Gjakovës, ndërsa në të folmet e Malësisë së Madhe si dhe në Malësinë e Brisk Shestanit është e zakonshme; e ka Fjalori i Arbëneshit Kruno Krstiçit, Rječnik govora zadarskih arbanasa *shporr* (me, m’u) “udaljiti (se) ukloniti, rastaviti se od”, *shporru pe sish* “udalji se od njih”; zonj shporr! “ukloni gospo!”, e arbëneshët e Zarës janë kolonistë të dalë nga ai krah i Malësisë së Krajës – po edhe shqiptarët e Rrafshnaltës së Peshterit ishin mërgimtarë kelmendas nga Malësia e Madhe, të dëbuar me dhunë nga vatrat e tyre shekullore e të vendosur në Rrafshnaltën e Peshterit të Sanxhakut të Novi Pazarit. Pas islamizimit të plotë të tyre, më vonë, në raste të rralla është bërë ndonjë shpërngulje individuale nga Peshteri edhe në Kosovë.

F. Vehbije 64 Ška t'ia kujtojš šokit tit elbete t'bie m(ë) krüe tat.

Kali yt kalit tit

i kalit Tit kalin tat, Mbi të folmen shqipe të Peshterit, f. 38, Gjurmime albanologjike.

Janë identike format e gjinore – dhanoreve ndër të dyja dialektet: të Vehbijes me të së folmes shqipe të Peshterit sikur dëshmojnë shembujt e fjalëve të sipërme, që, në instancë të fundit janë trajta përemërore të marra me vete e të sjella me rastin e shpërnguljeve të familjeve nga ana e Peshterit në Gjakovë, siç janë të parët e familjes së Tahir ef. Boshnjakut, të vendosur siç thamë, në Gjakovë; pra, ato s'janë tipike kosovare – gjakovare. S'është gjakovare, as sot kosovare trajta e v. I të përemrit vetor – u (=unë) qysh na del te Vehbija e Tahir efendi Boshnjakut. Kúš ma hupin ümrin tem i ngrati u. Kosova sot, edhe Gjakova vetëm une; nuk përjashtohet mundësia e përdorimit të u-së vise-vise edhe në anët malore të Kosovës, sidomos në anën e Jabllanicës së sipërme të komunës së Medvegjës në Serbinë Jugore, vetëm u. E folmja e Gjakovës, në qoftë se nuk e ka të autorit të Vehbijes, ajo, as të veten nuk mund ta ketë, përveç une, qysh e ka gjithë Kosova, apo una.

Këto shtesa, pas mendimit të Çabejt, Studime gjuhësore në fushë të shqipes, II Rilindja, 1976, f. 234 lidhen në thelb me parimin e bisilabizmit me prirjen e gjuhëve për të mbështetur me një rrokje të dytë fjalët njërrrokëshe të një përdorimi të shpeshtë. Ajo nuk ka moshë të madhe, gjithsesi e pas periodës së rotacizmit; nuk e njohin as Buzuku, as Budi, por arbëneshët e Zarës, Bardhi dhe Bogdani – po.

Edhe diçka tipike gjakovare – kosovare: një varg (kosovarizmash) gjakovarizmash:

Veta III e së pakryeres; Përse s'punoj*ke*, por po fol*ke*. Grupet konsonantike *kl*, *gl* të hershme në gjakovarishten e të këtij teksti, kanë përfunduar në *k*, *g* rregullisht pa përjashtim, bile në këto raste kemi velarizimin e okluziveve palatale *q>k*, bie fjala: Musa pa namin po *kajke* ai me lot; me *qesh*, > me *kesh*, me *qa>* me *kājt*, *king'*> *kingj*, nga *qelbi* >

kelbi, me *kep* > *me kep qerre* > *kerre*, (qelb> nga kalb), në të folmen shqiptare të Peshterit mjaft shpesh dëgjoen edhe trajtat me *q*: qelbet, qerr, qep – me qep.

Grupi konsonantik – *tj* > *ć*

Zoti tha: “Insani për veti *ķeter ga s’ka* por robin e mundimit e *kā*”.

Merr ibret prej belās t’qervet – ia t’qesin për ibret t’qervet, 65

ška – çka:

ška piqet nuk hiqet;

ška dihet,

škado me *kān*, keq – xhahili *āsht* ma i keq;

ška *āsht* shkruet n’bāll s’jet pa t’dāl;

ška t’ia kujtojsh shoqit tit t’bje m’krye tat

ška t’apish ti me dor, ata kije me pās n/vorr, s’un marrish *gā* me zor;

ška t’vye tu ti e kije, tu qetri asnji fije;

ška dihet me *hāl* sun fshihet me *fjāl*.

Për diçka, - për çkado 56.

F. 64 Kuš pvet nuk bjerret por rrall *gīndet* kalzues (i) drejt

Mos e harro hisen tande prej dynjas, 64

Aj tha s’jam une fatbardh sall me *tā*, (63)

Por ezijet ban me gu konšive ajo (63)

Komenti: Rrokja e parë e përemrit të pakufishëm tjetër në të folmen e Gjakovës kthehet në – q: qetër.

Përemri pronor i emëruar

Veta II

yti jotja

I	i tëndit	i sates
	tëndit	sates
	tëndin	tënden

prej tëndit	prej satës
-------------	------------

II	yti	jotja
	i tit	i tates
	tit	tates
	tat	taten
	prej tit	prej tates

Pa u hup rrena e hajnia sun drekët turkña, 59

Pa limue škado hupet, 59

Kuš pvet nuk bjerret por rrall gíndet kallxues i drejt

Dašnia jote t' kórron e t'šurdhon e ta hup menden, 60.

Te Vehbija kemi në përdorim dy folje me të njëjtin vështrim: *hup e bjerr* (pa u *hup* rrena, dhe Kush pvet nuk *bjerret*); do të thoshim që folja e parë (*hup*) ka kuptim të përgjithshëm jo vetëm në të folmen e Gjakovës, por edhe në gjithë Kosovën; e dyta do të jetë e autorit të veprës Vehbije – jo e njohur si në Gjakovë edhe në Kosovë. Kur themi se kuptimi i së dytës është i autorit të kësaj vepre, ne, njëkohësisht, pranojmë faktin se autori i Vehbijes Tahir efendi Boshnjaku ka prejardhje nga Sanxhaku, dmth., nga Rrafshnalta e Peshterit prindërit e të cilit të dalë në këto anë tona në fund të shekullit 17, apo në fillimet e tetëmbëdhjetëshit, por edhe ithtar dhe vijues i veçorive fonetike të gegërishtes veriperëndimore. Edhe diçka do të thoshim në vijim të këtij paragrafi e në lidhje me dy foljet e posapërmendura: për atë të parën qysh e quajtmë u desh të shtonim se ka variantin e saj *humb*, i cili nga pikëpamja aktuale semantike nuk përkon me të periodave paksa më të hershme të mbarë shqipes; vështrimi aktual i *humb* është sekondar, parësori i saj “kridhem, zhytem s’dukem më, humbsem, mbliidhem, rrudhem”; e kjo dëshmohet ndër pasuesit e perëndimorit që shtektuan në gjysmën e parë të shekullit XVIII në ngulimin pranë Zarës në Dalmaci.

Arbëneshi Kruno Krstić në Rječnik govora zadarskih Arbanasa 1986 regjistron:

Bjer(me) > *bir*“(izgubiti” (se),

Umb(me, m’u) “spustiti u dubinu; propasti, utonuti, nestati”;

- m’o bir pe sysh si da ‘sht um > në dhe / “nestao mi je s’očiju kao da je propao u zemlju”.

- *umbët*, pril. “duboko”;

- Nuk dyet me mi (- mih, mihur), aç umbet “ne treba kopati tako duboko”.

- *up*(upi) m. “gubitak”.

I umbet “profondo” dhe në Borgo Erizzo (Tagliavini).

E folmja e Arbëneshit në ngulimin pranë Zarës për “perdo” ruan dy fjalë: *bjer* > *bir* dhe *up*(upi) “gubitak”; e treta *umb* <humb rezervohet për vështrimet: “fundos, kredh”.

“Nga këto në bazë të fonetikës së shqipes parësia i përket pa dyshim formës *hup*. Kështu arrihet te një bazë * skup. Kjo mund të jetë një formë apofonike e fjalës *hap*” (Çabej, Studime etimologjike në fushë të shqipes III).

Marrëdhëniet gjuhësore shqiptare-sllave, f. 325-331

Wacław Cimochoowski, “Për gjuhën shqipe”

- *ograjë* nga čakavishtja *ograjā* < *ogordja “Ograda”, geg. *Megjë* nga shtokavishtja *medja*, tosk. *Mejë* nga čak. *meja* < *medja* etj.

Shënimi ynë: Fjalët shqipe *ograjë* e *mejë* s’kanë të bëjnë me čakavishten, shih Barić, Arhiv I “Ima li čakavskih pozajmica u arbanaskom?”. Hymje në historinë e gjuhës shqipe, 77, shën. 2.

Te tekstet e vjetra te prof. Rexhep Ismajli, f. 40/41

Prof. Rexhep Ismajli për mendimin e M. Pirrakut në lidhje me fillimet e para të letërsisë shqiptare me alfabetin arabo-turk shprehet kështu:

“Sipas tij, ndryshe nga të tjerët që si dokument të parë të shqipes së

shkruar me alfabet arab mbajnë Vehbijen e T. Efendi Boshnjakut të vitit 1835, “në Kosovë shumë para Vehbisë ka ekzistuar tradita e përqëndruar mirë e shkrimit të gjuhës shqipe me alfabet arab si vazhdim pa golla i veprimtarisë letrare shqipe të Buzukut, Budit, Bardhit, Bogdanit, respektivisht në kohën e këtyre të zënë ngoje ka ekzistuar edhe letërsia fetare islame në gjuhën shqipe në bashkekzistencë me letërsinë shqipe të konfesionit fetar të krishterë”, Pirraku, 1978, 81-82 Sipas Pirrakut, Dervish Hasani me ilahinë *Ah, un i mjeri kesh tue fjet te gjysmës së II të sh. 17 apo të gjysmës së parë të sh. XVIII*, duhet të jetë autori i parë shqip me alfabet arab, nëse jo në përgjithësi, në Kosovë po se po.

“Në historinë e letërsisë nuk është vënë në pah sa duhet ky moment. Por as gjuha e tekstit që është ruajtur vetëm si kopje nuk jep shumë elemente për një vlerësim të tillë. As ne nuk e radhitëm në të shekullit 17 pasi nuk kishim siguri”. – kështu gjykon me plot të drejtë Prof. Rexhep Ismajli në vlerësimin e dhënë mbi zanafillën e shkrimit të gjuhës shqipe me alfabetin arab në Kosovë. Mendimi i zotit Pirraku është i nivelit të ulët profesional – shkencor. Gjuha e Ilahisë së Dervish Hasanit, si paraqitet në tekstin që pason, mund të vendoset vetëm në kosovarishten e shekullit XX.

Ah un i mjeri kesh tu fjet
 E m’dul gjumi për ahiret,
 Me ni myrshid jom përpjek,
 Çka m’kallzojti ah medet,
 Ai mi çeli katër dyr
 Njonda osht a(h) shariat
 Osht e dyta tarikat
 Dera tret hakikat.
 Edhe njonda osht marifet
 Lumi ai qi e ka gjet,
 Sherijatin e morra vesh
 Me namaz e me abdes
 Tarikatin e kom gjet

Osht esrari Muhamed.
Ziqri yte ah medet
Nat e dit s'po m'le me fjet
Hakikat un jom vet,
Un te un e kom gjet,
Shtat mymhyr a(h) medet
Me ni emen kendohen krejt,
Marifet osht për me dit
Kta dy emna per mi gjet
Njonda osht ah hidajet
Osht e dyta dalalet.
Shejh Sylejman bon himet
Mos na le neve n'dalalet.
Ty te un t'kom gjet
Mu pi meje ti m'ke hjek.

Teksti i tejshkruar nga Pirraku!

GJUHA E “DIVANIT” TË SHEH-MALIQIT

Te revista letrare “Jeta e Re” (1953/3) Mark Krasniqi botoi një vështrim informues nëpërmjet të cilit njihnte botën kulturore e shkencore me deri atëherë të panjohurin autor të “Divanit”, me Hilmi Maliqin, sheh i Rahovecit. Vëzhgimi i posazënë ngoje i Krasniqit përmbante të dhëna themelore mbi veprimtarinë shkrimore të Sheh-Maliqit mbi dëshminë e të cilave autori i “Divanit” tërhoqte origjinën e tij nga katundet e Podrimës. Shkollimin e mori në Prizren ku zuri turqishten, arabishten, persishten, mësoi historinë dhe traditën islame.

Nga vitet tetëdhjetë të shekullit të kaluar ngrehu tëbanën në Rahovec ku punoi si hoxhë, pastaj edhe myfti. Me ndihmën që i dhanë popullsia e Rahovecit dhe me shpenzimet e tij, në Rahovec ndërtoi një shkollë që më vonë e shndërroi në teqe – sot nën mbrojtjen e shtetit.

Gjatë nëpunësisë së tij dyzetëvjeçare në Rahovec hoxhë e myfti, Hilmi Maliqi merrej me shkrime duke përkthyer nga arabishtja, persishtja dhe turqishtja. Prej arabishtes përktheu veprën e poetit arab Bedrurin Sulltani – Variadatet – katërqind faqesh nga një dorëshkrim i imtë – të shkruar me alfabetin arabo-turk në të cilin përkthim jepte shpjegime mbi disa pjesë të Kuranit duke sqaruar shumë koncepte fetare islame. Veprën e përktheu edhe në turqishte.

Sheh-Maliqi ka lënë një varg veprash origjinale në shqipe, të shkruara me alfabetin arabo-turk: 16 tregime: *Mullari izemrës, Sofa e Aliut, Kopshti i dashnisë, Loçka e zemrës* me përmbajtje fetare.

Për studimet dialektologjike të të folmeve shqiptare të Podrimes, “Divani”, një përmbledhje këngësh mistike, del me interes të madh. Kjo lloj poezie, bartës të së cilës janë dervishë dhe shehlerë të mësuar e të ditur – kultivohej nëpër teqe. Veçoritë e saj qëndrojnë në faktin që ajo poezi është shumë e afërt me poezinë popullore mbi të cilën ushtronte ndikim të

ndjeshëm. Sa i përket zanafillës së saj ajo, pa dyshim do të ketë qenë nën ndikimin e poezisë orientale që po zhvillohej nëpër teqe. Kur është fjala për një frymë që del e qartë te një varg shkrimtarësh shqiptarë, që janë në ballë të letërsisë sonë të Rilindjes, bie fjala rasti i Naim Frashërit, atëherë mistika aq e shpeshtë në veprat e tij mbështetjen e ka te misticizmi – një trup i huaj në kulturën e në letërsinë tonë – gjykime të huaja në botëkuptimin e në mendimin e shqiptarit, prandaj prania e misticizmit rrënjët do t'i ketë te ideologjia e te kultura e pushtuesit oriental (khs. E. Koliqi, *Influenze orientali sulla letteratura albanese*, in Oriente moderno, 1954).

Sa i përket formës së saj, sikundur të gjitha gjinitë e tjera të këtij lloji, ajo shquhet nga një veti që përmban vargje me nga dy gjysmëvargje që rimohen në mënyrë që në secilën strofë vargu fundor përsëritet dhe del i njëjtë me vargun e strofës paraprijëse.

*Kemi ardhun n gurbet
Lan e kemi shpin t vet
Arzaili vjen e thrret
S kemi amel hej medet*

*Jam' hutu me gafflet
S na bje n mend për ahiret
Ymri for' shpejt po na thrret
S po raditim he medet.*

*Nuk bajm taat ibadet
Pejgamberit s'dum m'u pshtet
Shpirti po lyp shum hizmet
S kemi amel he medet*

*Pa ziqr allah kush ka ndejt,
Zemra e tij i ka flet
... do t'del n'at jet*

guha s'i flet he medet.

“Divani” i Sheh-Maliqit të Rahovecit ka 77 këngë.

Hetimi i kësaj literature të një rëndësie të dorës së parë për kërkimet e të folmeve shqiptare të truallit gjuhësor të Kosovës, për të cilat kemi fare pak të dhëna, - u bie institucioneve tona kulturore e shkencore. Pastaj shtrohet nevojë e madhe që të vazhdohen gjurmimet e hetimet e veprave të tjera të këtij lloji në gjithë trevën e Kosovës, sepse ka të ngjarë që të ketë edhe shkrime të tjera të kësaj letërsie. Krahas me këtë punë, shtrohet, gjithashtu nevojë, sikundër u tha pak më parë, që dokumentet gjuhësore të kësaj literature të shkruar me alfabetin arabo-turk të merren në dorë dhe të studiohen sistematikisht. Kjo literaturë e shkruar me alfabetin arabo-turk në këtë mënyrë vihet në pozitë të barabartë duke iu kthyer asaj rëndësia që në të vërtetë kanë edhe dokumentet gjuhësore të këtij lloji të shkruara me alfabete të tjera.

VEÇORI FONETIKE

A. Zanoret dhe dukuritë e tyre

Të marrësh e ta shkruash shqipen me alfabetin arabo-turk, sikundër dihet, është rrezik i madh sepse edhe kjo është e ditur, sistemi vokalik i arabishtes është i varfër.

Alfabeti arab që turqit e përdorin deri në vitin 1928 – kur e zëvendësuan me alfabetin latin, ka gjithsej tri mundësi grafike për të shprehur sistemin diçka më të zhvilluar të turqishtes, prandaj vështirësitë janë të kuptueshme kur shtihet në punë në turqishten ai alfabet. Po këto vështirësi dhe paadekuatësi na dalin kur përdorim alfabetin arabo-turk për të shkruar gjuhën shqipe, një alfabet që për një kohë të gjatë e shtinë në punë një shumicë e shkrimtarëve shqiptarë që nga shekulli XVII e deri në qindjetëshin XX (Sheh-Maliqi e përdori këtë alfabet në veprimtarinë e tij shkrimore deri në vitin 1927).

Mjafton të themi që shenja grafike *vav* (و) e alfabeti arab përdorej

për të shprehur këto zanore të shqipes: *a, o, u, y*, si dhe *â*-në hundore, për të parë se me sa kujdes do të veprohet kur merret të transkriptohej një tekst shqip i shkruar me alfabetin arabo-turk. Në këtë mes deshëm të vëmë në dukje se çfarë vështirësish na kanë dalë duke transkriptuar tekstin e "Divanit" të Sheh-Maliqit në ato raste kur ndeshnim në grafemën arabe *vav* (و); nga transkriptimi i drejtë e i saktë i grafemës *vav*, varej a do të mundemi të konstatojmë ekzistencën e zanores *â* hundore, në gjuhën që shpreh të folmen shqiptare të Rahovecit dhe të rrethit të tij. Situata vështirësohet kur dihet se grafema *vav* shtihet në punë për të shprehur edhe vokalin *o*, prandaj në këtë mes do t'i jepet përgjigje pyetjes mos grafema *vav* në situata të caktuara do të lexohet, ndoshta, *o*. Ta themi më saktë në qoftë se jemi pajtuar që shenjën grafike të alfabetit arabo-turk ta lexojmë si *a* hundore dhe si *o* gojore, atëherë në shumë raste do të detyrohemi që grafemën *vav* ta riprodhojmë alternativisht, herë *a* hundore herë *o* orale.

Riprodhimin e saktë të kësaj shenje grafike të alfabetit arabo-turk e ban t'ë pasigurt edhe prirja e *a*-së s gjatë hundore e gojore – të këmbehet nga *o*-a, pothuajse në të gjitha të folmet shqiptare të truallit gjuhësor t Kosovës (khs. "Gjurmime albanologjike", I, 15-17).

Meqë hundorësia e zanoreve në ligjërimet shqiptare të Kosovës është ënjëra nga veçoritë themelore, kësaj çështjeje i kishim kushtuar kujdes të veçantë. Mund ta themi me sigurnë më të madhe që gjuha e "Divanit" është e pajisur me vokale nazale dhe ne e kemi riprodhuar atë duke u mbështetur edhe në grafinë saherë që hundorësia përgjigjeje edhe historikisht.

Në punën e përcaktimit të vokalit nazal *a*, jemi mbështetur edhe në një rrethanë, që velarizimi i vokalit të gjatë nazal a oral *a*, nuk njihej pothuajse fare në gjuhën e tekstit të "Divanit". Lidhur me këtë pikë mund të thuhet që çdo *a* e gjatë gojore shprehej me një grafemë që nuk linte kurrfarë dyshimi për riprodhimin e saj, ashtu që në tekstin e "Divanit" takonim rëndom *مانغات* - *ma ngat*, *مرا* *Me ra* e jo *me ro*: qysh dëgjohej sot, pastaj *sevda*; mos na *daj*, zemra po kan (45).

نات أبيت	nāt e dīt
ای زوطی ماذ	i zoti i <i>madh</i>
قان آرد	kan ardh – 25
قان شقو	kān shku – 27
بجيم واي	bajm vaj – 45
شار	sharr
ليمان	<i>iman</i>

Përkundër kësaj grafeme dhe këtij riprodhimi, *a*-ja hundore në “Divanin” tonë është shprehur me grafemë و (*vav*) *bâhet*,

اشرت زمراي ته مپاس دي تسقور هون *âsht zemra jote me pās drit sikur han.*

قوش تياكون	<i>kush t'i gjân – 43</i>
دوت وبتن مهلون	<i>duhet vehten me e lān</i>
قرون	<i>me ngrān – 45</i>
بوفشون	<i>po fshān – 45</i>
لوشن التون	<i>qysh na gjān – 44</i>
تويثون	<i>tuj thān – 49</i>
لونق مي	<i>lān e kemi – 25</i>
مويو مو	<i>m'u bā m'u</i>
قان بونون	<i>e kan bānun – 35</i>
قوركو	<i>kurgjā</i>

Në disa raste kemi gjetur edhe shembuj me zanore hundore të përftuara në rrymë të kohës, që janë rezultati i fqinjësisë së vokalit *a* me konsonantet *n* apo *m*, sikur janë: *قوم kam بومون jām kām*.

Për hundorësinë e vokaleve të tjera nuk mund të themi asgjë me siguri, sepse autori i “Divanit”, në alfabetin e përdorur për të shprehur nazalitetin e vokaleve *e, i, u, y* nuk kishte rezervuar kurrfarë shenje të veçantë grafike.

Një vlerë të tillë fonetike të *a*-së nazale e kishim konstatuar edhe për

ligjërimin shqip të Gjakovës të fillimit të shekullit XIX (1835) duke shtjelluar monumentin gjuhësor *Vehbije* të Tahir Efendi Boshnjakut (khs. *Gjurmime albanologjike I*, dhe *Pamje historike el igjërimit shqip të Gjakovës në villim të shekullit*, Prishtinë, 1960).

Sa i përket sistemit vokalik të gjuhës së tekstit tonë, mund të thomi me plot gojën se ai pa dyshim i ruan të gjitha zanoret që janë në përdorim në gjuhën e sotme letrare, prandaj nuk e shohim të arsyeshme, po të përjashtohet gjysmëzanorja *e*, të marrim e t'i rrokim vokalet e tjera veç e veç. Në lidhje me gjysmëzanoren *ë* do të vëmë në dukje që ajo në atë kohë nuk del kund në gjuhën e tekstit të “Divanit”, as në ligjërim të Sheh-Maliqit. Mbi dëshminë e një teksti tjetër të shkruar me alfabetin araboturk, këtë gjysmëzanore nuk e kishim ndeshur as në ligjërimin shqip të Gjakovës nga gjysma e parë e shekullit të kaluar me ç’rast theksonim si vijon: Mendojmë që *ë*-ja e rrëguar në tria fjalët, në parafjalët: *në, më* dhe në nyjen e paravendosur *të*, sikur delte në fjalët e zëna ngoje shënohej jo për arsye që ato faktikisht shqiptoheshin në atë të folme, porse ato duhen quajtur përdorime konvencionale të teologëve që në shkrimet e tyre shtinin në përdorje alfabetin arabo-turk me qëllim që ta bëjnë sa më të lehtë për ata që do ta përdornin (*Gjurmime albanologjike I*, f. 19). Në lidhje me këtë pikë do të shtonim edhe diçka, që rrëgjimi i gjysmëzanosës *ë* është dëshmuar mjaft heret; lëkundja e saj është konstatuar qysh në dokumentet gjuhësore të shekullit XVIII; *Unë po banj e po ta falinj* këtë *pun teme* (Justin Rrota, *Për historin e alfabetit shqip*, Shkodër 1936, 36, 37). Atë, ç’është e vërteta, nuk e gjejmë në përmbledhjen e këngëve popullore të regjistruara prej Vuk Karaxhiqit në vitet tridhjetë të shekullit të kaluar, që ia kishte diktuar një murg nga Gjukurakovci i Pejës, e që Norbert Jokli i botoi më 1921, në Përmendoren që i kushtohej sllavistit të mirënjohur serb A. Belić me rastin e njëzetepesëvjetorit të veprimtarisë së tij shkencore-mësimore.

Zhdukjen e gjysmëvokalit *e* në të folmen shqiptare të Shalës së Bajgorës e kishte persiatuar L. Mulaku në disertacionin e tij të doktoratës, f. 89-90.

Edhe pse kuantiteti i vokaleve është gjë e ditur dhe e njohur e të folmeve geqe, ne këtu do t'i sillemi për t'i parë mundësitë e tij grafike, që autori i "Divanit" i kishte në dispozicion, si dhe për t'u informuar se në ç'masë i shtiu ai në përdorim ato mukndësi.

Në shënimin e kuantitetit të vokaleve, sikundër duket që ne parë, Sheh-Maliqi i kRahkovecit përdori të gjitha mundësitë grafike që jep alfabeti i arabishtes dhe i turqishtes. Megjithëse alfabeti arab është konsonantik, autori ynë shtiu në përdorim gjithë inventarin e mundshëm grafik të arabo-turqishtes, sikur janë shenjat e alfabeteve të tyre të quajtura tinguj kompensatorë nëpërmjet të të cilëve përftohej kuantiteti i vokaleve: ato shenja grafike janë: *ا* *elif* – për të shënuar a-në e gjatë; *و* *vav* për të përftuar u-në e gjatë: *ي* *ye* – për i-në e gjatë: *كتاب* *kitab*-libër; *رسول* - *resull*; *تأمين* *temmin*-sigurim).

Vokalet e turqishtes, fatkeqësisht, nuk grupohen sipas kuantitetit të tyre, për ç'arsye inventari grafik i saj hyn në punë në atë gjuhë për të shënuar bashkëtingëllore dhe zanore të caktuara:

ي - *ye* – si konsonant lexohet – *je*;

si vokal mund të shënojë këto vlera: 1) tingull të zgjatur ndër fjalël arabe e turke; 2) është shenjë udhëzuese ndër fjalë turke për *i*, *y*, *u*, *e* qysh tregojnë këta shembuj:

أريك	erik
كيس	kis
كوتو	kutu
كور	koru
يرته	erte.

(Fehmi Bajraktareviç, *Fillime të gramatikës së turqishtes*. f. 14). Në paraqitjen grafike të "Divanit" Sheh-Mlaiqi i shfrytëzoi me të madhe të gjitha ato mundësi grafike të alfabetit turk, duke shtuar për më tepër se konsonantet e zëna ngoje më parë i shtinte në punë sa herë që e kërkonte nevoja për të shprehur vlerat kuantitative të zanoree të shqipes:

në të cilën fjali vlera e kuantitetit të vokaleve është shprehur nëpërmjet konsonantit ...ى.(ye); kuantiteti vokalit *i* jepet po me atë grafemë edhe në këtë shprehje: *hak tarîkîn* – 32; Vlera e gjatësisë së vokalit *a* është dhënë me shenjën grafike \bar{a} = *elîf*: اوڤار - udhtar – اوڤاري ه جى. udhtâr jemi; صون دى تار sundimtar.

I mbështatur te alfabeti i vjetër turk, e për të shprehur vlerën e vokaleve të shqipes, Sheh-Maliqi përdori konsonantet e përmendura sikur dëshmojnë shembujt si vijon: *çilna zemrën*, چيلنا زمرن - ku *ye* në fjalën *çilna* nuk shpreh kurrfare vlere tjetër, veçse paraqet shqiptimin e vokalit *i*, po atë funksion ka *ye*-ja edhe në togfjalëshin: *kemi pinun*, pastaj زوطت - zitat; مچوقته زوطت – me ashk të zotit; por ka edhe raste kur konsonanti në fjalë nuk shpreh vlerë vokale, veçse konsonanti: قوقه يغ – *kânke djëg*.

Në fund, po deshëm të bëjmë një përmbledhje ç'thamë deri këtu mbi kuantitetin e vokaleve në tekstin e “Divanit” të Sheh-Maliqit të Rahovecit, do të thoshim se kuantiteti i vokaleve në gjuhën e Divanit është ruajtur mirë, që autori i tij e shprehte me ato mundësi grafike që nuk i siguronin atij gjithërë saktësi të dëshiruar për mungesë të repertorit të pamjaftueshëm grafik të alfabetit të të dy gjuhëve orientale – të arabishtes e të turqishtes.

Gjuha e Divanit, e krahasuar me gjendjen e sotme të të folmeve të Kosovës, me disa tipare del mjaft arkaike, por në punën e diftongjeve, ligjërimi i këtyre anëve, mund të themi me plotë kujtë, nuk ndërthen në vete kurrfarë veçorish të shënueshme që nuk do të ishin veti dialektore edhe të të folmeve të tjera të truallit gjuhësor të Kosovës. Shkurt, diftongjet dhe bashkëlidhjet zanore të gjuhës së Divanit i gjejmë të mbledhura në monoftongje: me *na pshtu*; *qysh me shku* (43); *me punu*; *me kujtu*, *me u msu* (47); *tök e qill*, në zjarm t’ashit â djëg (36); m’u ka pjëk vuxhudi sikur buka n’fur, sikur helli jemi pjek; na *ki çu* (47); për *me knu* (47). Ç’është e drejta, në gjithë Divanin numëruam vetëm disa shembuj në të cilët ruhej diftongu i paprekur –*ue*: *digom ti mue*; dit për dit *t’u shtu* vaji ty opet (23); jam *hutue*; kam *fitue*, rahmet ban ti me *mue* (15).

Mbi dëshminë e disa thërimeve leksikore, mendojmë se diftongu *ue*

është ruajtur i paprekur dhe mund të përfundojmë se ato provojnë shkallën e zhvillimit të gjuhës së Divanit, në të cilin mbisundon një gjendje që karakterizon rrëgjimin e diftongjeve dhe të bashkëlidhjeve zanore në të folmen e truallit gjuhësor të Podrimes, ku e kishte prejardhjen autori i Divanit që po e studiojmë (khs. *Kangë popullore shqiptare të Kosovës-Metohisë*, I-III; Jeta e Re, 1949-59).

Për të krijuar një ide sa më të qartë mbi gjendjen e diftongjeve të të folmeve shqiptare të truallit gjuhësor të Kosovës mendojmë që formulimi më i saktë do të ishte ai që ligjërimet e këtyre anëve nuk paraqesin një pasqyrë të njësishtme. Procesi i monoftongimit në disa të folme të trevës së përmendur gjuhësore ka përfunduar që në fillim të këtij shekulli (*Kujunxhiç, Fjalori*, Beograd 1902).

Në anë tjetër mungojnë burime të sakta mbi bazën e të cilave mund të japim një pasqyrë të vërtetë mbi gjendjen e ligjërimeve të trevës gjuhësore të Kosovës. Për truallin gjuhësor të Drenicës, po patëm besim të përmbledhja *Tregime popullore të Drenicës* e Anton Çettës, në fushë të diftongjeve situata paraqitet mjaft e paqartë: ne dyshojmë të kenë qenë të mundshme përdorime alternative të dy formave të ndryshme të së njëjtës fjalë në të njëjtën kohë: njëherë me diftongun *ue*, herën tjetër me mbledhjen e tij në *u*.

Sot në truallin e përfillur dialektor procesi i monoftongimit është në fazën e shthurjes; në disa vise të atij trualli, sidomos në anët fushore të tij, monoftongimi mbizotëron mbi të gjitha prirjet e tjera, kurse krahu malor i Krahinës së Kosovës po i përballon gjithnjë tkurrjet dhe mbledhjet e diftongjeve dhe të bashkëlidhjeve të tjera zanore (khs. *L. Mulaku, E folmja e Shalës së Bajgorës*, Prishtinë, 1968).

Duam të theksojmë edhe një gjë që në gjuhën e Divanit, po të lihet jashtë fjala *dhetë*, nuk kemi ndeshur në këmbime të diftongjeve të mirëfillta, sikundër janë: *je, ja: m'u* ka pjëk vuxhudi (36); sikur helli jemi *pjëk* (42); m'zjarm t'ashkit kush â *djëg* (36). Diftongjet e këtilla të mirëfillta nuk kanë pësuar kurrfarë ndryshimi as të kategoria emërore, bie fjala: *pjepën, bjëshk; mjek*.

B. Bashkëtingëllore dhe dukuri të tyre

Të folmet shqiptare në Jugollavi me pak përjashtime, janë studiuar shumë pak. Mungon qoftë edhe një përmbledhje më e përgjithshme mbi veçoritë themelore të tyre, dhe hulumtuesit e dialekteve tona habiten shpeshherë me daljen e një tipari të quajtur të zhdukur deri atëherë.

Edhe vetë nuk kujtonim se në ndonjë prej të të folmeve tona në Kosovë nga fundi i shekullit të kaluar dhe në fillim të këtij tonit dalloheshin tipat e okluziveve palatale: *q – ç, gj – xh*. Çështje e drejta e në lidhje me dukurinë fonetike në fjalë, ne e dinim se në ligjërimet anësore të trevës gjuhësore të Kosovës – s’kemi diktuar kurrfarë rrafshimi në plan të shqiptimit të tipave konsonantikë në fjalë; bie fjala, të folmet geqe të Tetovës e Gostivarit, idiomat shqiptare toske në pellgun e Liqenit të Prespës, si dhe ligjërimet shqiptare të Preshevës, të Bujanovcit me rrethe të tyre. Tipat e okluziveve të përmendura të të folmet shqiptare në Mal të Zi, i gjejmë të shtjelluara më gjerë në veprën tonë – *Zhvillimi historik i së folmes geqe të shqiptarëve të Zarës*, Sarajevë, 1961.

Në gjuhën e Divanit të Sheh-Maliqit kemi konstatuar dallimin e këtyre tipave okluzivë; në veprën tonë në studim për më tepër s’kemi ndeshur asnjëherë në raste të rrafshimit të tyre, gjë që dëshmon për një diferencim të prerë në shqiptimin e okluzivive në vështrim. Të lëmë të flasin shembujt vetë:

shoq - شوک

Qysh nuk tutem morè vlla – 11

Ça ka, këqyri – 14

Edhe zemra për dilberin m’u ka ça – 15

Qysh nuk diti, me

ça pat... - 25

Sikur çarki ūj

kur ka – 11

Çka je ardhun – 43

Kush t’i gjān – 43

Zemra po kån, po gjimon? 45

kto gjasht

zemra *digjet* – 33

Gjith prej qille – 45

Ni túb gan*xhe*

m'ra n'dor – 36

N'xhehnem me

zinxhir, veç gjallni? 38, 23.

Mendojmë se shembujt e prurë këtu sipër, pa dyshim, janë provë e gjallë e diferecimit të prerë të okluziveve palatale nga jopalatalet në gjuhën e Divanit që në anë tjetër do të thotë se edhe mbartësit e atij ligjërimi i veçonin në shqiptim këta tipa konsonantesh (Rrethi i Rahovecit).

Në punën e paraqitjes së tyre grafike, autori, siç dihet, nuk kishte në dorë mundësi të mjaftueshme, porse ai shtinte në punë shenja grafike të alfabeve të të dyja gjuhëve orientale duke i kombinuar ato në një mënyrë racionale:

ك = *q*

ڪ = *gj*

چ = *ç*. چت *çift*;

ج *ğ* جمع *xhami*

E shohim të arsyeshme të vëmë në dukje që në gjuhën e Divanit ruhen të paprekura togjet bashkëtingëllore *nd, mb*, që në të folmet shqiptare të truallit gjuhësor të Kosovës sot i gjejmë të asimiluara në *n, m*,

Po j ndimoj

Po sundon

Mendon

Perendi

Me zā tāndin

Zemra s'mundet

Aty gjindet sulltani

Nisi menden me hallakāt

Nuk t'ka mbēt

Me na mbajt.

Në grupin e togjeve bashkëtingëllore bën pjesë zakonisht edhe bashkëlidhja *ng* që në tekstin tonë në studim edhe ajo është ruajtur e paprekur, që ai, për pasojë do ta ketë regjistruar edhe shqiptuar në të gjitha shkrimet e tij:

Kur t'bjë e kur t'ngrohet, as me pi, as me ngrân.

A do të thotë se togjet bashkëtingëllorese do të kenë qenë në përdorje edhe në ligjërimin e vendlindjes së autorit të Divanit, apo ndoshta jo. Por, mbi bazën e logjikës së shëndoshë do të pritej që në kohën e vepërimarisë së Sheh-Maliqit të Rahovecit që të tre tipat e togjeve bashkëtingëllore të kishin një përdorim të gjallë.

Sheh-Maliqi nuk ishte përpjekur ta bënte të aftë alfabetin araboturk, në mënyrë që grafikisht të mund të paraqiste pa vështirësi edhe ata tinguj të shqipes që nuk i kishin ato gjuhë, alfabetin e të cilave mori e e shtiu në përdorim. Është fjala për sonantet *l*, *ll*; *r*, *rr*; që ruhen si në të folmet, si në gjuhën e sotme letrare shqipe: një *l* palatale, e tjetra velare *ll*; pastaj një *r* dhe një *rr*: *lis*, *lopë*, *lugë*, *lyrë*, *lag*, *llucë*, *lloç*, *shullā* – *shullë*, *mulli*, *mollë*, *rjep*, *i ri*, *bar*, *tre*, *tri*, *furrë*, *burrë*, *barrë*, *birrë*.

Në gjuhën e Divanit autori s'ka përdorur shenja grafike dalluese për dy tipat e sonanteve: *l-ll*; *r-rr*; në këtë punë ai i mbahej hullisë dhe shkante pas mundësive që i lejonte alfabeti arabo-turk dhe gjuha e tij formalisht nuk jep kurrfarë provash mbi ekzistencën e dy tipave të sonanteve, por, megjithatë ne mendojmë se s'ka arsye të dyshohet në praninë e tingëllueseve të përmendura në gjuhën e Divanit të Sheh-Maliq Rahovecit, aq më parë që një rrafshim të këtyre sonanteve në të folmet shqiptare të truallit gjuhësor të Kosovës, po të lihet jashtë gjuha e popullsisë së disa qyteteve tona, nuk është konstatuar në asnjë pozicion (*Pamje*, 32-35; Gjurmime albanologjike I, 34-37).

Të shohim më për së afërmi se si dalin sonantet e përfillura në tekstin e Divanit të Sheh-Maliqit.

Ta përsërisim edhe njëherë që tingëlluesja *l* e Divanit është paraqitur me shenjën grafike-/po ashtu edhe *r*-ja në tekstin tonë është

shprehur nëpërmjet një shenje të vetme, edhe pse alfabeti arab ka mundësi ta veçojë *r*-në velare duke shtënë në punë shenjen e teshtidit që shënon geminacionin *rr*, *fjala vjen*. – Muhammed.

N'ahiret mos t'qorohet

mora erën

Çilma derën

Sikur n'fur –

Sa u përket sonanteve *l-ll*, qysh na dalin në gjuhën e divanit, si dhe në shkrimet e tjera të Sheh-Maliq Rahovecit, siur u theksua më parë, ato janë paraqitur me një shenjë të vetme grafike, që disponon alfabeti arabo-turk:

Alemi prej vori çohet, 31

Halki krejt – 33

Aty gjindet sultani (1 për 11) 34

Guha po flet – 36

gjalni 39

Kam ni dert s'muj

me kalxu

Tok e qil 50

Me sy t'balit 38

Nisi menden me halakat 25

Në paraqitjen grafike të tipave të tingullit *l*, sikur u pa më parë, autori i Divanit shtinte në punë shenjat që dispononte alfabeti arabo-turk, ëq në të vërtetë nuk i përgjigjet as njërit as tjetrit tip të sonanteve *l-ll*.

Po deshëm të dimë se me çfarë vlerash fonetike u riprovua në gjuhën e tekstit të Divanit *l*-ja e alfabetit arabo-turk, do të thoshim se përgjigjja më e drejtë do të ishte ajo që *l*-ja arabo-turke në pozicion përpara ose prapa zanoreve qiellzore në shqipen pasqyrohej zakonisht me *l* palatale, e kur gjendej në fqinjësinë e vokaleve prapaqiellzore *a, o, u*, në të shumtën e rasteve riprodhohej me *ll*-në velare: Salih, Fadil, Selman, Selim, Batil, jeshil, por Sulltan, hallk, batall (khs. Fjlaor i gjuhës shqipe). Konsonanti në fjalë i arabishtes a i turqishtes në serokroatishten mori vlerën e

sonantit të mesëm a evropian: Fadil, batal, sultan (A. Škalić, *Turcizmi u narodnom govoru i narodnoj književnosti I, II*, Sarajevo, 1957). Për tipat e tingullit /l/ në të folmet shqiptare të Krajës, shkruan shtjellueshëm Idriz Ajeti, *Godišnjak Balkanološkog instituta I, Sarajevo, 1957* – Tipat e /s-ë/ në dialektet shqiptare të Brisk-Shestanit të Krajës, te *Probleme të historisë së gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1971).

Edhe disa sqarime në lidhje me sonantet *r-rr*, mund të themi që ky tingull në shqipen del dhe shqiptohet si paralele *r* dhe velare *-rr*. Po përsërisim edhe një herë që alfabeti arabo-turk ka vetëm një mundësi grafike për të shprehur vlerat e tipit të dyfishtë të këtij sonanti: *r-rr*, por as autori i Divanit s'ka bërë përpjekjet e duhura që të shtinte në punë kombinime të nevojshme për të shprehur sa më drejt e sa më mirë tipat e dy fonemave *r-rr*. Sikundër thamë edhe më parë, alfabeti i arabishtes i siguronte autorit një shenjë grafike që në atë gjuhë quhet *teshtid*, për të përfutur geminacionin e të gjitha konsonanteve, që ai, fatkeqësisht nuk e shfrytëzoi.

Arsyet e autorit të tekstit të Divanit për një procedim të tillë ne i shohim në faktin që turqishtja, me përjashtim të fjalëve të marra nga arabishtja, në strukturën e saj nuk ka geminate, për ç'arsye autori s'e ka parë të nevojshme ta shtinte në punë teshtidin për të shprehur një geminate të vetme të shqipes *rr*. Shenjën e alfabetit arab për geminate autori nuk e përdori as ndër fjalë arabe: xhehnem: xhehennem; Muhammed, sepse ai kishte parasysh shqiptimin shqip të arabizmave a orientalizmave. Ka edhe një arsye tjetër që nuk mund të mos merret parasysh kur trajtohet çështja e konsonanteve likuide *r-rr*; është fjala për rrafshimin e dy tipave të sonanteve *r-rr* dhe rrëgjimin e tyre në një fonemë të vetme, qysh është konstatuar në të folmet shqiptare të qyteteve të Kosovës (Prishtina, Prizreni, Mitrovica, Peja, Vuçiterna, Gilani – *L. Mulaku, E folmja e shqiptarëve të Shalës së Bajgorës*).

Autori i Divanit kisthe qëndruar një kohë të gjatë në ato qndra, gjuhën e të cilave po e përshkonte një rrymë e fortë për rrafshimin e sonanteve *r-rr*, prandaj nuk përjashtohet mundësia që në gjuhën e tij të ketë ndikuar edhe rrethi, megjithëse me pak gjasë.

Për konsonantin *nj* që në tekstin e Divanit nuk na dilte kund, ne nuk jemi të bindur të jetë zhdukur që në atë kohë; mungesën e tij e shohim në mospasjen e ndonjë shenje të posaçme grafike për atë tingull në alfabetin arabo-turk.

Për të shprehur bashkëtingëlloret ndërthënë *dh*, *th*, autori i Divanit nuk kishte rezervuar shenja të veçanta grafike, porse për t'i paraqitur ato fonema përdorte grafemat tingullisht më të afërta me to:

- ج - zel për *dh*
- ث - për *th*
- udhtar jemi – do t'shkojm
- Ça t'urdhnon, 43
- M'u ka rrethu, 49
- Tuj thën ...gjitha po fshân, 45
- Tuj thân gjith po hecim, 59.

Kur bëhet fjalë për dallimin midis dy kryedialekteve të shqipes, gegërishtes dhe toskërishtes, zakonisht theksohet a vihet re që toskërishtja, përveç tjerash, në punën e përdorimit të spirantit *h* del shumë më konservative se gegërishtja që shquhet për tiparet e saj paravajtëse. Me kaq këtu nuk është thënë e gjithë e vërteta, sepse, në këtë fushë diferencim kemi vetëm në disa prej të folmeve geqe, kur këmbetet *h*-në *f*. Mendojmë që Çabej ka të drejtë kur thotë se kjo dukuri fonetike njëherë ka dalë në truallin qendror të shqipes (Buletin, 1955/1) e pastaj erdh e u shtri në anët periferike të zkonave geqe. Këtë shfaqje fonetike e kemi konstatuar sporadikisht e rrallë në truallin gjuhësor të gegërishtes të Kosovës. Këmbimi i tingullit *h* në *f* është dëshmuar edhe te Buzuku, i cili *h*-në e përdorte sistematikisht: *û* të *njoh* se je shpëtuomë en dorët përse nuk vinjë të ftofëtë.

Në Gramatikën e tij të gjuhës shqipe, f. 62, Pekmezi përpiqej t'i gjente arsyet e kthimit të *h-f* në gegërishten duke përfunduar që *h*-ja në pozicion prapa zanoreve të mbyllëta këmbetet në buzodhëmboren *f*: *njoh* = *njof*; *shoh* = *shof*; me ç'mendim ne pajtohemi veçse do t'i shtonim që ky kthim bëhet në fqinjësi të *h*-së me dhëmboren – *t*; me *njoht-me njoft*, *i njoftun*; *i ftohtë-ftohtë*.

Hiq rastet e përmendura, shqiptimi i spirantit *h* del mjaft i qëndrueshëm në gjithë tekstin e Divanit.

Na shohim, 47

Bim shehadet, 48

Guha...bân rahmet

Alemi prej vorrit çohet, 31.

Nât e dît duhet me kajt, 6

Hupni vehten

hasm t'bâhet

n'xhehnem, 26, 36, 38

Thuj allah, te allahi, 35.

Shqiptimi i spirantit *h* është i qëndrueshëm dhe i ruajtur mirë pothuajse në të gjitha të folmet shqiptare, mirëpo në disa idioma toske vihet re një lëkundje e ndjeshme në shqiptimin e kësaj foneme, (khs. ligjërimin e Korçës. Disa fshatra në rrethin e Oparit, sidomos ato që shkojnë me Korçën: në të folmen e Semanit, *h*-ja fërkimore në pozicione të caktuara paraqitet mjaft e rrëgjuar, vise-vise edhe e zhdukur fare (Buletin, 1957/1, 1962, I. Në kundërshtim me to të folmet geqe ruajnë një nyjtim shumë më të qëndrueshëm të këtij tingulli, porse edhe në to, herë-herë ndeshim në raste dobësimi dhe zhdukjeje në shqiptimin e fërkimores *h*. (I. Ajeti, *Istorijski razvitak gegijskog govora Arbanasa kod Zadra*, f. 45, 119). Në lidhje me këtë çështje mendimi i disa albanologëve i shprehur në tekstet dialektore dhe në studime gjuhësore të tyre, që *h*-ja frikative, fjala e tyre, nuk dilte as ndër shprehje, ku do të ishte e domosdoshme, nuk është i mbështetur mirë (J. Rrota, *Monumenti më i vjetri i gjuhës shqipe*, 1938, f. 13; Kujundžić, *Srpsko-arnautski rečnik*. Bgd. 1902; C. Tagliavini, *Le parlate Albanesi*, f. 42).

Në punë të shqiptimit të tingullit të zënë ngoje, të folmet shqiptare të Kosovës janë të njësishe, sepse *h*-ja fërkimore, siç u tha më parë, ruhet mirë, për më tepër mund të thuhet që ndeshet edhe në disa raste, ku nuk e duan arsyet etimologjike, prandaj rastet e tilla i quajmë sekundare, bie fjala, në shumicën e të folmeve të këtyre viseve thuhet: *Hasim, Hasime* –

emër i njohur në poezinë tonë historike, pastaj *Heme*, harushë, e shqiptimi burimor i këtyre emrave nuk ka *h*. Asim, Asime, Eme, Emja.

Gjuha e “Dinvanit” bën pjesë në ato të folme shqiptare që *h*-në fërkimore, qoftë të fjalëve të huazura orientale, qoftë të shprehjeve me burim të vendit, siç u theksua disa herë, e ruajnë mirë.

Në këtë paragraf të shkurtër po rrahim të përmbledhim duke shpjeguar nga ana fonetike disa fjalë që edhe në këtë të folme dëshmojnë ekzistencën e një tipari të njohur me kohë të vërtetuar në gjuhën e kelmendasve; domethënë ligjërimin e kelmendasve e cilëson vetia e asimilacionit të togut bashkëtingëllor *mb* në *p*, *nd* në *t*. Kjo veti vise-vise del edhe në shqiptimin e idiomave të tjera gege, në ligjërime shqiptare të Kosovës, për shembull, te fjalët: *mbramë* – *pram*; *humb* – *hup*; *humbun* – *hupun*; *ndesh* – *tesh*; *ndërroj* = *tërroj*; *kandevtem* = *kandetem* = *konet*. Mendojmë që rruga më e drejtë dhe më e sigurt është ajo që secili rast të merret e të shtjellohet në vete sepse, për disa fjalë nuk jemi të sigurtë a mund të grupohen në këtë lagje fjalësh. Në fjalët: *mbramë*=*pramë*, *humb*=*hup*, *ndesh*=*tesh*, *mundëm*=*mujtëm*, mbase i *sëmundë*=*smüt*, edhe ndonjë rast tjetër kemi të bëjmë me asimilimin e togjeve bashkëtingëllore *mb* = *p*; *nd* = *t*. Jashtë këtyre rasteve, togjet bashkëtingëllore në fjalë asimilohen zakonisht *mb* = *m*; *nd* = *n*.

Ky lloj asimilacioni që shtrihet në një truall të vogël, - në disa të folme del vetëm rrallë e sporadikisht, në ligjërimet gege nuk është shfaqje e re, sepse e gjejmë në monumentet e vjetra të klasikëve të shqipes që në shekullin XVII; në Fjalorin e Bardhit shkruan: *aeger* = *i sëmutë*, *aegere* = me u *sëmutë*; *aegerosus* = *sëmutë*; *aegritudo* = të *sëmutë*. Në fjalorin e tij, Rossi sjell këto forma: *malato* = *smut*, *i smutun*, *smut*; e Kristoforidhi na bie këto trajta të kësaj fjale në fjalor të vet: *i*, e *sëmutë* (për Shkodrën); Fjalori i Bashkimit që përmban leksikon e vjelë në Gropë të Shkodrës dhe në Mirditë i jep këto forma të fjalës sonë: *smuet*, *smunne*, (*i,e*) = *ammabile*, *dannoso alla salute, malattia, infermità*; *smunnë-a*, pl *smunna* = *malattia*.

Në formimin e shprehjes *kondet*, *-konet*, *m'u konet*, me vështrim – *ngihem*, *ngopem*, *fâhem*, me gjasë marrin pjesë dy elemente foljore: *kanda*

e kandet, përndryshe do të mbetej pa përgjigje formuesi *et te kandet* dhe *konet*, forma që ne i nxjerrim të dala nga togu bashkëtingëllor $nd = t$.

Më parë kishim vënë në spikamë që kjo dukuri na del mjaft rrallë që te Buzuku në shprehjen *i mjtun* (i fortë), një fjalë kjo që nuk mund të veçohet prej *i mundun*, prandaj trajta e Buzukut, *i, e mujtun* do të jetë përfitim i prodhuar nga togu bashkëtingëllor $nd=t$.

Do të prekim edhe reflekset e togjeve të njohura bashkëtingëllore *kl, gl*, jo për ndonjë arsye se në gjuhën e tekstit tonë, në krahasim me ligjërimet e tjera paraqesin shmangie nga pasqyrimet e njohura të këtyre bashkëlidhjeve, veçse për një arsye tjetër, që të vërtetohet reflektimi standard dhe qëndrueshmëria e tij. Togjet e lashta konsonantike të shqipes *kl, gl*, në tekstin e divanit morën këto pasqyime: *k, g*, klenë = klanë = kjanë = kanë; *ku jem kân*, erdhëm: *kânke djëg* sikur n'zjarm shpejt; 29; me *kân* me *dalun* – ku *jan kân*, 43 zemra po *kan*, po gjimon 45, ku *kan përvjen nga klan a kla*, sot *qa*, shkodranishtja: *kjaj: Athu po kan, pao knon*, 45; t'u *kajt*, 33.

Togu i afërm bashkëtingëllor *gl* ka marrë refleksin *g* në tekstin e Divanit: *nuk kam guh kuj me j kallxu; guhapo flet, a po ngoni*, 36, 4.

Ky refleks i togjeve të njohura bashkëtingëllore *kl, gl* është një tipar i rëndësishëm në fonetikën e të folmeve shqiptare për ç'arsye studiuësit e gjuhës shqipe e rrokin ate shpesh në studimet e tyre (*Jokl, Arxivum romanicum*, XXIV, 9, 10); *Tagliavini, Le parlate albanesi*, 50-57; *E. Çabej, Buletin*, 1958/1; *I. Ajeti, Govor Arbanasa kod Zadra*, par. 65-66, po ai, *Pamje*, 26-28; *L. Mulaku, Govor Arbanasa Šaljé*).

Po deshëm të vendosim një kronologji së paku relative të kësaj dukurie fonetike të të folmeve shqiptare të Kosovës – do të vinim në dukje që kemi të bëjmë me një tipar të hershëm të këtyre idiomave, që është njëkohësisht njëra nga vetitë themelore dalluese që i veçon ato duke i kategorizuar në një lagje në vete. E theksuam se shfaqja në fjalë është një tipar i vjetër, që e ndeshim në shkrimet gjuhësore të Bogdanit në shekullin XVII.

Për t'i pasur të qarta reflekset e bashkëtingëlloreve të lashta konsonantike *kl, gl* në të folmet shqiptare të zonës gjuhësore të Kosovës, do t'i

vështrojmë shkallët nëpër të cilat ka ecur pasqyrimi i këtyre togjeve. Mendohet që në zhvillimin e këtij procesi ka pasur tri shkallë:

1. e para, shkalla e lashtë nistore: *kl, gl*.

2. dora e dytë, shkalla e ndërmjeme – *k-j, g-j*, që karakterizohet nga qiellzorëzimi a zbutimi i të dyja pjesëve përbërëse, që ne, përnga shqiptimi i njehnim të barabarta me të maqedonishtes *kkk, ggg*, apo edhe me të shqipes së arbëreshëve të Italisë Jugore dhe të Greqisë. Shqiptimi në shkallën e ndërmjeme –*k-j g-j*– që u zu ngoje më parë, erdh e u bigëzua në dy drejtime: ligjërimet toske dhe idiomat e gegërishtes jugore dhe ato të krahinave qendrore të Shqipërisë deri të Kruja, Mati dhe Mirëdita – togjet konsonantike në studim, *k-j g-j*, i pasqyruan me prepalatalet (*k, ggg, q, gj*), në këtë lagje hyjnë të folmet e popullsisë së arbëneshëve të Zarës dhe shqipja e Ulqinit (khs. I. Ajeti, *Govor Arbanasa kod Govor Arbanasa kod Zadra*), pastaj ligjërimi shqiptar i Dibrës dhe dialektet e tjera në Maqedoni.

Një drejtim tjetër morën të folmet shqiptare të Veriut: Zadrime, Shkodra, si dhe ligjërimet e tjera shqiptare në Mal të Zi, që në punën e shqiptimit të togjeve në vështrim ndoqën rrugën e fortësimit të dyja elementeve, duke i veçuar ato në shqiptim të tyre – *k-j-g-j*.

3. Shkallën e tretë e përbën faza që cilësohet nga zhdukja e plotë e tingullit palatal dhe mbledhja e togjeve konsonantike *k-j, g-j* në *k, g* - në ligjërimet shqiptare të Kosovës. Tipari në fjalë është veçori gjuhësore, qysh u zu ngoje më parë, që në shekullin XVII – në shkrimet gjuhësore të Bogdanit: *gas=gjasë; ndëgon-ndëg-jon*. Këtë shkallë në zhvillimin e togjeve në vështrim të të folmeve shqiptare të truallit gjuhësor të Kosovës, për periudhat e mëpastajme e dëshmojnë Vehbija e Tahir Efendi Boshnjakut (*Pamje*); Përmbledhja e këngëve popullore e Vuk Karaxhiçit – te Pomendorja që iu kushtua përvjetorit të punës shkencore te A. Beliqit (1921), pastaj *Divani* i Sheh-Maliq Rahovecit, shkrimet e të cilit bien në fund të shekullit XIX dhe në gjysmën e parë të qindvjetëshit tonë; për Krahinën e Shalës së Bajgorës të dhënat i kemi prej Latif Mulakut (*Govor Arbanasa Bajgorske Šalje*, 1968).

VEÇORI MORFOLOGJIKE

Gjuha e Divanit nuk jep as shkas që të ndalemi te veçoritë e saj morfologjike, për ç'arsye do t'i prekim vetëm disa prej vetive të saj specifike; natyrisht në këtë vështrim do të vëzhgojmë vetëm disa prej tipareve që në dialektologjinë shqiptare paraqesin çështje të veçantë.

Një gjë që bie në sy posa të merret në dorë për t'u hetuar gjuha e tekstit tonë në studim si dhe gjuha e të folmeve të këtij trualli dialektor me shqipen mbarë – është thjeshtimi i sistemit lakimor që është tipar edhe i një lagjeje gjuhësh sllave e joslave popujt e të cilave gjëllinë në pjesën lindore të Gadishullit Ballkanik: bullgarishtja, maqedonishtja, rumanishtja, greqishtja (khs. K. Sandfeld *Linguistique Balkanique*, Paris, 1930; A. Belić, *Dialekti Istočne i Južne Srbije*, Beograd, 1905; - *Galički dijalekat*, 1935; Seliščev, *Slavjanskoe naselente v Albanii*, Sofje, 1931; P. Skok, in *Južnoslovenski filolog*, XII; Gjergj Pekmezi, *Grammatik d. alb. Sprache*, Wien, 1908, E. Çabej, *hyrje në historinë e gjuhës shqipe*, 1960; Ivan Popović, *Geschichte der serbokroatischen Sprache*, Wiesbaden, 1960).

Është përsëritur sa herë që shqipja ka krijuar një sistem deklinacioni analitik duke kryer një thjeshtim dhe sinkretizim trajtash rasore. Gjuha shqipe ka gjashtë rasi nga tetë, sa kishte paragjkuha mëmë indoevropiane, por edhe ato të gjashtat rasi nuk dalin me trajta të dallueshme njëra nga tjetra, sepse emërorja e kallëzorja, pastaj gjinorja me dhanoren dhe rrjedhoren njëjës e shumës, nuk paraqiten të diferencuara morfologjikisht, në qoftë se kemi parasysh përdorimin alternativ të rrjedhores së pluralit në sistemin emëror të lakimit të pashquar; si dhe gjinorja me dhanoren e rrjedhoren njëjës e shumës në lakimin e pashquar emëror. Mirëpo, një gjë e tillë në punën e mospërputhjes së trajtave emërore në kuptimin lingistik nuk peshon aq, sepse që të gjitha tajtat e rasave për nga vështrimi i tyre janë të dallueshme.

Si në gjuhën e Divanit, e për pasojë edhe në të folmen e autorit të tij, konstatoam zhdukjen e lokativit a të vendores, që me të madhe përdoret në disa ligjërimi shqiptare, sidomos ato me tipare arkaike, si dhe gjuha e

autorëve të vjetër të shkrimit shqip, pikërisht Buzuku me pasuesit e tij të shek. XVI-XVII.

Kjo rasë, sikundër thkotë Pedersen, është përftuar nga trajta e akuzativit të lakimit të pashquar emëror, duke iu ngjitur asaj nyja e prapavendosur – *t*. Në lidhje me përdorimin e kësaj rase, do të shtohet edhe ndonjë gjë, që ka të bëjë me parafjalë të caktuara që tregojnë zakonisht vend, shoqërim, etj. – *në, më, mbë, mbi*, ndër to, sikur thamë janë edhe disa parafjalë që nuk hyjnë në kategorinë e atyre prepozicioneve, siç janë: *për, me*, prandaj po të mbahet parasysh fakti që vështrimi i lokativit s'ka të bëjë me kufizime hapësinore dhe gjithë ç'u tha për përdorimin e tij, do të përfundonim që termi lokativ e do nevoja të nxirret nga përdorimi duke u flakur krejtësisht, e quajtja më e përshtatshme për emëritmin e itj, do të ishte: rasë parafjalore. Ja disa shembuj: *e vunë ënbë kryqt; endë pasionët të ti...se ky ansh të korpi em për gjak tem, Meshari, 206-207: E për ënbi prakt të derësë shtëpisë, ënbi dert; shtjerë thikënë tande ëndë millt tat, Meshari, 212, 213; Endë sinagogët ëndë klishë, 214, 215; e ranë për dhet, 212, 213.*

Budi sjell këta shembuj: për shpirtit të mi përingdë = *Pasqyra e të rrefyemit* 29; e ndë barkt të sim amë, PR 384; ndë barkt të dhënit të tinë zot, në parathënien e *Fjalorit*; Këtë trajtë e kemi takuar edhe në shkrimet e Bogdanit (1685): *në barkt të s'amësë ndë shtëpit teme, ndë njerëzit tanë.*

Përdorimi i lokativit është i gjallë, sikundër u përsërit sa herë, edhe në të folmet arkaike shqiptare; por në dialektet e tjera përgjithësisht është zëvendësuar me akuzativin; e këtë dukuri e kishim përsiatuar qysh në shkrimet e Buzukut që më përjashtime sporadike përdoret trajta arkaike pas parafjalëve të caktuara. Mbi arsyet e parashtruara, lokativi nuk figuron në tekstet e gramatikave të shqipes së sotme, sepse u nxor nga sistemi i rasave të shqipes.

Në gjuhën e Divanit, sikundër e kishim thënë më parë, s'kishim ndeshur në përdorjen e lokativit, krejt në kundërshtim me klasikët e hershëm të shkrimeve shqip të shekullit XVI-XVII, si dhe të disa ligjëri-meve shqiptare (Çabej, *Buletin*, 1955/4, f. 116). Në gjithë truallin gjuhësor të Kosovës, përdorimi i lokativit është tkurrur dhe mbledhur në disa raste,

duke u ruajtur si trajta të ngurosura: *n'gjyst, n'mujt, n'javt, n'skejt*, sikundër po duket qartas, vetëm pas parafjalës –*në*.

Sa u përket trajtave të tjera rasore dhe vështrimit të tyre, në gjuhën e tekstit të Divanit kishim dëshmuar përdorimin alternativ të ablativit të lakimit të pashquar dhe të shquar: *gjith prej qille po flitron*, 45; *pej teje*, 54; *pej shpirtit t'vet*, 27; *pej ati*, 27; *pej mosdije tan jan ik*, 42; *pej dilberit po mundohen me na da*, 15; *pej dynjas dona m'u da*, 9.

Në mbështetje të shembujve të përmendur mundëm të vërtetojmë që forma *ati* e togfjalëshit *pej ati* është trajtë përemërore në gjinore-dhanore, megjithëqë pas parafjalës *pej-prej* trajta përemërore do të sundonte rasën e ablativit: *prej asi* (prej si); zëvendësimi i ablativit në rasi të tilla është kryer në shumicën dërmuese të të folmeve shqiptare, për më tepër ajo është mirëpritur dhe legalizuar edhe në gjuhën e sotme letrare. Sikundër dihet, forma e ablativit është *a+si=asi, prej asi*, qysh del zakonisht në shkrimet e autorëve të vjetër të shkrimeve të shqipes dhe sikundër regjistrohët në gramatikat e vjetra të shqipes: Meyer, *Gramatika e gjuhës shqipe*, 23; Pekmezi, *Gramatika e gjuhës shqipe*, 130. Forma e vjetër e ablativit ruhet gjithashtu mjaft e gjallë edhe në ligjërimet anësore të shqipes; në të folmet e diasporës shqiptare në Italinë Jugore dhe të arbëreshët e Greqisë: trajta e përmendur është mjaft e gjallë edhe në ligjërimet shqiptare të Brisikut dhe të Shestanit të Krajës, në dialektin e arbëneshëve të Zarës, khs. I. Ajeti, *E folmja e shqiptarëve të Zarës*, 102, 132, 133, 134, 148-155.

Forma e ablativit që në gjuhën e sotme letrare na del mjaft e kufizuar edhe vetëm në lakimin e pashquar emëror; duke iu ngjitur nyja – *t*, dikur përdorej shpesh në lakimin e shquar emëror. Raste përdorimi të kësaj forme ndeshen sot e gjithë ditën në disa të folme periferike: për ligjërimet shqiptare në Jugosllavi dëshmitë i kemi të *E folmja shqiptare e arënesëve të Zarës*, pastaj te *Pamje*, më në fund te *Gjurmime albanologjike*, I. Dukuria në fjalë është e shpeshtë në gjuhën e autorëve të vjetër të shkrimit shqip – Buzuku: en buket e të pijë en kelqit, en korpit së Krishtit; *Meshari*, 206, 207; ën figet së shpirtit ti; te Bardhi (Fjalori): n'doret sonë, Bogdani, prej pjese sonëje; doret së sinë zot; darket simëje; lëkuret simëje.

Në të folmen e shqiptarëve të Briskut e të Shestanit, përdorimi i kësaj tajte të ablativit është sekondar, d.m.th. –*et* për femëroren e njëjësit; *sh-* për formën e shumësit: pej *rrashtet*, përmrena kmishet, mas disa kohet; ...u zu anej pej anet t'hyqmetit; ... t'martuome mas pashallarësh...i msyn ni shehrit (I. Ajeti, *vep. e cekur*, 90, 91).

Në fushën e formave rasore të tekstit të Divanit, të Sheh Maliq Rahovecit, sikundër kishim theksuar sa herë më parë, s'kishim diktuar shmangie pothuajse fare apo edhe risime të tjera që nuk do t'i takonim edhe në gjuhën e sotme letrare; për ç'arsye nuk e shohim të nevojshme të ndalemi në këtë pikë të sistemit rasor t'ëtekstit tonë.

Këmbimi i mbaresës nominale *u* me mbarsën *i*, në lakimin e shquar të mashkullorëve që përfundojnë në bashkëtingëllore *k*, *g* – quhet njëra nga tiparet themelore të ligjërimit të kësaj zone, për ç'gjë po sjellim disa shembuj që dëshmojnë për një përdorim alternativ të nyjës *i-u* të katgorisë së përmendur nominale:

Aj terigu, 31

ashki i hakit m'u ka shtu, 50

Hak tarkikin me e gjët, 32

Ashki yt

Hallki me t'pa, 2

Po lyp hallki sall me t'pa, 7

Thot ashiku çuni âsht n'sevda, 15

Keq jam pi me ashikin tand

Me ba fiqer hallki, 33

Xhehnem t'ashikit

Madhnillakun na diftojn, 63

Lejleki rakrrat po ban, 2

Rahatllakun kije lan, j23

Pa allahin s'mujm m'e ndejt, 33

N'zjarm t'ashikit kush â djeëg, 36

Me alallin për m'u pjek, 42

Sikur çarki uj kur s'ka, 11.

Në kaptinën mbi fonetikën kur po hetonim tingujt, i kishim vënë gisht një fakti që autori i Divanit Maliq Rahoveci, vokalet hundore i shënonte nëpërmjet bashkëtingëlloreve të ëcaktuara, në mënyrë që qysh menjëherë jemi në gjendje pa vështirësi fare të përcaktojmë voklain në pozicionin fundor. Me një kombinacion të caktuar, Sheh Maliqi kapërcente çdo vështirësi të mundshme në punë të përcaktimit jtë vokaleve skajore të emrat, një gjë kjo që për shqipen ka një rëndësi tepër të madhe, sepse, në çështjen e vokaleve fundore të emrave që marojnë në bahskëtingëllore grykore *Ik, gI*, ishim në situatë të caktonim aty për aty maresën rasore të kësaj kategorie emërore.

Theksojmë në mënyrë të veçantë një rrethanë lehtësuese që na vinte në dorë teksti i Divanit në punën e përcaktimit të vokaleve fundore të emrave të tillë, në kundërshtim me vështirësi që na dilnin me rastin e studimit të këtij teksti të këtillë të shkruar me alfabetin arabo-turk për punë të grafikës së mangët të atij alfabeti. E kemi fjalën për veprën e Vehbijes së Tahir effendi Boshnjakut të Gjakovës, që në punë kësodore nuk shtinte në përdorim mundësitë që jepte alfabeti arabo-turk për shënimin e vokaleve me ndihmën e shenjave konsonantike.

Këmbimi i nyjes *u* me nyjen *i* është konstatuar me kohë pothuajse në gjithë zonën gjuhësore të Kosovës (khs. *Kujunxhiq. Fjalori serbisht-shqip*, Beograd, 1902; pastaj *Kangë popullore shqiptare të Kosovës-Metohisë*, 1952, vëll. I-III; L. *Mulaku, E folmja e shqiptarëve të Shalës*, Prishtinë, 1968).

Nën vargun e fjalëve që i prumë pak më parë që të vërtetonim këmbimin e nyjes *u* me *i* në për atë kategori emrash që mbarojnë me bashkëtingëlloret grykore *k, g*, gjendeshin edhe disa fjalë që pas fërkimores *h* fundore, në vend të *u*-së përfundonin me *i*. Meqë një praktikë e tillë *u* bie ndesh rregullave gramatikore në fuqi, G. *Meyer, Gramatika e shqipes*, 11; *Pekmezi, Gramatika e gjuhës shqipe*, 85, kësaj çështjeje po i kthehemi edhe njëherë.

Burimet gjuhësore si dhe të dhënat përkatëse na japin pasqyrën e një gjendjeje të tillë, që të gjitha të dhënat dialektore që u takojnë të folmeve veriore të gegërishtes, duke nisur me Matin, pastaj duke rrokur gjithë krahinën e truallit gjuhësor të Shkodrës, ligjërimet malësore, idiomat shqiptare të zonës gjuhësore të Kosovës, si dhe të folmet shqiptare në Mal të Zi – dëshmojnë pa kurrfarë dyshimi që kategoria e emrave me *h* fundore që nga kohët e kryehershme mbaronin me nyjen *i*. Nga vepra e autorit të hershëm të shkrimit shqip – Buzukut, kishim nxjerrë këta shembuj: *e kuj u kallëzuo krahi e të mujtunitë e tanë zot*, 206, 207, ... *zotynë anshtë ënb anë të krahit djathë tit*, 85, ... *vjen me fuqi të madhe e krahi i tit ë zotnonjë*. Për zonën dialektore të Shkodrës në *Fjalorin* e tij të gjuhës shqipe Kristofotidhi sjell këto shënime: *krahi* dhe *krahu* me vërejtje që shembullin e dytë me nyjen *u* e kishte marrë nga shkrimet e Pjetër Bogdanit (sh. 17) e që ne e marrim me rezervë të duhur, sepse Bogdani pasqyronte ligjërimin shqip të shekullit XVII qysh flitej në zonën e Prizrenit, të Shkodrës dhe në territorin gjuhësor të Malësisë. Në *Fjalorin* e Bashkimit (1908) që përfshin thesarin leksikor të trevës së Shkodrës, si dhe të truallit dialektor të Mirditës – gjejmë *krah-i*, kurse Pekmezi, në pjesën leksikore të Gramatikës së tij, trajtën *krahie* vinte në kllapa.

Në idiomat e Matit, në një anë, kemi *besniku, bulku, plaku, uku*, e në anë tjetër *ahi, plehi, shehi*, etj. (*Buletin*, 1963/II, f. 209). Kjo gjendje dëshmohet edhe në të folmen malësore të Dukagjinit qysh na del në Monografinë e dijetarit polka *Cimohovski, Dialekti i Dushmanit*, Poznanj, 1951, ku gjejmë *a-hi, krah-i, sabahi, gjynahi*, porse *miku, shtegu, tregu*, f. 30-31. Për trevën gjuhësore të Shkodrës, në ligjërimet malësore të Veriut, provat i kemi te *Fjalori i Kordinjanos, Fjalori shqip-italidht*, 2, 82, 154.

Të shohim ç’na thonë të folmet shqiptare në Jugosllavi. Që në fillim do të vihet re rrëgjimi i ndjenjës për shqiptimin e drejtë të nyjes së prapavendosur *u* në atë kategori emërore të mashkullorëve me konsonantet *k, g*. Cakun kronologjik do ta nisim nga koha e P. Bogdanit nga shekulli 17. Çrregullimi i përmendur që më vonë do të shfaqet në gjuhën e vendlindjes së tij, nuk na del kurrkund në shkrimet e Bogdanit: ... *të jetë ëndë for’ së*

ndritshmet gjakut së Davidit, 8; *fryjet së barkut*. 9; *athue zogu gjithë i ngjyem*, 68; *pse asht i kuq petku yt*, 69; *e anëniku i tinaj Amoni*, 66; *se peshku*, 66. Këtë dukuri d.m.th. ruajtjen e nyjes *u* në kategorinë e zënë ngoje nominale e kishim konstatuar edhe në monumentin gjuhësor të vitit 1835, të quajtur Vehbije e të shkruar me alfabetin arabo-turk që për punë të mungesës së ndjeshme grafike, paraqet vështirësi të madhe në caktimin e llojit të nyjes, duke u mbështetur në gjendjen e ligjërimit të Gjakovës nga shekulli XIX, porse, mbi bazën e gjendjes njaft arkaike të së folmes së Gjakovës të fillimit të shekullit XIX, vendosëm që mbaresën fundore te kategoria e emrave që mbarojnë me *k*, *g*, ta lexojmë *u*, e jo *i*: *Rrāja* e azganllëkut është *gzimi* i insanity. Pra, sa ta shohin ejllekun – ta përmendim paqllëkun, 24; ylemallëkun, ahmallëkun, shkado me kân i keq, xhahillëku është ma *i* keq, 17; (I. Ajeti, *Pamje historike e ligjërimit shqip të Gjakovës në fillim të shekullit XIX*), porse që në fillim të shekullit tonë zënë të shfaqen lëkundje në punë të përdorimit të nyjeve të prapavendosura *u*, *i*, sikundër shihet te *Kujunxhiqi, Fjalori sherbisht-shqip; Taljavini, Të folmet shqiptare*, 65; pastaj *Kangë Popullore Shqiptare të Kosovës Metohis I-III*, dhe në fund, *Latif Mulaku, E folmja shqiptare e Shalës së Bajgorës* – kur shkon e shoqja *e begit*.

Në qoftë se në mbarim të këtij paragrafi duam të bëjmë një vështrim përmbledhës ç'u shtjellua këtu lidhur me nyjen *u-i* të emrave mashkullorë me grykoret *k*, *g* fundore, mendojmë që shqiptimi i mbaresës fundore te kategoria emërore e mashkullorëve, është lëkundur në masë të madhe dhe që përdorimi i tyre alternative në të folmet e truallit gjuhësor të Kosovës është i gjallë sot e gjithë ditën. Porse, kjo është vetëm gjysma e parë e punës; ana tjetër e çështjes është ajo që ka të bëjë me atë lagje të emrave mashkullorë që mbarojnë me fërkimoren *h*: *krah, pleh, shah, teh*.

Në lidhje me anën e dytë të çështjes, nuk e shohim të nevojshme të sjellim prova e dëshmi që, në kategorinë saherë të zënë ngoje emërore në këtë vështrim përdorej vetëm nyja *-i* e jo *u-ja*, qysh e vërtetojnë përmendoret e para gjuhësore të shkrimit shqip, autorët e të cilave kanë dalë prej zonave gjuhësore të Veriut (Shqipëria veriake, Kosova, Mali i Zi dhe

Maqedonia). Por, të përmbledhim gjithë ç'thamë deri këtu mbi këtë pikë.

Mbi dëshminë e burimeve më të larta gjuhësore të shqipes, mund të përfundojmë që kategoria e mashkullorëve me bashkëtingëllore velare *k, g* dhe me vokale *a, i, e* në lakimin e shquar e në fazën e hershme të zhvillimit të tyre, - do të merrnin nyjen *u*, nga stadet e mëpastajme të tyre, disa të folme shqiptare – idiomat shqiptare të Kosovës – mund të dilnin alternativisht me nyjën *i*, porse vetëm mashkullorët që mbaronin me bashkëtingëlloret grykore *k, g*.

Meqenëse nyja *it e* mashkullorja ka marrë një përdorim mbisundues në gjuhën shqipe, e *u*-ja del e kufizuar dhe vetëm të kategoria e mashkullorëve me fundoret *k, g* dhe me vokalet fundore *a, i, e* – çështja e burimit dhe e përfutimit të nyjes *u* në kategorinë e përmendur nominale, me të drejtë është hetuar shpeshherë në shkencën albanologjike. Nyjën *i* disa e njehtin të lashtë, nga e cila më vonë është përfutur tipi *u*, sepse e kërkonin arsye të forta (khs. Meyer, S. Riza). Në kundërshtim me ta, keltisti dhe albanologu danez *Pedersen (Festkrift til Vilhelm Thomsen, Kopenhage, 1894, f. 246-247)* dhe në punimin e tij mbi guturalet në shqipen, *KZ XXXVI (1900), f. 277-340*, mbronte mendimin mbi zanafillë të lashtë të nyjës *u* në kategorinë e mashkullorëve që mbarojnë me bashkëtingëllore grykore *k, g* dhe me zanore *a, e, i*. Po të pajtoheshim me gjykimin e kundërt, e kemi vështirë ta shpjegojmë shfaqjen që grykoret *k, g* në fqinjësinë me nyjen e prapme *i* palatalizohen në *q, gj*. Kjo çështje ende nuk ka gjetur zgjidhjen e vet të kënaqshme dhe ka mbetur pezull.

Në vazhdim të kësaj çështjeje del edhe një përfundim që të folmet shqiptare nuk janë të njësishtme në punë të nyjeve *u-i* në kategorinë e mashkullorëve, saherë të përmendura me bashkëtingëlloret grykore *k, g*. Që të gjitha të folmet toske pa dallim, pastaj idiomat gege të Shqipërisë Qendrore, - në grupin e mashkullorëve me fundoret *k, g*, integrojnë edhe atë lagje mashkullorësh që mbarojnë me fërkimoren *h*, e cila merr po ato veti që kanë grykoret *k, g*: Q'e pa djallënë e njo hu, 371... e fshe hu bukënë, 374; (*Pedersen, tekstet shqiptare* – 1895... e muar pir krahu e e qelli tek e jema – *Tradizioni popolari degli Albanesi d'Italia*, 1962, f.123. Dukurinë e

zënë ngoje e dëshmojnë edhe gramatikat e shqipes e G. Mayerit, Gj. Pekmezit. Për këtë arsye, nuk do të ndalemi më gjatë në shfaqjen në vështrim. Përkundër tyre, ligjërimet geqe nuk pajtojnë me të toskëvet. Këtu poshtë, do të përpiqemi të përcaktojmë shtrirjen gjeografike të këtyre të tjeravet.

Gjurmimet dialektologjike tregojnë shkoqur që nyja – *i* del në atë kategori mashkullorësh që përfundojnë me *h* në ato ligjërimet geqe që përfshijnë zonën gjuhësore qe nga Mati, ndërthen në vete krahinën e Shkodrës, të folmet e Malësisë të Shqipërisë Veriake, pastaj izoglosa e saj del në Lumë dhe duke kapërcyer kufirin shtetëror shfaqet në të gjitha të folmet shqiptare të Kosovës.

Kur bëhet fjalë për vjetërsinë e nyjes së përmendur, ne e mendojmë atë me moshë të madhe; vjetërsinë e saj e dëshmojnë përmendoret e para gjuhësore të shqipes me Buzukun në krye e me pasuesit e tij Budin, Bardhin e Bogdanin; e provojnë gjithashtu edhe të folmet e sotme geqe të truallit të përmendur dialektor të shqipes.

Nga të gjithë përemrat që kemi hasur në gjuhën e Divanit me rastin e vëzhgimit të tekstit të tij, vetëm përemrat pronorë na kanë ngjallur paksa shkas për t'i prekur ata Dy lloj përemrash, është marrë në hetim shpeshherë në literaturën albanologjike për larminë e trajtave të tyre.

Çështja qëndron këtu që trajta e përemrit pronor për vetën e parë njëjës, në të folme geqe, në të shumtën e rasave del kështu; *i em*, *e eme*, në kundërshtim me trajtën përkatëse që e ndeshim në përmendoret e vjetra gjuhësore të shkrimit shqip që nuk ndiqet me nyjen e përparme *i*, *e*.

Vlen të vihet re që në Divanin e Sheh-Maliq Rahovecit këtë pronor nuk e hasim të ndjekur me nyjet e përparme *i*, *e*, që do të thotë se ai ruan trajtën e kryehershme, arkaike:

Shtati *em* m'u bā i rand, 32

Ah*it* yt

Dost*i em* gjith m'u diftu, 50

në anë tjetër, në lidhjet gjenitivale, nyja del prap, d.m.th. ajo e shoqëron fjalën: kur del drita e sabahit, 25, me sy t'ballit

N'xhehnem t'ashkit, 38

N'baçe t'dostit, 33

N'zjarm t'ashkít, 38.

Sikundër e kishim vënë re edhe më parë, nyja e përparme e përemrave pronorë të vetave 1, 2 njëjës e shumës nuk haste asnjëherë në përmendoret gjuhësore të autorëve shqiptarë të shekullit XVI dhe XVII.

Buzuku:

Anshtë ligja juajl se ky anshtë korp/em;

gjinja jote

Ky anshtë yni

Gjuha jone.

Budi:

Faqëja jone, DK 177

Pasqyra jone, PK, 355

Matranga:

Pandohia jone, 13

Bardhi:

Ligjia jone,

Bogdani:

Feja jone.

Në kundërshtim me gjendjen e përshkruar, nyja e përparme në shumicën dërrmuese të të folmeve të sotme geqe, pa përjashtime, u paraprin përemrave pronorë të vet. 1 e 2 njëjës e shumës. Në tekstin e Divanit tonë, përkundrazi, sikundër u tha më parë, sollëm shembuj që na vërtetojnë një gjendje të hershme zhvillimi të përemrave pronorë. Qëllimi kryesor i kësaj çështjeje është të na tregojë se cila trajtë është e lashtë dhe parësore, ajo që del me nyjën e përparme apo ajo që duket pa të. Po vëmë në dukje duke e përsëritur edhe një herë se vjetët e fundit ishin ngjallur diskutimet në shkencën albanologjike mbi çështjen në vështrim, sidomos për zanafillën dhe përfitimin e nyjës. Vëzhgimi i kësaj çështjeje dhe i një vargu çështjesh të tjera ka të bëjë me herimin e nyjës përgjithësisht në gjuhën shqipe, e puna thelbësore në çështjen në vështrim është mosha e trajtave nyjore në

gjuhën tonë – të nyjës së përparme dhe të së prapmes, për ç’gjë mendimet e shkencëtarëve janë të kundërta, të ndara, edhe pse pas të gjitha gjasave del e qartë që nyja e sprasme është një cilësi e kryehershme e gjuhës shqipe që u përftua me anë të përsëritjes sintaksore të saj, duke u formuar artikulli i përparmë (*Çabej, Studii shi Cercetări, Buletin, SHSHUT*).

Sa herë që i kthehemi çështjes së sistemit të foljeve të gjuhës shqipe, sidomos të nënsistemeve dialektore të ligjërimeve të shqipes, gjëja kryesore që në vështrimin e parë bie në sy, është shmangia, e këtyre prej normës së gjuhës së sotme letrare në punë të asaj kategorie që, hiq ato që mbarojnë me *n*, përfundojnë me consonant. Me fjalë të tjera, kjo kategori foljore në vetën e parë të së tashmes së dëftores merr mbaresën *i* (në fillim – *inj* – tipar i një lagjeje tjetër foljore, i kategorisë së *n* koniugacionit). Mbaresën e përmendur *i*, në betën e parë njëjës, të kohës së tashme e kemi hasur edhe në gjuhën e Divanit në studim që i bie ndesh normës drejtshkrimore të gjuhës së sotme letrare shqipe – nuk po *lypi, çeli, fail, shkeli*.

Ky grup foljesh, sikundër duket sheshazi, nuk përfshin foljet me diftongje *ie=je*, pastaj as ato folje që metafoninë e kanë veçori gjuhësore: *sjell, sjell, sjell; vjel, vjel, vjel; dal, del, del; njoh, njeh, njeh*. Ky tipar është karakteristikë edhe it ë folmeve shqiptare të Kosovës dhe i ligjërimeve gege në Mal të Zi.

Në këtë mes do të sqarohet çështja a është ky tipar gjuhësor it ë folmeve të përfillura veti e kryehershme e burimore, apo del një cilësi e vonë e tyre. Mendojmë se kjo çështje përgjigjen e saktë mund ta marrë në qoftë se theksojmë që kjo veti e saj gjuhësore është tipar i kryehershëm i këtyre ligjërimeve, porse ajo nuk mund të quhet cilësi e tyre burimore, sepse nuk e gjejmë te të gjitha të folmet shqiptare (khs. *Meyer, Gramatika e shqipes*, 1888, *Pekmezi, Gramatika e gjuhës shqipe*, 1908). Vjetërsinë e kësaj karakteristike të të folmeve gege e dëshmon edhe fakti që këtë tipar e hasim në tekstin e përmendores së parë të shkrimit shqip nga shekulli XVI. Në atë monument gjuhësor, d.m.th. në Mesharin e Buzukut, ky tipar gjuhësor del aq shpesh mbi bazë e të cilit mund të pohohet që e gjithë kategoria e të folmeve që mbarojnë me consonant, pot ë lihen jashtë foljet

me diftongje bashkë me ato pak folje metafonike: *njoh, njeh; dal, del, del; rrah, rreh...*, - në vetën e parë të tashmes së dëftores, - që të gjitha dalin me temë të zgjeruar – *inj* duke hyrë në kategorinë e madhe foljore me-*n*.

Në lidhje me këtë tipar duhet të vinim në dukje një gjë që midis gjuhës së Mesharit të Buzukut dhe të folmeve shqiptare të Kosovës shquhet një dallim i vogël që mbaresat e vetave 2 e 3 të së tashmes nuk dalin të njëjta; në Mesharin e Buzukut ato pikërisht dalin tema të zgjeruara, duke marrë në vetat përkatëse të 2 e 3 mbaresa të veçanta: *ën, ën*, një veti kjo që nuk i shquan foljet gjegjëse të ligjërimeve shqiptare të Kosovës; në të cilat ky përdallim do të përftohet me anë të këmbimit të kuantitetit të vokaleve të mbaresave të përfilluar: *u çeli, ti çël, aj çël*, te Buzuku: *u çelinj, ti çelën, aj çelën*, trajtat e të cilave pajtojnë për mrekulli me format përkatëse që i hasim në të folmet shqiptare të Briskut e të Shestanit, në Mal të Zi, si dhe në ligjërimin arbënesh te Zara e Dalmacisë (khs. I. *Ajeti, E folmja geqe e arbëneshëve të Zarës*), me këro trajta.

Brisku e Shestani:

Un ikinj, iki	kapinj, kapi	pres	hipi
ti ikën	kapën	pritën	hipën
aj ikën	kapën	pritën	hipën

Edhe në ligjërimin e arbëneshëve të Zarës, po këto forma na dalin në pjesën dërmuese të të foljebe, në consonant ashtu sikundër e pamë pak më lart.

Un kapi, kapinj	tres	mbes
ti kapën,	tretën	mbetën
aj kapën	tretën	mbetën

Moshën e madhe të kësaj shfaqjeje, përveç shembujve nga Meshari i Buzukut, e dëshmojnë edhe rastet nga shkrimet e Pjetër Bogdanit ... tash po *ecën* i gjashti muej se ashtë me barrë (*Cuneus prophetarum*, redaktimi i Ndre Mjedës, f. 21): kah *ecën* e rrjedh tue kjanë dheu plot me zeha ari ... ujët *hipën* malevet; ujëtë ku mbë disa vise rrjedh verdhë (*Antologji e letërsisë shqipe*, f. 52).

Për një periudhë pak më të hershme e për një truall tjetër të të

folmeve shqiptare, dëshminë na e siguron *Fjalori* i Frang Bardhit (1635).

Po *dredhin*ujë *Shkimbinj*dritënë

I thithinjë gjaknë

*Mbushinj*butnë me venë

Zbardhin duertë.

Mprefën dhambët

*Mbërsjelinj*udhënë

Lidhin penë

Kush *frofën*

Ligjërimit e tjera shqiptare na shfaqen me një pasqyrë tjetër: të folët e Matit (*Buletin* 1963/2, f. 246) nuk tregojnë zgjerime temash e mbaresash në vetën e parë të së tashmes së dëftores: *un mush*; në kundërshtim me të filmet e Shqipërisë Veriore bashkë me dialektet e Malësisë, në të cilat zgjerimi i temave me mbaresa përkatëse në vetën e parë të së tashmes dëftore është njëri nga tiparet e tyre standarde (*Cimohovski, E folmja e Dushmanit*): *un mushi*. Shfaqjen e përmendur, sikur e theksuam më parë, e përforcojnë edhe të folmet shqiptare të Kosovës (khs, I. Ajeti, *Pamje; Histori e gjuhës shqipe – Morfologjia historike e shqipes*, 1969; L. Mulaku, *vep.cek.* 1968).

Më në fund, po deshëm të japim një pasqyrëz përmbledhëse mbi ç'u tha deri këtu, do të ishte e nevojshme të vëmë në dukje. që shfaqja e përfillur në të folmet toske është ruajtur rrallë në disa raste, sikur janë: *eci, hipi, lypi* (lipi), *iki*, me forma të vetave 2 e 3 *hipën, lypën, ecën, ikën*.

Asaj praktike të dialekteve roske (kjo praktikë ka hyrë edhe në gjuhën e sotme letrare) i ngjiten edhe trajtat përkatëse të të folmeve jugore gege dhe të ligjërimeve të zonës gjuhësore të Shqipërisë së Mesme që shtrihen deri në Mat. Në atë pikë pjesërisht bashkohen edhe idiomat shqiptare në Maqedoninë Perëndimore, e sidomos ligjërimit arbëreshe në Italinë Jugore dhe nëpër ishujt e Greqisë (khs. *Hahn, Studime shqiptare*, 1854; *Dozon, Manual ii gjuhës shqipe*, 1879; *Pedersen, Tekste të gjuhës shqipe me Glosar*, 1895; *Mejer, Studimet e gjuhës shqipe*, V).

Vlen të theksohet edhe një gjë, që në çështjen e shtjelluar që më

parë, midis ligjërimeve toske të diasporës dhe disa dialekteve gege, vihet re një bashkëpajtim çuditërisht i njëjtë. Sa u përket mbaresave që dalin si rezultat i zgjerimit të temave foljore te vetat 2 e 3 të së tashmes njëjës të dëftores, ligjërimet gege do të degëzohen në dy lagje: grupi i parë përfshin ato të folme të Shqipërisë Veriake me shkodranishten dhe idiomat e Malësisë, dialektet shqiptare të Kosovës, në të cilat elementi zgjerues paraqitet vetëm në vetën e parë të kategorisë përkatëse foljore: un (*u*) *mushi, shkeli, çeli, fail, ndeshi, kapi*, kurse në të folmet shqiptare veriperëndimore të Briskut e të Shestanit, si dhe në arbënishten e Zarës, elementi zgjerues shfaqet edhe në të dy vetat e tjera (2 e 3), njëjës: *fail* (falinj), *falën, falën, shkeli-ñj, shkelën, shkelën*.

Në lidhje me këtë çështje, e kemi për detyrë t'i shpjegojmë arsyet e përfitimit dhe vjetërsinë e këtij tipari gjuhësor të së folmeve shqiptare. Arsyet e përftimit të kësaj karakteristike mendojmë që duhen kërkuar në prirjen e mbartësve të gjuhës shqipe që mbaresat vetore të së tashmes së dëftores si për nga trajta, si për nga anët tingullore të bëhen sa më të lehta për t'i dalluar. Kjo kërkesë u arrit me zgjerimin e temave foljore, duke iu ngjitur atyre mbaresat të posaçme. Megjithatë, nuk është e sigurt nëse ky zgjerim i temave me elemente plotësuese në fillim i kishte prekur të gjitha vetat e së tashmes së dëftores, duke i përfshirë këtu vetat 2 e 3 të njëjësit.

Për moshën e kësaj shfaqjeje, mendojmë që ajo duhet venduar në shekullin XV, të thomi më drejt në XVI, kur u botia monumenti i parë ahkrimor i gjuhës shqipe, i cili njëkohësisht do të njihet dëshmi për ekzistencën e veçorisë gjuhësore në fjalë në ligjërimin e mbartësve të shqipes në zonën e saj veriore. Reduktimi i mbaresave në vetat 2 e 3 njëjës të së tashmes dëftore në disa të folme gege që u zunë ngojë më parë, dhe këmbimi i kuantitetit të vokaleve të tyre – për ç'gjë kishim shprehur dyshimin tonë – do të quhen një stad i ri, i mëvonë në zhvillimin e ligjërimeve shqiptare.

Kur bëhet fjalë për trajtat participore do të themi që në rekstin e Divanit kishim hasur një numër të madh participash arkaike me forma të plota. Të themi që këtë tipar të lashtë e gjejmë edhe në të folmen shqiptare

të Kosovës; të sjellim disa shembuj të nxjerrë prej tekstit të Divanit të Sheh Maliq Rahovecit:

Me *kā* me *dalun*, 32

Kemi *ranun* n'gaflet, 29

Jam *dalldisun* krejt

Jam *hapun*, 58

Me ta *falun* ket dynja, 10

S'jemi *kanun*, hiç na vlla, 17

S'kemi *pasun* – kush na i dha, 17

Kemi *ardhun* n'gerbet, 26

Kemi *pinun* uj sherbet, 53

Krahas këtyre shembujve të participave trajtëplota, në tekstin e Divanit kemi ndeshur gjithashtu edhe në raste participash trajtëshkurtra, që, padyshim do të njihen shfaqje të reja të disa të të folmeve shqiptare të Kosovës:

Me ashk t'zotit jemi pi, 57

Jem' *dalldis*

qysh ki *ardh*, 47

Ashki yt n'zembër ni qiri ma ka *kall*

M'u ka *pjek* vuxhudi

Sikur buka n'furr, 38

Kan *ardh*, kan *shku* n'shpi t'vet

N'ahiret kan *shku*

Keq jan *pi* me ashkin tand, 32

Sikur helli jem *pjek*, 42

Shfaqja në vështrim, sikundër u tha më lart, është një tipat i kryehershëm i të folmeve shqiptare, që në ligjërimet e Kosovës është ruajtur sporadikisht, e në disa idioma të tjera del shumë rrallë më një numër të kufizuar. Për moshën e madhe të cilësisë në studim flasin përmendoret e autorëve të vjetër të shkrimit shqip – Buzuku, Budi, Bardhi e Bogdani. Me këtë rast do të vinim në dukje edhe një gjë që midis mbaresave participore të gjuhës së tekstit të Divanit dhe të asaj që del në monumentet e shkrimit

të vjetër shqip, ka një dallim, sepse në tekstin e Divanit të Sheh Maliq Rahovecit forma e participit del me *un: falun, dalun, kanun, pasun, ranun, dalldisun, hupun*, përkundër praktikës që zbatohet në shkrimet e autorëve të vjetër që pikërisht ruhej: *m: bleem, klaam, shtiim, raam, gëzuom, ndërgjuem, dëshiruem, besuem, shpuum*, për kategorinë e foljeve që mbaronin me diftong thuaj në vocal; edhe – *un* për foljet e kategorisë që përfundonin me consonant, kur përjashtohen ato folje që sosnin me konsonante: *l, ll, r, rr, - pa klenë njuhunë...* qi ish vdekunë, qi u keshe lenë; ao kër ua kish thashunë, jam ardhunë se e kishnë qitunë jashtë; se koqeja e grunë qi anshtë enbjellë endë dhet; qi qish mort kish me marrë.

Çështje e drejta, në Mesharin e Buzukut, kishim hasur në mbaresa të tjera participore, siç është – *t*: porsi kau qi vjen *shput* me u therun, 204, 205; Ai kle *shpum*, 208, 209; as nuk hini ende shtëpi me *engranë* e me *pitë*, qi ën pari e kishnë *patë*; ku e kini *vutë*; me shpirt të *përvutë*.

Dëshminë që edhe kategoria foljore në diftong dhe vocal në kohën e Buzukut e njihje mbaresën infinitive – participin me *n-*, na e jep participi i emëruar:

Tëlyen, te Buzuku *të-lyenë*; qi u kishë lenë, u paçë të panëtë sot *të panë, tëpanë*. Prapashtesa –*t* nuk është zhdukur ende në të folmet shqiptare. Ajo është ruajtur edhe në ligjërimet shqiptare në zonën gjuhësore të Kosovës, pse vetëm si prapashtesë mbiemërore: *i shtruet, kryeshtruet, i ratë, i thatë, i prehtë, i ftohtë, e pitë*. Po në këtë truall gjuhësor të shqipes është mjaft e gjallë me përdorim mbiemëror prapashtesat participore: - *n* (në- *i lani, i pani*, khs. *Tpanë, i kqyrni, i fshani, i lyeni, i ngrani (i ngrani dreqit!)*); Formant ii përmendur participor përdoret sporadikisht në një masë të kufizuar si adjektiv i emëruar: *kryelanë – krelanë*, i përfutur prej *krye + lamë*; *tlyen = të + lyen*; *tëpanë = të + panë*.

Sa u përket formanteve participore në tekstin e Divanit do të vihet re, sikundër dëshmojnë shembujt e përfillur më parë, që janë reduktuar në trajtën e vetmë – *un: dalun, kanun, dalldisun, ardhun, pinun*, që shpeshherë dalin me formante të dyfishuara: *pinë + un = pinun*; *kanë + un = kanun*.

Në fund të kësaj pike po përmbledhim ç'thamë për formantet participore që i kishim hasur në tekstin e Divanit dhe për ato që dalin në gjuhën shqipe.

Format participore që ndeshen në monumentet e vjetra gjuhësore dalin kështu: *n* (*r, rë*), *un, -urë*; *m, rë, -t, të-* në gjuhën e Divanit që pasqyrojnë të folmet shqiptare të truallit gjuhësor të Rahovecit me rrethe, janë përndarë në kategori përkatëse gramatikore: - *un* është rezervuar për të paraqitur funksionin participor; *m* – ja ka marrë funksion mbiemëror; dhe *t*-ja ka hyrë në shërbim të mbiemrave gjithashtu.

Vjetërsinë e trajtave të përfillura participore e provojnë format përkatëse në gjuhën farefisnore indoevropiane, serbokroatisheja: *dan, dat; dana reč, data reč*, lat. *dic-t-us, doc-t-us*.

Një veti të re inovuese në gjuhën e tekstit të Divanit e përbën përdorja e koniunktivit mbi të cilin janë shprehur lëkundje të mëdha dhe pasiguri. Është fjala për zëvendësimin e trajtave koniunktivale të prezentit me forma të dëftores në vetëm 2 e 3 njëjës, ja disa shembuj nga Divani i Sheh-Maliq Rahovecit:

Ku do *t'del*

Teri *t'gjan*, 26

Ni dit do *t'vin* dush m'u da, 10

Gjith ç'a shohish

N'terr jesish pa drit, 38

Mos t'na *shkon* bosh ymri krejt, 29

Shembujt e përmendur përmbajnë disa trajta të futurit që janë përfutuar me anë të formave koniunktivale. Zëvendësimi i trajtave të rrjedhore njëjës mund të kryhet edhe në forma të shumësit, bie fjala, me vetën e 3 shumës të së tashmes: Ni dit do të *vin* (vijnë) në vend të njëjësit të lidhore – *vijë*.

Dihet me siguri se kjo shfaqje është një tipar i lashtë i folmeve gege ku bëjnë pjesë jo vetëm ligjërimet shqiptare të zonës gjuhësore të Kosovës, porse edhe idiomat e Shkodrës dhe ato të Malësisë (khs. *Jarnik, Zur albanischen Sprachkunde* i cili ka *t'bjerrin kushtin*, 340). Për të folmet e

Malësisë së Mbishkodrës dëshminë e kemi prej dijetarit polka Cimohovski (E folmja e Dushmanit): *ai t'sjellin*.

Sa i përket kronologjisë së kësaj shfaqjeje, mendojmë që të gjitha të dhënat flasin në dobi të faktit që ajo është një tipat i lashtë it ë folmeve të përmendura dhe se zanafilla e saj bie nga fund ii shekullit XVIII apo nga fillimi i qindvjetëshit XIX. Edhe kur është fjala për shtrirjen gjeografike të shfaqjes në studim, situatë na paraqitet mjaft qartë. E hasim në një terren rreptësisht të caktuar; izoglosa e saj shkon deri te Matja, porse nuk i kalon kufijtë e saj; përfshinë zonën e Shkodrës dhe truallin gjuhësor të Malësisë, pastaj merr e shtrihet duke kapërcyer kufirin shtetëror dhe del në truallin gjuhësor të Kosovës duke u shtrirë nëpër gjithë territorin e saj (khs. *Dija-lektološki zbornik za srpskohrvatski jezik*, Srpske akademije nauka i umetnosti; I. *Ajeti, Istorijski razvitak gegijskog govora Arbanasa kod Zadra; Pamje; Latif Mulaku, Govor Albanaca Šalje*, 1968). Në anën tjetër, në disa të folme ndeshim zëvendësimin e së tashmes dëftore me format e lidhore. Kjo shfaqje ka gjetur pasqyrim edhe në gjuhën e Divanit, në ligjërimin shqip të Prizrenit me rrethe të tij, porse del edhe në idiomën e Dibrës:

Gjith ça *shohish*, 14

N'ter *jesish*, pa drit, 33

Dush m'u da, 10

Për zanafillën e kësaj shfaqjeje, ne nuk mund të japim një mendim të prerë, qoftë për të provuar burimin indigjen të saj, qoftë edhe për ta hedhur poshtë atë. Një gjë në këtë mes dihet me siguri që marrja në përdorim e formave të lidhore atje ku shtihen në punë trajtat e dëftores, jemi të mendimit që ky tipar it ë folmeve të përmendura të shqipes është përfitim i brendshëm i saj.

Në vargun e tipareve inovuese në gjuhën e Divanit të Sheh-Maliq Rahovecit, padyshim do të ndërthehet edhe përdorimi alternativ i foljeve ndihmëse: *kam, jam*, kur zgjedhohen foljet jokalimtare:

Ku *jem* 'kän, erdhën opet, 35

Me *kan* me dal, 32

Ku *jam* kän, 48

Çka *je dalun*, 43

Ku *jam ardhun*, 43

Ku *jam kân*

Jemi ik, 42

Pej mosdije, tan *jan ik*, 42

Me sy t'ballit *kemi ik*, 38

Qysh *ki ardh*, 44

Ke mi ardhun n'gërbet, 26

Kan ardh, *kan shku* n'shpi t'vet, 26

Kemi ranun n'gaflet, 39.

Është e qartë që kjo shfaqje shuhësore gjendet e venduar po në atë truall dialektor, ku ishte përsiatuar edhe ekzistenca e shfaqjes së përmendur më parë, por që nga mosha nuk bashkëpajtohen. Lëkundja e madhe në punë të përdorimit të foljeve ndihmëse është një shfaqje e kryehershme për të folmen geqe, sepse e hasim qysh në përmendoren më të vjetër gjuhësore të shqipes, në Mesharin e Buzukut:

...ajo fjalë nuk *ish* klenë thashunë, 156-157

ai qi *anshtë* vdekunë, qi ish vdekunë

se ai *ish* dalë en tinë zot, 210, 211

em vëlla nuk *ë ish* vdekunë, 174, 175

qi *ish klenë* verbënë, 168, 169

U për vete ën vetëhej nuk *ë jam ardhunë*, 166, 167.

Teksti i Mesharit të Buzukut, sikur u vu re më parë, është përplot me shembuj që janë ndërtuar me foljen ndihmëse – *jam* në vend të asaj me *kan*, porse kjo nuk do të thotë që përdorimi i foljes *jam* mbizotëron mbi atë *kam*, që përkundrazi del në raste shumë më të shpeshta në gjuhën e Buzukut.

Mbisundimi i foljes *kam* në krahasim me ndimësen tjetër *jam* në të folmet shqiptare të Kosovës me kategorinë e foljeve jokalimtare është punë që duket sheshazi, porse na habit fakti përse në gjuhën e Divanit, në raste të tilla herë-herë na dilte ndihmësja – *kam*.

I pambështetur na duket mendimi i disa gramatikanëve që, fjala

tyre, në ligjërimet toske përdoret vetëm future me *do*+koniunktiv, e në idiomat gege njihet forma *kam* + infinitive: *kam me shkue, kam me gatue*.

Në gjuhën e Divanit, si duket në mënyrë të shkoqur në tekstin e tij, nuk del e kufizuar vetëm njëra formë e futurit në dëm të tjetrës; përkundrazi, në atë tekst na dalin doradoras që të dyja format e së ardhmes, me *do* + koniunktiv:

Udhtar jemi *do t'shkojm* krejt, 24

Kur *do t'del'n'* ...25

N'dynja nuk ka *me ndejt*

Tan *do t'desin, bahen mejt*. 30

Ku *do t'jet*

Kur *do t'nëshesh* për me shku

Do t'del, 26

Ni dit *do t'vin*– dush *me m'u*nda.

Nuk shohim të arsyeshme të ndalemi këtu mbi çështjen aq të diskutueshme të zanafillës së formave të futurit. Është interesante të vihet re që forma e futurit me *kam* + infinitive puqet për mrekulli me mënyrën se si përftohet future në gjuhën romane: *lavorero=lavorare+ho* (me punue kam); frëngj. *j'écrirai=écrire+j'ai*, me të vetmin dallim që në gjuhën romane folja ndihmëse *do* të vijë në fund, e shqipja *do* ta ketë në fillim.

Sa i përket moshës së formave të futurit në shqipen, mendimet e dijetarëve janë të ndara, megjithatë, mbizotron mendimi që forma *do* + koniunktiv është një krijim i rishmë në shqipen, i përftuar me anë të ndikimit të greqishtes që hyri edhe në bullgarishten, në ligjërimet serbokroate dhe në rumanishten. Ky fakt dëshmon se shqipja është formuar në sferën perëndimore dhe lindore të truallit indoevropian gjuhësor. Nga shembujt që nxorën prej tekstit të Divanit dëshmohet që edhe të folmet gege e njohin edhe mirë madje formimin e futurit me *do*+koniunktiv që pa të drejtë quhet veti e dialekteve toske të gjuhës shqipe. Mendimin tonë e përforcojnë shumë shembuj të përdorimit të trajtës *do*+koniunktiv në gjuhën e Mesharit të Buzukut.

Duke lexuar tekstin e Divanit dhe duke shtjelluar kategoritë grama-

tikore të gjuhës së tij, kemi formuar bindjen se format gjuhësore të tekstit të Divanit janë të qëndrueshme; në gjuhën e tekstit të Divanit kemi gjetur një numër të madh sinonimesh me një mori ndërtimesh gjuhësore.

Gjuha e kësaj vepre, padyshim, është trazuar me orientalizma të shumtë, me të cilët, sikundër dihet, ligjërimet popullore janë të përziara.

Sa i përket sintaksës nuk mund të thuhet që kjo vepër s'ka ndërtime të qëndrueshme në atë fushë; gjithashtu edhe trajtat morfologjike në gjuhën e tekstit të Divanit janë të qëndrueshme.

(Nxjerrë nga revista Gjurmime Albanologjike nr. 3. 1966, 27-52)

RRETH DISA VEÇORIVE TË TË FOLMEVE TË SHQIPTARËVE TË RRETHIT TË PRESHEVËS DHE TË BUJANOVICIT*

Me rastin e vizitës sime në Preshevë, në rrethin e saj dhe në disa fshatra të Bujanovcit, për arsye të kohës së shkurtër, munda të shënoja vetëm disa nga karakteristikat më kryesore të të folmeve shqiptare të këtyre viseve.

Me këtë hov ne nuk do ta marrim në vështrim e t'i prekim shtegtimet e popullsisë të kësaj zone, megjithëse nuk përjashtojmë dobinë e madhe që del nga ato në punën e ndriçimit të çështjeve gjuhësore. Por na mban shpresa se njohja jonë e gjendjes së tanishme të të folmeve shqiptare na lejon që, gjatë shtjellimit të këtij punimi, të mund të bëjmë krahasime përkatëse dhe, në mbështetje të tipareve gjuhësore të të folmeve të shqipes, të vërtetojmë përkatësinë e tij duke identifikuar tipin dialektor të idiomës në fjalë.

Në kërkimet e një lagjeje të dialekteve të shqipes është gjithherë e pranishme një rrethanë lehtësuese që mbartësit e tyre kanë ruajtur ndarjen në fise, gjë që e bën të mundur me një përqindje të madhe të identifikohet se cilit tip dialektor i takon popullsia, të folmen e së cilës jemi duke e hetuar në këtë vështrim. Në punën tonë do të mbështetemi kryesisht në materialin gjuhësor që do të na orientojë nga rruga që do të na sigurojë rezultate që flasin në dobi të përcaktimit të tipit dialektor në studim.

Për ta mbërthyer mirë trajtimin e së folmes sonë, është e domosdoshme të mbështetemi në monumentet gjuhësore të autorëve të vjetër shqiptarë dhe në materialin dialektor të vjelë që herët në këtë zonë; e gjithë kjo analizë do të krahasohet me materialin e mbledhur tani vonë

* Marrë nga "Studime Filologjike", 1971/3

prej nesh. Kur është fjala për të folmet e viseve të zëna ngoje, po u lanë mënjane pak thërrime dialektore të vjela prej etnologësh dhe dijetarësh të tjerë që kishin shënuar në këto anë nga fundi i shekullit të shkuar dhe në fillim të këtij tonit, atëhere Stefan Mladenov do të njihet i pari shkencëtar që kish mbledhur paksa material dialektor me rastin e vizitës së tij në këto vise, në kohën e pushtimit të këtyre anëve nga ushtria austro-hungareze dhe bullgare; dijetari bullgar, me atë rast, kishte vizituar Preshevën, Kumanovën, Shkupin me rreth, Tetovën, Gostivarin, Dibrën, Strugën, Ohrin, Resnin, Kaçanikun, Prizrenin dhe Prishtinën; materialin e vjelë me atë hov e botoi më 1925 në revistën gjermane *Balkan-Archiv*, I, f. 43-70, me titull *Bemerkungen über die Albaner und das Albanische in Nordmakedonien und Altserbien*. Studimi në fjalë ishte recensuar në Arhivin e **Bariqit**, 1926 (III) për disa tipare gjuhësore të këtyre anëve, duke u bazuar në studimin e Mladenovit, bënte fjalë linguisti dhe albanologu italian Carlo Tagliavini në punimin e tij *Le parlate albanesi di tipo ghego orientale (Dardania e Macedonia Nordoccidentale)*, që u botua në edicionin e Akademisë italiane të Romës, 1942. Mbi dëshminë e materialit të vjelë gjuhësor, folklorik e etnografik, prof Tagliavini na jepte një pasqyrë mbi tiparet dialektore të ligjërimeve më kryesore shqiptare në Jugosllavi; me atë rast ai prekte edhe veçoritë më kryesore të së folmes shqipe të Preshevës. Në monografinë e tij me titull *Gornja Morava i izmornik* në edicionin e përhershëm të Akademisë Serbe të Shkencave të Beogradit, *Naselja i poreklo stanovništva*, Beograd 1935, - prof. A. Urošević bën fjalë për disa tipare gjuhësore të të folmeve të kësaj zone, të cilat do t'i marrim në shqyrtim për arsye se me disa sosh nuk mund të pajtohemi.

Në prak të shpërthimit të Luftës së Dytë Botërore, Jovan Trifunovski kishte përfunduar kërkimet e ndërrimeve antropogjeografike mbi Karadakun e Kumanovë-Preshevës dhe monografinë e hetimeve të kësaj krahine e botoi më 1951 në edicionet e Akademisë serbe të Shkencave të Beogradit, seria – *Naselja i poreklo stanovništva*, lib. 33; libri u pajis me regjistër toponimesh dhe omonimesh që, si material gjuhësor, ka peshë të

madhe në punën e gjurmimeve të dialekteve shqiptare të kësaj zone.

Në librin II të Buletinit të Muzeut të Vranjës, Tatomir Vukanović botonte dy studime: i pari u kushtohej hetimeve të zhvillimit të trevës së Preshevës dhe të popullsisë së saj në periudhën 1945-1965, studimi tjetër na paraqet fizionominë e sotme shoqërore-gjeografike të Bujanovcit; nga ana metodologjike që të dyja kanë një prestigj mbi studimet e llojit të tyre, sepse paraqesin qartë zhvillimin ekonomik e shoqëror në kohën e sotme të qyteteve të vogla në jug të Serbisë, por që për punën e hetimit të dialektit tonë në studim nuk na dalin me ndonjë farë dobie.

I. VEÇORITË FONETIKE

A. Sistemi vokalik

1. E folmja e këtij rajoni na del me vokalizëm shumë të pasur, sikundër të gjitha ligjërimet shqiptare; dialekti në studim ka shtatë zanore: a, o, u, y, e, i, ë (ö), vokali i fundit gjendet në disa raste ku në vend të zanores y përdoret ö-ja, bie fjala *kröt* (kryet); - le t' thön; i ka dhimt kröt, pastaj söt për syt.

Një prej tipareve kryesore të sistemit vokalik të të folmeve gege është prania e bivokalizmit, që do të thotë ekzistenca e zanoreve gojore dhe atyre hundore, pastaj cilësi e përbashkët e të gjitha të folmeve gege edhe të një pjese të toskërishtes quhet kuantiteti i zanoreve që në studimet albanologjike kanë qenë shpeshherë objekt trajtimesh, sikundër është Auguste Dozon, *Manuel de la langue chkiye ou albanaise*, Paris, 1879, f. 179, Pekmezi; *Grammatik der alb. Sprache*, Vjenë, 1908, f. 46; G. Weigand, *Albanesische Grammatik im südgegischen Dialekt*, Leipzig, 1913, f. 5; G. Von Hahn, *Albanesische Studien*, II, Beitrag zur einen Grammatik des toskischen Dialektes, f. 27; E. Çabej, *Buletin i Universitetit shtetëror të Tiranës*, 1958/2, f. 207-214.

Të themi edhe njëherë që gjuha shqipe ka tri gjatësi zanoresh të

theksuara: të shkurtëra, të mesme e të gjata; për shembull: 1) *māl, līs, dërr*; 2) *nátë, pátë, rátë*; 3) *bâ, gjâ; rā, bā, bār, hatā; kâ, drū, frÿ, drÿ, pÿll*.

Lidhur me sa u tha këtu më parë, zona jonë dialektore nuk ka arsye të bëjë përjashtim kur është fjala për kuantitetin e vokaleve, që ne e kishim konstatuar me rastin e vizitës sonë në ato anë: *jâm mêt n'zäll*; bile ka *dëk*; u *bâ*: sahati *nâ:n*; *n'gjëm*; me *m'thâ:n* mue; i nxora *kīt* (kiet, qet); ni *çik* e emja; *z'guxoj* kurr^g*gâ* me *prëk* aty; me na *thâ:n*, dil se po *vīn* do agallār; kemi hi *n'öd*; e *kâm dīt*; kish pas *shkū*; pse *s'ja dhā*; i bin aty *dhīt*; ti *m'dhā* (Rahovicë); *s'u bâ*: me *pëk*; për *grūn*; jem *kâ:n*; e *kā* dikush, *bëshk* e madhe; ish *kâ:n*; *zâ:n*; *s'e lâ*: (Miratoc); kish pas *nëjt* (e orale); kur *â kâ:n* bari kish *dāl*; u dajtëm at *nāt*; mej *bâ*:; *çka* po *lyp*; kishin me pa (Corrotice); jo, ktu *s'kâ*; nuk kan *dāl*; ship kan *fōl*; jena *mbūsh*; *â dhān* (Shushaja e Sipërme dhe e Poshtnja); ka *dëg* e ka *pëk*; *çka* po *fōl* ti; *â pūn ajo*; kur hip *aj* (Ranatoc); puna *mso vêt*; *shī* po na duhet me *rā*; *s'e pīsh*; *çish* u *dān*; (edhe u dajtën); ish *kâ:n* qeni i meçëm; mere *tërnakopin* e prishe *xhamīn*: *n'idhnim t'hoxhve* u maruen di *xhamlā*; po nuk po thot qi e *kā* për mullinin; nuk *āsht pūn mulli*. Edhe ni *fjāl*; *s'po* liftohet *dōv* e *ilahī*; kur *hīp aj*; ish *bâ*: *tevdil*; *tësh* e *râ:n* (Samolica); ni *đāl* e ni *çik*; *dīrt* (dyert); ish pa *kâ:n* (Muhoc). Shembuj për dy gjatësitë e tjera këtu nuk po sjellim, sepse ato nuk janë të rralla në cilëndo të folme shqipe qoftë në një anë, dhe në anën tjetër në historinë e gjuhës shqipe ato nuk paraqesin ndonjë vështirësi për t'u shpjeguar, në kundërshtim me dy gjatësitë e para, me të shkurtëren dhe atë të mesmen, do t'i sillemi kuantitetit të gjatë për rrugën historike që ajo ka përshekruar e që filli i shpjegimit na del mjaft i kapërthyesëm. Gjatësitë e zanoreve të gjata nga zanafilla na del tri farësh: gjatësia e vokaleve në fjalët *thī, mī*, ka moshë të madhe dhe rrjedh nga trashëgime indoevropiane si dëshmohet nga latinishtja: *sūs, mūs* në të cilën gjuhë si mise e indoevropianishtes ruhen vokalet përkatëse të gjata (E. Çabej, Buletini 1958/2); kurse një kuantitet tjetër të fjalës *kūt* nga lat. *cubitus*, pastaj *pÿll*, një huazim i latinishtes padülem, trajtë metatetike e palüdem, si dhe *kāl* lat. *cabalus*; det = *dēubetos*, - do të jetë përfitim i kontaminimit të disa silabeve që me zhdukjen e tyre kanë ndikuar në

kuantitetin e vokaleve të shkurtëra, krsh. Pekmezi, Grammatik der alb. Sprache, 49; N. Jokl, Studien zur alb. Etymologie und Wortbildung 1911, 15. Te një numër rastesh gjatësia e zanoreve të gjata do shpjeguar me rrugë kompensimi të gjysmë-zanoreve a të zanoreve të reduktuara të rëna, të zhdokura në pozicione fundore në pjesën më të madhe të të folmeve geqe, sikundër janë këta shembuj: p̄ik (pikë), b̄ot (botë), b̄or (borë), ār (arë), anē = aan = ān; r̄anē = raan = r̄an; në këtë mes do thënë se gjatësia e përfutur në rrugën e përshkuar në rasiat e zhdrejta shkon e ndërron duke u këmbyer në gjatësi të mesme: *r̄ana*, Gjurmime albanologjike 1962/1, ; 12-13.

2. Vendi i theksit në fjalë. – Kur është fjala për vendin e theksit në të folmen e kësaj zone, do thënë që te fjalët e theksuara në rrokjen fundore nga fillimi i rrokjeve, - theksi shkon e lëviz përbrenda rrokjeve të fjalëve; këtu kemi të bëjmë me fjalë me gurrë orientale, kryesisht turke me theks në rrokjen fundore: babá = bábë, kafé, Fatimé = Fatíme, pará = páre, penxheré, sadé = sáde.

Në këtë seri fjalësh bëjnë pjesë edhe një kategori fjalësh të tjera të burimit të vendit të të folmeve të këtij territori, që ruajnë theksin në rrokjen e parafundit, fjalë theksi i të cilave në gjuhën e përbashkët letrare shtyhet në ultimën, d.m.th. në rrokjen fundore: véri = verí; njéri = njerí.

3. Hundorësia e zanoreve. – Kërkimi i zanoreve hundore të të folmeve geqe, për arsye të laryshisë dhe për arsye të koklavitjes së tyre, na del një problem i vështirë dhe i ndërlikuar. Përveç buzorëzimit të *a*-së hundore, zanoret hundore të këtyre ligjërimeve të gjuhës sonë nuk na paraqiten gjithherë me të njëjtin intensitet të hundorësisë (Pekmezi, Lambertz, N. Jokl, Vuksalbanische Liedersammlung; St. Mladenov, Bemerkungen über die Albaner und das Albanische in Nordmakedonien und Altserbien, in Balkan-Archiv, I, 1925; G. Weigand, Albanesische Grammatik).

Hundorësia e zanoreve të të folmeve të zonës sonë dialektore në hetim ruhet mirë në përgjithësi, porse lidhur me të do të vërenim që zanoren *e*, në kundërshtim me të folmet e Shqipërisë Veriore, d.m.th. të

idiomave malësore si dhe të të folmeve shqiptare të Kosovës, - e gjejmë të çkundorëzuar. Çhundorëzimi i zanoreve është i shpeshtë në të folme shqiptare të Shestanit dhe Briskut- Cimohovski, *Le dialecte du Dushmani* f. 58; I. Ajeti, *Istorijski razvitak govora Arbanasa kod Zadra*, 70-73.

Lidhur me këtë çështje më parë do të dëshironim të hetonim zanoret hundore të kësaj zone dialektore, pastaj në përmbyllje, në përshtetje të rezultateve do të mundemi të gjejmë burimin dhe fillin se kur nxjerr krye shfaqja e çhundorëzimit të tingujve dhe kur nisin të dalin risi të tjera nga fusha e hundorësisë..

Pak më parë thamë se e folmja jonë ka ruajtur hundorësinë e tingujve me përjashtim të vokalit *e*, që në këtë ligjërime përgjithësisht na del si tingull gojor, dukuri jo e rrallë e të folmeve gege të gjuhës sonë (idiomat gege të Maqedonisë, e folmja shqiptare e Ulqinit, i kanë zhdukur tingujt hundorë). Për ligjërimet shqiptare të zonës në fjalë po sjellim disa shembuj, të shënuar në Rahovicë afër Preshevës: u bâ: sahati nâ:n; me m'thâ:n mue; do ta pini edhe një:: Azem e ka pās emnin; z guxoj kurgjâ me prëk; ni ç̣ik emja; kur t'ja lshōjm qenin.

Miratoc: jem kân; ish kân; kemi edhe një, s'e lā

Ranatoc: jam kâ:n; dhâ:n; kâ:n; thâ:n; a â rren; kur â kâ:n.

Çorroticë: ven(d) i (e gojore); kasha pas nëjt (e gojore).

Shushaja: jem një::; nizet e pēs (*e* orale) â kâ:n, nuk â kân; bânëm, si t'bohem këtu (*o*-ja nazale u dëgjua si *o* orale), â dhâ:n; pēm s'kam shti; dhen (*e* orale) ku e kena pās vendin (*e* orale); n'at budalli – n'at budallijen teme; aj mulli: ish kâ:n; bâhet gruni mīr, veçse me kâ:n mej cit; n'kta venet e tan; n't'shmajt; ish një mâ i ri; a â pūn kjo.

Samolicë: Baba masi â plague; pe di ci â kâ:n, ish kâ:n qeni I meçem (*e* orale); nuk âsht pūn dini; ish bâ: tevdil; tēsh e rân (= pūn e rân).

Muhoc: âsht lshu pi burgi; ni kâjk; jâm kthie.

Hundorësia e tingujve është njëra nga veçoritë më kryesore të të folmeve gege, kjo karakteristikë e tyre përftohet kur pranë vokaleve gjendet njëra nga konsonantet *n* a *m*, bie fjala: hânë, nânë, rand, randësi,

mullî-ni (nga latinishtja *molinum*), syri, tosk. Syri, pëni, tosk. pë, pe nga lat. *panum*.

Në të folmen tonë hundorësia e tingujve, me përjashtim të vokalit *e*, në përgjithësi ruhet mirë. Kemi përshtypjen se nga të gjitha vokalet *a*-ja na del më e qëndrueshmja në ruajtjen e hundorësisë; intensiteti i hundorësisë së tingujve të së folmes në hetim është më i ulët, siç ndodh në përgjithësi në vokalizmin e të gjitha të folmeve gege të zonës dialektore të Kosovës, pjesërisht edhe idiomat malësore të Shqipërisë Veriore.

Na interesojnë jashtëzakonisht shumë rrugët e mënyra e çkundorëzimit të tingullit *e* në të gjitha pozicionet; siç dihet, të folmet shqiptare të Kosovës nuk njohin një dukuri inovuese të tillë; çkundorëzim të tingullit në fjalë – është fjala për tingullin *e* – nuk kemi as në ligjërime të Malësisë as në të folme të tjera të Shqipërisë Veriore, krhs. M. Lambertz, Bericht über meine linguistischen Studien in Albanien von Mitte Mai bis Ende August 1916, in Anzeiger der Akademie der Wissenschaften in Wien, te po ai, Albanische Märchen, wien 1922; Tagliavini, Le parlate albanesi; W. Cimochoowski, Le dialecte de Dushmani, Poznanj, 1951; J., Gjinari, Vrejtje mbi të folmen e krahinave të Krasniqes, Gashit e Bytyçit të rrethit të Tropojës, Buletin i Universitetit, 1963/4; E. Lafe, E folmja e Nikaj-Merturit, Studime filologjike 1967/2; A. V. Desnickaja, Albanski jezik i jего dialekti, Leningrad 1968. Porse dijetari polak Cimochoowski në monografinë e tij të zënë ngoje sjell shembuj me tinguj të çkundorëzuar; kama, pl. kam-t; pëllām, tosk. pëllëmbë, lan, lana; tosk. lendë; (vepra e tij, f. 59-60). Edhe shumë ligjërimeve të tjera u mungon nazaliteti: fjala vjen dibranishtes, krsh. Visaret e kombit, bleu XXV – Fyelli i Dibrës, redaktuar prej Haki Stërmillit dhe Gl. Elezović, Srpski dijalektološki Zbornik, libri XI, 1950. Përsa i njohim dialektet shqiptare në Maqedoni, ne konstatojmë se pjesës më të madhe të tyre u mungon nazaliteti përkundër të folmeve të Lumës, Peshkopisë, Lurës, Mirditës dhe Matit, në të cilat nazaliteti përbën një nga cilësitë kryesore të tyre, krsh. Buletin i Universitetit shtetëror të Tiranës, 1963/4, 122; Buletin, 1962/2, 221. Lidhur me veçorinë e nazalitetit ne nuk mund të pajtohemi me mendimin e Tagliavinit që edhe mbarë

zonën dialektore të Gegërisë Qendrore dhe Verilindore e gjente të denazalizuar; izofona që dijetari italian e kishte hequr – Le parlate albanesi ... brenda së cilës ngërthente edhe të folmet shqiptare të Jabllanicës së Epërme, në Serbinë Jugore, si dhe ligjërimet e tjera të Kosovës formon në të vërtetë një hapësirë shumë më të ngushtë. Neve na e merr mendja se këtu kemi të bëjmë me çbuzorëzimin e zanores *a* të gjatë, si dhe me tingullin hundor *â*, që karakterizohet nga një shkallë e ulët e intensitetit, porse kurrsesi nuk mund të pranohet mendimi i buzorëzimit të plotë të tingullit në fjalë gojor *a* hundor, gjë që dëshmohet prej të folmeve në zonën e Preshevës e të Bujanovcit, që na tërhoqën vëmendjen mbi vetinë për të cilën po bëhet fjalë.

4. Këtu do të vëzhgojmë disa fjalë me zanore të patheksuara. Gati të gjitha të folmet geqe cilësohen nga vetia që tingulli i patheksuar apo i reduktuar, siç ka marrë emrin në linguistikën bashkëkohore tingulli i zënë ngoje, - është zhdukur krejtësisht nga të folmet që posa u përmendën; por edhe në qoftë se aty-këtu është ruajtur, ai nuk ka më atë shkallë të mbyllët shqiptimi siç na del zakonisht në të folmet e tjera dhe në gjuhën e përbashkët letrare. Vokali në fjalë ka rënë krejtësisht në pozicionin e tij fundor: *u* ba sahati nân; *z* guxoj kurgjâ me prëk; edhe *u*-ja e rrokjes fundore anon nga tendenca e rënies, siç dëshmojnë fjalët kumblla (kumbulla).

5. Zanorja *e* në rrokjen e theksuar në përgjithësi është ruajtur mirë, e vetëm në raste të caktuara kalon në diftong, sikundër duket në këto fjalë: kie (ke); plurali i ka-ut. Në të folmen tonë del kie (qe); kuantiteti i *e*-së në fjalën që është i gjatë, pastaj vokali *e* në pozicion pa theks me rrugë shpërqiellorëzimi është kthyer në *u*: qershî = qurshi, çurshi. Ne nuk do të ndalemi në adjektivet e njohura jo vetëm të këtyre ligjërimeve, por as të atyre idiomave geqe të Kosovës, në të cilat në vend të *y*na del vokali *i* hipi, zhdiri, mosha e *e*-së së këtyre rasteve është e madhe në pjesën më të madhe edhe të tjerave dialekte geqe, në anë tjetër edhe origjina e tingullit të fjalëve në hetim është e errët.

6. Megjithatë ndërlikueshmëria dhe ndërthurja e formave na imponon të merremi diçka më thellë dhe të ndalemi pakëz në vokalin *y* që

në dialektet në studim të zonës së Bujanovcit është shpërngulur përpara dhe e gjejmë vetëm si *í*. Sikundër dihet, shpërqiellorëzimi i tingullit *y* nuk është veçse në raste të rralla dhe sporadikisht cilësi e të folmeve të Shqipërisë Veriore si dhe e idiomave shqiptare të zonës dialektore të Kosovës. (N. Jokl, Vuksalbanische Liedersammlung; Kujundžić, Rečnik; Mladenov, Balkan-Archiv; Tagliavini, Le parlate albanesi, 47). Qiellorëzimi i buzorëzimit në të vërtetë është veçori i ligjërimeve të Shqipërisë Qendrore (Mati, Mirdita, Luma, Dibra dhe e disa të folmeve në Maqedoninë Perëndimore), Lambertz, Bericht über meine linguistischen Studien, 1916; Albanische Märchen, Vjenë 1922; Desnickaja, Gjuha shqipe dhe dialekti i saj, 1968; Skok; Lingvistička proučavanja, Godišnjak Muzeja Južne Srbije, 1941; Instituti i folklorit, Folklor shqiptar I; Proza popullore, II, Gl.Elezović, Južnoslovenski filolog, Beograd 1950; Buletin i Universitetit shtetëror të Tiranës, 1963/4; Studime filologjike, 1964/4; Lëkundjen e vokalit *y* nga ana e përparme e gjuhës dhe shqiptimi palatal i tij (*ɲ*) e kemi vërejtur në katundin Samolicë, që është në anën e djathtë të autostradës duke shkuar nga ana veriore në drejtim të Bujanovcit, ku i shënuam këta shembuj: *ati* (aty), u *kthin* (u kthyen), *qish* u dān (qysh u danë), *gjinah*, *shiqir* (=gjynah, shyqyr), *po kqiri* (po kqyri), veç për *ti* (ty), *kshir* ti (këqyr ti), *me kqir at mikin*. Në fshatra që anojnë nga Presheva, aq më rrallë ndeshet dukuria e zënë ngoje, të themi të vërtetën në Shushajë kisha dëgjuar vetëm njëherë një fjalë me *í*-në palatale në vend të *y*-së; *n'krie* tri vjet (në krye). Përkundër fshatrave të Preshevës, në katundin Tërnoc dhe në gjithë rrethin që administrativisht i takojnë Bujanovcit, ndeshëm këtë shfaqje; atë e kishim gjetur edhe në Muhoc: *kri* (kry, krye); *diher*; *kah sit*; *babgji*: *dí* muej, *dí* vjet, *t' misin* breshkat (mbysin); *dirt* (dyrt, dyert); po rrokna *me ti* (ty); *kam kthie* (këthye) me māt *kryp* (në bisedën e zonjës së shtëpisë të Karaçevës ku dukuria në fjalë nuk dëgjohej). Në lidhje me këtë shfaqje fonetike mbetet për t'u caktuar shtrirja e saj territoriale, gjë që, pas mendimit tonë, do të lehtësojë tipin e së folmes bashkë me përkatësinë e saj dialektore.

7. Diftongje dhe grupe vokaliqe. – Në vijim të këtij shtjellimi, do të

trajtojmë duke hetuar gjendjen e tanishme të diftongjeve dhe të togjeve vokalike të të folmeve në studim. Në të gjitha, - dhjetë a dymbëdhjetë fshatra që kemi vizituar – kemi përshtypjen se diftongjet ruhen mirë, porse mund të thuhet se anojnë nga thjeshtimi i tyre dhe tregojnë lëkundje të ndjeshme në përdorimin e tyre. Mbase mund të thuhet se përdorimi i diftongjeve na del shumë më i qëndrueshëm në gojën e brezit të vjetër, përkundër brezit të ri në shqiptimin e të cilit ato i gjejmë në një masë të madhe të thjeshtuara, siç na dëshmojnë këta shembuj: edhe u *kthye*; me m'thâ:n mue; kryeforti; me ja çue; bje ūj aty; me i marue njiqind dyer; e t me katundi; me fatue, nji tjetër, ka shkue; kercyelli, u idhnue; na qite kerrin n'prue; na z'dishmi m'i rujt; kemi me fatu; n'promet i kallxum, i bin aty dhit (shembujt u shënuan në Rahovicë, afër Preshevës); n'dash i duj, n'dash mos i duj (duej).

Ka interes të rrokët edhe çështja e diftongjeve dhe e togjeve zanore si dalin në katundin e Miratocit, në jug të Preshevës, ku shënuam fjalë me diftongje të reduktuara dhe të thjeshtësuara, madje edhe të diftongjeve të mirëfillta që ruhen edhe ndër dialekte shqiptare kur shfaqen tendenca të forta monoftongimi të diftongjeve të zakonshme të ligjërimeve, - është fjala për asimilime diftongjesh që na dalin në sistemin emëror dhe në atë verbal, - sikundër dëshmojnë shembujt: pa mël (mjelë); a ven (a vjen); niqin e pes vët (vjet); bëshk e madhe (bjeshkë); ata kan pëll (pjellë); si kemi rrëdh (rrjedhë); do të sjellim edhe disa fjalë nga përmbledhja: Proza popullore I, botim i dytë, Tiranë 1966, me material dialektologjik të vjelë në Lumë, Bicaç:kur kishin vu dorën n'mekërr (227); gjali si shpoi pallën e hekurit kish dhet vet (vjetë), 226; ven koha me gran dark (vjen), 226; pse nuk ven (vjen) para bukës; t'parvemen, te vemen e t'sivemen (= parvemen...). Lëkundje të madhe në punë të diftongjeve diktuam edhe në të folmen e fshatit Çorroticë, afër Preshevës: m'kan rrethu (= rethue); qysh kena me kapërcye; lypka me e pushkatu (pushkatue); me rroque; lidhur me diftongjet e mirëfillta do theksuar se ato janë ruajtur për mrekulli, si në katundin që posa u përfill ashtu dhe në fshatrat e tjera të kësaj zone dialektore: asaj *tjetrës*, edhe në fshatin Shushajë diftongjet si të mirefilltat

ashtu edhe ato të zakonshmet ishin ruajtur mirë, sikundër duket nga këta shembuj: po m'doken dyqin para *mue*; pesdhet *vjet*; po duhet me shkue dhe me e shkruë; une kâm rrnuë tri vjet; i kâm harrue; dy *vjet*; jan *kthye* pej *mue*; n'krie tre *vjet*; vjet ka qitun ajo "zadrugga", e kan mbjell; pi *mue*; kam mbjell; na ka vllaznuë. Në ligjërimin e Karadakut të Shkupit diftongjet i gjejmë të paprekura, ruhen shumë më mirë se në viset rrafshore të kësaj zone në të cilën kanë zënë të shfaqen elemente inovuese në fushën e diftongjeve: po fol me *mue*; allahi ta ruejt fillanikin; ka dëg e ka pjëk; për her t'par po *niej*; e mos me çue gat; kishna mujt me shkue; si jemi çue si ari n'kâm; Bjeshka ish ma zotni se Rrafshi; pa shkue me marr pare: aj duel i dyti; ty pjëk. E në Samolicë të Rrafshit të Preshevës shënuam këto fjalë që dëshmojnë zotërimin e diftongjeve: pi ngoj; m'kan *ngue*; baba mos â plague; me shkue; pse po i *thue*; u *pjekën* me *mue*; n'at zjarm kish marr trishtim e ngasmi, e nxjermi u kthin, puna po bje, u maruen di xhamia. Në katundin Muhoc kishim dëgjuar format e këtyre fjalëve: *kri* (krye) por me *mjekue*; *dirt* (dyert); kur i kena maru; di muj (dy muaj); di *vjet*; filli (fyelli); kish pa plagu; asht lshu pi burgi; jam *kthie*; sjellmi; rrugën mujm na memaru; jem dërmue; jam kthie; jam dele si t'bjen.

Në fund të shtjellimit të kësaj pike, po deshëm të bëjmë një përmbledhje ç'u tha deri këtu, do të thoshim se në punën e togjeve zanore nuk kemi një shqiptim të njësisshëm. Në ligjërim të Rrafshit të Preshevës, brenda në Preshevë si dhe në rrethin e saj dhe në rajonin e Bujanovcit nga togjet zanore *ae* ruhet elementi i parë, sikundër na del në këto raste: pse s'ja dhâ; ti m'dhâ, në të cilët shembuj nga togu zanor *ae*, me anë të rrudhjes u përftua zanorja *a*. një veçori e tillë nuk i cilëson të folmet e Karadakut të Shkupit, ku kishim shënuar këta shembuj: *voe*, po më *thae*; ti m'*thae*. Arsyet e kësaj dukurie fonetike do të kërkohen te pozicioni i theksit, që në qoftë se mëshimi i theksit është më intensiv në elementin e togut zanor, e elementi i dytë i tij ka ngelur pas dore, atëhere ky i dyti në fazën e parë do të reduktohet, dhe me kohë do të bjerë krejt; dhe anasjelltas, në qoftë se masa e theksimit do të bjerë sipër elementit të dytë, i pari me kohë do të rrudhet si e tregojnë shembujt e sjellë: *voe* = *vo*; *voe* = *vé*; të reja = *të ra*;

vajza të *ra; ngae = ngā: ngē*.

8. asimilimi i togjeve bashkëtingëllore *mb, nd* në *m* e *n* është njëra nga dukuritë e zakonshme jo vetëm e ligjërimit të zonës por edhe i idiomave të tjera fqinje, bie fjala: anej (andej) mlidhet, jâm mêt (jam mbetë); n'disa *vena* (vende). Ne kishim shënuar edhe shembuj të paasimiluar: mundet me pasun; *kndēna* =(këndena), kndej; me kta katundart.

Në dialektin tonë gjejmë edhe zhvillime protezash, sikundër na dalin në këto raste: Nji shoq i *jemi*; atje kishim dëgjuar edhe kësi shembujsh: një çik *e emja*; pastaj *japin* (apin) *jap* (ap). Nga fusha e sistemit verbal kishim ndeshur në këso shfaqjesh: në vend të rasteve të zakonshme *-im*, për vetën e parë shumës të prezentit dhe të imperfektit, dëgjuam mbaresën *-mi*: *dal-mi, shesmi, kishmi, qesmi, shohmi* (dalim, shesim, kishim, qesim, shohim), që do të jetë përfutur me rrugë analogjike për një pamje simetrike me mbaresën e vetës së dytë shumës të kohëve të zënë ngoje: dilni, shihni, shitni; ne kishim shënuar edhe disa shembuj me zhdukjen e tingujve në pozicione fundore të fjalëve: *jem'* një; qi *kem'* rrëdh; pastaj atje kishim dëgjuar edhe disa fjalë me zanore të sinkopuara, dukuri që përftohet si pasojë e thjeshtimit të zanoreve të patheksuara: kashore, kashatë; sinkopuara (kafshore, kafshatë, kafshoj), pej, pi << prej.

B. Konsonantizmi

9. Shtjellimin mbi sistemin e bashkëtingëlloreve e fillojmë duke rrokur okluzivet qiellzore dhe çiftet e tyre afrikatet paraqiellzore: *q : ç; gj : xh*. Që në fillim do theksuar se çiftet e përfillura, përkundër idiomave shqiptare të Kosovës, ruhen mirë në ligjërimet tona. Është kjo një e folme e rrallë e dialekteve geqe që i ruan të paprekura çiftet e okluziveve qiellzore dhe afrikatet paraqiellzore. Në qoftë se duam të kërkojmë arsyet e ruajtjes së bashkëtingëlloreve në shqyrtim, na duket se ato duan parë në rrethanën e konsistencës së tyre edhe në gjuhë dhe dialekte të popujve fqinj të kësaj pjese të Gadishullit Ballkanik: edhe të folmet maqedone paraqiten shumë të palëkundura në punën e ruajtjes së çifteve bashkë-

tingëllore dhe na dalin mjaft arkaike në pikëpamje të dallimit të tyre; as të folmet serbe të këtyre anëve nuk njohin për ngatërrim në mes çifteve bashkëtingëllore në hetim.

T'u kthehemi të folmeve shqiptare të këtyre anëve dhe lidhur me bashkëtingëlloret në studim, të sjellim disa shembuj nga radhët e tyre: Nji shoq i jemi; ja kish māj̄t qorri! po kqyr nam â bereqeti; i gjakut âsht atje; me qēth bletën; pērqind; çka po lyp; shumë âsht e meçme; do çika t'zoja; e kena çeshmen; xhade; per kēt xhade; n'idhnim t'hoxhve; u maruen di xhamia; mere shkopin e prishe xhamin; bira e guxhavet na i thomi: prej gjānave, gjak për gjaki. Përkundër kësaj gjendjeje që konstatuam në Rrafsh të Preshevës, në dialektet e zonave të Karadakut ne nuk dëgjuam as diktuaam diferencimin në mes të okluziveve qiellzore dhe afrikateve paraqiellzore: *q : ç; gj : xh*. Atje, sikundër duket nën ndikimin e të folmeve shqiptare të Kosovës, bashkëtingëlloret në hetim ishin trazuar, duke u reduktuar në një konsonant të vetëm, kështu në mes të çifteve *q : ç* dhe *gj : xh* sot nuk ka asnjë dallim në shqiptim: *kētu na hupi đaja; çysh jo, ka đēt šyçyr*, veçse me *kâ:n* me e çit; ka đēg e ka pjek; s'kishmi *çef* me na *pa^o* kush; ma đinsa jān femnat, shoçja jote, ather kish edhe kaçāk.

Lidhur me gjendjen e bashkëtingëlloreve të të folmeve të kësaj zone, ne nuk mund të mos shprehim mospajtimin me mendimin e lingvistit bullgar Stefan Mlladenov, Balkan-Archiv, I, 1957, që e mbronte edhe dijetari italian Carlo Tagliavini – Le parlate albanesi, 1942, f. 51-52, që për dialektin e Preshevës shënonte dhe sillte këta shembuj në të cilët në vend të *q*-së a *ç* përdorej vazhdimisht një *č*: *čen* (qen); *džak* (gjak); *džarpën* (gjarpën); *džasht* (gjashtë); *džims* (gjymse).

Sot s'ka kurrfarë dyshimi që natyra e konsonanteve në hetim është dyfishe, njëra palë e tyre janë qiellzoret eksplozive të tipit të maqedonishtes *ќ, ѓ* e çiftet e tyre për nga artikulimi janë identike me të maqedonishtes, *č-dž* në kundërshtim me idiomat shqiptare të Kosovës, që në punë të bashkëtingëlloreve në studim kishin zënë të preken, të tkurren duke u mbledhur në një tingull të vetëm. Nga dy tipa bashkëtingëlloresh *č:č* u mblodhën në një, në bashkëtingëlloren *ć*, sikundër që prej dy tipash *đ*:

dž u tkurrën në një afrikate të vetme –*č*, pra nga katër tinguj të ndryshëm u rrudhën në dy tipa bashkëtingëlloresh: *č:ž*.

Mungesa e dallimit të dy çifteve të afrikateve na del me një intensitet më të madh edhe në të folmet serbokroate të Bosnes dhe të Hercegovinës, të Dalmacisë, të Kroacisë, etj., sidomos për popullsinë e konfensionit mysliman të qendrave qytetare të Bosnjes. Për këto anë dy faktorë quhen me rëndësi në rrafshimin e çifteve të afrikateve: faktori historik, që do të thotë se në perioda të hershme të gjuhëve sllave mungonte dallimi i konsonanteve në shqyrtim, e ky dallim mungon sidomos në rusishten, në gjuhët e tjera sllave, si dhe në anën perëndimore të zonës gjuhësore serbokroate (D. Bajraktarević, Priština u govoru Srba starinaca, f. 52; Govorne osobine Gnjilana, Gjurmime albanologjike, 2 (61-62); Ivan Popović, Istorija srpskohrvatskog jezika, Novi Sad, 1955, f. 136; Mihailo Stevanović, Đakovački govor, Srpski dijalektološki zbornik, XI, Beograd, 1950).

Fiset shqiptare të Shqipërisë Veriore dhe ato malaziasë në rrjedhën e kohës kishin kushte e rrethana identike historike, kishin institucione të njëjta sociale dhe një bashkëjetesë të përbashkët, që në fushën e gjuhës sollën jo veç paralelizma gjuhësore, por popullsitë e tyre jetuan një simbiozë të fortë.

Po deshëm të shpjegojmë çrregullimin që na del në fushën e okluziveve qiellzore e të afrikateve paraqiellzore të kësaj zone, të themi të shpjegojmë çrregullimin në punën e rrafshimit të bashkëtingëlloreve në studim, për dialektet e gjuhëve të ndryshme të zonës sonë, - ne nuk mund të mos marrim në vështrim faktorin e ndikimit të shojshoqëm në mes të bartësve të gjuhëve të ndryshme të një etnikoni mbi gjuhën e etnikonit tjetër: Aty ne nuk dyshojmë më; porse si duken rrugët konkrete të asaj simbioze, do të ishte shumë interesante të rroken më për së afërmi e të fillohen në situata konkrete.

Duke hetuar dialektet shqiptare të Kosovës dhe monumentet e tjera të kësaj gjuhe, Gjurmime albanologjike 1/1962, III, 1966, kishim dëshmuar që dallimi i okluziveve qiellzore prej joqiellzoreve dilte njëra nga veçoritë e ligjërimeve të kësaj zone dialektore së paku në mbarimin e shekullit të

kaluar dhe fillimin e këtij tonit. Për të folmen shqipe të Gjakovës dëshminë e kemi te Vehbija e Tahir Efendi Boshnjakut nga fillimi i shek. XIX (I. Ajeti, Pamje historike e ligjërimit shqip të Gjakovës, Prishtinë, 1960, dy vjet më vonë studimi në fjalë del në serbokroatishten); për ligjërimin e Gjurakovcit në 30-vjeçarin e shekullit të shkuar veçoritë fonetike në fjalë vërtetohen nga përmbledhja e këngëve popullore të shënuara prej Vuk Karaxhiçit, që ja kishte diktuar murgu i Gjurakovcit Obadović. Fakti që në përmbledhjen e tij të zënëngoje Vuku përdorte dy tipa grafish të ndryshme, flet në dobi të ekzistencës së dyjesisë së qiellzoreve në gjuhën e përmbledhjes së këngëve popullore që posa u zu ngoje; nga njëra anë *ќ*, *ѓ* dhe nga ana tjetër *ć*, *đ*. Në fillim të këtij qindvjetëshi dallimin e bashkëtingëlloreve të përmendura të së folmes fqinje shqipe të Gjakovës e dëshmon Fjalori serbisht-shqip i Kujunxhiçit.

Tipat e qiellzoreve të përfillura ruajnë idiomat shqiptare të Pre-shevës dhe të Bujanovcit. Dallimin e okluziveve qiellzore prej joqiellzoreve e gjejmë edhe te e folmja shqipe e zonës së Rahovecit në fillim të këtij shekulli që e dëshmon “Divani” i Sheh Maliq Rahovecit, gjuhën e të cilit e kemi studiuar në punimin tonë: O jeziku Divana Sejha Milićja, “Gjurmime albanologjike”, 3 (1965, 1966).

Po deshëm të përmbledhim ç’u tha këtu, do të thoshim se, në mbështetje të gjendjes së tanishme të dijes si dhe në bazë të kërkimeve tona mbi tipat e bashkëtingëlloreve në fjalë të të folmeve në studim dhe të të folmeve shqiptare të zonës dialektore të Kosovës, treguam rrugën e zhvillimit që këto bashkëtingëllore kanë ndjekur dhe bëmë kronologjinë e çrregullimeve që kanë pësuar okluzivet dhe afrikatet e përfillura ndër disa idioma shqiptare. Ndikimi i ndërmjetëm i njëjës gjuhë në tjetrën, ka luajtur një rol të caktuar në punën e trazimit të okluziveve me afrikate në të gjitha të folmet shqiptare të zonës dialektore të Kosovës. Edhe më në fund, në qoftë se pranuar raportin e shojshoqëm të tyre si dhe ndikimin e ndërmjetëm të tyre në planin e bashkëtingëlloreve të përmendura, linguistin do ta interesojë se çfarë raporti kishin ato gjuhë në mes të tyre dhe ç’intensitet ishte ai që shkaktoi ndërrimet e përmendura fonetike të

njërës dhe tjetrës gjuhë.

Përsa i përket ndërrimit të bashkëtingëlloreve të idiomave të këtij regjioni, ne e kemi situatën të qartë; njoftimet tona ngjiten në kohë të kaluara të këtyre të folmeve dhe në dritë të tyre pasqyrohen bashkëtingëlloret e përfillura. Përkundrazi, për ligjërimet serbe të kësaj zone, çështja e proveniencës së bashkëtingëlloreve në studim dhe zhvillimi i tyre historik na del shumë i ndërlikuar: në cilat dialekte, sikundër edhe në cilat idioma shqiptare të kësaj zone, kemi reduktimin e katër palë bashkëtingëlloreve në dy lagje.

10. Përsa i përket hundorit mediopalatal *nj*, e folmja jonë nuk paraqet ndonjë farë ndryshimi nga të folmet e tjera të regjionit dialektor të Kosovës, prandaj as nuk ka arsye të veçanta që bashkëtingëllorja në studim të merret në shqyrtim. Me qëllim që të konstatohen se në cilat kategori gjuhësore janë shkaktuar këto apo ato ndryshime, që përveç zonës të së folmeve në studim, na dalin edhe në regjione të tjera të ligjërimeve gege, problemin në hetim do ta prekim edhe me këtë hov.

Dihet me siguri se qiellzorja *nj* është zhdukur në disa kategori të të folmeve tona, bie fjala, në sistemin nominal në pozicionin fundor: *zōj* (zonjë); *rrâj* (rranjë); *bâj* (banjë) etj. Është ruajtur mirë në sistemin foljor, d.m.th. në kategorinë e foljeve që nisin me këtë bashkëtingëllore: njoh, njeh, njazoj, pastaj një lagje emrash që me të fillojnë: *njeri*, *njerk*, *njerkë*, *njollë*, *i njomë*, porse thuhet *ni* e jo *nji*, por *nja*, *njani*. Në qoftë se duam të thellohemi edhe më në punën e zhvillimit të mediopalatalit në hetim, ai, përkundër shumë të folmeve shqiptare të Kosovës, (Kujundžić, Fjalori), në idiomën tonë nuk na del me tërime fonetike sikundër është ndërrimi i tij fonetik nga *nj*-ja në *ngj*: njoh = ngjoh; njeh = ngjeh; i njomë = i ngjomë. Porse na duket që kur shprehet një mendim i tillë është e domosdoshme të bëhet me masë të duhur dhe të paraqiten rezerva për bashkëtingëlloren përkatëse të idiomave të tjera të rajonit të Moravës së Gjilanit.

11. Në pjesën më të madhe të të folmeve gege spiranti grykor *-h* na shfaqet i ndryshueshëm: ka raste të shpeshta që konsonanti në fjalë të zhduket fare në pozicionin e rrokjes fundore, prandaj e gjejmë të arsyesh-

me të marrim nga ana historike. Të themi të drejtën, spiranti grykor as në ligjërimin tonë nuk na del aq i paqëndrueshëm, që përkundër idiomave të tjera gege të krahinave të gjera, të paraqitet me lëkundje të ndjeshme; por edhe vetë për atë fakt, të merret e të hetohet në këtë vis. Lidhur me të, mund të theksohet një veti e tillë që na del e përgjithshme për një rreth shumë më të hapët të të folmeve gege, është fjala për një prirje të tillë alternimi në frikativin dybuzor *f* kur gjindet në fqinjësi të dhemborit *t*, bie fjala: *e kam njoft; i ftoft; njohtja = njoftja; njoftim*, veti që ndeshet në pjesën më të madhe të të folmeve gege. Përsa i përket idiomës sonë në hetim, bashkëtingëllorja në fjalë është ruajtur sidomos në pozicionin nistor të rrokjes: do t'i *rrehe*; po mellim shum *duhan* (Rahovicë); *kur hinëm; kemi hī n'ōd; ather āsht kâ:n koha*; a pe sheh *cat hoxhën*, shoqja e *ustahit*; jân *rahatue* shti; *hajde*; si *t'bâhen; bâhet* edhe n'fush; *bâhet gruni mīr; allahi* ta ruejt fllanikin, kur të delni te shpia e *Hasanit*, shti po na *duhet* me rā edhe hina mrena; mirpo *z'duhen* kto me u përdör; pse po t'guxon aj me *hi?* për me u *fhēh*; s'po liftohet dōv e i lahi; aj ja grahi; kur gjendet në pozicione fundore të fjalëve, frikativi në studim humb shumë nga masa e frikacionit duke mos u dëgjuar në shqiptim: aj *nje(h)*, e tashti ajo s'po na *nje(h)*.

Në pjesën më të madhe të të folmeve spiranti grykor *h*, në përgjithësi, ruhet mirë edhe është i qëndrueshëm; megjithatë për disa ligjërimime, kryesisht toske, nuk mund të mos pranohet që vise-vise paraqitet i lëkundshëm, krsh. idioma e Korçës, pastaj dibranishtja, si dhe dialekti i Beratit, Skraparit, Myzeqesë dhe në disa vende të krahinës së Oparit sidomos viset e tij që shkojnë me Korçën. edhe nga e folmja e Semanit *h*-ja frikative në disa pozicione na del e dobësuar, vise-vise edhe e zhdukur fare (Buletin, 1957, 1), 1962, 1; Jorgji Gjinari, Dialektologjia shqiptare, f. 37-38. Përkundër dialekteve toske, të folmet gege, me përjashtim të idiomës së Dibrës dhe të disa ligjëtimeve gege, ruajnë një artikulation shumë më të qëndrueshëm tingujsh, me anë tjetër, edhe në ato dialekte hasim sporadikisht në raste të humbjes së frikativit *h* (I. Ajeti, Istorijski razvitak govora Arbanasa kod Zadra, f. 49-119). Lidhur me spirantin velar *h*, ne nuk mund të pajtohemi kurrsesi me disa mendime të një lagje albanologësh, që në

punimet dhe në studimet e tyre dialektologjike të shqipes gjejnë humbjen e spirantit *h* ndër fjalë në të cilat konsonanti në studim na del i domosdoshëm (J. Rrota, Monumenti mâ i vjetër i gjuhës shqipe, 1938, f. 13); L. Kujundžić, Srpsko-arnautski rečnik. Beograd 1902; C. Tagliavini, Le parlate albanesi, f. 42). Frikativi në studim paraqitet sporadikisht edhe në disa ligjërime shqiptare të Kosovës, madje edhe atje ku arsyet etimologjike nuk e kërkojnë, bie fjala: Hasim, Hasime në vend të Asim, Asimme, pastaj Heme, harushë, në të cilat fjalë frikativi *h* gjenetikisht është sekundar.

12. Në ligjërimin tonë ne nuk gjejmë kurrfarë arsyeje që të na shtyn te të hetonim bashkëtingëlloren likuid *-rr*. Ai na del i qëndrueshëm; çifti i tij është *r*-ja e çiftet në fjalë paraqesin veti të dallueshme në sistemin verbal të shqipes. Me kaq ne do të kënaqemi, sepse nuk shohim ndonjë arsye që të thellohemi në çështjen e përfillur. Po kjo vlen edhe për bashkëtingëlloret *l-ll*: *l*-ja qiellzore dhe *ll*-ja grykore. Edhe tingujt – spirantet ndërthembore *th-dh* ne i njohim të qëndrueshëm dhe me një konsistencë stabile.

HISTORIA E GJUHËS SHQIPE
(Morfologjia historike)

HISTORIA E GJUHËS SHQIPE

(Morfologjia historike)

Në studimet e tyre historike, respektivisht etimologjike, sa i përket shqipes, albanologët kishin rrokur kryekëput Problematiken e fonetikës historike të kësaj gjuhe që bënte pjesë në ndërmarrjen e tyre me dimensione të mëdha të hetimeve të tyre etimologjike indoevropiane. Në këtë përpjekje të dijetarëve linguistë problemet e morfologjisë historike kishin mbetur, me gjithë gjasë, pas dore; ato në këtë kompleks studimesh kishin një vend të dorës së dytë, marginal dhe sporadik.

Megjithatë ato vise-vise rrihen prej albanologëve, siç janë F. Boppi, G. Meyeri, P. Pedersen e Jokli. Kohët e fundit studimeve morfologjike, megjithëse qëndrojnë në periferinë e interesimit të tij, E. Çabej u kushton kujdes të veçantë. Në një mënyrë më të hapët i ka kapur këto probleme dijetari austriak G. Meyeri duke dhënë një traktat gangullor mbi shumësin e emrave të shqipes: *Die Pluralbildungen der albanesischen Nomina* 1883. Disa dekada para studimit të përfillur më lart, themeluesi i studimeve krahasimtare Franz Boppi kishte rrokur në një syzim të vetin disa probleme të morfologjisë historike të gjuhës shqipe, duke u përpjekur t'i caktojë kësaj vendin në rrethin e meseve të tjera indoevropiane (*Das Albanesische in seinen verwandtschaftlichen Beziehungen*, 1854). Në rrjedhë të kohës albanologu austriak N. Jokli, shpjegoi një vistër çështjesh nga lëmi i morfologjisë historike të gjuhës shqipe. (*Beiträge zur albanesischen Gramatik – Der Akkusativ – Nominativ und der Geschlechtswechsel im Albanischen – JF 36* (1916) – 98-164). Para tij, në mbarim të shekullit XIX, indoevropeisti dhe albanologu danez Holger Pedersen shtroi problemin e pronoreve dhe të artikullit të gjuhës sonë: *Das albanesische Neutrum*, KZ 32 1894, (283-291), *Die Guturale im Albanesischen* KZ, 36 (1900), 277-340; Festkrift til Wilhel Thomsen; *Les pronoms démonstratifs de l'ancien arménien*, Kopenhagen, 1905 (*Les pronoms albanais*, f. 13-14) 315-316.

Nga ana e linguistëve shqiptarë, përveç E. Çabejt, problemet në

shqyrtim i hetojnë letrari e filologu Mjeda: *Vrejtje mbi përemna pronës të gjuhës shqipe*, Shkodër, 1934; dhe Selman Riza: *Diftorët e shqipes dhe historiat i tyre*, Prishtinë, 1953; *Pronorët e shqipes*, Buletini 1959/2,3; 1960/3; *Emrat në shqipe: Sistemi i rasavet dhe tipet e lakimit*, Tiranë, 1965.

Edhe pse në fushën e morfologjisë historike të gjuhës sonë na del shumë më i madh numri i problemeve që mbeten për t'u zgjidhur se sa ai i atyre që janë shtruar, në mbështetje të punës së kryer deri më tani, krahas me atë që mbetet për t'u gjurmuar nuk mund të quhet e pavend përpjekja e rrahja që të bëhet një sintezë rezultatesh të përkorta në fushën e morfologjisë historike të shqipes.

GJINIA E EMRAVE

Kategoria e gjinisë, që në këtë gjuhë na del tripalshe, është tipar i rëndësishëm morfologjik që dallon emrat e gjuhës shqipe: *mashkullorë, femërorë* e *asnjanës*.

Përpos gjinisë, emrat bashkë me mbiemrat i karakterizon në anën tjetër kategoria e numrit, e lakimit dhe e shquarsisë. Do theksuar që në fillim se gjinia asnjansë është reduktuar në një numër të vogël emrash. Kur marrim të dallojmë a të veçojmë gjinitë e kësaj gjuhe, na del punë bukur e vështirë, sidomos kur rrahim të japim një syzim fillzhvillimi të tyre historik. Më parë e më dalë është udhë mjaft e zorshme t'i dilet në krye çështjes së lakimit të gjinisë së gjuhës shqipe, kur mbështetemi në tinguj fundorë të temave të tyre, ashtu sikur veprohet zakonisht në disa gjuhë të tjera indoevropiane.

Për emrat e gjinisë mashkullore mund të thuhet se ata zakonisht dalin me temë në bashkëtingëllore, bie fjala: *krah, katund, lis, trup, gëzim, gjarpër, vesh, gjak*, që dikur, në periodën indoevropiane, përkatësisht romake përfundonin me një mbaresë tjetër tematike, që me kohë shkoi e ra fare. Fjala *gardh*, që është e trashëgimisë indoevropiane, krahasuar me të latinishtes *hortus*, na del pa mbaresën rasore indoevropiane, ekzistencën e së cilës na e dëshmon shprehja e sipërme latine *hortus*, si dhe *ductus*. Do ditur, pra, që hiq mbaresën fundore të emrave indoevropianë në *a* të gjatë, mbaresat e tjera të asaj periode nuk kanë lënë në shqipen farë gjurme, e kjo do të thotë që në rrjedhën e kohës kanë rënë duke mos lënë kurrfarë shenje në emrat mashkullorë të gjuhës sonë. Vetëm a-ja fundore, siç u theksua, në gjuhën shqipe është paraqitur me vokal të reduktuar e jo në emra mashkullorë, por në femërorët.

Në anën tjetër kur vështrojmë problemin e mashkullorëve të shqipes, nuk do harruar një gjë se në këtë gjuhë ndeshim edhe sot e gjithë ditën emra mashkullorë me mbaresë fundore më -ë: *djalë, burrë, ujë, brumë, gjumë*. Dijetari danez Pedersen, këto fjalë e shumë të tjera që në shqipen mbarojnë më -ë fundore i shpjegoi si të gjinisë asnjansë, e ato fjalë shqipe që me siguri janë të burimit latin i qiti gjithashtu të gjinisë asnjansë, duke i vërtetuar të asaj gjinie edhe në latinishten -*Das alb. Neutrum*, KZ. 32, fjala

lat. *rete* (Neutrum) dhe edhe në shqipen *rrjetë* me të njëjtën gjini në shkrimet e klasikëve të vjetër shqiptarë. Po kështu *voj*, *vaj* (këta voj) nga *oleum*; nga fondi indoevropian kemi *bhala* < *ballë* (këta ballë). Mendimi i Pedersenit në kohë të fundit u tumir nga Çabej, Gjon Buzuku, në Buletin, 1955/3, f. 40.

Asnjanësi në gjuhën shqipe

Përveç dy gjinive të njohura të mashkullores dhe të femërores, në gjuhën shqipe ruhet një numër i konsiderueshëm emrash e mbiemrash të gjinisë asnjane. Përdorimi i asnjanesit ishte shumë i përhapur në shqipen e periodave të hershme. Në rrjedhën e moteve kjo gjini, të shumtën, shkoi e u kthye në mashkullore a femërore. Emrat a mbiemrat që dikur na dilnin asnjane, sot i ndeshim të dalë vetëm në mashkullorë a femërorë.

Asnjanesit e shqipes u takojnë disa kategorive semantike e gramatikore, siç janë:

- a) emra lëndësh: *mish – mishtë(ë), drithë – drithtë, miell*
— *mielltë- djathët, dyllët, grunët, gjalpët, leshtë, vojt – vajt*;
- b) mbiemra të substantivuar: *të kuqtë, të bardhët* e vesë, *të zitë* (e ullirit), *të thatët* (=verdhëza);
- c) pjesore në formë mbiemrash të substantivuar: *të ardhurit*
— *të ardhunit, të nisurit – të nisunit, të larët – të lamit* a *të lanit*;
- ç) emra të tjerë të veçuar: *kye-t, ballët*.

Dijetarët albanologë, Hahni dhe Meyeri, në asnjanesin shikonin shumësa të zakonshëm, pse si njëra si tjetra palë dilnin në mbaresën *-t, të*, që ata i njihnin shumë. Mirëpo, mbaresat e asnjanesit – edhe pse mbarojnë me *-të* nuk mund të quhen plurale, sepse në rasat e tjera të zhdrejta kthehen e marrin mbaresa të gjinisë mashkullorë a femërore. Përkah burimi neutri i shqipes është asnjane i vjetër e për pasojë vazhdim i neutrit indoevropian. Tëfillimin e kësaj çështjeje ia detyrojmë arushanit danez Holger Pedersenit, që provoi ekzistencën e asnjanesit në gjuhën shqipe.

Në studimin e posapërmendur – *Das Albanesische Neutrum*, KZ, 32 (1894), 283-291, albanologu dhe keltisti i njohur danez Holger Pedersenit,

mbi dëshminë e materialit leksikor të shqipes me burim latin provoi përputhjen dhe përkimin e neutrave të latinishtes, huazuar në gjuhën shqipe: *vaj-voj* (asnjanës) marrë prej latinishtes: *oleum* (Neutrum), *rrjetë – rete*. Nga shkrimet e klasikëve shqiptarë të shekullit XVI e tëhu ky përkim në gjini i asnjansit të shqipes me të latinishtes na del shumë më i madh: *lini*, tosk. *liri* nga latinishtja *linum*; ar: *aurum*. Në të folmen e arbëreshve të Kalabrisë na del asnjansë edhe fjala *argjent*, *argjend*, e te Arbëreshët e Greqisë edhe shprehja *elb*.

Numri i asnjansëve nga fondi i trashëgimisë autoktone, siç na provojnë shkrimet e klasikëve shqiptarë si edhe dialektet arkaike të shqipes, dikur ishte shumë më i madh se në ditët e sotme: *ujë-t*, *mish-të*, *drithë-t*, *gjalpë-t*, *mjaltë-t*, *lesh-të*, *elb*, *brumë*, *ballë-t*, *gjalm-t*. Emrat e gjinisë asnjansë sot të shumtën janë kthyer në mashkullorë, sporadikisht edhe femërorë për arsye të pjekjes së tyre në lakim me mashkullorë a femërorë: *mish-i*, *gjalpë – gjalp-i*, *vaj– vaj-i*, *dyllë – dyll-i*, *ujë – uj-i*, *drithë–drith-i*. Emrat e gjinisë asnjansë, siç dihet mbarojnë me bashkëtingëllore: *mish*, *lesh*, apo me *-ë* (*ujë*, *gjalpë*).

Është krejt afër menç që gurrën e gjinisë asnjansë ta qesim prej asnjansëve të vjetra indoevropiane të shumësit që mbaronin me *a*, e dihet fort mirë që mbaresa *a* e gjatë në gjuhën shqipe do të jetë reflektuar me *e* në e reduktuar: *ë*, për çka mund të mbështetemi në shumësin e asnjansit latin: *templa*, si dhe në sllavishte: serbokroatishtja *seno*: *sena*, *selo*: *sela* (ta sela, tavrata, tookno: ta okna). Në këtë mënyrë u përzie shumësi me njëjës dhe i pari i lëshoi vendin të dytit.

Mashkullorët me *ë* fundore që u zunë ngojë më lart, Jokli i shpjegoi ,të dalë nga akuzativi që me kohë u shtri edhe në nominativin Singular (*Indogermanische Forschungen* 36, 98-158). Në këtë mes duhet shtuar edhe disa arsye të tjera që përligjin kuptimin e këtij lloji akuzativi në nominativ, pra ky shpjegim nuk është i vetmi që mund të jetë i mundshëm, sepse emrat si *djalë*, *gjumë*, *lumë* (tosk.) e *burrë* mund të rrjedhin pjesërisht prej neutrash të vjetër e femërorësh (abstraktë, kolektivë) e pjesërisht janë forma analogjike (Çabej, *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe*, Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, 1960/4).

Janë të gjitha gjasat që të gjitha huazimet e burimit lashtë- grek, latin

që në ato gjuhë kanë qenë neutra, në gjuhën shqipe do të jenë pasqyruar me të njëjtën gjini, mirëpo, me kohë, shkuan e u tëmuan gjinish, ashtu që ata emra hynë në gjuhën shqipe prej gjuhësh të tjera si neutra, sot të shumtën janë mashkullorë a femërorë. Porse në këtë mes huazimet e gjuhës shqipe me gurrë sllave e rijogreke duan veçuar prej huazimeve lashtogreke a latine, që posa u zunë ngoje, sepse asnjansit sllavë a rijogrekë në gjuhën shqipe nuk u pasqyruan me neutra, bie fjala *seno*: shq. *sa- në* (f); *korito*: *koritë* (f); *Dobro selo*: *Dobërsellë*, *Dobërsella* (f); nga të greqishtes: *trëndafille*: *τριανταρίλλου*. Sipas një gjykimi të dijetarëve albanistë neutrat e gjuhëve të tjera në gjuhën shqipe janë përfaqësuar me neutra deri në shekullin V të epokës sonë.

Më këto pak fjalë u shpjeguan një numër i vogël mashkullorësh me zanoren e reduktuar fundore – *burrë* e të tjera, pse morfologjikisht duhej të kategorizoheshin në femërorë, porse, për arsye që u zunë ngoje, ata bëjnë pjesë në kategori mashkulloresh.

Në gjuhën shqipe të klasikëve shqiptarë, formimi i emrave abstraktë nga mbiemrat asnjans ishte produktiv dhe i zakonshëm: *të bardhët* (ë), *të zitë* (sa të zitë e thoit), *të zitë* e ullirit, *të bardhët e vesë* (voes), *të madhtë*, *të njehunit*, *të keqtë*, *të naltëtë*, *të gjanëtë* (Bogdani). Formanti që hyn në punë në formimin e substantivave prej mbiemrave në vend të atij që posa u zu ngoje, sot na del kësisoji: *lartësi*, *gjerësi*, *mirësi*.

Një tubë emrash që tregojnë veprim formohen prej pjesoreve të adjektivizuara asnjansë: N' *së dashunit* së botës sanë. (Buzuku); i *të shkruemit* shejtë (Bogdani). Porse në kurriz të këtyre emrave të prejardhur që njihen jo të mirëfilltë, në këmbë të tyre, kanë marrë zhvillim të plleshëm emra foljorë me formante – *im*, *esë*, *je*, *afrim* (afroj) *bashkim* (bashkoj), *burim* (buroj), *peshim* (peshoj), *mësim* (mësoj), *rrënim* (rrënoj), *mërzim* (mërzej), *durim*, *duresë*, *shtim*, *shtesë*, *kujtim*, *kujtesë*, *harrim*, *harrësë*, *ngarkim*, *ngarkesë*, *ndërtim*, *ndërtesë*, *lëshim*, *lëshesë*, *shkrim*, *shkresë*, *shartim*, *shartesë*, *shtim*, *shtesë*, *fillim*, *fillesë*, *mbulim*, *mbulesë*, *lejim*, *leje*.

Formanti – *im* i emrave të përmendur tregon vetë veprimin, ndërsa ai me *-esë* rezultatin e veprimit.

Në kategorinë e mashkullorëve duhet rreshtuar edhe disa fjalë që mbarojnë me zanore të theksuara, bie fjala: *bari-u* që emitologjikisht do

afruar te shprehja *bëruo*, *bruo*, *i-ja* e së cilës është element i ngjitur bukur vonë, siç na dëshmon ruajtja e a-së së pa- theksuar që s'pësoi reduktim, sikur ka ngjarë në *bëruo*. Kjo fjalë përdoret në gegërishte dhe është emër kolektiv: *bari-a* (*çobani-a*, *çobanë-ria*) e kjo rrethanë na tregon se kjo është e pajisur me sufiks femëror të emrave abstraktë dhe kolektivë, prandaj *baria* duhet të jetë në thelb një emër abstrakt a kolektiv që në rrjedhën e kohës shkoi e ndërroi gjininë. Nga ana e kuptimit mbështetemi te *kalori* (kalorësit), *pari* (të parët) *grani* (gratë).

Përsa u përket femërorëve do theksuar se tema e tyre del zakonisht më zanore: *grua*, *nuse*, *faqe*, *lule*, *dele*, *magje*, *qerre*, *gëlqere*, *qime* (e~<ã), pastaj më – ë (nga indoevropian.: a>ë: *zo- një*, *dorë*, *kokë*, *udhë*, *urë*, *unë*, *degë*, *pulë* nga lat. *pulla*, *koritë* prej sllav. *kopyto*, nga *seno* > *sanë*. Një numër emrash femërorë që sot me të vërtetë mbarojnë më konsonant, dikur përfundonin më zanore të reduktuar ë: *andërr* (andërrë); *motër* – (motërë), *votër* (votërë). Femërorë janë edhe ata emra që dalin me zanore të gjatë fundore *i*: *shtëpi*, *dhi*, *mushkëni*, *mushkëri*, *vllazëni*, *vëllazëri*, *trimni*, *trimëri*. *burrni -a*, *burrëri*, *njerëzi*, *mirësi*, *pleqni*, *pleqëri*. Për një numër të emrave të sipërm do thënë se që në krye të herës na ishin me kuptim abstrakt a kolektiv, që, të shumtën edhe sot e gjithë ditën e ruajnë atë kuptim: *njerëzi* (shumë njerëz, tok njerëzish), *burrëni* (mbushullim burrash): në këta emra kemi një individualizim a singularizim të kolektivit. Në zanoren *i* femërore të gjatë do shikuar një sufiks femëror. Në një tok emrash femërorë zanorja fundore e theksuar do marrë ndryshe: si kontraktion zanoresh, bie fjala te: *ve-ja* nga *voe-ja*, *nge* prej *ngae*, e-ja e gjatë e theksuar do gjykuar si përfitim i mbledhjes a shkrirjes së togut zanor *oe*, respektivisht *ae* në *e* për efekt të shpërnguljes së theksit që rrinte mbi elementin e parë nga fillimi i fjalëve.

Në gjuhën shqipe kemi edhe gjininë asnjane, megjithëse të sjellë në një numër të vogël emrash. Ajo, siç u zu ngoje këtu sipër, në kohë të shkuara kishte përdorim shumë më të shpeshtë se sot. Nuk ka nevojë të rrokim përsëri problemin e kësaj gjinie, nga se shpjegimi që u dha pak më parë, është i mjaftueshëm për njohjen që duhet të kemi mbi problemin në shoshitje.

Formimi i shumësit të emrave

Pekmezi, një ndër të parët gjuhëtarë që na ka lënë një gramatikë të mirë të kësaj gjuhe, thotë se formimi i shumësit në gjuhën shqipe paraqet larmi të madhe formash (*Gramatik der albanesischen Sprache*, 1908 f. 87); kështu shprehet edhe K. Cipo në *Gramatikën shqipe*, 1949, 51, ku thekson: „Të formuarit e emërores shumës paraqet në shqipet laryshi të madhe trajtash. Kjo larmi kapërcen çdo kufi kur është puna për formimin e shumësit të mashkullorëvet". Këtë vështirësi të gramatikës shqipe e vë re kohën e fundit edhe Leonard Newmark në gramatikën e vet: – *Structural Grammar of Albanien*, Bloomington (Indiana), 1957, f. 41.

Lidhur me këtë çështje të gramatikës së shqipes pajtohem në përgjithësi me mendime të shprehura, porse duhet theksuar se shumica e emrave të gjinisë mashkullorë, pse atje shfaqen trajta të ndryshme plurali për një emër të vetëm, dalin me një formë shumësi që gjendet e përhapur të shumtën ndër të folmet e shqipes e si e tillë është marrë duke zënë rrënjë në gjuhën e shkrimit.

Në anën tjetër, nuk mund të mos pranohet gjykimi i disave që mendojnë se në gjuhën shqipe është një numër jo i vogël emrash, të shumtën mashkullorë, që na paraqiten me dy, tri, katër, herë-herë edhe pesë forma shumësi, p.sh.: *çoban*: pl. *çobanë, ço- bana, çobanër, çoben, çobenë, çabanër, çobenj*; *BARK*: pl. *barka, barqe, bargje, berqe*; *BISHT*: pl. *bishta, bishte, bishtër, bishtra, bishtre, bishtrinj*; *BUJK*: pl. *bujq, bujqër, bujq (ë) ra*; *DJALË*: pl. *djel, djelm, djem, djema*; *DJEP*: pl. *djepa, djepa, djepër, djepëra*; *DOKTOR*: pl. *doktorë, doktora*; *KOMUNIST*: pl. *komunistë, komunista, komunistër*; *OFICER*: pl. *oficerë, oficera*. Kjo trajtë përfshin shumicën dërmuese të të folmeve, qoftë geqe a toske, ajo rrok mbarë ligjërimet geqe dhe të shumtën e idiomave toske, siç rezulton nga studimi i hollësishëm i dijetarit të ri gjerman Wilfred Fiedler mbi gjurmimet e shumësit në gjuhën shqipe. Studimi në fjalë është fort i dobishëm, pse na jep një syzim mbi shtrirjen e formave të pluralit të një numri të madh emrash mashkullorë e femërorë, siç na paraqiten ndër të folme të ndryshme të shqipes dhe në gjuhë të shkrimtarëve. Gramatikanët tanë këtë vepër do ta kenë parasysh sa herë që marrin të peshojnë se cila

prej disa formave të pluralit të një emri do parapëlqyer, porse kriteri i përhapjes së trajtave në punën e vendosjes do të ketë rol vendimtar.

Shumësi i mashkullorëve

Formantet më të njohura që hyjnë në punë në formimin e shumësit të mashkullorëve janë këto: *-e*, *-i*, *-a*, *-ë*, e përveç tyre ka edhe të tjera që hyjnë në përdorim në punën e shumësit të mashkullorëve të gjuhës shqipe, që do të përmenden në shqyrtimin e sistemit të lakimit të gjuhës shqipe.

1. *Shumësi në -e*. Formantin *e* në plural e marrin një varg i mire emrash mashkullorë të gjuhës sonë; e marrin këtë prapashtesë zakonisht ata emra mashkullorë që në singular përfundojnë në *-ira*, (*shkrim*, *-e*, *pushim* *-e*, *këndim*, *-e* pastaj *kând*, *kënt*, *kënde*, *kânde*; *vend*, *-e*. *komb*, *-e* *themele*, *-e*, *varr*, *-e*).

Këtë lloj emrash e shquan një dukuri shumë interesante, që qëndron në ndërrimin e gjinisë së njëjësit në shumës të mashkullorëve të vargut posa të përfillur: *vend i bukur* – *vende te bukura*, *mall i mirë* – *mallra të mira*. Gramatikat tradicionale të shqipes si dhe albanologët e tjerë përgjithësisht emrat në diskutim i emërtojnë zakonisht me termin *ambigjini*, *ambigjen*; një lagje tjetër dijetarësh, emrat në shqyrtim i quajnë heterogjenë; gjuhëtarët rumunë këtë kategori emrash e konsiderojnë asnjansë, si dhe gjuhëtari italian Bonfante që emrat e tipet *l'uovo* – *le nova* i quan asnjansë.

Po deshëm t'i sillemi burimit të fenomenit të kësaj lagjeje emrash, na bien në sy dy gjëra, e para, ndërrim gjinie pësojnë ata emra, që në përgjithësi emërtojnë jofrymorë, e dyta, ndërrimi i gjinisë së kësaj kategorie emrash në njëjës mashkullorë e në shumës femërorë duket i qartë nga gjinia e mbiemrave që përputhen me ta: *mali i lartë*, – *i naltë* – *malet e nalta*.

Në punën e ndërrimit të gjinisë së kësaj kategorie emrash në shqyrtim duhet pasur parasysh fakti se jo të gjithë emrat jofrymorë paraqiten të tipit heterogjen, ata do të kushtëzohen prej pranisë së disa mbaresave të caktuara të shumësit: ndërrimi i gjinisë në gjuhën tonë vihet re pikësëpari te ata emra jofrymorësh, që në shumës dalin me formantin *-e*, pastaj aty

hyjnë edhe ajo lagje jofrymorësh që në shumës marrin mbaresën *t* të pluralit *-ra* (geg. *-na*), sporadikisht edhe ata emra që sosin në mbaresën *-a*. Po të mos plotësohen këto dy kushte s'ka ndërrim gjinie ndër emra, bie fjala mashkullorët: *burrë – burra; viç – viça; derr – derra* si emra frymorë të seksit mashkullor në shumës nuk pësojnë ndërrim gjinie. Shumësat me formant fundor në *-e*, siç duket në të folme çamërishte nuk na dalin me ndryshim gjinie: *korbe, urithe, vëndëse, nëpunëse*, ndërsa, siç dëshmojnë përrallat e vjela nga vetë Pederseni në dialektin çamë emrat e jofrymorëve do të pësojnë ndërrim gjinie: ato *llafe*, të tjera *vende*.

Përhapja e kësaj dukurie në disa gjuhë ballkanike i shtyu gjuhëtarët ta shikojnë këtë fenomen si tipar të përbashkët që shpie te një burim. K. Sandifeldi – (Linguistigue Balkanique), këtë dukuri e gjente të pronës së shqipes, të rumanishtes dhe të italishtes; disa linguistë gurrën e kësaj dukurie e kërkonin në substratin trak; një lagje sish burimin e saj e shihnin te latinishtja popullore; një palë tjetër gjuhëtarësh e qitnin të ardhur si një zhvillim paralel të atyre dy gjuhëve.

Fenomeni i ndërrimit të gjinisë së emrave në shumës duhet të jetë relativisht i vjetër në gjuhën shqipe, porse mosha e tij nuk mund të jetë aq e madhe sa të mendojmë ndikim të ardhur nga latinishtja.

Ndikimi i latinishtes mbi strukturën gramatikore të gjuhës shqipe, siç dihet, ka qenë minimal, mbi çka Pederseni ishte shprehur duke provuar mungesën e pranisë së ndikimit latin mbi fleksionin e shqipes; këtë mendim e tumiri me një rezervë fare të vogël edhe Çabej.

Për të vërtetuar vjetërsinë e kësaj dukurie të gjuhës shqipe bashkë me Shaban Demirajn e quajmë të arsyeshme të ngjitemi në kohë deri në mesjetën e hershme, në kohën paraletrare të shqipes, fenomen që na del që të shkrimtarët e vjetër veriorë: Buzuku, Budi, Bardhi, Bogdani, Kazazi: *këso fajesh* (faj-i), *petëka të bardha* (petëk-u), *ujënatë të mëdha* (ujë-të) me të forta *burgje*; mbi *malet e nalta*; (Buzuku); *ujënatë të mëdha*; për dy vjet *t'ungjina*; *gazmendetë e para*; *hire të panjefuna*, e të mira; me sa tjera *lëngime*; (Budi); *ato burgje*; unë dhashë *urdhënimet jo të mira* e me ato *kujtime fort të mira – Istorijski razvitak geg. govora Arbanasa kod Zadra*, I. Ajeti, 99 – *Studime filologjike*, – 1966/4.

Mbi dëshminë e materialeve dialektologjike provohet për bukuri një

tendencë a prirje e fortë e përdorimit të heterogjinisë ndër emra mashkullorë të gjuhës sonë; porse ndër dialekte shqiptarë toske e gege dukuria e heterogjinisë ku më shumë e ku më pak na del me lëkundje e luhatje, Studime filologjike, 89, – 90, I. Ajeti, *Ist. razv. gov. Arbanasa kod Zadra*, 89).

Përsa i përket gjuhës së shkrimit, dukuria e heterogjinisë në këta shekujt e fundit, me pak përjashtime, ka zënë të shtrihet gjithnjë e më shumë në shkrimet e autorëve gegë e toskë. Ky fenomen, siç u vërejt pak më parë, na del që në kohën paraletrare. Fenomeni duket te emrat asnjans me mbaresat e shumësit *-ra* (*ujëna*, *-ujëra-të ftohta*, *ftofta*) si dhe te ata mashkullorë që në shumës përfundojnë me mbaresën *-e*, janë këta emra foljorë të sajuar me prapashitesën *-im*, që janë formuar prej foljesh me *-oj*, *-uej* (*uaj*), *e-ej*, që tregojnë një veprim ose rezultatin e tij: *ligjërimet populllore*; *burime të ftofta*; *përparime kolosale*, mandej te emrat mashkullorë abstrakte të parmë (*zakone të vjetra*), *kuvende populllore*, *ato llafe*, *ato male*, *ato bereqete*, *ato zijafete*, *ato habere*.

Po deshem të hetojmë çështjen e lindjes së fenomenit të heterogjinisë, d.m.th. kalimin e emrave mashkullorë të tipave të caktuar të tyre në femërorë nuk mund të mos pranohet mendimi i G. Meyerit që këtu sheh tendencën e përgjithshme dhe relativisht me moshë të madhe të gjuhës shqipe për zhdukjen e „vijës së kufirit" ndërmjet gjinive të emrave që tregojnë jofrymorë. Mendimi i Pedersenit që zanafillen e këtij fenomeni e sheh të emrat e gjinisë asnjansë, duke mohuar mundësinë e ndikimit të mbaresave të shumësit në ndërrimin e gjinisë nuk na del i plotë, megjithëse përbën një kontribut të rëndësishëm për zbërthimin e problemit. Në vijim të këtij shtjellimi do theksuar se zhvillimin e kësaj prirjeje në gjuhën shqipe do ta kenë favorizuar dy faktorë kryesorë të natyrës fonetike dhe gramatikore.

Shtimi i madh i tingujve fundorë të fjalëve ka ardhur duke e vështirësuar gjithnjë dallimin e gjinisë së emrave të jo frymorëve në gjuhën shqipe; faktor tjetër vendimtar merret veprimi i analogjisë që luajti rol të ndjeshëm në integrimin e shumë emrave asnjansë e mashkullorë në gjininë femërore të shumësit, bie fjala mashkullorët, mbaresa e të cilëve në shumës përfundon me *-e*, në pjesën më të madhe të ligjërimeve të gjuhës shqipe janë kategorizuar në gjininë femërore nën veprimin e analogjisë: *lëngje*,

male, vende, gëzime, bekime – janë sajuar sipas modelit të femërorëve: *nuse, dele, katundare*.

2. *Shumësi në -a*. – Formanti *a*, siç dihet, është parashtesë plurali e femërorëve për origjinën e të cilit mendimet e dijetarëve nuk pajtohen. Formanti në fjalë, në rrjedhën e kohës ka zënë e ka dalë edhe ndër mashkullorë si shenjë plurali duke u shtrirë me të madhe në pjesën më të madhe të folmeve gege, sporadikisht edhe në ligjërimi popullore toske: *derr-derra; burrë-burra; krimb, krymb-krimba, krymba*; e kjo prapashtesë në këtë tip mashkullorësh zuri vend dhe u stabilizua mirë. Një shenjë gramatikore nga përdorimi i gjatë dhe familjarizimi i folësve me të, me kohë, siç thotë Çabej, mund të bëhet i zbartë dhe të dobësohet në kuptim të rrëgjimit të tij si karakteristikë dalluese e shumësit, në këmbë të të cilit merr e shtrihet një mjet tjetër gjuhësor. Nga fusha e fleksionit nominal të gjuhës shqipe mjafton të përmendim vetëm fundorin *a* të pluralit të *profesora, doktora, shofera, ministra, oficera, studenta* në vend të formantit të hershëm *-ë*: *oficerë, studentë, profesorë*, etj., që me ndjenjën gjuhësore të folësve të kësaj gjuhe kishte zënë të dobësohej dhe të humbaste kumbimin e mjaftueshëm fonetik dhe ekspresivitetin e duhur.

Duket se kalimi i formantit *a* të femërorëve shumësisë të mashkullorët do të jetë bërë nëpërmjet emrave mashkullorë që në njëjës mbarojnë me *-ë*, siç janë *burrë, djalë*, pastaj të emrave mashkullorë të gjinisë gramatikore, porse femërorë përkah trajta: *babë-baba, Kolë-Kola, gegë-gega, toskë-toska*.

Përsa i përket burimit të formantit *-a* në shqyrtim, duket që ai u përftua nga fundorja e temës *-ë* dhe prej *e-së* prapashtesë e shumësit, siç janë nxjerrë nga Krasis: grimcat përemërore: $m + e = ma$; $të + e = ta$; njashtu *burrë + e = burra*, që u përhap edhe të emrat e tjerë.

Formanti në studim u gjet te mashkullorët që shënojnë qenie të gjalla (nëpunës – pl. – nëpunësa).

3. *Shumësi në -ë*. – Edhe kjo prapashtesë na del e për- bashkë për shumësin e mashkullorëve dhe të femërorëve. Ajo duhet të ketë ardhur nga formanti *-a* i vjetër indoevropian, që mund të afrohet te neutrat e latinishtes: *templa* (templum).

Ë-ja fundore e shumësit të mashkullorëve dhe femërorëve në të

shumtën e të folmeve gege nuk dallohet nga shqiptimi i njëjësit ku ajo nuk del: *puntor –puntōr, katundar – katundār, fajtor – fajtōr*. Në lidhje me këtë mungesë ndryshimi në shqiptim të emrave të përmendur, nuk mund të lëmë pa theksuar një gjë, që në ligjërimet gege që posa u trajtuan, te ky tip i emrave singulari prej pluralit shquhet edhe për atë se formanti *-ë* fundor në shumës nuk shqiptohet, porse dallimi do të bëhet me anë të kuantitetit të vokalit të silabës fundore: *një fajtor: shumë fajtōr; një zemrak: shumë zemrāk; një bukurosh: shumë bukurōsh;*

4. *Shumësi në -i*. Formanti *-i* që na del shumë shpesh në shumësin e mashkullorëve, sot nuk duket më në shumësin e pashquar, por e ndeshim vetëm në shumësin e mashkullorëve të shquar.

Po deshëm të hetojmë gurrën gjenetike të kësaj prapashtese, na duket se ky formant nuk na del i kryehershëm, si na dalin prapashtesat e tjera me anë të të cilave formohen shumësat e mashkullorëve.

Fjalët e çdo gjuhe formohen prej komponentësh të ndryshëm bashkëtingëlloresh e zanoresh që shpeshherë dalin të një shqiptimi herë të volitshëm, herë pak a shumë jo të lehtë. Prandaj këtu duhet kërkuar shtigjet që shpien te lehtësimi shqiptimor.

Kur ndeshen dy vokale njëri me tjetrin, atëherë në gjuhë shfaqet prirja për lehtëshqiptim, prirje që në gjuhësi njihet me emrin jo diftong, hiatus, për mënjanimin e të cilit ndërhyjnë bashkëtingëllore antihiatizuese, siç janë konsonantet: *j, v, h*: siç duket në këta shembuj: *një museje, një pune, disa çupave, disa djelme-djeme, lahem, kapem*; në mes dy bashkëtingëlloresh që përbëjnë një grup tingujsh pak a shumë të vështirë për t'u shqiptuar, zhvillohet një zanore anaptiktike, përkatësisht ndërhyjnë vokali *-i*, që vendoset ndërmjet temës nominale dhe mbaresës; në gjuhën e sotme të shkrimit, siç dihet, ndërhyjnë në pozicionin që u tëfillua pak më parë vetëm vokali *-i*, përkundrazi në shkrimet e vjetra të shkrimtarëve veriorë, veçanërisht te Buzuku shfaqet edhe vokali *-u* alternativisht me anaptiksin *i*; pra *i : u*: Matrënga: *ndër barku; Buzuku; mbë barkut, mbë pellëgut, ndë tjeskut*. Anaptiksi *-u* me funksion mënjanimi të pengesave e vështirësive shqiptimore të tingujve ndër fjalët të gjuhës sonë, shkon krahas me anaptiksin *-i*, njësoj, siç rrinë kundruall njëra tjetrës nyjet e prapme që përdoren në sistemin nominal të gjuhës shqipe: *i-u*.

Është mjaft vështirë të përcaktohen në mënyrë. të saktë rrethanat në të cilat futen në përdorim vokalet anaptiktite *i-u* për kohën e vjetër – dhe vetëm *i-ja* për kohën e re në gjuhën shqipe. Kur merren në vështrim arsyet që anaptiksin e sollën dhe e vendosën ndërmjet temës nominale dhe mbaresës, nuk mund të mos tumiren shkaqet që shqiptimin e fjalëve të gjuhës sonë ta bëjnë sa më të lehtë.

Po deshëm t'i sillemi këtij problemi më për së afërmi e të përpiqemi t'i caktojmë kategoritë nominale të shqipes që marrin *i-në* e përfillur anaptiktike, do të thoshim, pa pasur farë pretendimi të thellohemi në këtë çështje dhe të nxjerrim rezultate të mëdha e drejtimdhënëse, që anaptiksin *i* e ndeshim të emrat që përfundojnë me prapashtesa: *-ës, -as*, mandej te ata që në shumës e zgjerojnë temën me *-ëz, -ën, -er*, bie fjala: *shkundësit, tundësit, bishtatundësit, prishtinasit, njerëz-it*; anaptiksi duhet të ketë ndërhyrë edhe te emrat që mbarojnë me *k, g*, që këtu e pandehim me vjetërsi të madhe, përndryshe do të jetë vështirë të shpjegohen arsyet e palatalizimit të velareve; bie fjala: *plak, shteg, zog-pleq, shtigje, zogj*, megjithëse arsyet e këtij palatalizimi kërkohen më të drejtë te ekzistenca e dikurshme e një *i-je* në fjalën fundore të kësaj kategorie nominale që shkaktoi qiellzimin e velareve përkatëse.

Këtu, në këtë kategori emrash duhet të hynte edhe *shok*, me plural *shokë* me mungesën e palatalizimit të velarit *k* dhe *q*, për çka mendojmë se format *shok e shokë* janë sajime të reja, e trajta e parë e tyre ka qenë *shoq*, si përdoret të shumtën e herës ndër ligjërime geqe ku *shok* nuk na del kurrkund dhe ku janë në përdorim *shoq: shokë* (fonetakisht *shōk*); *shoq* na del krejt në rregull me fonetikën historike prej asaj të latinishtes *socius*, pra *shoq e shokë* si plural do të jetë formuar analogjikisht me *duej: daek* (një duek – shumë duej). Anaptiksi shfaqet edhe te ata emra mashkullorë që mbarojnë me dy bashkëtingëllore nga të cilat ajo e fundit një grykore – velare, *peshk – peshqit, turk – turqit*.

Një prapashtesë shumësi e mashkullorëve që del ndër ligjërime geqe njësoj në singular e plural në *-i*, nuk është gjë tjetër veçse një-*ij* dalë prej-*inj* e krahasueshme me prapashtesën *-yne* të lituanishtes e në *-inium* të latinishtes si në *sterquilinium* (grumbull pleh). Prapashtesën e pluralit *-inj* apo *ënj*, që në gjuhën shqipe del veçanërisht në singular në *-i*, Jokli e lidhi

me *-inium* të ilirishtes, në emra visesh, siç është *Delminium* pranë etnikut *Delmatae*, krhs. apelativin gegë *delme*, mandej *Ulcinium*, shq. *ulk*; për origjinë ilire të prapashtesës së shumësit shprehej edhe P. SKOK.

Një kategori emrash formojnë shumësin me prapashtesën *-inj-ij, -enj-ej, -enj-ej*, siç janë emrat: *drapën, drapër, pl. drëpenj, drëpej, drapëra, drapna, drepna; gjarpën, gjarpër, pl. gjarpij, gjarpërinj; lum, lumë, pl. lumenj, lumej; kunat, pl. kunet, kunetij, kunetinj; ari, pl. arij, arinj*.

Një tubë emrash mashkullorë që mbarojnë me *-ll, në shumës likuiden -ll e kthejnë në -j, fjala vjen: buell, buall: buej, buaj; shuall, shuell: shuaj, shoje, mashkull: mashkuj, meshkuj; ungjill: ungjij; thëngjill: thëngjij; qiell: qiej; dell: dej turtull: turtuj; pyll: pyje, pyj*.

R- j. Një varg i vogël mashkullorësh likuidën *r* në shumës e kthejnë në friktivin *j*, për shembull: *bir-bij; lepur-lepuj*, por edhe *lepura; flamur – flamuj; duar-i, duer-i – duaj, duej*; kalimi i *r* në *j* përligjet edhe nga fonetika historike e shqipes: *varzë-vajzë*.

Konsonanti *-n* që vjen fill pas një vokali i të gjatë kthehet në *-j*. tosk. *-nj*; frikativi *-j* që gjendet pas vokaleve të gjata *i, u* zakonisht zhduket; *mi: mijë (mij)* huazuar prej të latinishtes *-milia*; *bri, brij* (fonetikisht *brī*) – *brij, brinj; kushëri – kushërij* (fon. *kushërī*); *kufi – kujij* (fon. *kufi*); pastaj *thua, thue – thoj; ftua, ftue – ftoj, ftonj*.

Sipas ligjeve të vjetra fonetike të gjuhës shqipe një *-i* në silabën fundore duhet të ketë ekzistuar në pluralin e fjalëve: *dash: desh; rrath: rreth; thak: thek, thekë; mëzat: mëzet; tar: ter: tarak: litërak, litrak, taroç*, në shumësin e këtyre shprehjeve kemi metafoninë e shkaktuar prej veprimit të *i-së* së silabës fundore. Fjalët e përmendura këtu sipër, siç shihet nuk ruajnë më në trupin e tyre kurrfarë gjurme të ndonjë *i-je* të hershme, mirëpo fonetika historike e ka provuar që moti se në një kohë të lashtë gjuha shqipe duhet ta ketë pasur, përndryshe nuk do të kishte si të shpjgohet dukuria e kahershme e metafonisë.

Prapashtesën *-ën (-ër)* që e gjejmë te disa mbiemra, siç janë: *i shkurtën, i shkurtër* (lat. *curtus*); *i shtrembën, i shtrembër; i verbën, i verbër*; pastaj tosk. *i kaltër* (lat. *caltha*) e që u ngjitet edhe një vargu emrash mashkullorë: *breshër, gjarpën, krahën-krëhër*, pastaj *dimën, dimër, emën, emër*, sipas mendimeve të dijetarëve albanologë na del me burim të ndry-

shëm. Ēn (ēr) -in e palës së parë të fjalëve, G. Meyeri e gjen të ardhur prej një prapashtese indoevropiane *-en, -on*: kurse te lagjja tjetër e mashkullorëve sipas këtij dijetari, ruhet prapashtesa indoevropiane – *men*. Grupit të parë i shtohen edhe *prehën, prehër; kulpën, kulpër* (kurpën) *arbën, arbër*.

Në një numër shumë të kufizuar mashkullorësh përdoret prapashtesa e burimit turk *ler, -llar*, që është formant plurali i turqishtes: *babë – ballarë; hoxhë – hoxhallarë; pashë – pashallarë; sheh – shehlerë*.

Në fund të këtij vështrimi mbi formimin e pluraleve të gjuhës shqipe, do t'u sillemi disa emrave që sot në gjuhën shqipe përdoren si singulare e që historia e gjuhës na dëshmon se ata në kohë jo aq të largëta ishin pluralë. Këtij shqyrtimi po ia nisim prej shprehjes shumë të përdorur: *vis, pi. vise*, me kompozitat *amvise, mjedis*, te Buzuku *vjedmis*, formë e asimiluar e *mjedvis*. Studimet e vona e kanë treguar se emri *vis*, që bën pjesë, siç u pa në disa kompozita, do të jetë, me gjithë gjasë, plural sot i singularizuar i fjalës *vend* (E. Çabej, *Arb. vise und die singularisierten plurale im Albanesischen*, – Lingua Posnaniensis, 1958– 1960, VII – VIII).

Këtu kemi të bëjmë pa dyshim me një alternim nga fusha e morfologjisë, pra kemi një zhvillim të brendshëm të shqipes që ka urë për t'u shpjeguar sikur na provon fjala *mish* që ngjan të jetë e afërt me atë të latinishtes *mensa*, të sllav. *meso*, pra *en+s* do të jetë ndërruar në *-i*, në *mish*; në fjalën *vis*, prej *vend*, vokali nazal e me të kaluar në *-i* njëherazi është denazalizuar, siç na vërteton edhe një shprehje tjetër nga shqipja: *rë*, ku *e*-ja nazale me të luajtur vend nga fillimi del errët që do ta ketë humbur karakterin nazal.

Duke vijuar shqyrtimin e kësaj pike mjaft interesante nga fusha e morfologjisë po rreshtojmë edhe disa shembuj të tjerë duke u rrekur që fjalët e sjella të sqarojnë ndërrimin e *a*-së në *e*, që do të thotë metafonizimin e *a-së, në -e*.

Në gjuhën shqipe sot ndeshet fjala *thek-thekë* si singular me pluralin e vet *thekë*: me vështrim *xhufkat, tufat* e një petku, qilimi a perdje, që Çabej me të drejtë e lidh me fjalën shqipe *thekën*, tosk. *thekër*, të cilën përkah burimi linguistët e huaj e bien të ardhur nga latinizma *secale*, ndërsa dijetari shqiptar, siç u vu re këtu sipër e qas te *thak, thek* duke i

konsideruar të dy fjalët *thak*, *thekë*: *thekën*, *thekër* me mbaresë plurali *-ën*, *ër*, identike edhe nga ana kuptimore: *thak*: 1) *thakët e grurit*; 2) halat e kalliut të grurit; 3) në thekun e zemrës në thelbin e zemrës (Çabej, *Lingua Posnaniensis*, VII-VIII). Duke vështruar metafoninë në gjuhën shqipe, shumë të përhapur e në fjalë të tilla duke vërejtur plurale të singularizuara, Çabej e shton numrin e tyre në studimin, që u zu ngojë. Këtu po i paraqesim disa shembuj: Në *gjedh* (më) *gjedhe* (f) si sheh një plural të singularizuar nga një arketip *-gadh* duke e mbështetur te fjala *gjeth* që Jokli e kishte qitur prej një forme ma të vjetër *gath*.

Edhe në fjalën *pter-i*, *ter-i* me kuptim dem: *lopa mori terë - u mbars*; *mëzat ter - mëzat i patredhur*; te *ter*, *mëzat*, pasqyrohet shfaqja e metafonisë *a – e*, pse ajo lidhet pa farë dyshimi me *tarak*, *tareç* që ndeshet edhe me këtë trajtë fonetike *terak* (Jabllanicë); fjala bazë, pas kësaj analize, na del *tar* që me kthimin e *a-së* në *e* do konsideruar singular i hershëm, e *ter* plurali i dikurshëm që në rrjedhën e kohës mori e u singularizua në ç'vështrim është sot në përdorim. Në këtë kuptim do shpjeguar edhe shprehja e gjuhës shqipe *bredh-i*. Në qoftë se kësaj fjale duam t'i gjejmë formën përkatëse me *a* në trup të saj që të përligjej trajta tingullore me *e* si plural i lashtë e në kohë të vona kthyer në singular, – në gjuhën shqipe një forme të tillë me *a* nuk mund t'i biem ndesh. Për fat forma e hershme e singularit bën pjesë ndër ato fjalë të pakta me burim shqiptar që u shtrinë nga gjuha shqipe në rumanishten në një periodë të mugët të zhvillimit të kësaj gjuhe, kur lidhjet e këtyre dy gjuhëve ishin më të ngushta e pjekjet e tyre të pandërmjeme. Në gjuhën rumune fjala shqipe ruhet në trajtën *brad*, shumësi *braz*. Analiza e një numri fjalësh në gjuhën rumune me gurrë shqipe, siç janë *zară* nga shqipja *dhallë*; *vjezura* prej shq. *vjedhull*; *barză* (*kanjushë*), huazuar prej shqipes *bardh*, na dëshmon se forma e vjetër e rumanishtes që do t'i ketë prirë kësaj të sotmes *brad*, do të ketë qenë *braz*, çka është krejtësisht në rregull me fillzhvillimin e atyre huazimeve të rumanishtes me burim shqiptar që përmbajnë një spirant të tashëm ndërthëmbor *dhe* e që historikisht del prej një guturali palatal të vjetër. Fjala *bredh* në gjuhën shqipe, në analizë të fundit, do të jetë plural i singularit të dikurshëm *bradh*.

Te De Rada haset *Vlem' e Maljsorëve – Lega dei Montanari* që s'kemi si ta shpjegojmë ndryshe veçse me metafonizimin e *a > e* e

njëkohësisht me kthimin e pluralit në përdorim të singularit, pra nga *vëllam* – *vllam-vllami* (pobratimstvo). Po ky shtek do rrahur edhe në punën e tfillimit të femërorës *hepe*- 1) plasë; 2) maja e majës, te Bashkimi e Busetti = *caverna*, në Mirditë fjala jonë mban vështrim serb. *pukotina*, *napuklina*; Lambertz Rib- *pukotina*, *naprslina*, rascep te Nopsca (*Geographie und Geologie Nordalbaniens*, 1929); në Mirditë emër katundi: *Hepe* – *Hepja*; *prvue*: *Uj-Hepe*; e Gazulli sing *hep*: 1) plasë, 2) maja e majës. – *më ra brisku në hep të drrasës*. Që të dyja dalin nga *hap-i*, singulari i hershëm.

Ndër dy format: *shkrap-i*, sh. *shkrapa* me vështrim *akrep* çfurk dhe *shkrep-i*, sh. *shkrepa*, s'ka dyshim se forma primare njihet ajo që në trup mban vokalin *-a*. Në vazhdim të kësaj analize po i zëmë ngojë edhe dy a tri fjalë nga fusha e pluralit të singularizuar.

Po marrim në shqyrtim disa sosh: *duaj*, *duej*; *muaj*, *muej*; *i huaj*, *i huej*. Mundim të madh u kishte qitur studiuesve frikativi fundor i fjalëve të përmendura. Që të tria i janë shtuar nga kërkimtarët albanistë, vargut jo aq të madh të emrave që dalin me temë në *-on*, mirëpo, konsonanti *-j* në këto fjalë vëzhgimtarëve u qitte punë e nuk ia dilnin dot në krye ta shpjegonin. Është krejt afër menç që së paku *muej* – *muaj* të qasej te shprehjet që shfaqin idenë e periodës përkatëse kohësore në shumicën e gjuhëve indoevropiane: lit. *menuo*, got. *'mena*, gjerm *Monat*, shq. *muej*, *muaj*. Në këtë mes do thënë edhe një gjë tjetër, që fjala shqipe *muej*, *muaj*, pl. *muej*, *muaj* nuk mund të lidhet kurrsesi me ata emra të gjuhës shqipe me temë në *-on*, siç janë *ftue* – *ftua*, pl. *ftoj* a *ftonj*; *përrue*, *përrua*, pl. *përronj* *përrenj*; *thua*, *thue*, pl. *thonj* (thoj); *krua*, *krue*, pl. *kronj* (kroj, kroje); *vargue*, *vargua*, pl. *vargonj* (vargonj), pse sikur shihet qartë, këta emra në shumës përfundojnë me *-nj* (në geg. me *-j* prej *-nj*), ndërsa që të tria fjalët *muej*, *duej*, *i huej* mbarojnë me *-j* fundore në të gjitha të folmet e gjuhës shqipe. Ky është indic që na drejton të kapim shtigje të reja në kërkimin e burimit të fjalëve në shqyrtim. Mendojmë se Çabej (*Lingua Posnaniensis*) ia ka dalë në krye t'ia gjejë gurrën fjalës *duej* – tosk. *duaj* kur thotë se fjala jonë në studim do konsideruar si plural i singularizuar, i dalë prej *dueri duari*, sikur te *varzë*, *vajzë*, me *-ri* >*j*.

Sipas të gjitha gjasave fjala *thekën* tosk. *thekër* nuk do nxjerrë prej asaj të latinishtes *sécale*, pse nuk mund të kapërcehen shumë vështirësi të

natyrës fonetike në përgjithësi, kurse shtegu i burimit vendas të kësaj është i hapët. Kjo shprehje do afruar te plurali i dikurshëm *thek=thakë*, krh. vështrimin e saj: -thakët e grurit, halat e kalliu të grurit (*Fjalori i gjuhës shqipe*); mbaresat -*ën*, -*ër* duhet konsideruar sufikse pluralesh, aq të shpeshtë në gjuhën shqipe.

Po kështu duhet gjykuar edhe sufiksi i pluralit në fjalën *vargën*, tosk. *vargër* (pl. vërgenj) – *vargës*, *vërgar* geg. *vergâ-* dash a cjan i patredhur (Fjalor i gjuhës shqipe), *dashi vargnuer*; format me -*ën* përkatësisht -*ër* pandehet të ketë dalë prej *varg* me shtimin e prapashtesës sufiksale -*ën*, -*ër*, ndërsa *vërgâ-ni* do të jetë pa dyshim, zhvillim i pluralit të dikurshëm *vargën* sot singularizuar. Arketipi i të gjitha trajtave në shqyrtim është forma – *varg*, që në rrjedhën e kohës pësoi ndryshime, qoftë me shtimin e prapashtesave sufiksale, qoftë me shpërnguljen e theksit.

Plurale të singularizuar duan konsideruar edhe këta emra, *telloznë* (tatim), *gurra* e së cilës do kërkuar te fjala e greqishtes *telos*; *tellozna* është plural formuar përbrenda shqipes dhe kthyer në singular. Në këtë varg pluralesh të singularizuar hyjnë emrat: *bashlinë* nga turq. basli = gjilpërë me krye nga plurali i gegërishtes *bashlinë*; pastaj *verzën*, *verzna* (f) sh. *verzna-t* (pjesa e anijes që qëndron brenda n'ujë – Fj. i shqipes). Po kështu duhet shpjeguar edhe fjalët tona: *godì* – *në*, pl. *godina* – *t* (me burim sllav, nga *po-goditi*); *ndodhine-a*, *mbeturinë*, *shkretinë-a*, që të gjitha plurale të singularizuara. Shumësa të sjellë në njejës duan trajtur edhe disa emra të sferës bimore me sufiksa -*nje*: *frashën -frashër*; *ilnje-ilqe*; *shelk-shelqe*; *shelnje*: *dushk-dush-nje*; *mushk-mushnje*. Sufiksi i përmendur i pluralit -*nje* përdoret me shumicë në arbërishten e Zarës, bie fjala, *gjel-pl.gjelnje*, *gardh- -gardhnje*; *kol-kolnje*. Janë për t'u vënë në dukje edhe disa emra të gjuhës shqipe nga fusha e toponimisë që mbarojnë me sufiksin -*at*, që linguistët e qesin të ardhur nga fondi i trashëgimisë indoevropiane dhe e gjejnë të përdorur ndër emra fisesh ilire: -*ates*; fjala vjen *Delmates*, *Labeates*; ja disa fjalë nga toponimia: *Filat*, *Zhylat*, *Dukat*, *Deshat* (Çabej – L. Posn. VIII).

Një numër jo i vogël emrash nga ana e toponimisë dhe të apelativave të pajisur me sufiksin -*et*, ngjan të jetë origjine latine a italiane, bie fjala: *Kallmet*, *Qerret*; *Shpërdhet*, *shkozet* (shkorret, pyll shkozash), *kashnjet*

(pyll gështenjash) – krh. Çabej, vepra e përmendur). Kur marrim e vëzhgojmë toponiminë dhe antroponiminë duhet të kemi kujdes të veçantë që edhe në këtë fushë kërkimesh ndeshim emra që duhet marrë si plurale të singularizuar me ç'rasë duhet t'i shterim të gjitha mundësitë e gjurmimit të tyre të brendshëm e vetëm pastaj të hidhemi në terrenin e krahasimeve të jashtme.

Shumësi i emrave femërorë

Formantet e pluralit të femërorëve na dalin shumë më të thjeshta, pa farë lëkundjesh të mëdha si i gjejmë te mashkullorët që posa i shqyrtoam. Formantet më të shpeshta të femërorëve janë: *-ë, -a*.

Mbaresat rasore të gjuhës amë-indoevropiane, madje as vokalet fundore të asaj gjuhe, në gjuhën shqipe nuk kanë lënë farë gjurmësh, më përjashtim të vokalit *-a* fundor të femërorëve, që në gjuhën shqipe u pasqyruan me *-ë*-në neutrale.

Formantet më të përdorura të emrave femërorë të pluralit në gjuhën shqipe na dalin *-ë, -a*. Për origjinën e formantit të parë të vokalit neutral *ë* që shfaqet në shumësin e femërorëve duhet të pranojmë, sipas të gjitha gjasave, se kemi të bëjmë me shkrirjen e vokalit neutral të temës *ë* dhe të vokalit tjetër *-e* të pluralit e që, në instancë të fundit mbaruan me një *ë* të përbashkët dhe mori funksionin e formantit të pluralit të femërorëve. Nëpërmjet të një zhvillimi të komplikuar shkuan e sosën me një formë të vetme për singular e plural ata femërorë që hyjnë në kategorinë e emrave që përfundojnë me *-e*: sing, *lule-pl. lule*. Për burimin e *a*-së si formant plurali, që na del te femërorët dhe mashkullorët, u bë fjalë pak më parë kur shqyrtoam këtë prapashtesë me qëllim që ta shpjegojmë origjinën e saj: *punë* – pl. *punë*; *vajzë* – pl. *vajza*.

Në këtë mes e quajmë të dobishme të rrokim këtu dy femërorë që kanë peshën e tyre në morfologjinë historike të gjuhës shqipe: *natë, ditë*, pl. *net, dit*, që sot hyjnë me kategorinë nominale të femërorëve me temë të hershme në *-a*; këta femërorë që na dalin me shumësa të parregullt ka mundësi që t'i vendosim për kohën e lashtë në një tubë emrash me temë në *-i*, që në rrjedhën e kohës shkaktoi me veprim të metafonisë te *natī*, në shu-

mës *net*, po kështu edhe nga një e hershme *ditī*, na rrodh *dit*, ku *i*-ja fundore nuk kishte si të kthente *i*-në e silabës së parë në një *e*, që prodhoi *e*-në nga *a*-ja te fjala *natë* (*natī*). Femërorët e tashëm, *natë-ditë*, për arsye që u dhanë këtu, në perioda të hershme të historisë së gjuhës shqipe nuk mund të thuhet të kenë qenë të kategorisë së femërorëve me temë në *-a*; porse, sipas të gjitha gjasave, duhet të kenë bërë pjesë në tipa nominalë me temë në *-i*.

Shumësi i femërorëve *duar*, *duer* – është përftuar prej diftongimit të vokalit *o* te singulari *dore*, fjalë me gurrë autoktone, e trashëgimisë indoevropiane: ghëres; nga diftongimi i *ē*-së në *ye* rrjedh edhe shumësi i *dyer* nga *derē*.

Lidhur me këtë fushë kërkimesh do vënë re se të gjitha zanoret fundore që hasen sot ndër emra të gjuhës shqipe duan marre sekondare, apo të dala prej diftongjeve, për pasojë edhe nyjet e prapme *-i*, *-u* etj. po i konsideruam të vjetra, do t'i marrim të përftuara nga diftongje.

Mbaresat rasore nominale kanë lidhje të ngushtë me sistemin e nyjeve të gjuhës shqipe: njëherë sistemi nominal i gjuhës sonë pikënisjen e vet e ka te sistemi i nyjeve që në këtë gjuhë zuri të gjinikohet si rezultat i dobësimit dhe i zhdukjes së plotë të sistemit rasor të periodës indoevropiane në këtë gjuhë. Përfundim bën mbaresa rasore e emërores njëjës të femërores që në gjuhën shqipe na del me *-ë*, e që duhet të përqaset te *a*-ja e lashtë e periodës indoevropiane që në gjuhën amë indoevropiane përdorej si mbaresë rasore e emrave me *-a* të gjatë fundore. Fundorja e përfillur shkoi e u kthye në vokal neutral *a* të reduktuar në gjuhën shqipe. Asnjë vokal tjetër fundor i trashëgimisë indoevropiane s'ta lënë kurrfarë gjurmësh në gjuhën shqipe.

Në artikullin që zuri vend e u ngulit në shqipen e ditëve më të vona, kemi të bëjmë edhe në reformimet në sistemin nominal të rasave të gjuhës shqipe, por në sajimet e reja të këtij sistemi format e ndryshme të artikullit do të kenë marrë pjesë më të ma· dhe. Zhvillimi i *a*-së fundore të femërores të së shquarës do të jetë përftim i një ngjitjeje të $\ddot{e}+e=a$ (*plasë+e-a*, *plasa*); këtu, pra, kemi të bëjmë me reduktimin a neutralizimin e dy vokaleve në një vokal të vetëm.

Përsa i përket sistemit lakor të gjuhës shqipe dihet se me gjithë sinkretizimin a pjekjen morfologjike të disa rasave, për periodën e mesjetës

qysh provohet nga shkrimet e teksteve të vjetra në gjuhën shqipe paraqiten shtatë rasa: 1) emërorja, 2) gjindorja; 3) dhanorja; 4) kallëzorja; 5) thirrorja; 8) vendorja dhe 7) rrjedhorja.

Në qoftë se vendoren e veçojmë si krijim të ri në sistemin e lakimit të gjuhës shqipe që sot në këtë gjuhë ka shkuar duke u kufizuar në përdorime sporadike – atëherë, hiq edhe thirroren, gjuhës shqipe praktikisht i mbeten pesë rasa. Kur kemi para- sysh numrin e mbaresave rasore të gjuhës shqipe nuk mund të tumiret mendimi i disave që edhe gjuhën shqipe e fusin në kategorinë e atyre gjuhëve ballkanike në të cilat sistemi analitik i lakimit është veçori e tyre nominale.

Emërorja e kallëzorja

Mbaresat rasore të emërore – kallëzores piqen morfologjikisht, sidomos në lakimin e pashquar nominal: *punë-punë; burrë-burrë; shteg-shteg*. Është e vërtetë se tingujt fundorë të emrave në rasën neutrale a të drejtë, përkatësisht në rasën emërore paraqiten me prirje që të rrëgjohen, të shumtën edhe të zhduken se sa tingujt fundorë të rasave të zhdrejta, bie fjala: *pë, peni, peri: panum; shullâ, shullë, shullâni, shullëri: solanus; mullî, mullîni, mulliri: molinum; krue, krua, kroi kroni*, pra dy rasat e përmendura në lakimin e pashquar, siç u tha, morfologjikisht nuk ndryshojnë në mes të tyre; në këto dy rasa dallim njohin vetëm disa përemra, bie fjala: të përemri pyetës na paraqiten këto forma të rasave emërore – kallëzore: *kush, këtë*; te përemrat vectorë: *-unë, mue, na, neve; ti, ty, ju ju(ve); ai, ate, ajo, ate; ky, këte; ajo, ate; kjo, këte*; dëftorët shumës shfaqen pa kurrfarë ndryshimi morfologjik në mes të emërores e kallëzores *ata: ato; këta: këto*.

Në punën e sinkretizimit të rasave të kësaj gjuhe, ndeshim në disa vështirësi, jo të lehta për t'u kapërcyer: kur marrim në vështrim emëroren dhe e krahasojmë me kallëzoren njëjës të lakimit të pashquar, vëmë re barazinë absolute morfologjike në mes të formave të tyre; bie fjala *shteg-shteg*; gjithashtu barazia e tyre morfologjike vështrohet edhe te një kategori tjetër emrash mashkullorë te emërore-kallëzorja njëjës: *burrë-burrë*. Në kundërshtim me gjendjen si paraqitet te femërorët e njëjësit, mashkullorët e

gjuhës shqipe na dalin mjaft të konklavitur në mbaresat e tyre e shpjegimi i tyre do shtyrë në perioda të mungëta historike të gjuhës shqipe.

Mbaresat e emërore-kallëzores njëjës përfundojnë në një anë me bashkëtingëllore, e në anën tjetër, siç u pa pak më parë, një kategori e vogël emrash mashkullorë dalin me vokalin neutral *ë*; fjala vjen: *shteg-shteg; gardh-gardh; burrë-burrë; gjumë-gjumë, lumë-lumë* (tosk.). Fonetika historike e gjuhës shqipe na mëson se mbaresa fundore e mashkullorëve njëjës na del qysh në kohë të hershme me bashkëtingëllore – *shteg*; ndërsa fundorja e kallëzores njëjës të mashkullorëve do të ketë përfunduar me-*ë*: *shtegë*, ardhur nga grupi fundor – *om*, që ka ndjekur fatin fonetik të grupit fundor *-am*. Sipas tezës së pranueshme të Joklit (*Der Akkusativ – Nominativ und der Geschlechts Wechsel im Albanesischen, Indogermanische Forschungen*, 36, f. 98-164) mbështetur në studimet e G. Meyerit (Alb. stud. 3,83), tingulli fundor *-a* tek emërorja e femërorëve njëjës në gjuhën shqipe ka shkuar e është dobësuar në *-ë-në* neutrale; *spudna a spunda* > *pimë*; grupi vokalo-konsonantik fundor i periodës indoevropiane *-am*, i kallëzores përkatëse, nëpër një shtjellim të brendshëm përfundoi në një barazim me emëroren, pra pikësisht e grupit të përmendur mbaronte me *ë-në* neutrale. Këtu, siç shihet, barazimi i emërore-kallëzores nuk ka përshkuar nëpër një rrugë paralelizmi veçse fundore të grupeve vokalo-konsonantike shkuan e sosën me vokalin neutral-*ë*: *punë-punë*. Paralelizëm analogjik kemi pa farë dyshimi te barazimi: *shteg-shtegë*, i formuar në "bazë të emërores, që nxirret e dalë prej një fundoreje *-os*, kurse akuzativi *shtegë* do shikuar i ardhur prej fundores indoevropiane *-om*, që kaloi nëpër shkallaren *-am*. Barazimi i këtyre dy rasave te kategoria e mashkullorëve *grunë-grunë*: *burrë-burrë; brumë-brumë*, përkundrazi do të jetë bërë, siç thotë Jokli, duke u nisur nga baza e kallëzores: *drurë* dhe duke u arritur paralelizmi i të dy rasave: kallëzore *grurë, emër, grurë, burrë – burrë* etj.

Mashkullorët me *ë-në* fundore, që u zunë ngojë këtu lart, Jokli i shpjegoi të dalë nga akuzativi, që me kohë u shtri edhe në nominativin Singular (*Indogermanische Forschungen*, 36, 98-158). Në këtë mes duhet shtuar edhe disa arsye të tjera që e përlligjin kuptimin e këtij lloj akuzativi në nominativ, pra ky shpjegim nuk është i vetmi që mund të jetë i mundshëm, sepse emrat si *djalë, gjumë, lumë, brumë, burrë* mund të rrjedhin pjesërisht prej neutrash e femërorësh (abstrakë, kolektivë) e pjesërisht janë

forma analogjike (Çabej, *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe*, Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, 1960/4). Janë të gjitha gjasat që të gjitha huazimet e burimit lashtogrek, latin, që në ato gjuhë kanë qenë neutra, në gjuhën shqipe të jenë pasqyruar me të njëjtën gjini, mirëpo, ato, me kohë shkuan e u tërnuan gjinish, ashtu që ata emra, të hyrë në gjuhën shqipe prej gjuhësh të tjera si neutra, sot, të shumtën janë mashkullorë a femërorë. Porse në këtë mes huazimet e gjuhës shqipe me gurrë sllave e rijogreke duan veçuar prej huazimeve lashtogreke a latine, sepse asnjanset sllave a rijogreke në gjuhën shqipe nuk u pasqyruan me neutra, bie fjala: *seno* shq. *sanë* (f); *koryto-koritë*, nga të greqishtes *trëndafil-i* *τριανταφυλλα*. Sipas një gjykimi të dijetarëve albanistë neutrat e gjuhëve të tjera në shqipen janë përfaqësuar me neutra deri në shekullin V të epokës sonë.

Në kategorinë e mashkullorëve duhet futur edhe disa fjalë që mbarojnë me zanore të theksuara, bie fjala: *bari-u*, *urith-i*; fjala *bari-u* etimologjikisht do afruar te shprehja *bëruo*, *i-ja* e së cilës është element i ngjitur bukur vonë, siç na dëshmon ruajtja e *a-së* së patheksuar, që s'pësoi reduktim, sikur ka ngjarë në *bëruo*. Kjo fjalë përdoret në gegërishte dhe është emër kolektiv – *baria* (çobania, tosk. çobanëria) e kjo rrethanë na tregon se ajo është e pajisur me sufiks femëror abstraktesh dhe kolektivash, prandaj *baria* duhet të jetë në thelb një emër abstrakt a kolektiv, që në rrjedhën e kohës shkoi e ndërroi gjininë. Nga ana e kuptimit mbështetemi te *kalorī* (kalorësit); *parī* (të parët); *granī* (gratë).

Nga sa u tha deri këtu mbi mbaresat fundore të emërore-kallëzores të mashkullores dhe femërores njëjës dhe shumës, del se barazimi i tyre ishte arritur qysh te shkrimet e autorëve klasikë shqiptarë të shekullit XVI-XVII vetëm te shumësi i sistemit të lakimit, ndërsa emrat dëftorë në kallëzore dhe emërore ndryshojnë edhe sot e kësaj dite midis tyre për numrin njëjës *këte*; *ate* kundrejt *-ky*; *ai*, përkatësisht *kjo*; *ajo*, kurse për numrin shumës këta përemra si na paraqiten në tekstet më të vjetra të autorëve shqiptarë nuk dalin me ndonjë ndryshim në këto rasa: *këta-ata*; *këto-ato*.

Po t'u sillemi mbaresave të kallëzoreve të shquara mashkullore e femërore në njëjës, siç janë *dhënë*, *lirinë*, duhet të pranojmë se ato, në të vërtetë, janë mbaresa të aspektit të pashquar lakor, pse mungon nyja me të cilën dikur ishin të pajisura; e me kohë mbaresa – *n* (në) e aspektit të

pashquar lakor u zhduk dhe kështu kallëzorja e pashquar u njëjtësua me emëroren e po të këtij aspekti, të aspektit të pashquar lakor. Përkundër kallëzoreve të sipërme, pa nyjë, kemi kallëzoret e shquara asnjënjëse gjithashtu në njëjës të pajisura me nyjë: *dyllë + të, mish + të*; ku është i ruajtur nyja e prapme: *të*.

Pasi t'i kemi trajtuar edhe disa rasa të tjera, nuk mund të lëmë pa e vështruar një pikë të përbashkët të tyre, që njihet si shpifje që shfaqet te një lagje rasash të aspektit të shquar lakor nominal. E kemi fjalën, pra, për anaptiksin *4*, -u, që na dalin për shkaqe thejstë fonetike ndërmjet temës dhe mbaresës. Të shtojmë edhe këtë se në tekstet e vjetra e vetmja rasë e lakimit të pashquar, në të cilën shfaqej zanorja anaptiktike -i midis temës dhe mbaresës, ishte rrjedhorja shumë; ndërsa në lakimin e shquar anaptiksin e marrin disa rasa njëjës: emërore-kallëzorja asnjënjëse e kallëzorja sekundare mashkullore dhe asnjënjëse; në shumës: emërore-kallëzorja mashkullore, kallëzorja sekundare mashkullore, rrjedhorja mashkullore dhe femërore.

Gjinorja dhe dhanorja e lakimit të pashquar të gjuhës së sotme shqipe, në tekstet e vjetra dalin më mbaresën *i* te emrat mashkullore dhe me e te femërorët: rreth burimit të tyre mendimet e dijetarëve janë të ndara; një palë dijetarësh mbaresën -i e kanë nxjerrë prej mbaresës -ei të dativit ose të lokativit tematik indo-evropian. Pala tjetër e linguistëve e qesin të ardhur nga mbaresa e gjinores -i e gjuhëve indoevropiane perëndimore; lagjia tjetër e lidhin me dativin indoevropian -oi në rrokje të patheksuar, ndërsa mbaresën -u me dativin analog më -ou ose me lokativin më -oi. Linguistët nuk pajtohen as sa i përket çështjes së vjetërsisë a moshës së gjinores e dhanores; cila do të ketë moshë më të madhe: gjinorja apo dhanorja?

Gjinorja në gjuhën shqipe, siç dihet, ka mbaresën -i e për emrat me temë të bashkëtingëllores grykore ose zanore -u; ajo ka të njëjtën trajtë me dhanoren, me të vetmin ndryshim se ajo është e pajisur me dëftorthin. Pedersen siç dihet, është përpjekur ta qesë nga një dativ indoevropian me -o duke pandehur se o-ja ka dhënë -u dhe pastaj -u-ja është kthyer në -i.

Mbaresën -u të gjinore-dhanores ndër emra mashkullore njëjës, Pedersen e qet të dalë prej njëjës së shquar të emrave mashkullore: *miku* (i

një miku, i një kau, i një dheu), duke e quajtur formim analogjik, sajuar siç u tha, sipas nyjës -u në emëroren e shquar: *kau, miku, dheu*.

Pedersen (Festschrift, dhe Gutturale) e gjen mbaresën -u me të vjetër për arsye se po të kishte moshë më të madhe varianti tjetër i mbaresës -i, atëherë kjo -i do të shkaktonte palatalizimin e grykoreve që gjenden në kategorinë e vogël të emrave me temë në *k, g (h)*: *mik + i = miqi, ulk + i = ulqi*. Pedersen, pra, nyjën e prapme -u tek emrat, siç është *kau*, e gjente primare, kurse sekundare nyjën e sprasme -i, bie fjala te emri – *lisi*. Po kështu Pedersen shpjegonte dhe alternancën e mbaresave -u -i në gjinore-dhanore, p.sh. (i) një *dheu*, (i) një *kau*, kundruall (i) një *lisi*, (i) një *plepi*, në të cilën gjente një formim analogjik sipas alternancës së artikujve -u, -i, në emërore të shquar: *kau, lisi*.

Edhe alternancën *thau, foli*, Pedersen e lidhte me alternancën e dëftorit + *u*, + *i*. Në studimin e vet mbi *Nyjat e shqipes*, S. Riza parashtroi kundërtëzën e tij me të cilën e kundërshtoi mendimin e Pedersenit që, qoftë te nyja e prapme -u e emërores së shquar, qoftë te mbaresa -u e gjinore-dhanores: (i) një *kau*, (i) një *dheu*, qoftë edhe te mbaresa -u e së kryeres te foljet *thau* nuk kemi një -u primare, veçse këtu në të gjitha rasat e sipërme do të kemi pasur një + *vi* e analizueshme në -*v* si tingull antihiatizues dhe në -*i*, që njihet qoftë si nyje e prapme e një emri në emërore, qoftë si mbaresë e një emri të pashquar në gjinore-dhanore, qoftë mbaresë e një foljeje në të kryeren e thjeshtë: *kam > kau*; nga kjo kategori emrash -u-ja shkoi e u shtri edhe te një tjetër kategori emrash me temë në grykore: *k, g*, bie fjala: *mik* me ndërhyrje për të mënjeluar shndërrimin e bashkëtingëllores grykore në qiellëzore: *mik + *miqi, i një miqi*.

Kur krahasohet artikulli prepozitiv i emrave mashkullorë e femërorë me mbaresat e mashkullorëve dhe femërorëve në njëjës, atëherë në këtë punë na shfaqet një ndryshim, kështu që te femërorët nyja nuk pajtohet me mbaresën rasore të gjinore-dhanores së pashquar: *vajza-vajze, fusha-fushe*; mashkullorët në këtë pikë na dalin të njëjtë, mali: gjind., dhan., rrjedhore *mali*. Porse, në këtë mes do ditur se mbaresat e rasave të përmendura nuk mund të qëndrojnë njëra në këmbë të tjetrës edhe pse dalin me të njëjtën morfemë në fund, çka na dëshmon se secila rasë ka funksionin e vet të pazëvendësueshëm prej të tjerave, përndryshe edhe përkah përdorimi dhe funksioni ato do të njësoheshin.

Në shkencën albanologjike ka ngelur i pazgjidhur edhe sot e gjithë ditën problemi i origjinës së nyjave bashkë me mbaresat rasore të shqipes.

Sistemi i nyjeve në gjuhën shqipe duhet të ketë moshë të madhe, sipas të gjitha gjasave ai i takon periodës indoevropiane të kësaj gjuhe, dhe ka ardhur si kompensim i zhdukjes së sistemit lakor nominal indoevropian në gjuhën shqipe.

Lidhur me këtë fushë kërkimesh do vënë re se të gjitha zanoret fundore që hasen sot ndër emra të gjuhës shqipe duan konsideruar sekundare, apo të dala prej diftongjeve, për pasojë edhe nyjat e prapme *-i*, *-u*, etj., po i quajtëm të vjetra, do t'i marrim të përfuara nga diftongjet.

Me ndërtimin e shumë rasave emërore në sistemin e lakimit nominal të gjuhës shqipe duhet t'u qasemi nyjeve të kësaj gjuhe për të dalë të burimi i riformimeve e sajimeve të disa rasave nominale të kësaj gjuhe.

Edhe në sajimin e rasave në shqyrtim nyjat duhet të kenë luajtur roli vendimtar, bie fjala nyja e prapme e shquar: *fusha* do të ketë dalë nga *fushë* + *e*; prandaj gjithandej kësaj gurre do t'i drejtohem për ta qitur në dritë punën e burimit të gjinore-dhanores njëjës: *fushe*, dalë prej *fushë* + *e*, e kjo e fundore do të jetë përfuar në një periodë që i printe kohës kur *ë* + *e* jepte *-a*: *fushë* + *e* = *fusha*.

Megjithatë a do të kenë dalë disa mbaresa rasore të kësaj gjuhe nga artikujt apo anasjelltas, shkenca albanistike sot për sot nuk është në gjendje kësaj çështje t'i japë udhë. Disa dijetarë, siç u pa këtu pak më parë, nyjat e shqipes i veçojnë prej mbaresave rasore duke e drejtuar në gurra të ndryshme burimin e tyre. Porse, në këtë punë një gjë është e sigurt, që nyjat e kësaj gjuhe, si- kur në të gjitha gjuhët, të pajisura me nyja, janë përfuar prej dëftorëve. *T*-ja e mashkullorëve e femërorëve shumë si dhe nyja *të* e gjinisë asnjansë e kanë burimin, pa farë dyshimi te përemrat dëftorë: (a) *ta* (a) *to*, zanoret e të cilave janë sjellë në *ë-a*, *o-ë*. Edhe nyjat e tjera të gjuhës shqipe *të*, *së* të rasave gjinore, dhanore e rrjedhore – linguistët e qesin nga dëftorët përkatës të kësaj gjuhe.

Në vazhdim të këtij shtjellimi mbi rasat e gjuhës shqipe, respektivisht mbi gjinore-dhanoren njëjës, po i shtojmë edhe disa, cilësi të tyre që i karakterizojnë. Në këtë vështrim të emrave do t'i trajtojmë një tubë mashkullorësh që na merr mendja se duan shpjeguar, pse gjendja e sotme e tyre

nuk piqet me situatën e hershme në një anë, dhe në anën tjetër as krye-dialektet e gjuhës shqipe në këtë punë nuk pajtohen. Në këtë varg emrash mbërthyer pra, ajo kategori mashkullorësh që dalin në diftongje (*ue, ua*) përfutur prej zanores o të gjatë a të shkurtër sipas të cilës një konsonant mbyllte rrokjen, ai konsonant ishte një likuidë a nazal: *-ol, -oll, -or, -on*. Kjo kategori emrash mashkullorë ka peshë të veçantë në lakimin e emrave, prandaj lidhur me aspektin e tij kryekreje fonetik, dijetari i Vjenës, Norbert Jokli, ia kishte kushtuar një studim të mirë – *Zur Geschichte des alb. Diphthongs -ua, -ue* (në *Indogermanische Forschungen*, 49,50). Ky studim i hapët i albanistit austriak, përpos vleftës së madhe fonetike, peshon shumë edhe në punë të gjurmimit morfologjik të diftongjeve në vështrim.

Nga rastet e sipërme *-ol, -oll, -or, -on* zanorja o e të cilave është diftonguar në *-ua, ue*, duke kaluar gjashtë shkallë të tjera, veçojmë atë të fundit, lidhjen e sprasme *-on* dhe e vëmë në spikamë shtjellimin e saj si na paraqitet në perioda të ndryshme kohore. Vetëm lidhja *-on* e bjerr në të gjitha rasat nazalin *-n*, për ta kthyer përsëri në shumës, kurse lidhjet e tjera e ruajnë likuidën në të gjitha rasat njëjës e shumës.

Emrat mashkullorë me temë të vjetër në *-on* ndahen në shenjë nga një numër i madh mashkullorësh që përfundojnë në vokale të theksuara *i, e, a, u*, të nazalizuara prej konsonantit nazal, që e kishin pas dhe që mbyllte silabën, p.sh. *mullí* nga *mullin* (tosk. *mullir – mulliri*); *pé* nga *pen*, (tosk. *pë – për*); *fré* nga *fren* (tosk. *frë – frër*), *freni, frëri, freri*; *shullá* nga *shullan* (tosk. *shullë-shullër*), *shullani, shullëri, gjú* nga *gju* (*gjun, gjui*) – *gjuni, gjuri*.

Nga sa u shtjellua deri këtu në lidhje me natyrën e vokaleve nazale, shkaktuar prej konsonantit nazal që u printe, na del e qartë se në punën e nazalizimit të vokaleve që u zunë ngoje do përjashtuar nga kjo shfaqje vetëm kategoria e emrave mashkullorë që mbarojnë me temë të hershme *-on*, që ka rrahur një shteg të veçantë në zhvillimin e vet historik. Tema *-on* i ka shpëtuar pra, nazalizimit të vokalit *o*, ndërsa në punën e zhdukjes së konsonantit nazal edhe kjo lidhje ka ndjekur po atë rrugë zhvillimi që kanë zbatuar lidhjet me vokale të tjera: *vok + n + vokal*.

Dijetari i Vjenës, Norbert Jokli, ma i madhi njohës i gjuhës shqipe i shekullit XX, që ishte marrë me problemin në hetim thotë se edhe vokali *-o*

i lidhjes *-on* do të ketë shkuar nëpër shkallën e nazalizimit që me kohë zu të denazalizohet si na paraqitet sot në të gjitha të folmet e gjuhës shqipe.

Kur kërkohen shkaqet e denazalizimit të vokalit *o* të kësaj lidhjeje, duket se nuk mund të mos merret në vështrim natyra e vokalit *-o* të shqipes, si tingull që, me përjashtim të vokaleve të tjera, nuk e duron nazalizimin, punë që do të jetë e lidhur me rrethanën e përfimit fiziologjik të vokalit në shqyrtim: *ftôn = ftô; përrôn = përrô; (u) dërgôn – (u) dërgô* u zhvilluan në *ftôi, përrôi, dërgôi*, që u denazalizuan në *ftoi, përroi, dërgoi*.

Këtë lidhje e kemi veçuar, siç u tha pak më parë, për arsye të paraqitjes së saj të ndryshme në të folmet e gjuhës shqipe, prandaj edhe N. Jokli në veprën e përmendur mbron tezën se trajtat *ftoi, përroi, kroi*, të cilat në mbarë toskërishten dhe në gegërishten jugore dhe në atë qendrore, përdoren si emërore të shquara, si dhe si gjinore dhanore të pashquara, ndërsa format *ftoni, kroni, përroni, vargoni, langoni*, etj. njihen si emërore të shquara dhe si gjinore-dhanore të lakimit të pashquar në gegërishten veri-ore, mandej në të folmet shqiptare të Kosovës në mbarë shqipen e periodave paraletare paskan qenë morfologjikisht të diferencuara: trajtat *ftoi*, etj. quheshin si emërore të shquara, kurse *ftoni* – etj. qenkan përdorur vetëm si gjinore-dhanore të pashquara.

Në epokë të re të historisë së gjuhës shqipe u zhvilluan ndikime e barazime reciproke. Format e hershme *ftoi, kroi, përroi, langoi, vargoi*, të cilat dikur i rezervoheshin, sipas Joklit, vetëm emërores së shquar në mbarë gjuhën shqipe u shtinë mbi gjinore-dhanoren e pashquar, por vetëm në të folmet toske e pjesërisht edhe në disa dialekte gege që shkojnë kah merr Gegëria Jugore dhe ajo Qendrore, kurse në një pjesë të gegërishtes veriore format *ftoni, kroni, përroni, vargoni*, etj. të gjinore-dhanores u shtrinë mbi emëroren e shquar:

ftoni, kroni, përroni – gjin. dhan. e pashquar

ftoi, kroi, përroi... – emërore e shquar

Në studimin e gjerë *Nyjet e shqipes*, S. Riza mbron tezën se këto dy palë trajta janë variante fonetike, prandaj ai ka rrahur një shteg tjetër në kërkimin e burimit të tyre. Pa hedhur poshtë mendimet e të tjerëve, shfaqur në lidhje me tfillimin e kësaj çështjeje, mund të anohet nga një mendim i përkundërt, është konstatuar mbi dëshminë e disa të dhënave që trajtat që

dalin në të folme të gegërishtes veriore dhe të dialekteve shqiptare të Jugosllavisë me – konsonantin *n* (*kroni, përroni, thoni, etj.*) duan konsideruar relativisht të reja në dialektet përkatëse. Prej këndeje del e qartë se rruga që ndjek N. Jokli në shpjegimin e këtij problemi morfologjik të sistemit lakor nominal të shqipes nuk duket e mundur, njëherë pse urë të shëndoshë për një ndërtim të tillë dokumentet gjuhësore, nuk sigurojnë, e as që del ndonjë e dhënë nga të folmet e shqipes së sotme.

Ka gjasë që format e atyre rasave që dalin me konsonantin *-n* të jenë riformime të reja, dhe të mos kenë qenë në përdorim në krye të herës. Prandaj trajtat *kroi, gjin. dhan. të një kroi, një kroi; përroi, vargoi, langoi* etj. duhet të kenë qenë primare e ato me *-n* do të quhen sekundare.

Vendorja. – Në grammatikat tradicionale të gjuhës shqipe në rrethana të caktuara përdoret një rasë që quhet me emrin jo aq të lumtur, me emrin *vendore*. Përdorimi i saj kushtëzohet nga prania e një vargu parafjalësh që pjesërisht tregojnë vend. Kjo rasë, përkatësisht rasi vendore, është e mangët nga shumë pikëpamje.

1) Sikur gjuha shqipe, ajo e sotmja, si dhe ajo si na del ndër tekste të vjetra të saj, – të kishte pasur një rasë vendore, ajo do të paraqitej njësoj që në dy aspektet e sistemit lakor nominal të saj; në lakmin e shquar dhe në atë të pashquarin, (dihet se kjo rasë haset vetëm në lakimin e shquar). Mungesa e kësaj rase dokumentohet meqë ajo nuk shfaqet të mbiemrat, mbiemrat pra nuk e njohin rasën e quajtur vendore; pastaj ka në gjuhën shqipe shumë parafjalë të tjera, që nuk ndërtohen me rasën vendore, porse me rasi të tjera, si me kallëzoren, me rrjedhoren, prej këndeje del termi rasë parafjalore. Ky term për vendoren nuk mund të merret si i drejtë, përveç tjerash edhe për arsye se vendorja ndërtohet edhe me parafjalët: *me, pa*, të cilat nuk tregojnë, kurrfarë vendi, parafjalë që në lakimin e pashquar kërkojnë rasën kallëzore, për ç'arsye Pedersenit këtë rasë e quajti kallëzore parafjalore, e si do ta quajë S. Riza – „trajtë sekundare e kallëzores së shquar“.

Ja parafjalët që në tekstet e vjetra marrin të ashtuquajturën rasë vendore:

1) *mbë: mbë të djathtët, mbë jet të dërejtë (Buz. 85/26); ndë famullit e mbë kishët të vet (Budi, P. R. 396); mbë malt të Libanit ishte një lis, mbë*

të sillt kish. (Bogdani, pjesë e parë 1/2, paragr. 9).

2) *mbi* (përmbi): *mbi gjithë shërbiset* (Matr. 16; *përmbi shtëpit*, (Buz. 31/16); *përmbi gjithë zotënit, e regjinit, e perandorët të shekullit* (Budi, D. K. 21); *mbi dhet* (Bardhi, 166); *përmbi dhet* (Bogd. Të primitë përpara letërarit = parathënie, f. 18);

3) *me*: *me zemërët, pra me gluhët* (Matr. 18); *me të shën Marit* (Matr. 11); *me sy e me shpirt tand* (Buz. 23/2a); *me invidiet e resët të disave* (Budi, P/R+52); *me zotënit tande* (Bardhi, 206); *giuha jonë qi me dijet duver edhe fjalëtë* (Bogd. Parath. 17.pj. f. 22).

4) *ndë*: *ndë këtë gjellë pra... ndë tjerëtë* (Matr. 4); *ndë vorrt të ti, ndë hit e ndë pluhënit* (Buz. 23/1a, 110/2b); *nd' ate të mbrapët, e të pandonjë shpresët zakon të tyne* (P.R. 21); *ndë zakont plak* (Budi, P.R. 52); *ndë misalt, brevialt, eritualt* (Bardhi, parath. 6); *si krypa nd' ujët* (Bogd. parath. 17);

5) *ndënë*: *ndënë krahëruart* (Matr. 3); *ndënë strehët të shtëpisë* (Buz. 41/2b); *përndënë portegut tand* (Buz. 10/2a); *ndenë dorët të tinëzot* (Bardhi, 161); *ndënë Beçit* (Bogd. Parath. 17); *ndënë zât të djallit* (Bogd. pj. I, f. 3, nr. 11).

6) *ndër*: *ndër gjithë grat* (Matr. 11); *ndër gjithë grat* (Ant. 31/lb); *ndër duort të anëmiqivet vet* (Budi, P.R. 378); *ndër të pafet ndër terrëtit* (Bardhi, Parath. 3/2,+ 5/2);

7) *pa*: *pa të bëmet të mira* (Matr. 16); *peshkut, pa mpkatit së lem* (Bogd. pj. I, 112, pj. II, 2);

8) *për*: *për elpidet të tinëzot – per la sperenza di Dio* (Matr. 9); *për miqt të vet* (Buz. 82/1a); *për urdhënit e për fjalët të tyne* (Budi, P.R. 360); *për kryet tem* (Bardhi 88); *për gojët të Arnos* (Bogd. parath.) (= shembujt nxjerrë nga: *Emrat në shqipe* (të S. Rizës). Vendorja shquhet, siç shihet qartas, prej momentit kategorial që do të thotë se kjo trajtë sekundare e kallëzore si quhet tani zakonisht na del vetëm për lakimin e emrave të shquar, e jo njëherazi edhe për lakimin e përemrave si pandehte S. Frashëri.

Momenti sintaktik që e shquan rasën në shqyrtim karakterizohet nga cilësia që ajo përdoret bashkë me disa parafjalë, siç ja- në *mbë, mbi, me,*

ndë, ndënë, ndër, pa, për, ndërsa momenti historik qëndron në faktin se rasa në shqyrtim edhe pse me përdorim të dendur në tekstet e vjetra të gjuhës shqipe, prapëseprapë nuk mund të thuhet të ketë pasur e të ketë përdorim të përgjithësuar, dhe në fund momenti tjetër që e dallon këtë rasë është ai që trajta sekundare e kallëzores së shquar pa dallim gjinie dhe numri merr trajtën *-t* (jo-*të*) të nyjës së prapme, pastaj kjo rasë pa dallim gjinie dhe numri ndiqet nga trajta të (e jo *e*) e nyjës së parme apo të dëftorthit të mbiemrit të nyjshëm apo të emrit në gjinore.

Format lokative a vendore shfaqen pa farë dyshimi edhe për numrin shumë, mendim ky që nga një lagje e konsiderueshme dijetarësh nuk pranohej:

Buzuku: *ndër gjithë grat*, 10 b 22, *ndë fushat* 164 b 19, *ndë panagjyrat* 162 b 6, *me syt tanë* 163 b 11, *ndë buzët të tu* 8 b 4, *mbë të ditunat e tyne* 3 a 30; *mbë dyert të qytetevet* 102 b 5; *me pleqt të dheut* 162 b 8.

Matrënga: *mbi gjithë shërbiset* 16, *ndrë gjithë grat* 11; *pa të bëmet të mira*, 16.

Budi: *përmbi gjithë zotënit e ugjinjt, e perandorët të shekullit*, D.K 21/17.

Bardhi: *ndër te pafet*.

Bogdani: *për të lutunat të fort ndriçimit, parath*.

Samiu: *Udhët për të cilat* (Shqipëria, 116), *nëpër lumenjt* 35; *në vendet të tyre* 105; *në gjuhërat të tyre* 82; *nëpër krehëret të maleve* 35; *në zemërat të Tyrqet* 17; *në malet të tyre të rreptë* 49. (Shembujt u nxorën nga vepra e zënë ngojë e S. Rizës).

Rrjedhorja. – Kjo rasë që në njëjës mashkullor e femëror dilte me *i*, *e*, e në lakimin e shquar me *it. et*, e në shumë në të dy lakimet mbaronte më *-ish e shit*, në perioda të hershme të teksteve të vjetra kishte përdorim shumë të dendur: *lisi, shtylla; li- sit, shtyllet; prej doret; shumë: lisash, lisash.it; punë burrash; prej djemsh (it), prej vajzash (it); ën zakoneshit plaka* (Buzuku, f. 239); *ën mendjet se tyne: engriu ecë prej mjesëditet; qi del prej qytetjet... ën jush;... në fejeftë kush ëndër ju ën udhet së dërejte...* Në gjuhën e sotme shqipe përdorimi i rrjedhores është sjellë në rasa sporadike kryesisht reliktoze. Në këmbë të formave a trajtave ablativë, të

njohura e shumë të përdorura në tekstet e vjetra të autorëve veriorë, – në rrjedhën e moteve zunë të hyjnë në përdorim trajtat dativë e arsyet duan kërkuar jo te zhdukja e rrjedhës nga sistemi lakor i gjuhës shqipe, por këtu kemi të bëjmë me një ndërrim të thjeshtë në reksionin e parafjalës: *prej doret prej dorës*. Në lidhje me studimin e parafjalëve të gjuhës shqipe do pasur parasysh fakti, se si në gjuhën e sotme, ashtu dhe në tekstet e vjetra nuk kemi përputhje absolute: derisa te Bardhi, bie fjala, parafjala jashtë merr rrjedhoren: *jasht dheut, jashtë shtëpiet*, e njëjta parafjalë te Buzuku, përkundrazi, kërkon kallëzoren: *jashtë qytetnë*. E shndërrimin e parafjalëve ablativë në dativë duhet ta ketë shkaktuar jo analogjia sintaktike, as ajo morfologjike, porse përputhja e thjeshtë fonetike e trajtave të rrjedhës me trajtat përkatëse të dhanores, bie fjala, *prej një çuni, një çuni; prej një vajze: një vajze; prej çunit, çunit; prej vajzës, vajzës*.

Megjithëse e reduktuar, në bazë të saj përdoret edhe gjinorja-dhanorja, rrjedhorja e të dy numrave nuk është¹ e zhdukur krejtësisht në gjuhën shqipe; ndërkaq rrudhjen e saj e konsiderojmë me përdorim sporadik dhe reliktor. Përdorimin e saj të dikurshëm me shumicë e dëshmojnë foljet; me fjalë të tjera një lagje verbash e kërkojnë ablativin, në fushën e ngërthimit sintaksor; qoftë si ablativ partitiv a pjesor, a si plotës argument, e ky farë plotësi sundonte ablativin edhe në gjuhën latine:

U lava shtetsh, shtëç (shtati); largomu, shporrmu sysh; hiq- mu qafe; hiqmu sysh; u qita duersh.

Formantet e rasave të numrit shumës

Nga formantet e rasave shumës të gjuhës sonë interes bukur të madh paraqesin formantet e gjinore-dhanores shumës, pse në perioda të teksteve të vjetra të gjuhës shqipe ato na dalin dy farësh: me *-e*, dhe me *-ve*; formantin e thjeshtë e shumës e paraqesin mashkullorët e femërorët shumës në bashkëtingëllore, ndërsa shumësat në zanore dalin me formantin *-ve*; ja shembuj nga vepra e Buzukut: – gjaku *i qevet, i sjepet*; përpara *njerëzet*; e përpara *gravet*; t'errëtitë e *mendet tinëve*; *d'miravet tuaja*; kondrë *anëmiqet tuve*; dy-ve pleq-*e*; të zanë fill të muoj-*et*; Ordhënoi xhakon-*et*, e tha dishipuj-*ei*; t'parë-*vet*; priftën-*ei*; të ullinj-*et*; e ama e *d'bij-*et**; Budi (Doktrina e Kërsht.): ati i qiell-*et*; me syt të mend-*et* e të shpirtit; me u

mpsuom djelm-*et* e fëmisë. (Pasq. e t Rrëfyemit): zakoni i fratën-*et*; madhësinë e shumë-*ve*; Shpellë-në e gjerpinj-*et*; Zogorisë uq-*et*; e të kulçedra-*vet*; Bardhi: pushtetia e shumë regjinje e përandorë-*ve*, koshi i rush-*et*; kundrë anëmiq-*et*; këtyne udhë-*ve*; kopështi i mollë-*vet*; të njerëz-*et*, e të shtasë-*vet* e t'ujëna-*vet*, e të male-*vet*, e të fusha-*vet*, e të sa tjera, Kafshë-*ve*; emënat e qytete-*vet* e të kështjell-*et*; Bogdani (pjesë e pa- rë): u hyji i engjij-*ef*, e i gjithë kafshë-*uei*, zotyni i prind-*et* ti-*ve*; prej pleq-*et* sinësh; pëmbrendësat e njerëz-*et*, mirë-*vet*, ashtu t'këqi-*ve*; e dhenë dha bij-*et* njerëz-*et* (Shembujt nxjerrë nga *Emrat* në shqipe, 57).

S'ka kurrfarë dyshimi se mbaresa *e* e gjinore-dhanores te shumësat në bashkëtingëllore dhe mbaresa *-ve-t* e po asaj rase të shumësat në zanore që përbëjnë rregull në tekstet e vjetra të shkrimtarëve klasikë shqiptarë. Në rrjedhën e kohës mbaresa primare *-e* në mashkullorë e femërorë të rasës gjinore-dhanore shumësu të zëvendësohej me mbaresën sekundare *-ve*, e cila në shekullin XIX ishte përgjithësuar në të folmet gege si dhe në tekstet e dialekteve gege. Toskërishtja në këtë fushë veprimesh na del më konservuese, pse forma primare *-e* vazhdon të mbizotërojë deri nga fundi i shekullit XIX, për çka na dëshmojnë veprat e S. Frashërit dhe tekstet e veprës *Albanesische Texte mit Glossar* të dijetarit danez, Holger Pedersen, (1895).

Është e vërtetë se mënjanimi i mbaresës *-e* në të mirë të sekundaresh *-ve* në gegërishte sipas dëshmisë së veprës së Bogdanit na del qysh në shekullin XVII dhe në këta 3-4 shekujt e fundit. Stabilizimin e mbaresës sekundare *-ve* në kurriz të primares *-e* do ta kenë favorizuar dy fakte, njëri me karakter morfologjik e tjetri me cilësi fonetike. Dihet se zhvillimi morfologjik i emrave në gegërishten e këtyre 3-4 shekujve të fundit karakterizohet nga shtimi i gjithnjë e më i madh i emrave shumësu që mbarojnë me zanore, ndërsa numri i emrave që mbarojnë me bashkëtingëllore shkonte përherë duke u pakësuar, e kjo prirje i ngushtonte rrrathët e zbatimit të mbaresës primare *-e*; bie fjala, prej: dy ulla dy ulla-*e* na dolën dy ulli: dy ulli-*ve*. E kështu edhe në tekstet e vjetra tipat e emrave në zanoren ë, në gjinore-dhanoren e shumë- sit na dilnin herë me mbaresën *e*, herë me *-ve* – mâ kryetë e njiqind vjet-*e*; – e u dëftuonë shumë vetë-*ve*; gjithë shintet konfesor-*e*; gjithë shintet martire e shintet konfesorë-*ve* (Budi).

Kur është fjala për moshën e mbaresave në shqyrtim, duhet thënë se ajo me *-e* ka vjetërsi më të madhe, njëherë pse *-e*-ja do të jetë përftuar pa farë dyshimi nga *-om* indoevropiane si e qet të dalë Pedersen (Festschrift, 254), pastaj bashkëtingëllorja *-ue* do të pandehet konsonant antihiatizues, që këtu ndërhyr për të larguar hiatin: *nuse + e = nuse + v + e*.

Mbaresa e shumësit në lakimin e pashquar na del më *sh* (*sysh*, *duersh*, *kohësh*, *mundimesh*), dhe *-shit* mbaresë e lakimit të shquar, që dikur në tekstet e vjetra përdorej me të madhe ndërsa sot është rrudhur në disa shembuj sporadikë dhe reliktorë: *lisashit*, *fjalëshit*, prej *urtishit*, ëndë *dellshit*, *n etheshit*.

Dihet me siguri se prania e disa parafjalëve e marrkan rrjedhoren qoftë njëjës, qoftë edhe shumës, siç janë: *jashtë*, *pas*, (*rribas*), *përpara*, *prej* etj; pastaj rrjedhoren shumës e gjejmë të përdorur edhe pas një tube verbash: *hiqmu sysh*, *shporru sysh*, *lahem shteq*, *qitu duersh*.

Lidhur me mbaresat fundore të rasave në shqyrtim do të hetohet një vokal që del te fundoret e rasave në studim me funksion ndërhyrjeje në mes temës së trajtës dhe mbaresës së saj, që ta lehtësojë shqiptimin e fjalëve.

Vokalet që shpifën në vendet e caktuara janë dy farësh: i pari tingull ka karakter antihiatizues, kurse tjetri është tingull anaptiktik.

Tingulli i parë ndërhyr ndërmmjet dy zanoresh që përbëjnë jo diftong, por hiatus dhe largon përftimin e hiatit; e këtë largim e shkaktajnë bashkëtingëlloret; *j*, *v*, *h*, – *lule-j-e*, *pun-e*, *vajza-v-e*, *djem-e*, *shko-v-a*, *dol-a*, *lahem*, *la-h-em*, *sillem*. Anaptiksi na del në mes të dy bashkëtingëlloreve, që formojnë një grup tingujsh pak a shumë të vështirë për shqiptim: *njerëz-i-sh*; në gjuhën e sotme na del vetëm një anaptiks-i, porse në tekstet e vjetra. përpos *-i-së* përdorej alternativisht edhe *-u*-ja, për shkaqë thjesht fonetike, siç na dilte përdorimi i nyjës *i:u* (mbë *ban-kut* mbë *pellëgut*, përndënë *portegut* – Buzuku).

Siç u pa prej disa shembujsh, anaptiksi ndërhyr në rrjedhoren e shquar të numrit shumës te emrat që dalin në bashkëtingëllore, ashtu që rrjedhoret e pashquara përfundojnë në grupin konsonantik, bie fjala: *miq*, *miqsh*, *miqshit*. Kështu edhe te emrat shumës që dalin në zanore e që theksohen mbi rrokjen e parafundit, anaptiksi do të ndërhyjë në rrjedhoren

e shquar: *lisashit, mundimeshit, katundarëshit*. Një lagje shembujsh të emrave shumë në rrjedhoret e shquara që theksohen mbi rrokjen e fundit, anaptiksin e marrin për analogji, fjala vjen: *gra-grash, rê – rêsh, rêshit, etj.*

Ndeshen edhe shembuj emrash filli i anaptiksit të të cilëve është vështirë te gjendet, prandaj ata njihen vetëm si shfaqje pasigurie të ndjenjës gjuhësore dhe lëkundje në zbatimin e disa rregullave në vetë ndërgjegjen e folësve. (S. Riza).

Buzuku: *e për hirit të tinëzot; mbë hirit (ndë hirit); mbë shekullit; mbë shekullit.*

Budi: *përmbi të vobegjit; ndë ligjt;*

Bardhi: *mbë hesapit;*

Bogdani: *ndë parrisit;*

Matrënga: *mbë diafuart, kurse të dukuaritë.*

Anaptiksi tek emrat që dalin në një grup konsonantik, bie fjala:

Buzuku: *banqitë, për bagmit;*

Budi: *me pishqit; të mangutë;*

Bardhi: *tirqitë;*

Bogdani: *pa peshkut, peshqitë; Tudhesqitë në gjigantit, ndë ajrit; ndër shpirtit; ndë timbit me shenjtit;*

Matrënga: *ndë barkut, për shpirtit shenjt me shpirtit e me kurmit.*

Anaptiksi shpifet edhe tek emrat që mbarojnë me një bashkëtingëllore të vetme, por të theksuar mbi rrokjen parafundore:

Buzuku: *përmbi te vogjëlit; për të lutunit të saj; emënitë; nierëzitet; përmbi gjithë dreqënit;*

Budi: *ndë të bekuomit barkut të saj; ndë të pasunit; me urdhënit; mbi shekullit; mbë truollit;*

Bardhi: *faqe njerëzish; për truollit; të moçmitë posi katun-dasitë;*

Bogdani: *përmbi petëkut tem; me avullit;*

Matrënga: *mbë shekullit; të faluritë.*

Pavarësisht nga çdo faktor fonetik, anaptiksi del përherë tek emrat në rrjedhoren e shquar të shumësit:

Buzuku: *n'trimashit, etheshit; n'grashit; n'qiellshit n'pleqshit; n'duorshit;*

Budi: *en gjithë fajeshit; nderesh.it;*

Bardhi: *n qieleshit;*

Bogdani: *Ushtërishit; plagëshit; rêshit;*

Matrënga: *me djallashit; së këqiashit* (=S. Riza *Emrat e shqipes* – Sistemi i rasavet dhe tipat e lakimit).

Kategoria e nyjeve të shqipes

Tipar i veçantë që dallon gjuhën shqipe prej një serie gjuhësh të tjera të familjes indoevropiane është pajimi i saj me sistemin e dyfishtë të artikujve – nyjave: me artikullin postpozitiv a enklitik (të prapmë) dhe me atë prepozitiv (proklitik a të përparmë). Dihet se gjuha shqipe dhe ajo rumune lidhen njëra me tjetrën përkah përdorimi i të dy palëve të artikullit: këto dy gjuhë kanë të përbashkët të dy llojet e nyjave, kurse me bullgarishten e maqedonishten në këtë mes shqipja afrohet në përdorimin e artikullit enklitik.

Çështja e artikullit të gjuhës shqipe, qoftë si proklitik qoftë ai postpozitiv a enklitiku hyn në vargun e atyre shfaqjeve të shumta gjuhësore që i kanë të përbashkëta gjuhët e anëve lindore të Gadishullit Ballkanik; këto dukuri quhen ballkanizma ku ngërthehen: infinitivi, zëvendësimi i tij me koniuktivin, përdorimi i dyfishtë i kundrinave përemërore, p.sh. bullg: *prijatel – prijatelët*; rum. *prieten – prietenul*, shqip *mik – miku*; greqishtja ka qysh prej epokës së lashtësisë artikull, porse ai rri para emrash, *o adherfos = miku: e hora (dheu, toka)*.

Artikullin enklitik e njohin edhe disa gjuhë gjermanike, siç janë: norvegjishtja, suedishtja, danishtja, islandishtja e vjetër, jashtë tyre armenishtja, etj. Me artikullin proklitik a prepozitiv janë të pajisura gjuhët romane: italishtja, frëngjishtja, spanjishtja, megjithëqë e ama e tyre – latinishtja nuk njihnte farë artikujsh, e kjo do të thotë se sistemi i artikullit në to ka dalë nga përemrat dëftorë të latinishtes: prej përemrit dëftor *ille* të kësaj gjuhe u përftuan zhvillime të mëtejme të frëngjishtes: *le, la, les*, të italishtes: *il, la, gli, i, le*.

Përsa i përket gjendjes së sistemit të artikullit të gjuhëve që u përmendën, një gjë dihet me siguri, se artikujt e të gjitha gjuhëve janë gjinikuar prej dëftorëve të gjithëve përkatëse në pozicionin e tyre të rrëgjuar, a të thurrur, d.m.th. me kalimin e trajtave të dëftorëve ndër kategori të tjera gramatikore ato do të pësojnë ndryshime të mëdha fonetike.

Kur dimë se artikujt e shqipes janë përftuar prej përemra- ve dëftorë, atëherë është e domosdoshme që të japim një pasqyrë të trajtave të tyre bashkë me dëftorët e kësaj gjuhe si na paraqiten. Tabela e tyre pra duket kështu:

	Përemri dëftor	Nyja e përparme	Nyja e sprasme
	I	II	III
Njëjës mashkullor			
Emërore	(a)i, y	i	-i, -u
Gjin. dhan	(a)ti, (j)	të	-t
Kallëzore	(a) tê, të	të	(-në, -in, -un)
Rrjedhore	(a) si	së, të	t
Njëjës femëror			
Emërore	(a) jo	e	a-
Gjin. dhan	(a) saj	së	-së, -s, së,
Kallëzore	(a) tê, të	të	-në, n
Rrjedhore	(a) so	së, të	së, s
Shumës			
Emërore	(a) ta, (a) to	të	të, -t
Gjin. dhan	(a) tyne (tyre)	të	-t
Kallëzore	(a) ta, (a) to	të	-të, -t
Rrjedhore	(a) sish, (a) sosh	së, të	-t

Po të krahasojmë format ndër rase përkatëse të dëftorëve dhe të dy palëve të artikullit të shqipes, do të na dalin të qarta zhvillimet e artikujve nga dëftorët; ja si duken ato: emërorja e mashkullor ja njëjës të dëftorit, po t'i hiqet elementi i saj deiktik a (ai, ay), piqet morfologjikisht kryekëput me

trajtat e rasës përkatëse të nyjeve të gjuhës shqipe *-i, -i, (u) i madh, i bukur, djalë-djali, mal-mali*, postpozitivi i gjuhës shqipe na del me dy trajta *-i, u: djali, mali dhe fiku, miku*; ky i fundit d.m.th. artikulli enklitik *-u*, përdoret te emrat që përfundojnë me vlera *k, g, (h)* ose me zanore të theksuar: *shteq, lak, breg, shok, ten, pleh, vlla dhe shtegu, laku, bregu, shoku, tehu, plehu, vllau, dheu, shiu*. Këtu shtrohet çështja e gjenezës së këtij artikulli, artikullit të sprasmë *-u*, që albanologu Meyer e qet të dalë nga artikulli enklitik *-i*, ngërthyer me bashkëtingëllore grykore, nga i cili ngërthim fundorja *-u*, nisur në fillim ndër emra me temë në grykore e përhapur pastaj ndër kategori të tjera nominale (Meyer, *Kurzgefasste albanesische Gramatik, 1883*).

Albanisti i madh danez, Holger Pedersen i mbronte tezën se artikulli enklitik *-u* duhet të ketë moshë më të madhe në topikën emër + mbiemër i pajisur me një prepozitive: *pus i thellë = pusi i thellë*; ndërsa *lidhja mik u mirë*, s'ishte punë që bëhej, pse *i*-ja prepozitive kishte kohë që kishte flakur artikullin proklitik *u*, që rrinte përpara një kategorie nominale të shqipes (Festschrift til Vilhelm Thomsen 284; KZ. 36, 309), prandaj shprehja në fjalë u transformua në *miku i mirë*. Burimin e artikullit postpozitiv-*u* në kategorinë e caktuar nominale, S. Riza (Buletin) e gjen te emrat që mbarojnë me zanore ku del njëherë *-v* epentetike me qëllim heqjeje të hiatusit, bie fjala *kai – kavi; vëllai – vëllavi*, ndërsa me zhdukjen e *i*-së fundore e me kthimin e *v-së* në sonant doli formimi i ri *kau, vëllau* etj. Ky zhvillim u shfaq siç dihet, së pari ndër emra që mbarojnë me zanore, e pastaj shkoi e u shtri në kategori të tjera nominale, fjala vjen të emrat me temë në gutural: *iik-u, lak-u, shteg-u, bark-u, burg-u, drang-u, teh-u*. Mendimi i Pedersenit se *-u*-ja duhet të ketë qenë primare në këtë lloj emrash, duket i pakundërshtueshëm pse *i*-ja e fjalëve të përmendura do të shkaktonte palatalizimin e guturaleve ndër shprehje të kategorisë nominale në shqyrtim.

Format e nominativit mashkullor njëjës të artikujve të gjuhës shqipe, d.m.th. të prepozitivit dhe të postpozitivit janë identike, pra artikulli proklitik i gjuhës shqipe *-i* u krijua nga enkletiku *i-* me anë të një përsëritjeje hiperkarakterizuese brenda sandhit (Çabej, *Studii Si Cercetări Lingvistice, X, 4, 1959, Buletin, 1963/3, f. 78*). Në vazhdim të këtij shpjegimi të marrim në shqyrtim e të theksojmë pëlqimin e plotë të

gjinore-dhanores bashkë me kallëzoren e dëftorit me rasat përkatëse të prepozitivit në pozicionin e tij të dobësuar, duke u reduktuar vokali i tij në gjysmëvokalin *ë*: *atij* (j), *atê*, *atë*, *tê*, *të*. Po kjo gjë mund të thuhet për dobësimin e rrjedhës së dëftorit me ç'rasë reduktohet vokali i saj në rasën gjegjëse të njëjës së përparme (a) si: *së*.

Sa i përket artikullit enklitik ai megjithëse përftohet nga dëftorët, nga ana tingullore ai ndryshon pak prej njëjës proklitike. Në qoftë se format e të dy palëve të artikullit të gjuhës shqipe i lëmë anash, pse ndër to nuk gjejmë kurrfarë ndryshimi, e të marrim në vështrim trajtat e gjinore-dhanores, në to vihet re një ndryshim i vogël, që forma e njëjës palë, e lagjes së prepozitivit na del me *të*, kurse artikulli enklitik mbi dëshminë e fillit të traditës sonë letrare, përfundonte më *-t*; e mbaresat rasore të shumësit të dhanores dhe kallëzores na dalin me *-të*, që vërtetojnë reduktimin e një zanore je të gjatë, zakonisht të vokalit *a*.

Te gjinore-dhanorja e shquar e mashkullores na del një *-i*; (i) *gur-i-t*, e që sipas të gjitha gjasëve na dëshmojnë emrat e farefisnisë që nuk njohin një shfaqje të tillë, duket të jetë e re: *të birt*, *të vëllat*, *të shoqt*, përkundër: (i) *gurit*. Ky vokal që është quajtur shtesë anaptiktike ngjan të ketë hyrë prej emërores së shquar a nga gjinore-dhanorja e pashquar.

Sa i përket kallëzores njëjës mashkullore e femërore, puna ndodhi si vijon: të merrej *nusenë bukur*, ishte punë që nuk mund të qëndronte, sepse, siç dihet, njëjës të parme *-në*, gjuha shqipe nuk mbahej mend të ketë pasur, atëherë në këtë shprehje ndërhyri në analogji me format e trashëguara *i-ja* apo *e-ja* e emërores njëjës e artikullit prepozitiv. *Në-ja* është zhvillim i asimilimit të grupit *-nt* që mori rrugën e formimit të okluzivit *-t* në *-d*, pra *-nd*, pastaj përfundoi te *-nn* dhe më në fund *-n* (ë); e kjo kronologjikisht duhet të vihet në periodën përpara depërtimit të latinizmave të para, kur një lidhje e tillë *-nt*, sot te *nd*, pra një grup i tillë, grupi *-nt* i huazimeve latine nuk merr pjesë më në ndërrimin e përmendur fonetik të fjalëve të fondit të trashëgimisë indoevropiane.

Vjetërsia e lashtë e akuzativit të shqipes, pra edhe mosha e madhe e artikullit të saj provohet me anë të formës së kësaj rase, në formimin e të cilës marrin pjesë, trajtat e vjetra indoevropiane të akuzativit *-om*, *on* dhe *-t* e burimit të artikullit dhe përfundoi te trajta e akuzativit të sotëm. Rrugën e

zhvillimit të tillë e vërteton edhe forma e vetës së tretë shumës të prezentit: *shohënë-shohin*, *japënë-japin*, *vrasënë-vrasin* forma që përveçse te monumentet e vjetra gjuhësore të gjuhës shqipe, na dalin edhe sot e gjithë dltën ndër disa dialekte arkaike të shqipes; e trajta verbale *-ënë* na del prej *-onti*, *krah...* të lat. *agunt*.

Me errësimin e trajtave përkatëse të dëftorit janë përfutur, siç u tha, format e artikujve të gjuhës shqipe; në këtë mënyrë nga dobësimi i gjinore-dhanores njëjës të femërores dolën *së*, dhe *-së*, *s*, si dhe prej rrjedhores (*a*) -*so* po me këtë rrugë u zhdrivilluan format e artikujve të kësaj gjuhe: *së*, *së*, *-s*. Te gjinore-dhanorja e dëftorit u desht të tfillonim *j* – në fundore, e cila mendojmë del si pjesë anorganike e sekundare, po ashtu e po me atë funksion që ka një *j* që shfaqet te një kategori e vogël emërore, *te muej*, i *huej*, (Çabej, *Lingua Posnaniensis*, VII-VIII).

Tashti t'i rrokim format e nominativit njëjës të artikullit prepozitiv dhe të atij postpozitive: *e -a*; që në ballë të këtij vështrimi na bie në sy mospuqja e tyre përkundër nyjës së plotë të trajtave mashkullore njëjës të artikujve përkatës: *i madh-madhori*, *lisi*.

Burimin e artikullit prepozitiv *-e* të femërores njëjës, G. Meyeri e qet të dalë prej temës përemërore indoevropiane *-ia*, që në shkallaren e parë u përfutua *-jo* te *ajo*, *këjo* (*kjo*), e që në nyjën e patheksuar *-ia-u* kthye në *-e*. (Albanesische Studien III, 3). Në shpjegimin e gurrës së artikullit në shqyrtim, arbëresh M. La Plana rrah shtigje të tjera (*Studi Lingu, albanesi*, I, 27), duke u mbështetur në femëroren indoevropiane *e-ja* që në fazën e parë në gjuhën shqipe dha *-ajo* e prej këndej *-eo* që me pësimin e mëvonshëm përfundoi në *-eio*, *eu*, më në fund në *e*.

Mendimi i G. Meyerit është i kritikueshëm njëherë pse një temë indoevropiane me *-a* të gjatë në gjuhën shqipe nuk do të soste te *e* sipas rregullave fonetike të kohës së atëhershme, por vetëm te një *o*, siç rezulton nga shprehjet e shqipes së fondit indoevropian a lashtogrek; të krahasohet lat. *mater*: shq. *motër*; greq. vjet. *makhana*: shq. *mokën*, *mokër*; këndej na del se pasqyrimi i temës së dëftorit indoevropian me një *a*, siç është rasti i dëftorit *-ia*, është *o*, në *ao*, *ajo*, *kë-jo*, *kjo*, e jo kurrë *-e*. Edhe analiza e Joklit li- dhur me prepozitivin në fjalë, në thelb, donte të provonte vështirësitë e pranimit të një shpjegimit të Meyerit. (*Indogermanisches*

Jahrbuch XX (VII) 114). Rrugët që përshkon dhe shkallaret e zhvillimit të këtij artikulli që paraqet arbëreshi M. La Piana nuk na bindin.

Gjykimi i Çabejt që e ka shfaqur tash sa kohë, krahas. *Studii si Cercetări Lingvistice*, XII, 1959, dhe Buletin, 1961/4 ka zënë e po tumiret, që artikullin proklitik *-e* e qet prej artikullit postpozitiv *-e* me anë të një përsëritjeje sintaktike, në fjalët: *fushë+e: fusha*. Formimin e saj e vendoste në kohë kur krasis i lidhjes *ë+e* nuk jepte një *a*, qysh zhdrivillohej ky grup duke përfunduar me një *a*: *më+e=ma; të+e=ta*, e me analogji edhe *i+e=ia, ja*. Burimin e *e*-së prepozitive, Çabej e gjente te mbaresa e femërore të kategorisë nominale më *-e nuse, lule, viçe; nuse bukur-nuse e bukur, lule bukur-lule e bukur*; ky artikull u shtri mandej edhe ndër kategori të tjera nominale: *dele e bardhë, vajzë e re, ditë e gjatë*; artikulli në fjalë, me anë të përsëritjes, kaloi në gjini të tjera: *mallnë e lartë, zogun e malit, miellit e bardhë* (Çabej, Buletin, 1961/4). Me këtë shpjegim e burim të artikullit proklitik të emërores njëjës nuk kënaqet M. Camaj (*Albanisch Wortbildung*), që *-e*-ja e femërores njëjës të ketë dalë prej një forme të artikullit enklitik *ë+e=e*, ndërsa më vonë kemi zhvillimin *ë+e=a; më -t-e+ma, të+e=ta*, etj pse, siç thotë ai historikisht nuk kemi farë dëshmish mbi zhvillimin e krasit *ë+e=a* (131), qysh e kish tfilluar Meyeri në gramatikën e tij të vogël, faqe 24. Camaj i del zot një shpjegimi tjetër, që mbështesa e këtij artikulli, e nyjës proklitike femërore njëjës (*e*), do të ketë qenë një temë me *-o*, që prodhoi *a*, që fonetikisht është krejt në rregull, e cila *-a* më vonë me dobësimin përftoi një *e*.

Me anë të dobësimit të vokaleve të formave përkatëse të dëftorëve të gjuhës shqipe, kanë dalë trajtat gjegjëse të artikujve të kësaj gjuhe po ashtu nga emërore-kallëzorja shumë e dëftorit: (*a*) *ta*, (*a*) *to* u përfatuan nyjat *-të: -të, -t*; nga gjinore-dhanorja shumë e dëftorit (*a*) *tyne*, (*a*) *tyre*, dolën *-të, -të, -t*, si dhe rrjedhorja *sish, sosh*, të cilat me errësimin e vokaleve të trupit të këtyre trajtave gjinikuan *-së, -të: -t*. Këtu na bie në sy një gjë që ndër trajtat e rrjedhores së artikullit proklitik e enklitik, përveç *-së* na dalin edhe *-të, -t*, që s'janë përfundime a zhvillime të dëftorit *sish, sosh*, por vijnë prej formave të rasave të tjera, të gjinore-dhanores.

Meqë gjuha shqipe ka dy palë artikujsh, artikullin prepozitiv dhe atë postpozitiv, vendosja e moshës së tyre ka peshën e vet, prandaj do që shqyrtohet pak më për së afërmi.

Në zhdrivillimin e problemit të sistemit të artikullit *të gjuhës shqipe kemi provuar dyjësinë e artikullit, gjë e njohur që moti.

Çështjen e artikullit e kishte hetuar në studimet e veta dietari i njohur, albanisti i shquar dhe indoevropëisti i dalluar, Holger Pedersen, njëherë në studimin që e botoi në bleun *Festkrift til Vilhelm Thomsen* (1894), pastaj në traktatin – *Die Gutturale im Albanesischen*. KZ. 36 (277-341), ku, duke rrokur problemin e origjinës së sistemit të artikullit të gjuhës shqipe, e duke shikuar faktet lidhur me këtë sistem në tërësinë e tyre, i njeh parësinë prepozicionit, pse nga neksi *pus i thellë* nxjerr lidhjen tjetër adjektivale *pusi i thellë*, prej këndeje edhe burimin e postpozitivit prej artikullit proklitik (Buletin, 1959/3), 228. Tezën e prioritetit të prepozitivit e mbron edhe S. Riza (Buletin, 1958/4), duke i dalë zot gjykimit që shqipja e vjetër njihte vetëm sintaksën e njëjës prepozitive që e dëshmojnë, sipas mendimit të tij reliket e përdorimit të emrave farefisnorë, pajisur me artikullin proklitik: e *ema*, *i biri*, *i ati*, *i ungji*, *e bija*, *i nipi*, *e mbesa*. etj. Në vazhdim të kësaj paraqitjeje. S. Riza përfundon me pohimin se nyja prepozitive e shqipes si dhe mbarë prokliza e pronorëve me përmbysjen e saj, me kohë u shpërngul prapa emrave dhe u vendos sintaksa postpozitive. Skema e reliktit të *mi vllazën* tregon qartë, sintaksën e dikurshme të proklizës ku *të* do kuptuar si artikull i emrit vllazën, e *mi* pronor primar i panyjshëm që pastaj, e përmbysur, na del lidhja *vllazën të mi*.

Në anën tjetër, faktet gjuhësore të gjuhës shqipe, po edhe të asaj rumanishte, peshuar njëherë e mirë, shkojnë në dobi të parësisë a të moshës më të madhe të enklizës. Qysh S. K. Sandfeldi kishte shfaqur mendimin se postpozitivi është më i vjetër se prepozitivi (*Balkanfilologien*, 98, khr. Jokl, *Litteris*, IX, 206); këtij lloji artikulli ia njihte vjetërsinë duke e qitur të periodës prehistorike edhe M. La Piana (*Studi Linguistici albanesi* 1939, 29). Mbështesë të fortë gjen ky mendim edhe bëhet më afër menç ikur dihet se burimi i enklizës dëshmohet me zhvillimin e akuzativit të gjuhës shqipe në formimin e të cilit merr pjesë mbaresa e lashtë indoevropiane të cilës i ngjitet, po në atë kohë, artikulli *t*; *mt*, *nt*, që me rrugë asimilimi na del *nd* dhe në fund *nm*, *në*; përfundimin e këtij asimilimi e shohim në vetën e III shumës, siç e zëmë ngojë, të prezenti *-onti*, *shohënë*, *shohin* lat. *agunt*. Lidhur me vjetërsinë e tij, H. Pedersen nga analizimi që u kishte bërë nyjave të shqipes postpozitivin e qitte nga artikulli prepozitiv, porse në

anën tjetër ky dijetar ka vërtetuar në mënyrë të prerë që akuzativi i shquar i gjuhës shqipe -*në* të fjala *nusëne* buron prej bazës parashqiptare *nusam + tam* nga e cila lidhje u përftua trajta e sotme *nusen* (s). Nga përfundimi i sipërshënuar del e qartë se një zhvillim i tillë hyn te perioda që i prin depërtimit të parë të huazimeve latine qysh e vuri re arbëreshi M. La Piana (*Studi linguistici albanesi I*, 1939, 29). Pak ndryshe gjykon Jokli kur artikullin e gjuhës shqipe përkah koha e vendon në periodën e ndikimit të latinishtes (JF. 50, 45).

Dihet se artikulli postpozitiv është i qëndrueshëm, i ngulët, qoftë përkah forma e vet, qoftë nga ana e kuptimit. Funkzioni i tij mbetet ai që të dallojë diçka që s'njihet nga ajo gjë që na është e njohur. Në anë tjetër, artikulli prepozitiv na del i lëkundshëm dhe me një hape të konsiderueshme funksionesh me tendenca të forta kalimi prej një kategorie në një tjetër; pra ai paraqitet i lëvizshëm, i paqëndrueshëm, përkundër artikullit enklitik.

Një raport i tillë në analizë të fundit na dëshmohet nga krahasimi i gjendjes së sotme i të dy palëve të artikullit dhe të asaj si na paraqitet ajo në monumente të vjetra letrare si dhe nga dialektet më arkaike të gjuhës shqipe nga ato më të rejat, – post- pozicioni na del me vjetërsi të madhe, përkundër prepozitivit që na del më i vonë dhe zë vend në periodën letrare. Për vërtetim të moshës relativisht të vogël të artikullit prepozitiv dhe të vjetërsisë së lashtë të artikullit postpozitiv të vazhdojmë së shqyrtuari raportin sintaktik midis artikujve të gjuhës shqipe. Këtu duhet të kemi parasysh faktin se artikulli prepozitiv ka lidhje të ngushtë me fjalën që i prin dhe ai shfaqet kur ajo është e pajisur me artikull postpozitiv, përkundrazi ai mungon kur fjala na paraqitet pa nyjë: *lulja e malit*, ndërsa *lule mali*, *mishi i viçit*, por *mish viçi*, gjë që na shtie të pranojmë se pozicioni proklitik varet nga enkliza. Këtë raport e përforcon edhe pajtimi i artikullit prepozitiv jo me fjalën që e ndjek, por me atë që i prin; kongruenca e artikullit prepozitiv me fjalën përkatëse bëhet në gjini e në numër: *kopsht i luleve*, *maja e malit* (të Çabej, *Buletin*, 1963/3).

Para se të rrokim në një vështrim të imët paraqitjen e artikullit prepozitiv ndër kategori të shumënduarshme gramatikore të gjuhës shqipe, e quajmë të dobishme të përsërisim edhe njëherë shfaqjen relativisht të re

të proklizës dhe gjenezën sintaksore të saj nga pozicioni enklitik. Mund të thuhet me Çabejnë se për prepozicionin nuk vërtetohet një moshë e madhe.

Dijetari freng A. Dozon (*Manuel de la langue chkiye ou albanaise*, (1879), 201), shtjelloi drejt se artikulli prepozitiv, përveç përpara një emri ose një determinativi tjetër, përdoret edhe përpara një mbiemri a participi të substantivuar; ai gjendet edhe përpara numërorëve rrjeshtorë, *i dytë, i pestë, i shtatë*, pastaj e hasim përpara disa mbiemrave a përemrave të përcaktuar, *i tillë, i këfillë, i atillë, i tanë*, atë e ndeshim përpara numërorëve themelorë, *si të dyja, të tre*, te numërorët që kanë kuptim, *që të dy, ata të dy, ata të tre*; prepozitivin përkatës do ta gjejmë edhe përpara emrave të ditës dhe të disa kremtave: *e hënë, e martë, e enjte, e premte*; ai na del gjithashtu përpara disa përemrave pronorë: *djemtë e mi, vajzat e tua*; si një farë mbeturine, prepozitivi është ruajtur edhe përpara një kategorie të vogël emrash, të afërisë a të farefisnisë: *e ema, i ati, i nipi, e mbesa, i ungji*, që të gjithë me raport pronësie. Në atë kategori hyjnë edhe shprehjet: *i zoti, e zonja* me kuptim pronari, *i aftë, e aftë, i vlefshëm*. Po të përmbliidhen të gjithë këta shembuj lidhur me përdorimin e artikullit proklitik, na merr mendja se mund t'i mbërthejmë në dy kategori, pra prepozitivi në fjalë na del në dy kategoritë e artikullit mbiemëror e genitival, siç thotë Çabej, këtu bëjnë pjesë pra edhe numërorët rrjeshtorë si dhe mbiemrat, si *i tillë, i tanë* (tosk. – *i tërë*), *i cili*. Po këtu duhet të ngërthehen, si gjykon edhe Çabej (*Buletin*, 1963/3), edhe emrat e ditëve të javës dhe të festave, që kanë dalë, qysh shprehet ky dijetar, me anë të një elipse, prej shprehjesh si *ditë e mërkurë-mercuridies*. Në këtë kategori vendosen edhe disa emra entikë që na dalin me ose pa sufiks: *i Pukës, i Bregas, i Gjakovës, i Matjan, Arbëresh i Katundas* (F. Bardhi), *i Temalas, të gjytetasitë, i Misiras* (P. Bogdani, *Cunues Prophetarum* – 1685). Në këtë sferë duhet, pa farë dyshimi, të vihen edhe shprehjet siç janë *i zoti, e zonja*, për karakterin e të cilavet paraqiten dy palë mendimesh: njëra lagje dijetarësh i quan mbiemra, pala tjetër, përkundrazi, atyre u njeh bashkë me emrat e afërsisë së tipit *i nipi, i biri, e ama, i jati*, që u përfillën pak më parë, një raport pronësie siç shprehet shkencëtari shqiptar, Çabej duke i futur këta emra të gjinisë në kategorinë e artikullit genitivor, mendim që e përkrah në mënyrë të vet edhe arbëreshi, M. La Piana, i cili te artikulli proklitik sheh një përemër dëftor me funksion pozitiv (*Studi Linguistici albanesi*, I (1939), 136).

Dihet se sistemi dy palësh i artikullit buron nga një sistem i vetëm, pra ai në kohët e para na del me një artikull. Punën e përfutimit të artikullit të gjuhës shqipe nuk mund ta ndjekim hap e të ngjitemi në kohë në perioda të hershme të kësaj gjuhe për shkak të mungesës së traditës së vonë të dokumenteve të saj. Ngjan që arsyet e gjinikimit të sistemit të artikullit të kësaj gjuhe duan kërkuar në zhdukjen e plotë të sistemit rasor të periodes indoevropiane. Në qoftë se duam ta zbërthejmë një çështje në këtë sistem të artikullit të gjuhës shqipe – çështjen e prioritetit të artikujve të saj. duket që postpozitivi në këtë gjuhë del pa kurrfarë dyshimi me moshë më të madhe, që në rrjedhën e zhvillimit, të saj e përfutoi, siç është përsëritur sa herë në këtë trajtim, artikulli proklitik në një përsëritje sintaktike që me shumë të tjerë e gjejmë te tendenca për një mbikarakterizim gjuhësor, siç e njih dijetari, Eduard Schwyzer (*Sprachliche Typencharakterisierung, Abhandlungen der Preussischen Akademie der Wissenschaften* 1941 = Çabej, *Buletin* 1963/3). Mbështetur në këtë dukuri së cilës deri tash vonë nuk i ishte kushtuar vëmendja që i takonte, Çabej e shtie tash së voni në punë në tfillimin e në shfaqjen e artikullit prepozitiv me një vistër kategorish gjuhësore të gjuhës shqipe.

Tendenca e fortë e mbikarakterizimit në gjuhën shqipe dhe në gjuhët e tjera dëshmohet dhe përfordhet me shumë shembuj të kësaj dukurie, t'i përmendim disa: mbaresa e fundorit *a* të kategorisë së fleksionit nominal, domethënë të emrave të vjetër të gjuhës shqipe, pra të tipit: *trima, pusa, derra, burra, lamsha*, shtrihet në një kategori tjetër emrash që në shumës mbarojnë me *-ë*, si *doktorë, profesorë, studentë, nëpunës, civilë, shoferë* etj., ku vokal i reduktuar *ë* nuk shqiptohet në pjesën më të madhe të të folmeve gege; një palë arsyes duan kërkuar edhe në faktin që *-fundori ë* i kategorisë së përmendur nominale nga përdorimi i gjatë dhe prej familjarizimit të folësve më të, siç thotë Çabej shkon e bëhet i pamjafte-shëm për të shfaqur karakteristikën e shumësit të asaj lagjeje të emrave në shqyrtim, prandaj ndihet nevoja e dallimit të shumësit të kësaj kategorie emrash edhe përkah ana tingëllore duke marrë fundorin *-a* që u përket emrave mashkullorë të tipit të përmendur: *doktora, profesora, studenta, civila, shofera, mjeshtra, nëpunësa*, etj.

Bukuria e mbikarakterizimit në gjuhën shqipe shprehet në mënyrë të dukshme edhe te mohimi i dyfishtë bashkë me një sërë gjuhësh të tjera,

qysh e vuri re dijetari shqiptar Gj. Pekmezi në gramatikën e tij (1908), e që këtë dukuri e zë ngoje edhe E. Schwyzer. Në këtë shfaqje bën pjesë nga fusha sintaktike edhe pjesëza *dot* që shpreh pamundësinë e një pyetjeje, në ngërthim: *nuk vij dot (nuk mund të vij)*; mandej – *vjen dot?* (= *mund të vijsh*), që e kish shpjeguar Max Lambertzi (*Leipziger Vierteljahrsschrift für Südosteuropa*, VII; Alb. Lesebuch I, – *Lingua Posnaniensis*, VII, 92), duke e qitur nga futuri *do të*; ika gjasa që pjesëza *dot* nga që është specifike e toskërishtes dhe e arbërishtes së Greqisë të ketë dalë nga përsëritja e fjalisë: *nuk do të vij dot* duke u shkëputur prej saj pjesa *dot* dhe dalë më vete, e pavarur. Formime relativisht të reja na dalin edhe protezat *a, kë*, të përemrat dëftorë, që për arsye fonetike nuk mund të jenë kurrsesi të vjetra, pse, siç dihet në ballë të fjalëve ato do të rrëgjoheshin ose do të zhdukeshin fare: *ai, ky, ata, këta, atillë, këtillë, ashtu, kështu, atje, këtej, shkodranisht njिता kosovarisht çetu, çeta, (= këtu, këtë), tutje (=këtu, atje)*.

Trajtat e pronorëve të gjuhës shqipe, ato të femërorëve si na paraqiten në gjuhën e sotme letrare si dhe në shumicën dërmuese të dialekteve të kësaj gjuhe, dhe ato të një faze më të vjetër të shqipes, të periodës paraletrare dalin me ndryshime të ndjeshme; ja skema e tyre:

femërorë I – të mira, të tua, tona, tueja,

mashkullorë II – të mi, të tu, tanë, tuej.

Në dokumentet e hershme të gjuhës shqipe, në Mesharin e Buzukut format e pronarëve në shqyrtim nuk na dalin të ndryshme për mashkullorë e femërorë, porse ato na paraqiten morfologjikisht të njëjta për emrat e gjinisë mashkullorë e ata femërore. Disa shembuj nga ata të gjuhës së vjetër këtë e sqarojnë dhe e dëshmojnë më së miri: Buzuku – *duartë e mi, e kanbëtë e mi, bijtë e tu, e bijat e tu vinjënë; udhëtë e ti, për të drejtat tonë; të lutunatë tonë*; te Budi këto forma na dalin dyfish, domethënë na duken në dy forma në trajtën mashkullorë dhe femërore: *të lutunatë e mi, fjalët e mi, gjymtyrëtë tonë*, përkundrejt: *zemëratë tona, vashasit e tua*; ndërsa te Bogdani kosovar na shfaqet vetëm forma më e re, ajo që është në përdorim sot. Një fillzhvillim të tillë e ndeshim edhe sot e gjithë ditën në të folme toske e gege: thuhet *jot' amë* e jo *jote amë, jot kunatë*, por jo *jote kunatë*, porse *ama (e) jote, kunata jote*. Sot thuhet dhe shkruhet zakonisht burrat e tjerë, gratë e tjera: *burra të tjerë, gra të tjera*, por në disa dialekte si dhe në

gjuhën letrare të gegërishtes vihet re të shumtën një përdorim kësisoji i kësaj lidhjeje: *burra tjerë, burrat tjerë; gra tjera ndoshta edhe gra t'tjera* – thënë më saktë: *gra t'tjera; gratë t'tjera* (krh. *Jeta e re, Përparimi* si dhe krijimtarinë letrare të shkrimtarëve shqiptarë në Jugosllavi). Vendosja e artikullit prepozitiv midis një emri dhe një mbiemri, apo të një atributi, në rasën gjinore a dhanore nuk na del e zakonshme ndër monumentet e vjetra të klasikëve shqiptarë: Buzuku e pasuesit e tij.

Buzuku (Meshari), te muojt shtatë (=muojt të shtatë), 291; *gjellënë e jetësë glatë (-të glatë)*, 291, *-flit Jezu t'parëvet priftënet (=të priftënvet)*, 99. Në *formulën e pagëzimit* (1462) thuhet: Premërit Atit; te *Budi* (DC) ndeshim këta shembuj: e gjenisë tyne (=së tyne); në *Parathënien e Fjalorit të Bardhit* hasim: mjeshtrit pëllasit; *Bogdani* na sjell (I, 55,54): valëvet detit (=Çabej, *Buletini*, 1963/3) në *Rapsodie e scene di vita degli Albanesi di Calabria*, (mbledhur nga Giuseppe Ferrari) gjejmë: ndë përroit Kalabrisë, *dreq zallit detit*, në veprën *Manuel de la langue chkiye ou albanaise* të A. Dozonit shënojmë: *na vjen në shtëpi të çupave mbretit* (=të mbretit), tq. 208, nga shkrimet e Kristoforidhit nxjerrim *bukëvet elpta*, prej Kanasë Galilesë; *qenit bardhë* (gramatika e tij) (Dhiata e Re në gjuhë gegërishte, 219 (=Çabej). Edhe në *Divanin* e Sheh Maliqit të Rahovecit na dalin shembujt të tillë: *Emrit zotit mos m'u da*; mandej: *n'det dynjas kemi sharru* (47). Në *Divanin* e përmendur të Shehut të Rahovecit e në lidhje atributive: *ashki yt, zemra jote me pas ndrît sikur hana* (43), *shtati em m'u ba i rând* – nuk na shfaqet kurrfarë artikulli prepozitiv, që sot në të folmet shqipe të kësaj ane është tipar i zakonshëm.

Në disa raste të dokumenteve të vjetra të klasikëve shqiptarë të shekullit XVI e më vonë, si dhe në materiale jo të pakta të të folmeve arkaike shqipe, kryesisht të kolonive arbëreshe të Jugut të Italisë dhe të asaj të Greqisë, artikulli postpozitiv që i rri- prapa atributit të gjinores shpeshherë i mungonte kësaj rase: *pulomba e dorës, brezi pjakavet* (Çabej, *Buletini* 1963/3) dhe nga *Divani* i Sheh Maliqit: *drita hakit*.

Po u përmblohdh ajo që u tha në lidhje me mungesën e artikullit prepozitiv në një periudë të hershme të gjuhës shqipe e në lidhjen emër i pajisur me artikullin postpozitiv dhe mbiemër që i mungon artikullin prepozitiv, si dhe në lidhjen genitivale, domethënë emër + emër në rasën

gjinore-dhanore, – na del qartë që skema e të dy rasave të përmendura ka qenë e njësishe, që do të thotë pa artikull prepozitiv. Artikulli prepozitiv mungon edhe sot e gjithë ditën me ndërtime të bisedave me pjesëmarrje shpirtërore siç e konsideron Çabej këtë lloj kuvendimi, përkundrazi ndërtimit të bisedës referuese: *nëna e shkretë*. Shfaqjen e vonë të artikullit prepozitiv përgjithësisht në lidhje të përmendura e përforcon edhe rrethana, që mbiemrat e gjuhës shqipe na dalin me artikull, e pa të paraqiten edhe sot mbiemrat e përbërë dhe të prejardhur: *i pashëm, i sqimët* pranë: *sqimtar, sqimtare, sqep gjatë, sqepkuq, i zemrueshëm, zemrak, dimërak, gushtak, mollë verore, mollë dimërore, kontratë afatgjatë, dele bardhoke, dele e bardhë*. Nga sa u pa prej shembujve sjellë këtu sipër, ajo lagje e mbiemrave të paartikull të kategorisë së kompozitave dhe të atyre të prejardhur nuk formuan ndërtime me artikull, sepse sufiksi që u rrinte pranë ia zinte këmbën artikullit, që përndryshe, është i domosdoshëm te kategoria tjetër e mbiemrave, te mbiemrat e nyjshëm. Po deshëm të sigurohemi për kronologjinë e kësaj shfaqjeje në gjuhën shqipe mbi dëshminë e shumë të dhënave mund të provohet se mungesa e këtij tipi të adjektivave vërehet edhe në periodën e hershme të kësaj gjuhe, për çka disponojmë dokumente të shumta: *botëkuqe, gunëzi, Marco Gunëzi, Janë Gunëzi Gruemirë* (Villa clamada grouemir), *Pietro Grouemira – Catastro Veneto, 1416-1417; gojëmadhi, Bencho Gogliamadi – Golamadhët* – ruhet sot e gjithë ditën në Mal të Zi dhe shënon emrin e një farë fisi malazez); *qimekeq* (Villa Clamada Chimechechi), *Gi- orgi Chimechierchi*, dokumentuar më 1416-1417, si na dalin te *Co- rdignano – Catastro Veneto*. Po të kësaj periode datohen edhe shumë mbiemra që janë zveshur prej artikujsh prepozitivë: adjektiva që shënojnë përkatësi familjare: *Vogli, Bardh% Ziu, Kuqi. Verdhi, Madhi, Shkurti, Shkurta, Gjergj Zeza* (Çabej). Lidhur me artikullin prepozitiv të këtij tipi të adjektivave që mungon te një lloj i tyre, është vështirë të pranohet pandehja se prepozitivi me substantivimin e mbiemrave humbi pse zhdukja e artikullit do të ishte vështirë të mendohej ,sikur ai të kishte qenë pjesë e tij konstativë që në krye të herës. Artikulli i mbiemrave të substantivuar ruhet në gjuhën shqipe të mëvonshme, si na dëshmojnë këto shprehje: *e kuqja, e djathta, e mira, e liga*. Arsyeja e mungesës së artikullit do të kërkuar gjetiu, ai do të kërkuar në faktin që emrat që tregojnë person a ndonjë vend – toponim marrin pjesë në ndryshimet

fonetike, por jo edhe në ndryshimet gramatikore (Çabej). Pranë lidhjeve *Justië e gjanë, fushë e bardhë, guri i zi, gur i kuq, ujë të mirë, krye të zi*, nga toponimia u rrinë përballë emrat përkatës: *Fushëgjanë-a, Fushëbardhë, Gurzi, Gurakuq, Ujmirë* (në Drenicë të Kosovës), *Kryezi*, etj. Edhe emrat e disa vendeve nga ata të toponimisë të dalë nga shenjtoreësh, paraqiten konservativë, pa artikull, ndërsa emrat e vetë shenjtoreëve na dalin me artikull, prepozitiv gjithsesi: *I shën Kolli, I shën Gjergji*, përballë emrave të vendeve: *Shënkoll, Shëngjergj* (Çabej, në veprën e cekur).

Nga një vështrim përmbledhës mbi sa u shtjellua deri këtu mbi përfitim e sistemit të artikullit të gjuhës shqipe, del e qartë shfaqja e proklizës nga enkliza.

Një fakt që enklizën e gjuhës shqipe e bën me moshë më të madhe se proklizën, përveç të dhënash të tjera në radhë të parë është qëndrimi dhe zënia vend e artikullit postpozitiv para emrit, dalë prej përemrit dëftor që në anë tjetër provon edhe pozicionin e mbiemrit dhe të atributit përgjithësisht para emrit. Pozicioni i mbiemrit të gjuhës shqipe paraqet rëndësi vendimtare në punën e vjetërsisë së artikullit të kësaj gjuhe. Analiza e periodës së vjetër të gjuhës shqipe si dhe gjendja e saj na dëshmon që pozicioni i adjektivit dhe i atributit pas emrit paraqet ndërtimin normal; ndërtimi i anasjelltë jo që nuk është i mundur në gjuhën shqipe edhe në perioda të hershme të saj, veçse do pasur parasysh një gjë që pozicioni i kundërt parapëlqehet, siç shprehet Çabej „kur është puna për një theksim afektiv: në literaturë, përveç rasave ku ka imitime modelesh së huaja, me këtë ndërtim synohet dhe në një të spikatur e të vënë në pah". Për gjenezën e artikullit pre- pozitiv që u përftua prej enklizës me anë të një përsëritjeje në ngërthim të fjalisë, do ditur se shfaqja e tij në gjuhën shqipe të periodave të lashta është minimale e përdorimi i tij sa vinte e përherë shtohet.

PËREMRRAT

Përemrat vetorë

Kategori gramatikore më vete, me shumë interes shkencor na dalin në gjuhën tonë përemrat, sidomos përemrat vetorë.

Përemrat vetorë i cilëson veçoria e numrit, e rasës dhe e vetës.

Përemrat vetorë, në kundërshtim me përemrat e tjerë, nuk kanë kategori të gjinisë, ku na del vetëm një trajtë e gjinisë për mashkullorët dhe për femërorët.

Pothuaj se të gjitha gjuhët indoevropiane paraqesin interes të shënueshëm në punë të përemrave vetorë, që duket në punën e identitetit a puqjes së rrënjës së njëjësit të vetorit *unë* (u) me shumësin *na, ne*: origjina e vetës së dytë, njëjës kundruall shumësit *ti: ju*. Lidhur me këta përemra një gjë na del e qartë, që trajta *-na, ne* në vete nuk ngërthen shumë „unë”, porse ajo për- mban një „unë” me shumë të tjerë, gjithashtu edhe *-ju* do të thotë ti me shumë të tjerë, e jo shumë „ti”.

Një karakteristikë tjetër e tyre shfaqet në faktin që tema e përemrave vetorë ndryshon prej trajtave të zhdrejta të tyre e që dalin rrënjësh krejtësisht të ndryshme, qoftë në gjuhën shqipe, qoftë edhe në gjuhë të tjera indoevropiane: *unë, i mue, mue (më), meje*; lat, *ego, mihi*, greq. vjetër: *ago-emon*; serbokroat. *ja-mene, meni, oni-njih, njima*; gjerm.: *ich: meiner, mir, mich*.

Shqipja ka katër përemra vetorë: 1) veta e parë njëjës: *unë (u, una)* veta e parë shumës: *na, ne*; 3) veta e II nj. *ti*; veta e dytë shumës: *ju*. Këtu kemi edhe një trajtë të përemrit vetvetor: *vetë, veten, vehten*.

Një veçori tjetër i cilëson përemrat vetorë të gjuhës shqipe dhe të disa gjuhëve të anës lindore të Gadishullit Ballkanik është dukuria që në rasat dhanore e kallëzore, në shumicën e rasave pranë trajtave tonike ata kanë edhe ato atonet. Trajtat e patheksuara përdoren me funksion përsëritjeje të kundrinës së zhdrejtë dhe të zhdrejtë sidomos atëherë kur ajo shprehet me anë të një përemri ose të një emri të shquar. Përdorimi i dyfishtë i kundrinës me ndihmën e përemrave vetorë a dëftorë të patheksuar është një prej elementeve të përbashkëta të gjuhëve ballkanike, që, përveç shqipes e kanë rumanishtja, bullgarishtja, maqedonishtja dhe greqishtja e re.

Për origjinën e këtij fenomeni që përbën një pikë të rëndësishme të ballkanistikës, mendimet e dijetarëve janë të ndara. Dukuria në fjalë ngërthehet në ato pika gjuhësore të përbashkëta, që i lidhin disa gjuhë të Ballkanit Lindor.

Mbi dëshminë e rezultateve të fundit shkencore është vërtetuar se

përdorimi i dyfishtë i përemrave vetorë nuk del i ri, porse do ta kenë një palë gjuhësh të periodave të hershme në këto anë të Ballkanit antik. E përse i përket burimit të këtij fenomeni, mendimi më i pranueshëm do të jetë ai që gurrën e tij e gjen te poligjeneza dhe që edhe ndikimi reciprok do të ketë luajtur një rol të madh.

Njëjësi

Emër. unë, (un, una)

Gjin. i mue, e mue

Dhan. mue (mua) më

Kall. mue (mua) më

Rrjedh. meje (mejet)

-Unë është trajta e lejueshme e përemrit vetor, ndërsa dy të fundit *-u*, *una* gjenden në disa të folme popullore të gjuhës sonë. Kur shtrohet çështja e burimit a e vjetërsisë, trajta *-u* del forma më e vjetër, e dy të tjera janë riformime të reja që kanë zënë të përdoren vise-vise në ligjërimet të gjuhës shqipe. Pjesa *-në* a *-na* te *-unë*, *una* konsiderohet element i përforsimit. Prandaj *u*-ja te *unë* del trajta me vjetërsinë më të madhe nga e cila në rrjedhën e kohës kanë zënë të formohen dy të tjerat: *unë*, *una*. Linguisti italo-shqiptar Mark La Piana, mendonte se *u*-ja s'ka kurrfarë lidhesh me atë të indoevropianishtes *-eg (h) om*; porse e gjente të ardhur prej indoevropian, *sue* dhe nuk e pandehet përemër të vetës së parë, por e merrte si përemër identiteti që hynte në punë për të tri vetat njëjës; pastaj e përqaste te *M*-ja e verbave pësorë; siç janë: *u dogja*, *u dogje*, *u dogj*. Sipas mendimit të dijetarit shqiptar forma *u*- në fillim shkonte bashkë me formën *-ezu* që ai e merrte si përemër vetor; pra *u- ezu*, siç përdorej në gjuhën latine: *ipso-ego*, dhe më vonë për arsye thjeshti md *u- ezu* u rruadh në *-u*. (M. La Piana, *Studi Linguistici albanesi*).

Mendimi i linguitit shqiptar na del shumë më bindës se mendimet e të tjerëve, që *-u*-në e qesin të dalë nga format e plota *unë*, *un*, *u*, pse ai përforskohet nga ana gjenetike e kronologjike: *u*-në e gjejmë qysh te Buzuku, Matrënga, mandej ajo na del në arbërishten e Italisë, në arbërishten e Greqisë, në ligjërimet shqiptare të Kosovës si dhe në të folmen e Gjirokastrës e gjetiu.

-Në-në e unë-it dhe una-it, që e zunë ngojë pak më parë e gjejmë edhe në forma të tjera të përemrave, bie fjala, te (*a)tina*, e vetës së tretë të përemrit vetor *-ai*, me origjinë dëftore: *ky-këtina*.

Trajta *mue, mua (muo)* dhanore-kallëzores do të lidhet me paraformën e hershme *-mōn, men* ku duhet të kërkohet burimi i saj e te e cila do të përqasen format e disa gjuhëve të tjera indo-evropiane, fjala vjen, ato të sllavishteve: *mene, meni*, lat. *me, mei*.

Zanafilla e trajtës së rrjedhore *meje (mejet)* do të kërkuar te arketipi i vjetër indoevropian: *me (mo)* shq. *-me* ndërsa *je-ja* do të jetë përfitim i veprimit analogjik të lakimit të një palë emrash femërorë (*luleje, rrufeje, nuseje* etj.); këtë element Boppi e afronte te mbaresa indoevropiane e një lloj përemri në-*sjo* (*Über das Albanesische in-seinen verwandtschaftlichen Beziehungen*, f. 8).

Format e shkurtra të patheksuara të përemrit vetor *unë* na dalin kësisoji: dhanore-kallëzore njëjës: *më-*

Veta e II njëjës *ti*, siç dihet, ka burim indigjen, është e trashëgimisë indoevropiane, del nga një arketip *tu*, sllav. *ti*, serbokroatisht *ti'* lat, *tu*, gjerm. *du*.

Emër. *ti, (tine, tin, tire)*

Gjin. *i ty... e ty*

Dhan. *ty, (tyj, tynë,) të*

Kall. *ty, të*

Rrjedh. *teje (tejet).*

Kjo vetë përemërore e vetorit, siç u pa, merr vise-vise pjesëzën përforcuese *-na, në* dhe nga ajo dalin zhvillime të reja të saj në të folme që nuk quhen trajta letrare, por janë forma dialektore a krahinore. Forma *ty* lidhet me atë të emërores *ti* që këtu labializohet në *-y*, pra *ty*. Frikativi *j*, i *tyj* që herë-herë ndeshet në përemrat vetorë, shpjegohet duke u parë në të një mbeturinë e nbaresës përemërore *-sjo*, që posa u përfill; në të disa shohin një sonat epentetik.

Rrjedhorja e *ti* del *tej* e *te-ja* rrjedh nga një *teu*; *je-ja* do gjykuar njësoj si ajo e *meje*. Te shkrimtarët e vjetër kjo formë na del *te* (n te). Format që na shfaqen me *t*: *tejet* duhet të jenë riformime analogjike sipas

sistemit lakor të emrave femërorë të tipit *punet, sheget, buzet, hundet*.

Veta e parë shumës na del me këto trajta:

Emër. na, ne (na)

Gjin. i ne, neve

Dhan. neve, ne

Kall. ne

Rrjedh. nesh

Format enklitike të dhanore-kallëzore dalin me na.

Na- duhet të jetë përftuar prej rrënjës indoevropiane *-nos* lat. *nos*, serbokroat. emërorja *mi*, kallëzo. *nas*, dhan. *nama*, ndërsa trajta shqipe *-ne* i përgjigjet temës përemërore indoevropiane *nos*. Ky shpjegim kundërshtohet nga M. La Piana, i cili *ne* e qet të dalë prej trajtës së dhanores *neve* > *nee* > *ne*.

Format e dhanores *neve* duan shpjeguar të veçuara sime + *ve*; sonati *-v* i elementit të fundit *-ve* do marrë pjesëz antihiatizuese, siç na del si në sistemin lakor të emrave, ashtu edhe në një kategori verbale të gjuhës sonë: *shko-v-a, pre-v-a, shke-v-a; vesh, pl. veshë: sivonë*. Forma në shqyrtim e gjinore-dhanores, me kohë ka kaluar në rasa të tjera, në emërore dhe kallëzore.

Linguisti shqiptar, M. La Piana, formën gjinore-dhanore, që me kohë doli në përdorim të emërores e kallëzores, nuk e gjen të trashigimisë indoevropiane, të dalë prej trajtës përemërore indoevropiane *nos*, siç e qesin të ardhur shumë dijetarë; përkundrazi Mark La Piana (*Intorno al riflesso della vocale „o” lunga dall’ indoeuropeo del latino nell’ Albanese*, – Palermo, 1937 – f. 14-15), në atë formë vëren zhvillim të brendshëm të *na + ve: ne + ve* që në rrjedhën e kohës u shtri në rasat e emërore-kallëzore nga veprimi analogjik i sistemit lakor nominal: *burrave: burra + ve*.

Rrjedhorja *-nesh* ka dalë nga ndikimi i lakimit nominal, të cilës i është ngjitur mbaresa emërore *-sh*: lule-sh, prej *burrash*.

Veta e dytë shumës dhe trajtën *-ju, jë* e cilëson veçoria *-u, -ju, -juve (ju)*.

Gjin. i juve, e juve

Dhan. juve (ju)

Kallëz. ju, juve

Rrjedh. jush.

Format enklitike të dhanore-kallëzores përfundojnë *me-u*, që me anë të protezës *-j* dha trajtën *-ju*.

Përemri vetvetor (Refleksivi)

Në sistemin e saj lakor përemëror gjuha shqipe ka edhe përemrin vetvetor – *vetë*, që përdoret edhe si mbiemër përcaktues vetvetor. Ky përemër përdoret pa dallim gjinie dhe për të tri vetat, si në njëjës dhe në shumë. p.sh. : *erdhi vetë, vetë e thatë, erdhën vetë*.

Përpos përemrit të përmendur vetvetor *vetë*, që prapë përdoret edhe si mbiemër vetvetor, *vetë* na del shumë dendur edhe trajta e substantivuar e gjinisë femërore – *vetvetja* apo *vetja* dhe kështu ka dalë si emër femëror: *vetja* a *vete-ja: veteja*.

Fjalët *vetja* a *vetvetja* lakohen rregullisht si emrat e gjinisë femërore, porse vetëm në numrin njëjës dhe në lakimin e shquar. Ja lakimi i saj:

emërore *vetja*, (*vetvetja*)

gjin. dhan. rrjedh. *vetes* (*vetvetes*)

Fjala *vetë* në gjuhën shqipe përdoret si apelativ, bie fjala: kanë dalë pesë *vetë* a *veta*, siç shihet vetëm në numrin shumës.

Nga ky përemër kanë dalë riformime të tjera të ngurosur, siç janë trajta *vetiu* dhe *vetvetiu*. që përdoren më shumë me vështrimin e një ndajfoljeje mënyre: kjo gjë vjen *vetiu* a *vetvetiu*.

Përemri vetvetor *vetë* na del edhe me domethënie përemri pronor vetvetor: *i veti, e veta, te vetët, të vetat*; mandej ai na paraqitet me vështrim ndajfoljor në format: *vetëm* dhe *veç*.

Përemri vetvetor ngërthen në vete shumë cilësi përemrash vetorë, prandaj trajtohet bashkë me përemrat vetorë, jo vetëm në gjuhën shqipe, por edhe në gjuhë të tjera indoevropiane, bie fjala në serbokroatishte: *svoj*,

lat. *suus*, prus. e vjetër *swais*. Në fjalorin e vet etimologjik të gjuhës sonë, albanisti i shquar austriak, G. Meyer, vetvetorin vetë e çitte të ardhur prej rrënjës pronominale indoevropiane – *sve* – *svojeti* – 468.

Përemri vetvetor *vetë* në gjuhën shqipe ndeshet edhe në forma të fortuara, fjala vjen *vendit*, *vedën*, me fortimin e dentalit *t në d*.

Përemrat dëftorë

Përemra dëftorë të gjuhës shqipe janë: *ai*, (*ay*), *ajo*, *ky*, *kjo*; shumësi: *këta këto*, *ata*, *ato* si dhe *e këtillë*, *i*, *e atillë*.

Përemrat dëftorë *ai*, *ajo*, *ata*, *ato*, siç dihet hyjnë edhe në kategorinë e përemrave vetorë, megjithëse në të vërtetë janë dëftorë të mirëfilltë. Ky lloj dëftorësh ka tri gjini: mashkulloren femëroren, dhe asnjën. Trajatat e dëftorëve asnjën *këta*, *ata*, që përdoren vetëm në numrin njëjës, në gjuhën e sotme të shkrimit na dalin shumë rrallë, ato në përgjithësi janë zëvendësuar me trajtat e përemrave dëftorë *kjo*, *ajo*. Në shkrimet e autorëve të vjetër shqiptarë – hasen me përdorim të dendur: për këta anshtë me u *maravejuem-e këta ai nuk e tho ën vetëhenë* (Buzuku).

Njëjës		Shumës	
mashkullore-femërore	asnjanëse	femërore	mashku.
Emër. ky, kjo	këta	këta	këto
Gjin. i këtij, i kësaj	i këtij	i këtyne	i këtyne
Dhan. këtij, kësaj	këta	këtyne	këtyne
Kall. kësi (këtij) këso	(kësaj)këta	këta	këto
Rrjedh. kësi (këtij)	kësish	kësosh	
	kësyresh (këtyne),	këtyne(ve)	
	këtyre (ve)	këtyre-ve	

Njëjës	Shumës			
mashkullore	femërore	asnj.	mashku.	femërore
Emër. ———	ai (ay) ajo	ate	ata	ato
Gjin. ———	i atij asaj	atij	atyne (-re)	atyne (re)
Dhan. ———	atij asaj	atij	ata	ato
Kall. ———	asi (j) aso (asoje)	asi	asish	asosh

sije(atij) (asij) (atyne-re-atyne(re))

Përemri dëftor i thjeshtë, pa elementin deiktik, na del në mënyrën pasuese:

Njëjës

Shumës

mashkullore femërore

mashku. femërore

Emër. ———	i, y	-j(o)	ta	to
Gjin. ———	i ti (j)	i saj	i tyne-tyre	i tyne, i tyre
Dhan. ———	ti (j)	saj	tyne-tyre	tyne-tyre
Kall. ———	si (je),	sije so-soje	sish	sosh

Përemrat dëftorë *ky, ai (ay), këta ata* na dalin përpara me elemente deiktikë: *kë* –, *a* me kuptim afërsie a largësie. Në anë tjetër prania e tyre dëshmon moshën e re të këtyre përemrave, pse sikur ekzistenca e tyre të na dilte e kryehershme trajta e tyre fonetike do të paraqitej ndryshe: njëherë *a-ja* e dëftorit *ai (ay)*, duke qenë e patheksuar në pozicionin nistor, do të kishte përfunduar në një vokal të reduktuar *-ë*, ose do të ishte zhdukur krejtësisht.

Po t'i sillemi burimit të përemrave dëftorë *ai, ay, ky, kjo, (këjo), këta, këto, ata, ato*, mendimet e dijetarëve na dalin të ndryshme. Është interesant të vihet re, se përemrat dëftorë na shfaqen tri rrënjësh a temash: me zanore (*i, y*), mandej me *t* (*të, të, to, ta, tyne, tyre*), si dhe me *-s* (*si, so saj, sish sosh*).

Te vokalet *-i, -y* të përemrave dëftorë *ai, ay, (ky)* sipas mendimit të G. Meyerit *i-ja* u përftua nga arketipi indoevropian *is*, ndërsa *-jo-në* e *kjo – këjo, (a) jo* e nxirte nga tema pronominale indoevropiane *ia* dhe e krahasonte me të latinishtes *-is, ea*, got *is*, ind, vjet. *ya*. Kur e mori në vështrim *y-në* e dëftorit *ky*, Meyeri parapëlqente një riformim përftuar nga evolucioni i elementit deiktik *kë-* dhe të dëftorit *i-* që nga ngërthimi i tyre doli *ky* me velarizimin e *i-së* në fqinjësi të velarit *k*. Sa i përket *y-* te *ay*, që na del në të folmet toske, Meyeri këtu sheh rezultat të veprimit analogjik të përemrit *ky*.

Trajtat përemërore që dalin me konsonantin *-s*, Meyerit i pandehte të dala nga tema indoevropiane përemëror + *ki*, + *ko*. Përveç pengesave të tjera, këtu ndeshim në vështirësi të pakapërcyeshme fonetike, pse, siç ka provuar Pedersenit, palatalet indoevropiane në gjuhën tonë pasqyrohen jo me sibilantin *s*, dhe *z*, por me spirantin interdental *th*: *dh*, e dental *d*, fjala vjen: *i athët*, lat. *acidus*; *bathë*, gr. *phakos* (thjerr); *dhândër*, *dhëndër*: lat. *gener*; gr. *gomoros*, sllav. *zet*; *dhallë*, gr. *gala* (qumësht); *lidh*, lat. *ligura*; *mbledh*, lat. *lego*, gr. *lego*; *dimën-dimër* (lat. *hiems*, gr. *heimo* (shtrëngatë), sllav. *zima*. – Pasi e kundërshtoi tezën e Meyerit lidhur me burimin e elementeve pronominale të dëftorit *a-i*, *k-y* (*a-y*), që del në *i*, *y*, Pedersenit rrahu një shteg tjetër përsa i përket origjinës së dëftorit në shqyrtim, në të vërtetë për të shpjeguar burimin e dëftorëve të gjuhës shqipe ai nisej prej përemrit indoevropian +*so*, +*sa*, + *tod*, që në greqishte kishin sosur te: (*o*, *e*, *tod*). Ky dijetar paravendon *u*-në si vokal primar te përemri mashkullor (*a*) *i*, (*a*) *y*, dalë nga rrënja përemërore indoevropiane – *so* që në gjuhën shqipe shkoi e u zhvillua më *-u*, pastaj me rrugë fonetike në këtë gjuhë doli *i* (*y*) = *ai*; *ay*, *ky* e që e gjejmë edhe si artikull postpozitiv në një kategori nominale të gjuhës shqipe: *miku*, *lugu*, *vëllau* etj. Vokali *o*, te përemri *-jo* - *i*, *a-jo*, sipas këtij dijetari duhet të ketë rrjedhur nga baza përemërore indoevropiane *-sa*; *j-ja* te *ajo* do të pandehet pjesë epentetike antihiatizuese. Për trajtat e zhdrejta të përemrit femëror në studim, Pedersenit mendonte një burim gjithashtu indoevropian dhe i binte të ardhura nga baza e përemrit indoevropian *-to* – dhe hidhte poshtë mendimin e Meyerit, i cili për origjinën e tyre nisej nga rrënja përemërore KI – KO; nga *to* a *tja* + *toja* Pedersenit *i doli* **so*. Te *sije*, *soje* kemi zhvillime të reja analogjike me shpifjen e një *-j* – *je* epentetike. Sibilantin *s*, te *si* duke u mbështetur në teorinë e vet mbi pasqyrimin e guturaleve indoevropiane në gjuhën shqipe, Pedersenit (KZ. 36, 309, 315) e qitte të dalë nga baza indoevropiane *kuei*.

Përemri dëftor – *ta*, te, *ata*, *këta* i mashkullores për emëroren, sipas Pedersenit (KZ. 34, (284, 288), 36 (309, 315) pasqyron një rrënjor indoevropian *-toi*, ndërsa trajtën e kallëzores e përqaste te baza përemërore indoevropiane – *tons*; neutri i shqipes *-ta* pasqyron dëftorin indoevropian – *tod*, *to-ja* e neutrit shumë që sot është barazuar me femëroren ka rrjedhur prej një baze indoevropiane *-ta*.

Femëror ja e shumësit *-to*, si për emëroren ashtu edhe për kallëzoren

rrjedh prej kallëzores indoevropiane *-tas*; po ashtu edhe mashkullorja *-ta*, emërore – kallëzore, do të ketë dalë nga një bazë e kallëzores indoevropiane *tons* (Çabej, *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe*).

Gjinore-dhanorja njëjës *tij (ti)* do ta ketë burimin e vet te trajta lokativale indoevropiane më *-ei*; *j-ja* e *saj* si dhe ajo e *-saj* do të jenë prodhim epentetik, i dalë në kushte të sandhit.

Format *atë, atë* të kallëzores njëjës të përemrit dëftor *ai, ajo*, na dalin të përbashkëta për të dy gjinitë. Që të dy format janë të pajisura me elementin deiktik *a-*, që shënon largësinë, përkundër trajtës *këtë, këtë* me elementin nistor *-kë* që tregon afërsinë. Elementin e dytë a bazën e formave në shqyrtim te veçuar nga pjesa deiktike *a kë* i gjejmë vetëm me parafjalë: *me (të), pa të (të)*, si dhe përemrin e pronës: *tand, tënd, tande, tënde*, etj. Nga trajtat gege shihet qartazi që primitivi i tyre do të ketë qenë i pajisur me një konsonant nazal *-n*: *a- tan; kë – tan*, si e kishte vënë re, përveç të tjerëve N. Jokli (JF. 36 (98), LKU), që kishte konstatuar grafitë *atan* për *ate, ndë tan (in esso)* që gjenden te Bogdani.

Baza indoevropiane e formës mashkullore të gjuhës shqipe *-të (ai)* është *-tom*; për femëroren e gjuhës shqipe (a) *të, (ajo)* primitivi indoevropian do të dalë në *-tam*, lat. *is-tam*, mashk. *is-tum*; sllav. vjet. *tb:to*, ind. vjet. *tam:tām*.

Nga trajtat e njëjësit të rrjedhore *si-so (sij, soje)* që rrinë në format *kësi, këso, asi, aso, mbas-si > mbasi*, kanë dalë format e shumësit të dëftorit: *sish, sosh (kësish, kësosh, asish, asosh)* me shtimin e mbaresës *-sh* të sistemit nominal për rrjedhoren shumë. Në disa dialekte gege ndeshet forma përemërore *syresh* (prej *syresh*) që do të jetë përftuar nga shkrija a kontaminimi i trajtës gjinore *-tyre* me formën e rrjedhore *sish*.

Forma e gjinore-dhanore shumë *tyne*, prej *tyne: tyre*, përdoret në vend të rrjedhore *sosh, sish* si në sistemin nominal, ashtu dhe në kategorinë e përemrave dëftorë.

Origjina e trajtës gjinore-dhanore shumë *-tyne: tyre*, është e diskutueshme; përpjekjet e dijetarëve për t'ia gjetur burimin, nuk kanë dhënë fryte të kënaqshme dhe etimologjia e trajtës në shqyrtim nuk ka gjetur pëlqim te pjesa më e madhe e albanologëve, porse, në mungesë të një etimologjie të kënaqshme tolerohet.

Me studimin e formës në fjalë, përveç tjerash *yn te tyne*: *tyre*, Pedersenit e qet të dalë prej mbaresës indoevropiane *om* nga o-ja e *të cilës ka rrjedhur y-ja e yn-ës*. Nga e njëjta mbaresë indoevropiane *-om*, sipas Pedersenit, ka dalë mbaresa e te- *tyne*, *tyre* përkatësisht *-ve* me konsonantin antihiatizues *-v*: *ty neve*, *tyneve*, *tyreve*. Sa i përket gurrës *-ty* të trajtave përemërore *tyne*, *tyneve*, *tyre*, *tyreve*, romanisti dhe ballkanologu jugosllav Petar Skok e gjente të dalë nga kontraktimi i një forme të zgjeruar *të + vë + i > të vi > tij*.

Trajta përemërore e dëftorit *-ky*, sipas G. Meyerit, duhet të ketë dalë prej *kë+i*, kurse Pedersenit e qet të dalë nga një bazë – *ku*.

Me rënien e *ë-së* të pjesës deiktike te format *këtij*, *këtë kësi*, *kësaj*, *këso*, *këta*, *këtyne*, *këtyneve*, *kësish*, *kësosh*, janë formuar trajta: *kti*, *ktê*, *ksi*, *ksaj*, *kto*, *kta*, *ktyne*, *ktyneve*, *ksish* *ksosh*, forma që përdoren në të folmet e gegërishtes veriore (dhe në ligjërimet shqiptare të Kosovës).

Trajtat e sipërme që na dalin me *j*-në fundore, në ligjërimet e zëna ngoje *j*-në e përmendur e zhdukin fare nga shqiptimi dhe nga përdorimi: *kti*, *ati*.

Në rasat e zhdrejta të kallëzores po këto trajta përemërore të dëftorit *ë-në* e pozicionit fundor e bjerrin dhe shqiptohen si *at*, *kët*, *ket*.

Në shembujt e përfillur të gjinore-dhanores shumë trajtat *atyne*, *këtyne*, *atyre*, *këtyre* – na dalin me riformime të reja me *shtimin e një -v-je* antihiatizuese: *atyneve*, *këtyneve*, *atyreve*, *këtyreve*, që janë përfutur si rezultat i veprimt analogjik të trajtave gjinore-dhanore shumë të emrave të gjuhës shqipe.

Në ballë të këtyre përmrave dhe ndër fjalë kategorish të tjera na del shpesh shfaqja e protezave deiktike *a + kë*, elemente që do të konsiderohen jo të lashta për arsye të ruajtjes së tyre në pozicionin e patheksuar, në të cilin po të kishin moshë të madhe, do të kishin pësuar ndryshime të ndjeshme fonetike e në atë rrugë do të ishin zhdukur fare. Nga disa shembuj pjesëza formimi na dalin fort të lëkundshme dhe të zëvendësueshme me pjesëza të tjera: *njita*, *njito*, *njitu*; *çetu*, *çeta*, *çeto*, *çeshtu*, etj. Shembujt e parë, ata që në ballë ruajnë protezën *-nj* janë në përdorim të shkodranishtes, të dytat që kanë pjesëzën *-ç* i gjejmë në ligjërimet shqiptare të Kosovës. Një gjë duket e qartë ndër fjalë me këto dy

pjesëza, që në to nuk bëjnë pjesë më protezat deiktike *a*, *kë*, pra dy palë protezash nuk qëndrojnë bashkë veçse njëra lagje pjesëzash bie.

Përemrat pronorë

Ndër të gjithë përemrat e gjuhës shqipe, pronorët kanë qenë më së shumti objekt diskutimesh e hetimesh të albanistëve të huaj e shqiptarë.

Është e vërtetë se pronorët e shqipes paraqesin vështirësi të madhe shpjegimi pse janë rezultat kombinimesh a aglutinimesh të elementeve të ndryshme të kategorive gramatikore e është dashur me njohuri e akribi të hollë linguistike të shkoqen palët e ngjitura.

Më i madhi organizues i shkencës krahasimtare të gjuhëve indoevropiane – Franz Boppi (1791-1867) *Über das Albanesische in seinen verwandtschaftlichen Beziehungen*, 1854, f. 520-521) pronorët e gjuhës shqipe i gjikoi të dalë nga bashkimi i dëftorëve me vetorë në formën e gjinore: pra elementet nistore te pronorët *-jo-te*, *y-t*, sipas mendimit të tij duan shpjeguar të ardhura prej *a-jo*, e *y-ja* e *yt-it* do të qitet nga përmri vetor, veta e III.

Lidhur me pronorët e gjuhës shqipe ishte vështirë të qëndronte mendimi i poetit Mjeda, që pronorëve u kushtoi një punim të tërë. Pronorët e gjuhës shqipe poeti dhe filologu shqiptar i nxirrte nga aglutinimi i përemravet dëftorë me trajta të vetorëve bie fjala: *y-në* = (a) *i* + *nesh*. Një sajim i tillë i pronorëve nuk njihej në asnjë gjuhë indoevropiane, prandaj ai u flak me të drejtë, pse nuk kishte kurrfarë urë qëndrimi.

Dihet se albanisti i madh danez, Holger Pedersen, mendonte që pronorët e gjuhës shqipe duan qitur prej bashkimit të nyjave të parme me pronorët origjinarë të kësaj gjuhe. Skema e pronorëve *y-në yt*, *y-j* nga *y-(j)*; *jo-në*, *jo-te*; *juoj*, prej *jo-u* (j) asnjë: *ta-në*, *ta-t*, *ta-j* prej *ta-u(j)*, sipas Pedersenit do zberthyer në këtë mënyrë: *pjesa e parë e të gjithë pronarëve të shënuar është nyjë e parme y* (dalë prej *u-je*) mandej *o-ja* e jotizuar e *jo-së* dhe e *ta-së*, që të gjitha aglutinuar me pronorët origjinarë.

Pronorët *im*, *ime*, Pedersenit i gjikonte të dalë me anë të aglutinimit të nyjës edhe të pronorit primar a origjinar, ndërsa elementin nistor *i*,

përkundër elementit *y*-të *pronorëve y-në, y-t*, e qitë të ardhur prej *nyjës -i*, duke dalluar për *pronorët e zënë* ngoje dy burime *nyjësh*, e ky mendim nuk është i pa të meta; të gjitha gjasët janë në të mirë të një *nyje të vetme*, qoftë për *-y-në* e *yt-it*, qoftë për *i-në* e *im-it* (S. Riza, *Pronorët e shqipes*, Buletin, 1959/2, 3; 1960/3). Veçse do theksuar një gjë në këtë mes që në ndërgjegjen *gjuhësore të shqiptarëve y-ja* e *pronorëve ynë, yt* nuk ndihej më si *nyjë e përparme*, kurse *nyja e pronorit të dikurshëm + y + im*, më vonë u çnyjësua në *-im*, e sot ndër shumicën e gegërishteve me palatalizimin e *y-së* në *-i* u kthye në *i + im* (i em).

Ngjan të jetë i drejtë mendimi i disave që në *pronorë* shikojnë shkrirjen e dëftorit primitiv me *vetorin*, p.sh. të *jonë* elementi nistor do nxjerrë nga dëftori i vetës së III – *a + jo, këjo* dhe prej *vetorit ne, neve* të *gjinore-dhanores: a-jo + ne (neve) = jonë, jonë*. Gjithashtu edhe *-jo* në *jote* do gjykuar rrënjor primitiv i demonstrativit *ajo*, e *te* në thelb do të jetë formë *pathekse* e reduktuar e *përemrit personal të gjinores ty*.

Shenja e *gjinisë së gjuhës shqipe*, siç dihet, në kohë të *mugëta* shprehej vetëm me pjesën e parë: *-y-t*, femër. *jo-t*, sikur na dëshmon edhe sot e gjithë ditën: *jot motër; jot amë*. Pjesa fundore *e* e *femërores* në *pronorin jote, sate*, etj., do gjykuar shtesë *hiperkarakterizuese*, që vihet për të dalluar *trajtën e femërores nga ajo e mashkullores*. Me këtë kuptim do vështruar edhe shtesa e artikullit *prepozitiv të pronorët e jote, e jot ja, i yt, i yti*, shtesë që quhet e *burimit shkollor e gramatikor* (Buletin, 1963/2, f. 133-135).

Në një *trajtim të pronorëve të shqipes* si përdoren në *gjuhën e sotme letrare* dhe ndër të folme të *ndryshme e shohim të arsyeshme të vëmë në dukje se në shkrimet e Buzukut ruhej edhe një pronor tjetër që zuri të zhduket nga shekulli XVIII; është ky pronori njëjës *mashkullor yj*, të cilin që nga koha e *qindvjetshit XVIII ia zuri këmbën femërori juoj*, sot (i) *juaj*.*

Ja tabela e *rasave të pronorit në fjalë si paraqitet te Buzuku*:

	<i>Njëjës</i>	<i>Shumës</i>	<i>Njëjës</i>	<i>Shumës</i>
Emër.	yj	taih	juoj	tuoih
Dhan.	tij	tiveh	saih	tuoieh
Kallëz.	tâih	taih	taih	tuoih
Rrjedh.	sij	sish	saih	souish
	suvih			

Po japim format lakore të pronorëve për dy vetat e para:

	<i>djali</i>	<i>bija</i>
Emër.		eme
Gjin. dhan.	tim	sime
Kallëz.	tim (tem)	temeh
Rrjedh.	(n atit) sim	tehmeh
Rasa parafjalore: (për gjakut)	tem	temeh
	teme	
<i>miqtë</i>		
<i>ffalëtë</i>		
Emër.	e mi	
Gjin. dhan.	miveh	e mi
Kallëz.	e mi	mive
Rrjedh.	së mish	e mi
Rasa parafjalore: teh mi		së mish
	<i>burri</i>	<i>gluha-gjuha</i>
Emër.	ynë(h)	jonë
Gjin. dhan.	tinë	sanë
Kallëz.	tanë	tanë
Rrjedh.	sinë	sonë
	<i>përintësh</i>	<i>gratë, duort (e)</i>
Emër.	tanësh	tonësh
Gjin. dhan.	tinëveh	tonëve, tinëveh
Kallëz.	-	tonësh
Rrjedh.	sinësh	sonësh
Kallëz. parafj.	tanësh	tonësh
	<i>populli</i>	<i>vajta</i>
Emër.		
Gjin. dhan.	yt	jote
Kallëz.	tit	sate
Rrjedh.	tand	tande
Kall. parafj.	sit	sote
	tand	tande
	<i>bijtë</i>	<i>bijatë</i>
Emër.	e tu	e tu
Gjin. dhan.	tuve	tuve
Kallëz.	e tu	të tu
Rrjedh.	së tush	së tush, së tu
Kallëz. parafj.	-	teh tu
	<i>zâni (h)</i>	<i>zemra (Buz. zemëra)</i>

Emër.	yj	juoj
Gjin. dhan.	tij	saih
Kallëz.	taih	taih
Rrjedh.	sij	saih, souih
Kallëz. parafj.	tâih	tâih
	<i>përintëh</i>	<i>(të lipanatë)</i>
Emër.	taih	tuoih
Gjin. dhan.	tiveh	tuoih
Kallëz.	taih	tuoih
Rrjedh.	sish	suoih
Kallëz. parafj.	-	touih

Përmerat lidhorë e pyetës

Përmerat *kush*, *çë* (ç'), *sa*, *se*, *cili* (*i*) *cili*, *cila*, (*e*) *cila*, *cilët*, *cilat*, (*të*) *cilët*, (*të*) *cilat*, sipas rrethanave na dalin me funksione të ndryshme, herë si lidhorë herë si përëmra pyetës, disa sish na paraqiten si përëmra të pakufishëm. Këtu bën pjesë edhe përëmi i palakueshëm *që* (*qi*).

Fjala vjen përëmi *kush* përdoret herë si pyetës: *kush erdhi?*, *herë si lidhor: kush duron – trashëgon*; përëmi *kush* na del edhe si i pakufishëm: *kush këndej, kush andej* (= *dikush këndej, dikush andej*).

Burimi i tij nuk na del i qartë; mendimet e dijetarëve janë të ndara për sa i përket origjinës së tij. Ngjan të ketë gurrë indoevropiane; një lagje linguistësh e qesin të ardhur nga një bazë indoevropiane: *ku – kua*-te e *cila* do përqsatur edhe përëmi i latinishtes *qui, quas, quod*. Sidoqoftë puna *sh*-ja fundore pasqyron një *s*, që gjendej në trup të fjalës, e që nuk pëson kurrfarë ndryshimi edhe pse gjendej në pozicionin fundor, si u mbajt nga vokali fundor, që me kohë u zhduk. Në këtë mënyrë, pra *kush* dikur do të ketë qenë dysilabik gjë që e dëshmojnë: *kuo* e *mos* (Çabej, *Studime filologjike* 1964/1). Forma *kujt* do të ketë rrjedhur duke iu shtuar temës *ku – mbares*a i e gjinore, ndërsa *kujt* do t'i jetë ngjitur artikulli postpozitiv *-t*, si mendon Pedersen (Arb. Texte mit Glossar, 200; KZ, 316).

Formën e akuzativit *ke, kë* prej bazës indoevropiane *kuom* e kishte parë qysh Gustav Meyeri (*Alb. Studien*, III).

Të rrënjori përëmëror indoevropian *-kuo* – duan afruar edhe trajtat e

sotme përemërore: *ku, qysh* (= *qish*) dhe lidhëza parafjalë *-ke*; te kjo bazë përemërore indoevropiane do të lidhen format përemërore të shqipes: *se, sa, si*, me ndryshim që këto trajta përemërore do të përqasen te rrënjori indoevropian *-kue-a kui-*.

Në gjuhën e sotme shqipe trajta përemërore *-se* shkon me parafjalë *-vie, për, mbi në* (*me se, perse, mbi se, sej* me j-në antihiatizuese; *prej sej, gjithsejt, i, e sejtër* kryesisht në toskërishte).

Trajta përemërore *sa* përdoret në shumës dhe lakohet duke marrë mbaresat emërore *-ve* për gjinore-dhanoren *-save* dhe *-sh* për rrjedhoren *-sash*. Nga tema *sa* sajohet edhe përemri pyetës *i sati, e sata*, që ka formën e një mbiemri të nyjshëm dhe takohet mbi emrat e nyjshëm në trajtën e pashquar në gjininë mashkullore dhe femërore dhe në të dy numrat (*i sati, të satët*), porse rëndom përdoret në rasat emërore e kallëzore dhe zakonisht me njëjës.

Përemrin pyetës *si* e qesin të ardhur nga baza përemërore indoevropiane *-kuei-*, dhe ai rri në rrënjorin e formave të sajua të përemrave pyetës të gjuhës shqipe: *cili, cila*, primitivi i të cilëve do të jetë, siç thamë, një *si*. Trajta më e vjetra që del në përemra të zënë ngojë është ajo që mbaron me *-ll*: *silli, silla*, që dëshmohet në të folmet gege veriore si dhe veprat e shkrimtarëve të veriut: Buzukut, Budit, Bardhit dhe Bogdanit: *i sill*, femër. *e sije*; plur. *të sij, të sija*; forma primare *si*, përmbahet në *akëcisë, akëcisë cia, ciri* që i sjell Hahni.

Format bazë, sipas Pedersenit, janë ato të thjeshta pa *ll*, *ciu, ciri*, të cilave në rrjedhën e kohës iu ngjit formanti *-ll*, analogjikisht me përemrin *i tilli, e tilla*, që afrohet te *talīs* gr. *τηλικος-* = *telikos*. Në shpjegimin e origjinës së përemrit në shqyrtim, Çabej rrah shtigje të reja; mbi dëshminë e disa shembujve që dalin në literaturën e autorëve të vjetër shqiptarë, siç janë shum. *fari- zej, në njëjës farizell; skundinj; skundili; kërminj, kërmill*, konsonantin *-ll* në njëjës in e këtyre fjalëve, si dhe në trajtat e përemrave *i sill*, mandej *i cili*, atë *ll* Çabej e bie të dalë me rrugë të zhvillimit të brendshëm, si përfitim të riformimeve më të vona në mbështetje të *-j-së* që paraqitet në formate shumësit të përemrave në studim. Frikativi *-j* do të jetë shfaqur në trajtat e shumësit: *të sij, të sijte, e sija, të sijatë* dhe u sajuan trajta të reja të singularit *i silli, i cili, e silla, e cila*,

Zhvillime formash të reja të singularit si rezultat i veprimit analogjik nga plurali na dalin në një masë më të gjerë në gjuhën shqipe, bie fjala nga shumësi *thëngjinj* a *sëngjinj* (e folmja e ar bëreshëve te Zarës) u formua singulari *thëngjin*: *sëngjin*; *purri*: *purri*: *puril* (Plavë e Guci).

Trajta e lejueshme e përemrit pyetës është: *cili*, lidhori *i cili* (*cilli*, e *cilla*, *i cilli*, e *cilla* janë forma dialektore a krahinore). Afrikata nistore është sekundare, siç u pa më parë e rri në këmbë të primares s që në ngërthim me aitkullin prepozitiv *-t* u kthye në afrikatën *c*.

Përemri *-c* – mund të jetë me funksion përemri pyetës, mbiemri pyetës, dhe përemri lidhor; *ç'bëre*, *ç'dëm bëri*, *ç'premtton*, e *bën*.

Njëherë do pranuar se trajta përemërore *çë* (*ç*) brenda gjuhës shqipe piqet në formë *-që* (*qi*), e cila në funksionet e veta qoftë si përemër lidhor, qoftë si lidhëz në dialektet e Greqisë, të Italisë dhe Ukrainës del vetëm *çë*, forma e plotë *-çë* kundrejt *ç* – do konsideruar primare; mandej një lidhje gjenetike ndërmjet *çë-së* dhe *që-së* me *çish*: *qish* nuk mund të hidhet poshtë, prandaj Pedersenit format *çish*, *qish* i quan primare dhe *çë*, *ç*, *që* i të dala nga ato të plotat – (*çish*. *qish*).

Mendimi i disave që përemrin pyetës, *ç*, *çë* (*ça*, *çar*) e nxjerrim prej rumanishtes *-ce*, nuk mund të qëndroj siç e hedh poshtë me të drejtë H. Pedersenit (KZ. 36, 328), i cili *-ë-në* e *çë-së* e qet sekundare. Format *çish*, *qish* ky dijetar i qet të dala nga një bazë indoevropiane *-kuo* –.

Origjinën çakave – kroate të përemrit *çë*, *ç* që e mbrojnë Treimeri, Jokli, Vaillanti, ndërsa e hedh poshtë Bariçi, pse, siç, thotë ai „përemrat nuk janë mall që eksportohet“.

Forma e hershme *qish* (sot përemër pyetës, herë edhe lidhor) e shkrimtarëve të vjetër, tani vonë na del në trajtën *qysh*.

Përemrin *ç-* e gjejmë dhe në kompozitat: *çfarë* – *çka* *-shka*; të sajua-ra në elementin e parë nga *ç-* dhe në të dytin prej emrit: *farë*; *çka* do zbërthyer në *ç-* dhe foljen *ka*: *ç* + *ka* = *çka*, me shurdhimin e *ç* pran *k-*: *shka*.

Përemrat e pacaktuar

Përemrat e pacaktuar të të gjitha gjuhëve i lidh një cilësi e përbashkët,

që ata formohen prej elementesh e na dalin të përngjitura e të formuara me anë aglutinimit të përemrave pyetës a lidhorë me trajta foljore ose edhe me përemra të tjerë, që kthehen në pjesë të palakueshme dhe u ngjiten përemrave pyetës a lidhorë. Pjesëzat e përmendura mund të qëndrojnë herë përpara, herë prapa elementeve përemërore a të pjesëve të tjera të ligjëratës.

Një tubë përemrash të pacaktuar formohen duke iu ngjitur elementit përemëror folja: *do*; bie fjala: *kushdo, cilido, cila-do - cilado; ç + do > çdo; çka > çkado; çfarëdo*, një lagje tjetër përemrash të pacaktuar nisen me foljen *di* - : *dikush, diç, diçka; dishka*; një palë tjetër zë me *do*, fjala vjen: *ndokush, ndonji, ndonjëri, ndonjani*, numërori *një a një* bashkohet me lidhës mohimi *as*: *as- një (asnji), asnjëri, asnjani*; si dhe ndajfoljen *kurrë*: *kurrnjë, kurrnjâ, kurrkush*. Në një palë përemrash të pacaktuar përemri *kush* përbën elementin kryesor, që lakohet, ndërsa pjesa tjetër e atyre lloj përemrave qëndron e palakueshme: *dikush, ndokush, askush, kurrkush, sekush, gjithkush, gjithsekush, shumëkush, tjetërkush (kushdo)*.

Një lloj tjetër përemrash përbëjnë këta: *secili, gjithsecili, akëcili, cilido*, që janë formuar me pjesëmarrjen e përemrit *cili*, e lakohen si përemri *cili*, veçse me njëjësin e shquar.

Emër.	secili	secila	cilido-cilado
Gjin. Dhan.	secilit	secilës	cilitdo-cilësdo
Rrjedh.	secilin	secilën	cilindo-cilëndo
Kallëz.			

Edhe emri *gjâ, gjë* mund të përdoret si përemër i pacaktuar, e atëherë na del vetëm në trajtën e pashquar njëjës dhe në rasën kallëzore *a ke gjâ për të bâ? a ke gjë për të bërë?* – Me fjalën *gjâ: gjë* janë formuar edhe një vistër përemrash të pacaktuar *asgja, asgjë, kurrëgjâ, gjëkafshë, gjasend, gjësend*.

Përemrat *sa, (ca), disa, do* lakohen vetëm në shumësin e pashquar me përjashtim të *-do* që mbetet i palakueshëm.

Kur zënë vendin e emrave dhe tregojnë frymorë, sende, ide etj., ndajfoljet e sasisë: *shumë, pak, aqë, kaqë*, përdoren shpesh si përemra të pacaktuar.

Gjithë- tanë (tërë), tjetër që në gjuhën shqipe konsiderohen përemra

të pacaktuar, të thjeshtë, si mbiemra mund të dalin me një dhe pa të; si përemra përdoren të panyjë. Në shkrimet e autorëve të vjetër dalin zakonisht pa një, e cila në fillim del në shumës e më vonë u shtri edhe të mbiemrat.

Sa i përket burimit të përemrit të pacaktuar *tanë (tërë)* G. Meyeri e nxirrte nga latinishtja *totanus* që pandehet trajtë popullore e latinishtes shkollore *totus*; mendimi i Meyerit u kundërshtua nga Çabej, i cili atë e gjente të gurrës origjinale të gjuhës shqipe, të pajisur me nyjen proklitike.

Përemri a mbiemri i pacaktuar *tjetër*, që në të folmet toske na del *tjatër* do të zbërthehet në elementin protetik një dhe në pjesën *tjetër* a *jetër*, që ruhet edhe sot e gjithë ditën në ligjërime arkaike të shqipes si dhe në shkrimet e autorëve të vjetër shqiptarë.

Përemri ka nga një trajtë të veçantë për njëjës e shumës: *tjetër, tjerë*. Edhe ky përemër del nga burimi i vendit; përemrin *tjetër* e qesin të ardhur nga përemri indoevropian *eter: jetër*; ndërsa shumësi *tjerë* vjen nga *etéroi*, ku e-ja nistore është e patheksuar. T-ja te *tjelër* e *tjerë*, siç u tha pak më parë, do të jetë, pa farë dyshimi, artikulli në trajtën e tij të kallëzores që është përgjithësuar mandej në mbarë lakimin e singularit; në trajtën e shumësit ky përemër i pacaktuar mori edhe një palë njëjsh duke dalë te – *të tjerë*.

Edhe përemri i pacaktuar *gjithë*, në shumës del me protezën *t*, si e pamë më parë.

Mbiemrat e pacaktuar *aq (ë), kaq, (ë)* janë të pajisur me protezën deiktik *k (ë), a*, njëra për të treguar afërsi, tjetra për të shfaqur largësi, ndërsa primitivi i tyre është *-që*; pjesëzat e përmendura deiktike i ndeshim te përemrat dëftorë dhe te një vistër ndajfoljesh, pastaj ato i takojmë edhe te mbiemrat *i atillë, i këtillë*, të nisur prej bazës *i tillë*, që do qasur te ajo e latinishtes *talis*.

Përemri *gjithë* kur gjendet para një emri zakonisht nuk lakohet, e ndër rasi të zhdrejta ai rëndom merr artikull prepozitiv: *gjithë fshati, gjithë katundi*; (të) *gjithë fshatit, (të) gjithë katundit*; (të) *gjithë fshatin, a katundin*; plur. *të gjitha fshatrat* a *ka- tundet*; kur është vetëm, atëherë ai lakohet dhe mund të marrë një, porse mund të rrijë edhe pa të. Fjala vjen: (të) *gjithë-ve, -sh (të) gjitha-ve, sh*.

FOLJET – (VERBAT)

Pothuaj të gjithë kërkimtarët e gramatikanët e gjuhës shqipe, që këtë gjuhë e kanë studiuar nga aspekti diakronik, apo i janë sjellë asaj nga ana sinkronike e vëzhgimit – janë të një mendimi që foljet e kësaj gjuhe në ravën e zhvillimit të saj kanë pësuar tërime të mëdha. Po t'u shkohet një sy do të shihet se foljet e gjuhës shqipe paraqesin larmi të mëdha formash; nuk janë të rralla rastet kur një folje ndër dialekte të kësaj gjuhe në fillzhvillimin e vet shfaqet në trajta të nduarnduarta, prandaj me një formë merr pjesë në një tip të foljeve me trajtë tjetër pasqyron kategori tjetër foljesh. Në anën tjetër duhet të theksohet që sistemi foljor i gjuhës shqipe ka ruajtur shumë relikte nga perioda e trashëgimisë indoevropiane, çka nuk mund të thuhet për sistemin e saj nominal.

Në punën e studimit të kësaj kategorie gramatikore të shqipes do pohuar që, hiq disa përpjekje fillestare, nuk kemi sot e gjithë ditën një pasqyrë përmbledhëse të morfologjisë historike të gjuhës shqipe. Thënë të drejtën, mund të ndeshim në ndonjë çështje të natyrës morfologjike, që lëvruesit e gjuhës shqipe i kanë kushtuar, gati aksidentalisht, pak radhë. Në qoftë se është zgjidhur ndonjë problem nga fusha morfologjike, kjo i detyrohet në rend të parë Meyerit, Pedersenit, Joklit, Çabejt e të tjerëve; që në punën e tyre shkencore nga fusha albanistike, ndriçuan disa çështje të karakterit morfologjik. Kohët e fundit studimet e gjuhës shqipe kanë shkuar përpara dhe janë hapur shtigje të reja në gjirin e gjurmimeve albanistike e për pasojë edhe të morfologjisë historike të *kësaj gjuhe*. Janë ribotuar të *transkribuara veprat* e autorëve të vjetër shqiptarë që i lehtësojnë me të madhe studimet e problemeve morfologjike. Edhe disa studime të bëra tash vonë nga lëmi i dialektologjisë janë ndihmë e dobishme e gjurmimeve mbi problemet në shqyrtim.

Klasifikimi i foljeve

Problemi që shtrohet në ballë të çdo punimi që i përket trajtimit të morfologjisë së gjuhës shqipe është pa dyshim shtjellimi i problemit të grupimit të foljeve.

Është e vërtetë që çdo gramatikan që është rrekur, duke zbatuar kritere të posaçme, të vendojë farë sistemi në këtë gjuhë foljet e saj i ka grupuar në kategori që nuk pajtohet me atë të atij para tij. Pa ngrehur farë pretendimi t'i japin pikëpamjet e secilit gramatikan veç e veç, po bëjmë përpjekje t'i parashtrojmë disa sosh si na ravizohen ndër gramatika të gjuhës shqipe. Nga kriteret e ndryshme të gramatikanëve, në trajtimin e foljeve të gjuhës shqipe rrjedhin pra edhe grupimet e tyre ndër kategori që nuk piqen në mes të tyre. Disa nisen nga mbaresat vetore të prezentit të dëftores, pala tjetër në degëzimin e foljeve të gjuhës shqipe, nisen gjithashtu nga prezenti pa lënë pas dore participin e ky filldrejtim i shpie te rezultate të tjera.

Gustav Meyeri, foljet e shqipes (*Kurzfassste albanesische Grammatik* Leipzig, 1888) i ndante në dy grupe: 1) foljet që ruajnë mbaresën e vjetër indoevropiane të – mi koniugacionit (*kam, jam. thom*) dhe 2) në këtë grup klasifikonte të gjitha foljet e tjera me mbaresën e vjetër indoevropiane *o*, ndër të cilat veçonte një palë me mbaresë të vjetër *io*.

Duke u mbështetur të shumtën në mbaresa vetore të prezentit të mënyrës dëftore, Pekmezi (*Grammatik der alb. Sprache*), foljet e shqipes i grupon në katër zgjedhime. Në grupimet e tij peshim të shënueshëm zë barazimi me temën e me mbaresat e aoristit. Pajtohemi me mendimin e disa që në këtë punë zbatojnë kriterin e klasifikimit të foljeve sipas gjendjes se tyre të tanishme, veçse një shumicë sosh duan shpjeguar historikisht, përndryshe një pjesë e mire e tyre, të shpërngulura prej një klasifikimi në një grupim tjetër, ngelin pa u sqaruar nga ana diakronike. Megjithëse, të gjitha foljet e gjuhës shqipe i mbërthen në dy grupe, Gustav Meyeri, s'i lë gjë mangut tfillimit të tyre historik duke i plotësuar me komentime të dobishme në ç'punë dijetari shqiptar, Gj. Pekmezi, s'është pa të meta.

Kriteri, sipas të cilit bëhet ndarja e foljeve të gjuhës shqipe në katër grupe të mëdha, është i drejtë, me kusht që variacionet e ndryshme përftuar në rrjedhën e kohës në punën e foljeve të vihen në dukje me shkoqitje të duhura. Në rrjedhën e zhvillimit të kësaj gjuhe me gjithë elementet e ruajtura të sistemit foljor indoevropian, janë dëshmuar mjaft ndryshime: kanë bjerrë shumë mbaresa, kanë rënë tinguj fundorë, janë formuar zhvillime të reja, janë përftuar formime sekundare analitike; ka vepruar

brenda kësaj gjuhe një fuqi me tendenca rrafshimi të ndryshimeve.

Sistemi foljor i gjuhës shqipe, mbështetet, siç dihet, në dy te- ma, në temën e prezentit të indikativit dhe në atë të aoristit.

Fleksioni i – mi koniugacionit

Fleksioni verbal i gjuhës – amë indoevropiane kishte dy kategori foljesh, grupin e *-mi* koniugacionit dhe atë me temë në -o < krh. të latinishtes – *lego; canto*, të greq. *didomi*, ind. vj. *bher-o*), grupi i parë bën pjesë në ato folje që quheshin atematike, mbaresat e të cilave i ngjiteshin temës verbale drejtpërdrejt, ndërsa pala tjetër e foljeve mbante emrin tematik, mbaresat e të cilave lidheshin me temë me anë të një teme, e jo drejtpërdrejt. Në këtë kategori verbale hyjnë tri folje të gjuhës shqipe: *jam, kam, thom*, për arsye të mbaresave a të fundorëve të tyre në vetën e parë të prezentit indikativ.

Ja si duket paradigma e fleksionit të foljes *jam* ndër trajtat të prezentit të indikativit te gjuha amë indoevropiane dhe te bijat e saj.

	<i>Indoevrop.</i>	<i>Ind. vjet.</i>	<i>Greq.</i>	<i>Lot.</i>
Sing.	1. es-mi	as-mi	ei-mi	sum
	2. esi-essi	asi	ei-es-si	es-s
	3. esti	as-ti	es-ti	es-t
Plural	1. smes(i) smos(i)	s-mah	e-mes	sumus
	2. ste(sthe)	s-tha	es-te	es-tis
	3. senti, sonti	s'anti	enti	s-unt
	<i>Lituan.</i>	<i>Got.</i>	<i>Sllav.</i>	<i>Shqip</i>
Sing.	1. es-mi	im	jes-m	jam
	2. es-si	is	jesi	je
	3. es-ti	is-t	jes-t	âsht-është
Plural	1. es-me	sij-m	jes-m	jemi
		sij-up	j es-te	jeni, je:
	2. es-të	s-ind	s'-ot	janë

Barazimi i fleksionit të kësaj folje të lashtë indoevropiane qet në dritë asiminimin e fortë të trajtave të hershme të prezentit që janë përftuar në gjuhën shqipe. Me gjithë ndërrimet e mëdha që ka pësuar në punën e fleksionit, përkundër gjuhëve të tjera indoevropiane, gjuha shqipe mu në këtë folje bashkë me verbat e tjera që bëjnë pjesë në grupin *e mi* – koniugacionit paraqitet me trajtë të vërtetë morfologjike indoevropiane.

Përpyekja për të identifikuar mbaresat vetore ndër folje kategorish të tjera do të shkojë huq, pse elementet e temave të tyre janë ngjitur me mbaresat vetore në atë mënyrë që është e pamundur të shkoqet njëra palë prej tjetrës.

Jam është refleksi i indoevropianishtes *esmi* e baza e pandërmjetshme e gjuhës shqipe do të jetë *em*, të krah: arm. *em*, got. *em* ind. vjet. *asmi*, lit. *esmi*, sllav. vjet. kishtarë *jesmb*, greq. *ei-mi* si gjykojnë G. Meyer EW. 160; Alb. Studien, III 63, 85), Jok (Albanisch, 148, LKU. 8), Boisacqne (226; Berneker I 266, Walde-Bokorny, I 160, II 509), Pokorny (340), Vasmer (REW, I 405), Çabej, (Buletin, 1963/2, f. 128).

Sa i përket formës së vetës së dytë të singularit -je, dijetari gjerman Bopp – (Über das Albanesische in seinen verwandtschaftlichen Beziehungen, 1855, f. 11-12 (470, 526), quhet i pari kërkimtar që kishte vënë re gjatësinë e vokalit *e* te *je*-ja si dhe te trajtat e koniunktivit (të) *jem*, (te) *jesh*, (të) *jene*, po ashtu edhe te -të *jemi*, të *keni* përkundër *jam*, *kam*, *jini*, *kini*, etj., të cilin vokal shkencëtari gjerman me të drejtë e shpjegon diakronikisht me zhdukjen e shenjave personale siç shprehet edhe Çabej (Buletin për shkencat shoq. II (IV), 1957, faqe 208, shën. 9). Forma -je, pra, shpjegohet prej një trajte indoevropiane -esi, që mund të krahasohet me gr.ez, nga *esi*, arm. *es*.

Forma -*âsht* (e hershmja: *âshtë*, *anshtë*) është, nxirret, siç thotë me të drejtë Pedersen, nga baza *en* + *esti* (aty brenda është).

Te format *jemi*, *kemi*, *jini*, *kini* vokali *i* nuk mund të jetë i vjetër, ato nuk mund t'i pandehim të dalë nga *i*-ja e vjetër verbale, pse ai do të kishte rënë me kohë. Vokali fundor i formave *jemi*, *kemi* do të jetë përfuar nga një *i* e gjatë e silabës fundore, që e shkaktoi metafoninë: *a* > *e* ndër forma të koniunktivit të *jem*, të *jesh* (Çabej, Buletin 1963/2).

Te *i*-ja e gjatë e rrokja fundore duhet ta ketë burimin metafoia e trajtës (të) *jenë* ndaj *janë*, megjithëse nuk përjashtohet mundësia që edhe analogjia të ketë luajtur rolin e vet. Trajta -*janë* mund të quhet e dalë nga -*enti* që afrohet te format gr. dol. *enti*, ind. e vjet. *santi*: togu silabik -*në* ka rrjedhur prej -*nt* që shkoi nëpër fazat: *nt* > *nd* > *nn* > *η* (në).

Nga tema verbale e prezentit përftohen duke iu ngjitur mbaresat gjegjëse presenti i koniunktivit, imperfekti i indikativit dhe i koniunktivit,

mënyra urdhërore, mënyra kushtore (kondicionali).

<i>Indikativi</i>	<i>koniunktivi</i>
Prezenti	
jam	të jëm
jë	të jësh
është, ështëë	të jetë
jemi	të jemi
jeni	të jeni
janë	të jenë

Imperfekti na paraqitet me një hape formash: *unë ishe, isha, ishnje, ishnja, ishnjem. ishnjam, ishje, ishja, ishjem, ishjam*, që janë përfutur për analogji nga kategoria foljore e verbave me *-n* dhe njihen trajta sekundare.

Ndër të folme arkaike të gjuhës shqipe, sidomos në ligjërimet e kolonive shqiptare të Italisë Jugore dhe të Greqisë mandej në të folmet marginale, bie fjala në çamërishten, forma imperfektive të foljeve: *jam* e *kam* na dalin me trajtë mjaft të vjetër:

unë jeshë, jeshë	na, ne <i>jeshëmë, jeshmë</i>
ti jeshë	ju <i>jeshëtë, jeshhtë</i>
ai, ajo <i>ish, ishte</i>	ata, ato <i>ishnë</i>

Në të folmën e kolonistëve të Zarës që themeluan ngulimin e tyre në shekullin XVIII (1726-1733) në afërsinë e këtij qyteti të Dalmacisë Qendrore, është në përdorjen edhe një forme tjetër imperfekti: *kesh*, *keshe, keshi, keshim, keshit, keshin* që, si gjykojnë ka dalë nga tema e aoristit *kjesh, kesh*, siç përdoren format e kësaj kohe foljore në këto vise të gegërishtes veriperëndimore.

Format e sotme imperfektive *isha, ishe* etj., kanë dalë prej vetës së 3. të singularit e pluralit *ish, ishnë; te-ja* që del në vetën e 3. Singular të imperfektit, do konsideruar trajtë inovuese, zhvillim i kohëve të vona ardhur me folje të kategorivet të tjera që ky sufiks është pajim i tyre karakteristik. Edhe trajtat që posa u zunë ngoje të arbëreshve të Zarës – na merr mendja se duhen tfilluar ashtu që të jenë rezultat i ngërthimit të dy temave të ndryshme, njëra është e formës së foljes *jam* (= ken) dhe në elementin e dytë shohim trajtën imperfektive të kësaj foljeje *jeshë, ishe, isha*.

Në këtë kategori hyjnë edhe dy folje të tjera të shqipes: *kam* e *thom*.

	<i>pres. ind.</i>	<i>pres. i koniunkt.</i>	<i>imperf. ind.</i>
Sing.	1. kam të kem	kisha	[keshë]
	2. kē të kesh	kishe	[keshe]
	3. k̄a të ketë	kish, kishte	[kish, kej]
Plural.	1. kemi të kemi	kishim	[keshëmë]
	2. kenf të keni	kishit	[keshëtë]
	3. kanë të kenë	kishin	[kishnë-kejnë]

Trajta e vetës së parë të prezentit indikativ *kam* e ka burimin te paraforma shqiptare *-gabmi* a *gob(h)mi* që përqaset te *habeo* e latinishtes, got. *habai*. kelt. *kab*, *gab*.

Mendimi që *kam* të ketë dalë nga bashkimi i një *kë*-je deiktike dhe të formës *(j)am* është vështirë të tumiret (M. Camaj, „ich bin" und „ich habe" in Albanischen = Beiträge zur Südosteuropa – Forschung, 1966).

Kuantiteti i gjatë i vetës së dytë e të tretë të kësaj folje (*kam*), *ke*, *ka* që e kishte vënë re F. Boppi në studimin e tij *Über das Albanische in seinen verwandtschaftlichen Beziehungen*, 1855 duhet të jetë përfutur nga zhdukja e shenjave personale qysh shpjegohen edhe disa trajta të formës *-jam*.

Po 'tu sillemi vetave të prezentit të koniuktivit njëjës e shumës të kësaj foljeje të *-mi* koniugacionit do të konstatojmë pa farë dyshimi kuantitet (të gjatë të vokaleve, burimi i të cilave do këkuar gjithashtu në zhdukjen e mbaresave të hershme vetore personale.

Në paradigmen e sipërme, përveç formash të rëndomta të imperfektit, na dalin edhe një lagje të tjerash që quhen arkaike. Këto të sotmet *kisha*, *kishe*, *kishin*, etj. kanë dalë prej vetës së tretë njëjës, a shumës *kish*, *kishnë*, që me kohë u përhapën në të gjitha vetat e tjera.

Format imperfektive të *-mi* koniugacionit nuk paraqiten të njësishtme, ato na dalin me shumë forma në të cilat vërehen kombinime të formave të dy palëve të imperfektit sigmatik dhe të atij asigmatik.

Në format *kej*, *kejnë* që shfaqen si trajta imperfektive në dialektin e arbëreshve të Greqisë shohin njëzime që duan zberthye në *keshni* a *këshjënë* në të cilat tingulli *sh* ka rënë pranë konsonantit nazal.

Verbi i tretë që bënë pjesë në kategorinë *e-mi* koniugacioni është, *thom*: *them*, *thue* (*thua* < *thuo*), *thotë*, *thomi*, *themi*, *thon*, *thonë*; veta e

dytë Singular e prezentit të indikativit *thue, thua (thuo)* e ka pikënisjen e vet te arketipi indoevropian *kenskens ken* që nis me guturalin palatal *k* që në gjuhën shqipe është zhvilluar në interdentalin *th*; *e*-ja e gjatë e periodës indoevropiane në gjuhën shqipe u kthye në vokalin *o*, që më vonë u zbërthye në diftong, siç u zhvillua ky vokal duke qenë në atë pozitë pa përjashtim në diftong edhe në një kategori emrash (*uo*) *ua, ue: përrue fvue, krue*, etj. Nga baza *-tho* – në vetën e tretë njëjës kemi formimin *tho-të*, në të cilin pasqyrohet mbaresa personale e vetës III njëjës; edhe në vetat e tjera shumë, nisur nga tema, *tho*-u përftuan fundoret përkatës vectorë: *thomi, themi (thoni), thonë*.

Folja *-thom* e – *mi koniugacionit* paraqitet me këto forma imperfektive: *unë thoshe, t'i thoshe, ai, ajo thosh a thoshte, na ne thoshim, ju thoshit ata thoshin*. Kjo folje na paraqitet me një trajtë tjetër në zgjedhimin e imperfektit në të cilin kryqyzohen format e imperfektit sigmatik me ato të asigmatikut: *thoshnjam thoshnja, thoshnje*, etj.

Format e imperfektit të indikativit si i ndeshim në ligjërimin arbëresh të Greqisë nuk pajtojnë me trajtat përkatëse (të dy folje ve të tjera të *-mi koniugacionit*: *jeshë, jeshe, ish: keshë, keshe*, pse na dalin me këto forma: *thojë, tho je, thoj, thojëmë, thojëtë, thoj në* dhe në këtë mënyrë piqen me një kategori tjetër formash imperfektive, p.sh. *di: dijë, dije, dij, dijëmë, dijëtë, dijnë; hajë, haje haj, hajmë, hajëtë, hajnë, klajë, klaje, klaj, klajëmë, klajëtë, klajnë vejë, veje, vej, vejëmë, vejëte, vejnë* që i gjejmë të shënuara në Gramatik der albanischen Mundart von Salamis të *Claus Haebler-it, f. 134*.

Përsa u përket vokaleve të disa vetave të prezentit të indikativit të kësaj kategorie foljore, që dalin si vokale fundore a të mbaresave, duhet të dimë se ato nuk mund të jenë të vjetra, sepse të gjitha vokalet personale të periodës indoevropiane me të kaluar në gjuhën shqipe u zhdukën e nuk lanë farë gjurmësh, prandaj vokalet që i ndeshim sot në mbaresat verbale duan konsideruar të reja, inovuese, pra rezultat formimesh të brendshme të kësaj gjuhe, bie fjala te *kemi, jemi. të jemi, të jeni, të kemi, të keni*.

Dhe në fund në kategorinë e përmendur disa e grupojnë edhe foljen *vete, vete, vete, vemë, veni, venë* në vetat e singularit të së cilës janë zhdukur mbaresat personale.

Po të quajmë kategori të veçantë atë grup foljesh ku bëjnë pjesë të tre verbat e *-mi* koniugacionit, e ato për kah tiparet e tyre veçohen nga të tjerat folje të gjuhës shqipe, atëherë verbat e tjera të kësaj gjuhe do t'i grupojmë në katër zgjedhime.

Në grupin e parë do të sistemonim ato folje, tema verbale e të cilave përfundon me konsonant në kundërshtim me ato, tema foljore e të cilave ose më *-n* e më *-t*; në zgjedhimin e parë grupojmë pra foljet që mbarojnë në konsonant, siç janë: *hap, tremb, tund, shkund, përkund, lag, shkel, ther, lidh, lodh, ngjesh, vesh, kreh, fsheh, njoh, preh*, etj. Që të gjitha karakterizohen nga tipari që ato nuk ndryshojnë vokalin e rrënjës së tyre gjatë zgjedhimit ndër veta të prezentit indikativ, mandej aoristi nisët nga tema verbale e prezentit duke marrë mbaresat vetore të aoristit. Duke pasur parasysh principet që posa u thanë këtu sipër, këtu grupojmë edhe ato folje që mbarojnë me temë në *-t* (veta e parë përfundon më *-s* nga një zhvillim i $t\bar{i} > s$, siç janë këta verba: *porosis, mbys, kullos, kullot. këpus, t\bar{i} këput, ne këpusim, ju këputni, ata këpusin*, etj., për arsye se, siç u tha pak më parë, nuk e alternojnë vokalin e trupit të këtij grupi foljor. Nga ky grup verbash duan veçuar një kategori tjetër foljesh, megjithëse edhe ato në vetën e parë përfundojnë më *-s*, mirëpo, prejse në to paraqitet alternimi i vokalit të tyre në zgjedhim e sipër, siç janë foljet me mbaresat e njohura *-at, (as) -et-t (-flas, flet, flasim, flitni, flasin); thërres; thërras, thërret, thërret, thërrasin, thërritni, thërrasin; bërtas, bërtet, bërtet, bërtasin, bërtitni, bërtasin, mandej, vras, vret, vret, vrasim, vritni, vrasin; ngas, nget, nget, ngasim, ngitni, ngasin*.

Në zgjedhimin e parë në shqyrtim sistemojmë edhe atë klasë foljesh që prezentin e indikativit e shfaqin me ndryshime të vokalit; alternimi vokalik paraqitet edhe në punën e temës së aoristit që ndryshon nga ajo e prezentit: *dredh, ju dridhni, dridhi, drodha, mbledh, mbliidhni, aor. mblodha, vjel, mini, vola; mbjell, mbillni, mbolla, mjel, milni, mola; shtjerr, shtirni, shtora; pjek, piqni, poqa; djeg, digjni, dogja; heq, (hjek), hiqni, hoqa, vjell. villni, volla; tjerr, turrni, tora: nxjerr, nxurrni, nxora*. Ky tip foljesh quhet edhe grup apofonik i verbave, që tema e prezentit u del më diftong nga një *e* e shkurtër indoevropiane, ndërsa forma e aoristit u përftohet atyre prej një *e*-je të gjatë indoevropiane.

Një vistër foljesh me *a* apo *o* në rrënjë në vetën e 2 e 3 të prezentit të indikativit paraqiten të metaforizuara, siç janë *marrë, dal, njoh, shoh* (*merr, del, njeh, sheh*), porse do ditur që *-o* ja e tyre nuk mund të qitet nga një *e* – e gjatë indoevropiane. Dy të parat që sosin me *a*: *marr, dal*, bënin pjesë me prapashtesë *-n* që me kohë shkuan e e asimiluan konsonantin nazal *n*, për çka sot i kategorizojmë në klasën e I verbale.

Këtu ngërthehen edhe ato folje që sosin me *-is, os*, që janë kryekreje të greqishtes, apo edhe formime të pajisura me prapashtesa greke, *-izo*, dhe *-isa* në aorist: *pajis, stolis, qëndis*. Kjo prapashtesë është bërë mjaft produktive dhe zakonisht u ngjitet foljeve të ardhura nga turqishtja: *ujdis, degdis, begendis, begenis, bezdis*. Prapashtesën greke e gjejmë prore të kryqëzuar me atë të shqipes që e hasim në një lloj foljesh me origjinë greke a turke.

Tipi i kësaj kategorie foljore ka pasur, siç dihet, ndryshime për arsye të ndikimit të kategorisë së madhe verbale më *-nio*; duke qenë kjo e grupit foljor indoevropian me mbaresën e hershme *-o*, që me kohë shkoi e ra duke u zhvilluar krejtësisht, e duke përfunduar për pasojë në konsonant: *hap, lag, puth, sos, lidh*, etj., – në një kohë të zhvillimit të gjuhës shqipe, shumica e të folmeve shqiptare i zgjeruan mbaresat vetore në singular të prezentit të indikativit: *ik-ënj, ikën, ikën, ecënj > ecinj > eci, ecën, ecën; hip-ënj > hipi, hipën, hipën*.

Zgjerimi i mbaresave personale përveçse te foljet e kategorisë me konsonant, duket edhe te një grup foljesh që heret sosnin më vokal, siç janë *kla, kla*, ai *kla*, veta e parë shumë *klamë*, vet. 3. *klanë*. ndërsa veta 2 shumë na del me zgjerimin e mbaresës *-ni* që përvjen nga kategoria foljore e *-n* koniugacionit. Me foljen e përmendur, siç dëshmojnë disa të folme arkaike të gjuhës shqipe; arbërishtja e Greqisë dhe dialektet shqiptare të jugut të Italisë shkojnë edhe: *di, di, di; ha, ha ha; (kla, kla, kla) vë, vë, vë; lë, le, lë; ble, ble, ble, blemë, blinë, blenë: flë, flë, flë. flëme, flini, flenë; gecj. flê, flê, flê. flême, flini, flenê*. Shumica dërmuese e foljeve që përfundojnë më *-n* e sistemohen në kategorinë e këtij zgjedhimi të madh verbal në perioda të hershme bënin pjesë në *-o-në* e kategorisë së foljeve. Jashtë këtij ndikimi ngeli ajo kategori foljesh që cilësohen nga shfaqja e apofonisë, siç janë: *marr, merr, dal, del; njoh, njeh, shoh, sheh; ap, jap, jep*

(te Budi edhe kjo folje na del me zgjerim me anë të formantit *-ënj*, *-inj*; *apinj* që vjen nga *apënj*; në verba të quajtura apofonikë hyjnë: *sjell*, *solla* si edhe verba të tjerë; *vjel*, *vola*; *vjell*, *volla*; *shtjerr*, *shtora*; *dredh*, *drodha*; *pjell*, *polla*.

Shfaqja e zgjerimit të mbaresave personale të një kategorie verbale nga kategoria tjetër foljore në një anë dhe mungesa e saj në disa të folme shqiptare, kryesisht ndër ligjërime toske, hapin problemin e kronologjisë së kësaj shfaqjeje në gjuhën shqipe. Situata e kësaj dukurie, siç u tha pak përpara na paraqitet kësajsoj: dialektet arbëreshe të Greqisë nuk i zgjerojnë vetat verbale të prezentit të kategorisë foljore në konsonant me formante të reja të dala nga grupi i verbave të *-n* koniugacionit; të folmet toske të Shqipërisë Jugore janë të zhveshuna nga shtime formantesh kësodore; ndërsa arbërishtja e Italisë Jugore të shumtën na del me formante të ngjitura në foljet e kategorisë me konsonante (krh. Haebler, *Gramatik der albanischen Mundart von Salamis*, Giuse ppe de Rada: *Gramatica della Lingua albanese*, II edizione, Cosenza, 1965; Mark la Piana, *Studi lingustici albanesi*, Palermo, 1939).

As të folmet gege nuk paraqiten të njësishtme përsa i përket dukurisë në fjalë: gegërishtja jugore dhe ajo qendrore nuk na da- lin me formantin e zënë ngoje në singularin e prezentit të indikativit, përkundër dialekteve veriore dhe atyre kosovare, në të cilat formanti i përmendur na shfaqet në veta përkatëse të prezentit; këtu do theksuar që vetat II dhe III nuk marrin kurrfarë formanti, veçse kuantiteti i vokalit të trupit të verbave në këto dy veta shtohet, prej këndeje shumë shkrimtarë e punëtorë gegë të këtyre viseve edhe sot e gjithë ditën edhe grafikisht e shënojnë këtë kuantitet vokalesh duke u ngjitur verbave të këtilla një e të reduktuar (ë) *ti*, *ai shkelë*.

Burimi i këtij kuantiteti do kërkuar në zhdukjen e formantit në fjalë, që do të thotë se edhe këto dialekte ishin të pajisura me një formant të tillë, në dobi të çkahit është fakti që në shkrimet e autorëve të Veriut ndeshje me të madhe formanti që posa u zu ngoje ndër veta të kategorisë foljore me konsonant.

Kjo shfaqje sipas të gjitha gjasave zuri të duket ndër dialekte të gjuhës shqipe para periodës letrare diku e intensifikuan rrethanat, në vise të tjera ngeci.

Një lloj foljesh që sistemohen në zgjedhimin e parë në shqyrtim, janë folje denominative, pse dalin zakonisht prej mbiemra vet duke marrë prapashtesa të ndryshme: *is, ërris, ullis; kuqë- rris; rrok-ull + is > rrokullis*.

Një vistër foljesh të kësaj kategorie formohen prej mbiemrash e emrash duke marrë përpara ndonjë parafjalë apo para- shtesë: *i trashë > ntrash; dritë > zdris, zdit, etj., ndryshk > ndryshk; i bardhë > zbardh; i verdhë > zverdh; i kuq > skuq; i zi > nzij > nxij, vesh > zvesh, zhvesh; palë > paloj; mbledh > përmbledh; sjell > -përcjell; farë > faroj edhe shfaros; plak > folje plak; plakem, mplak; gjak > përgjak; përbuz; përdor, marr > ndër-marr; lidh, ndërlidh, ndërlidhje.*

Ajo folje të kësaj kategorie që sosin në velare e që janë folje apofonike konsonantin fundor zakonisht e palatalizojnë: *pjek, ju piqni, aor. poqa; djeg ju digjni, dogja; hjek, hiqni, hoqa*. Një tubë foljesh apofonike që mbarojnë me temë në *a* apo *o* në vetën e II dhe të III të singularit të prezentit do t'i metafonizojnë vokalet përkatëse duke i kthyer në *-e*: *marr: merr, merr; dal, del, del; njoh, njeh, njeh; shoh. sheh, etj.*

Këto të fundit dhe disa folje të tjera që përfundojnë në konsonantin *h*: *njoh, shoh, preh, mpreh*; nga një paraformë *-eh* nga ka dalë edhe *teh*, njihen të vjetra në gjuhën shqipe, zhvilluar nga një arketip i hershëm mbaresa: – SKO (krh. cognosco); këtu duan radhitur: *ngroh, shkreh, shpreh, mih*.

Kur është fjala për aoristin e këtij vargu foljesh që tubohen në zgjedhimin e II, do theksuar që të gjitha foljet e kësaj klase marrin një formë të vetme aoristi, shkojnë pra me atë klasë foljesh që të kryerën e thjeshtë e formojnë nga tema e prezentit e aoristit me prapashtesat e kësaj kohe: *a(e), e, i (u), -më, -te -në(ë)*. Ky varg foljesh, pra që rreshtohen në tubën e parë foljore, temat verbale të aoristit nuk i zgjerojnë me anë të konsonanteve të tjera qysh ngjan shpeshherë te zgjedhimet e tjera foljore: *unë hap; unë hapa; puth: putha; qeth: qetha; flas: fola (– falas > fëlas > flas), ther: thera; lidh, lidha; lag: laga, lage, lagu; djeg: dogja; dredh: drodha; sjell: solla; marr: mora; dal: dola*.

Zgjedhimi i II

Në zgjedhimin e II bëjnë pjesë një varg foljesh të gjuhës shqipe,

tema e të cilave mbaron me *-t*, ndërsa mbaresa e vjetër e tyre përfundonte me *-io-*; porse veta e I njëjës e prezentit të indikativit sos edhe me *-s* që përvjen nga një lidhje e hershme *t-io*, bie fjala nga *mat io* u përftua një *mas*, prej *mat-īs* > *mat mat-īt* > *mat*.

Foljet e kësaj kategorie i ndajmë në dy grupe: 1) në vargun e atyre verbave që kanë një temë të vetme për prezentin dhe aoristin e tyre; dhe 2) në tubën e atyre foljeve që dalin me dy forma temash pak a shumë të ndryshme në prezentin dhe aoristin. Për grupin e parë po sjellim: *godis* a *godit* – *godit-a*; për vistrën e dytë shënojmë këto folje: *flas* – *fol*, *ngas* – *nga-va*, *bërtas* (nga *brit-as*), *brita*, *bërtita*; *kërcas-krisa*, *kërsita*; *kall-këllas*, *kalla*.

Në klasën e parë hyjnë foljet:

a) Ato që mbarojnë me *-is*, pjesorja *-itë* (tosk. *grabitur*) *grabis*, *grabita*; b) ato që sosin me *-as*, *-atë*: *vikas-vikatë*; c) në *os-otë*: *kullas*, *kullotë*, ç) në *-us-utë*, *këpus*, *këputë*; d) me *ys*; *ytë*, *mbyas*, *mbytë*; dh) foljet me *yes-yetë*: *pyes*, *pyetë*; e) edhe ato verba që mbarojnë me *-es*, *-itë*: *pres* – *pritë*; *shes* – *shitë*.

Pjesa më e madhe e verbave të këtij tipi janë të origjinës sllave, vijnë nga sllavishtja, prej serbokroatishtes, bullgarishtes a maqedonishtes: *grabis* < *grabiti*; *vozis* < *voziti*; *prashis* < *prashiti*, *çu-dis* < *çuditi*; *plaçkis* < *plačkati*. Nuk guxojmë të lëmë në harresë që edhe një grup foljesh me burim shqip dalin me këto prapashtesa: *lajthis*, *lajthita*. Mandej një varg foljesh me gurrë thjeshtë shqipe marrin prapashtesën e zënë ngojë për t'u klasifikuar në këtë zgjedhim: *ujë*, *ujis*; *zvarris*, *zvarrit*, *zvarritem* (varem) nga *dritë*, *ndris*, *ndrit*, *zdris*.

Nga çdo gramatikë shkollore rezulton që foljet me *as*, *-et* na dalin nga tema e shkurtër e aoristit, apo dhe prej temash të prezentit, bie fjala *brit*, *grish*, *klith*, *kall* që përftohen nga prapashtesa *-as* e të tjerë sufiksa: *bërtas*, *kërthas*, *këllas*. Vokali i trupit të temave të përmendura pajisur me prapashtesën *-as*, *et*, me ç'rast ai do të gjendet në pozicionin paratheksor, zakonisht reduktohet: *kall-këllas*; *pall-pëllas*; *grish-gërshas*; *thirr-thërras*; *virr-vërras*, etj. Këto lloj foljesh kanë dy forma prezentesh: atë me prapashtesë *-as*, dhe një tjetër më të shkurtër, tema e të cilave pajton fjalë për fjalë me temën e aoristit: *kall*, *kalla*; trajta tjetër e prezentit *këllas*

formon një trajtë më vete aoristi: *këllita*; *plias*, *pllita*, part. *plllilë*; *gërshas*, *gërshita*, *gërshitë*; *thërras*, *verras*, *thërrita*, *vërrita*. Ky tip foljesh qaset te verbat e njohura të gjuhës shqipe: *qell*, *sjell*; aoristi *mardha*, prez. *mardh* dalin nga arketipi *-morg*.

Te folja *pall*, aor. *palla* duan afruar *përpall*, *shpall*; verbi *flas* nga forma e aoristit *fol* e ka burimin te latinizma *fabella* që në ravën e gjuhës shqipe i përshkoi këto shkallë: *fë-ella*, *fel-la*, *fjalë*.

Numri i këtij vargu foljesh me *-as*, *-et* nuk di a kap 30-35, forma e aoristit të të cilave mbaron me *-ita*: *bërtas*, *bërtita*, *buças*, *çokas*, *çukas*, *gëlthas*, *gërgëras*, *gërshas*, *gërthas*, *hëngëllas* edhe *hin-glloj*, *hërças*, *këlças*, *këlfas*, *këlhas*, *këllas*, *kërcas*, *kukas*, *pëlças*, *pëllas*, *piskas*, *sokëllas*, *sokëllij*, *spërkas*, *shpërkas* (stërpik) *stërkas* *stërklas*, *trokas*, *thërras*, *ulëras*, *uluroj* *vërras* (aor. *virra*); *humbas* aor. *humba*; *mërdhas* – aor. *mardha*; *shklas*, *shkela*. Përveç formave të shënuara, foljet e përmendura, të shumtën, na dalin dhe me trajta të tjera të këtij tipi foljor; – *is*, *it*: *buçis*, *çokis*, *hëngëllis* edhe *hinglloj*, *mërdhis*, *stërkis*, *idëris*, mandej *një varg sosh na paraqiten me -ij*, *hëngëllij* (edhe *hinglloj*); *mërdhij*, *sokëllij*, *ulërij*.

Format e aoristit të këtij tipi verbash, të atyre me mbaresa në *-as* na dalin zakonisht më *-ita*, trajtë që mbisundon mbi të tjerat, mirëpo, shikuar nga aspekti i moshës së saj, mund të thuhet se ajo këtu na del në krye të herës, pse ajo do të jetë formë aoristi e foljeve më *-is*, që më vonë zu të shtrihet edhe ndër folje të tipit më *-as*.

Ndër folje të këtij tipi, të tipit më *-as*, që me vetën e dytë e të trete të së tashmes marrin pjesë në metafonizmin e vokalit *a* në *e*, hyjnë edhe një varg verbash me origjinë sllave, që zakonisht nuk marrin pjesë në dukurinë e zënë ngojë të altemimit të vokalit *a* në *e*; e shembujt *godas*, *godet*, *godet* e disa të tjerë duan marrë zhvillime të reja dialektore, dukuri sporadike të verbave me gurrë sllave – për foljet e fondit autokton të gjuhës shqipe do të jetë tipar karakteristik.

Një numër foljesh e zgjerojnë temën e tyre me prapashtesa të ndryshme, siç janë: nga *plasë* > *plasaris*; *humb* > *humbullis*; *rras* > *rrasallis*; *shkund* > *shkundullis*.

Në këtë klasë ngërthejmë edhe një tip foljesh të tjera me origjinë të huaj, të turqishtes: *çatis* (ja beh, vij papritur), *davrândis* (mbaj qëndrim i të

mirë) nga perfekti i turqishtes *davrandi*, *degdis* prej *degdi*, inf. *degviek*; *delendis* = i nxij faqen dikuj duke folur poshtë e lart keq për të, përftuar prej perfektit turk *dillendi*.

Zgjedhimi i III

Në këtë zgjedhim foljesh përfshihen të gjitha ato verba me temë më -n dhe me mbaresë të lashtë -lo – që në analizë të fundit del më -nio; përfaqësuesi tipik i kësaj kategorie foljore merret fol.ja *bâj*, tosk. *běj* (*bânj*, *bënj*): *bâj* (běj), *bân*, *bân* (*bën*, *bën*), *bâjmë*, (*bëjnjë*), *bani* (*bëni*), *bajnë*, (*bëjnë*); mandej këtu përfshihet si përfaqësues i denjë i kësaj kategorie foljore verbi *pugâj* (*pugânj*), tosk. *pëgënj*, *pëgëj*, *pugân*, (*pëgën*) etj., aoristi i tij duket kështu: *pugâna*, participi *pugâmë*, mandej *laj*, *lan*, *lan*, *lajmë*, *lani*, *lajnë*, këtu mandej duan varguar *shaj* – (shani), *shan*, *shan*, etj., *ndaj*, *mbaj* (mbanj). Në këtë kategori hyjnë edhe vargje foljesh të tjera, të reja për nga formimi i tyre: *shkoj*, *përparoj*, *shtektoj*, *organizoj*, *pajtoj*, *zhvilloj*, *pushoj*, *mbaroj*, *gatuaj*, *fyej*, *luej*, *ziej*, *ktiej*, *thyej*, *mbaj*, *çaj*, *fshij* (shij).

Ky zgjedhim përfshin, siç dihet numrin më të madh të foljeve. Foljet e kësaj kategorie formohen, të shumtën nga emra, mbiemra, ndajfolje dhe prej rrënjësh foljore, e quhen denominative me kuptim kauzativ: *punoj*, *gozhdoj*, *besoj*, *emëroj* (emër); *paloj* (palë) *afroj*, *vogëloj*, *holloj*, *liroj*, *largoj*, *pakoj*, *shumoj*, *vonoj*, *shpejtoj*, *ngadaloj*. Një numër sish janë të prejardhur prej parashtesash apo prapashtesash: *zbardhoj*, *zbardhulloj*, *ngarkoj*, *shkarkoj*, *shfryj* (*fryj-frymë*); *mbuloj*, *zbuloj*, *dëboj*. *prāj* (āj), (ëj), *përgjoj* (*gjuaj*, *gjuaj*); *martoj*, *shtektoj*, *shkoj*, *paguej*, *paguaj*, *luftoj* (luftë); kjo e fundit na del edhe me forma të tjera: *luftoj* a *liftoj* – trajta dialektore. Verbin *martoj* shprehje e mbarë gjuhës, Jokli (Untersuchungen 13) e qet me burim autokton, nga një arketip indoevropian *·meri*; sufiksi -*ëtoj* në gjuhën shqipe është një prej mjeteve të shpeshta të fjalëformimit me kuptim faktitiv: *madhëtoj*, (i madh), *shtektoj* që, sipas të gjitha gjasëve, gjinikoi foljen *shkoj* duke u përshtuar nëpër shkallaret *shtëkoj*, *shtektoj*, *shkoj*, ku dëshmohet asimilimi i grupit të tri konsonanteve -*shtk*> *shk*. (shtek).

Foljet e gjuhës shqipe të grupeve latine kanë hyrë të shumtën në kategorinë me -*onj*, *oj*, ndërsa ato verba të gjuhës shqipe që dalin me -*uej*,

uaj (= *uoj*) nuk na vijnë nga latinishtja, ky varg foljesh i gjuhës shqipe janë të kryehershme në këtë gjuhë, veçse *paguej* a *paguaj* që në shqipen ka hyrë prej italishtes paraqet përjashtim, si dhe *gatuej* a *gatuaj* që qitet nga sllavishtja.

Një varg foljesh me prejardhje latine hyjnë në këtë kategori verbale, siç janë *këndo*, *ngarkoj*, *shkaktoj*, *shëroj* < *sanare*, *dëgjoj* (intelligere).

Një numër i madh foljesh që përfundojnë më -oj janë formuar me zgjerimin e kësaj prapashtese: (ë) *loj*; – (ë) *lloj*; – (ë) *soj*; (ë) *toj*; (*e*) *zoi*; (ë) *noj*; (ë) *zoi*, – *shtoi*.

Foljet që dalin me -*toj* a -*ëtoj* formohen prej emrash, mbiemrash herë- herë paraqiten primitiveve foljesh: *copëtoj*, *emërtoj*, *kaptoj*; ky formant paraqitet edhe i zgjeruar: me një *a* përpara: – *atoj*, *rrezatoj*, *rrethatoj*, *rrethakoj*, *pezmatoj*; të formuara prej emrash, mbiemrash e ndajfoljesh (-*a*-ja mund të quhet e përfutur për analogji me ato fjalë që janë të pajisura me një *a* fundore).

Me formantin -*soj*, *ësoj* dalin folje kryesisht faktitive të formuara nga mbiemra, emra, ndajfolje si dhe prej foljesh: *gjâsoj*, *pakësoj*, *krahasoj*, *befasoj*, *dendësoj*, *ambëlsoj*, *përgjasoj*, *pakësoj*, *butësoj*.

Në tipin e atyre foljeve që formohen me formantin -*zoi*, *ëzoi*, hyjnë përveç verbit të mbarë shqipes: *kallëzoi* (*shpif*, *fus kalla*, informoj autoritetet zyrtare për një njëri a një gjë), *tregoi*, *dëftoi*, *rrëfej*. Në gegërishte shqiptohet kryesisht *kallxoi*, *kalxoi*, me fortim të spirantit në afrikatë pas likuidës, por pasi kishte rënë *ë*-ja e patheksuar. Në Arbëresh të Zarës shqiptohet *gaxue*, e në Shestan të Krajës *kaxoi*, me *kaxuo*. Fjala bazë nga e cila u zhvilluan shumë të tjera është -*kall* prej së cilës doli *këllas*; primitivi i të gjitha fjalëve të formuara nga ai lidhet me anë të apofonisë kualitative me *qell* e me *sjell*; prej tij rrjedh mandej *kalla* = „fitme, shpifje, spica“.

Me formantin -*noj*, tosk. -*roj* (-*ënoj*, -*ëroj*) na dalin folje të formuara nga emra, mbiemra: *vllazënoj*, *vëllazëroj*, *vëllazërohem* (nga *vllazën*, *vëllazër*, *vëllezër*); *trimnoj*, *trimëroj*; *mbretnoj*, *vibretëroj*; *plehnoj*, *plehëroj*; *burrënoj*, *burrëroj*; *vargnoj*; *qytetnoj*, *qytetëroj*; *turpnoj* *turpëroj*; lidhur me trajtën fonetike të këtyre foljeve do theksuar një gjë që ato paraqiten të zgjeruara nga një -*n*, a *r* që u shtohen prapashtesave në fjalë; të

zgjeruara dalin edhe emrat e formuar nga tema në fjalë të zëna ngoje këtu sipër, por vetëm në shumësin e tyre: *vëlla, vëllazën, mbretën, -ër*. Një numër foljesh të kësaj kategorie që ngërthehen këtu në këtë klasë e që paraqiten të zgjeruara vetëm më *-ëroj*, siç janë: *flakëroj, hudhëroj*.

Varg të vogël foljesh paraqesin ato, tema e të cilave zgjerohet me anë të një formanti që shprehet me prapashtesë *-(ë) loj* a *(ë) lloj* e që formohen prej mbiemrash, emrash e foljesh: *tundu- lloj, da > dalloj. i kuq > kuqëloj, pikë a pikël > pikloj > pikëloj, shkundulloj*.

Janë të shumta ato folje që kanë mbaresën më diftong *uaj, uej*, diftongu i të cilave del prej *o-së* së vjetër që në rrjedhën e kohës shkoi e u diftongua: *shkruaj, kruaj, bluaj, paguaj*, etj. Burimi i foljes *shkruej, shkruaj*, është kërkuar te ajo e latinishtes *scribo, scribere*, por ky mendim i dijetarëve nuk duket i mbështetur mirë, pse ndesh në vështirësi fonetike, pastaj është vështirë të kapërcehet fakti se të gjitha foljet e gurrës latine në gjuhën shqipe përfundojnë me *-aj*; sipas të gjitha gjasëve folja *shkruej* duket të ketë dalë nga primitivi *kruej*, pajisur me prefiksin *-sh*; këto folje janë edhe apofonike, në aoristin e të cilave del *o-ja*, që në format e prezentit, u diftongua me *ue, (ua)*. Në kategorinë foljore më diftong hyjnë edhe ato folje që përfundojnë në *-ej, yej*: *blej, rrëfej, thyej*, diftongu i të cilave ka dalë nga *e-ja* e gjatë, e që do të thotë se dikur mbaronin me vokal (unë *ble*, etj.) që më vonë duke u diftonguar morën edhe prapashtesën verbale *-nj, j*, dhe për pasojë u klasifikuan në kategorinë e *n-* koniugacionit.

Foljet me *aj*, siç janë *qaj, mbaj, thaj* e të tjera, nuk mund të jenë të hershme në këtë kategori verbale, sepse po të bënin pjesë që në krye të herës këtu në këtë klasë foljore, ato do të paraqiteshin me një trajtë tjetër fonetike, do të dilnin me vokal të nazalizuar në gegërishte dhe me zanore të reduktuar në toskërishte, siç janë *banj, baj, bëj* e foljet e tjera të tilla. Foljet e përmendura në krye të herës bënin pjesë në vargun e verbave në vokal: : *kla > qa > qanj > qaj-*; *mba > mbaj*. Kjo kategori foljore është njëra ndër më të shumtat klasa verbale, por që për kah kronologjia verbat e saj nuk mund të jenë të vjetra, pse pasqyra e tyre fonetike do të dukej sot krejt ndryshe; pjesa e tyre dërmuese bënte pjesë në grupin e *-aio-* koniugacionit, e jo në atë të *-nio* koniugacionit, ku kishte zënë vend qysh herët folja tipike *banj, baj, bënj, bëj*. Kështu, folja e sotme *punonj*: *punoj* klasifikohej, siç u

tha këtu para, ndër verba të *aio* koniugacionit: *spudnaio*, më drejt *spundaio* nga e cila formë u përftua *-punoo* > *puno*, që mori mbaresën personale a pseudombaresat e tipit verbal të *-nio* koniugacionit

I kësaj kategorie foljore është edhe tipi i verbave që dalin me *-ij* (*ënj*, *inj*, *ij*, *i*) dhe formohen nga rrënja foljore, pastaj prej foljesh si dhe nga fjalë të tjera. Këto folje shkojnë, duke qenë në pajtim me kërkesa të kategorive përkatëse, me dy palë klasash verbale: nga *gjallë* > *ngjall* dhe *gjellij* (*gjellinj*) në një anë edhe në anë tjetër *mbyllinj*, *kap: kapinj*, *kapij*, *kapi*.

Të gjitha foljet më konsonant, me përjashtim të atyre që grupohen në verba apofonikë, na dalin të shumtën e të folmeve me mbarsa të zgjeruara: (*shkeli*) > *shkelënj* > *shkelinj* > *shkeli*. Është mjaft interesant të theksohet se tipi i atyre foljeve të kësaj kategorie që dalin me zgjerim të temës me anë të prapashtesave, apo me formante të tjera, në shumë vise të territorit të gjuhës shqipe nuk shfaqen temash të zgjeruara, siç janë të folmet toske si dhe ligjërimet e gegërishtes jugore e qendrore; këtij vargu të të folmesh i bashkohen dhe dialektet arbëreshe të Greqisë, ndërsa arbërishtja e Italisë Jugore në shumë vise del e zgjeruar me anë të formanteve; në këtë radhë vargohen dialektet geqe: shkodranishtja, të folmet e Malësisë së Madhe, ligjërimet geqe të shqiptarëve në Jugosllavi: Kosova, të folurit shqip të Krajës, si dhe arbërishtja e Zarës. Zgjerimi i kësaj kategorie foljesh bëhet me një formant pseudombaresash *-enj*, *inj*, *i*, që një lagje dialektesh të gjuhës shqipe nuk e kanë, siç u tha pak më parë, në një anë, e në anën tjetër edhe vetë foljet e atyre të folmeve që dalin të pajisura me formante kësodore, format e aoristit nuk pajtojnë me ato trajta të kësaj kohe që quhen primare: më *-rua*., si dëshmohen ato në folje tipike të verbave të kësaj kategorie, të *-n* koniugacionit: *bâna: bëra*, *shtura: shtina*; *shpura*, *vura: vuna*; trajtat e aoristit që paraqiten me *-va* duhet të jenë sekundare, inovuese.

Në arbërishten e Italisë Jugore nxjerrim këto forma prezenti: lagënj a lagingj, ti lagën, ai, ajo lagën, ne lagënjëmi a lagënjem apo lagëmi, lagëni, lagënjën; falinj (Gramatica della lingua albanese, Giuseppe De Rada).

Pseudombaresat e përmendura i gjejmë shumë të përhapura në të folmen e Briskut me Shestanin dhe në arbërishten e shqiptarëve të Zarës:

un hapi

na hapim, hapëm

ti hapën	ju hapni
ai hapën	ata hapin, hapën

godis, goditën, goditën, godisim a godisëm, ju goditni ata godisin a godisën. Në Arbëresh të Zarësh i kemi shënuar këto forma: un *mbes*, ti *mbetën*, ai *mbetën*

ne po mbesim	unë biri	ne birim
ju po mbetni	ti birën	ju birmi
ata po mbesin	ai birën	ata birin

(I. Ajeti. Istorijski razvitak gegijskog govora Arbanasa kod Zadra, Sarajevo, 1961, f. 95-96, 136-148).

Në grupin e IV klasifikohen ato folje që mbarojnë me vokal e që në krye të herës përfundonin më *-o*, *i cili* vokal u thjeshtua e më vonë u zhduk; bie fjala baza e hershme e foljes *di* duhet të ketë qenë një arketip indoevropian *gino*, që s'ka pasur si të përfundojë veçse në *di*, *di*, *di*, *dimë*, *dini*, *dinë*. Ky verb në shumicën e të folmeve gege ka kaluar në tipin e *n*-koniugacionit, me këto mbaresa vetore: *un dij*, *ti din*, *ai din*, etj., siç kanë kapërcyer në këtë tip foljesh edhe verba që sosin më vokal: *pi*, *rri* (*pij*, *pin*, *rrij*, *rrin*); këso ndryshimesh pësojnë edhe foljet apofonike: *shtie*. *shpie* (*shtij*, *shtin*, a *shtjen*); *bie* (*bij*, *bjen*); *fle*, *fle* (*flej*, *flen*), *ha*, *ha*, *ha*, *hamë*, *hani*, *hanë* = *haj*, *han*, *han*), *due* (*dua*) *-do*, *do* (= *due*, *don*, *don*); nuk ka farë dyshimi se alternimet e zëna ngoje janë inovuese, e nuk mund të jenë të vjetra, njëherë që nuk i ndeshim në shkrimet dhe në dokumente gjuhësore të shkrimtarëve të vjetër gegë, mandej ato nuk i gjemë as në ligjërimet e tjera gege.

Në këtë kategori foljesh hyjnë sot edhe ato verba që mbarojnë në vokal nazal në gegërishte, kurse në të folmet toske do të sosin me vokal të reduktuar: *zâ*, *zê*, *zê*, *zâmë*, *zini*, *zânë*, tosk. *zë*, *zë*, *zë*, *zëmë*, *zini*, *zënë*, *flë*, *flë*, *flë*, *flëmë*, *flini*, *flënë*; *flë*, *flë*, *flë*, *flemë*; *flini*, *flënë*, porse format e kësaj foljeje në ligjërimet toske dalin dhe me vokal të plotë *une fle*, *fle*, *fle*, *flemë*, *flini*, *flenë*; unë *lâ*, *lë*, *lë*, *lâmë*, *lini*, *lânë*: *lë*, *lë*, *lë*, *lëmë*, *lini*, *lënë*.

Për ato folje që radhiten në kategorinë e foljeve me vokal, siç janë: *zâ*, *zë*, *zë*, *vë*, *lâ*, *lë* e të tjera, duan thënë disa fjalë. Ato sot klasifikohen, siç dihet, në një grup më vete, mirëpo mbaresat nazale fundore shpien te

konsonanti i tyre nazal si mbaresë, prandaj ato dikur dilnin në konsonantin *-n*, dhe si pasojë bënin pjesë në tipin e foljeve të *-n* – koniugacionit. Me rënien a zhdukjen e konsonantit nazal që gjendej në fund, dhe me ndryshimin që ato, me këtë rast pësuan, zunë të përfundojnë në vokal: *zâ* (*zan*), *vë* (*ven*); po kështu do gjykuar edhe për fle (*flen*) që është pajisur me prefiks *f* dhe temën *-lënë* (Çabej, *Buletin*, 1962/1-f. 100).

Një numër i mirë i foljeve të kësaj kategorie në aorist dalin me *n-a r* siç janë këto verba: *vê, vë; vuna: vura; zâ: zë; zuna, zura; shpie, shpuna: shpura; shtie: shtina: shtura*; çka dëshmon se këto folje dikur klasifikoheshin në kategorinë e *n* koniugacionit ku hynte verbi *bâj, bëj (bâna; bëra)*.

E tanishmja e dëftores – prezenti indikativ

Mbaresat indoevropiane të foljeve janë reflektuar në gjuhën shqipe me të njëjtat forma, mirëpo ato në të shumtën e rasteve janë zhdukur dhe vetëm përjashtimisht i gjejmë të ruajtura në sistemin verbal të gjuhës shqipe. Ato shpeshherë janë ngjitur me temën verbale në mënyrë që sot është shumë vështirë të veçohet elementi i temës nga pjesa që do të njihej mbaresë personale e verbit.

Klasifikimi i foljeve të gjuhës shqipe, sikur dhe verbat e të gjitha gjuhëve, bëhet në mbështesë të mbaresave indoevropiane që janë pasqyruar në secilën gjuhë, të dalë nga gjuha – amë indoevropiane. Mbaresa personale e gjuhës – amë indoevropiane e foljeve më *-o*. në gjuhën shqipe është reflektuar në atë mënyrë që mbaresa në fjalë e periodës indoevropiane është zhdukur duke qitur kategorinë e këtyre foljeve në konsonant: *mbledh: mlodha*: lat, *legē*, nga **legē*; *rrah* serbokroatisht *rezati; razina* (= *shesh, rrafsh, fushë*), për *rrah* (e godis, i bie, përshkoj një vend) do të mendohet i dalë nga një bazë e *rag-h-sko*. Në këtë kategori grupohen foljet që në vetën e parë të prezentit përfundojnë në mbaresën: *o; mbyll, lidh, kalb, ndez, puth, vesh, lag, var, lidh*; tema e prezentit dhe e aoristit të tyre është identike: *putha, nisa, lidha, kalla, ndeza, vara, mbylla, laga, vesh, etj.*

Mbaresat indoevropiane janë këto: *o, io, -i e-s (i); -i, e-t (i)*; në plural ato duken kështu: *o-mos* (apo *o-mos*) (*io-mos*); *-i (e-te)*; *o-nti*; në

latinishte ato paraqiten në këtë mënyrë: *o (io), s, -t, -mus, -tis, -nt*; mbaresat personale të indishtes së vjetër duken kështu: *-(a) mi; (a) -ti; -a-ti; a-mah; -a-tha; -a-nti*: paradigma e mbaresave vetore shfaqet kështu: *fer-o, fer-eis; fer-ei; fer-o mes*; mbaresat e gotishtes dalin (men); *fer-e-te, fer-onti*

bair-a	bair-a-m
bair-i-s	bair-i-p
bair-i-p	bair-a-nd

Në lituanishte mbaresat duken kështu:

dĩr̃b – u	dĩr̃b -a-me
dĩr̃b, – i	dĩr̃b -a-te
dĩr̃b – a	

ndërsa në sllavishten e vjetër ato shfaqen në këtë mënyrë:

ber -a	ber-e-m
ber-e-ši	ber-e-te
ber-e-te	ber-ot-ь

Dihet me kohë që mbaresat indoevropiane të singularit në gjuhën shqipe kanë rënë; vetëm mbaresa e vetës së parë ka lënë një farë gjurme në shkrirjen e temës me mbaresën personale të saj. Përsa u përket vetave të pluralit, ato janë ruajtur dukshëm, pra ato duken në vetën e parë dhe të tretë të pluralit; në vetën e dytë të pluralit në gjuhën shqipe nuk del arketipi i vjetër indoevropian i kësaj vete.

Siç ti përmend pak më parë, mbaresat e vetës së parë kanë qenë *-o* apo *io*, të cilat ngjiteshin me bashkëtingëlloret fundore të temës verbale: *t, n*, pra *tǰo, -nǰo -no*. Nga bashkimi i parë ka dalë zhvillimi *tǰo*; për shembull: *mat-io > masu > mas*; *godit-io > godisu > godis*, *porosit-ǰo > porosisu > porosls*; prej lidhjes *-n -ǰo* është formuar ky zhvillim *bhanio > banio > banjo > banju > bānj*, tosk. *bēnj*, sot *bāj*, *běj* mandej prej temës *daln* dhe mbaresës *o* pra *dal-n-o* na doli forma: *dallo > dallu > dall > dal* e vetat e tjera, veta e dytë, fjala vjen formohej nga trajtat: nga tema: *dall-* dhe mbaresa *is*, pra, nga *dall-is > delli > del*, veta e III sing, ka dalë nga *dall-it > delli > del*; vetat e pluralit do të zhvilloheshin kështu veta e I shumë: *dal-n-omos > dallamas > dallëmë > dalëmë > dalimë > dalim*; veta e III shumë ka ndjekur këtë shteg zhvillimi: *dal-n-o-ntai > dallante > dallande > dallanne > dalënë > dalinë > dalin*. Nga një bazë *gnosk-o* zuri fill veta e parë e singularit *njoh*; veta e dytë doli prej **gnoskis > njeh*, e treta u

zhvillua nga **gnoskit* > *njeh*; vetat e shumësit nisin prej **gnoskomos* > *njohama* > *njohëmë* > *njohimë* > *njohim*; e dyta vetë personale doli nga **gnoskite* > *njehit* > *njihi* > *njihi* (*njihni*); e treta vetë shumës u përftua nga forma bazë: **gnoskontai* > *gnoskantai* > *njohana* > *njohënë* > *njohinë* > *njohin*. Të vazhdojmë analizimin e kësaj kategorie foljore me një verb apofonik – verbin *marr*. Kjo folje në perioda të mugëta mbaronte më *-n* që do të thotë: me formën *marr*, e cila me anë të asimilimit të lidhjes konsonantike *rn* në *rr*, fenomen i njohur në fonetikën historike të gjuhës shqipe. Veta e parë *marr*, doli nga *marn* nëpërmjet të asimilimit të fundorit vetor, e dyta vetëm *merr* erdhi nga *marnis*, prej të cilës trajtë shkoi e u zhduk silaba fundore që shkaktoi njëherë metafonizimin e vokalit të *a*-së në trup të fjalës në shqyrtim; nga i njëjti veprim rrodhi ai, ajo *merr*, *marnit* nëpërmjet metafonizimit të vokalit të *a*-së dhe me rënien e silabës fundore, siç e pamë më lart. Trajtat e shumësit morën këtë rrugë zhvillimi: *marna-mos* > *marrama* > *marrëmë* > *marrimë* > *marrim*; veta e dytë shumës u zhvillua kështoj: *marnite* > *marri* > *merri* > *merrni*; veta e III shkoi e u përftua prej *marn-o-ntai* > *mar ranne* > *marrënë* > *marrinë* > *marrin*.

Kategorinë e *-n* koniugacionit e përfaqëson fol ja më tipike: *bânj* – *bënj* – *bâj* – *bëj* që doli nga një bazë e vjetër: *banio* > *banjo* > *banju* > *banj*: *bënj*.

Veta e dytë e singularit është nxjerrë nga një bazë e hershme, nga arketipi *bhanis* (*i*) njësoj sikur veta e tretë, prej *bhanit* (*i*) që përfunduan në këto zhvillime: *banis* > *banit*, mirëpo këto trajta të mugëta do të sosnin në këto formime: *bê*, pse silaba fundore me vokalin e ngërthyer brenda do të shkaktonte alternimin e *a*-së në *e* që gjendet në trup të fjalës; mandej veta e II shumës nga një *banite* e vjetër do të dilte *bini* në gegërishte dhe *biri* në toskërishte, sepse *n*-ja ndërzanore do të kthehej në *r*. Prandaj rruga më e drejtë e zhvillimit të bazës *rend-parë* që do të rrihet është forma e lashtë – panshqiptare *ban* që me kohë mori një *d* homorganike pra *band* > *bann* > *ban*, *bën*, (*banis* > *bandis* > *band* > *ban*; *banit* > *bandit* > *bandit* > *band* > *ban*, tosk. *bën*). Për vetën e I shumës, nga forma parashqiptare *bhaniomos* > *banjama* > *banjëmë* *bënjëmë* *bajnë* > *bëjnë*. Nga *banite*, për vetën e II shumës, u zhvillua forma *banni*, *bani*, tosk. *bëni*. Prej formës parashqiptare *banj anti banjanti banjandi banjanë* doli *banjënë* *bajnë* *bëjnë*. Mbaresa personale e vetës III *-në*, rrodhi nga forma e mbaresës

vetore *-ntai*. që u zhvillua në *-në* nëpërmjet *nt > nd > nn > në*, po ashtu siç ishte formuar nga e njëjta trajtë e hershme parashqiptare dhe mbaresa vetore të *ja-në*, *kanë*.

Foljet atematike nuk dot'i zëmë ngoje këtu, (*jam, kam, thom*) sepse i kemi analizuar më parë në vështrimin e kësaj kaptine mbi sistemin vokal të gjuhës shqipe.

Kategoria e *n* - koniugacionit në *-nio* paraqet grupin më të madh të foljeve, porse ato duket se janë formuar në analogji me tipin më të shënueshëm të kësaj kategorie, me foljen *bani, baj, bëj*; mosha e të tjerave nuk është e madhe, çka dëshmohet nga mungesa e ndryshimeve që do të pësonin ato në trajtën e tyre fonetike sikur të ishin me lashtësi të madhe; bie fjala *shanj, shaj, mbaj, mbaj, baj, çaj, qaj (klai)*. Për një pjesë të mirë të foljeve të kësaj kategorie dihet me siguri se në një periudhë jo të largët hynin a grupoheshin në një radhë tjetër foljesh, pse paraqitja e tyre tingullore ndryshonte nga ajo e sotmja, ato pra atëherë nuk përfundonin në konsonantin *-n* a lidhjen *-nio*, ku kanë zënë dikur më vonë të strehohen.

Në kategorinë e *-n* – koniugacionit dikur hynte edhe ajo tubë foljesh që sot në vetat e singularit të prezentit sosin me – vokale nazale të folmet geqe, ndërsa në ligjërimet toske vokalet përkatëse janë reduktuar siç dihen te folje, *zâ: zë, lâ: lâ, nxâ: nxë; flê: flë a fle; vê: vë*. Klasifikimin a ngërthimin e kësaj radhe të foljeve në kategorinë e *-n* koniugacionit e deshmon mbaresa *-vokal* e tyre fundore me karakter nazal, që ka dalë nga konsonanti fundor i natyrës nazale (*n*), që me të zhdukur të tij shkaktoi nazalizimin e vokalit fqinjë. Këto ndryshime fonetike sollën me vete grupimin e foljeve të zënë ngojë në një kategori tjetër, në kategorinë e IV, apo në atë që njihet me emrin e kategorisë së foljeve me – vokal. Rruga e zhvillimit të një folje të kësaj kategorie duket në këtë mënyrë: *zano > zanu > zan > zâ, tosk; zë; veta e dytë ndoqi fillzhvillimin që pason: zanis > zeni > zen zê: zê: zë: njashtu edhe veta e III Singular e prezentit të verbit në shqyrtim: zanit > zeni > zen > zê: zë; shumësi i kësaj foljeje na paraqitet kësajsoji: zana-mas > zanëmë > zannëmë > zânmë > zemë, zanite > zenit > zini; veta e III shumës përfundoi kështu: zanne > zanënë > zan-në > zânë > zënë. Të njëjtat shtigje i përshkuan edhe tjerat folje të kësaj kategorie, të kategorisë së verbin vokal.*

Të kategorisë së *-n* – koniugacionit ishin dikur, siç është theksuar edhe disa folje apofonike, sikur janë *verbat*: *nxjerr*, *marr*, *shtjell* etj., *rr*-ja rrotullare e të cilave është përfutur nga asimilimi i grupit konsonantik *-rn* që në rrymën e motit përfundoi në *-rr*. Këto folje, siç dihet, në aorist nuk dalin me *rr* rrotullare, porse me *r*-të thjeshtë sepse temat e prezentit dhe të aoristit nuk piquen, nuk janë identike. Në këtë tubë foljesh hyjnë një vistër sosh që mbarojnë në vokal, siç janë *pi*, *di*, *rri*, *ha* mandej të tjera që përfundojnë në diftong, bie fjala: *shtie*, *shpie*; në lidhje me foljet e fundit, ato të kategorisë në shqyrtim, do theksuar që ato në vetën e dytë e të tretë singular të prezentit, me disa dialekte geqe, sidomos në ato të gegërishtes verilindore, marrin nga një *n*; *di(j)*, (ti, ai) *din*; (ti, ai) *pin*; *shtien*; *shpien*; dhe kështu konsonanti i hershëm i disave nga këto folje kthehet prapë; është kjo një dukuri e re e disa të folmeve geqe verilindore.

Në lidhje me kategorinë e *-n* koniugacionit nuk mund të mos përmendim edhe një gjë, që pjesa më e madhja e foljeve në konsonant janë të pajisura me të ashtuquajturën pseudombaresë të *-n*- koniugacionit: (unë) *-ec-ë-nj*, (ti) *ecën*, (ai, ajo) *ecën*; sot edhe *ecinj*, *eci*, *ik-ë-nj* (*iknj*, *iki*), (ti) *ikën*, (ai) *ikën*.

Dihe se në të folmet e shqiptarëve në Jugosllavi si dhe në ligjërimet veriore të Shqipërisë, *verbat* e pajisur me tiparin e përfillur ndeshen me shumicë, mund të thuhet pa dyshim që të gjitha foljeve që në prezent të dëftores dalin me konsonant, veta e parë u mbaron me vokal: (û) *lidhi*, (ti) *lidh*, (aj) *lidh*; *fali*; *fal*; *veshi*, (ti, ai) *vesh*. (û) *keshi*, (për qesh); këtu, siç dihet, nuk dalin me vokal ato folje që në trup mbajnë diftong, as ata *verba* vokalet e trupit të të cilave pësojnë alternime a metafonizohen: *dal*, *del*, *del*; *marr*, *merr*, *merr*; *sjell*, *sjell*, *sjell*; *pjell*, *pjell*, *pjell*; *mjel*, *mjel*, *mjel*; *mjell* (për mbjell); *dredh*, *mledh* (për mbledh). Zgjerimi i foljeve në konsonant që posa i përmendëm këtu sipër, me anë të pseudombaresave të *-n*- koniugacionit del qysh në shkrimet e Buzukut: ai qi *kurorën* se ajo *shetatën*; te Bardhi (Fjalori): *extinguo luceram-shkimbinj dritën*; *exugo sanguinem illi – i thithinj* gjaknë unë, *imple dolium vino – mbushinj* butnë me venë; *inalbesco manus – zbardhinj* duertë; *inspicat dentes – mprelën* dhambëtë, *intercludo iter-shq. i mbërshelinj* udhënë; *necto jilum – lidhinj* *peenë*, *përspergo aguam-po derdhinj* ujë.

Është shumë interesant të konstatohet barazimi i plotë, në këtë pikë, i ligjërimin arbëresh të Zarës bashkë me dialektin amë dhe me gjuhën e autorëve të vjetër, të Buzukut me shokë, që nuk njohin kurrfarë përjashtimi në përdorimin e mbaresave, qysh u zunë ngoje këtu te verbat që në prezent sosin me konsonant: *un ik-inj*, a *ik-i*, ti *ikën*, ai *ikën*: na *ikim* a *ikëm*, ju *ikni*, ata *ikin* a *ikën*; *un hipi*, ti *hipën*, ai *hipën*; *un hapi*, ti *hapën*; *un pres* ti *pritën*; *godis*, ti *goditën*.

Mënyra lidhore (koniunktiv)

Format e prezentit të koniunktivit dhe ato të prezentit të indikativit dalin me pak ndryshime në vetën e dytë e të tretë të singularit. Ndryshime të këtyre mënyrave verbale shfaqen në vetën e III shumës të foljeve të *mi*-koniugacionit: *kanë*, te *kenë*, *janë*, të *jenë*.

Mbaresa – *sh* na del në vetën e dytë njëjës të prezentit, ndërsa *-ë-ja* ndeshet në vetën e tretë të kësaj kohe.

Dy mbaresat e përmendura nuk na dalin identike ndër të gjitha kategoritë foljore të shqipës.

Ndër folje me konsonant mbaresat në shqyrtim duken *-ësh*, *ë-ja* e të cilës kthehet në *-i*, pra *ish*, ajo paraqitet edhe *-sh*; të *hapësh*, të *hapish* a të *hapsh*.

të çelësh, të *çelish* a të *çelsh*

të shohësh, të *shohish* a të *shohsh*

të ikësh, të *ikish* a të *iksh*

të flasësh, të *flasish*, të *flassh*, a të *flaç*

të thërrasësh, të *thërrasish*, a të *thërrassh*

të vrasësh, *vrashish*, *vrassh*, *vraç*

të presësh, *presish*, *pressh*

Mbaresat e zënë ngoje na del disi me pak ndryshime fonetike te foljet me vokal si dhe te ato të *n*-koniugacionit; e kemi fjalën për mbaresën e prezentit të vetës së dytë te të tretë të koniunktivit:

të hash *të hajë*

të dish *të dijë*

<i>të flesh</i>	<i>të flejë</i>
<i>të vesh</i>	<i>të vejë</i>
<i>të kërkosh</i>	<i>të kërkojë</i>
<i>të lash</i>	<i>të lajë</i>
<i>të zâsh: zësh: të zâjë: të zerë – toskërisht</i>	
<i>të lâsh: lësh të lâjë: të lerë</i>	
<i>të biesh</i>	<i>të bjerë</i>
<i>të shtiesh</i>	<i>të shtijë – të shtjerë</i>
<i>të shpiesh</i>	<i>të shpjerë</i>
<i>të vesh</i>	<i>të vejë: të verë</i>
<i>të pish</i>	<i>të pijë</i>
<i>të rrish</i>	<i>të rrijë</i>

Në shkrimet e autorëve të vjetër shqiptarë mbaresat e vetës së II e III të singularit të prezentit dalin me një trajtë më të lashtë; në foljet *n* – koniugacionit ato për vetën e dytë duken kështu – *njesh: të banjësh*, e ajo e të tretës paraqitet në formën: të banjë, ardhur prej arketipave: *bhan-io* > *banjo banj*; *bhan-je*, si *baniesh* > *banjësh*; *bhan-je-ti* > *banjet* > *banjë*. - *Nj-ja* e formave të sipërme është kthyer në *-j*, ashtu ato janë rrudhur në këto trajta: *të bâj; të bâjsh, të bâjë: le të bëj, të bësh, të bëjë*.

Format e prezentit të koniunktivit dhe të atyre të indikativit të foljeve apofonike, domethënë të atyre që në disa veta verbale cilësohen nga metafonizimi i vokalit *a* në atë e kanë një ndryshim që trajtat e koniunktivit nuk i shtrohen metafonizimiit, siç ndodh puna me ato të indikativit: *shosh: sheh*,

Koniunktiv: *të shoh, të shohësh, të shohë*

Prez. ind. *marr, merr, merr*

Koniunkt. *të marr, të marrësh, të marrë*, (të marri).

Dal, del, del

të *dal, të dalësh*, (të dalish); *të dalë – (të dali)*.

Është shumë interesante të vërehet që trajta e vetës së tretë ndër disa ligjërime gege del kësisoji: ai *të dalin*, apo *të del*; forma e parë përdoret në disa të folme malësore (Dukagjin-krh. Cimoehowski, Le Dialecte de Dushmani) si dhe në dialekte të shqiptarëve të Jabllanicës: ai *të shohin*; *të falin, të marrin, të çesin, fshehin, të lugin*.

Mendimi se kjo përmbyse a ky ngatërrim i singularit me pluralin ka

ardhur nga ndikimi i serbokroatishtës të cilës i mungon koniunktivi, nuk duket i drejtë, pse po të ishte punë që dialektet serbe të këtyre anëve të kenë ndikuar në përzierjen e këtyre dy formave në përdorimin e pluralit në vend të singularit, do të dëshmohej në rend të parë e para së gjithash në dialektet shqiptare të Malit të Zi, në Krajë dhe sidomos në arbërishten e Zarës. Si duket nga shënimet tona, në gjuhën shqipe të Dibrës bashkë me të folmet e tjera shqiptare gege e toske të Maqedonisë Perëndimore, nuk del kurrfarë ngatërrimi në përdorimin e prezentit të indikativit me atë të koniunktivit, siç thotë M. Domi në *Morfologjinë historike*, f. 55.

Dibranishten me shqipen e Prizrenit dhe me rrethe i cilëson një dukuri tjetër, ajo është në përdorim të vetës së II të koniunktivit në vend të indikativit: *a shkojsh ti? a vi(j)sh edhe ti me ne?*

Po deshëm të caktojmë kronologjinë e zëvendësimit të njërës formë nga forma tjetër në të folmet shqiptare të Kosovës, duket që ngatërrimi i tillë do kërkuar që në fillim të shekullit të XIX, pse në çerekun e parë të atij qindvjetshi del me të madhe me shkrimet e Tahir-efendi Boshnjakut (Vehbije, 78 1835).

E pakryera – imperfekti

Gjuha shqipe ka sot dy trajta të imperfektit, njëra është ajo që quhet imperfekt-sigmatik, ndërsa tjetra thirret e pakryera asigmatike. Është i vërtetë pohimi se secila nga këto forma imperfekdash del me trajta të shumta. Forma që përdoret kryesisht në toskërishte del me *-nje*, a *nja* në vetën e parë, dhe *-nje*, (*n*) *te* – në vetën e II e III të singularit, si dhe *nim(ë)*, *nit(e)*, *nin(e)* – në shumës.

Mbaresat e imperfektit sigmatik që sot përdoren në pjesën më të madhe të gegërishteve, dalin kështu:

Veta e I, njëjës: *-she* a *sha* (*jshe*, *jsha*), veta e II e III: *-she* (*jshe*), - (π) te njëjës dhe *-shim* *-shit*, *-shin* në shumës. Për kronologjinë e këtyre trajtave të imperfektit do të bëjmë fjalë më vonë.

Këtu poshtë po japim një pasqyrë imperfektesh të të gjitha kategorive foljore, ashtu siç dalin sot në gjuhën e shkrimit, duke i përfshirë të dy dialektet e shqipes, toskërishten dhe gegërishten letrare.

Singulari:

- | | |
|-----------------|-------------------------------|
| 1. hapja, hapje | - (hapnja, hapnje); hapshe(a) |
| 2. hapje | - hapshe |
| 3. hapte | - hapte |

Plurali:

- | | |
|-----------|-----------|
| 1. hapnim | - hapshim |
| 2. hapnit | - hapshit |
| 3. hapnin | - hapshin |

Singulari:

- | | |
|-----------------------------|--------------------------|
| 1. çel | (2) djeg |
| 1. çelja, (e) - çelsha (e); | digjja (e) - digjsha (e) |
| 2. çelje - çelshë | digjje - digjshë |
| 3. çelte - çelte | digjte - digjte |

Plurali:

- | | |
|---------------------|---------------------|
| 1. çelnim - çelshim | digjnim - digjeshim |
| 2. çelnit - çelshit | digjnit - digjshit |
| 3. çelnin - çelshin | digjnin - digjshin |

lidh *jap*

Singulari:

- | | |
|---------------------------|---------------------------|
| lidhja (e) - lidhsha (e) | - jipja (e)- jipsha (e) |
| lidhje lidhshë | jipje - jipshë |
| lidhte lidhte | jipte - jipte |

Plurali

- | | | |
|---------|----------|------------------|
| lidhnim | lidhshim | jipnim - jipshim |
| lidhnit | lidhshit | jipnit - jipshit |
| lidhnin | lidhshin | jipnin - jipshin |

flas *shes*

- | | | |
|------------|--------------------|-----------------------------|
| 1. flitja, | flisja-flitsha (e) | shisja (e) - shitsha |
| 2. flitje, | flisje-flitshë | shisje - shitshë |
| 3. fliste | - flitte | shite - shittë |

- | | | |
|------------|-------------------|--------------------|
| 1. flitnim | -flisnim-flitshim | shitnim - shitshim |
|------------|-------------------|--------------------|

2. flitnit	-flisnit-flitshit	shitnit	- shitshit
3. flitnin	-flisnin-flitshin	shitnin	- shitshin

di

dija	- dinim;	- dijshe	- dijshe	- dijshe	- dijshe
dije	- dinit;	- dijshe	- dijshe	- dijshe	- dijshe
dinte	- dinin;	- dinte	- dinte	- dinte	- dinte

<i>ha</i>	<i>dua, due</i>		
haja (haje)	- hajshe (a)	doje (a)	dojshe (a)
haje	hajshe	doje	dojshe
hante	hante	donte	donte
hanim	hajshim	donim	dojshim
hanit	hajshit	donit	dojshit
hanin	hajshin	donin	dojshin

<i>qaj</i>	<i>blej</i>		
qaja	qajsha	bleja	- bljesha
qaje	qajshe	bleje	blejshe
qante	qante	blente	blente
qanim	qajshim	blenim	blejshim
qanit	qajshit	blenit	blejshit
qanin	qajshin	blenin	blejshin

<i>běj, báj;</i>	<i>shkruaj (shkruej)</i>		
bėja	- bájsha	shkruaja	- shkruajsha
bėje	- bájshhe	shkruaje	shkruejshe
bēnte	- bānte	shkruante	shkruante
bēnim	- bájshim	shkruanim	- shkruajshim
bēnit	- bájshit	shkruanit	shkruejshit
bēnin	- bájshin	shkruanin	shkruejshin

Këto janë, siç u tha këtu pra, format e imperfektit si dalin në gjuhën e sotme të shkrimit. Po të bënim një krahasim me ato trajta imperfektive që paraqiteshin në shqipen e hershme, në atë të autorëve të vjetër si dhe ndër dokumente të lashta të shqipes, – në mes njëres dhe tjetres palë të formave të imperfektit do të konstatojmë ndryshime të shënueshme. Për format e sotme të imperfektit mund të themi se ato karakterizohen nga shtime të ndieshme fonetike e për pasojë ato i cilësojnë kalime prej një tipi foljesh në kategori të tjera.

Dialektet arkaike të gjuhës shqipe, kryesisht të folmet e kolonistëve shqiptarë në Greqi dhe në Jug të Italisë, në Kalabri e Siqeli, paraqiten me trajtë të vjetër fonetike të sistemit verbal. Edhe gjuha e Buzukut, si ruhet në Mesharin e tij del me trajta të vjetra foljore.

U mor vesh se tema e prezentit që rri në bazë të sajimit të imperfektit gjatë zgjedhimit pëson ndryshime fonetike, shfaqje që dëshmohet edhe në pjesën më të madhe të gjuhëve indoevropiane.

Një krahasim i formave: tema me mbaresa vetore të paragjuhës indoevropiane dhe të bijave të saj, me gjuhën shqipe do të na lehtësonte zhvillimin e formave të imperfektit si kanë zënë fill dhe do të na tregonte rrugën e shtjellimit të tyre në rrjedhën e kohës.

Paragjuha indoevropiane

Singul.	Plur.
1. e-bher-o-m	1.
2. e-bher-e-s	2.
3. e-bher-e-t	3. e-bher-o-nt

Ind. vjetër	Greq.	Latinishtja	Sing.
1. á-bhar-a-m;		e-fer-o-n	ferebam
2. á-bhar-a-h;		e-fer-e-s	ferebas
3. á-bhar-a-t;		e-fer-e	ferebat

Plur.			
á-bhar-á-ma;	e-fer-o-mas	-	
a-bhar-á-ta;	e-fer-o-te	-	
a-bhar-a-n;	e-fer-o-n	ferunt	

Format imperfektive që ruhen në të folmet arkaike të gjuhës shqipe do të mund t'i shpjegojmë lehtë po i shënuam këtu si na paraqiten në ato dialekte. Fjala vjen mbaresat imperfektive në Mesharin e Buzukut shfaqen kësisoji: veta I *-e*; e dyta *-e*, e treta del pa farë mbarese; në shumës do t'i ndeshim *imë*, *-itë*, *-inë*, po të marrim foljen *bânj*, format e imperfektit në gjuhën e Mesharit të Buzukut janë kësisoji: *banjë*, *banje*, *ban*; *banjimë*, *banjitë* dhe *banjinë*.

Po të nisemi prej formës parashqiptare nga e cila duhet të kenë dalë trajtat e sotme imperfektive, arketipin e trajtave imperfektive të foljes *banj*

e paravendojmë më të drejtë në formën: *e-bhan – io- m* për vetën e parë, që në instancë të fundit do të ketë përfunduar duke përkthyer shkallët e duhura fonetike të trajta *banj* <*baniom* < *banjën* <*banjë*. Mbaresa *-nj* e kësaj vete ka dalë, siç pamë, prej temës verbale *-nio*, kurse mbarsa *-m*, ka rënë në rrjedhën e kohës. Për vetën e dytë banje duhet të nisemi nga *e-bhan-ie-s* > *baniës* > *banje*.

Veta e III njëjës e imperfektit të foljes *banj* del *ban* të Meshari i Buzukut dhe piqet krejtësisht me vetën e III të prezentit; arketipi i saj duket: *e -bhan-i-t*, që në rrjedhën e kohës ka shkuar duke u thjeshtuar, ashtu që në krye të herës kish rënë *e-ja* nisto- re e formës parashqiptare dhe është sjellë në atë formë, nga e cila u përftua veta e III e prezentit *bhan-i-t* që shkoi e përfundoi në *ban*. Rruga e zhvillimit të kësaj forme të imperfektit, do të jetë kjo: *e-bhan-i-t* > *bhan-i-t* > *banit* > *bandit* > *bandit* > *band* > *bann* > *bân*.

Trajtat e hershme të kësaj folje në arbërishten e Siqelisë na. dalin:

bënja	bënjëmë
bënje	bënjëtë
běj	bënjënë

Format e sotme të kësaj foljeje janë këto:

bëja	bëjëm	vise-vise dhe
bëje	bajët	bëim
běj	bějën	bëit, bëin

Këtu duan sqaruar disa forma verbale, pse ato kanë pësuar ndryshime fonetike dhe në këtë mënyrë janë tërnuar tingullisht dhe morfologjikisht.

Para së gjithash do shpjeguar a-ja e vetës së parë singular *-bënja*, e s'ka kurrfarë dyshimi që -a-ja fundore, mbarsa e zënë ngoje fundore qitet prej *α-së* vetore të aoristit: *bâna: bëra*. Edhe veta e III *-běj* do tfilluar, *j-ja* do të ketë dalë prej një *-nj*, që do të thotë se forma e saj e moçme duhet të ketë mbaruar me *bënj*, e *-nj* e kësaj forme pandehet sekundare, e dalë prej *-n-së*. Po s'u pranua një rrugë e këtillë gjinikimi a përftimi i formës në shqyrtim, atëherë do të ishte e pamundur të kapërcenim vështirësitë fonetike që

do të dilnin me shpjegimin e kësaj trajte verbale impfektive; do të ishte vështirë të mënjanohet rotacizmi që do të shfaqej në toskërishte nga një *-n* intervokale.

Një formë e këtyllë gjendet, megjithëse rrallë, në formën e vetës së III Singular që del pa mbaresë vetore e që sporadikisht ndeshet ndër dialekte anësore të shqipes, në të folmet arbëreshe të Greqisë dhe në shqipen e Çamërisë, në toskërishten jugore: ai *shkon*; ai *bën*, (te Buzuku: *ban*), ai *marton*; *shërben*; *kërkon*; *dil*, (*dilte*), ai *piq* (= *piqte*); ai *rrin* (*rrinte*) ai *bij* (*binte*); *ajo vajza s'duaj të martonej* (Pedersen, *Tekstet shqiptare*); *ajo pela nuku pill* (*-pillte*) (Pedersen, po aty).

Çdhe *nj-ja* te format e pluralit të foljes *banj*, *banjimë*, *banji-të*, *banjinë*, që ndeshen në *Mesharin* e Buzukut, si dhe trajtat përkatëse impfektive të arbëresheve të Italisë Jugore, të Siqelisë: *bënjëmë*, *bënjëtë*, *bënjënë*, që u radhitën pak më parë, do të quhen sekundare, të dala prej veprimit analogjik të formave të singularit ku *-nje-ja* është mbaresë mbisunduese vetore. Me këtë rrugë duan shpjeguar edhe trajtat e reja, ato të sotmet të arbërishtes së Siqelisë *-ku-j-ja* gjendet në të gjitha trajtat e vetë formave më të vjetra impfektive, që posa u shqyrtuan.

Duhet të kthehemi e t'i hetojmë mbaresat vetore të kategorisë foljore të *-n* koniugacioniit, që na paraqiten, të shumtën, edhe te kategoritë e tjera verbale të shqipes.

Mbaresa impfektive e vetës së I Singular është *-ë* (*sot a a e*) si figuron te *Meshari* i Buzukut dhe ndër dialekte të tjera anësore shqiptare. Njëherë duhet të dimë se mbaresat vetore të sistemit verbal të gjuhës shqipe janë përfutur prej, temave foljore dhe mbaresave të periodës indoevropiane, po ashtu zanorja *-o-* tematike e foljeve që dalin me *-nio* në shqipe u zhvillua në *-a*, që e bashkuar me mbaresën vetore *-m* përfundoi me *-om -am*, që duke qenë në pozicionin fundor *m-ja*, para se të zhdukej krejtësisht njëherë u kthye në konsonantin *-n*, e *α-ja* e asaj lidhjeje u reduktua në *-ë*, si e gjejmë te Buzuku dhe ndër të folme shqiptare që zakonisht njihen arkaike: *baniam* > *banjam*, > *banjën* > *banjë*.

Po ta vazhdojmë punën e shqyrtimit të mbaresave vetore impfektive e ta hetojmë vetën e dytë njëjës *-e-në* e *banje*, *bënje* do ta nxirrim nga një *-es*, indoevropiane, ajo pra del prej *-s* dhe *e-së* si zanore tematike. Nuk

do lënë pa përmendur në këtë mes që kjo *-e* ka kaluar edhe në vetën e parë ku kemi përdorimin alternativ të *a-së* dhe *-e-së*: *lanja > lanje > laja: laje: lajsa: lajshe*.

Duke shtjelluar këtë tematikë nga sistemi verbal i gjuhës shqipe po rrahim të shpjegojmë vetën e III njëjës; veta e III singular në paragjuhën indoevropiane na dilte në *-it*, ku *i-ja* njihej zanore tematike kurse, *-t* quhej mbaresë e mirëfilltë vetore.

Baza më e afërt nga e cila do të ketë dalë trajta e sotme vetës së III singular të imperfektit do të paravendohet *e-*: *bhan-i-t* që ndoqi shkallaret e këtij zhvillimi fonetik: *banit > bándit > bandit > band > bann > ban*, që dëshmohet në shkrimet e Buzukut, në *Mesharin* e tij. Në toskërishte kësaj trajte i përgjigjet forma imperfektive *bën – faciebat*. Në dialektet italoshqiptare të Siqelisë ruhet forma *běj*, që nuk mund të ketë dalë prej së vjetrës *ban, bën*, veçse nga një arketip *banj*, që do të jetë përfutur si rezultat i vepërimit analogjik të trajtave imperfektive të singularit *banja, banje: bënja, bënje* në të cilat na del i pranishëm konsonanti *-nj*.

Fundor ja *-te* te foljet e *n* – koniugacionit, e te verbat e tjera që i takon vetës së III të imperfektit, bie fjala *bânte, bënthe, shkonte, mbaronte, lidhte, shkelte, vriste, vritte, dinte, rrinte*, nuk mund të jetë i vjetër, pse vokalet fundore të vjetrat kanë rënë me kohë, dhe ato që gjenden sot në atë pozicion, do të jenë zhvillime të reja. Te *-ja* e përmendur njihet si rrokje mbështetëse përfutur për arsye ritmi, e që del edhe në vetën e I të prezentit në të folmen e çamërishtes dhe të labërishtes; *kamte, vijte*, e te Buzuku edhe *vetme* – për *vemi* me funksion diferencimi të vetës së III Singular të imperfektit nga veta e III e prezentit: *bân: bân*. fundorja *te* te veta e III imperfektive del qysh në shkrimet e Budit e të Bogdanit dhe nuk do lexuar *-të*, siç e pa Mark La Piana.

Sa u përket formave të shumës si si i pamë këtu para *ë-ja* e tyre tematike, që del te dialektet arbëreshe të Italisë Jugore, nuk do marrë primare; pos vokal që aty do të ketë qenë pa farë dyshimi së pari *i-ja* si figuron në shkrimet e Buzukut: *banjimë, banji- të, banjinë*. Konsonanti *-nj* te format e zëna ngoje do të jetë sekundare, pse s'ka farë baze që do ta përligjte përfutimin e një *-nj, -n-ja* e formave të tilla do quajtur primare; *pra banimë, banitë, baninë, banimë, bënitë, bëninë* format që dalin prej bazës para

shqiptare – *e bhani-mos, e bhanite; e – bhanito*. Edhe një gjë duhet ta kemi të qartë në këtë mes; mungesa e rotacizmit në toskërishte nga bën të paravendojmë pranë *n-së* në trup të fjalës bazë një konsonant tjetër; në zhvillimin e një *-t* në afërsi të konsonantit *-n* shohim vështirësi që nuk kapërcehen aq lehtë. Nuk mendojmë që pranë konsonantit të përmendur *-n* të jetë zhvilluar një *d* homorganike, pse kjo dukuri është shfaqje relativisht e re ndër disa fjalë të gjuhës shqipe.

Me mbaresat imperfektive që i pamë këtu para në shkrimet e Buzukut pajtohen edhe ato që na dalin e ruhen sot e gjithë ditën në të folmen arbëreshe të Greqisë, si pasqyrohen në Gramatikën e C. Haeblerit (1965):

Singul. Plur.

jap

hapë	hapnjëmë	jipjë	- jipnjë - jipnjëmë
hape	hapnjëtë	jipje jipnje	jipnjëtë
hap	hapnë	jip	jipnë

lidh

kërkonj

lidhë	lidhnjëmë	kërkonjë	kërkonjëmë
lidhe	lidhnjëtë	kërkonje	kërkonjë të
lith	lidhnë	kërkon	kërkonjë

therr

hinj

therrë (thernjë),	thernjëmë	hinjë	hinjëmë
therrë (therni),	thernjëtë	hinje	hinjë të
therr	therrë	hin	hijnë

shoh

di

ha

shihë - shijnjëmë	dijë - dijëmë	hajë - hajë - hajëmë
shihe - shijnjëtë	dije - dijëtë	haje - haje - hajëtë
shih - shijnë	dij - dijnë	haj - haj - hajnë

flas

vras

flasë	flasëmë	vrasë	vrasëmë
flasë	flasëtë	vrase	vrasëtë
flit	flitnë - flinë	vrit	vritnë - vrinë

Format imperfektive që dalin te dialektet anësore të gjuhës shqipe, sidomos ndër ligjërime të kolonive shqiptare të Greqisë pjesërisht edhe të Italisë Jugore, konsiderohen të vlefshme, pse në to ndahen trajta të fosili-

zuara që na përudhin e na shpieren te një periodë e hershme kur shqipja paraqitej me një trajtë të vjetër morfologjike. Një gjë që duhet patur parasysh përherë, është tendenca e fuqishme që shfaqet vazhdimisht me ndërrimin e pasqyrës fonetike, dhe si pasojë edhe morfologjike në sistemin verbal të gjuhës shqipe. Kjo gjë gjen vërtetimin e saj në paradigmen që u shikua pak më parë. Në dialektet e shqipes shohim rrugën që kanë marrë format e ndryshme foljore si dhe shkallët, që ato kanë kapërcyer në fillzhvillimin e tyre historik.

Në lidhje me atë problematikë del edhe përdorimi i formave alternative dy palëshe, zgjeruar qoftë me një lagje shtesash, qoftë me tema të foljeve të tjera, e që pastaj do të klasifikohen në një varg tjetër foljor: bie fjala në Përmet gjejmë dy forma të vetës së III shumës të imperfektit: që *të vidhnjënë mbretinë dhe kur donjën të vidhin mbrenë*; mandej atje shënojmë: *shihin* përkundër formës së sotme toske: *shihnin*.

Pjesa më e madhe e foljeve më konsonant në singular nuk marrin kurrfarë shtese, me anë të të cilës do t'u zgjerohej tema: *shihë, shihe, shih; lidhë, lidhe, lidh* (lith); *therë, there, ther*, përkundër formave të shumësit që marrin e shtojnë temën e tyre me anë të formanteve përkatëse: *shihnjënë – shihnin, hapnjënë, hapnin, thernjëmë, thernjënë, thernim, thernin*. Formanti i foljeve në shqyrtim është temë e kategorisë verbale me-*n* (-*nio-m*) e në lidhje me format e tyre, që dalin në shumës zakonisht, por që duken edhe në singularin e verbave në vokal: *dijë, dije, dij*, konsonanti -*j* (fundor) i të cilave do të ketë dalë nga -*nj*- ja: *dinjë*, e kështu me radhë te format imperfektive të kategorisë verbale me -*t*, bie fjala: vrasë, vrase, vrit, vritim (i) vritit (e), vritin (ë), dalin me ndryshime të shënueshme ndër ligjërime të shqipes: këtu mpleksen a përzihen temat, përkatësisht vetat vetore të singularit me ato të pluralit, bie fjala: ndërsa në një anë gjejmë: *vrasë, vrase* (singul.) në anën tjetër këtë temë verbale e ndeshim me të madhe edhe në vetat e shumësit: *vrasimë*, etj. Duke ndjekur këtë dukuri ndër dialekte të tjera të gjuhës shqipe shohim që tema e tyre me gjithë mbaresa të shumësit është shpërngulur e është shtrirë edhe në veta të singularit: *vrise, vrisje, vriste, vritnim, vrisnim, vritnit, vrisnit, vritnin, vrisnin*; alternimi i këtyre formave duket edhe në shtimin nëpërmjet formantesh përkatëse të një kategorie tjetër verbale, të vargut të *n*- koniugacionit. Format më të vjetra të kësaj foljeje me gjithë verbat e kësaj kategorie që pajtojnë me bazën në të

cilën shikohet gurra e tyre i gjejmë kësisoji:

1. *e-ver a -t-io-m* = *veratiam* > *vëressan* > *vrassë* > *vrasë*
2. *e-vera-t-ie-s* = *veraties* > *vërasses* > *vrasse* > *vrase*
3. *e-vera -t-i-t* = *vëratit* > *vëreti* > *vërit* > *mit*

1. *e-vera-t-i-mos* = *veratimas* > *vëretima* > *vëretimë* > *vritimë*
2. *e-vera-t-i-te* – *veratite* > *vërtite* > *vëritite* > *vrititë*
3. *e-vera-t4-nto* = *veratinta* > *vëretinna* > *vëritinë* > *vritinë*.

Marco La Piana, Studi *Linguistici Albanesi*, Palermo, 1939, (85).

Para se ta përfundojmë vështrimin mbi këtë pikë të imperfektit, të imperfektit asigmatik, nuk mund të lëmë pa zënë ngoje së paku edhe llojin tjetër të imperfektit që ka marrë të përhapur të madh në dialektet gege; është ai imperfekti sigmatik: *martojsha(e)*, *martojshë*, *martonte*, *martojshim*, *martojshit*, *martojshin*; *kërkojsha*, *kërkojshë*, *kërkonte*, *kërkojshim*, *kërkojshit*, *kërkojshin*.

Është problem shumë interesant përftimi i imperfektit sigmatik në të folmet gege, arsyet që e shkaktuan shfaqjen e tij, në një anë dhe në anë tjetër burimi nga u morën format që më vonë e përfshinë tërë gegërishten.

Në këtë punë shohim dy probleme që duan sqaruar: ku duan kërkuar format sigmatike të këtij lloji imperfekti dhe arsyet e daljes në dritë të formave përkatëse imperfektive. Përsa i takon arsenalit të trajtave sigmatike prej nga u nxorën format e imperfektit sigmatik, duket që shqipes nuk i kanë munguar mënyrë dhe kohë foljore as në kalesën e largët me trajtë sigmatike: njëherë imperfekti sigmatik i foljeve shumë të vjetra të *mi* – koniugacionit, mandej imperfekti admirativ: *paskësha*, *punuekësha*, siç dihet, është pajisur me forma sigmatike; gjithashtu prezenti i foljeve pasive në qoftë se në këtë punë merret në peshim, – të gjitha këto sigurojnë forma me hape sigmatike nën ndikimin e të cilave u përfatuan trajtat e imperfektit sigmatik në pjesën më të madhe të gegërishteve të sotme.

Ku duan kërkuar shkaqet? Na merr mendja se ato duan kërkuar në tendencën e shqipfolësve që format e kohëve të ndryshme foljore t'i kenë të ndryshme a të dallueshme edhe për kah trajtat e tyre tingllore që të mos lënë kurrfarë shteg-dykuptimësie, pse duke qenë të afërta, bie fjala, format e prezentit me ato të imperfektit, do të ishte shumë vështirë t'i largoheshin rrezikut të ngatërrimit të kuptimeve që paraqesin ato. Rrahja e shqipfolësve

t'u rinë larg shfaqjeve kuptimore me anë të sigurimit të formave edhe tingullisht të ndryshme të dy kohëve ka në vete vështrim psikologjik dhe karakter praktik. Në shkrimet e Pjetër Bogdanit format e imperfektit të dëftores na dilnin me këtë trajtë: *na punojim, ju punojit, ata punojin*, ndërsa prezenti i kësaj foljeje paraqitej: *na punojmë, ju punoni, ata punojnë*, e format e dy kohëve i gjejmë tingullisht shumë të afërta, pra ndërgjegjia gjuhësore e shqiptarëve ka kërkuar mënyrë të shëndoshë e të sigurt mosleximi të kuptimit të të dy formave duke u siguruar trajtë të dallueshme tingullore. Në të mirë të këtij mendimi flet edhe fakti se në gegërishten jugore imperfekti në singular del me një palë formash e në shumës me një lagje tjetër (G. Weigand, *Albanesische Grammatik im südgegischen-Dialekt*, Leipzig, 1913); mandej në gegërishten qendrore në Mat, (Sh. Buletin, 1963/2, f. 222-247).

Në rrethin e përdorimit të imperfektit mbetet të ndriçojmë edhe një gjë që nuk ka qenë objekt trajtimi në shkencën albanistike. Është fjala për vetën e III të imperfektit të indikativit, si del në të folmen e shqiptarëve të Kosovës me variantën: *ai punojke, ai bajke, ai u endke ai sillke (ai sillte)*. Arsye që ta përligjin një ndërrim të tillë fonetik nuk ka, pse deri më sot në të folmet e gjuhës shqipe alternime kësisoji fonetike nuk janë dëshmuar, prandaj shkaqet e shfaqjes duan lypur gjetiu. Siç e kemi shtjelluar në një vend tjetër, shfaqim mendimin se trajta e përmendur e imperfektit të dëftores përkatësisht veta e III singular, s'është gjë tjetër veçse veta e III singular e admirativit: *unë bakështa, ti bakëshe, ai bake(j)*. Forma e fundit u mor e u shti në imperfektin e dëftorës mu atëherë kur admirativi ishte në gjuhën shqipe shumë i gjallërishtëm dhe kishte përdorim të shpeshtë.

Kur bëhet fjalë për moshën e të dy formavë itë imperfektit në gjuhën shqipe, atëherë imperfektit sigmatik i do lëshuar epërsia përsa i përket përdorjes së tij në foljet supletive a të verbave të *-mi* koniugacionit: *javi, kam, thom; (isha), (ishe), ish, ishim, ishit, ishin; kisha(e), kisha, kish; thosha; e* në këtë mes do theksuar edhe një gjë tjetër, që këto forma imperfekti na dalin në mbarë gjuhën shqipe, porse vetëm në folje ndihmëse, siç u pa pak më parë. Në anën tjetër, në grupet e tjera të foljeve të toskërishtes nuk ka kurrfarë gjurme që të kenë ekzistuar format e imperfektit sigmatik ndër folje transitive të diatezës veprorë. Mandej këtu do thënë edhe një gjë tjetër lidhur me moshën e të dy varianteve të imperfektit të gjuhës shqipe, që im-

perfekti sigmatik, pasi të përjashtohen foljet supletive që u zunë ngoje, edhe në gegërishte dalin shumë vonë: kah mesi a fundi i shekullit XVIII. Në shkrimet e Bogdanit forma sigmatike nuk ndeshim kund në veprën Kuvendi i Arbënit (1706) nuk hasim në imperfektin e përmendur.

Me sa thamë deri këtu në lidhje me shfaqjen e imperfektit sigmatik, del e qartë se format e tij pandehen, hiq verbat supletive, dukuri e vonë e gegërishtes.

Duke përfunduar trajtimin e imperfektit në gjuhën shqipe, këtë pikë të morfologjisë historike do ta përmbylim duke zënë ngoje format imperfektive të *-mi* koniugacionit: *jam, kam, thom*. Trajtat e kësaj kohe dalin shumë arkaike ndër ligjërime të gjuhës shqipe: *jeshë, jeshë, ish, jeshmë, jeshhtë, ishnë*, që i ndeshim në arbërishten e kolonistëve shqiptarë të Greqisë, ato ruhen mandej edhe në dialektet toske të Çamërisë dhe të Toskërisë Jugore.

Të paraqesim paradigmën e formave imperfektive të *-mi* koniugacionit:

<i>jam</i>	<i>kam</i>
unë jeshë(e) na jeshmë jeshëmë	keshë (e) kesh(ë) më
ti jeshë ju jeshhtë, jeshëtë	keshe kesh(ë) të
ai, ajo, ish ata, ato, ishnë	kish(kej) kishnë(kejnë)

thom

thoshë(e)	thosh(ë) më
thoshe	thosh(ë) të
thosh(te)	thoshnë.

Format e sotme ndryshojnë nga ato të dikurshmet *ishe (isha), ishe, ishte, ishim, ishit, ishin*; që janë përfutur prej formës së vetës III njëjës a shumë: *ish, ishnë* që me kohë u shtri në të gjitha vetat e tjera njëjës e shumë.

Lidhur me format e *mi-* koniugacionit tërheqim vëmendjen mbi faktin që imperfekti i *mi-* koniugacionit, i foljeve *jam, kam, thom* është imperfekt sigmatik, që në krye të herës në të gjitha dialektet e gjuhës shqipe; në këtë mes format e imperfektit sigmatik të foljeve të kësaj kategorie të vogël të verbave, të *mi-* koniugacionit marrin formante foljesh të kate-

gorive të tjera: *ish- nja, ishnje* etj. *ishjem* – që janë formante të *n-* konjugacionit.

Mënyra urdhërore – imperativi

Mund të thuhet se përkufizimi më i drejtë i imperativit të gjuhës shqipe, duke pasur parasysh përjashtimet e duhura, është ai që ngërthen formulimin pasues: veta e II e singularit të imperativit sajohet prej vetës së dytë shumësisë kur i hiqet asaj mbaresa *-ni*, që ajo mban në vete; bie fjala: *lidh* ka dalë prej *lidhni*; *njih* nga *njihni*; nga *digjni* doli *digj*, *piqni* dha *piq*; *avitni* > *avit*, *shit- ni* > *shit*; *pritni* > *prit*; *matni* > *mat*; *milni* > *mil*; *mbillni* > *mbill*; *vilni*, > *vil*; *sillni* > *sill*; *hiqni* > *hiq*; *ripni* > *rip* (e), (*ryep*); *merrni* > *merr*; *mirrni* > *mirr*; *dilni* > *dil*; *dilni* > *del*.

Nga sa u pa prej shembujve të zënë ngoje deri këtu, del e qartë se foljet apofonike në format imperative dalin me alternimin *-e e a ie* (je) në *-i*; këtë dukuri e kanë edhe ato verba që hyjnë në "kategorinë e parë foljore, ato folje, pra, tema e të cilave përfundon më *-t*, fjala vjen: *shes*: *shit*: *shitni*, *pres*: *prit*: *pritni*, *mas*: *mat*: *matni*.

Foljet e kategorisë së tretë, d.m.th. ata verba që mbarojnë më *-n*, ato folje, pra, të *n-* konjugacionit me vokal të gjatë, siç janë *laj*, *mbaj*, *ndaj*, *shkruaj*, *fryj* (*frij*) *gjej*, forma e vetës së dytë të imperativit del gjithashtu me formantin *j*: *baj*, *mbaj*, *ndaj*, *shkruaj*, *fryj*, *gjej*, *ziej*, *duej* *duoj*, *bluej*; porse frikativi në fjalë, *-j* -ja mënjanohet kur forma e vetës së dytë të imperativit, shkon e merr grimca përemërorësh: *mbama*, *gjema*; *ndama*, *bluema*, *ziema*, *shkruema*, *duemë*, *duena*; *mbamna*, *gjemna*, *ndamna*, *bluemna*, *ziemna*, *shkruemna*, etj.

Foljet e kategorisë verbale me – vokal, nuk marrin kurrfarë formanti në vetën e dytë singular të imperativit: *pÿ*; *pinÿ*: *hâ*; *hani*, *fli*, *flini*; vokali i formave të singularit të foljeve në shqyrtim ka kuantitet të shkurtër.

Një palë foljesh të kësaj kategorie që dalin me një *-r* në *te-* më, ruajnë vokalin *-ë* si mbaresë të vjetër: *verë* (tosk.), *ven-* gegërisht; pl. *vini* – *veni*; *nxerë* – *nxen*, *bjerë* – (*bjer*) – edhe *bje* – *bini*, *birni* (*bini*, *bjeni*); *lerë* (*len*), *le(le)*, *lini*, *leni*, *shpjerë*, *shtjerë*.

Veta e III e imperativit ndërtohet nga veta e II e koniunktivit që i

shtohet fjalëve *le- të marrë; le të dalë, le-të shkruaj {shkruaj}*.

E kryera e thjeshtë – aoristi

Peshuar nga aspekti indoevropian, aoristin do ta nxjerrim nga imperfekti indoevropian. Lidhur me këtë problem të indoevropianishtes duan veçuar dy palë formash të aoristit. Për aoristin sigmatik forma të posaçme ruajnë indishtja e vjetër, greqishtja dhe gjuhët sllave te jugut; format e aoristit latinishtja i ka bashkuar me tipin e perfektit, që sot përkah trajta paraqet aoristin asigmatik apo aoristin e thjeshtë (gjerm. Wurzel. Aoristi, it. Aoristo radicale, korenski aorist).

Aoristi i thjeshtë ndërtohet duke iu ngjitur rrënjës mbaresat vetore të aoristit: *lidh-a, lidh-e, lidh-i (lag-u), lidh-më*, (sot me shpifjen ndërmjet rrënjës dhe mbaresës së një ë-je, apo si rezultat i një veprimi metatetik të vokalit të reduktuar): *lidh-ë-m, lidh-ë-t, lidh-ë-n*, njësoj si në indishten e vjetër: nga rrënja *-dha* kemi *a-dha-m; a-dha-s; a-dha-t; a-dha-ma; a-dha-ta, a-dh-ur*. Një palë foljesh në indishten e vjetër, në greqishte e zgjerojnë rrënjën me shtesa të tjera të cilave u ngjiten mbaresat vetore (aoristi tematik).

Foljet e grupit të madh, ato me temë të vjetër në *-n*, pra të *n-* koniugacionit si dhe ato me temë në zanore, do të shpifin midis temës dhe mbaresave të vetës së parë dhe të dytë nga një *-v* antihiatizuese: *shko-v-a, shko-v-e; shkro-va, shkro-ve-e; pre-v-a, pre-v-e; la-v-a, la-ve-e; fry-v-a, fry-v-e; zje-v-a, zje-v-e*. Mendimi i Franc Bobit që u tumir mandej nga Gustav Meyeri që ndikimi i latinishtes ka depërtuar thellë edhe në sistemin gramatikor të shqipes, konkretisht në fleksionin e foljeve, e që lidhur me këtë aoristi i shqipes i tipit: *këndova, punova, mendova*, do ta ketë burimin në imperfektin e latinishtes: *laudabam, amabam, monebam, legebam*, elj. gjet pëlqimin e dijetarëve të mëvonë. „Për shumë arsye kjo gjë është e pamundshme, thotë Pedersen, si në gjuhët latine dhe romane ashtu edhe në gjuhën shqipe kategoria e së pakryerës dhe ajo e së kryerës edhe sot e kësaj dite shquhen prethazi njëra nga tjetra. Është gjithashtu një gjë tepër e azarduar që të kryerën e shqipes ta derivosh nga e pakryera e latinishtes; në përgjithësi kapërcimi i një mbarese kohore nga një gjuhë në përdorjen e gjallë të një tjetre është një fenomen skajshmërisht i habitshëm. Për më

tepër një supozim i këtillë mkatëron lamdër ligjevet fonetike, sepse në shqipe një *b* midis dy zanoresh nuk shndë- rrohet në *v*, por zhduket" – Pedersen, *Kontribut për historinë e gjuhës shqipe*, në Buletin, 1959/3, përkthim; (botuar në *Festschrift Vilhelm Thomsen*, Kopenhagen 1894).

Përsa u përket formave të aoristit të gjuhës shqipe kur përjashtohen ato pak folje që bëjnë pjesë në imperfektin sigmatik, ato lidhen me trajtat e së kryerës së mbarindoevropianishtes, me shndërrimin e *e*-së indoevropiane në *o* në gjuhën shqipe, për shembull: *mbledh*: *mblodha*; *lat. lego, legis, legi*; *sjell*: *solla*; *dredh*: *drodha, vjedh*: *vodha, vodhe, vodhi*; *marr*: *mora, more, mori (muor, muar, muer)*; në këto forma *o*-ja e aoristit pasqyron *e*-në e gjatë indoevropiane, kurse *ie*-ja e prezentit të shqipes reflekton *e*-në e vjetër indoevropiane, p.sh, *mos* = gr. *me*; për *ie*-në a *je*-në e prezentit të gjuhës shqipe, khr. *bie* që shpie te baza e vjetër indoevropiane *bher* = *bie* (të *bjerë, birni*), ndërsa *borë, dëborë* rrjedh prej *bhera*.

Mbaresa e vetës së III – singular *soll-i (lag-u)* ngjan të jetë veta e III e përemrit (*nyja ay-ai*). Trajtat mbaresore të singularit të aoristit *soll-a, soll-e* nuk mund të jenë të vjetra në gjuhën shqipe, as mund të lidhen me kurrfarë mbaresash indoevropiane, ato, përkah burimi mbeten të errëta. Disa i konsiderojmë të ardhura nga zhvillimi i diftongjeve ose i pandehin formime relativisht të reja. Vetën e III njëjës pa mbaresë, Pedersen i qet të ardhur prej vetës së III të mbarindoevropianishtes me temë në *-e*.

Lidhur me daljen e tingullit *-v*, të vetës III njëjës që është i pranishëm te mbaresat e tjera të singularit, mendimet e dijetarëve janë të ndara: rruga e zhvillimit të mbaresës së vetës së III njëjës na del interesante që nuk pajton me të dy mbaresat e para të singularit, në të cilat tingulli *-v* ndër folje të kategorisë së përmendur gjendet përherë pranë. Shfaqjen alternative të mbaresave vetore *-u*: *i* në vetën e III të aoristit (*ai thau; ai fali*) Pedersen i në – *Festschrift* dhe në *Die Gutturale*, e tfillon duke pranuar moshën më të madhe të tingullit a të dëftorit *u*- kundrejt atij *-i*. I një burimi të tillë duhet të jetë, sipas mendimit të tij, edhe mbaresa e vetës së III Singular e aoristit, si dhe te mbaresat e rasave të gjinore-dhanores të emrave të pashquar: *kau, lisi*. Moshë më të madhe në këtë alternancë të mbaresave ka, siç duket, sheshazi, varianti me *-u*, pse sikur të paravendohej një *-i* e vjetër ajo do të palatalizonte konsonantet vetore fundore.

Lagja tjetër e albanistëve në këto raste shohin këtë rrugë zhvillimi se *u*-ja në këto rasa të ketë dalë nga një *-v* (*thava – thave*) që ruhet në të parat mbaresa vetore të singularit të aoristit, bie fjala: *thava, thave; thavi > thau*. Me këtë rrugë shpjegohet edhe prania e mbaresës rasore *-u* te një kategori emërore e gjuhës shqipe: *ka-v-i > ka-u*. Ndërhyrjen e vokalit *u*-te foljet në grykore kjo palë dijetarësh e gjejnë në shtrirjen analogjike të *u-së* njëj përkatësisht mbaresë, – është kjo një shtrirje analogjike që ka mënjeluar shndërrimin e bashkëtingëllores grykore në qiellëzore: *mik + miqi + i një miqi* (S. Riza, *Emrat në shqipe*, 26).

Një palë foljesh në vetën e III singular na dalin me dy forma, siç dëshmojnë këta shembuj: *mort: muar, muer; doli: duel: dual*. Po u shtrua puna e vjetër sise se tyre, ne na duket se format e pajisura me diftong duhet ië jenë më të reja, të dala prej të parave, në të cilat vokali o i theksuar me kohë zuri të diftongohet, siç tregojnë foljet e sjella këtu para.

Në shumës na dalin të njëjtat mbaresa që i hasim te format e prezentit të imperfektit: *-më, -të, -në*.

Siç kemi parë më parë në këtë shtjellim të sistemit foljor të gjuhës shqipe, aoristi ndërthen a ruan një temë të veçantë, që shpeshherë del shumë më konservative se tema e vetë prezentit.

Diftongu i këtyre foljeve, d.m.th. i foljeve që mbarojnë më likuidë: *l, ll, r, rr*, na shfaqet gjithashtu në trajtat ë shumësit: *soll- më – sollëm > suallmë > suallëm; solltë > sualltë; sollnë, suallnë > suallë*.

Një lagje foljesh apofonike, konkretisht ata verba të gjuhës shqipe tema e të cilave del në konsonante velare, *k, g*, përveç apofonisë që është cilësi e njohur e tyre, ato do të pësojnë tërime fonetike në kuptim të palatalizimit të velareve të përmendura, që kthehen në *-q* përkatësisht në *gj*: *djeg: dogja; pjek, poqa*; lidhur me këtë palatalizim velaresh, është përlyer mendimi i disave që thonë se burimi i kësaj dukurie do kërkuar te veta e III njëjës: *dogji* nga e cila u shtri mandej edhe në veta të tjera të singularit: *dogja, dogje*. Shfaqja e përmendur nuk i ka përfshirë ato folje, siç janë: *ai lagu; -iku*, çka tregon se pikënisja e palatalizimit do të ketë qenë veta e III njëjës.

Në këtë mes është për të vënë në pah edhe një palë foljesh të tjera të kategorisë me *-t* veta e parë e prezentit del në *-s*), *shes, pres*, që në aorist da-

lin me ndërrime metafonike, do të thotë se vokalin e trupit të temës e metafonizojnë në *i* në krye të herës në vetën e III: *shiti* e cila me kohë u shtri edhe në veta të tjera të singularit e të pluralit: *shiti, priti:shita, prita*, etj.

Në shqyrtimin e sistemit verbal kemi zënë ngoje një shfaqje të foljeve të gjuhës shqipe që verbat e shqipes, përveç tjerash kanë dy tema të rëndësishme, temën e prezentit dhe atë të aoristit.

Po t'i sillemi kësaj pike, pikës së aoristit, duhet të pranojmë se format e kësaj kohe nisen nga tema e prezentit, prej trajtës së thjeshtë pa farë zgjerimesh të temës së prezentit zakonisht: kë-llas, kalla; pllas: palla; flas: fola, mandej ngas: ngava. Një varg foljesh sot me prezentin në -t (s), dihet që së lashti nuk bënin pjesë, nuk hynin në kategorinë e verbave në -t, porse ato grupoheshin në foljet me vokal; vetë fakti që këto folje aoristin e ndërtojnë me mbaresën -v-a, flet kundër përqasjes qysh në kohë të lashta të kësaj pakice foljesh në klasën e verbave me t.

Një varg i vogël foljesh të kësaj kategorie, të foljeve në -t format e aoristit i ndërtojnë nga tema e thjeshtë; prodhohen edhe prej një teme të zgjeruar të prezentit, fjala vjen: bërtas: bërtita, e brita; thërras: thirra; thërrita; kërcas: krisa, kërcita; këtu kemi përfutimin e vokaleve a/e në i si rezultat i veprimit tëasimilimit dhe të përgjithësimit analogjik. Në lidhje me asimilimin e grupit -lnë, -llnë; -rnë, në -lë, llë, -rë, -rrë: folnë > folë; duelnë > duelë; duolë; suollnë > suollë; thirrnë > thirë: thirrë, duket fare mirë se format e sjella janë trajtë aoristi të vetës se III shumës. Kur bëhet fjalë për moshën a kronologjinë e kesaj dukurie, del e qartë se ajo shfaqet qysh te shkrimet e Buzukut, – pra që në shekullin e XVI, porsa format e asimiluara do të kenë qenë në përdorim qysh më heret, para shekullit XVI.

Në këtë mes duhet të vërehet një gjë, që asimilimi i grupeve të zënë ngoje konsonantike kufizohet vetëm me një lidhje të caktuar konsonantesh: lnë, llnë; rnë, rlnë, lë, -llë; -rë, -rrë; fenomeni fonetik në fjalë në shkrimet e Buzukut gjendet i rrudhur në folje që mbarojnë me temë në – likuide: l, r, ll, rr; kurse në lidhje të tjera konsonantike një asimilim të tillë nuk e ndeshim kund. Shfaqja e përmendur fonetike këtu e dy shekuj përpara me rrugë analogjike zuri të përhapet edhe ndër lidhje të tjera konsonantike; sidomos ndër të folme toske; bie fjala dhnë > dhë: lidhnë > lidhë; vodhnë > vodhë; ata erdhnë > erdhë, forma që në Mesharin e Buzukut nuk bien

ndesh kund. Këto forma i gjejmë të dala vonë, siç u tha këtu sipër, si rezultat i zhvillimit të analogjisë.

Me forma të veçanta aoristi dalin edhe ato folje me temë në zanore, porse në vokal fundor në dialektet gege, kurse në të folmet toske vokalet e tilla fundore janë reduktuar a rruddhur: ë, për shembull format e prezentit zâ: zë (zan) vë, vë (ven); në aorist shfaqen siç pasojnë; zuna, zura, vuna, vura; mandej folje të tjera të kësaj kategorie njihen edhe pasueset: shpie: shpuna: shpura; shtie: shtura, porse edhe shtiva, shtina; shtira; bie: pruna: prura; lidhur me format e aoristit të këtyre foljeve do vënë në spikamë një gjë, që në to ndeshim formime të reja aoristi për vetën e III singular; ai zuri-zuni, ai zu; ai pruni-pruri pru, format e shkurta dalin pa farë mbaresash.

Këtë thjeshtim konsonantesh e gjejmë edhe në shumësin e aoristit të foljeve në shqyrtim: vun-më > vumë; shpur-më > shpumë; zun-më > zumë; lan-më > lamë; lan-në > lanë. Asimilimi në fjalë del si efekt a rezultat i ndeshjes së një lidhjeje konsonantike ku elementin e dytë e përbëjnë mbaresat vetare të shumësit-n + më, -r-më; n + të; n + në; r + të; r-në = këtë rrugë do ta ndjekë edhe folja banj, baj, bëj, që njihet njëra ndër verbat më tipike të -n koniugacionit: bamë>ban-më; batë, ban-të; banë (bënë) >ban + në.

Me një temë të foljeve në -t (veta e I e prezentit del në -s) në aorist shfaqen edhe disa folje edhe pse nuk hyjnë në kategorinë e foljeve në -t; bie fjala verbi, prezenti i të cilit në krye te herës na dilte në vokal: flë, flë me të marrë mbaresën a prapashtesë – mbaresën -të të verbave përkatës, ka zënë vend në kategorinë e foljeve me -t; fjejta, fjeta, ndejta, fry-v-a, fry-n-a por edhe fryj-t-a; mandej ngrit nga ngre; gjithashtu mba-jta, gjej, gje-t-a, di > dita, bar > barta.

Lidhur me aoristin sigmatik do vënë në dukje që format e kësaj kohe janë kufizuar shumë, saqë ato ruhen vetëm në vetën e parë njëjës të një numri të paktë foljesh, të foljeve kryesisht supletive: jam, qeshë; thom-thashë, kam-paçë (nga patshë); bie-rashë; shoh-pashë; jap-dhashë, lâ-lashë.

Në këtë mes do vënë re që trajtat e përmendura sigmatike nuk ruhen në të gjitha dialektet e në mbarë shkrimet e autoreve të vjetër: Buzuku shkruan: qi u juve u dhae, 283; u ty të pae, 309. Të paraqesim paradigmen e këtyre formave të gjymta asigmatike të aoristit, që i hasim në shkrimet e

Buzukut e që në

unë – dhae unë – pae unë – lae
 ti – dhae ti – pae ti – lae
 ai – dha ai – pa ai – la

gjuhën e shkrimit të shqipes sonë, në dialektet e saj, në veten e parë njëjës dalin me forma sigmatike.

Disa folje që në gjuhën shqipe ruajnë forma sigmatike, në arbërishten e Italisë jugore dalin me trajta aoristi asigmatik qysh dëshmohen ato në këngën e përmallshme të arbëreshëve;

O e bukura More

Çë kur të lje

Më nëng të pe.

Format foljore Ije (lë) e pe na paraqiten të kontraktuara, pra gjendja e tyre e hershme dilte: *unë; lae, unë pae*.

Është shumë interesante të vërehet se format sigmatike ndeshen kyesisht te foljet supletive, për më tepër ato bashkë me trajtat e prezentit: jam – qeshë, shoh – pashë e të tjera, që historikisht, ngjan të kenë qenë sinonime që, pasi kishin humbur disa forma gramatikore morën e u plotësuan prej rrënjës se palës tjetër.

Edhe aoristi sigmatik është gjurmë e vjetër e sistemit fleksiv të gjuhës shqipe. Meqë format e aoristit sigmatik nuk janë vërtetuar në të gjitha gjuhët indoevropiane, por në një pjesë sosh: indishtja e vjetër, greqishtja, gjuhët sllave të jugut, atëherë ky fakt dëshmon mbi praninë e një izoglose të vjetër të dialekteve indoevropiane, që flet në dobi të individualizimit të gjuhës shqipe në një trevë ku jetonin të parët e sllavëve të Jugut ku zuri të veçohet gjuha e tyre.

Pjesorja – participi

Mendimi i linguistëve që participi i gjuhëve indoevropiane ka ruajtur tipare të shumta që e lidhin me adjektiva prej të cilëve sipas të gjitha gjasëve u përftua në perioda të mëtejshme indo-evropiane, përligjet në çdo hap.

Pothuaj të gjitha gjuhët indoevropiane, ku më tepër ku më pak, ruajnë gjurmë të formave të ndryshme participore qysh janë ndërtuar në gjuhën – amë indoevropiane: pra edhe në këtë pikë, mund të thuhet, ato pasqyrojnë vazhdimësi të vërtetë të paragjuhës indoevropiane.

Duket se të gjitha format participore që dalin në gjuhën shqipe janë të trashëgimisë indoevropiane. Këtu do theksuar se shqipja ka ruajtur vetëm trajta të participit të shkuar, në qoftë se emrat me sufiks *-ës, s: mësues, mësonjës, nxanës (nxënës), hollues, shkues, hupës*, etj. nuk trajtohen si participa të tashëm.

Trajtat e participit dalin zakonisht prej temave të aoristit, bie fjala: *folë, folun*, ndërtohet prej temës së aoristit: *fol-a*; mandej *hap-a > hapun: hapur: hapë; pi-v-a > pi-më: pirë; . nga-v-a > nga-më: ngarë*.

Disa folje të tjera paraqesin shmangie, pse tema e aoristit ndryshon nga ajo e prezentit, në ç'rasa participi do të sajohet prej temës të së tashmes: *dal: part. dalë, aoristi dola; marr > marrë, aor. mora, sjell > sjellë, aor. solla, vjel: vjelë (vola) tjerr > tjerrë (tora), shtjerr > shtjerrë (shtora); rjep > rjepë, rjepun: rjepur (ropa); djeg > djegë, djegun: djegur (dogja); pjek > pjekë: pjekun, pjekur (poqa)*.

Participet e shqipes dalin me formante të ndryshme, sipas temave në të cilat shfaqen foljet e kësaj gjuhe.

Një palë sosh na paraqiten pa formante: *punue, krye, shkrue*; mandej ato në-ë, *vjelë, marrë, dalë, sjellë, mjelë, lidhë*, një lagje sosh dalin me formantet pasuese: *-në, -rë, -r, -un, ur(ë): dhânë, dhënë, thânë, thënë, lânë, lënë, larë, parë, lidhur, lidhur*; një varg sosh përfundojnë me formante: *-m, mun, bam, bamun*: porse tri trajtat kryesore të pjesores janë me *-n*, me *-m (ë)* dhe me *-ë*.

Pjesorja – me – në

Formantin participor – në nuk e gjemë të dalë prej participit indoevropian me + *no*, që do të shprehej në participat e njohur të shqipes; *dhânë – dhënë; thânë – thënë; lânë – lë-në; ngrânë – ngrënë; zânë – zënë*, tosk. *vënë* (geg. *vu*), *shtënë* (geg. *shti*); *shpënë* (geg. *shpumë*) *rënë-*; (geg,

ra). pse po të ishte e vërtetë, atëherë *n*-ja intervokalike në toskërishte do të shndërrohej në *r*. Përkundër mendimit të Meyerit (*Albanesische Grammatik* f. 42-44), sufiksin participor të shënuar këtu sipër e qesimprej participit të hershëm indoevropian me temë në *-nt* (prej indoevrop. *bher-o-nt* nga baza *bher-* me bartë), që me anë të asimi-limit *-nt = nd-* dalim te *-në*-ja e participave të shqipes që u zunë ngoje pak parandej.

Këtu del një vështirësi që nuk mund të kapërcehet aq lehtë, sepse në gjuhë të tjera indoevropiane nuk del kund ndër formaparticipore ndonjë konsonant tjetër pranë formantit *n*, pra nuk dëshmohet kund një *-t* lidhja e së cilës *nt* do të përfundonte te *-në*; prandaj ky problem për ne mbetet i hapur, më mirë të themi ai ngel i pambërthyer sa duhet.

Një formant tjetër me *-në*, që do të dalë prej formantit të hershëm të indoevropian *-no*, në toskërishte shfaqet i kthyer në *-r* e një dukuri të tillë e gjejmë të përligjur me rregullat e fonetikës historike të shqipes, pse një *n* e vjetër ndërzanore e shqipes, në toskërishte do të alternohej në *-r*: *shullâni*, *mullini*: *shullëri* mulliri.

Formanti indoevropian – i participimit – me *-no* në toskërishte do të përfundojë me *-r*, si e gjejmë ndër folje të kategorisë me temë në vokal; *pirë*; *larë*; mandej te foljet e *-n* koniugacionit: *punuar*, *lyer*; ky varg foljesh dalin me participa pa prapashtesa *pa*, *la*, *ra*, *sha*, *lye*, *fye*, (*bërë*). Mirëpo disa mbeturina a relikte participore – adjektive, me vonë substantivuar, dëshmojnë për ekzistencën e formantit participor *tëlyen*: *tlyen*, që del prej prepozitivit *-të* dhe formës participore *lyen*: *të + lyen*; kështu duhet të zhvillohet edhe asnjanesi te *lanat* – (uji me të cilin janë larë enët) që përdoret në Malësi, Kosovë; kurse sot mund të thuhet *enët e lame*, por edhe *enët e lane*; këtu hyjnë *kryelanë* e *krelanë* (*kryelan*, *krelan*) si dhe *të panë* (*t'pan*); mandej *rrenë*, dalë prej foljes *rrej*.

Format participore me *-në* gjejmë edhe te Buzuku: *i parilenë*, *i shpërblenë* (*i shpërbljem*), mandej trajta infinitive *me pinë*, *me blenë*, *me panë*. Në ligjërimet shqiptare të Kosovës formanti *-në* del shumë shpesh te adjektivet e substantivuar: *i ngrani*, *i lani*, *i bleni*, *ara e punune*, *letra e shkrune*, *teshat e lane*, *buka e gatune-gatuene*; (S. Riza, Tri monografina albanologjike). Edhe participi *bërë* i toskërishtes nuk mund të lidhet me temën *-nt*, porse do nxjerrë nga participi me sufiks *-no = r*, sajuar pra prej

një *n*-je ndërzanore. Ky particip në gegërishte është reduktuar: *bâ*, *ã*-ja nazale dëshmon mirë praninë e dikurshme të konsonantit nazal *-n*; *banë*; *krh*. sllavishten *radan*, *znan*, që janë formime adjektivash foljorë. Në këtë mes do vënë në pah nje gjë që *n*-ja e vjetër e shqipes që ndodhej ndërmjet dy zanoresh në toskërishte do të kthehej në *-r*, e lidhur me këtë nuk e gjejmë të mundur përfitim e *-r*-së prej *n*-së ntervokalike te participat verbalë *pirë* nga *pinë*; *larë* < *lanë*; *qarë* < *qanë*, pse format e vjetra të gegërishtes *pinë*, *lanë*, *qanë*, në gegërishten e sotme do të përfundonin në *pî*, *lâ*, *qâ*, nuk janë dëshmuar kund në të folmet gege. Nga trajtat e paravenduara *pî*, *lâ*, *qâ* do të mund të ndërtoheshin pa farë vështirësie format participore + *pinë* = *pirë*; *lanë* > *larë*; *qanë* > *qarë* në dobi të të cilave flet *flë* që sipas të gjitha gjasave do qitur prej *f* + *lanë*.

Pjesoret e foljeve me temë në konsonant marrin formantin participor *-un* (unë) *ur* (urë), bie fjala: *lidhun-lidhur*, *goditun-goditur*. *U*-ja e prapashitesës *-un* është shpjeguar si një vokal anaptik, shpifur për të lehtësuar lidhjen e temës me formantin që niste me bashkëtingëllore.

Nje formant tjetër që kishte përhapje të gjerë ishte *-m*, që e gjejmë te shkrimtarët e vjetër: Buzuku, Budi, Bardhi e Bogdani, e që ndeshet te foljet me temë në zanore: *bleem*, *klaam gëzuom*, *shtektuom*, *dëshiruem*, *besuem*. Ne të folmen e Elbasanit këtë formant e gjejmë me përdorim adjektivor, por edhe si thjesht pjesore: kam blem, kam shkuem; formantin në shqyrtim participor me funksion adjektival a nominal e gjejmë në të folmet arbëreshe të Siqelisë e të Kalabrisë: im *Zot i bekuam*; *i mallkuami*; trieza e *shtruame*, të *bëmat*; një qen *i tërbuam*.

Lidhur me formën participore që del në *-më* do vënë në dukje që sufiksin në *-më* e ndeshim si në adjektiva, ashtu dhe në participa të gjuhës shqipe. E kanë participat (edhe infinitivat) e plota të kësaj gjuhe, dhe del qysh heret në shkrime të autorëve të vjetër të Buzukut me shokë; mandej kjo formë sufiksale haset në disa të folme gege, ndërsa e përdor me të madhe ristofofidhi në shkrimet e veta, kryesisht në përkthimet e tij: Buzuku: *tue shtektuomë*, *me amblëtuom*; Bardhi: *urdhënuem*, me *u gazëmuem* (Bardhi, Fjalori). Mirëpo, sufiksi *-më* (*-m*) del dhe te adjektivat verbalë, dhe shfaqet bukur heret, qysh te Matrënga: *i mbësuumi*; sot në gegërishte format *i blem*, *i fshimi(ë)*, *i thyem*, *i martuem*, *i bâm*, (i bâmun), janë formime

të zakonshme, që në toskërishte u përgjigjen: *i blerë, i fshirë, i martuar, i thyer, i bërë*.

Formanti i sufiksit participor me *-ë*, që ndeshet te foljet me temë në konsonant, gjendet në shumicën e të folmeve gege; ai ndeshet me të madhe po në atë pozicion edhe në varianten gege të gjuhës së shkrimit. Po iu sollëm të folmeve toske si dhe variantes toske të gjuhës letrare, do të vërejmë një situatë tjetër; atje një formant *ë* në participa do të të dilte zakonisht ndër ato folje tema e të cilavet përfundon në likuide: *l, ll, r, rr: vjelë, vjellë, marrë, etj*.

Pra, pjesorja e shumicës së të folmeve gege të sotme, foljet e të cilave sosin me temë në likuidë, nuk merr kurrfarë formanti e që nga prezenti veçohet prej vetës së parë singular të së tashmes përkah kuantiteti i vokaleve, përndryshe pajtojnë ndërmjet tyre plotësisht. Me rrugë analogjike, formanti i zënë ngojë participor ka zënë e është shtrirë edhe në të tjera kategori foljesh që mbarojnë me konsonant. Në të folmet e toskërishtes puna e participit del shumë më e ndërlikuar; atje participi shfaqet me tri fomante: *-ë, ur*, dhe *-tur*. Në një varg ligjërimesh toske, foljet e të cilave sosin me likuide: *l, ll, r, rr*, ne particip marrin kurrfarë formanti, pra sosin me *-ë*: *vjelë, marrë, dalë, nxjerrë*, etj. në një palë tjetër foljesh me temë – në likuide por që nuk e ndryshojnë temën në aorist marrin formantin *-ur*; bie fjala: *çelur, falur, ndalur, ngelur, ngulur, përkdhelur, shkelur, kallur, mbyllur, tallur, therur, thurur, korrur, errur*; një lagje e foljeve të përmendura më parë si formant participor marrin *-tur, ngjallur, thertur, mbyllur, përdorur*.

Formanti i pjesores me *-ë* është shpjeguar prej shumë dije tarësh në disa mënyra: një palë sish e qesin të dalë nga asimilimi i grupit *-lnë, llnë, -rnë, rmë*, që me kohë shkoi e u rruddh në *-lë, llë, -rë, -rrë*, bie fjala te foljet: *-vjelne > vjelë; vjellne > vjellë; marrne > marrë*, rruddhja e togut në fjalë konsonantike shfaqet ndër ato folje që mbarojnë me temë në – likuide; këtij mendimi i qëndronte, siç dihet, albanologu i shquar austriak G.Meyer ; prania e kësaj dukurie edhe te folje të tjera, tema e të cilave nuk sos me likuide, nuk mund të ketë moshë të madhe, kurse ajo shfaqje duket të jetë prodhim i shkrirjes analogjike ndër kategori foljesh të tjera.

N. Jokli (*Beiträge zur albanesischen Gramatik – der Akkusativ –*

Nomimtiv und der gesochlechtswechsel im Albanesischen, JF, 36), formantin -ë nuk e shihte si rezultat të rrudhjes së togut të zënë ngojë bashkëtingëllor, pse, në bazë të rregullave fonetike në fuqi togu i përmendur do të përfundonte jo në fundorin -l, llë, r, rrë, porse në formantin sufiksial: -në për shembull nga *vjelnë* do të dilte: *vjenë; nxjerrnë > nxjenë*; mbi dëshminë e disa shembujve ndër të folme arkaike të shqipes mund të rezultonte një përfitim i tillë i togjeve në shqyrtim.

Linguisti shqiptar, Gjergj Pekmezi, në gjuhën shqipe sheh dy trajta participore: një me formë të plotë, dhe një tjetër me trajtë të shkurtuar, që e bie të ardhur nga një formë sot të humbur të infinitivit, të cilin mendim e kundërshton dietari austriak N. Jokli. Sipas gjykimit të Joklit, pjesoret me fundorët -urë dhe ë në gjuhën shqipe dalin krejt në pajtim me rregullat fonetike të kësaj gjuhe, nga kallëzorja dhe emërorja e mbiemrit foljor indoevropian me -onos.

Ky mendim i Joklit nuk tumiret prej linguistit arbëresh Mark La Pianës, që në pjesoren me -ë, shikon një formë të ditëve të vona, që nuk e njohin klasikët e shkrimeve të para të shqipes Buzuku, Budi, Bogdani.

Mbi dëshminë e shkrimevet të Buzukut dhe të të dhënave të ligjëri-meve arkaike të shqipes format participore të foljeve me – konsonante dalin qysh në krye të herës me formante -unë, urë; *hjekunë, ndjekunë*; ndërsa participat e foljeve me likuide dalin pa farë formanti, pra ato sosin – me-ë qysh prej shekullit të XVI e ndoshta para kësaj në periodën e shfaqjes së dokumenteve të para të gjuhës shqipe, si dëshmohen nga shkrimet e Buzukut e të dokumenteve të dala disa qindvjetsha para tij; bie fjala: *dalë, folë, mbërshelë, nçelë, nçalë, me shkalë, me shkelë, shkulë, gjellë, mbjellë, me u ngjallë, me përcjellë, pështjellë, sjellë, bjerë, korë-korrë, marrë*. Në këtë mes do theksuar një gjë, se foljet në likuide qe temën e aoristit e ndryshojnë nga ajo e prezentit, në pjesore nuk marrin pa kurrfarë përjashtimi formant, pra ato dalin me -ë, ndërsa ato folje që në sajimin e prezentit dhe të aoristit nisen nga një temë e vetme, paraqiten me nga dy trajta alternative qysh vërtetohen te Buzuku: *ngjallunë; ngjallë*.

Përkitazi me daljen e kësaj pale të foljeve me formantin -zero, domethënë me fundorin -ë në format participore, nuk do lënë pa shpjeguar edhe një gjë, që kjo është rezultat i asimilimit të konsonantit nazal në bash-

këvajtje me likuidet që ndeshen në kategorinë e përmendur verbale, e që ajo merret dukuri me moshë të madhe fonetike; e shohim të arsyeshme ta quajmë të lashtë e ta vëmë për kah ana kronologjike në atë periodë kur zë të shfaqet asimilimi i lidhjes *-In, -lln, -rn* në shqipe: *dal < daln; nxjern > nxjerr; furna > furrë*.

Ruajtjen besnike të gjendjes së vjetër pa formant të participit të foljeve në likuide, që dalin pa farë alternativimesh të temës së aoristit, ia detyrojmë faktit që format participore të asaj pale foljesh dilnin morfologjikisht të dallueshme me format e vetës së tretë shumës të aoristit që paraqiten formash të asimiluara. Buzuku: *ata suollë* e kryera e thjeshtë; *sjellë* – pjesorja.

Format alternative me formant respektivisht dhe pa të të participave të foljeve që zotërojnë temë të vetme të participit dhe të aoristit, duan shpjeguar si prodhim i tendencës së veprimit analogjik të formanteve që i ndeshim te foljet me konsonante të tjera, si nevojë e domosdoshme e dallimit të temës participore prej asaj të aoristit, respektivisht si nevojë e veçimit të vetës së III shumës – nga forma participore: *falë: falë (ata falë, ata ngulë, ata mbyllë)*; *falë, ngulë, mbyllë* janë forma participore.

Në pjesën më të madhe të gegërishteve formanti zero zë të shtrihet në participat e kategorisë foljore në konsonant: *djeg: djegë; pjek; pjekë; vjedh: vjedhë*, etj. me anë të veprimit të analogjisë, me particip të shkurtër dalin edhe ato folje që përfundojnë me vokal: *pa, (nda)*; me formant të shkurtër participor shfaqen edhe disa folje të *-n* – koniugacionit; *shaj, sha, ndaj-nda; shkue, shkrue; pague*. Një lagje foljesh të kategorive të ndryshme verbale e ruajnë formantin e zgjeruar participor dhe sot e gjithë ditën ndër disa ligjërime geqe që njihen të folme në stadin arkaik verbal në gjuhën shqipe.

Një sufiks tjetër, që u ngjitet adjektivave e që shikohet particip i vjetër i shqipes, i cilëson ata më mirë si të tillë, i përforcon në përdorjen e tyre sot si mbiemra, – shfaqet me formën *-t*, Përveç gjuhësh të tjera prapashtesa mbiemërore *-i* ndeshet me shumicë në sllavishten, si sufiks infinitivi a participi *da-ti, da-t* (edhe *dan*), lat. *dic-t-us* – particip perfekt.

Përdorimi i prapashtesës në fjalë në gjuhën shqipe është kufizuar në adjektiva, e porse do vënë në dukje që sufiksi në studim del sporadikisht particip dhe infinitiv në shkrimet e Buzukut: *kam vutë, kam pitë*. Adjektiv

verbal a particip, pajisur me sufiksin *-i* do gjykuar edhe forma e toponimit *Vûthaj*, dalë nga *vutth + aj*, që me asimilimin përfundoi në *Vûthaj* (Çabej, *Lingua Posnaniensis XIII*).

Paskajorja – Infinitivi

Infinitivi me forma qysh shfaqen në gjuhët indoevropiane gjuha - amë indoevropiane nuk ka pasur, porse do ditur që në mbarindoevropianishten janë konstruktuar shumë forma substantivash verbale që si ngurime rasash janë përdorur në shumë gjuhë indoevropiane në trajta dhe me funksione infinitivash të sotëm.

Mund të thuhet me siguri se nga forma e abstraktit me temë në *-ti* doli më vonë, në kohën historike, forma e infinitivit të gjuhëve baltike dhe sllave. lit. *duoti*, sllav. *dati* (jap), që në paragjuhën indoevropiane, me gjithë gjasë, ishte me vështirësi lokativi; edhe forma e dativit të abstraktit indoevropian *-ti*, do të ketë dhënë infinitivin e indishtes së vjetër te tipit *pitaye* (ie. *pitei-ei*), Infinitivi i kësaj gjuhe me formë fundore *-tum*, në të vërtetë do shpenjë gjithashtu te trajta e akuzativit të abstraktit të vjetër indoevropiane në *-tu*, krh. lat. *ex – ixtu-s*,

Si qëndron forma e infitivit në gjuhën shqipe? – Për historikun e tij, mjerisht, nuk dimë gjë. Nuk jemi të sigurt a e ka pasur shqipja infinitivin me forma të ngjashme si del në gjuhë të tjera indoevropiane në trajtë sintetike.

Format e tij si shfaqen sot në ketë gjuhë janë analitike të sajuara rishitas me anë të pjesëzave parafjalore *më, për* dhe të participit: *me punue, me mësue*, që në shkrimet e autorëve të vjetër dhe në disa te folme dalin fytyrë-plota: me *shtekëtuon* (Buzuku), me *bâmun*, me *dalun* etj. (vise-vise edhe në kosovarishte).

Kjo formë infinitivi përdoret kryesisht në ligjërimet gege (gegërishtja jugore dhe të folmet e shqiptarëve të Maqedonisë në vend të tij shtien në përdorje koniunktivin). Në pjesën toske të gjuhës shqipe infinitivi është zëvendësuar me koniunktivin, që vise-vise paralelisht me këtë haset infinitivi: *a do me dalë ne kopësht? A di me këndue, lexue? A do të dalim në kopësht? A di të këndosh, të lexosh? Më jip me hangër (a ngranë) diçka; më jip të ha diçka.*

Në gegërishte, pra, përdoren të dy format; në toskërishte del kryesisht forma e koniunktivit, trajta e infinitivit është sporadike, shumë e rrallë: domethënë: *do+me + thenë*; *tuk me mbaruar darsmën*, ra të flerë dhëndëri me nusen; *tuk me thënë këto* iku dhe vajti më punë te tij (Dozon *Manuel de la langue chkip on albanaise*, 1879, f. 72, 73); s'është turp, me qenë dituritë, njeriu të jetë i paditur (Naimi, „E këndimit çunave II”).

Shtjellim i këtij problemi përben një unazë në hallken e atyre pikave që shtrohen gjithherë së toku me ballkanizma të tjera në fushën gjuhësore.

E tillë është gjendja në gjuhë të tjera ballkanike; rumanishtja s'ka më infinitiv ashtu si paraqitet te motrat e saj të Gadishullit Apenin, në trevën e romanitetit perëndimor. Të themi të drejtën në këtë gjuhë ka gjurmë të supinit latin: *ban de mâncat, uçor defâcut*, mirëpo zëvendësimi i tij me pjesëzën sa edhe me koniunktivin: *stin sa cânt; pot sa cânt, da-mi sa beau*; një përmbysje të tillë sintaksore e ndeshim dhe në gjuhë të tjera të popujve të Ballkanit, bullg. *dajmi da pija*, greq. *dhos mon na pio*, shq. *am të pi*, maqedonisht: *dojde da vidi neçe da jade*; në te folmen e popullsisë serbe në treva lindore të Republikës së Serbisë gjejmë: *moram da dodjem* (letërishtja: *moram doçi*, dhe *moram da dodjem*).

Tashti erdhëm te ana më e ndërlikuar e problemit, te origjina e çështjes, te burimi i saj dhe shkaqet e përmbysjes së formes me anë të së cilës paraqitej dikur në gjuhët ballkanike një veprim, një gjendje që në të ardhmen do të realizohej.

Në lidhje me shkaqet që kushtëzuan zëvendësimin e infinitivit me tipin e koniunktivit që erdh e u përhap në të gjitha gjuhët ballkanike qysh u tha pak më parë, do theksuar një zëvendësim i infinitivit me një fjalë të varur qëllimore që do të ruante domethënien qëllimore të infinitivit, që, në të vërtetë, shfaq një send të përgjithshëm, ku nuk shprehet qëndrimi i folësit a vepruesit lidhur me veprimin a gjendjen që përmban folja. Duket që mu këtu duan kërkuar shkaqet e përmbysjes sintaksore të kësaj forme të infinitivit dhe zëvendësimi i tij me koniunktivin në gjuhët ballkanike. Ky mendim që e shfaqti H. Barić (*La perte de l'in-finitif dans les langues balkaniques* – Godišnjak, XI, Sarajevo, 1961), është shumë afër meç për t'u pranuar. Mendime të përparme, që burimin e këtyre inovacioneve rrahin t'ia mvëshin gjuhës shqipe (Miklosich e Meyer – Lübke (në fillim), si dhe

ato që pikënisjen e këtyre zhvillimeve sintaksore e lypin në gegërishte, nuk janë aq bindëse, siç nuk ka farë ure për të qëndruar shpjegimi i dijetarëve bullgarë që gurrën e të gjitha atyre pikave që përbëjnë problematikën e ballkanizmave përpiqen ta qesin prej bullgarishtes së vjetër.

Po deshëm të nxjerrim një bilanc përmbledhës nga ç'u tha deri këtu lidhur me zhvillimin e infinitivit dhe të problemeve rreth tij, do të themi, se infinitivi i shqipes, qysh na del në dokumentet e para e deri në ditët tona nuk mund të jetë vazhdim i infinitivit indoevropian, njëherë pse formë të caktuar infinitivi mbarindoevropianishtja nuk ka pasur, mandej format e tij, qysh i gjejmë ndër gjuhë indoevropiane në perioda të mëvona historike nuk piqen me trajtat e infinitivit të shqipes.

Infinitivi i shqipes shfaqet me trajtë analitike tingullore, që do të thotë së është zhvillim i brendshëm, i vonë, i kësaj gjuhe. Edhe sikur të pranohet mendimi i Joklit (*Litteris, IV, 207*) e tash rishtas, i Xhuvanit (*Lingua Posnantensis, XIII -L'infinitiv en albanais*), që infinitivin e shqipes rreken ta qesin shumë të vjetër nga participat që në këtë gjuhë dalin formash të ndryshme, edhe atëherë kjo formë infinitivi do konsideruar zhvillim i ri, që më vonë në të folmet e kësaj gjuhe, ku më shumë e ku më pak, shkoi e u zëvendësua me koniunktivin si u dëshmuua edhe në gjuhë te tjera ballkanike.

Koha e ardhshme – futuri

Futur me forma të mirëfillta gjuha – amë indoevropiane, sipas të gjitha gjasëve, nuk ka pasur. Porse në disa gjuhë indoevropiane, futuri sajohej me anë të sufiksit *-sio*, – *sie*, që i prapangjiteshin mbaresat e prezentit tematik, indishtja: *da-syami* (do të shkoj), litv. *duo-siu*, ind. Bhavi; – *syā – mi* (do të jem), greq. – dorishtja: *do-se-o* tipat e tjerë të futurit grek dilyn me forma: *dō- s-ō*; futuri i latinishtes në të vertetë s'është gjë tjetër veç koniunktiv:

Koni. prez.

1.legam

2.legas

3.legat.

Futur I

1. legam – legemus
2. legas – legetis
3. Leget – legent

Siç shihet, në fazën e tyre të hershme, një pjesë e gjuhëve indoevropiane kishin në përdorim futurin sintetik, ndërsa sot, në shumicën e tyre dërmuese, futuri i tyre është analitik. Analitik është edhe futuri i shqipes si dëshmojnë dokumentet e saj më të vjetra. Shqipja, sikur dihet, ka dy trajta futuri: njëra sajohet me anë të *do + të +* (që do të jetë trajtë e shkurter e dua, mund të jetë edhe veta e III e njëjësit *do (ai do)* dhe të prezentit të koniunktivit.

Paradigma e futurit të shqipes*mësoj*

unë do të mësoj na, ne do të mësojmë
 ti do të mësojsh ju do të mësoni
 ai, ajo do të mësojë ata, ato do të mësojnë

baj, bëj

unë do të báj, bëj na, ne do të bájme (bëjmë)
 ti do të bájsh, bësh ju do të báni (bëni)
 ai, ajo do të bájë, bëjë ata, ato do të bájne (bëjnë)

za, zë

unë do të zâ (zë) na, ne do të zâmë (zëmë)
 ti do të zâsh, (zësh) ju do të zini
 ai, ajo do të zâjë (zëjë) zërë ata, ato do të zânë (zënë)

Në anë tjetër në gegërishte mbizotëron një ndërtim tjetër futuri, me *kam* (prezent i foljes ndihmëse *kam*, të cilit i prapashtohet infinitivi i verbit që zgjedhohet: *me pasë*, pra: *kam + me pasë, kam me pasë; kam me dalë; kam më mësue*, etj. Në gjuhën shqipe, siç u theksua këtu sipër, kemi dy trajta futuri: njëri i tipit *do të punoj* që ndeshet kryesisht në toskërishte, porse ai përdoret edhe në gegërishte, edhe tjetra formë e futurit del me *kam + infinitiv*, që e gjejmë në gegërishte kryesisht veriore (në të folmet e shqiptarëve të Jugosllavisë). Do vënë re që në gegërishten jugore, në të

folmet e shqiptarëve të Maqedonisë thuajse nuk përdoret fare ky lloj futuri.

Ndërtimi i dy llojeve të futurit në gjuhën shqipe përbën një ndër pikat e atyre çështjeve që gjuhët ballkanike i afrojnë midis tyre me lidhje të ngushta gjuhësore, mandej janë vënë re tipare të përbashkëta edhe në fusha të tjera të historisë, të entologjisë, etj. të popujve të Ballkanit.

Vetë fakti që në gjuhën shqipe paraqiten dy tipa futuri shtrohet me të madhe trajtimi i këtij problemi, që gjithë herë është studiuar në kuadrin e gjurmimeve ballkanologjike.

Problemi është dukuri morfologjike thuj e të gjitha gjuhëve ballkanike: e greqishtes se re, e bullgarishtes, e maqedonishtes, e serbokroatishtes, e rumanishtes dhe e shqipes, veçse këto gjuhë, me përjashtim të shqipes, kanë një formë futuri, atë me *do të* dhe me prezentin e koniunktivit. Dihet se ky lloj futuri në greqishten njihet heret, në kohën e koinesë (greqishtja e vjetër e përbashkët), prandaj mendimi i atyre dijetarëve (Sandfeldi, Pedersen) që anojnë nga greqishtja, – dokumentuar shumë heret, kur është puna te caktohet burimi i kësaj shfaqjeje morfologjike, – nuk mund të mos merret në peshim, aq më tepër kur dihet që tiparet në shqyrtim me shumë të tjera, janë vërtetuar në pjesën jugore të Gadishullit Ballkanik, trevë e sferës gjuhësore të greqishtes. Por ka edhe gjykime të tjera: linguisti gjerman, Gustav Weigand e kundërshtoi tezën e shkencëtarëve danezë – dhe shtroi arsyetime që në këtë punë greqishtja gëzon epërsi vetëm pse si gjuhë u përfill shumë heret, atëherë kur për gjuhët e tjera ballkanike nuk dihej kurrëgjë e që nuk do të thotë se këto femomene dolën për herë të parë në greqishte. Çështja mbetet e hapët, pse, para së gjithash nuk i dihet kronologjia, koha e shfaqjes së saj.

Lidhur me këtë lloj futuri, me futurin *do të*, që del kryesisht në dialektin toskë, e ai tjetri me *kam*, që shfaqet thuaja vetem në gegërishte, – duhet t'i vihet gisht moshës të të dy formave e të veçohet njëra prej tjetrës nga aspekti i kohës: kur shfaqet njëra e kur tjetra. Ky problem jo që nuk është shtruar deri tash vonë, jo, ai ka qenë shumë herë objekt studimesh të dijetarëve, por për mungesë dokumentesh të vjetra gjuhësore ka ngelur i pazgjidhur. Në këtë mes nuk do lënë pa theksuar që përkundër futurit të vërtetë, *futurit volitiv*, në shqipe, më saktë në gegërishte, futuri me *kam* (në arbërishte thuhet: *ka të shkonj*, *ka të vete*) mbizotëron e quhet *futurum*

necessitatis, një të ardhme detyrimi, e sipas mendimit tonë ky tip futuri në kosovarishte ka vështrim domosdoje. Ndërsa kur është nevoja të shprehet një veprim ose gjendje që pritet të kryhet, atëherë do të përdoret futuri *volitiv*: *do të*, diferencimin e tyre e dallojmë kur themi: *kam me gatue*, por *s'do të gatuej*, që do të thotë: kam nevojë për bukë, skam bukë, prandaj duhet të gatuej, porse s'do të gatuej (ky i fundit është e ardhme e mirëfilltë). Nuk është i rrallë edhe një tip tjetër „futuri” që shprehet me formën: *a do me gatue, nesër? -a doni me kosit (ë) nesër?*, që, përveç kuptimesh të tjera, ka edhe nuanca veprimi që do të kryhet në të ardhmen.

– *Mënyra e habitores (admirativi)*

– *Mënyra dëshirore – optativi*

Mënyra habitore del në gjuhën shqipe zakonisht me katër kohë: prezentin, imperfektin, perfektin dhe pluskuamperfektin; prezenti i saj sot duket i një forme të parme; mirëpo, të gjitha trajtat e saj, edhe ato të kohës së tashme zërthehen në elemente përbërëse: ato veçohen në formën e tyre të participit që vjen në ballë, pastaj del elementi i dytë i ndihmëtares *kam* e *jam* respektivisht format imperfektivale *këshe*: *paskam (pasë + kam)*; *paske, paska, paskemi, paski a paskeni, paskan*; *paskëshe, paskëshe, paskëssha, paskej, etj. paskam punue; paska pasë dalë*:

Siç shihet nga format e tij – prezenti i admirativit: *pasëka > paska; qenë-ka > qenka; pi-kam > pikam; la + kam > lakam; lakëssha > lakej; vjelkam > vilkam; rjepkam; rjepkëssha; nxjerrkam* – nis me pjesoren e shkurtër qoftë në gegërishte, qoftë në toskërishte: *pa-kam; pasë + kam; – ë-ja* fundore e të cilave duke qenë në pozicionin fundor dhe e patheksuar, është asimiluar në *pas + kam; qenkam; etj. pjesorja e admirativit në ligjërimet toske vise-vise del e plotë: djegërkam, hypërkam* me rrëgjimin e vokalit fundor *-u: djegur, hypur* në *-ë*.

Kategoria e foljeve apofonike si dhe ata verba që në temë kanë vokalin *e* në vetën e dytë të pluralit vokalin *e* e kthejnë në *i: nxjerrkam > nxirrki; vjelkam > vilki; rjepkam ripki*.

Foljet e *-n* – koniugacionit, ajo klasë e tyre që në temë kanë diftong, këtë dyzanorësh *-ue-në* sporadikisht e monoftongojnë, e kthejnë në *-o*; bie fjala: *shkuekam, shkuakam, shkuokam, punuakam, punuekam, punokam*. Nga format alternative që posa u zunë ngoje, parapëlqehet ajo që mban diftongun.

Shikuar nga ana morfologjike, prezenti i admirativit s'është tjetër veçse perfekti i indikativit *shkue* + *kam*: *kam* + *shkue*; te imperfekti: *shkue* + *kështa*: *kisha* + *shkue*. Inversionin e këtillë e ndeshim shumë shpesh në gjuhën shqipe kur shqipfolësi do të shprehë një veprim emfatik, kur ai dëshiron të paraqesë një gjendje afektive: *Sha zotin me pa pa valët e Drinit, habit met e kres t'u kishin!* Versioni i elementeve të perfektit është mjaft i shpeshtë me kusht që të ngërthejë në vete një veprim afektiv – edhe sot e gjithë ditën: *Në kambë e në duer lidhë e ka*; kjo dukuri ka moshë të madhe, ajo del qysh në kohë të Buzukut: Teofilë, qysh moti *folë kam* ën gjithë anso kafshësh (253).

Kur merret parashysh përmbysja e elementeve në fjalë të perfektit në këtë gjuhë, për të shfaqur një veprim me intensitet të theksuar, apo një gjendje të tillë afektive, – dikur e jashtëzakonshme, – sot shumica e dijetarëve – albanologë anojnë nga mendimi që ajo renditje e dikurshme e elementeve në fjalë me kohë zuri e u bë e zakonshme e normale dhe kështu u sajua në këtë gjuhë një mënyrë e re në sistemin verbal që u quajt mënyrë habitore a admirative. Daljen e admirativit nga përmbysja, që posa u zu ngoje e elementeve të perfektit e provojnë edhe rrethanat e veçanta të përdorimit të tij në gjuhën shqipe: situata të papritura që shfaqen në një veprim, mandej shprehja e habitë, çudisë nga ana e folësit, sepse paraqet një veprim që nuk pritej, admirativi do të përdoret në gjuhën shqipe edhe atëherë kur shqipfolësi do t'u japë intensitet fjalëve të tij:

Të lumt na për t'madhin zot,
 Që s'jem kânë e zoti na ka falë!
 Dritë ka dalë e dielli ka bâ.
 Çka ka ba Gjeto Bashe Muji?
 Se n'krajli Muji paska dalë,
 Edhe' i nuse e paska zanë,
 Zanë e paska t'bin e krajlit.

Perfekti i maqedonishtes dhe i bullgarishtes merr vise-vise funksion admirativi, që prof. Koneski (*Istorija na makedonskiot jazik*, 1965, 148-154) e bie të forcuar nga ndikimi i turqishtes në maqedonishte: *taj bil dobar čovek turq. ey adam imiş*. Përdorimi i perfektit me veshtrim admirativi daljen e admirativit të shqipes prej perfektit, edhe në këto gjuhë e bën shumë afër menç.

Kur dihet për origjinën e daljen e admirativit të shqipes dhe kur kemi parasysh funksionin e admirativit, që perfekti i bullgarishtes dhe i maqedonishtes merr sporadikisht, atëbotë mendimi i N. Joklit, që admirativin e shqipes e bie të dalë prej futuri kundërshtohet nga fakte të gjithmbarshme. As mbështetja e tij në fjalinë e nxjerrur: *gati dreka kâka = skoro će podne*, nuk e forcon tezën e tij, pse *kâka - kânka: qenka*, është prezent i admirativit dhe ka vështirësi të një veprimi të tashëm që ngërthen në vete një dozë habie, pse folësi nuk priste që drekën ta gjente *gati*. (N. Jokl, *Litteris*, 4, 1927 faqe 207).

Për vjetërsinë e kësaj kategorie të sistemit foljor mund të themi se ajo ka moshë relativisht të madhe, pse e ndeshim në veprën më të vjetër të letërsisë shqipe, në Mesharin e Buzukut (1555); mandej ajo gjendet në ligjërimet e gegërishtes dhe të toskërishtes, çka dëshmon lashtësinë, të themi relative të kësaj shfaqjeje të gjuhës shqipe. Kur i sillemi vjetërsisë së kësaj kategorie verbale të gjuhës shqipe nuk mund të mos përmendim edhe faktin se forma e participit që del në admirativin e shqipes, nuk është e plote, sidomos ajo e toskërishtes që, përndryshe, edhe në këtë periudë të zhvillimit të saj, paraqitet e plotë: *-parë*, kurse *pakam; lidhur*, përkundër: *lidh(ë)kam*, etj. Në anën tjetër mungojnë të dhëna gjuhësore që të dëshmojnë për daljen e admirativit që në krye të herës, prandaj lidhur me këtë problem na pëlqen shprehja „relative” me anë të të cilës shprehim rezervën tonë përkritazi me moshën e kësaj dukurie të sistemit verbal të gjuhës shqipe. Këndeje anojmë edhe për një arsye tjetër, pse admirativi duket se nuk del në të folmet e diasporës shqiptare të Greqisë dhe të Italisë Jugore. Mungesën e saj në ato ligjërimet e shpjegojmë me zhdukjen e tipareve rudimentare që kishin zënë të shfaqen e që në viset e reja, në ngulimet e rishme ajo dukuri shkoi e u zbu. Përkundër tyre, arbërishtja e kolonistëve shqiptarë afër Zarës të Dalmacisë e ruan admirativin: *kenkam, kenke, kenko, kenkami, kenkeni, kenkan; paskam, paskë, pasko, paskami, paskeni, paskan* (I. Ajeti, *Istorijski razvitak gegijskog govora Arbanasa kod Zadra*, f. 139, 141, 144).

Ndaj formës imperfektive të admirativit që shumkush e quajnë „lindore”, *shkojke, bajke (bake), dilke, mirrke, falke*, e që del edhe te matjani Pjeter Budi, për të cilin thuhet se ka shërbyer për një kohë të gjatë në viset e Kosovës, – duhet të mbajmë qëndrim të drejtë e të shfaqim mendimin tonë. Ajo formë, siç dihet, është trajtë imperfektive e admirativit të pësorës:

(veta e III njëjës e imperfektit). Ajo sot në ligjërimet shqiptare të Kosovës ka funksion imperfekti të indikativit, prandaj paragjykimi i disave që edhe sot e gjithë ditën e marrin formë admirativi duhet të flakët. Dalja e kësaj forme në shkrimet e Budit nga Guri i Bardhë i Matit, nuk do pandehur trajtë „lindore“ e marrë nga Budi në kohën e qëndrimit të tij në trevat e Kosovës, ajo do quajtur trajtë e përgjithshme, që mund të ndodhë në mbarë shqipen, pra edhe ndeshjen e saj në shkrimet e Budit matjan do ta konsiderojmë normale.

Mënyra dëshirore (optativi)

Edhe mënyra dëshirore a optativi – kategori e veçantë e sistemit verbal të gjuhës shqipe, me anë të së cilës shqipfolësi shpreh dëshirë për diçka a dikën, është e zbërthyeshme në dy elemente, në elementin e parë, që konsiderohet temë, dhe në pjesën e dytë që mund të jetë prapashtesë – mbarese. Në temë që duhet të jetë bazë e kësaj kategorie foljore të shqipes, qëndron zakonisht aoristi, respektivisht tema e tij, herë-herë në bazë të optativit vihet tema e participit, vise-vise atje rri edhe prezenti.

Mbaresat e optativit dalin me këto forma: *-sha, -sh, të*; plur. *shim, – shi (shit), – shin*.

Po t'i sillemi origjinës së mbaresave të optativit, duhet të pranojmë se në punën e zanafillës së tyre ndeshim në veshitësi, prej këndeje as mendimet e dijetarëve rreth burimit të mbaresave në fjalë nuk piqen. Një fjalë sish gurrën e tyre e kërkojnë të forma imperfektive e ndihmëtares *jam (isha)*; lagjja tjetër në ato mbarese shikojnë një aorist të vjeter që ka marrë funksionin a vështrimin e optativit.

Kategoria e *-n* – koniugacionit dhe ata verba që në temë kanë një vokal, në punë të mbaresave të optativit dalin disi me forma të tjera; optativi i tyre paraqitet me aso formash që paksa *shkofsh, ai ajo shkoftë; punova: punofsha, punofsh, punoftë, punofshim, punofshi (a punofshit), punofshin*; me këto mbarese ndryshojnë prej atyre që posa u zunë ngojë: *shkova: shkofsha, shfaqen edhe foljet me vokal: piva: pifsha, pifsh, piftë, etj.*

Në bazë të këtyre foljeve, aoristi, siç dihet, del me këtë temë: *shkova: shkofsha*, me një ndryshim të vogël nga fusha fonetike që shfaqet

në formen e optativit nga *t*-ja që pranë sibilantit *-sh*, kthehet në spirantin *-f*, siç e dëshmojnë shembujt e sjellë pak më parë.

Një tubë verbash të kësaj kategorie, ato që i quajmë folje apofonike, në bazë të optativit nuk marrin temën e aoristit, veçse në sajimin e optativit ato mbështeten në forma të prezentit, bie fjala: prez. *mjel*: opt, *mjelsha*, *mjelshe*, *mjeltë*, etj.; aoristi I tyre siç dihet, del: *mola*, *dola*, *solla*, *tora*, *polla*, *mbolla*; optativi i të cilave paraqitet: *dalsha*, *dalsh*, *daltë*; *sjellsha*, *sjellsh*, *sjelltë*; *tjerrsha*, *tjerrsh*, *tjerrtë*; *djegsha*, *dredhsha*. Spiranti *-sh* i mbaresave të optativit vende-vende kthehet në *-ç*: sjellça.

Edhe pse e kësaj kategorie, folja *flas*: aoristi *fol*, që pritej sikur simotrat e saj, optativin ta mbështese në temë të prezentit, në kundërshtim me to, forma e optativit të saj del si pason: *folsha*, *folsh*, *foltë* etj.; *vras*, që nuk hyn në kategorinë e përmendur foljore optativin e qet *vrafsha* – aor. *vrava*. Nga tema e aoristit *plasa*, folja *plas* nga *pëlcas*, e kjo prej *plas-as*, optativin e bën *plaça*, *plaç* – *plastë* që pëson alternim asisoji fonetik ku *s*-ja në fqinjësi të *-ç*-së shkon e zhduket.

Foljet që dalin në konsonant me përjashtim të tyre që u përfillën ketu para, optativin e sajojnë në mbështetje të aoristit: *prita*: *pritshta*; *dita*: *ditsha*; *hapa*: *hapsha*; *ika*: *iksha*.

Folje në konsonant – folje të n – koniugacionit dhe ato në vokal	
Sing. Veta e 1. – sha (tosk. Edhe ça).	f. – sha
2. – sh	f. – sh
3. – të	f. – të
Plur.	
1. – shim	f. – shim
2. – shi	f. – shi
3. – shin	f. – shin

Format e optativit *vofsha*: (*vofsh*, *voftë*), *vofsha*, më aorist *vojta*, *vajta* kanë përdorje shumë më të hapët se të tjerat: *vojtshta*: *vajtsha*.

Optativi i foljeve, participi i të cilave del me *-në*, siç janë: *zâ* – *zânë* – *zënë*; *vë* tosk. *vënë*; *dhânë-dhënë*, *thânë-thënë*; tosk. *rënë*; *lânë* – *lenë*; tosk. *shpënë*, formohet prej participave të tyre: tosk. *zença*, *vënça*, *dhënça*, *thënça*, *lënça*, *shpënça*; në ligjërimet geqe, si dhe në varianten geqe të gjuhës së shkrimit – format e optativit shfaqen siç pason: *zâ(n) sha*, *za(n)*

sh, zantë; dhasha, dhash, dhashtë (dhaça); thasha, thash, thashtë; rafsha, rafsh, raftë; lasha, lash, lashtë; format e optativit të gegërishtes nuk sajohen prej trajtave participore qysh formohet optativi i toskërishtes, porse ato mbështeten në temën e aoristit. Foljet supletive a të -mi koniugacionit: kam, jam (thom); paça, paç, pastë; qofsha, qofsha, qoftë.

Gjuha shqipe, megjithëse jo aq e përpunuar dhe e studiuar, është e pasur për kah sistemi i saj gramatikor; në strukturën e saj ajo ngërthen nëntë mënyrë verbale: dëftore, lidhore, habitore, dëshirore, kushtore, urdhërore, paskajore, përcjellore e pjesore (indikativ, koniunktiv, admirativ, optativ, kondicional, imperativ, infinitiv, gerundiv dhe particip). Secila në gjirin e saj ka zhvilluar nga disa kohë. Deri këtu u shtjelluan një pjesë e tyre, ato të thjeshtat, ndërsa *miset* e tjera të sistemit verbal, analitikët apo perifrastikët nuk janë prekur: e kryera (perfekti) e dëftores, e habitores, e dëshirores si dhe kohë e tjera relative të së kaluarës (e kryera e plotë apo pluskuamperfekti i dëftorës; i lidhores e i habitores, e kryera e tejshtuar e dëftores, mandej e ardhshmja e përparme a futuri ekzakt dhe kushtorja e shkuar (kam punuar, të kem punuar, paskam punuar, paskështa punuar, pata punuar, do të kem punuar, do te kisha punuar).

Trajtat e permendura janë sajuar prej pjesores dhe foljes ndihmëtare *kam* në kohët e në mënyrat përkatëse. Kur është fjala për ndihmëtares e shqipes: *kam e jam*, që merren si elemente të para, të domosdoshme në formimin e kohëve perifrastike analitike të kësaj gjuhe, – do theksuar që *kam* përdoret për foljet kalimtare veprorë; në ligjërimet geqe ndihmëtarja *jam* del edhe për foljet jokalimtare: *jam shkue, jam dalë, jam kanë, jam ardhë, jam qëllue a qillue* (Kosovë – Shkodër – Malësi e Madhe). Kjo shfaqje nuk është edhe e re, e ndeshim në Mesharin e Buzukut. E edhe s'ish ënbëritunë Jesu ëndë kështjellt e se *ai ish dalë ën s'inë Zot*, 211.

Se ku duhet të kërkohet mënyra e përdorimit që folja ndihmëtare *kam*, që hyn ne formimin e kohëve të tjera analitike e perifrastike, – është vështirë të thuhet; disa dijetarë burimin e kësaj dukurie e kërkojnë te latinishtja, apo në gjuhët romane, në latinitetin e Ballkanit.

Depërtim të ndikimit të latinishtes në gjuhën shqipe, përveç në leksik, kanë shikuar gjuhëtarë të shquar edhe në fushën e sistemit gramatikor: F. Bopp, Miklosich, Schuchardt e Gustav Mayer. Ndikim të latinishtes në

këtë gjuhë gjejnë ata sidomos në fleksionin e verbit. Aoristin e shqipes, atë në *-va*, e nxjerrin, siç dihet, prej imperfektit latin në *-abam* (laudabam). Dijetari Schuchardt, formën verbale *është*, *âsht*, e gjen të dalë prej asaj të latinishtes *est*; ndërsa albanologu i dijshtëm austriak, G.Meyer përemrin *i kuj* e qet të ardhur prej të lat. *cuius* (*quis, qui*); mandej optativin, po ky shkencëtar e sheh të dalë prej pluskuamperfektit të koniunktivit (këndofsha: *cantavisse*); burimin e mbaresës verbale të kategorisë foljore më të madhe me *-oj, -onj*> të tipit: *punoj, këndoj* – e qet të ardhur prej të latinishtes *ara në kantarè, laudare*.

Kësaj prirjeje romanizuese ia prenë hovin Holger Pedersen, Meyer – Lübke, Kr. Sandfeld, punën e të cilëve e vijuan N. Jokli e Bariçi. Në punimet e veta nga lëma historike, etimologjike, Pedersen ia ktheu shqipes atë fond leksiku që albanologët para tij ia kishin rrëmbyer e për kah burimi e kishin qitur të huaj.

Kur dihet për përqindjen e madhe të latinishtes në shqipe, në fushën e saj leksikore, atëherë është krejtësisht afër menç të pranojmë njëfarë ndikimi të asaj gjuhe edhe në fleksionin verbal të gjuhës shqipe, bie fjala perfekti i shqipes sonë duhet të jetë sajuar pas modelit të latinishtes *habeo scriptum: kam shkruar: kam shkruar*. Këtu, në të vërtetë duhet të kemi një calque gramatikor e jo një ndikim të drejtpërdrejtë të latinishtes mbi fleksionin verbal të shqipes.

Në anën tjetër shfaqjen sporadike të foljes ndihmëtare *jam* në verbat jokalimtare të një pjese ligjërimesh geqe, nuk mund të mos e quajmë të ardhur nga ndonjë gjuhë e huaj, sigurisht fqinje, sipas të gjitha gjasëve prej gjuhëve sllave të Ballkanit, në të cilat ndihmëtarja *jam* është e vetmja folje qe hyn në punë në sajimin e kohëve analitike apo perifrastike.

FORMIMI I FJALËVE DHE PASURIMI I GJUHËS SHQIPE

Pjesa e fjalëformimit të gjuhëve, këtu edhe ajo e gjuhës sonë letrare, paraqet gurin themeltar dhe luan rol të dorës së parë në punën e pasurimit të gjuhëve përgjithësisht, e të asaj letrare veçanërisht. Në punën e formimit të fjalëve të një gjuhe pasqyrohen kriteret se si bashkohen fjalët në një njësi të vetme, funksioni dhe vështrimet e tyre të reja që ato marrin me të përzier të tyre në një fjalë.

Gjuha shqipe, si dhe gjuhët e tjera, ka tri rrugë me anë të së cilave pasurohet vazhdimisht, e ato janë: nëpërmjet parashtesave, prapashtesave dhe me anë të kompozimit, d.m.th. me anë të lidhjes së dy fjalëve në një fjale të vetme.

Po të rroket kronologjikisht, puna e pasurimit leksikor të gjuhës shqipe del shumë e vjetër: e ndeshim ndër fjalë të trashëgimisë indoevropiane. Ngadonjëherë është shumë vështirë të veçohet elementi formativ nga primitivi – sidomos kur kemi të bëjmë me zberthimin e fjalëve të pajisura me parashtesa e prefiksa, pse këto në shumë raste nuk është e mundur të veçohen ngase që të dy palët janë tretë më një element me largime kuptimi.

Studimet e parashtesave i ndjek edhe një gjë tjetër; ato për kah numri janë më të pakta, e **prapashtesat më të pasura, por më të lehta për t'u zberthyer, ndërsa të parat**, numerikisht s'dihet a përfshijnë diçka më shumë se gjysmën e prapashtesave, që vetëm ato të sistemit nominal kapin 160-170 formante.

Prapashtesat, të shumtën s'kanë gurrë autoktone, por janë huazime, ndërsa parashtesat, në pjesën më të madhe dalin sajime vendi.

Kjo pjesë e gramatikës së gjuhës sonë, që prej Hahnit e këtej në dimensione herë të ngushta e herë të gjera, preket në gramatikat dhe në vëzhgimet e dijetarëve – albanologë, mirëpo ato janë vetëm kërkimet pjesore a parciale, të shkëputura andej këndeje nëpër revista dhe studime të ndryshme.

Deri tani vonë nga lëmi i studimeve në fjalë, kishim vetëm një tok material dhe një burim të mangët: Nikollë Gazulli kishte vjelë e venë në hyrje të *Fjalorit të ri* një varg parashtesash dhe prapashtesash ne vitin 1942; „Instituti i Studimeve Shqiptare” kishte mbledhur dhe ruante dorëshkrim një punim kësisoji, mandej po në këtë kohë punëtori i zellshëm I. Mitrushi kishte grumbulluar material të pasur gjuhësor. E. Çabej; siç rrëfen vetë, kishte qëmtuar nga botime te ndryshme material me karakter letrar, gjuhësor e folklorik. Në mbështetje të këtij materiali A. Xhuvani dhe E. Çabej, hartuan dhe botuan në Buletin për shkencë shoqërore (1956) 4 (66-103) një studim mbi parashtesat e gjuhës sonë, dhe më 1962, doli një libër i veçantë, ku autorët e përmendur rrokën 168 formante prapashtesa, kryesisht nga ato të sistemit nominal; V. Dançetoviqi boton më 1960 – Pri-shtinë: „Sufiksi deminutiv i emrave të gjuhës shqipe”.

Metodologjikisht do të ndjekim këtë rrugë në punën e hetimit të formanteve të gjuhës shqipe: njëherë do të marrim disa prej formanteve, që dalin te fjalët, pajisur me prapashtesa, mandej do t'i vështrojmë në një numër të kufizuar, një palë prapashtesash, dhe do ta mbyllim këtë kapitull me vëzhgimin e një lagjeje fjalësh që në gramatikë njihen me emrin kompozita.

1. *Parashtesat*

A. – Këtë prapashtesë e gjejmë te përemrat dëftorë, te ata të pacaktuar, dhe te një lloj ndajfoljesh përemërore me funksion proteze deiktike e me kuptim largësie përkundër protezës deiktike *kë*, që tregon afrim: *ai (ay)* përkundruall *ky, ajo: kjo, ata: këta, ato: këto, i atillë: i këtille (-i tillë), ash-tu: kështu, aty: këtu, atje: këtje, atej: këtej, andej: këndej*.

Gjuha e sotme e shkrimit ka nisur të marrë fjalë me origjinë greke e të pajisura me prapashtesën *a* e me kuptim privativ bie fjala: *apolitik, ana-cional, animal, asociativ, ateist*.

Ementin protetik *-a* e mbajnë një varg i konsiderueshëm fjalësh, fjala vjen: *avull (valë), akull, afër, agër, acarr*, te fjala e fundit duan për-qasur shprehjet e kësaj familjeje: *carac, cirris*;

Elementi *a*, që ndeshet në një numër të konsiderueshëm fjalësh, del me vështrim privativ; fjala afër, që do zbërthyer në pjesën nistore a me kuptim privativ dhe në primitivin *-fër*, që kuptimisht do të lidhet me atë të gjermanishtes *urweit*, sërbo-kroatishtja *nedaleko*; e për nga forma, *afër* do të qaset te anglishtja *far* „larg” dhe të gjermanishtja *fern* „larg”.

Formanti privativ *a*, herë-herë edhe *e*, do të jetë refleksi i *n*-së indoevopiane, që në greqishte del *a*, në latinishten *in*, në gotishte-*un*. Formanti *e* – që duket te fjala *esëll* nga *sillë*, e kjo shprehje lidhet me sjell, e që do të jetë përfitim i alternimit metafonik të *a*-se: *gardh* > *gjerdhe*, *kalb* > *qelb*; etj.

Parashtesën *a* e gjejmë në fjalën *agër* (gomar), shprehje që del së pari te Buzuku e që sot ka tretur si apelativ, porse e ndeshim si mbeturinë në toponiminë e Shqipërisë Veriore: *Qafa e Agrit*, midis Dukagjnit e Nikaj-Merturit; *Kroni i Agrushit*, në Iballë. Në toponiminë e Lumës respektivisht të Beratit dalin emra te maleve: *Shpinagri* (shpinë gomari), që me anë të rotacionit në toskërishte doli *Shpiragri*. Te Buzuku, siç u pa më parë, del forma bazë a rënjor *gare*, që është forma femërore e një *gar* me vështrim gomar.

Vokali *a* me kuptim prefiksial del edhe te fjala *atillë*, *avull*, në të cilat *a*-ja konsiderohet si element protetik, ndërsa primitivi – *vull* lidhet me *valë* e prej kësaj doli *vëloj*.

Me formantin protetik *b* (ë) dalin një lagje emrash, siç janë: *bzhollë* (*b+zhollë*) *gzhollë*, *bushtër* (*b+ushtër* – kalliri i papjekur, pemë e papjekur, *bisht* (*b+ithsht*), *burith* (*b+urith*), *byr* (*b+ur-i*). – *Bër* është zgjerim i *be*-së me një *r* epentetike, për shembull, te fjala: *ber* – *bue*, mandej te topiku *Bërzallë* (zall). Emra të pajisur me formantin *b*(ë) a *bër* janë edhe këta: *bërçâ-ní*, *bërcak*, *bërcak*, *bërcanë*, *bërcak*, veçse do thënë elementi primitiv I tyre nuk del i qartë.

Parashtesa në fjalë është e përgjithshme në gjuhën shqipe kur është fjala për burimin e saj mund të paravendohet në thelb parafjala *-mbë*.

Parashtesa *-c* sot në gjuhën shqipe paraqitet si variacion dialektor i formantit prefiksial *s*-që para bashkëtingëlloreve te tashme del *-z*, e në shumë fjalë alternon në *-r*. Kur u ngjitet foljeve ajo paraqitet me kuptim të antonimit: *cbërthej* (*mbërthej*), *cbrej* (*mbrej*); në një varg fjalësh kësodore

parashtesa *c*- shndërrohet në parashtesën *s a z a x a c*, bie fjala: *svesh*, *xvesh*, *zbërthej*, *zbuloj*, *çthur*.

Parashtesa në fjalë del e paqartë në një lagje emrash, siç janë: *çbor* (*borë*), *cmir* a *smir*; sllav. *mir*; *Cregë* (*rogë*); mandej *çfurk*; (*furkë*); *çfytës* (*fyt*), *skërfyell* (*fyell*), në te cilët emra kuptimi i ngjasisë duket i qartë.

Parashtesa *ç*, që në shumë pika ka një kuptim të barabartë me atë të perfiksit *c* – u ngjitet disa foljeve që u jep kuptim antonimi, bie fjala: *çajem* (*ajem*), *çfryej* (*fryej*), *çkallmoj* (*ngallmoj*), *çkarkoj*, (*ngarkoj*), *çkatërroj* (*ngatërroj*), *çkath* (*ngath*), *çkreh* (*ngreh*), *çkrij* (*ngrij*), *çkujdesem* (*kujdesem*), *çkul* (*ngul*), *çpengoj* (*pengoj*), *çpij* (*pij*), *çrrethue* (*rrethue*), *çthur* (*thur*), *çvesh* (*vesh*). Nuk do harruar se disa prej fjalëve të përmendura mund të përdoren, siç u pa pak më parë, edhe me parashtesën *c*: *cthur*, *cvesh*.

Një palë foljesh, dalë prej emrash, formohen me parashtesën *ç*, që del po me këtë funksion; *çkadhis* (*kadhë*), *çkoq* (*koqe*); me *çbordue* (*borde*). Prefiksi *ç*- disa foljeve u jep kuptim faktiv a intensiv, fjala vjen; *çkëmbej*, (*këmbej*), *çkëpus* (*këpus*), me *çmekë* (*mekë*) me *çmundue* (*me mundue*), *çpaguej* (*paguej*), *çprish* (*prish*), *çquaj* (*quaj*). Në vend të parashtesës *ç*, në shumicën e fjalëve të përmendura përdoret parashtesa *sh*-; bie fjala: *shkëmbej*, *shpaguaj*, *shquaj*, *shprish*, *shkëpus*, *shliroj*, *shrregulloj*.

Parashtesa *c*, – sikurse u pa pak më parë, del si një variant e sibiantit *s*, po ashtu edhe *ç*-ja mund të thuhet se në gjuhën e sotme duket si një variantë dialektore e *sh*-së, për të cilën mund të thuhet se mbizotëron në pjesën më të madhe të shprehjeve të zëna ngoje: *shkarkoj* – *çkarkoj*, *shkruej* – *çkruej*, *shkrij* – *çkrij*, *shkul* – *çkul*, *shkoq* – *çkoq*, *shpall* – *shpërblej*.

Forma prefiksale *çë* – duke qenë në pozicionin patheksor ka prirje të shndërrohet me *ça*, fjala vjen; *çafurde* (*furde*), *çamaroke* (*maroke*), analogjikisht me *ça*-në, do të jetë zhvilluar parashtesa *çu*-, te fjalët: *çubardhë* (*i bardhë*), si dhe te shprehja *çuherdhe* (*herdhe*), këtu ndoshta kemi të bëjmë me një kontaminacion të *çerdhe* + *herdhe*.

Formanti *ç* – del qysh te Buzuku, për shembull: *me çpërthyem çkushlluom*; këto trajta nuk mungojnë as te Budi e as te Bogdani: *çkrepem*, *për të çpejtë*, *të çtjella*.

Përsa i përket burimit të parashtesës në shqyrtim, një pale dijetarësh

e qesin të ardhur nga të indoevrop. +*dis-*, që lidhet me formën e gjermanishtes së vjetër të lartën *zir* e me greqishten *δύζ*.

Formanti *d* (*ë*), siç provohet dëshmohet nga shumë anë e shumë shembuj, u ngjitet disa foljeve dhe emrave, që u jep kuptim intensiv, bie fjala: *dëboj* (fjala primitive *boj*, që, si e tillë, përdoret në shumë ligjërime shqiptare *u buen pelat: u dëbuen*; formantin *d* (*ë*) e gjejmë edhe te *dbjerr* (bjerr, *d*-ja e së cilës ka edhe variacionin e vet *z*, *x*: *zbjerr*, ai ndeshet te *dëfrej* (*fryj*, *-sh- fryj*), *dërmish*, *dërrudhem* (rudhem), *dëftoj* (ftoj që ruhet te arbëreshët e Italisë), te foljet e përmendura sipër formantit *-d* është zgjeruar me *r* epentetike; parashtesa *-dë* rri te *dllir* (i lirë). Në disa fjalë ajo del me funksion antonimi, për shembull: *dvesh* (vesh), *dvishem* (vishem), *dathë* (zbathët, dbathë). Formanti në fjalë ngjitet edhe te këto shprehje: *dëborë* (borë), *dërrasë* (rrasë), *dërrudhë* (rudhë), këtë formant e mban edhe folja *dëkoj* e zbërthyeshme në *-koj* si bazë dhe në parashtesën *-dë*.

Parashtesa *e*, rrallë në shqipen që ka funksion privativ i ngjitet fjalës esëll (sillë), dhe barazohet për nga ana kuptimore më parashtesat greke e latine: *a*, *in* me funksion privativ edhe ato *anorganik*, *asociativ*, *amorf*, *amoral*, *inadekuat*, *inauguracion*, *inaugurim*, *invalid*.

E-ja respektivisht *a*-ja konsiderohet refleksi i *n*-së sonantike indoevropiane. Këtu shtrohet problemi i pasqyrimin të *n*-së sonantike indoevropiane në gjuhën shqipe, për çka mendimet e dijetarëve nuk piqen: njëra palë me *e*-në privative shohin refleksin e *n*-së sonantike indoevropiane, lagjja tjetër refleksin e *n*-së sonantike e gjejnë te *a*-ja, që del te fjala *a-fër*, *unfern*, *ne-daleko*; të gjitha gjasat janë në dobi të moshës më të madhe të *a*-së, nga e cila do të ket dalë *e*-ja si rezultat i veprimin të metafonisë.

Formanti *f*-, del te një numër jo krejt i vogël foljesh dhe emrash me funksion intensiv dhe antonimi: *fshâj* (*shaj*), *fshij* (*shi*) *fshëh*, (*çef*), greq. *skapakso*; *ftoh*, sllav, *toplo*, lat, *tepidus*; parashtesën *-f* e gjejmë te ndajfolja *fshtirë*, *vështirë*, (*shtirë*) e këto forma ne bazë të tyre kanë *shtie*.

Me parashtesën *f*- duket të jetë pajisur folja *flê*, *flë* që ka për bazë *f* + *la*; *f* + *lë*. Me formantin *f*- e mendohet edhe emri fruth: *f* + *ruth*, baza primitive e të cilit u regjistrua nga Tagliavini në Arbëresh të Zarës në Dalmaci; forma *ruth* ngjan të jetë baza e kësaj fjale, e *fruth* pandehet një përngjitje me *f*.

Të sëmurit i dalin puçriza të kuqe, prej nga sëmundja u quajt *ruth* që në krye të herës dilte me vështrim *kuq*; po të jetë I vërtetë burimi i apelativit *ruth* me domethënie *i kuq* atëherë te emni i kësaj sëmundjeje ruhet në gjuhën tonë fjala indoevropiane për *kuq*, që është e burimit latin, nga *cucceus*.

Edhe folja *fshâj*, që del me forma të tjera të thjeshta *shâj*, *shëmoj* prej *shamoj*, *shâmë*, *shamtinë*, është e zbërthyeshme në *f+* *shâj*. Varianta toske *shërë-tij* ka dalë prej anës së gegërishtes *shanë* + *ti* me kthimin e *n*-së intervokalike në *r*, prej këndeje rrodhi tosk. *psherëtij* me prefiksin *për*.

Gjithashtu edhe *fshat*, *pshat*, *fshatar*, *fshatarak* do të veçohen në dy elemente: në elementin formativ *-f* dhe në tjetrin *shat*. Po u hodh poshte mendimi sipas të cilit format e fjalës sonë qiten prej *fossatum* (hendek), përkundër tij albanologët anojnë nga burimi autokton duke e sjellë prej bazës *shat* që me format e tjera të shumta formon një familje të madhe fjalësh: *shat*- *Nënshat*, *Bushat*, *gërshet*, *kërshet*, *këshet*, *shet*, *sheça*, *shetkë* (jele e kalit, krife).

Edhe pse formantet *f* e *p* janë dy parashtesa të ndryshme, ato na paraqiten të shumtën si variacione në një fjalë, bie fjala *fshat*: *pshat*.

Parashtesën *g* e ndeshim te emrat, siç janë këta: *gdhâ-ni*, *gdhë-ri* (*nyell* që del nga druri si *xhungë*, *gdha*, *dhâ*; fig. njeri i trashë nga mendja, i pagdhendur). Fjala bazë e kësaj shprehjeje, siç u pa, do të jetë *dhâ*; formanti në fjalë del te *gëdhaç*; mandej te *gëthap*, shmnësi *gëthep* (çengel druri a hekuri për të varur diçka më të; brirët e çfurkut, gëthapët e kalasë = bedenat e kalasë – *Fjalor i gjuhës shqipe*); ky formant i është ngjitur primitiv *ledhë* > *gledhë* = *ledhe*, *dhele*, *përkëdhelje*, *naze*.

Parashtesën *g* (*ë*) e gjejmë te *ngdhend*, fjala rrënjë e të cilës është *dhend* që e hasim në pjesën më të madhe të ligjërimeve geqe; *gdhihem* (*dij*, *dihem*, *ditë* = *behet ditë*, *agon*); elementi formativ *-g* u ngjitet edhe fjalëve të tjera, siç janë *gëzhøjë*, *gëzhitë*, *gëzhutë*, *gëzhollë* me variacionet: *gazhollë*, *gazhotë*, *galamsh* (lamsh); *garrumbull* (grumbull), këtu shihet zhvillimi i një *a*-je në pozicion para theksit.

Parashtesa *-g* (*e*) duket edhe te toponimi *Gëzezat* me fjalën bazë *zeza*; me formantin *gë* (*g*) del e pajisur shprehja *gështallë*, në bazë të cilës rri *shtall*, *shtjell*; si dhe te fjalët: *gërgas* (*ngas*); me rrjedhoja *gërgas-i*,

gërgamë-a, gëshet (kërshet, kësiet, shet). Në një palë emrash duket një variacion tjetër i parashtesës *-gë* me likuiden *l* në këmbë të likuidës *r*; *gë-së* i ngjitet vise-vise edhe parashtesa *l*: *gëlvozhgë*.

Te *gelbazë, këlbazë*, nuk kemi të bëjmë me formantin *gë-a kë*, pse këto janë të fjalës *-kalb*.

Po t'i sillemi burimit të parashtesës *gë*, do të konstatojmë lehtë se ajo është barazi me parashtesen *-k, kë*, si e qet të ardhur N. Jokli. Kjo parashtesë në kalesën e kësaj gjuhe del e përgjithshme, por sot nuk është më produktive; e funksioni i saj në të shumtën e rasave mbetet i paqartë, Kjo parashtesë, siç u pa këtu sipër, doli nga fortimi i velarit *k* të parashtesës *kë-*, që duket ndër përemra dëftore e të pacaktuar dhe te ndajfoljet përemërore, që marrin kuptim afërie, përkunder formantit *a-* që ka funksion largësie, siç u pa në shqyrtimin e përemrave te pacaktuar; bie fjala: *ky, ai, kjo* (dikur kë-jo) ndaj *ajo; keta; ata; këto; ato; i ketillë: i atille; kështu: ashtu; këtu, aty, këtë; atje; kënde; andej; këtë; atej*.

Parashtesa *-kë* u ngjitet edhe një palë foljesh per shembull: *këqyr, kqyr (qyr)*, që dalin qysh te Buzuku. E gjejmë te një tubë emrash: *kështallë* edhe *gërshtallë; këputë* (putër, shputë) që del me veshtrime: *shputa e këmbës, putra e këmbës*, me formantin *kë* duken fjalët: *këlysh* (nga folja *lej*), *klëmëz (lemëz) këthap* thep, *gëthapë*); parashtesa në fjalë del te *këshet* a *kshet* (krhs, *gërshet, shet* – Kalabri); mandej *-kmer (merë, tmer)*; te Bardhi gjejmë *keshemëlyrë* – për *shemëlyrë*. *Kë-ja* u vihet mbiemravet: *i kthjellët, i kthellë* (i thellë). Në shembujt e sipërsënuar parashtesa *k (ë)*-konsiderohet e përgjithshme në gjuhën shqipe.

Me shtimin e likuides *r*, me parashtesën *-kë* zhvillohet forma e zgjeruar e këtij formanti, që e gjejmë te fjalët *kërbot, kërbot*, (botë) me kuptim: „gur më të kuq, që e presin farkëtarët; pluhurin e tij ia hedhin hekurit të kuqur për ta ngjitur me një copë hekur tjetër” (*Fjalori i gjuhës shqipe*): *kërbisht* (bisht) me veshtrime, kocka që gjenden në pjesën e fundit të peshkut, të kurrizit dhe formon anën e prapme të komblikut” (Fjalor i gj. shq.); *kërbotull* (botë) –, deltinë e kuqe, baltë e kuqe”. Këtu hyjnë mandej *kërcingël* (cingël) = një shkop i vogël i prerë së kithi në te dy majat që e përdorin kalamanjtë bashkë me kutin për të lojtur shkop e cingël” („Fjal. i gj. shq.). Formanti *-kë* del te *kërleshem* (lesh), *kërthnezem* (ndezem), *kër-*

qethem (qethem), *kërveshem* (vesh).

Me bashkimin e formantit *-kër*, *-n* dhe kthimin e tyre në *-ngër*, sajo-het një variacion tjetër i parashtesës në fjalë, për shembull: *ngërthej* (krh. mbërthej), mandej *ngërrusem* prej kërrusem.

Me kthimin e *ë-së* neutrale në *a*, del parashtesa *-ka* që e gjejmë te emrat *kabisht* (*bisht*, *karrabisht*); *kaçubë* (*çubë*); *kaçubet* (*çubë*); *kalesh*, *kaleshan* (*lesh*) *katund* (*tund*), *kaletore*, *kalehte* (*lehtë*); *kamasë* (*masë*); *kacub* (*cub*); parashtesa *-ka* – del edhe te disa emra familjesh e vendesh: *Kagjin*, (*Gjin*), *Kagjinas* (*Gjin*); ajo duket te një lagje foljesh: kapërdij (përdij), kapërsjell (përsjell, përcjell), *kapërthej* (*përthej*).

Mendohet që edhe *kashtup* = kashta që mbulon kallirin e misrit, është përftuar nga kontaminacioni i fjalëve *kashtë* e *shtupë*.

Parashtesa *kaca* – që me gjithë variacionet e saj del e kufizuar në të folmet geqe dhe që gjithashtu edhe në ligjërimet e Kalabrisë, dëshmon për një përhapje dikur të gjerë në mbarë shqipen. E gjejmë të ngjitur te emrat: *kacadrê* (*drê*) një farë kacabuni i madh, i zi e i murmë, me kokë të gjerë dhe me nofulla të forta, të zgjatura si brirthe’’ (Fjalor i gj. shq.); *kacabû-ni*, pl. *kacabuj* = *kolepter* rend insektesh me katër krahë, nga të cilët dy të sipërmit janë të fortë dhe mbulojnë dy të fundit, me të cilët fluturon insekti (Fjalor); *kacafik* (*fik*) = një vend i vogël i ndërtuar permbi kasolle, ku bekçiu rri e ruan vreshtat dhe bostanet, fig. shtëpi e keqe, e vogël’’ (Fj. i gj. shq.); *kacagjel*, rri *kacagjel* = *kapardisem*’’; *kacarrum* = „kalli misri i shkoqitur’’; *koçan*; *kaçarrum* (*rrum*) = hekur i gjatë e i trashë e me kokë të rrumbullaktë, që varet pëmbrenda kumbonës, batoq; e ndeshim mandej te *kacarry* (*rryl*) 1) gabzherri, skërfyelli; 2) gryka e shishes; fig. budallë.

Parashtesa në fjalë tregon një përgjasim zvogëlimi të primitivit a të fjalës rrënjë *kacadrê-ni* = që i përngjan drenit. Në foljet *kacafytem* (*fyt*), *kacagjelohem* (*kacagjel*), *kacambytem* (*mbytem*) = kapem, përleshem; *kacavirem* (*varem*, *virem*), parashtesa *kaca* – tregon njëfarë tundje, lëvizje të hovshme të trupit. Me anë të formantit në shqyrtim formohet ndajfolje: *kacagjetthi*.

Forma *-kaci* konsiderohet variacion i parashtesës *-kaca* e ajo gjendet në fjalët: *kacibardhë* (trandafill i egër, kaçë, kace); formanti *-kaci*, del mandej te *kacimare* (mare, mareje = shkurre gjithmonë e blertë, me lule të

bardha në vile, me një pemë si e drethëzës, me të cilën bëjmë raki: *kaçimare, mare marë, marushë* (Fj. i gj. shq.).

Formanti *-kaca* ka një variacion tjetër me formën *kaça* – që shfaqet te fjalët: *kaçarrum: kacarrum* – koçan; me kaçandukë (nduk andej kënde; *kaçarrena* (rrena). Te fjala *kaçamill* kemi një kryqëzim të kërmillit me formantin *-kaça*.

Fjala *kacavidë, kaçavidë, kaçavidhë* do të jetë huazim prej italishtes *cacciavite, venec, cazzavide*.

Sa për parashtesën *-kakë* do të pranojmë se ajo del si variacion reduplikacioni i parashtesave *-kë* dhe *-ka*, e kuptimi i saj mbetet i paqartë. E gjejmë te një tubë emrash, të shtazëve, siç janë: *kakëzogëz*, (= rrëshqanor nga familja e hardhucave në trajtë të gjarpërit, po i padëmshëm: *kakëzozë, kakëzorë; kakëdhözë, kakëdhonë, kakmill*.

Një variacion tjetër del me epentezë të *r-së*, qysh duket te fjalët: *kakërdhiçkë, kakërdhiçë, kakërdhocë, kakërdhok, kakërdhoq, kakërllocë, kakërzogë, kakëzozë, kakërdhok – kakërdhi*, te të cilat fjalë del ndikimi i shprehjes *kakë-* a i *kokërr* bashkohet me *dhi*.

Në vazhdim të kësaj sinteze mbi formantet e gjuhës shqipe nuk duan lënë pas dore parashtesa, siç janë *kala, kara, -kata*, e shumë te tjera.

Parashtesën *kala-* e gjejmë te emrat: *kalavesh* (vesh rrushi), *kalatunde, kalangërç* (ai që e kap ngërçi, paralitik, shëndetlig); *kaladhâ-ni, kaladredh*, (= *kaladredhan, flokë – kaladredh*); *kalamorde, kalakiç; kalakudhe*, e ndeshim te ndajfoljet: *kaladoras*: ec *kaladoras*, (= *kambadoras*), *kalihum – picingul, kalacujas* (= *galiç galuc*), *kalakiç, kalapiç = kaliboç, kalaqafë* = mënyra e të mbajturit të një të vogli në qafë me këmbë të varura përpara: *kaliqafe, shaluar* (Fj. i gj. shq.); *kalaveshas*, (= *keqas*), *kalavigjas* – thuhet për një njeri që e mbajnë për kokë e këmbësh për ta shpënë gjetiu (Fj. i gj. shq.). Te një palë fjalësh *-kali* del variacioni i kësaj parashtese: – te fjalët: *kalikiç a kalikoç, kaliqafe, kalistrof*, vëse-vise e gjejmë edhe pa *i-në*: *kalvar, kalvos* = rrëkaj po rrjedh tatëpjetë. – *Kalivar* si toponim e gjejmë në Mirditë e Mallakastër (Xhuvani – Çabej: *Parashtesa të gjuhës shqipe*).

Me shtim të një *-s-je*, variacioni i parashtesës në vështrim, del *skala-*: *skalapurri, skalapurritiu* (inversamente, alla rinfusa), *skalavarun*. Një variacion tjetër i formantit *kala* del me shtimin e *sh-së*, që përftohet *-shkala*

dhe e gjëjmë te foljet: *shkalaveshi* (shkalaviq) = *zdërfaq*, *zbruj*: rri se të kap e të shkalaviq me shqelma.

Në një numër të mirë fjalësh origjina dhe funksioni i parashtesës në studim nuk dalin të qartë. Në disa sosh mendohet të ketë ndikuar fjala *kalë*; *kalaqafë*, *kaliboç*; te një palë fjalësh të pajisura me formantin *kala*, në rrënjë duket se rri fjala: *humb*, (*kalahum*, *kalihum*). Te një tubë fjalësh formanti *kala*, *kali*, *kal* – zberthehet në *kë*: ka dhe në *lë*, *li*, që të dyja parashtesa: *ka* + *liva-re*.

Parashtesa jonë gjendet edhe në greqishten e re: *καλ αποδς*. Parashtesa *kara* – që na duket se në gjuhën shqipe ka hyrë me gjithë elemente të turqishtes, del edhe te shumë fjalë autoktone zakonisht me kuptim pejorativ a intensiv, dhe kështu është bërë produktive në gjuhën shqipe: *kara-batak*, *karabina*, *karabojë* (*karaboj* – në Kosovë). *Karabullak*, *karabullar*, *karagrosh*, *karakush* (krh. Karakušević – serbokroatisht), *karaserda*, *karakoskë*, *karagjoz*, *ragjoza karatauk*, *karakanxoll* (*kara* + *koncolos*). E gjejmë siç u tha pak më parë, edhe te fjalë të trashëgimisë së vjetër: *karathi* (*thi*), *karabishte* a *karrabisht* (*bisht*) *karavoshem*, *karavuhem* me kuptim superlativ. Iu ngjitet edhe disa fjalëve që për nga kuptimi dalin të errëta, siç janë: *karabush*, *karavuç*, *karakoç*, *karabobe* (*bobël*, *bobole*); *karaushë*, *karajel*.

Një palë fjalësh me *kara* – si formant me origjinë turke, në gjuhën shqipe dalin me shpërngulje kuptimi; bie fjala – *karabatak* në turqishte ka vështrim *zhytër*, *zhytra*, *zhytarak* (= rosë e egër, notarak), kurse në shqipe ka marrë kuptim metaforik të një *batakçiu*; gjithashtu edhe fjala turke *karabullak* në shqipen del pejorativ (i trashë).

Me formantin *kara* – të burimit turk do të jetë trazuar parashtesa thjesht shqipe *karra* – që është sajim analog i formantit *kala* të turqishtes.

Mendimin e Çabejt që parashtesa – *kata*, me funksion të errët, „duket të jetë një zgjerim ekspresiv i parashtesës *ka-* me të cilën alternon”, – e gjejmë të drejtë, siç del te fjalët *katalesh* (*lesh* - *kaleshan*, *leshatak*, e *katarëmbëz* – *bza* (përrallëz, shpifje) nga *kata* dhe *rëmb*, *rrëmb*, *kataros* mund të shpjegohet duke i konsideruar të ardhur prej numërorit *katër* pse edhe përkah ana vështrimore fjala jonë do të mbështetet te numërori *katër*.

Sumë e afërt me parashtesën e sipërme *kata*, del formanti *katra-* që e

gjejmë te emrat: *katalojë* (lojë), *katralig* (lig), *katrasjel* = *rrok më rrok*; *m'u rrëxue katrasjel*; *katrapilas* (ndf. *rrëmuje*, *barë e mbrapshtë*, *lesh e li*; *katrapilzoj* - *mpshtjelloy*, *bëj lesh e li*; *katrasyll* = *vangosh në tëdy sytë*; *katravesh -i* = *bishë e përrallave të vjetra që ha njerëz si kuçedra* (Fj.gj.shq.).

Kur merret me kuptimin e këtyre lloje emrash, Çabej thotë që „shumica e fjalëve të formuara me këtë parashtesë shihet se tregojnë një veprim ose një gjë të ngatërruar e të shtrembër”.

Këtu hyn edhe fjala *katragjysh*, pjesa e parë e të cilës do të jetë numërori *katër*; gjendet edhe pesëgjysh, si në gre. *τριπατωζ* prej *τριτοζποππος* *tripator*: *tritos pappos*.

Një palë emrash e fjalësh të shqipes marrin në fillim formantin *ko-* disa të tjera dhe reduplikacionin e tij: *koko-*; parashtesën *ko-* e gjejmë te fjalët; *kullum* (llum) „baltë e rrahur për të bërë tulla” –; *kodhele* (gdhele); *kodhe* (po bëj dhe, po bënj kodhe); *kokosh* (krh. sllav. serbokroat. *koka*, -*kokoš*, *kokoška*) me kuptim *pulë*, kurse në shqipe fjala del me vështrim *gjel* pupagjel; gjel kokoshi.

Fjala *kopil*, shprehje e mbarë gjuhës sonë, kaluar edhe në gjuhë të tjera të Ballkanit, sipas Oštirit. do të afrohet te sankr. *ka-* (keq), dhe del me vështrim pejorativ: Primitivi i fjalës në studim do shpënë te *pjell*.

Reduplikacioni i *ko-së* njihet parashtesa *koko-* që e gjejmë te *kokorreth* (= rreth prej stufe a thesi, i mbushur me kashtë a me lecka, që vihet mbi kokë, kur marrim tepsinë në furrë a kur mbajmë ndonjë shtamë me ujë mbi kokë); *kokopord* (*kokopordhë*) -*kokërdhi*, regjistruar në Arbëresh të Dalmacisë; *kokové(ve)*; në disa fjalë del si sajim analogjik: *kokorec*, *kokoreç*, *kokoresh*; *kokoreshë*, *kokorresh*, *kokorosh*, *kokorush*. Të gjitha këto formime drastike të gjuhës popullore japin, siç thotë Çabej, idenë e një gjeje rrotullare ose rumbullake.

Parashtesa *l (ë)*, me gjithë varacionet e saj *la*, *li*, *lu*, ndeshet shumë me shpesh në shqipen e dikurshme dhe në ligjërimet e saj, se sa në ditet e sotme. Ajo u ngjitet disa emrave dhe foljeve: *lashkë* (ashkë), *ashkël*, *bujashkë*, *lëmazë* (mazë), *mazë*, *kajmak*, *lëkojë*: *koje* (bimë ujëse), *lëmashk* (mashk) *lëvore* (*var*, *lëfyty* (fyty) = *çep*, *lëkitër* (kitër, kitërr), *Imaje*: *maje*, *Imuç* a *Imuq* (it. mucchio), *lmyshk* (myshk), *Iputë*: *putë lëverca*: *verzat* e

peshkut; *lëpender e lëpandër* (*pendel, lëplungë: plungë* (Dukagjin, Jabllanica e Epërme në Serbinë Jugore); *lëbozë: lëpozë*, forma metatike të *blozës, lëbarkë* (dizenteri): *bark; lëvare (var)*. Me këtë parashtesë dalin edhe disa emra tipikë: *Lbumi, Qafa e Lbunit, Maja e Lbanit: ban*. Formantin në fjalë e gjejmë edhe te një tufë foljesh: *lëbardh* (i bardhë), *lëmekem* (mekem), *Ithur* (thur) *lëkund* (përkund, shkund), *lëvyrem, lëvirem* (virem), *Imbarem* (mbarë), *lëkuqem* (kuqem), *Ifarem* (farë).

Në disa emra parashtesa në fjalë del me kuptim përngjasimi me fjalën primitive, por në instancë të fundit pasojat nga ana kuptimore nuk pajtojnë me primitiv; ka edhe aso fjalësh të pajisura me formant që nga ana e vështrimit nuk ndryshojnë nga primitivi.

Parashtesa jonë ka edhe variacionet e veta, siç u tha pak më parë, e që duken: *la, li, lu: latredh* (tredh); *latrak; lamardhe* (mardhë); *lavar, lavare* (rreth thuprash për të kapur shtizën e parmendës me zgjedhë; hallkë qeni; *loze*-ja: paska lëshuar kungulli lavarët); *litrak; lubardh* (lumbardhë-pëllumb i bardhë luqerbull (qelb); *limburem* (mburrem);

Me parashtesën *l (ë)*, me anë kontaminimi del edhe *laka* (*la + ka*); mund të jetë që është zhvilluar nga ndikimi i emrit lak-: kaladredhas.

Parashtesa jonë del shumë heret qysh në ilirishte: Liburni (Burni), atë e ndeshim edhe në greqishten e vjetër, si dhe në gjuhë të tjera të Azisë.

Formanti *m (ë), -mb (ë)* u ngjitet emrave, mbiemrave, foljeve konsiderohet parafjalë a parashtesë.

Si parafjalë e gjejmë te një palë emrash: *mbatërshanë* (*m + patërshanë*); *ëndrekë* (*më + drekë*); *mëzemër* (del nga *më + zemër* - në kohë të iqindisë); *mplur* (*m + pluer*); *mëndore* a *mbëm dore* (*më + n + dore*); *engojë* (*më + n + gojë*); *mnot* (i ra *m + not*); *mboh* (*m + boh*: me i ra mboh; shprehja e shqipes ka ardhur nga serbishtja; udanti u bah, *iz ubaha*). Formanti në fjalë del edhe te këta emra: *mdheskë* (dhe); *mgojcë* a *mbëgojcë* (*m + goj + cë*); *mkresë* (*m + kre + së*); *mkrejcë* (*m + kre + ce*); *mkamc* a *më këmbës* (*m + kambë: këmbë + s*). Te këta emra parashtesa s'ka ndonjë funksion: *mgje-u* (*m + gjije*) = kasollë për gjënë e gjallë; *mëshjtjerrë* (*m + shtjerrë, shtjerrë*); *mtî-ni* (*m + tinë*) që thuhet edhe *pti-ni* me metatezë *tpi-ni*, që në shqipen ka hyrë nga lat. *tinus* a nga ital. *tino*; *mner* (*m + ner*); *mshikë* (nga lat. *vesica*). Me këte parashtesë dalin edhe

këta emra topikë, siç janë: *Mguri* (*gur*), *Mripa* (*ripë*); *Mshkalla* (*shkallë*); *Mziu* (*ziu*), *Muzeshku* (*zeshk*, lagje në luginë të Cemit, Grudë), *Mëzezi* (afër Tiranës).

Edhe këto folje nisin me *m-* në parashtesë: *mballoj* (*m + ba-llë*); *mbëltoj* (*m + baltë*); *mëkamben*, *mëkëmbem* (*më + kambë, këmbë*); *mnotoj* (*m + not*); *msyj* (*m + sy*) *mshenjoj* (*m + shenjë*); *mbudhem* (*mb + udhë*); *me mbrijue* (*m + brijë*); *mbruj* (*brumë*); (*m + bukur*), *mblak* (*m + plak*); *mbraps* (*m + prapë*); *mbreh* (*m + preh*); *mshij* (*m + shij*); *mshel* (*m + shel + çel*) edhe *mërshel*; *mbërdhezem* (*m+b + [r] dhezem*).

Në disa shembuj të tjerë parashtesa *-m* do të jetë përftuar nga prefiksi *-n*, që në pozicion përpara labialit fillestar të primitivit, ndërrohet në *-m*, si *mbush* që del prej *n + bush*, qysh shfaqet edhe te Buzuku: *enbush* për *mbush*, mandej *enbaj* për *mbaj*, ku *e*-ja reflekton një *n*-sonantike.

Disa fjalë të gjuhës sonë mbajnë në pozicionin nistor parashtesën *-më*, bie fjala *i mëtejme*, *i mëtejshëm*, *i mëvonë*, *i mëvonshëm*, *më* në fund etj.

Parashtesa *mbi*, identike me parafjalën *mbi*, nuk del e përhapur në ligjerimet popullore te gjuhës sonë; përkundrazi, në gjuhën e shkrimit e pas modelit të gjuhëve të huaja me këte parashtesë formohen shumë fjalë, për shembull: *mbishkrim*, *mbivlerë*, *mbiçmoj*, *mbikëqyr*, *mbisundoj*.

As parashtesa *-ma*, që u ngjitet disa fjalëve te gjuhës shqipe, nuk del e përgjithshme.

Sa i përket parashtesës *-mos* me kuptim privativ, është shumë më e shpeshtë në të folmet popullore toske, se sa në ato gege; bie fjala: *mosgjë*, *moskurrë*, *moskund*, *mosnjeri*; te Variboba *mosgjakun*; geg. *mosmerë*.

Krejt ndryshe qëndron puna sa i përket përdorimit të saj në gjuhën tonë të shkrimit; atje ajo është shumë produktive: *mosardhje*, *mosbesim*, *moskuptim*, *mosmarrëveshje*, *mospagim*, *mospërfillje*, *mospranim*, *mosdije*, *mossulmim*, *mosbamje*, *mosbërje*, *mosbarazim*, *mosbashkim*, *mosbindje*, *mosbluarje*, *moscënim*, *mosdashqe*, *mosdukje*, *mosduim*, *mosevari*, *moskalim*, *moshyrje*.

Kësaj parashtesës i konkurron me të madhe prefiksi *-pa*; *padashje*-*mosdashje*; *padurim*-*mosdurim*; *pabarazi*-*mosbarazi*, *pabesim*-*mosbesim*. Që të dy këto parashtesa kanë funksion privativ. Siç del te Sandfeldi, edhe në dialektin e aromunëve parafjala *fară* me vështrim „*pa*” duket me

funksion privativ, ndërsa në sllavishte i përgjigjet parafjala: *bez* – *bezobrazan* (*bez* – *obraz* + *an*); *be-sumnje bez* + *sumnje*); *bezumlje* (*bezumlje*); *bezbrizhan*, *bezgre-šan*; lat. *po-te pos-itus*.

Parashtesa *n-* apo *-në* që u ngjitet emrave, mbiemrave, foljeve, ndajfoljeve, parafjalëve, paraqitet si parafjalë a parashtesë, fjala vjen: *nëpunës*, *nëqesh*, *nfal*, *nfle*, *ngjas*, *ngazëlloj*, *ngdhin*, *ngdhihem*, *ngazëllim*, *ngisht*, *ngishtë*, *ngishtëz*, *ngojëz*, *ngryk* (*n* + *grykë*), *ngrykë*, *ngjat* (*n* + *gjatë*); *nishk* (*n* + *dishk*, *tishk* = *tisica*); *niri* (*n* + *iri* lat. *ira*), *nijë* (*n* + *ijë*), *ndoreja* (*n* + *dorë*); *nkrejcë*; *ngoje*, *ngjak* (*n* + *gjak*), *Nizhull Lezhës* (*Insel von Lezhë* = *ishull i Lezhës*), *-nasill* (*në* + *esil*), *nândërr* (*n* + *andërr*), *i ngurtë* (*n* + *gur-të*), *te ndrejt*, *ndreq* (*n* + *drejt-dreq*), *ndez* (*n* + *djeg*), *ndotem*, *ndyj*, që sipas Meyerit e Joklit lidhet *te dhjes*; *nxij* (*n* + *zi*), *ngri*, *krh*. *shkrij*, *ndjek* lit. *tekis*, *vrapoj*” slav, *teka*, serbokr, *tek*, *tok*, *nduk* (lat. *duco*).

Te parashtesa – *pala*, që u ngjitet pak fjalëve të shqipes, siç janë *palavig* (*vig*), *palapetë* (*petë*), kemi te bëjmë me një kontaminacion të *pa* + *la*.

Kur trajtohet parashtesa *-para*, bie në sy një fakt se ajo del edhe me një formë tjetër, që konsiderohet e vjetër, e ajo është *pare*, *par* (*pardje*, *parëmbamë*, *parvjet*); kurse riformimet e reja që parashtesa në studim u ngjitet, ku ajo del me trajtën *para* – që më gjuhën e shkrimit është bërë produktive sipas modelit të gjuheve të huaja: *parafytyrim*, *parakalim*, *parashtesë*, *parathënie*, *paravithe*, *paravesh*, *paravang* (*para* + *vang*), *paralajmëroj*, *pararobjë*, *paraluftë*, *paraushtarak*, *paraparak*, *parakuptim*, *paralobjë*, *parapagesë*, *parasysh*, në disa fjalë me burim të huaj parashtesa – *para* del gjithashtu me gurrë të huaj, siç janë: *paralel*, *parafrazë*, *paradë*, *paragraf*, *parantezë*, *etj*.

Parashtesa *-për* në kundërshtim me të tjerat, gjen përdorim mjaft të madh si në ligjërimet popullore të gjuhës shqipe, e edhe në gjuhën e shkrimit. U ngjitet emrave, mbiemrave, foljeve e ndajfoljeve dhe u jep vështrime të ndryshme; bie fjala; *përcjell*, *përsjell* (*për* + *sjell*), *përziej*, *përgjoj*, *përçmoj*, *përshtjellak*, *përvëlak*, *përlesë*, *përshesh* (*përshij* + *shesh*), *përkresë* (*krye-kre* + *së*) *përderës*, *përbuz* (*buzë*), *i përvûtë* (*vë*, *vu* + *të*), *i përhimë*, *i përthimë*, *i përhitur* (*hi*, *i thimë*), *i përgjumshëm* (*gjumë*), *përballë* (*ballë*) *përsipër*, *përrashta*, *përpara*, *përparcë*, *përmjet*, *përprjetë* *përmal* (serbokr., *odozdo*, *odozdol*), *përditë*, *përore*, *përnjëherë*, *përherë*,

përdhunë (dhunë), përnjëmend (mend); përemër, i përkohshëm, e përkohshme, i përsosur.

Po t'i sillemi origjinës së parashtesës në shqyrtim do të pranohet mendimin e Pedersenit dhe të Joklit, që burimin e kësaj parashtese e qesin të ardhur nga një bazë indoevropiane *-pro-*, që në sllav. del *pri: pričekati, priroda*; rus. *pričerni* (i zi); çek, *pričernaly* „zeshkan”.

Formanti *-po*, që ka hyrë në disa fjalë të gjuhës shqipe del i burimit sllav, siç janë: *potkue* a *patkue, porez, poterë, pobratim, pojatë, polem-in, Jokli* e qet të ardhur nga folja *lej-krh. narod (roditi)*.

Parashtesa *prapa-mbrapa* ka zënë e është bërë produktive kryesisht në gjuhën e shkrimit: *paramendim, prapashtesë, a mbrapashtesë, prapavijë, mbrapavijë, prapambetur, mbrapambetur, prapanik*.

Në gjuhën shqipe, më tepër në gegërishte, del formanti *-pre*, duhet të jetë ndërrim i parafjalës *-prej* apo i prapashtesës për-: *prehaluc, pregatis: përgatis; pregim: përgim; pregjim: përgjim*; formanti *pre-* del ndër fjalë me burim sllav: *preseka*.

Formantin *-pro*, që e gjejmë në pak fjalë të ligjëtimeve geqe, nuk e shohim përfundim të kryqëzimit të *për* me parashtesën sllave *pro*, por e konsiderojmë ngatërrim a ndërrim për arsye lehtësimi shqiptimi të *për-* me tingujt nistorë të primitivit: *provanue, provani, proshmue, prozhmue: përcmue, pravalloj; përavulloj, proj: përroj* (Buzuku); *prore: përre*; parashtesa *-pro*, del edhe te një vistër fjalësh me gurrë sllave: *prosek*; te disa sosh ajo del e burimit grek a latin: *prosodi, prosodhi, proces, profet, prognozë, program, propagandë*.

Formanti *-r(ë), -r, rr(ë)*, që gjendet në të folme popullore, u ngjitet një numri emrash, mbiemrash, foljesh dhe ndajfoljesh, për shembull: *rrashtë (rr + ashtë); rrëmiqe; rrëmore (mih, rremih); rrëpuje (opekotina) = pujë, pullë; rraberr (berr); rrëshek (rr + shek, shak, shakull); rrëfanë (rrë + fanë, vanë); rruvâ-ni rrë, (rru-vanë+vâ); rrëzall (n+zall), i rrëmaktë (i majtë); i rrëgjakur; rrëqethem (qethem); rrëmih (mih); rëposh (poshtë)*. Parashtesa është e përshtatshme dhe e barazueshme me prefiksin *-për*.

Parashtesa *-ri*, -që ka shkuar e është bërë produktive këto pesëdhjetë vjetët e fundit, fjalëve bazë u jep kuptim përsëritjeje të një veprimi: *ribotim – ribotoj, rifitim, riformim, rifreskim, rihapje, rikëqyr, rikrijim, rindërtim,*

ringjall, ripastrim, që në shqipen ka hyrë nga italishtja, që del te fjalët ital. *riposo, riguardo, risveglio, risorgimento*; në disa fjalë me *-ri*, ka ndikuar fjala shqipe *i ri, rishtas, rishtazi, risht-ë*;

Edhe parashtesa *s* – del mjaft e plleshme në ligjërimet e gjuhës sonë, dhe si e tillë gjen përdorim të gjerë edhe në gjuhën e shkrimit: *sprovë (provë), spikth (pikth), spurdhë (këpurdhë), sterrë, sëketerrë (terr), spurth (purthe, pordhë)*, vështrim privativ kane këto fjalë: *samtim (i amtë, amëz), i sëmundë (mund), skamje (kam), smir (mirë)*;

Parashtesat që vijnë pas shkronjes *-s*, – domethënë ato që zënë me *-sh*, siç janë *-sh-*; *shala, shara*; – *shka-*, *shkar (r)a, shpër, shtë, shtër*, që të gjitha dalin në të folmet popullore që me vonë u shtrinë edhe në gjuhën e shkrimit.

Formanti *-sh*, del me funksione të ndryshme, herë-herë pa kurrfarë funksioni të dukshëm; bie fjala: *shgun a zhgun (gunë), shkarpë (karpë), shkrep (krep), shputë (putër)*; mandej: *shkorre, shkurre (korr)*. *Sh*-ja e Shkodrës s'di a mund të jetë prefix i këtij toponimi që do të zberthehej në formantin *-sh*, dhe në primitivin *kodër*. Me funksion faktitivi a intensivi dalin *shkapërthej (kapërthej); shpraz (sllav. prazan); shkëpus (këpus), shkapërcej (kapërcej); shndërroj (ndërroj); shpik (pikë); shter, shterr (ter), shkreh (ngreh); shlyej (lyej), shpaloj (paloj, palë); shpengoj (pengoj); shpërdorj; (përdorj); shkadhish (kadhë); shkokloj; shkokrojt (-kokël, kokërr); shkoq (koqe); shpartalloj (partalle)*.

Sipas mendimit të Joklit, Burimi i *-sh-së* do të kërkuar te baza indoevropiane **sm-*, sllav. vjetër *-so*; te një lagje fjalësh *sh*-ja ka dalë nga *ds-dsh*, lat. *dis*: *shkas, shpartalloj, shpëtoj*. *Sh*-ja e shqipes, sipas disave, mund të jetë analogu i të greq. i të lat. *ex*.

Formantet e përmendura *shala – , shara – , shka – , shkar- (r)a* i gjejmë në disa fjalë të gegërishtes veriore me funksion intensiv, pa ndonjë funksion të caktuar, herë-herë u ngjiten fjalëve të tjera për analogji: *shalakuq, shalakuqem (nxehem, thekem mirë pranë zjarrit), kuq, shalavriq-e*, thuhet për një njeri që ecën shtrembët; primitivi i kësaj fjale duhet të jetë *shalë*; *sharapjek* (e përplas djathtas e majtas, – *sharapiqem* - përplasem andej e këndeje: *shara + pjek; sharavidh-ja* (= gocë deti; – xhavidhe; shkapërdhi (= kalamna që s'ri rahat, që ngjitet nëpër drunj si dhia; kalama

qe s'le dy gurë bashkë); *shkadhec* (dhe-u) = trinë me të cilin rrafshojnë plisat e dheut, serb. vlača; *sharamunduk* ka dy formante: *shara* + *m* – që i ngjiten primitivit *nduk*. –

Parashtesa *shpër* –, mjaft e përhapur si në ligjërimet shqiptare, ashtu edhe në gjuhën e shkrimit, del me vështrime intensive; ka kuptim përhapjeje apo domethënie shtrembërimi; ky formant në një vistër fjalësh del me veprim të përkundërt;; bie fjala: *shpërndaj* (daj), *shpërdjerr* (djerr), *shpërdredh* (dredh); *shpërblej* (blej, shpërbyth (= marr nëpër këmbë, përbyth); *shpërdor* (dorë); *shpërderdh* (derdh); *shpërdhet*, (pyll me shpardha); *shpërdhitë* (= gdhi, dhi, dij); *shpërkoq* (koq, kokërr); *shpërlaj* (laj); *shpërnderoj* = *shnderoj*; *shpërngul* (ngul); *shpërthej* (thej); *shpërvjel* (vjel). *Shtë*-, *shtër*-. – Janë dy formante, burimi i të cilave do nxjerrë prej asaj të italisht. *stra*-, që kanë funksion largimi a intensiteti; fjala vjen: *shtëmang*, *shtëmëng*, *shtërbardhë*, *shtërkuqe*.

Formanti *t(ë)*-, që u ngjitet një lagje fjalësh, ka zakonisht funksion intensiteti, por del edhe me funksion të paqartë, fjala vjen: *tamë* (amë) këtu ndoshta kemi të bëjmë me artikullin *të*-; sikur te *tambel*, *tëmbël* (*ambël*, *ëmbël*), *ibanë* (*banë*, *banoj*, *banesë*, *tfurk* (*furkë*), *terr* (*err*), *tlana* (*të* + *laj*; *lanë*), *tlyen* (*lyej*), *tpujë* (*këpujë*) *tjetër* (*të* + *jetër*), *terratis*, (*të* + *err*), *tfilloj* (*t*-+ *filloj*), *t-hapem* (*t* + *hapem*), *tëharr* (*të* + *harr*), *tëholloj* (*të* + *holloj*), *tëhuej* (*të* + *i huej*), *tepër* (*epër*).

Formantet *tej*-, *te*- dhe *tër*-, janë parashtesa që gjenden qoftë ndër ligjërimet popullore, qoftë edhe në gjuhën e shkrimit. Të parat tregojnë banorin e një vendi që ndodhet matanë: *Temali tej*, *përtej mali*); *tejdriinas* (*tej*, *Dri-ni*); *tejdetas* (*tej* + *det*); ky formant ka zënë të përhapet edhe në gjuhën e shkrimit: *tejqyrë*, *tejkaloj*, *tejpashëm*, *tejshkuem*; nga kjo parashtesë duhet të ketë dalë si variacion i saj formanti *tu* – me funksion intensiv: *mirë e tumirë*, *tumir*; *keq e tukeq*; *tumirë*, *tukeq*; *i tukejme*.

As formanti *-tër*-, nuk është aq i përhapur në gjuhën e shkrimit e funksioni i tij nuk del i qartë; për shembull: *tërfurk*, (*furkë*), *terplotë*, (*plot*), *tërthore* (*thore*, *thur*), *tërmekem*, *tërme-gem* (*mekem*), *terma* (*mal*), *tërthuer*, *tërthori* (*thore*); në gjuhën e shkrimit kemi disa rrjedhoja, siç janë: *tërheqje*,

Nga të dy parashtesat *u*-, e *v(ë)*-, kjo e dyta në gjuhë del disi më e

përcaktuar dhe më e afërt, e me funksion të paqartë: *vgjallë (gjallë)*, *vemesë (v + mes + zi=„cipa e hollë e fletëve të qepës“*; nga kategoria e foljeve me këtë parashtesë dalin këto verba: *vdes (des)*, *vdjerr (djerr)*, *vgjaj (gjaj, gjej)*, *vgjendem (gjendem)*, *vjetem (jes; ti jet, ai jet, na jesim, ju jetni, ata jesin)*.

Formanti *-vër*, del variacion i parashtesës *v(ë)* – me zgjerim të likuides *-r*: *vërsulem (sulem)*; *i vergjakët (gjak)*. Te fjala *vdorë*, stomi të bëjmë me parashtesë, veçse me metatezë dhe alternim të *b-së* në *v-dëbor>bëdorë>vdorë*; primitivi i të gjitha formave është *-borë*.

Te fjalet *i vorfën* nga lat. *orphanus*; *i verbët* (lat. *orbis*); *vepër* (opus – operis); *voj-vaj* (lat. *oleum*), kemi një zhvillim fonetik të *v-së*; e shprehja *votër*: *vatër* është fjalë vendi, e krahasueshme me të lat. *atrium*.

2. Prapashtesat

Që në hyrje të këtij kapitulli do të cekim se prapashtesat, për nga numri në gjuhën tonë zënë një vend shumë me të hapët, porse, nga ana e burimit, ato paraqiten në pjesën më të madhe të origjinës së huaj.

Po zëmë me prapashtesën *a*, që del rrallë në disa ndajfolje nga pjesoret e disa foljeve duke u kthyer *-ë-ja* fundore në *a*, bie fjala *fshehura* (fshehurë). *A-ja* prapashtesë duket analogjikisht në disa fjalë, siç janë këto: *brenda, mbrenda (brendë, mbrendë)*, *jashta, (jashtë)*, *përjashta; përjashtë, mbrama, mbramë*.

Prapashtesa *-ac*, – që në gjuhën shqipe ka hyrë prej serbo-kroatishes, ka më shumë kuptim pejorativ, fjala vjen: *burrac (burrë)*, *dorac (dorë)*, *gojac* (ai që i merret goja), *shurdhac, qyrrac, tullac, mërdhac* (mardhë, mërdhij), *përtac, qelbac*.

Kjo prapashtesë gjen përdorim të shpeshtë në një varg emrash me funksion të ndryshëm në serbokroatishte: *poklopac, gubavac, vrabac, rebac*. Siç dihet, kjo prapashtesë është përhapur kryesisht në të folmet gege, ndërsa në toskërishte e gjejmë formantin *-ec*, që do të ketë hyrë pa farë dyshimi nga maqedonishta e bullgarishtja.

Formantet *ac*, dhe *ec-*, që dalin në gjuhën shqipe, i pari në të folmet gege dhe i dyti në toskërishte, në gjuhën shqipe kanë hyrë prej sllavishtes,

njëri nga serbokroatishtja, duke zënë vend në ligjërimet gege, e tjetri në idiomat toske, me anë të bullgarishtes a maqedonishtes.

Prapashtesa *ac, ec* dalin nga rrënja *iči*; vokali neutral *a* i reduktuar i sllavishtes *ī, ū* në serbokroatishte u pasqyrua me *a*: në bullgarishte dhe maqedonishte reflektohet me *o, e*, bie fjala: *otīc, atac, atec; sŭpŭ: sop, bŭz: boz* (shtog). Shembujt që në gegërishte i gjejmë me refleksin *e* të sllavishtes *īū*: *stavilec, barrec, mistrec, kastravec, pijanec, kasnec, turrec*, nga toponimia: *Gradec, Denica, Sterbec, Buleca*, nuk mund ta kenë burimin në bullgarishte a maqedonishte, pse një kalim nga ato gjuhë nuk mund të përliqjet as historikisht; prapashtesa *ec*, e ligjërimeve gege shpjegohet krejt lehtë kur dihet që një *e* e çelët e të folmeve malazeze ishte përfutur nga vokalet neutrale *ī, ū* të sllavishtes, që në bullgarishte e maqedonishte pasqyroheshin me *e, o*. Mendimi që formanti në *fjalë (ec)* në dialektet gege të ketë ardhur nga ndikimi i maqedonishtes, nuk mund të qëndrojë.

Prapashtesa *-aj*, gjendet në emra fisesh: *Gjinaj, Zenelaj, Bardhaj, Dardhanj, Dedanj, Gjelij, Kolaj, Nikaj, Qosaj, Metaj, Bìcay, Gegaj, Vataj, Vuklekaj, Duçaj, Papdedaj, Kalovaçaj*. S'ka farë dyshimi që forma më e vjetër e këtij formanti del me *-anj* si ndër toskë, ashtu edhe ndër gegë; bie fjala: *Shkurtanj; Spatanj, Dimitranj, Bardhanj, Dedanj*, që ruhen në patroniminë e Shqipërisë Jugore, në atë Veriore, ndër patronime dhe toponime të shqiptarëve në Jugosllavi (I. Ajeti – *Istorijski razv. geg. govora Arbanasa kod Zadra*, Sarajevë 1961). Mosha e saj më e vjetër del edhe në formën *Pleqënia e shtëpisë Bogdananj* që duket në veprën e P. Bogdanit.

Origjinën e saj, N. Jokli e qet të dalë prej prapashtesës latine – *aneus, anius* (Jokl, *Zur Lehre von den alb. griech. Teilgleichungen*, Revu Internationale des Etudes Balkaniques, 1934/35, I-II, 61-62).

Formantin në fjalë e ndeshim në disa patronimika italiane: *Mascagni, Galvagni*.

Format ndajfoljore *kurraj, ngjetaj, njëditëzaj, njënatëzaj* janë sajime analogjike.

Formanti *-ajë (-aje)*, që fonetikisht i afrohet prapashtesës që posa u zu ngoje, u ngjitet emrave, të shumtën kolektive, e që në pjesen më të madhe kanë përdorim topik; fjala vjen: *dushkajë, fjerajë, bungajë, bishtajë,*

gurajë, lisanjë.

Është e vertetë se ky lloj emrash del në gegërishten veriore, në shqipen e Kosovës, e sa i përket mendimit se ata kanë zënë të dalin në idiomën e Mirëditës, ku *i*-ja e theksuar zakonisht në pozicion fundor, diftongohet me *ajë*, nuk duket krejt i mundur, për arsye se dukuria e diftongimit të vokalit *-i*, në rrethana të caktuara nuk i përfshin të folmet shqiptare të Kosovës, as idiomat shqipe të Malit të Zi.

Disa nga emrat e cekur më sipër, janë kolektivë: *grunajë, kurpnajë, lisanjë*. Fjala *murtajë* është huazuar nga latinishtja: *mortalia*. Ne disa shprehje të tjera, si *piptajë, tymtajë*, formanti *-ajë*, u bashkua me dentalin *-t*: fjalët *arnaje -t* dhe *lammaje -t*, që dalin me kuptim topik, janë shumësa të shprehjeve *arë, lamë*.

Përsa i përket burimit të formantit *-ak*, mendimet e dijetarëve – albanologë, janë të ndara; një palë sish (Meyer, Belic, e Selishev) e qesin të ardhur nga sllavishtja; një lagje tjetër e konsiderojnë me gurrë autoktone, thjesht shqipe, në një fjalë, siç është plak (Bariçi, Jokli); Buonamici dhe Trombetti shprehen për burim mesdhetar të kësaj prapashtese.

Prapashtesa *-ak* del mjaft produktive, e gjejmë të ngjitur te emra e mbiemra që u jep kuptime të ndryshme: *ftujak, bucak, rrethak, rosak, kodrak, pishak, çufrak, ferrak, trumcak, torak zborak* (zog këngëtar i rendit të Harabelave), *durrësak, romak,*

ulqinak; emra që dalin prej foljeve, që tregojnë frymorë, e gjësede: *dështak, dinak* (di), *lidhak* (lidh), *përshjtjellak, pjellak, tredhak*.

Një palë emrash të pajisura me formantin *-ak*, dalin me kuptim pejorativ, herë-herë edhe pa të: *burrak, cubak, fillak, motak, qyrrak, (qyrr), rrafshak, rrotullak, shtëpiak, veshtak, shurrak, vjeshtak, zemrak, sorrak*.

Nga kjo prapashtesë (*ak*) formohen emra femërore me anën e një *e*-je: *idhnake, gjunjake, dërmake*.

Formantet *-ar, -are* janë prapashtesa që i gjejmë në gjuhët ballkanike: në shqipe, në serbokroatishte, në bullgarishte, në maqedonishte, në rumanishte, në greqishten e re me funksione të ndryshme: *dhiar, dhenar* (dhen), *kopshtar, kumandar, kumerqar* (kumerq), *luftëtar, shtambar, shterpar, (shterpë), fshatar, katundar, kosovar, murgar, mungar, (murg,*

mung) gënjeshtar, kundërshtar, kuvendar, mujshar, qyqar,

Prapashtesa është bërë mjaft produktive në gjuhën tonë të shkrimit, gazetar, kopshtar, detar, etj.

Siç thamë këtë, prapashtesë e kanë, edhe gjuhët e tjera ballkanike: serbokroatishtja: *zidar, knjižar, kuvar, novinar, mlinar*; bullgar.: *knizar, nozar*; ruman.*albinar (bletar, albina), bucatar* (gjellëtar, *bucata*), *stirpar (shtërpar-sterpu)*; (maca e madhe), *ποδαποδ* (këmbë e madhe). Përsa i përket origjinës së prapashtesës në fjalë, mendimet e shumicës së dijetarëve e qesin të ardhur nga formanti latin *-arius*, që hyri e u përhap në të gjitha këto gjuhë ballkanike. Në anë tjetër, prapashtesën *-ar* e ndeshim edhe në ilirishte, që e gjejmë në një palë emrash e mbiemrash si: *Andarus, Langarus, Leucarus, Masarus*, „prandaj në shqipen mund të jetë përzier një formant vendi me një të ardhur prej latinishtes” (Çabej).

Prapashtesa *-as* që është mjaft e përhapur në gjuhën shqipe, del në këtë gjuhë shumë herët; u ngjitet fjalëve me funksion prejardhjeje – dhe etnikash (emrash banorësh); formon emra topikë dhe ndajfolje, për shembull: *vendas, i temalas, qytetas, i katundas, prishtinas, elbasanas, gjakovës, beratas, e Beratës, vendase vendës, tiranas, fytas, barkas, kapuças, guxhas, shortas, thias, huazas, çartas, djathtas, rishtas, anasjelltas, doradoras*.

Variante të kësaj prapashtese janë formantet *-az, -azë, -azi-, aza*; bie fjala: *djathazi, gjitsazi, poshtazi, brendazë, rishhazi, huaza, pshehaza*.

Kështu konsiderohen neologjizma këto fjalë: *haptas, shkurtas, shkurtazi*.

Formanti *-b (ë)*, që del në disa emra deverbativë, ka origjinë auto-ktone, dhe e gjejmë te fjalët: *shkelb, shqelm, shkelm, shtalb* (shtjell); e kemi te emrat denominative: *dhebë* (një farë toke), *zebë* (dhi me njolla të zeza), *vorbë* (sllav. *vreti, vár* = gëlqere). Nga mbiemrat me këte formant dalin: i ngjelbët (lat. *sal. salis*, sllav. *sol –sô*, i tharbët, që nuk është e pllëshme. Formantin *-b (ë)*, vise-vise e gjejmë të ndërruar me prapashtesën *-m*; *shkelb:shkelm, gjalbë: gjalmë, i ngjelbët: i ngjelmët, reshpe: reshme, i tharbët: tharm*.

Prapashtesa *-dhë* u ngjitet pak fjalëve, emrave femërorë: *zgurdhë-a* (fundi i zorrës së trashë); *shpardhë, shparr* (një lloj dushku me fletë të

gjëra) (Fjalori); *vadhë, vodhë* (= voesë). Origjinën e saj Jokli e afron te prapashtesa sllave *-da: pravda* (prav).

Prapashtesa *-ëshë*, që është mjaft e përhapur në të folmet e shqipes dhe në gjuhën e shkrimit, merr funksion nocioni: *turfulleshë, thineshë* (thi), *mbretneshë, kaurreshë, hyjneshë, mjekeshë*; një palë emrash të tjerë dalin me cilesi mashkulli: *trimneshë, burrneshë; hajneshë*; disa të tjerë tregojnë profesion të mashkullit: *çobaneshë, mungeshë, rrogteshë, bujkeshë, mjekeshë, rninistreshë*.

Te disa emra kjo prapashtesë i ngjitet shumësit, bie fjala: *mbretneshë, mbretëreshë* (*mbretën, mbretër*), *robëreshë* (*robër*), *priftneshë, prijtrëshë* (*prijtën, priftër*); të një lagje tjetër emrash formanti *-ëshë*, del i zgjeruar me konsonantin *n*: *n+ëshë* (*-neshë*). Burimi i saj qitet prej prapashtesës latine *-issa*, që e gjejmë edhe në greqishte.

Edhe formanti *-et* ka përdorim të gjerë në gjuhën shqipe, i cili që në fillim duhet të ketë hyrë bashkë me ndonje emër të burimit latin e të pajisur me sufiksin *-etum*, që pastaj shkoi e u përgjithësua.

Emrat me formantin sufiksial *-et* tregojnë zakonisht vend, janë toponime: *kaçubet, kallmet* (*kallm*), *kashnjet, Mëllet* (*mollë*), *Çërret* (*qerr, qarr*), *Shkorret* (*shkorre*), *shkozet* (*shkozë*), *shpërdhet* (*shpardh*).

Një palë emrash që në gjuhën shqipe dalin me sufiksin *-et*, kanë burim latin me formant *-ate*, që me të hyrë në gjuhën tonë *a*-në e kthyen në *e*, pra *-et*; fjala vjen: *shëndet, vullnet, vërtet, pushtet*. Disa fjalë që mbarojnë me *-et* dalin me gurrë turke: *kismet, dovlet, medet, siklet*.

Prapashtesa *-ë* që formohet thuaja vetëm nga foljet, del kryesisht te të folmet geqe, e shumë rrallë e gjejmë në ligjërime toske: *rrnojë, lojë, mardhë, pritë, veshë, mbathë, shtrojë, bulojë, sëmundë, dalë, plasë, srisë, kryelanë – krelanë, dekë, lânë, kullotë kullojë*; kjo prapashtesë në toskërishte i përgjigjet formantit *-je*: *veshje, vdekje, pritje, ikje*.

-Ë-ja fundore e gjuhës shqipe do të jetë përftuar prej një *a*-je të gjatë fundore, që perkah ana morfologjike piqet me formën e shkurtër të pjesorës së gjuhës shqipe: *dekë – dekë; kam sjellë-sjellë – a; jam veshë: vesh-a; kam pritë – pritë-a*.

Tipat e formanteve *-i* që dalin në gjuhën tonë, kanë burim të

ndryshëm, prandaj çdonjëra prapashtesë do shtjellim të posaçëm.

Një *-i* prapashtesë që formon një palë emrash abstraktë e kolektivë të gjinisë femërore, e gjejmë te një lagje emrash, siç janë: *blegtori, kopili, amështi, amulli, begati, pasuri, pari, urti, çudi, mahi, mbledhi, dëshmi, dredhi, lakmi, mërzi, thërmi, acari*; disa emra me formantin *-i* janë sajuar prej shumësit, bie fjala: *priftën, priftëni, priftër – priftëri; vëllazën-vëllezër – vëllazëri; kunetën – kuneti*.

Prapashtesa *-i* e kësaj palë emrash ka burim indoevropian dhe do qitur prej bazës *-ija*, që u reduktua në trajtën e sotme: *-i*.

Tjetër burim ka prapashtesa e një lagjeje tjetër emrash, për shembull: *veri, njeri, kalli, i-ja* e gjatë e te cilëve u përfutua me shpërngulje të theksit në *-i* fundore që dalin me nyjën e prapme *-u*: *ari-u, kalli-kalliu, njeri-njeriu, veri-veriu*.

Prapashtesa *-im*, shumë e përhapur në gjuhën e popullit dhe në atë të shkrimt, formohet nga foljet, me *-oj- uaj (uej)-, ej* dhe gjinikon emra veprimi, d.m.th. emra të tillë që kallëzojnë veprim, ose rezultatit e tij: *këndim, kallëzim, mbulim, ngushllim, rrënim, qëndrim, mendim, pagim*.

Kjo prapashtesë formon emra me kuptim kolektiv: *granim, njerëzim, parësim, shterpënim, vogjëlim*.

Sa i përket etimologjisë së prapashtesës në studim, mendimet e dijetarëve janë të ndara, një palë, si G. Meyeri dhe Meyer-Lübke e bien të ardhur prej të latinishtes *-imens*, ndërsa Pedersenit e qet të dalë me burim autokton dhe e përqsas te greqishtja *-mos*. Sipas një mendimi tjetër etimologjia e prapashtesës në fjalë do qitur prej participit të shqipes me anë të zhvillimit të brendshëm të saj.

Duke lënë pa prekur shumë prapashtesa të tjera, po rrokim disa sosh rrëshqitthi, bie fjala *-osh – oshe*; që u ngjiten emrave e mbiemrave dhe u japin atyre kuptim pejorativ: *djalosh, mërkosh djalë, mër-k, osh*); *mandej balosh, qyrrosh, vetullosh, vogëlosh, ziosh, bukurosh*: prapashtesa *-osh, (oshe)* mund të ndërrohet me formante të tjera, siç janë: *-ash, dhe-ok, -ush*; bie fjala: *balosh: balash; bardhosh: bardhash; bardhush: bardhok; larash: larosh larush*.

Prapashtesën *-osh* e gjejmë edhe te një tubë emra personash, fa-

miljesh dhe toponimesh: *gjelosh, kalosh, metosh, lepurosh* (*Prapashtesat e gjuhës shqipe*, Xhuvani – Çabej). Prapashtesa *-osh* del edhe në serbokroatishte, siç tregojnë fjalët e personave: *Miloš (milo), Dragoš (drag, drago), Mugoš, Mogoš*. Linguistët rumunë prapashtesat *-ush*, e *-osh*, që janë në përdorim në shqipe e rumanishte, i gjejnë të burimit trakas.

Prapashtesa-*të* është shumë e përhapur në gjuhën shqipe dhe del produktive edhe sot e gjithë ditën: e ndeshim te një lloj emrash, siç janë: *ditë, dritë, botë, det*; mandej e gjejmë me të madhe ndër mbiemra që dalin prej emrash: *dhi – i dhintë, i dhirtë, lëkurë – i lëkurtë; grunë – i gruntë, i grunjtë – grytë, ram – i ramtë; u-ni (u-nia- në Jabllanicë) – i unët, i urët (i uritur)*. Një palë mbiemrash pajisur me prapashtesën *-të*, ka dalë prej foljesh: *i ngathët (ngath), i shkathët, i thatë, i ngordhët, i përlyet*.

1, 229; *kamaleshi; kamamadhi; Qimekeqi, Qimetraşi, Bukadjathi; Gruomirë; Bukëmirë; Gunëzi, Goliamadi = Golamadhi - Gojëmadhi; Mishabardhi* (cituar sipas *Povijest Sjevernih Arbanasa*, Arhiv, II (1924), f. 28, dhe mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe të Androkli Kostallarit, Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, 1961/3.

Qysh në ballë të këtij shtjellimi thamë se albanistët, pionierët e parë të studimeve albanologjike kishin shprehur dyshim për mundësinë e pasurimit të gjuhës sonë me anë të kompozitave, prandaj, të shumtën, ata s'i kishin prekur ato në studimet e tyre albanologjike. F. Boppi, bie fjala nuk i zë ngoje kompozitat e shqipes në studimin e tij – *Über des Albanesische in seinen verwandtshaftlichen Beziehungen*, edhe pse ky dijetar në veprën e përmendur s'kishte lënë pa rrokur disa probleme gramatikore nga fusha e verbave dhe prej disa lëmenjve të tjerë të gjuhës sonë. Nuk është çudi që qëndrimi i këtij dijetari ndaj kompozitave të gjuhës shqipe nuk mbet pa ushtruar ndikim në albanologë të tjerë, kundrejt kësaj pike të gramatikës së gjuhës sonë.

Kjo pikëpamje aprioristike mbi varfërinë gjoja të gjuhës shqipe në kompozita, d.m.th. në krijimin e kompozitave, duket edhe te albanologë të tjerë të mëvonë: Hahn, Kamarda, Dozon, Weigand me çka dëshmojnë mosnjohjen e begatisë leksikore të gjuhës sonë në punën e farkimit të kompozitave.

Arsyet e qëndrimit aprioristik skeptik të albanologëve mbi mundë-

sinë e pakë të formësimit të gjuhës shqipe, duhet të kërkojen në njohjen e mangët të shqipes nga ana e hulumtuesve të kompozitave – të kësaj gjuhe, përndryshe nuk dimë se si mund të shpjegohet fakti që përfillja e shembujve sjellë prej Hahnit në fjalorin e tij (*Beiträge zu einer Grammatik des toskischen Dialektes – Albanesishe Studien*, Jena, 1854, Heft II. f. 45), siç janë: *derë barth*; *derë-zi*; *kokë-lesh*; *kokë-rogje* që flasin në të mirë të ekzistimit të kompozitave në gjuhën shqipe.

Në fushën e kompozitave nuk janë të gjitha fjalët e përbëra kompozita të përfunduara; për t'u bërë kompozita të mirëfillta, fjalët e bashkuara do të kalojnë nëpër disa faza: një lagje fjalësh të bashkuara, siç janë *vojguri*, *vajguri*, *gurkali*, *fletënderi*, *panxharsheqeri*, *qymyrguri*, janë fjalë të bashkëngjitura që i cilësojnë togfjalëshat: emërore ose kallëzore+ rrjedhore e njëjst; kompozitat e gjuhës shqipe dalin kësisoji: *vendbanim*, *datë-lindje*, *ditë-lindje*, *pikënisje*, *vendlindje*, *bregdet*, *buzëdet*, *vendstrehim*, *vend-qëndrim*.

Lidhja e kompozitave bëhet në atë mënyrë që komponentët formësues kanë një theks të vetëm dhe ato kanë një karakter homogjen nga përmbajtja e tyre leksiko-gramatikore, ndërsa te fjalët e bashkëngjitura bashkimi i komponenteve formësuese ka karakter heterogjen.

Komponentet e kompozitave që dalin në etapat më të vjetra të zhvillimit të gjuhës sonë, lidhen, siç dihet, me anë të zanoreve 1, 229; *kamaleshi*; *kamamadhi*; *Qimekeqi*, *Qimetrashi*, *Bukadjathi*; *Gruomirë*; *Bukëmirë*; *Gunëzi*, *Goliamadi* = *Golamadhi* - *Gojë-madhi*; *Mishabardhi* (cituar sipas *Povijest Sjevernih Arbanasa*, Arhiv, II (1924), f. 28, dhe mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe të Androkli Kostallarit, Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, 1961/3.

Qysh në ballë të këtij shtjellimi thamë se albanistët, pionierët e parë të studimeve albanologjike kishin shprehur dyshim për mundësinë e pasurimit të gjuhës sonë me anë të kompozitave, prandaj, të shumtën, ata s'i kishin prekur ato në studimet e tyre albanologjike. F. Boppi, bie fjala nuk i zë ngoje kompozitat e shqipes në studimin e tij – *Über des Albanesische in seinen verwandtschaftlichen Beziehungen*, edhe pse ky dijetar në veprën e përmendur s'kishte lënë pa rrokur disa probleme gramatikore nga fusha e verbave dhe prej disa lëmenjve të tjerë të gjuhës sonë. Nuk është

çudi që qëndrimi i këtij dietari ndaj kompozitave të gjuhës shqipe nuk mbet pa ushtruar ndikim në albanologë të tjerë, kundrejt kësaj pike të gramatikës së gjuhës sonë.

Kjo pikëpamje aprioristike mbi varfërinë gjoja të gjuhës shqipe në kompozita, d.m.th. në krijimin e kompozitave, duket edhe te albanologë të tjerë të mëvonë: Hahn, Kamarda, Dozon, Weigand me çka dëshmojnë mosnjohjen e begatisë leksikore të gjuhës sonë në punën e farkimit të kompozitave.

Arsyet e qëndrimit aprioristik skeptik të albanologëve mbi mundësinë e pakë të formësimit të gjuhës shqipe, duhet të kërkojnë në njohjen e mangët të shqipes nga ana e hulumtuesve të kompozitave – të kësaj gjuhe, përndryshe nuk dimë se si mund të shpjegohet fakti që përfillja e shembujve sjellë prej Hahnit në fjalorin e tij (*Beiträge zu einer Grammatik des toskischen Dialektes – Albanesishe Studien*, Jena, 1854, Heft II. f. 45), siç janë: *derë barth*; *derë-zi*; *kokë-lesh*; *kokë-rogje* që flasin në të mirë të ekzistimit të kompozitave në gjuhën shqipe.

Në fushën e kompozitave nuk janë të gjitha fjalët e përbëra kompozita të përfunduara; për t'u bërë kompozita të mirëfillta, fjalët e bashkuara do të kalojnë nëpër disa faza: një lagje fjalësh të bashkuara, siç janë *vojguri*, *vajguri*, *gurkali*, *fletënderi*, *panxharsheqeri*, *qymyrguri*, janë fjalë të bashkangjitura që i cilësojnë togfjalëshat: emërore ose kallëzore+ rjedhore e njëjstit; kompozitat e gjuhës shqipe dalin kësajsoj: *vendbanim*, *datëlindje*, *ditëlindje*, *pikënisje*, *vendlindje*, *bregdet*, *buzëdet*, *vendstrehim*, *vendqëndrim*.

Lidhja e kompozitave bëhet në atë mënyrë që komponentët formësues kanë një theks të vetëm dhe ato kanë një karakter homogjen nga përmbajtja e tyre leksiko-gramatikore, ndërsa te fjalët e bashkëngjitura bashkimi i komponenteve formësuese ka karakter heterogjen.

Komponentet e kompozitave që dalin në etapat më të vjetra të zhvillimit të gjuhës sonë, lidhen, siç dihet, me anë të zanoreve apo të komponentit të parë: *dashamirë*, *djegagur*, *hjekakeq*, *puthador*, *mollakuq*, *ndjellamirë*, *rrahaderë*, *bjerrafat*, *tudabisht*, *krymbalesh*, *kambadoras*, që sot, zakonisht, nuk janë më pjellore.

Lidhja e bashkimi i komponenteve të fjalëve në kompozita, bëhej,

siç u zu ngoje pak më parë, me anë te zanoreve lidhëse. E sot shumica e kompozitave të gjuhës shqipe formohen pa zanore si element lidhës.

Sa i përket burimit të elementeve vokalike që lidhin dy komponentet e kompozitave, mund te themi që *o*-ja do të jetë prodhim i ndikimit nga gjuhë të huaja, kompozitat e të cilave formohen me anë të zanores *o*, bie fjala, të italishtes, frengjishtes: *il patto franco – italiano: frengj* „le nom indoeuropien”, E ashtuquajtura lidhëse *a* „e cila historikisht në gjuhën tonë e ka burimin tek zanorja fundore e komponentit të parë, e bën kompozimin më të qartë dhe shqiptimin më të lehtë”. (A. Kostallari, *Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe*, f. 15); zanorja lidhëse *a*, nuk del vokal fundor a mbaresë rasore, pse *a*-ja fundore e komponentit të parë të kompozitave, nuk pajton me mbaresën rasore njëjës a shumës.

LITERATURA E PËRDORUR NË HARTIMIN E KËSAJ VEPRE

- Franz Bopp, Über das Albanesische in seinen verwandtschaftlichen Beziehungen, 1955.
 Gustav Meyer, Kurzgefasste albanische Grammatik, 1888; Albanische Studien, III.
 H. Barić, Hymje në historinë e gjuhës shqipe, Prishtinë, 1955 (edicioni serbokroatisht: Istorija arbanaškog jezika Sarajevo, 1959.
 La perte de l'infinifit dans les langues balkaniques.
 Godišnjak Balkanološkog instituta Sarajevo, 1961,
 Gjergj Pekmezi, Grammatik der albanesischen Sprache, Vjenë, 1908.
 Lecce Francesco Maria, Osservazioni grammaticali nella lingua albanese, Romë 1716.
 Anton Xanoni, Gramatika shqyp, 1909,
 Haebler Claus, Grammatik der albanischen Mundart von Salamis Wiesbaden, 1965.
 E. Çabej, Hyrje në historinë e gjuhës shqipe, – Fonetika historike e shqipes, Tiranë 1961.
 Xhuvani-Çabej, Parashtesat e gjuhës shqipe, Buletin 1956/4; Prapashtesat e gjuhës shqipe, Tiranë, 1962.
 Lingua Posnaniensis, VII-VIII.
 E. Çabej, Shumësi i singularizuar në gjuhën shqipe, Tiranë, 1967, N. Jokl, Zur Geschichte des albanischen Diphthongs *ua, ue* Indogerm, Forschungen, 49 -50,(1913-1932).
 M. Camaj, Albanische Wortbildung, Wiesbaden, 1966.
 II Missale di Gjon Buzuku, Roma, 1958.
 Vitore Pisani, Glottologia indoeuropea, Torino, 1961.
 Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Tiranë, 1959/3.
 Hans Krahe, Indogermanische Sprachwissenschaft, I-II, Walter de Gruyter et Co, Berlin, 1958/1959.
 A. Xhuvani, L'infinifit en albanais, Lingua Posnaniensis, VIII (1960), 66-70.
 M. Pavlović, La perte de l'infinifit dans les langues balkaniques, Zbornik za lingvistiku i flologiju, N. Sad, 1960 (35-45).
 Arhiv za arbanasku starinu, jezik i etnologiju, Bgd. 1923-1926.
 A. Belić, O jezičkoj prirodi i jezičkom razvitku, Bgd. 1959.
 Ivan Popović, Geschichte der serbokroatischen Sprache, Otto Harrassowitz, Wiesbaden, 1960.
 Wifried Fiedler, Untersuchungen zur Pluralbildung im Albanischen (Dissertation, 1961).
 Zur Genus im Albanischen, Beiträge zur Sprachwissenschaft, Volkskunde und Literaturforschung Akademie – Verlag, Berlin, 1965.
 Tradizioni popolari degli Albanesi d'Italia (Istituto di Studi Albanesi Facolta di Lettere e filosofia. Università di Roma 1962).
 Shaban Demiraj, Morfologjia e gjuhës shqipe, I, Tiranë, 1961 (Dispensë). Rreth ndërrimit të gjinisë së emrave shumë në shqipe, Studime filol. 1966/4 Fjalori i Bashkimit, Shkodër, 1908.
 Gustav Weigand, Albanisch-deutsches und deutsch-albanisches Wörterbuch, Leipzig, 1914.
 Albanische Grammatik im südgegischen Dialekt, Leipzig, 1913.
 Fjalor shqip-greqisht i Kristoforidhit, transkribuar e përpunuar prej prof. Aleksandër Xhuvanit, Tiranë 1961.
 Fjalor i gjuhës shqipe, Tiranë, 1954.
 Fjalor i fjalëve të rralla i Gazullit, Tiranë, 1942.
 Fjalor i fjalëve të rralla i Gazullit, Tiranë, 1942.
 St. Mann, Historical Albanian english dictionary, Londër, 1948.

- Dictionarium latino-epiroticum, Roma, 1635 i Frang Bardhit.
- Idriz Ajeti, Istorijški razvitak gegijskog govora Arbanasa kod Zadra, Sarajevo, 1961.
- Gjurmime Albanologjike, Prishtinë, 1962, 1965, 1966;
- I. Ajeti, Pamje historike e ligjëritit shqipe te Gjakovës në fillim të shekullit XIX, Prishtinë, 1960.
- P. Skok, Considérations générales sur la déclinaison nominale ruomaino-albanaise, Barić – Arhiv. III.
- Holger Pedersen, Kontribut për historinë e gjuhës shqipe, Buletin i Universitetit të Tiranës, 1959.
- Albanische Texte mit Glossar, Leipzig, 1895.
- Les pronoms démonstratifs de l'ancien arménien (Les pronoms albanais, 13-14) Kopenhagen, 1905).
- Sheperi Dilo, Gramatika dhe sintaksa e gjuhës shqipe, Vlorë, 1927.
- Ndre Mjeda, Vrejte mbi artikuj e përemna pronës të gjuhës shqipe, Shkoder, 1934.
- S. Riza, Diftorët e shqipes dhe historiati i tyre, Prishtinë, 1953.
- Ponorët e shqipes, Buletin, 1959/2, 3; 1960/3.
- Buletin i Universitetit të Tiranës, 1958/3 (– Desnickaja: Mbi strukturën morfologjike të gjuhës shqipe).
- Mahir Domi, Morfologjia historike e gjuhës shqipe, Tiranë, 1961.
- O, Hujer, Uvod u istoriju slovenskih jezika, Beograd, 1935.
- André Vaillant, Grammaire comparée des langues slaves, I. II Flection nominale, Paris, 1959.
- S. Riza, Tri Monografina albanologjike, Tiranë, 1944.
- Emrat në shqipe: sistemi i rasavet dhe tipet e lakimit, Tiranë, 1965,
- Sandfeld Jensen, Linguistique balkanique, Problèmes et résultats, Paris, 1930
Jahresbericht des Instituts für rumänische Sprache, IX.
- Franjo Miklošić, Die slavischen Elemente im rumänischen Sprache, Denkschriften der Wiener Akade. der Wissenschaften, Phil. hist. Cl. XII. Norbert Jokl (Litteris, IV).
- C. H. Th. Reinhold, Noctes pelasgica vel symholae ad cognoscentes dialectos graeciae pelasgicas collatae, Athenis, 1855.
- G. Weigand, Das Albanesische in Attika, Balkan-Archiv, II, Leipzig, 1926.
- E. F. Hamp, On the Arvanitika Dialects of Attika and the Megarid Balkansko ezikoznanie, III, Sofje, 1961.
- Alois Schmaus, Beobachtung zu Bedeutung und Gebrauch des Albanischen Admiratives – Beiträge für Südosteuropa – Forschung, München, 1966.
- Blaže Koneski, Istorija na makedonskiot jazik, Skopje, 1965.

VËSHTRIM I SHKURTËR I PUNËS NË STUDIMET ETIMOLOGJIKE TË GJUHËS SHQIPE

Zhvillimi i gjuhësisë shqiptare a i albanistikës, marrë në kuptim të gjerë, duhet projektuar në dy fusha të kundërta vepruese: në njërin anë qëndron ajo vendëse-gjuhësia shqiptare me traditë treqindvjeçare në burimet e së cilës është fjalori latinisht-shqip i zadrimit Fran Bardhi.

Gjuhësia shqiptare e cila u gjallërua veçanërisht në gjysmën e dytë të shek. XIX, - deri në mbarim të Luftës së fundit nuk tregoi interesim për çështje me rëndësi të gjuhësisë krahasimtare. Ajo u ishte kthyer çështjeve praktike të problemeve gjuhësore aktuale, veçanërisht çështjes së krijimit të gjuhës letrare shqipe, duke i kushtuar kujdes të veçantë sigurimit të teksteve shkollore: gramatikave, fjalorëve dhe doracakëve të gjuhës shqipe të asaj kohe; por në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar, u shquan një varg veprimtarësh në fushën e kulturës, si Konstandin Kristoforidhi, Sami Frashëri, Jeronim De Rada, Dhimitër Kamarda etj., veprat e të cilëve përqendrojnë në themelet e gjuhësisë shqiptare – albanistikës. Konstandin Kristoforidhi, në Fjalorin e tij të gjuhës shqipe, të shpjeguar me greqishten e re (i botuar pas vdekjes së autorit në Athinë më 1904), fjalët e përfshira në të i shqyrtoi dhe i shoshiti edhe nga aspekti historik a nga pikëpamja etimologjike. Një kapitull të vogël të këtij fjalori e përbëjnë huazimet sllave të gjuhës shqipe. Në vështrimin e tij për fjalorin e Kristoforidhit, veçanërisht për interpretimet e tij etimologjike, prof. Eqrem Çabej thotë se etimologjitë e Kristoforidhit në një pjesë të mirë janë të pakontestueshme (të bindshme). Linguistin arbëresh Dhimitër Kamaradën e shquan talenti i rrallë dhe prirja për kombinime, porse i mungonte prirja për të dalluar dhe veçuar fondin e leksikut autokton nga pasuria leksikore e huazuar. Në fillim të shekullit tonë në punën rreth studimit të albanistikës në radhët e shqiptarëve të Italisë atë e zëvendësoi arbëreshi Mark La Piana. Vlera e

veprës së tij shkencore qëndron më tepër në vëzhgimet e reja në fushën e morfologjisë historike, që shënojnë një përparim të rëndësishëm në studimet albanistike. Marko La Piana ka lënë në dorëshkrim një gramatikë historike dhe një fjalor etimologjik të gjuhës shqipe.

Në studimet albanistike, veprën e Kristoforidhit në mënyrë të denjë e vazhdon studiuesi i pasionuar A. Xhuvani: atë shpeshherë e tërhiqnin çështjet e etimologjisë. Siç pohon me të drejtë prof. Çabej: “Mund të thuhet se me Xhuvanin fillon puna në studimet etimologjike nga shkencëtarët shqiptarë”. Nëse i kemi kuptuar mirë fjalët e prof. Çabejt, ai do të thoshte se studimet etimologjike në radhën e shkencëtarëve shqiptarë vetëm sa kishin dalë nga rrethi i diletantizmit. Në të vërtetë, Aleksandër Xhuvani, si njohës i mirë i dialekteve të gjuhës shqipe, jo rrallë, ka mundur në mënyrë intuitive dhe t’ia qëllojë ndonjë etimologjie.

Në anën tjetër qëndron albanologjia a albanistika e huaj, fillet e së cilës i hetojmë në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar, themelues i saj është - së paku sa i përket veprimtarisë së saj të ngushtë linguistike, krijuesi i linguistikës krahasuese evropiane, gjermani Franc Boppi. Pas punimeve të Franc Mikloshiçit, të përqendruara kryesisht në fushën e leksikut të gjuhës shqipe, studimet albanologjike i mori përsipër prof. i linguistikës komparative indoevropiane në Universitetin e Gracit Gustaf Meyer, me emrin e të cilit janë të lidhura aq shumë nisma në hulumtimin e strukturës së gjuhës shqipe. Fjalori i tij etimologjik i gjuhës shqipe (1891), edhe se në shumë vise i vjetruar, mbetet vepër monumentale në fushën e studimit të historisë së gjuhës shqipe. Në hulumtimin e studimeve etimologjike të gjuhës shqipe vetëm me Mejerin sistematik niset në një rrugë të re. Ky punonjës shkencor në një farë dore është figura qëndrore në organizimin e gjithë punës rreth studimeve etimologjike të gjuhës shqipe. Është merita e këtij zelltari që studimet etimologjike të gjuhës shqipe u nisën në rrugën në të cilën shkojnë edhe studimet e gjuhëve të tjera indoevropiane. Megjithatë, fjalori i tij i lartpërmendur, i cili paraqet një vepër sintetike dhe përfshin krejt ç’është arritur në fushën e leksikut historik edhe për kohën e botimit vuante nga mangësi të ndjeshme metodologjike. Lënda e tij

leksikore ishte mbledhur në trevat e diasporës italo-shqiptare dhe të kolonive arbëreshe të Greqisë, në të cilat fondi i trashëguar gjuhësor ishte rralluar dukshëm dhe zëvendësuar me italianizma dhe greqizma, të hyra nga të folmet italiane dhe greke të Italisë Jugore dhe Greqisë. Duhet të mbahet parasysh edhe fakti se shumica e albanologëve në studimet albanologjike kishte shkuar përmes studimeve sllavistike, apo romanistike, dua të them, indoevropiane. “Kjo rrethanë është shprehur negativisht në studimet etimologjike të gjuhës shqipe, ngase roli i huazimeve në strukturën e saj leksikore është mbiçmuar tej çdo mase”. (A. Kostallari, *Konferenca e studimeve albanologjike*, nëntor 1962). Studimet etimologjike të gjuhës shqipe të asaj kohe kanë pasur edhe mangësi të tjera etimologjike.

Me këtë rast nuk mund të lihet anash bardi i studimeve albanologjike, indoevropianisti, keltisti dhe albanologu Holger Pedersen. Në studimin e problemeve gjuhësore ai ka hapur shtigje krejtësisht të reja, duke prerë rrugët tradicionale metodologjike të gjeneratës së mëparshme të albanologëve. Duke mos lënë pas dore arritjet shkencore të fonetikës historike të gjuhës shqipe, në të cilat ka edhe risime, ai ka vërtetuar ekzistencën e dy tipave të tingullit /në gjuhën shqipe; shumëçka ka korrigjuar nga pikëpamjet shkencore të Meyerit rreth çështjes së grykoreve indoevropiane dhe zëvendësimeve të tyre në shqipen. Veprimtarinë e vet shkencore Pedersoni e përqendronte në historinë e brendshme të gjuhës shqipe, në studimin e strukturës së saj morfologjike: formimi i nyjës së përparme dhe asaj tësë prapmës në gjuhën shqipe, çështja e përemrave pronorë etj. Në këtë fushë puna e tij çmohet si cilësi, por mbetet dukshëm prapa sa i përket çështjes së sasisë. Është dëm i madh që në hulumtimin e problemeve albanologjike, Pedersen u largua që herët, por pasi kishte zbërthyer (zgjidhur) çështjet kyç, të cilat punonjësve shkencorë të asaj kohe u shkaktonte vështirësi të shënueshme.

Anëtari i tretë i trinomit të njohur (Meyer-Pedersen-Jokl) është albanologu i njohur vjenez Norbert Jokl. Veprimtaria shkencore e tij përfshin një spektër të gjerë të degëve shkencore albanologjike, në të cilat, duke shkuar pas Pedersenit, ka shpënë përpara bazën e tij hulumtuese e

shkencore, dhe ka arritur kështu rezultate të pakontestueshme në shumë disiplina të gjuhës shqipe. Pasi erdhi e u përqendrua njëherë e mirë në studimin e gjuhës shqipe, nuk u largua më kurrë, duke bërë kështu karrierë të qëndrueshme të profesorit universitar dhe të shkencëtarit të çmuar në fushën e studimeve albanologjike. Në fushën e hulumtimeve etimologjike ka shfrytëzuar jo vetëm dëshmitë gjuhësore po edhe të dhëna të kulturës materiale duke u mbështetur në metodën: “Wörter und Sachen”, Jokli zbatoi këtë metodë që nga hapat e parë të veprimtarisë shkencore në fushën e studimeve albanologjike.

Në gjysmën e parë të këtij shekulli në studimin e historisë së gjuhës shqipe u shquan edhe linguistët jugosllavë: Petar Skok, Karel Oshtir e Henrik **Bariq**; dy të fundit janë marrë me analizën etimologjike të pjesës (elementeve) indoevropiane në leksikonin e shqipes; Oštiri është marrë me hulumtimin e relikteve mesdhetare në gjuhën shqipe (*Alarodische Sprachwissenschaft*, Vjenë, 1921; Arhiv za arbanašku starinu, jezik i etnologiju, Beograd, 1923-26); **Bariqi** vërteton periudhat e ndikimit të latinitetit ballkanik në gjuhën shqipe (*Albanorumnische Studien*, 1919, Arhiv, 1923-26; *O uzajamnim odnosima balkanskih jezika*, Beograd, 1937, *Lingvističke studije*, Sarajevo, 1954; *Ilirske jezične studije*, Rad, 272, Zagreb, 1948; *Ime reke Bojane*, *Slavistična revija*, Lubjanë, 1950); *Hymje në Historinë e gjuhës shqipe*, 1955, *Istorija arbanaškog jezika*, Sarajevo, 1959.

Që të dy këta linguistë jugosllavë janë ihtarë ortodoksë të metodës shkencore të neogramaticienëve. Oštiri “zbuloi” një numër të madh të inventarit leksikor mesdhetar në shqipen. Sa i përket pranisë së substratit mesdhetar në shqipen, rezultatet e tij janë pritur me rezervë nga ana e studiuesve albanologë.

Merita e **Bariqit**, veç tjerash, është se ai në shqyrtimin e thesarit leksikor të gjuhës shqipe, avancoi edhe studimet që kanë synuar që në mënyrë sa më besnike edhe sa më objektive t’i veçojnë elementet indoevropiane nga fondi leksikor i huazuar. Sa i përket metodës së tij shkencore linguisti italian Vittore Pisani (1962) thotë: “...La dernière synthèse sur ce sujet est, si je ne me trompe pas, l’intéressante brochure du feu

Henrik Barić (*Istorija arbanasčkog jezika*, Sarajevo, 1959), laquelle répond, fidèlement aux principes informateurs du dit répertoire, selon lesquels une langue est quelque chose qui reste essentiellement identique à soi même telle qu'elle est née, c'est – à dire au moment de son enfantement par une langue mère..." ((*Studia albanica*, I, 1964).

Romanisti e ballkanologu P. Skok në fondin leksikor të shqipes kryesisht ka studiuar ndikimin e latinitetit ballkanik; është marrë me toponimet në vendet jugosllave; duke i prekur disa toponime në Shqipëri, si Shkodër, Bunë e Durrës, në format e sotme fonetike nuk shihet ndërmjetësimin e shqipes në kalimin e tyre nga forma lashtërishte në shqiptimin e sotëm. Edhe se në shoshitjen e lëndës leksikore të gjuhës shqipe fjalori i Skokut shënon përparim të dukshëm që është në qarqet shkencore të vendit dhe në saje të entuziastëve të rrallë, studimet etimologjike të gjuhës shqipe mbeten prapa, në shkallën e njohurive të paralulftës në këtë degë të linguistikës, pa përtëritje të reja e pa përvetësimin e metodave, bashkëkohore gjuhësore. Një pjesë e fondit leksikor të gjuhës shqipe i cili, i përpunuar në këtë fjalor, ka përdorim lokal, për prejardhjen jo shqiptre të të cilit autori në të shumtën e rasteve angazhohet pa pasur mbështetje të forta.

Me punën e tij aktive në studimin e çështjeve të shumta në degë të ndryshme të linguistikës shqiptare, Skoku zë një vend me rëndësi në historinë e albanistikës, prandaj është e pakuptueshme që në punimet e tij hasim edhe qëndrime që u bien ndesh edhe vetë bindjeve të tij personale dhe mendimeve të qëndrueshme në shkencën e gjuhësisë. Në të vërtetë, te Skoku ndeshim edhe një gjykim si ky për prejardhjen e shqiptarëve dhe të gjuhës së tyre: "Popujt e tjerë të Ballkanit cincarët, shqiptarët dhe grekët e rinj, nuk njohin fare si huazime fjalët "*Zhuban as Zhupani*". Dhe ky fakt negativ mund të shpjegohet. Rumunët ballkanikë mesjetarë, nga të cilët rrjedhin cincarët e shqiptarët, kanë jetuar në katundet e tyre lëvizëse si blegtorë nomadë, duke u mbartur me bagëtinë nga venddimërimet në vendverime ("Petar Skok, *O etimologjskom rječniku hrvatskog ili srpskog jezika*, "Filologija", I f. 17, Zagreb, 1957). Edhe nëse Skoku ka pasur bindje

të tillë është dëm që këtë nuk e ka dëshmuar me argumente.

Se ç'vend zë linguistika italiane në studimin e çështjeve albanologjike, do ta tregojë mendimi i linguistit italian dhe albanologut Karlo Tagliavini në *La stratificazione del lessico albanese*, Bolonjë, 1965 f. 40.

“L’Italia, che pure vanta meriti insigni per la indagine scientifica dell’Albania e conta anche fra i viventi degli albanologi di alto valore, come Antonio Baldacci, geografo e naturalista, nel campo della linguistica albanese non ha avuto dei nomi tali da poter opporrai tedeschi e agli slavi; i nostri linguisti, che si sono occupati di albanese, lo hanno fatto più che altro in margine ad altre occupazioni (Ascoli, Bartoli, ecc.) e fra gli italo-albanesi, che sono italiani per cultura, tradizione e appartenenza politica, come linguisti si può citare solo il nome del Camarda. Anche chi vi parla è giunto all’albanese in seguito ai suoi studi di linguistica rumena e balcanica comparata; in un primo tempo l’Albanese ha rappresentato solamente un’occupazione marginale nel più vasto ambito della linguistica balcanica”.

Duke mos i lënë anash studimet ballkanologjike dhe studimet e linguistikës së përgjithshme dhe asaj indoevropiane, Tagliavini, në vitet e tridhjeta të shekullit tonë, në mënyrë aktive, është marrë edhe me çështje albanologjike. Vepra e tij kryesore nga fusha e studimeve etimologjike të gjuhës shqipe siç e cilëson edhe albanologu austriak Norbert Jokli, paraqet: “Eine treffliche Dialektmonographie, die aber insbesondere durch ihren Hauptteil, das etymologische Wörterbuch, auch über einen engerem Bereich der Mundartkunde hinaus, jedem dem sprachwissenschaftliche albanische Studien am Herzen liegen, reiche Belehrung bietet”, pastaj “Eine Art Kanon und Vademecum der alb.Etymologie”, *Zur Erforschung der albanischen Mundart von Borgo Erisso in Dalmatien, in Archivum Romanicum*, vol. XXIV (1940).

Tagliavini nuk ndërpreu kurrë lidhjen me çështjet e disiplinave gjuhësore të gjuhës shqipe. Vitet e dyzeta të shekullit tonë (1942), pasi mblodhi lëndë të pasur dialektologjike, botoi studimin e gjerë: “Le parlate albanesi di tipo ghego orientale”; me studimet albanologjike me gjasë u përshëndet kur botoi librin: *La stratificazione del lessico albanese*,

Bolonjë. Tagliavini ishte punëtor i vyeshëm shkencor, çdo punim i tij shquhet me të dhëna të gjera, por edhe asosh të imëta, gjë që mundëson shqyrtim të sigurt të temës në tërësinë e saj dhe zgjidhje të çështjes në vështrim. Në albanistikë Tagliavini la gjurmë të shënueshme me vlerë të pakrahasueshme dhe të përherëshme; një numër jo i vogël i eitmologjive të tij të trajtuara kanë gjetur zgjidhje, prandaj nuk ka nevojë t'u kthehemi, kjo vlen veçanërisht për venecianizmat e pranishme në gjuhën shqipe. Profesor në univeristetin e Padovës, Karlo Tagliavini në thelb është neogramaticien: në trajtimin e leksikut në hulumtimin e prejardhjes së fjalëve të caktuara, kryesisht mbështetet te albanologët më të shquar, te Pedersenin dhe Jokli.

Në një vështrim të shkurtër të punës së linguistëve në studimet albanologjike në fushën e etimologjisë, nuk mund të lihet anash prania dhe rëndësia e Vittore Pisanit. Herë pas here ai merrej edhe me këto probleme, ndërsa veçanërisht shpesh i kthehej temës së tij të preferuar – burimit të gjuhës shqipe, duke shfaqur në këto raste prirje dhe mendjemprehtësi në rrokjen e kësaj teme të ndërlikuar e të zorshme. Kapjet metodologjike të neogramatikanëve nuk e kënaqnin, prandaj me të drejtë gjurmonte rrugë të reja në zgjidhjen e këtij problemi kyç të linguistikës ballkanike. (*Studia albanica*).

Çështjes së gjenezës së gjuhës shqipe, kohë pas kohe, i kthehej edhe prof. Giuliano Bonfante; në punimin e tij “*Premesse e problemi per un dizionario etimologico albanese (Udine, 1950)*” G. Francescato përmend dy punimet e tij dorëshkrim “*Contributi al dizionario etimologico albanese*” (1945) dhe “*Nuovi Contributi al dizionario etimologico albanese*”, 1949.

Linguistika franceze, as herët e as më vonë, nuk ka treguar interesim të veçantë për problemet etimologjike të gjuhës, ndonëse është e ditur se interesimi dhe marrja, në mënyrë aktive, me çështje të degëve të tjera të shkencës albanistike nuk kanë munguar (Mario Roques, *Le dictionnaire albanais de 1635; Recherches sur les anciens textes albanais*, Paris, 1932). Henri Boissin *Grammaire de l'Albanais moderne*, Paris, 1975.

Shkenca linguistike anglosaksone po ashtu nuk ka treguar prirje e as

interesim për problematikën etimologjike të gjuhës shqipe, edhe se s'mund të thuhet se ka munguar interesimi për leksikografinë e saj (Stuart Mann, "An English-Albanian Dictionary, Cambridge, 1957, *An Albanian Historical Grammar*, Londër, 1974, *II An Historical grammar of Albanian*, Hamburg, 1977).

Për shkencën gjuhësore gjermane lidhur me problemet etimologjike të gjuhës shqipe është bërë fjalë më lart; këtu po rikujtojmë se albanologjia e huaj ka zënë fill pikërisht në truallin gjerman, mirëpo, fijet e saj, me vrasjen e Norbert Joklit u këputën dhe ajo u varfërua ndjeshëm dhe deri më sot ajo nuk mori fuqinë për t'u mëkëmbur, ndonëse, aty-këtu, ka përpjekje të suksesshme për mëkëmbjen e saj.

Natyrisht, ky varfërim nuk vlen për degë të tjera të shkencës albanistike, përkundrazi, në qarqet kulturore dhe shkencore si në Berlin, në Bohum, në Munih, në disa disiplina të shkencës albanistike janë arritur rezultate të dukshme dhe degët gjuhësore gjegjëse të albanistikës janë avancuar në shumë drejtime të reja si në pikëpamje të metodës shkencore, ashtu edhe për shkallën e duhur të rezultateve të arritura.

Në Akademinë e Shkencave të Berlinit është ngritur një bërthamë – me numër e vogël, por mjaft e zellshme, që mbi një program të qartë e shumë të rëndësishëm, vepron në gjurmimin e problematikës albanistike;

1. Wörterbuch (albanisch – deutsch) von Oda Buchholz, Wilfried Fiedler, Gerda Uhlisch; Albanische Grammatik, - Oda Buchholz, Wilfried Fiedler; Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës Wilfried Fiedler *Das albanische verbalsystem in der sprache des Gjon Buzuku (1555)*, Prishtinë, 2004.

Në linguistikën polake në të kaluarën ka pasur përpjekje sporadike që edhe ndonjë fjalë e shqipes të merret për trajtim etimologjik; por vetëm pas luftës së fundit në shkencën linguistike polake u shqua zelltari i merituar dhe i denjë në fushën e studimeve etimologjike, Wacllaw Cimochowski, i cili pas vetes la një numër të madh dhe të sigurt zgjidhesh etimologjike në leksikun e gjuhës shqipe.

Në mbështetje të traditës gjuhësore albanologjike, në linguistikën çekoslovake në të cilën me meritën e J. J. Jarnikut pati fillime me rezultate të ndritshme – në periudhën e mëvonshme u shqua Vladimir Bubeni, ndërsa në studimet etimologjike të shqipes përpjekje të suksesshme ka bërë V. Polak, me synim e qëllim që të hartojë një fjalor etimologjik të gjuhës shqipe. Atij i ka munguar metoda e vërtetë shkencore bashkohore në analizën etimologjike të gjuhës shqipe; por emri Polakut në historinë e studimeve etimologjike të gjuhës shqipe do të mbetet përherë jo për zgjidhjet e shumta etimologjike, po për vendosmërinë dhe qëndruesën e tij në kërkimin e çështjeve etimologjike të gjuhës shqipe.

Para Revolucionit të Tetorit në Rusinë cariste nuk ka pasur ndonjë emër të dalluar e as shkencë të vërtetë albanistike, e kjo do të vazhdojë edhe në periudhën e mëvonshme deri para Luftës së Dytë Botërore. Pas luftës atdhetare, në Leningrad, nën udhëheqjen e shkencëtares së zellshme A. Desnickaja filloi veprimtaria e degëzuar në shumë fusha të shkencës albanologjike; u ngrit kuadri shkencor për të gjitha profilet e shkencës albanologjike, i cili po arrin rezultate të dalluara në të gjitha degët linguistike të gjuhës shqipe. Sipas degëzimit dhe shumësisë së temave në njërën anë, dhe rezultateve të arritura në anë tjetër, qerthulli albanologjik i Leningradit është ekipi më i fortë shkencor jashtë mjediseve shqiptare. Çështje e vërtetë, studimeve etimologjike nuk u kushtohet ndonjë rëndësi e veçantë, edhe me arsye, sepse këto punë bëhen në mjedise e qendra të tjera ku janë siguruar kuadro përkatëse dhe kushte të tjera.

Shkenca linguistike rumune edhe sipas natyrës së punës është marrë dhe po merret me të madhe edhe me problematikën albanologjike – pra edhe me studimet etimologjike të gjuhës shqipe. Mangësi e ndjeshme heqet në këto studime për shkaqe se ajo ngultas i përmbahet substratit, sikur ai si me shkop magjik a priori t'i zgjidhte çështjet kyçe të prejardhjes së gjuhës dhe të popullit rumun dhe marrëdhëniet e ndërsjella me gjuhën shqipe.

Shkenca linguistike bullgare ka pasur fatin që t'ia hapin rrugën dhe ta udhëheqin një numër i vogël, por i shquar punonjësish shkencorë (St.

Mladenov, Delčev, Georgiev etj.). Sa u përket çështjeve kryesore të linguitikës ballkanike, siç është ajo se në ç'masë është ruajtur substrati iliro-trak në gjuhët e sotme ballkanike, një degë e strumbullarit shkencor që merret me marrëdhëniet e problemeve ballkanistike, një kujdes i tepër u kushtohet relikteve të gjuhëve paleoballkanike.

Është vështirë të pranohet teza e përhapur, jo vetëm e historianëve të gjuhës bullgare, që në leksikon e gjuhëve të sotme ballkanike: rumune, bullgare e shqipe, janë ruajtur një numër i madh i mbeturinave gjuhësore iliro-trake; në raste të këtilla do të duhej të pranohim pikëpamjet për statikën, në dëm të zhvillimit dinamik të çdo gjuhe, që është në kundërshtim të plotë me ligjet e natyrës dhe të shoqërisë. Ta argumentojmë këtë mendim vetëm me një shembull. Nga mesi i shekullit të kaluar, I, 243, qysh babai i albanologjisë, Georges von Hahni ka përkrahur mendimin, të cilin më vonë shumë lingvistë e kanë përsëritur në mënyrë mekanike, që shembujt e shumtë nga fusha e emrave vetjakë dhe të vendeve të Ballkanit të lashtë si *Brebista*, *Bistue vetus*, *Bistue nova*, emri i fisit trak *Biston*, si edhe emri i liqenit *Bistonis*, mund të vihen në lidhje me shprehjen e gjuhës shqipe, e cila në pikëpamje fonetike është identike me këto pjesë të fjalëve të përbëra, *bist*, shqip *bisht*. Madje, është menduar që kjo pjesë e këtyre fjalëve të përbëra në mënyrë të drejtpërdrejtë ka vazhduar në shqipen në formën “bisht”; ndonëse, studimet e mëvona etimologjike kanë dëshmuar se etimoni “bisht” në shqipen është krijim i ri; me fjalë të tjera në këtë gjuhë ekziston fjalëza –*ith* (diçka që gjendet pas, prapa), e cila ka hyrë në fjalën e përbërë: m (b) +*ith*+*sht*: në të cilën *b*-ja është prefiks, ndërsa =*sht* sufiks, prandaj *b+ith+sht=bisht*, si grup trekonsonantik i thjeshtësuar ka dhënë –*bisht*, siç tregojnë edhe shembujt: *vjel+shtë=vjeshtë*, *hell+shtë=heshtë*.

Shkenca linguitike greke nuk ka pasur studiues të dalluar në fushën e studimeve etimologjike – prandaj as në fushën e hulumtimeve etimologjike albanistike. Kjo, natyrisht, nuk do të thotë se nuk ka pasur as në fushën e degëve të tjera linguitike, pra edhe në albanistikën. Disa ndihmesa të pakta të shkencëtarit grek me prejardhje shqiptare Furiqi,

janë pranuar në studimet etimologjike të gjuhës shqipe dhe janë kontribut i qëndrueshëm në studimet albanistike. Titos Jochalas, *Fjalori i Marko Boçarit*, Athinë, 1980.

Kontributi i shkencës gjuhësore amerikane në studimet etimologjike në gjuhën shqipe është i papërfillshëm; në studimet e shumë gjuhëve indo-evropiane të gjuhëtarit amerikan E. Hampit (Eric Hamp) lshpesh gjenden edhe probleme etimologjike të gjuhës shqipe. Punimet e tij nga fusha albanistike paraqesin ndihmesë të sigurt për studimet etimologjike të gjuhës shqipe. Huld Martin E Basic *Albanian etymologies* California state Univesity, Los Angeles, 1984; Huld Martin E. *Accentual Stratification of ancient greek-loanevords in Albanian*. KZ. Vol. 98 (1985)

Nga brezi i ri i shkencëtarëve të ne, me problemet e albanologjisë në mënyrë të drejtpërdrejtë është marrë vetëm Ivan **Popoviqi**, i cili vdiq shumë herët. Ai në disa punime të tij, të botuara edhe në gjuhë të huaja, avancoi dukshkëm studimet e përbashkëta gjuhësore shqiptare – sllavojugore.

Në çerekshekullin e fundit, kryesisht pranë Fakultetit Filozofik dhe të institucioneve të tjera shkencore të Prishtinës është rritur një bërthamë e vogël shkencore, e cila deri më sot ka arritur rezultate të dukshme në fushën e shkencës albanologjike. Me meritën e individëve në hulumtimin e shumë çështjeve nga fonetika historike dhe gramatika e gjuhës shqipe, - duke zbatuar metodat shkencore bashkëkohore, janë arritur rezultate të dalluara. Metoda tradicionale shkencore, me të cilat shkenca mbi gjuhën u përtërit dhe u përparua (Bokshi, Ismajli). Përparim i dukshëm vërehet në fushën e studimeve të marrëdhënieve gjuhësore të ndërsjella shqiptaro-sllavojuge, si edhe në fushën e studimeve ballkanologjike (Ajeti, Bokshi, Ismajli).

Në bërthamën e përmendur shkencore pak kush merret me studimet etimologjike, hiq autori i këtyre rreshtave, i cili mbi traditat e shkencës linguistike jugosllave në mënyrë sistematike vazhdon punën në hulumtimin e marrëdhënieve gjuhësore të ndërsjella shqiptare-sllave. I shtyrë nga mendimi i shumë shkencëtarëve se kjo anë e marrëdhënieve të ndërsjella të gjuhëve ballkanike ishte lënë anash dhe se, madje në lidhje

me këtë ka pasur edhe lajthitje, ai mbi një bazë të mirë me rezultate të dalluara të arritura në punimet e të ndjerit Ivan Popovićit, nisi ta rrëzonte hipotezën se gjoja një mundësi e tillë s'kishte të ngjarë të ndodhte për mungesë së bazës politike e kulturore të popullit shqiptar. Edhe rezultatet modeste të arritura deri tani hodhën poshtë këtë paragjykim e dyshim të tillë, duke dëshmuar karakterin aktiv e dinamik të dialekteve shqiptare në raportet e këtyre gjuhëve. Punimet nga fusha e onomastikës, fitonomisë e iktiofaunës në Ulqin dhe në rrethinën e tij bregdetare është ndihmë e mirëpritur për punonjësit e një fushe të tillë shkencore.

Pas vdekjes tragjike të Norbert Joklit, njohësit të rrallë të problemeve gjuhësore të shqipes, puna në hartimin e fjalorit të tij etimologjik pothuajse ra përgjithmonë në ujë, dhe vetëm Eqrem Çabej, nxënës i Joklit, ka mundur ta merrte mbi vete këtë detyrë të vështirë dhe ta kryente me sukses. Studioi në Vjenë te profesorët me renome Paul Kreçmeri dhe albanologu Norbert Jokli.

Çabej, vite me radhë, në mënyrë sistematike, përgatiti terrenin, duke i bërë edhe parapërgatitjet e domosdoshme për fillimin e punës në hartimin e fjalorit etimologjik të gjuhës shqipe. Ai ishte i vetëdijshëm se vetëm ai ishte i paracaktuar për trajtimin e veprës monumentale – librit të parë të botuar në shqipe – aq i rëndësishëm për kulturën e popullit shqiptar. Ai ka përfituar nga rrethana se me vite kishte qëndruar në Romë, ku në mënyrë të papenguar ka mundur të gjurmojë dokumentet e rralla të cilat vetëm në arkivat e qytetit të lashtë të Romës mund të gjendeshin, si ky i *Mesharit* të Gjon Buzukut (1555); ai këtë libër e studioi në mënyrë sistematike duke e bërë transliterimin e transkriptimin në mënyrë që të shërbejë si model si duhet të veprohet në punën tekstologjike. Duke u njohur edhe me vepra të tjera të letërsisë së vjetër shqipe, si të Budit, të Bardhit, të Bogdanit, të Kazazit dhe me literaturën arbëreshe, Çabej pasuroi shumëfish skedarin e fondit leksikor me fjalë të panjohura deri atëherë. Ai shfrytëzoi edhe rrethanat e tjera të volitshme, si numrin e shtuar të të folmeve të trajtuara, pasurimin e letërsisë së shkruar në gjuhën shqipe me vepra të reja, krahas edhe të inventarit leksikor.

Që nga numri i katërt i revistës shkencore *Buletin i Universitetit Shtetëror dhe Studime filologjike*, filluan të botohen versionet selektive të *Fjalorit etimologjik*, në të cilin përpunoi afro njëmijë njësi leksikore; në vitin 1976, në botim të Akademisë, doli në dritë vëllimi i dytë i fjalorit të tij etimologjik (*Studime etimologjike në fushë të shqipes*). Në këtë vëllim Çabej trajtoi dy shkronja (A-B) të alfabetit të shqipes, me afro njëmijë fjalë.

Vëllimi i parë, i cili paraqet hyrje në librin e dytë të botuar (1976), e pa dritën më 1982. Libri i parë përmban në vete studimin e përgjithshëm, në të cilin jepet në mënyrë kritike vlerësimi i studimeve etimologjike të botuara deri atëherë në gjuhën shqipe, pastaj parashtrhen parimet teorike në të cilat autori mbështet punën e vet në këtë fushë shkencore dhe natyrisht prosedeun metodik. Veç kësaj, autori paraqet një varg të tërë të rezultateve themelore rreth përbërjes shtresore historike të leksikut të shqipes, pastaj çështje të raportit të fondit leksikor burimor ndaj fondit të saj të huazuar.

Nga ana tjetër, mbështetja në lëndën e pasur dhe deri sot të pashfrytëzuar, njohja e thellë e fakteve gjuhësore dhe rreptësia e metodës shkencore, së cilës autori i është përmbajtur në mënyrë të përpiktë, dhe në bazë të qëndrimit që vetëm pas krahasimit të brendhshëm të kalohet në krahasimet e ndikimeve të jashtme të gjuhëve ballkanike, dua të them të gjuhëve indoevropiane – e gjithë kjo ka mundur t'i japë autorit të fjalorit etimologjik të gjuhës shqipe, profesor Çabejt, mundësi të mëdha që të arrijë rezultate të rëndësishme, të zbërthejë etimologji të reja dhe të pranueshme. Falë mënyrës së këtitillë të trajtimit, ka qenë e mulkndur të interpretojë e të shpjegojë një varg etimologjish deri atëherë me gurrë enigmatike ose së paku të nxjerra gabimisht.

Kuptimi i gjerë që autori i jepte disiplinës etimologjike, e cila nuk merret vetëm me kërkimin e prejardhjes së fjalëve, por përcjell tërë jetën e tyre, mjedisin ku u krijuan ato, shtrirjen e tyre gjeografike brenda territorit gjuhësor të shqipes dhe jashtë tij, aftësishtë e tyre për krijimin e fjalëve të reja, shkathtësinë që të hyjnë në përbërjen e fjalëve të tjera – e gjithë kjo i

jep kësaj vepre të rrallë rëndësi të shumëfishtë për kërkime të shumëllojshme në fushën e problematikës gjuhësore të shqipes, në planin diakronik dhe në atë sinkronik.

Në veprën e vet *Studime etimologjike të gjuhës shqipe*, Çabej, pasi kishte bërë në mënyrë të thukët e kritike analizën e punës së kryer në fushën e studimeve etimologjike të studiuesve të mëparshëm, me argumente dhe bindhës-m kontestoi një varg zgjidhjesh të etimologëve të mëherhësëm, qoftë për shkaqe të mlungesës së objektivitetit, qoftë për shkaqe të mosnjohjes së mjaftueshme të gjuhës shqipe, qoftë, më në fund për shkak të mangësive në punën metodologjike, a në parimet mbi të cilat mbështeste teorinë e tij gjuhësore duke i përforcuar me të madhe të dhënat e reja – shpjegimet e veta.

Në hyrjen e kësaj vepre të vëllimshme mbi studimet etimologjike të shqipes, si edhe në punimet e mëhershme të tij, Çabej dhe shumë studiues të leksikut historik të shqipes, e intereson raporti i pjesës së huazuar, në një rën anë, dhe i pjesës burimore të fondit leksikor të shqipes, në anën tjetër. Gustav Mejeri, në fjalorin e tij etimologjik të gjuhës (1891) mbi një lëndë leksikore prej afro 5140 fjalësh kishte arritur të vërtetonte burimin indoevropian të 400 njësive leksikore, dm.th. 7.77% të shprehur në përqindje; por nuk ia doli të përcaktojë prejardhjen e sasisë leksikore të afro 700 fjalëve. Para themelimit të gjuhësisë krahasuese indoevropiane, Xylanderi (*Die Sprache der Albanesen oder Schkipetaren*, Frankfurt mbi Main, 1835, 294), në tërësinë leksikore prej 1800 fjalësh, konstatoi se gjysma e tyre i takonte pjesës së huazuar, ndërsa pjesa tjetër, pak më e madhe, kishte prejardhje indoevropiane. F. Nopça (F. Nopcza, *Die Albaner*, Urania, Wien, nr. 1-2, 1913; e ribotuar: A. Baldacci, *Rivista d'Albania*, 3, 1930), duke i shqyrtuar 282 fjalë të gjuhës shqipe, të regjistruara në Shqipërinë e Veriut, në 126 sosh vërtetoi burim trashëgues, 52 me prejardhje turke dhe vetëm 18 me buirm sllav. shkencëtari prijatar në romanistikë, Meyer-Lübke, mendonte se fjalori etimologjik i gjuhës shqipe i Gustav Mejerit përmban vetëm 10% nga fondi leksikor indoevropian e sipas Nahtigalit e Oshtirit ky fjalor përfshin 14,2% të shprehjeve

të pahuazuara të fjalorit, ndërsa albanologu anglez St. Mann shpreh mendimin se numri i njësisve indoevropiane, të vërtetuara nga Gustav Mejeri, duhet pesëfishuar.

Nuk ka farë dyshimi se në mbështetje të njohurive të sotme të visarit leksikor të shqipes, është e pamundur të bëhet një statistikë definitive e raportit të fondit të trashëguar dhe atij të huazuar, sepse lënda e fjalorit të gjuhës shqipe as për së afërmi nuk është regjistruar, prandaj, si statistikat e hershme, edhe ato të sotmet të këtyre raporteve, mund të jenë veçtm të përafërta.

Statistika e këtyre raporteve mund të bëhet si mbi njërën, edhe mbi tjetrën bazë: jo në mbështetje të raporteve numerike të visarit leksikor burimor ndaj atij të huazuar, po në mbështetje të cilësisë së vetë leksemave, sipas asaj se në ç'ënduri paraqiten në tekstin e dhënë. Do të thotë, është e nevojshme të shikohet se në cilat kategori leksikore të pasurisë gjuhësore është përdorur fjala burimore dhe me çfarë frekuence, në njerën anë, dhe të vërtetohet dinamika e një fjale të huazuar në tekstin e dhënë, në anën tjetër; edhe nëse ekzistojnë statistika të tilla, ato janë shumë të rralla.

Një pasqyrë e përgjithshme do të tregonte se elementi autokton burimor i visarit leksikor të shqipes është më i madh në raport me pjesën e saj të huazuar kur pasqyron format primitive (të pazhvilluara) të jetës, shkallën e ulët të ekonomizimit blegtoro-agrar dhe atë kulturor, ndërsa mbizotërues është fondi i shprehjeve të huazuara në sferat gjegjëse me format më të zhvilluara materiale e shpirtërore të jetës dhe punës: në emërtimet e konfiguracionit të terrenit, në emrat e botës bimore, të dukurive atmosferike, në emërtimet e prodhimeve bujqësore e të qumështit, në emërtimet e trupit të njeriut dhe funksioneve të tij, - në të gjitha sferat e përmendura mundësitë shprehëse të trashëgimisë indoevropiane janë më të shumta në raport me ato të huazuara; në tërësinë leksikore prej afro 564 fjalësh, raporti është 342 ndaj 222 huazimeve. Ndryshe nga ky përpjesëtim, në disa sfera të tjera elementi i huaj që ka hyrë në gjuhën shqipe në rrjedhën e zhvillimit të saj, tejkalon elementin autokton. Në

tërësinë leksikore prej afro 860 shprehjesh kemi këtë raport: 325 autoktone ndaj 535 elementeve të prejardhjes së huaj. Këto dy shuma përbëjnë tërësinë prej 1424 njësive leksikore, në të cilat del përpjesëtimi 667 elemente autoktone ndaj 757 shprehjeve të huazuara. Siç shihet nga kjo pasqyrë, e cila, po e theksojmë, mund të jetë vetëm e përkohshme, kurrësi përfundimtare, në tërësinë e gjithmbarshme leksikore të gjuhës shqipe, siç na është e njohur, pjesa e saj e cila në një periudhë të gjatë kohore ka arritur të depërtojë në të, mbizotëron ndaj pasurisë leksikore autoktone, edhe se në gjendjen e sotme të shkencës, siç u theksua edhe më lart, në raportin midis këtyre dy përpjesëtimeve të leksikut të gjuhës shqipe, nuk mund të bëhet kurrfarë bilanci përfundimtar.

Çështja e huazimeve, numri i të cilave çdo ditë në çdo gjuhë rritet pandërprerë, duhet vështruar në një kontekst më të gjerë, në dritën e marrëdhënieve të ndërsjella gjuhësore, d.m.th. të gjuhëve në kontakt. Ndërvarësia sot është diçka e përhershme dhe çështje themelore në studimin e gjuhës (Çabej), *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, I, 112-113).

Fjalori etimologjik i gjuhës shqipe i Eqrem Çabejt, për jetë të tij nuk mori formën përfundimtare; e ishte menduar të ketë 8-10 vëllime – si vepër e jetës e autorit.

ARRITJET KRYESORE TË STUDIMEVE ETIMOLOGJIKE TË SHQIPES

Kërkimet e historisë së gjuhës shqipe e bashkë me të edhe hetimet etimologjike në fushë të kësaj gjuhe kanë një rëndësi të madhe edhe në punën e ndriçimit të çështjeve të historisë së popullit tonë. Me ndihmën e gjurmimeve të degëve të ndryshme të gjuhësisë, duke u mbështetur në realizime të arkeologjisë, të historisë, etnologjisë, studimet etimologjike në fushë të shqipes kanë hapur horizonte të reja duke shënuar përparime në të gjitha fushat kërkimore të gjuhësisë shqiptare.

E vënë në baza të drejta teorike, gjuhësia shqiptare ka zënë të hetojë në mënyrë sistematike gjithë strukturën e gjuhës shqipe në zhvillimin e saj të kohës sonë, të folur e të shkruar. Në këtë rrugë ajo ka shënuar, në radhë të parë në sajë të studimeve të kryera në institutet shkencore përkatëse në shtetin ëmë përparime të dukshme në të gjitha degët e saj të ndryshme.

Në hetimin e pjesëve të ndryshme dhe ligjëratës, si dhe të sistemit emëror e foljor, kanë marrë pjesë dhe vazhdojnë parreshtur të angazhohen edhe studiues shqiptarë në Jugosllavi mbi të cilat realizime është bërë një sintezë e thelluar e strukturës gramatikore dhe fonetike të gjuhës sonë, e mbi bazën e analizës së bërë deri këtu, gjuhësia jonë ka depërtuar më thellë në historinë e brendshme të shqipes dhe po e çon më tej edhe studimin e marrëdhënieve të jashtme të saj në rrafshin krahasues historik. Kontributi i tyre na është i dukshëm edhe në fusha të tjera të disiplinave albanologjike. Me botime të përkthyer dhe me studime origjinale gjuhësia jonë po freskohet me metoda të reja linguistike që ndihmojnë çështjet e gjuhës sonë të kapen në mënyrën tërësore.

Mbi bazën e përfundimeve të rëndësishme të arritura në fusha të ndryshme të gjuhësisë, u krijuan kushte fort të mira për riorganizimin e studimeve në fushën e historisë së gjuhës shqipe. Në këtë lëmë

albanologjia e huaj, na kishte lënë një trashëgim mjaft të pasur, por me vlerë të diskutueshme shkencore dhe me të meta metodologjike.

Studimet etimologjike kanë kapërcyer atomizmin e historicizmin e gramaticientëve të rinj dhe ndjekin rrugë të drejtë studimi. Duke ecur në rrugë të tillë, studimet etimologjike shqiptare kanë arritur të kryejnë realizime të lakmueshme shkencore. Punonjësi më i merituar në këtë fushë studimesh, pa dyshim, është Eqrem Çabej. Është merita e tij që në këtë truall kërkimesh janë bërë përgjithësime të qëlluara. Duke filluar nga numri 4 (1960) i revistës Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Çabej zuri të botojë një verison selektiv të fjalorit etimologjik, në të cilin u përpunuan nja njëmijë fjalë; në vitin 1976, botimi i Akademisë së Shkencave të RPS të Shqipërisë – Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, doli bleni II i fjalorit etimologjik të E. Çabej me titull: Studime etimologjike në fushë të shqipes II, (A-B); ky ble përfshin afër njëmijë fjalë.

Me shfrytëzimin e një materiali të pasur leksikor, të mbledhur në një kartotekë të pasur skedash dhe me vjeljen e fjalëve të rralla, të grumbulluara ndër fjalorthë e glosarë nga dialektet dhe ligjërimet shqiptare brenda dhe jashtë vendit, E. Çabej shoshiti dhe përpunoi një sasi të madhe fjalësh nga sfera të ndryshme të kulturës popullore, të materiales dhe të mendores.

Ky ble me titull: Studime etimologjike në fushë të shqipes ngërthen dy shkronjat e para të alfabetit të shqipes (A-B), në të cilën zberthehen, siç u tha, afër njëmijë fjalë.

Fjalori etimologjik i hartuar prej Çabejt qëndron më lart se të gjitha përpjekjet që deri sot janë bërë në këtë truall studimesh që nga Gustav Meyeri. Fjalori shquhet nga një pasuri e madhe lënde leksikore me zbatimin e kriterëve të drejta në hartimin e zberthimin e visarit leksikor të gjuhës sonë; është punuar me një frymë objektive, siç i ka hije një shkencëtari të vërtetë.

Njëri nga qëllimet e hartuesit të këtij fjalori etimologjik të shqipes është që të veçojë brumin leksikor të trashëguar nga ai që ka hyrë së jashtmi në gjuhën tonë. Natyrisht, autori asnjëherë nuk insiston një fjalë të

nxjerrë të rrjedhës së vendit, aty ku argumentet nuk flasin për një burim autokton të saj; e kur mungojnë argumente të sigurta për një fond burimor dhe s'ka të dhëna të vërtetuara për një brumë të huaj të një fjale, ajo atëherë lihet pa shpjegim, që është parim i drejtë.

Duke trajtuar fjalën shqipe *amull*, II, Çabej polemizon dhe me N. Joklin që te LKU, 271; IJ. VIII, VII, 84 mbronte mendimin se ajo do të lidhet, me *mbulim* "burim", si dhe emrin e burimit *Bulentum*, të cilin Çabej e mendon të vazhduar nga e sotmja *Omla* pranë Raguzës në Dalmaci.

Me hetimet e hidronimit *Ombli*a që në mesjetë përdorej në forma të ndryshme dhe me vendthën *Bulentum* që gjendej në luginën përplot me gurra e kroje të ftohta te Dubrovniku, janë marrë shumë dijetar: së pari për to bën fjalë historiani i mirënjohur i popujve të Ballkanit, Konstantin Jireček, në studimin e njohur të tij me titull: "Die Handelsstrassen und Bergwerke von Serbien und Bosnien Während des Mittelalter, Pragë, 1879, versioni serbokroatisht: Trgovački putevi i rudnici Srbije i Bosne u srednjem vijeku od Dr Konstantina Jirečeka, Prag, 1879, Zbornik Konstantina Jirečeka, I, Beograd, 1959, str. 217-218.

Në faqet e shënuara, Jirečeku shkruan: "S one strane Brgata (selo Brgat u srednjem vijeku Vregatum, Virgatum, nesumjivo rimsko Virgetum) na njegovoj sjevernoj strani nalazi se divna, sjenovita dolina navodnjena jakim vrelima, koja se u starodubrovačkim dokumentima naziva Junchetum, sada se zove italjanski Zonchetto, a slav. Šumet (šumice). Njezine vode teku u Omblu, u Arion Patamos,¹ starogrčkih moreplovaca".

Norbert Jokli, sikundër u pa, në vështrimin e tij nuk e zë ngojë emrin e burimit *Ombli*, por vetëm bën fjalë për gurrën e vjetër në atë krah të Dubrovnikut. E romanisti i njohur i Zagrebit P. Skok, i sillet kësaj fjale të burimit *Bulentum*, me rastin e shqyrtimit të tij në një recension që po i

¹ Njezino ime, koje se u srednjem vijeku pisalo *Umbula*, *Umbola*, *Ombli* spada takodje u predslovenski period. Slaveni zovu *Omblu* prosto *Rijeka*. Drugo mjesto u blizini izvora *Ombla* bilo je u srednjem vijeku poznato pod imenom *Bulentum* (svako današnje *Obuljeno*). A pede montis *Liute usque ad Bulentam de Ombla* 1366 (libro Rosso-8) – za *Omblu* sr. u Dalmaciji i Crnoj Gori takodje često ime sela *Ubli* (Plur. prvob. *Obli*).

bënte studimit të Norbert Joklit te Glasnik Zemaljskog muzeja B i H, XXX, p. 155, dhe te Arhiv za arbanašku starinu, jezik i etnologiju, knj. I, sv. 1-2, f. 7; emri i burimit të përfillur Ombla nuk qe objekt shqyrtimi në studimet e përmendura të ballkanologut kroat. P. Skok. Çështë e drejta fjala Ombla trajtohet nga ky njohës i gjuhëve ballkanike në një vend tjetër, në Fjalorin e tij etimologjik të serbokroatishtes, III, f. 533-534. sub. Ubao, ku thotë: *Ubao*, gen. *Ublom* (Vuk, Crna Gora), 2 toponim *Ubli* (Crna Gora) “Samoglasnik *u* je nastao iz velarnog nazala. Taj se vidi u tal. Nazivu Ombla za Dubrovačku Rijeku” f. 534.

Te Narodna enciklopedija srpskohrvatsko-slovenačka, knj. III, gjejmë këtë shpjegim për emrin e burimit *Ombla*: “Današnje talijansko ime *Ombla* prvi put se javlja 1363. godine. Raniji su oblici Umbula (1160), Ombula (1255), Ombla (1346), Umbola (1366, 1347), Onbula (1358), Unbula (1304), Umbla (1258). Umbula izgleda na prvi mah latinska reč, ali se ona ne može dovesti u vezu ni za kojim latinskim terminom, koji bi pristajao imenu reke. K. Jireček došao je na ispravnu misao kada je tobožnji talijanski oblik Ombla usporedio sa Ubli, Uble u okolini Trogira, sa veoma čestim imenom u Dalmaciji i Crnoj Gori”.

Me punimin e tij – Prania e etnosit shqiptar në Kosovë gjatë shekujve XIII-XIV, botuar në blenin e përbashkët me titull: Onomastika e Kosovës, Prishtinë, 1979, f. 59-104, duke prekur këtë çështje mjaft të koklavitur, Skënder Gashi, në vend që të qiste pak sa dritë në të, ai për mendimin tonë, e ngatërroi atë edhe më shumë.

Pështjellimi i çështjes në fjalë mund të përmbliidhet në këto pika: format e toponimeve të caktuara Skënder Gashi i vendon në vatra fjalësh krejtësisht të pakrahasueshme, duke i përqasur ato me përgjasimet e tyre fonetike; së dyti mendimet e autorëve nuk i jep në mënyrë objektive, por sjell vetëm ato pjesë që u përshtaten koncepteve të tij të përmendura, duke i lënë jashtë dhe duke i shmangur gjykimet e tjera të tyre. Përkthimet nga serbishtja janë tjetër për tjetër, e gabimet teknike e vështirësojnë kuptimin e drejtë të fakteve që sillen.

Kur bën fjalë për shtrirjen e katundit mesjetar Trepça, S. Gashi

thotë se si ky katund kishte për kufi një vendth të quajtur *Ambul*, qysh figuron te Krisobula e Shën Savës (Svetosavska Hrisobula e L. Kovaçevićit, f. 3), së cilës nuk ka arritur t'i caktojë domethënie vështrimore. Megjithatë, Gashi këtë toponim (*Ambul*) e afron te mbiemri shqip *ambël – embël* – pastaj edhe te hidromimi *Ombla*, që bie te Dubrovniku, për më tepër këtë ai e përqsas me toponimin *Bulentum e Bulet*, po në ato troje, vep. e përmendur, 75-76.

Duke përmbledhur ç'u tha mbi çështjen në shqyrtim, për mendimin tonë mund të përfundojmë. Me përjashtim të S. Gashit që nuk mban qëndrim kritik ndaj pikëpamjeve të tjerëve, shkencëtarët që kishin rrahur çështjen e burimit të hidromimeve *Ombla* e *Bulentum*, në afërsi të Dubrovnikut, - emrat e tyre nuk i gjenin me një moshë parasllave; këtu do të hapim një parantezë e të thomi që për hir të së vërtetës, historiani K. Jireček, në studimin e përmendur – Rrugët e tregtarëve dhe minierat e Serbisë dhe të Bosnës në kohën e mesjetës – pohonte se hidronimi *Ombla* heq rrënjët e tij në lashtësinë, mirëpo, ai, po aty, emrin e hidronimit në fjalë (*Ombla*) e lidh me emrat e shpeshtë të toponimeve *Ubli*, *Uble* në Mal të Zi e *Dalmaci*, që paraqesin formën mesjetare të një *Omble* të sllavishtes së vjetër me vështrim “burim”. P. Skok i mbahet, po këtij mendimi, në Fjalorin e tij etimologjik të serbokroatishtes, III, sub. “*ubao*”.

Një vjetërsi e madhe e emrit *Ombla*, sikundër mendon S. Gashi, nuk ecën as nga pikëpamja fonetike: *Ambël, ambël, ëmbël, ambla, ëmbla* sepse okluzivi *b* nuk është i hershëm, por një tingull homorganik i përftuar relativisht vonë në gjuhën shqipe, te Buzuku: *sen, sot send*, paraforma e katundit është *katun*, qysh del edhe në gjuhë të tjera të Ballkanit: *katun, katuna*, rum. *catun*.

Dhe, më në fund, te hidronimi *Ombla* për sllav. Rijeka nuk kemi të bëjmë me ndonjë adjektiv shqiptar, sikur mendon E. Çabej, *Ältere Stufen des Albanischen im Lichte der Nachbarsprachen*, te *Zeitschrift für Balkanologie*, II (1964), Studii si *Cercetări Lingvistice*, X (4), 1959, që toponimi i sotëm italisht *Ombla* e që për herë të parë del më 1160, të burojë nga mbiemri i shqipes *ambël, ambla* me labializimin e a-së nazale

ombël, ombla, e që shënonte një burim me ujë të ëmbël. Burimit nga shqipja të këtij toponimi i dalin disa vështirësi jo të lehta për t'i kapërcyer: së pari, në sferën e fjalëformimit të gjuhës shqipe nuk di si mund të hiqet pengesa që kompozitet me vlerë pronësore mos të kenë dy komponente; të parin e të dytin, që është zakonisht një atribut përcaktues, bie fjala: Gurabardhi, Ujëbardhi, Gurthati, Guraziu, Gurakuqi, Ujmiri, - Omblu do të ishte një përjashtim i rrallë, prandaj vjetërsia e saj, për mendimin tonë, do të vihet në dyshim.

Nga materialet që këtu u sollën dhe nga mendimet e shprehura prej shkencëtarëve, për ne është e qartë se *Bulentum* dhe *ombla* janë dy emra për dy hidronime të ndryshme, gjuhësisht të pakrahasueshme: *Ombla* në përdorim të dalmatishtes romane, që sipas mendimit të përgjithshëm ka origjinë sllave, nga Oble “burim” që dha *Ubli*. Në anën tjetër, emri *Bulentum*, sllav. *Oko* ose *Vrelo* quhej vendi nga rridhte lumi Omblu.

Teza e N. Joklit, te LKU, 271, dhe te IJ. VIII; VII, 84, për rrjedhën shqiptare të hidronimit *Bulenta*, nga një mbulim “burim” – një denominativ i *bulës* – nuk mund të mbahet, sikundër e ka shpjeguar Çabej, Studime etimologjike në fushë të shqipes, (A-B), f. 387.

Formave të emrit të shkurrës *bezgë, bexgë, bexg*, që kryesisht rritet në viset jugore të Shqipërisë e në Gegëri del trajta *bjezgë* (Kelmend-Shkurtaj), Gazulli edhe: u çua e iku *rrozga* me *bjezga* (shpejt e shpejt), po u sillemi jo për të hetuar burimin e tyre gjuhësor, por vetëm për trajtat e tyre pak a shumë të ndryshme. Sikundër shihet sheshazi, k fjala jonë në shqyrtim rron me monoftong, herë-herë edhe me diftong, në të folmet e gjuhës sonë. Së pari duhet, të theksojmë se emri i kësaj bime në dialektet shqiptare ka hyrë nga ligjërimet serbe – malazeze dhe maqedone, nga një *belica, belca, bečkë* me rënien e sonatit l në grup tri konsonantesh *lek-bezgë*, etj.; po këtë zhvillim duhet ta ketë ndjekur edhe *bjezgë* nga *bjelica*. Për këtë rrugë zhvillimi të formave të kësaj bime, s'ka kurrfarë dyshimi. Emrat dyformësh: me monoftong e diftong të tipit *bezgë=bjezgë, belish-bjelish* na provokojnë të vrasim pakëz mendjen për zhvillimin e tyre. Duhet të theksojmë edhe njëherë se te emrat e tipit të këtillë kemi të bëjmë me

fjalë me rrjedhë prej sllavishtes: serbokroatishtes, maqedonishtes, por, duhet ta themi që emrat me diftong nuk duhet të kenë moshë të madhe, sepse huazime të tilla prej sllavishtes në shqipen kanë hyrë në periudha së paku në mesjetë të hershme, që të gjitha na dalin me monoftong: *rekë*, *stenë* (mrezha). Është fjala për karakterin e fonemës *jat (è) të sllavishtes së vjetër*, që, me gjithë mendimet e ndara të sllavistëve, në ato kohë të mungëta, nuk kishte arritur të ketë një trajtë dhe shqiptim të njësishtëm.

Një gjendje e tillë sundoi në gjuhë të sllavëve të Jugut shumë kohë pas dyndjes së tyre në troje të reja të Ballkanit, prej këndeje del e natyrshme që sllavizmat e asaj periudhe të gjuhës shqipe nuk dalin me diftonge prej (è)jatit të hershëm sllav.

Format e fjalëve sllave – *bjezgë*, *bjelishtë* etj. duhet të jenë relativisht të reja, të mesjetës së vonë, e ruajtjen e tyre e mban të gjallë afërsia e dialekteve jekavike malazeze.

Për burimin e fjalës së mbarë gjuhës *bërësi-të*, “fundërria e rrushit, e ullinjve dhe e kumbullave që mbetet si të shtypen a shkelen këto”, - janë shprehur shumë mendime: në bazë të formave me të cilat thuhet ajo në gjuhë të popujve fqinjë, duhet të pranohet mendimi që trajta e saj parësore duhet të ketë qenë, sikundër thotë Çabej, Studime etimologjike në fushë të shqipes, II, (A.B) 212, *brisë a birsë*, qysh ruhet në serbokroatishten: *brs*, *bersa birza*, *breza*, *birsa*, *birsat* – me kuptim, “lëmashku që kapet në verë, e që shkaktohet prej fermentimit, nga thartimi”.

Bollza f. “shpatëza e parmendës, pjesa e poshtme e saj që ngjitet me dhe e në të cilën ngjitet nga përpara plori”, Çabej, Studime etimologjike në fushë të shqipes, II, 285, e ka nga Malësia e Gjakovës dhe prej Rr. Zojzit, BiS, IV, (1950), te A. Zuberi – Dituria, 1971/72, 2-3, f. 94, fjala sillet me një zhvillim tjetër kuptimor “pjesë të përparme të qerres, ke podat e qerres”, për të folmen e Lugut të Drinit të Bardhë të Rrafshit të Dukagjinit (te Fjalori i tij i fjalëve të rralla, Rilindja, 1979), që u lëshua këto ditë në qarkullim, autori shënon ballëz, *ballza*, me vështrim: dërrasë që vihet në ballë të podeve të qerres së drunjtë (Istog). Burimin e saj Çabej e bie të ardhur nga *ballë*, *ballëza* me shqiptimin e mbyullët të *a-së* përnga *o-ja*. Në

të folmet e shqiptarëve të Jabllanicës *bollëz-bollza*, sh. *bollza* “shpatëzat e sajeve nga dy anët e tyre që rrëshqasin në borë sikundër bolla, gjarpri”.

Për mendimin tonë kemi të bëjmë me dy emra që do të shpihen te forma fjalësh të ndryshme: në një anë është *ballza* nga ballë që shërben për të mbrojtur me pallën e hekurt boshitn e qerres, që diku quhet edhe ballnik, (Zhegra e Karadakut të Gjilanit), e në anë tjetër janë *bollëzat*, që të gozhduara në dy anët e sajës, të tërhequr prej qesh a kuajsh në gjasim të bollës rrëshqasin në borë.

Rrugët e ardhjes së një tipi fjalësh kryesisht të huaja në gjuhën shqipe kryesisht që mbarojnë me –o në pozicion nazal a likuid (n.r, 1) – (O) + n, o+r, o+1,) nuk është punë e lehtë të caktohen mirë e drejt, prandaj Çabej na përdh nga kriteret fonetike dhe gjeografike. (Studime etimologjike në fushë të shqipes, f. 11-161). Rastet më të shumta të kësaj lagjeje fjalësh në arbënishten e Zarën kanë ardhur nëpërmjet të folmeve kroate të Dalmacisë: sartur; ven. sartor, sllav, sartur; marun, maron, marum; marangun, marangon, marangun; peverun, peveron, peverun; kapuner, caponera, kapunera; shkatull-a, scatola-škatula; sampun-ni, sapon, sapon; balku-ni, Bashkimi: balkue, balkoi e balkoni; Sapuo-ni (Shestani), Sapu-ni (Pinçiq). Sikundër shihet prej shembujve të sjellë sipër, vokali o i kësaj kategorie fjalësh të huaja në gegërishten sidomos veriperëndimore është zbrëthyer në diftong: samuo-ni (Shestani), balkue-balkoi, balkoni (Bashkimi).

Bujan “pellg me shumë ujë brënda” në Progonat të Kurveleshit edhe në Piqeras të Bregut, të Detit, në Çamërishten: Bujanë, “pellg i thellë në lumë”. Sipas Çabejt e zbrëthyeshme në elemente morfemore: *b-uj-anë* një kompozit i ujë-it me b-, një hipostazë *mbë+ujë*. Bujan, katundi i rrethit të Tropojës dhe të Lipjanit në Kosovë, edhe te Gjilani.

Në toskërishten jugore rron edhe folja buis me vështrim, “del a shpërthen me shumicë” (bari, lulet), gëlon, grah (njerëzia ose blea, çdo shazë me shumicë, gjaku). “Gjan t’i përkasë foljes bujis”, thotë Çabej, e kjo folje gjëllin në shqipen me këto kuptime “qan, tajit” (shtamba). Në këtë vatër vështrimore ndoshta do të hyjë edhe folja buson –“kjason, tajit, qan”

(shtamba e ujit) ose drutë e njoma, - është një me bulson “buron”, rrjedh uji (Lumë), që në analizë të fundit do të jetë një denominativ *bulë-s*.

Në Tupallë të Jabllanicës (Serbia Jugore) shprehje *bujs!* Përdoret si thirmë, kur kalit a qeve u japin ujë, që të qetësohen e të pinë ujë mirë e ngeshëm. Te shprehja *bujs!*, pa dyshim, kemi të bëjmë me një leksikalizim nga *ujë*+*b*+*ujë* (mbë+ujë).

Kur marrim për të hetuar burimin e shprehjeve me të gjitha vështrimet e tyre neve na dalin vështirësi, sepse ka në serbishten me dialektet e saj fjalë e shprehje të njëjta me të shqipes.

Një *bûjan*, *jna*, *jno*, si adjektiv ka edhe serbishtja me kuptim: i ardhangët, i rritshëm, i mugullueshëm, i gufueshëm, i dëndur, (sidomos për bimë dhe flokë); një send i rritshëm, i fortë, i njomë, i kërtthndeztë, i këndellshëm (për trupin e njeriut); që dikon a rrjedh rrëmbyeshëm a shpejt (për ujin): Hej, trubaçu, s bujne Drine! Dubrovačka Rijeka, kad je bujna, valja 17 puta više vode no kad je mala”. (Fjalori i Akademisë Serbe të Shkencave dhe të Arteve), *bujica* dhe *bujica* – uji i një përroi a sheu, pasi të dehet bora, fig. buri, shumësi, rrëmujë (e njerëzve) – bujica reçi, misli – rrjedhë mendimesh a fjalësh; në këtë ka edhe një folje; *bujati*; edhe toponimi Bujanovac do të lidhet me kuptimet e sjella në serbishten.

Po të lihet mënjanë toponimi *Bujan* – katund në rrethin e Tropojës e në Kosovë, të gjithë emrat e këtij tipi (bujan, buis, bujis) përdoren në tokërishten jugore, prandaj për nga gjeografia linguistike mund të thuhet se ato nuk kanë një përhapje të përgjithshme në gjuhën shqipe. Prej këndeje për gurrën e këtyre fjalëve nuk jemi në gjendje të shprehim mendim të prerë.

Në blenin e tij VI, Çabej vendon foljen *lentoj* “krijoj” – fjalë e dialektit arbënesh në Dalmaci, për të cilën nga pikëpamja e burimit ktë saj pajtohet me mendimin e Joklit, *Archivum romanicum* XXIV, 16, që e bie të ardhur nga një denominativ me – (ë) *tonj* i landë-s, baza e një lënd(ë)-tonj.

Përsa i përket burimit të foljes *lentoj* të Arbëneshit nga një *landë*, ne

nuk e shohim të mundur një zhvillim të tillë, sepse kuptimi parësor i *landë-*s në ligjërimet gege, së paku, del me vështrim: dru si material ndërtimi; në një uratë fetare, pra në sferën e besimit folja *lentoj* me kuptim *creare* “krijoj”, shumë më lehtë do të përfitohej nga një particip *lej*(me le) *lenë* (te Buzuku: ashtë lenë (tosk. lerë-cum natus esset.).

Curri-n (Curri) e ka fjalori i emrave të përvetshëm te serbët e Milica Gërkoviç – “Vuk Karadžić”, - Beograd, 1977, - për burimin e së cilës ajo shprehet kështu: “Mund të jetë një hipokristik shqiptar a rumun nga Georg” (Krisobulla e Deçanit). Këtu Curri emër familjeje në Malësi të Gjakovës e në Mirditë (Galesius=Gazulli, Hylli i Dritës XVI, 144), një fjalë e moçme që ruhet sot vetëm në gegërishten veriore me kuptime dhe përdorime shumë të përhapura: curr m. “shkëmb i lartë”; *curre* “pelë me flokë të rrallë në ballë”; *currë f.* “dhi me veshë të shkurtër”; *curroj veshët* (ngreh vesh të përprjetë si qeni, kali, mushka prej frike a prej zemërimi); *i curroj veshët* “ia shkurtoj veshët”; *veshcurrë* (Leka I, 115) “veshë të shkurtër e ngrehë përprjetë”. Mendimi i Çabejt (Studime gjuhësore I, 96) që curroj del me kuptim të kryehershëm: “pres, shënoj, shkurtoj” e për curr “i prerë, me majë” – është i mbështetur mirë dhe i pranueshëm, dhe lidhet me *therr* (ther), -ur përvjen prej një r-je sonantike që në shqipen përfaqësohet me një -ur; rr-ja duhet të jetë përftuar nga r-ja me një greminacion ekspresiv.

Čaktar– “këmbanë e cjamin”, e regjistruar në Kolashin të Malit të Zi, te Vuk Karaxhiçi, Fjalori – e përdorim në Kuç të Malit të Zi, gjithashtu dhe në të folmen e malazezëve të Piperit – *čektar*. Përsa i përket origjinës së fjalës në vështrim, I. **Popoviqi** te Studi etimologjici Montenegrini, Ricerche Linguistiche, II, Bolletino dell Istituto di glottologia dell Università di Roma, shpreh mendimin se për arsye të prapashtesës – *tar* që në gjuhët sllave nuk del gjëkund, duhet të ketë burim shqiptar.

Karma “shkëmb, shkrep, kep, shkëmb që ngrihet thikë në majë të malit”: kemi edhe *karpë* e te këto dy forma kemi të bëjmë me ndërrim të shpeshtë *b:m* e *p:m* *harbi-harmi; shqelb-shqelm; tharb-tharm*. Variantet e fjalës sonë në shqyrtim kanë qenë trajtuar nga një varg dijetarësh: sllavisti i

njohur gjerman Max Vasmer, Studien zur alb. Wortforschung I, 25, Revue des études slaves V, 152; Zeitschrift für slavische Philologie XIV, 59, mbi dëshminë e formave të shqipes dhe të përhapjes gjeografike kryesisht në dialektet romane i gjen të ardhura nga një gurrë ilire; këtij mendimi i mbahet edhe Jokli, Vox Romanica VIII, 198. Që në serbokroatisht nuk mungojnë elemente shqiptare në emërtimet e shkëmbinjve, këtë e tregojnë, përveç tjerash, edhe fjalët e përfillura serbokroate *karpa* dhe *shkrapa* “shkëmb që del përmbi faqe të ujit, gumë”, të cilën Vasmeri e nxjerr prej *shkrep* e që Çabej i bie të ardhur nga një shkallë më të moçme, prej njëjësit të hershëm *shkrapa*. Fjala shqipe ka kaluar në dialektet serbokroate.

Katračošiti se ili katračošiti se (Mal të Zi) e jep Fjalori i gjuhës popullore dhe letrare serbokroate me këto vështrime: “krekohem, krekosem, kapërdisem, (mbahem i madh), mbaj kryet përpjetë, pispillosem”; disa emra, ndajfolje me folje të shqipes përmbajnë parashtresën *katra*, siç janë: katralig (lig), katralojë (lojë), katrasyll (syll), katravesh (vesh), katrapilas (pilas), katrapilëz (katrapilas), katrasjell (sjell). Fjalët të cilave u ngjitet parashtesa *katra* tregojnë një veprim apo një gjë të ngatërruar a të shtrembët dhe që del jashtë masës reale, qoftë në kuptimin parësor, qoftë në vështrimin e figurshëm; Fjalori i Akademisë Serbe të Shkencave sjell edhe *katračoš: na katračoš*”, na silu, silom, na zor” (me dhunë, me detyrim, me pahir).

Kur i sillemi burimit të fjalës sonë në vështrim, duke pasur parasysh njëherë përdorimin e saj vetëm ndër të folmet malazeze në një anë dhe mungesën e saj në serbokroatishten dhe në gjuhë të tjera sllave të Jugut dhe sllave përgjithësisht, me zbrëthimin e saj në elemente përbërëse – në formant *katra* dhe në fjalën bazë *qoshe*, një turqizëm i gjallë në gjuhën shqipe, - ne anojmë origjinën e saj ta shohim në shqipen që e dëshmojnë fjalë të përmendura të shqipes të pajisura me formantin *katra*.

Në veprën magjistrale të Akademisë Serbe të Shkencave jepet fjala *kaštar* me përdorim krahinor (Mal i Zi) me këto vështrime: kosh i rrumbullakët misri – atje ku e vënë misrin, ngrehinë e ndërtuar me thupra

dhe e mbuluar me kashtë për të vënë e ruajtur misrin, drithnik” (Jovićević). Në fjalorin e tij etimologjik të serbokroatishtes P. Skok regjistron *kaštar* (Vuk) që si adjektiv merr kuptimet: “i athët, i thartë, thartosh, -e, thartanik (sidomos për verën)”, dhe e përqsas me greq. *kastos* dhe lat. *castus* me të cilën e kryqëzuar me të sllavishtes *ostar* – jep ndoshta *kaštar*. Mbi dëshminë e kuptimeve që merr fjala e sjellë nga Skoku s’ka të bëjë me *koštar* që jepet te fjalori i Akademisë. Ç’është e drejta, në disa të folme të serbokroatishtes në veri të Jugosllavisë, vise-vise edhe në sllovenishten, përdoret, siç thotë Skok, fjala *kašta* me kuptimin: “hambar, drithnik, gardhec, kashtare”, por ajo ka të bëjë me të gjermanishtes *Kaste* “arkë”.

Në truallin e shqipes ka shumë fjalë si rrjedhoja të saj që dalin prej *kashtë-s*. Në fjalorin e vet, Kristoforidhi jep një kashtarë (Tiranë) “atje ku vënë misërinë”, krhs. *gazhdare*, kotec, korronec, koshar”.

Gashdare (grashdare) Elbasan = “ndërtesa me katër qoshe thurë me purteka e mbulume me tjegulla për të vum misërinë”; *gardhec* “grashdare e rrumbullakët e mbulume me kashtë”.

Në fjalorin e Bashkimit, gjejmë këto fjalë të kësaj çerdheje: kashtar – ital. “Castone fatto di vimini per riporre le pannocchie del frumentone”, në Fjalorin e gjuhës shqipe (Tiranë, 1954), jepen këto leksema të thurura me bazën *kashtë*: kashtare = 1. kashtë; 2. Degë misri; 3. flakadâ; folje: kashtoj = vesh me kashtë, mbuloj me kashtë; vesh gardhin e stanit me kashtë; *kahtare*- 1. damixhanë; 2. kasolle me kashtë; 3. ahuri i kashtës, kulla e sanës; *kashtërrojë* = kashta e misrit që mbetet në arë si të jetë prerë misri; *kashtull* = kashta e kumtrit, byku i kumbarës; *kashtup* = lëvorja që mbulon kallin e misrit; *kashturina* = 1. kashtëra; 2. barëra ligatinash; barojë.

Pas këtij vargu rrjedhojash që përftohen prej fjalës shqipe kashtë s’mbetet kurrfarë dyshimi që edhe *kaštar* po me ato vështrime që ka ajo burimin e vet duhet ta ketë te gjuha shqipe pikërisht te leksema + e përmendur *kashtë*.

Në fjalorin e përfillur të Akademisë Serbe të Shkencave jepet edhe

kaštra me përdorim lokal a krahinor me vështrim “kuća” – shtëpi sidomos në gjuhën e muratorëve në rrethinën e Uzhiçës, në masën më të madhe në gjuhën e zanatçinjve në krahun e atij qyteti, në argot e atyre viseve-fjala jonë del me kuptim “kisha”.

Në fjalorin e tij të të folmeve serbe, në Krahinën e Kosovës, G. Elezović jep *keća* – emër ndër myslimanë dhe shqiptarë, por në Fjalorin e madh të Akademisë Serbe të Shkencave jepen një varg nga rrënja *keć*, sikur janë *Kećanović* mbiemër familjeje, mandej folja *kećati* “përpiqem, mundohem, duroj, duke mos e shfaqur dhimbjen; ankoem për vështirësitë, qahem nga dikush për dikë” (Mal i Zi – P. Šoć); Më tej adjektivi *kećav*, a, o, me përdorim të kufizuar: i dobët, i lightë, i dergjishëm, që lëngon, - Nešto sam kećav, pa ne mogu (Mal i Zi – P. Shoq), si edhe *kećava* – emër rose.

Për origjinën e varinateve të ndryshme të fjalës *keć* të përdorura kryesisht në Mal të Zi dhe në Kosovë ndër dialektet malazeze e serbe të atyre vendeve, nuk dyshohet për burimin shqiptar të saj. Fjala shqipe del zakonisht si mbiemër: i keq, e keqe. (Kjo edhe si emër abstrakt). Në shqipen e Greqisë është regjistruar folja *ngoqonem* për zemërohem; për etimologjinë e saj të këqyren Studime gjuhësore I, 273-274 të E. Çabejt.

Knāditi (sknaditi) “thur, hartoj, këndoj një këngë a vjershë, thur një këngë mbi një ngjarje”. Ne bi mogo sve ikxnaditi i saćinit” i u pero složit’ (- Nev. II, 255). Më duket që nga të gjithë studiuesit e kësaj fjale që e kanë fjalorët e serb, e janë të rrallë që e kanë, vetëm T. Maretiçi te Fjalori i Madh i Akademisë Jugosllave të Zagrebit i ka rënë në fije origjinës së saj duke na përudhur që ajo është shumë e rrallë në të folmet serbokroate, prandaj kur mbahet parasysh përdorja e kufizuar e saj do të vijmë – themi ne, te burimi shqiptar i saj. Si nga pikëpamja fonetike, si nga vështirimet, kuptimore të saj, folja *knaditi*, *sknaditi*, *isknaditi* do të ketë buruar prej të shqipes *këndoj*.

Te Fjalori i gjuhës popullore dhe letrare serbokroate i Akademisë Serbe të Shkencave dhe të Arteve, jepen këto fjalë nga onomastika: *Kokez*, mbiemër dhe emër familjeje, pastaj *Kokëza* – emër familje, dhe

Kokezić – emër familje. Këta emra familjesh që dalin padyshim prej fjalës shqipe *kokë* (sllav. i përgjigjet glava – Glavić) gjejnë përdorimin e tyre kryesisht në Dalmaci, Hercegovinë e Bosnë.

Në gjuhën e zanatçinjve 80 për qind e visarit leksikor janë prej brumit të shqipes: *klonište*, ka të bëjë me të shqipes *klumësht*, sot qumësht, në dialektet e veriut kјumsht – *kumsht* (Kosovë). Forma e hershme e *klumshtit* në serbokroatisht do të ketë hyrë në Mesjetën e vonë. Edhe *kishnja*, shprehje e argove për xhaminë, prej të shqipes *kishë*.

Fjalori serbokroatisht i gjuhës popullore dhe letrare jep *kolje* me përdorje krahinore në frazë: nije mi kolje; nemam kolje=nemam kad, nemam vremena.

- Stan' polako crnogorski knjaže! Nijë kölje tražit' banovine, mi ćemo te s carom umirit' (Narodne poslov. Vuk, V, 400). – Kome je putovati' nije mu *kölje* drijemat'! (Vuk, Rječnik). Sidomos pas vështrimit të saj, fjala jonë ka të bëjë me të shqipes – *kohë*; formalisht del vështirësi të mbaresa e saj të rrokja e dytë (ko) – *lje* është shtesë e serbokroatishtes – *lje*, sepse shqiptimi i silabës së dytë që përmban spirantin *h*, ka pësuar asimilimin, sikur e shënojnë për maqedonishten K. Sandfeld, Linguistique balkanique, 68 dhe I. Popović, Zsph, XXIII, f. 127 Koa “*Zeit*”.

Po në atë fjalor kemi fjalën shumë të përhapur në gjuhë të popujve të Ballkanit – edhe në serbokroatishten: *kopile*, gjin. *kopileta* që del më këto vështrime: a) fëmijë ilegjitim, bastardh; b) fig. “zuzar, dinak; hor, kopuk, askushi, kurrkushi”, c) një që është i shkathët, i gjallë në punë, në të ecur, i shkathët, i shpërdhitë, i lehtë, i shpejtë; i zgjuar, veshtar, veshtar, d) dhelperak, dinak; e) dështak; pjella e dështuar; shtijak. Për fjalën *kopil* Skoku pranon mendimin se ajo është relikto gjuhësor i Ballkanit të Vjetër, e burimin e saj e shpie te ilirotrakishtja, “që në gjuhën shqipe është ruajtur trajta e saj më origjinale”. Nga gjuha shqipe shkoi te gjuhë të tjera të Ballkanit. Për burimin e saj, sipas Oštirit e Skokut duhet të nisemi nga e shqipes *pjell* që iu ngjit formanti parashtesor *kα*, për mbledhjen e diftongut *je* te *pjell* = *kopil*, në gjuhën shqipe kemi mbështetje *te vile* nga *vjeļ*, të vishta prej *vjeshtë*.

Te fjalori i Vukut jepet folja *koprcati se* – bëj lëvizje me duar a me këmbë, apo me gjithë trup, hidhem, luaj me këmbë e duar në ujë; fjalën e ka edhe Fjalori serbokroatisht i Akademisë Serbe të Shkencave të Beogradit. Gurrën e saj Weigandi e shihte te e latinishtes *Capritiare* (Capra). Alb. duet. und d. alb. Wörterbuch, ndërsa I. **Popoviq**, IF. Këtë folje e bie të ardhur prej të shqipes *kapërcenj, kapërcej*, hyrë në dialekte serbe në Mesjetë; në këtë mes duhet të vihet në spikamë kalimi i vokalit a-o; për kronologjinë e kësaj dukurie fonetike mund të mbështetemi te shembuj të tjerë: maq. pora (Makedonski jazik, II – 1951, 92), me vështrim: gjeneratë, brez prej sh. *fara*; pastaj *Korda* (Vidoeski, Porečkiot govor, 1950), nga shqipja *gardh*, ku, përveç përfutimit të a-o është zhvilluar edhe shurdhimi i okluzivit g=K.

Do të ketë hyrë prej të shqipes edhe *krena* m. emër dhie; nga shqipja do të kenë kaluar, pa dyshim edhe këta terma të sferës abstrakte: *krenija*, - “kreni, madhështi”, pastaj denominativi krenisati – “krenohem”, si dhe *krenta* – “këshill, tubim, mbledhje”: - Ne, neçû ja da ulazim u tu krentu, (Vuçitern, G. Elezović), “kurthë komplet, përbejm, kongjurë, besatim i fshehtë”.

Edhe për burimin e foljes *krliješiti, krliješim* - “vij papritur, ia beh”; rri ratë, lëshohem me gjithë fuqinë, forcën, me gjithë peshën duke humbur drejtpeshimin, mbështetjen – ne nuk shohim tjetër gjuhë përveç shqipes – “kërleshem” – thuhet për macën, për qenin a për ndonjë shtazë tjetër kur u ngrihen leshrat përpjetë: përleshem, kapem me një; folje e zbërthyeshme në formant *për-* dhe primitivin *lesh*.

Mendimin që fjala *kuventa*, “kuvend, kuvendim, bisedim, bashkëbisedim, këshillim”, si dhe folja *kuveniti, kuvetati* ka hyrë prej gjuhës shqipe – ne e gjejmë të mbështetur mirë: - Jednu kuventu d’učinimo (K. M. Elezović, G. 3); M. Miljanov: Sve nešto kuvetaju izmedju sebe, C. G. Skadar, Šoć.

Një truall në Kuç të Malit të Zi *Mulini* (Etnografski zbornik, VIII, 89), meqë këtë term për të shënuar njëfarë trualli ku dikur kishte ndonjë mulli, - ku jetojnë shqiptarët me shumicë, ka të ngjarë që shprehja jonë *mulini* të ketë hyrë te serbishtja malazeze prej shqipes *mullini*.

Foljen *ošórat* se *ošóram* se si dhe *pošórat* e jep në fjalorin e vet Popovič me kuptim *mokriti* (përmjerr, ndrag, derdh ujët e hollë), në Fjalorin e tij Vuku sjell – *ošurati* , (oparati, osmuditi)’ djeg, përvëloj, shkrumboj”, me përdorim krahinor përreth Drinës. Si nga format, si nga kuptimet foljet e sipërshënuara kanë ardhur nga fjala shqipe *shurrë*.

Shprehja *plaka* për të shënuar një grua të moshuar e të moçme me përdorim krahinor, te mutavxhinjtë e Vranjës, në Serbinë Jugore, ka kaluar prej shqipes *plakë*, nga kjo fjalë, gjithashtu nga shqipja kanë hyrë në serbokroatishten për të emëruar emra familjesh – Plakić, një toponim, katund në Krahinën e Toplicës, krahinë e banuar prej shqiptarësh deri në kohën e Kongresit të Berlinit (1878) – quhet *Pljakovo* (analogjikisht me Takovo, Gjakovo, Smederevo, Podujevo, Valjevo etj.).

Nga dy bazat *mio* dhe *mila* të serbokroatishtes nga *mil* e *mir* (nemir) janë formuar shumë rrjedhoja të reja me anë formantesh, sikur janë: Siraj, (Smiriti); *raz-mir*; *raz-mirica*, sipas P. Skokut, fjala sllave ka shkuar edhe në shqipen –*zmir* (!). Ç’është e drejta, në shqipen kemi *cmir*, *smirë* (zavist) edhe smiroj, e *kam smir* = e kam zili, *smirak* – smirzi, restar; *smirë zezë*; pastaj – *amtimë*, *i samtë* nga *i amtë* (bljutav): *sêmundë* (mund), *skam*, (kam); *smir* (mirë), spagië, paqë (porse s-ja në bazë të fjalive merr kuptimin privativ), s-a=s, nuk ka vështrim privativ, veçse ajo të fjalët serbokroate përforcon kuptimin e tyre. Mendimi i P. Skokut, ER 426 që *zmir* i serb. të ketë shkuar edhe në shqipen, si *zmir*, *smir*, nuk gjen mbështetje sidomos në kuptimet e fjalëve tona në shqyrtim, sepse distanca e tyre kuptimore është shumë e madhe: shq. *smirë-zavist* nga *mirë* me parashtesën privative s.

Më parë botuar te “*Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare*, VI(1979).

Në pjesën e dytë të këtij punimi do t’i sillemi një inventari tjetër, që ka të bëjë me një tubë fjalësh e shprehjesh me burim shqiptar në dialekte të truallit jugor e lindor të serbishtes.

Hetimi i këtij inventari fjalësh e shprehjesh me gurrë shqiptare në të

folmet serbe të truallit të zënë ngoje serb, tash sa kohë është objekt i studimit tonë. Në këtë mes do të marrim në vëzhgim një fond të vogël leksikor të hyrë nga të folmet shqiptare të këtyre anëve në idioma serbe të trevave të përmendura.

-*Štirkinja* (Vuk, Budmani), *širka* dhe *štirkinja* (Kosovë) del me këto vështirime: 1. grua shterpë, beronjë, barkthatë, dhe *širka* (Budmani-Leka) – “beronjë; shterpë; “thuhet për bagëti; bullg. *štirica*, *sterica* – “lopë shterpë”; shqip – *shterpë* thuhet për dele, dhi, lopë, që nuk pjell a që nuk ka pjellë sivjet; - *lule shterpë* = lule që s’ka farë” – thuhet edhe për gra: kjo grua është shterpë, -“është beronjë, barkthatë;” rum. *stir* (Moldavia) – *shtepë*, *barkthatë*, *beronjë*”. Këtë shprehje nga sfera e jetës baritore P. Skok e bie të ardhur prej të greqishtes *stiros*, e mbiemrin e shqipes *shterpë*, si dhe fjalën sllovene *stirp* (Loška Dolina) – me vështirime – “*ftujë, edh njëvjeçar*”, - Skoku i çon te latinishtja ballkanike, në të cilën e sheh zanafillën e tyre.

Mendimi i Skokut për shpjegimin e kësaj etimologjie bashkë me versionet e trajtave të tjera në gjuhët e përmendura nuk del i mbërthyer mirë duke ngjallur dyshime. Para së gjithave, gjykimi i tij mbi huazimin e një lekseme të tillë për të shprehur një nocion elementar të shterpësisë së gjëve të gjalla dhe të grave, mbi mungesën e pjellorisë së bagëtive, si dhe të grave, - për ne nuk është i mbështetur mirë.

S’ka asnjë gjuhë ballkanike, qofshin edhe ato fondi leksikor i të cilave është rralluar tepër me ndikime të jashtme, që për të shprehur nocionin e shterpësisë së gjëve të gjalla shtëpiake mos të ketë ruajtur së paku disa leksema burimore. Për të qendruar në truallin e shqipes, të themi që vetëm ajo ka së paku tri fjalë për të shprehur një nocion të tillë: *shterpë*, *beronjë*, *barkthatë*.

Në sferën e blegtorisë dhe të jetës baritore ka terma sikundër janë: *shter*, *shterr* nga i cili arketip do të kenë dalë pa kurrfarë dyshimi adjektivi *shterpë* emri *shtjerra*, *shqerra*, *prandaj* fjala *shterpë* nuk mund të ketë të bëjë kurrsesi me të latinishtes *extirpus*, qysh gjykonte P. Skok në fjalorin e tij etimologjik të serbokroatishtes, aq më pak mund të afrohet te e

sllovenishtes *strip*– “ftujë”, që do të ketë burimin te *exstirpus*.

Format e shprehjes *shterpë, shter, shterr, shterc (plak i lënë), shtjerrra, shqerra*, do t'i bashkohen trajtës së foljes *ter* = thaj nga një më e vjetër *tar*, që ruhet si oronim e hidronim këtij e përtej Adriatikut: *Tara, Tarentum, Taranto*, mbase edhe *Tarabosh*, e *shter, shterr*; përrenj e lumenj që shterin verës në viset jugore, sidomos nëpër trevat karstike, janë një dukuri e ditur për gjeografinë, Çabej, Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës 1963/3, 98, 99. Që të gjitha këto fjalë janë përfutuar përbrenda gjuhës shqipe dhe nga burimi i saj leksikor. E për sa i përket termit štirkinja, i përdorur në terminologjinë baritore e blegtorale të serbokroatishtes, mbi bazën e njoftimeve tona, burimin e saj e shohim të gjuhës shqipe.

Në fjalorin e gjuhës popullore dhe letrare të serbokroatishtes që hartohet në Akademinë Serbe të Shkencave dhe të Arteve gjejmë foljen: *zaprušiti, zàprušim*, një krahinarizëm që del me këto kuptime: “këllas, shtie në dhé, mbuloj, mbush me dhé, me zall, me ranë”: - Domaćice, čim izmaknu lonac s jelom iz ognjišta, odmah *zàpruše* onaj krug pepela koji je lonac ostavio; Daj, idi zapruši tu rupčinu. Në shtëpinë e zjarrit, në votër, në mbrëmje, pasi të përgatitet gjella e të hahet darka, prushi i zjarrit do të mbulohet me hi, që gacat të ruhen për zjarrin e nesërm. Po t'i sillemi fjalës sonë në shqyrtim *zaprušiti, zaprušim*, që del me një vështrim të caktuar, ne nuk arrijmë ta afrojmë te çfarëdo folje tjetër të serbokroatishtes, që të ketë një kuptim të afërt me fjalën tonë në studim; një farë afërie fonetike dhe kuptimore e gjejmë te shprehja *zaprashiti* e serbishtes, e dalë nga *prah-pluhur*, “pluhroj, pluhuros, bëj me pluhur, ngre, çoj pluhur”. Po të merrej si fjalë vendi do të mbetej i pashpjeguar ndërrimi nga *zaprušiti* dhe në fonetikën e serbokroatishtes nuk ka mbështetje.

Mbi mbështetjen e shpjegimit të sipërm fonetik e vështrimor, foljen serbe *zaprušiti* ne e gjejmë të sajuar nga e shqipes *prush* i zgjeruar me parashtesën sllave *za*.

Në fjalorin e Akademisë Serbe të Shkencave, që posa u përmend, regjistruam edhe një folje tjetër për burimin e së cilës ngjallen dyshime dhe shprehen pikëpamje të ndryshme; është fjala për foljen *zašátiti, zašátim* me

përhapje të kufizuar, e krahinore te Uzhica, në Serbinë Perëndimore, që del me një vatër të gjerë vështrimore: “kap, marr, nxjerr, rrëmbej, përfshij, rrok një sasi ujë, ose diçka tjetër”.

Po të duam të ndjekim etimologjinë e kësaj fjale, si çdoherë, edhe këtu pikësëpari ajo do të zërthehet në elemente të saj përbërëse; pastaj, po s’qe e mundshme të bëhet një analizë e tillë e saj, që do të thotë se, pas të gjitha gjasave, nuk është e përfutur nga burimi i gjuhës amtare, atëherë do të rrihet një rrugë tjetër duke kërkuar lidhjet e jashtme të saj. Në rastin konkret, një – *šat*, që kur të veçohej do të dilte nga *zašatiti*, nuk është e vërtetuar kund në ndonjë prej gjuhëve sllavojugore, që të përkonte si nga forma, si nga kuptimi me fjalën tonë në shqyrtim. Prandaj, deshëm, s’deshëm, do t’i drejtohem një gjuhe tjetër të popujve fqinjë. Për mendimin tonë, fjala e shqipes *shat*, si nga pikëpamja fonetike, si nga ajo kuptimore, i përgjigjet për mrekulli foljes së dialekteve serbe *zašatiti*, një postverbal nga *šat*, të cilit i është ngjitur parashtesa sllave – *za*, duke krijuar një folje me kuptim: “*marr, rrok me shat dhé*”.

Nga ky fjalor i Akademisë së Beogradit hartimi i të cilit s’ka arritur as te gjysma e kësaj përmendoreje madhështore të kulturës së popullit serb, kroat, malazez e mysliman, nxorëm fjalën *délak, àka*, djalosh, djalë i rritur, 14-16 vjeç; Fjalori kishte edhe një formë tjetër *dalapak* me kuptim – “djale 8-14 vjeç”; këto fjalë paraqiten në një truall të kufizuar gjatë Anamoravës, në Serbinë Lindore.

Mbi dëshminë e fakteve dhe në mbështetje të njohurive tona mbi të folmet serbe të këtyre anëve, ne nuk dimë të ketë kund në gjuhët sllavojugore, ndonjë fjalë me trajtë të ngjashme që të përkonte me këtë tonën, si nga pikëpamja fonetike, si nga ajo vështrimore. Për mendimin tonë, nuk mund të quhet kontribut në hetimin e saj as gjykimi i Prof. Momčilo Savićit, i shfaqur kohët e fundit në Južnoslovenski filolog, XXX, 1-2, që shprehjen *delak* e heq të ardhur nga një turqizëm me gurrë arabe – *dželat*, shqip *xhelat* – “ai që zbaton publikisht dënimin me vdekje të një njeriu, duke i prerë kokën, fig. njeri pa mëshirë, mizor”, sepse sidomos nga pikëpamja e kuptimit kurrsesi nuk i afrohej fjalës sonë në studim.

Në historinë e kësaj fjale *delak*, duke hapur një shteg tjetër, na mban shpresa se me këtë rrugë do t'i jepet zgjidhja e kënaqshme kësaj çështjeje. Përballë gjeografisë dialektore nuk është vështirë të mendohet një shprehje e të folmeve shqiptare përreth burimit të Moravës – *djalë*, në këto anë *gjal*, shumësi *gjel*, të jetë shtrirë njëherë si term në gjuhë të fshehta serbe të këtyre anëve në të cilat pjesën dërmuese të inventarit të tyre leksikor e përbëjnë leksemat e gjuhës shqipe. Ndonjë fjalë nga sfera e gjuhëve të zanatçinjve, me kohë, mund të jetë shtrirë edhe në gjuhën e përditshme të popullsisë serbe të këtyre anëve.

Në Fjalor të Akademisë Serbe të Shkencave gjetëm të regjistruar një folje me shumë forma, është fjala për shprehje *zdeknuti*, *zdeknem*, me përdorim krahinor, e me kuptime: “vdes, ngordh”. – Samo da oće jedared taj matori *zdeknuti* da i mi što nasledimo (Bačka, Radonić N.), Vojv, Bori. Pop. Dj.4) = “Veç të vijë koha e të ngordhë kjo rrole, që edhe ne të trashëgojmë diçka nga pasuria”. Nga forma *zdeknuti* u përfatuan edhe trajta të tjera, sikur janë këto: *zdićiti*, *zdoknuti*, pastaj *zdoksati*, *izdekati*, (vdes, ngordh, e shtroj në dru, ja vesh një shuplakë). Meqë në dialektet e gjuhëve sllavojugore nuk e shohim elementin primitiv të foljeve në shqyrtim për ne rrënja nga e cila u përftua gjithë kjo lagje foljesh, do të kërkohet në truall të shqipes, pikërisht te trajta participore – dek, herë-herë edhe te tema e aoristit diç (dić), në serbishten të pajisura me parashtesa dhe prapashtesa, sidomos infinitivore *a*-ti që nganjëherë marrin edhe infikse, d.m.th. vokale-lidhëse.

Forma e foljeve të përmendura janë shënuar e regjistruar në truallin dialektor të serbokroatishtes e të maqedonishtes, në jug të Serbisë, në Kosovë, Maqedoni dhe Bosnë.

Në këtë Fjalor, shumë herë të përmendur, morëm edhe shprehjen *zdegač*, një fjalë dialektore me kuptim – “shkop për të shprishur leshin”. - Kozina se prostre po dasi pa se *zdegač* uzima u ruke i seca neprestano, te se tako kozina razbija ili raztresna – (Mij, 7, 89). Po të duam ta veçojmë këtë fjalë në pjesët e saj përbërëse, s'ka sesi mos të zbërthehet në deg, që del si temë e saj e që në serbokroatishte s'i gjendet kund filli. E po t'i sillemi shqipes, atëherë do të gjejmë fjalën *degë*, që mrekullisht përkon me

shprehjen në shqyrtim si nga pikëpamja fonetike, si nga ajo e kuptimit. Në katunde gratë shprishin leshin zakonisht me njëfarë shkopi a dege që përgatitet nergut për rrahjen e tij.

Autorët e këtij Fjalori s'janë përpjekur ta shpjegojnë shprehjen *zàpus* pa i dhënë kuptimet e saj; - I to Vlaše *zàpus* učinilo (Vuk, Fjalori); në mbështetje të kësaj frazeologjie, për mendimin tonë, fjala gjen shpjegimin përbrenda shqipes, te *pus* – “*izvor*” që është i ngjitur parashtesa sllave – *za*, nga lidhja sintagmatike – *e bane pus, e paske ba pus*, (nagrdio si ga, uprskao si ga).

Në të folmen malazeze është shënuar, e Fjalori i Akademisë Serbe të Shkencave “regjistron” foljen *zarepati, zàrepam*, – “premtoj, jap fjalën, zotohem”; zgjedhim mesor – *zarepati se, zotohem, rrëfëhem*” - zarepao se pred poštenim ljudima da neće to više učiniti, (u ka dhënë fjalën burrave se nuk do të bëjë më punë të tilla të këqija!).

Edhe se nuk do të pritej, kjo folje gjen shpjegimin e vet vetëm përbrenda shqipes, te folja e sferës fetare – *rrëfëhem*, që me kohë është shtrirë edhe te sfera të tjera pa u larguar nga qendra e saj kuptimore. Në këtë punë duhen shpjeguar disa ndryshime a ndërrime fonetike, që janë kryer në fjalën tonë në studim – *zarepati*, është fjala për ndërrimin e *F:P*, një dukuri fonetike kjo relativisht e vjetër në të gjitha gjuhët sllave; *focaccia=pogač* gr. *Trafos=trap; frigere-priganica*; nga shqipja *farë*, maq. *pora* – “brez, gjeneratë” (Makedonski jazik, II (1951), 92; Ivan Popović, Grčko-srpske lingvističke studije, III, Zbornik radova Vizantološkog instituta, knj. III, par.6.). Ndërrimin *F:P* në dialekte të maqedonishtes e ndeshim te fjala: *kepte* = “gërmaz, fyt” (Vidoeski, Porečkoit govor, 1950), që në maqedonishten do të ketë hyrë, pa dyshim prej të folmeve shqiptare në Maqedoni – “qafë, qeft” (sqep). Te *porá* e maqedonishtes me gurrë shqiptare prej *fara*, sikundër u tha pak më lart, është kryer edhe ndërrimi fonetik, që pasqyrohet në mbylljen e *a-së* në *o*, që shprehet edhe në një tjetër, rast, te *korda* e maqedonishtes nga shqipja *gardh*; *a>o, =dh>d*.

Na mbetet të themi diçka edhe për kronologjinë e kësaj shfaqjeje: kur është kryer këmbimi i *F:P*, në një anë, dhe mbyllja *a>o*, në anën tjetër.

Mbi dëshminë e shumë fjalëve të huazuara nga greqishtja në serbokroatishten, maqedonishten, këmbimi f > p bie në mesjetë, duke vepruar deri nga fundi i saj; e mbyllja e vokalit *a* me *o* është një dukuri fonetike e serbishtes së vjetër dhe e maqedonishtes, që në këto dy gjuhë sllave vepronte në kohën e dokumenteve të para shkrimore të tyre, që do të thotë se edhe mbi dëshminë e dy huazimeve maqedone me gurrë shqiptare *pora ara, korda gardh*, vërtetohet vjetërsia e madhe e këmbimit të *ao*, I. Popović, Grčko-srpske lingvističke studije, III, 131.

Shprehja *lökora*, (Ston në Dalmaci) 1. “pjesa e fortë e mishit, 2. zhangël, lapër e mishit”; augmentativi i saj *lakorina* – “lëkurë që mbështjell një muskul a një gjëndër” (Dubrovnik, Ston), del e pajisur edhe me deminutivin *-ica* – *lakorinica* (Skok, fjalori etimologjik). Te Fjalori i tij, Skoku gjen te kjo shprehje një fjalë të shqipes, nga *lëkura*, e për ne, përkundrazi, ajo do të ketë ardhur prej *lakur* nga e cila u përftua *lakuriq*.

Nga fjalori i Akademisë Jugosllave të Zagrebit, Skoku mori dhe e radhiti foljen *šuriti, šurim* (Sllavonia, Kroacia, Bosna) që del me këto kuptime: “përvëloj me një valë, e përvëloj, e përcëlloj, djeg”, por pa u shprehur për etimologjinë e saj. Për ne kjo fjalë ka të bëjë me leksemën e shqipes *shurrë*, një fjalë e mbarë gjuhës, postverbal i shprehjes së shqipes. Si shumë fjalë të tjera, edhe kjo jona është e sferës së gjuhëve të fshehta të zanatçinjve në Serbinë Lindore dhe Jugore dhe Maqedoni, fondin e të cilave në pjesën e tyre më të madhe e përbëjnë fjalët shqipe.

Me këtë hov nuk do të marrim në hetim problemet e fonetikës se të dyja gjuhëve tona, edhe pse e quajmë shumë të dobishme t’i afrojmë këto dy gjuhë në plan të fonetikës. Duke i lënë ato mënjanë, po përmendim vetëm formantin *-za* që del te ndonjë fjalë të serbokroatishtes; *dretza* me burim të shqipes *dredhëz-za*, ai u shtri edhe në antroponiminë sllavoju-gore; nga Ivo-Iveza, Ivezic (=Ivić) e regjistruar në Grudë, që pastaj u përhap edhe në vise të tjera të Sanxhakat, të Malit të Zi, të Serbisë. Formantin në fjalë e kanë edhe këto antroponime: *Nikeza, Nikezići* prej *Niko, Nika*, pastaj *kokeza*, Dalmacia (nga apelativi i shqipes kokë, kokëza (glava, glavica, Glavić).

Krahina e Kuçit në Mal të Zi është njëra nga zonat etnikisht të përziera shumë interesante; një shembull kalkimi (përkthim nga shqipja në serbisht) më së miri vërtetohet: “Govori se da je to bilo mrtvije i ranjenije Kuča i Pipera stotinu, ali Pipera *tvrdlo malo*, no su sve Kuči bili”, Marko Miljanov, Pleme Kuči u narodnoj priči i pjesmi, Titograd, 1967, str. 46, ata që paksa e njohin shqipen, do të diktojnë menjëherë se në bashkëlidhjen – *tvrdlo malo* kemi të bëjmë me një përkthim fjalë për fjalë të lidhjes sintagmatike *fort pak* që del me kuptim shumë pak *tepër pak*.

ASHAK, Vepra 3, Prishtinë, 1998

MBI DISA FJALË E SHPREHJE SHQIPE NË DIALEKTET E SLLAVËVE TË JUGUT

Në blenin XXX, fashikulli 1-2, f. 579-587 të Južnoslovenski filolog, Prof. Momčilo Savić botoi një punim të shkurtër me titull: “Burimi dhe vështrimi i një fjale në Serbinë Lindore” (Đelak) dhe u përpoq ta vërtetonte gurrën dhe kuptimin e kësaj shprehjeje të rrallë të përdorur në fondin leksikor të popullsisë së asaj ane.

Do t’i sillemi kësaj çështjeje, sepse na duket që ka elemente dhe dëshmi që na përudhin nga një zgjidhje tjetër, prandaj po marrim ta hetojmë duke shkoqitur mendimin tonë.

Në blenin e përmendur të revistës së njohur Južnoslovenski filolog, Prof. Savići kishte ngritur çështjen e burimit të shprehjes “delak” që nga të gjithë doracakët leksikorë e sjell vetëm Fjalori i serbokroatishtes letrare dhe popullore që hartohet në Akademinë Serbe të Shkencave dhe të Arteve në të cilin thuhet pikërisht: “Đelāk-āka, fjalë krahinore me vështrime: çun, djalosh, (Trojanović, Gl. – E.M. 1926, 61). Po në këtë fjalor jepet edhe shprehja *đalapak* me domehtënie: çun, djalosh 8-14 vjeç (Tupižnica), që mbi dëshminë e vështrimeve të saj nuk mund të jetë gjë tjetër, veçse do të lidhet me *đelak*.

Që në fillim do të theksojmë se fjala *đelak* ishte regjistruar në një truall të Serbisë Lindore dhe të Bregmoravës; e sa i përket rrezes vështrimiore të saj, mendojmë se s’ka gene nevoja t’i shtrohej vatrës së saj kuptimore asnjë domethënie tjetër plotësuese.

Meqë edhe Prof. Savići e kishte përsjatur se fjala jonë në hetim s’mund të ishte me prejardhje sllave, atë e interesonte në mënyrë të veçantë tama e saj zanafillëse dhe rrugët që i përshkoi duke u shfaqur në të folmen serbe të Serbisë Lindore dhe të Bregmoravës. Për këtë qëllim mori të gjurmojë mos fjala jonë në shqyrtim lidhet kund me ndonjë prej gjuhësh

fqinje të popujve joslavë që gjëllinin apo gjëllijnë edhe sot e gjithë ditën në ato anë.

Në disa doracakë dygjuhës Prof. Saviçi kishte ndeshur më një fjalë të ngjashme për nga trajta të regjistruar në të folme të rumanishtes *gealak*, vllah. *Gelak* me vështrim xhelat, gjakësor, div, xhin, dorás, grindavec, megdanxhi; në kuptimin figurativ fjala del me vështrim: “rrugaç, torrollak, ngalakaq, karabush, kastravec, trim, i fuqishëm, i fortë; zemërak, i rrëmbyeshëm”.

Në përmbledhjen Cintece batrinesti si doine, që përmbante material folklorik, i qëmtuar në territorin jugosllav, në jug të Danubit nga folkloristi rumun Cristea Sandu Timoc gjendej në atë një hope këngësh lirike dhe epike edhe vjersha Tarul Murat și Radu Voivoda (Car Murati dhe Vojevoda Radu) me këto vargje.

” *Voi Cinici sute de gelați*”

(Ju të pesëqindtë xhelatët).

Prof. Saviçi shpreh dyshim që shprehja *gelati* (gjelaci) në vargun e përmendur të ketë kuptim *xhelat*, sepse, pas mendimit të tij, me gjithë lirinë dhe hiperbolizimin poetik të tepruar, s’do të kishte kuptim që sulltani të mobilizonte pesëqind xhelatë për t’ia këputur kryet një vojvode të vetëm.

Gurrën e shprehjes serboktoate *đelat* dhe burimin e të rumanishtes *gelat*, *gelat* e shpien, pa farë dyshimi tek arabishtja *gallad-galada*, që nëpërmjet turqishtes ka depërtuar në të gjitha gjuhët ballkanike.

Kuptimi i parë i kësaj fjale si në serbokroatishten si dhe në çdo gjuhë tjetër ballkanike është ky: *xhelat*, gjakësor, doras, tiran, mizor, kapadai; pastaj kuptimet e figurshme – “trim, i fuqishëm, i fortë, zemërak, i rrëmbyeshëm” nuk largohen fare nga vatra themelore e vështrimit; në këtë mes e kemi parasysh shprehjen që, siç thamë, nëpërmjet turqishtes u shtri në të gjitha gjuhët e popujve të Ballkanit, pra është fjala për emërtimin “dželat”, mbi të cilin do t’i themi nja dy fjalë.

Në fillim të theksojmë që duke u mbështetur në logjikën e

shëndoshë dhe duke mbajtur parasysh nevojën gjuhësore, ne nuk shohim kurrfarë arsyeje që të folmet serbe në Serbinë Lindore dhe Bregmoravën në një kohë të caktuar të kenë qenë të shtrënguara të huazojnë nga vllahishtja një turqizëm të njohur edhe më parë me qëllim që ta pasurojnë qarkun e tij edhe me një vështrim përfytyrues “i fortë, k i fuqishëm, zemërak, i rrëmbyeshëm”.

Shprehja *dželat* do të jetë shtrirë në gjuhë të Ballkanit, sepse paraqiste një risi në procedurën gjyqësore të kodit penal turk, e sa për kuptimet përfytyruese të termit në vështrim të folmet serbe të atij krahu do të kishin në dispozicion një arsenal të tërë mundësish shprehjeje burimore.

Kur bëhet fjalë për origjinën e termit *dželak* që në fillim mund të themi se prejardhja e tij do kërkuar të të folmet shqiptare, në pellgun e Moravës së Sipërme, sepse duhet të mbahet parasysh fakti që në argotë e zanatçinje të Leskovcit, të Nishit, të Vllasotincës dhe maqedone, - pjesa më e madhe e fondit leksikor është me burim shqiptar, prandaj me të drejtë mund të pritët që ndonjë shprehje e atij visari leksikor të jetë shtrirë edhe në përdorje të gjuhës së përditshme.

Duke shfletuar shumë punime dhe studime mbi gjuhët e fshehta a argotë¹ e zanatçinje të dikurshëm nëpër qendra të përmendura, kemi konstatuar, ç’është e drejta në një masë të vogël, që thërmiqe të brumit leksikor të të folmeve shoqërore kanë zënë vend e janë ngulitur në leksikon e të folmeve territoriale duke fituar të drejtë përdorimi në ligjërimin e përditshëm si mjet komunikimi në mes të bartësve të të folmeve a të gjuhës së njësuar letrare:

Ćeno – qeni – qen i vogël

Keć – keća, kić, kića, thirmë e barinjve kur ndjellin a ngasin dhinë (Hercegovinë)

Rulek – ruljka (pelene, - mnela)

Ruljče

¹ M. D. Milićević, Kneževina Srbija, 1884.

Lika (ujët e hollë)

Ljiljka (kad dete ukvasi pelene, kaže se napravila se *ljiljka* – (Vranje), (materiale në Fjalorin e Akademisë Serbe të Shkencave dhe të Arteve).

Trem (trim)

Vajza (vajzë)

Djale (çun, djalë).

djalac

đale

đaljarče

đalarče

Në argotë maqedone janë regjistruar këto fjalë:

đalovče, *đaljovče*, - fëmijë (Makedonski jezik, 1951, 3-4).

đalapak (çun, djalosh 8-14 vjeç).

đalac – ofiq familjar (Erdeljanović)

đaletić – patronim (Šobajić), Fjalor i serbokroatishtes letrare dhe popullore i Akademisë Serbe të Shkencave dhe të Arteve.

Në pikëpamje të vështrimit në mes *dželak* në një anë dhe *dželarče*, *đalac*, *đale*, *đalovče*, *đaljovče*, në anën tjetër, kemi një përkim të mirëfilltë në kundërshtim me vështrimin përfytyrues të shprehjes rumune, vllahe apo moldave *gealat*, *gilat*, *gelat* “njeri i fuqishëm, i fortë”. Në rastin e parë, me rastin e fjalës *dželak* me forma të tjera të afërta kemi të bëjmë me një kuptim rreptësisht të caktuar – çun, djalosh 8-14 vjeç pa farë plotësimesh të tjera, kurse fjala vllahe *gilat*, *gelat* që Prof. Saviçi i paravendon bazë të përfutimit të shprehjes *dželak* të përdorur në të folmen e Serbisë Lindore dhe të Bregmoravës në pikëpamje të vështrimit paraqet një vetëkundërshti.

Në planin fonologjik shpjegimi është i dukshëm, sepse *dželak* me trajtat farefisnore *dželarče*, *dželjarče* dalin nga format e shumësit të të folmeve shqiptare të pellgut të Moravës së Sipërme dhe prej ligjërimeve shqiptare në Maqedoni, d.m.th. prej fjalës *djalë* shumë *djel* (m) – fëmijë, çuni, çifti konsonantik *dji* të cilave është shndërruar në *gi* (đ) në mënyrë që

edhe trajta e njëjësit *džalac, đale, đalovče, đaljovče* në pozicionin nistor kanë marrë e janë qiellzorëzuar.

Në rrafshin morfologjik fjala jonë është formuar duke iu ngjitur elementit themelor morfema *-ak*, sikur te fjalët: *sëdmāk, pètāk, vēštāk, pròstāk*: elementi primitiv *đel* del edhe te rrjedhja me elemente prapashoresore – *ak, avče, e*, në dialekte shoqërore të maqedonishtes trajtave të qiellzorëzuara njëjës *đal, đel*, u është ngjitur prapashtesa – *ovče: đalovče, đaljovče*.

Më në fund, kur marrim të përmbledhim ç'thamë deri këtu në lidhje me fjalën *dželak*, jemi bindur se shprehja shumë herë e përfillur si në pikëpamje të formimit fonetiko-morfologjik e sidomos për nga ana veshtrimore e saj, fjala jonë në shqyrtim nuk mund të rridhte dot prej të vllahishtes *gilak, gelak* (rum. *gealak*), së cilës në gjuhët ballkanike i përgjigjet turqizmi me origjinë arabe *dželat, (xhelat)*. Burimit të fjalës sonë në idiomat serbe të Serbisë Lindore prej të folmeve vllahe i bien ndesh vështirësitë e pakapërcyeshme, sidomos të natyrës veshtrimore.

Curi-n (Curri) e ka fjalori i emrave të përvetshëm te serbët e Milica Grkoviç – “Vuk Karadžić”, - Beograd, 1977, - për burimin e së cilës ajo shprehet kështu: “Mund të jetë një hipokoristik shqiptar a rumun nga Georg” (Krisobulla e Deçanit). Këtu Curri emër familjeje në Malësi të Gjakovës e në Mirditë (Gelasius = Gazulli, Hylli i Dritës XVI, 144), një fjalë e moçme që ruhet sot vetëm në gegërishten veriore me kuptime dhe përdorime shumë të përhapura: *curr* m. “shkëmb i lartë”; *curre* “pelë me flokë të rrallë në ballë”; *curre* f. “dhi me veshë të shkurtër”; *curroj veshët* (ngreh veshët përpjetë si qeni, kali, mushka prej frike a prej zemërimi); *i curroj veshët* “ia shkurtoj veshët”; *veshcurrë* (Leka I, 115) “veshë të shkurtër e ngrehë përpjetë”. Mendimi i Çabejt (Studime gjuhësore I, 96) që *curroj* del me kuptim të kryehershëm: “pres, shënoj, shkurtoj” e për *curr* “i prerë, me maje” – është i mbështetur mirë dhe i pranueshëm, dhe lidhet me *therr* (ther), *-ur* përvjen prej një *r*-je sonantike që në shqipen përfaqësohet me një *-ur*; *rr*-ja duhet të jetë përftuar nga *r*-ja me një geminacion ekspresiv.

Čaktar – “këmbanë e çjapit”, e regjistruar në Kolashin të Malit të Zi, te Vuk Karaxhiçi, Fjalorin e përdorin në Kuç të Malit të Zi, gjithashtu dhe në të folmen e malazezëve të Piperit – *čektar*. Përsa i përket origjinës së fjalës në vështrim, I. **Popoviqi** te Studi etimologjici montenegri, Ricerche linguistiche, II, Bolletino dell Istituto di glottologia dell Università di Roma, shpreh mendimin se për arsye të prapashtesës – *tar* që në gjuhët sllave nuk del gjëkund, duhet të ketë burim shqiptar.

Karma “shkëmb, shkrep, kep, shkëmb që ngrihet thikë në majë të malit”; kemi edhe *karpë* e te këto dy forma kemi të bëjmë me ndërrim të shpeshtë *b:m* e *p:m*; *harbi-harmi*; *shqelb-shqelm*; *tharb-tharm*. Variantet e fjalës sonë në shqyrtim kanë qenë trajtuar nga një varg dijetarësh: sllavisti i njohur gjerman Max Vasmer, Studien zur alb. Wortforschung I, 25, Revue slavistique V, 152; Zeitschrift für slavische Philologie XIV, 59, mbi dëshminë e formave të shqipes dhe të përhapjes gjeografike kryesisht në dialektet romane i gjen të ardhura nga një gurrë ilire; këtij mendimi i mbahet edhe Jokli, Vox Romanica VIII, 198. Që në serbokroatishten nuk mungojnë elemente shqiptare në emërtimet e shkëmbinjve, këtë e tregojnë, përveç tjerash edhe fjalët e përfillura serbokroate *karpa* dhe *shkrapa* “shkëmb që del përmbi faqe të ujit, gumë”, të cilën Vasmeri e nxjerr prej *shkrep* e që Çabej e bie të ardhur nga një shkallë më të moçme, prej njëjësit të hershëm *shkrapa*. Fjala shqipe ka kaluar në dialektet serbokroate.

Katračošiti se ili *katročošiti* se (Mal të Zi) e jep Fjalori i gjuhës popullore dhe letrare serbokroate me këto vështrime: krekohem, kreko-sem, kapardisem, (mbahem i madh), mbaj kryet përpjetë, pispillohem”: disa emra ndajfolje dhe folje të shqipes përmbajnë parashtesën *katra*, siç janë: katralig (lig), katralojë (lojë), katrasyll (syll), katravesh (vesh), katrapilas (pilas), katrapilëzj (katrapilas), katrasjell (sjell). Fjalët të cilave u ngjitet parashtesa *katra* tregojnë një veprim apo një gjë të ngatërruar a të shtrembët dhe që del jashtë masës reale, qoftë në kuptimin parësor, qoftë në vështrimin e figurshëm; Fjalori i Akademisë Serbe të Shkencave sjell edhe *katračoš*. na *katračoš* “na silu, silom, na zor” (me dhunë, me detyrim, me pahir).

Kur i sillemi burimit të fjalës sonë në vështrim, duke pasur parasysh njëherë përdorimin e saj vetëm ndër të folmet malazeze në një anë dhe mungesën e saj në serbokroatishten dhe në gjuhë të tjera sllave të Jugut dhe sllave përgjithësisht, me zbërthimin e saj në elemente përbërëse në format *katra* dhe në fjalën bazë *qoshe*, një turqizëm i gjallë në gjuhën shqipe, - ne anojmë origjinën e saj ta shohim në shqipen që e dëshmojnë fjalët e përmendura të shqipes të pajisura me formantin *katra*.

Në veprën magjistrale të Akademisë Serbe të Shkencave jepet fjala *kaštar* me përdorim krahinor (Mal i Zi) me këto vështrime: “*kos^{hi}* rrumbullakët misri – atje ku e vënë misrin, ngrehinë e ndërtuar me thupra dhe e mbuluar me kashtë për të vënë e ruajtur misrin, drithnik” (Jovićević). Në fjalorin e tij eimologjik të serbokroatishtes P. Skok regjistron *kaštar* (Vuk) që si mbiemër merr kuptimet: i athët, i thartë, thartosh, - e, thartanik – (sidomos për verën”, dhe e përqsas te greq. *kestros* dhe te lat. *castus* me të cilën e kryqëzuar me të sllav. oštar – jep ndoshta *kaštar*. Mbi dëshminë e kuptimeve që merr fjala e sjellë nga Skoku s’ka të bëjë me *kaštar* që jepet te fjalori i Akademisë. Ç’është e drejta, në disa të folme të serbokroatishtes në veri të Jugosllavisë, vise-vise edhe në sllovenishten, përdoret, siç thotë Skok, fjala *kašta* me kuptimin: “hambar, drithnik, gardhec, kashtare”, por ajo ka të bëjë me të gjermanishtes *kaste* “arkë”.

Në truallin e shqipes ka shumë fjalë si rrjedhoja të saj që dalin prej *kashtë-s*. Në fjalorin e vet, Kristoforidhi jep një kashtarë (Tiranë) “atje ku vënë misërinë”, khs. *gashdare*, kotec, korronec, koshar”.

Gashdare (Grashdare) Elbasan = “ndërtesë me katër qoshe thurë me purteka e mbulueme me tjegulla” për të vûm misërinë; *gardhec* = “grashdare e rrumbullakët e mbulueme me kashtë”.

Në fjalorin e Bashkimit gjejmë këto fjalë të kësaj çerdheje: *kashtar* – ital. “cestone fatto di vimini per riporre le pannocchie del frumento ne”, në Fjalorin e gjuhës shqipe (Tiranë, 1954), jepen këto leksema të thurura me bazën *kashtë*: kashtare, = 1. kashtë; 2. degë misri; 3. flakadâ; folje: kashtoj = vesh me kashtë, mbuloj me kashtë; vesh gardhin e stanit me kashtë; *kashtore* = 1. damixhanë; 2. kasolle me kashtë; 3 ahuri i kashtës, kulla e

sanës; *kashtërrrojë* = kashta e misrit që mbetet në arë si të jetë prerë misri; *kashtull* = kashta e kumtrit, byku i kumbarës; *kashtup* = lëvorja që mbulon kallin e misrit; *kashturina* = 1. kashtëra; 2. barëra ligatinash; barojë.

Pas këtij vargu rrjedhojash që përftohen prej fjalës shqipe kashtë s'mbetet kurrfarë dyshimi që edhe *kaštar* po me ato vështrime që ka ajo burimin e vet duhet ta ketë te gjuha shqipe pikërisht te leksemat e përmendur *kashtë*.

Në fjalorin e përfillur të Akademisë Serbe të Shkencave jepet edhe *kaštra* me përdorim lokal a krahinor me vështrim “kuća” – shtëpi sidomos në gjuhën e muratorëve në rrethinën e Uzhiçës, në masën më të madhe në gjuhën e zanatçinjve në krahun e atij qyteti, në argot e atyre viseve – fjala jonë del me kuptim “kisha”.

Në fjalorin e tij të të folmeve serbe, në Krahinën e Kosovës, G. Elezović jep *keća* – emër ndër myslimanë dhe shqiptarë, por në Fjalorin e madh të Akademisë Serbe të Shkencave jepen një varg nga rrënja *keć*, sikur janë *Kećanović*, mbiemër familjeje mandej folja *kećati* përpiqem, mundohem, duroj, duke mos e shfaqur dhimbjen; ankohe për vështirësitë, “qahem nga dikush për dikë” (Mal i Zi – P. Šoć); më tej adjektivi *kećav*, a, o, me përdorim të kufizuar: i dobët, i lightë, i dergjshëm, që lëngon; - Nešto sam kećav, pa ne mogu (Mal i Zi – P. Šoć), si edhe *kećava* – emër rose.

Për origjinën e varianteve të ndryshme të fjalës *keć* të përdorura kryesisht në Mal të Zi dhe në Kosovë ndër dialektet malazeze e serbe të atyre vendeve, nuk dyshohet për burimin shqiptar të saj. Fjala shqipe del zakonisht si mbiemër; i keq, e keqe. (Kjo edhe si emër abstrakt). Në shqipen e Greqisë është regjistruar folja *ngeqonem* për zemërohem; për etimologjinë e saj të këqyren Studime gjuhësore I, 273-274 të E. Çabejt.

Knäditi (isknaditi) “thur, hartoj, këndoj një këngë a po vjershë, thur një këngë mbi një ngjarje” – Ne bi mogó sve isknaditi i saćiniti i u pero složiti (- Nev. II, 255). Më duket që nga të gjithë studiuesit e kësaj fjale që e kanë fjalorët e serb. e janë të rrallë që e kanë, vetëm T. Maretiçi te Fjalori i Madh i Akademisë Jugosllave të Zagrebit i ka rënë në fije origjinës së saj

duke na përudhur që ajo është shumë e rrallë në të folmet serbokroate, prandaj kur mbahet parasysh përdorja e kufizuar e saj do të vijmë – themi ne, te burimi shqiptar i saj. Si nga pikëpamja fonetike, si nga vështrimet kuptimore të saj, folja *knaditi*, *sknaditi*, *isknaditi* do të ketë buruar prej të shqipes *këndoj*.

Te Fjalori i gjuhës popullore dhe letrare serbokroate i Akademisë Serbe të Shkencave dhe të Arteve, jepen këto fjalë nga onomastika: *kokez*, mbiemër dhe emër familjeje, pastaj *kokeza* – emër familje, dhe *Kokezić* – emër familje. Këta emra familjesh që dalin padyshim prej fjalës shqipe *kokë* (sllav. i përgjigjet glava – Glavić) gjejnë përdorimin e tyre kryesisht në Dalmaci, Hercegovinë e Bosnjë.

Në gjuhën e zanatçinjve 80% e visarit leksikor janë prej brumit të shqipes: *klonište*, ka të bëjë me të shqipes *klumësht*, sot qumësht, në dialektet e veriut *kjumsht* – kumsht (Kosovë) Forma e hershme e *klum-shtit* në serbokroatisht do të ketë hyrë në Mesjetën e vonë. Edhe *kishnja*, shprehje e argove për xhaminë, prej të shqipes *kishë*.

Fjalori serbokroatisht i gjuhës popullore dhe letrare jep *kolje*, me përdorje krahinore në frazë: *nije mi kolje*; *nemam kolje* = *nemam kad*, *nemam vremena*.

- Stan polako crnogorski knjaže! Nije kolje tražit banovine, mi ćemo te s'carom umirit (Narodne poslov. Vuk, V, 400). – Kome je putovat' nije mu *kölje* drijemat'! (Vuk, Rječnik). Sidomos pas vështrimit të saj, fjala jonë ka të bëjë me të shqipes – *kohë*, formalisht del vështirësi te mbaresa e saj apo te rrokja e dytë (ko)-*lje* është shtesë e serbokroatishtes – *lje*, sepse shqiptimi i rrokjes së dytë që përmban spirantin *h* ka pësuar asimilimin, sikur e shënojnë për maqedonishten, K. Sandfeld, Linguistique balkanique, 68 dhe I. Popović Zs Ph. XXIII, f. 127 – *Koa* “Zeit”.

Po në atë fjalor kemi fjalën shumë të përhapur në gjuhë të Ballkanit – edhe në serbokroatishten: *kopile*, gjin. *kopileta* që del me këto vështrime: a) fëmijë ilegjitim, bastardh; b. fig. “zuzar, dinak, hor, kopuk, askushi, kurkushi,” c) një që është i shkathët, i gjallë në punë, në të ecur, i shkalët, i

shpërdhitë, i lehtë, i shpejtë; i zgjuar, veshtak, veshtar, d) dhëlpërak, dinak; e) dështak; pjella e dështuar; shtijak. “Për fjalën *kopil*, Skoku pranon mendimin se ajo është relik i gjuhësor i Ballkanit të Vjetër, e burimin e saj e shpie te ilirotrakishtja, “që në gjuhën shqipe është ruajtur trajta e saj më origjinale”.

Nga gjuha shqipe shkoi te gjuhë të tjera të Ballkanit. Për burimin e saj, sipas Oshtirit e Skokut duhet të nisemi nga e shqipes *pyell* që iu ngjiti formanti parashtesor *ko*, për mbledhjen e diftongut *je* te *pyell* = *kopil*, në gjuhën shqipe kemi mbështetje te *vile* nga *vjel*; *të vishta* prej *vjeshtë*.

Te fjalori i Vukut jepet folja *koprcati se* – bëj lëvizje me duar a me këmbë, apo me gjithë trup, hidhem, luaj me këmbë e duar në ujë; fjalën e ka edhe Fjalori serbokroatisht i Akademisë Serbe të Shkencave të Beogradit. Gurrën e saj Weigandi e shihte tek e latinishtes *Capritiare* (capra), Alb. deut. und d. alb. Wörterbuch, ndërsa I. **Popoviq**, IF. këtë folje e bie të ardhur prej të shqipes *kapërcenj*, *kapërcej*, hyrë në dialekte serbe në mesjetë; në këtë mes duhet të vihet në spikamë kalimi i vokalit a-o; për kronologjinë e kësaj dukurie fonetike mund të mbështetemi te shembuj të tjerë: maq. *pora* pastaj korda (Vidoeski, Porečkioi govor, 1950), nga shqipja *gardh*, ku, përveç përfutimit të a-o është zhvilluar edhe shurdhimi i okluzivit *g=k*.

Do të ketë hyrë prej të shqipes edhe *krena* m. emër dhie; nga shqipja do të kenë kaluar, pa dyshim edhe këta terma të sferës abstrakte: *krenija*, - “kreni, madhështi”, pastaj denominativi *krenisati* – “krenohem”, si dhe *krenta* – “këshill, tubim, mbledhje” – Ne, neçu ja da ulazim u tu krentu, (Vučićrn, G. Elezović) – “kurthë, komplot, përbetim, kongjurë, besatim i fshehtë”.

Edhe për burimin e foljes *krliješiti*, *krliješim* – “vij pa pritur, ia beh”; rri ratë, lëshohem me gjithë fuqinë, forcën, me gjithë peshën duke humbur drejtpeshimin, mbështetjen – ne nuk shohim tjetër gjuhë përveç shqipes – “kërleshem – thuhet për macën, për qenin a për ndonjë shtazë tjetër kur u ngrihen leshrat përpjetë; përlëshem, kapem me një;” folje e zbërthyeshme në formant *për*– dhe primitivin *lesh*.

Mendimin që fjala *kuventa* “kuvend, kuvendim, bisedim, bashkë-bisedim, këshillim”, si dhe folja *kuveniti*, *kuvetati* ka hyrë prej gjuhës shqipe – ne e gjejmë të mbështetur mirë: - jednu kuventu d’učinimo (K.M. Elezović, G. 3): M. Miljanov; Sve nešto kuvetaju izmedju sebe, C. G. Skadar, Šoć).

Një truall në Kuç të Malit të Zi – *Mulini* (Etnografski zbornik, VIII, 89), meqë këtë term për të shënuar njëfarë trualli ku dikur kishte ndonjë mulli, - ku jetojnë shqiptarët me shumicë, ka të ngjarë që shprehja jonë *mulini* të ketë hyrë te serbishtja malazeze prej shqipes *mullini*.

Foljen *ošorati se*, *ošoram se* si dhe *pošorati* e jep në fjalorin e vet **Popoviq** me kuptim *mokriti* (përmjerr, ndrag, derdh ujët e hollë; në Fjalorin e tij Vuku sjell – *ošurati*, (opariti, osmuditi) “djeg, përvëloj, shkrumbuj”, me përdorim krahinor përreth Drinës. Si nga format, si nga kuptimet foljet e sipërshtënuara kanë ardhur nga fjala shqipe *shurrë*.

Shprehja *plaka* për të shënuar një grua të moshuar e të moçme me përdorim krahinor, te mutavxhinjtë e Vranjës, në Serbinë Jugore, ka kaluar prej shqipes *plakë*, nga kjo fjalë, gjithashtu nga shqipja kanë hyrë në serbokroatishten për të emëruar emra familjesh – plakić një toponim, katund në Toplicë, krahinë e banuar prej shqiptarësh deri në kohën e Kongresit të Berlinit (1878) – quhet *Pljakovo* (analogjikisht me Takovo, Gjakovo, Smederevo, Podujevo, Valjevo, etj.).

Nga dy bazat *mio* dhe *mila* të serbokroatishtes nga *mil e mîrë* (nemir) janë formuar shumë rrjedhoja të reja me anë formantesh, sikur janë: Smiraj, (smiriti); *raz-mîr*; *raz-mirica*, sipas P. Skokut, fjala sllave ka shkuar edhe në shqipen – *zmîr* (!). Ç’është e drejta, në shqipen kemi *e mir*, *smirë* (zavist) edhe smiroj, *e kam smir* = e kam zili, *smirak* = smirzi, restar; *smirë zezë*; pastaj – *samtimë*, *i samtë* nga *i amtë* (bljutav); *sêmundë* (mund), *skam*, (kam): *smir* (*mirë*), spagjë, paqë (porse s-ja në bazë të tyre merr kuptim privativ, s-ja = s, nuk ka vështrim privativ, veçse ajo përforcon kuptimin e tyre. Mendimi i P. Skokut, E R 426 që *zmîr* i serb. të ketë shkuar edhe në shqipen si *zmîr*, *smir*, nuk gjen mbështetje sidomos në kuptimet e fjalëve tona në shqyrtim, sepse distanca e tyre kuptimore është

shumë e madhe: shq. *smirë-zavist* nga *mirë* me parashtesën frikative *š*.

*Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën
Shqiptare 7 (1980) Prishtinë 1982*

I. Do të vëmë në pah se mbi gjuhët shoqërore të disa qendrave në Maqedoni, në Serbinë Jugore dhe në Bosnje e Hercegovinë ka një hope materiali gjuhësor:

1. M. D. Milićević, *Kneževina Srbija*, 1884;
 2. Vuk St. Karadžić, *Sepski Rječnik*;
 3. V. Jagić, *Die Geheinsprachen bei den Slaven*, in Sitzungsberichte d. phil. hist. Klasse d. K. Akademie d. Wissenschaften in Wien, CXXXIII (1895);
 4. I. D. Šišmanov, *Beleški za belgarskite taini ezici i poslovečki govori*, Sbornik za narodni umotvorenja, nauka i knjižina, XII (1895).
 5. Cepenkov, *Usloven botušarski ezik v Prilep*, in Sbornik VIII (1892)
 6. Luka Grdić Bjelokosić, Balanački, Zadručki, *Dumdžerski jezik*, in Glasnik zemaljskog muzeja u Bosni i Hercegovini, XII (1900);
 7. S. Argirov, *Kem belgarskite taini ezici*, in Sbornik, 1901.
 8. N. Araudov, *Taen terzički ezik*, iz Sbornik (1906-1907) XXII-XXIII;
 9. S. Trojanović, *Prilozi tajnim jezicima*, Južnoslovenski filolog, V (1925-25); recension i N. Joklit in Indogermanisches Jahrbuch. XII, (sek. VII).
 10. Živko D. Petković, *Jezik naših šatrovaca*, Beograd, 1928.
 11. M. Filipović, *Tajni jezici u Velesu*, in Glasnik Skopskog naučnog društva, IX, 1934, rec. Jokl. te Indogermanisches Jarbuch, XXIII (VII).
 12. Carlo Tagliavini, *Le parlate albanesi di tipo ghego orientale* (Dardania e Macedonia Nord-occidentale, Centro studi per l'Albania, Roma, 1942, str. 73-82.
 13. H. Barić, *Miscellen*, Arhiv, 3,
 14. H. Barić, *Albanisches in wortschatz der Vranjaer Mutafđži*, Arhiv, III.
 15. H. Polenaković, *Prilozi koi makedonskite tajni jazici*, Makedonski jazik (1951) – 3-4, 1951/9-10.
 16. Olivera Jašar – Nasteva, *Albanski zborovi vo makedonskite tajni jazici*, M. J. IV/ 3,4; 5-6 (1953), 60-64; 84-92; 122-139;
 17. Kadri Halimi, *Godišnjak Muzeja grada Beograda*, 1954.
- II. Burim nga shqipja sheh te kjo fjalë edhe Ivan **Popović** në studimin e tij; Albano-slavica – Zur Geographie und chronologie der albanesischen Sprachein flüsse auf die

- Südslaven, SOF XV, f. 518-519 (1956); pastaj te Geschichte der serbokroatischen Sprache, Wiesbaden, 1960, f. 601.
- III. 1. N. Jokl, *Vorläufiger Bericht über die im Auftrag der Balcan-Kommission der K. Akad. Wissenschaften in Wien (in Anzeiger, Wien 1915).*
2. M. Lambertz, *Bericht über meine Linguistischen Studien in Albanien von Mitte Mai bis Ende August 1916.*
3. M. Lambertz, *Albanische Märchen*, Eien 1922.
4. St. Mladenov, *Bemerkungen über die Albaner und das Albanische in Nordmacedonien und Altserbien*, Balkan Archiv, I, 43-70.
5. A. Urošević, *Gornja Morava i Izmornik*, Srpski etn. zbornik, knj. 51, 1935.
6. M. Filipović, *Običaji i verovanja u Skopskoj kotlini*, Srpski etng. zbornik, Beograd, 1939.
7. Petar Skok, *Lingvistička proučavanja neslovenskog stanovništva Skopske kotline, Godišnjak Muzeja Južne Srbije, 1941.*
8. Carlo Tagliavini, *Le parlate alb.*, Roma, 1942, f. 58, par. 19.
9. Gliša Elezović, *Glasovne osobine arbanaškog dijalekta Debra i njegove okoline*, Srpski dijalektološki zbornik, knj. XI, 1950.
10. Bahri Beci, *Mbi katër inovacione fonetike të të folmeve të Gegnisë së Mesme*, në Konferencën e Parë të Studimeve Albanologjike (12-21 nëntor 1962, Tiranë, 1965, f. 261-269).
11. Jorgji Gjinari, *Dialektologjia shqiptare*, Tiranë 1963.
12. A. B. Desnickaja, *Gjuha shqipe dhe dialektet e saj*, Prishtinë, 1971.
13. I. Ajeti, *Glavnije jezičke osobenosti govora Albanaca preševske i bujanovačke okoline*, Vranjski glasnik V, 1969, f. 268-269.
14. Mehemet Halimi, *Vëzhgime mbi të folmen e Moravës së Poshtme*, te Gjurmime albanologjike, Seria e Shkencave Filologjike II, (1972) f. 119-120.

PËR GJALLËRIMIN E STUDIMEVE GJUHËSORE BALLKANIKE DHE PËR DISA HUAZIME SHQIPTARE NË TË FOLMET SERBOKROATE

Përkimet strukturore të gjuhëve ballkanike janë të njohura dhe ato më tradicionale po përsëriten vazhdimisht në trajtimet që bëhen duke synuar të theksohen lidhjen mes tyre.

Përkimet, barazimet dhe përgjasimet më të njohura janë këto:

- a) pakësimi, rrudhja a reduktimi i theksuar i rasave që ka çuar në zëvendësimin e sintetizmit me analitizmin;
- b) zhdukja e infinitivit;
- c) dyfishimi i përemrave vetorë;

ç) sajimi a përftimi i shkallës krahasore të mbiemrave duke i ngjitur pozitivit apo shkallës pohore të mbiemrit fjalëzën *-më*, sikur në disa gjuhë sllave të jugut: maq. bullg. *-po, -naj*, shqipja *i madh më i madh më i madhi*

maq. bullg. *golem po golem naj-golem*; kurse serbokroatishtja qendrore

velik (i) - veći - najveći

zao - gori - najgori

bled - bleđi - najbleđi

dobar - bolji - najbolji

latinishtja – gjuhë sintetike: *bonus – melior – optimus*,

gjuhët romane kaluan në analitizëm:

it. *grande più grande il più grande*

frenqj. *grand plus grand le plus grand*

Risi themelore në këtë mes qendron jo në përdorimin e fjalëzave që u ngjiten mbiemrave, por në përdorimin e shkallës pohore;

e) Formimi i futurit me ndihmën e foljes – *jam*, (në kundërshtim me gjuhët romane);

f) Përdorimi a përftimi i nyjës së paravendosur dhe prapavendosur;

g) Prirja për shkurtimin e kuantitetit të vokaleve: (serbok. sôk, grâd, vûk, maq. sok, grad, vuk – theksi i serbokroatishtes është muzikal, melodik, tjetri – dinamik.

Këto tipare që dalin të përbashkëta për shumicën e gjuhëve ballkanike e që formuan lidhjen gjuhësore ballkanike – studiohen këtu e me se një shekull më parë nga studiues linguistë.

Një lagje dijetarësh këto veçori gjuhësore ballkanike (Milan Budimir, F. Mikloshiq, Pisani) i shohin të ardhura nga periudha të lashta pararomake në gjuhë të popujve të Ballkanit, pra janë zhvillime gjuhësore të kohëve paleoballkanike, me përjashtime të rralla – tipare të trashëguara të substratit për shumicën e gjuhëve ballkanike.

Pala tjetër e studiuesve ballkanologë, zanafillën e këtyre dukurive strukturore që krijuan një tipologji të veçantë gjuhësore, - e shohin në shtresën e gjuhëve romane – në dialektet e latinishtes ballkanike; disa të tjerë këto veçori gjuhësore i nxjerrin të dala nga një etnos gjuhësisht krejt të romanizuar që gjëllinte në rripin e Serbisë së sotme Lindore, një truall ky që ndante sllavët e lindjes prej atyre të perëndimit (bullgarët nga serbët); nga kjo gjuhë romane buroi rumanishtja e sotme. Këtu do të bëjmë një parantezë duke shtuar se mendimi i atyre ballkanologëve që formimin e gjuhës shqipe e shohin të dalë nga kjo trevë e populluar prej një etnosi roman – neve na duket i pambështetur mirë, zotën shumica e dijetarëve për formimin e gjuhës shqipe bëjnë një rezervë të madhe.

Për të qenë objektivë duhet thënë se në këto vise janë konstatuar shumë toponime rumune: Surdulica, Xhep ... me përjashtim të toponimit të njohur Naissus-Nish në këtë truall nuk ka vendbanime, lokalitete që nga format e tyre të mirëfillta në ato të sotmet të kenë kaluar me ndërmjetësim të shqipes. Ç'është e drejta, më në jug ka toponime të tilla: Scupi-Shkup; Astibus-Shtip; oronimi i njohur, i lashtë – Scardus mons-Shari; Perustae – Qafa e Prushit – fise ilire – trajtat e sotme të të cilave duhet të kenë dalë me ndërmjetësim të shqipes.

Kryesisht studiuesit bullgarë e ndonjë tjetër mendojnë që ballkanizmat – sikur u quajten me të drejtë këto tipare gjuhësore ballkanike, do të ishte e drejtë të emërtoheshin billgarizma. Megjithëqë një shpjegim i tillë i ballkanizmave tona të njohura nuk do të zgjidhte problemin e këtyre çështjeve të lidhjes gjuhësore ballkanike, veçse do të ishte zëvendësimi i një madhësie të panjohur me një të panjohur tjetër; - kjo në instancë të fundit dëshmon se ndikimin e huaj do ta ketë pësuar njëherë bullgarishtja, që pastaj u shtri, të themi, në dialekte të tjera serbe, në Serbinë Lindore e në gjuhë të tjera ballkanike. Për shqipen edhe këtu do të hapim një parantezë, sepse inventari gjuhësor nga i cili u ndërtua, bie fjala mbaresa rasore e kallëzores njëjës dhe kronologjia e rregullave të fonetikës historike që sundonin në kohën e përfuturit të asaj rase – kanë një vjetërsi të madhe; as gjykimi i një tube ballkanologësh (Sandefeld, Rohlf, Malecki) që ballkanizmat e njohura të gjuhëve të Gadishullit Ballkanik vatrën e rrezatimit ta kenë pasur te greqishtja – neve nuk na duket i arsyeshëm, sepse epërsia kulturore, lulëzimi ekonomik dhe ngritja e organizmave të tjera shoqërore të Greqisë së lashtë – nuk ushtronin një ndikim të tillë që të rezultonin risime e zhvillime të reja strukturore të gjuhëve të Ballkanit.

M. Pavloviç truallin e këtij iradiacioni të ballkanizmave e mendonte në një trevë sllave të Epirit nga u shtrinë pastaj tiparet e përmendura në katër anët.

Gjithë repertori që përmban ballkanologjia nuk mbaron me leksik, veçse shtrohet nevoja e ngutshme të zgjerohen e të thellohen studimet e saj edhe në fusha të tjera gramatikore e frazeologjike rezultatet e të cilave për herë të parë i kishte përmbledhur Kristian Sandfeld në veprën e tij *Linguistique Ballkanique*, 1930.

Në anë tjetër kanë qitur krye edhe pikëpamje që kërkojnë të rru-dhet, të ngushtohet e të pakësohet inventari i ballkanizmave (që teorikisht do të thotë mohim i ballkanologjisë). Mendimet e tilla mbështeten mbi bazën e objeksioneve që po u gjet ndonjë prej tipareve tashmë të quajtura ballkanizma edhe në ndonjë vend jashtë Ballkanit – atëherë si tipar gjuhësor nuk mund të quhet ballkanizëm.

Një temë tjetër e madhe gjuhësore e ballkanologjisë së sotme qendron në çështjen se ku duhet kërkuar vendburimi, vatra e këtyre ballkanizimeve, që pastaj erdhën e u shtrinë në gjuhë të tjera ballkanike.

Ballkanologët-linguistë kërkojnë me ngulm edhe me të drejtë që caqet e studimeve të ballkanistikës tradicionale të zgjerohen duke pasur parasysh se në truallin gjuhësor të sllavishteve jugore, sidomos në dialektet serbokroate, ndikimet e huaja të substratit – të atij romak a grek nuk janë sqaruar në mënyrë të kënaqshme. Pa dashur të përçmojmë toponomastikën, që megjithë rëndësinë e madhe që ka për vjetërsinë e saj, ajo në anë tjetër në punë të tipologjisë së gjuhëve të Ballkanit nuk ka ndonjë peshë të shënueshme.

Studime të thelluara duhet të bëhen në fushën e sintaksës e cila, edhe pse s'ka forcë të mjaftueshme sa mund të ketë toponomastika, ka peshën e vet, edhe si dega më pak e lëvruar gjuhësore. i quajmë të drejta pikëpamjet e disa studiuesve (Seidel), që theksojnë faktin se jetesa nomade, përzierja e bashkësive të ndryshme shtegtuese baritore, blegtorale kanë pasur rëndësi të madhe për afrimin tipologjik të gjuhëve ballkanike. Pak më lart u zu ngoje prirja e fortë e gjuhëve ballkanike nga analitizmi. Nga shumë kush është thënë se analitizmi është pasqyrë dhe dëshmi i një të menduari të primitivit, porse është e vërtetë, gjithashtu, se orientimi nga analitizmi është cilësi e gjuhëve indoevropiane, me ç'gjë hidhet poshtë pohimi mbi primitivizmin e folësve të atyre gjuhëve.

Për t'u kuptuar mirë e drejt situata e gjuhëve ballkanike, duhet mbajtur parasysh fakti se Ballkani është zonë shumëfish e përzier. E folmja romake u shndërrua në latinishte popullore pothuajse në saje të përhapjes së saj duke integruar në vetvete shumë grupe popujsh të pushtuar e të nënshtruar. Nga bashkëtakimet e ngushta të gjuhëve rrjedh si pasojë thjeshtimi i sistemit të tyre. Në qoftë se bashkohen, ndërthuren, gërshetohen dy gjuhë nga të cilat njëra me sistem të thjeshtë gjuhësor, e tjetra me strukturë të zhvilluar – rezultati i bashkëveprimit të tyre do të jetë prirja dhe thjeshtimi i sistemit të tyre. Edhe në ato raste kur kemi të bëjmë me një bashkëveprim sistemesh të zhvilluara të dy gjuhëve me tipologji të ndrysh-

me strukturore – rezultati i fundit do të tregojë prirje thjeshtimi.

Kohët e fundit theksohet nga shumë linguistë, sllavistë e josllavistë se nuk janë shfrytëzuar të gjitha mundësitë për një analizë gramatikore të gjuhëve, sidomos të dialekteve të sllavishteve jugore, do të thosha edhe të idiomave qendrore të serbokroatishtes. Duke lënë jashtë të folmet e krahinave anësore të kësaj gjuhe, siç thotë Dalibor Brozović – dialektet kryesisht shtokavike qendrore serbokroate kanë një konstrukt të tipit normal evropian: “Un me ty”, kurse në të gjitha gjuhët e tjera sllave pa përjashtim zotëron konstrukt i tipit – “ne me ty”, duke gjykuar se kur jam unë me ty, atëherë ne të dy jemi – “ne”. Shqipja, sikundër dihet, pajton në këtë mes me sllavishten jugore, pra me dialektet shtokavike të serbokroatishtes: të themi që konstrukti në fjalë do të jetë përftuar në trojet e Ballkanit.

Edhe sistemi fonologjik i dialekteve serbokroate, sipas gjykimit të prof. Brozoviçit (siç janë inventari i fonemave dhe cilësitë e tyre gjallëruese, rregullat e përndarjes, prirja e artikullimit) pajtojnë shumë më tepër me tipat mesdhetarë (ballkanikë) se sa me ata të sllavishteve të tjera. Këto tipare e shumë të tjera flasin në të mirë të një konstatimi se kemi të bëjmë me cilësi gjuhësore josllave shumë të vjetra, që edhe sot e gjithë ditën gjejnë përdorim të madh e të shpeshtë në dialektet serbokroate. Kjo cilësi gjuhësore e dialekteve serbokroate dëshmon se kemi të bëjmë me dukuri reliktoze të substratit për të cilin thuhet se është i qëndrueshëm sidomos ndaj veçorive më specifike të gjuhës së re. Duke pranuar në parim mundësinë e shfaqjeve mbeturinore të substratit në sferën gramatikore të serbokroatishtes u afrohem në këtë mënyrë çështjeve nga të cilat priten edhe rezultate konkrete.

Inflacioni i demunitivave dhe i hipokoristikës, sikur shkruan Brozoviçi, është cilësi e të gjitha gjuhëve sllave që marrin pjesë edhe disa dialekte të anëve skajore serbokroate; për çudi të folmet shtokavike në truallin qendror dhe perëndimor si dhe çakavishtja lindore sundojnë një dukuri të përkundërt, të anasjelltë; na del pra një shfaqje e qëndrueshme, një inflacion augmentativësh dhe pejorativësh: *moja ženturača*, *moja kućerina* –

augmentativa me ngarkesë pejorative: *glavurda, nožurda, ruçurda; nosina, babetina, glavetina, glavurina*. Modeli i dialekteve shtokavike qendrore serbokroate – shton Brozoviç, është i mbrojtur nga ndikimi i gjuhëve të huaja të gjermanishtes dhe të italishtes që bëjnë presion në të folme të tjera serbokroate, sllovene të anëve skajore të zonave kufitare të shtetit. Tiparet e zëna ngoje do të jenë mbeturina të substratit ndoshta duhen njuhur zhvillime specifike të këtyre dialekteve.

Në pjesën e dytë të këtij punimi do t'i sillemi një inventari tjetër, që ka të bëjë me një tubë fjalësh e shprehjesh me burim shqiptar në diakete të truallit jugor e lindor të serbishtes.

Hetimi i këtij inventari fjalësh e shprehjesh me gurrë shqiptare në të folmet serbe të truallit të zënë ngoje serb, tash sa kohë është objekt i studimit tonë. Në këtë mes do të marrim në vëzhgim një fond të vogël leksikor të hyrë nga të folmet shqiptare të këtyre anëve në idioma serbe të trevave të përmendura.

Štirkinja (Vuk, Budmani), *štirka* dhe *štirkinja* (Kosovë) del me këto vështrime: 1. grua shterpë, beronjë, barkthatë, dhe *štirka* (Budmani-Lika) – “beronjë; shterpë;” thuhet edhe për grua: – kjo grua është *shterpë*, por zakonisht thuhet për bagëti; bullg. *štirica, sterica* – “lopë shterpë;” shqip – *shterpë* thuhet për dele, dhi, lopë, që nuk pjell a që nuk ka pjellë sivjet; - *lule shterpë* = “lule që s’ka farë” – thuhet edhe për gra: kjo grua është shterpë, – “është beronjë, barkthatë;” rum. *stir* (Moldavia) – “shterpë *barkthatë, beronjë*”. Këtë shprehje nga sfera e jetës baritore P. Skok e bie të ardhur prej të greqishtes *stiros*, e mbiemrin e shqipes *shterpë*, si dhe fjalën sllovene *stirp* (Loška Dolina) – me vështrime – “*ftujë, edh njëvjeçar*,” – Skoku i çon te latinishtja ballkanike, në të cilën e sheh zanafillën e tyre.

Mendimi i Skokut për shpjegimin e kësaj etimologjie bashkë me versionet e trajtave të tjera në gjuhët e përmendura nuk del i mbërthyer mirë, duke ngjallur dyshime. Para së gjithave, gjykimi i tij mbi huazimin e një lekseme të tillë për të shprehur një nocion elementar të shterpësisë së gjëve të gjalla dhe të grave, mbi mungesën e pjellorisë së bagëtive, si dhe të grave, - për ne nuk është i mbështetur mirë.

S'ka asnjë gjuhë ballkanike, qofshin edhe ato fondi leksikor i të cilave është rralluar tepër me ndikime të jashtme, që për të shprehur nocionin e shterpësisë së gjëve të gjalla shtëpiake mos të ketë ruajtur së paku disa leksema burimore. Për të qendruar në truallin e shqipes, të themi që vetëm ajo ka së paku tri fjalë për të shprehur një nocion të tillë: shterpë, beronjë, barkthatë.

Në sferën e blegtorisë dhe të jetës baritore ka terma sikundër janë: *shter*, *shterr* nga i cili arketip do të kenë dalë pa kurrfarë dyshimi adjektivi *shterpë*, emri *shtjerra*, *shqerra*, prandaj fjala *shterpë* nuk mund të ketë të bëjë kurrsesi me të latinishtes *extirpus*, qysh gjykonte P. Skok në fjalorin e tij etimologjik të serbokroatishtes, aq më pak mund të afrohet tek e sllavishtes *stirp* – “ftujë,” që do të ketë burimin te *extirpus*.

Format e shprehjeve *shterpë*, *shter*, *shterr*, *shterc* (*plak* i lënë), *shtjerra*, *shqerra*, do t'i bashkohen trajtës së foljes *ter=thaj* nga një më e vjetër **tar*, që ruhet si oronim e hidronim këtej e përtej Adriatikut: *Tara*, *Tarentum*, *Taranto*, mbase edhe *Tarabosh*; e *shter*, *shterr* përrenj e lumenj që shterin verës në viset jugore, sidomos nëpër trevat karstike, janë një dukuri e ditur për gjeografin”, Çabej, Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës 1963/3, 98, 99. Që të gjitha këto fjalë janë përfutur përbrenda gjuhës shqipe dhe nga brumi i saj leksikor. E përse i përket termit *stirkinja*, i përdorur në terminologjinë baritore e blegëtorale të serbokroatishtes, mbi bazën e njoftimeve tona, burimin e saj e shohim të gjuhës shqipe.

E përditshmja “Politika” e 5 gushtit 1973, f. 9, botonte një reportazh me titull: “Vonesa për në mbledhje”, në të cilin, përveç tjerash shkruante: “A nećemo krepat od gladi, nijesmo ni za prvog rata kad ti je otac poginuo i kad sam Vas *veja* s ovijeh deset nokata podigla i podnjivila”. Fjala – “veja” për mendimin tonë në këtë kontekst do të dalë me vështrim: *e ve*, *e veja* – “thuhet për gruan që i ka vdekur bashkëshorti”, serb. *udòvica*, lat. *vidua*, prandaj është e mundur që kjo fjalë e të folmeve malazeze të ketë hyrë në to nga idiomat e shqiptarëve që gjëlljnë në ato treva. Ç'është e vërteta, në ligjërime serbe të Kosovës takojmë shprehjen *veja*, gjin. *vejë*, bullg. rus. *vehà*, sllav. vj. *veja*, “*karthje*, *karthi*, *shkarpa* të thata, *flakërishta*;

bimë” ...; por kjo fjalë pas gjithë gjasash nuk ka të bëjë me trajtën tonë në shqyrtim *veja*, sepse kësaj së dytës i dalin vështirësi të pakapërcyeshme vështrimore. Në këtë mes po shtojmë edhe një të dhënë që, si informatori i reportazhit, si autori i tij, ishin malezezë.

Në Fjalorin e gjuhës popullore dhe letrare të serbokroatishtes që hartohet në Akademinë Serbe të Shkencave dhe të Arteve gjejmë foljen: *zaprušiti, zàprušim*, një krahinarizëm që del me këto kuptime: “këllas, shtie në dhé, mbuloj, mbush me dhé, me zall, me ranë:” - Domaćice, čim izmaknu lonac s jelom iz ognjišta, odmah *zàpruše* onaj krug pepela koji je lonac ostavio; Daj, idi zapruši tu rupčinu. Në shtëpinë e zjarrit, në votër, në mbrëmje, pasi të pregatitet gjella e të hahet darka, prushi i zjarrit do të mbulohet me hi, që gacat të ruhen për zjarrin e nesërm. Po t’i sillemi fjalës sonë në shqyrtim *zaprušiti, zaprušiti, zaprušim*, që del me një vështrim të caktuar, ne nuk arrijmë ta afrojmë te çfardo folje tjetër të serbokroatishtes, që të ketë një kuptim të afërt me fjalën tonë në studim; një farë afërie fonetike dhe kuptimore gjejmë te shprehja *zaprashiti* e serbishtes, e dalë nga *prah-pluhur*, “pluhuroj, pluhuris, bëj me pluhur, ngre, çoj pluhur.” Po të merrej si fjalë vendi, do të mbetëj i pashpjeguar ndërrimi nga *zaprashiti*, në *zaprušiti* (prah: pruš). Që në fonetikën e serbokroatishtes nuk gjen arsye.

Mbi mbështetjen e shpjegimit të sipërm fonetik e vështrimor, foljen e të folmeve serbe *zaprušiti, zaprušim* ne e gjejmë të sajuar nga e shqipes *prush* e zgjeruar me parashtesën sllave *za*.

Ne fjalorin e Akademisë Serbe të Shkencave, që posa u përmend, regjistruam edhe një folje tjetër për burimin e së cilës ngjallen dyshime dhe shprehen pikëpamje të ndryshme; është fjala për foljen *zašátiti, zàšátim* me përhapje të kufizuar, e krahinore te Uzhica, në Serbinë Perëndimore, që del me një vatër të gjerë vështrimore: “kap, marr, nxjerr, rrëmbej, përfshij, rrok një sasi ujë, ose diçka tjetër”.

Po të duam të ndjekim etimologjinë e kësaj fjale, si çdo herë, edhe këtu pikësëpari ajo do të zbërthehet në elemente të saj përbërëse; pastaj, po s’që e mundshme të bëhet një analizë e tillë e saj, që do të thotë se, pas

të gjitha gjasave, nuk është e përfutur nga brumi i gjuhës amtare, atëherë do të rrihet një rrugë tjetër duke kërkuar lidhjet e jashtme të saj. Në rastin konkret, një *-šat*, që kur të veçohet do të dilte nga *zašatiti*, nuk është vërtetuar kund në ndonjë prej gjuhëve sllavojugore, që të përkonte si nga forma, si nga kuptimi me fjalën tonë në shqyrtim. Prandaj, deshëm, s'deshëm, do t'i drejtohem një gjuhe tjetër të popujve fqinjë. Për mendimin tonë, fjala e shqipes *šat*, si nga pikëpamja fonetike, si nga ajo kuptimore, i përgjigjet për mrekulli foljes së dialekteve serbe *zašatiti*, një postverbal nga *šat*, të cilit i është ngjitur parashtesa sllava *-za*, duke krijuar një folje me kuptim: “*marr, rrok me shtat dhé*”.

Nga ky fjalor i Akademisë së Beogradit hartimi i të cilit s'ka arritur as te gjysma e kësaj përmendoreje madhështore të kulturës së popullit serb, kroat, malazez e musliman, nxorëm fjalën *đelāk, āka*, djalosh, djalë i rritur, 14-16 vjeç; Fjalori kishte edhe një formë tjetër *đalapak* me kuptim – “djalë 8-14 vjeç”; këto fjalë paraqiten në një truall të kufizuar gjatë Bregmoravës, në Serbinë Lindore.

Mbi dëshminë e fakteve dhe në mbështetje të njohurive tona mbi të folmet serbe të këtyre anëve, ne nuk dimë të ketë kund në gjuhët sllavojugore ndonjë fjalë me trajtë të ngjashme që të përkonte me këtë tonën, si nga pikëpamja fonetike, si nga ajo vështrimore. Për mendimin tonë, nuk mund të quhet kontribut në hetimin e saj as gjykimi i Prof. Momçilo Saviçit, i shfaqur kohët e fundit në Južnoslovenski filolog, XXX, 1-2, që shprehjen *đelak* e heq të ardhur nga një turqizëm me gurrë arabe – *dželat*, shqip *xhelat* – “ai që zbaton publikisht dënimin me vdekje të një njeriu, duke i prerë kokën, fig. njeri pa mëshirë, mizor”, sepse ai sidomos nga pikëpamja e kuptimit kurrsesi nuk i afrohet fjalës sonë në studim.

Në historinë e kësaj fjale *đelak*, duke hapur një shteg tjetër, na mban shpresa se me këtë rrugë do t'i jepet zgjidhja e kënaqshme kësaj çështjeje. Përballë gjeografisë dialektore nuk është vështirë të mendohet një shprehje e të folmeve shqiptare përreth burimit të Moravës – *djalë*, në këto anë *gjal*, shumësi *gjel*, të jetë shtrirë njëherë si term në gjuhë të fshehta serbe të këtyre anëve në të cilat pjesën dërmuese të inventarit të tyre

leksikor e përbëjnë leksemat e gjuhës shqipe. Ndonjë fjalë nga sfera e gjuhëve të zanatçinjve, me kohë, mund të jetë shtrirë edhe në gjuhën e përditshme të popullsisë serbe të këtyre anëve.

Në Fjalor të Akademisë Serbe të Shkencave gjetëm të regjistruar një folje me shumë forma, është fjala për shprehjen *zdeknuti*, *zdeknem*, me përdorim krahinor, e me kuptime: “vdes, ngordh”. – Samo da oće jedared taj matori *zdeknuti* da i mi što nasledimo (Bačka, Radonić N.), Vojv. Borj. Pop. Dj. 4) = “Veç të vijë koha e të ngordhë kjo rrole, që edhe ne të trashëgojmë diçka nga pasuria”. Nga forma *zdeknuti* u përfatuan edhe trajta të tjera, sikur janë këto: *zdićiti*, *zdoknuti*, pastaj *zdoksati*, *izdekat*, (vdes, ngordh, e shtroj në dru, ja vesh një shuplakë). Meqë në dialektet e gjuhëve sllavojugore nuk e shohim elementin primitiv të foljeve në shqyrtim, për ne rrënja nga e cila u përftua gjithë kjo lagje foljesh, do të kërkohet në truall të shqipes, pikërisht te trajta participore – *dek*, herë-herë edhe te tema e aoristit *diq* (dić), në serbishten të pajisura me parashtesa dhe prapashtesa, si domos infinitivore *-a-ti* që nganjëhorë marrin edhe infikse, d.m.th. vokalo lidhëse.

Format e foljeve të përmendura janë shënuar e regjistruar në truallin dialektor të serbokroatishtes, e të maqedonishtes, në jug të Serbisë, në Kosovë, Maqedoni dhe Bosnjë.

Në këtë Fjalor, shumë herë të përmendur, morëm edhe shprehjen *zdègāč*, një fjalë dialektore me kuptim – “shkop për të shprishur leshin, -Kozina se prostre po daski pa se *zdègāč* uzima u ruke i seca neprestano, te se tako kozina razbija ili rastresa – (Mil. 7.89). Po të duam ta veçojmë këtë fjalë në pjesët e saj përbërëse, s’ka sesi mos të zberthehet në *deg*, që del si temë e saj e që në serbokroatishten s’i gjendet kund filli. E po t’i sillemi shqipes, atëherë do të gjejmë fjalën *degë*, që mrekullisht përkon me shprehjen në shqyrtim si nga pikëpamja fonetike, si dhe ajo e kuptimit. Në katunde gratë shprishin leshin zakonisht me njëfarë shkopi a dege që përgatitet nergut për rrahjen e tij.

Autorët e këtij Fjalori s’janë përpjekur ta shpjegojnë shprehjen *zápus* pa i dhënë kuptimet e saj; - I to Vlaše *zápus* učinilo (Vuk, Fjalori); në

mbështetje të kësaj frazeologjie, për mendimin tonë, fjala gjen shpjegimin përbrenda shqipes, te *pus* – “*izvor*” që i është ngjitur parashtesa sllave – *za*; nga lidhja sintagmatike – *e bane pus*, (nagrdio si ga, uprskao si ga).

Në të folme malazeze është shënuar, e Fjalori i Akademisë Serbe të Shkencave “regjistron foljen *zarépati, zârêpām* – “premtoj, jap fjalën, zotohem”; zgjedhimi mesor – *zarepati se*, “zotohem, rrëfëhem” – *zarepao* se pred postenim ljudima da neće to više činiti, (u ka dhënë fjalën burrave se nuk do të bëjë më punë të tilla të këqia!).

Edhe se nuk do të pritej, kjo folje gjen shpjegimin e vet vetëm përbrenda shqipes, te folja e sferës fetare – *rrëfëhem*, që me kohë është shtrirë edhe te sfera të tjera pa u larguar nga qendra e saj kuptimore. Në këtë punë duhen shpjeguar disa ndryshime a ndërrime fonetike, që janë kryer në fjalën tonë në studim – *zarepati*; është fjala për ndërrimin e *f>p*, një dukuri fonetike kjo relativisht e vjetër në të gjitha gjuhët sllave; *foccacia* = *pogača* gr. *trafos*=*trap*; *frigere*=priganica; nga shqipja *farë, fara*, maq. *pora* – “brez, gjeneratë (Makedonski jezik, II (1951, 92; Ivan Popoviq, *Grčko-srpske lingvističke studije, III*, Zbornik radova Vizantološkog Instituta, knj. III, par. 6). Ndërrimin *f>p* në dialekte të maqedonishtes e ndeshim te fjala: *képte* = “gërmaz, fyt” (Vidoeski, Porečkiot govor, 1950), që në maqedonishten do të ketë hyrë, pa dyshim prej të folmeve shqiptare në Maqedoni – “qafë, qeft” (sqep). Te *pora* e maqedonishtes me gurrë shqiptare prej *fara*, sikundër u tha më sipër, është kryer edhe ndërrimi fonetik, që pasqyrohet në mbylljen e *a*-së në *o*, që shprehet edhe në një tjetër rast, te *korda* e maqedonishtes nga shqipja *gardh*; *a>o*, = *dh>d*.

Na mbetet të themi diçka edhe për kronologjinë e kësaj shfaqjeje: kur është kryer këmbimi i *f>p*, në një anë, dhe mbyllja e *a>o*, në anë tjetër. Mbi dëshminë e shumë fjalëve të huazuara nga greqishtja në serbokroatishten, maqedonishten, këmbimi *f>p* bie në mesjetë, duke vepruar deri nga fundi i saj; e mbyllja e vokalit *a* me *o* është një dukuri fonetike e serbishtes së vjetër dhe e maqedonishtes, që në këto dy gjuhë sllave vepronte në kohën e dokumenteve të para shkrimore të tyre, që do të thotë se edhe mbi dëshminë e dy huazimeve maqedone në gurrë shqip-

tare *pora* < *fara*, *korda* < *gardh*, vërtetohet vjetërsia e madhe e këmbimit të *a>o*, I. Popoviq, Grčkosrpske lingvističke studije, III, 131.

Shprehja *lákora*, (fton në Dalmaci) 1. “pjesa e fortë e mishit, 2. zhangël, lapër e mishit”; augmentativi i saj *lakorina* – “lëkurë që mbështjell një muskull a një gjëndër” (Dubrovnik, Ston), del i pajisur edhe me deminutivin – *ica* = lakorinica (Skok, Fjalori etimologjik). Te Fjalori i tij, Skoku gjen te kjo shprehje një fjalë të shqipes, nga *lëkurë*, e për ne, përkundrazi, ajo do të ketë ardhur prej *lakur* nga e cila u përftua lakuriq.

Nga fjalori i Akademisë Jugosllave të Zagrebit, Skoku mori dhe radhiti foljen *šúriti*, *šurim* (Sllavonia, Kroacia, Bosna) që del me këto kuptime: “përvëloj me ujë valë, e përvëloj, e përcëlloj, djeg”, por pa u shprehur për etimologjinë e saj. Për ne kjo fjalë ka të bëjë me leksemën e shqipes *shurrë*, një fjalë e mbarë gjuhës, postverbal i shprehjes së shqipes. Si shumë fjalë të tjera, edhe kjo jona është e sferës së gjuhëve të fshehta të zanatçinjve në Serbinë Lindore dhe Jugore dhe në Maqedoni, fondin e të cilave në pjesën e tyre më të madhe e përbëjnë fjalë shqipe.

Me këtë hov nuk do të marrim në hetim problemet e fonetikës se të dyja gjuhëve tona, edhe pse e quajmë shumë të dobishme t’i afrojmë këto dy gjuhë në plan të fonetikës. Duke i lënë ato mënjane, po përmendim vetëm formantin – *za* që del te ndonjë fjalë e serbokroatishtes; *dretëza* me burim të shqipes *dredhëz-za*; ai u shtri edhe në antroponiminë sllavoju-gore; nga Ivo-Iveza, Ivezic (=Ivić) e regjistruar në Grudë, që pastaj u përhap edhe në vise të tjera të Sanxhakut të Malit të Zi, të Serbisë. Formantin në fjalë e kanë edhe këto antroponime: *Nikeza*, *Nikezić*, prej *Niko*, *Nika*, pastaj *kokeza*, Dalmacia (nga apelativi i shqipes *kokë*, *kokëza* (glava, glavica, Glavić).

Krahina e Kuçit të Mal të Zi është njëra nga zonat etnikisht të përziera shumë interesante; një shembull kalkimi (përkthimi nga shqipja në serbisht) më së miri vërtetohet “Govori se da je tu bilo mrtvije i ranjenije Kuča i Pipera stotinu, ali Pipera *tvrd*o malo, no su sve Kuči bili, Marko Miljanov”, Pleme Kuçi u narodnoj priči i pjesmi, Titograd, 1967, str. 46, ata që paksa e njohin shqipen, do të diktojnë menjëherë se në

bashkëlidhjen – *tvrdò malo* kemi të bëjmë me një përkthim fjalë për fjalë të lidhjes sintagmatike *fort pak* që del me kuptim – *shumë pak, tepër pak*.

*Studime Gjuhësore në Fushë të Shqipërisë I, "Rilindja",
Redaksia e botimeve, Prishtinë 1982*

SHQIPJA E VËSHTRUAR NGA ASPEKTI I STUDIMEVE BALLKANISTIKE

Në punën e hetimit të problemit të burimit të shqipes nga ilirishtja, në punë të birërisë së saj nga kjo, pas rezulteteve të arritura gjatë shekullit XX në gjuhësinë albanologjike dhe në linguistikën krahasimtare – jemi të mendimit se kishte ardhur koha që shkencëtarët më shumë t'i sillen metodologjisë së atyre studimeve sesa çështjeve të tjera lidhur me marrëdhëniet e të dyja gjuhëve të sapopërmendura. Prof. Çabej ishte njëri nga të rrallët dijetarë që shkencëtarëve albanistë u tërhoqte vëmendjen në këtë pikë, duke përfunduar një studim mbi raportin e ilirishtes ndaj shqipes në veprën e përbashkët “Ilirët dhe gjeneza e shqiptarëve”, Tiranë, 1969, thoshte shprehimisht: “Është gjithashtu metodikisht e gabuar të flitet për një substrat ilir në këtë gjuhë (e kishte fjalën për shqipen). Sikur kemi theksuar edhe herave të tjera koncepti i substratit është i lidhur me një ndërrim gjuhe. Një ndërrim i tillë nuk dihet të ketë ngjarë në Shqipëri ashtu si ka ngjarë p.sh. në Rumani në rrjedhim të romanizimit të atij vendi”, vep. e përmendur, f. 52.

Në një studim tjetër me titull: “Disa faza më të mëdha të shqipes në dritën e gjuhëve fqinje”, Revistë shkencore e Institutit Pedagogjik Dvjetëor të Shkodrës, E. Çabej u drejtohej kolegëve me këto fjalë: “Unë aty po lejohem vetëm të bëjë këtë vërejtje që tashmë ka ardhur koha që shprehja huazime “trake” të zëvendësohet me huazime “shqipe të vjetra”.

Në kohën antike në një territor relativisht të ngushtë të Gadishullit Ballkanik banonin popuj të paktë në numër: ilirë, makedonë, trakë, dakë, mizë. Mendohet që ilirët shtriheshin kryesisht në pjesën perëndimore e qendrore e edhe trakasit derdheshin nga lindja deri në perëndim. Këto lëvizje e shtegtime të popujve të posazënë ngoje, shkaktuan rrafshime deri diku të dallimeve nacionale, pasojisht edhe në fushën gjuhësore. Në këto pritje e procese në një kohë relativisht të gjatë merrnin pjesë parreshtur

keltët që u integruan në qytetërimin e përgjithshëm të popujve të Gadishullit Ballkanik. Nuk duan qitur në harresë popuj të tjerë gjermanë (gotët etj.), që në Ballkan, si stacion i përkohshëm, qëndruan për t'u dyndur nga Gadishulli Apenin.

Këto procese u intensifikuan, sidomos, në periudhën e sundimit romak në Gadishullin tonë afër tetëqind vjet. Pasojat e atij sundimi qenë zhdukja a shuarja e gjuhëve të ndryshme jo latine në Ballkan: makedonishtja, ilirishtja, trakishtja etj.

Një degë e ilirëve në jug të Ballkanit i shpëtoi asimilimit duke ruajtur identitetin e vet bashkë me gjuhën.

Qytetërimi i Ballkanit të lashtë s'ishte e mundshme të tretej krejtësisht, veçse duke u gërshetuar me kulturën materiale dhe shpirtërore të ardhësve të rinj indoevropianë, u bë pronë e këtyre. Qytetërimi grek a hellen (kultura greke) nuk nis me të ngulur të indoevropianëve grekë, ajo kulturë – edhe se në thelb thjesht greke, në strukturën e saj ka një komponent të dukshëm egjean: në sistemin e ndërtimit, në arkitekturë, në ngritjen e qendrave urbane, në tregëti, mjeshtëri të lundrimit nëpër dete (detari) etj.

Në studimin e kulturave të popullsive të Ballkanit të lashtë rrugët metodologjike duan harrur vazhdimisht, sepse kemi të bëjmë me një botë dhe me një qytetërim të perënduar në një përmytje katastrofike. Për këtë arsye vazhdimësia e kombeve të sotme ballkanike s'është dhe nuk mund të jetë një gjë që kuptohet vetvetiu. Ajo do kuptuar vetëm "si problem, e jo si fakt i fortë", kështu që do zhvilluar pareshtur (Katiçiç).

Jeta e përbashkët me shekuj e popujve tanë në Gadishullin Ballkanik, gërshetimi i kulturave të tyre, ndërthurja e gjuhëve, përthyerja e kulturave të popullsisë antike në kulturën autentike të popujve tanë, krijuan, të thuash, një veçori të përbashkët në kulturën e tyre, bashkëfërkime, barazime dhe zhvillime paralele në gjuhët e tyre, në mënyrë që të mund të flitet për një tip ballkanik të kulturës, për një lidhje gjuhësore ballkanike.

Është krejtësisht i pranueshëm mendimi sipas të cilit njësia e zënë ngojë gjuhësore ka mundur të krijohet vetëm në një hapësirë të ngushtë,

gjë që i shënoi rrugën për të krijuar kategori të reja gjuhësore në disa prej gjuhëve ballkanike: rumunishten, shqipen, bullgarishten, maqedonishten, greqishten, e në disa dialekte serbe. Ajo që karakterizon njësinë gjuhësore ballkanike është i ashtuquajtimi analitizëm. Ky analitizëm gjuhësor, siç thamë, ka mundur të krijohet në një hapësirë të kufizuar, pikërisht për shkak të përzierjeve të gjera e të shumanshme. Nga shumëkush është thënë se analitizmi është pasqyrë dhe dëshmi e një të menduari të primitivit, porse është e vërtetë, gjithashtu, se prirja nga analitizmi është veçori e gjuhëve indo-evropiane, me ç'rast hidhet poshtë pohimi mbi primitivizmin e folësve të atyre gjuhëve.

“Mendohet, kryesisht, se njerëzit që kanë mësuar gjuhë të fqinjëve të tyre sipërfaqësisht, aq sa kanë pasur nevojë për të zgjidhur çështje praktike, elementare, kanë folur në mënyrë analitike, sepse dualizmi është veçori e çdo polilinguizmi të papërsosur. Njeriu që gjuhën e huaj nuk e njeh mirë e e flet atë me guxim, të folurit e tij e rruddh në një mënyrë të vogël kategorish, duke mos mbajtur parasysh finesat dhe “ngarkesat” e kësaj gjuhe të huaj. Gjuhëtari i njohur serb Iviç këtë fenomen e përkufizoi kështu: “Kontaktet e afërta shpesh kanë për pasojë thjeshtësimin e sistemit; nëse kryqëzohen një sistem më i ndërligjshëm me një tjetër të thjeshtë – rezultati anon nga tipi më i thjeshtë... edhe në rastet kur përzihen dy sisteme të ndërligjshme, të ndryshme, janë gjasat që përfundimi të jetë më i thjeshtë se ç’janë këto dy sisteme”.

Dr. Irena Grickat lidhur me këtë thotë: “...Me këtë nuk do harruar se folësit të cilët i kanë afruar në këtë mënyrë sistemet e tyre, në rastin tonë knaë qenë në radhë të parë blegëtorë të lashtë dhe bujq, pastaj tregtarë mesjetarë, zanatçinj, bredhës etj., e të tillët nuk çajnë kokën për normat e tyre (të gjuhëve), siç brengoset njeriu i arsimuar”.

Për t’u kuptuar mirë e drejt situata e gjuhëve ballkanike, duhet mbajtur parasysh fakti se Ballkani ishte zonë shumëfishe e përzier: e folmja romake u shndërrua në latinishte popullore në saje të përhapjes së saj, duke integruar në vetvete shumë grupe gjuhësh të popujve të pushtuar e të nënshtruar.

Në lidhje me krijimin e formave analitike të së kryerës në gjuhën shqipe dhe në gjuhët e tjera ballkanike mbizotëron mendimi që ato janë përftuar në ndikimin e latinitetit ballkanik, por ka edhe një mendim tjetër, që në këtë rast kemi të bëjmë me një dukuri ballkanike, pikërisht, një lagje dijetarësh si këtë veçori edhe zhvillime të tjera analitike i shohin të ardhura nga periudha të lashta pararomane, pra janë zhvillime gjuhësore paraballkanike – tipare të trashëguara (Miklosich, Weigand, Budimir, Pisani). Çabej shton se në rastin tonë nuk është fjala për një ndikim mbi sistemin e formave, por, më parë, për një kalkim gramatikor, imitim i një forme të huaj shprehjeje me lëndën e gjuhës (*factum habeo, casus, sum, casum habeo*) shq. “kam punuar, kam bërë, kam qenë”, maqed. përveç konstruktit të hershëm *sum dosol*– zhvilloi forma të tjera të reja *imam dojdeno, sum dojden*, rum. *am vinuta* “kam ardhur”, *am vidzuta* “kam parë”.

Trajta e foljeve analitike janë krijuar në gjuhët gjermanike dhe në gjuhët sllave. Këto të dhëna dëshmojnë për një prirje të përgjithshme të gjuhëve indoevropiane për të krijuar forma foljore analitike që të shprehin më qartë kuptimin e perfektit.

Shqipja dhe rumanishtja, kur është fjala për kohën e kryer, edhe foljet jokalimtare i ndërtojnë me anë të foljes ndihmëse *kam*, kam qenë, kam ardhur, kam dalë, kurse gjuhët romane me – *jam*: sono venuto, sono stato, je suis venu, por j'ai été; gjerm. ich bin gewesen, ich bin gekommen.

Për tipar karakteristik të ballkanizmave hiqen edhe format e përfuara të admirativit në gjuhën shqipe, maqedonishten, bullgarishten. Format e shkurtra të participit dhe trajtat e së tashmes ndihmëse (*kam*): pasë + kam = paskam, imperfekti: pasë + kësha = paskësha; paskam pasur, paskësha pasur.

Tipare të përbashkëta janë konstatuar edhe në sistemin e numërimit prej 11-19 mbi gjuhë ballkanike (gjuhët sllave, letonishtja e grupit baltik, shqipja dhe rumanishtja). Në këtë sistem numërimi të shqipes (11-19) Çabej i mbahet mendimit të Joklit sipas të cilit kemi të bëjmë me një izoglosë të vetme të gjuhëve: shqipe, baltike – sllave e jo një imitim nga gjuhët sllave, sikundër mendon Puşçariu (*Limbâ romanâ I*, 285 *Die Rumänische Sprache*, 358).

Kurrrfarë ndikimi nga gjuhët sllave nuk mund të ketë, sidomos në mënyrën e formimit të numërorëve me njëzetëshe (20, 40, 60, 80).

Këtu në shqipen Jokli sheh një relikto paraindoevropian, sepse sistemi vigesimal i numërimit, në kundërshtim me sistemin dekadik, që është karakteristik për botën indoevropiane, është tipari i një substrati paraindoevropian në gjuhën shqipe (njëzet, dyzet, dikur trezet e katërzet).

Këto tipare e shumë të tjera, që dalin të përbashkëta për shumicën e gjuhëve ballkanike, studiohen këtu e më se një shekull më parë nga studiues linguistë.

Përsa i përket gjendjes së sistemit të nyjës së gjuhëve të pajisura me të, një gjë dihet me siguri se nyjat e të gjitha gjuhëve janë përfutur prej dëftorëve të gjuhëve përkatëse në pozicionin e tyre të rregjuar a të tkurrur, d.m.th. me kalimin e trajtave të dëftorëve ndër kategori të tjera gramatikore, ato do të pësojnë ndryshime të mëdha fonetike.

Para se të rrokim në një vështrim më të imët paraqitjen e nyjës së parme ndër kategori të shumënduarshme gramatikore të gjuhës shqipe, e quajmë të dobishme të përsërisim njëherë shfaqjen relativisht të re të proklizës dhe gjëzën sintaksore të saj nga pozicioni enklitik.

Çështjen e nyjës e kishte hetuar në studimet e veta dijetari i njohur, albanisti i shquar, indoevropianisti i dalluar Holger Pedersen, njëherë në studimin e botuar në blenin **Festskrift til Vilhelm Thomsen** (1894), pastaj në traktatin *Die Gutturale im Albanischen*, **KZ** 36 (277-341), ku, duke rrokur problemin e prejardhjes së sistemit të nyjës së gjuhës shqipe, e duke shikuar faktet lidhur me këtë sistem në tërësinë e tyre, i njeh parësinë paravendosjes, pse nga *pus i thellë* nxjerr lidhjen tjetër mbiemërore *pusi i thellë*, prej këndeje edhe burimin e prapavendosjes prej nyjës së përparme (Buletin 1959/3, 228). Tezën e përparësisë së nyjës së përparme mbron edhe S. Riza, Buletin 1958/4, duke i dalë zot gjykimit që shqipja e vjetër njihje vetëm sintaksën e nyjës së përparme, që e dëshmojnë, sipas mendimit të tij, relikto e përdorimit të emrave farefisnorë, të pajisur me nyjën e përparme: e ëma, i biri, i ati, i ungji, e bija, i nipi, e mbesa etj. Në vazhdim

të kësaj paraqitjeje S. Riza përfundon me pohimin se nyja e përparme e shqipes si dhe mbarë prokliza e pronorëve me përmbysjen e saj, me kohë u shpërngul prapa emrave dhe u vendos sintaksa prapanyjore. Skema e reliktit *të mi vëllazën* tregon qartë sintaksën e dikurshme të proklizës ku *të* do kuptuar si një e emrit *vëllazën*, e *mi* pronor primar i panyjshëm, që pastaj, e përmbysur na del lidhja *vëllazën të mi*.

Në anën tjetër, faktet gjuhësore të gjuhës shqipe, po edhe të rumanishtes, peshuar njëherë e mirë, shkojnë në të mirë të parësisë a të moshës më të madhe të enklizës.

Dihet se nyja e prapme është e qëndrueshme, e ngulët, qoftë për nga forma, qoftë për nga ana e kuptimit. Funkzioni i saj mbetet ai që të dallojë diçka që s'njihet nga ajo gjë që na është e njohur. Në anë tjetër, nyja e përparme na del e lëkundshme dhe me një hapje të konsiderueshme funksionesh me tendenca të forta kalimi prej një kategorie në një tjetër, pra ajo paraqitet e lëvizshme, e paqendrueshme përkundër nyjës së prapme.

Prapavendosja e nyjës na del me vjetërsi të madhe, përkundër paravendosjes së saj që na del më vonë dhe zë vend në periodën letrare. Këtu duhet të kemi parasysh faktin se nyja e përparme ka lidhje të ngushtë me fjalën që i prin dhe ajo (nyja) shfaqet kur fjala është e pajisur me një të prapme, përkundrazi ajo mungon kur fjala na paraqitet pa një: *lulja e malit*, ndërsa *lule mali*, *mishi i viçit*, por *mish viçi*, gjë që na shtie të pranojmë se pozicioni i nyjës së përparme varet nga enkliza. Këtë raport e përforcon edhe pajtimi i nyjës së përparme jo me fjalën që e ndjek, por me fjalën që i prin; Kongruenca e nyjës së përparme me fjalën përkatëse bëhet në gjini e në numër: Kopshti i luleve, maja e malit (te Çabej, 1963).

Në disertacionin e tij të doktoratës, e sidomos në një vepër të veçantë (**Prapavendosja e nyjës në gjuhët ballkanike**, 1984) të B. Bokshit, zhvillimi i nyjës dhe këmbimi i saj nuk vështrohen si çështje më vete. Zhvillimi i saj ndiqet në kuadër të përcaktimit të sistemit rasor, si element i rëndësishëm në një fazë qendrore të këtij sistemi.

Në këtë punim të disertacionit B. Bokshi thotë që emri e kishte

nyjën shquese në pozicion prokliitk, qysh e kishte konstatuar S. Riza (të vëllazën = *të* mi vëllazën, në të cilin togfjalësh segmenti *të* lidhet me elementin e fundit me emrin *vëllazën*, një lagje tjetër e lingvistëve elementin nistor të *e* lidh me pjesën përemërore *mi*, pra *të mi*).

Ndikimi që latinishtja ka ushtruar mbi gjuhën shqipe për afro tetë shekuj, ka rëndësi të shumëfishtë për historinë kulturore e gjuhësore të shqiptarëve. Që nga shekulli II para erës së re e deri në qindvjetëshin VI të kësaj ere nëpërmjet organizmash të ndryshëm rëndoi pareshtur pesha e sundimit romak e në rrymë të kësaj kohe, me rrugë të caktuar, edhe në lëmin e gjuhës shqipe.

Megjithëse shqipja nuk është gjuhë romane, numri i latinizmave të saj në fushën e termave kishtarë është shumë më i madh se ç' duket ai në rumanishten, ku në sferën kishtarë mbizotërojnë terma kishtarë sllavë, e në shqipen në atë fushë nuk del asnjë shprehje me burimin sllav. nga kjo rezulton se dyndja sllave në këto vise gjeti një kishë shqiptare të organizuar që s'kishte më nevojë për terma plotësues e të rinj kishtarë (E. Çabej, **Buletin**, 1963/3). [Në fondin e leksikut të shqipes ka huazime latine që nuk ruhen në gjuhë të tjera romane, siç është fjala *e diel*, për emrin e së cilës, s'është gjë tjetër veç përkthim fjale i shprehjes latine *dies solis* nga periudha pagane; e në gjuhët romane përdoret një emër shumë më i vonë, që është shfaqur në shekullin IV të erës sonë, *dominica*, fr. *dimanche*, it. *domenica*, rum. *domineca*]. Vjetërsia e latinizmave të shqipes ka peshë të madhe dhe është një indic vendimtar në përcaktimin kohor e hapësinor të tyre, e për mendimin tonë, është vështirë të hidhet poshtë mendimi që ato zunë të hyjnë në këtë gjuhë që para erës sonë në bashkëtakimet e para të romakëve me popullsinë e fiseve ilire, sidomos përgjatë viseve bregdetare.

Në pjesën e hyrjes, u prekën disa elemente të formimit të gjuhëve të popujve të Ballkanit, mënyra e formimit të tyre, trysnitë që eventualisht kanë ndikuar në ndryshimin a ndërrimin e sistemit gjuhësor, në krijimin e kategorive të reja gjuhësore në disa prej gjuhëve të Ballkanit: kalimi nga sintetizmi në analitizëm gjuhësor ballkanik. Po edhe në kohët antike në një territor relativisht të ngushtë të Gadishullit Ballkanik qytetërimi i lashtë i

tij s'ishte e mundshme të tretej krejtësisht, veçse, duke u gërshetuar me kulturën materiale dhe shpirtërore të ardhërsve të rinj indoevropianë u bë pronë e këtyre. Qytetërimi grek a helen (kultura greke) – po e përsërisim, nuk nis me të ngulur të indoevropianëve grekë – ajo kulturë edhe se në thelb thjesht greke, në strukturën e saj ka një komponent të dukshëm egjean.

Para asnjë shkence nacionale, asnjë gjuhësie historike, kurrnjë disipline gjuhësore nacionale nuk shtrohen detyra më të ngutshme kombëtare për t'u zgjidhur se ç'i dalin gjuhësisë shqiptare. Vetëm gjuhësia historike krahasuese ka mjete, pothuajse, të sigurta gjuhësore në sqarim të çështjeve nacionale, sikur janë: prejardhja e popullit shqiptar dhe e gjuhës së tij, identifikimi i vendit të formimit të gjuhës shqipe – vetëm albanistika – gjuhësia historike shqiptare – si e brendshme edhe e jashtme, mund ta zgjidhë lëmshin e koklavitur se cila hipotezë – ajo ilire apo trakase e gjuhës shqipe ka më shumë prova e dëshmi të pranueshme.

Si kalimthi po u biem disa faktorëve që tërthorazi ndihmojnë për sqarimin e çështjes kardinale të prejardhjes së shqiptarëve dhe të gjuhës së tyre: 1. mbishtresimi grek dhe ai latin i thesarit leksikor të gjuhës shqipe mund të ndodhte vetëm në territorin e Ballkanit të vjetër; 2. Gjuha shqipe flitet vetëm në terrenin e mirëfilltë ilir; 3. Nuk ka kurrfarë lajmesh për imigrimin e shqiptarëve në mesjetën e hershme në atdheun historik të tyre. Në një gjendje të tillë të dijes del përfundimi, pothuajse vetvetiu se shqipja paraqet një formë moderne të ilirishtes. Mbrojtësve të hipotezës trake të gjuhës shqipe u mbetet vetëm një “argument”. Emrat gjeografikë antikë të Shqipërisë në formën e tyre moderne gjoja nuk përkuakan me ligjet fonetike të shqipes dhe ata u shpjeguakan vetëm me ndërmjetësimin e gjuhëve të tjera, me të rumunishtes dhe të sllavishtes jugore, “kurse trajtat e sotme sllave të jugut të emrave antikë në territorin qendror të Ballkanit, dëshmojnë për ndërmjetësimin e ligjeve fonetike të shqipes” (R. Katiçiç). Në lidhje me emrat antikë të Shqipërisë duan shtuar edhe nja dy fjalë: nuk qëndron mendimi se ata nga pikëpamja e ligjeve fonetike përputhen me të rumanishtes dhe të gjuhëve sllave jugore; gjuhësia, jo vetëm shqiptare, ka

vërtetuar se emrat topikë të atjeshëm nga ana e ligjeve fonetike, pajtojnë më së miri, porse me të gjuhës shqipe.

“Hipoteza trake është vetëm një konstruksion interesant – dhe supozimi që shqipja të ketë prejardhje ilire mbetet për shkak të rrethanave të përshkruara në fillim alternativa më e mundshme, që, në anë tjetër, nuk është vërtetuar me siguri”. (R. Katiçiç, *Provincat ballkanike*, Gjurmime albanologjike, 14/1984, f. 40-42, së pari – *Die Balkanprovinzen*, in *Die Sprachen in Römischen Reich der Kaiserzeit*, Köln und Bonn, 1980, 115-116).

Që prejardhja e shqiptarëve dhe e gjuhës së tyre të mos ketë “alternativë” duhet të ekzistonte një gjysmë faqe teksti në ilirishte, në mënyrë që mbi bazën e një krahasimi me të shqipes së sotme apo të gjuhës së Buzukut, të vërtetohet rrjedhja e gjuhës së sotme shqipe nga gjuha ilire e dikurshme dhe që shqipja të paraqiste një formë moderne të ilirishtes, sikur nga latinishtja klasike apo nga latiniteti vulgar rrjedhohet frengjishtja e vjetër apo italishtja e mesjetës së hershme.

Në rastin e dytë njihen që të dyja madhësitë për mrekulli, si latiniteti vulgar edhe frëngjishtja e vjetër, po ashtu edhe italishtja e mesjetës së hershme; madhësitë e rastit të parë nuk i njohim njësoj, dimë shumë vetëm për njërën nga këto – shqipen, kurse ilirishten e njohim fare pak a aspak “sidomos jemi krejt në errësirë në punë të strukturës së saj gramatikore dhe mezi po arrijmë ta rindërtojmë deri diku atë gjuhë me anën e thërri-meve që mund të thuhet se na kanë mbetur prej saj”, thotë E. Çabej tek “Ilirët dhe gjeneza e shqiptarëve”, në studimin e tij “Ilirishtja dhe shqipja”.

Mundësitë e sqarimit të problemit të prejardhjes së shqiptarëve dhe të gjuhës së tyre mund të shtoheshin po të shtoheshin me ndonjë zbulim material i krahasimit.

SHQIPJA DHE GJUHËT FQINJE

Titulli i sipërm i kësaj teme në veprimin e gjurmimit të saj do të merrte një kuptim krejtësisht formal kur unë, në këtë mes e me këtë rast të përpëlitesha t'u hyja t'i përsëritja të gjitha ato teza mbi origjinën dhe prejardhjen e gjuhës shqipe dhe të shqiptarëve. Gjykoj se nuk e shoh të nevojshme të hyja e të përsëritja të gjitha ato teza mbi origjinën e prejardhjes së gjuhës shqipe dhe të shqiptarëve, por, sido që të jetë puna çështja e hulumtimit të tezave të prejardhjes së popullit shqiptar dhe të gjuhës së tij nuk mund të anashkalohet.

Në lidhje me tezat e prejardhjes së shqiptarëve dhe gjuhës së tyre kanë rëndësi pohimet e historianëve të shquar të Perandorisë romake, pikërisht historianit Momsen e të tjerëve, të cilët sipas linguistit Seit Mansakut, janë marrë me fatin e Perandorisë romake, se ilirët e Jugut nuk u romanizuan në kuptimin e plotë të fjalës, ndonëse si ilirishtja pastaj edhe shqipja pësuan ndikim të ndjeshëm të latinishtes, kryesisht në fushën e leksikut. Pakësimi relativ i romanizmit në Ilirinë e Jugut shpjegohet me numrin e vogël të mbishkrimeve latine në këtë pjesë të Perandorisë romake se ç'janë gjetur në anë të tjera të saj. Sh. te Kuvendi I i studimeve ilire; ndryshe në Dakinë ku me një përqendrim më të theksuar kolonizimi mbi një politikë gjeostrategjike, me synime përzgjerimi e pushtimi nga veriu e lindja Perandoria shtriu dhe vendosi sundimin e vet në gjithë Luginën e Danubit të Poshtëm duke siguruar kufijtë e saj nga rreziqet që mund të vinin nga Perëndimi a Veriu. Romantizmi disashekullor varfëroi gjuhën shqipe duke pakësuar leksikun e saj, por thelbin e kësaj gjuhe nuk arriti ta shuante.

Më 23 maj 2003 Gjirokastra, me rastin e 95-vjetorit të lindjes së Prof. Eqrem Çabejt, në Universitetin e vendlindjes, organizoi Konferencën Ndërkombëtare në të cilën Prof. Seit Mansaku duke njohur profesorin e tij thellë si shkencëtar dhe si njeri, me frymë të skajshme objektive, e vlerësoi

opusin shkencor të dijetarit shqiptar. Për profesorin e tij Mansaku vazhdoi duke deklaruar se si linguisti i njohur shqiptar mbështeste me realizëm tezën e prejardhjes ilire të gjuhës shqipe dhe të shqiptarëve megjithë argumentet historiko-shkencore që zotëronte dija e albanistikës. Nuk i përjashtonte tezat e tjera sidomos tezat gjuhësore veçse nuk e miratonte pellazgjishten. Ajo, pas gjykimit të tij, s'kishte të bënte as me ilirishten, as me fazën e re të saj – shqipen, shpjegonte nxënësi i tij S. Mansaku. Autoktoninë e shqiptarëve, sipas Mansakut, Çabej e kuptonte si jo të plotë, si të kufizuar, si relative; këto dy teza, teza ilire e shqiptarëve dhe teza trake e shqiptarëve, s'janë veçse teza shkencore që rreken të shpjegojnë historinë e lashtë të popullit shqiptar dhe të gjuhës së tij.

Nga shekulli V-VII në vise të Ballkanit ndodhën ngjarje me rëndësi të madhe për fatin e popullsisë të vjetra të Gadishullit Ballkanik; është fjala për vendosjen e sllavëve në treva të Gadishullit që pati pasoja të ndjeshme e të mëdha politike e kulturore.

Depërtimi i sllavëve në tokën e shqiptarëve u nis nga dy pika të ndryshme: duke ndjekur rrjedhën e lumit të Drinit e pastaj duke rënë në Shkodër dhe rrethin e saj me përfshirjen e gjithë atë krah jugor të Shkodrës dhe duke shtënë në dorë edhe vetë qendrën e saj.

Në jug të Shqipërisë sllavët shpërthyen në anë të Beratit (Belgrad) dhe të Skampës (Elbasanit) duke dalë tek lumenjtë e Devollit dhe të Vjosës (Vojushës).

Simbioza sllavo-shqiptare, e cila zgjati gjithë mesjetën përfundoi në mbarim të kësaj periode duke rezultuar: shumë sllavë u shqiptarizuan në Shqipëri, e shumë shqiptarë u sllavizuan, sidomos në viset periferike të Veriut. Ky proces i fundit në veriperëndim të Shqipërisë vazhdoi dhe në kohën e re (Çabej), “Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes”, 95.¹

Historiani i madh Konstantin Jireček, specialist i historisë së mesjetës, pasi shpjegon rastin që e kishte shkaktuar një kontest gjyqësor,

¹ K. Jireček, *Die Romanen I*; Sufflay, *Acta Albaniae, I*; ARHIV, II, Jokl, *Archivum Romanicum* 7. Një mendimi të tillë i mbahet edhe Petar Skok, *ER, II* 219.

merr e vë në dukje sesi nga mbarimi i mesjetës, sidomos në Dubrovnik, po grumbullohej një numër i madh shqiptarësh të ardhur prej viseve shqiptare në kërkim të punës: tregtarë, zejtarë e sidomos murgj e priftërinj në njëkohë kur tregtia, detaria e lundrimi po merrnin hov në një kohë kur breznitë e reja po kërkonin të pushtonin hapësira tokësore e detare të reja.

Ne po lejohe mi të sjellim një dokument shkrimor që historiani i njohur çek K. Jireček e kishte gjetur në arkivin e Dubrovnikut: “*Audivi unam vocem clamantem in monte in lingua albanesca*” 1285, Zbornik Konstantina Jirečka, II Bgd. 1962, f. 51.

Besimi katolik ndër shqiptarë erdhi nga Dalmacia e afërt.

Shkodrani humanist Marin Barleti formimin e nisi në Shkodrën e tij, e vazhdeoi në Raguzën fqinje, për të vijuar e përfunduar në Venedik e Romë.

Fan Noli për të tha: “Me latinishten e tij elegante dhe me stilin e kujdesur të tij, fitoi këndonjë anembanë botës dhe e bërë të pavdekur kujtimin e Skënderbeut në Evropë.

Prof. Sima Çirkoviç kishte lexuar, për temën bosht: “Ilirët dhe shqiptarët”, pjesë nga referati i tij me titull “Shqiptarët në dritën e burimeve të sllavëve të jugut”.

Këtu do të vihen re, sidomos njoftimet mbi trojet shqiptare të shekullit XII dhe të fillimit të XIII që tregojnë sesi në atë kohë shqiptarët mbanin një territor me kufij krejt të caktuar, porse ai territor nuk mund të zgjerohej e të shtrihej sipas dëshirës a tekave të dikujt. Burimet e sllavëve jugorë përmbajnë gjithashtu gjithë ç’kanë tekset bizantine dhe të tjera mesjetare, me fjalë të tjera ato tregojnë se shqiptarët qysh në mesjetë kishin zënë të mërgojnë nga vatra e të parëve të tyre e pafrytshme dhe e metë për të ushqyer tepricën e popullsisë. Ata (shqiptarët) nuk lëviznin nga vendi i tyre nga motive pushtimi veç nga nevoja e madhe e tyre, sikundër edhe të gjithë banorët e trevave malore. Dyndje të pandërprera popullsish në drejtim të vendeve më të buta të kultivuara dhe më pjellore mund të ndiqen me shekuj në zonat dinarike dhe alprike dhe jo vetëm në

ato anë të banuara nga shqiptarët. Këtu përshkruhet mënyra sesi zë fill boshatisja e një vendi duke filluar nga braktisja individuale që nga rrallëkush diktohet një fenomen të cilin e kishim hetuar ndër klerikë dhe punëtorë shqiptarë”.

Emërtime gjeografike në shqipen dhe serbokroatishten

Duke rishikuar kohët e fundit etimologjinë e Shestanit, në veprën e Erdelanoviçit, kemi hasur në një frazë shumë drejtimdhënëse: “držati na šestu”, me kuptim “punoj, a lëvroj tokën e huaj dhe pronarit i jap të gjashtë e frutit”. Pas mendimit tonë, trevat që mbanin emrin *Shestani* duhet të kenë qenë zotërime feudalësh që punoheshin prej katundarëve me detyrime që feudalit t’i jepnin pjesën e gjashtë të prodhimit të tokës.

Në këtë analizë onomastike po i sillemi ta vështrojmë emrin e Kuçit, dikur Nahije, një emërtim që studiuesit e Malit të Zi e përdornin për krahina të ndryshme të tij. Krahina e Kuçit përmendet për herë të parë në krisobulat e Deçanit më 1330.

Kur marrim e gjurmojmë burimin (prejardhjen) e këtij emri – një gjë që në këtë mes na intereson, del se studiuesit s’pajtohen në mendime; në hetimin e gurrës së këtij emri topik janë shfaqur dyshime, lëkundje dhe përfundime të gabuara. Mendimi më i përhapur është ai që prejardhjen e tij e nxjerr të dalë nga mbiemri “i kuq” i shqipes duke menduar se kemi të bëjmë me një truall të kuq.

Ç’është e drejta edhe vetë jemi lëkundur saherë që është dashur të marrim qëndrim në lidhje me gurrën e këtij toponimi. Por kur merret puna e këqyret më imtas dhe në mënyrë të shtjelltë del se ekzistenca e apelativit *kuç*, por jo “i kuq” në gjuhën shqipe ka kuptim “një lloj kuthi a vorbe me dy veshë, dhe emër vendi i ngulur në një gropë, në një luginë, emër që i përgjigjet vorbës e vorbëtinës” (Çabej). “Nga vështrimi i apelativit *kuç* (vorb, kuth) u motivua më vonë një kuptim metaforik me ç’gjë shkoi e u zgjerua fusha semantike e tij”. Te ky emërtim ka mbetur për t’u shpjeguar

Kuçi edhe diçka tjetër tek apelativi kuç dhe emëritmi topik Kuçi përmbahet afrikatja ç, por jo paraqellzorja q, në të folmen shqiptare të këtyre viseve këto dy bashkëtingullore dallohen prerazi.

Mali i Zi, Bosna dhe Hercegovina u japin blegtorëve në katunet kushte të mrekullueshme me kullotat e tyre të begatshme, dhe është e natyrshme që përbrenda tyre të lëviznin një numër i madh barinjsh me origjinë vllahe, shqiptare dhe serbe.

Një nga nahijet e mirënjohura me shumë katune dhe fshatra në mesjetë është rrehti i Kuçit me këto “katune”: Pantalesh, Barzan (Bardhan), Benkeç, Bytidosi (Bythëdosi), Lazorci (1497). Këto katune dhe emërtimet e tjera me origjinë shqiptare kanë marrë prapashtesa të gjuhës serbe: Leškovići, Lopari, Vjeduši, Bardići, Kuçi. Prapashtesa të serbishtes kanë edhe emërtimet e disa fshatrave dhe katuneve në nahijen e Kelmendit (1497), Liçeni (Liqeni) e Shpaja me katunet Djonovići, Leškovići, Murović, Kolemade (shqip Golëmadhe, Gojëmadhi). Në nahijet e tjera në atë të malit të Hotit dhe të Piperit, gjejmë të dëshmuar katune dhe fshatra me emra shqiptarë që nga fundi i shekullit XV; Keçi, Špihja, Bushat, Rogami, Bukmir (shq. Bukëmirë).

Komuna blegtorale e quajtur Burmaza ose Burmazovići që daton në shekullin XIV, e emërimi i së cilës ruhet edhe sot e gjithë ditën te Stoca e Hercegovinës, do një çikë shpjegim: shqiptimi i emërtimit të ri topik është vllahisht, ndërsa, po të zërthehet në elementet e saj, përbërsit që e formojnë janë krejt shqip (Burrë i madh), V. Ćorović, ARHIV, II.

Toponimi Bytidosi, Bitadosi është shumë i vjetër; është një kompozitë shqipe e mirëfilltë *Bythëdosë* – Bythëdosë-t (podex porci) me siguri apelativi i një vëllazërie Bythëdosë-t, që më vonë u zhvillua në katun, duke mbajtur edhe emrin e vet.

Apelativi Lopari (me kuptimin e loparit, bariut të lopëve) lidhet me shqipen *lopë*, ashtu si dhiar me *dhi*; është një fshat në Fundanë të Kuçit. Toponimi Fundena, Fundëna në Fundanë të Kuçit përmendet afër Drivasit (shqip Drisht – 1402). Po ky apelativ gjendet edhe në Kuç. Sa për

originën e tij, është i padyshimtë burimi i tij nga shqipja, prej fjalës fund dhe prapashtesës së shumësit (e)-*na*, që i gjejmë në një pjesë të madhe të toponimeve të tilla në territorin gjuhësor shqiptar, si Lis-na; nga *kishë* kemi Kishën, fshat afër Shkodrës, nga shtek, shumë shtiqe, shtigje (Çabej); *bisht* Bishtna- në Malësinë e madhe. Origjina e toponimeve të lartpërmendura Ligatici dhe Ligatë (njëri në Hercegovinë dhe tjetri në Bosnë), duhet kërkuar te fjalët shqipe. Ato rrjedhin prej shqipes ligatë, kurse kjo është një derivat nga *lag* dhe prapashtesa – *atë*. Një tokë e tillë është gjithmonë e lagët me ujë; prej *lagate* te ligatë nga pikëpamja gjuhësore rruga është shumë e thjeshtë; ligate si apelativ dhe toponim Ligatë nuk mund të vihet në lidhje me fjalën *i lig* (i sëmurë), pra “vend i pashëndetshëm”, siç shkruan Lirak Dodbiba, “Studime filologjike” 1, 1967, 44.

Emri i katunit *Ćeret* (në Zagarçin e Poshtëm) është identik me emërtimin e aq të shpeshtë, nëpër vise me popullsi shqiptare, në krahinë ku rriten shkurret, dushqet e lisnajat. Në këtë mes është me rëndësi të vihet re se emri i këtij toponimi është një rrjedhojë nga fjala bazë qarr e zgjëruar nga sufiksi – latinoroman *etum*, që del në tria gjuhët ballkanike: në shqipen, dalmatishten romane dhe në rumanishten, me vështrim oronimesh që tregojnë vendin ku rriten një shumicë drunjsh e bimësh që tregon fjala primitive në truallin e shqipes; *Kashnjet* (*Castagnetum*), *Kallmet* (kallm), *shkozet* (shkozë), *shkorret* (shkorre, shkurrë), *shelqet* (shelg, shelk).

Në Fjalorin e gjuhës popullore dhe letrare të serbokroatishtes që hartohet në Akademinë Serbe të Shkencave dhe të Arteve gjejmë foljen: *zaprušiti, zàprušim*, një krahinarizëm që del me këto kuptime: “këllas, shtie në dhé, mbuloj, mbush me dhé, me zall, me ranë”: - Domaćice, čim izmaknu lonac s jelom iz ognjišta, odmah *zapruše* onaj krug pepela koji je lonac ostavio; Daj, idi zapruši tu rupčinu. Në shtëpinë e zjarrit, në votër, në mbrëmje, pasi të përgatitet gjella e të hahet darka, prushi i zjarrit do të mbulohet me hi, që gacat të ruhen për zjarrin e nesërm. Po t’i sillemi fjalës sonë në shqyrtim *zaprušiti, zaprušim*, që del me një vështrim të caktuar, ne

nuk arrijmë ta afrojmë te çfardo folje tjetër të serbokroatishtes, që të ketë një kuptim të afërt me fjalën tonë në studim; një farë afërie fonetike dhe kuptimore gjejmë te shprehja *zaprashiti* e serbishtes, e dalë nga *prah-pluhur*, “pluhuroj, pluhuros, bëj me pluhur, ngre, çoj pluhur”. Po të merrej si fjalë vendi, do të mbetej i pashpjeguar ndërrimi nga *zaprushiti* (prah: pruš) që në fonetikën e serbokroatishtes nuk gjen arsye.

Mbi mbështetjen e shpjegimit të sipërm fonetik e vështrimor, foljen e të folmeve serbe *zaprushiti*, *zaprushim* ne e gjejmë të sajuar nga e shqipes *prush* e zgjeruar me parashtesën sllave *za*.

Në fjalorin e Akademisë Serbe të Shkencave, që posa u përmend, regjistruam edhe një folje tjetër për burimin e së cilës ngjallen dyshime dhe shprehen pikëpamje të ndryshme; është fjala për foljen *zashatiti*, *zashatim* me përhapje të kufizuar, e krahinore te Uzhica, në Serbinë Perëndimore, që del me një vatër të gjerë vështrimore: “kap, marr, nxjerr, rrëmbej, përfshij, rrok një sasi ujë, ose diçka tjetër”.

Po të duam të ndjekim etimologjinë e kësaj fjale, si çdo herë, edhe këtu pikësëpari ajo do të zbërthehet në elemente të saj përbërëse; pastaj, po s’që e mundshme të bëhet një analizë e tillë e saj, që do të thotë se, pas të gjitha gjasave, nuk është e përfutur nga brumi i gjuhës amtare, atëherë do të rrihet një rrugë tjetër duke kërkuar lidhjet e jashtme të saj. Në rastin konkret, një – *šat*, që kur të veçohet do të dilte nga *zashatiti*, nuk është vërtetuar kund në ndonjë prej gjuhëve sllavojugore, që të përkonte si nga forma, si nga kuptimi me fjalën tonë në shqyrtim. Prandaj, deshëm, s’deshëm, do t’i drejtohem një gjuhe tjetër të popujve fqinjë. Për mendimin tonë, fjala e shqipes *shat*, si nga pikëpamja fonetike, si nga ajo kuptimore, i përgjigjet për mrekulli foljes së dialekteve serbe *zashatiti*, një postverbal nga *šat*, të cilit i është ngjitur parashtesa sllave –*za*, duke krijuar një folje me kuptim: “*marr, rrok me shat dhé*”.

Grēmëratë “kullloshtër”, del për herë të parë e vetëm te Reinholdi, *Noctes pelasgicae*, 1855, 66. Me të drejtë Çabej e hedh poshtë shpjegimin e Meyerit nga lat. *Cremoratum*, e ajo nga cremor “qull, lëng i trashë”, si dhe mendimin e këtij albanologu austriak, që pasi e tërheq etimologjinë e parë

të tijën grëmëratë e binte të ardhur prej lat. *glomus* “lëmsh” (Alb. Studien V); s’ka si të qëndrojë as etimologjia e Pascut (Rum. Elemente in den Balkansprachen, Dictionnaire étym. macedoroum) për të vetmen arsye sepse ajo nuk ishte dëshmuar gjëkund në dialektet rumune.

Në shqipen fjala del me përdorim të kufizuar, e njohin, me sa duket vetëm ligjërimet arbëreshe të Greqisë, prandaj Çabej (Buletin, 3/1963) gjen vështirësi ta shpjegojë me mjete të gjuhës shqipe, në analizën e së cilës ai arriti të një *grëmë* të pavërtetuar. Në hetimin e kësaj fjale, sipas mendimit tonë, duhet të kapërceheshin disa vështirësi, po të mendohet se ajo ka burim shqiptar: njëherë të zgjidhet çështja pse forma e greqishtes *gramenata* del me veçori të gegërishtes, mendimi i Çabejt se trajta geqe e saj hyri në greqishten në një fazë parashqiptare, për ne nuk është bindës, e dihet që huazimet shqiptare të greqishtes kanë trajta të toskërishtes e jo të gegërishtes.

Burimi i kësaj fjale do të kërkohet të gjuhët sllave të shprehja serbokroate *grumen*, nga një trajtë më e moçme *grudmen*, ku – *men* do të njihet prapashtesë e vjetër parasllave, që shpejt u zhduk nga sllavishtet, me vështrim: “toptha të qumshtit kur mbështillet, kokrriza qumështi, plis dheu, top dheu, shuk bore, sumbull gjaku”. Fjala përqaset me gjerm. gries; fjala sllave u shtri në shqipen e hershme *grumen* që, sipas rregullave në fuqi të shqipes u zhvillua trajta *grëmenatë*, që më vonë me rregullimin mekanik akcenti u shpërngul në rrokjen e parafundit *grëmerat* duke pësuar rotacizmin, ndërsa forma e greqishtes së re (*gramenata*) u muar jo me ndërmjetësinë e shqipes, veç pavarësisht, përndryshe, po të kishte hyrë ndërmjetësisht, do të mbetej pa shpjegim mungesa e rotacizmit në formën e fjalës greke *gramenata*; për rrjedhim qoftë të *gremenata* dhe *gremerata* nuk kemi të bëjmë me zhvillime shumëfish me anë të *na, ra*.

Kur me të rënë të sllavëve në bashkëtakim me popullsinë romane të Dalmacisë masa e madhe sllave zuri shumë shpejt të ndikojë në të folmen romane, dhe ndër të parat huazime sllave të dalmatëve romanë, që emri i hidronimit *Ombla*, që, krejt në pajtim me fonetikën historike rridhte nga trajta e fjalës së sllavishtes së vjetër përkatësisht nga zanorja *o* në

pozicionim hundor të hidronimit *oble* me shqiptim *Ombla* me vështrim “gurrë, burim”.

Kohë më pas zanoret hundore *o*, *e* të sllavishtes morën rrugën e çhundorëzimit në *u-e*, pra u përfatuan nga *om*, *en* në *u*, *e*: *Ubli*, pastaj në *Uba*: suditi (shq. *sundoj*, *red*(shq. *rend*).

Zanoret hundore të dialekteve serbe e kroate ishin në përdorim deri nga gjysma e dytë e shekullit X, thotë sllavisti i shquar Jugoslav Radosav Bošković, te *Osnovi uporedne gramatike slovenskih jezika*, Beograd, 1968, f. 63.

Te hidronimi *Ombla* për sll. Rijeka, që është një gji i detit të Adriatikut te Dubrovniku nuk kemi të bëjmë me ndonjë adjektiv shqiptar, siç mendon E. Çabej² i cili hidronimin e sotëm italisht *ombla* e që për herë të parë del më 1160, e bie të ardhur nga adjektivi i shqipës *ambël*, *ambla*, me buzorëzimin e *a*-së hundore *ombël ombla*, e që duhej të shënonte një burim me ujë të ëmbël; burimit nga shqipja të këtij hidronimi, kur jemi në truall të shqipës, i dalin disa vështirësi jo të lehta për t’u kapërcyer: në sferën e fjalëformimit të gjuhës sonë nuk di si mund të hiqet pengesa që kompozitet ekzocentrike me vlerë pronësore mos të kenë dy komponente: të parën dhe të dytën që është zakonisht një atribut përcaktues, bie fjala Gurabardhi, Ujëbardhi, Gurëthati, Guraziu, Ujmiri, - *Ombla* do të ishte përjashtim i vetëm, prandaj vërtetësia e saj, sipas mendimit tonë vihet në dyshim.

As historiani i njohur i popujve të Ballkanit K. Jireček hidronimin *Ombla* te Gruzha e Dubrovnikut nuk e quan të gurrës së huaj, veçse ai atë e çon tek emrat e toponimeve aq të shpeshta nga Kraja e Malit të Zi, te Kuçi e deri në Dalmaci:

Uble – te Spliti

Ub – në Serbi

² (Altere Stufen des albanischen im Lichte der Nachbarsprachen, te Zeitschrift für Balkanologie, II (1964), Betrachtungen über die rumänisch-albanischen sprachbeziehungen – Revue Roumaine de Linguistique X (1965), Studi si Çerçetari Lingvistice X/4,1959.

Ubalac – te Podgorica

Ubli – te Cetinja e Malit të Zi

Ubli – në Kuç të Podgoricës

Ubli – te Nikshiqi

Ubli – në Hercegovinë.

Besimi katolik ndër shqiptarë erdhi nga Dalmacia e afërt.

Shkodrani humanist Marin Barleti formimin e nisi në Shkodrën e tij, e vazhdoi në Raguzën fqinje, për të vijuar e përfunduar në Venedik e Romë.

Fan Noli për të tha: “Me latinishten e tij elegante dhe me stilin e kujdesur të tij, fitoi këndonjës anembanë botës dhe e bëri të pavdekur kujtimin e Skënderbeut në Evropë. Këndon liksht, po ka zë të bukur!”, te “Historia e Skënderbeut”, Boston, 1921.

RRETH ZËVENDËSIMIT TË TOGUT BASHKËTINGËLLOR LATIN –CT NË GJUHËN SHQIPE

Kalimi i fonemës q(ć) qiellzore në fërkimoren j është dukuri mjaft e shtrirë në të folmet shqiptare, sidomos para bashkëtingëlloreve: **t, n, m, v, sh, ç, th**.¹ Kjo dukuri mund të provohet nga tekstet e vjetra shqipe.

Ndonëse refleksi –jt (it) nuk përbën sot një çështje me interes, as ka ndonjë rëndësi, ne po e rimarrim për punë të prejardhjes së saj; po i kthehemi sepse nga grupi konsonantik latin **ct**, ka në shqipen edhe një përfaqësim me **kt**. Një trajtë me –kt (qt) ne gjejmë, siç u tha në përmendoret e vjetra të shekullit XVI; kemi, gjithashtu, dysorët, në një anë i **drejtë** dhe, në anë tjetër: **i dreqt (i drekë) ndret, dret**.

Trajta **dreqtë** është enigmatike, sepse ka përmbysur konceptin sipas të cilit –jt është pasqyrim i grupit konsonantik latin **ct**, me më shumë arsye që forma **kt** është e vjetër: takohet te Buzuku në shek. XVI, me gjithë faktin që ne e kishim dëgjuar në Brisk dhe Shestan. Prof. Çabej² na kishte siguruar prova për këtë trajtë: ndër të folmet e toskërishtes jugore dhe me të arbëreshëve të Italisë Jugore. Ndër arbëreshët te Zara ruhet forma **ndret**, trajta e kryehershme e së cilës është mjaft vështirë të vërtetohet, sepse është e pamundur të përcaktohet me siguri zhdukja e bashkëtingëllores së saj.

Për sa i përket reflektimit të **ct** latine në shqipen mendimet e albanologëve janë, përgjithësisht, të ndara: një palë e tyre mbrojnë mendimin që togu bashkëtingëllor është zëvendësuar nga **ft** në një anë, dhe lagjja tjetër e tyre me –jt, lat. *lucta* = shq. luftë; *trocta* = troftë; *directus* = drejt, rum. drept; *fructus* = fruit, fryt. Këtu duhet të vihet në dukje që reflektimi shqip i të latinishtes **ct** ndër disa fjalë përshtatet në mënyrë të përsosur me të dalmatishtes romane të vdekur, në të cilën ky

grup latin **ct** është ruajtur mirë ose kthyer në **jt**; e njëjta gjë ka ndodhur me **-x (ks)**: lactem = laite, tractam = traite, Maximus = Maisan³.

Disa njohës të historisë së gjuhës shqipe⁴ mbrojnë pikëpamjen që **ct** latine i përgjigjen tri reflekse: **ft (qt)**, **jt**, **t**. Dijetari Norbert Jokl (l.c) në pasqyrimin shqip të **-jt** sheh një formë të rrjedhur nga një fazë më e vjetër **kt**, bie fjala paq = paqtoj, paqoj, **q**-ja e së cilës, zakonisht, ka përfunduar në **j**, **jt**. Në të vërtetë, Jokli, për këtë fenomen gjen një mbështetje në fonetikën bashkëkohëse të shqipes: shoqi-shojnë, me kallëzoren shojnë < shoqin, porse ne mendojmë se kjo është një dukuri e vonë në këtë gjuhë, që do të thotë se **paqtoj** duhet të jetë me siguri një fjalë e prejardhur, sikundër, me plot arsye ai e bie të dalë nga **paqë**, ndërsa **paqtoj** e gjen një huazim nga e latinishtes pactare.

Dijetari Eqrem Çabej mbron, ai vetë, reflektimin e tri llojeve të latinishtes **ct** në gjuhën shqipe, Hyrje, p. 51, 109, për çka sjell shembuj të njohur: luftë < lucta, drejt < directus, ndërsa nga factura jepet fetyrë, fytyrë, qysh i del atij në studimin e përmendur.

Ne mbështesim mendimin e dijetarëve për pasqyrimin e trefishtë të togut bashkëtingëllor latin **ct** të shqipes, por vetëm përsa i përket rezultatit përfundimtar.

Në lidhje me grupin të përmendur latin, ne po ngremë një çështje, e cila, sipas nesh nuk ka marrë zgjidhje të rregullt. Pra, fjala është për çështjen: cila nga të dy format e reflektimit (pasqyrimin) **-jt**, **qt**, është më e hershme. Jokli, siç e kishim thënë, pohoi se **-jt** është një trajtë më e vonë, së cilës i paraprinte **kt**-ja; e është nxënësi i tij Eqrem Çabej ai që ia vërtetonte⁵, duke cituar formën **dreq** pranë **drejt** nga e latinishtes **directus**, e cila ndeshet te Buzuku si **dëreq**. Mendojmë se është guxim të sillen përfundime të ngjashme, me anën e një shembulli të vetëm. Përveç kësaj, takohet shpesh kjo formë (dreq) në disa raste të idiomave të vjetra shqiptare që i përmendëm këtu sipër.

Jokli dhe Çabej mbështeten mbi pasqyrimin e njohur të kthimit të **q** në **j**, që ruhet jo vetëm në gjuhën e sotme shqipe, porse gjithashtu në

dorëshkrimet e vjetra të gjuhës së shek. XVI, e më vonë: plejtë, zojtë < pleqtë, zogjtë, zoqtë, Pedersen, Alb. Texte mit Glossar; te Buzuku: të kejtë < të keqtë; Bardhi: i kujth = i kuqth, Dictionnaire, 136.

Mendojmë se harrohet fakti që në tekstet e vjetra shqipe gjenden tipare rinuese që më vonë shtrihen në gjuhë. E në lidhje me këtë, në shembullin **dreq**, që është vërtetuar në gjuhën e Buzukut, ne shohim një process risimi të dalë nga forma e përgjithshme shqipe drejtë, i drejtë: lat. tracta > shq. trajtë. Kujtojmë se prirja e vështruar e kalimit të **-j-së** në **q** dëshmon (provon) mendimin tonë sikundër po shihet nga shembujt **biqt** (**biqt**) dhe **biçët** për **bijt** (les fils), që kishim shënuar (regjistruar) gjatë shqyrtimit në terren në Krajën e Malit të Zi – në Shestan e Brisk dhe në Arbënesh te Zara. Ka një shumicë shembujsh për këtë dukuri: paskal > paskaj(ë): **paskaq** është një huazim grek i **paspal**-it (miell që bie gjatë derdhjes).

J-ja ka kaluar në **q**; këtë huazim grek e gjejmë në të folmet serbokroate nën formën **paspal** (Rasina në Serbi⁶, në të folmen e Zenicës me kuptim pluhuri i Kërpit)⁷.

Forma e kryehershme greke ka pësuar ndryshime në shqipen, është përfutur me anë të disimilimit një **sp**, ku **-l**-ja është kthyer në një farë mënyre në **-j** pra paskaj(ë) > paskaq, sikur nga golë > gojë; ksh. Golamadi = golë + e madhe, lat. vitulea > ftulë, ftujë; familia > fëmilë, fëmijë; përmes shembullit kollaj > kollaq (“lehtas, pa mund, pa vështirësi”)⁸, të përqaset me shembuj: sjetull : sqetull, sjap, cjad, sqap.

LITERATURA

1. Jokl, Untersuchungen, 203, Pedersen, Alb. Texte mit Glossar, 7; G. Meyer, Alb. Studien; EW. 484; Reinhold, Glossar, 26, 36; M. Marchiano, Poesie sacre albanesi 17; Foklor II 225, Tagliavini, L'Albanese di Dalmazia 315.
2. Hyrje në historinë e gj. shqipe, Tiranë, 1960, p. 75.
3. H. Barić, Južn. filolog III 1922/23, 209; O uzajamnim odnosima balkanskih jezika, § 21; Albanisch, romanisch und rumänisch, Godišnjak balk. instituta, Sarajevo, 1957, p. 10.
4. Jokl, Revue Internationale des Etudes Balkaniques, tome I-II, livre 3-4, p. 64; E. Çabej, Buletini i Universitetit Shtetëror të Tiranë, puis; Hyrje në historinë e gjuhës shqipe, p. 51.
5. Buletin: Për historinë e konsonantizmit të gjuhës shqipe: Hyrje në historinë e gjuhës shqipe.
6. Srpski etnografski zbornik LIV, 21.
7. Ivan Popović, Srednjogrčke i novogrčke pozajmice u savremenom srpskohrvatskom jeziku, Zbornik radova, Vizantološki institut, 21, 189-232.
8. D. Kurti, Pralla komtare, I, 54.

KONTRIBUT PËR STUDIMIN E ONOMASTIKËS MESJETARE NË TERRITORIN E MALIT TË ZI, BOSNËS E HERCEGOVINËS DHE TË KOSOVËS*

Në literaturën e pasur që merret me studimin e kushteve të jetesës së barinjve ballkanas, krahas toponimeve dhe antroponimeve vllahe në „katun"-in** mesjetar, gjejmë me shumicë emra visesh dhe emra vetiakë me origjinë shqiptare. Gjurmët shqiptare dhe thërrmia gjuhësore me origjinë shqiptare vërtetohen edhe nga burime historike, të cilat dëshmojnë për përkatësinë gjuhësore shqiptare të emrave të disa vëllazërive të vjetra të Zetës, siç janë Mataguzhët te Podgorica e djeshme (1335), te Mahina Bregdetare (1435) të cilat me emrin e tyre, siç pohon Shuflaji (Arhiv 22) të kujtojmë Maniojët Ilirë (Μαγία), pastaj Malonshiqët (Malonsi), në luginën e lumit Zeta (Jeriček, Staat, 2, 34; krh. Nicolaus Malonsi 1775, kryedhjak. më vonë peshkop i Shkodrës (Šuflaj, tek Thalloczy III Forschungen, I 256, nr. 1), Petrus Malonsis, peshkop i Leshit (Arhiv II, 277). Njohësi i madh i historisë së Shqipërisë mesjetare, historiani Milan Shuflaj në studimin e tij sociologjik *Povijest sjevernih Arbanasa*¹ shkruan sa vijon: „Në vitin 1278 tufat shqiptare përmenden në lumin Cemvi ose shqip Cemi, degë e Moraçës (A. Alb 1, 386, 650, 759). Një dokument i manastirit të Deçanit (1330) numëron midis Limit dhe Drinit të Bardhë shumë katune shqiptare... Siç mund të shihet nga masa kompakte shqiptare afër Dubrovnikut dhe Kotorrit në shekullin XIII, këtu ka pasur kudo edhe mbetunina autoktone ilire, të shpërngulura, nga një bërthamë „shqiptare".² Në librin³ e vet Ilia Sindiku shkruan sa vijon: „Në qytet dhe rrethinat ka pasur shqiptarë që në shekullin XIII. Nga fundi i shekullit XIII ata i gjejmë si tregtarë, si punëtorë të

* Marrë nga Gjurmime Albanologjike, Prishtinë, 1974/IV.

** *Katuni-i* sh. - e.

¹ „Arhiv" II, 227

² M. Sufflay, në „Ungarischer Rundschau" 5/1916, 11

³ I. Sindik, Dubrovnik i okolina, Naselje i poreklo stanovniStva. libri 23, 1926.

kategorive të ndryshme dhe veçanërisht si fretër dhe si priftërinj, sepse dubrovnikasit nuk i kushtoheshin me qejf profesionit të priftit në kohën kur ishte në lulëzim tregtia dhe detaxia".⁴ Historiani i mirënjohur i popujve të Ballkanit, Konstantin Jirečeku në veprën *Romani u gradovima Dalmacije tokom srednjega veka*,⁵ shkruan: „Të përraendurit e parë të gjuhës shqipe e kam gjetur në një akt të një procesi gjyqësor në Dubrovnik më 1285, për një vjedhje në Kasale (Casale) kryer nga një farë Petar do Voici në Belen (Plati i sotshëm), në Zhupë. Dëshmitari Matheus, biri i Markut të Menges, thotë: „Audiui unam vocem, clamantem in monte in lingua albanesca”. Kjo është, padyshim, një informatë e rëndësishme, sepse për herë të parë në historinë e vet gjuha shqipe përmendet me emrin e saj të vërtetë”.

I. Mali i Zi, Bosna dhe Hercegovina u japin blegtorëve në katunet kushte të mrekullueshme me kullotat e tyre të begatshme, dhe është e natyrshme që përbrenda tyre të lëviznin një numër i madh barinjsh me origjinë vllahë, shqiptare dhe serbe.

Në studimin tonë do të shqyrtojmë vetëm ato katune të cilat me emrin e tyre dhe me atë të barinjve që jetonin aty vërtetojnë origjinën shqiptare. Një shqyrtim i tillë do të ishte, pa dyshim, një nga kontributet e para për të interpretuar nga pikëpamja gjuhësore emrat e shumtë të katimeve. Para kësaj, do të përpiqem të shpjegoj edhe origjinën e vetë emrit „katun”.

Është me interes të përmendim se kuptimi që ka pasur dikur fjala „katun” si në sllavishte, ashtu edhe në shqipe, nuk përputhet me kuptimin që ka kjo fjalë sot në gjuhën shqipe, ndërsa kuptimi i saj në serbishten e vjetër dhe në shqipen e vjetër ka qenë: stane nomade (të një kolektivi) blegtorësh.⁶ Në lidhje me origjinën e fjalës „katun”, duhet të përdorim metodën që ka zbatuar për shumë vjet me radhë linguisti shqiptar E. Çabej,⁷ metodë shkencore e cila kërkon që, kur shqyrtojmë burimin e kësaj

⁴ Dhe ai citon: Thalloczy, Jireček, Sufflay *Acta Albanie I* Vjenë 1913, II. 1918, Vëll. I, Nr. 175, 527, 601, 606, 681, 697, 722, 760; II, Nr. 48, 50, 60, 7.4, 80, 95, 124, 208, 219, 345, 397, 434, 550, 622, 675, 949.

⁵ K. Jireček, *Romani u gradovima Dalmacije tokom srednjega veka*, 51.

⁶ N. Jokl, *Linguistisch-kulturhistorische Untersuchungen aus dem Bereich des albanischen*, 152, 172, 179; M. Sufflay, *Povijest Sjevemih Ar. banasa, Srbi i Arbanasi*, Beograd 1925.

⁷ E. Çabej, në *Premier Congrès International des Etudes Balkaniques* ischen zum Balkansprachbund (versioni shqip në „Studime filologjike” 1970/IV).

fjale ose të emërtimeve të ngjashme, të bëhet ndarja e fjalës në pjesët përbërëse. Originën e fjalës *katun* e ka shpjeguar albanologu austriak Norbert Jokl.⁸ Ai e nxjerr nga begatia gjuhësore shqiptare. Në analizën e hollësishtme, dijetari austriak N. Jokli e ka ndarë këtë fjalë në formantin *kë pkt. ka*, që ndodhet edhe te *fjalët: kë-tu, kë-ta, kë-tillë, kë-shtu, kë-tej, kë-shtallë, kë-thadër, kë -putë* (putër, shputë); *kë-lysh (lej), kë-shet*; tema e fjalës *katun* është *tuni(d)*.⁹

Po të duam të vërtetojmë origjinën e fjalës sonë dhe burimin e saj nistor si dhe shtrirjen në gjuhët e popujve të tjerë të Ballkanit, mendojmë se hulumtuesit nuk mund t'i shmangen fjalës *katun* të shqipes, për shkak të lehtësisë së shpjegimit të saj me mjetet e fonetikës historike të gjuhës shqipe.

Në dokumentet dhe burimet historike, në studimet etimologjike të hulumtuesve vendës dhe të huaj janë grumbulluar një shumicë e madhe emrash të viseve dhe emrash vetjakë; ndër të cilët, siç e kemi theksuar më lart, një pjesë e mirë është me origjinë shqiptare.¹⁰

⁸ Në „Indogermanische For schlingen“, XXXIII, 427.

⁹ Dhe në të vërtetë shqipja ofron, siç më duket mua, një shpjegim plotësisht të mjaftueshëm geg. *katund, katun*, tosk. *katunt* i përket (lidhet me) tosk. *ndenja, ndeja*, geg. *ndeja, ndejta*, që funksionon si aorist (e kryer e thjeshtë) më tej (lidhet) me *end nura*, geg. *e ndietmeja, ndieme* (Meyer. E. W. 300) *nnej, nneja* „banesa, qëndrimi“ (Baik. 300), *nd tor* „banor“ (Meyer l.c), një çerdhë të cilën Mejeri në mënyrë të mprehtë e ka vendosur te *nden*, geg. *ndej* „ndej“ tërheq, shtrij, tendos telat e një instrumenti ngatë *tentio*: greq., rrënja indoeur. *ten* —. Zhvillimi i kuptimit „ndejbanoj“ shpjegohet tamam si një term i jetës së barinjve nga nderja (tendosja) e çadrave. Në të vërtetë edhe *katuni* „shtrihet, ndehet“. Kështu në një këngë popullore serbokroate të cituar nga Vuku thuhet: *razapeše Piperi katune*. „Piperët ndenë (shtrin. shpalosën) katunet“. Morfologjikisht *katunt* është një formim pjesor me prapashtesën *-to-*, e cila është përdorur dikur në shqipen për formimin e kësaj kategorie fjalësh... Sipas shkallës vokalike *katunt* duhet vështruar si *ka + tunt*, paraqet pra të njëjtin refleks (përfaqësues) të n-së, (sikundër del edhe në *grund, munt, štrung, tunt* (Autori, stud, 2. alb. Etym. und Wortb, f. 25, 58, 89, 91). *k -?* *Ka-* është i njëjti prefiks (parashtesë) që mund të dëshmohej edhe në *g ent*, geg. *end, enn, g in* dihet „gdihet“, *dit, kiet, jelm, k nevi*. f. 428 *katunt* është pra „e nderuara“, „çadra“, pastaj më tej „e banuara“, banesa, qëndrimi.

¹⁰ L. Thalloszy, C. Jireček, M. Sufflay, *Acta et diplomata res Albaniae Mediae Aetatis illustrantia*, vëll. 1, Vindobonae 1913, II. F. Cordignano, *Catasto veneto di Scutari e Registrumconcessionum*, (1416 —17), Shkodër 1940; Onomasticon del Catasto veneto di Scutari e Registrum concessionum. Tolemezzo 1945; B. Bolizza, *Relatione*

Një nga nahijet e mirënjohura me shumë katune dhe fshatra në mesjetë është rrethi i Kuçit me këto „katune”: *Pantalesh, Ba rzan* (Bardhan), *Bankec, Bytidosi, Lazorci* (1497). Këto katune, si dhe emërtimet e tjera me origjinë shqiptare, kanë marrë prapashtesa të gjuhës serbe *Leškovići, Lopari, Vjeduši, Bardići, Kući*. Prapashtesa të serbishtes kanë edhe emërtimet e disa fshatrave dhe katuneve në nahijen e Kelmendit (1497): *Lićeni* (liqeni) e *Shpaja* me katunet; *Djonović, Lešković, Murović, Kolemade* (shqip Golëmadhe – gojëmadhi). Në nahijet e tjera, në atë të malit të Hotit dhe të Piperit, gjejmë të dëshmuar katune dhe fshatra me emra shqiptarë që nga fundi i shekullit XV: *Keći, Špihja, Bušat, Rogami, Bukmir* (shqip Bukëmirë).

Është e njohur komuna blegtorale *Burmaza* ose *Burmazovića* në krahinën blegtorale *Stolac* që në shekullin XIV, e cila është me sa duket së paku nga emri i themeluesit të saj me origjinë shqiptare *burrë i madh*.¹¹

Në fushën e Sarajevës fshati *Butmir* që nga shekulli XV; në vitin 1455 fshati është shënuar *Budmir*, kurse më 1485 është shënuar *Budmire*.¹² Dervish M. Kurkut, emrin e lartpërmendur të fshatit *Butmir*, „që dallohet për tokën e mirë për të lëvruar” e ka nxjerrë nga fjalët shqipe *bota e mirë – botë e mirë – tokë e mirë*.

Skariçi ba botuar te „Glasnik Zemaljskog Muzeja”, XXX, një listë të gjatë me emra visesh në Hercegovinë, ndër të cilët gjejmë *Ligate* të Foças dhe *Ligatići* të Bosnjës, të cilët, për sa i përket origjinës, nuk mund të ndahen kurrsesi nga emri shqip *Ligatë*, që ndeshet kaq shpesh në toponiminë shqiptare.

Njoftimi më i lashtë për katunin *Zhur*, të quajtor më vonë *Žurovići* në

e descriptione del Sandjaccato di Scutari, 1614; Rovinjski, *Černogorija*, 1897; H. Hecquard, *Historie et description de la Haute-Albanie ou Guegarie*, Paris 1859; Jovan Erdeljanović, *Naselja*, 4; *Hronika Popa Dukljanina* (1200); Stojan Novaković, *Selo*, 1965; C. Jireček, *Istorija Srba* „Zbornik” 1959, I, II. 1965; M. Sufflay, *Srbi i Arbanasi*, 1925; Id., *Povijesti sjevernih Arbanasa*, Arhiv, II; B. Dur de v, *Iz istorije Crne Gore, brdskih e mälisorskih plemena*, „Radovi NR B i H”, Sarajevë, 1954; S. Pulaha, *Krahinat perëndimore dhe qendrore të Sanxhakut të Shkodrës ne fund të shek. XV*, „Studime historike”, 2, 3, Tiranë 1971.

¹¹ VI. Ćorović, „Arhiv” II.

¹² S. Šabanović, *Bosansko krajište 1448—1463*, God. ist. društva B i H, viti IX, Sarajevë 1958, 200.

Mal të Zi, mban datën e vitit 1367.¹³ Edhe fshati *Žurovići* e ka marrë emrin nga *Zhur-i* katuni i të cilit përmendet më 1367; emrin *Zhur* e kemi edhe afër Prizrenit si toponim dhe ai është në lidhje të ngushtë me të lartpërmendurin *Zhur* të Malit të Zi.

Sa për origjinën, ajo fjalë duhet vënë në lidhje me fjalën latine *sabur*, e cila në gjuhën shqipe, sipas ligjeve të saj ka dhënë *shur*, dhe me kohë, nëpërmjet të sonorizmit, kaloi në *zhur*, me kuptimin „shur, rërë e hollë”.

Le të shohim më hollësisht toponimet e lartpërmendura.

Kuçi përmendet në një dokument të Deçanit të vitit 1330. Prof. Gjurgjev,¹⁴ për këtë çështje shkruan sa vijon: „Në dokumentin *Ljesh, Tuzi* dhe *Bushat* (të cilët në një dokument të vitit 1497 janë regjistruar si katun në *Piper*) dhe Mataguzha. Ky katun shqiptar është vendosur në malësitë e pronave të manastirit të Deçanit. Në një dokument tjetër të Deçanit, ky katun ndodhet i regjistruar pas fshatit Krushevc të Zetës. Në vitin 1416 ka kuças të ngulur në rrethin e Shkodrës, zaten edhe një fshat mban emrin Kuçi, porse nuk janë vetëm këta, ka edhe një varg të tërë sish për të cilët mund të provohet në një mënyrë ose në një tjetër se kanë lidhje me katunet e Zetës (Tuzi, Bushati, Bitidosi etj., zaten një shtëpi është regjistruar në zotërimin Pipërit). Është e qartë se krahina në bregun lindor të liqenit të Shkodrës dhe të famullive të Zetës u bë treva ku po zbrisnin këto katune. Ata kishin formuar komunitete të vogla në veri të Zetës duke filluar nga jug-perëndimi drejt verilindjes: Mataguzhi, Tuzi, Kuçi, Bushati kurse në jug në bregun lindor të liqenit të Shkodrës fshatrat Tuzi dhe Kuçi. Kuçasit përmenden më 1455 si njësi fisnore më vete, por Erdelanoviçi ka të drejtë kur shpreh dyshimin që ata në atë kohë të jenë një fis tashmë i formuar. Më 1485 ekziston tashmë i formuar territori i sotëm i Kuçit.”¹⁵ Fshati Kuç përmendet në lindje të Vlorës më 1421.¹⁶ Nga pikëpamja gjuhësore është e pamundur të shpjegohet toponimi Kuçi, po të mos merret si mbështetje fjala *kug* (i kuq), që është në këtë gjuhë një huazim latin *cucceus*. Emri ka shumë të ngjarë të ketë dalë nga toka e kuqe.

¹³ D. Kovačević, Simpozijum o srednjovekovnom katunu, *Sarajevë 1961*, 127

¹⁴ Prof. B. Đurđev, *Iz istorije Crue Gore*, brdskih i malisorskih plemena, Radovi 1954.

¹⁵ Erdeljanović, *op. cit.*, 191—192

¹⁶ H. Inalcik, *Süreti Deferl Sancaki Arvanid*, Ankara 1954.

Po të kesh parasysh burimin shqiptar të emërtimit Kuçi dhe të emrave të tjerë të shumtë të katuneve në Krahinën e Zetës, të trevave malore të Malit të Zi, atëherë është shumë vështirë të pranosh thënien e disa etnografëve dhe historianëve (Erdelanoviçi, M. Filipoviçi, Çubrilloviçi) që në rrethin e Kuçit të sotëm gjer nga fundi i shekullit XIV dhe nga fillimi i shekullit XV nuk ka pasur blegtorë shqiptarë, kurse serbët kanë pasur aty Gorska Zhupën si organizim *territorial*; dhe në lidhje me këtë, siç ka thënë me të drejtë prof. Gjurgjev, del pyetja pse Kuçin nuk e quajnë Gorani?!

Nga gjithë fshatrat që i përkasin nahijes së Kuçit janë me siguri me origjinë shqiptare sa vijon: *Pantalesh*, *Barzanj* (Bardhanj), *Bankeqi*, *Butidosi* (Bytidosi). Emri i katunit *Pantalesh* është sajuar nga dy pjesë: nga përbërësja *Panta* dhe nga përbërësja shqipe *lesh*; përbërësen e dytë e gjejmë te emri i përveçëm *Kambalesh* „Nichola.Gambalessa" ose „Jon Cambalessi",¹⁷ ndërsa emri i katunit *Barzanj* (Bardhanj) është një krijim gjuhësor thjesht shqiptar, nga fjala shqipe Bardh (i bardhë) dhe prapashtesa (a/nj), toponim shumë i shpeshtë në truallin gjuhësor shqiptar.

Do të ndalemi veças në sqarimin e emrave të dy toponimeve që përmendëm më lart: *Barzanj*, *Bardhan* dhe emrin e katundit të njohur *Burmaza* ose *Burmazoviç* në Hercegovinë. Po kthehemi te këta për shkak të trajtës së tyre. Për sa i përket emrit të parë, toponimet *Barzanj*: *Bardhanj*, studiuesit e dokumentit në fjalë (prof. Gjurgjev, Selami Pulaha) nuk janë të një mendjeje lidhur me transkribimin e këtij emri. Në të vërtetë në tekstin e shkruar me germa arabe ka *مبارک* që duhet të lexohet *Barzanj*, siç e ka lexuar edhe prof. Gjurgjev në studimin e vet *Iz istorije Crne Gare, brdskih i malisorskih plemena* (Radovi Naučnog društva B i H, Sarajevo, 1954). Transkribimi i Selami Pulahës është më larg origjinalit, por është afër shqiptimit të sotëm të këtij apelativi në gjuhën shqipe: *Bardhanj*. Me këtë, ndoshta, është hapur një çështje e re, së cilës është vështirë t'i japësh ndonjë zgjidhje. Në të vërtetë në defterin që ka botuar prof. Gjurgjev. në studimin e lartpërmendur (fjala është shkruar lexueshëm *مبارک* (*Barzanj*), porse në atë kohë, nga fundi i shekullit XV, më "1485, çështja a i është diktuar shkruesit si *z* apo si *dh*, me fjalë të tjera, a është shqiptuar ajo fjalë

¹⁷ F. Cordignano, *Catasto veneto dl Scutari*, 1416—17, 142.

apo ai toponim në gjuhën shqipe me *z* apo me *dh*, mbetet një çështje e hapët. Sipas nesh, për zgjidhjen e kësaj çështjeje janë të mundshëm dy interpretime. Sipas interpretimit të parë, ekziston mundësia që palatali indoevropian që ndodhet në këtë fjalë (*barg*), i cili i ka prirë interdentalës së sotme *dh* në gjuhën shqipe, atëherë kishte kaluar nëpërmjet fazës së afrikatit *z*; këtë gjendje e vërtetojnë një numër i madh shembujsh në gjuhët e tjera veçanërisht në rumanishte, në të cilën huazimet shqipe kanë ruajtur fazën kalimtare të afrikatit *bardh*<*barza*, *dhallë*<*rum. zare*; *vjedhull*<*rum. viezura*, pra, në zëvendësimin e palataleve indoevropiane *k*, *g* rruga deri te spirantet interdentalë ka kaluar përmes afrikateve; + *barĝ*>*barz*>*bardh*; + *maĝ*>*maz*>*madh*. Këtë fazë kalimtare e vërtetojnë edhe shumë shembuj të vetë shqipes: *thimc* : *thimth*; *cep*>*thep*, *cjap*>*thiap*. Në këta shembuj afrikatja *z* i ka prirë spirantit *th*: *c*>*th*.

Duke e lidhur argumentimin tonë me formimin e trajtave të lartpërmendura të emrave *Barzanj*, resp. *Bardhanj*, mendojmë se mund të nxjerrim konkluzionin se tingulli *z* përbën një fazë kalimtare në shqiptimin e palatales indoevropiane *ĝ* në gjuhën shqipe; një supozim tjetër është se interdentalen *dh* shkruesi meqë shqipja s'ka qenë gjuha e tij amtare, e ka dëgjuar si *z*.

Shqiptimi dymënyrësh i spirantes interdentalë në shqipe si *z* dhe *dh* shpjegohet me kronologjinë, d.m.th. janë gjithë gjasët që shqiptimi i tij si *z* është më i vjetër, kurse refleksi me *dh* është më i vonë në shqipe.

Përsa i përket *Kolemadi*, që të dy hulumtuesit pajtohen në transkribimin e tekstit nga gjuha turke.

Shpjegimi i emrit të katunit *Bankec* bëhet i mundshëm vetëm nëpërmjet shqipes: *ban+keq*, ashtu si *dasha+mirë*, *ndjella + zi*.

Toponimi *Bytidosi*, *Bitadosi* është shumë i vjetër. Është një kompozitë shqipe e mirëfilltë *bythëdosë* – *Bythëdosë-t* (podex porci) me siguri apelativi i ndonjë vëllazërie *Bythëdosë-t*, që më vonë u zhvillua në katun, duke mbajtur edhe emrin e vet.

Toponimet e lartpërmendura: *Rogami*, *Bušat*, *Bukmira*, *Bukumir*, që përmenden në Shqipërinë e Veriut edhe si emra. familjeje, nuk mund të shpjegohen me saktësi pa ndihmën e gjuhës shqipe; me të vërtetë, fjala *Rogami* është derivat nga fjala shqipe *rogë* dhe me formantin *amë*; fjala

rogë nuk duhet të jetë e vjetër, sepse okluzivi *g* do të kishte rënë me kohë, në qoftë se ai në këtë shprehje do të kishte qenë i parmë në pozicion intervokalik; elementi i parë lidhet me shqipen *rruej/rruaj* me kuptimin „një vend në mal, i mbuluar me bar dhe pa drurë; rrah“.

Toponimi *Bushat*, pa dyshim rrjedh nga fjala *shat*: *Nënshat* është një toponim afër Shkodrës; pastaj ai lidhet me apelativin *fshat* i cili përbëhet nga komponentja kryesore *shat* dhe nga formanti *f* (*f+shat*). Afërsia e toponimit *Bushat* të Zadrimës dhe të emrit Bušat të Zetës, sipas mendimit të Prof. Gjurgjev¹⁸ shpjegohet me lëvizjet e katunit në këtë krahinë prej kullotave dimërore te kullotat verore dhe nga shpërndarja e tyre (f. 177).

Do të përmendim akoma edhe disa katune, emrat e të cilëve lidhen pa dyshim me apelative shqipe, siç janë *Koće*, katund në *Kuči* (1497); *Koći*, sot një fshat dhe banorët e tij, kurse emërtimi rrjedh nga fjala shqipe që ka kuptimin e kokrrës (së drithit ose të rrushit).

Apelativi *Lopari* (me kuptimin e loparit, bariut të lopëve) lidhet me shqipen *lopë*, ashtu si *dhiar* me *dhi*; është një fshat në Fundanë të Kuçit. Toponimi *Fundana*, *Fundina* ose *Fundëna*, përmendet afër Drivasi-t (shqip Drisht – 1402). Po ky apelativ gjendet edhe në Kuç.¹⁹ Sa për origjinën e tij, është i padyshimtë burimi i tij nga shqipja, prej fjalës *fund* dhe prapashtesës së shumësit (*e-*) *-na*, që i gjejmë në një pjesë të madhe të toponimeve të tilla në territorin gjuhësor shqiptar, si *Lis-na*; nga *kishë* kemi *Kishën*, fshat afër Shkodrës, bisht – *Bishtna* në Malësinë e Madhe, *Shtiqën*, fshat në Lumë, Shqipëria e Veriut, nga *shtek*, shumë *shtiqe*.²⁰

Origjina e toponimeve të lartpërmendura *Ligatici* dhe *Ligate* njëri në Hercegovinë dhe tjetri në Bosnë), duhet kërkuar te fjalët shqipe. Këto fjalë rrjedhin prej shqipes *ligatë*, kurse kjo është në shqipe derivat nga *lag* dhe prapashtesa *-atë*. Një tokë e tillë është gjithmonë e lagët me ujë; prej *lagatë* te *ligatë* nga pikëpamja gjuhësore rruga është shumë e thjeshtë; *ligatë* si

¹⁸ Prof. B. Đurđev, Iz istorije Crue Gore..., 177.

¹⁹ Rovinski, Čemogorija, I; Erdeljanović, 'Naselja I.

²⁰ E. Čabej, në Lingua Posnaniensis" VII, 1959, VIII, 1960, botimi shqip: *Shumësi i singularizuar në gjuhën shqipe*, Tiranë 1967, 97.

apelativ dhe toponimi *Ligatë* nuk mund të vihet në lidhje me fjalën *i lig* (i sëmurë), pra „vend i pashëndetshëm”, siç shkruan Lirak Dodbiba.²¹

II. Toponimia e përzier e këtyre krahinave na nxit të bëjmë kërkime edhe në një fushë tjetër shkencore, në *antroponimi*, që të marrim vesh diçka më shumë mbi përbërjen etnike të banorëve të këtyre krahinave gjatë shek. XV dhe XVI. Fusha e kërkimeve tona do të përfshijë edhe krahinën e Kosovës dhe të Metohisë, për të cilën këto vitet e fundit kemi në dorë regjistrin turk të zotërimit të quajtur *Oblast Brankovića* të vitit 1455 dhe regjistrin e Sanxhakut të Shkodrës për vjetët 1485 deri më 1582. Në qoftë se dijetarët i janë drejtuar edhe më parë kësaj lënde, d.m.th. antroponimisë në krahinat e përmendura, e kanë bërë përciptazi dhe shpejt e shpejt, dhe shumica kanë pranuar se emrat vetiakë në regjistrat e mesjetës kanë shënuar edhe përkatësinë etnike të krahinave përkatëse (Novaković, S. K. Jireček).

Dijetari serb Stanoje Stojanović (*Lična imena i narodnost u Srbiji srednjega veka*, „J. Filolog”, libri VIII, 1928-1929, f. 151-154), pasi sajoi një listë me emra personash nga Regjistri i Parë i Deçanit, vuri në dukje sa vijon: „Ndërkaq, në bazë të materialit të nxjerrë një gjë është e qartë dhe e sigurtë: emrat vetiakë në dokumentet mesjetare nuk mund të merren në asnjë rast si të dhëna, mbi të cilat mund të mbështetesh për të caktuar me saktësi kombësinë (narodnost) e personit përkatës”.²² Kështu ai ka caktuar këtë marrëdhënie familjare:

I

Baba – emër i huaj Biri – emër serb

Shleman Rajko

Tanush Boljko

Gjin Nojan

II

Baba – emër serb Biri – emër i huaj

Bogdan Borhan

Maroje Beran

²¹ L. Dodbiba në „Studime filologjike” 1 (1967), 44.

²² S. Stanojević, *Lična imena i narodnost u Srbiji srednjeg veka*, „J. Filolog”, knj. VII (1927—1929), 154.

Bogdan Progan

III

Gjyshi – emër i huaj Nipi – emër serb

Bukur Trajko

Shin Bogdan – Rajko

IV

Gjyshi – emër serb Nipi – emër i huaj

Pretac Nikola – Vitan

Dobrota Gal

V

Baba – emër serb Biri – emër i huaj Nipi – emër i huaj

Sramko Stulça Milovan

Dragomir Lagos Priboje

VI

Baba – emër serb Biri – emër i huaj Nipi – emër i huaj

Dobromir Hronzha Hunjer

Dobren Milos Malha

VII

Baba – emër serb Biri – emër serb Nipi – emër i huaj

Lesh Nikola Rajko

Toan Bratoslav Tomislav

VIII

Vëllezërit: njëri ka emër serb tjetri – emër të huaj

Radoslav Sishan

Drajko Gjon (Djon)

Drazhut Gjin (Djin) Brajen

Një përzierje të tillë të emrave vendës dhe të huaj e gjejmë edhe në regjistrin e popullsisë të krahinës së Brankoviçasve të vitit 1455²³ dhe në regjistrin e banorëve dhe të pasurisë të Sanxhakat të Shkodrës të shek. XV e XVI.²⁴ Duke marrë në shqyrtim mendimin e disa historianëve në lidhje

²³ Botoi Orientalni Institut i Sarajevës, srria Monumenta turcica pregatitur nga H. Hadžibegić, A. Handžić dhe E. Kovačević.

²⁴ Kadastrin 1485 i Sanxhakat të Shkodrës, bot. i Institutit të Historisë, Tiranë 1974, pregatitur Selami Pulaha.

me interpretimin e emrave vetjakë në dokumentet mesjetare, Stankoviçi thotë fjalë për fjalë: „Kështu konsiderohet se çdo njeri me emër vllah në dokumentet e vjetra është edhe nga përkatësia etnike vllah, çdo njeri me emër shqiptar është shqiptar”.²⁵

Mendimi i Stanojeviçit se në bazë të emrave vetjakë të dokumenteve mesjetare është shumë vështirë të përcaktosh përkatësinë etnike të personit, është i pranueshëm por duhet vënë në dukje se ai nuk është munduar të zgjidhë këtë enigmë shkencore. Sot kemi në duar dokumentet më të shumta dhe më të bollshme lidhur me këtë çështje, të cilat kanë të bëjnë me shek. XV e XVI. Banorët e Metohisë janë regjistruar te Defteri i Sanxhakut të Shkodrës (1485-1582). Ky regjistër i Sanxhakut të Shkodrës përfshin këto nahi: Nahijen e Shkodrës me rrethet, Nahijen e Dushmanit, pastaj Zabojanën, Mërkotin, Krajën, Briskun e Shestanin, Podgoricën, Zhablakun, Hotin, Bjelopavliç, Piperin, Pejën, Metohinë (Altun-Ili-në), Plavën dhe disa rrethe të tjera.²⁶

Nga regjistrat e lartpërmendur, Selami Pulaha ka nxjerrë emrat e gjithë fshatrave të krahinës (trekëndëshit) Tropojë-Junik-Gjakovë; përbri emrit të çdo kryefamiljari është shënuar edhe emri i atit, shpeshherë emri i vëllait ose i një farefisi; janë regjistruar afro 50 fshatra. Të dhënat, që paraqet ky regjistër kanë rëndësi të dorës së parë për studimin e onomastikës dhe për strukturën etnike të banorëve në këtë krahinë prej fundit të shekullit XV. Ajo që karakterizon familjet e kësaj krahine është shumëllojshmëria e emrave, midis të cilëve ka emra sllavë dhe emra josllavë, midis të cilëve numri më i madh është ai i emrave shqiptarë. Një numër i mirë fshatrash me emrat e familjeve janë kryesisht me origjinë shqiptarë, p.sh. në fshatrat Plekani, Mel, Morinë, Dujak, Dolina, Cërna, Peronja, Radosh, Burxhani, Bozhani, Vuçidol, Berbat, Veliki Dobrosh, Mali Dobrosh, Brankoviç, Tërnova, Bogova, Koliç, Goraniça, Kolshid, Sismanoi, Popovci, Bonisuci, Stubla, Rogami, mund të themi se gjithë emrat vetjakë janë shqiptarë, siç janë emrat *Gjin, Gjon, Leka, Kola, Gega, Progor, Tole,*

²⁵ S. Stanojević, *op. cit.* 151.

²⁶ S. Pulaha, *Nahija e Altun-Ilisë dhe popullsia e saj në fund të shek. XV-të*. Elementi shqiptar sipas onomastikës së krahinave të Sanxhakut të Shkodrës në vjetët 1485—1582, në „Studime historike” 1 e 4 1972.

Lesh, Pepa, Bardo, Kolsh, Gjec, Tanush, Bushat, Lulo, Mazarak, Pal, Duka etj.

Disa emra të krishterë janë të përbashkët për të dy grupet etnike: Nikola, Andreja, Lazar, Gjorgj, Stepan, Dimitër, Petër, Mihalj, Mihal etj., gjë që e vështirëson përcaktimin e përkatësisë etnike. Megjithatë, një numër jo i vogël emrash vetjakë është me origjinë sllave pkt. serbe. Kështu, fshati Rjenica, që ka 74 kryefamiljarë dhe 14 anëtarë meshkuj të rritur, të aftë për punë, vetëm 17 prej tyre kanë emra karakteristikë shqiptarë, ose të marrim fshatin Batusha me 37 kryefamiljarë dhe 15 meshkuj të rritur vetëm 5 prej tyre kanë emra shqiptarë. Një strukturë të tillë etnike, po të gjykojmë nga emrat vetjakë, kanë këta fshatra: Sosami, Pole, Dragobile, Jasiqi, Kovaç, Milohani, Gorani, Tripole, Kamenica etj. Sa për shembull, po japim përbërjen sipas emrave vetjakë të familjeve të një fshati:

Fshati Morina

Gjon-i, i biri i Ogëm-it (Ugëm-it)

Leka, i biri Dimitr-it

Gjin-i, i biri i Todor-it

Gjon-i, i biri i Andrij-ës

Bogdan-i, i biri i Llesh-it

Pepa, i biri i Andrij-ës

Bogosav Nikolla

Gjorgj-i, i biri i Bur-it (Bor-it)

Pop-i, i biri i Progon-it

Niku, i biri i tij

Pavl-i, i biri i Gjon-it

Gjin-i i biri i Gjorgj-dt

Gjin-i, i biri i Gjon-it

Nikolla, i biri i Gjon-it

Petro-ja, i biri i Nikollë-s

Gjorgj Siromah

Petr-i, i biri i tij

Gjon-i, i biri i Siromah-ut
 Nehko-ja, i vëllai
 e veja Marija
 e veja Tole (e Toles)
 Pepa, i biri i Nikollë-s
 Ukça, i biri i Llesh-it
 Gjon-i, i biri i Todor-it
 Mihail-i, i biri i Dimitr-dt
 Pepa, i biri i Bogdan-it
 Novak-u, i biri Dardo-s
 Nenko-ja, i biri i Nikollës
 Andrija, i biri i Gjorgj-it
 Pavl-i, i biri Andrijë-s
 Mihail-i, i biri Bojici-it
 Rashko-ja, i biri Gjorgj-it
 Gjorgj-i, i biri Gjon-it
 Dimitr-i, i biri i Gjon-it
 Vlad-i, i biri i Andrijë-s
 Andrija, i biri i Gjon-it
 Nikolla, i biri i Gjorgj-it
 Dimitr-i, i biri i Giverdar-it
 Vuka, i biri i Smil-it (Ismil-it)
 Nikolla, i biri i Andrij-ës
 Pepa, i biri i Nikoll-ës
 e veja e Deja

Nga kjo pasqyrë e emrave vetjakë në krahinën e Metohisë prej fundit të shekullit XV (1485) dhe nga pasqyra e emrave vetjakë në 50 fshatra, që nuk janë paraqitur këtu, shihet se numri i antroponimeve thjesht shqiptare është mbisundues dhe diku numri i tyre është më i vogël në krahasim me emrat thjeshtë sllavë pkt. serbë.

Simbioza shqiptare-sllave ose shqiptare-serbe në fushën e emrave vetjakë në krahinën e Metohisë dhe në zonat e tjera kufitare është e qartë dhe ajo përzierja e emrave vetjakë në një familje, ku prindërit mbajnë përzierje emrash shqiptarë, kurse bijtë dhe vëllezërit kanë emra karakteristikë serbë, nuk mund të zbërthehet mekanikisht. Këtu duhen marrë parasysh rrethanat shoqërore historike. Nuk ka dyshim se ndikimi i administratës serbe dhe ai i institucioneve fetare dhe kulturore ortodokse mbi banorët shqiptarë në periudhën paraturke si dhe ndikimi i kishës ortodokse edhe gjatë sundimit turk, ka qenë shumë i madh. Nën Despotatin e Brankoviçit ka pasur 12 manastire dhe 5 kisha: në zotërimet e Deçanit ka pasur kaq shumë priftërinj sa njërit nuk i binin më shumë se 20 shtëpi, kurse në 8 katune të Vllehëve të Deçanit dhe në një të shqiptarëve, që kishin 266 shtëpi, nuk është shënuar asnjë prift.²⁷ Kështu në 504 shtëpi vlllehësh të Sveti Stefan-it përmenden vetëm 2 priftërinj, ndër vlllehët e Hilandarit në 107 shtëpi përmendet vetëm një prift dhe në 226 shtëpi vlllehësh të vlllehëve të Zhiças gjithashtu vetëm një prift.²⁸

Ky ndikim është ndjerë më pak në regjistrimin që është bërë 100 vjet më vonë (më 1582), sepse ishte përmbysur aparati shtetëror i klases feudale serbe dhe ishte zvogëluar ndikimi i kishës ortodokse, gjë që del sheshit në onomastikën e fshatrave të lartpërmendura. Në qoftë se përjasim dy regjistrimet e mësipërme të banorëve të Sanxhakut të Shkodrës, shihet qartë se në regjistrimin e parë (1485) banorët me emrat vetjakë kryesisht serbë mbizotërojnë në krahasim me emrat shqiptarë, kurse në regjistrimin e dytë numri i emrave serbë është reduktuar në minimum dhe mbizotërojnë emrat vetjakë shqiptarë.²⁹

Tani duhet të bashkojmë elementet e veçanta dhe të nxjerrim prej tyre konkluzionet e duhura. Nga sa u tha tani del se:

1. Në bazë të materialit të parashtruar që u përpunua këtu, është krejt e qartë se mund të pohohet me gjasë të mëdha përkatësia etnike e banorëve të zonave të lartpërmendura të Dukagjinit.

²⁷ Stojan Novaković, *Selo*, Beograd 1965, 173.

²⁸ L. cit.

²⁹ S. Pulaha, *Nahija e Alltun-ilisë dhe popullsia e saj në fund të shek. XV*, në „Gjurmime albanologjike”. Seria e shkencave historike, 1971/1, 199.

2. Numri i emrave vetjakë karakteristikë shqiptarë në regjistrimin e Sanxhakut të Shkodrës në disa fshatra të nahijes së Dukagjinit është shumë më i madh se sa ai i emrave vetjakë serbë.

3. Ky numër rritet vazhdimisht në favor të onomastikës shqiptarë, gjë që duket sheshit nga regjistrimi i dytë i vitit 1582.

4. Letërsia e pasur kishtare e mesjetës vërteton qartë se organizimi i pushtetit të kishës katolike ishte shumë i dobët te shqiptarët, prandaj ortodoksizmi, sipas mendimit tonë, depërtonte lehtë midis (tyre).

Zgjidhja e çështjes së formimit të emrave vetjakë shqiptaro- -serbë te familjet e regjistruara shihet qartë, po të kemi parasysh pozitën që kishin grupet etnike në marrëdhëniet me despotët e trevës së Dukagjinit dhe të krahinave fqinje.

Pozita e tyre dhe ndikimi i madh i kishës ortodokse të organizuar mirë brenda këtyre zonave vetjake serbe nga ana e elementit shqiptar. Në një situatë të tillë është shumë vështirë të përcaktosh se deri në ç'shikallë është përdorur gjuha shqipe në masat e shqiptarëve, sepse për këtë mungojnë përmendoret dhe dokumentet historike. Por zakoni që përbri një emri thjesht shqiptar të theksohet posaçërisht emri „Arbanas“³⁰ e vërteton me siguri praninë e popullsisë shqiptarë në këtë pjesë të Dukagjinit edhe para shekullit XV, kjo popullsi ka përdorur gjuhën amtare shqipe.

5. Trajtimi objektiv i dokumenteve mesjetare dhe i defterëve turq hedh poshtë pohimet e historianëve borgjezë se shqiptarët kanë ardhur në krahinat e Kosovës dhe të Metohisë nga fundi i shekullit XVII dhe fillimi i shekullit XVIII pas tërheqjes së elementit serb prej këtyre krahinave drejt veriut; me të vërtetë, në dokumentet serbe të mesjetës shqiptarët përmenden si barinj shëtitës; shumica e madhe e emrave vetjakë shqiptarë midis banorëve të ngulur, të shumë fshatrave të Metohisë nuk mund të shpjegohet ndryshe veçse me praninë e masave etnike shqiptare në to.

6. Janë pa bazë edhe pohimet e disa historianëve borgjezë të cilët mbrojnë mendimin edhe në kohët e fundit se prania e shqiptarëve në krahi-

³⁰ A. Hadžić, *Nekoliko vijesti o arbanasima na Kosovu i Metohiji sredinom XV vijeka*, në Simpoziumi për Skënderbeun (10—12 maj 1968), Prishtinë 1969, 204 Simpozijum o Skanderbegu.

nat e tokave serbe të mesjetës është vërtetuar vetëm te katundet; onomasika me karakteristikë të qartë shqiptare kaq e bollshme në dokumentet serbe të mesjetës, vërteton qartë praninë e shqiptarëve si masa etnike të ngulura në krahinat e lartpërmendura, pra para dyndjes turke.

7. Shtimi i madh i elementit shqiptar gjatë shekullit XV e XVI, siç e tregojnë regjistrimet e para turke të banorëve, të *Dukagjinit dhe të Kosovës*, shpjegohet jo ashtu siç duan ta shpjegojnë një palë gjoja me pozitën e privilegjuar të shqiptarëve, pra të fesë katolike nën sundimin e Turqisë, porse me rritjen natyrore të shqiptarëve në ato krahina të Metohisë dhe të Kosovës si edhe me lëvizjen e banorëve shqiptarë. Zonat nga mendohet se filluan të depërtojnë shqiptarët në Kosovë fill mbas pushtimit turk të këtyre krahinave, ishin të përziera në një përqindje të madhe me masa etnike shqiptare-sllave, kështu që migracionet e banorëve të viteve të para të sundimit turk kanë qenë një vijim i natyrshëm i lëvizjes së shumëhershme që ka bërë popullsinë nga njëra krahinë në tjetrën.

Botuar te Gjurmime Albanologjike – Seria e Shkencave Filologjike, IV (1974), 7—20.

RRETH DISA EMRAVE TOPIKË ME PREJARDHJE SHQIPTARE NË MAL TË ZI NË VËSHTRIM GJUHËSOR

Në këtë analizë gjuhësore do t'u sillemi t'i vështrojmë disa emra toponomik të Kuçit si dhe të Kuçit vetë.

Krahina e Kuçit përmendet për herë të parë në Krisobulat e Deçanit më 1330. Prof. Gjurgjev, në studimin e tij¹, shkruan: Përveç në Bushat, kuçët i përmendin edhe në katunin e Lezhës dhe të Tuzit qysh figuron në Krisobulat e Deçanit, pastaj në Kadastrën e Shkodrës. Nje fshat me emrin Kuç zihet ngoje në lindje të Vlorës më 1342². Emri topik Kuçi ka marrë një përhapje të gjerë në gjithë Shqipërinë dhe në ngulimet e kolonistëve shqiptarë në Greqi dhe në Italinë Jugore.

Kur marrim e gjurmojmë burimin e këtij toponimi - një gjë që në këtë mes na intereson është se studiuesit nuk pajtohen në mendime: në hetimin e gurrës së këtij emri topik janë shfaqur dyshime, lëkundje dhe përfundime të gabuara. Mendimi më i përhapur që në lidhje me prejardhjen e toponimit në vështrim zotëron, është ai që origjinën e tij e nxjerr dalë nga mbiemri "i kuq" i shqipes, duke menduar se kemi të bëjmë me një truall të kuq;³ një mendimi të tillë i mbahet edhe Skok⁴. Ç'është e drejta, edhe vetë jemi lëkundur sa herë që është dashur të marrim qëndrim në lidhje me gurrën e këtij toponimi. Por, kur merret e puna këqyret më imtas del se ekzistenca

e apelativit kuç që në gjuhën shqipe ka kuptim "një lloj kuthi a vorbe me dy veshë edhe emër vendi i ngulur në një gropë, në një luginë", emër që i përgjigjet vorbës, vihet në dyshim të madh dhe merr lëkundje mendimi i gjertanishëm që sundonte në lidhje me burimin e emrit topik këtu në vështrim.

¹ Iz istorije Crne Gore, Sarajevo 1954.

² H. Inalcik, Ankara 1954.

³ K.Jireček, Die Romanen, I.

⁴ ER, II, 219.

Mendimin e sipërm s'e ka gjetur të drejtë, sidomos, Çabej, i cili është i pari studiues që e ka lëkundur me argumente të forta gjykimin e save - ndonëse dijetarë të njohur në fushën e gjuhësisë, ballkanologjisë, albanologjisë, për të cilët kemi përshtypjen sikur nuk i afroreshin me gjithë mend e seriozisht rrahjes se çështjes në shqyrtim.

Prejardhja e emrit topik të Kuçit, pas shumë gjasave, nuk ka urë për të besuar një bazë nga adjektivi "i kuq", sikundër pandehin një palë shkencëtarësh albanologë. Ndonëse edhe pala tjetër kundërshtarë, më në fund e ka gjetur të drejtë prejardhjen e emërimit Kuçi nga një bazë **kuç**, që ndër dialektet dhe oroniminë shqiptare - sikur u pa këtu sipër, ka një shtrirje të hapët, tani lind një problem tjetër në mes dy gjykimeve e mendimeve mbi përkatësinë e kësaj baze: ku do kërkuar e parë origjina e saj: ndër shqiptarë apo sllavë. Formime nga kjo bazë ndeshen edhe ndër sllavë të Ballkanit: Kuevo, Kuajna, Kuaj, planina. Ka në lagjen e mendimit kundërshtar edhe asish, sikur është këtu sipër i përmenduri Vanja Staniši edhe të tjerë që thonë se gurra e kësaj baze do të kërkohet te vllhtë, tek apelativi ci, sh. **kuçi** (mal), i regjistruar tek fjalori etimologjik i moldav- ishtes, Kishiniov, 1978; kurse në një fjalor tjetër **Dictionnaire aroumain (macédo-roumain) général et étymologique**, Bucarest 1974, ndonjë **cuc**, këtu me kuptim "mal" nuk e gjejmë, por edhe sikur të jetë e vërtetë – po a pak fjalë shqipe kanë të folmet e asaj gjuhe?!

Kur dihet se emërtimi **kuç** dhe shumë emra të tjerë në trevën e zënë ngoje kanë karakter të gjuhës shqipe, atëherë dalin vështirësi, pothuajse, të pakapërcyeshme rreth pajtimit me pohimin e disa studiuesve etnografë dhe historianë (Erdeljanović, Filipović, Cubrilović) që, fjala e tyre në Krahinën e Kuçit të sotëm s'janë vërtetuar gjurmë të barinjve shqiptarë deri nga mbarimi i shekullit XIV dhe XV, kur serbet, siç thonë ata, kishin formuar qarkun e tyre administrativ fisnor - një njësi territoriale malore të tyre dhe, rrjedhimisht, do të shtrohet pyetja - qysh e bën edhe prof. Gjurgjev me plot të drejtë, si bëhet që kuçet nuk u quajtën, nuk morën emrin malorë (gorani) sipas emërimit të krahinës së tyre?

Me zanafillën e fisit Kuç, dikur i gjithë shqiptar, është marrë një lagje e madhe hisrorianësh dhe hetuesish të tjerë duke mos harruar gurrën e emrit Kuç të tyre. Ajo palë kërkuesish dhe studiuesish të këtij fisi të njohur

bigëzohet në dy tabore, i pari, ai kryesisht sllav (Erdeljenovic, Dedier, A. Jovičević, Čubrilović) popullsinë e fisit **kuç** e sheh me prejardhje sllave, të përzier me shqiptarë - fjala e tyre, të ardhur në **Kuç** nga shekulli XV e tëhu.⁵ Në këtë mes do të vihet re që gati të gjithë ata nuk lënë pa gjetur tipare shqiptare të popullsisë së fisit kuç. Sa i përket burimit të emrit Kuç shumica sish, sikur u tha sipër, atë e lidhin me fjalën shqipe "i kuq". Filologu i njohur serb Djuro Danišić në lidhje me origjinën e emrit Kuç, kuçët, shprehet kështu: "Sipas dialektit të shqiptarëve veriorë emërtimin kuç e gjen të së njëjtës rrënjë me emrat topikë Kuçevo, Kuçaja". Dijetari rus Rovinski,⁶ mendonte se emri i krahinës **Fund'na**, që bie në Nahijen e Kuçit s'është gjë tjetër veçse reflektim i latinizmës **fontana**; këtë gjykim ai e mbështeste me faktin se Krahinës së Kuçit natyra i paska falur shumë burime të freskëta; një mendim i tillë ndesh në pengesa të pakapëreyeshme sepse një **fontana**, kur mbahen parasysh ligjet fonetike të shqipes, mund të kishte reflektim **fundâna**, analogjikisht me shembullin **solanus** shq.shullâni, një fund'na në shqiptim të popullsisë së atjeshme, nuk ka urë të përlligjet, prandaj kombinimi me të latinishtes **fontana** nga pikëpamja gjuhësore nuk mund të merret në vështrim. Po të përjashtohen zbërthimet e Çabejt, kur është fjala për burimin e emrave të Kuçit, **Fund'na-s** - i marrim këto dy toponime, trajtimi i të tjerëve sikur kemi përshtypjen se nuk është bërë seriozisht e me gjithë mend; ka në punë të tyre mendime arbitrare, e pra puna e kërkimeve etimologjike do të bëhet sipas parimit të njohur: "etimologjitet nuk kërkohen, ato gjenden" (Le ethnologie non si creano, esse si trovano). Ka në gjykimet, në hetimet e tyre, të thuash spekulime, gjykime pa vlerësime objektive. Ç'është e drejta, edhe albanisti i ri Vanja Stanišić – këtu i përmendur, ndonjëherë nuk i del krah asaj pale studiuesish - albanologë që në këto troje nuk shohin gjurmë lashtërisht shqiptare. Ai emrin topik **Fund'na** në Nahijen e Kuçit e gjen drejt duke mbështetur mendimin për prejardhjen shqiptare të tij, sikur e nxirrte Çabej vetë. Pranë këtij toponimi ky albanist, ky gjurmues i bashkëmarrëdhënieve të ndërsjella serbo-shqiptare a shqiptare-serbe radhit edhe një fjalë, mbase të rrallë në këto tërthore malazeze - **Krûng** "rrafshnaltë, pllajë".

⁵ *Pleme Kuçi u narodnoj priči pjestni, II, 1967, f. 205-225.*

⁶ Černogoria, I, 93.

Do të bëjmë përpjekje disa raste emrash topikë si **Krusa Glavica**, **Krusi Dolovi**, që si emërtime dalin në rrafshin e Ulqinit në trajtën **Krute** (Kryth). Që të gjitha format e sjella këtu sipër do të çohen tek apelativi bazë "**kryeth, kryth**" (glava, glavica) - rrjedhojë toponimike e pajisur me formantin prapashtesor - **th**, sikur shfaqet në të folmet malazeze (glava, glavica) e që do të jetë riadaptim fonetik i fjalës **kryeth, kryth** (CKryeth, Kryth).

Në punën e adaptimit të këtij emërtimi do të vihet në dukje një gjë që spiranti ndërthëmbor **th** në të folmen malazeze ka marrë e është kthyer në sibilantin **s**, sikur vërtetojnë shumë raste: **frus** nga fruth i shqipes, në rumanishte **cursa** nga e shqipes **kurthë; sarbad**, shq. **tharbët**.

Për ta përligjur kalimin e spirantit ndërthëmbor të shqipes (**th**) në sibilantin **s** të të folmeve malazeze, **s**-ja e dhënë këtu sipër do të mbështetet edhe me **frus-in** në ato të folme. Në Fjalorin e vet Vuk Karadić i shënon atë shprehje (**frus**) me kuptim "puçrra që u dalin fëmijëve", me vërejtje që e kishte regjistruar në Mal të Zi; fjalën e ka edhe Fjalori i Akademisë Kroate të Shkencave.

Kjo sëmundje e fëmijëve në shqipen quhet **fruth**, e shprehja, siç shihet sheshazi, kaloi në të folmet malazeze të zonave kufitare. Është me interes të theksohet që në të folmen e arbëneshëve të Zarës këtë sëmundje e quajnë **ruth, rus**, që do njehur rrënjë e kryehershme e fjalës shqipe, e cila në ligjërimet e tjera shqipe sot del vetëm me prefiksin **f**, pra **fruth**. Kur dihet që trajta arbëneshë përbën bazën më të hershme të kësaj fjale të shqipes (fruth), atëherë ajo do lidhur me bazën indoevropiane **rud(h)** "i kuq" dhe nuk ka kurrfarë dyshimi që shprehja indoevropiane përbën bazën e formave sllave të saj, rus. e vjetër **ruds**, lit. **rausvas** "diçka e kuqe", lat. **russus** (ruber).

Ne nuk e vëmë në dyshim prejardhjen e përbashkët sllave, por nuk mund të pranojmë prejardhjen sllave të kësaj shprehjeje të shqipes, një mendim të cilit i dalin zot autorët e Fjalorit të Akademisë Kroate të Shkencave: "nga gjuhët sllave kjo fjalë kaloi në shqipen dhe rumanishten".

Tani shtrohet çështja e mundësisë së burimit a e kalimit të fjalës sllave (e serbokroatishtes) **rus, rusa** në të folmet shqipe, që sikur është vërtetuar, ruhet vetëm në formën e arbëneshëve të Zarës. Prejardhjes sllave të

kësaj fjale të Arbëneshit të Zarës nuk i bie ndesh kurrfarë pengese fonetike e as formale: tingulli i fundit, frikativi **th** i fjalës **ruth** fonetakisht mund të shpjegohet: një **s** e vjetër serbe në disa raste është zëvendësuar në disa fjalë të shqipes me interdentalen **th**: sinje (**more**); **thinjë**, folje **thinj** "jam thinjur", mirëpo nga ana tjetër, s'mund të përjashtohet mundësia e përfimit të pavarur si ne shqipen dhe serbokroatishten, e tingulli **th** i Arbëneshit të Zarës të jetë reflektim i palatalit indoevropian **kth**.

Emri i katundit **eret** në Zagaracin e Poshtëm, është identik me emërtimin e një vargu emrash topikë me të njëjtën formë në mjedise shqiptare; në vende ku rriten shkurret, dushqet e lisnajat. Në këtë mes është me rëndësi të vihet re se emri i këtij toponimi del një rrjedhojë e fjalës bazë "qarr" e zgjeruar me anë të sufiksit latino-roman **etum** që duket në të trija gjuhët ballkanike: në shqipen, dalmatishten romane dhe në rumanishten me vështrim oronimesh që tregon fjala e parë, në truallin e shqipes: **Kashnjet** (castagnetum), **kallmet** (kallm), **Shkozet** (shkozë), **Shkorret** (shkorre, shkurre), **Shelqet** (shelk, shelg), **Mollet** (mollë).

Në lidhje me ç'u tha më sipër jo për të gjitha shpjegimet etimologjike të emrave topikë brenda Nahijes së Kuçit, por vetëm tre emrave toponimikë të asaj Krahine: **Kuçi**, **Fund'na**, **Krung** do t'u kthehemi rrjedhimeve që rezultojnë nga zbërthimet e tyre. Në punë të derivimit të dy të parëve, sikur shihej, merrnin pjesë dy palë studiuesish, njëra lagje, pa u thelluar në çështjet në hetim, marrin e përsërisin mendimin e njëri tjetrit pa shtuar gjë prej gjëje; ne punën tonë këtu në trajtim, emrin topik Kuçi - mbi një bazë që duket faqeza e bien të ardhur nga latinizma **cuceus**, që në shqipen ka dhënë "i kuq", jo "kuç"; një grup tjetër gjurmuesish, duke mos u kënaqur me përsëdytje boshe e të mërzitshme në kërkim shtigjesh të reja, pa u larguar nga mundësitë që ofrojnë dialektet e të folmet e shqipes, kanë gjuajtur shenjë mirë. Vetëm emri **Kuç** (Kuth) - ç'është e drejta, një fjalë e rrallë në leksikon e shqipes "një lloj kuthi a vorbe me dy veshë edhe emër vendi i ngulur në një gropë, në një luginë, emër që i përgjigjet vorbës", si nga pikëpamja e fonetikës edhe ajo e vështrimit të topikut në fjalë, i përgjigjet më së miri prejardhjes së tij. Edhe për prejardhjen e emrit tjetër - **Fund'na**, si u pa nga zbërthimi i tij, jepen argumente të parrëzueshme e të qëndrueshme. Vanja Stanišić, te vepra e tij **Srpsko-albanski jezički odnosi** në Nahijen e Kuçit ka regjistruar një lloj emri topik **Krung** "një rrafsh-

naltë a pllajë", që është reflektim i fjalës së serbishtes së vjetër **krogu** (qark, rreth) me **-un** të dalë nga **o-ja** e sllavishtes së vjetër.

Në qoftë se fjala etimologji do të thotë burim, gurrë apo prejardhje e një fjale, atëherë emrat topikë **Kuçi** dhe **Fund'na** janë, pa dyshim, të leksikut burimor të shqipes në një anë dhe në anë tjetër, - në ato treva, në ato tërthore janë shqiptarët ajo popullsi që kanë zënë vend në arealet e Kuçit që para një etnie tjetër që fliste sllavisht; ndryshe nuk mund të shpjegohet fakti që gjithë Krahina a Nahija të jetë emërtuar shqip, gjithashtu krahinëza *Fundna* që përthekon disa katunde, të mbajë emër shqip - *fund*, shm. *Fundna*, *Fund'na*, *Fundna*.

Po të jetë e vërtetë që një lloj rrafshnalte a pllaje mban emrin *krung*, në Kuç të Malit të Zi, është edhe ajo një dëshmi që Kuçi do të jetë një ngulim i hershëm në ato anë, sepse *krung*, sikur u vu në dukje saherë në këtë tekst, është reflektim shqip i sllavishtes *krogu*, që përmban *o-në* hundore e që nuk del kund në dialektet e sllavishtes jugore pas shek. X, pasojisht shqiptarët gjëllinin vonë-vonë në Kuç e gjetkë që nga shekulli X në Mal të Zi.

Gjurmë të shqipes gjejmë edhe më herët, por edhe më vonë. Ka në Mal të Zi, bie fjala, një vëllazëri të quajtur *Mataguzhi* (një etni e vjetër) "stari narod zagonetnog imena koji je sedeo na današnjoj kučkoj zemlji" zabeleen 1335, kraj Podgorice kao Arbanasi"⁷, pastaj *Ma(h)ine* - Sufflay-it ia kujtojnë Manioi-t e ilirëve, edhe Malonshiqët-në Fushën e Zetës; të kujtojnë fjalën *Mal* të shqipes. Ka një fshat me emrin *Malenza* (shq.mal); një toponim **Malošin Do**, patronim: Malošević⁸; të mesjetës: *Bukumirët*; vëllazëri e barinjve Golemade (gojëmadh - thellë në Mal të Zi;⁹ Vëllazëri në Zetë: *Bitodosi* (Bythëdosë); *Bushat ë+shat Bushat* "Mbi shat"; emër i një mali në Kuç.

Ne s'i kishim vënë vetes për detyrë të hartojmë një listë toponimesh llojesh të ndryshme shqipe, të regjistruara në botime të çfarëdo natyre, ndonëse sikur është e ditur, Mali i Zi është plot e përplot emrash topikë, antro-

⁷ J. Erdeljanović, SEZB VIII, 1907

⁸ V. Čubrilović, 1964

⁹ Suffllay, Arhiv, II, 1925

ponimesh, vëllazërisht që nga antika, mesjeta e më vonë. Synimi që donim të arrinim përqendronte në një pikë, në mbështetjen e shpjegimit e të sqarimit kryesisht të dy emrave topikë (Kuçi, Fundna) me anë të të cilëve do të zgjidhej një problem mjaft kompleks i mbetur pezull tash sa kohë.

Tani që, pas gjykimit tonë këta dy emra topikë (Kuçi e Fundna) pas shpjegimit të Çabejt¹⁰ morën përgjigje të drejtë e të pranueshme në lidhje me ta shtrohet një problem tjetër, gjithashtu me interes etnogjuhësor. Për vetë faktin se emrat topikë Kuçi dhe Fundna janë krijuar a formuar nga shqiptarët shqip - ishin edhe të konfesionit katolik - si shkruante Marin Bolica (1610)- "Chuzzi del rito romano cattolico", në këtë mes do te merret në vështrim edhe një dëshmi a provë që mbështet e vërteton lashtësinë e banorëve shqiptarë në Nahijen e Kuçit,- është fjala për emrin topik të **Krungë-s** të regjistruar në toponiminë e Kuçit edhe nga prof. Dragoljub Petrović¹¹ "një rrafshnaltë a pllajë".

Në qoftë se rezulton e drejtë etimologjia e toponimit të fundit, fjala **krung(ë)** krogu provon vazhdimësinë e shqiptarëve edhe në arealin e Kuçit e që mbështetet në reflektimin e vokaleve hundore të sllavishtes së vjetër **o**, e të ruajtura në gjuhën shqipe e të ndryshuara në dialektet malazeze të këtyre anëve vonë-vonë në gjymsën e dytë të shekullit X. Dukuria në fjalë, pas mendimeve të përgjithshme të sllavistëve, nuk gjente kund realizim pas shekullit të pastajmë në të folmet sllave të këtyre anëve.

Në mbështetje të tyre-disa toponime dhe antroponime të ruajtura në territorin e Malit të Zi, të para këtu sipër bashkë me këtë në shtjellim e sipër (krungu), flasin qartë në të mirë të dëshimit e të vërtetimit të vazhdimësisë së shqiptarëve në anën e Zetës e në kohën e Mesjetës së hershme. Për periudhat më të hershme mbështetjet i kemi në ruajtjen e disa toponimeve dhe antroponimeve malazeze që heqin gurrën ilire të tyre; për kohën paraturke viset e Malit të Zi janë përplot emrash topikë, vëllazërisht, fshatrash e katunesh shqiptare, e ne po lejohe mi të sjellim vetëm një dokument shkrimor që historiani i mirënjohur çek K. Jireček e kishte gjetur në

¹⁰ E. Çabej, *Lingua Posnaniensis*, VII, VIII, 1959, 1960; Shumësi i singularizuar në gjuhën shqipe, Tiranë 1967

¹¹ Onomatološki prilozi, IX, 82.

Arkivin e Dubrovnikut: *Audivi unam vocen clamantem in monte in lingua albanesca i vitit 1285.*¹² Historiani i madh, specialist i historisë së mesjetës, pasi e shpjegon rastin që e kishte shkaktuar një kontest gjyqësor, merr e e vë në dukje se si nga mbarimi i Mesjetës, sidomos në Dubrovnik po grumbullohej një numër i madh shqiptarësh të ardhur prej viseve shqiptare në kërkim të punës: tregtarë, zejtarë, e sidomos murgj e priftërinj në një lak kohe kur tregtia, detaria e lundrimi po merrnin hov, në një kohë kur breznitë e reja po kërkonin të pushtonin hapësira tokësore e detare të reja.

Po afrohemi te Prizreni, te rrethi i tij për ta këqyrur edhe pakëz emrin topik, të emërtuar dy formash: *Landovica* dhe *Lutovica* sikundër na del te **OP VII, 30**, dhe ku sllavisti i njohur Mitar Pešikan, në punimin e tij të hapët: "Antoponimia e Podrimës së Poshtme që të dyja format i çon te baza *Lot* (*Defteri i Nahijes së Prizrenit, 1571*) - nga e cila në të folmen shqiptare ruhet trajta e hershme **land** me zanore hundore, kurse **lut** formë sekondare e përfutur që nga gjysma e dytë e shekullit X e tëhu në të folmet serbe të këtyre anëve.

Po e përfundojmë me një tezë - kundërtezë "Meqë kufiri etnogjuhësor shqiptar-serb ishte i ndarë me një toponimi dukshëm sllave, mund të mendohet se shqiptarët vetëm në kohën e sundimit turk kishin zënë të kalojnë në anë të majtë të Drinit", Mitar Pešikan: "Emrat e vjetër në Podrimën e Poshtme".¹³

Një gjykim i tillë i Peshikanit nuk ka mbështetje të pranueshme, sepse është e kundërshtueshme nga argumente të forta e prej faktit se në anë të majtë të Drinit është lokaliteti i *Landovicës*; ç'është e drejta toponimi në fjalë nuk ka prejardhje nga gjuha shqipe, veçse përqëndron në vete një fakt, një provë nga të fonetikës historike të sllavishtes jugore të reflektuar në shqipen e Mesjetës së hershme që në dritën e emrave të vendeve përforcon problemin e autoktonisë së shqiptarëve në këto anë tona.

¹² *Die Romanen in den Städten Dalmatiens während des Mittelalters* – Zbornik Konstantina Jirečeka, II, Bcograd, 1962, f. 51.

¹³ Onomatloški prilozi, VII, 92

ZHVILLIME PARALELE FONETIKE DHE NDIKIME TË NDËRSJELLA TË DIALEKTEVE SHQIPTARE DHE SERBE TË KOSOVËS

Në mes tipit dialektor të shqipes së Kosovës dhe atij serb ka disa përkime të përbashkëta gjuhësore të zhvilluara si rezultat i bashkëjetesës së popullsisë së dy popujve në fushën e fonetikës, të leksikut dhe të prozodisë. Që në dy tipat dialektorë të gjuhëve të përmendura artikulimi i çifteve ç-q, xh-gj, serb. č-ć, dž-đ, ka marrë e është rrafshuar në dy tipa: č-đ duke u mbledhur në afrikatat paraqiellore; do t'i sillemi edhe ndryshimit që ka pësuar theksi në dialektet serbe të këtij trualli gjuhësor. Bashkëpërkimet e tjera që ndeshen në dialektet e dy gjuhëve tona, nuk do t'i prekim për arsye se ato janë rrokur nga lingvistë të tjerë edhe më parë. Thamë se do t'i sillemi aq sa e do nevoja prirjes për shkurtimin e kuantitetit të zanoreve të dialekteve serbe të kësaj treve, - një risi që të folmet shqiptare të këtij trualli s'i ka prekur fare për të hedhur poshtë mendimin e pambështetur që edhe kuantitetet e zanoreve të dialekteve shqipe i sheh të ndryshuara me ushtrimin e ndikimit të turqishtes, si në serbishten si në shqipen e këtyre anëve. Të shtrojmë, pra, një problem mjaft interesant, por edhe tepër të koklavitur: tipat e grykoreve qiellzore, burimin e tyre, shtrirjen dhe tkurrjen e çifteve nga katër në dy palë, si në të folmet shqipe, si në dialektet serbe të trevës gjuhësore të Kosovës. Kjo çështje është e pamundshme të hetohet ndaras, për shqipen veç e për serbishten veç, sepse bashkëjetesa e popullsisë së dy popujve ka lënë gjurmë të dukshme në dialektet e të dyja gjuhëve.

Në parim të folmet serbe në truallin e Kosovës nuk bëjnë pjesë në Lidhjen gjuhësore ballkanike, porse ato në strukturën e tyre dialektore ngërthejnë në vete një inventar të mirë veçorish gjuhësore – veti të atyre gjuhëve ballkanike që me dukuritë e tyre strukturore – me plot të drejtë, krijojnë një tipologji analitike gjuhësore. Ky analizëm gjuhësor ka mun-

dur të krijohet në një hapësirë të kufizuar të Gadishullit Ballkanik, pikërisht për shkak të përzierjeve mbimesatarisht të gjera dhe të shumanshme. “Mendohet kryesisht se njerëzit që i kanë mësuar gjuhët e fqinjëve të tyre vetëm sipërfaqësisht, aq sa kanë pasur nevojë për të zgjidhur çështjet praktike, - kanë folur në mënyrë analitike, sepse analitizmi është veçori e çdo polilinguizmi të papërsosur. Njeriu, që gjuhën e huaj nuk e zotëron e e flet me guxim, të folurit e tij e rrudh në një numër të vogël kategorish duke mos mbajtur parasysh finesat dhe ngarkesat e asaj gjuhe të huaj”. Gjuhëtari i njohur serb, Pavle Iviç, këtë fenomen e përkufizoi kështu: “Kontaktet e afërta shpesh kanë për pasojë thjeshtësimin e sistemit. Nëse përzihet një sistem më i ndërliqshëm dhe një tjetër më i thjeshtë – rezultati anon nga tipi më i thjeshtë dhe në rastet kur kryqëzohen dy sisteme të ndërliqshme të ndryshme, ka gjasa që përfundimi të jetë më i thjeshtë se ç’janë këto dy sisteme”.

Sikundër thamë më sipër, nga gjithë inventari i veçorive të përbashkëta gjuhësore, ne do të kufizohemi te dy tipare: te çiftet e qiellzoreve dhe te një tjetër – te theksi, shumë shkurt.

Për sa i përket shqipes formën qiellzore të grykores ne e ndeshim që herët, janë të gjitha gjasat që qiellzoret *q:ç*, *gj:xxh* gjuha mëmë indoevropiane nuk i kishte, veçse ato u krijuan në rrymë të kohëve në këtë gjuhë: *q*-ja u përftua nga vlerat e thjeshta pranë të cilave gjendeshin zanore qiellzore, pastaj ajo dilte nga lidhja *ci*: socius = *shoq* etj.; ndërsa *gj*-ja u përftua nga bashkëtingëllorja indoevropiane, bie fjala *gjak*, sllav. *sōk*; *gjashtë*, lat. *sex*, gjerm. *sechs*, sllav. *šest*; *gjumë*, lat. somnus, greq. hypnos; një *gj*shqipja e prodhoi prej një *j*-je indoevropiane dhe latine: *ngjesh*, sllav. (po)*jas*; *gjyq*, lat *iudicium*.

Me anë të metafonizimit nga një bashkëtingëllore prapaqiellzore *g*, një risim që ka përkufizuar gjithë sistemin morfologjik e leksikor të shqipes në periodën e saj historike dhe si i tillë nuk është njohur dhe vlerësuar sa duhet në rëndësinë e tij – është prodhuar bashkëtingëllorja qiellzore: *argull*, shumës *arguj*, por edhe *ergjes*; nga greq. *kakos* në shqipen kemi *keq*; nga **darg* – *dergj*, *dergjë*; nga *djerg* – *dirgjem*, *zhdirgjem*; *gallus* – shumësi i

dikurshëm *gjel*, sot i singularizuar; *gjeth* nga **gath*; *gjedh* prej **gjadh*, sllav. *govedo*; *gardh* – shm. *gjerdhe*.

Togu konsonantik *-sk* në pozicion para një zanoreje originalisht të mbyllët ka përfunduar në *-h*, e para një të çelët në *-ç*: hap-i çap-i; i *çalë* nga një **skel-no*; *çel*, lit. skeliu “çaj”, skiliu “çel zjarrin”, *çaj* ind. vj. skhadate “*çan*”. Nga këto dy fonema *-sh-ç*, për mendimin e Çabejt (Mbi disa rregulla të fonetikës historike të shqipes, Studime filologjike 1970/2 77-95) në ndërrimin e tyre fonetik më i vjetër del *-sh-ja*; krahas me *çel*/ka një *mbërshel*, *mëshel*; krahas me *çef*, *mëçef*, *ka-fsheh*; pranë *çaj* ka *shaj* “fyej me fjalë të rënda, flas keq për një njeri; gjykoj një njeri, vërtetoj fajin e tij”. Përbri i *çalë* është *-shalë* “ana e mbrendshme e kofshës; pjesa e trupit që shkon nga rrëza e kofshës gjer poshtë te syri i këmbës (zogëza e këmbës)”. Nga ky shtjellim i shkurtër i përfutimit të qiellzoreve dhe afrikateve del e qartë se shqipja dhe shumica dërmuese e të folmeve të saj kanë katër çifte palatalesh dhe afrikatesh: *q-ç*, *gj-xh*. Në këtë mes do të thuhet që fonema e afrikates *xh* nuk mund të jetë e lashtë. Sot, sikundër dihet, çiftet e përmendura të palataleve – bashkë me afrikatet – të ruajtura në shumicën dërmuese të të folmeve të gjuhës shqipe – në një numër dialektesh gege janë rrafshuar duke u tkurrur në dy fonema: *ç-đ*.

Treva ku këto bashkëtingëllore kanë pësuar zhvillime të mëtejme kap një pjesë të madhe të gegërishtes – duke nisur me Dukagjinin e duke përfshirë Tropojën e Kukësin, e në jug izoglosa kap Pukën, Mirditën dhe del në Dibër, shkon në anën verilindore duke u hapur në një territor të madh që ngërthen të gjitha të folmet shqipe të Kosovës dhe të Maqedonisë veriperëndimore. Zhvillimet e përmendura i takojnë edhe në Shkodër – ndër popullsinë e konfesionit katolik.

Të para në tërësinë e tyre, zhvillimet fonetike të bashkëtingëlloreve të zëna ngoje këtu sipër, kanë mbetur pa u studiuar nga një anë e rëndësishme do të thoshim ne: Ku duan kërkuar shkaqet e ndryshimeve të çifteve të përmendura të qiellzoreve: te faktorët e brendshëm apo te ata të jashtëmit:

Shqiptimi i sotëm i grykoreve qiellzore në gjuhën tonë që na shfaqen

me nga dy çifte; q -ç, gj - xh , na del i reduktuar: çifti i parë mbliidhet në një shqiptim të vetëm $q, ç > = \acute{c}$, lagjja e dytë e tyre tkurret gjithashtu nënjë shqiptim: gj - $xh = \acute{d}$.

Po deshëm të hetojmë kohën e këtyre ndryshimeve në sistemin e bashkëtingëllimit të dialekteve verilindore d.m.th. të ligjërimeve kosovare, - neve na duket se duhet të gjejmë ndonjë pikëmbështetje për të arsyetuar rrafshimin e dy palë çifteve të guturaleve të përmendura qiellzore. Dihet me siguri që kjo shfaqje e dialekteve shqiptare të Kosovës nuk është dukuri e izoluar, atë e ndeshim te dialektet serbe të këtyre zonave. E vëmë në pah këtë fakt për arsye se shpjegimi i kësaj dukurie në dialektet shqiptare nuk mund të dalë bindës dhe i mbështetur mirë po s'u mbërthye në rrethanat e kushtet që përftuan kthimin e të dyja togjeve të guturaleve në një palë guturalesh edhe te dialektet serbe të këtyre trevave si dhe te të folmet serbokroate të Bosnjes dhe të Hercegovinës, kryesisht ndër popullsinë e konfesionit mysliman.

Natyrisht, do të mbahen parasysh skemat e krijuara pas ndërrimeve që pësuan okluzivet qiellzore duke u mbledhur në afrikate paraqiellzore në dialektet e gjuhës shqipe, si dhe rrafshimi i dy palë afrikateve në një tip në të folmet serbe të Kosovës. Por, në anë tjetër, ndikimi i njëres gjuhë mbi tjetrën në këto troje nuk mund të merret i kryer në mënyrë mekanike; do të shqyrtohen të gjitha rrethanat gjuhësore e historike.

Nga ana e studiuesve shqiptarë ky ndërrim a rrafshim okluzivësh palatale në afrikate në një lagje të folmesh shqiptare jo që s'ka qenë objekt hetimesh (E. Çabej, Për historinë e konsonantizmit të gjuhës shqipe, BUSHT 1958/1; J. Gjinari, Për historinë e dialekteve të gjuhës shqipe, Studime filologjike 1968/4; I. Ajeti, Pamje historike e ligjërimit shqip të Gjakovës në fillim të shekullit XIX, Prishtinë 1960; Gjurmime albanologjike 1966; Istorijski razvitak geg. govora Arbanasa kod Zadra, Sarajevo 1961; H. Agani, Fjalori i Lubomir Kujunxhiçit, Prishtinë 1981), porse me përjashtim të Ajetit dhe Aganit asnjëri prej tyre deri më sot s'është marrë me çështjen e shkaqeve të nivelimit të fonemave në shqyrtim. Të huajt përkundrazi (P. Ivić, Dva glavna pravca razvitka konsonantizma u

srpskohrvatskom jeziku, Godišnjak filozofskog fakulteta u Novom Sadu, knj. II. 1957; Dijalektologija srpskohrvatskog jezika, N. Sad 1956; Srpski narod i njegov jezik, SKZ 1971; D. Barjaktarević, Dijalektološka istraživanja, "Jedinstvo", Priština 1977; Govor Srba u Metohiji, "Jedinstvo", Priština, 1979; A. Peco, Iz fonetske problematike ikavskošćakavskih govora zapadne Bosne, J. filolog, XXXI, Beograd 1974-75) kur marrin e trajtojnë çështjen e okluziveve qiellzore d.m.th. mosdiferencimin e dy palë afrikateve në një palë të folmesh të serbokroatishtes, shkaqet i shohin edhe te interferencat apo ndikimet e ndërsjella të atyre dialekteve me të shqipes. Meqë dukurinë e përmendur të rrafshimit të bashkëtingëlloreve të përfillura e gjejmë edhe në një lagje të të folmeve të shqipes, bie fjala tek ato të Kosovës e gjetiu, reduktimin e katër çifteve në dy sosh e shpjegojnë si rezultat të ndikimit të serbishtes (P. Iviç, aty 161), ndërsa D. Barjaktareviqi këto ndërrime, si në dialektet serbe si në ato shqiptare të Kosovës i gjen në bilinguizmin apo te ndikimi i turqishtes i ushtruar mbi serbishten dhe shqipen e këtyre anëve.

Në parim ndikime të gjuhëve të përmendura njëra mbi tjetrën kanë qenë të mundshme, pa farë dyshimi në këto anë dhe jo vetëm në këto anë, por edhe në ato treva ku bashkëjetesa e mbartësve të këtyre gjuhëve në rrymë të kohës ka qenë shumëshkullore. Mjafton të kujtohet shqiptimi i okluziveve qiellzore dhe i paraqiellzoreve në disa dialekte shqiptare të Malit të Zi (rrethi i Podgoricës, pjesët e Malësisë së Madhe në Mal të Zi, rrethi i Plavës dhe i Gucisë). Në strukturën e këtyre tingujve kanë ngjarë lëvizje duke iu adaptuar afrikateve të dialekteve malazeze pikë për pikë, e pjesërisht ushtrimi i tyre duket edhe tek afrikatja paraqiellzore e dialekteve të Krajës me Malësinë e saj (Kraja, Brisku, Shestani), ndërsa okluzivet qiellzore s'janë prekur fare nga ndikimi (Ajeti, Istorijski razvitak; H. Agani, Fjalori i Kujunxhiçit).

Po si qëndron puna me të folmet shqiptare e serbe në Kosovë? Kushtet dhe rrethanat historiko-shoqërore këtu ishin ndryshe, prandaj skemat e huaja në këtë fushë nuk mund të zbatohen mekanikisht.

Sa i përket kronologjisë së këtyre shfaqjeve në dialektet shqiptare të

Kosovës, mbi dëshminë e monumenteve shkrimore mund të thuhet se dukuria në shqyrtim zë të nxjerrë krye nga mbarimi i shekullit të kaluar.

Për të dëshmuar ndikimin e turqishtes në lëvizjen e okluziveve qiellzore dhe të afrikateve paraqiellzore duke u rrafshuar ato në dy çifte bashkëtingëlloresh: *ć,đ* si në shqipen si në serbishten e këtyre anëve, njëherë duhet të zgjidhet çështja enigmatike: përse turqishtja nuk mundi të ushtronte farë ndikimi në fushën e këtyre lëvizjeve në dialektet maqedone dhe në të folmet serbe të pellgut të Moravës Jugore? Kur është fjala për mundësinë e ushtirimit të ndikimit të serbishtes mbi të folmet shqipe të anëve të Kosovës, - do të thoshim se gjasat e një ndikimi të tillë ishin fare të vogla: neve na dalin dy vështirësi në këtë mes. Për ne mbetet e paqartë puna nëse dialektet serbe të këtyre anëve që nga shekulli XV-XIX zotëronin katër çifte afrikatesh, apo jo. Po s'u sqarua kjo çështje, ka fare pak mundësi që këto të folme të kenë vepruar në drejtim të rrafshimit të bashkëtingëlloreve në fjalë të dialekteve shqiptare të Kosovës. Për ne, prapë, mbetet një çështje pezull: pse serbishtja e këtushme nuk veproi mbi shqipen e këtyre anëve në punë të rrafshimit a tkurrjes së bashkëtingëlloreve të lëngëta r:rr; lëkundje të këtyre bashkëtingëlloreve të lëngëta, sidomos nëpër katunde nuk janë vërejtur – pse?

Duke bërë tonin mendimin e H. Aganit, e në lidhje me ndërrimin dhe lëkundjen në bashkëtingëllimin njëherë në të folmet shqiptare të Kosovës – do të përfundonim se kthimi në afrikate i okluziveve qiellzore nuk u bë nën ndikimin e gjuhëve të tjera, por është rezultat i zhvillimit të brendshëm të këtyre të folmeve shqipe – atëherë kur mesgjuhoret *q, gj* do ta kenë humbur vlerën e tyre fonologjike “në trevat e përmendura gjuhësore në rrethana historiko-shoqërore”. Faktorët e jashtëm gjuhësorë e shoqërorë në përgjithësi, pa farë dyshimi, e kanë favorizuar me të madhe procesin e nisur kaherë në të folmet e gjuhës sonë.

Përfundimet e proceseve analogjike të krijuara edhe në dialektet serbe të këtyre anëve ne i shohim gjithashtu rezultate të proceseve të brendshme të favorizuara nga ndryshimet e mëdha shoqërore, shtegtime përbrenda vendit, nga shpërngulje të ngadalshme dhe nga përzierje të

mbartësve të dialekteve dhe të gjuhëve të tjera të ardhur në këto anë prej viseve jugore dhe lindore. Gjykimet tona rreth proceseve strukturore të konsonantizmit dhe ndërrimet e tyre si në dialektet shqipe si në ato serbe të këtyre anëve nuk puqen me të Barjaktareviqit (Dijalektološka istraživanja, 22) i cili lëkundjet në çiftet e okluziveve palatale dhe afrikatet në dialektet e të dy gjuhëve tona të rrafshuara në afrikate prepalatale (ć, đ) i gjen të përfutuara nën ndikimin e turqishtes – një mendim të tijin që ne nuk e shohim të mbështetur mirë. Ç’është e drejta, në koleksionin shkri-mor të Graçanicës duken qartë të përdorura afrikatet prepalatale: Vla-dičice naše Bogorodice...; oč; Hercegovackog; čestiago; očinu; plaču, četušten (čitajući, onaj koji čita). Vetëm në këtë mes një tjetër gjë nuk del e qartë – kopjesit e tekstit ishin vendës apo të vendeve të tjera; ata, pa farë dyshimi ishin të shkolluar dhe pak gjë të përbashkët kishin me gjuhën e popullit të këtyre anëve.

Dukuria që u përpoqëm ta sqarojmë ka një karakter më të përgjithshëm dhe një shtrirje shumë më të hapët: na del në dialektet shçakavike – ikavike dhe shtokavike të Bosnjës. Epiqendra e saj ishte Bosnja Perëndimore që me kohë, me shtegtime të popullsisë nga ana perëndimore e Bosnjës në drejtim të viseve qendrore dhe lindore të saj u shtri edhe në të folmet e atyre krahinave duke sosur në Sanxhak. Shfaqjen në fjalë e ndeshim edhe në treva të tjera të vendit tonë – në përgjithësi e takojmë kudo që kemi përzierje gjuhësh me sisteme të ndryshme: në Vojvodinë, në Dalmaci e gjetiu. Gjykimet dhe mendimet e ekspertëve rreth përfutimit të shfaqjes në shqyrtim janë të ndara. Patriarku i sllavistikës jugosllave A. Belić i mbahej mendimit të vet, qyshkur të shprehur, se prirja e qiellzimit të afrikateve në ato dialekte ishte rezultat i trashëgimit të një gjendjeje të hershme që sundonte në sllavishten e vjetër e ruajtur në rusishten edhe sot e gjithë ditën, d.m.th. fonema č ishte shumë më e butë se ć na del sot në serbokroatishen. Shqiptimi i saj qiellzor ruhet edhe në të folmet e përmendura shçakavike – ikavike, pastaj edhe në ato shtokavike. Hetuesit e tjerë këtë dukuri e shohin ndryshe. Dialektologu i njohur serb Pavle Ivić e nxjerr nga ndikimi i turqishtes, meqë ajo shfaqet kryesisht te

popullsia e konfesionit mysliman në Bosnjë. Asim Peco, edhe vetë boshnjak, i mbahet mendimit të A. Beličit duke i sqaruar në shumë vise pikëpamjet e mësuesit të vet dhe thotë: “Domaće prilike su urodile tu pojavu... Strani uticaj, ako ga je to uopšte i bilo, mogao je samo da potmogne njenoj bržoj kristalizaciji, ali nikako da bude i njen podstrekač (215). Sve ovo ima oslonac u činjenici da nigdje na području čijim je fonetskim osobinama ovdje riječ nismo imali bilingvizam kao opštenarodnu pojavu”.

Gjurmuesi më i mirë i të folmeve serbe të Kosovës është Barjaktareviqi, i cili që nga viti 60 ka zënë të hetojë sistematikisht tipin kosovar të serbishtes. Rezultat i këtyre përpjekjeve të tij janë dy vepra të veçanta që sapo u zunë ngoje. Në studimet e tij, prof. Barjaktareviçi ka vënë në pah shumë veçori të përbashkëta të serbishtes dhe të shqipes së këtyre anëve si dhe u ka vënë gisht shumë bashkëpërkimeve dhe barazimeve në fushë të fonetikës dhe në lëmin e prozodisë. Një cilësi të përbashkët të hyrë nga turqishtja në të dyja gjuhët tona – në serbishten dhe në shqipen e Kosovës Barjaktareviçi e sheh edhe te shkurtimi i kuantitetit të vokaleve të theksuara dhe të patheksuara. Në parim nuk mund të mohohet ndonjë ndikim i turqishtes edhe në fushë të prozodisë mbi gjuhët tona – te dialektet serbe të këtyre anëve, por për të folmet shqiptare të këtyre viseve nuk është vërtetuar kund kurrfarë ndikimi. Në gjuhën shqipe, sipas Joklit, akcenti që nga koha romake e këndej ishte fiksuar, nuk qe më lëvizës, një gjë që gjen vërtetimin e vet edhe në fjalët me burim latin të gjuhës shqipe: *pres-biter – prift; puteus – pus; padulem – pyll*, etj. Gjykimet e Barjaktareviqit rreth ndikimit të turqishtes mbi dialekte serbe të anëve tona në punë të prozodisë nuk na dalin të mbështetura mirë, sepse në rrethana të njëjta mund të bëhet pyetja – pse një ndikim i tillë nuk u ushtrua në të folmet serbokroate të Bosnjës ku për më tepër një numër i madh i popullsisë morën fenë e pushtuesit duke u afruar edhe në punë të gjuhës nëpërmjet të konfesionit. Edhe aty shkaqet duhen kërkuar në proceset e brendshme të të folmeve në fjalë, të ndihmuara nga faktorët e jashtëm.

EMËRTIME GJEOGRAFIKE NË SHQIPEN DHE SERBOKROATISHTEN

Shqipja-gjuhë e një populli që në pjesën më të madhe ka jetuar dhe jeton sot e gjithë ditën në viset malore, ka ruajtur mirë emrat me anë të të cilëve shënohen emërtimet e truallit dhe ato gjeografike. Është e ditur fare mirë se fjalori i gjuhës shqipe shkoi e u rrallua ndjeshëm me të hyrë në të sidomos elemente të latinishtes dhe huazime të ardhura prej gjuhëve fqinje. Po të merret e të shohitet mirë fondi i përgjithshëm leksikor në cilindo fjalor të gjuhës shqipe, - bie në sy menjëherë se sasia më e madhe e inventarit leksikor në sferën e konfiguracionit të terrenit, - ka prejardhje indoevropiane; huazime ka fare pak.

Nga një statistikë e përafërt që kishte bërë linguisti Eqrem Çabej, dilte se në një masë prej 51 fjalëve të sferës së konfiguracionit truallsor dijetari shqiptar kishte konstatuar një raport si ky: 34 fjalë vendi, 17 të huazuara. Në vijim të kësaj përlogaritjeje çështja paraqitet kështu: “Në fushë të leksikut gjithë ajo pjesë që i përket një jete të lidhur me natyrën dhe një ekonomie e një kulture më fort primitive, në pjesën më të madhe na del e pajisur me fjalë të visarit leksikor të trashëguar. Elementi i huaj, përkundrazi, mbizotëron në atë pjesë të folurit që lidhet me një jetë materiale e morale më të zhvilluar”.

E kishim thënë edhe në krye të këtij vështrimi, - se i kishim vënë vetes për detyrë të përpiqemi me disa shembuj të shpjegojmë si zunë fill e u përfatuan disa terma gjeografikë kryesisht në breza kufitarë jugosllavo-shqiptarë. Disa raste të përkthimit apo të kalkimit, të imitimit, të bartjes së kuptimit a vështrimit nga një gjuhë në tjetrën, në rastin tonë nga serbokroatishtja te shqipja apo anasjelltas prej shqipes te serbokroatishtja – u kishin vënë gisht edhe më parë¹, por edhe ne vetë, në disa punime kishim

¹ I. Popović, Neki gentilni i njima srodni termini kod Crnogoraca i Arbanasa, Radovi, Sara-

vënë në dukje – e kishim persiatur një bashkëpunim të ngushtë ndërmjet dy gjuhëve tona në punë të emërtimit të sa e sa toponimeve në ato treva në të cilat bashkëjetojnë me shekuj këta dy popuj, për ç’gjë, disa emra gjeografikë, del mjaft vështirë të jenë përftuar spontanisht” pa farë ndikimi së jashtmi.

Në shtjellimin e kësaj teme ka një rrethanë lehtësuese, sepse mbi jetesën dhe doket e zakonet e popujve që gëllijnë në zonat kufitare, kemi një lëndë të bollshme që del në punimet dhe veprat e një vargu kërkimtarësh të zellshëm – sikundër janë: Erdljanović, Jovićević, Dučić, Šobajić e të tjerë. – Në regjistrat e të cilëve – të përgatitur me kujdes të rrallë, gjendet një material i pasur, që mund të hunte në punë edhe për tema kësisoj onomastike.

Së pari do të zëmë një emër të një nahije (krahine) qysh e quanin zakonisht studiuesit e posazënë ngoje – krahinën e Shestanit; burimin e Shestanit, një vis në rrëzë të malit Rumi, në veriperendim të Krajës, - që e kishim prekur në vështrimin e toponomastikës së kësaj treve të Malit të Zi në punimin e disertacionit tonë.² Por, në atë rast nuk ia kishim dalë në krye ta zgjidhnim punën e etimologjisë së toponimit në hetim. Nuk është i drejtë as mendimi i Joviçevićit³ - sipas të cilit shpjegimi i kësaj do kërkuar në gojëdhënë që thotë se në këtë vend kishin ardhur e ishin vendosur shumë herët gjashtë vëllezër dhe nga numërori gjashtë (šest) i pajisur me formantin *an*, (ani) i gjithë vendi mori emrin *Shestan*, *Šestani*.

Duke rishikuar kohët e fundit etimologjinë e Shestanit, në veprën e Erdelanovićit, hasem në një frazë shumë drejtimdhënëse: držati na šestu – me kuptim, “punoj, a lëvroj tokën e huaj dhe i jap pronarit të gjashtën e frutit”. Pas mendimit tonë trevat që mbanin emrin Shestani duhet të kenë qenë zotërime feudalësh që punoheshin prej katundarëve me detyrime që feudalit t’i jepnin pjesën e gjashtë të prodhimit të tokës.

Në këtë analizë onomastike do t’i sillemi ta vështrojmë emrin e

jevo 1954.

² Istorijški razvitak gegijskog govora Arbanasa kod Zadra, Sarajevo 1961.

³ Crnogorsko primorje i Krajina, f. 69.

Kuçit dikur nahije - një emërtim që studiuesit e Malit të Zi përdornin për krahina të ndryshme të tij. Krahina e Kuçit përmendet për herë të parë në krisobulat e Deçanit më 1330. Prof. Gjurgjev, në studimin e tij që mban titullin: *Iz istorije Crne Gore brdskih i malisorkih plemena*, Radovi Naučnog društva NR Bosne i Hercegovine, (Sarajevo 1954) shkruan: “Përveç në Bushat, Kuçët i përmendin edhe në katunin e Lezhës dhe të Tuzit qysh figuron në krisobulat e Deçanit; pastaj më 1416 në kadastrën e Shkodrës, ata na dalin të përderdhur në rrethina të Shkodrës, bile atje edhe një fshat mban emrin Kuç. Më 1455, ata formojnë siç *thuhet* njësi organizative të pavarura. Në vitin 1485 kanë zënë vend në territorin e sotëm të Kuçit, të krahasojmë studimin e sipërm të Gjurgjevit (191-192). Një fshat me emrin Kuç zihet ngoje në lindje të Vlorës më 1342.⁴ Emri topik Kuçi ka marrë një përhapje të gjerë në të gjithë Shqipërinë dhe në ngulimet e kolonistëve shqiptarë në Greqi dhe në Italinë Jugore.

Kur marrim e gjurmojmë burimin e këtij emri – një gjë që në këtë mes na intereson, del se studiuesit s’pajtohen në mendime: në hetimin e gurrës së këtij emri topik janë shfaqur dyshime, lëkundje dhe përfundime të gabuara. Mendimi më i përhapur, që në lidhje me origjinën e toponimit në vështrim zotëron, është ai që prejardhjen e tij e nxjerr të dalë nga mbiemri i *kuq* i shqipes, duke menduar se kemi të bëjmë me një truall *të kuq*.⁵ Një mendimi të tillë i mbahet edhe P. Skok⁶. Ç’është e drejta, edhe vetë jemi lëkundur saherë që është dashur të marrim qëndrim në lidhje me prejardhjen e këtij toponimi. Por, kur merret puna e këqyret më imtas dhe në mënyrë të shtjelluar, del se ekzistenca e apelativit *kuç*, por jo i *kuq* në gjuhën shqipe ka kuptim “një lloj kuthi a vorbe me dy veshë, dhe emër vendi i ngulur në një gropë, në një luginë, emër që i përgjigjet vorbës e vorbëtinës”. Nga vështrimi i apelativit *kuç* (vorbë, kuth) u motivua më vonë një kuptim metaforik me ç’gjë shkoi e u zgjerua fusha semantike e tij.

⁴ H. Inalcik, Süreti Defteri Sancaki Arvanid, Ankara, 1954.

⁵ Jireček, Die Romanen, Süffay, Acta Albanica, I, 789; Apxub, II 1981, Jokl, Archivum Romanicum, XXIV.

⁶ Etimologijski rječnik hrvatskoga ili srpskog jezika, II, 219.

Te ky emërtim (Kuçi) ka mbetur për t'u shpjeguar edhe diçka tjetër: tek apelativi *kuç* edhe emërtimi topik *Kuçi* përmbahet afrikatja ç, por jo paraqie llzorja q (ć), në të folmen shqiptare të këtyre viseve këto dy bashkëtingëllore dallohen prerazi; fonemat e zënë ngojë të këtyre të të folmeve shqiptare në zonat kufitare s'kanë pësuar sheshime sikur në disa ligjërime të tjera gege, porse për hir të së vërtetës do thënë se nga ndikimi i dialekteve malezeze të serbokroatishtes formimi i tyre bëhet jo atje ku zakonisht ato përftohen në pjesën më të madhe të dialekteve shqiptare. Duke përfunduar ç'thamë për emërtimin e Kuçit, atë do ta lidhim me apelativin *kuç* me të gjitha vështrimet që ka, në mënyrë të veçantë me kuptimin e tij metaforik, pra me *kuçe* jo i *kuq*.

Kur dihet se emërtimi Kuçi dhe shumë emra të tjerë në trevën e zënë ngojë kanë karakter të gjuhës shqipe, atëherë dalin vështirësi pothuajse të pakapërcyeshme në punë të pajtimit me pohimin e disa studiuesve etnografë dhe historianë (Erdeljanović, Filipović, Čubrilović) që, fjala e tyre, në Krahinën e Kuçit të sotëm, s'janë vërtetuar gjurmë të barinjve shqiptarë deri nga mbarimi i shekullit XIV dhe nga fillimi i qindvjetëshit XV kur serbët, pas mendimit të tyre, kishin formuar qarkun e tyre administrativ fisnor – një njësi territoriale malore të tyre dhe rrjedhimisht, do të shtrohet një pyetje, qysh e bën edhe prof. Gjurgjev me plot të drejtë, si bëhet që kuçët nuk u quajtën, nuk e morën emrin- “malorë”, sipas emërimit të krahinës së tyre?!

Do të ndërhyjmë edhe për emërtimin e ujit Šaljeza, Šaljeza, shqip *Shalëza*, që Erdelanoviçi e kishte regjistruar në Cucat e Nahijes së Katunit. Në këtë nahije, sikundër duket, nuk ka aq gjurmë të gjuhës shqipe. E do të ndërhyjmë me qëllimin që ta hedhim poshtë mendimin mashtrues të ngulitur sipas të cilit ndërmjet fjalës *shalë* (shalë kali) dhe asaj *shalë* – “*Borrage officinalis*”, pastaj Shalë-s-një emër i fisit, shqiptar në Shqipërinë VeriAKE, dhe të Mitrovica e Kosovës, si dhe Shalë-s- emërtim i shpeshtë i lumenjve apo i fshatrave – paska farefisni apo birëri gjuhësore nga se, që të gjitha u dashkan çuar te huazimi latin i shqipes – *shalë* (sella). Kur lihet jashtë *shala* e kalit, që të gjitha format e tjera do të përmbliidhen tek ape-

lativi *shalës* dhe *shalëz* – aq të përhapur në gjuhën shqipe – e para me vështrim kuptimor “njëfarë dheu që del edhe në trajtën *salcë* (ajo arë asht *salcë* e bardhë). Shprehjen e hasim edhe në formën e *shalësinë* (tokë mashkullore, jo e gratshme), që është e gjallë, si në emra visesh, edhe lumenjsh, si edhe në leksik – e pajisur me formantin – toponimik – *në*, sikur te *baltinë*, *djerrinë*, *ligatinë*, me këtë formant sajohen emrat e vendeve – nomina loci, me ç’gjë përforcohet kuptimi i fjalës bazë. Forma e fjalës *Shalës* në instancë të fundit, çohet te e shqipes *shalë*, që gjëllin vetëm në emrin e Krahinës së Shalës dhe në shumë emra arash, kullotash, etj. të viseve Veriore dhe Jugore të Shqipërisë. Për historinë e gjuhës shqipe është me rëndësi të dorës së parë të vihet në dukje, që emërtimet me kuptime të ndonjë farë dheu, janë formuar në mbështetje të fjalëve me rrënjë, që në krye të herës kishin vështrime: “pres, çaj, veçoj” nga fusha e shqipes të krahasohen: *deltinë*, *daltë*, *daltim*, *daltoj*”; prej gjuhësh të tjera *caementum* “çimento” e *caedo* “godit, këpus, ther”. Në fushën e shqipes kjo *shalë* e *Shalës-it*, nga pikëpamja etimologjike është një me emrin e bimës *shalë* “*Borrago officinalis*”, lidhet me toponimin *Shalë*, si dhe me i çalë; piqet më tutje edhe me çel e me *mëshel*, *mbërshel* “mbyll”; në një vijë më të largët edhe me *halë*, *hell*, e *hollë*, *huall*, *hojë*.⁷

Sa i përket Erdelanoviçit, ishte gjë e padyshimtë, se ai, mbi dëshminë e mangësisë së tij në punë të çështjeve etimologjike, do t’i mbahej mendimit të Gustav Meyerit kur është fjala për burimin e *shalë-s* (shalë kali) dhe të shalë-s, Shalës, me të gjitha vështrimet e tyre.⁸ Prej këndeje, nuk mund të pranohet ngulmimi i tij, që prejardhja e emrit Šaljeza të nxirret nga rumanishtja, duke mbajtur qëndrimin kundër burimit të tij nga shqipja për mungesë kujtimesh për barinjë shqiptarë që në ato kohë silleshin nëpër Nahijen e Katunit, për të cilët edhe ai vetë flet në veprën e tij të njohur.

Ka dëshmi mbi verimin e barinjve vllah dhe shqiptarë në bjeshkë të Nahijes së Katunit. Vetë Erdeljanoviçi, në veprën e tij Stara Crna Gora, kishte regjistruar një numër të mirë emrash të vendeve, sikur janë Čava, -

⁷ Çabej, *Studime filologjike*, 1966/1.7-9.

⁸ Stara Crna Gora, 623.

një rrafshnaltë a pllajë te Llovqeni; ky emër topik është shumë i shpeshtë në Mal të Zi, Malësitë e tij dhe në Zetë; serbët e Kuçit, thotë Erdelanoviçi, këtë emërtim ia përkthenin atij në këtë mënyrë: “*Kryth, Kryeth*. Kodrë, majë qafë”; pastaj *Krusa Glavica, Krusi dolovi* (Krythi, Krythi i Lugut; - në krahun perëndimor të Lugut (Ržani Do) gjendet një lug që mban emrin Štek Shtek) – “grykë mali, qafë mali, pastaj Steci-lagje në Leshanska Nahija; përdoret mandej edhe si patronim Stekoviçi, dhe si emërtim i fiseve të Vitasoviçët; ka pastj *Arbanaška medja* në juglindje të Cetinës. Mandej Arbanaški Do, gjithashtu në juglindje të Cetinës dhe të Vrellave; *Djinov Do, Djinova Glavica, Djinovo Brdo* (Kodra e Gjinajve, - në fushën e Cetinës, Djinović (Djinajt lagje e fisit Kosier.

Përsa i përket burimit të toponimit të zënë ngojë të emërtimit *Šteke, Šteci* që Erdeleanoviçi i kishte regjistruar te Nahijet Lješanska dhe Katunska, ne nuk e gjejmë të nevojshme të gjykohe mi, sepse për ne është krejt e qartë se kemi të bëjmë me një apelativ të shqipes, nga shprehja *shteg, shtek*, shumësi *shtigje*, nga njëjësi i së cilës *shtek*, në dialektin malazez të serbokroatishtes na qenka formuar në šteke apo šteci (Šteke, Šteci) – me kuptim “shtigje, shteg mali, qafë mali, kapërcell”.

Tashti do të përpiqemi t'i shpjegojmë rastet e përfillura *Krusa Glavica, Krusi Dolovi*, që si emërtime të fshatrave paraqiten në rrafshin e Ulqinit në trajtën *Krute* (Kryth). Që të gjitha format e sjella këtu sipër do të çohen (përmbledhen) tek apelativi si bazë *kryeth, kryth* (glava, glavica), - si rrjedhojë toponimike e pajisur me formantin sufiksial *-th*, bash sikur na del në të folmet malazeze (*glava+ica*), që do të jetë riadaptim fonetik, i fjalës shqipe *kryeth, kryth*. Në punën e adaptimit të këtij emërtimi do të vihet në dukje një gjë që spiranti ndërthëmbor *-th*, në të folmen malazeze është kthyer në sibilantin s, sikur vërtetojnë raste të shumta: *frûs* – nga *fruth* i shqipes në rumanishten *cursa* nga sh. *kurthë, sarbad, shq. tharbët*.

Erdelanoviçi, si jo ekspert që ishte në punë të gjurmimeve etimologjike, përqafoi pa ngurrim mendimin e Jireçekut në lidhje me zanafillën e emërtimit *Krus* prej latinizmit *kryq* (lat. *crux*) të gjuhës shqipe, megjithëse në hartat e shtatmadhorisë austriake shënohej *Krûs* (Krys), që

Erdelanoviçin mund ta përudhte në drejtim të duhur për t'i rënë në të burimit të emërtimit në fjalë, ai, në hetimin e tij u largua duke gjykuar kështu: “Ka mundësi që në kohë ne verimit të barinjve vllëh dhe shqiptarë në fushat e Cetinës dhe rreth saj, të ketë pasur atje një “kruq” në mbështetje të të cilit u quajt nga barnjtë e përmendur i gjithë ai vend *Krus*, të cilin emërtim e rimori pastaj popullsia e mëvonë sllave”.

Në Nahijen Ljeshanska ka diçka më shumë emërtime toponimike me gurrë të shqipes: Brina, Golemadi (Golëmadhi) emër i një fshati në Ljeshanska, Brigje (fshat në Ljeshanska dhe një lagje e tij), *Kruset*, e *Sipërme*, *Kunje*, *Kunji i Poshtëm* (mal dhe një farë dheu në Dugi Dol; një majë në kufirin e Ljeshanskës, në Zagaraçin e Poshtëm. *Sukeza* (katund), *Suka* (kodër) në kufirin e Kumanit me Bjellopavliq; *Qeret* (katund në Zagaraçin e Poshtëm; *Grope* (lugina në Zagaraç; *Gropeza* (një anë e fshatit Rvsh; një Grykë në Bjelloshë; Grop *Gropa* – emërtim në përdorim të shqiptarëve të Kuçit për lugina, gryka, hepe⁹ etj.

Për hir të së vërtetës, do të themi, neve në këtë mes, përveç numrit të toponimeve jo sllave, na intereson prejardhja e tyre, prandaj do të rrahim t;ua gjejmë burimin më të pranueshëm, aq më tepër se përpjekjet e Erdelanoviçit në punë të zgjidhjes etimologjike të sa e sa antroponimeve, patronimeve dhe toponimeve, nuk dhanë rezultate të kënaqshme.

Së pari, do të meritonte, ndoshta, vëmendjen tonë, nga pikëpamja e problemit që ngërthen në vete, toponimi *Suka*, *Sukeza* (kodër, katundth); në lidhje me të njëherë do të themi se ky toponim ndeshet kudo që ka popullsi shqiptare të krahinave gege; së dyti t'u shtojmë këtyre fjalëve se këto emërtime kanë lidhje të pandëmjeshme me çukë (një apelativ i përhapur në të gjitha gjuhët e Ballkanit), dhe se treti do të tërheqim vëmendjen se forma *çukë* është një fjalë e kryehershme, sepse në pozitën e saj nistore ka afrikatën ç, nga e cila, në rrjedhën e kohës mori e u përftua sibilanti s, sikur të shembujt: (*çukë-sukç*), rum, *cióra shqipe sorrë*; sllav, poručiti – porosis; *čuln* – sule. Do të themi, gjithashtu, se *çuka* përdoret

⁹ Erdeljanović, vepra e përmendur, Regjistri 799.

përgjithësisht në të folmet toske, ndërs *suka* në ligjërimet gege.

Sa i përket prejardhjes së saj, mendimet e linguistëve janë të ndryshme.

Në punë të etimologjive të disa emërtimeve të toponimeve të Mal të Zi as Šufflay s'ishte ndarë në shenjë (s'ishte dalluar), ç'është e drejta, ai (Šufflay) pasqyron gjendjen e studimeve etimologjike të ne dhe gjetkë. Sikundër ai, edhe të tjerët, toponimin e Kuçit e bien të dalë nga gjuha shqipe, prej mbiemrit i kuq, Arhiv, II, 198; ndërsa emërtimet e toponimeve, *Fundina* dhe *Kuruse* i nxjerrin me burime të gjuhëve romane, mbijetime të tyre (Arhiv, II, 231). *Fundina* del edhe me shqiptime të tjera: Fundina, Fundëna. Ky i fundit, me gjasë, paraqitet më drejt, një gjë që i pari e persiati Milorad Stijović me rastin e redaktimit të veprës së Mark Milanit: Pleme Kuçi u narodnoj priči i pjesmi (II 1967), me ç'hov shkruante: “Kur është fjala për emërtimin e toponimit *Fundëna* nuk ka mbështetje mendimi sipas të cilit ai duhet të ketë rrjedhje latine, nga fjala *fontana*. Me anë tjetë në gjuhën shqipe nga apelativi i saj *fund*, shumësi formohet *fundena*, *fundna*, që që fushën e onomastikës (Fundna), do të thotë krah i një krahine, sllav. Krajina, qysh edhe quhet në këtë gjuhë”. Kësaj rrjedhje të emërtimit *Fundena* i shtojmë që ai është përftuar duke iu ngjitur fjalës bazë mbaresa e shumësit – *na*, që duket te një numër emrash toponimikë: Karpënkarpë; Lisna, nga lis-shm. Lisna; Kishën, nga Kishë-shum, rrjedhimisht edhe Funderna nga fund-shum. *fundna* që ishte i regjistruar më 1402 edhe si *Fund'na Bishtna*, nga bisht-bishtna regjistruar në Malësi.¹⁰

Pak më sipër e zumë ngoje edhe emrin e fshatit dhe të një krahu të tij *Bride* dhe në lidhje me të shtrojmë pyetjen si është formuar trajta e shumësit të tij (Bride-Brigje). Pas mendimit tonë, këtu s'ka fushim, forma e këtij toponimi (Bride) është përftuar nga e shqipes *breg* shum. Brigje pra, *Bride*, qysh përdoret për të emërtuar një fshat dhe një krah të tij në Mal të Zi, është, sikundër thamë, një shumës par excellence, i formuar sipas

¹⁰ E. Çabej, *Lingua Posnaniensis*, VII, 1959, VIII, 1960; *Shumësi singularizuar në gjuhën shqipe*, Tiranë 1967.

modelit të ligjësiive gjuhësore të shqipes: *breg-brigje*; në të folmet malazeze të serbishtes do të kishim *breg* e *brege* apo *bregovi*; sikur e pamë pak më sipër: *štek*, sh. *Šteke*, *Šteci*, *kurrë* e asnjëherë *Štide* nga pikëpamja e ligjeve gjuhësore të serbokroatishtes.

Krahina e Kuçit është qëndisur gjolla=gjolla me emra toponimikë sllavoshqiptarë: *Gura* (një greqizëm shih *gurrëgurna*; një burim në Oraho-vë të Malit të Zi; *Rogami* është një emër mali, ndërsa *Rogame* – emër fshati ndër Pipërit, që përmendet qysh më 1455; *Roge* vend ku Kuçët mbli-dhen për të kuvenduar e pleqëruar. Patronimi *Rogami* dhe toponimin *Rogamë*, *Rogame* i gjejmë në rrethin e Shkodrës dhe të Malësisë, *Roga*, *Roga* si emër na del shpesh në hartën topografike të Shqipërisë. Fjala *rogë* dhe toponimi *Rogami* – i zgjeruar me formantin-*amë*, nuk mund të jetë i kryehershëm, sepse *g-ja* e tij ndërvokalike, po të kishte ai moshë të madhe, do të zhdukej me kohë. Emri topik *Rogomi* zbërthehet në *rogë* dhe formantin-*amë*, e tema e tij del një deverbativ nga *rruaj*, *rruej* (pastroj mirë sipërfaqen e diçkaje, e apelativi *rogë* ka këtë fushë semantike: “lëndinë me bar në mes të pyllit a në faqe të malit; vendi i zhveshur në mes të pyllit: 2). Pjesë e zhveshur ose i rjepur; pyll, larë”. Në truallin e Malit të Zi emër-timet *Roge* janë të shpeshta që rrjedhin prej toponimit dhe fjalës shqipe *Roga* – *rogë* (proplanak, ledina). Ato, në të shumtën e rastëve, përdoren në shumëse: *Briske* (nga *brisk*), *Brisk*, *Brisku* i Poshtëm) *Ripe*, *Bride* (në gjuhën shqipe – me përdorim në shumës, që ka zënë vend edhe në ligjë-rimet malazeze).

Në vazhdim po marrim në vështrim emrin topik *Bushat* që e gjejmë të regjistruar në krisobulat e Deçanit, II, III¹¹, pastaj na del si emër fshati ndër Kuçët dhe Pipërit.¹²

Një numër i mirë fshatarsh në Shqipërinë Veriore mbajnë emrin *Bushat*; si patronim na del në emrin e një bariu: Gjon Bushati; në rreth të Tuzit nga viti 1335 (Acta Albaniae, II, Nr. 798) dhe Michele Bossato, 1376.

¹¹ M. Grković, Imena u Dečanskim hrisovuljama, 48, 73, 164.

¹² Marko Miljanov, Pleme Kuči u pjesmi; red. Milorad Stojičić, Titograd 1967.

Nopcsa (Geographie und Geologie Nordalbaniens, 125-245), përveç Bushatit në Zadrinë, përmend edhe *Bregu Bushat* – një emër i një shpati të Malit të Traboir në Hot. Disa emra të tjerë, topikë e sqarojnë mirë kuptimin toponimit të sipërm: Bushati i Mithajt – quhen tokat e këtij katundi, në Nikaj na del *Bushati i Nikajt*, në Lumë Bushati i Bicajt; afër Tiranës Bushtat quhej një koriçe (zabel); te Logoreci e Manni kemi *bushat, bashat* “*pasuri toke, selishte, bashinë*”, te Godini-bushatë “*çiflik; tokë bushate – “tokë pjellore*”. Kuptimi i përgjithshëm i fjalës sonë, siç po duket, është “*tokë, tokë buke*”.¹³

Do t'i sillemi apelativit *bushat* si dhe antroponimit *Bushat* nga pikëpamja e burimit të tij.

Erdelanoviçi, me sa dihet, s'e kishte rrokur toponimin *Bushat* nga pikëpamja etimologjike e tij, atëherë kur në fillim të këtij shekulli kishte zënë të mblidhte material etnologjik në viset e Kuçit. Analizën etimologjike të toponimit dhe të apelativit tonë *Bushat, bushat, bushat* e kishte bërë bard i studimeve etimologjike të leksikut të shqipes E. Çabej (Studime etimologjike në fushë të shqipes, II, (A-B) Tiranë 1976, 393). Këto kohët e fundit, Milica Grković, në veprën e saj këtu të përmendur, *Imena u Dečanskim hrisovuljama, (Emrat në krisobulat e Deçanit)* në disa vise të tyre kishte zënë ngoje antroponimin *Bushat*. Në kategorinë e emrave me etimologji sllave, me rrënjë – *bud*, “*vigilare*”, ajo, përveç shembujve të tjerë me mbaresën-at, kishte vënë edhe antroponimin e toponimin *Bushat* (op. cit. 48, 73, 164). Mirëpo, shtjellimi i përimtuar i antroponimit dhe toponimit *Bushat, bushat* nga ana e Çabejt, siç po duket sheshazi, asaj nuk i jep të drejtë, sepse nuk është fjala për bazën sllave *bud*, as kemi të bëjmë me formantin – at. Gjithë ajo fushë semantike që ka apelativi ynë në gjuhën shqipe, si dhe shtrirja e tij gjeografike, që të gjitha ato burimin e saj e përdhin, e çojnë te gurra shqipe. Rrënja e apelativit tonë, siç dëshmon analiza e Çabejt, shpie në një arkepit të kryehershëm, -*shat* dhe *fshat*, të cilit i është ngjitur formanti-*mbë, bë*-duke u kthyer

¹³ E. Çabej, *Studime gjuhësore, I*, 85, Prishtinë, 1976.

gjysmë vokali në *u*: *Mbëshat, bëshat, bushat, Bushat-analogjikisht* kemi – shij, fshij, mëshij; *mbëshij* njësoj te Bushale – Shalë – zgjeruar me prefiksin morfemor-*mbë bë-* (Çabej, vep. cit).

Mbi prejardhjen e emrit të lumit *Lim*, që buron prej Liqenit të Plavës, rrjedh nëpër krahinat e Malit të Zi dhe derdhet në Drinë te Vishegradi (bën gabim P. Skok – në fjalorin e tij të kroatishtes e të serbishtes ku thotë se Limi kalon nëpër Hercegovinë, një mendim i rimarrë nga fjalori i Vukut), “Ka dy gjykime të kundërta; i pari është shprehur nga E. Çabej,¹⁴, sipas të cilit emërtimi në fjalë do të ketë buruar nga folja e shqipes *lyej*, që ka një pjellori të rrallë zhvillimi: tëlyen, tëlyer, lez, lezmë, lyth, lyerth, lym, dhe *lim*. Një mendim tjetër mbronte romanisti dhe ballkanologu P. Skok tek etimologjiski rječnik hrvatskog ili srpskoga jezika, II), i cili i mbahej gjykimit të Norbert Joklit -¹⁵ dhe në punë të prejardhjes së emrit të lumit *Lim* shfaq bindjen se ai duhet të çohet te shkalla e hershme indoevropiane *lei* (sllav. liti, me formantin *-m* dhe i mbahet me ngulm mendimit se nuk ka të bëjë me fjalën *lumë*. (Skok vep. cit. 305).

Mendojmë se baza nga e cila niset linguisti shqiptar Çabej qëndron në këmbë jo të sigurta edhe nga pikëpamja e vërtetësisë gjuhësore dhe logjike. Është vështirë, për të mos thënë e pamundshme, që nga nocioni që në fushën semantike të gjuhës del me kuptim *tëlyen* (lyej), lyth, lyerth, lez, lezmë, të jetë përfutur emërtimi i lumit; përkundrazi, nga vështrimi që shënon diçka që rrjedh me shkulum, diçka që shkulumon, hedh valë, kur hidhet vera në gotë apo nga një fuçi tjetër; nga ujis, njom, vadit, - është krejt e logjikshme, pra, të ketë shumë më tepër gjasa formimi i shprehjeve që përmbajnë domethënien e lumit.

Emri i katundit *Çeret* (në Zagaraçin e Poshtëm) është identik me emërtimin e aq të shpeshtë nëpër vise me popullsi shqiptare, në krahinë ku rriten shkurret, dushqet e lisnajat. Në këtë mes është me rëndësi të vihet re se emri i këtij toponimi është një rrjedhojë nga fjala bazë *qarr* e zgjeruar

¹⁴ *Studime etimologjike në fushë të shqipe, I, 1982, 76, 95.*

¹⁵ *Studien zur albanesischen Etymologie und Wortbildung, Wien, 1911.*

nga sufiksi-latino-roman *-etum*, që del në tria gjuhët ballkanike: në shqipen, dalmatishten romane dhe në rumanishten me vështrim oronimesh që tregojnë vendin ku rriten një shumicë drunjsh a bimësh që tregon fjala primitive: në truallin e shqipes: kashnjet (*castagnetum*), kallmet, (kallm), shkozet (shkozë), shkorret (shkorre, shkurre), shelqet (shelg, shelk).

Shpeshherë, edhe më parë, e kishim shprehur mendimin tonë në lidhje me burimin e hidronimit *Ombla* te Gruzha e Dubrovnikur, me ç'rast, zakonisht, nuk kemi mundur të pajtohemi me përfundimin që nxirrej në lidhje me prejardhjen e këtij hidronimi. Meqenëse, pala tjetër me ngulm mbron mendimin e vet, duke mos mbajtur parasysh gjykimin e lagjes tjetër, po lejohemi që me këtë hov të shtrojmë pikëpamjen tonë. Edhe me këtë rast nuk e gjejmë të nevojshme mendimit tonë të mëparë t'i shtojmë ndonjë send; veçse duam të tërheqim vëmendjen mbi shpjegimin – e propozuar më herët.

Ombla është një emërtim i ri i lumit Trebishnica (Trebinje), që hyn në dhe e del prapë te Gruzha e Dubrovnikut me një emër tjetër (*Ombla*). Emërtimin *Ombla* e gjejmë te Korpusi Monumenta Ragusina I-II, e italisht shfaqet me shumë trajta: *Ombula*, *Ombla*, *Umbla* *Ombola*, *Vimbola*. S'ka dyshim se të gjitha këto trajta duan lidhur me shkallën e vjetër të fjalës *obl* me kuptim “burim” e që në të folmet e sotme serbe e kroate shqiptohet *ubao*, forma mesjetare *ubli*, *bullg*, *vebel*.

Nga sa u tha më sipër këtu kemi të bëjmë me përfaqësimin e shprehjes sllave *obl* me një ndërmjetësim të huaj, me ndërmjetësimin e dalmatishtes romane, ku ishte ruajtur shqiptimi nazal i formës së kryehershme. Në trajtën e saj të sotme, këtë shprehje e ndeshim mjaft shpesh në zonat bregdetare, në Mal të Zi dhe në vise të tjera të Jugosllavisë: “*Ubao*”; në të folmen e shqiptarëve të Malit të Zi e kemi regjistruar trajtën *Ubël*, “gurrë, burim, vorbull”.

Shpjegimit të etimologjisë së toponimit sllav *Ombla* nga shqipja *ambël*, *âmbła*, *ombla*¹⁶ i bien ndesh pengesa të pakapërcyeshme, sepse për

¹⁶ Çabej, *Studi si cercetari lingvistice 1959/4*, 52 f. 560; *Buletin*, Tiranë 1963/3.

të emërtuar ndonjë gurrë, burim ose vorbull nuk mjafton vetëm cilësori *ambla, ombla*, që në këtë rast përcakton një tipar të ujit të burimit, a të fjalës kryesore, që duhet të jetë e pranishme, krh. Gruemirë, Gurakuqi, Gurabardhi, Gurazi, Kryezi, Bukëmirë etj.

LITERATURA

1. *Regjistri i kadastrës dhe i koncesioneve për rrethin e Shkodrës* (1416-1417), (Akademia e Shkencave e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, Tiranë 1977).
2. *Milica Grković: Imena u Dečanskim hrisovuljama*, Novi Sad 1983.
3. Selami Pulaha, *Popullsia shqiptare e Kosovës*, Tiranë 1984.
4. Jovan Erdeljanović, *Stara Crna Gora*, Beograd 1926.
5. Milan Šufflay, *Srbi i Arbanasi*, Beograd, 1925.
6. Milan Šufflay, *Povijest sjevernih Arbanasa, Arhiv za arbanasku starinu, jezik i etnologiju*, knj. II (1924), Beograd 1925.
7. Petar Skok, *Etimologijski rječnik hrvatskoga ili srpskoga jezika*, II, Zagreb 1972.
8. Eqrem Çabej, *Elemente vendëse në terminologjinë gjeografike malore në gjuhën shqipe*, Studime filologjike 3/79, f. 31-47, 47-49.
9. Marko Miljanov, *Pleme Kuçi u narodnoj priči i pjesmi* (priredio Milorad Stojović), Titograd 1967.
10. Eqrem Çabej, *Lingua Pasnaniensis*, VII (1959), VIII (1960); Alb, vise "Orte, Plätze" und die singularisierten Plurale im Albanischen 145-200, 71-132.
11. Eqrem Çabej, *Shumësi i singularizuar në gjuhën shqipe*, Tiranë 1967.
12. Eqrem Çabej, *Studime gjuhësore II*, Rilindja 1976.
13. Eqrem Çabej, *Studime etimologjike në fushë të shqipes II* (A-B) Akademia e Shkencave e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, Tiranë 1976.
14. Eqrem Çabej, *Studime etimologjike në fushë të shqipes I*, Tiranë 1982.
15. Idriz Ajeti, *Studije iz Istorije albanskog jezika* (Akademia nauka i umetnosti Kosova) Prishtina 1982.

*Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare 12,
Prishtinë, 1987*

MBI ORIGJINËN ILIRE TË GJUHËS SHQIPE*

Jeta e përbashkët me shekuj e popujve tanë në territorin e Si-ujdhesës së Ballkanit, gërshetimi i kulturave të tyre, ndërthurja e gjuhëve, përthyerja e kulturave të popullsive antike në kulturën autentike të popujve tanë të sotëm, krijoi dhe formësoi, mund të thuhet, një veçori të përbashkët në kulturën e tyre, përkime dhe përgjasime në gjuhën e tyre, kështu që mund të flitet për një tip ballkanik të kulturës, për një lidhje gjuhësore ballkanike.

* Version i lexuar në Kongresin IX të LK të Serbisë, 1982. Në Kongresin e nëntë të Lidhjes Komuniste të Serbisë, të mbajtur në Beograd në vitin 1982, në të cilin merrja pjesë edhe unë, lexova një paraqitje në lidhje me disa probleme të gjuhës letrare shqipe, me historinë e kësaj kombësie, mbi tekstet e botuara në Enciklopedinë Jugosllave, që bënin fjalë mbi tekstet e letërsisë dhe kulturën e shqiptarëve në Jugosllavi. Pas pak ditësh, nga Zagrebi erdhën kërcënime me letra anonime për akademikun Idriz Ajetin:

“Sada imate posla sa nama. \\ Vi cete biti srećan čovek jedino u Albaniji \\ U zemlji odakle ste i došli! \\ Sutra je u pitanju \\ A noć je duga i \\ Za Vas i za Vaše najdraže!

(Tash keni punë me ne. \\ Ju do të jeni njeri i lumtur vetë në Shqipëri \\ Vendi prej nga keni ardhur! \\ Çështja është për nesër \\ Ndërsa nata është e gjatë edhe \\ për Ju edhe për më të dashurit Tuaj!)

P
SADA IMATE POSLA SA
NAMA. VI CETE BITI
SREĆAN ČOVEK JEDINO U
ALBANIJI U ZEMLJI
ODAKLE STE I DOŠLI.
SUTRA JE U PITANJU
A NOĆ JE DUGA I
ZA VAS I ZA VAŠE
NAJDRAZE!

2 | C
2 | C

Meqë e kemi më të afërt këtë problematikë të themi nja dy fjalë për njësinë gjuhësore ballkanike. Është fare i pranueshëm mendimi sipas të cilit kjo njësi gjuhësore ka mundur të krijohet vetëm në një hapësirë të kufizuar, gjë që i shkoi për shtat krijimit të kategorive të reja gjuhësore në disa gjuhë ballkanike: në greqishten, në rumanishten, në shqipen, në maqedonishten, në bullgarishten, pjesërisht në serbokroatishten dhe në sllovenishten. Ajo që karakterizon njësinë gjuhësore të disa popujve ballkanikë është i ashtuquajtimi analitizëm: zhdukja e rasave, dyfishimi i përemrave, krahasimi analitik, dyfishimi i objektit, zëvendësimi i paskajores me lidhore, paraqitja e nyjës në të gjitha gjuhët e lidhjes gjuhësore ballkanike, shprehja e futurit me “do”, përzjerja e shprehjeve për qëndrim dhe lëvizje.

Ky analitizëm gjuhësor, siç thamë, ka mundur të krijohet në një hapësirë të kufizuar të Siujdhesës Ballkanike, pikërisht për shkak të përzjerjeve të gjera dhe të shumanshme mbimesatare.”Konsiderohet kryesisht se njerëzit, që i kanë mësuar gjuhët e fqinjëve të tyre vetëm sipërfaqësisht, aq sa kanë pasur nevojë për t’i zgjidhur çështjet praktike, kanë folur në mënyrë analitike, sepse analiticiteti është veçori e çdo polinguizmi të papërsosur. Njeriu, që gjuhën e huaj nuk e njeh mirë e e flet me guxim, të folurit e tij e rrudh në një numër të vogël kategorish duke mos mbajtur parasysh finesat dhe ngarkesat e asaj gjuhe të huaj”. Gjuhëtari i njohur serb Pavle Iviç këtë fenomen e përkufizoi kështu: “Kontaktet e afërta shpesh kanë për pasojë thjeshtësimin e sistemit. Nëse kryqëzohen një sistem më i ndërliqshëm me një sistem të thjeshtë rezultati anon nga tipi më i thjeshtë... edhe në rastet kur kryqëzohen dy sisteme të ndërliqshme të ndryshme, janë gjasat që përfundimi të jetë më i thjeshtë seç janë këto dy sisteme”. Dr. Irena Grickat lidhur me këtë thotë: “Lidhur me këtë nuk do harruar se folësit të cilët i kanë afruar në këtë mënyrë sistemet e tyre në rastin tonë kanë qenë në radhë të parë blegtorë të lashtë dhe bujq, pastaj tregtarë mesjetarë, zanatçinj, bredhës e të tjera, e të tillët nuk çajnë kokën për normat e gjuhës, siç brengoset njeriu i arsimuar” (I. Grickat, Studije is istorije srpskohrvatskog jezika, 53).

Jam i vetëdijshëm se ky shqyrtim i përimtuar dhe kjo tendencë për ta shpjeguar lidhjen e përmendur gjuhësore ballkanike, për hsumë kend në këtë tubim do të duket i pazakonshëm, ndoshta i tepërt, por mendoja se këtu hetohet një shumësi temash të cilat, përveç interesimit shkencor, përmbajnë në vete edhe dimensionin edukativ, të cilin eksperti s'mund ta lërë anash kurrë. Njohja reciproke e gjeneratës sonë të re me këtë gjendje të gjërave, qoftë edhe në një segment të sistemit tonë arsimor dhe të sistemit të përgjithshëm të të gjitha profileve, i ndihmon detyrimisht afri- mit të bartësve të gjuhëve të ndryshme, ç'gjë anojnë të arrijnë edhe shko- llat tona.

Në shtudimin e kulturës së popullsive të Ballkanit të lashtë rrugët metodologjike duan përsosur vazhdimisht, sepse kemi të bëjmë me një botë të zhdukur në një përmbysje katastrofale. Për këtë arsye vazhdimësia e popujve të sotëm ballkanikë nuk është dhe nuk mund të jetë diçka që kuptohet vetvetiu. Ajo do kuptuar vetëm si problem, e jo si fakt i fortë kështu që vazhdimisht do zhvilluar. Prandaj studimi i së kaluarës dhe i kulturës lillire, për shembull, nuk është, siç ka mundur të mendohej ndonjëherë, vetëm çështje e një rrethi të ngushtë ekspertësh, ilirologësh; e kaluara dhe kultura e ilirëve është pjesë përbërëse e historive kombëtare të kroatëve, të malazezëve, të sllovenëve, pjesërisht të serbëve, dhe, kuptohet, mbi të gjitha të shqiptarëve, për të cilët sot mund të thuhet se edhe shkencërisht të shtë vërtetuar prejardhja e tyre e drejtpërdrejtë nga ilirët e lashtë – thotë profesor dr. Aleksandar Stipčević në librin e tij *Iliri* të botuar në vitin 1974, në Zagreb.

Lidhur me këtë edhe profesor dr. Radosllav Katiçiqi thotë sa vijon: “Në saje të kontributit të gjuhësisë bashkëkohëse krahasimtare, përkatësisht të ballkanistikës, në radhë të parë, shohim se lidhur me prejardhjen e gjuhës shqipe edhe te gjuhëtarët e shquar shpesh ka pasur përfundime të nxitura. Kjo shkencë, siç dihet, ka dëshmuar se argumen- timi kundër prejardhjes ilire të gjuhës shqipe përmes të cilit mendohej se mund të vihej në dyshim mundësia e interpretimit të marrëdhënieve gjuhësore, nuk mund t'i qëndrojë shqyrtimit sado pak kritik që do të bëhej

në dritën e të dhënave përkatëse.

Nuk ka arsye të bindshme gjuhësore që do të na bënin ta hedhim poshtë prejardhjen ilire të gjuhës shqipe. Kjo, natyrisht nuk do të thotë se të gjitha argumentet kundër kësaj prejardhjeje janë të parëndësishme dhe se kjo çështje nuk nxjerr probleme të tjera. Madje edhe vetë hedhja poshtë e këtyre argumenteve ka qenë e dobishme për historinë e gjuhës shqipe dhe për gjithë linguistikën ballkanike. Por, meqë as alternativa tjetër, domethënë prejardhja trakase, nuk mund të dëshmohet me kritere gjuhësore ajo atëherë ka shumë më pak gjasë sakohë që alternativa ilire të mos hidhet poshtë me argumente të forta, sepse i gjithë territori gjuhësor i shqipes është pjesë e territorit të dikurshëm të Ilirisë, së paku në bazë të asaj që ka arritur të njohë shkenca deri sot. Kjo gjë në linguistikën bashkëkohëse ballkanike ka marrë vend shumë të rëndësishëm, me të u vunë bazat e mira metodologjike për çdo shqyrtim të prejardhjes së gjuhës shqipe për arsye të pozitës gjeografike dhe sakohë që të mos ketë dëshmi të kundërta, prejardhja ilire e gjuhës shqipe mbetet më e bindshme”.

Shkrime pa mbështetje për probleme të ndieshme

Pas përpjekjes për kontrarevolucion në Kosovë, shtypi, duke u munduar që të ndihmojë në zbulimin e armikut dhe të japë kontributin e vet në kapërcimin e gjendjes së vështirë, vuri në dyshim saktësinë e disa qëndrimeve në tekstet për shqiptarët në Enciklopedinë e Jugosllavisë. Gazeta e përditshme Politika më 6 qershor 1981 botoi shkrimin në të cilin autori i tij, duke kritikuar pjesën mbi gjuhën, thotë se indikatorëve të gjuhës në të u është dhënë rëndësi joadekuate. Duke lexuar tekstin mbi gjuhën autori i shkrimit në fjalë mendon se është jologjike, e panatyrshme dhe më në fund e pashpjegueshme që disa toponime antike të kenë mundur të formësohen në gjuhën shqipe. Pranoj se është shumë vështirë të hysh në diskutim lidhur me këto probleme linguistike me një joekspert për të cilin gjuhësia ballkanike dhe albanologjia janë fushë shkencore plotësisht e panjohur.

Në studimin e historisë së gjuhës shqipe ka një paradoks e ky është: nga një anë kemi një nga popujt më të vjetër të Ballkanit, nga ana tjetër monumentet e tij të para gjuhësore dalin shumë vonë, vetëm në shekullin XV, ndërsa libri i parë i botuar në shekullin XVI. Kur të kihet e gjithë kjo parasysh, është fare e kuptueshme se në hulumtimin e problemeve të historisë së gjuhës shqipe provat duan kërkuar edhe në faktorë ekstralinguistikë: në toponomastikën e asaj pjese të Ballkanit Jugor në të cilën jetonin paraardhësit e shqiptarëve të sotëm, mos gjindet në të ndonjë dromcë leksikore, ose ndonjë veçori fonetike, e cila do të dëshmonte dhe vërtetonte një shkallë diçka më të hershme në zhvillimin e kësaj gjuhe, periudhë për të cilën nuk ka gati asfarë dëshmie.

Lidhur me vërejtjet e një historiani tonë të njohur duhet të them se problemeve gjuhësore lidhur me tekstin shqiptarët dhe marrëdhëniet jugosllavo-shqiptare, në E.J. u qaset ekskluzivisht nga aspekti historik, duke mos provuar të shohë rrugën specifike të zhvillimit të historisë së gjuhës shqipe. Në vërejtjet e tij lidhur me tekstin mbi gjuhën, ky historian, natyrisht, ndalet në çështje krejtësisht të dorës së dytë, asesi thelbësore. Në tekst, përveç të tjerash, flitet për lëvizjen e ndieshme dhe për fiksimin mekanik të theksit qysh në kohë romake, për çka ai historian bën vërejtje duke pyetur me habi: "Si është e mundur të flitet për gjuhën shqipe qysh në kohën romake, kur gjuha është shenjues etnik i popullit, ndërsa në kohën romake nuk kanë mundur të formohen si etnos, si popull asfarë shqiptarësh". E si do të quhej, pyesim ne, gjuha me siguri e gjallë në kohën romake, në të cilën pikërisht në këtë kohë hyn një fond aq i madh fjalësh të latinishtes lindore, a të romanitetit ballkanik, nëse nuk e pagëzojmë disi? Si do të studiohet elementi gjuhësor indoevropian, përkatësisht lashtogrek, pastaj sllav në këtë gjuhë të paqenë? Po të ndjekim këtë logjikë arrijmë te absurdi se, nëse burimet historike greke apo latine nuk e përmendin, nuk paska ekzistuar bashkësia etnike që e përdorte këtë gjuhë. E nëse ky historian mendon se është shkencërisht e saktë se kjo gjuhë e periudhës romake, që në shekullin XI e këndej do të ketë të drejtë ta ketë emrin shqipe – duhet të quhet ilirishte, atëherë ai a priori merr anën e prejardhjes së saj ilire.

Teksteve të përmendura, pra, edhe atij mbi gjuhën, mund t'u bëhen edhe vërejtje të ndryshme, për shembull tezat mbi prejardhjen e gjuhës shqipe duhet të gjejnë vend në çdo tekst mbi gjuhën dhe prejardhjen e saj.

Çdo trajtim i gjenezës së gjuhës shqipe është njëherësh edhe shqyrtimi i njerës nga çështjet qendrore të gjuhësisë ballkanike, elementet e së cilës studiohen pa ndërprerë ka më shumë se një shekull, e megjithatë ende nuk është arritur të pajtohen shkencëtarët. Kjo është në radhë të parë çështje shkencore dhe zgjidhja e saj pritet vetëm nga shkenca. Ndërhyrja në këtë çështje e të tjerëve, të painformuarve, vetëm mund ta ngatërrojë të gjithë çështjen, ashtu siç ndodhi me çështjen e gjenezës së gjuhës shqipe dhe me shumë probleme të tjera nga fusha e historisë së këtij populli.

Pas tentimit për kontrarevolucion të nacionalistëve shqiptarë në Kosovë, edhe shtypi edhe publicistika nisën të merren me çështjen e krijimit të gjuhës letrare shqipe. Veçernje novosti me 1 e 2 korrik 1981 botuan shkrimin mbi krijimin e gjuhës letrare të shqiptarëve, ku manipulojnë formimin e saj, duke mistifikuar këtë çështje deri në përmasa të përbindshme dhe duke mashtruar në këtë mënyrë lexuesit dhe opinionin, ashtu sikur gjoja kjo gjuhë na qenka imponuar neve shumicës së shqiptarëve, se ajo na qenka variant toskë, e tjera.

Vendosjen e gjuhës letrare e pranoi në mënyrë plebishitare gjithë kombësia shqiptare në Jugosllavi dhe ajo e mëson dhe kultivon atë me dashuri si mjet të pazëvendësueshëm në emancipimin dhe afirmimin kulturor të të gjitha vlerave të saj materiale dhe shpirtërore. Prandaj shkrimin në Veçernje novosti të 1 e 2 korrikut 1982 ajo e priti me indinjatë si shkrim që fyen këtë kombësi, atë që është e shenjtë për çdo popull – gjuhën, formimin e së cilës autori i shkrimit në fjalë e quan lojë.

Studimi i trashëgimisë kulturore – e drejtë e çdo populli

Shqipja letrare e sotme nuk është toskërishte. Ajo paraqet një sintezë në bazën letrare të së cilës janë ndërtuar elemente si të variantit

toskë ashtu edhe të variantit letrar tjetër. Në strukturën e saj janë integruar shumë veçori dialektore të dy variantëve letrare q kishte gjuha shqipe. Sipas disa përlogaritjeve raporti midis këtyre elementeve dialektore të ndërtuara në strukturën e shqipes letrare sillet rreth 13:8, domethënë 13 elemente të toskërishtes letrare dhe 8 të gegërishtes letrare. Pra, struktura e gjuhës letrare shqipe e sotme nuk është shkrirje mekanike e varianteve letrare, po një sintezë e re organike e kësaj gjuhe – e krijuar në një proces zhvillimi historik. Ajo është rezultat i natyrshëm i më shumë se njëqind vjetë të përpjekjeve të dashamirëve, të punonjësve të kulturës dhe të ekspertëve të vendit dhe të huaj, parimi themelor i të cilëve është karakteri konvergjent i elementeve gjuhësore të varianteve letrare të gjuhës shqipe.

Kontributi i ekspertëve dhe i shumë punonjësve të tjerë të kulturës nga radhët e shqiptarëve në Jugosllavi në ngritjen e kësaj gjuhe është evident, e kjo shihet nga marrëveshjet e shumta të ekspertëve dhe punonjësve të kulturës nga viti 1952, 1957, 1963 dhe 1968 kur pavarësisht por në mënyrë plebishitare u vendos që gjuhë letrare e shqiptarëve në Jugosllavi të jetë gjuha letrare që sotë është në përdorim. Zgjidhjen e drejtë të shqipes letrare e bëri të mundshme klima e favorshme në jgithëbashkësinë tonë socialiste vetëqeverisëse, në të cilën vlerësimi të trashëgimisë kulturelle të çdo populli dhe kombësie i kushtohet kujdes i nevojshëm. Mbi këtë bazë i kushtohet kujdes dhe gjuhës si mjet themelor i komunikimit masiv.

Të rrëmbyer më shumë nga entuziazmi se ç'lejonin kushtet e krijuara atëherë (është fare e qartë se këto kushte nuk ishte e mundshme të krijoheshin brenda ditës), ata pak ekspertë, inteligjencia kulturore e teknike i hynë punës dhe qysh në vitet gjashtëdhjetë filloi të shtrihet rrjeti i institucioneve të shkollimit të lartë, kështu që në fillim të viteve shtatëdhjetë themelohet Universiteti i Prishtinës. Gjatë këtyre dhjetë vjetëve të punës ai u ndihmua me gjithë zemër dhe pa kursim nga ekspertët e universiteteve të tjera të Jugosllavisë dhe kështu shënoi një përparim të dukshëm në krijimin e kuadrit të nevojshëm të ekspertëve për ekonominë dhe superstrukturën kosovare. Mungesa e traditës dhe shpejtimi që të kapërcehen shekujt lanë dhe kanë lënë gjurmë të ndieshme në formimin e

inteligjencies humanitare dhe të kuadrit në fushat e shkencave shoqërore. Eksperti i ri i papërvojë, por pretencioz, që nuk e ka mësuar filologjinë lashtogreke, latine dhe lashtosllave e ka vështirë t'ia dalë në krye me sukses punimit të një teme nga fusha e toponimisë historike. Pa njohjen e qytetërimit të lashtë ballkanik është e dyshimtë çdo përpjekje për të ndriçuar qytetërimet e përmendura të Ballkanit të vjetër. Për një ekspert të tillë bëhen gjedhe shumë pseudoshkencëtarë të dyshimtë të cilëve u mungojnë rrugët e qëndrueshme shkencore dhe baza ideologjike, kështu që ai nuk është në gjendje të dallojë shkencëtarin e vërtetë nga pseudoshkencëtari.

Studimi i trashëgimisë kulturore të një populli ka për qëllim që pëveç të tjerash, të dëshmojë vetëmohimet e tij të mëdha dhe qëndresën në mbrojtjen e të drejtave vitale dhe themelore për një jetë të denjë, njerëzore në trevat e tij të gjëra ku jeton me shekuj. Kjo është e nevojshme para së gjithash për ngritjen e vetëdijes së popullit, sidomos të brezit të ri.

Nëse sot ia hyjmë studimit objektiv, për shembull, të Lidhjes së Prizrenit, në asnjë mënyrë nuk mund të aktualizohen kërkesat dhe programi i saj i dikurshëm (të drejtat të cilat kombësia shqiptare – ta përmendim vetëm këtë, i fotio dhe i gëzon sot në gjithbashkësinë jugosllave, e kapërcejnë kërkesat e tilla thelbësisht, jo formalisht, me qindra herë në raport me ato që ofron te Lidhja).

Për shkak të rëndësisë që ka, çdo komb dhe kombësi e gjithëmbashkësisë sonë socialiste do ta studiojë kulturën e vet dhe trashëgiminë kulturore. Por, meqë kjo trashëgimi kulturore është shumë komplekse, e ndërliqshme, ndërthurur, hulumtimi i saj, për shkaka të mungesës së dëshmive historike dhe të burimeve të shkruara, do të bëhet në kushte dhe rrethana shumë të vështira.

Gjatë studimit të ngjarjeve historike dhe historisë së çdo populli tonë në tërësi duhet të kemi kujdes për fillet metodologjike në mënyrë që historia e kombësisë të vështrohet në lidhje me historinë e vendit. Kjo, por me fjalë të tjera, domethënë se çdo histori e një populli patjetër përmban edhe komponentën e historisë së trojeve. Deri vonë kishte paragjykime në rrugët e studimit të historisë nacionale. Historia borgjeze kishte qëndrim

mohues ndaj elementit të trashëguar të botës antike. Një numër historianësh deri vonë në studimet e tyre niseshin nga Mesjeta për të arritur në ditët e sotme. Lagjja tjetër, duke parë gjenezën e popullit të vet në kohë antike në këto hapësira ballkanike, merrej vetëm e vetëm me botën antike dhe me epokën e saj.

Për fat të keq edhe sot e gjithë ditën aty-këtu ka mbetur gjallë një fill drejtimi i tillë në hulumtimin e trashëgimisë kulturore, sepse si mund të shpjegohet ndryshe zhagitja e punëve në zbulimin e një lokaliteti mesjetar te Prizreni? Apo si mund të arsyetohet insistimi i pakuptueshëm që, përkundër ndalesave ligjore në një vend zbulimi arkeologjik te Peja nga periudha ilire, të ngrihet fabrika e re e baterive?

Nëse studimit të trashëgimisë kulturore i afrohem nga pozita shkencore marksiste, atëherë rezultatet e këtij hetimi do të jenë të suksesshme, e kjo do të na ndihmojë shumë në ngritjen e vetëdijes mbi gjithëbashkësinë e kombeve dhe të kombësive tona.

Nëse elementet e përbashkësisë i hetojmë thellë në të kaluarën në jetën e përbashkët dhe në krijimin e tyre, kjo vetëdije ndihmon njohjen reciproke dhe e forcon vetëdijen për nevojën e jetës dhe të punës në përbashkësi.

NJË FUSHATË FILLZEZË KUNDËR SHQIPTARËVE

Në një lak kohe kur studimet albanologjike tek ne po shënonin rezultate të pavëna re deri atëherë, për të cilat po shfaqnin interes edhe studiues të huaj, nisma jonë për të organizuar Seminarin Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, u mirëprit me gëzim dhe shkoj e u bë një bërthamë e mirë studimore, duke vendosur bashkëtakime të përhershme me dashamirë të kulturës shqiptare të botës së jashtme dhe me albanologë, të moshuar e të rinj të huaj, që studimet albanologjike i kultivojnë me dashuri. Ka edhe një faktor tjetër që organizimin e Seminarit tonë e ka shpejtuar: rritja e një armate të tërë studiuesish në botën e jashtme.

Në vitin 1974, kur po zinim t'i vinim në jetë idetë dhe nismën rreth organizimit të Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, zemrat tona mbusheshin me ndjenja gëzimi, në një anë, por në anën tjetër na shqetësonte një ndjenje tjetër: a do t'i dilnim në krye kësaj pune kaq fisnike dhe dobiprurëse në përparimin e shkencave albanologjike? Rezultatet e punëve që ishin kryer flisnin në mënyrë të qartë se rruga e nisur do të vijojej, natyrisht, duke kërkuar vazhdimisht shtigje e forma të reja organizimi të Seminarit. Në ato fillime, me çaste shqetësimesh dhe pasigurie, neve asnjëherë s'na ka lëshuar zemra duke pasur besim të ngulët në traditën dhe në dashurinë që punonjësit e shkencave albanologjike edhe të botës së jashtme kanë ushqyer për degë të ndryshme albanologjike.

Baza a boshti mbi të cilin ishte ndërtuar Seminari ynë lejonte që punimet e tij të ecnin në dy drejtime: së pari ishte vija e nxënies së shqipes me anë të kurseve të gjuhës, dhe së dyti, veprimi i tij përqendrohej në forma të ndryshme studimore të trashëgimit lëndor e mendor të popullit

shqiptar: a) me anë të ligjëratave nga lëmi i filologjisë në kuptimin e saj më të gjerë, dhe b) ciklit të tyre vinte e u shtojnë një cikël ligjëratash nga fusha e zhvillimit ekonomik, shoqëror e sistemor. Formën e tretë të punimeve të Seminarit e përbënte sesioni shkencor, kumtesat e të cilit u sillleshin temave bosht, të zgjedhura nergut për secilin sesion shkencor të Seminarit.

Në programin e atyre viteve kur zumë të organizojmë seminarët e para, ne s'e kishim projektuar sesionin shkencor, si formë pune të tij. Pas sa vjetësh e pamë të nevojshme që në aktivitetin e tij të brendandërtojmë edhe këtë formë pune që sa vinte e po bëhej një formë e gjerë shkencore.

Me temat bosht sesioni shkencor ka rritur të shtronte e të rrihte një mori çështjesh nga të fushave të ndryshme gjuhësore e të trashëgimit kulturor të popullit tonë. Natyrisht, problemet që brezat më të hershëm shkencor të huaj i shtroheshin në mënyrë të theksuar, kanë ndrushuar; para brezit të sotëm shkencor të huaj e shqiptar dalin çështje krejt të tjera. Kemi përshtypjen dhe bindjen bile se brezit tashmë të zhdukur i binte barra të rrokte e të zbrëthente çështje fundamentale të gjuhës dhe të kulturës shqiptare, bie fjala çështjen e burimit, të origjinës së gjuhës shqipe, në të cilën familje gjuhësore bënte pjesë shqipja, karakteri indoevropian i saj, lidhjet e saj me miset e tjera të kësaj familjeje gjuhësore, vendi i formimit të saj, ç'trashëgoi në fushën e leksikut nga periudhat e hershme, elementi huazues i saj, cili është karakteri dhënës i saj, etj.

Kanë marrë zgjidhje të pranueshme e të kënaqshme problemet kyç të fonetikës, të morfologjisë, janë shoshitur një numër i mirë i fjalëve të leksikut të shqipes; janë hedhur poshtë pikëpamjet e mendimet që shqipja na qenkësh një gjuhë gjysmëromane; i janë kthyer leksikut të shqipes një numër i mirë fjalësh të marra për huazime, etj.

Sot albanologjia e huaj e shqiptare ecën në vija të tjera studimi e gjurmimi, duke përsosur e duke përqaftuar metoda të reja studimi; ajo i kthehet gjuhës shqipe, problemeve të brendshme të saj; në studimin e çështjeve gjuhësore, bie fjala nisjet së brendshmi për të dalë, kur e do puna, në sfera të jashtme studimi e krahasime.

Po t'i binim shkurt, do të thoshim, që përfundimet e arritura në 16 seminarët tona, me, pothuajse aq botime të Seminarit, në fusha të gjuhësisë, të gjurmimeve letrare e folklorike – janë të pazëvendësueshme e shumkëpërfillshme, si nga ana e metodave të zbatuara, edhe rezultatet e korrura.

Seminari, që është bërë një manifestim tashmë tradicional shkencor dhe kulturor, brenda 16 vjetëve të punës së tij intensive, ia ka dalë të ngjallë një interes të mirë tek brezi i ri i albanologëve si dhe ndër punonjësit tashmë të njohur në fushën e studimeve albanologjike të Evropës. Nuk do harruar të vihet në dukje se studimet albanologjike kishin zënë fillll – sidomos ato linguistike të shqipes, ndër qendra universitare dhe ndër institute shkencore të Perëndimit evropian – të Vjenës, të Lajpcigut, etj. – diçka më pak në qendrat e tjera të kontinentit të Evropës.

Nuk do harruar se hulumtimet albanologjike tradita të pasura kanë edhe në qendrat universitare dhe në institucionet shkencore jugosllave e ballkanike para dhe pas Luftës së Dytë Botërore, në punë të kultivimit të trashëgimit të ndërsjellë shpirtëror. E udhëheqja e Seminarit tonë është e vetëdijshme për rëndësinë që ai kishte në punë të bashkimit të forcave të reja shkencore në arritje të rezultateve në truall të dijes, në fushë të mirëkuptimit dhe mirëbesimit midis njerëzve dhe popujve – një nevojë aq e madhe kjo sot në këtë botë kaq të shqetësuar dhe nga veprimet shkatërrimtare të forave të ndryshme rrënuese.

Ndër temat bosht të sesioneve shkencore të Seminarit tonë, s'ishin të rralla tema, që rrihnin bashkëtakimet gjuhësore shqiptare – sllave e ballkanike. Përveç kureshtjes thjesht shkencore, që ka në ato bashkëmarrëdhënie gjuhësore, në to shihet vazhdimisht edhe një dimension tjetër – ana edukuese së cilës i është kushtuar përherë një kujdes që e meritonte.

Në vazhdë të kësaj politike, gand e papritur këto ditë nëpërmjet dekanit të Fakultetit Filologjik, udhëheqjes së Seminarit i erdhi një shkresë nga Sekretariati Krahinor për Arsim dhe Kulturë ku shkruhej: “Meqë nga ana jonë nuk kemi mundësi të mbështesim organizimin e Seminarit të sivjetshëm për gjuhën dhe letërsinë shqipe dhe kur mbahet parasysh fakti

se as Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë nuk ka interes për të organizuar një seminar të tillë – në kuadër të marrëveshjeve shtetërore, mendojmë se sivjet nuk duhet të organizohet, pra as të mbahet Seminari XVII për gjuhën dhe letërsinë shqipe, që ishte planifikuar punimet e veta t'i zhvillojë në Gjakovë”.

Komenti ynë – shumë i shkurtër: në paperspektivën kur gjithë populli shqiptar i Kosovës është mbërthyer a ngujuar nga organet policore të Serbisë me qëllim që moralisht ta thyejë, të bëjë ta presë uria, fizikisht ta dërmojë e zhdukë, nuk lë kurrëfarë dyshimi për ta kuptuar cakun e Serbisë zyrtare!

Këto ditë një shkresë na erdhi edhe nga Ambasada Gjermane në Beograd me të cilën na informonte sesi atë që në gjysmën e parë të muajit maj Enti Federativ për bashkëpunim shkencor kulturo-arsimor e teknik e bënte me dije se Seminari i sivjetshëm nuk do të organizohet, pra, s'do të mbahet. Këtu Enti Federativ, me qëllim o pa të ka dalë nga kompetencat e veta, sepse mbyllja e një seminari të tillë është e drejtë e organeve të Fakultetit Filozofik të Prishtinës e jo, aspak e organeve federative. Këtu kemi të bëjmë me cenim të të drejtave....

Më 13. VIII. 1989

AUTOKTONIA E SHQIPTARËVE NGA PIKËPAMJA LINGUISTIKO-HISTORIKE

Bilanci i shtetit “juridik”

Në studimin e historisë së popullit shqiptar dhe të gjuhës shqipe ka një paradoks. Në të vërtetë, nga njëra anë populli shqiptar është njëri nga popujt më të vjetër të Ballkanit, e nga ana tjetër monumentet e para gjuhësore të tij paraqiten shumë vonë – në shekullin XIV, përkatësisht XV, kurse libri i parë i shtypur në shekullin XVI (“Meshari” i Gjon Buzukut – 1555). Historia e gjuhës askund nuk është e lidhur aq ngushtësisht me historinë kombëtare, sikurse ndodh me historinë e popullit shqiptar. E kur jemi te historia në përgjithësi vlen të thuhet se ajo ndaj popullit shqiptar, njërit nga etnosët e rrallë paleoballkanikë që ka mbijetuar dhe ka përballur shumë përplasje, ka pasur qëndrim njerke. Shkurt, historia ndaj tij ka qenë kryesisht e pamëshirshme dhe e pamposhtshme. Prandaj, me të drejtë mund të thuhet se, gjatë shumë periudhave, nuk e ka marrë me të mirë sikurse ka vepruar me të tjerët.

Edhe atëherë kur është dashur të tregojë pjesëmarrjen e tij qoftë edhe të vogël në thesarin kulturor të popujve ballkanikë si trashëgimtar i drejtpërdrejtë i kulturës së lashtë ilire në këto hapësira ballkanike, ajo i ka kaluar të gjitha këto. Në lidhje me këtë, pa kurrfarë mëdyshjeje, gjurmët e kulturës ilire, përmes të parëve të popullit shqiptar depërtuan te kulturat më të reja të popujve ballkanikë, e kjo pasqyrohet në shumë fusha të krijimtarisë. Në qoftë se është fala për marrëdhëniet gjuhësore në Gadi-shullin Ballkanik, duhet të kemi parasysh faktin të cilit nuk i është kushtuar kujdesi i duhur, së paku jo aq sa e ka merituar. Këtu është, para së gjithash, ndikimi i gjuhës shqipe në disa të folme fqinjësore, për çka ata që treguan të parët ishin linguistët sllovenë J. Kopitar dhe Franc Mikloshiç.

Mikloshiç, në studimin e fonetikës historike të gjuhës shqipe (Alba-

nische Forschungen, 1870) ka përcaktuar edhe aso ligjësish vlerën e të cilave e kanë vërtetuar edhe krerët e mëvonshëm të albanistikës si rregull dominuese. Edhe në fushën e leksikut blegtoral nga të folmet shqipe në idioma të gjuhëve të tjera të afërme ka depërtuar një numër i konsiderueshëm i fjalëve të trajtuara si terma deri në ditët e sotme. Nga pikëpamja historike, prejardhja e tyre shqiptare mund të vërtetohet lehtë në qoftë se merret parasysh se blegtoria ka qenë profesion nacional i shqiptarëve, barinj të e të cilëve, duke kërkuar kullota të pasura, fjalët nga terminologjia blegtorale shqipe i kanë bartur në krahina të tjera.

Po sjellim disa fjalë me prejardhje sigurisht shqipe nga terminologjia baritore që takohen në të folmet serbe dhe malazeze: *katun*, *struga*, *strunga*, *balega* (shqip balgë, bajgë, bagël); *hira*, *urda*, *zarica* (shqip dhallë); *shulina* (shqip shëllinë); *barla* “kësulë e punuar me lëkurë deleje; *barzast*, *bardoka* “delja e bardhë” (shqip bardhoka); *balj* – “emër i deles në Hercegovinë”; *bala* “macula frontalis” (Mali i Zi); *balosh*, *balin kokot* “gjeli i bardhë”; *balast* “kau, përkatësisht dhija me lara të bardha në kokë”; *baleshka*, *baloshka*, *balota* “zogu me lara të bardha në kokë” (Vuk, Joviqeviq).

S’ka dyshim se të gjitha format e përmendura, në thelb, kanë trajtën e përbashkët shqipe: *bal* – me domethënien “i bardhë”, larëza (Kuçi, Mali i Zi), përkatësisht larëza “zogu me pupla të bardha që jeton në gur “. Një numër i fjalëve - termave të përmendura, nga pikëpamja e burimit dhe e krijimit të tyre, është e diskutueshme dhe mendimet e linguistëve – kryesisht të ballkanologëve e të albanologëve janë të ndara, meqenëse pozitat bazë i kanë të ndryshme, por numri më i madh i tyre nga pikëpamja e prejardhjes mund të zgjidhet fare lehtë, sepse, pa fije mundimi, mund të arrihet në burimin e tyre.

Duke ndjekur këtë rrugë mund të thoshim se në gjuhën shqipe dhe rumune ka një grup fjalësh prej afro shtatëdhjetë sosh të përbashkëta për të dy gjuhët ballkanike.

Ngjashmërinë e rumanishtes me shqipen e kishin diktuar shumë linguistë në shumë pika të sistemit të tyre të tërësishëm: jo vetëm në të

folur dhe në zhvillimin e tingujve (fonemat), por edhe në strukturën morfologjike, në eptim dhe në fjalëformim, në sintaksën e emrave, të foljeve dhe të parafjalëve, në renditjen e fjalive dhe në topikë, përkatësisht në rendin e fjalëve brenda fjalisë, në frazeologji dhe në shprehjet proverbiale.

Leksikun e përmendur shqiptaro-rumun ekspertët e kanë quajtur substrat, do të thotë fjalor të përbashkët të trashëguar nga dakishtja, përkatësisht dakomizishtja. Ky substrat gjuhësor është shumë i dyshimtë, sepse njohja jonë e trakishtes, përkatësisht dakomizites, është shumë e dobët, për të mos thënë kurrfarë. Në qoftë se është punuar diçka në këtë drejtim, në pjesën më të madhe është merita e linguitit shqiptar Eqrem Çabejt, i cili, në saje të trajtimit metodologjik më real dhe më objektiv pa mëdyshje ka treguar se një numër i mirë i këtyre shprehjeve të përbashkëta leksikore mund të shpjegohet me anë të gjuhës shqipe: ai, në të vërtetë, ka konstatuar se një pjesë e mirë e materialit leksikor mund të zërthehet në komponente përbërëse që pikënisjen e kanë në gjuhën shqipe.

Meqenëse fati i popullit shqiptar vështirë mund të ndahet nga gjuha e tij, ne, edhe në këtë vështrim të shkurtër, do t'i drejtohem gjuhës sepse ajo e përcjell besnikërisht këmba-këmbës veçmas në periudhat kur të gjithë të tjerët e injorojnë. Nuk është thënë rastësisht se historia e gjuhës është njëkohësisht historia e popullit i cili e ka përdorur atë gjatë shekujve dhe e përdor edhe sot e kësaj dite. Megjithëse e rralluar me depërtimin e elementeve të huaja, gjuha shqipe është dëshmitari i gjallë më i besueshëm i shumë ngjarjeve të lidhura me popullin, për të cilat historia nuk e thotë asnjë fjalë.

Gjuha, në rastin tonë gjuha shqipe, për mungesë dhe mospasje të fakteve dhe të dokumenteve historike, ofron një mori të dhënash të sakta mbi vendin e formimit të vet, mbi përhapjen e etnosit shqiptar në periudhën e Ballkanit të lashtë; mbi huazimet e gjuhës shqipe nga greqishtja e vjetër dhe latinishtja - të hyra në gjuhën shqipe para erës sonë.

Shtrohet çështja: cilat janë ato mundësi që ka gjuha dhe me të cilat është në gjendje t'i zërthejë fenomenet historike dhe gjuhësore? Natyrisht, fjala është për rregulla të caktuara fonetike të gjuhës përkatëse që

nuk janë statike, por dinamike – në zhvillim të vazhdueshëm, por janë të kufizuara për nga koha. Rregullat e tilla na mundësojnë të përcaktojmë kohën e depërtimit të elementeve të shumta gjuhësore të hyra së jashtmi në gjuhën tonë. Në të vërtetë, në gjuhën shqipe ka disa huazime me prejardhje latine që kanë hyrë në gjuhën shqipe para erës sonë, për shembull: *Diana*, shqip *zana*, ndërkaq fjala *djall* nga latinishtja *diabolus* në shqip ka depërtuar në erën tonë.

Si shihet, përcaktimi i ligjësiive fonetike dhe kronologjia e tyre na mundësojnë që të përcaktojmë edhe krijimin e toponimeve të lashta, të vendqëndrimeve, të vendbanimeve, të kolonive, të oronimeve dhe të emrave të lokaliteteve, të qyteteve të lashta dhe të lumenjve: Scupi, Skardon, Skardos, Astibos, Scodra, Mathis, Drinus, Lissus, Issamus, Dyrachium, Barbanna, Pirustae, Perustae. Është me rëndësi të madhe të shpjegohet dhe të përcaktohet në çfarë mënyre ka qenë i mundshëm transformimi i toponimeve të përmendura të lashta, i hidronimeve dhe i emrave të tjerë të vendeve dhe të personave në forma të tashme: Shkup, Sharr, Shtip, Shkodër, Mat-i, Dri-Drini, Lesh (Lezhë), Ishmi, Buenë, Bunë, Durrës, (Qafa) e Prushit.

Shkenca linguistike komparative ka përcaktuar se vetëm në bazë të ligjeve dhe të rregullave të fonetikës historike të gjuhës shqipe ka qenë e mundur të shpjegohet zhvillimi dhe formësimi i toponimeve antike në forma të tashme, të ndryshuara dhe këto të gjitha në pajtim me rregullat e fonetikës historike të gjuhës shqipe. Për shkaqe historike dhe linguistike këtu, me të drejtë, përjashtohen gjuhët sllave, sepse Skardon, si Skardona – Skradin, Pirustae-Perast mund të lidhej me gjithçka vetëm jo me emrin e Sharrit.

Për shkaqe të arsyeshme heqim dorë nga shpjegimi më i gjerë fonetik.

Në bazë të sa u tha më sipër është krejtësisht e sigurt se etnosi - populli shqiptar, që prej kohës antike e deri në ditën e sotme, jeton në këto hapësira. Edhe diçka në lidhje me këtë. Në qoftë se prania e popullit shqiptar në këta meridianë që prej periudhave më të lashta është fakt i pamohueshëm, atëherë si përfundim imponohet se edhe gjuha shqipe në këto hapësira – në Dardaninë e lashtë dhe Kosovën e mëvonshme - ka

filluar të merrte formën e vet. Në të kundërtën toponimet dhe hidronimet, nga pikëpamja e transformimit fonetik, do të mbeteshin të pashpjegjuara.

Mbetemi edhe më tutje në rajonin e Dardanisë antike, por në periudhën nga fundi i mesjetës, me qëllim që ta shpjegojmë situatën etnoghjësore në mënyrë që, në planin e onomastikës – në kuptimin më të gjerë – të mund të përcaktonim mbijetimin e etnosit shqiptar pas thyerjes në të cilën u shpartallua pa kthim bota antike. Do të ndalemi në onomastikonin si na paraqitet ai në dokumentet e vjetra serbe, sidomos në krisobulat e Deçanit, mandej në defterët osmanë të shekullit XV e XVI. Aty, si dihet, është regjistruar inventari i emrave të përveçëm që ofrojnë të dhëna të shkëlqyeshme mbi përbërjen etnike të popullsisë në rajonin e Kosovës.

Të dhëna të hollësishme të natyrës onomastike japin defterët turq të shekullit XV e XVI. Shumë studiues i ishin kthyer edhe më herët kësaj materieje, do të thotë onomastikës së rajoneve të përmendura, por këtë e kanë bërë shkel e shko dhe shpejt e shpejt dhe shumica pohonte se emrat e përveçëm në hartat e mesjetës shënjojnë edhe përkatësinë etnike (S. Novaković, K. Jireček). Në publikimin e defterëve turq, që kanë të bëjnë me viset tona, dallohet orientalisti i ri shqiptar Selami Pulaha; ai ka publikuar defterin përplot me të dhëna të Sanxhakut të Shkodrës 1485-1582, Tiranë, 1974. Orientalisti i zellshëm Pulaha me shumë studime i ka pasuruar njohuritë tona mbi rrethanat ekonomike dhe etno-linguistike të popullsisë në hapësirat tona. Botimi i tij i defterit të Sanxhakut të Shkodrës dhe shumë punime në lidhje me këtë janë nxitje për onomastikët e tjerë. Këtu vlen të theksohet sllavisti i Beogradit Mitar Peshikan, i cili, në vitet e fundit, në bazë të lëndës së Pulahës dhe të studimeve të tij ka filluar të hulumtojë sistematikisht onomastikonin serbo-shqiptar në *Kontributet onomatologjike* (Onomatološki prilozi, II-VII, 1981-1986). Studimet e tij janë me themel dhe gjithëpërfshirëse dhe, në qoftë se trajtimi i tij i temave dhe metoda shkencore janë të drejta dhe të pranueshme, kjo gjithsesi do të thotë se edhe përpunimi i tyre është zbatuar objektivisht.

Mirëpo, kjo nuk do të thotë se në hollësi, madje edhe në disa çështje parimore, mund të pajtohemi me të. Sipas vlerësimit tonë, mungesa

themelore e tij është që, me rastin e përcaktimit të përkatësisë etnike të bartësve të emrave të përveçëm nuk merr parasysh rrethanat shoqërore dhe historike. Jemi të bindur se është vështirë të gjendet një hulumtues objektiv i cili, në këtë onomastikon, do të mund të konstatonte pa kurrfarë vështirësish strukturën e pakontestueshme populative shqiptare dhe përkatësinë etno-gjuhësore të saj. Strukturë të ngjashme etno-gjuhësore kanë edhe një numër i mirë fshatrash e lagjesh në Tropojë, Junik e Gjakovë (S. Pulaha, Studime historike, 1, 2, 1972). Vështirësitë paraqiten atëherë kur, në strukturën e onomastikonit gjenden emra të përveçëm të përzier shqiptaro-serbë. Peshikan i ka zgjidhur në mënyrë shumë radikale vështirësitë e përmendura: “Duhet të mbahet parasysh fakti se disa emra vetjakë përjashtoheshin nga rrethi i mjedisit etnik të tyre, duke depërtuar në mjedise etnike të tjera, gjë që për pasojë emra shqiptarësh Llesh, Gjin, Gjon dalin në mjediset sllave, kurse emrat sllavë Vuk, Dejan etj. i gjejmë në rrethe shqiptare”, *Onomatološki prilozi*, III, f. 61. Në një numër të mirë fshatrash, po të gjykohet nga pikëpamja e emrave të kryefamiljarëve, mund të themi plot gojen se gjithë onomastikoni i tyre është me gurrë shqiptare: Gjin, Gjon, Leka, Kola, Gega, Pal, Duka etj. gjithashtu në pesëdhjetë fshatra të tjerë me ndonjë përzierje të vogël të emrave buri-mesh shqiptare-sllave, antroponimia thjesht shqiptare është mbisunduese. Një përzierje të tillë të emrave vendës dhe të huaj e gjejmë edhe në regjistrimin e popullsisë të Krahinën së Brankoviçve të vitit 1455.

Simbioza shqiptaro-sllave, ose shqiptaro-serbe në fushën e emrave vetjakë në krahinën e Rrafshit të Dukagjinit, është e qartë dhe ai trazim i emrave të përveçëm në një familje, ku prindërit mbajnë përzierje emrash shqiptarë, kurse bijtë me vëllezërit kanë emra karakteristikë serbë, nuk mund të zgjidhet mekanikisht. Këtu duhen marrë parasysh, sikur u tha sipër rrethanat shoqërore-historike. Nuk ka dyshim se ndikimi i onomastikës serbe dhe ai i institucioneve fetare dhe kulturore ortodokse mbi banorët shqiptarë në periudhën paraturke si dhe trysnia e ndikimit të kishës ortodokse, edhe gjatë sundimit turk, ka qenë shumë i madh. Nën despotatin e Brankoviçit kishte 12 manastire dhe 5 kisha. Në zotërimet e

Deçanit kishte aq shumë priftërinj sa njërit nuk i binin më shumë se 20 shtëpi, kurse në 8 katunde të vllëve të Deçanit dhe në një të shqiptarëve që kishin 266 shtëpi, nuk kishte asnjë prift (Stojan Novaković, Selo, Bgd. 1965, f. 171-173).

Trajtimi objektiv i dokumenteve mesjetare dhe i defterëve turq hedh poshtë pohimet e historianëve e në ditën e sotme edhe të sa e sa publicistëve se shqiptarët në Krahinën e Kosovës dhe të Rrafshit të Dukagjinit kanë ardhur nga fundi i shekullit XVII dhe fillimi i shekullit XVIII, pas tërheqjes së elementit serb prej këtyre anëve drejt veriut. Po këto materiale e dokumente, po të këqyren drejt e me frymë objektive, flasin shkoqur për praninë e elementit shqiptar në strukturën etnike-gjuhësore të shtetit mesjetar serb, e me shtimin e natyrshëm edhe në periudhën e parë të sundimit turk. Si element konstitutiv i atij shteti shqiptarët me popuj të tjerë në kontekstet e ndryshme shoqërore me mjete të shumëllojshme materiale e djersë të ballit të vet, kanë vënë gurë të çmueshëm në ndërtesën e bashkarisë feudale të atëhershme serbe.

Fjala shpeshherë e përsëritur në të kaluarën nga një vargan listorianësh nga i të brezit të moshuar e e përsëdytur me zjarr në kohën tonë se Kosova është tokë vetëm e serbëve si djepi i tyre që na qenka, mbi të cilën paskan të drejtë historike, s'është e s'mund të jetë e plotë; ajo do të thuhet e plotë vetëm atëherë kur në ngarkesën e vet vështrimore të përfshijë pa ngurrim edhe elementin etnogjuhësor e struktural shqiptar si anas në këto troje.

Është interesante të theksohet që borgjezia serbe, pikërisht krahu i djathtë i saj shqiptarëve s'ka pranuar ndonjëherë t'ua njohë të drejtën për vetëvendosje: luftërat çlirimtare të tyre i pandehte luftëra pushtimi, ato, sipas saj, nuk kanë pasur karakter çlirimtar; intimisht, si ajo, as komunistët serbë, s'janë pajtuar kurrë që Kosovës t'i njihet autonomia.

E ka dëshmuar ajo këtë mospajtim sa e sa herë duke kurdisur procese gjyqësore në Kosovë që para ngjarjeve të njohura të vitit 1981; e kishte për qëllim të bindë opinionin e gjerë jugosllav, fjala e saj, për qëndrimin dhe përcaktimin antijugosllav të shqiptarëve si element antishtetëror.

Në kohën kur Evropa, me hapa të mëdhenj po ecën në drejtim të integritit të plotë dhe të demokracisë - duke arritur suksese të dukshme dhe Evropa Lindore po i këput prangat bolshevike, politika serbe, e cila njëherë ka pësuar disfatë të plotë me pasoja të rënda të paparishikueshme, popullin shqiptar të Kosovës e ka futur në geto me qëllim që ta thyejë moralisht, ta presë uria dhe ta zhdukë fizikisht. Kjo është njëra anë e medaljes, kurse në anën tjetër lexohet: pajtimi popullor dhe homogjenizimi kombëtar i popullit shqiptar të Kosovës e gjetiu për mbrojtje nga politika pushtuese, nga terrori i paparë kafshëror mbi popullin duarthatë e të pambrojtur në shtetin “juridik” në të cilin sundon dhuna dhe në të cilin më efikase janë organet policore të cilave u vjen ndoresh shumë shpejt dhe me sukses që të ushtrojnë arbitrarisht ekzekutimin e shpërndarjes së Kuvendit Krahinor dhe të parlamentit të tij, ta shkatërrojnë ekonominë e Kosovës, ta asgjësojnë shëndetësinë dhe shkollat, t’i pushojnë arbitrarisht në masë nga puna punëtorët shqiptarë, t’i mbyllin shkollat në gjuhën shqipe. Ja, kjo është një pjesë e bilancit të shtetit “juridik” të Serbisë në Kosovë.

Harrohet vetëm një gjë: se politika e këtillë gjithmonë ka qenë jo produktive dhe shkatërruese – në kundërshtim me arritjet qytetëruese të kontinentit të vjetër.

“Danas”, Zagreb, 1 shkurt 1991

MBI DISA PROBLEME TË FORMIMIT TË GJUHËS SHQIPE DHE PËRPJEKJET E KEQPËRDORIMIT TË REZULTATEVE SHKENCORE

Në këtë vështrim të disa problemeve të krijimit të gjuhës shqipe, do të përpiqemi të parashtrojmë rezultatet që kanë arritur studiuesit e hulumtimeve paleoballkanike gjuhësore në lidhje me gjenezën e gjuhës shqipe. Studiuesit e situatës gjuhësore të Ballkanit të lashtë dinë se gjuha shqipe është e vetmja gjuhë jogreke trashëgimtare e drejtpërdrejtë e njëres nga gjuhët e vjetra ballkanike.

Interesimi për problemet gjuhësore të Ballkanit të lashtë është shtuar shpejt pas luftës. Në këtë kuadër të çështjeve vend qendror ndër këto hulumtime zë gjeneza e popullit shqiptar dhe e gjuhës së tij. Ndër institucionet e ngjashme shkencore në vendet ballkanike, për problemet e gjenezës së gjuhës shqipe është e interesuar edhe shkenca shqiptare. Disa persona i kanë keqpërdorur arritjet shkencore të bardit të kësaj shkence, Eqrem Çabejtë, të cilat ai i ka arritur me shumë maturi e në mënyrë të përmbytur dhe racionale, duke i shpallur si të vërtetuara edhe ato që Çabej i ka dhënë si mundësi. Në anën tjetër, kryesisht në krahun e joekspertëve të papërgjegjshëm dhe jokompetentë është hedhur dhe hidhet poshtë gjithë ajo që është pozitive, ose edhe tërë teza mbi prejardhjen ilire të gjuhës shqipe, duke e quajtur këtë edhe si tezë raciste. Prandaj e kemi parë të nevojshme dhe të domosdoshme që objektivisht, pa njëanshmëri i ekskluziviteteve, t'i paraqesim rezultatet që ka arritur shkenca mbi gjuhën në periudhën e pasluftës në studimin e problemeve të gjuhës shqipe.

Tash më se një shekull shkenca evropiane mbi gjuhën, në material jo të plotë dhe të gjymtë të gjuhëve – ilirishtes e mesapishtes - nga njëra anë dhe të trakishtes nga ana tjetër – bën krahasime midis situatës bashkë-

kohëse të gjuhëve ballkanike dhe të gjendjes gjuhësore të Ballkanit të lashtë. Shkenca gjuhësore ka arritur të përcaktojë disa përkime analogjike në fushën e fonetikës, të fjalëformimit, të leksikut, të emrave të përveçëm dhe të toponimeve të ilirishtes, të mesapishtes dhe të trakishtes nga njëra anë dhe të gjuhës shqipe bashkëkohore – të vetmes trashëgimtare jogreke të situatës gjuhësore paleoballkanike - nga ana tjetër.

Mbi bazë të grimcave gjuhësore të situatës së lashtë gjuhësore ballkanike dhe të gjuhës bashkëkohore shqipe është konstatuar, pra, se gjuha shqipe ka ngjashmëri dhe afri si me ilirishten, ashtu edhe me trakishten, por marrëdhëniet me ilirishten i ka më të drejtpërdrejta dhe me disa përparësi. Teza ilire e gjuhës shqipe ka një dimension që i mungon teorisë trackase të gjuhës shqipe; këtu është përparësia e tezës mbi prejardhjen ilire të gjuhës shqipe; fjala është për faktin se shqiptarët jetojnë në të njëjtat vise të Ballkanit perëndimor, ku ka jetuar dega jugore e etnosit ilir dhe nuk ka konfirmime historike sipas të cilave të parët e shqiptarëve kanë ardhur nga pjesët lindore, përkatësisht veriore të Siujdhesës Ballkanike. Provat mbi vazhdimin e drejtpërdrejtë dhe të pandërprerë të traditës së lashtë të gjuhës shqipe në rajonet në të cilat shtrihet edhe sot, arsyetohen me interpretimet linguistike të disa toponimeve, si Dri, Drini (Drinus), mandej Mat, Mati (Mathis), Shkodër (Scodra), Drisht (Drivastum), Lesh, Lezhë (Lissus), Ishm (Issamnus), Shkumbi-ni (Scampinus), Vlorë (Aulona), Durrës (Durrachium), Çam (Thyamis).

Astronomi dhe gjeografi aleksandrin Ptolomeu nga shekulli II i erës sonë, na ka lënë të dhënë, sipas së cilës, në hartën e vet gjeografike të botës e ka shënuar emrin e fisit autokton me emrin **Albanoi**, të cilin e ka vendosur në veri të Durrësit. Qyteti **Albanopolis**, si konsiderojnë shumë shkencëtarë, midis të cilëve edhe vetë Hahn-i, sipas të gjitha gjasave, gjendej në vendin ku tash gjenden gërmadhat e **Zgërdheshit** në rrethinën e Krujës. Ky emër do të thotë “vend i rrethuar me gardh, vend i rrethuar, i rrethuar me rrethojë”; toponime me kësaj emërtimi gjejmë edhe gjetiu në viset e banuara me shqiptarë – **Kardhiqi** afër Gjirokastrës, **Gardhiqi** – vend i banuar me shqiptarë në Greqi. Emrin **Albanoi**, populli shqiptar i

mëvonshëm, gjatë shekujve të ardhshëm, e ka ruajtur në formë pak të ndryshuar si **Arbën, Arbër, Arbëresh, Arbënesh**, derisa është zëvendësuar me emërtimin tjetër për vendin dhe popullin.

Onomastika është fushë në të cilën pasqyrohet identifikimi i ilirishtes, përkatësisht i mesapishtes dhe i gjuhës shqipe: Bardhyllis, mesapisht Barzi, shqip Bardho, Bardhul, që përmbajnë fjalën bardh; ilirisht Dasius, Dassium, Dassium, mesapisht Dazimas, shqip Dash; ilirisht Bato, shqip Bato; ilirisht Ladius, shqip Laç; Skenobardus, mesapisht Barzides, Barzidihi, shqip i bardhë, Bardhi; ilirisht Bardibalus, shqip balë; ilirisht Bistum – shqip bisht; ilirisht Brindia, Brendesion, mesapisht brenton (kokë derri), shqip bri-ni; ilirisht Bigeste - shqip bigë; ilirisht Dimalum, Matuntum, shqip mal; ilirisht Ulcinium – shqip “ulk”.

Në planin gjuhësor, tezën ilire e mbështet, vërtet, në mënyrë indirekte, material i ri: fjala është për disa elemente leksikore, të vërtetuara në të dy gjuhët klasike dhe në disa dialekte alpino-apanine. Është interesante se këto elemente gjuhësore, bukur dhe pa vështirësi më të mëdha, mund të shpjegohen me anë të gjuhës shqipe. Si ilirizma përmenden **equas bardias**, që interpretohet me greqishten **hippas foras** (pelat grvide), kurse Jokli e interpreton këtë me ndërmjetësimin e shqipes **mbarsë** dhe **mbartë** (grvide); e mandej latinisht **mannus** “poni, mazi” dhe e krahason me shqipen **mâz. mēz**, rumanisht **minz**, mesapisht Jupiter **menzana**. Latnisht **brisa** “komina”, shqip bërsi. Këtë inventar leksik Çabeji e plotëson me këto fjale: latinisht **burdonis** dhe **burnus** “mushkë”, shqip (dialektet arbërishte në Greqi **burdhë** “thes” dhe vihet në lidhje me shqipen **barrë; baronis** (tutkun), shqip te Buzuku –**bëruo** (bari), te Budi **bruo**; shqip **bëruo** reduktohet në **bari** me elementin sufiksor –**uo, -ua, -ue**, si te **varguo, vargua, vargue, përruo, përrua, përrue, kruo, krua, krue** etj.

Për një varg fjalësh e shprehjesh të greqishtes së vjetër, që nuk mund të interpretohen me anë të kësaj gjuhe, e që identifikimin e tyre e gjejnë në gjuhën shqipe, metodologjikisht është fare e drejtë që shpjegimin e tyre ta kërkojmë në gjuhën shqipe. Glosa greqishte **dhiza** (dhia), që konsiderohet fjale lakedomone e dorasve të vjetër të Peloponezit, sipas mendimit të

prof. Çabejt, nuk mund të ketë burim tjetër pos nga shqipja **dhizë**, dhi, dhia. Fjala e greqishtes së vjetër **laros** (pulëbardhë), sipas mendimit të Çabejt, nuk mund të ndahet nga fjala shqipe **larë** (larë, njollë e bardhë në lëkurën e shtazëve, nga e cila janë krijuar edhe disa emra të shpezëve dhe të shpendëve si **larash**, **laradash**, **laramane**, **laraskë** (Çabejt. Hyrje në historinë e gjuhës shqipe, 1969, f. 22),

Që në shekullin XVIII është vërtetuar identifikimi leksik midis trakishtes dhe shqipes. Fjala trakishte **manteia**, **mantia** “manaferra”, është shpjeguar me anë të shprehjes shqipe **man** (manaferra). Nga bimët mjekësore termin **amalusta** “kamomili”, Tomashek e vë në lidhje dhe përpiqet ta gjejë prejardhjen e saj nga shqipja **ambël**, **ëmbël** etj.

Pas luftës, në Krahinën Autonome të Kosovës janë krijuar aso kushtesh që kanë bërë të mundshme ngritjen e brezit të ri shkencor nga radhët e nacionalitetit shqiptar. Në vitet gjashtëdhjetë ka filluar zgjerimi i shpejtë i rrjetit të shkollave të larta dhe formimi i institucioneve kulturore e shkencore. Është rritur plejada e shkencëtarëve të rinj të cilët janë rrokur me një numër të madh problemesh nga fusha të ndryshme të shkencave. Ç’është e vërteta, duhet të thuhet se punonjësit shkencorë nga fusha e disiplinave albanologjike – sidomos kuadri shkencor i shkencave filologjike - është formuar shumë ngadalë. Për fat, albanologjia jugosllave në Kosovë është bërë bërthamë shumë e rëndësishme dhe deri tash ka arritur rezultate të konsiderueshme në studimin e historisë së gjuhës shqipe. Ç’është e vërteta, me meritën e disa individëve, rezultate të dukshme janë arritur në studimin e shumë çështjeve nga fonetika historike dhe gramatika e gjuhës shqipe duke zbatuar metoda shkencore bashkëkohore. Metodat shkencore tradicionale po zëvendësohen ngadalë por me siguri me parime shkencore bashkëkohore, me të cilat shkenca freskohet dhe bashkëkohësohet. Është arritur përparim në fushën e hulumtimit të marrëdhënieve të ndërsjella gjuhësore shqiptaro-jugosllave si dhe në fushën e studimeve ballkanologjike. Përpos kërkimesh shkencore, gjurmimet dhe arritjet e këtilla kanë edhe rëndësi të posaçme shoqërore, sepse mbi këtë bazë mund të ndërtohet shumë mirë dhe të thellohet njohja e ndërsjellë dhe

vetëdija për përbashkësinë e kombeve dhe të kombësive tona.

Në këtë rrafsh, ka individë që konsiderojnë se mund të shkruajnë për gjithkënd gjithçka – në mënyrë sovrane, në të vërtetë jo të papërgjegjshme. Individët e këtillë vuajnë nga sëmundja foshnjore dhe u mungon njohja e gjithanshme dhe më e thellë e problemeve të degës së vet, kurse për shkenca me lidhje farefisnore shpeshherë nuk kanë as njohuri themelore. Ai që ka ndërmend të kumtojë diçka për toponomastikën, edhe nëse atë e ka degë të ngushtë, duhet të njihte bazat mbi të cilat themelohet kjo disiplinë shkencore, që të mos i ndodhë që toponimin **Prishtina** ta vërë në lidhje me fjalën e anglishtes “**pristin**” me domethënien” i lashtë, i moçëm. i hershëm” dhe që emërtimin lokal **Pejë** ta nxjerrë nga turqishtja **Ipek (Peq)**. me çka tregon mosnjohjen totale të problematikës onomastike. E çka të themi për ndonjë individ, fatbardhësisht të rrallë, për të cilin studimet etimologjike janë dëfrim, hobi, dhe huazimin latin të gjuhës shqipe **popull** dhe shprehjen serbokroate **pleme** (fis) e nxjerr nga folja shqipe **pjell**! Këto, në studimet etimologjike, quhen bravurozitetë të cilat na kthejnë në shekullin XIX. Kjo dëmton, në radhë të parë, atë që bën këso bravurozitetesh e mandej shkencën, por edhe lexuesin e painformuar – të etshëm për dituri.

Me organizim më të mirë të punës shkencore në Krahinë, me bashkëpunim më të ngushtë të institucioneve tona shkencore dhe me përkryerjen e informacioneve të ndërsjella do të shtohet kontributi i studimeve albanologjike për përparimin e studimeve ballkanologjike në vendin tonë, e me këtë do të rritet edhe prestigji i bashkësisë sonë socialiste vetëqeverisëse - Jugosllavisë.

Tubim shkencor, Prishtinë më 19-21 qershor 1985

TEKST I BOTUAR NË ENCIKLOPEDINË JUGOSLLAVE

Gjuha

Shqiptarët janë një nga popujt më të vjetër të Ballkanit, e në mbështetje të të dhënave deri sot të ruajtura monumentet e para gjuhësore në historinë e kësaj gjuhe shfaqen bukur vonë, vetëm në shekullin XIV, e libri i parë botohet në qindvjetëshin XVI. Nga përmendoret e para gjuhësore vlen të përmenden: një fragment nga Ungjilli i Pashkëve; Formula e Pagëzimit (1462), me veçori dialektore të krahinës së Matit; pastaj Fjalori i von Harfit (1496) që në vete përmban nja pesëdhjetë fjalë të regjistruara në Ulqin dhe në bregdetin shqiptar.

Gjuha shqipe bën pjesë në familjen e madhe të gjuhëve indoevropiane. Rezultatet që në rrjedhën e një shekulli janë kryer në gjuhësinë krahasuese indoevropiane kanë bërë të mundshme të përcaktohet më për së afërmi, më sigurtë e më drejt, vendi i kësaj gjuhe në rrethin e gjithëbashkësisë gjuhësore indoevropiane; në këtë punë merita kanë sidomos F. Bopp, G. Meyer, H. Pedersen, N. Jokl, etj.

Meqë në ilirishten nuk është ruajtur kurrfarë teksti, linguistët u detyruan këtë gjuhë ta gjurmojnë nga materialet që, për vetë karakterin e tyre, nuk lejonin të zbatohet në mënyrë të mjaftueshme struktura e saj, e ato ishin antroponimet e toponimet (emrat e njerëzve dhe të vendeve), të ruajtura në mbishkrimet dhe në shkrimet e autorëve grekë e latinë. Studimet linguistike entologjike, arkeologjike dhe hetimet e tjera na çojnë nga burimi ilir i gjuhës shqipe. Këtë teori e mbrojnë J. Thummann J. H. Hahn, G. Meyer, H. Pedersen, N. Jokl, V. Pisani, E. Çabej, W. Cimochowski, A. Desnickaja, R. Katičić.

Ç'është e drejta është përsjatur njëfarë bashkëpërkimi leksikor ndërmjet shqipes dhe trakishtes, bie fjala leksema trake manteia, mantia

(manaferrë) shpjegohet me të shqipes man; pastaj amalusta (kamomilë) krahasohet më të shqipes ambël, ëmbël, si dhe fjalën trakishte skiare (gjëmbaç) disa i bien të ardhur prej foljes – shqerr, shkier (shqej); përfaqësuesit e tezës trake të gjuhës shqipe janë: K. Pauli, H. Hirt, G. Weigand, S. Mladenov, J. Pokorni, D. Dečev, H. Barić, V. Georgiev, I. Popović.

Me refleksin *b* për *bh* indoevropiane – njëra nga veçoritë qenësore në planin fonetik, gjuha shqipe pajton me shumicën e gjuhëve të bashkësisë gjuhësore indoevropiane.

Me përfaqësimin e guturaleve palatale indoevropiane *k*, *ĝ*, *ĝh* me anë të shpiranteve (th, dh, d) lat. *acidus*, shq. *i athët*; *gener*, sh. *dhëndër*, serbokroatisht *zet*; *lego*, *lidh*-; *hiems*, *dimër*, serbokr. zima) gjuha shqipe shkon me grupin satem të gjithëbashkësisë gjuhësore indoevropiane, *bashkë me indoiranishten, jermenishten, me grupin e gjuhëve sllave dhe baltike* (V), (O-ja e shkurtër indoevropiane reflektohet me *a*: *natë*, gjerm. *Nacht*, lit., *naktis*; lat. *nox*, *-ctis*. Në këtë punë, shqipja bashkëtakohet me gjuhët gjermanike dhe baltike). Në fushë të konsonantizmit, gjuha shqipe bashkëpajtohet me ilirishten e trakishten në mënyrën e pasqyrit të ndryshëm të labiovelareve indoevropiane përpara zanoreve të çelëta (i,e) dhe të zanoreve të mbyllëta (a, o, u), pajtim që me përjashtimin e trakishtes nga ky mes qysh bën W. Cimochoowski, na del një tezë e re e një bashkëpërkimi specifik ndërmjet ilirishtes e shqipes.

Ka një mendim sipas të cilit theksi i ilirishtes, njësoj si në gjuhën gjermanike të përbashkët, në gjuhë italike, si dhe në keltishten, mbase, qëndronte në pozicion nistor. Edhe për shqipen gjithashtu është vërtetuar një rregullim mekanik i akcentit, që në kohën romake zuri vend në rrokjen e parafundit. Ngulitja e theksit mbi këtë rrokje në shqipen na provon se kjo gjuhë, në bjerrjen e shpeshtë të rrokjeve fundore, në rrymë të kohës, prej theksimit nistor, sosi në theksimin e rrokjes fundore, duke kaluar nga një ritëm daktilik në një tjetër trokaik. Ky është një bashkëpajtim i shënueshëm ndërmjet ilirishtes e shqipes në vijën e zhvillimit më së miri e ilustrorj në toponimet: Drivastum, (Drisht), Issamus (Ishëm), Durrachium –

Durrës. Në lidhje me mbaresat fundore te toponimet me origjinë ilire *Scupi, Scodra* edhe të nyjës shquese të mbrapme *i, -a*, të shqipes së sotme: *mal-i, ar-a* vërehet një bashkëtakim i dukshëm ndërmjet ilirishtes dhe shqipes në fushë të fleksionit të emrit.

Po ashtu, si disa gjuhë indoevropiane, edhe në ilirishten mbaresa *-ie* gjinore njëjës të mashkullorëve, mendohet të ketë vazhduar të mbijetojë te lidhja shqipe *i ati, i t'et*.

Në fushë të fjalëformimit ka përkime të dukshme ndërmjet shqipes dhe ilirishtes: suf. *-at* (Demi) *Demat*; te emrat e vendeve: *Dukat, Filat*; ilir. *-at* (Delmates, Daesitiates, Ulciniatae; Lamatis Aematae; shq. *- shtë* (kopësht, vneshtë), ilir. *-st* (Tergeste, Ladeste), mbase edhe *-inj* (kerminj, shkëmbinj), ilir., *inium* (Delminium, Ulkinium). Ndër parashtesa të vihen re: ilir. *-li* (liburni (Burni), shq. *-lë* (lëfyt: fyt: lëmazë; litrak-lëtrak lë + tar + ak.

Huazimet latine të shqipes kanë një peshë të rëndësishme në punë të caktimit të truallit në të cilin u formua kjo gjuhë. Karakteri i tyre arkaik është provë e mirë që dëshmon se ato në shqipen kanë depërtuar që herët. Një karakter të tillë kanë edhe huazimet e greqishtes së vjetër – të pakta si numër, nja tridhjetë gjithsej. Pastaj terminologjia e krishterë kishtare është krejtësisht latine, gjë që dëshmon se huazimet latine në këtë sferë kanë hyrë në viset bregdetare.

Fondi leksikor i shqipes është rralluar mjaft nën ndikimin e gjuhëve sllave – (Marrëdhëniet shqiptare-jugosllave, gjuha), të turqishtes dhe të gjuhëve të tjera.

Dialektet. Nga pikëpamja dialektore, gjuha shqipe degëzohet në dy grupe kryesore dialektesh: grupi i dialekteve geqe dhe lagjia e dialekteve toske. Të folmet shqiptare të Kosovës janë pjesë e tërësisë dialektore geqe; në këtë palë të folmesh hyjnë edhe pjesa më e madhe e ligjërimeve shqiptare në Maqedoni, që në veri shtrihen deri te Kumanova dhe Bujanovci, e në jug derdhen deri te Struga; në këtë tufë dialektesh geqe përfshihen edhe të folmet në Jabllanicën e Epërme, pastaj ato të Sanxhakut me të Plavës e

Gucisë, mandej ato në rrethin e Titogradit, të folmet e zonave kufitare – të Briskut e Shestanit me të Ulqinit, si dhe të arbëneshëve të Zarës. Dega jugore e të folmeve toske ndërthen në vete ligjërimet veriore dhe jugore të Toskërisë me të labërishtes dhe çamërishtes.

Dallimet që dalin te këto dy grupe të dialekteve shqiptare në pjesën më të madhe kanë karakter fonetik, pastaj morfologjik, prej të cilave disa janë të hershme, e të tjerat të kohëve të vona, të përfuara në rrymë të këtyre dy shekujve të fundit. Dialektet gege shquhen me një tipar mjaft arkaik, me vokale hundore, kurse jugoret ndahen në shenjë me rotacizëm: geg. *zâ-ni, kâmbë, rrânjë, mullí, -nî, sý-ni*; tosk. *zë-ri, këmbë, rrënjë, mullí-ri, sy-ri*, etj. Mendohet se kjo shfaqje fonetike e të folmeve toske u përfuara në antikën e vonë a në mesjetën e hershme: *verë* (venë), *emër* (emën), *zura* (zuna) etj.

Tipar i hershëm i këtyre dy grupeve kryesore të dialekteve do të quhet edhe kalimi i *â*-së hundore gege – në gjysmëvokalin neutral *ë* toskë, bie fjala – *nâna – nëna; bâna – bëra; shullâni – shullëri*, si dhe ndërrimi i *vo*-së të dialekteve gege në *-va*- të toskërishtes: *votër-vatër vorr-varr; voj-vaj*. Rotacizmi, një dukuri fonetike që i veçon të folmet toske, me përjashtim të disa rasteve të veçuara, s'ka përfshirë fondin e huazuar të leksikut sllav të shqipes, një gjë që dëshmon se kemi të bëjmë me një veçori të hershme. Njëri nga dallimet e para midis dy kryedialekteve kryesore të shqipes, është edhe ai, që lagjja e dialekteve gege shquhet për bivokalizmin, që d.m.th. ka dy radhë vokalesh: hundore dhe gojore, që, herë-herë kanë vlerë fonetike: *â, û, ý, î, ê: a, o, u, z, i, e, ë*, e të folmet toske kanë vetëm një seri vokalesh, vokalet gojore. Vlera fonetike e dy serive të vokaleve duket, bie fjala te fjalitë: *u vrâ* (moti): *u vra*.

Kuantiteti i vokaleve të theksuara ka moshë të madhe, por mund të jetë edhe i kohëve të vona. Mbi dëshminë e disa shembujve kuantiteti i zanoreve paraqet vazhdimin e tij nga periudha të lashta, bie fjala thī, mī, lat. sūs, mūs; rastet e fundit të latinishtes provojnë vjetërsinë e kuantitetit në të dyja fjalët shqipe. Kuantiteti i gjatë i disa të tjerave është rezultat i procesit të rrudhjeve të rrokjeve; fjala vjen: pÿll, dēt, kūt të ardhura nga

latinishtja: *padúlem* (palúdem), *cūbítus*; dët është fjalë vendi, e fondit leksikor indoevropian.

Të folmet toske janë më të qëndrueshme në punë të ruajtjes së diftongjeve: *ua, ie, ye*, të cilat diftongje të folmet gege, kryesisht i mbledhin në monoftongje: *u, i* z: *krua-* (krue) –*kru, diell-* (diell) –*dill; fyell-* (fyell) –*fyll*). Një shkallë para këtyre diftongjeve dilte me trajtën: *uo*, që e ndeshim tek autorët e vjetër Gj. Buzuku (“Meshari”, 1555) dhe P. Budi (1566-1622), e që ruhet edhe sot e gjithë ditën në disa të folme arkaike gege e toske. Shkalla diftongore, që i printe kësaj të fundit, ndonëse nuk e gjejmë të regjistruar kund ndër monumente shkrimore as nëpër dialektet shqiptare, mendohet të ketë qenë forma *ou*, qysh e kishte diktuar dijetari austriak N. Jokl, duke e rindërtuar nga huazimet sllave të shqipes, prej fjalës *potkova*. shq. *potkuo, potkua, potkue* (potku, patku).

Togu i lashtë bashkëtingëllor *kl, gl*, në të folmet e sotme shqiptare del me këto trajta: format e para të saj ruhen në disa të folme arkaike të shqipes, bie fjala në idiomën e Dardhës te Korça, ndër arbëreshë të Italisë Jugore dhe të Greqisë; dorën e dytë *kj, g-j* e kanë të folmet e Zadrimes, e përdorin shqiptarët-katolikë të Shkodrës, ligjërimet në Shqipërinë e Veriut, të folmet e Krajës – rrethi i Ulqinit si dhe arbëneshët e Zarës (kaj, g-jób, g-juh); lagjia e tretë është ajo që ka sosur me qiellzorëzimin e togjeve: *q, gj* (*gj, quaj, gjobë, gjuhë*), - që i gjejmë në pjesën më të madhe të të folmeve toske, pjesërisht gege; dhe më në fund shkalla e katërt *k, g*: (*kaj, guh, gob*) mbijeton në Shqipërinë e Veriut, - përgjatë brezit të kufitit shqiptaro-jugosllav, pastaj në ligjërimet shqiptare të Kosovës, ndër shiqptarë të jugut të Serbisë – në Preshevë, Bujanovc dhe në Jabllanicën e Epërme.

Gjuha letrare. Libri i parë i botuar në gjuhën shqipe “Meshari” i vitit 1555, është një vepër e Gjon Buzukut, famullitar në Ipeshkvinë e Tivarit; libri i dytë është përkthimi i katekizmit – Dotrina Christiana të Ledesmës i Lekë Matrëngës nga viti 1592, të një arbëreshi nga Sicilia. Në kohën e botimit të veprave të përmendura, në Shqipëri po ktheheshin misionarë katolikë, që kishin mbaruar studimet në kolegjin e Loretos (Itali), të cilët ndër manastire e kuvende të famullive hapnin shkolla. Është e njohur lufta

e këtij vargu klerikësh shqiptarë duke nisur me Gj. Buzukun e duke mbaruar sidomos me P. Budin kundër klerit të huaj dhe përpjekja që të përdornin një gjuhë sa më të përgjithshme në shërbimet fetare. Në këtë punë dallohej P. Budi (1560-1622), nga Mati, një kohë ishte administrator famullie në Kosovë dhe ipeshkv në Zadrimë. Përktheu *Doctrina Christiana* dhe *Rituale Romanum* (Romë 1618 si dhe “*Speculum Confessionis*” (Romë, 1621). F. Bardhi (1606-1643), ipeshkv i Zadrimës, hartoi fjalorin e parë latinisht-shiqp (1635). Nga mbarimi i shekullit XVII. P. Bogdani, një shiqptar nga Zhuri i Prizrenit, shkroi shiqp dhe italisht veprën (“*Cuneus Prophetarum*”, të botuar më 1685 në Padovë të Italisë që njihet përmendorja më e bukur shkrimore e prozës në dialektin letrar gegë të asaj kohe.

Gjuha shqipe e shekullit XVI. dhe XVII na del në dy variante letrare (gegërishte e toskërishte), që i shquan baza popullore dhe marrin një shtrirje jashtë përdorimit lokal dhe fisnor, duke u përhapur në një truall më të gjerë gjuhësor.

Në gjysmën e parë e sidomos në gjysmën e dytë të shekullit nëntëmbëdhjetë, shpejt e në përmasa të gjera zë të zhvillohet Rilindja kombëtare. Në këtë lëvizje nacionale dhe kulturore, gjuha letrare merr një rol jashtëzakonisht të rëndësishëm me përmbajtje të re në luftë për realizimin e synimeve shekullore të çlirimit. Edhe pse gjuha shqipe kishte dy variante letrare mbi bazën dialektore, te veprimtarët e kulturës dhe te punonjësit publikë rritet vetëdija për të krijuar një gjuhë të përbashkët letrare shqipe. Në vitet gjashtëdhjetë e shtatëdhjetë të shekullit nëntëmbëdhjetë K. Kristoforidhi përktheu dhe botoi libra kishtare në të dyja variantet letrare. Fjalori i tij i vogël (Athinë, 1904), i shpjeguar greqisht, përmban të gjitha tiparet e gjuhës së përbashkët letrare shqipe, e për nga konceptimi dhe mënyra e hartimit ngërthen në vete të gjitha vetitë e Fjalorit të serbishtes të Vuk Karaxhiçit.

Që nga viti 1864, puna e alfabetit të shqipes është njëra nga çështjet më të diskutuara në mbledhjet e shqiptarëve të shquar që rrihnin të gjenin zgjidhjen më të pranueshme e më të përshtatshme për një alfabet të

përbashkët. Alfabeti s'ishte vetëm çështje gjuhësore, por ai shpeshherë merrte karakter thjesht politik. Prandaj vetëm motmot pasi në Prizren u krijua Lidhja e Prizrenit, më 1879 u themelua në Stamboll "Shoqëria e shkronjézave e Stambollit", që hartoi alfabetin e gjuhës shqipe duke e shoqëruar atë me abetaren, ku vepronin patriotët shqiptarë-punonjës të dalluar të kulturës, të shkencës dhe punëtorë publikë: S. Frashëri, J. Vreto, P. Vasa, K. Hoxhi etj.

Zgjedhja e alfabetit latin për të shkruar shqipen, ishte një fitore e madhe, me ç'gjë veprimtarët me të shquar të kulturës, të shkencës dhe të publicistikës të tria besimeve i tregonin mbarë botës se ishin bashkuar në çështjen e emancipimit arsimor, kulturor e gjuhësor. Alfabeti i Stambollit mbështetej te parimi që çdo tingull të kishte një shkronjë të veçantë, duke u caktuar një raport i drejtë midis shkronjave e tingujve të shqipes, që, në pikëpamje linguistike pasqyronte zgjidhjen më të mirë gjuhësore që atëherë ishte e mundshme. Çështje e drejta, alfabeti i Stambollit ishte heterogjen, sepse kishte huazuar disa shenja grafike nga greqishtja, një gjë që nga shtypshkronjat kërkonte përpjekje të shtuara për shtypjen e librave, në një anë, porse në anë tjera paraqiste një rrethanë të volitshme, sepse me të mund të pasqyroheshin nuancat e ngjyrimet më të imëta fonomorfe-matike dhe prozodike të gjuhës shqipe. Alfabeti i Shoqërisë së Stambollit u mirëprit sidomos nga veprimtarë të shquar të shkrimit shqip në kolonitë shqiptare të Rumanisë, Bullgarisë, të Egjiptit si dhe në rrethe të inteligjencies shqiptare të Stambollit e në vende të tjera. Zuri të rritet numri i gazetave, revistave, botimeve të shtypura me këtë alfabet. Nga fundi i shekullit XIX., gjuha e shkrimit, duke përdorur këtë alfabet, zgjeroi shumë shpejt funksionin e vet shoqëror në kundërshtim me gjuhën e shkrimit të shekujve më parë me përdorim ngushtësisht të kufizuar dhe me një karakter thjesht fetar. Puna që ishte kryer në gjysmën e dytë të shek. XIX në fushë të gjuhës së shkrimit të shqipes dhe të alfabetit të saj i sheshoi shtigjet e Kongresit të Manastirit (1908) dhe garantonte sukses të plotë të tij. Kongresi i Manastirit përqafoi përdorimin e dy alfabeve, duke bërë një sintezë të alfabetit të Stambollit e të alfabeve latine, si dhe të alfabetit të

De Radës. Alfabeti i Stambollit, siç u tha, ishte heterogjen, i përbërë prej sistemesh të ndryshme grafike, ndërsa alfabeti i sotëm i shqipes është homogjen, i sajuar prej shkronjash latine, porse në vete ngërthen dy shkronjështa (digrame) për nëntë bashkëtingëllore: *dh, gj, ll, nj, rr, sh, th, xh, zh*. Dy alfabetet e pranuara bashkëjetuan një kohë edhe pas Kongresit të Manastirit kohë kur edhe alfabeti i Stambollit dalngadalë po i lëshonte vendin alfabetit të sotëm të gjuhës shqipe. Pas Luftës së Dytë Botërore gjuha letrare shqipe, në rrethana të reja vazhdon vijën e vet – konvergjente dhe qendërsynuese qysh ishte ravizuar para më se një shekulli.

Gjuha letrare merr një hov rritjeje të paparë deri atëherë, duke kaluar përfundimisht nga gjendja dyformëshe në një njësi njëformëshe (Konsulta e Prishtinës, më 1968, dhe Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, Tiranë 1972).

Studime Gjuhësore në fushë të shqipes III, "Rilindja", Prishtinë, 1985

SHQIPTARËT E GJUHA E TYRE

Shkenca në shërbim të politikës

Në strukturën etnike të Perandorisë Austro-Hungareze kishin hyrë shumë popuj të sllavëve të jugut dhe atje mbetën deri në shpartallimin e saj më 1918. Në kryeqytetin e Perandorisë – Vjenën – të pasur me tradita kulturore, trashëgimi shkencore e linguistike, studimet albanologjike, veçmas në pjesën e dytë të shekullit XIX, kishin punonjës të zellshëm (J. Kopitar, F. Mikloshiq, G. Meyer, P. Kretschmer, Jokl etj.). Në këtë qendër kulturore shkencore me një numër të madh entesh e institucioneve shkencore, kanë fituar kulturën e tyre linguistike një plejadë e tërë shkencëtarësh-linguistësh të ardhshëm nga viset e ndryshme, të cilët, pas Luftës së Parë Botërore, do të hyjnë në përbërjen a bashkësisë shtetërore jugosllave: P. Skok, H. Bariq, K. Oshtir, R. Nahtigal, etj. – t'i përmendim vetëm disa që, në karrierën e tyre shkencore, ekskluzivisht pos pjesërisht, do të merren me çështje të albanistikës. Disa prej tyre, për shembull albanologu Henrik **Bariq**, i cili, gjatë tërë karrierës së vet shkencore, mund të thuhet se është marrë me çështje të historisë së gjuhës shqipe, me marrëdhëniet e ndërsjella të saj me gjuhët e tjera ballkanike. Edhe të tjerët nga grupi i përmendur, në shumë raste, janë kthyer nga problemet qendrore kryesore të linguistikës shqiptare.

Gustav Meyer – një shkencëtar i rrallë sistematik, i cili mbi rezultatet e përkora por pioniere të Franc Mikloshiqit, ndërtoi veprën e vet të rëndësishme. Ndërtues i zellshëm i godinës madhështore të albanologjisë, gjatë jetës së vet të shkurtër, Meyer shtiu borxh shkencën shqiptare mbi gjuhën me disa studime të rëndësishme. Me emrin e tij lidhet një varg i tërë fillimesh në studimin e strukturës së gjuhës shqipe. Meyer, njëfarë dore, është figura qendrore në organizimin e kërkimeve etimologjike të gjuhës shqipe. Fjalori etimologjik i tij, megjithëse në disa pjesë mjaft i vjetruar, mbetet

vepër monumentale në fushën e studimeve etimologjike të gjuhës shqipe.

Meqenëse monumentet e shkruara të gjuhës shqipe dalin në shesh shumë vonë, afërsisht me ardhjen e turqve në Ballkan, çështjet e gjuhës shqipe janë vënë gjithmonë në lidhje me aso problemesh që me vështirësi kanë gjetur zgjidhje të pranueshme, sikurse janë: prejardhja e gjuhës shqipe; raporti i saj ndaj gjuhëve të tjera të lashta ballkanike; a është gjuha shqipe vazhdimi i ilirishtes, përkatësisht i trakishtes; vendi i krijimit dhe i formimit të gjuhës shqipe; në cilin skaj të Ballkanit të lashtë banonin shqiptarët – në thellësinë e tij ose në trojet e tyre historike (në truallin e vet historik). Këto janë disa nga temat më të shpeshta që i shqetësonin vazhdimisht studiuesit albanologë. Çështje e vërteta, duhet të thuhet se doktrina e Meyerit, në disa pika të saj, vuante nga mungesat metodologjike. Në studimet e tij dhe në kërkimet e albanologëve të mëvonshëm, ngulmohej në fakte të jashtme të zhvillimit të gjuhës shqipe dhe, duke mos përfillur faktet e brendshme të saj, ata përqëndroheshin në studimin e historisë së jashtme, kështu që studimi i vetë strukturës së gjuhës shqipe, i historisë së hershme të saj, zinte pak vend aty.

Danezi Holger Pedersen, indoevropianist, keltist dhe albanolog, i vuri themelet studimit të problemeve gjuhësore të albanistikës dhe me një rrugë krejtësisht të re i dha fund trajtimit metodologjik tradicional të gjeneratave të mëparshme, duke bërë zbulime të reja dhe duke përqëndruar veprimtarinë e vet në historinë e brendshme të gjuhës shqipe. Puna e tij në këtë fushë shquhet për cilësinë e vet, kurse, sa i përket sasisë, ajo mbetet mjaft mbrapa.

Në marshimin që ishte ndërmarrë me të drejtë kundër doktrinës së Meyerit merr pjesë një numër bukur i madh ekspertësh – albanistë, kryesisht nga radha e studiuesve etimologjikë, të udhëhequr nga Pederseni dhe Jokli. Në këtë aksion gjendej edhe albanologu i ri jugosllav Henrik Bariqi.

Në të kaluarën, mbi prejardhjen e shqiptarëve dhe të gjuhës së tyre, mbizotëronin kryesisht dy doktrina, të cilat vlejné edhe sot e kësaj dite: sipas njëres shqiptarët janë pasardhës të ilirëve, e gjuha shqipe vazhdim i

njërës nga të folmet e tyre. Këtë teori e mbështesnin – e disa edhe sot i përmbahen asaj – një numër i mirë historianësh e linguistësh, sikurse janë: Thunmanni (1774), G. Hahni (1854), linguistët G. Meyer, P. Kretschmer, N. Jokl, N. Budimir, C. Tagliavni, E. Çabej, V. Cimochofski, etj. Nga fundi i shekullit XIX dhe fillimi i shekullit XX, këtë teori, të cilën e mbështeste një numër i mirë i historianëve dhe i linguistëve, e zëvendësoi teoria të cilën e pranoi një numër i madh i studiuesve të gjuhës, sipas të cilëve, shqiptarët janë pasardhës të trakasve, të ardhur nga viset lindore në viset bregdetare të Adriatikut, kurse shqipja, sipas tyre, duhet të ishte faza e re e trakishtes së shuar, përkatësisht “dialekt i ilirizuar i trakishtes” (H. Hirt, G. Weigand, H. **Bariq**, H. Krahe, etj.). Pohimi i përmendur është në lidhje të ngushtë me mendimin e shprehur të disa historianëve dhe linguistëve se në kohë të lashta, përkatësisht në mesjetën e hershme, ka pasur lëvizje dhe dyndje të masave të tëra të etnisë shqiptare nga viset lindore të Gadishullit tonë në jug, në viset e detit Adriatik dhe të detit Jon. Në qoftë se për një moment edhe mund të pajtoheshim me këtë pikëpamje, do të gjendeshim në pozitë të vështirë si do ta bindnim historianin ose shkencëtarin e cilësdodisiplinë shkencore se është e saktë teoria mbi lëvizjen e masave shqiptare nga veriu i Gadishullit në jug kur dihej se në atë kohë edhe lëvizja më e vogël e popujve regjistrohej nga kronistë greko-romakë, e sidomos si mund të kalonin pa u vënë re nga syri i mprehtë i bashkëkohësve migrimet masive të një popullsie të tërë.

Albanologu Henrik Bariq mbështeste mendimin se vendbanimet më të hershme të entosit shqiptar kanë qenë në malet e Ballkanit e të Rodopeve (“O uzajamnim odnosima balkanskih jezika”, I, 22, 1937); kurse etnografi serb, në punimin e tij “Makedonski Srbi”, i mohon migrimet e shqiptarëve nga lindja në jug për shkak të ndryshimeve gjuhësore të gegëve e të toskëve duke pohuar edhe se zakonet e tyre dëshmojnë se shqiptarët, që nga lashtësia, jetojnë në vatrën sotme. Përqaftimi i krishterimit dhe organizimi i kishës, terminologjia e së cilës është krejtësisht nga latinishtja, janë me rëndësi shumë të madhe për historinë e popullit shqiptar dhe të gjuhës së tij për shkak të karakterit letrar të latinizmave të gjuhës shqipe, që flet

në favor të fazë së hershme të gjuhës latine në njërin anë dhe mbështet tezën mbi autoktoninë e shqiptarëve në viset bregdetare, nga ana tjetër.

Ithtarët e teorisë trakase të gjuhës shqipe e kanë relativizuar ose edhe problematizuar problemin e onomastikës në truallin e Shqipërisë, duke mohuar çdo mundësi të ndikimit të gjuhës shqipe në të: emrat e qyteteve të lashta, të lumenjve, të maleve shqiptare: Scodra – Shkodër; Lissus – Lesh – Lezhë; Barbanna – Buenë – Bunë; Drinus – Dri; Drini Matthis – Mat; Dyrrachiun – Durrës; Aulona, Valona – Vlonë, Vlorë; Thiamis – Çamë, gjoja u kanë ardhur shqiptarëve nëpërmjet sllavëve - pohojnë Selishçev, Weigand. I. Popoviq, ç’është e vërteta, duke ecur në rrugën e Joklit, shqiptarët i gjen në Shkodër e rrethinë para dyndjes sllave në tokën e Shqipeve. Pa dashur të hyjmë pak më thellë në këtë problem, edhe ne dëshirojmë të kujtojmë se toponimia antike e Shqipërisë, në një pjesë të madhe të saj, ndërrimi fonetik nga format e lashta në forma të sotme, mund të shpjegohet vetëm me ndërmjetësimin e gjuhës shqipe e jo me ndonjë gjuhë tjetër – sllave, gjithsesi jo. (Barić, Ime reke Bojane, Slavistična revija, Ljubljana 1950).

Merita e **Bariqit**, pos të tjerash, është se ai, duke shoshitur fondin leksik të gjuhës shqipe, ka arritur t’i nxiste studimet etimologjike të saj me qëllim që ta veçojë sa më objektivisht thesarin e huazuar leksik nga pjesa indoevropiane e tij. Sa i përket metodës shkencore të tij, linguisti italian Vittore Pisani thotë kështu: “Në manualin e tij – Hyrje në historinë e gjuhës shqipe (1955), H. **Bariq** ka shqyrtuar disa probleme të gjuhës shqipe duke i krahasuar me marrëdhëniet nga familja e gjuhëve indoevropiane. Manuali është vlerësuar si vepër që i ilustron besnikërisht parimet indormative të një repertori tradicional sipas të cilave gjuha është diçka që, në esencë, i përgjigjet stadi të vet fillestar.

Romanisti dhe ballkanologu P. Skok, në fondin leksikor të gjuhës shqipe, e ka studiuar kryesisht ndikimin e latinitetit ballkanik; e ka hulumtuar toponiminë në tokat sllave të jugut. Duke prekur disa toponime në Shqipëri, p.sh. Shkodra, Buna dhe Durrësi, në format fonetike të sotme nuk sheh ndërmjetësimin e gjuhës shqipe në kalimin nga format e tyre të

hershme në të folurit bashkëkohës. Ballkanologu i njohur jugosllav është marrë edhe me kërkimet e lashtësisë së popullit shqiptar dhe të gjuhës së tij. Këtu ai, me përjashtime të rralla, ka ndjekur mendimin e albanologut të Vjenës, Norbert Joklit, sipas të cilit, toponimia shqiptare flet kundër vazhdimësisë së shqiptarëve në viset e tyre të sotme; me fjalë të tjera, djepi i hershëm i shqiptarëve pandehet diku tjetër, atje ku arrinin ilirët e trakasit. Shqipëria veriperëndimore nuk mund të supozohej si vendbanim i hershëm i tyre, por, si thamë pak më parë, djepi paraparak i shqiptarëve duhet të kërkohet në Dardaninë e lashtë (*Zeitschrift für Ortsnamenforschung*, IV).

Me punën e vet aktive në studimin e problemeve të shumta në degë të ndryshme të shkencës albanologjike, Skok zë vend me rëndësi në historinë e albanistikës, prandaj është e pakuptueshme kur në punime të tija hasim edhe në qëndrime që nuk përkojnë me bindjen e tij dhe me gjykimin e rrënjësor në shkencën linguistike. Në të vërtetë, te Skoku gjejmë edhe kësi gjykimi mbi prejardhjen e shqiptarëve dhe të gjuhës së tyre: “Popujt e tjerë të Ballkanit si cicarët, shqiptarët dhe neogrekët nuk i njohin fare huazimet si ‘zhupa’ dhe ‘zhupan’. Edhe ky fakt negativ mund të shpjegohet. Rumunët ballkanikë mesjetarë, nga të cilët rrjedhin cincaret e shqiptarët, kanë jetuar në katundet e veta shëtitëse si blegtorë nomadë, duke u shpërngulur me tufat e veta nga viset e larta në rrafsh”. (Petar Skok, *O etimologijskom rječniku hrvatskog ili sprskog jezika*, Filologija, I, f. 17, Zagreb 1957). Në qoftë se Skoku ka formuar edhe një bindje të tillë, është dëm që këtë nuk e ka arsytuar edhe me argumente.

Për shkak të rëndësisë vendimtare që ka toponimia historike për autoktoninë e shqiptarëve në trevat në të cilat banojnë dhe jetojnë sot së paku që prej periudhës antike, do të ndalemi shkurtimisht në disa probleme të saj. Sot është gabim i pafalshëm, por edhe më parë konsiderohej kështu, në qoftë se studimi i toponimisë së Shqipërisë, si thotë Çabej, trajtohet ashtu që merret harta gjeografike dhe nxirren prej asaj mekanikisht disa emra të lokaliteteve pa i sistemuar sipas kriterit të qëndrueshëm kronologjik dhe mbi këtë bazë ndërtohet gjykimi mbi autoktoninë e

shqiptarëve, duke pohuar se ata nuk kanë qenë banorë të lashtë të hapësirave të Ballkanit të lashtë. Sa u përket emrave të lokaliteteve kryesore në territorin e Shqipërisë, ata, pa fije dyshimi, kanë prejardhje të huaj, por, kur është fjala për formën fonetike të tyre, ata, në pjesën më të madhe tregojnë zhvillimin gjuhësor prej formave të vjetra të tyre deri te format e sotme në pajtim me ligjet fonetike të gjuhës shqipe, kështu që forma e sotme e tyre mund të shpjegohet vetëm me mjetet e shqipes e jo të ndonjë gjuhe tjetër të Gadishullit Ballkanik – theksojnë Çabej dhe Cimochowski (Buletini i Universitetit të Tiranës, 1958/II). Rezervën që e ka bërë Jokli në kohën e vet në lidhje me analizën etimologjike të disa toponimeve në rajonin e Shkodrës e të rrethinës së saj, me fjalë të tjera, pikërisht në kohën kur, duke bërë përpjekje për ta shpjeguar krijimin fonetik të toponimit të Shkodrës dhe të disa lokaliteteve në rrethinën e saj, nuk e ka pasur parasysh kushtin – kronologjinë në zëvendësimin e disa konsonanteve indoevropiane dhe të grupeve konsonantike në fazën më të vjetër të gjuhës shqipe. Çabej e ka parë këtë gabim të Joklit.

Gustav Meyeri, një dijetar pozitiv kishte konstatuar që në leksikon historik të shqipes ka një sasi të vogël, sidomos të kulturës materiale të trevës mesjetare, të hurë në kohën parahistorike, protohistorike ose antike nga ndonjë gjuhë jo indoevropiane e kësaj treve apo e orientit të vjetër. Nga fusha e bimisë, Meyeri shfaq mendimin se fjala shqipe *shegë* vinte nga një gjuhë lindore, nga e cila për mendimin e tij rrjedh edhe sidhe – emri i kësaj peme në greqishten, Nuova antologia, 50, (1885).

Linguisti sloven Karel Oshtir ka zbuluar në gjuhën shqipe një numër bukur të madh të inventarit leksik nga pellgu mesdhetar. Sa i përket të ashtuquajturit fond leksikor alorodik në gjuhën shqipe, mendimet e shkencëtarëve janë të ndara dhe hyjnë kryesisht në fondin leksikor joindoevropian. Por, Çabej ka deklaruar se mohimi a priori i tij nuk do të ishte konfirmim i qëndrimit shkencor objektiv. Ato pak elemente leksikore alorodike në gjuhën shqipe janë provë e gjallë dhe dëshmi e fortë se shqiptarët që nga lashtësia, në çdo rast që nga antika, banojnë edhe në viset mesdhetare, nga njëra anë, dhe janë vërtetim i marrëdhënieve shumë

të ngushta me fqinjët grekë e romakë, nga ana tjetër, fakt ky që flet për karakterin evropërimor të kulturës së shqiptarëve.

I. **Popoviq** - një studiues i ri nga shkolla sllavistike e Universitetit të Beogradit, me hapa të guximshëm la pas traditën, duke thyer paragjykimet se serbokroatishtja s'është e trazuar me elemente leksikore, të hyra së jashtmi dhe tregoi se në tëfolmet serbe e maqedone në inventarin e tyre, kanë një leksik të përfillshëm të shkuar atje nga gjuhët e tjera, edhe prej idiomave shqiptare

Sa u përket çështjeve të rrahura këtu, si I. **Popoviqi** edhe studiuesit e tjerë jugosllavë shkojnë pas hullisë në të cilën ecnin mësuesit e tyre (Skok, e Bariq), I **Popoviqi**, për më tepër, u tregua këmbëngulës në gjykimet e tij mbi problemet në shqyrtim duke ndjekur pikëpamjet e dijetarit sovjetik Selishçev – Popullsia sllave në Shqipëri, Sofje, 1931).

Profesori Radosav Katiçiç, mbi etnogjenezën e shqiptarëve dhe të gjuhës së tyre, në një rast ka thënë edhe kështu: “Kryesisht në saje të kontributit të lingistikës shqiptare, të parashtruar në rend të parë në punimet shkencore të E. Çabejt, shohim se, në lidhje me prejardhjen e gjuhës shqipe edhe të lingvistët më të shquar shpeshherë ka pasur përfundime të shpejtuara. Çabej, si dihet përgjithësisht, ka treguar se argumentet kundër prejardhjes ilire të shqipes, me të cilat mendohej se mund të mohohesh mundësia e interpretimit të marrëdhënieve gjuhësore – nuk mund t'i qëndrojnë një shqyrtimi kritik sado pak serioz që mund të bëhej në dritën e fakteve përkatëse. Nuk ka mbështetje bindëse gjuhësore që të mund të na shtynin ta hedhim poshtë prejardhjen ilire të gjuhës shqipe” (Studia albana, II, Tiranë, 1972, 269-274). Në një vend tjetër, profesori Katiçiç shton: “Bei dieser Lage unseres Wissens drängt sich der Schluss formlich auf das Albanische sei eine moderne Form des illyrischen”, Die Sprachen im Römischen Reich der Kaiserzeit, Kolloquium von 8 bis 10 April, 1974, Bon, 1980, f. 115.

Duke përmbledhur gjithë ç'thamë, do të konstatojmë se albanologët jugosllavë, si të gjeneratës së paraluftës e nga pak edhe të asaj të pasluftës, për mungesë të zotërimit të historisë së gjuhës shqipe dhe të zbatimit të

metodave të braktisura në studimet nga problematika albanologjike, ofrojnë në skema të vjetra në petka të reja, e përsërisin teorinë tashmë të njohur në pjesën më të madhe të vjetruar a të ndryshuar, që nuk ofron asgjë të re të rëndësishme dhe nuk i avancojnë në asnjë pikëpamje rezultatet e njohura.

Në Akademinë Serbe të Shkencave dhe të Arteve në Beograd, gjatë vitit 1986, është mbajtur një cikël ligjëratash rreth temës: “Ilirët dhe shqiptarët”, të cilin e ka organizuar Këshilli Ndërkademiq për Studimin e Kosovës në bashkëpunim me Repartin e Shkencave Historike të ASSHA në qershor të vitit 1986. Të pesë ligjëratat e mbajtura janë publikuar në një botim të veçantë në vitin 1988.

Bie në sy se ndër ligjëratat e mbajtura asnjë nuk është nga fusha e lingistikës. Kjo mungesë është e dukshme. Problemi i prejardhjes dhe i krijimit të ilirëve të lashtë dhe të shqiptarëve është trajtuar kryesisht nga aspekti arkeologjik dhe historik.

Kjo ndërmarrje e Akademisë, si thuhet edhe në hyrjen e redaktorit dhe në fjalën hyrëse të akademikëve, është reagim i drejtpërdrejtë ndaj shkrimeve të shumta gjithnjë e më të shpeshta të trajtimeve shkencore të kësaj problematike në shkencën shqiptare, e cila po arrin rezultate gjithnjë më të mëdha në të gjitha disiplinat albanologjike dhe është bërë faktor që s’mund të mos përfillet në trajtimin e etnogjenezës së popullit shqiptar dhe të gjuhës së tij.. Është interesante të theksohet se autorët e ligjëratave të parashtruara, të përfshira në këtë cikël, të preokupuar nga miti i Kosovës, duke harruar qëndrimet e veta të mëparshme në lidhje me gjenezën e shqiptarëve dhe të gjuhës së tyre, pajtohen me ata ithtarë të cilët gjenezën e këtij etnosi paleoballkanik e shohin jo si mbetje ilire, por konsiderojnë se në formimin e tij rolin më të madh e kanë luajtur mbetjet e elementeve të ndryshme të substratit të vjetër paleoballkanik.

Në librin “Ilirët dhe shqiptarët” (“Iliri i Albanci”) prej gjashtë ligjëratave të mbajtura janë publikuar pesë. Në këtë libër mungon teksti i ligjëratës së profesorit Jovan Kovačević: “Shqipëria dhe vendet fqinje prej shekullit VII deri në shekullin IX”. Titujt e pesë ligjëratave të tjera janë: Milutin Garashanin – Krijimi dhe prejardhja e ilirëve; Fanula Papazoglu –

Mbretëria ilire dhe dardane; Vladislav **Popoviq** – Shqipëria në antikën e vonë”; Bozidar Ferjançiq – Shqiptarët në burimet bizantine; Sima Çirkoviç – Shqiptarët në dritën e burimeve të sllavëve të jugut”; Shqyrtime të përfundimtare (M. Garashanin).

Qëllimi kryesor dhe i vetëm i ekspertëve të shquar në shkencat përkatëse të Akademisë Serbe të Shkencave e të Arteve ka qenë mohimi i tezës ilire mbi prejardhjen e popullit shqiptar dhe të gjuhës së tij. Shkencëtarët e disiplinave albanologjike e kanë fare të qartë se problemi i etnogenezës së shqiptarëve është shumëdisiplinësh, prandaj edhe në këtë rast konkret, mungesa e multidisiplinaritetit, sidomos nga pikëpamja linguistike e çështjes, është mashtrim i pafalshëm. Ç’është e vërteta, në këtë cikël të ligjëratave, Vladislav Popoviq, pasi kishte informuar për rezultatet e shkencës shqiptare mbi prejardhjen e formimin e shqiptarëve (megjithëse kompetencat personale të tij janë shumë larg nga njohja e saj) ka kontribuar, që sado kudo, edhe linguistika dhe arritjet e saj të jenë të përfaqësuar në këtë çështje komplekse të prejardhjes së etnosit të lashtë shqiptar.

Trajtimi i çështjes së prejardhjes së etnisë parashqiptare është një lëmsh kompleks: popujt paleoballkanikë – ilirët dhe trakasit etj., për fat të keq, nuk na kanë lënë kurrigjë nga dokumentet e shkruara dhe dëshmitë mbi jetën e tyre; gjuha shqipe me siguri është vazhdim i drejtpërdrejtë, përkatësisht faza e re e njëjës nga gjuhët e lashta paleoballkanike – ilirëve ose trakasve. Meqenëse jemi në gjendjen e mosnjohjes së plotë të gjuhëve të etnikumit të Ballkanit të lashtë, si *conditio sine qua non* na imponohet njohja e plotë e kulturës së popullit shqiptar dhe e gjuhës së tij me thellimin në sekretet e zhvillimit të saj veçmas të fonetikës historike të saj. Në lidhje me gjithë këtë theksojmë se në studimin e historisë së gjuhës shqipe gjurmë të qëndrueshme lë vetëm ai shkencëtar – albanolog, i cili arrin t’i mbizotërojë si fazat më të vjetra të zhvillimit të kësaj gjuhe, ashtu edhe gjendjen bashkëkohëse të saj. Na duhet të themi edhe se ndër shkencëtarët jugosllavë, që janë marrë me çështjet e historisë së gjuhës shqipe, të tillë, fatkeqësisht, nuk ka pasur dje e nuk ka as sot ndër bashkëkohësit.

Mungesa e zotërimit sovran të ligjshmërive fonetike të gjuhës shqipe

ka qenë pengesë e pakalueshme për “albanologun” Popoviq që, në lidhje me toponiminë historike në mjediset shqiptare, ta shprehte mendimin e vet personal, prandaj ka qenë i detyruar të pranojë gati gjithçka nga ajo që është servirur qëmoti në lidhje me këtë çështje. Popoviq nuk ka qëndrim të tij personal as rreth çështjes se a janë shqiptarët autoktonë në territorin e vet historik: pranon lehtë dhe pa mëdyshje mendimin e filologut sovjetik Selishçev dhe të sllavistit më të ri, të ndjerit I. **Popoviq**, se sllavët, në dyndjen e tyre në atdheun historik të shqiptarëve nuk kanë hasur në kurrfarë pasardhësish të tyre. E sikur Vl.Popoviq, rastësisht, të kishte shikuar në terminologjinë e krishterë kishtare të gjuhës shqipe, do të bindej qind për qind se ajo është krejtësisht me prejardhje latine: kishë, lter, prift, mëkat, djalë, kreshmë, qelq, kangë, këngë, kuvend, pagëzoi, shpirt, shelboj, mreku, dreq, ungjill, kryq, famull. Së këndejmi del se sllavët të shqiptarët e kanë gjetur kishën e organizuar e cila nuk kishte nevojë për shprehje të reja plotësuese dhe se procesi i kalimit të parashqiptarëve në krishterim nuk është zhvilluar në bashkësi me sllavët, të cilët, në atë kohë ende kanë jetuar në anën tjetër të Karpateve. Kur jemi të huazimet latine të gjuhës shqipe, nuk do të duhej harruar fakti se ato kanë filluar të depërtojnë në këtë gjuhë që në shekullin II të erës së vjetër, në kohën e paganizmit, për çka tregojnë edhe disa huazime, si Diana: Zana, etj. E njohësit e shkëlqyeshëm të gjuhës shqipe kanë konstatuar se ajo, në veten e vet, fsheh fuqinë magjike të vërtetimit në zbërthimin e lëmshit të çështjeve enigmatike të prejardhjes, të vendit të krijimit dhe të zhvillimit të etnosit shqiptar; zbulon lidhjet dhe marrëdhëniet me popujt fqinjë dhe ndikimet e tyre të ndërsjella në kulturë dhe në gjuhë. Me anë të gjuhës shqipe dhe të dialekteve të saj, një ekspert i shkathët do të ishte në gjendje ta trajtojë dhe ta shpjegojë në mënyrë precize ndërrimin fonetik të toponimeve në ngulime të lashta të popullit shqiptar, si Scodra – Shkodër; Lissus – Lesh, Lezhë; Mathis – Mat; Drinus – Dri-ni; Drivastum – Drisht; Dyrachium – Durrës; Valona – Vlonë, Vlorë; Scupi - Shkup; Astibos - Shtip; Scardus mons – Sharr; Dardania – Dardhë etj.

Me lashtësinë e vet, huazimet e vjetra greke dhe latine të shqipes

zbulojnë shtresimin kronologjik të leksikut të saj, e me këtë edhe ligjësitë fonetike të gjuhës shqipe. Në zgjidhjen e problemeve të përmendura të popullit shqiptar gjuha e tij përfaqëson themelin e saj, ndërsa rezultatet e shkencave të tjera, siç janë arkeologjia dhe historia, kanë domethënie ndihmëse dytësore.

Cikli i ligjëratave të publikuara në librin “Ilirët dhe shqiptarët”, i menduar me pretendime të mëdha, nuk ka arritur t’i lëvizë nga vendi të arriturat në fushën e gjurmimit të problemeve kryqëzore rreth marrëdhënieve farefisnore të ilirëve të lashtë dhe të shqiptarëve pasardhës të tyre. Autorët e ligjëratave të përmendura, sipas të gjitha gjasave, si kemi theksuar edhe më parë, qëllim themelor kanë pasur që, duke sakrifikuar bindjet e tyre të mëparshme, të bëjnë përpjekje që t’i problematizojnë lidhjet farefisnore të ilirëve dhe të shqiptarëve, sikur këta nuk janë pasardhës të ilirëve, por se “në formimin e shqiptarëve (dhe të gjuhës së tyre - vërejtja jonë) rol më të rëndësishëm kanë luajtur mbetjet e elementeve të ndryshme të substratit të vjetër paleoballkanik: ilire, dardane e trakase” (M. Garašanin, *Iliri i Albanci*, 366). Në lidhje me këtë doemos shtrohet një çështje: linguistika ka përcaktuar pavarësinë e gjuhëve të përmendura si anëtare të veçanta të bashkësisë gjuhësore indoevropiane e një lidhje e tillë mekanike e vështirëson dallimin e elementeve të ndryshme gjuhësore arbitrarisht të integruara me reflekset diametralisht dispartiste të vokaleve dhe të konsonanteve indoevropiane në gjuhën e sotme shqipe të njësuar. Bashkimi i elementeve të ndryshme gjuhësore në gjuhën parashqipe në asnjë mënyrë nuk do të mund të përfundonte me transformimin fonetik krejtësisht unik të huazimeve leksikore të greqishtes së vjetër, të latinishtes, të sllavishteve etj. në gjuhën shqipe dhe në të folmet e saj.

Duke i përfunduar këto disa mendime tona me vështrimin në kontributin e disa punonjësve linguistikë të gjeneratave të mëhershme dhe të punonjësve bashkëkohës në studimet albanologjike, me keqardhje kemi konstatuar një përparim të përkorë të studimeve në ciklin e ligjëratave “Ilirët e shqiptarët”, të organizuar nga Këshilli i përmendur Ndëraka-

demik i Akademisë Serbe të Shkencave në vitin 1986 – me të vetmin qëllim që me mjegullimin e problemit të prejardhjes së shqiptarëve dhe të gjuhës së tyre të shkaktojë mëdyshje dhe turbullime në çështjen edhe kështu komplekse të prejardhjes së shqiptarëve në hapësirat e Gadishullit Ballkanik.

Akademiku M. Garashanin, redaktor i këtij edicioni, me ndrojtje i përfundon shqyrtimet përfundimtare të librit “Ilirët e shqiptarët” me fjalët: “Kemi frikë se qëndrimet e parashtruara këtu, të bazuara në vështtrimin interdisiplinar të problemit të ilirëve e të shqiptarëve nuk do të pranohen nga shkenca shqiptare. Mirëpo, do të ishte mirë sikur shikimi i këtillë i problemit t’i nxiste shkencëtarët shqiptarë për pranimin e diskutimit të tyre. Kjo do të ishte në dobinë e shkencës shqiptare e jugosllave edhe evropiane”.

*Shkruar në vitet nëntëdhjeta të sh. XX; botohet për herë të parë te
Shqiptarët dhe gjuha e rtyre, ASHAK*

PATOLOGJIA E NJË SIMETRIE

Në trashëgiminë kulturore në vështrimin e saj më të përgjithshëm nga të periudhave të hershme të Ballkanit, një vend të rëndësishëm zë toponimia si tërësi e emërtimeve të vendeve të ndryshme me toponomastikën-një degë e gjuhësisë që merret me kërkimin, shpjegimin e burimit dhe me vështrimin e nomenklaturës gjeografike.

Studiuesit e kësaj dege të gjuhësisë përsërisin përhera gjykimin e tyre, që të merresh me punë të nomenklaturës gjeografike paraqet vështirësi shpeshherë të pakapërcyeshme. Gjurmuesit e temave nga ky truall studimesh duhet të jenë të armatosur me njohjen e kulturave dhe të gjuhëve të ndryshme të popujve që në rrjedhë të moteve kanë jetuar në këto anë, duke lënë gjurmë të thella edhe në relievin dhe emërtimet gjeografike të këtyre tërthoreve tona. Ata vënë në dukje sidomos nevojën e madhe për zotërimin e veçorive dialektore të të folmeve të ndryshme që janë folur në këto vende tona në kohë të mugëta.

Meqë, pothuajse të gjithë studimtarët e kësaj dege pajtohen në mendimin që kjo është një fushë kaq komplekse kërkimesh, është e nevojshme të përsoset përherë metodologjia dhe rrugët që do të ndiqen në hetimin, bie fjala të nomenklaturës gjeografike. Paragjykimet subjektive duhen lënë mënjanë e të udhëhiqet prej frymës objektive në punë të tilla kërkimore-shkencore.

Mbi përfundimet shkencore, që rezultojnë nga studimet e degëve të ndryshme, si arkeologjia, etnografia, historia e sidomos nga gjuhësia krahasuese, në këto anë tona janë konstatuar shtresa gjuhësore të ndryshme; në fushë të emërtesës gjeografike mbijetojnë sot e gjithë ditën shumë emra toponimesh që trashëgohen popull pas populli, gjulhë pas gjuhësh për vështrimin e të cilëve dija e gjuhësisë edhe sot sillet në labirintin e kombinimeve pa qenë e zonja t'ua gjejë fillin atyre.

Me siguri të madhe janë konstatuar në territorin e Ballkanit të lashtë emërtime toponimesh që mbijetojnë edhe sot në këto anë tona nga gjuhë të popujve paleobalkanikë: ilirë, makedonë, trakë, dakë etj., të shuar si etni e gjuhë. Mbi sa dihet në shkencën e gjuhësisë komparative për tipat dhe veçoritë e atyre gjuhëve janë gjendur përkatësitë gjuhësore të një vargu emërtimelesh gjeografike. Në këtë mes nuk duhen harruar sferat e ndikimit kulturor të qytetërimit grek e latin me përcaktimet të përpikta të zonave kulturore të tyre. Mbi njohjen e tipareve gjuhësore të dy gjuhëve klasike është caktuar vija e demarkacionit të zonave kulturore të tyre, që niset nga jugu i Shqipërisë, përshkonte krahinat jugore të Maqedonisë dhe vazhdonte duke dalë në qendrën e atëhershme të Konstantinopolit (Stambolli sotmë). Scupi me Scardus mons (që nga ato kohë vazhdojnë në shqipen si Shkup dhe Sharr) i takonin një kulture e gjuhe jo greke, kurse, Astibos ishte një serë kulturore greke (nga ASTIBOS) me reduktimin e silabës nistore të pathekse, një rregull e stabilizuar që sundonte në gjuhën shqipe u përftua Shtip me shurdhim të okluzivit fundor $b=p$ aq i shpeshtë në këtë gjuhë. Emërtimi Skopje e Skoplje është diçka më i vonë, i dalë nga shqiptimi grek i këtij toponimi: Skopia-Skopje-Skopje.

Në lidhje me përkatësinë e këtyre toponimeve në këtë apo atë gjuhë, me këtë apo atë vështrim, shkenca nuk di shumë; ajo megjithatë mund të thotë me siguri se janë të periudhave antike, pra në format e tyre të para nuk janë as greqishtja, as latinishtja, as shqipja, as sllavishtja, porse në lidhje me Scadrus mond=Sharr shihet mungesa e ndërmjetësisë sllave e likuidametezës, eky ndërmjetësim del përkundrazi te Scardoma e Dalmacisë në Skradin. Kalimi i një forme Scodra të kohës antike në Shkodër-n e sotme është në pajtim të plotë me ligjet fonetike të shqipes, të njëjtin kalim e gjejmë në Scupi-Shkup.

Me përjashtime të pakta, si Ulpiana antike, sot Lipjan, Lipjan e ndonjë tjetër, emërtime të hershme, parasllave, në territorin e Kosovës nuk janë ruajtur, qytetet e kësaj krahine mbajnë emra relativisht të rinj, nga periudha e mesjetës dhe janë kryesisht sllavë: Prizren, Prishtina, Peć-Pejë. Prizren “majë mali që së largu duket sikur të ishte afër, Ozren “një majë

mali që së largu duket nga të katër anët”.

Ka, ndërkaq, në mikrotoponiminë e Krahinës emra oronimesh me prejardhje latine: Shur Zhur jo fort larg nga Prizreni që e bien të ardhur nga latinizma sabura “zall, rërë”. Duke ndjekur kurrizin e maleve, ndeshim në Qafën e Prushit që të kujton emrin e fisit ilir Pirustae, Perustae. Në këtë zonë kufitare gjendet masivi i njohur i maleve Bjeshkët e Nemuna (Prokletije) – një vend shumë i thyeshëm e i vështirë; ky anonim mban dy emra: një shqip, tjetri serbisht: Bjeshkët e Nemuna – Prokletije. A kemi të bëjmë me ndonjë kalkim (përkthim) apo me një zhvillim spontan paralel, kjo është vështirë të diktohet.

Emri i qytetit të *Pejës*, turq. *Ipek*, është përshtatje fonetike e emërtimit sllavisht të tij – Peć, që semantikisht lidhet me peć – pećina “ngush-ticë a shteg i thellë mali ku mund të kalohet, vend i ngushtë e i thellë midis dy maleve zakonisht gjatë rrjedhës së një lumi a përroi”. Mendimet e tjera që në kohë të fundit janë shfaqur për burimin e këtij emërtimi, shkencërisht nuk kanë kurrfarë mbështetjeje shkencore.

Shoshitja e visarit leksikor të shqipes dhe studimi etimologjik i tij, ka arritur shkallën më të lartë që realisht mund të mendohet në kushtet e sotme. Të operosh sot me një metodë të tillë njohëse, që për fat të keq ka zënë e po zbatohet nga ndonjë studues fillestar këtu te ne, nuk do të thotë gjë tjetër veçse të bësh punë prej diletanti.

Në Krisobulat e Deçanit, që datohet në shekullin XIV, është regjistruar një oronim sot toponim i quajtur Unjemir (Ujumirë). Këtë emërtim sot e mban një katund në kapërcell të Drenicës me të Rrafshit të Dukagjinit (të Metohisë). Më vonë emrit Ujumirë nga bartësitë e serbishtes së këtyre anëve u mor edhe u përkthye me Dobra Voda. Një varg studimesh Ujumir-in, e kanë çuar e çojnë edhe sot te shqipja ujë+mirë. Në këta vjetët e fundit një sllavist (Mitar Pešikan) ka arritur në përfundim se Ujumiri mund të jetë një emër i përveçëm sllav, që nuk ndeshet kund në gjuhët e sllavëve të jugut, porse është ruajtur në onomastikën e sllavëve jashtë Ballkanit. Një mendim i tillë në vështirë të parë nuk mund të hidhet poshtë, mirëpo në lidhje me të nuk mund të mos mbahet parasysh një rrethanë, ajo pse

mos të jetë regjistruar ndokund në gjithë arealin gjuhësor të sllavëve të jugut dhe në mbarë toponiminë sllave të Gadishullit Ballkanik. Mungesa e emërimit të tillë në tërthoret e hapëta ballkanike e bën të dyshimtë vërtetësinë sllave të Ujmirit.

Përgjatë Grykës së Ibrit plak në anën e tij të djathtë, që nga mesjeta nxirren xehe të çmuara mineralesh të ndryshme, vetë emri topik i *Kopaonikut*, më parë i *Kopalnikut*, dëshmon për pasurinënëntokësore të atij masivi malor. Emërtimet Trepça e Zveçan tregojnë gjithashtu se ky zgrip i Kosovës në fund të mesjetës ishte zonë e pasur mineralesh. Mbeturina të një kulture për nxjerrjen dhe përpunimin e minieraleve, ruhen edhe sot në shpatijet e Shalës së Bajgorës. E prurë punën te këto dy emërtime gjeografike, të cilat, për disa arsye na kënda t'i shpjegojmë nga pikëpamja etimologjike e tyre. E do puna të sqarohen ato, sepse nga ana e zberthimit të tyre nuk ka pajtime në rrethet e studiuesve të onomastikës.

Bajgorë-n, emër me të cilin emërtohet një ose më shumë katunde të krahinës së Shalës te Mitrovica e Kosovës, në pikëpamje të prejardhjes së saj një lagje studiuesish e kanë çuar te baza bajgë (*balgë*) e pajisur me sufiksin pronor –or- ore (Çabej). Një burim të tillë ne nuk e shohim të mundshëm, sepse do ditur që në vetë qendrat administrative, në kohën e sundimit turk, edhe në këto anë kishte emra topikë me origjinë turke. Emërtime gjeografike me turqizmin bair; bajr “kodër, shpat-, një faqe e shpatit” janë të shpeshta te ne brenda në qytetin e Mitrovicës së Kosovës një kodër e shpat në rrugën e vjetër për në Prishtinë quhet Bajr prandaj te toponimi Bajgorë kemi të bëjmë me dy emra gjuhësish të ndryshme me të njëjtin kuptim: turq. Air” dhe serb. “gora” me zhdukjen e likuides r.

Mbi bazën e apelativit toskë “balgore” – “kosh i madh i lyer brenda e jashtë me baltë e me bajgë, që përdoret për të mbajtur drithë” nuk gjen shpjegim emërtimi i gjithë një katundi a krahine qysh gjykon Çabej (Studime etimologjike në fushë të shqipës, II, A-B, f. 133). Në gegërishten e këtyre anëve nuk është ruajtur kund trajta *Bajgë* e së parës *balgë*, por vetëm ajo metatetike *bagël*.

Duam të sqarojmë toponimin *Shala*, që emërton gjithë një krahinë e

që edhe nëpër stdime përkatëse pandehet i dalë nga *shala e kalit* – një latinizëm nga *sella*. Ka shumë të dhëna e mbështetje dialektore që e kundërshtojnë një burim të tillë. Çabej është i pari hulumtues që kishte persiatuar ekzistencën e një lidhjeje tjetër gjuhësore të toponimit në fjalë. Ka në gjuhën shqipe apelativa të tjerë që e largojnë toponimin tonë nga kuptimi i “shalës së kalit”: një *shalë* emër luleje *Borrago officinalis*, *shalë*, *shalëz*, *shalësinë*, “tokë mashkullore jo e gratshme”; një shalë del në shumë emra arash, kullotash e që të gjithë këta emra, me përjashtim të shalës së kalit, lidhen me emrin topik *Shala* (Shala e Bajgorës).

Fjala shqipe ka shkuar jashtë truallit gjuhësor të shqipes; dijetari Jovan Erdeljanović e kishte regjistruar në Cucët e nahijes së Katunit, në Mal të Zi me formën *Šaljeze* (shqip Shalëz, një emër uji).

Emri i Prishtinës – relativisht i ri, në qoftë se do të mbahet i drejtë gjykimi i Skokut, në thelb do të jetë një prišt, “fshikë, fshikëz”, që më vonë ka hyrë në bazë të shumë emrave e të foljeve, sikur janë serbisht prsnuti, prasnuti, briznuti, brizgati; aty do të hyjë edhe *Prištevka*, një degë e lumit të Sitnicës si edhe vetë emërtimi i Prishtinës. Bien poshtë të gjitha kombinimet e tjera që thuren mbi prejardhjen e këtij toponimi. Emrat e qyteteve dhe të qendrave të tjera më të vogla në krahinën e Kosovës janë formime edhe më të reja. Ferizaj është një qendër banimi relativisht e re, mendohet qënë atë truall njëfarë Ferizi tregtar kishte ngritur dyqan me bujtinë ku dredhonin e bunin tregtarë e udhëtarë që merrnin rrugë për në Shkup e vende të tjera. Pas ndërtimit të hekurudhës Kralevë-Shkup nga fundi i shekullit XIX aty u ngrit stacioni hekurudhor sipas të cilit i gjithë ngulimi i ri u quajt Tasion. Pas luftërave ballkanike, me vendosjen e pushtetit serb në Kosovë, emrat e disa vendbanimeve dhe të qendrave të vogla morën emërime të reja, njëri ndër to është edhe Ferizaj a Tasjoni, që u ripagëzua Uroševac me të cilin bashëjetuan duke u përdorur nga popullsia shqiptare dy emërtimet e para: Ferizaj dhe Tasjon.

Dihej edhe më parë, por në këtë mes gjeti vërtetimin e vet përdorimi shumëgjuhësor pothuajse i shumicës dërrmuese të toponimeve në Kosovë. As aktet më të larta juridike federative dhe republikane të shtetit mbi të

cilat mbështeten themelet e Federacionit jugosllav nuk përqendron ndonjë dispozitë me të cilën kufizohen të drejtat e kombeve dhe të kombësive tona për përdorimin e gjuhëve dhe të toponimeve në pajtim me traditën dhe ligjet fonetike të gjuhëve të tyre. Prandaj nuk kanë kurrfarë të drejte ata që kërkojnë kufizim dhe njësim të emrave të përveçëm dhe të emërtimeve gjeografike. Njëherë se çënohen të drejtat e paprekshme të kombeve dhe të kombësive tona të garantuara me aktet themelore të bashkësisë sonë socialiste, në një anë dhe në anën tjetër se ulet prestigji i lartë që gëzon vendi ynë në katër anët e botës. Do të bëheshim gaz i dheut po të preknim në të drejtat e qytetarëve të bashkësisë sonë vetëqeverisëse në sytë e popujve të kontinentit plak të Evropës.

Hapeni çfarëdo harte gjeografike që të doni e do të shihni se gjurmë të botës sllave mbijetojnë në Gjermaninë Lindore, Austri, Hungari, Rumania, në anën lindore të Republikës Demokratike Gjermane do të takoni Feistritz (Bistrica), Rudeneck (Rudnik), Leibnitz (Lipovica). Në Austri emri i qytetit Graz është identik me Gradac. Toponimia e Rumanisë është përplot me emra e emërtime gjeografike sllave: Budin e Peshta, Peçuj, Velika Kaniža, Estergon, Dombovar, Solnik, Vesprem, Çongrad (Crn Grad, Crn Grad, pandan i Belgradit).

Përkundër rivalitetit të egër midis botës sllave dhe asaj gjermanike që është arritur në Gjenocid kundra fiseve e popullsive sllave, historia kulturore e përbotshme nuk ka regjistruar ndonjë kërkesë që të ndërrohen toponimet sllave në krahinat gjermane, austriake, hungareze, rumune etj.

Kam dëgjuar që Ahmet Zogu në kohën e sundimit të egër në Shqipëri kishte pasë menduar të urdhëronte ndërrimin e emrave të shumë toponimeve sllave në vise të ndryshme të shtetit, por, për fat, s'kishte pasë gjetur përkrahje tek intelgjencija e vendit. Pas luftës së fundit, s'kam ndier të jetë ngritur tjetër kund në atë vend ndonjë kërkesë për ndryshimin e relievit në kuptim të shqipërimin të toponimeve.

Shkenca historike dhe gjuhësia komparative kanë dëshmuar me kohë praninë sllave në toponiminë e Greqisë, jo vetëm pjesët kufitare jugo-sllavo-greke, por edhe thellësi i stolisin qyteza, katunde e vende të shumta

të emërtuara sllavisht e shqip. Studimtarët e qytetërimit grek thonë për më tepër se gjurmët sllave në toponiminë e Greqisë, janë vonë-vonë të mesjetës së hershme. Për një pjesë bukur të mirë të toponimeve në anë të ndryshme të Greqisë, siç janë Gardhiqi, Kriekuqi, Hundekuqi, studiuesit e onomastikës nuk kanë rënë në një fjalë, nuk pajtohen as sot kur është fjala për gurrën dhe vështrimin e tyre. Në lidhje me rrjedhën e këtyre emërtimeve në truall të Greqisë bie në sy një gjë, ajo që te forma e Gardhiqit mungon likuidametateza, një dukuri aq e qëndrueshme fonetike, e kryer gjithherë e gjithkund pa përjashtime në gjuhët e sllavëve të jugut dhe në toponiminë e tyre. Vetëm kaq mjafton që prejardhja sllave, gjoja Gardiç. Krivokuc – Hudokući e toponimeve në fjalë të vihet në dyshim dhe të kërkohen rrugë të reja për sqarimin e tyre. Po të përjashtohet greqishtja, në vështirm vjen vetëm prejardhja nga shqipja me Gardhiqin, Kriekuqin (kryekuqin), Hundëkuqin – emërtime toponimike aq të shpeshta në truallin gjuhësor të shqipes.

Bota e qytetëruar nuk është në dijeni pëor ndonjë hap të popullit grek a të pushtetit të tij për “pastrim” të relievit të atdheut të tij nga trysnia “barbare” në fushën e nomenklaturës gjeografike të vendit.

Ne vetë nuk mund ta kuptojmë ngulmin me të cilin po kërkohet unifikimi i toponimeve në disa vende të bashkësisë Ssonë socialiste që shkurt po urdhërohet që të gjitha toponimet të marrin një formë të vetme duke hequr me dekret format e variantet e tjera fonetike që përdoren tradicionalisht në gjuhët e kombësive; me fjalë të tjera të lejohet zyrtarisht përdorimi i vetëm e vetëm: Skopje, Kiçevo, Debar, Ohrid, Bitola e të ndalohen variantet e kombësive Shkup, Yskup, Kërçovë, Dibër, Ohër, Manastir.

Ne jo se jo, por as bota e qytetëruar nuk do të kuptojnë një kërkesë të tillë gjoja për pamjen simetrike të emërtimeve gjeografike, që s’është gjë tjetër veçse kundërshti e papajtueshme me frymën e mirëfilltë të institucioneve tona demokratike.

Parimi njësia brenda ndryshimeve mbetet edhe për sferën e onomastikës me vlerë absolute!

DISA MENDIME MBI SHKRIMET E DISA SHKENCËTARËVE NË SHTYP E NË PUBLICISTIKËN TONË MBI GJUHËN SHQIPE DHE KULTURËN SHQIPTARE

Përbashkësinë e popujve tanë, veçmas të popujve jugosllavë – të serbëve e të maqedonasve - me shqiptarët, që nga mesjeta e hershme, e karakterizon jeta e tyre paqedashëse. Dëshmia më e mirë për këtë, përveç dëshmive të tjera, janë huazimet e shumënumërta në gjuhët e tyre, mandej format e organizimit fisnor etj.

Mirëpo, në periudhat e mëvonshme të luftërave çlirimtare, borgjezitë e disa popujve ballkanikë, të dehura nga sukseset momentale në fushën politike e ushtarake, kanë filluar të shfaqin qëllime pushtuese dhe zaptuese dhe kjo, normalisht, i ka çrregulluar mjaft marrëdhëniet e mira fqinjësore të tyre.

Në bashkësinë jugosllave për një kohë të gjatë konsiderohej se problemi i pakicave kombëtare, përkatësisht i kombësive, është zgjidhur që në kohën e luftës dhe se kësaj s'ka se çka t'i shtohet ngase problemi është zgjidhur njëherë e përgjithmonë.

Ishte ky një mashtrim i rëndë.

Menjëherë pas demonstratave të njohura të marsit e të prillit të vitit 1981 në shënjestër të sulmeve të tërbuara u vunë shkencat albanologjike: historia, gjuha dhe trashëgimia kulturore e popullit shqiptar. Një nga shigjetat e para e goditi tekstin mbi shqiptarët në “Enciklopedinë e Jugosllavisë”. Mohohej këtu emërtimi i disa toponimeve me formën fonetike të gjuhës shqipe në disa pjesë të vendit tonë megjithëse ky emërtim ka qenë përcaktuar e pranuar më parë. Mohohet nga ana historianëve, por jo edhe e linguistëve, ekzistimi i gjuhës shqipe në kohën e sundimit romak në hapësirat ballkanike. Në goditje të disa joprofesionistëve u gjet

edhe çështja e formimit të gjuhës letrare shqipe dhe formimi i saj mistifikohet deri në përmasa monstruoze.

Karel Oshtir, duke u marrë me analizën etimologjike të pjesës indoevropiane të leksikut shqiptar e ka studiuar shtresën indoevropiane të saj dhe numrin më të madh të studimeve të veta shkencore e botoi në të parën revistë Arkivi për lashtësinë, gjuhën dhe etnologjinë shqiptare – *Arhiv za arbanashku starinu, jezik i etnologiju*, Beograd. 1923-1928.

Është shumë i madh kontributi i linguistëve të hauj dhe i punonjësve gjuhësorë të albanologjisë së jashtme për zgjidhjen e çështjeve kyçe të albanologjisë, dhe gjuhësia shqiptare e vendit është shumë mirënjohëse për kontributin, përpjekjet dhe rezultatet e mëdha të tyre.

Nëse dëshirojmë të mësojmë cilat janë, megjithatë, dobësitë e albanologjisë së jashtme, e cila nuk ka qenë immune ndaj tyre, duhet të vërejmë se dobësia e saj është pasqyruar pikërisht në zgjedhjen e metodës shkencore dhe në trajtimin metodologjik të problemeve me të cilat është marrë në mënyrë të gjithanshme dhe të gjerë. Në të vërtetë, ajo, në gjuhën shqipe, i ka studiuar marrëdhëniet që kanë sunduar atëherë midis kësaj gjuhe dhe bashkësisë së madhe gjuhësore indoevropiane; ajo, mandej është interesuar për fondin e huazuar leksikor të gjuhës shqipe që ka arritur tek ajo me rrugë të ndryshme; ka studiuar, pra, probleme jashtëgjuhësore, duke mos përfillur strukturën e brendshme të gjuhës shqipe.

Nga ana tjetër, duhet theksuar se në mjedisin shqiptar nga shqiptarët, pak më herët, lindi filologjia shqiptare, fillet e së cilës nisin në shekullin XVII dhe në burimet e së cilës hartohet Fjalori latinisht-shqip i Frang Bardhit (*Dictionarium latinp-epiroticuk*), Romë, 1635. Gjuhësia shqiptare e vendit, e cila ka marrë hov sidomos në gjysmën e dytë të shekullit XIX, në kohën e Rilindjes Shqiptare e më vonë, deri nga fundi i luftës së kaluar, nuk ka pasur vesh për çështje të mëdha të linguistikës krahasimtare indoevropiane. Ajo ka qenë e kthyer nga problemet gjuhësore praktike të vendit, sidomos nga çështja e krijimit të gjuhës letrare shqipe dhe kujdes të posaçëm i kushtoi sigurimit të teksteve shkollore dhe të doracakëve të tjerë të gjuhës letrare shqipe bashkëkohore.

Megjithëse orientimi i saj ka karakter praktik, gjuhësia shqiptare e vendit, edhe e viteve të mëhershme, ka arritur suksese të rëndësishme në studimin e problemeve morfologjike, sintaktike dhe leksikore të gjuhës shqipe, që kanë shërbyer mirë për studimin e strukturës së gjuhës shqipe bashkëkohore dhe linguistike krahasimtare indoevropiane. Në këtë rrafsh janë angazhuar aktivisht punonjësit shkencorë në Kosovë, rezultatet e të cilëve janë të dukshme dhe të shënuara e të njohura. Janë botuar vepra të rëndësishme origjinale e të përkthyer nga fusha e linguistikës, të cilat, me parimet e veta metodologjike, sjellin freski dhe rigorozitet shkencor.

Albanologjia, si grup disiplinash shkencore që kanë për subjekt studimin e historisë, të arkeologjisë, të etnologjisë, të gjuhës e të letërsisë së popullit shqiptar, është mbështetje themelore e sqarimit, përpos të tjerash, edhe të prejardhjes dhe të përcaktimit të identitetit të popullit shqiptar.

Seminari për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare u kushtohet albanologëve të huaj dhe ka për detyrë që, studentëve të dy viteve të fundit, mandej asistentëve dhe punonjësve të tjerë të rinj shkencorë të shkencave filologjike, t'u japë njohuri themelore nga gjuha dhe më vonë, me anë të formave të tjera të punës, t'i njohë me arritjet në fushën e gjuhës, të letërsisë dhe të trashëgimisë kulturore të popullit shqiptar.

Programi i seminarit është për çdo vit më i zhvilluar. Është veçanërisht i madh interesimi i ndjekësve për takime shkencore – forma të punës së seminarit në të cilat paraqesin kumtesa nga fusha e gjuhës dhe e letërsisë edhe albanologët e jashtëm. Sivjet, rreth temës së punës së sesionit shkencor – *Përkthimet nga shqipja e në shqip dhe analiza kontrastive e gjuhës shqipe dhe e gjuhëve të tjera* janë paraqitur rreth 30 kumtesa të albanologëve të vendit e të huaj, ndër të cilët: Dr. Oda Buchholz RDGj - Modelet e fjalive të gjuhës shqipe e gjermane; Dr. Irena Savicka – Format e sand-hit në gjuhën letrare shqipe në Kosovë; Wilfried Fiedler - Format foljore analitike të tipit ballkanik në historinë e gjuhës shqipe etj.

Kjo është vetëm një pjesë e përmbajtjes së Seminarit i cili, si realizim shkencor kulturor është bërë manifestim tradicional. Për të interesohen shumë punonjës shkencorë në qendrat universitare nga Evropa dhe

kontinentet e tjera si dhe shumë punëtorë shkencorë nga institucionet hulumtuese, që hetojnë trashëgiminë e popujve ballkanikë, rrjedhimisht edhe thesarin kulturor të shqiptarëve.

Organizues i Seminarit për gjuhë, letërsi e kulturë shqiptare është Fakulteti Filozofisë i Prishtinës. Instituti Albanologjik i Prishtinës është njëri nga bartësit e studimeve albanologjike, por nuk është i vetmi. Në përparimin e studimeve të përmendura, për shembull, punojnë të dy degët e gjuhës e të letërsisë shqipe pranë Fakultetit të Filozofisë; mandej Redaksia e botimeve “Rilindja” etj.

Është fare e natyrshme që Instituti Albanologjik (i themeluar në vitin 1967) mban barrën themelore dhe kryesore në përparimin e studimeve albanologjike ndër ne. Punëtorët shkencorë të tij tash disa vjet punojnë sistematikisht, para së gjithash, në mbledhjen e lëndës nga kultura shpirtërore dhe materiale e shqiptarëve në Kosovë dhe në Jugosllavi. Punohet sistematikisht në mbledhjen e lëndës folklorike që do të botohet në 24 vëllime; deri tash janë botuar 10 vëllime. Gjatë këtyre viteve, punonjësit shkencorë të Seksionit të Gjuhës pranë këtij Instituti punojnë në përgatitjen e atllasit të gjuhës shqipe; ky është projekt afatgjatë i Institutit. Projekte afatgjata punohen intensivisht edhe nga fushat e tjera shkencore albanologjike – letërsia, historia etj. Instituti ka botuar dy fjalorë bukur të mëdhenj: Fjalorin serbokroatisht - shqip (1974) dhe Fjalorin shqip-serbokroatisht (1981).

Instituti ka zhvilluar bashkëpunim të vëllimshëm me institucione të ngjashme shkencore të vendit dhe të jashtme.

Redaksia e Enciklopedisë së Jugosllavisë për Kosovë, para një kohe, më ka angazhuar që për Enciklopedinë e Jugosllavisë (EJ) të shkruaj tekstin për gjuhën shqipe (krijimi dhe zhvillimi i saj, mandej mbi dialektet dhe mbi zhvillimin e gjuhës letrare shqipe). Botimi latin i vëllimit të parë të EJ është publikuar.

Pas demonstratave kundërrevolucionare në Kosovë, disa tekste mbi shqiptarët e gjuhën e tyre kanë qenë objekt i reagimeve të caktuara të disa

redaktorëve të gazetave të përditshme dhe periodike (“Politika”, “Veçer-nje Novosti”). Në këto shkrime mohohet saktësia e disa tezave shkencore në tekstet mbi shqiptarët në EJ. Në njërin prej këtyre shkrimeve kritikohet pjesa mbi gjuhën dhe bëhet vërejtje se indikatorëve linguistikë në këtë pjesë nuk u është dhënë rëndësia përkatëse, mandej se nuk është logjike dhe e natyrshme dhe, fundja, si thuhet atje, se është e pashpjegueshme se si mund të jenë formësuar disa toponime në gjuhën shqipe. Redaksia qendrore e EJ në Zagreb të gjitha këto tekste i ka dhënë përsëri për recensim dhe ato kanë ardhur në duar të historianëve, por edhe ato tekste mbi gjuhën shqipe.

Në pyesim, nga pak të habitur. Pse Redaksia e EJ e RS të Serbisë për recensues ka caktuar vetëm ekspertët nga fusha e shkencave historike, kur dihet se ndër tekstet që është dashur të rishikohen ka pasur edhe të atilla që nuk hyjnë në fushën e historisë? Nëse synohet gjykimi meritore objektiv, atëherë, pa kurrfarë dyshimi, në grupin e punës do të duhej të caktoheshin ekspertët e disiplinave përkatëse.

Lidhur me vërejtjet e një historiani tonë duhet të vërej se ai – problemeve linguistike në lidhje me tekstin “Shqiptarët dhe marrëdhëniet jugosllavo-shqiptare” në EJ - u është afruar vetëm nga pikëpamja historike, pa provuar të thellohet në rrugën specifike zhvillimore të gjuhës shqipe. Në vërejtjet e veta lidhur me tekstin për gjuhën, historiani i përmendur, natyrisht, ndalet në çështjet shumë dytësore, aspak qenësore. Në tekstin tonë mbi gjuhën, përveç të tjerash, flitet edhe për lëvizje të rëndësishme dhe fiksime mekanike të theksit që në kohën romake, e lidhur me këtë historiani vëren duke pyetur i habitur: “Si është e mundur të flitet për gjuhën shqipe në kohën romake, kur gjuha është shënjim etnik i popullit, e kurrfarë shqiptarësh s’ishin formuar si etnos në kohën romake?” E si, pra, pyesim ne, të quhet gjuha, me siguri e gjallë, në kohën romake, në të cilën, në atë kohë, kalon gjithë ai fond leksikor i latinitetit lindor, a i latinitetit ballkanik, në qoftë se nuk emërtohet disi? Duke ndjekur këtë logjikë, puna çohet në absurditet ashtu që po të mos jetë përmendur gjuha shqipe në burimet historike greke a latine, atëherë nuk paskan ekzistuar grupet

etnike që e kanë përdorur atë (gjuhën shqipe).

Pas përpjekjeve të kundërrevolucionit të nacionalistëve shqiptarë në Kosovë, shtypi dhe publicistika filluan, si thamë, të merren edhe me çështjen e krijimit të gjuhës letrare shqipe dhe në një gazetë të përditshme (“Veçernje Novosti”, më 1 e 2 korrik 1981) u publikua një shkrim mbi krijimin e gjuhës letrare të shqiptarëve në Jugosllavi, në të cilin manipulohet formimi i saj, i mistifikuar deri në masat monstruoze, duke u mashtruar lexuesit dhe opinioni se si ajo (gjuha letrare e shqiptarëve) i është imponuar pjesës më të madhe të shqiptarëve, se ajo është varianti toskë etj.

Përdorimin e gjuhë letrare e ka pranuar në mënyrë plebishitare dhe e ka përvetësuar tërë kombësia shqiptare në Jugosllavi dhe ajo e mëson dhe e kultivon me dashuri si mjet të pazëvendësueshëm për emancipimin kulturor dhe afirmimin e të gjitha vlerave materiale e shpirtërore të saj. Prandaj ajo e ka pritur me neveri shkrimin e përmendur, i cili fyen këtë nacionalitet dhe atë që është e shenjtë për çdo popull - gjuhën, krijimin e së cilës autori i shkrimit të përmendur e quan “lojë”.

Gjuha letrare shqipe bashkëkohore nuk është toskërishte; ajo është sintezë e variantit letrar në të cilën janë mishëruar elemente dialektore si të variantit letrar toskë ashtu edhe të variantit letrar gegë. Në strukturën e saj janë integruar, pra, mjaft tipare dialektore të të dy dialekteve letrare që ka sistemi i gjuhës shqipe. Sipas disa përlogaritjeve, raporti i këtyre elementeve dialektore të thurura në strukturën e gjuhës letrare shqipe është 13:8, do të thotë 13 elemente të variantit letrar toskë dhe 8 elemente të variantit letrar gegë. Pra, struktura e gjuhës letrare shqipe bashkëkohore nuk është shkrirje mekanike e varianteve letrare, por ajo është sintezë organike e kësaj gjuhe - e krijuar në rrugën e saj historike. Ky është rezultat i më shumë se njëqind vjet përpjekjesh të punonjësve kulturorë dhe të ekspertëve të vendit e të huaj, parimi themelor i të cilëve është konvergjenca e elementeve gjuhësore të varianteve letrare të gjuhës shqipe.

Polemika rreth teksteve mbi shqiptarët në EJ është hapur për arsye se në debat janë përzier, para së gjithash, joprofesionistët, të cilët nuk synojnë të vërtetën shkencore, por, të ngarkuar me tradicionalizëm dhe

paragykime romantike, kanë bërë gjithçka që, duke shfrytëzuar situatën politike, çdo tezë shkencore, p.sh mbi gjenezën e gjuhës shqipe, madje edhe mbi krijimin e gjuhës letrare shqipe bashkëkohore, ta lidhin me tentativën e kundërrevolucionit në Kosovë, të mbarsur me nacionalizëm dhe irredentizëm.

Nuk është për t'u habitur shumë që disa gazeta të përditshme janë orientuar nga interpretimi i këtillë i problemeve shkencore serioze, por është e pakuptueshme që këtë interpretim po e përqafojnë edhe disa shkencëtarë, duke i sjellë kështu dëm shumë të madh vetë shkencës nacionale.

Është detyrë e shenjtë e çdo disipline shkencore që t'i përvishet objektivisht sqarimit të çdo dukurie dhe ngjarjeje shoqërore. Nga qasja dhe trajtimi objektiv i interpretimit veçmas të ngjarjeve dhe të personaliteteve historike mund të ketë vetëm dobi për ndriçimin e përbashkësisë. Nuk shohim arsye që kjo ose ajo gjenezë e popujve, përkatësisht e kombësive tona, mund ta dëmtojë përbashkësinë tonë. Prandaj, është i paqëndrueshëm botëkuptimi i disa kuazishkencëtarëve se, p.sh., teza ilire e gjuhës shqipe është raciste, dhe se teza trakase, e kundërt me të, është e vetmja e drejtë! Këto çështje duhet t'u lihen vetëm ekspertëve, të cilët do t'i shqyrtojnë të qetë e objektivë dhe do të arrijnë të vërtetën e duhur.

VËREJTJET E PROFESORIT DHE PËRGJIGJET TONA

Në fillim të kësaj përgjigjeje lidhur me vërejtjet e prof. Hrabakut duhet të them se problemeve linguistike në lidhje me tekstin “Shqiptarët dhe marrëdhëniet jugosllavo-shqiptare” në Enciklopedinë e Jugosllavisë ai u ishte afruar vetëm nga pikëpamja historike duke mos provuar të thellohet në rrugën specifike zhvillimore të historisë së gjuhës shqipe. Kjo rrugë përcakton edhe parimin dhe metodën shkencore. Në të vërtetë, në studimin e historisë së gjuhës shqipe, do të thoshim, ka një paradoks, e ky është se, nga njëra anë kemi një nga popujt më të vjetër në Ballkan, e nga ana tjetër, monumentet e para gjuhësore të tij shfaqen shumë vonë – në gjysmën e parë të shekullit XIV, kurse libri i parë i shtypur - në shekullin XVI. Kur të merren parasysh ndryshimet që kanë ndodhur në sistemin e kësaj gjuhe gjatë zhvillimit të saj, duke përfshirë edhe rrallësinë a pakësinë e fondit leksikor të saj me depërtimin e barbarizmave të shumta, atëherë është e kuptueshme që në studimin e problemeve gjuhësore të historisë së popullit shqiptar vërtetimet duhen kërkuar edhe në faktorët jashtëgjuhësorë: në toponimi dhe në huazimet e saj nga greqishtja e vjetër, latinishtja, sllavishtja etj., që e provojnë shkallën pak më të hershme të gjuhës shqipe si dhe vendin e krijimit të saj në hapësirat ballkanike.

Në vërejtjet rreth tekstit mbi gjuhën, kolegu Hrabak, natyrisht, ndalet në çështjet sporadike, assesi qenësore. Te lëvizja mjaft e rëndësishme e theksit dhe fiksimit mekanik i tij, Hrabaku pyet i habitur: “Si është e mundur të flitet për gjuhën shqipe që në kohën romake, kur gjuha është shenjimi etnik i popullit, e kurrfarë shqiptarësh nuk mund të ishin formësuar si etnos “popull” në kohën romake. Shembujt krahasues për ilirishten janë nga koha romake”. Po, pyesim ne, si do të quhet gjuha, me siguri e gjallë në kohën romake, në të cilën kalon pikërisht në ato kohë gjithë ai fond leksikor i latinitetit lindor-latin, përkatësisht ballkanik, nëse nuk

“pagëzohet” disi. Si do të studiohet, pra, elementi i tij indoevropian, përkatësisht antik grek e mandej sllav në atë gjuhë “të paqenë”? Duke ndjekur këtë logjikë vijmë tek absurdi se, në qoftë se burimet historike greke, përkatësisht latine, nuk përmenden, atëherë as ka ekzistuar grupi etnik që i ka përdorur këto! E në qoftë se kolegu Hrabak konsideron se listorikisht është e drejtë që ajo gjuhë nga periudha romake, e cila nga shekulli XI do të ketë të drejtë ta mbajë emrin “gjuha shqipe” - duhet të quhet “ilire”, atëherë ai a priori përqafon prejardhjen ilire të gjuhës shqipe.

Interpretimi i toponimisë nuk ka për qëllim kurrfarë përvetësimi të territorit të kujtdo, por që, në mungesë të konfirmimeve historike, të konstatojë formësimin e disa nga toponimet antike në gjuhën shqipe në rajonin në të cilin në atë kohë kanë jetuar të parët e shqiptarëve dhe që të përcaktohen cilat janë ato ligje fonetike që kanë qenë në fuqi në gjuhën e tyre në kohën romake: Pse, për shembull, për –sc nuk është zëvendësimi – h (helm) në gjuhët gjermane –scalmo, scelmo “vdekja e zezë”, mandej halë – “ferra, ashti i peshkut”, skala në gjuhët gjermane, në serbokroatisht školjka, por –shk, si Scodra – Shkodër; skarfion – shkarpë; mandej scamnum – shkëmb; scalme – shkallmë, shkallme (lloj shpate). Nuk vrasim mendjen, si thotë Hrabaku, që ta dallojmë toponiminë ilire nga ajo romake, por të shohim a mundet toponimi ilir, në pikëpamje domethënëse, të identifikohet me anë të gjuhës shqipe, nga njëra anë, dhe a është formësuar ndonjëri prej tyre ashtu që do të thotë se është kontinuitet i tij në gjuhën shqipe, nga ana tjetër.

Ne e kuptojmë plotësisht kolegun Hrabak që formësimi i disa toponimeve antike në gjuhën shqipe i duket i pamundshëm; linguistët e kanë fare të qartë këtë, por jo edhe “historianët”, të cilët, si ai, çdo fenomen dhe çdo ngjarje e peshojnë me kutin e vet, gjithsesi të shkurtër, kurse linguistika, për ata, është fushë shkencore krejtësisht e panjohur. Pse Hrabakut i duket e paarsyetueshme lidhja midis toponimit antik Malontum dhe apelativit shqip mal? Po a thua në njësinë morfeme mal – në Malontum dhe shqipen mal nuk ka ngjashmëri fonetike dhe identifikim të domethënies? A nuk vërehet pajtimi i domethënies së toponimit Dimal-

lum (toponim afër Dubrovnikut) me shprehjen shqipe Dy male (Di = d; mallum = mal)? A thua komponentja fillestare e morfemës metu (në ilirishten Metubarbis – ishull i vogël – mesbaltor në lumin Sava) nuk mund të vihet në lidhje me shqipen mjet në ndërmjet, përmjet madje edhe Mjeda, latinisht medius, italisht mezzo? Fjalën mjet e përmbajnë edhe fjalët mjedis nga *mjed-vis* – frëngjisht milieu. Pjesa e dytë e fjalës së përmendur – barbis përmbahet në emrin antik të lumit Barbanna – Buenë, Bunë, Bojana, etj.

Nuk mund të pajtohem (ndonjëherë mund t'i bëjë vërejtje dikush edhe Hrabakut) se ilirët kanë qenë substrat i shqiptarëve të ardhshëm – këta të fundit jano vetëm pasardhës të ilirëve, ndërsa sllavët etj., kolegu Hrabak, pa kurrfarë dyshimi, kanë qenë adstrat, e jo substrat i shqiptarëve! Metodologjikisht është fare e gabueshme të flitet për substratin ilir në gjuhën shqipe. Një zëvendësim i tillë nuk është konfirmuar në Shqipëri, sikurse është konstatuar kjo në Rumani si pasojë e romanizimit të këtij vendi.

Dhe në fund, pyesim nga pak të habitur, pse Redaksia e RS të Serbisë për recensues ka caktuar vetëm ekspertë nga fusha e shkencave historike, kur e di se ndër tekstet që është dashur të shqyrtohen ka pasur edhe të atilla që nuk hyjnë në domenin e historisë? Në qoftë se ka pritur gjykim profesional objektivist merit, atëherë, pa kurrfarë dyshimi, në grupin e punës do të duhej të caktonte edhe ekspertë të disiplinave përkatëse.

VROJTIME MBI FORMIMIN E POPULLIT SHQIPTAR DHE TË GJUHËS SË TIJ

Sa herë që jemi rrekur të thellohemi dhe ta themi ndonjë mendim mbi ndonjë problem të historisë së popullit shqiptar dhe të gjuhës së tij, e kemi parë më se të arsyeshme të vëmë në ballë të punës fjalën “paradoks”, duke e shpjeguar atë se në këtë mes nga një anë kemi një nga popujt më të vjetër të Ballkanit, nga ana tjetër përmendoret e tij të para gjuhësore dalin shumë vonë – në mesjetën e vonë. Kjo gjuhë, sikundër dihet, është dokumentuar me shkrim vetëm prej shekullit XV.

Në lëvrimin e në studimin e gjuhës shqipe kanë vepruar dy lagje punonjësish duke u përqëndruar në dy fronte të ndryshme, pa ndonjë lidhje të ngushtë midis tyre. Grupi nga radha e shqiptarëve në hetimin e çështjeve të gjuhës shqipe përqendronin punimet e tyre në përshkrimin e strukturës gramatikore të shqipes së sotme. Kjo palë veprimtarësh shkencorë shqiptarë punuan shkëputur nga problemet e mëdha të gjuhësisë indoevropiane. Gjuhësia shqiptare nxori në shesh disa veçori shumë të rëndësishme nga fusha e morfologjisë e të sintaksës si dhe në lëmin e leksikut.

Rezultatet më të njohura e të shënuara në studimet e gjuhës shqipe, të kryera prej linguistësh e veprimtarësh të tjerë në fushën e gjuhës shqipe nga mbarimi i shekullit XIX, janë meritë e studiuesve albanologë të huaj: G. Meyer, Pedersen, Jokl që e vunë albanistikën historike të krahasuar në rrugën e zgjidhjes së më shumë çështjeve themelore. Nga pikëpamja gjenetike u dëshmuua se shqipja është gjuhë indoevropiane dhe që zë vend në rrethin e familjes së madhe gjuhësore indoevropiane, në sajë të analizës së strukturës së saj fonetike, gramatikore dhe leksikore. U përcaktuan rrugët metodologjike që do të ndiqeshin në studimet e gjuhës mbi të cilat kërkohej që të veçohej elementi i vjetër trashëgues nga elementi i huazuar.

Metoda studimore e albanistikës ishte metoda e gjuhësisë historike

krahasuese me epërsitë dhe dobësitë e saj. E meta e albanistikës qendron-te në programin e saj – të zbulonte se ç’ë bashkonte shqipen me gjuhë të tjera indoevropiane dhe ç’ë dallonte atë prej tyre. Në studimet e studiuesve të huaj u mëshohej kryesisht çështjeve të jashtme të gjuhës shqipe e lihe-shin jashtë faktorët brendagjuhësorë të saj. Me studimet e Holger Pedersenit merr e përvijohet një drejtim i ri në studimin e gjuhës shqipe duke u përqëndruar në gjurmimin kryesisht të strukturës dhe duke kundruar problemet e kësaj gjuhe së brendshmi, një rrugë që më vonë do të ndiqet nga Jokli e të tjerë.

Pasi ishte vërtetuar me argumente shkencërisht karakteri indoevropian i gjuhës shqipe, përpara gjuhësisë indoevropiane krahasuese u shtrua problemi tjetër edhe më i mprehtë shkencor: ku u formua kjo gjuhë, për të cilën linguisti gjerman Franz Bopp kishte thënë se “në elementet e saj themelore me asnjërin nga gjuhët motra indoevropiane të kontinentit tonë nuk ka ndonjë lidhje më të ngushtë ose, aq më pak, ndonjë lidhje rrjedhjeje, burimi”. Në lidhje me çështjen e vendit të formimit të popullit shqiptar dhe të gjuhës së tij, sikundër dihet, ka dy drejtime kërkimi: Gjuha shqipe e ka vendin në truallin e saj të sotmin që prej kohësh të vjetra; sipas një mendimi tjetër, bartësit e saj kanë shtegtuar duke zënë vend në trevat e sotme prej krahinash më në lindje, më në veri. Si përgjigje shumëfish e pranueshme mund të jetë edhe kjo që kurrkund në shkrimet e kronistëve antikë grekë e romakë nuk bëhet fjalë për ndonjë shtegtim të shqiptarëve nga veriu në jug.

Në mungesë të fakteve e të dokumentimeve historike është gjuha ajo që jep njoftime pak a shumë të sakta e të pranueshme për vendin e formimit të saj, për shtrirjen e etnisë shqiptare në kohë të lashta ballkanike. Ligjet fonetike dhe kronologjia e tyre na japin dorë t’u vëmë gisht toponimeve të lashta, vendbanimeve, emrave të maleve, qyteteve të moçme: *Shkupi, Shari, Shtipi, Shkodra, Mati, Drini, Lezha, Ishmi, Buena-Buna, Durrësi, Qafa e Prushit*, (Scupi, Scardus mons, Astibos, Mathis, Drinus, Lissus, Issamus, Perustae, Pirustae).

Është konstatuar se shumica e këtyre toponimeve janë ilire e zhvilli-

mi i formave të sotme të tyre nga ato të moçmet ka qenë i mundshëm vetëm me ndërmjetësim të fonetikës historike të shqipes; gjuhët sllave, me të drejtë, përjashtohen, sepse në kohën e këtij procesi gjuhësor, bartësit sllavofolës të tyre, në ato kohë, po gjëllinin përtej maleve Karpate.

Për sa u përket toponimeve sipër të përmendura, studiuesit si të djeshmit si të sotmit, mund të thuhet me plot gojen, se kanë rënë nga pikëpamja metodike, duke bërë gabim se nuk përfillin rendin historik të tyre. Ata ato i vështrojnë sikur që të gjitha të kishin kronologji të përbashkët, të formuara në një periudhë historike, një gjë që nga puna e trajtimit gjuhësor do të ishte lajthitje e pafalshme metodike me rrjedhime të rënda në kërkimin e së vërtetës shkencore. Ka në historinë e gjuhësisë shqiptare, në albanologjinë e huaj, veprues edhe të shquar, bile, që në veprimtarinë linguistike nuk kanë përfillur një prirje të tillë të ligjeve të brendshme të gjuhëve për ç'arsye rezultatet e tyre shkencore kanë qenë jetëshkurtër.

Edhe huazimet latine dëshmojnë për një ndikim sidomos në terminologjinë kishtarë që paraqesin, edhe ato, një karakter urban qytetor – një gjë që tregon se në kohën kur sllavët u shtynë në anën e tokave shqiptare, shqiptarët bënë edhe jetë qytetore; kishin një organizim kishtar me një gjuhë kishtarë e terminologji krejt të latinishtes, bile klasike: *episcopus* > ipeshkëv, *monachus* > munëg, murg, *civitatem* > qytet, *castellum* > kësh-tjellë, këshqel, *hospitium* > shtëpi, *palatium* > pëllas, etj.

Për të mundur të projektohet disi gjuha shqipe e periudhës antike, e në mungesë të një tradite shkrimore të saj, mjafton të merret e të shikohen se çfarë ligjesh fonetike sundonte ajo në punë të huazimit të leksikut të latinishtes, sidomos të fondit të terminologjisë kishtarë: në huazimet latine të kohës, pasqyroheshin më së miri ligjet fonetike në një anë, dhe në anë tjetër jetësia (vitaliteti) e gjallësia e saj duke treguar një aftësi të madhe përvetësuese ndaj elementeve të huazuara; ajo i ka ndryshuar ato duke u dhënë atyre tiparet e veta fonetiko – gramatikore, “fytyrën” shqipe (A. Kostallari).

Mbi dëshminë e kërkimeve të tij, historiani erudit Jireçek, shqiptarët që në kohën antike i gjeti edhe përgjatë bregdetit Adriatik, të cilët, po në

atë kohë në vjetët e parë të erës së re, përqufuan fenë e re të krishterë – gjithqysh para dyndjeve sllave që vërshuan në zotërimet e Perandorisë romake e në tokat shqiptare: “Në burimet mesjetare nuk bëhet fjalë kurrkund për krishtërimin e shqiptarëve; ata përqufuan fenë e krishterë në antikën, një gjë që mbështet edhe historia e Ipeshkvisë së Durrësit dhe të Shkodrës e cila mund të ndiqet pandërprerë që nga vitet e para të erës së re e deri në ditët tona” (K. Jireček, Trgovački putevi i rudnici u Srbiji i Bosni u srednjem veku).

Në një periudhë kohore para sundimit romak në fqinjësi me kolonistët grekë përreth Bregdetit adriatik tek gjuha shqipe erdhën një numër fjalësh greke në një masë të vogël, por të rëndësishme për fonetikën historike të shqipes, sepse në shqipen e atëhershme sundonte një shkallë gjuhësore identike me të leksikut trashëgues indoevropian: mater > motër (a>o); edhe në huazimet e greqishtes së vjetër të shqipes: mahana>mokën, mokër (a>o); elementet latine s’kanë marrë pjesë në këtë ndërrim, domethënë a latine ka dhënë a.

Kësaj paraqitjeje të shkurtër toponimike po i shtojmë një shënim mbi emrin topik të Landovicës pranë Prizrenit. Duam, pra, ta këqyrim pakëz këtë toponim të emërtuar dyfarësh: *Landovicë* edhe *Lutovicë*, që të dyja format çohen te baza sllave Lot (Defteri i Nahijes së Prizrenit, 1571) nga e cila në shqipen ruhet trajta *Land* me zanore hundore, e përftuar jo më vonë se nga fundshekulli X, kurse forma *Lut* (Lutovica) është sekondare e dalë pas asaj kohe në të folmen serbe. Forma e parë (Landovica) provon praninë e shqiptarëve që në shek. X në këto anë të Kosovës, në një anë e në anë tjetër kontestohet mendimi i M. Peshikanit: “Meqë kufiri etnogjuhësor shqiptar-serb ishte i ndarë në mënyrë të prerë me një toponimi dukshëm sllave, mund të mendohet se shqiptarët vetëm në kohën e sundimit turk kishin zënë të kalojnë në anë të majtë të Drinit”, M. Peshikan, Stara imena u Donjem Podrimlju, Onomatološki prilozii VII, 92.

*Është kjo një pjesë e pabotuar, e nxjerrë nga një punim më i hapët – reagim ndaj shtrembërimeve e botimeve qëllimkëqija e me frymë tendencioze, të kryera këto kohët e fundit në rrethe shkencore jugosllave. “Koha Ditore”, 01. 04. 1997

RRUGA E FORMIMIT TË GJUHËS LETRARE SHQIPE

Gjuha është treguesi dhe tipari më i dallueshëm i çdo njeriut dhe i çdo populli – ajo është edhe pasqyra më e qartë e kombësisë dhe e kulturës së saj.

Rruga nga gjuha me shumësinë e të folmeve të saj deri në formimin e shkallës letrare të çdo populli e kombësitë paraqitet e mundimshme dhe e gjatë.

Nga pikëpamja thjesht gjuhësore, s'ka dialekt të ndonjë gjuhe që mos mund të merret e të vihet në bazë të gjuhës letrare, të gjuhës së shkrimit të një populli; mirëpo, në punën e stabilizimit dhe të ndërtimit të normës letrare shtrohen kërkesa që një e folme e tillë do t'i ketë format sa më të drejta e sa më të përgjithshme: do të gëzojë një lloj prestigji a epërsie në krahasim me të tjerat dialekte të asaj gjuhe. Edhe shtrirja sa më e gjerë e tipareve të atij dialekti me pretendime letrare nuk mund mos të luajë rol të shënueshëm në punën e ngritjes së tij në shkallë të gjuhës letrare.

Historia e gjuhës letrare shqipe zë fill me përpjekjet e para për të shkruar shqipen, që nisin nga shekulli XV a XVI kur shfaqen dokumentet e para të saj dhe me botimin e librave të parë të gjuhës shqipe. Që atëherë zien procesi i formimit të gjuhës sonë letrare të shkruar në dy variante letrare kryesore të ndërtuara mbi baza dialektore. Variantet e saj letrare dialektore ngërthejnë në vete vetitë më të përgjithshme dialektore e që për gegërishten mbidialektore të shkrimit kishte arritur shkallën më të lartë në prozën e kosovarit Pjetër Bogdanit.

S'ka farë dyshimi se përmendoret e para të shkrimit shqip na dilnin në dy variantet letrare – në gegërishten e në toskërishten. Natyrisht, në këtë moment nuk do t'i mëshonim aq, sikur kohën e fundit në masë të madhe mos të ndihej mangësi e skajshme në punë të informacionit mbi formimin e gjuhës letrare shqipe.

Në kohën (shekulli XVI e më vonë) kur po botoheshin veprat e autorëve nga Shqipëria e Veriut e prej Kosove, ndër vendet e banuara prej shqiptarëve prej Italie pareshtur po ktheheshin misionarë katolikë të brezit të ri, që kishin mbaruar Kolegjin e Loretos dhe që në manastire, kuvende dhe ndër famulli hapnin shkolla. Është e njohur lufta e atij vargu klerikësh shqiptarë duke nisur me Buzukun e duke vazhduar sidomos me Budin kundra klerit të huaj dhe përpjekja ta përdomin një gjuhë sa më të përgjithshme në shërbimet fetare. S'është gand e e rastit që libri i tij Pasqyra e të rrëfyemit mban shtesën: „Për ndihmë të gjuhës arbëneshe”. Edhe Frang Bardhi gjithashtu ishte frymëzuar nga këto qëllime që po gjenin shprehje në hartimin e fjalorit të tij latinisht – shqip (1635). Njësoj shkruan edhe Bogdani nga Zhuri i Hasit, më 1675 në një letër që ia niste Propaganda Fides në Romë „Ma anche trovandosi la nazione tra Turchi, Greci e Saviani di continuo la lingua va perdendosi” (Te M. Roque, Recherches sur les anciens textes albanais, 35). Vepra e tij e shkruar shqipe dhe italisht – Çeta e profetëve – Cuneus prophetarum, Padovë, 1685, njihet monumenti më i bukur shkrimor i prozës në dialektin letrar gegë të asaj kohe.

Gjuha e shkrimtarëve gegë të Veriut e të Kosovës e shekujve XV – XVIII, siç u tha, na paraqitet më komplekse, një gegërishte më e përgjithshme, e ngritur në një gjuhë shkrimi mbidialektore. Mirëpo, funksionet shoqërore të asaj gjuhe ishin ngushtësisht të kufizuara: gjuha e shkruar me karakter fetar përdorej në një rreth të ngushtë klerikësh, dhe meqë letërsia fetare e asaj kohe i drejtohej një pjese të kufizuar të shqiptarëve të besimit katolik. ajo s'kishte si të përhapej në masat e gjera, përveç tjerash, edhe për arsye të karakterit fetar.

Në gjysmën e dytë të shek. XIX, në mënyrë spontane, por me siguri kishte zënë e po vëlonte procesi i shturjes së marrëdhënieve feudale: kishin filluar të çajjnë rrugë dhe të ardhengeshin trishet e marrëdhënieve kapitaliste në prodhim; shturjen e feudalizmit ushtarako-otoman, sikundër dihet e shpejtuan në mënyrë të veçantë reformat e Tanzimatit, pas të cilave zunë të krijohen ndër shqiptarë çifligje të mëdha private, prona të bejlerëve feudalë. Krahas ndryshimeve në planin ekonomik të shoqërisë shqiptare, sidomos në gjysmën e dytë të shek. XIX, filloi procesi i formimit të kombit

shqiptar edhe i lëvizjes nacionale borgjeze në kushte të vështira të zgjedhës së egër të pushtimit osman, të prapambetjes ekonomiko-shoqërore.

Veprimtarët e kësaj lëvizjeje të quajtur Rilindje ishin të ndërgjegjshëm për rolin dhe rëndësinë e madhe të gjuhës shqipe, prandaj s'është gjë e rastit që asaj i kushtuan kujdes të veçantë duke e vënë atë në një vend të posaçëm dhe duke u përpjekur për njësimin e shkrimit të saj.

Në lëmin e gjuhës letrare, si qëllim i përhershëm në programin e rilindësve qëndronte afrimi i të dy dialekteve letrare në shkrim, duke u hedhur në këtë mënyrë hapa të rëndësishëm historisë përpara në njësimin e gjuhës së shkruar që ishte bërë strumbullari i të gjitha kërkesave kryesore të afirmimit kulturor.

Duam të theksojmë në mënyrë të veçantë që parimi themelor i të gjithë veprimtarëve të periudhës së Rilindjes në punë të gjuhës ishte përpjekja për njësimin e të dy kryedialekteve letrare të shqipes. Ky ishte dhe mbeti boshti kryesor i veprimtarëve dhe i inteligjencies në fushë të njësimimit të gjuhës letrare shqipe. Çdo rrugë tjetër që do të ndiqej në kërkimin e kombinacioneve për zgjidhjen e gjuhës letrare, nuk do të ishte e natyrshme, adekuate dhe e drejtë. Ç'është më e natyrshme se një popull – edhe pse i ndarë në bashkësi të pavarura shtetërore, të ketë një gjuhë të përbashkët letrare?!

Kur kundrohet gjithë prodhimi publicistik, kulturor e letrar i militantëve dhe i veprimtarëve patriotë të Rilindjes një gjë i bie në sy vëzhguesit, në send do të duket i qartë që, toskërishtja si variant letrar i gjuhës shqipe gjen përdorim shumë më të hapët në gjithë atë periudhë se sa gegërishtja e cila në rrjedhën e shekujve XVI – XVIII mbante epërsinë me shkallën shumë më të lartë të përdorimit në gjithë veprimtarinë kulturore. Prova më emirë është shtypi dhe publicistika që në atë kohë dilte në qendrat e vendeve ballkanike, pastaj në Egjipt dhe Amerikë ku vepronin kolonitë shqiptare. Shtylla kryesore dhe nismëtari, merita e të cilit është ky afrim i dialekteve të shkrimit, padyshim ishte gjuhëtari dhe shkrimtari i njohur Konstandin Kristoforidhi që kishte pikëpamje të drejta për krijimin e gjuhës letrare shqipe. Ai i zotëronte që të dy dialektet e shkrimit – raste të rralla në historinë e deriatëhershme të shqipes së shkruar: militant i lëvizjes kombëtare, pjesëmarrës në zhvillimin, ngritjen dhe në përhapjen e kulturës

e të arsimit në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar studiues i gjuhës shqipe dhe njohësi më i mirë dhe më i thellë i saj i kohës së vet, një nga themeluesit e gjuhës letrare dhe përkthyesi i shkëlqyeshëm.

Në kundërshtim të hapët me parimet mbi krijimin dhe zhvillimin e gjuhës letrare shqipe në vijën konverguese të dialekteve të shkrimit të saj, po gjëllinte të kleri katolik një gjuhë e shprehur në letërsinë fetare, e cila për arsye të koncepteve të ngushta dhe dogmatike mbi krijimin e gjuhëve letrare dhe përse nuk trajtonte probleme të përgjithshme e më jetësore të popullit shqiptar që e shqetësonin atë, funksioni i asaj gjuhe u kufizua në një masë të ndieshme duke u ngushtuar fusha e rrethi i përdorimit të saj.

Interesimi për krijimin e gjuhës letrare nuk po pakësohej as pas vitit 1912. Provë e mirë e një kujdesi për fatin e gjuhës letrare është Komisia Letrare e Shkodrës 1916-1917, në punimet e së cilës merrnin pjesë Gjergj Pekmezi, Aleksandër Xhuvani dhe lingvisti slloven Rajko Nahtigal. Komisia Letrare synonte që dialektin letrar verior ta bënte të aftë për nevojat e kohës duke shtënë në të veçori fonetike më të përgjithshme të të folmeve të tjera gege.

II

Gjatë luftës së dytë botërore, kur në Kosovë u hapën shkollat në gjuhën shqipe dhe shqip punoi administrata, u përdor bashkëvarianti letrar verior i mesëm. Ky variant i mesëm letrar qysh ishte bërë zakon të quhej, nuk ishte dialekti më i pastër qysh po mendonin disa që, fjala e tyre, ky dialekt flitet në një krahinë kapërcyell ndërmjet gegërishtes dhe toskërishtes për ç'arsye duhej të vihej në ballë të gjuhës së përbashkët letrare shqipe. Përkundrazi, Vuku i shqiptarëve – K. Kristoforidhi, i cili që të dy dialektet letrare shqipe i shtinte në përdorim njësoj, nuk pajtohej me një mendim të tillë.

Shqiptarët në Jugosllavi, pas Luftës së fundit botërore, vazhduan të përdorin bashkëvariantin letrar të mesmin, po atë variant të gegërishtes që në kohën e Luftës e shtinë në përdorje në ato pak shkolla dhe në administratë. Ajo pak inteligjencie tregonte kujdes të meritueshëm për gjuhën letrare në përdorim. Ne nëntor të vitit 1952, në një mbledhje ajo shtroi problemin e drejtshkrimit të gjuhës letrare shqipe, me ç'rast u trajtuam disa çështje të ortografisë shqipe, për të cilat në praktikën e

përditshme të variantit tonë letrar nuk kishte një mënyrë të njësishtme shkrimi. Pas pesë vjetësh, në vitin 1957, u shtrua prapë puna e ortografisë së gjuhës letrare shqipe (Prishtinë, më 30-31 maj, 1957). Mbledhja e gjuhëtarëve dhe e punonjësve të arsimit e të kulturës e 1957, mori në shqyrtim një numër të madh çështjesh nga të gjitha kategoritë gramatikore të shqipes.

Këshillimi i tretë i lëvruësve të gjuhës shqipe, i arsimtarëve dhe i veprimtarëve të tjerë rreth çështjeve të drejtshkrimit të gjuhës letrare shqipe, zhvilloi punimet e tij më 1963. Dokumenti Ortografia e gjuhës shqipe, Prishtinë 1964, që u përgatit një kohë të gjatë para mbledhjes si dhe pas saj nga një komision ekspertësh të gjuhës, është dëshmi e mirë se studimi i gjuhës letrare shqipe si nga sasia, si nga cilësia kishte arritur një shkallë të mirë dhe se funksioni i saj shoqëror sa vinte e po shtrihej në masa të gjera të popullit.

Në ravë të këtyre përpjekjeve dhe të këtij kujdesi për përsosjen e gjuhës së shkrimit të shqipes, në kushtet që sa po vinin e po krijoheshin, – në vitin 1968 u bë Konsulta e Prishtinës në të cilën u miratua kërkesa që gjuha letrare shqipe e kohës sonë, pa kurrfarë sugjerimi as ndikimi të jashtëm të merret e të zbatohet nga shqiptarët e Jugosllavisë. Vendimet e Konsultës shkencore të Prishtinës të vitit 1968 ishin rezultati i zhvillimit kulturor të shqiptarëve në Jugosllavi dhe i përpjekjeve të vetëdijshme të punonjësve të kulturës, arsimit e shkencës. Ato u bënë shtysë e fortë për përpjekjet e studiuesve, të milinantëve dhe e veprimtarëve më të shquar të lëvizjes së madhe gjuhësore që u mbyll duke u kurorëzuar me zgjidhje të drejtë të gjuhës letrare shqipe në Kongresin e drejtshkrimit të vitit 1972.

Në normën e gjuhës shqipe janë thithur e brendandërtuar veçori të të gjitha dialekteve të gjuhës shqipe, poashtu sikur kishte porositur dhe realizuar parimet konverguese të varianteve letrare të kësaj gjuhe – Konstandin Kristoforidhi. Gjuha e sotme letrare shqipe u përkrah në mënyrë plebishitare duke e bërë atë të veten mbarë kombësia shqiptare në Jugosllavi. Kujdesi i saj ndaj gjuhës së vet dëshmohet me dëshirën ta zotërojë atë duke e kultivuar si një mjet të pazëvendësueshëm në punë të emancipimit kulturor dhe në afirmimin e të gjitha vlerave materiale dhe shpirtërore të saj. Gjuha e sotme letrare shqipe nuk ka në bazë të saj vetëm

veçori dialektore të toskërishtes, veçse ajo paraqet një sintezë në normën e së cilës janë integruar dhe brendathurur një mori elementesh si të variantit letrar toskë si të variantit verior të gegërishtes letrare. Në strukturën e saj, sikundër u tha më sipër, janë thithur tipare dialektore të të dyja varianteve letrare të shqipes. Sipas disa përlllogaritjeve raporti i elementeve dialektore brendadepërtuara në strukturën e gjuhës së sotme letrare shqipe sillet nga 13 me 8, që do të thotë 13 veçori dialektore të toskërishtes dhe 8 të gegërishtes letrare. Prandaj, struktura e gjuhës së sotme letrare shqipe, nuk është, sikur na thonë disa, një shkrirje mekanike e tipareve dialektore të varianteve letrare veçse është një sintezë organike elementesh të gjuhës shqipe, e formuar në një proces me kushte e rrethana historike specifike.

Që të kemi një pasqyrë të qartë mbi integrimin e një numri veçorisht të përbashkëta të brendathura në sistemin e gjuhës letrare shqipe do t'u vëmë gisht disave: 1. Bashkekzistenca e rotacizmit me thyerjen e tij d.m.th. mbizotërimi, por jo zotërimi absolut i rotacizmit, bie fjala: verë, kurorë, rërë, por krahas këtyre ranishtë, zanë e jo zërë, zanore e jo zërore, dashnor, krenohem, krenar, përkrenare, syri por synoj, synim. Thyerja e rotacizmit është bërë duke depërtuar fjalë të variantit letrar verior që kanë sjellë ndryshime në strukturën fonetike të gjuhës letrare; 2. Zotërimi i plotë i e-së së theksuar në lidhje me mospranimin e zanores hundore (më, mëz, bëj, shullë etj., dhe jo mâ, mâz, bâj, shullâ etj.); 3. Mosasimilimi i togjeve të bashkëtingëlloreve *mb,nd, ng, ngj* (gjembi, vendi, kënga, ngjarje, ngjit); 4. Vendosja e ngulitja e bashkëtingëllores *rr* në vend të *r*-së edhe në raste kur ajo nuk ka funksion kuptimdalues; rrugë, rrallë, rrotë, urrej, rreth, rri, rrit, marr, therr (përdorimi i kësaj foneme shumë më stabil në dialektet gege); 5. Mosshurdhimi i bashkëtingëlloreve të zëshme (veçori e gegërishtes) në fund të fjalës: *lab, breg, dredh, hedh, fund, kënd, tund, shkund, brez, ndez* (tosk. lap, brek, dreth, bres, heth, funt etj.); 6. Bashkëjetojnë në një strukturë të vetme togu zanor *ua* (me prejardhje jugore) me togun *ne* (me prejardhje veriore): *punuar*, – por tokë e *punueshme*, i *shoqëruar*, – por shok i *shoqërueshëm*, *pajtuar* – i *pajtueshëm*, *zbatuar* – i *zbatueshëm*, *mësues*, *lexues* (zhvillime gege); 7. Në strukturën morfologjike pesha specifike e elementeve të dialektit verior po shtohet jo vetëm si sasi por edhe si cilësi, bie fjala integrimi i përemrit pronar *i vet, e vet* (më përpara veçori vetëm e bashkëvarianteve letrare veriore); 8. Prrirja për zgjerimin e

klasëve të emrave që e bëjnë shumësin me mbaresën *-a* (gisht – gishta, çelës – çelësa, viç, – viça, nip – nipa, (veçori e dialektit letrar verior): 9. Kategoria e foljeve me mbaresë *-një* në kohën e tashme të dëftores dhe në të pakryerën në gjuhën letrare shqipe merr spiranten *j* e jo mbylltoren *-nj* të toskërishtes: *punoj, laj, diktoj* – e jo *punonj, lanj, diktonj; punoja, laja, diktoja* – e jo *punonja, lanja, diktonja*; 10. Trajtat e habitores të së tashmes bëjnë *lakam* etj. e jo *larkam, o lakêrkam* (këto dyja të fundit forma toske).

Nga ky vështrim i shkurtër duket qartë se rruga e zhvillimit të gjuhës letrare shqipe karakterizohet nga vija konverguese dhe nga filli i bashkëveprimit dhe i gërshetimit të veçorive ndërdialektore të varianteve letrare shqipe. Një rrugë e tillë nuk mund të mos çonte në krijimin e një gjuhe letrare të vetme, prandaj nuk mund të mbrohet teza e disa fatalistëve, defetistëve dhe skeptikëve që, fjala e tyre, gjuha letrare shqipe s'është gjë tjetër veçse një njazim artificial veçorish dialektore të gjuhës shqipe me një epërsi absolute elementesh të variantit letrar toskë, e krejt kjo është mashtrim i rëndë.

Dhe më në fund të bëjmë një përmbledhje ç'u tha deri këtu: 1. Gjuha letrare shqipe e shqiptarëve në Jugosllavi s'është kurrfarë krijese artificiale, aq më pak një gjuhë e imponuar së jashtmi qysh na thonë disa të painformuar; 2. Ajo është një fitore e madhe e dalë si rezultat i përpjekjeve më se njëqindvjeçare të veprimtarëve kulturorë dhe të ekspertëve shqiptarë dhe të huaj që ndiqnin parimin e ndërveprimeve të varianteve letrare shqipe; 3. Kontributi i specialistëve dhe i punonjësve kulturorë shqiptarë në Jugosllavi është i dukshëm në punën e krijimit të gjuhës letrare shqipe, një gjë që shihet nga konsulatat e shumta gjuhësore të ekspertëve dhe të veprimtarive duke nisur nga vitet 1952, 1957, 1963 dhe më në fund më 1968, kur në Konsultën e Prishtinës në mënyrë plebishitare u aprovua kërkesa që gjuha letrare shqipe e shqiptarëve në Jugosllavi të jetë kjo e sotmja.

RRUGA E ZHVILLIMIT TË GJUHËS LETRARE SHQIPE NË KOSOVË

Rruga e derisotme e zhvillimit të gjuhës letrare shqipe ndër shqiptarët që jetojnë në Jugosllavi, ka pasur etapat e saj që janë njëkohësisht etapa historike të popullit shqiptar.

Procesin e pandërprerë të zhvillimit të gjuhës letrare, që mund ta quanim histori të gjuhës letrare shqipe, do ta ndanim në dy periudha të mëdha, në periudhën parakombëtare, atë para Rilindjes, që përfshin shekujt XVI—XVIII dhe fillimin e shekullit XIX ndërsa etapa e dytë e historisë së gjuhës letrare shqipe nis me gjysmën e dytë të qindvjetëshit XIX e arrin deri në ditët tona. Këto periudha dallohen nga një varg veçorish të karakterit gjuhësor e historik.

Për historinë e gjuhës letrare shqipe „Meshari" i Buzukut shënon një kapërcyell me rëndësi të dorës së parë, sepse me botimin e tij gjuha shqipe zë të ngrihet në shkallën e një gjuhe të shkrimit, kur shqiptarët nisin e kapin fillët e kulturës, atëhere me karakter fetar-laik. Lidhur me gjuhën e „Mesharit" të Buzukut do theksuar një moment i rëndësishëm, që këtu kemi të bëjmë me një traditë të shkrimit të kësaj gjuhe, pëmdryshe nuk mund të kuptohet, me gjithë lëkundjet dhe inkosekuencat, stabilizimi i formave fonetike-morfologjike dhe visari i veprës së përmendur.

Karakter të përgjithshëm ka edhe gjuha e shkrimtarëve që vijnë pas Buzukut: e Budit, e Bogdanit, e të tjerëve, çka duhet të lidhet me qenjen e një tradite shkrimi të gjuhës shqipe, para se të dalë kjo lagje shkrimtarësh me Buzukun në krye, Baza e gjuhës së tyre ishte, pa kurrfarë dyshimi, e folmja e secilit autor veç e veç, e karakteri i përgjithshëm i gegërishtes së tyre mbidialektore do kërkuar te qëndrimi i shkrimtarëve të zënë ngoje në krahina të tjera dhe njohja nga ana e tyre e ligjërimeve të tjera të shqipes.

Tipare themelore të gjuhës sonë letrare parakombëtare, sipas Androkli Kostallarit, mund të quhen këto: „Copëzimi i madh i bazës dialektore të gjuhës së shkrimit dhe funksionimi paralel i disa varianteve

letrare të tipit njëkrahinor a disakrahinor";

a) „Mbizotërimi i zhvillimit të veçuar e divergjent të varianteve krahinore me një farë konvergjence kryesisht brendadialektore";

b) „Shkalla e ulët e normalizimit, qoftë brenda varianteve qoftë midis tyre, dhe afëria e madhe, për të mos thënë gati përputhja e strukture fonetiko-gramatikore e leksikore të varianteve letrare me strukturën e të folmeve e të nëndialikteve përkatëse".¹

E gjuha e shkrimtarëve gegë të Veriut të Kosovës të shekujve XVI-XVIII, na paraqitet më komplekse, një gegërishte më e përgjithshme, e ngritur në një gjuhë shkrimi mbidialektore. Mirëpo, funksionet shoqërore të asaj gjuhe ishin ngushtësisht të kufizuara; gjuha e shkruar me karakter fetar përdorej në një rreth të ngushtë klerikësh dhe, meqë letërsia fetare e asaj kohe i drejtohej një pjese të kufizuar të shqiptarëve të besimit katolik, ajo s'kishte si të përhapej në masat e gjera të popullit shqiptar, përveç të tjerash edhe për arsye të karakterit fetar. Rëndësi të madhe në planin funksional kishte mospërdorimi i shqipes së shkruar në këtë periudhë si gjuhë shtetërore, as si gjuhë themelore e arsimit, në mungesë të shtetit, së paku në kuptimin e atëhershëm të organizimit të tij me institucionet arsimore-kulturore dhe me mekanizma të ngritura të tjera; përkundrazi zhvillimi i gjuhës bëhej në kushtet e përndjekjeve politike dhe fetare. Në periudhën e pushtimit osman gjuha shqipe zhvillohej duke u përdorur në kushte të veçanta. Në kushtet e forcimit të pushtetit, ngritja e institucioneve arësimore-kulturore të pushtuesit osman, kishte për qëllim nënshtrimin shpirtëror të popujve të Ballkanit, rrafshimin shpirtëror të të gjithë popujve, që përfshiheshin në gjirin e Perandorisë, errësimin e shuarjen e elementeve thelbësore të vetëdijes së kombësisë, sikundër janë gjuha dhe formimi shpirtëror, që mbështetet në tradita të vjetra e të thella popullore, dhe, më në fund, asimilimin e plotë të ekzistencës së institucioneve politike, kulturore që kishin një rrjetë të gjerë në Shqipëri e kudo që gjëllinin shqiptarët brenda kufijve të Perandorisë Osmane. Letërsia që zhvillohej në

¹ A. Kostallari. *Mbi disa veçori strukturore e funksionale të gjuhës letrare të kohës sonë*, „Studime filologjike" (1970/2, f. 3).

² A. Kostallari. *Diskutim rreth kumtesës së N. Aplanit. Ndikimet e gjuhës dhe letërsisë turke në gjuhën dhe letërsinë shqipe në „Konferenca e dytë e studimeve albanologjike"*, III, f. 311-315

atë kohë quhet zakonisht letërsi shqiptare me shkronja arabo-turke. Kjo letërsi kishte përmbajtje fetare, mbështetej tek dogma islame, te metafizika dhe fatalizmi dhe sillej në botën e misticizmit. Me tematikën dhe idetë e saj kjo letërsi ishte idealiste, prapanike dhe u shërbente interesave të huaja, duke forcuar dhe duke u dhënë krah pushtuesve dhe feudalëve të vendit. Në anë tjetër letërsia me shkronja arabe-turke duhet të gjejë vend të caktuar në historinë e letërsisë shqipe, si dhe në historinë e gjuhës shqipe, posaçërisht në dialektologjinë shqiptare.²

Gjuha e asaj letërsie nuk mund të bëhej gjuhë e shkrimit as e shqiptarëve të besimit mysliman, sepse me atë gjuhë nuk trajtoheshin punë dhe probleme të mëdha të popullit shqiptar, sikundër ishin ato të periudhës së Rilindjes. Rilindja kombëtare vuri para shqiptarëve, në ato turbullira të kohës, detyra të dorës së parë për ekzistencën e tyre si komb. Njëherë përpara tyre shtrohej detyra të çliroheshin nga zgjedha e rëndë e pushtuesit osman, – e prej saj rridhnin probleme e detyrime të shumta në plan të ngritjes së ndërgjegjes kombëtare, – dhe të lidheshin ngushtë me popullin, duke nxjerrë nga burimet e tij forcat prore këndëllëse, që t'i bënin ballë luftës së egër kundër pushtuesit, duke u frymëzuar nga qëndrimi i tij stoik e trimëror në mbrojtje të trojeve të tija.

Rezultatet e mëdha që u arritën në kohën e Rilindjes në fushën e gjuhës me të gjitha karakteristikat e saj, me prirjen e vazhdueshme konverguese të variantave letrare shqipe, – nuk gjetën shprehjen e tyre kudo, sepse në vilajetet që pas vitit 1912 u integruan në shtetin jugosllav, mungonin kushtet për një krijim e zhvillim të kulturës më elementare në gjuhën shqipe. Kontributi i shqiptarëve të krahinave që përfshiheshin në vilajetet e përmendura në veprën e madhe të Rilindjes kishte karakter të qëndruesës së armatosur kundër pushtuesit dhe në fushën e kulturës dhe të afrimitit të gjuhës letrare shqipe, në punë të nderveprimi, bashkëveprimi, bashkëveprimi midis varianteve letrare, për arsye të ditura, nuk mund të ishte kontribut në përpjekjet e faktorëve kulturorë në procesin e formimit të gjuhës sonë letrare.

Pas viteve 1912—1918, në kushte të reja historike-shoqërore,

³ Hasan Kaleshi, Prilog proucavanju arbanaske knjizevnosti iz vremena Preporoda, në „Godisnjak” – I

shqiptarët që banonin në Jugosllavi, nuk mundnin të shtinin në përdorim gjuhën shqipe për ç'arsye ata nuk morën pjesë në punën e konvergencës së përgjithshme gjuhësore. Ndonjë përpjekje sporadike individuale që shqipja në atë periudhë të përdorej në korrespondencën individuale nuk mund të peshonte në lëvizjen e madhe të të gjithë inteligjencës shqiptare për afirmim të kulturës së saj dhe për vënjen në pah të vlerave pozitive popullore. Letërsia me shkronja arabo-turke vazhdoi, në kushte të saja specifike, të jetojë në përpjekjen anakronike të ndonjë hoxhe a dervishi, e larguar si gjithherë nga trulli i popullit, nga problemet shoqërore reale, si dhe nga shqetësimet e detyrat e tij historike. Në anë tjetër, nga pikëpamja thjeshtë gjuhësore, shkrimet e asaj letërsie kanë rëndësinë e tyre, sepse na dalin të vetmet dokumente gjuhësore të kohës për këto vende („Emni Vehbije" i -Tahir Efendi Boshnjakut 1835; Mevludi i Tahir Efendi Popovës nga Vuçitëri, nga fundi i shekullit XIX, veprat e Rexhep Vokës nga Tetova fundi i shek. të kaluar dhe fillimi i këtij tonit; i Hilmi Maliqit të Rahovecit³ Gjuha e letërsisë me shkronja arabo-turke ishte e trazuar me elemente të gjuhëve orientale, të sjella në shqipen nëpërmjet turqishtes, por ajo, sikundër u tha më parë, meqë na dilte e shkruar vetëm në atë letërsi, pasqyron shkallën e zhvillimit të ligjërimeve shqiptare të këtyre anëve me të gjitha karakteristikat e tyre e që nuk mund të mos ketë rëndësinë e vet në historinë e dialektologjisë shqiptare.

Në kohën e shkurtër gjatë Luftës së parë dhe të dytë botërore, kur shqipja u përdor në shkollat fillore dhe në të mesmet, nuk kishte se si të shtrohej çështja e madhe e gjuhës letrare. Në ata pak vjet gjatë Luftës së dytë botërore, kur në Kosovë dhe në Maqedoninë Perëndimore u hapën shkollat në gjuhën shqipe dhe punoi shqip administrata, u përdor bashkëvarianti letrar verior i mesëm. Dihet se kuadri mësimor i shkollave fillore kishte mbaruar Normalen e Elbasanit, dhe në shumicën dërmuese përdorte gjuhën e mesme a variantin letrar verior të mesëm. Nga fundi i Luftës së dytë botërore, pikërisht në vitin 1944, u botua një libër që përmblihte disa monografi, të cilat rrihnin të shpjegonin disa nga problemet e mprehta të gjuhës letrare shqipe, si dhe vetë çështjen e madhe të gjuhës sonë letrare.³ Atje ngrihej teza mbi themelimin e gjuhës letrare të

⁴S. Riza, Çështja gjuhësore, në „Tri monografina albanologjike” Tiranë 1944, f. 223 v.

gegërishtes, e cila nuk pati mbështesë dhe nuk u tumir, as u kuptua nga shkrimtarë e lëvrues të gjuhës shqipe; teza e pangegërishtes i binte ndesh prirjes së përgjithshme konverguese të varianteve letrare të shqipes. Ngjallja e disa formave tashmë të vjetëruara gramatikore, siç është pjesorja e adjektivuar, bie fjala *i lani*, *i palani* *i shkruen*, *i punueni*, dhe paraqitja e pretendimit që ajo lagje adjektiva të merreshin e të shtiheshin në gjuhën letrare, të themi më saktë, në variantin letrar verior, ishte shfaqje e një koncepti anakronik, që në efektet e tij të fundit kërkonte të hiqej dorë nga çdo përpjekje për njësimin e gjuhës letrare shqipe. Kjo tezë, sikundër dihet, pretendonte të kishte epërsi mbi dy variantet e tjera; të bashkëvarianteve letrare veriore: atij të mesmit dhe atij skajor. Ngritja e këtij pretendimi përkundër tendencave dhe prirjes konverguese të varianteve letrare shqipe, njehej shfaqje e një ndërmarrjeje që nuk i jepte krah bashkëveprimit ndërdialektor dhe nuk i favorizonte përpjekjet, procesin e stabilizimit dhe vendosjen përfundimtare të gjuhës njësore shqipe, meqë kërkonte veçimin dhe konstitucionalizimin e prerë të pangegërishtes letrare, duke arritur në përfundimin fatalist se „sikundër shkabën e flamurit e kemi me dy krerë, ashtu edhe gjuhën e kombit do ta kemi me dy kryedialekte”.⁴ Anët pozitive të pangegërishtes, siç na del te autori i saj, duken sheshazi te elementet që e bëjnë atë shumë të afërt me koinenë jugore, në plan të drejtshkrimit, në fushën e fonetikës, të gramatikës e të fjalëformimit. Pas Luftës së egër e të rëndë katërvjeçare, në të cilën edhe shqiptarët e atyre anëve dhanë kontributin e tyre duke marrë pjesë aktive në të me sakrifica, – në rendin e ri shoqëror që u vendos pas saj në bashkësinë e re të popujve të Jugosllavisë, ndër të drejtat e para që shqiptarët zunë të gëzonin, ishte edhe hapja e shkollave të profileve të ndryshme në gjuhën shqipe. Gjuha e shkollave dhe e administratës vazhdoi të mbetet bashkëvarianti letrar i mesëm, po ai variant i gegërishtes qënë kohën e luftës shtihej në përdorim në ato pak shkolla dhe në administratë. Varianti letrar verior, i mesmi, që po përdorej në shkolla, në shtypin e përditshëm dhe në atë periodik, në administratë, si edhe në të gjitha mekanizmat zyrtare të Krahinës në punën e drejtshkrimit, nuk mund të hiqte dorë menjëherë nga shumë formësia e gjuhës letrare, që, në instancë të fundit, nuk i jepte krah konvergencës

⁵ Shih për këtë: Androklli Kostallari, Mbi disa veçori strukturore...,f. 10.

gjuhësore dhe përpjekjes që të çonte në vendosjen e njësisë njëformëshe të gjuhës së përbashkët letrare. Problemi i madh i mesëm, po ai variant i gegërishtes që në kohën e luftës shtihej i natyrshëm në ata vjetët e parë pas Çlirimit, nuk shtrohej në plan të parë të veprimtarisë kulturore-shkencore. Arësyet duhen kërkuar në qenjen e pamjaftueshme të ekspertëve të gjuhës që ishin të kënaqur me ç'ishte arritur në punën gjuhësore, prandaj çështja e njësimimit të gjuhës së përbashkët letrare nuk i shqetësonte. Zhvillimi spontan i gjuhës së përbashkët letrare ishte rruga e saj e natyrishtme për ta, që një dite do të çonte në vendosjen e njësisë njëformëshe të gjuhës letrare shqipe. Ata harronin që në proceset e zhvillimit historik dhe në punën e përcaktimit të normës dhe kristalizimit të gjuhës letrare, faktor gjithëherë i pranishëm është ndikimi subjektiv. Kështu në luftën shumëvjeçare e shpesh herë të rreptë për vendosjen e gjuhës letrare serbokroate deri në fitoren e saj përfundimtare, rolin kryesor të saj e luajti Vukë Karaxhiçi. Është vështirë ta mendosh formimin e një gjuhe letrare që të mos t'i jetë nënshtruar këtij apo atij ndikimi subjektiv të shoqërisë përkatëse. Duke u rritur vazhdimisht niveli i kuadrove të arsimit fillor e të mesëm, këto kuadro nuk mund të pajtoheshin më me lëkundjet drejtshkrimore që po dukeshin. Kjo shpuri në formimin e dy lagje pikëpamjesh në fushën e drejtshkrimit të gjuhës letrare. Inteligjenca e atëhershme nuk mund të shikonte, pra, në mënyrë pasive një lëkundje që sa vinte po zgjerohej në punën e drejtshkrimit të letrarishtes dhe intuitivisht ndjente nevojën e madhe të ndikimit mbi të të faktorit subjektiv, që në emër të shoqërisë, si rregullues normalizues i gjuhës letrare, t'i priste hovin procesit të vetvetëshëm të variantit letrar, në përdorim. Kujdesi i madh ndaj stabilizimit të normës së gjuhës letrare kombëtare në Shqipërinë e re, trajtimi i shpeshtë e sistematik i problemeve të gjuhës letrare kombëtare, që shërbente si forcë e gjallë dhe që ndihmonte me të madhe e fuqimisht ecjen përpara të shoqërisë socialiste, – nuk mund të mbetej pa ushtruar ndikim, me gjithë pengesat dhe vështirësitë e kohës, mbi procesin konvergues gjuhësor, që në instancë të fundit, ishte ndikim në përpjekjet e kuadrove të arësimit e të kulturës që lëvronin kulturën gjuhësore dhe përhapnin shprehjen e gjuhës letrare shqipe në rininë shkollore të fshatrave e të qyteteve të Kosovës dhe të viseve të tjera të Jugosllavisë ku banojnë shqiptarë. Problemit të drejtshkrimit të gjuhës letrare shqipe iu kushtua

një mbledhje në nëntor të vitit 1952 (në Prishtinë), me ç'rast u trajtuan disa çështje të ortografisë shqipe, për të cilat në praktikën e përditshme të variantit tonë letrar, nuk kishte një mënyrë të njësishtme shkrimi. Pika kryesore e drejtshkrimit mbi të cilën u këmbyen mendimet në mbledhjen e parë të ekspertëve të gjuhës, përveç tjerash, ishte përdorimi i gjysmëzanores ë në gjuhën letrare shqipe, për shkrimin e së cilës largoheshin pikëpamjet e gjuhëtarëve. Për problemin gjithnjë të mprehtë të gjuhës letrare shqipe, të shtruar në mbledhjen e përmendur, thuhej sa vijon: „Meqenëse pakica kombëtare shqiptare në RFPJ flet një dialekt të gegënishtes, gjuha e shkrimit për ne nuk mund të jetë veçse gegënishtja", (*Përparimi*, 1955, 1—2 f. 14).

Në konkluzionet, në të cilat u përmblohdën diskutimet që u bënë në mbledhjen e përmendur të 1952-së, Komisioni prej nëntë vetash, në emër të delegatëve të mbledhjes së gjuhëtarëve dhe letrarëve e punonjësve të tjerë të kulturës së shqiptarëve të atyre anëve, për drejtshkrimin e shqipes letrare, në formë porosie, propozoi sa vijon:

„... Gegënishtja e përdorun ndër ne në pjesën e saj më të madhe, është tashmë e përcaktueme si për kah trajtëfjalët, ashtu për kah drejtshkrimi, si shifet kryesisht në të përkohshëmen „Jeta e re". Prej pikave ku nuk mbretton ende një njëjtësi e plotë, më të randësishmet, mbas mendimit t'anë janë këto që vijojnë:

1). Trajta *jam shkue*, *jam ardhë* etj. duhet të mënjanohet si prodhim i njëj evolutive partikulariste.

2). Gjithashtu kosovarizmat *po vijka*, *po shkojka*, e tjera, në vend të *ardhka*, *shkueka*, *bleka*, e tjera, janë për t'u menjanue si prodhim i njëj evolutive partikulariste.

3) Komisioni është i mendimit që trajta e imperfektit *punonja* dhe *punojsha* të lejohen me u përdorë krahas, simbas parapëlqimit të shkrimtarit,

4) Detyrimi i përtardhun: *kam me pasë* mund të përdoret vetëm gabimisht në vend të kohës së përtardhun (fatur) *do tëkem*.

5). Komisioni rekomandon gjithashtu që akordimi logjik, për shembull *shtetet e mëdhej*, të lejohet me u përdorë *shtetet e mëdha*.

6). Krahas me trajtat *libër i shkruem, letër e shkrueme*, duhet të përdoren trajtat *libër i pasun, letër e ndrydhun*.

7). Janë të drejta vetëm trajtat: *kam shkue, kam folë, kam ndejtë* e tjera e jo *kam shkruem* ose *shkruejtë, kam folun, kam ndejtun* etj.

8). Përsëritja pleonastike e njëj objekti – emëni i pashquem – si për shembull: *e bleva një pulë*, është gabim (njizanit). Kur objekti është emën i shquem, shumica prej gjashtë kundër treve rekomandojnë mbajtjen e pleonazmit vetëm atëherë kur objekti emën i shquem vjen para foljes, për shembull: *librin e lexova*, kështu që mbas kësaj shumice do t'ishte gabim me shkru: *e lexova librin*.

9). Foljet që n'infinativ mbarojnë me „ye” e me „-a” në vehtën e tretë t'aoristit mbarojnë me „-u” për shembull: *kthye-ktheu, kërcye-kërceu, lalau*.

10). Janë të drejta vetëm orthografinat „mundësi”, kurse „i mundëshëm”, e „mundëshme” (me fjalë tjera prej dy ë-ve postonike që vijnë mbas theksit tonik, e parafundit bije).

11). *Me lëvrue, lëkurë, me lëvdue, me lëshue* janë orthografina të drejta.

12). *Jane të drejta vetëm orthografinat këndue* etj.

13). Janë të drejta orthografinat: *i haptë, i lagtë, i përbashktë* etj. e jo *i hapët, i lagët, i përbashkët*.

14). Janë të drejta orthografinat: *i vetëm, e vetëme, punë, punëtuer, kangë, kangëtar*.

15). Me një shumicë prej pesë kundër katër janë të drejta vetëm orthografinat: *liris, Jugosllavis* etj.

16). Komisjoni me shumicë prej 7 mbi 2 rekomandon drejtshkrimet. e pronarëvet: *t'im t'and*, me apostrof, dhe përdorimin e nyjës „i-e” në nominativ; për shembull: *libri i im, motra e jote*.

17). Mbetet për diskutim *t'anë e t'onë* për njëjsin e mashkullores ..."

Kur shikohen me kujdes të veçantë disa nga pikat e konkluzioneve të dala nga Mbledhja e 1952-së, bien në sy menjëherë dy rryma që ortografinë e gegërishtes letrare e përdhnhin në drejtime të ndryshme: njëra përpiquej që ajo të shkonte duke u përputhur, qoftë edhe vetëm në punë të

drejtshkrimin, me gjuhën letrare kombëtare që ishte në përdorim në të gjitha fushat e veprimtarisë krijuese të shoqërisë socialiste të Shqipërisë së re; ishin ata përkrahës të vetëdijshëm të vijës konverguese të gjuhës letrare shqipe, që nesër do ta kishin të gjithë shqiptarët; lagja tjetër e gjuhëtarëve dhe e punonjësve të tjerë në punë të kulturës nuk shihnin rëndësinë historike të tezës që karakterizohej nga përpjekjet që, mbi baza dialektore të ndërtohet një gjuhë njëformëshe letrare shqipe; ata mendonin që gjuha letrare shqipe duhet të ketë një zhvillim të lirë e spontan; një palë tjetër e kësaj teze perspektivat e gjuhës letrare i shihnin në zhvillimin e dalluar e të prerë të gegërishtes letrare nga „toskërishtja“ sikundër thoshin ata.

Ana pozitive e kësaj Mbledhjeje qëndron në faktin që, duke u krijuar kushtet dhe mundësitë, problemi i gjuhës letrare po shtrohej vazhdimisht dhe po kërkoheshin shtigje të drejta e efikase që gjuha letrare e shqiptarëve në Jugosllavinë e re, duke u stabilizuar e duke u bërë gjuhë e njësishtme, të kryejë një rol të madh shoqëror në ngritjen e masave shqiptare, në bashkësinë e atjeshme.

Pas pesë vjetësh, në vitin 1957, prapë u shtrua puna e ortografisë së gjuhës letrare shqipe (Prishtinë, 30—31 maj 1957). Në Rekomandimet, që porosiste Mbledhja e gjuhëtarëve thuhej shprehimisht... „Mbas shqyrtimit të gjithanshëm e pik' për pikë të secilës çashtje të parashtrueme në referate e tue pasë parasysh përfundimet e Mbledhjes së parë, kjo Mbledhje pat për qëllim sëpari me thjeshtue sa të jetë e mundun ortografin shqipe, por gjithnji tue u kujdesë që të mos cenohet aspak karakteri shkencuer i saj. Për shembull, në lidhje me ë-në, mbledhja qe e mendimit që ajo te përdoret vetëm aty ku është e domosdoshme. Nji qëndrim i këtillë përlligj vetëvehten e i jep dorë zhvillimit të gjuhës bashkëkohore, tue qenë në përputhje të plotë me ortoepin, rrugë kjo që medoemos evolucioni i gjuhës do të kalojë nëpër të për me mbërrijtë zhvillimin e vet të fundit“ (*Përparimi*, 1957, 6. f. 375).

Mbledhja e gjuhëtarëve dhe e punonjësve të arsimit e të kulturës e 1957-ës, mori në shqyrtim e trajtoi një numër të madh çështjesh nga të gjitha kategoritë gramatikore të shqipes; së dyti, u propozua që ë-ja të hiqet nga të gjitha pozicionet ku ajo del e pathekse bie fjala: *randësi* rekomandohet të shkruhet *randsi*; jo *mundësi* po *mundsi*; jo *punëtuer* por

puntuer; jo *kangëtar* por *kangtar*; nuk lejohet të përdorej imperfekti asigmatik: *punonja* a *punoja*, por vetëm *punojsa*.

Mbështetja vetëm e vetëm në ortoepinë, si shprehen gjuhëtarët në konkluzionet që nxorën nga Mbledhja ku merrnin pjesë punonjës të arësimit dhe të kulturës, u binte ndesh edhe fort, prirjeve kryesore të zhvillimit të mëtejshëm të gjuhës letrare shqipe dhe të drejtshkrimit të saj. Është e vërtetë se parimi themelor i drejtshkrimit të gjuhës sonë mbështetet në shqiptimin më të përgjithshëm të saj, por krahas me to rrihet që në shkrim të ruhet njësia e trajtave të pjesëve të ndryshme të ligjëratës, me fjalë të tjera të ruhen morfemat fjalëformuese. „Thjeshtimi“, si shprehen përpiluesit e konkluzioneve të Mbledhjes së përmendur të gjuhëtarëve dhe të punonjësve të kulturës, sipas nesh, synonte në punë të trajtimit të problemeve gjuhësore një rrugë që, sikundër thamë, nuk përputhej me vijën tradicionale të ndjekur nga inteligjenca shqiptare që nga Rilindja e këtej.

Kundër tendencave diverguese të atyre konkluzioneve dhe rekomandimit të tyre u ngritën reagime, e ndër të parat në „Përparimin“ 1958/7-8, u botua artikulli: „A ka gjâ ma punë në ortografinë e shqipes“.⁵ Në atë punim të shkurtër, autori ngrihej kundër konceptit që synon të ecet në një rrugë që dialektet letrare shqipe i largoi njërin nga tjetri.

Këshillimi i tretë i lëvruesve të gjuhës shqipe, i arsimitareve dhe intelektualëve të tjerë rreth problemeve të drejtshkrimit të gjuhës letrare shqipe, zhvilloi punimet e tij pikërisht më 14, 15, 16 kallnor 1963. Në Mbledhje merrnin pjesë, sikundër u tha, lëvrues dhe profesorë të gjuhës ndër shkolla të mesme, përfaqësues dhe profesorë të gjuhës ndër shkollat e mesme, përfaqësues redaksish të revistave dhe fletoreve të ndryshme të Kosovës, të Maqedonisë, të Malit të Zi dhe të Beogradit.

Dokumenti „Ortografia e gjuhës shqipe“ (Prishtinë 1964), që u përgatit një kohë të gjatë para Mbledhjes si dhe pas saj nga një komision ekspertësh të gjuhës, është dëshmi e mirë se studimi i gjuhës letrare shqipe kishte arritur si nga sasia, si nga cilësia në një shkallë të mirë dhe se funksioni i saj shoqëror sa vende e po merrte përpjestime të gjera në masat

⁵ Idriz Ajeti, *A ka gjâ mâ punë n'ortografinë e shqipes?* „Përparimi“, 1958, nr. 7—8 f. 471—476.

e popullit shqiptar (në Jugosllavinë e pasluftës). Dokumentin e karakterizojnë rrahja e një kompleksi problemesh nga fusha e drejtshkrimit të gjuhës letrare shqipe dhe nga ana tjetër, orientimi që në të të marrin zgjidhje çështjesh drejtshkrimore me synime konverguese, që në instancë të fundit favorizojnë zgjidhjen pozitive të gjuhës letrare shqipe, duke përfunduar në të ardhmen në një fizionomi njëformëshe.

Nga kjo pamje e shkurtër mbi historiatin e drejtshkrimit të gjuhës letrare shqipe, nga kujdesi e interesimi i shoqërisë që ajo të studjohet e të përpunohet gjallërisht, si fenomen shoqëror që është – gjuha po bëhet mjet i fuqishëm në punën e ndërtimit të gjithanshëm të shoqërisë. Intensiteti i zhvillimit të saj dhe orientimi që merrte ajo në drejtim të konvergencës me variantin letrar gjuhësor, vareshin nga faktori subjektiv: nga kushtet që sa vente e po krijoheshin duke u vënë në plan të parë aftësimi i gjuhës letrare shqipe, që me efikasitet e shpejtësi t'u përgjigjet nevojave në fushën e veprimtarisë krijuese të shoqërisë. Pas një kohe jo të gjatë, më 22 e 23 prill 1968, në kushtet që sa vinin e po krijoheshin duke u thelluar e zgjeruar ditë për ditë, në vitin 1968, me inisiativën e Institutit Albanologjik dhe të Katedrës së Gjuhës dhe të Letërsisë Shqipe të Fakultetit Filozofik u bë Konsulta e përfaqësuesve të arësimit, të kulturës, të shkencës e të publicistikës të shqiptarëve në Jugosllavi, në të cilën u aprovua kërkesa që gjuha letrare kombëtare shqipe e kohës sonë të merret e të zbatohet edhe nga shqiptarët e atjeshëm. Edhe pse atë kohë nuk shihnim mundësinë e përhapjes së shpejtë të gjuhës së njësishtme letrare shqipe, ngulmi me të cilin u shtrua çështja e saj nga ekspertë dhe nga përfaqësues të tjerë të pranishëm në Konsultë, disponimi i rezervë i tyre të përdorin gjuhën e përbashkët letrare shqipe, na jepte shpresa të mëdha se, met'u miratuar, ajo te përhapej shpejt në shkolla, në botime dhe në programe të emisioneve të radios e të televizionit.

Vitin pasues 1969, redaksitë e të gjitha ndërmarrjeve botuese të zbatojnë vendimin e marrë në Konsultën e gjuhës, duke botuar dhe ribotuar libra shkollorë në gjuhën letrare shqipe; gjuhën letrare e shtinë në përdorim në të gjitha botimet zyrtare, në shtypin e përditshëm dhe në atë periodik si dhe në botimet shkencore.

Vetëm Enti i botimit të librave shkollorë që nga viti 1969, kur zuri ta

përdorte në botimet e veta gjuhën letrare shqipe, botoi më se 500 tituj librash shkollore me një tirazh prej më se 5 milion ekzemplarësh. Edhe krijimtaria artistike, me përjashtime fare të vogla, shkruhet e botohet në gjuhën letrare shqipe, Në përhapjen e gjuhës letrare shqipe, faktor me rëndësi të. dorës së parë del sidomos shtypi i përditshëm. Dyqindmijë nxënës të shkollave fillore të Krahinës lexojnë shprehjen e shkruar dhe dëgjojnë tingullin e fjalës letrare nga mësuesi i tyre. Truall i përshtatshëm realizimi të gjuhës letrare shqipe janë 25 mijë nxënës të shkollave të mesme. Vatra të rëndësishme të zotërimit të gjuhës letrare shqipe janë edhe fakultetet e Universitetit të Prishtinës, dhe shkollat e larta dyvjeçare pedagogjike, ku mësojnë në letrarishten më se 8000 sudentë te rregullt.

Si faktor i dorës së parë në punën e përvetësimit të gjuhës letrare, paraqiten mjetet e komunikimit: radjoja dhe televizioni; në Krahinë ka 45000 radioaparate të regjistruara dhe 60000 televizorë, në qoftë se gjysma e tyre janë pronë e shqiptarëve të Krahinës, del se 50000 familje me nga shtatë anëtarë që bëjnë 350 000 banorë, dëgjojnë fjalën në gjuhën letrare shqipe.

Disponimi pozitiv i të gjithë faktorëve për ta zgjidhur drejt gjuhën letrare shqipe, entuziazmi i të gjitha kategorive që atë të shtien në përdorim, guximi i madh i të gjithëve ta shkruajnë e ta flasin atë janë garanci se procesi i përhapjes dhe i zotërimit të gjuhës letrare shqipe, në fazën e saj të dytë, do të bëhet me një ritëm shumë më të shpejtë sesa mund të mendohet.

PËR NGRITJEN E KULTURËS GJUHËSORE

Me përjashtime të rralla, gjuha e shtypit dhe e publicistikës sonë në Kosovë ende është e varfër, stereotipe, e thatë, e paqartë, e mbytur me skema e modele të gjuhëve të huaja. Në veprimtarinë e kulturës së gjuhës nuk mund të ketë sukses po nuk u edukua dashuria për gjuhën amtare, ndjenja e përgjegjesisë dhe qëndrimi i ndërgjegjshëm ndaj saj.

Gjuha, si dihet, është një mrekulli e madhe, që e ka krijuar njeriu. Ajo i ka bërë të mundur atij që të veçohet, të ndahet nga bota shtazore dhe të krijojë bashkime të ndryshme njerëzore dhe organizma të tjerë e të arrijë një zhvillim të madh e të gjithanshëm.

Me këtë desha të them se gjuha ka rëndësi të madhe në të gjitha sistemet shtetërore dhe shoqërore.

Kur është fjala për gjuhën shqipe, natyrisht ne nuk mund të marrim e të hetojmë duke u thelluar në rrugën që gjuha letrare shqipe ka ndjekur në fazat e ndryshme të zhvillimit të saj në të kaluarën. Një gjë në këtë mes duket e qartë, se ajo ka ndjekur pareshtur e hap më hap fatin e popullit duke e shoqëruar atë në luftërat që ai ka bërë për vetëmbrojtje dhe për të ruajtur vlerat më pozitive e më përparimtare të popullit që e flet.

Pa dashur e pa mukndur të thellohemi në rrugën që ka ndjekur gjuha shqipe në punën e stabilizimit e të krijimit përfundimtar të një gjuhë letrare, vetëm do të themi se ka një veçori që në lëvizjen e madhe të popullit shqiptar në kohën e Rilidjes e shquante atë dhe që do ta shoqërojë duke e ruajtur atë veti të saj deri në fund, e që qëndron në vijën e konvergencës së bashkëveprimeve të dialekteve shkrimore të kësaj gjuhe. Veçoria e afrimit a e konvergencës së dialekteve shkrimore të shqipes, që i përshkonte gjithë përpjekjet në fushën e krijimit të një gjuhe letrare e të përbashkët shqipe u kurorëzua me zgjidhje të drejtë të gjuhës letrare shqipe në Kongresin e drejtshkrimit që zhvilloi punimet në nëntor 1972 në

Tiranë. Një shtysë të fortë këtyre proceseve pozitive të zgjidhjes së drejtë të drejtshkrimit, thuaj të stabilizimit të gjuhës letrare shqipe i dhanë vendimet e Konsultës shkencore të Prishtinës (1958) si rezultat i zhvillimit kulturor të shqiptarëve dhe i përpjekjeve të vetëdijshme të punonjësve të kulturës, të arsimit dhe të shkencës.

Që nga këto dy ngjarje me rëndësi të dorës së parë në kkulturën shqiptare, gjuha e njësuar letrare shqipe ka zënë e po përvetësohet dhe po zbatohet nga të gjithë ata që në çfarëdo mënyre kanë të bëjnë me gjuhën: në shkolla fillore e të mesme, në Universitetin e Kosovës, në institucione botuese e në organe të shtypit. Natyrisht, kuadrot e të gjitha këtyre institucioneve, me gjithë përpjekjet që ata bëjnë vetë në përvetësimin e normës së gjuhës letrare, kanë nevojë për ndihmë të vazhdueshme me botime që në përgjithësi s'u kanë munguar: Drejtshkrimi i gjuhës shqipe (1973), 1974, Gjuha letrare shqipe për të gjithë (1976), Fjalori drejtshkrimor (1976).

Në këto përpjekje për përvetësimin dhe zbatimin e normës letrare të gjuhës shqipe, vihet re dëshira e madhe sidomos e të rinjve kudo që ata jetojnë e veprojnë, këtu brenda edhe punonjësit në publicistikën tonë: dhe në këtë truall janë arritur dhe po arrihen rezultate të mira. Por, do të thoshim se këto rezultate të arritura janë më tepër fryt e fitore individësh që si përgjegjës në redaksi të ndryshme të shtypit e të institucioneve të kulturës janë ngarkuar si korrektorë a redaktorë të gjuhës. Ndonjë institucion që të bashkërendonte punën dhe ndihmën e vazhdueshme me sugjerime e këshillime gjuhësore, ende s'kemi. Ç'është e drejta, në gazetën e përditshme tonën, në "Rilindje", herë pas here botohet ndonjë artikull për gjuhën: ndonjëherë çështjes së gjuhës i sillen edhe fletore e gazeta të tjera periodike e gjithë këtë pune e quajmë kontribut të mirë e të pazëvendësueshëm për ngritjen e kulturës së gjuhës në përgjithësi.

Kanë munguar nismat e redaksive të shtypit e të institucioneve të tjera kulturore: të "Rilindjes", të "Zërit të Rinisë", të "Botës së Re", të "Shkëndijës", të "Pionierit", "Kosovares", etj. për të organizuar ndonjë këshillim për gjuhën, me ç'rast do të vihej në diskutim se ç'gjuhë përdorin revistat tona, shtypi i përditshëm a periodik, se ç'gjuhë ka publicistika jonë,

emisionet televizive për nga gjuha a u përgjigjen nevojave dhe detyrave që në atë drejtim kanë ndaj dëgjuesve dhe shikuesve të televizionit, që ç'është e vërteta, deri tashti kishte organizuar një emision që i kushtohej gjuhës që në atë institucion aq me rëndësi shtihet në përdorim; si dhe një këshillim me punonjësit e Televizionit, me ç'rast shkruesi i këtyre rreshtave u foli atyre për rezultatet që në atë fushë kanë korrur ata si dhe për lajthimet, lëkundjet drejtshkrimore që u përvidhen spikerëve dhe punonjësve të tjerë në Televizionin e Prishtinës, duke u sqaruar atyre ç'është norma letrare e kultura e gjuhës, cilat janë sot çështjet më të rëndësishme në këto fusha, ç'janë stilet e gjuhës, ç'veçori e ç'karakteristika kanë, ç'gabime, shmangie ose pasaktësi gjuhësore vihen re, sikundër thash te spikerët në të lexuar të teksteve, si duhen ndrequr ato, ç'detyra ka shtypi, publicistika, Televizioni për përvetësimin e normës letrare dhe për ngritjen e nivelit të përgjithshëm të kulturës së gjuhës.

Natyrisht, ne me këtë rast, për arsye të ditura, nuk mund ta trajtojmë shtjellueshëm çështjen e gjuhës në shtypin dhe në publicistikën tonë që këtu në Kosovë zhvillohet në gjuhën shqipe në tërësinë e tyre. Do të prekim vetëm disa raste nga të cilat do të shihet qartas se në ç'vise të gjuhës sonë gabimet janë më të shpeshta, me qëllim që të shtohet kujdesi i të gjithëve për ngritjen e kulturës së gjuhës dhe të përvetësohet norma e gjuhës letrare shqipe.

Punonjësit në redaksi të ndryshme të shtypit tonë, duke mos mbajtur parasysh gjithherë kërkesat e tipologjisë së gjuhës sonë dhe të ligjesisë së saj, thyejnë rregullat e strukturës së gjuhës sonë; bie fjala, nga gramatika e gjuhës shqipe dihet që emri në rasën kallëzore ose dhanore në funksionin e një kundrinori të drejtë a të zhdrejtë varet zakonisht nga një folje, ose emrat në dhanore mund të varen vetëm prej foljesh, por s'mund të varen prej emrash (daç edhe foljorë); thuhet *mbaroi së lexuari*, *mbaroi së punuari tokën*: Por, në gjuhën e shtypit dhe në emisione të Televizionit dëgjojmë raste të përdorimit të kundrinorëve pranë emrash: dorëzimi i pushtetit personaliteteve; pas vizitës zyrtare vendit tonë, vizita e NN Pragës, kryerja e shërbimeve kulturele pemëve; në Beograd u shpall kumtesa

e përbashkët mbi vizitën e ministrit të punëve të jashtme të Republikës së Zambisë vendit tonë; respekt traditës dramaturgjike (duhet: të respektohet tradita e dramaturgjisë, Rilindja, 21.IV.1977, f. 11); Mundësitë e gjetjes punë janë të (=mundësitë për të gjetur punë janë të shumta). Ndërtime të tilla dalin artificiale e të vështira, shpesh sjellin keqkuptime, prandaj nuk duhet përdorur, sepse kundrinori përdoret pranë një foljeje: t'u kryejmë shërbimet kulturore pemëve.

Frazeologjizmat janë njëra nga pikat më të dobëta ku punonjësit e redaksive të shtypit tonë të përditshëm e periodik rrëmbehen vazhdimisht nga prirja që çdo togfjalësh a frazeologji t'i përkthejnë fjalë për fjalë, që është gabim i pafalshëm, “Në frazeologjinë gjuhësore përfshihen ata togfjalësh të qëndrueshëm të formuar historikisht, me një kuptim tërësor të figurshëm shpesh me ngurosjë të formës dhe që nga funksioni në gjuhë janë të baravlershëm me fjalët. Ky i fundit përbën tiparin themelor që i bashkon këta togfjalësha me fjalët dhe për rrjedhim që të studiohen në leksikologji. Ata quhen edhe ekuivalentë të fjalëve dhe hyjnë në përbërjen leksikore të gjuhës: *flet kodra mbas bregu*, = flet kot; *ka dorë* – vjedh; *i jap udhë një pune* = zgjidh; *i jap udhë dikujt* – e përzë; *i bëhet ferra Brahim* = trembet kot; *bëj pallë* = pushoj; *heq për hunde* = mashtraj.

Punonjësve të shtypit tonë, në punën e tyre të përditshme u ndodh të përkthejnë nga serbokroatishtja ose të kenë të bëjnë me këtë gjuhë vazhdimisht e pareshtur, me ç'raste edhe frazeologjizmat e kësaj gjuhe t'i përkthejnë fjalë për fjalë; natyrisht teksti i përkthyer del i paqartë duke marrë vështrim krejt tjetër për tjetër nga ai i origjinalit, bie fjala: *Grlom u jagode* – titulli i një emisioni që për një kohë u shfaq në Televizionin e Prishtinës – në shqipërimin e pagëzuar: *Me dredhëza në fyt*, me këtë titull figuroi te “Rilindja” ky emision në shpalljen e programit të Radiotelevizionit për një kohë të gjatë. Është për të ardhur keq që asnjë punonjës në këto dy institucione kulturore nuk e vuri re që kalku a përkthimi:

- Me dredhëza në fyt, i frazeologjisë serbokroate – *Grlom u jagode*, s'ka kurrfarë kuptimi; lidhja sintagmatike serbokroate *Grlom u jagode* del me këtë kuptim: të nisësh një punë pa farë përgatitjeje paraprake. Vjen

(shkon, nisët si në darsmë vjen, (shkon, nisët në një punë i papërgatitur i shkujdesur pa mjetet e pajisjet e nevojshme). Po nga ky parim a koncept udhëhiqen punonjësit e këtyre institucioneve tona dhe ata të redaksive të revistave të tjera që dalin në Prishtinë kur u takon të përkthejnë lidhje të ndryshme sintagmatike, bie fjala: Konferenca po mbahet mbrapa dverve të mbyllura për Konferencija se održava iza zatvorenih vrata, në vend të shprehjes standarde shqipe; Konferenca mbahet me dyer të mbyllura; *u pitanju je* – përkthehet pothuajse pa kurrfarë përjashtimi – *është në pyetje*, e pra në shqipen është thënë dhe thuhet – është fjala për... ke të bësh me...; *për doviditi u pitanje nešto*, ka zënë rrënjë përkthimi: *sjell në pyetje diçka* – në vend të shprehjes shqipe – vë në dyshim, vihet në dushim diçka; nuk e vëmë në dyshim = ne dovidimo mi to u pitanje; *nuzprodukti* përkthehet me *muzprodukte*, që shqip duhet thënë – *nënproduktet*, apo *derivatet*, për *masovan*, jo *masovik*, por *masiv*; *prekonoć*, jo *brenda natës*, por atypëraty, përnjëherë, menjëherë; *potez* jo me *potez*, por me *gjest*, *lëvizje*, *hap*...

Të ndikuar nga serbokroatishtja, gazetarëve, redaktorëve, korrektorëve në redaksitë e shtypit e të publicistikës sonë si dhe punonjësve të Radiotelevizionit të Prishtinës nuk u kanë mjaftuar mundësitë që ka shqipja për të pasqyruar kuptimet e foljes serbokroate javiti: *javiti se nekome pismom*; *javiti se nekome telefonom*, por kanë marrë foljen shqipe të diatezës veprorë e kanë kthyer në një folje joveprorë pa farë nevojë: *lajmërohem* për të shprehur situata të ndryshme vështrimore që shqipja për të shprehur kuptimet e veta serbokroate *javiti se* i ka në dispozicion, duke i mënjeluar të gjitha ato folje sinonimike, me të cilat shprehen rrethanat vështrimore të serbokroatishtes *javiti se*: nije mi se javio na ulici (Nuk m'u lajmërua në rrugë!) – në vend: nuk më përshëndeti në rrugë; Iz Beograda mi se još nije javio: Nga Beogradi ende s'mu ka lajmëruar! (- në vend që të thuhet: Nga Beogradi s'më ka shkruar ende, e me telefon: s më ka marrë në telefon... s'më mori në telefon; ko se javio na telefonu, niko se ne javlja na telefonu: s'doli kush në telefon, e jo s'po lajmërohet kurrkush në telefon, sikundër thuhet gabimisht. Nga *prijatno*

nas je iznenadio... merret e përkthehet jo kuptimi, por elementet shprehëse të kësaj lidhjeje sintagmatike: na befasoi këndshëm, e pra kuptimi i brendshëm është ky: na dha një kënaqësi, për ne ishte një kënaqësi...

Në përdorimin e fjaëve të huaja vihet re mungesa e kritereve të drejta të shëndosha gjuhësore; në këtë mes natyrisht nuk duhet të bëhemi puristë të tepruar, duke mos lejuar që asnjë fjalë e huaj, që shihet e nevojshme me ndonjë ngjyrim të ri vështrimor, të zërë e të ngulitet në gjuhën shqipe. Në ato raste, ku fjala e huaj nuk sjell kurrfarë nuance a ngjyrimi të ri kuptimor, s'ka nevojë të shtihet në gjuhën shqipe; na merr mendja se të tilla leksema të huaja janë këto: *detanti* – ulje e tensionit, *optimal*, më i mirë, më i zgjedhur; *avancoj* – përparoj; *koincidoj* – përkoj, rastis; sanim i gjendjes – përmirësim i gjendjes, *kidnapoj*, *kidnapim* – rrëmbej, rrëmbim; *esencë* – thelb, *superioritet* – epërsi; definoj, definim – përcaktoj, përcaktim.

Kur kemi nevojë për to, atëherë duhet t'i përdorim drejt e pa gabime: *amendment*, sh. amendamente, sipas shqiptimit italian, e jo frëng, që thuhet amendament – shqiptohet: amāndamā nga e cila gjuhë u mor në serbishten; thuhet *garanci-a* e jo *garancion*, *garancë* (!) Do të thuhet *dukuri* (a fenomen) atmosferike e jo *elementare* – (elementarne nepogode). Gjithashtu, edhe folja latine e romane imponoj (imponirati, imponiram) në shqipen e serbishten nuk del me të njëjtin vështirim: *ia ngarkoj*, *ia mvesh mendimin* – në shqipen; të bën ta respektosh – në serbo-kroatishten.

Me përjashtime të rralla, gjuha e shtypit dhe e publicistikës sonë në Kosovë, për mungesë të kualifikimit profesional të punonjësve në ato institucione kulturore, të daktilografëve, të tipografëve, korrektorëve e redaktorëve, prej të cilëve varet shumë niveli gjuhësor i shtypit tonë, sa vjen e po bëhet gjithnjë më i varfër, stereotip, i thatë, i paqartë, i pa gjallëri, i pa jetë, i mbytur me skema e modele të gjuhëve të huaja, i zhveshur prej frazeologjizmave; nuk tërheq as kur trajton tema interesante e të dobishme.

Prandaj, shtrohet si nevojë e ngutshme dhe e mprehtë të ngrihet një

lëvizje e gjerë e të hapet një front i bashkuar, me qëllim që të gjithë atyre që merren me shkrime t'u vihet në ndihmë në punën e kualifikimit e të ngritjes së kulturës gjuhësore të tyre. Në veprimtarinë e kulturës së gjuhës nuk mund të ketë sukses po nuk u edukua dashuria për gjuhën amtare, ndjenja e përgjegjësisë dhe qëndrimi i ndërgjegjshëm ndaj saj. Në shtyp e në Radiotelevizion duhet të hapen rubrika e emisione të përhershme që të shpjegojnë e të përhapin kërkesat e kulturës së gjuhës dhe të tërheqin vërejtjet për gabimet e ndryshme gjuhësore. E quajmë të nevojshme të botohet një revistë e veçantë për probleme të normës letrare e të kulturës së gjuhës ku të përqëndrohet gjithë puna që do të bëhet në këtë fushë. “Për kryerjen e këtyre detyrave me ekspertët e gjuhës do të bashkëpunojnë në këtë ballë të gjerë pune arsimtarët, shkrimtarët, punonjësit e shtypit e të botimeve, gazetarët, njerëzit e shkencës e të kulturës, të gjithë ata që e ndiejnë përgjegjësinë ndaj gjuhës amtare, sepse ajo nuk është vetëm një thesar i kulturës sonë, por edhe një mjet i fortë në punë të përparimit dhe të zhvillimit shoqëror”, sepse ajo nuk është vetëm një thesar i kulturës sonë, por edhe një mjet i fortë në punë të përparimit dhe të zhvillimit shoqëror”.

Pa gjuhë të pasur e të pastër, s'ka as ide e mendime të larta

Çmimin e papritur të Redaksisë së botimeve të “Rilindjes” për veprën time *Studime gjuhësore në fushë të shqipes II*, botuar nga kjo shtëpi botuese vitin e kaluar, e, mbi kriteret e saj ta quajë botim me epërsi cilësore mbi realizimet e tjera nga fusha e gjerë e kulturës, e prita me gëzim të madh dhe ai ka një kuptim të dyfishtë: njëheër, me të më njihen përpjekjet që unë këtu e dyzet vjet bëj për të hedhur ndonjë gur në ndërtesën e kulturës së shqiptarëve në Jugosllavinë tonë Socialiste. Për mua personalisht ky çmim paraqet një njohje për punën dhe për rezultatet modeste që kam realizuar brenda këtyre katër dekadave.

Por ky çmim, është, njëkohësisht, njohje për të gjithë veprimtarët në

fushën e mendimit shkencor, sidomos të atyre që rrahin të ngrenë ndërtesën e kulturës dhe të mendimit shkencor në lëmin e shkencave albanologjike. Përveç tjerash, edhe kjo njohje, për të gjithë ne që merremi me degëzime të ndryshme të mendimit gjuhësor, do të jetë, padyshim, një shtysë e fortë në punën tonë të mëtejshme.

Vepra e posazënë ngoje u takon punimeve në fushën e studimeve dialektologjike, të përderdhura poshtë e lart deri tashti vonë, e këtu të bashkuara në mënyrë të përzgjedhur. Dua të theksoj se në këtë përmbledhje ka gjetur shtegun e botimit të vet, për herë të parë shqip, monografia e disertacionit tim të doktoratës, që së pari është botuar serbo-kroatisht në serinë e botimeve të Institutit Ballkanologjik të Sarajevës (1961): *“Zhvillimi historik i së folmes geqe të arbëneshëve të Zarës (Istorijski razvitak gegijskog govora Arbanasa kod Zadra, Balkanološki Institut, Sarajevo, 1961)*. Kjo monografi dialektologjike, qysh e quan edhe albanologu polak Cimochoowski në recensimin e tij të rrallë që iu soll këtij punimi shkencor, është studimi i tretë gjuhësor me pretendime shkencore që merr në vëzhgim veçoritë dialektore të kësaj enklave të vogël të shqiptarëve pranë Zarës në Dalmaci. E folmja e këtij ngulimi shqiptar në Dalmaci kishte qenë objekt hetimi të lingvistit gjerman G. Weigand (1911); pas tij albanologu italiana C. Tagliavini rrok të folët e këtij ishulli gjuhësor të shqipes (1937). Indoevropiani dhe albanologu i njohur jugosllav Henrik **Bariqi**, s’kishte mbetur i kënaqur me përfundimet që u kishin dalë gjurmuesve të zënë ngoje të këtij ligjërimi të izoluar të arbëneshëve të Zarës; prandaj, në takimin e parë, ma rekomandoi ta rimerrja edhe unë dhe ta vështroja këtë ligjërim gegë, mbartësit e të cilit ishin shkëputur nga djepi i hershëm i shqiptarëve të Krajës në gjysmën e parë të shek. XVIII (1726-1733). Një recensim të rrasët ia kishte bërë kësaj monografie, siç thamë, albanologu polak Cimochoowski (*Lingua Posnaniensis*, XII/XIII 1958-176-184). Duke përmbledhur vlerësimin e tij për këtë monografi dialektore, Cimochoowski thotë: “Pas këtij komentimi të përgjithshëm mbi monografinë e I. Ajetit, konstatohet se ajo paraqet një punim të paçmueshëm shkencor, i cili pasuron njohurinë tonë mbi dialektologjinë historike

dhe mbi zhvillimin thelbësor të brendshëm, historik të shqipes”. (f. 180). Kur bashkohen këto tri monografi, që rrahin të shpjegojnë tipare të përgjithshme dialektore të së folmes gege të oazës së vogël gjuhësore shqipe të Dalmacisë, qysh ia ka ënda ta emërtojë këtë ligjërimit shqip të Dalmacisë albanologu italian Tagliavini, ne nuk mund të mos shprehim bindjen se, për kohën e vet, ato japin një pasqyrë reale të së folmes së arbëneshëve të Zarës.

Në këtë vëllim të studimeve gjuhësore në fushë të shqipes kanë gjetur vend disa punime dialektologjike nga dorëshkrime shqipe me alfabet arabo-turk, i pari me titull *Emni Vehbije* (Dhuratë) i Tahir ef. Gjakovës, që daton nga viti 1835; një tjetër i shkruar me alfabetin arabo-turk nën titullin *Divani* hartuar prej sheh Maliqit të Rahovecit (nga fundi i shekullit të kaluar). Autori i *Vehbijes*, sikur u tha, është Tahir ef. Gjakova prej Gjakove, njeri me kulturë të gjerë teologjike dhe njohës i mirë i së folmes së vendlindjes.

Përveç *Divanit*, sheh Maliqi nga Rahoveci ka lënë një varg veprash shqip të shkruara me alfabetin arabo-turk: 16 tregime – me përmbajtje fetare. Për studimet dialektologjike të të folmeve shqiptare të Podrimes, *Divani* – një përmbledhje këngësh mistike, del me interes të madh. Ky lloj poezie, bartës të së cilës janë dervishë dhe shehlerë të mësuar e të ditur – kultivohej nëpër teqe. Hetimi i kësaj literature ka një rëndësi të dorës së parë për kërkimet e të folmeve shqiptare në truallin gjuhësor të Kosovës, sepse ka të ngjarë të ketë edhe shkrime të tjera të kësaj letërsie. Krahas me këtë punë shtrohet, gjithashtu, nevoja që dokumentet gjuhësore të kësaj literature, të shkruara me alfabetin arabo-turk, të merren në dorë dhe të studiohen sistematikisht. Në këtë mënyrë kjo literaturë vihet në pozitë të pabarabartë duke iu dhënë asaj rëndësia që kanë tekstet e shkruara me alfabete të tjera.

Në këtë vepër dialektore ka hyrë edhe një studim, që e kisha nxjerrë nga një dorëshkrim shqip, të cilin linguisti italian Matteo Bartoli e kishte botuar, pa farë transkriptimi, te revista *“Studi albanesi”*, I. 1932, f. 7. Është fjala për tekstin *Djali plëngprishës në të folët shqip të Istrisë*, që ishte

gjetur në arkivin e Bibliotekës Ambrosiana të Milanos. Dialektologu italian Bernardino Biondelli kërkonte prej famullitarëve të të gjitha famullive përbrenda territorit gjuhësor italian që secili nga treva e tij e në të folmen e vendit të vet të regjistronte për atlasin e projektuar dialektologjik të italishtes tregimin e *Djalit plëngprishës*. Me tekstet e arritura u gjet edhe një i shkruar në dialektin e një grupi të shqiptarëve që aso kohe jetonin në Istri (1841).

Do të përmend edhe punimin që në vëllimin II ka zënë vend me titull: *Tipat e l-së në dialektet shqiptare të Brisk-Shestanit të Krajës*. Udhëheqësi im në punë të përgatitjes së disertacionit H. **Bariqi**, me rastin e bashkëmarrëveshjes rreth temës, përvec tjerash me thoshte se gjoja një sllavist e njohës i mirë i të folmeve malazeze kishte persiatuar në ligjërimin shqiptar të Shestanit një tipar të veçantë, shumë interesant për studimet albanologjike, se na paska diktuar në atë të folme shqipe tre tipa të konsonantit *l*, prandaj, ia vleka, mos për asgjë tjetër, së paku për këtë shpikje, të merret e të trajtohet edhe një herë ligjërimi i arbëneshëve të Zarës bashkë me të folmet e Shestanit. I kishim rënë saherë Shestanit kryq e tërthor, regjistruam lëndë të bollshme, por nuk u vërtetua shpikja e sllavistit e dialektologut të njohur Branko Miletiqit (*E folmja e Crmnicës*), SD. Zbornik IX 1940, f. 281). Mbi këtë çështje bëj fjalë në punimin e zënë ngoje në mënyrë të thelluar. Edhe në këtë mes konstatova bindshëm se gjuha shqipe ka pasur dhe ka dy tipa bashkëtingëlloresh *l*, *ll*: një *l* palatale dhe një tjetër velare. Nga pikëpamja e gramatikës historike të gjuhës shqipe, arushani i Kopenhagës, Holger Pedersen, (*L-Laute im albanesischen*, KZ XXXIII, f. 535.551), s'e kishte gjetur të drejtë pohimin e save që thoshin që në gjuhën shqipe paskemi tre tipa të konsonantit *l*, përkundrazi, në dialektet e shqipes ai provoi me fakte ekzistencën e dy tipave të këtyre sonanteve (1-11).

Për epërsinë e këtyre metodave s'mund të bëhet fjalë, sepse krejt puna qëndron në qëllimin që gjurmuesi ia vë vetes; metodat janë të pavarura dhe krejt të vetvetishme. Në studimet e mia dialektologjike kam parapëlqyer përhera metodën diakronike: ma ka marrë mendja se kjo

metodë çështjet gjuhësore i bën më të qarta edhe kur është fjala për ndonjë dukuri dialektore të një faze të caktuar historike. Përqasja me të folmet e tjera të truallit gjuhësor të shqipes ka qenë dhe ka mbetur një kapje tjetër e përhershme metodologjike në studimet e mia jo vetëm dialektologjike. Metoda komparative historike, për mua së paku, kap çështjet gjuhësore nga të gjitha anët dhe ato dalin shumë më të qarta; po s'u rrah një rugë e tillë shoshitjeje e çështjeve gjuhësore, më duket sikur diçka ka mbetur pezull dhe e errët. Ky orientim u detyrohet mësuesve të mi Skokut, **Bariqit**, Tagliavinit kryesisht edhe formimit tim linguistik.

Dihet fare mirë se fjalori i gjuhës shqipe ka marrë e është rralluar ndjeshëm me të hyrë në të sidomos elemente leksikore të latinishtes dhe huazime të ardhura prej gjuhëve fqinje.

Me Mikloshiçin fillojnë studimet reciproke të gjuhëve ballkanike duke ndjekur parimet dhe metodën e gramatikanëve të rinj – si Mikloshiçi, edhe të tjerë linguistë ballkanologë, kur bëhej fjalë për shqipen, rroknin kryesisht historinë e jashtme të saj, ndërsa studimit shkencor të strukturës së vetë shqipes së folur e të shkruar, pra historisë së brendshme të saj, i lihej një vend shumë i vogël. Studimet etimologjike të kohës së Mikloshiçit si dhe vetë punimet e tij të gjuhës vuanin nga metoda që karakterizohej nga zbërthimi i leksikut të gjuhës shqipe, duke kërkuar gurrën e fjalëve të saj te krahasimet gjegjëse të gjuhëve të tjera.

Mbi një analizë të huazimeve sllave, vihet re se mbizotëron ndikimi në fushën e kulturës materiale e të ekonomisë shtëpiake, si dhe në emërtimet e veglave shtëpiake, bujqësi, blegtori e zeytari. Kjo anë e bashkëmarrëdhënieve të ndërsjella gjuhësore sllavo-shqiptare ka gjetur shprehjen e realizimit të vet në shumë studime, duke nisur me sllavistin e madh Mikloshiç, e duke vazhduar me sllavistin sovjetik Selishçev (1931), e të tjerë. Ana tjetër e bashkëmarrëdhënieve gjuhësore shqiptaro-sllave, deri tashti kishte mbetur djerrinë, tokë e papunuar.

Mbi dëshmistë e studimeve të kryera në kohët e fundit, në të folmet e sllavëve të Jugut, sidomos në idiomat serbokroate, e maqedone, është konstatuar një leksik i gurrës shqipe në një masë shumë më të madhe sesa

mendohej. Nga ana historike, burimi shqiptar i tij për ligjet shumë lehtë, ngase blegtoria ishte mjeshhtëria nacionale e shqiptarëve, barinj të e të cilëve duke shtektuar vend më vend, përhapnin fjalë – terma nga fusha e blegtorisë në vise të tjera të Ballkanit, bie fjala *vatra*, *katun* (*d*), *balega*, *frus*, *korda*, *žalo*, *hira*, *strunga* (shq. shtrungë), *šulina*, *bardoka*, *balja*, *balješka*, *ljareza*, *djama* – (shumicë, mori, shumicë fëmijësh në familje), e shumë të tjera.

I ndjeri Ivan **Popoviq** – një studiues i zellshëm i studimeve shqiptare-sllave, më thoshte se numri leksikor i shqipes në të folmet serbe, maqedone mund të kapë një mijëshin.

Në inventarin leksikor të shqipes, të kaluar në të folmet serbe e maqedone, ka një numër me moshë të madhe, sikur janë *zarepati*, *zarepam* (premtoj, jap fjalën, zotohem); *zarepati se*, *zarepam se* (zotohem, rrëfhem: zarepao se pred poštenim ljudima da neće to više činiti) u ka dhënë fjalën burrave se nuk do të bëjë më punë të këqija) dhe *pora-brez*, gjeneratë (*Makedonski jazyk II 1951*) – çohet te fjala shqipe *fara*, ndërsa *zarepati* (*se*) rrjedh pandërmjetshëm nga shqipja – rrëfhem. Në këtë mes ka peshë kalimi i frikativit *f* në *p* te gjuhët sllave, të cilat në sistemin e tyre nuk e kishin frikativin *f*.

Ç'mendoj unë në lidhje me vendin që zë gjuha shqipe në rrethin e gjuhëve indoevropiane – përgjigjja ime do të jetë e shkurtër. Dua të them se në këtë mes një gjë, në lidhje me këtë çështje, është e qartë që nga G. Meyeri e këtej – shqipja bën pjesë në grupin e gjuhëve lindore, ose satem, ku hyjnë, përveç tjerash edhe gjuhët sllave. Një lagje e mirë e linguistëve janë të mendimit se shqipja është e vetmja gjuhë e familjes gjuhësore indoevropiane që ruan tri seritë e guturaleve të gjuhës mëmë indoevropiane. Porse, mendimet e linguistëve janë të ndara kur është fjala për refleksin e palataleve indoevropiane në gjuhën shqipe: një lagje e tyre i mbahet mendimit të G. Meyerit, i cili thotë se refleksin e tyre në shqipe janë dypalëshe: - *s*, *z*, dhe *th*, *dhe* (*d*); pala tjetër, në kundërshtim me Meyerin, është e mendimit që këto në gjuhën shqipe reflektohen vetëm me spirantet interdentalë *th dh* (*d*) – është kjo teoria e Pedersenit (*Guturales në gjuhën*

shqipe, KZ, 36). Në këtë punë linguisti shqiptar Eqrem Çabej ka hedhur dritë përsa i takon *z*-së, gjoja reflektim i *ǵ*-së e *ǵh*-s indoevropiane duke e çuar këtë *z* – në ballë të fjalës te një – *j* indoevropiane (*Zeitschrift für Phonetik und allgemeine Sprachwissenschaft*, 9 (1956) – më parë në shqipe te “Buletin për shkencat shoqërore” III (1952). Gjuha shqipe, - një mis i familjes së madhe të gjuhëve indoevropiane ka pika takimi me të gjitha gjuhët e tjera indoevropiane, por me asnjërën nga ato një raport birërie; në trungun e kësaj familjeje ajo formon një degë më vete. Një afri më të shënueshme ka me grupin e gjuhëve baltike-sidomos me lituanishten.

Problem shumë më të ndërlikuar paraqet vendi i formimit të gjuhës shqipe; mirëpo, meqë nuk jemi të sigurt, a kërkohet apo s’kërkohet në këtë mes mendimi ynë në lidhje me këtë çështje, ne me këtë rast nuk po marrim ta shfaqim gjykimin tonë.

Praktikisht gjuha letrare shqipe si njësi njëformëshe po përdoret edhe këtu te ne tash sa vjet edhe me sukses. Ky hap i ri historik i shqipes letrare – edhe para sanksionimit *de iure* nga Kongresi i Drejtshkrimit (1972), këtu te ne po stabilizohej si e njësishtme letrare. Në periudhën pas Konsultës gjuhësore të Prishtinës (1968) dhe të Kongresit të Drejtshkrimit, norma gjuhësore e përbashkët është kristalizuar, ngulitur e përhapur në të gjitha sferat dhe stilet. Norma e gjuhës së njësuar letrare shqipe e zotëruar mirë, do të vihet në përdorim në mënyrë krijuese dhe aktivisht nga të gjithë, sidomos nga arsimtarët në shkolla, në mjetet e informimit masiv, në publicistikë, në organizata shoqërore, në organet krahinore. Pa gjuhë të pasur e të pastër, s’ka as ide e mendime të larta e të përpikta.

Kjo betejë shkencore historike është fituar; rezultatet e saj, të përhapura, do të përparohen pareshtur – e kjo detyrë, në radhë të parë, i bie brezit të ri.

- Gjuhëtar i mirë është ai që zotëron në mënyrë të shkëlqyer një degë shkencore mbi gjuhën, e që përhera gjendet në ballë të luftës e të përpjekjeve që kultura gjuhësore të ngrihet masivisht e me rreze veprimi të gjerë.

- Në të gjitha detyrat pak a shumë udhëheqëse, që, në rastet më të shpeshta më ishin besuar për hir të moshës, jam përpjekur përhera që bashkëpunëtorët t'i njoh shokë të barabartë, të tregoj durim e tolerancë saherë që në trajtimin e ndonjë problemi shfaqeshin pikëpamje të kundërta, duke pasur parasysh qëllimin e fundit, pas gjykimit tonë, të dobishëm e konstruktiv. Pikëpamjet e kundërta asnjëherë s'i kam identifikuar me shprehësin e tyre; ato i kam quajtur këmbim mendimesh që rrahin të kërkojnë rrugën më të drejtë në zgjidhjen e çështjeve në shqyrtim.

Rruga e njësimin të shqipes letrare *

Për historinë e gjuhës letrare të shqipes “Meshari” i Buzukut shënon një kapërcyell me rëndësi të dorës së parë, pse me botimin e tij gjuha shqipe zë të ngrihet në shkallën e një gjuhe të shkrimit me anë të së cilës shqiptarët nisen e kapin fillet e kulturës atëherë me karakter fetaro-laik. Lidhur me gjuhën e “Mesharit” të Buzukut do shënuar një moment i shënueshëm që këtu kemi të bëjmë me një traditë të shkrimit të kësaj gjuhe, përndryshe nuk mund të kuptohen, me gjithë lëkundjet dhe inkonsekuencat, stabilizimi i formave fonetike, morfologjike dhe visari leksikor në shqyrtim.

Karakter të përgjithshëm ka dhe gjuha e shkrimtarëve që vijnë pas Buzukut, Budit, Bardhit, Bogdanit e të tjerëve që duhet të lidhet me qenien e një tradite shkrimi të gjuhës shqipe para se të dalë kjo lagje shkrimtarësh me Buzukun në krye.

Baza e gjuhës së tyre ishte pa kurrfarë dyshimi e folmja e secilit shkrimtar veç e veç, e karakteri i përgjithshëm i gegërishtes së tyre mbi-dialektore do kërkuar te qendrimi i shkrimtarëve të zënë ngoje në krahinat e tjera dhe njohja nga ana e tyre e ligjërimeve të tjera të shqipes. Kështu pra, gjuha e shkrimtarëve gegë të Veriut na paraqitet më komplekse e madje një gegërishte më e përgjithshme, e ngritur në një gjuhë shkrimi mbi-dialektore.

* Marrë nga “Përparimi”, 1958/7-8.

Edhe autorët e këtyre shkrimeve, bashkë me mbarë veprimtarinë mendore të shekujve XVI-XVII, nuk mund të thuhet se s'kanë qenë të vetëdijshëm për rëndësinë e shkrimeve të tyre, shkrime që ishin të caktuara për vise e krahina të hapura e shtresa të gjëra të popullit.

Për dashurinë e tyre ndaj atdheut, gjuhës e besimit, ata luftuan me gjithë forcën e tyre dhe derdhën mund të madh për ruajtjen e këtyre vlerave. Gjon Buzuku tregon se si iu vu hartimit a përkthimit të “Mesharit”... en së dashunit së botës sanë” e fjala botë këtu na del me vështrim të latinishtes patria.

Edhe Pjetër Budi, gjatë shërbimit të tij si prift në Kosovë dhe në vise të tjera të Shqipërisë e më në fund si ipeshkv në Zadrimë, zhvilloi një veprimtari politike, agjitore të gjallë që t'i shtyjë malësorët shqiptarë të çohen kundër pushtetit otoman e te hedhin zgjedhën e tij; dihet se si mbaroi jeta e Budit: u mbyt në Drin.

Bardhi, siç dihet, përveç Fjalorit që hartoi, shkroi edhe një broshurë latinisht me karakter polemik, në të cilën hidhte poshtë tezën që synonte ta mohonte origjinën shqiptare të Skënderbeut. Pjetër Bogdani gjithashtu i frymëzuar nga veprimtaria e të ungjit, zhvilloi edhe ai nëpër vise të ndryshme ku gjëllinin shqiptarët, një aktivitet të madh.

Kur është fjala për ortografinë e këtyre shkrimeve të autorëve veriakë shqiptarë, mund të provohet pa farë dyshimi që ajo, me gjithë lëkundjet na del e stabilizuar dhe e aftë për shkrime letrare. Terminologjia fetare që na del e ngulitur dhe e fiksuar, pa farë trazimesh, sidomos sllave, është provë e gjallë e përdorimit të kahershëm të shqipes si gjuhë shkrimi.

Ortografia si edhe mënyra e të shkruarit të gjuhës shqipe të kësaj kohe nuk kanë karakter regjional porse janë të përgjithshme. Shënimi i kuantitetit të gjatë të vokaleve me zanore dyfishe, siç ishte zakon në shkrimet e autorëve gegë të Veriut si edhe të shkrimtarët arbëreshë të Italisë Jugore, nuk mund të njihet si koinçidencë gand e rastit, mandej shenja grafike për *sh* e shqipes dëshmon për një traditë të përbashkët në shkrimet e shkrimtarëve të Veriut dhe të atyre të Jugut shqiptar para

shpërnguljes shqiptare në Italinë Jugore. Edhe ekzistimi dhe veprimtaria e gjallë e disa urdhërave, fetare, benediktinë, domenikanë dhe françeskanë flasin në dobi të shkrimit të shqipes në periodën paraturke.

Në shekujt e pastajmë gjuha shqipe vazhdoi të shkruhet, por ajo kishte karakter regjional, dialektor, bie fjala, në qendrat tregtare dhe qytetare të Elbasanit, Beratit etj., në shkëmbimin në mes të tyre tregtarët e shtinin në punë shqipen e atyre krahinave; në lëvizjen e përmendur letrare u shquan Todri dhe Anonimi i Elbasanit. Këta të dy u dalluan në punën e pasurimit të gjuhës që e shkruanin, duke farkuar fjalë të reja, porse neologjizmat e tyre, në shumicën dërmuese nuk hyjnë në fjalorin e shqipes.

Kjo lloj letërsie shkruhej me alfabetin grek të stilizuar. Me alfabetin grek, ndër të tjera, u shkrua edhe “Bibla” e Grigor Gjirokastritit (1824).

Në dyzetvjetëshin e shekullit XIX ndër shqiptarët zunë të bëhen ndryshime të mëdha në fushën e marrëdhënieve ekonomike. Tregtia po rritej vazhdimisht; vëllimi i saj sa vinte e më shumë po shtoej. Si pasojë e këtyre tërnimeve ekonomike e tregtare shtrohen me të madhe kërkesat e shqiptarëve para pushtuesit: ngrihet ndërgjegjja e popullit shqiptar, që shkon duke u zhvilluar e forcuar gjithnjë e më shumë e që pasqyrohet në ngjarjet e përparshme politike të shekullit: kryengritjet e armatosura popullore të Tanzimatit, mbledhja e Lidhjes së Prizrenit, themelimi i shoqërisë së Stambollit etj.

Shprehësit më të mirë të këtyre lëvizjeve shoqërore politike ishin mu organizuesit e tyre që me dashuri e vetëmohim iu përveshën punës për t’i treguar popullit shqiptar rrugën e lirisë dhe të përparimit. Në këtë punë një vend të shquar zunë shkrimtarët e patriotët si Naum Veqilharxhi, Konstandin Kristoforidhi, Naim e Sami Frashëri, Jani Vretua, Vasë Pashë Shkodrani etj. Ata zhvillojnë veprimtari kulturele për të gjithë shqiptarët, shkruajnë në gjuhën e tyre amtare. Këta e të tjerë intelektualë shqiptarë luftojnë me pendë e me fjalë për përhapjen e shkrimit shqip.

Në këtë aktivitet të shqiptarëve gjuha shkon gjithnjë duke u afirmuar si gjuhë shkrimi me tendenca gjithnjë të forta afirmimi.

Letërsia shqipe bashkë me gazetarinë marrin hov të gjallë nga mbarimi i shekullit XIX. Pengesë e madhe në këtë punë, në punën e përhapjes së shkrimit aso kohe paraqitej mungesa e një alfabeti të përbashkët. Pos alfabetit, që shkruhej në punë në shkrimet e shkrimtarëve veriorë (ai i Buzukut me pasuesit e tij) u sajuan edhe alfabete të tjera që kishin në bazë alfabetin latin, ato të gegërishtes, ndërsa në përkthimet toskërisht përdorte alfabetin grek.

Në lidhje me gjuhën e shkrimit, rilindasit i kishin shtruar vetes detyra të dyfishta: në lëvrimin e saj përpiqeshin ta pasurojnë sa më shpejt e sa më mirë, e në anën tjetër u vriste sytë fakti që gjuha jonë e shkrimit aso kohe na dilte e trazuar me fjalë të huaja, sidomos me turqizma. Në punën e harrjes së gjuhës që ata përdorin, dalloheshin: Naum Veqilharxhi, Kristoforidhi, Naim Frashëri, që pa kurrfarë ngurrimi flakën pothuaj të gjitha ato fjalë që ata i shihnin të huaja e që pas mendimit të tyre e shëmtonin gjuhën e shkrimit. Këtë qëndrim ndaj pastërtisë së gjuhës nuk e mbanin bejtëxhitë që i lejonin vetes të përdornin jo veç atë fond fjalësh me burim oriental, por edhe nga ato që nuk gjenin në ligjërimet popullore. Përkundrazi tyre, siç theksuam më parë, Rilindasit, sidomos Kristoforidhi, studiues i zoti i shqipes, krijuan një mori fjalësh, vetëm Kristoforidhi nja pesëqind, sipas gjedhës së shqipes. Këtë rrugë e ndoqën, duke korrur sukses Naimi, Samiu, Konica e shumë të tjerë. Nga koha e Rilindjes na mbetën e hynë në gjuhë të shkrimit edhe këto fjalë: *abetare, atdhe, letërsi, gjithësi, hapësirë, mjekësi, ligjëratë, fatbardhësi, mosqenie, qytetëri, qytetyrim, ndërgjegje, shtypshkronjë, udhëheqës*, fjalë të krijuara të shumtën nga Kristoforidhi.

Ajo që ka peshë të madhe në çështjen e gjuhës së kësaj kohe është puna se si duket ajo në këtë periodë të Rilindjes, çfarë synimesh na dalin në njësimin e saj. Në këto kohë shqipja na del e shkruar në dy dialektet e saj, në toskërishte dhe gegërishte. Toskërishtja duket shumë më e njësi-shme se gegërishtja e shkruar. Mund të themi si gjuha e shkrimit shkon dita-ditës duke u afruar; ne vërejmë një tendencë të përgjithshme të shkrimtarët dhe intelektualët shqiptarë drejt afirmimit të gjuhës.

Naimi, Samiu e Veqilharxhi marrin e shtien shpesh fjalë të gegë-

rishtes, p.sh. *dashun, padije, i vet*, (Veqilharxhi), *emën i krishtenë, anemik* (Samiu); *mëni, venë, zotënisë* (Naimi), *e kallëzue me, të këputunë, për të patregueninë, e papame, përpara pamësit, papam, shef, njef* (Jani Vretua). Gegizma gjejmë edhe në fushën e morfologjisë të një lagje shkrimtarësh jugorë (Jani Vretua, Naim Frashëri etj.) *me punue, me ba; duhej me qenë i ndalë, me qenë si gjë pa shpirt, edhe mos me pasë as të mirë e të drejtë...; me ditun; s'po mundemi me thënë...; për mos me u mërguar puna që bie të mirë...; për me mundurë të bëjmë, ka me u dukurë; ka me dalë etj.* ("mirëvetija" Jani Vretua). E Naimi ka përdorur shpesh paskajoren perifrastike të gegërishtes: *hyji* për mos me prishurë, për të mos përpjekurë njëri me tjetrinë e për të mos *mbeturë* mb'udhë...;

Këto gegizma e shumë të tjera që i ndeshim në shkrimet e Jugorëve do të jenë marrë prej veprave të Kristoforidhit, të shkruara gegërisht, kryesisht nga përkthimet gegërishte.

Ato dëshmojnë për animin e shkrimtarëve toskë që në përdorjen e gjuhës së shkrimit të afrohen sa më shumë që të jetë e mundur. Kjo rrugë në përdorimin e gjuhës letrare, ky afrim i dialekteve, nuk shpinte nga njësimi i gjuhës së shkrimit.

Po të marrim në peshim rolin e Kristoforidhit që ai luajti në punën e stabilizimit e të njësimin të gjuhës sonë të shkrimit, do të shohim që ai në këtë punë ndoqi një rrugë që ndryshon nga ajo e të tjerëve. Siç dihet, Kristoforidhi mori rrugën e afrimit: dialektet tona të shkrimit, toskërishten e gegërishten, ai mendonte t'i pajtonte duke përdorur për gegërishten ortografinë konvencionale, në të cilën parimi fonetik gërshetohej me parimin historiko-etimologjik, ashtu që gjuha e tij e përdorur në përkthimet gege na doli shumë e afërt me gegërishten e Budit e të Bogdanit. Kjo rrugë shpuri në afrimin e gegërishtes me toskërishten që përndryshe, po të zbatohet parimi fonetik i tyre ato do të na dilnin të larguara me ndryshime, sidomos fonetike. Duke i imituar shkrimtarët e vjetër të Veriut, në shkrimet e tij gegërishte ai i përdor të plota diftongjet *-ue*, *-ie*, *-ye*; të plota na dalin në shkrimet gegërisht të Kristoforidhit – *mb*, *nd*, *ng*, *ngj*, *ë*-ja e reduktuar e neutrale, prandaj nga Kristoforidhi gjithherë edhe në

përkthimet gegërisht atje ku e ka vendin. Edhe gjatësinë e zanoreve Kristoforidhi e dallonte me shenja të veçanta grafike; ndërsa shkrimtarët e vjetër gegë të Veriut, zanoret e gjata i shënonin me zanore dyfishë. Kristoforidhi zbatoi praktikën e albanologëve, duke shtënë në punë vizat përkatëse përsipër zanoreve.

Gegërishtja e Kristoforidhit ushtroi ndikim të madh mbi një varg shkrimtarësh gegë të pastajmë, nga ajo mësuam shumë edhe vëllezërit Frashëri në përpjekjen e tyre për stabilizimin dhe njësimin e toskërishtes së shkruar; fatkeqësisht gegërishtja e përpunuar e Kristoforidhit nuk pat ndikim në shkodranishten, që vazhdonte traditën e shkrimtarëve të vjetër, gegë të Veriut, me ndryshim të karakterit të saj të ngushtë krahinor e që në bazë kishte të folmen popullore të Gropës së Shkodrës, ajo pra na dilte gjuhë me karakter të thjeshtë krahinor, e mbytur me fjalë të huaja, sidomos me turqizma, e kjo praktikë e shkrimtarëve katolikë shkodranë nuk pajtonte me prirjen e përgjithshme të lëvizjes patriotike të Rilindjes as në punën e bashkimit të forcave kundër pushtuesit të huaj, ashtu edhe në fushën e përpjekjeve për njësimin e gjuhës së shkruar të shqipes.

Po ta shikojmë fill zhvillimin dhe rrugën e toskërishtes së shkruar, do të na bjerë në sy fakti që ajo ndoqi ravën e afrimit të dialekteve toske dhe të njësimin të vazhdueshëm të toskërishtes letrare. Në shtjellimin më të imtë të kësaj pike do të shohim dy drejtime që kishin kapur shkrimtarët dhe patriotët shqiptarë: në një anë një lagje poetësh të quajtur bejtexhi, si Muhamet Çami, Dalim Frashëri, Hasan Zyko Kamberi, shkruajnë mbi baza ndërdialektore dhe me një fond fjalësh të marra nga turqishtja dhe prej gjuhëve të tjera orientale; pala tjetër e shkrimtarëve, të nisur nga baza mbidialektore, në rrjedhën e kohës shkojnë duke e përgjithësuar ligjërimin e tyre krahinor dhe ia dalin në krye ta bëjnë të kuptueshëm për krahina më të hapëta dhe për shtresa më të gjera të popullit në të cilin varg radhiten një plejadë shkrimtarësh dhe patriotësh shqiptarë, ndër të cilët shquhen K. Kristoforidhi, Sami e Naim Frashëri dhe Jani Vretua nga jugorët. Arbëreshët e Italisë jugore që zhvilluan një aktivitet të madh kultural e letrar që nga koha e shekullit XVI, duke nisur nga arbëreshi siqeljan

Matranga, - aktivitet që u dha dorë me të madhe përpjekjeve e luftës së shqiptarëve për pavarësi e ngritje kulturele, - në planin e njësimin të gjuhës letrare të shqipes nuk arritën ta japin ndihmën që pritej prej tyre.

Duke marrë për bazë ligjërimet arbëreshe me elemente shumë të vjetra gjuhësore, gjuha e tyre nuk ia doli në krye të imponohej si letrariste e gjithë shqiptarëve. Karakteri i saj tepër arkaik nuk lejonte kurrsesi që ajo të bëhej urë bashkimi e njësimi e të gjitha dialekteve që asokohe shërbenin si idioma letrare të shqiptarëve.

Kriteri i bashkimit të dy dialekteve letrare të shqipes mbetet parimi kryesor i shkrimtarëve dhe i lavruesve të gjuhës në punën e përpjekjeve të tyre rreth afrimit dhe njësimin të shqipes letrare.

Pas 1912-s, në periudhën e pavarësisë së shtetit shqiptar, përpjekjet për afrimin e gjuhës letrare marrin formë më konkrete: më 1917 ngrihet një komision që mblidhet në Shkodër (Komisia letrare), me qëllim që t'i shtrojë disa çështje nga fusha gjuhësore e shqipes dhe drejtshkrimi i saj, me ç'rasë mori disa vendime në lidhje me normat e shkrimit të gjuhës shqipe. Komisia letrare u pajtua dhe e tumiri mendimin e kahershëm që në bazë të gjuhës së shkruar shqipe të merret dialekti i Shqipërisë së Mesme; e ky qëndrim respektohej si i vetmi parim në punën e çështjes së gjuhës letrare shqipe.

Kontribut të zbatimit e parimit të zënë ngoje solli filologu dhe pedagogu Aleksandër Xhuvani që për më se 50 vjet veprimtarie në fushën e arsimit dhe në lëmin e kulturës përgjithësisht u shqua në radhët e para për stabilizimin, normimin dhe njësimin e gjuhës sonë letrare.

Koha e pavarësisë së shtetit shqiptar, përse i përket stabilizimit të normave gjuhësore dhe njësimin të gjuhës së shkruar të shqipes, karakterizohej nga orvatja sporadike e individuale e ndonjë filologu dhe mungesa e një pune të organizuar kolektive të një lagueje specialistësh, që t'i hetonin problemet gjuhësore të shqipes dhe t'i përudhnin e t'i shpinin përpjekjet nga stabilizimi dhe kodifikimi i normave të gjuhës së shkruar të shqipes. Zgjidhja e problemit të gjuhës letrare shqipe vështirësohej me të madhe

dhe nga mungesa e studimeve të veçanta të çështjeve teorike të gjuhës sonë bashkë me të drejtshkrimin të saj. Gjithandaj do kërkuar dështimi i përpjekjeve të save që, në bazë të gjuhës sonë të shkrimit të vihet dialekti i gegërishtes jugore që favorizohej nga pushteti i atëhershëm i shtetit shqiptar.

Megjithëse orvatja e tyre për disa dekada në shkrimet e tyre u pëpoqën ta afirmojnë dialektin e mesëm gegë, nuk u realizua, ajo pati një të mirë shumë të dobishme pse ngjalli dëshirën e shkrimtarëve, sidomos gegë, t'i afrohen gjuhës së mesme e të mënjanojnë në shkrime shumë tipare krahinore të dialektit që e shkruanin, fjala vjen, një palë shkrimtarësh të brezit të pasluftës së parë botërore shkepen nga të shkruarit tradicional të Shkodrës, flakin shumë veçori krahinore të shkodranishtes, dhe në punën e shkrimit i aviten prirjes së njësimin të gjuhës letrare shqipe.

Pas luftës revolucioni popullor dhe zhvillimi ekonomikokultural çështjen e gjuhës së shkrimit e shtrojnë në plan të parë në RP të Shqipërisë. Në punën e njësimin të gjuhës letrare në bazë me toskërishten, elementet gege marrin pjesë me një palë tiparësh e veçorish të ligjërimeve gege.

Në bazë të gjuhës së shkrimit të shqiptarëve në Jugosllavi ka qenë gjithherë në pjesën më të madhe, dialekti i gegërishtes jugore, ishte ajo gjuha e mesme, siç quhej në emërtimin gjuhësor, dhe synimi i saj kryesor ishte afrimi i kryedialekteve letrare dhe njësimi i gjuhës së shkrimit të shqipes. Edhe kuvendimet e specialistëve dhe të dashamirëve të gjuhës sa herë që u mbledhën në Prishtinë kishin për qëllim të afrojnë variantet letrare të gjuhës sonë të shkrimit.

Secila mbledhje që shtronte çështjet gjuhësore të letrarishtes sonë, shënonte hapa gjithnjë më të mëdhenj në drejtim të njësimin të gjuhës sonë të shkrimit.

Njësimi i drejtshkrimit në stadin e sotëm, paraqet, pas mendimit tonë, hapin vendimtar në punën e afrimit të varianteve letrare të gjuhës sonë të shkrimit.

Parimi kryesor në të cilin mbështetet drejtshkrimi i shqipes sonë letrare është parimi fonetik, prandaj ortografia e letrarishtes sonë do të

bazohet në shqiptimin më të përgjithshëm. Por gjuha jonë synon edhe një objektiv tjetër, që në shkrim të ruhet njësia e formave të pjesëve gramatikore të gjuhës sonë, të ruhen të paprekura morfemat e gjuhës sonë, d.m.th. të ruhen në shkrim struktura dhe njësia e trajtave, si dhe struktura e formimit të fjalëve, kjo është rruga që ka ndjekur zhvillimi i gjuhës sonë letrare.

Vepra 2, Prishtinë, 1998

ÇËSHTJE TË GJUHËS LETRARE SHQIPE

Në Konsultën e gjuhëtarëve dhe përfaqësuesve të shtypit, të publicistikës, të shkollës dhe të institucioneve shkencore e kulturore, të mbajtur në prill të vitit 1968 në Prishtinë, duke pasur parasysh karakterin konvergjent të dialekteve letrare të gjuhës shqipe, *u vendos*, plotësisht në mënyrë të pavarur, që si gjuhë letrare e shqiptarëve në Jugosllavi të jetë gjuha e sotme letrare shqipe. Kështu, më në fund, morën fund përpjekjet më se njëqindvjeçare të zelltarëve të vyeshëm, të punonjësve të kulturës dhe të ekspertëve për krijimin e gjuhës letrare, e cila do të lehtësojë shfrytëzimin e krijimtarisë letrare dhe arritjet e tjera në të gjitha fushat e jetës shoqërore të një populli, i cili flet një gjuhë të vetme. Në normën letrare të gjuhës sonë janë gërshetuar elemente të të gjitha të folmeve të gjuhës shqipe – pikërisht ashtu siç kishte porositur dhe vetë vepruar në realizimin e parimeve konvergjente të varianteve letrare të kësaj gjuhe “Vuku shqiptar” – Kristoforidhi.

Këtë gjuhë të sotme letrare – në mënyrë plebishitare e pranoi dhe e përvetësoi e tërë kombësia shqiptare në Jugosllavi, dhe ajo me dashuri e mëson dhe e kultivon atë si mjet të pazëvendësueshëm në emancipimin kulturor dhe në afirmimin e të gjitha vlerave të saja materiale e shpirtërore. Mu për këtë ajo me neveritje priti shkrimin e botuar në “Večernje novosti” të 1 e 2 korrikut i cili fyen tërë kombësinë dhe atë që është e shenjtë për çdo popull – gjuhën, të cilën shkruesi i këtij artikulli e quana “lojë”.

Në serinë e shkrimeve që sjell gazeta “Borba” e 5 korrikut të vitit 1981, shoku Sinan Hasani, nënkryetar i Kuvendit Federativ, duke shkruar për nacionalizmin në kulturën e shqiptarëve të Kosovës, preku edhe çështjen e formimit të gjuhës letrare shqipe, me të cilën shërbehen të gjithë shqiptarët në Jugosllavi. Shoku Sinan Hasani pas 13 vjetësh nga Konsulta

Gjuhësore e Prishtinës (1968), në të cilën e tërë inteligjencia humaniste dhe ajo teknike mori vendim për futjen e kësaj gjuhe letrare që është në përdorim sot, mori e foli duke shprehur keqardhje pse ka ndodhur kështu. Shkruesit e të dy shkrimeve rreth formimit të gjuhës letrare shqipe kanë treguar njohuri tejet të kufizuara lidhur me formimin a rrugën që ka kaluar gjuha e shkruar shqipe – i pari edhe shpirtligësi me këtë rast. Do të përpiqemi të integrojmë atë ç’është e përbashkët në këto shkrime, dhe të japim përgjigjen e duhur. Që të dy shkruesit nga mosdija totale gjuhën letrare shqipe e quajnë “toskërishte” (“toskanski” apo “toskajski”); sa i përket termit, i drejtë është vetëm emërtimi “toskijski”, ashtu si e përdor shpeshherë drejt edhe autori i shkrimit në “Večernje novosti”. Termi “toskanski” i përgjigjet emërtimit të së folmes së italianëve në Toskanë – në atdheun e Dante Aligerit. Mirëpo, me këtë nuk përfunduar, ngase thelbi i çështjes ende ka mbetur i pashpjeguar.

Gjuha e sotme letrare shqipe nuk është toskërishte, ajo pasqyron sintezën, në bazën e së cilës u ndërtuan elementet dialektore si të variantit letrar toskë ashtu edhe të atij gegë. Në strukturën e saj janë integruar mjaft veçori dialektore të të dy të folmeve letrare të sistemit të gjuhës shqipe. Sipas disa përlllogaritjeve raporti i këtyre elementeve dialektore të ndërthurura në strukturën letrare është 13 me 8, apo 13 elemente janë toske, ndërsa 8 elemente të variantit letrar gegë. Sipas kësaj, struktura e gjuhës së sotme letrare shqipe nuk është bashkim mekanik i varianteve letrare, por është sintezë e re organike e elementeve të gjuhës shqipe të krijuar në një rrugë historike. Në themelin e sistemit të saj gjenden elemente të gjuhës shqipe që i ndeshim në të dy variantet letrare.

Krejtësisht është normale që shtypi jugosllav e ka intensifikuar informimin e masave të gjera lidhur me përpjekjet për kundërrevolucion të një pjese të studentëve dhe pak punëtorëve në Prishtinë e në disa komuna të Kosovës me orientim armiqësor e irredentist në mënyrë që të ndihmojë zbulimin e armiqve dhe në këtë mënyrë të ndihmojë tejkalimin e situatës vërtetë të rëndë.

Kësaj, padyshim, i kontribuon edhe autori i shkrimeve serike të

botuara në “Večernje novosti”. Ky autor në shkrimin e botuar me 1 korrik 1981 përpiket t’i informojë lexuesit e kësaj gazete, përveç tjerash, edhe për zhvillimin e gjuhës letrare shqipe, dhe për mënyrën si u ngrit ajo në gjuhë letrare të shqiptarëve në Jugosllavi. Në këtë mënyrë, ai ka dëshmuar injorancë të përsosur sa i përket formimit dhe zhvillimit të kësaj gjuhe, por edhe shpirtligësi dhe dashakeqje, e mësuesit të tij do t’i vinte turp për “dijën” e nxënësit të vet. Megjithëkëtë, ai në këtë materie jashtëzakonisht të vështirë të historisë së gjuhës shqipe sillet si sovran, thuase i ka kaluar edhe njohësit më të mirë të linguistikës shqiptare. Duket naiv, sidomos kur shpreh keqardhje për humbjen e nazaleve. Kjo mund t’u ndodhë vetëm atyre që duke hyrë në fushën e një shkence krejtësisht të panjohur çdo term e çdo gjykim i duken gabim. Specialistët e gjuhës, natyrisht, nuk e kanë të qartë për çfarë nazalesh është fjala, për hundorësinë e zanoreve apo për bashkëtingëlloret. Autori në fjalë pohon se bashkëtingëllorja *n* me dhunë është kthyer në *r*, dhe jep shembujt *venë* – *verë*. Natyrisht nga ky autor nuk mund të kërkojmë as rigorozitetin minimal shkencor. Duket qartë se fjala këtu nuk është për zanoret hundore, por për një dukuri krejtësisht tjetër fonetike në të folmet toske, dua të them për të ashtuquajturin rotacizëm, e kjo do të thotë se është fjala për zanoren e ndërmjetme, të hershme *n* që ka kaluar në *r*. Nëse këtij autori i vjen keq për humbjen e zanoreve hundore, për ç’gjë s’ka dyshim, atëherë është për habi pse nuk e vajton humbjen e znaoreve hundore në gjuhën e vet, një gjë e cila ka ndodhur padyshim, e për të qenë habia më e madhe këto zanore janë ruajtur në huazimet sllavojuge të gjuhës shqipe.

T’i përmbledhin mendimet kryesore që i kemi paraqitur në këtë vështrim të shkurtër.

1. Gjuha letrare e shqiptarëve në Jugosllavi nuk është kurrëfarë krijimi artificial, e aq më pak diçka e imponuar me forcë nga jashtë, siç dëshirojnë ta paraqesin formimin e saj disa të painformuar dhe qëllimkëqinj;

2. Ajo është rezultat i natyrshëm i përpjekjeve të më shumë se njëqind vjetëve që kanë bërë veprimtarët, punonjësit e ekspertët e kulturës, të brendshëm e të jashtëm, qëllimi kryesor i të cilëve ishte

karakteri konvergjent i elementeve gjuhësore të varianteve letrare të gjuhës shqipe;

3. Kontributi i gjuhëtarëve dhe i një numri të madh të punonjësve të kulturës nga radhët e shqiptarëve që jetojnë në Jugosllavi është i madh në formimin e kësaj gjuhe, gjë që shihet edhe nga numri i madh i konsultave gjuhësore profesionale të specialistëve e të punonjësve të kulturës duke filluar nga viti 1952, pastaj 1957, 1963 e deri te viti 1968, kur në mënyrë plotësisht të pavarur e plebishitare është vendosur që gjuha letrare e shqiptarëve në Jugosllavi të jetë gjuha e sotme në përdorim;

4. Nëse është kështu, e kështu është padyshim, atëherë është për t'u dënuar çdo përpjekje që bëhet për t'u vënë në dyshim formimi dhe mënyra e pranimit dhe e përvetësimit të kësaj gjuhe: prandaj nëse dikush nga punonjësit publikë të vendit ose ndonjë krijues me fajin e vet nuk është inkuadruar në përpjekjet për formimin dhe krijimin e saj, është e pakuptueshme që pas 13 vjetësh ta kontestojë atë dhe të shprehë kështu edhe skepticizëm në rregullësinë dhe përligjen;

5. Gjuha letrare mësohet deri në fund të jetës; ka vise të tëra në Jugosllavi, e folmja e të cilave ruan tipare arkaike ose që në ndikimin e gjuhëve fqinje aq shumë u është nënshtruar ndryshimeve, sa që përvetësimi i gjuhës letrare paraqet mundim të madh; veçanërisht është e vështirë sintaksa e serbishtes, a kroatishtes letrare; e ç'mund të thuhet për sistemin e saj prozodik; nëse nuk nxihet së pari në gjirin familjar vështirë mund të vërtetësohet gjatë gjithë jetës.

Jam thellësisht i bindur se gjuha letrare shqipe nuk hyn në ato gjuhë indoevropiane, zotërimi i të cilave paraqet vështirësi të caktuara. Kam pasur rast që për këtë të bindem nga disa të huaj, të cilët gjuhën letrare shqipe e kanë përvetësuar në mënyrë të përsosur, e sipas pohimeve të tyre shqipja nuk është aspak gjuhë e vështirë për t'u nxënë.

TOSKËRISHTJA DHE BAZA DIALEKTORE E SHQIPES LETRARE

I

Në 75-vjetorin nga lindja e Andokri Kostallarit - njërit nga veprimtarët më të zellshëm e të merituar në punë të zgjidhjes së gjuhës letrare shqipe, organizatorë të Kongresit të Drejtshkrimimit të 1972; i grishur të marrin pjesë në një botim që i kushtohet kësaj figure të shënuar në historinë e re të kulturës - në veçanti në gjuhësinë shqiptare, duam me kënaqësi me nja dy fjalë bashkërisht ta kujtojmë këtë burrë të njohur në kulturën dhe shkencën shqiptare.

Që nga vitet e pesëdhjeta, Androkli Kostallari hyn në radhën e filologëve të rinj, që po merrnin barrën e rëndë, po të shenjtë të organizimit e të krijimit të institucioneve kulturore e shkencore - bërthama të ardhshme të Universitetit dhe të institucioneve shkencore. Në sajë të talentit dhe të aftësive organizative, Androkliut i besohen detyra në udhëheqjen e Institutit Histori-Filologji në krye të të cilit do të qëndrojë me dekada. Ky institut e merr shpejt veten dhe pas një kohe relativisht të shkurtër arriti të bëjë projekte me rëndësi kombëtare, sikur janë: projekti për regjistrimin, grumbullimin dhe vjeljen e lëndës dialektore në gjithë territorin brenda shtetit dhe jashtë tij; projekti i studimeve arkeologjike, të cilat në kohë të regjimeve të mëparshme i bënin të huajt; me organizimin e ekspeditave kërkohet të zbulohen dëshmitë lëndore të kulturës së hershme ilire, shqiptare. Në sajë të punës paraprake me rëndësi të madhe për kulturën kombëtare, Instituti zuri shpejt të organizojë njërën pas tjetrës, konferenca albanologjike në shkallë kombëtare në të cilat merrnin pjesë me interesim të madh edhe specialistë dhe studiues të huaj - Tirana po bëhej qendra e studimeve albanologjike që në të kaluarën ishte jashtë - në Austri e në qendra të tjera të Evropës Perëndimore.

Interesimi i tij shkencor përqendrohet kryekrejt në dy degëzime albanologjike - do të thoshim në dy fronte shkencore: në studimin e gjuhës letrare, në një anë dhe në anë tjetër, ai gjurmon mënyrat më produktive dhe më aktive të pasurimit të leksikut të shqipes së folur e të shkruar dhe të zhvillimit të sistemit të saj fjalëformues e gramatikor; për të qenë më të përpiktë, ai gjuan me përgjegjësi të ndërgjegjshme studimin e formanteve të kompozimit të fjalëve në shqipen - të lënë anash nga studiuues albanologë.

Gjuha letrare shqipe ishte tema më e preferueshmja e Androkli Kostallarit; asaj ia kushtoi një jetë të tërë njeriu - shkencëtari. Tok me bashkëpunëtorët e tij, pas përgatitjeve të domosdoshme paraprake, Kostallari arriti të organizojë Kongresin e Drejtshkrimit (1972), që trajtoi gjuhën letrare shqipe dhe problemet themelore të drejtshkrimit të saj.

Nën udhëheqjen e vazhdueshme e të drejtpërdrejtë të Androkli Kostallarit fill pas Kongresit të Drejtshkrimit e për të lehtësuar përqafimin e normës së gjuhës letrare dhe për ta zotëruar atë drejt e sa më shpejt, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë i Akademisë së Shkencave zuri të hartojë e të botojë një lloj literature plotësuese. Drejtshkrimi i gjuhës shqipe (Tiranë, 1973 - Prishtinë, 1974); Fjalori Drejtshkrimor, Tiranë, 1976; Gjuha letrare shqipe për të gjithë, Tiranë, 1976; Fjalori i gjuhës së sotme shqipe (1980); Fjalori i shqipes së sotme (1984); Fonetika e gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe. Do të vihet në dukje edhe fakti që kontribut të mirë në përvetësimin dhe zbatimin e normës letrare shqipe, në një anë, dhe në studimin e mëtejshëm, në anë tjetër, kanë sjellë dy simpoziumet shkencore për problemet e kulturës së gjuhës, të mbajtura në Prishtinë e Tiranë (1980, 1984), që pandehen aksionet më të mëdha të gjuhësisë normative pas Kongresit të Drejtshkrimit (1972).

II

Pas përmbysjes së sistemit monist në shoqërinë shqiptare të Shqipërisë u bënë ndryshime të mëdha nga të konteksteve shoqërore e shtetërore.

Disa zëra të mbytur që po dëgjoheshin edhe para atyre ndryshimeve në jetën shoqërore të shtetit të mëparshëm shqiptar, vitet e fundit kanë zënë të tingëllojnë më shpesh dhe të shprehin pakënaqësinë e tyre ndaj zgjidhjes së çështjes së përbashkët letrare shqipe. Kontestohen vendimet e Kongresit të Drejtshkrimit, gjuha letrare e sanksionuar nga Kongresi, sepse në bazë të saj vihej dialekti letrar toskë. Ajo lagje intelektualësh shqiptarë, e rekrutuar në gjirin e një pale albanistësh të një qendre veriake të shtetit - e ndezur edhe nga përkrahja së jashtmi, do të ngrejë fushatë kundër gjuhës së sotme letrare; të bëjë rishikime, bile rrënjësore duke kërkuar të krijohet edhe një gjuhë tjetër letrare shqipe; të shembë ndërtesën e gjuhës sonë letrare në ngritjen e së cilës më se 4 a 5 breza veprimtarësh specialistë e patriotësh me ndjenja e mendimet të çiltëra.

Disa thonë se “po kalojmë, po përjetojmë një krizë në zbatimin e normës së gjuhës letrare, e që është në lidhje shkakore me krizën shpirtërore dhe morale, në të cilën, si edhe shoqëritë e tjera paskomuniste, jemi gjetur edhe ne pas përmbysjes së sistemit totalitar. Pas përmbysjes së sistemit komunist një numër i gjuhëtarëve, i shkrimtarëve dhe i intelektualëve tanë kanë filluar jo vetëm ta kritikojnë por edhe ta mohojnë plotësisht planifikimin e përparshëm gjuhësore, e kjo domethënë gjuhën e njësuar letrare” (Qosja).

Në vijim duam të marrim në vështrim mendimet dhe pikëpamjet e dy intelektualëve shqiptarë rreth çështjes së gjuhës së përbashkët letrare shqipe: si e gjykojnë ata zgjidhjen e gjuhës letrare shqipe; si e shohin ata fushatën e ngritur kundër shqipes letrare (Bahri Beci, *Filologji*, 1997/3; *Rexhep Qosja*, *Gjurmime albanologjike*, *Seria e shkencave filologjike*, 26-96 (1997)).

Beci: “Ne, duke u pajtuar me zgjidhjen, nuk pajtohemi kurrsesi me manipulimet e bëra lidhur me shpjegimin e kushteve e të rrethanave që çuan në këtë zgjidhje dhe me vlerësimet e përmbajtjes së saj. Për Shqipërinë themelore ishte të pranohej gjuha letrare kombëtare pavarësisht nga baza dialektore e saj dhe kjo është arsyeja që atë e përshëndetën të gjitha forcat kombëtare”, f. 53.

Sikur edhe të gjitha mendimet e shfaqura nga Prof. Beci, lidhur me shpjegimet e bëra prej A. Kostallarit për bazën dialektore të gjuhës letrare shqipe, të ishin të drejta e të sakta, megjithatë dialektet toske, duke arritur të krijonin një koine letrare toske, një toskërishte të përbashkët letrare, ato paraqesin një epërsi ndaj gegërishtes dialektet e së cilës nuk ia kishin dalë të sosnin në një koinë letrare gege, në një letrarishte mbarë gege. Ç'është e drejta, ekzistonte një gegërishte e mesme letrare, në të cilën nuk merrte pjesë shkoderanishtja; një gegërishte e shkruar në vete.

Nga pikëpamja thjesht gjuhësore s'ka dialekt të një gjuhe që mos mund të merret e të vihet në bazë të gjuhës letrare, të gjuhës së shkrimit të një populli; porse ai dialekt që mendohet se i plotëson kërkesat e duhura format në fonetikë e morfologji do t'i ketë sa më të drejta e të përgjithësuara; të gëzojë një lloj privilegji a epërsie ndaj të tjerave të asaj gjuhe. Sa më i madh që të jetë prestigji i tij mbi të folmet e tjera, aq më lehtë do të mbështetet e të pranohet ai që të vihet në bazë të gjuhës së përtardhur letrare.

Një e folme e tillë ndër toskët është ligjërimi i Permetit me rrethin e tij; ajo e folme toske - do të thoshim, është një toskërishte që i afrohet gjuhës letrare shqipe për mrekulli, bile, me trajta fonetike dhe morfologjike më të drejta e të sajta se ç'është gjuha e vëllezërve Naim e Sami Frashëri; mjafton t'i hidhet një sy prozës, siç del te botimi i nohur Manuel de la langue chkip ou albanaise, Paris, 1879 i Auguste Dozonit. Po të kishte pasur gegërishtja një dialekt të tillë të pastër e të pasur, do t'i konkuronte toskërishtes dhe shumëkush në Kongresin e Drejtshkrimit të 1972-ës, do të lëkundej për toskërishten apo gegërishten - po të përjashtohej, natyrisht faktori jashtëgjuhësor, faktori shoqëror a politik.

Është ky faktori ndër vendimtarët në punën e zgjidhjes së gjuhës letrare. Në Konsultën e Prishtinës (1968) faktori jashtëgjuhësor, faktorit politik i mëshohej shumë më tepër, ai gjeti numrin më të madh të ithtarëve - edhe me arsye: veprimtarët e kulturës shqiptare: gjuhëtarë, punonjës të tjerë të arsimit e të kulturës së përgjithshme, në punë të gjuhës gjetën një truall më të lirë ku më me lehtësi shihnin hapësirë e fushë të lirë veprimi,

pak a shumë të pavarur, në një anë, dhe në anë tjetër krijimi i gjuhës së përbashkët letrare do të shënonte një fitore jashtëzakonisht të madhe, do të thoshte, se shqiptarët po shtinin në dorë mjetin kryesor në fushë të bashkimit shpirtëror me mundësi komunikimi më gjithë botën shqiptare.

Prof. Beci pa fije nevoje ngulmon të zbulojë qëllimet e këqija, të fshehta të A. Kostallarit dhe të pasuese të tij duke e akuzuar atë për manipulimet e bëra lidhur me shpjegimin e kushteve e rrethanave që çuan në zgjidhjen kësisoj të gjuhës letrare “duke e politizuar çështjen e zgjidhjes së gjuhës letrare dhe duke marrë edhe bekimin zyrtar që praktikisht u absolutizua deri në atë shkallë sa që çdo shpjegim tjetër vlerësohej si anti-kombëtar”, f. 53.

Prof. Beci e di fort mirë se të folmet toske kishin arritur të afrohen në atë shkallë sa që kishin krijuar një koine të përbashkët; në kohën e Rilindjes kombëtare toskërishtja e shkruar kishte marrë e ishte shtrirë në përmasa të gjera duke e lënë gegërishten e shkruar shumë prapa; - mjafton të merret e të shikohet botimi “Mendimi politik e shoqëror i Rilindjes Kombëtare Shqiptare” (Përmbledhje artikujsh nga shtypi: vëll. I (1879-1908), II (1908-1910).

Raporti i të dy kryedialekteve të gjuhës shqipe, të përfaqësuara në këto dy vëllime, paraqitet 2/3 daj 1/3 (tosk. - geg.), prandaj edhe sikur përpjekjet për të krijuar gjuhën e përbashkët letrare të mos gëzonin mbështetjen e faktorit shoqëror-politik - e pashmangshme në ngritjen e një shoqërie e shteti modern, epërsia e toskërishtes letrare do të çonte me siguri të madhe në vënien e saj në bazë të gjuhës së njësuar letrare shqipe.

Prof. Qosja: “Ne nuk mund të themi se toskërishtja është marrë për themel të gjuhës së njësuar letrare për shkak se është dialekti që më së pakti dallon prej dialekteve të tjera! Toskërishtja dallon prej gegërishtes po aq sa gegërishtja prej toskërishtes, kurse prej shumicës së të folmeve të tjera të shqipes më shumë se gegërishtja”, f. 58.

Prof. Qosja vise-vise mendimet i veta i lë pezull e të pambaruara, si këtu sipër, bie fjala, ai kërkon që toskërishtja të merret e të shikohet sa

dallon ajo brenda të gjitha të folmeve toske e gege; këtu kemi të bëjmë me dy madhësi kundërshtare, të pakrahasueshme; toskërishtja, logjikisht e gjuhësisht mund të përqaset brenda arealit dialektor toskë, e jo kurrësi duke përfshirë aty arealin dialektor gegë. Dialekti toksë, siç thotë F. Konica (Albania I, 1897, Nr. 7) “i gjallë, i shkathtë, i lehtë dhe në një evolucion të vazhdueshëm” - toskërishtja e shkruar, pra, me një strukturë të qëndrueshme formash kishte përfunduar në një shkallë të atillë zhvillimi me shfaqje shkrimi, pothuajse unike, në një koine sui generis toske. Gegërishtet e shkruara nuk kishin mbërritur në shfaqjen e tyre të shkrimit me një afrim që do të bashkonte të gjitha të folmet gege.*

“Mund të thuhet, ndërkaq - vazhdon Qosja, se rrethanat politike dhe historike e kanë sjellë toskërishten në themel të gjuhës zyrtare e, pas-taj, edhe të gjuhës së njësuar letrare, por rrethanat politike dhe historike edhe gegërishten do të mund ta sillnin në themel të gjuhës së njësuar letrare. Sikur dikur diktatori komunist Envet Hoxha t’i përkiste trevës së gegërishtes për themel të gjuhës letrare do të ishte marrë gegërishtja”, f. 59.

Po, pse në kohën e sundimit të diktatorit Ahmet Zogu nuk u zgjidh gjuha letrare shqipe. Çështë e drejta, në kohën e tij favorizohej me të madhe gegërishtja - gjuha e mesme, por edhe në atë kohë në jetën publike, në publicistikë shkodrani shkruante shkodranisht, toska toskërisht.

“Zgjedhja e toskërishtes për themel të gjuhës së njësuar letrare është vendim para së gjithash politik, i marrë duke u pasur parasysh vullneti i klasës politike në pushtet”, f. 59. Nga sa shkruan Prof. Qosja del pa farë dyshimi, se paska ekzistuar vullneti i klasës politike që para se të merrej vendimi që në themel të gjuhës së njësuar letrare të vihet toskërishtja letrare.

E, pra, te Drejtshkrimi i gjuhës shqipe, Tiranë, 1973, f. 16, shkruan: „Me nismën e Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë të USHT, u mblodh në Tiranë prej 20 deri 25 nëntor 1972, Kongresi i Drejtshkrimit të gjuhës

* Prof. Qosja, porse është ihtar i paepur për një gjuhë të përbashkët letrare shqipe. Po të ishte e mundur teknikisht, ai Fjalorin e shqipes së sotme, do ta mbante vazhdimisht në xhep, që ta konsultonte në çdo çast, sikur Ernest Koliqi që nuk ndahej kurrë nga Fjalori i Bashkimit.

shqipe, ku u përfaqësuan gjerësisht forcat e shkencës, të arsimit dhe të kulturës shqiptare; forumi më i lartë i tij analizoi e diskutoi gjerësisht parimet themelore, çështjet e përgjithshme dhe shumë zgjidhje të veçanta të drejtshkrimit të shqipes, si edhe probleme të tjera teorike e praktike, që kanë të bëjnë me normën letrare në përgjithësi”, f. 16-17.

Për rolin dhe rëndësinë e madhe që në çështjen e zgjidhjes së gjuhës letrare luan faktori politik i një populli, me Prof. Qosjen kemi pajtim të plotë, megjithatë sikur kemi krijuar bindjen se ai në mes të dy faktorëve: zgjidhja e gjuhës së njësuar letrare shqipe është vepr e marrëveshjes së gjuhëtarëve, shkrimtarëve, mësuesve dhe përfaqësuesve të tjerë të viseve të ndryshme që kanë marrë pjesë në Kongresin e Drejtshkrimit të gjuhës shqipe më 1972 - apo fryt i marrëveshjes politike, Qosja është i prirur faktorit të dytë t'i lëshojë vendin e parë si vendimtar, duke i dhënë atij përparësitë e dukura. Toskërishten nuk e ngriti politika komuniste në të cilën mbizotëronin folësit e dialektit toskë. Epërsitë e saj ndaj gegërishtes së shkruar ishin rezultat i përpjekjeve të një lagjeje të tërë të elitës shkencore e kulturore shqiptare të nisura këtu e më se njëqind vjet më parë e që rezultuan në një bashkafrim të të dy kryedialekteve të shkruara.

Kur është fjala për rolin që luan pushteti në punë të zgjidhjes së gjuhëve letrare, duhet të vihet në dukje një gjë që aty nuk ka një vijë simetrike; në rastin kur pala shkencore e kulturore në luftën për krijimin e gjuhës letrare - siç tregon historia e formimeve të kombeve evropiane, ka ndodhur që kasta burokratike e ka mbështetur zgjidhjen e drejtë të gjuhës letrare - pasojisht, mendojmë se pozitive duhet të njihet edhe mbështetja e gjuhës së njësuar shqipe nga ana e klasës politike shqiptare. Kushdo që përkrah nismën dhe jetësimin e zgjidhjes së gjuhës së njësuar letrare shqipe do të quhet ndihmesë pozitive. Në historinë e popujbe të Ballkanit ka një rast të kundërt; e kam fjalën për nismën dhe luftën gjysmëshekullore të Vuk Karaxhiçit për krijimin e gjuhës letrare serbe, që shënoi një kthesë revolucionare në historinë kulturore të atij populli: këtu kemi një shembull tipik ku reforma e gjuhës dhe e kulturës nuk gjeti përkrahje në qarqet intelektuale, në rrethet klerikale dhe oborrin mbretëror.

Ka edhe një rrugë të tretë që është rrahur në krijimin e gjuhëve letrare: këtu bëhet fjalë për krijimin e gjuhës letrare italiane. Çështjes së zgjidhjes së gjuhës së përbashkët letrare italiane i vuri vulë autoriteti i shkrimtarëve të mëdhenj italianë të shekullit XIII-XIV: Dante Alighieri, Giovanni Boccaccio; i pari me *Divina commedia* (Komedia hyjnore), i dyti me *Decameronin* e famshëm. Dialekti i melodishëm, i ëmbël i Toskanës u tejbart në farkën e krijuesve të mëdhenj duke u bërë i përjetshëm kujtimi i tyre - trashëgim në thesarin e përbotshëm artistik. Megjithatë italianët donin që dialekti i ëmbël toskanez të përshkohet nëpër shqiptimin romak: **La lingua toscana in bocca romana!**

Vepra 2, Prishtinë, 1998

Idriz Ajeti
STUDIME PËR GJUHËN SHQIPE
Vepra të zgjedhura
2017

Botues
AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

Redaktor teknik:
ASHAK

Realizimi kompjuterik:
ASHAK

Madhësia: 50.5 tabakë shtypi
Tirazhi: 300 copë
Formati: 16x24 cm

Shtypi:
Focus Print
Shkup

Katalogimi në publikim - (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

811.18-26
811.18-112

Ajeti, Idriz

Studime për gjuhën shqipe: Vepra të zgjedhura/ Idriz Ajeti; zgjedhi dhe përgatiti akademik Rexhep Ismajli. - Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, 2017. – 804 f.: ilustr.; 24 cm. - (ASHAK: Botime të Veçanta; CLXI: Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë; Libri 57)

Titulli paralel në gjuhën shqipe dhe angleze

1. Ismajli, Rexhep

ISBN 978-9951-615-69-3